FAKULTETI I FILOLOGJISË – PRISHTINË
FACULTY OF PHILOLOGY – PRISTINA

FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI – TIRANË
FACULTY OF HISTORY-PHILOLOGY – TIRANA

SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE

INTERNATIONAL SEMINAR FOR ALBANIAN LANGUAGE, LITERATURE AND CULTURE

REVISTË SHKENCORE/ SCIENTIFIC JOURNAL

35

ISSN 2521-3687

PRISHTINË, 35/2017

Editor in Chief / Kryeredaktor: Rrahman Paçarizi

Editorial Board / Redaksia: Rrahman Paçarizi (Pristina/Prishtinë), Qibrije Demiri-Frangu (Pristina/ Prishtinë), Bardh Rugova (Pristina/ Prishtinë), Nysret Krasniqi (Pristina/Prishtinë), Milazim Krasniqi (Pristina/Prishtinë), Muhamet Hamiti (Pristina/Prishtinë), Anton Berishaj (Pristina/Prishtinë), Ag Apolloni (Pristina/Prishtinë), Isa Memishi (Pristina/Prishtinë), Shezai Rrokaj (Tirana/ Tiranë), Aljula Jubani (Tirana/Tiranë), Ymer Çiraku (TIrana/Tiranë), Dhurata Shehri (Tirana/Tiranë), Mimoza Kore (Tirana/Tiranë), Vjollca Osja (Tiana/Tiranë), Bardhyl Demiraj (Munchen/Munih), Maksimilijana Barančić (Zadar/Zarë), Aleksandar Novik (Saint Petersburg/ Shën Peterburg), Premysl Vins (Prague/Pragë), Emilia Conforti (Cosenza/KOzencë), Agron Tufa (Tiran/Tiranë), Anton Panchev (Sofia/Sofje), Giovanni Belluscio (/Cosenza/Kozencë), Giuseppina Turano (Venezia/Venedik).

https://filologjia.uni-pr.edu/Seminari.aspx
e-mail: seminari.filologjik@uni-pr.edu
ISSN 2521-3687

GJUHËSI / LINGUISTICS

Bardh RUGOVA

GABIMET GJUHËSORE

A ka gabime gjuhësore?

Për ta diskutuar këtë pyetje, do t'i marrim tri fjali të ndryshme, të cilat u janë dhënë për komentim folësve të ndryshëm të shqipes, kryesisht arsimtarë dhe mësues të shkollave fillore të Kosovës – pjesa më e madhe të programit AKM – jo doemos arsimtarë të shqipes.

1. Djali ka me shku n'shkollë.
2. /Djʌ:li kʌ me ʃku:e ən ʃkö:L/
3. Djali ia dha librin atyre.

Në perceptimin e zakonshëm, dy fjalitë e para konsiderohen të gabuara. 181 (90,5%) nga 200 të anketuarit e shtresave të ndryshme shoqërore kanë theksuar se shembulli i parë është gabim dhe 189 (94,5%) se shembulli i dytë është shumë gabim. Pyetjes se përse shembulli i parë është gabim, thuajse shumica i janë përgjigjur: "Nuk është pjesë e shqipes standarde". Pyetja (e hapur) se përse shembulli i dytë (variant audio) është gabim, ka pasur disa përgjigje të ndryshme: 32 kanë theksuar është i pashkollë; 29 - i paarsimuar; 16 - qesharak e kështu me radhë. Shembulli i tretë është konsideruar i drejtë nga 163 (81,5%) të anketuar. Një numër më i vogël (31 sish) e kanë konsideruar të gabuar, 6 nuk kanë dhënë përgjigje. Të pyetur se përse është i drejtë, 127 nga të anketuarit kanë theksuar se është i shqipes standarde.

Kjo anketë ka provuar se në perceptimin e zakonshëm në Kosovë një formë gjuhësore konsiderohet e saktë ose jo nëse është në përputhje me botëndijimin e të anketuarve për shqipen standarde.

Në të vërtetë, një gjuhëtar mund të vërejë se shembulli i parë dhe shembulli i dytë janë krejtësisht gramatikorë, brenda sistemit të tyre gjuhësor. Mirëpo, të dy rastet përbëjnë shembuj të gegërishtes, me përdorimin e futurit të domosdosë me foljen kam, me paskajore dhe me formën e pjesores së shkurtuar (shku), si dhe me grafi, në të cilën nuk është përfshirë shkronja ë te parafjala në. Në shembullin e dytë, ofrohet transkriptimi i një të folme të etiketuar si më pak prestigjioze brenda arealit të gegërishtes, duke e pasur përdorimin e tingullit /ö/ si variant i lirë i fonemës /o/. Shembulli i tretë, ndërkaq, në paraqitje është i shqipes standarde, por është

jogramatikor, për shkak se përdoret trajta e shkurtër *ia* në vend të trajtës *ua*, duke u përdorur kështu rimarrja e kundrinës njëjës (atij i), në vend të shumësit (atyre u).

Mirëpo, derisa e zbërthyem perceptimin e folësve, nuk zbuluam shumë nëse ndonjëri prej këtyre shembujve është i gabuar ose jo.

Në të vërtetë, trajtimi i pyetjes së fillimit (a ka gabime gjuhësore?) do përgjigje që zbërthehet në disa këndvështrime të ndryshme linguistike.

Këndvështrimi i parë, është ai që del natyrshëm si nevojë nga përgjigjet e dhëna nga të anketuarit: është këndvështrimi i sistemit, pra gramatikor.

Në këtë kuadër, do të bëjmë dallimin themelor në mes të nocioneve gabim dhe gramatikalitet. Një trajtë është jogramatikore, kur nuk është në përputhje me sistemin e vet. Po e zëmë, në gjuhë ka një mënyrë gramatikore për ta shënuar rimarrjen e kundrinës në shumës dhe njëjës dhe përdorimi i njërës në vend të tjetrës përbën formë jogramatikore. Përdorimet e tilla të gjuhës: *Djali erdhën të shtunën*, ose *Unë Tarzan, ti Xhejn* ose *Unë i mora librave* ose *E ka bir prej kepit* e kështu me radhë janë forma jogramatikore brenda gjuhës, për shkak se ekziston një formë gramatikore, e cila krijon kundërvënie kundrejt formave të tjera për të shprehur një kategori të caktuar gjuhësore.

Gramatikaliteti është ekzistimi i një forme gjuhësore që shërben për të përcaktuar një kategori gramatikore më vete, po e zëmë, nyja te emri djalë – djali, formantët e habitores: paska, a të dëshirores: këndofsh, format e gjinisë a të vetës e kështu me radhë.

Përdorimi (apo ususi) e përcakton gramatikalitetin në një gjuhë.

Gramatikalitet ka njësoj stili formal, ashtu edhe stili joformal.

/Me ʃku:e ən ʃkö:L/ është i gramatikalizuar po aq sa varianti standard: Për të shkuar në shkollë a Të shkosh në shkollë.

Geoffrey Pullum (2014) këtë e përkufizon me thënien: "Gramatikalitetin nuk mund ta ngatërrojmë me zgjedhjet e stilit formal, sepse edhe stili informal është njësoj gramatikor".

Mirëpo, as jogramatikaliteti nuk nënkupton gabim nga këndvështrimi i gjuhëtarit. Një formë jogramatikore, në kontekste të ndryshme, mund të triumfojë mbi forma të tjera. Sa për ilustrim, krijimi i rotacizmit nën nevojën për labërgim të kundërvënies n – nn në një periudhë të caktuar historike, sinkretizmi i gjinores dhe i dhanores, palatalizimi dhe metafonia, humbja e paskajores, e karakteristika të caktuara gramatikore të varianteve të ndryshme të shqipes, në periudha të ndryshme do të kenë qenë "jogramatikore" dhe shmangie nga "rregullat". Një gjuhëtar deskriptiv do t'i hetojë prirjet e caktuara gjuhësore dhe do t'i parashikojë dinamikat e zhvillimit të gjuhës. Prirjet e sotme për shkurtimin e pjesoreve, nevoja për përdorimin e paskajores

edhe në mesin e folësve toskë, situatat e zëvendësimit të përemrave të dhanores në kallëzore (Na ftoi neve, ose na dha ne), heqja e apostrofit te lidhja e trajtave të shkurtra m'i – mi, t'u – tu e kështu me radhë janë disa nga prirjet e zakonshme që duan hulumtuar.

Sa për ilustrim, e folmja e Pejës është karakterizuar me vendosjen e theksit në pozitën fundore të rrënjës, por me shkurtim njëmorësh në situatat e vendosjes së mbaresave (La· la). Një punim masteri i Drita Bardhajt i vitit të shkuar tregon se nën ndikimin e prurjeve demografike nga rrethinat e fshatrave të rrafshit të Pejës, kjo dukuri ka filluar të zbehet dhe të ketë situatë të theksimit dymoraik të rrokjes së rrënjës (La:la). Në asnjërin nga këto raste, nga këndvështrimi i studiuesit, nuk mund të flitet për gabim. Mund të flitet për trajta që gëzojnë prestigj më të lartë dhe të tjera që janë më inferiore, që kanë përdorim më të dendur ose më të rrallë.

Shembulli: *Ia dha librin atyre* nuk është në përputhje me sistemin gramatikor të parashkruar, por nëse dinamika gjuhësore shkon drejt neutralizimit të kundërvënies ia/ua, atëherë sa mund të quajmë gabim?

Qëndresa, kandidatja ime e nivelit master që po punonte për rimarrjen e kundrinës në gjuhën shqipe, erdhi një ditë tërë lot, duke thënë se në mediumet dhe në veprat letrare në Shqipëri kishte vërejtur më shumë raste të përdorimit të trajtës *ia* në vend të *ua*, se sa në Kosovë. E shkreta. Rezultati i hulumtimit i kishte dalë ndryshe nga ajo që e kishin mësuar (nga common sense i Kosovës) dhe që e kishte pritur dhe tash kishte drojë se komisioni nuk do ta kalonte. U qetësua, kur mësoi se nuk kishte qenë detyrë studimi të gjente kush bën më shumë gabime, por t'i analizonte dinamikat e zhvillimit të shqipes përmes trajtave të shkurtra.

Rasti i Qëndresës na ofron këndvështrimin themelor të trajtimit të "gabimit": këndvështrimin e gjuhësisë si objekt studimi.

Në këtë këndvështrimin e dytë, atë të studiuesit të gjuhës, të atij që kërkon të gjejë përgjigje për gjuhën, si mjet komunikimi mes njerëzve, nuk mund të ekzistojë nocioni "gabim". Studiues të gjuhës, siç është përkufizuar objekti i studimit të gjuhës që nga Sosyri ([1916] 1977), e hulumtojnë gjuhën si sistem, për ta përshkruar atë sistem. Mbi këtë parim, ekziston gjuha si përdorim dhe punë e studiuesit është që ta hetojë atë sistem, ta përshkruajë dhe ta parashikojë eventualisht dinamikën e zhvillimit të gjuhës.

Johnstone (2008:271) këtë e përkufizon kështu: "Studiueset e teksteve dhe të diskurseve, pavarësisht nga korpusi, shtrojnë pyetje të ndryshme në formë hipotezash varësisht nga objekti i tyre i studimit dhe si në çdo fushë tjetër të studimit, mbështeten në mjete teorike dhe mekanizma të ndryshëm metodologjikë për të provuar propozime të ndryshme që mund të shërbejnë si përgjigje të atyre pyetjeve".

Në gjuhësi (Sosyr [1916] 1977, Johnstone 2008, Rasinger 2013, Rugova, Sejdiu-Rugova 2015b, Rugova 2016), sikur edhe në çdo disiplinë tjetër studimore (Popper [1935] 2005, Pigliucci 2010, Reeves 2005), nevoja e përshkrimit (deskripcionit) mbetet magisterie e studiuesit të gjuhës. Kjo na sjell kundërvënien themelore mbi të cilën tundet fjala *gabim* – kundërvënia deskriptivizëm dhe preskriptivizëm. Përkufizimi i shkencës dhe prandaj i shkencës së gjuhësisë nuk e njeh preskripsionin. Megjithatë, historia e gjuhësisë shqiptare e disa dekadave rresht në epokë "preskriptive", pra të dogmës, ka qenë pikërisht histori preskripsioni. Ndryshe nga deskriptimi, preskriptimi është një tërësi rregullash të parashkruara, të cilave individët duhet t'u nënshtrohen, pavarësisht të vërtetës.

Shembulli i Galileut do të ishte i mjaftueshëm për ta përshkruar parashkrimin – "Eppur si muove" – 1642. Megjithatë, për ta ilustruar parashkrimin unë do ta përkujtoj Dhjatën e Vjetër dhe ndëshkimin për ata që dalin në punë të shtunave (në sabbath):

"Te libri i Numrave 15, bijtë e Izraelit e gjejnë një njeri në një vend të egër tek po mblidhte shkopinj në ditën e ndaluar. E arrestojnë dhe e pyesin zotin çfarë të bënin me të... Tërë grupi e çoi jashtë kampit dhe e vrau me gurë; dhe ai vdiq, ashtu si e kishte urdhëruar zoti Moisiun". (Dawkins [2006] 2014).

S'është me rëndësi a është e drejtë a jo. Libri thotë se burri i ngratë duhet vrarë me gurë meqë ka punuar në një ditë të ndaluar.

Zhizheku na sjell një tjetër shembull; atë të policëve të UDB-së jugosllave që i mbytnin dajak "armiqtë e popullit" që i kishin shkelur parimet marksiste. Natyrisht, asnjëri nga ata policë as nuk e dinte se cilat ishin ato rregulla, sepse asnjëri as nuk e kishte lexuar Marxin.

Parashkrimi është karakteristikë e dogmave dhe e shoqërive totalitare e autoritare. Gjuha është mjet i shoqërisë për t'i përmbushur nevojat e komunikimit dhe duke qenë mekanizëm shoqëror, nuk ndryshon nga mekanizmat e tjerë shoqërorë të sjelljes njerëzore: shija muzikore, veshmbathja, ondulimi, zgjedhjet politike e kështu me radhë. Parashkrimi i gjuhës është i barabartë me parashkrimin e secilës nga këto gjendje.

Për ta ilustruar një parashkrim të këtillë, do ta ofrojmë edhe shembullin e këngëtarit Benzad Pajaziti, këngëtari i grupit "Vizionet e thyera", autor dhe interpretues mes tjerash edhe i këngës "Hero i qytetit pa lumë" të "Gjurmëve". Në vitet e tetëdhjeta, në Radio Prishtinë, këngëtari kishte shkuar ta regjistronte këngën: "Atje ku dielli e ka folenë", një variant i new-wave-it perëndimor dhe me një tekst dashurie. Në tekst ishte një varg: "Ne të dy do ta pushtojmë botën". Radio Prishtina atëbotë kishte lektor, një formë e redaktorit gjuhësor. Lektori do të kujdesej që teksti

të mos kishte "gabime gjuhësore". Lektori e kishte lexuar tekstin dhe kishte thënë se nuk bën të këndohej: "Ne të dy do ta pushtojmë botën". Këngëtari më kot ishte përpjekur të kundërshtonte, duke thënë se nuk kishte asnjë gabim drejtshkrimi. Lektori kishte ngulur këmbë: kush je ti ta pushtosh botën. Ai kishte kërkuar që, nëse donin ta regjistronin këngën, duhet ta ndryshonin vargun dhe ta këndonin: ne të dy thurrim kurorë.

- Mirëpo, unë nuk po dua të thurr kurorë. Dua ta pushtoj botën… është dashuri që nuk njeh kufi.

Lektori nuk kishte lëshuar pe. Benzad Pajaziti e kishte kënduar strofën e parë sipas kërkesave të lektorit dhe…, kur lektori kishte dalë jashtë për të marrë ajër të pastër dhe për të pushuar veshët nga ritmi elektronik i new-wave-it, Benzadi në strofën e dytë kishte kënduar me të veten: "Ne të dy do ta pushtojmë botën".

Parashkrimi, pra, siç e tregon ky shembull, do që ta kontrollojë sjelljen e njeriut dhe ndërhyn deri në shprehjen e dashurisë së të rinjve.

Parashkrimi, pra, është veçori e dogmës.

Parashkrimi dhe gjuhësia përbëjnë oksimoron, sepse shkenca dhe parashkrimi përbëjnë oksimoron.

Shkenca (dhe gjuhësia pra) njeh vetëm përshkrimin: hulumtimin e gjendjeve gjuhësore, pa etiketat pozitive dhe negative.

Preskriptivizmi në gjuhë është kritikuar së fundit nga gjuhëtari Geoffrey Pullum, autori i gramatikës së anglishtes të botuar nga Cambridge (2002). Në Konferencën për gjuhën dhe ideologjinë të mbajtur në Salzburg më 2014, preskriptivizmin e konsideron ideologji më vete.

Duke i quajtur pseudo-rregulla, rregullat e përcaktuara nga një grup gjuhëtarësh, ai (Pullum 2014) çështjen e preskriptivizmit e sheh si ideologji konservatore. Ai sheh parime rregullative e jo rregulla konsekutive të gjuhës. Një varg kriteresh jashtëgjuhësore të propozuara nga preskriptivistët janë dëshmuar të paqëndrueshme.

Pullum (2014) shpjegon: "Përse dështojnë kriteret e jashtme të arsyetimeve të ideologëve preskriptivë? Sepse nuk kanë bazë: pohimet e tyre nuk janë të sakta".

Derisa dy këndvështrimet e para qenë gjuhësore (shpjegim i gjuhës si sistem dhe si objekt studimi), kënvdvështrimi i tretë dhe ai i katërt janë tekstorë, ose, më saktësisht, kontekstualë: njëri social dhe tjetri psikologjik.

Në këndvështrimin kontekstual social, do t'i trajtojmë dy standarde tekstualiteti sipas gjuhësisë së tekstit: synueshmëria dhe pranueshmëria.

Derisa dy këndvështrimet e para sqaruan se studiuesi i gjuhës nuk njeh gabim, por gjendje gjuhësore dhe se ka trajta gramatikore dhe jogramatikore, nuk e diskutuam deri në fund nëse forma jogramatikore është e gabim gjuhësor (Ia dha librin atyre).

Këtu na hyn në punë pranueshmëria.

Quirk et al (1985) i diskuton termat gramatikalitet dhe pranueshmëri, ndërsa De Beaugrande dhe Dressler (1981) termin pranueshmëri në kuptim të ngushtë e diskutojnë si pranim të një konfigurimi gjuhësor si tekst koheziv e koherent (që është gramatikaliteti) dhe në kuptim të gjerë si vullnet aktiv i marrëses për të marrë pjesë në diskurs dhe për të ndarë një synim të përbashkët me emetuesen. Dmth. Nga një anë e kemi dëshirën për të komunikuar dhe në anën tjetër dëshirën për ta nxjerrë maksimumin e domethënieve nga të thënit e ofruar.

Para disa vjetësh, në Ulqin, kohë vere, vendosa ta dërgoja makinën për ta pastruar.

Iu afrova punëtorit.

- Sa kushton mjeshtër?
- Ne rezumem, më tha.

Ndonëse bëhet fjalë për dy gjuhë krejtësisht të ndryshme, mund të vërejmë ngjashmëritë fonetike kushton – koshta dhe mjeshtër – majstore. Po ashtu, konteksti ishte i qartë, unë me makinë gjithë pluhur, para një punëtorie ku pastrojnë makina. A nuk është një rast tipik i mospranueshmërisë tekstore? Thjesht, po kuptonte fort mirë, por po kërkonte t'i drejtohesha në gjuhën e tij.

Teoria gjuhësore çështjen e pranueshmërisë e rreh nga këndvështrimi personal (Greenbaum), social (Labov) por edhe si veprim probabilistik (Bolinger 1968): Fjalitë quhen gramatikore nga të anketuarit, kur mund t'ua imagjinojnë kontekstet e mundshme.

Një komunikim i suksesshëm e kërkon aftësinë për t'i detektuar ose rezervuar synimet e pjesëmarrësve në komunikim. Në këtë kuadër, emetueset e tekstit pritet t'i parashohin reagimet e marrëseve si mbështetëse ose refuzuese, pra, duke e ndërtuar një plan të brendshëm të marrëses – si tërësi besimesh a njohurish e dijesh (De Beaugrande, Dressler 1981).

Prandaj, *Unë Tarzan, Ti Xhejn*, thënë nga mbreti i Xhunglës, nuk është gramatikor, është eliptik, por nuk mund të quhet gabim, sepse Xhejni përpiqet të komunikojë, prandaj edhe ta kuptojë.

Refuzimi për të komunikuar, ose mekanizmi i denigrimit të varieteteve jostandarde, bart më vete ideologji të caktuara që lidhen me grupet sociale dhe me rajone të caktuara. Për ideologjinë e gjuhës së popullit dhe të standardit – në vitet e komunizmit kemi raportuar më herët (Rugova, 2015, Rugova, Rugova-Sejdiu 2015a).

Në këtë kuadër, edhe Pullumi (2006) e kritikon si ideologji denigrimin e sistemeve gramatikore jostandarde nga qarqe të caktuara që e shfrytëzojnë sistemin gramatikor standard.

Kjo është diskutuar edhe në rrafshin e funksioneve të gjuhës standarde: me ç'rast krahas funksionit bashkues të tij, ekzistojnë, mes tjerësh, edhe ai i prestigjit dhe ai i ndarjes. Për këtë ka raportuar edhe Rustemi (1979).

Refuzimi dhe denigrimi i një varianti gjuhësor nënkupton ndarje, jo bashkim.

Këndvështrimi i katërt, psikologjik, është një variant i Greenbaumit, pra lidhet me gjendjen e folësit.

Nusja që shkon sefte në shtëpinë e burrit ka pak turp dhe kjo manifestohet edhe në zgjedhjet gjuhësore, të cilat ndryshojnë sapo ajo të jetë rehatuar në vatrën e re. Djali që del sefte me vajzën ka pakëz drojë dhe kjo manifestohet edhe në performancën e tij gjuhësore, e cila do të ndryshojë ndërkohë patjetër. Këtë e di secili që është i martuar. Kusuri e merr vesh më vonë.

Mirëpo, historia e gjithë kësaj është provuar me një eksperiment të tmerrshëm, aq të tmerrshëm sa që e quajnë "Eksperimenti i Monstrës".

Më 1939, Wendell Johnson dhe Mary Tudor në Universitetin e Iowas kanë kryer një eksperiment me 22 fëmijë jetimë, gjysma nga të cilët kishin defekte të të folurit – belbonin. Johnson dhe Tudor i merrnin fëmijët që kishin probleme dhe i trimëronin, duke u dhënë fjalë të mira për çdo përparim të tyre, duke bërë kështu që gjendja e tyre gjuhësore të përmirësohej. Me ata 11 të tjerët që nuk kishin probleme, e bënin të kundërtën. Pas çdo 'shkarjeje' të tyre, i qortonin dhe i përmirësonin. Eksperimenti quhet "Eksperimenti i Monstrës", sepse Wendell Johnson në mënyrë të qëllimshme, për të provuar një hipotezë shkencore, arriti që këta 11 fëmijë që nuk kishin probleme gjuhësore, përmes qortimeve e përmirësimeve të vazhdueshme, t'i shndërronte persona me defekte serioze psikologjike. Në belbanë. Për gjithë jetën e tyre.

Performanca gjuhësore e një individi varet nga gjendja e tij personale psikologjike, nga rrethanat sociale dhe nga kompetenca e tij. Asnjëra nga këto nuk ka kufij që e ndajnë të drejtën nga e gabuara.

Mirëpo, përse në perceptimin e të anketuarve në Kosovë, përfshirë një pjesë të komunitetit të gjuhëtarëve, shembujt e fillimit konsiderohen "gabime"?

166 persona apo 83% e të anketuarve, të përballur me pyetjen: çfarë është gjuha standarde, duke e pasur mundësinë e zgjedhjes mes tri varianteve: 1. Gjuha e vërtetë; 2. Një variant i mirë gjuhës; 3. Njëri nga variantet e gjuhës – janë përgjigjur "gjuha e vërtetë".

Kjo vjen si pasojë e propagimit të vazhdueshëm se gjuha e njësuar letrare e vitit 1972 është gjuha shqipe e të tjerat janë shkarje nga norma. Inercia e kësaj propagande dhe ideologjia, për të cilën kam diskutuar më 2015 në konferencën e Pogradecit (ideologjia e gjuhës së popullit) dhe në Seminar (ideologjia e shqipes standarde), është

manifestuar përmes mësuesve të asaj periudhe dhe një grupi autorësh që vazhdojnë të kenë trajtim preskriptiv (të parashkruar) për gjuhën dhe sjelljen shoqërore përgjithësisht. Ky këndvështrim ka vënë etiketa "pozitive" dhe "negative" mbi shprehje të ndryshme. Një përpjekje e tillë është bërë edhe në konceptet: fjala shqipe në vend të fjalës së huaj. Sa për ilustrim, fjala *hava* ka etiketën negative dhe kërkohet të zëvendësohet me qiell. Mirëpo, *hava* nuk ka kuptimin vetëm të qiellit, por e ka edhe të hapësirës dhe të motit (kohë), por edhe në sintagma: *E çoi në hava* dhe *e çoi në qiell* janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme. E para e ka kuptimin e bombardoi, e shpërtheu, ndërsa e dyta e lavdëroi shumë. Paçka ngjyrimet kuptimore: hava ka përdorim në stilin ironizues dhe evokues.

Po ashtu, fjalori i shqipes nuk e ka fjalën *hajgare*, me arsyetimin fjalë turke, ndonëse përdoret në tërë Kosovën, por kërkohet që në vend të saj të përdoret fjala *shaka*, e cila, po ashtu, është turke dhe ka përhapje gjeografie dhe përdoruesish të njëjtë (jo më të madhe) se hajgare. Kjo lidhet, po ashtu, edhe me refuzimin për ta mësuar dhe/ose paaftësinë për ta mësuar Sosyrin, me të cilin edhe nis gjuhësia moderne. (1916). Sa për ilustrim, pas vitit 1916 janë shpikur antibiotikët (1928), televizorët (1925), struktura e ADN-së (1950), të mos flasim për kompjuterët, internetin, raketat. Ta refuzosh këtë, është si të kthehesh në dijen e epokës para antibiotikëve e televizorit e kompjuterëve.

Nëse gjuhësia parasosyriane studionte formën si fenomen në zhvillim, por në varësi nga interesi historicist romantik, Saussurei gjuhësinë e konsideroi si shkencë që merret me studimin e gjuhës "më vete dhe për vete" (Ismajli 1974), ndërsa pikëvështrimi krijon edhe objektin e studimit.

Tani, këtu dikush do të thotë: po mirë, përse pra u vini vijë të kuqe studentëve që shkelin "normën"? Studentë që bëjnë trajta jogramatikore – po e zëmë e shënojnë mbiemrin muzikor në shumës pa *ë*, që ngatërrojnë trajtat e shkurtra, që përdorin trajtat e dëftores në lidhore e kështu me radhë – a janë duke bërë gabime? Në këtë kuadër kemi një tjetër kontekst. Nëse e bëjmë këtë pyetje këtu, jemi duke mos e ditur dallimin ndërmjet nevojave didaktike dhe atyre studimore.

Gabimet, po ashtu, trajtohen si mekanizëm studimi për mësimin e gjuhës së dytë. Analiza e gabimeve studimore është mekanizëm që ndihmon mësimin e gjuhës së dytë, duke parashikuar ndërlidhjet dhe ndikimin e sistemit të gjuhës së parë mbi të dytën. Mirëpo, kjo bëhet jo për hir të vetë formave jogramatikore, por për gjetjen e metodave dhe të mekanizmave të përmirësimit të nxënies së gjuhës së dytë.

Mësimi i një sistemi gramatikor është shkathtësi që duhet të dëshmohet. Një studente që shkel trajtat gramatikore, kur e bën shndërrimin e një varianti çfarëdo në variantin standard, i nënvizohen me të kuqe shkarjet, sikur që i nënvizohen me të kuqe

shkarjet që i bën, kur t'i kërkohet ta shndërrojë një tekst të variantit standard në një variant tjetër; kur ngatërron regjistrat e përdorimit gjuhësor. Njësoj ndodh edhe me rastet e tjera, kur përdor mbiemra subjektivë në tekste të synuara për objektive.

> *"Fan Noli edhe këtë herë ka hapëruar në vijën e hollë të virtuozitetit. Përmbledhja e tij "Albumi" është një perlë e rrallë e letrave shqipe. Ai i vë në pah ndjenjat më sublime dhe më të thella të shpirtit të tij të madh artistik për atdheun. Vargjet e tij vigane janë grusht çdo armiku të shqipes. Strofat e tij janë demonë për injorantët vendas e të huaj. Secila vjershë shfaqet në horizontin e gjerë të urtakëve me penda të arta të shqiptarisë si një kurorë dafine…".*

Nga 200, të anketuarit, ky nxënës merr notën 5 nga që të gjithë: "nuk ka gabime drejtshkrimi", "ka fjalor", "si poet".

Mirëpo, zëvendësoje Fan Noli me Migjeni dhe ndërroje titullin e librit. Zëvendësoje tutje me cilindo emër tjetër dhe do ta shohësh se, në të vërtetë, nxënësi as nuk e ka lexuar librin fare. Mungesën e përmbajtjes e zëvendëson me fjalë boshe dhe etiketime. Në gjuhësi logore, si diare veç me fjalë.

Duke i ndjekur gabimet e drejtshkrimit, nuk ua kemi mësuar nxënësve mendimin kritik, argumentimin, të shkruarit për nevoja akademike. Kemi një shoqëri ku mungon mendimi i mirëfilltë kritik dhe ku ka mungesë mendimi kritik ka paragjykime dhe etiketime.

Sa për ilustrim, me të anketuarit e njëjtë, të fillimit, kam shtruar pyetje të ndryshme: A është mirë apo keq të pihet duhan? Kush është shkrimtari më i mirë shqiptar? Kush është intelektuali më i madh shqiptar? A ka ndonjë parti politike për të cilën do të ziheshe grushte me dikë tjetër?

Për dy pyetjet e para, përgjigjet kanë qenë 100% të njëjta, për të tretën ka pasur një shumicë që e ka dhënë një përgjigje dhe për të fundit kanë qenë afër një të tretës që janë përgjigjur: Po.

Kur u kam kërkuar ta argumentojnë përgjigjen e tri pyetjeve të para, asnjëri nuk ka qenë në gjendje të japë një argumentim faktik.

Pyetjes së parë u janë përgjigjur kryesisht: se është i dëmshëm, por nuk ka pasur arsyetim se përse. Për pyetjen e dytë e të tretë po i jap disa nga përgjigjet: "Se qashtu osht", "shkruan bukur", "është përkthyer në disa gjuhë", "ka marrë çmimin Nobel (sic)", "ka ndjenja".

Asnjë argument i mirëfilltë letrar, apo jo?

Për pyetjen e katërt, kam kërkuar të më tregojnë që, meqë janë të gatshëm të zihen grushte me dikë për partinë e preferuar, a e kanë lexuar programin e asaj partie për çështjet e ekonomisë.

Filluan të qeshen. Asnjëri nuk e ka lexuar, por janë në gjendje të zihen grushte me ty për ta.

Një studim ende i papublikuar, trajton diskutimet e politikanëve/politikaneve dhe të analistëve/eve kosovarë/e në TV. Hulumtimi trajton argumentimin. Shifrat ende nuk janë komplete, por hulumtimet e deritashme tregojnë një shumicë të rasteve, kur politikanet i shtrojnë tezat e tyre, por pastaj nuk i argumentojnë dhe në vend të argumentimit shfrytëzojnë etiketa, të ngjashme me ato të nxënësit që shkruante për Nolin.

Kjo tregon shkallë parashkrimi mendor.

Shkarje ka kur dikush "shkel" rregullat e gramatikës dhe të drejtshkrimit dhe shkarje njësoj është edhe kur një shkrimtar ofron një shprehje të re, ose krijon një fjalë. E para duket gabim, sepse e ka etiketën e gabimit, ndërsa e dyta jo, sepse nuk e ka këtë etiketë.

Në një debat televiziv, një preskriptivist, fliste për gabimet e drejtshkrimit, por thoshte se Kadareja nuk bën shkelje se ai është prodhues i gjuhës. Dmth. vetëm Kadareja qenka prodhues gjuhe, askush tjetër?! Qy deri ku të shpie dogma.

Si përfundim, do të përsërisim se në këndvështirmin linguistik nuk ekziston koncepti gabim gjuhësor, ndonëse brenda një sistemi ka trajta gramatikore dhe jogramatikore që i konkurrojnë njëra-tjetrës. Në këndvështrimin studimor, punë e gjuhëtarit është ta hulumtojë gjendjen e gjuhës dhe të bëjë parashikime, mbështetur në metodat linguistike dhe mbi faktet e mbledhura, për zhvillimin e dinamikave të gjuhës. Në këndvështrimet psikologjike, përdorimi i gjuhës është i lidhur me gjendjen e folësit dhe ndjekja e gabimit krijon "memecë", ndërsa në këndvështrimin social lidhet me nevojën e komunikimit.

Kërkimi i gabimeve gjuhësore në tekste dhe paraqitja e tyre si gjetje studimore është një punë shumë e lehtë dhe nuk është assesi objekt studimi i gjuhësisë (jo që nga 1916, të paktën). Studimet gjuhësore janë më të komplikuara se kaq, realizohen me metoda të mundimshme dhe të lodhshme për të përshkruar gjendje gjuhësore dhe për të parashikuar dinamika të zhvillimit të gjuhës. Shumë shpesh janë të mërzitshme. Duan shumë durim. Se e tillë, e komplikuar, e lodhshme dhe e mërzitshme është shkenca. Dhe pikërisht kjo e bën shumë intersante.

Do ta përfundoj në anglishte, duke cituar fjalët e një shkencëtari të madh, Richard Dawkinsit:

"Science is interesting, who doesn't agree, can go and fuck himself".

Apo ndoshta bëra gabim tash?

Bibliografia

Bolinger D. 1968. Judgements of grammaticality. *Lingua 21*.

Dawkins R. 2006 (2014). *Deluzioni zot*. Prishtinë: Trembelat

De Beaugrande R., Dressler H. 1981. *Introduction to Text Linguistics*. London: Longman

Greenbaum S. 1977. *Acceptability in Language*. The Hague: Mouton

Ismajli R. 1974. Ferdinand de Saussurei dhe gjuhësia moderne. Në: *Studia Humanistica I*. Prishtinë: Fakulteti Filozofik i Prishtinës

Johnston Barbara. 2008. *Discourse Analysis*. Singapore: Blackwell

Labov W. 1972. *The Social Stratification of English in New York City*. Washington, D.C.: Center for Applied Linguistics

Pigliucci M. 2010. *Nonsense on stilts. How to tell science from bulk*. Chicago: University of Chicago Press

Popper C. 1935 (2005). *Logic of scientific discovery*. London, New York: Routledge

Pullum G. 2006. *Ideology, Power and Linguistic Theory*.

Në: https://people.ucsc.edu/~pullum/MLA2004.pdf

Rasinger S. 2013. *The Quantitative Research in Linguistics: An Introduction*. London, New York: The Bloomsbury Academic

Quirk R., Greenbaum S., Leech G., Svartvik J. 1985. *A Comprehensive Grammar of the English Language*. Essex: Longman

Reeves

Rugova 2015 Ideologjia e preskriptivizmit në gjuhën shqipe. Në*: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 33/1*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës

Rugova B., Sejdiu-Rugova L. 2015a. The Ideology of "people's language" in the development of Standard Albanian language. Në: Demiraj B. (red) *Sprache und Kultur der Albaner – zeitliche und raumliche dimensionen*. Wisbaden: Harrasovic,

Rugova B., Sejdiu-Rugova L. 2015b. *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat

Rugova B. 2016. Gjuha e shkencës. Në*: Riçke rome itaçi e zakucati – përmbledhje punimesh për tekstin dhe gjuhën në shoqëri*. Prishtinë: Trembelat

Rustemi F. 1979. What's the signifiance of Standard Language Theory for the Study of Language Planning. Sunny at Buffalo

Sosyr F. 1916 (1977). *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*. Prishtinë: Rilindja

Bardh RUGOVA

LANGUAGE ERRORS

Abstract

The article emphasizes the differences in the perception of language errors among the scientists (linguists) and the traditional difference between the prescription and description in science: the prescription as a dogmatic tendency in science and the description as a scientific method itself. Grammatical mistakes found in the text "prescribed" by prescriptivists as error analysis and being revealed to as scientific achievements are not to be considered as such. Linguistic studies are more than that, they keep being realized by very hardworking methods of describing the real-life language situation and by observing the dynamics of language development. The difference between prescription and description has been explained through the concepts of intentionality and acceptability, too, in terms of text grammar analysis and text linguistic viewpoint.

Rrahman PAÇARIZI

NETLEKTI

Fillimisht pse Netlekt? David Crystal në librin e tij "Txting the gr8 db8" flet për atë që unë e pata quajtur thjesht gjuha e mesenxherit, që ka të bëjë me gjuhën e komunikimit të shpejtë të atypëratyshëm, natyrisht online. Punimi ishte botuar në revistën Filologjia në vitin 2008, do me thënë në të njëjtën kohë kur David Crystal e kishte nxjerrë botimin e tij të parë të librit ku këtë formë të komunikimit e quante texting. Në vitin 2001 në librin Gjuha e internetit, David Crystal textingut nuk i kishte kushtuar më shumë se dy-tri faqe, ndërkohë që me këtë çështje ishte marrë pak më shumë në "Glossary of Netspeak and Textspeak (2004)" ku sërish vetëm sa kishte përfshirë disa nga shkurtesat më së shpeshti të përdorura në komunikimin online. Duke qenë se bëhet fjalë për një mënyrë tashmë globale të komunikimit, ai ka evoluuar shumë më shpejt seç mund ta përcjellin librat e punimet shkencore, që në natyrën e tyre nuk janë aq dinamike sa zhvillimet teknologjike. Linguistët janë mësuar t'i ndjekin dhe t'i përshkruajnë fenomenet e gjuhësisë me ritmin e tyre të ngadalshëm dhe për këtë arsye disiplinat linguistike deri tash janë ndier rehat në ngadalësinë e tyre, meqë ritmi i zhvillimit të gjuhëve e sidomos ndryshimet e tyre impononte një ndjekje po aq të ngadalshme. Mirëpo, që nga viti 2008, kur David Crystal e botoi librin e parë, sigurisht shumë të guximshëm për textingun, apo gjuhën e mesenxherit dhe mesazheve, gjuhën e komunikimit instant, gjërat kanë ndryshuar shumë. Me këtë libër, ai e ka tejkaluar edhe Fjalorin e netspeak dhe textspeak, botuar vetëm katër vjet më herët, pasi që komunikimi ka evoluuar duke ndjekur ritmet e zhvillimeve tekniko-teknologjike. Përderi sa më 2004 ishte në modë MSN mesenger, Facebook i nisur si një faqe interneti për fotografi personale po zhvillohej me shpejtësi marramendëse, duke zhvilluar mesengerin e vet, të pavarur nga mesengeri i MSN-së, i cili ofronte më pak mundësi komplementare. Viber, i dha një shtysë tjetër zhvillimit të gjuhës së internetit platforma globale u ofroi mundësi thuajse të barabarta të gjitha gjuhëve, natyrisht duke ia lënë vetiu anglishtes prestigjin më të lartë, jo vetëm si gjuhë përmes të cilës ishin ofruar këto produkte, por edhe si lingua franca.

Më 2008, këtë formë të komunikimit e pata cilësuar gjuhë e folur që shkruhet. Besoj që ajo vazhdon të jetë e tillë. Ajo që ka ndryshuar brenda tetë vjetësh është se ky komunikim ka arritur një shkallë të lartë të standardizimit, duke u shndërruar, nëse jo

në një varietet të komunikimit gjithëkombëtar, me çka do ta rivalizonte varietetin standard që e mëton këtë përhapje, atëherë është ngritur në një vernakular të Kosovës, duke pasur të gjitha kapacitetet e përhapjes, ndërkohë që prestigji i takon vernakularit të folur të Prishtinës.

Tani, shkalla e përhapjes, tendencat e shpërfaqjes së përkatësisë sociale përmes një "siseti" linguistik, i cili njëkohësisht shpërfaq edhe diferencat gjuhësore si mjet për kontrollin e grupit social, e çojnë lloj komunikimi në nivel të një formacioni linguistik. Duke qenë se e ka bërë një moshë të caktuar, ky formacion linguistik ka ndier nevojën për të pasur rregulla të caktuara, para së gjithash sa i përket pasqyrimit grafik të tingujve të fjalëve. Kjo tendencë që më shumë është sociale sesa linguistike në esencën e saj, paqëllimshëm ka arritur të realizojë një shkallë të caktuar gramatikaliteti. Duke pasur të gjitha këto tipare, ky formacion linguistik është njëfarë sociolekti, mirëpo, për shkak të përhapjes jashtëzakonisht të madhe (meqë komunikimi tejkalon kufijtë e një qyteti, pastë ai qytet edhe tendenca metropolitane) unë e kam quajtur net-lekt, duke përdorur "net" për rrjetin si truall i realizimit të atij formacioni dhe "lekt" si paradigmë për varietetin gjuhësor. Mbështetur në qasjen sociokognitive (Temmerman, 1997, 2000, 2001), termi e jep idenë e qartë të formacionit linguistik me të gjitha tiparet, duke mos u izoluar vetëm në atribute të përkatësisë a diferencave sociale.

Ajo që Crystal e ka quajtur komunikim virtual në fakt është i tillë vetëm për nga mënyra e realizimit, pasi funksioni është krejt i njëjtë. Njerëzit edhe në tëkaluarën kanë komunikuar në largësi të mëdha, por pa pasur mundësinë e komunikimit instant, meqë përgjigja duhej pritur gjatë. Për këtë arsye, ky lloj komunikimi vazhdon të jetë gjuhë e folur që shkruhet. Në fillimet e tij, komunikimi online shihej më shumë si mënyrë për t'u argëtuar a për të njohur njerëz, mirëpo tash ky komunikimi e ka zëvendësuar gati tërësisht komunikimin me telefon, sidomos tash kur paltformat që sigurojnë komunikimin e shkruar instant, kanë edhe komponentët e komunikimit me zë, siç ishte telefoni. Bota fillimisht ishte e shqetësuar se instant messaging do ta shkatërronte gjuhën. Në librin e tij "Texting the gr8 db8", Crystal (2008:7) thotë: Disa madje mendojnë se textimi po e shkatërronte gjuhën si të tërë. 'Mesazhet e shkruara po e shkatërrojnë gjuhën tonë" ishte titulli i një shkrimi në Uashington më 2007, ku autori thotë: E dija se kjo do të ndodhte. Që nga momenti kur një mik imi me dërgoi mesazhin:"I've got 2 go, talk to U later,' e dita që fundi është afër, shkruante autori. Mirëpo, Crystal mbështetur në hulumtimet dhe rezultatet eksperimentale, nuk pajtohet me pikëpamjet se përdorimi i shkurtesave dhe zhargoneve, të tilla si ato në gjuhën e SMS-ve, do të çojë në uljen e nivelit të shkrim-leximit dhe drejtshkrim të keq në mesin e fëmijëve.

Shkumbin Munishi, në punimin e tij "Gjuha shqipe në internet", thotë se "Në dhomat e bisedave (chat rooms), në format e komunikimit përmes mesazheve të çastit në mesenxherë (messenger instant messaging) dhe format e tjera të komunikimit të ndërmjetuar me kompjuter (CMC) shqipja del në të gjitha variantet e saj gjeografike, por edhe në formë të kodeve shoqërore, disa prej të cilëve mund të quhen regjistra të veçantë, siç është p.sh. komunikimi me mesenxher". Ky pohim çon kah arsyetimi i netlektit si një kod i veçon kah arsyetimi i netlektit si një formacion gjuhësor i shqipes, që nuk është mirëfilli dialekt, për shkak se i mungojnë izoglosat, pra nuk e ka komponentin gjeografik, por as sociolekt mirëfilli, pasi përdoret nga grupe të ndryshme sociale, më shumë me qëllim të gjithëpërfshirjes sesa të diferencimit.

Stili

A kishte të drejtë Crystal, apo ishte tepër liberal në pikëpamjen e tij karshi gjuhës online? Nëse komunikoni me mosha të reja, deri në 25 vjeç apo edhe me më të vjetër, por që i janë ngjitur keqas internetit, mund të shihni një gramatikalitet të theksuar dhe përdorim, ndonëse alternativ, të pothuajse të gjitha mjeteve linguistike e paralinguistike. Pauzaliteti dhe mbushësit verbalë e joverbalë janë thjeshtuar në "hmmm", dyshimi që në komunikimin e zakonshëm shprehet më ngritje vetullash a ngritje krahësh, këtu shprehet me "aha", ndërsa habia dhe mosbesimi me "ahaa". Përderisa pajtimi shprehet me "OK", tjetrit i themi se e kemi kuptuar me "op"(po). Shkurtesat nuk janë cështje mode, por ekonomi gjuhësore: Faleminderit është "flm", ndonëse "m" nuk e jep idenë e nderit, ndërsa "s'ka përse" shkruhet "sps". "Ckemi" është hyrja në bisedë, si kuazikomunikim, ndërsa pyetja e vërtetë shkruhet "c(q)a ka 3", ndërkaq, "tung", "ntm" etj. tregojnë fundin e bisedës. Pa këto elemente komunikimi konsiderohet i papërfunduar, ndërsa bontoni i papërmbushur. Këto janë elementet themelore, te të cilat nuk vërehen diferencat sociale.

Në përpjekje për të ndjekur dinamikat e komunikimit të shpejhtë, komunikimi instant duket sikur është holofrastik, me ç'rast një frazë e vetme shërben për të krijuar idenë themelore.

Fonetika

Ato diferenca vërehen te realizimi grafik i tingujve të të folurit, të cilët anojnë kah një labializim i skajshëm i a-së, në "o". Osht/o, jom, u kon, koma, dhomi etj janë vetëm disa nga rastet e këtij pasqyrimi. Nëse dikush shkruan "kam qenë", ai nuk është pjesë e netlektit të Kosovës. Të rinjtë ta tërheqin vërejtjen. Nëse shkruan "kam qenë"

apo "kam ngrënë" apo "kam hangër", ti je bal. Forma e drejtë është "kom honger". Përdoruesit e netlektit e kuptojnë kur shkruan "lol", kur shkruan "brb", "cu". Sigurisht që të gjitha e dinë se cka do të thotë "td" ose "tdsh", sinonim i të cilës është "t lovi". Është perceptim i gabueshëm me mendu që netlekti i Kosovës është pasqyrim i slengut të Prishtinës. Slengu i Prishtinës vazhdon ta bëjë jetën e tij edhe brenda netlektit, për të njëjtin qëllim si në gjuhën e folur, pra, për diferencim social.

Intonacioni dhe elementet e tjera fonetike shprehen me zgjatje zanoresh e ndonjëherë edhe bashkëtingëlloresh "fortttt miiiiiir", "t'duuuuuuu", "ikkkk".

Gramatikaliteti

Se ky lloj komunikimi në të vërtet është netlekt, dëshmon edhe shkalla e lartë e gramatikaliteti. Përdoruesit e tij bëjnë "gabime" po aq sa edhe pjesëtarët e një vernakulari. Netlekti i Prishtinës është i ngjashëm me vernakularin e Prishtinës. Emrat marrin mbaresat rasore që i marrin edhe në vernakularin e folur të Prishtinës: itaqi/i,e itaqit/itaqit/itaqin/pi itaqit;, vërjetur nga Bardh Rugova. Gjithashtu edhe foljet kanë një përdorim të rregullt, për aq sa ky përdorim është i tillë në vernakularin e Prishtinës, sipas Munishit, apo në atë që profesor Ismajli e pati quajtur pellgu gjuhësor i Prishtinës. Folja "flas" del "unë foli/ ti fol/ ai fol/ne folim, ju folni/ata folin, ndërakaq folja e parregullt "jap/me dhane" mbetet e parregullt por me rend të përmbysur nga forma e zakonshme e shqipes, që ka hyrë edhe në normë. E tashmja bën "dha" (ta dha, s'ta dha), e kryerja e thjeshtë bën "jepa" (ia jepa ni libër), e pakryera bën "dhasha" (kur dhasha mësim n'kursin e anglishtes), ndërkaq pjesorja del "jep" (kom jep). Ky rend i përmbysur ka arsye sociolinguistike. Se vernakulari i folur i Prishtinës pasqyrohet në netlektin e Kosovës (po them të Kosovës, pasi shkalla e përhapjes eshte pakrahasimisht më e madhe, mundësu nga teknologjia) dëshmon edhe përdorimi i trajtave të shkurtra, ku për shembull në vend të "jua" përdoret "jau", e cila trajtë përdoret edhe për "ua", ndërkohë që trajta e shkurtër "i" është ruajtur, trajta "u" është zëvendësuar pothuajse krejtësisht nga "ju".

Sintaksa është krejtësisht e rregullt dhe nuk dallon me asgjë.

Shkurtesat

Ato nuk janë çështje e netlektit, por kanë arritur një standardizim të përdorimit dhe kryejnë funksione të caktuara, me shkallë të lartë të konsensusit gjuhësor. Përdoren me të madhe në netlektin e Kosovës dhe kanë arritur një shkallë të lartë të konsensusit ndërmjet folësve të netlektit. Në këtë k,omunikim përdoren shumë edhe

shkurtesa të marra nga anglishtja, ndërkohë që ato të shqipes janë ndërtuar sipas të njëjtit model me ato të anglishtes, duke mos përfaqësuar elementet përbërëse të një kompozite a fjale të përngjitur, por para së gjithash duke u mbështetur në pasqyrimin e bashkëtingëlloreve më reprezentative apo ndonjëherë të atyre me markante. Për shembull "faleminderit" nuk bën "fmn", ose "fn", por "flm", pastaj në vend të "nm" (natën e mirë), del "ntm":

Formime të shqipes:

"1her" (një herë); "2shim" (dyshim); "3gom" (tregomë); "7zon" (shtatzënë); "as1her" (asnjëherë); "cka ka 3"? (çka ka të re?); "dtl" (ditëlindje); "e vër8" (e vërtetë); "fk" (fakultet); "fr" (frajeri); "gz" (gëzohem); "hjg" (hajgare); "i 3nt" (i trent); "kl" (klasë); "kz" (kallëzomë); "nsr" (nesër); "ntm" (natën e mirë); "pldh" (pa lidhje); "prsh" (përshëndetje); "sps" (s'ka për se); "spv" (secili për vete); "srz" (seriozisht); "t2" (të dy); "td" (të dua); "tdsh" (për të dua shumë); "v@" (vet/ë);

Formime të anglishtes në përdorim:

atm -at the moment; bf – boyfriend; brb – be right back; btw -by the way; g8 – great; gf –girlfriend; msg – message; omg -oh my god; pls/plz – please; RIP- Rest in peace; thnx -thank you; wtf -what the fuck

Bibliografi

Crystal, David (2001). Language and the Internet. Cambridge: Cambridge University Press, 2001

Crystal, David, A Glossary of Netspeak and Textspeak. Edinburgh: Edinburgh University Press, 2004

Crystal, David, *Txting the Gr8 Deb8,* Oxford University Press, 2008

Munishi, Shkumbin, Gjuha shqipe dhe interneti, *http://linguasocio.blogspot.com/2009/05/gjuha-shqipe-dhe-interneti.html*

Paçarizi, Rrahman, Gjuha e mesenxherit, Filologjia 14, Prishtinë, 2006

Rugova, Bardh, Riçke rome itaçin e zakucati, Trembelat, Prishtinë, 2016

Temmerman, R. (1997) "Questioning the univocity ideal. The difference between sociocognitive Terminology and traditional Terminology". Hermes. Journal of Linguistics 18. pp. 51-91.

Temmerman, R. (2000) Towards New Ways of Terminology Description. Amsterdam / Philadelphia: John Benjamins.

Temmerman, R. (2001) “Sociocognitive terminology theory”. In: Cabré, M.T. & J. Feliu (eds.) Terminología y Cognición. Barcelona: Universitat Pompeu Fabra. pp. 75-92.

Rrahman PAÇARIZI

NETLECT

Abstract

Netlect would be another name for the instant messaging and other communication through social networks. The term has not yet been used and it is unusual to mark this concept, as Crystal has called it "Texting" in English. Not because the fact that the term “text” would not function in Albanian, but the most suitable term for this variety of language would be netlect, as a blending word consisted of “net(work)” and “(dia)lect)”. Caroline Tagg, analysing David Crystal's "Texting the gr8 db8", says that this book is "a fun and illuminating discussion of the great debate that surrounds the media ", while the main thesis of the book relates to the notion that the texting not only doesn’t hurt the language, but it can have beneficial effects on growth skills of knowledge and ability to write. The traditional view considers texting as a messy speech that damages language and communication. However, is it so? Research shows that the text is actually turning into netlect and it is not done at all. Pristina youngsters will correct you while texting, which means there is a grammaticality. Kosovo's netkeeper does not accept "jam", but "jom"; does not accept the form "kam hanger" or "hangër” or “kam”, but "kom honger", etc..

The netlect, therefore, regardless of the tags is more than slang - it has grammatical rules.

That although different from those normative, are still the rules. The extraordinary infrastructure of spreading and enforcing rules, social differentiation and other attributes make netlect a pervasive phenomenon.

Linditë SEJDIU-RUGOVA & Giuseppina TURANO[1]

ANALIZË E ROLEVE SEMANTIKE DHE STRUKTURAT THEMELORE TË FJALIVE NË GJUHËN E VIBER-IT

1. Viber-i, duke qenë një nga mediumet më të përdorura të komunikimit (për shkak të shpejtësisë dhe të efikasitetit të komunikimit si dhe duke qenë pa pagesë në hapësirat e mbuluara me rrjet wi-fi ose me pak pagesë krahasuar me mesazhet e shtrenjta klasike telefonike gjatë komunikimit brenda ose edhe jashtë vendit), paraqet një nga korpuset më të pasura të analizës semantike dhe sintaksore të strukturave të përdorura brenda kontekstit të një komunikimi të tillë. Ky punim do të merret drejpërsëdrejti me analizën sintaksore të roleve semantike të argumentave të foljes në strukturat e përdorura të shqipes gjatë komunikimit në viber, si dhe do të ofrojë një klasifikim të mundshëm të këtyre strukturave duke u mbështetur në teorinë e roleve theta për argumentat e foljes. Gjithashtu, lëvizja e këtyre roleve dhe ndryshimi i rendit të fjalëve brenda këtyre strukturave do të vështrohen përgjithësisht, por duke i krahasuar gjithnjë në rrafshin: çfarë është gramatikore e çfarë jo, jo çfarë është standarde e çfarë jo, sepse shpeshherë edhe strukturat dialektore që nuk na dalin si struktura standarde, janë gramatikisht korrekte.

Çfarë është Viber-i?

Viber-i është një aplikacion për dërgimin e mesazheve të atypëratyshme dhe jo vetëm (edhe për Voice over IP) në android që mund të shkarkohet falas nga interneti. Më 2 dhjetor të vitit 2010 ka dalë për herë ta parë publikisht, i themeluar nga 4 partnerë izraelitë dhe bjellorusë, dhe i regjistruar në Las Vegas dhe në Qipro si pjesë e Viber Media. Paraqet një nga aplikacionet më të përdorura në Republikën e Kosovës, në konkurrencë të vazhdueshme me Skype, i njohur në Kosovë kryesisht për video-komunikim. Gjatë vitit 2014, Viber-i pati mbi 100 milionë përdorues aktivë dhe rreth 280 milionë përdorues të regjistruar në mbarë botën[2].

[1] Të dyja autoret janë përgjegjëse në tërësi për këtë kontribut shkencor, megjithatë vihet në dukje se Lindita Sejdiu-Rugova është autore e § 1 dhe Giuseppina Turano e § 2.
[2] Të dhënat e përgjithshme për Viber-in janë nxjerrë nga uebfaqet: https://en.wikipedia.org/wiki/Viber, dhe https://support.**viber**.com, në gjuhën angleze.

Duke qenë se përdoret nga të gjitha moshat e popullsisë në Kosovë, sidomos në formë të mesazheve të atypëratyshme, gjetja e korpusit nuk do të duhej të paraqiste problem. Megjithatë, çështja e korpusit doli të jetë problematike meqë njerëzit hezitonin t'i tregonin mesazhet personale, qoftë edhe nëse kishim për t'u ofruar atyre deklaratë profesionale me shkrim që mesazhet e tyre do të përdoreshin në anonimitet. E tëra kjo ngaqë njerëzit në viber shkruajnë për gjithçka dhe çdo gjë.

Një problem tjetër me të cilin u ballafaquam ishte ai i klasifikimit të gjuhës së Viber-it si gjuhë e shkruar: ajo është gjuhë e shkruar për shkak të paraqitjes grafike, por stilistikisht me elemente të gjuhës së folur. Shpeshherë, për ta paraqitur verbalitetin e saj, ndërthuret edhe me ikona dhe simbole që shprehin gjendje emocionale ose ndjesi të atypëratyshme.

Gjuha e viber-it e rrafshon në njëfarë mënyre dallimin esencial ligjërim i shkruar dhe ligjërim i folur- në Viber shprehjet e ligjërimit të folur nuk i merr era.(Sejdiu/Rugova&Rugova, 2015: 43)

Duke i analizuar sipërfaqësisht disa nga strukturat gjuhësore në mesazhet personale, strukturat sintaksore të gjuhës së përdorur në viber dallojnë shumë nga ato që i gjejmë në një komunikim standard. Dhe kjo ishte hipoteza fillestare e punimit tonë:

H1: Strukturat sintaksore të gjuhës së Viber-it janë përdorur shlirshëm, pa restriksione drejtshkrimore dhe pa një kompleks të të shkruarit "drejt" nga ana e dërguesit të mesazhit. Rrjedhimisht, dallojnë nga strukturat e përdorura në gjuhën e shkruar të mediumeve tjera. Por, kjo hipotezë nuk u përmbush plotësisht!

Kur i analizuam rolet semantike të argumentave të foljes në fjali duke u mbështetur në Rolet theta (Andrew Carnie, Syntax – A Generative Introduction, 2012: 221) si dhe duke i analizuar sintagmat në korpusin e zgjedhur, e kuptuam që komunikimi në viber ndërmjet grupmoshave të ndryshme dallon shumë (komunikimi midis dy tinejxherëve, një tinejxheri dhe një të rrituri me arsimim të lartë, ndërmjet një personi me arsimim të lartë dhe tjetrit me arsimim të ulët si dhe komunikimi ndërmjet familjarëve kundruall jofamiljarëve).

Korpusi i përfshin diku 2000 fjalë të mesazheve të analizuara, apo rreth 500 fjali në formë të dialogëve. Mëtuam që ky hulumtim të na japë përgjigje në këto dy pyetje themelore;

A dallojnë rolet semantike në gjuhën e viber-it nga ato që i gjejmë në ligjërimin e shkruar në përgjithësi? Dhe nëse po, cilat struktura sintaksore dallojnë ose paraqiten të ndryshme nga ato që zakonisht konceptohen si struktura gramatikisht korrekte?

Në një korpus të tillë, së pari janë identifikuar rolet semantike që përdoren për ta përshkruar rolin e një argumenti në raport me predikatin. (Carnie, 2012: 221-230)

Dhe, këto role tematike që i analizuam në dialogët e nxjerrë nga korpusi i përshkruam nëpërmjet marrëdhënies së:

1. Rolit të iniciuesit (initiator) ose bartësit (doer) të një veprimi, që kryesisht del si kryefjalë e fjalisë dhe njihet si agent:
   [K: Ne foto po duket pak me ndryshe
   K: Nejse une sot shkoj e shoh me sy
   K: Pastaj te shkruaj ty] K – klienti në korpus
2. Rolit të përjetuesit (experiencer), që kryesisht del si kryefjalë dhe si kundrinë:
   [C: edhe ti i bon boll muhabet kunates,
   A: Vjen rralle
   C: po edhe keto dite mujm me u pa
   A: se me ardhe shpesh nuk ia kisha fute Hahahaha]
3. Nëpërmjet njësive që u nënshtrohen veprimeve, njësi që lëvizen, përjetohen ose përftohen e që quhen thjesht tema (themes):
   [A: a hengre buke
   A: gjelle me patate
   B: mora qipsa e ato e lash mu nxe
   A: a mos ke harru tu u nxe
   B: jo veq sa e lash n2sh
   B: qe 5 min
   A: Kontrolloje kqyre
   B: u bo]
   Ose:
   [A: I bukur shume me ka pas pelqy, e tash po rilexoj dostojevskin pas 30 vitesh…]
   Ose:
   [A: Nuk mujta me vendos a me ardhe a mos me ardh neser
   A: Nese me thush hajde
   A: Muj me ardhe mengjes pak]
4. Nëpërmjet njësisë drejt së cilës ndodh veprimi, rolit semantik të qëllimit, e që në vete mund të ngërthejë edhe lëvizje abstrakte, jo vetëm konkrete:
   A: qa po bon o bal
   B: qe qitu po rri
   A: edhe 3 muj chill babo
   B: hahahaha spo di njeri qa me ba
   B: 3 muj
   A: bash kisha shku nshkoll qaty qitash

B: hahahaha pse mer
A: notat e mbyllta veq me nejt
B: hahahahaha per ashtu edhe une
A: edhe qishtu se kena keq
B: hahahaha duhet mu kane i knaqt
A: op valla

5. nëpërmjet marrësit apo pranuesit (recepient), që zakonisht shkon me folje që tregojnë ndërrim pronësie:
[A: Ti mund ta marresh (atë)
A: Per mua nuk ka problem
A: Merre me vete] (është fjala për një person)
Ose:
[A: Nja 5000 me shkojne
A: Vec dritaret 2000
A: Se po du me I marr prej te Mirave]
6. nëpërmjet njësisë që shpreh të kundërtën e qëllimit, pra paraqet burimin apo pikënisjen e veprimit (source):
[A: E godite ndonje mjeshter garant
A: Une po du me i hy shpise tash
B: Po
B: I ka gjete
B: Mezi]
Ose të dyja rolet të përdorura njëra pas tjetrës;
[te fala nga dhermiu
nga jeshili i malit - source
tash ne te kaltren e detit] - goal
7. Lokacion: vendi ku ndodh veprimi
A: Ku jeni tash
B: Nkafe
A: pyte per gjyshin
B: kafe jom ka pi
A: a eshte me mire
B: po nime
A: Tregome
B: Nese qel vet temen e pys
A: Duhet
B: Hajt bre

A: Ok Tung
B: Oki Tung

8. nëpërmjet të instrumentit (mjetit), apo të objektit, me të cilin kryhet veprimi:
   A: miremengjes me dy dallendyshe (jepet fotoja)
   B: Miremengjesi goca! Pa dallendyshe te une (dy simbole te smile-t)
   Ose:
   [SH: Ky osht ai lloji tjeter
   SH: Znj.XXX me oferte Air Comfort Plusi
   K: Une nese e marr
   SH: me 1009.90euro]
   SH- shitësi në korpus, K – klienti në korpus
9. dhe nëpërmjet rolit të përfituesit (beneficiary) siç është rasti me strukturat:
   A: Urime XXX, shyqyr qe e paska marre djali vizen. Sukseset e percjelleshin gjithmone (djalin)
   B: Po po bash feste. Por vec nji semester viza
   B: Kryesorja po shkon

Meqë kriteri theta në vetvete i përfshin një tufë rolesh semantike që i përmendëm më lart e që njihen edhe si theta grid dhe i cili e përcakton saktësisht rregullën se një argument i foljes mund ta ketë vetëm një rol theta (qofshin këto role të brendshme (kundrinat) apo të jashtme -kryefjala). Meqë axhunktët (plotësit opsionalë, në terminologjinë tradicionale sintaksore shpesh gabimisht janë barasvlerësuar me rrethanorët) nuk mund të jenë argumentë të foljes dhe nuk janë pjesë e analizës së roleve semantike, pra nuk paraqiten asnjëherë në theta grids (tufë theta), atëherë del se shumica e strukturave në Viber dominohen nga rolet semantike:

1. tematike, përafërsisht 39%
2. të përjetuesit dhe të agjentit diku 22 %
   - të qëllimit diku 17%
3. si dhe rolet e tjera dalin proporcionalisht të barabarta dhe të gjitha së bashku (lokacioni, mjeti dhe përfituesi) përbëjnë 22% të korpusit të analizuar.

Këtë përqindje e kemi fituar duke i mbledhur së pari të gjitha rolet semantike ekzistuese për një predikat: pra, kemi shkuar sipas kriterit Theta ku një argument i foljes përputhet me një rol semantik, sipas parimeve të Carnie-t, e pastaj i kemi klasifikuar sipas roleve të mësipërme të paraqitura më lart.

Nëse keto përqindje i krahasojmë me një komunikim të njëjtë, por të kthyer në variantin e shqipes standarde, atëherë përqindjet do të jenë pothuajse të njëjta, me ndonjë përqindje minimale të ndryshuar për shkak të ndryshimit të tërë fjalisë, si psh:

Varianti i viber-it:

C: *se me ardhe shpesh nuk ia kisha fute*

Varianti standard:

Po të vinte shpesh, nuk do ta përfillja, (roli semantik i pësuesit shndërrohet në rol të përjetuesit).

Ose edhe në shembullin tjetër të nxjerrë nga korpusi:

SH: Besom qe ja vlen zonj. XXX	*(Zonja XXX, besomëni që ia vlen)*
SH: Se dyshek ma te mire se ky nuk ka	*(Se dyshek më të mirë nuk ka)*
SH: Po te tregon edhe kualiteti cmimi e sheh edhe cilesin	*(Këtë e dëshmon edhe kualiteti, edhe çmimi)*

Një rezultat i tillë dëshmon se strukturat sintaksore që lidhen me argumentat e foljes e që janë qenësore për përcaktimin e roleve semantike në një komunikim nuk ndryshojnë shumë, siç kemi gjykuar në fillim të hulumtimit, në variantin e gjuhës së viber-it nga varianti standard sepse shqipja nuk ka një rend të ngurtë të fjalëve në fjali dhe kombinimet e tilla të argumentave rreth foljes janë gramatikisht në rregull.

Por, çfarë ndodh me strukturën e strukturave sintaksore në korpusin tonë të nxjerrë nga mesazhet në viber? A dallojnë strukturat e Viber-it nga ato që konceptohen si struktura gramatikalisht korrekte në gjuhën standarde? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, do ta analizojmë strukturën e brendshme të disa fjalive dhe sintagmave themelore që karakterizojnë gjuhën e Viber-it duke përdorur modelin teorik të zhvilluar në kuadrin e gramatikës gjenerative (Chomsky 1980, 1981, 1986).

2. Strukturat sintaksore në gjuhën e Viber-it

Duke filluar nga struktura e fjalisë, tipari i parë që vërejmë është shkurtësia e saj. Në gjuhën e Viber-it, fjalitë janë të reduktuara në minimum. Periudhat rrallë janë të formuara prej më shumë se një fjalie, dhe kur ato janë më të gjata, i gjejmë të prera, si në shembujt e mëposhtëm:

(1) *- e vesh fustanin e ri vjollc*e?
- qe e bleme bashke?

Nga pikëpamja sintaksore, fjalia e parë *e vesh fustanin e ri vjollc*e? është fjali pyetëse, e pavarur; kurse fjalia e dytë *qe e bleme bashke* është fjali relative, e varur, që duhet të hyjë në lidhje me kokën relative *fustan* (Koleci 2013)*;* për këtë arsye nuk mund

të ndahet nga fjalia kryesore. Në gjuhën standarde, fjalia *qe e bleme bashke,* e izoluar nga fjalia kryesore, do të ishte jogramatikore, kurse në gjuhën e Viber-it, që është kontekst specifik, ajo perceptohet gramatikalisht korrekte.

Në një bisedë tjetër, gjejmë një sekuencë si ajo në (2):

(2) - *Ska kuptim me lene*
- *per me dal me shoqe*

Të dyja fjalitë, nga pikëpamja sintaksore, janë fjali jo të plota. Në të parën mungon kundrinori i drejtë, kurse e dyta është fjali me folje paskajore me vlerë qëllimore dhe si e tillë duhet të varet nga një fjali kryesore. Në çdo tekst të shkruar tjetër si, për shembull, në letërsi, ose në gazetari, do të ishin të papranueshme; këtu, me qenë se vijnë njëra pas tjetrës, tingëllojnë si normale, përshtaten me kontekstin. Meqë në gjuhën e Viber-it përdoren fjali me strukturë të reduktuar, fjalitë e nënrënditura trajtohen si fjali të pavarura.

Fjali të tjera që në gjuhën standarde do të perceptoheshin si jogramatikore janë ato në (3):

(3) - *se isha komision*
- *Une nese e marr*

dhe fjalitë eliptike, pa folje, si ato në (4):

(4) *Kafe gjate dites*
sa vjece
me shpinen çel

Këto deshmojnë se gjuha e Viber-it është gjuhë telegrafike dhe tregojnë se efikasiteti komunikues është me i rëndësishëm sesa korrektësia formale.

Jo vetëm struktura e fjalisë, por edhe struktura e brendshme e sintagmave, në Viber, mund të jetë e thjeshtësuar siç e tregon heqja e disa elementeve funksionale, si parafjalët dhe pjesëzat modale të foljeve. Për shembull, në disa mesazhe mungon parafjala që u paraprin rrethanorëve të vendit:

(5) *me shku deti*
shkoj ulqin
shku shpesh shpi

Në gjuhën standarde, rrethanorët e vendit të këtij lloji, shoqërohen nga parafjala *tek* ose *në,* prania e së cilës është e domosdoshme. Në gjuhën standarde, shembujt në (5) do të përbëheshin nga një sintagmë foljore (*me shku/shkoj/shku*) dhe nga një

sintagmë parafjalore (*tek deti/në Ulqin/në shpi*). Në Viber, sintagmat parafjalore janë shpesh të reduktuara. Këtë mund ta vërejmë duke e konsideruar strukturën e brendshme të sintagmës.

Teorinë që do të përdorim për strukturën e sintagmave është ajo që quhet X' (*X-bar*), një teori universale që mund të zbatohet në të gjitha gjuhët natyrore. Sipas teorisë X-bar, sintagmat kanë një strukture hierarkike. Çdo sintagmë është projektimi i një koke. Koka përfaqëson elementin qendror të sintagmës dhe i jep emrin kësaj të fundit. Prandaj, nëse një sintagmë ka si kokë një emër, ajo do të emërtohet Sintagmë Emërore; nëse koka është një folje, emërtimi do të jetë Sintagmë Foljore; kur koka është një mbiemër, atëherë kemi Sintagmë Mbiemërore; nëse është parafjalë, do të quhet Sintagmë Parafjalore. Koka shënohet si X (ose X°), një variabël që mund ta zëvendësojmë me secilën prej kokave leksikore: emrin, foljen, mbiemrin dhe parafjalën. Përveç kokës, që përfaqëson nivelin bazë (ose zero) të projektimit, çdo sintagmë ka një komplement. Koka dhe komplementi i saj formojnë projeksionin e ndërmjetëm, që shenohet si X' (X me një vizë). Projeksioni i ndërmjetëm paraprihet nga tjetër element, specifikuesi. Njësia e formuar nga projeksioni i ndërmjetëm dhe specifikuesi është projeksioni maksimal, që shënohet si X" (X me dy viza). Projeksioni maksimal është paraqitja e plotë e sintagmës. Struktura e sintagmës paraqitet kështu:

(6)



Në strukturën e fjalisë, sintagmat parafjalore projektohen si **adjunktë** që i shtohen foljes në nivelin e ndërmjetëm. Struktura paraqitet si në diagramin (7):

(7)



Sintagma foljore është e formuar nga folja *shkoj,* që është koka dhe nga komplementi. Bashkimi i foljes me komplementin formon projeksionin e ndërmjetëm F'. Përbërësit me parafjalë i shtohen formantit të foljes dhe komplementit të saj duke qenë se janë pjesë e kësaj sintagme foljore.

Në Viber, siç e pamë më lartë, rrethanorët e vendit shpesh i gjejmë pa parafjalë. Domethënë se, fjalitë si *me shku deti/shkoj Ulqin/shku shpesh shpi* nuk kanë një strukturë të plotë si ajo e paraqitur në (7), por një strukturë të reduktuar që përfshin vetëm sintagmën foljore kurse rrethanori i vendit interpretohet si kundrinor i drejtë. Kjo strategji është e mundur sepse folja *shkoj* është jokalimtare, prandaj brenda sintagmës foljore, pozicioni i komplementit është bosh:

(8)



Struktura në diagramin në (8) është më e thjeshtë sesa ajo në diagramin në (7), dhe ky është një nga tiparet themelore të gjuhës së Viber-it.

Elemente funksionale të tjera që mund të hiqen janë pjesëzat që shprehin modalitetin e foljes. Këto përdoren rrallë në Viber, ku foljet janë të zgjedhura në kohën e tashme edhe kur, për shembull, u referohen kohës së ardhme. Ja disa shembuj:

(9) *te premten nuk jam ketu*
per vikend shkoj Ulqin me autobus
kthehem te marten maksimalisht

Struktura e foljes së tashme është shumë më e thjeshtë sepse ajo shpreh vetëm dy tipa të ndryshëm informacionesh morfo-sintaksore: atë të kohës së veprimit dhe atë të përshtatjes, pra tiparet e vetës dhe të numrit. Struktura e foljes në kohën e tashme përbëhet nga dy pozicione: ai bazë, ku gjenerohet folja dhe ai i eptimit, ose i fleksionit, domëthënë pozicioni ku folja bashkohet me tiparet e kohës dhe të përshtatjes me kryefjalën. Në skemën në (10) kemi projektimin e foljes *lexoj*:

(10)



Folja *lexoj* gjenerohet si kokë e sintagmës foljore, por e lë këtë pozicion për t'u ngritur në të majtë të frazës për të marrë fleksionin. Kështu, në sintaksën e shfaqur, atë e gjejmë në pozicionin kokë të sintagmës eptimore. Kjo është struktura e foljes në kohën e tashme.

Foljet që janë të formuara nga pjesëza modale, si koha e ardhme, mënyra lidhore ose ajo kushtore, përveç morfemës të kohës dhe të përshtatjes, përfshijnë edhe pjesëza të pandryshueshme, si *do* dhe *të*. Këto, në strukturën e foljes, nuk janë në pozicionin e fleksionit por zënë një pozicion të ndryshëm nga ai i foljes flektive. Koha e ardhme, për shembull, ka një strukturë më të ndërlikuar që përfshin dy pozicione sintaksore, të etiketuara si Sintagmë Mënyrore, që krijojnë vend edhe për pjesëzat *do* dhe *të*. Pra, struktura e foljes në kohën e ardhme ka pozicionin kokë ku zë vend folja leksikore (*lexo*). Duke u ngjitur drejt pozicionit të fleksionit, folja merr morfemën e kohës dhe të përshtatjes. Por *lexoj* ende nuk është në kohën e ardhme: forma e plotë e foljes duhet të përfshijë edhe pjesëzat *do* dhe *të*, të vendosura në pozicionin kokë të sintagmës mënyrore. Struktura e foljes në kohën e ardhme ka një paraqitje skematike si ajo e mëposhtme:

(11)



Foljet që i gjejmë në gjuhën e Viber-it kanë strukturë të reduktuar, si ajo e paraqitur në diagramin në (10), kurse ato të gjuhës standarde kanë një strukturë më të ndërlikuar, si ajo në (11).

Zakonisht, elementet që eliminohen janë funksionale. Shmangiet dhe lëshimet nuk janë të rastësishme, por më tepër të motivuara nga ana sintaksore. Janë elementet që shpesh lihen jashtë edhe nga fëmijët, dhe nga njerëzit që flasin një gjuhë të huaj. Janë fjalë që nuk kanë një përmbajtje treguese pra, shpesh janë lënë jashtë në mënyrë që elementet leksikore (si emrat, foljet, mbiemrat dhe ndajfoljet) të marrin gjithë vëmendjen e të adresuarit. Pra, shmangiet dhe lëshimet u binden parimeve universale.

Por, tipari që bie më shumë në sy, në gjuhën e Viber-it, është lëvizja e sintagmave, që, në fjali, shpesh ndryshojnë vendin e tyre. Në gjuhën shqipe, rendi normal i fjalëve është subjekt – folje – komplement (si në shembullin *Beni lexon librin*). Në gjuhën e Viber-it, gjejmë shumë raste në të cilët kundrinori i paraprin foljes, si në shembujt në (12):

(12) *asgje mos prishni*
kafe jom ka pi
dyshek ma te mire se ky nuk ka

Në këto tri mesazhe, kundrinori i drejtë *asgje/kafe/dyshek* nuk është i realizuar në pozicionin e tij brenda sintagmës foljore, por ndodhet në fillim të fjalisë, në periferinë e majtë të frazës, në një pozicion *Topikë*. Edhe elementi Topikë i ka tre nivele projektimi, në përshtatje me skemën X': kokën, specifikuesin dhe komplementin. Elemente si *asgje/kafe/dyshek* mbërrijnë në vendin e specifikuesit, të zhvendosur si pasojë e procesit të topikalizimit.

(13)



Jo vetëm kundrinori, por edhe axhunktët, në gjuhën e Viber-it, shpesh i gjejmë në fillim të fjalisë:

(14) *Me qejf kisha ardhe*
Per jastek e carcafe nuk kam nevoje

Në këto raste, sintagmat parafjalore zhvendosen nga pozicioni i tyre fillestar, brenda sintagmës foljore, drejt pozicionit të Specifikuesit të sintagmës Topikë:

(15)



Këto struktura mund të interpretohen si stil i lirë i shkruesit të mesazhit, të lejuara nga fakti se, në gjuhën shqipe, sintagmat mund të zhvendosen lirshëm duke zënë pozicione të ndryshme në frazë.

Shkurt, analiza sintaksore e gjuhës së Viber-it tregon se ky mjet komunikimi, duke i marrë parasysh rrethanat e caktuara ku përdoret, karakterizohet nga prania e fjalive dhe e sintagmave që nuk kanë strukturë të gjuhës standarde sepse nuk janë të ndërtuara sipas rregullave të saj. Dërguesit e mesazheve nuk u kushtojnë vëmendje normave të drejtshkrimit dhe të ndërtimit të fjalive. Kjo lidhet me faktin që Viber-i përfshin shumë karakteristika të të folurit; ka një gjuhë më pak formale, me shprehje tipike të regjistrit bisedor, shprehje rajonale dhe dialektore. Megjithatë, edhe strukturat që dallojnë nga ato të gjuhës standarde, për shkak të shmangieve, të zhvendosjeve, të reduktimeve, perceptohen gramatikisht korrekte sepse nuk e prishin gramatikalitetin e frazës.

Bibliografia

Chomsky, N. (1980), "On Binding", *Linguistic Inquiry* 11: 1-46.

Chomsky, N. (1981), *Lectures on Government and Binding*, Foris, Dordrecht.

Chomsky, N. (1986), *Knowledge of Language*, Praeger, New York.

Koleci, F. (2013), *Frazat relative të shqipes, parë në këndvështrimin gjenerativist,* Klass, Tiranë.

Turano, G. / Koleci, F. (2000), *Sintaksa gjenerative e shqipes*

Rugova, B. Sejdiu-Rugova, L. (2015), *Hyrje në gramatikë të tekstit të gjuhës shqipe*, Koha, Prishtinë

Carnie, A. (2012), *Syntax – A Generative Introduction*, Blackwell Publishing

Linditë SEJDIU-RUGOVA & Giuseppina TURANO

SEMANTIC ROLES AND BASIC SENTENCE STRUCTURES IN THE LANGUAGE OF VIBER IN ALBANIAN

Abstract

The present study investigates the semantic and syntactic roles of verb arguments in the clauses being used in Viber communication in Albanian. It also gives a classification of Albanian clauses based on the type of semantic arguments of the verbs extracted from the Viber communication. Semantic roles are essential elements in analitical deconstruction of clauses into their arguments. However, the number of arguments does not necessarily correspond to the number of semantic roles used in the clauses. The present study shows that the number of semantic roles, besides being mainly dependent on the verb that governs the clause, could rely on the speaker's point of view, too. Therefore, the analysis of the clauses used in Viber communication in Albanian are grounded on the voice as a grammatical factor, situationality as an expression of speaker's perspective and on the structural types of the clauses, typical for Viber messages. The corpus analysed is being extracted from the daily conversations of different social groups (different strata of participants' age and social status) and, as a result, different outcomes have been hinged.

Key words: semantic roles, arguments, clause, complements, voice, discourse

Emilia CONFORTI

GLI ITALIANISMI NELL'ARBËRESH DI ALCUNE COMUNITÀ ALBANOFONE DELLA CALABRIA

Introduzione

La parlata arbëresh è molto influenzata dall'italiano dal momento che è la lingua con cui viene in contatto non solo nel lessico ma anche nella sintassi e nella strutturazione dell'informazione del testo, ed è un idioma di minoranza linguistica storica, che va trattato in termini non unitari e distingue all'interno di esso diverse varietà che si differenziano per i loro tratti peculiari.

L'influsso dell'italiano sulle varietà dialettali arbëreshë, che sono 50 in tutta Italia, è sostanziale anche se si rileva una forte appartenenza alla lingua di origine tanto da aver adattato i prestiti alle forme grammaticali albanesi riuscendo a ricostruire un nuovo codice linguistico.

1. L'indagine linguistica

La difficoltà dell'indagine linguistica applicata alla stratificazione dei prestiti nei dialetti è stata più volte ribadita dagli studiosi che si sono occupati dell'argomento[1]. Non è, infatti, sempre possibile ripercorrere la storia di ciascun vocabolo, soprattutto in assenza di documenti che permettano di stabilire con precisione la data d'inizio della loro diffusione; certo è che si trovano dei prestiti più antichi e altri anche più recenti.

Il caso di *penxonj*, è una prova dei prestiti antichi (non troviamo neppure nei primi scritti degli arbëreshë l'utilizzo di *mendoj*), che nella maggior parte delle comunità albanofone d'Italia diventa *penxonj*, più chiaramente prende in prestito il verbo pensare dell'italiano e lo utilizza in contesto arbëresh, creando oggetto di studio il suo adattamento fonologico, morfologico e semantico degli italianismi nell'albanese. Ciò avviene in diversi settori in cui è richiesto un codice elaborato, nel codice delle relazioni ufficiali quali il settore amministrativo come nel caso di *komun*, *solldët*,

[1] Alessio, 1960; Beccaria 1968; Zolli 1982; Coluccia 1987.

l'italiano ha assunto la funzione di lingua in più settori, anche in quello tecnico-amministrativo e della scienza.

Gli italianismi si piegano molto ai caratteri peculiari della lingua arbëreshe in modo da conservarne una qualche traccia; ma in non pochi casi, la parola arbëreshe è surrogata da una voce del tutto italiana, conseguendo così l'italianizzazione.

L'espandersi dell'obbligo scolastico e della scolarizzazione di massa ha fatto molti passi avanti nell'avanzamento dell'italiano ma non è riuscita a sostituire il dialetto, piuttosto si può parlare di dialetto italianizzato; questo a tutela delle origini nei rapporti con i parenti, i paesani e, soprattutto, con i più anziani. Nelle comunità albanofone è molto vivo il mito della *gjitonia* che vuol dire vicinato, dove si conservano gli usi, gli strumenti e le abitudini e si usano i costumi e la lingua arbëresh, è l'esemplificazione del suo essere coeso e poco aperto verso l'esterno.

Diversa è la situazione che si crea tra genitori e figli perché si pensa che l'abitudine all'uso del dialetto sia nocivo all'apprendimento dell'italiano e che, l'uso del dialetto sia troppo limitato in quanto compreso da pochi sul territorio regionale. L'utilizzo dell'italiano, è considerato sia più vantaggioso a scuola che sul posto di lavoro, fuori dal centro albanofono di riferimento, che rimane un'isola linguistica[2], per l'esigenza di garantire ai propri figli un'ascesa sociale.

Con poche eccezioni, queste comunità, sono circondate ovunque da un mondo linguistico diverso che li separa e contemporaneamente ne determina il carattere della loro lingua[3].

Nella lingua albanese, le ragioni di questa, spesso, pedissequa sottomissione all'italiano per quanto riguarda l'importazione di prestiti adattati sono molteplici, per i prestiti di necessità, si tratta soprattutto di esigenze di precisione e rigore. Quando infatti manca un corrispettivo in albanese per un nuovo conio tecnico(ed ecco che è il prestito moderno), l'italiano presenta il vantaggio di essere funzionale alla comunicazione proprio perché rimane isolato e contribuisce quindi alla monoreferenzialità.

[2] In quanto, dal punto di vista geografico, queste comunità sono disperse e separate l'una dall'altra, ma il dato da considerare è che sono quasi sempre circondate da popolazioni italiane più rilevanti

[3] Çabej, E., 1970.

2. Italianismi per necessità

Alla formazione dei prestiti di necessità concorrono due fattori:

- La difficoltà di tradurre facilmente e adeguatamente in arbëreshë la forma della parola che nella lingua di tanti anni fa non era contemplata come nei casi di *radiografia*, *ecografia*, *certificato*, *convertitore*, *frullatore* e così tanti altri.

Per quanto riguarda invece i molti italianismi che non sono introdotti per necessità, le ragioni della loro importazione si possono riassumere in elementi simbolici e potere connotativo del termine italiano, anche di ordine grafico e fonico come nel caso di *din don* e *toc toc*, il cui motivo di utilizzo potrebbe anche essere stilistico.

- La terminologia e il lessico di norma, le discipline maggiormente esposte all'ingresso di prestiti non adattati sono quelle di nuova formazione come l'economia e l'informatica. Le discipline affermatesi da tempo (medicina, scienze naturali, fisica, chimica), che hanno adottato nomenclature internazionali di base neolatina e posseggono terminologie già sperimentate e stabili, importano prestiti quali *bannare*, *scannerizzare*, *schedulare* e *scrollare*.

3. L'influenza del contatto linguistico

Come dice Camaj (1976), il contatto fra i due gruppi etnici (nonostante gli albanesi vivevano in territorio italiano), dal quale è condizionato il contatto linguistico, avvenne troppo tardi quindi anche a questo elemento si deve attribuire la conservazione delle oasi linguistiche albanesi. Le relazioni matrimoniali tra italiani e albanesi furono successive e dai registri parrocchiali si evince che le donne che giungevano in matrimonio in queste comunità imparavano l'idioma locale e pertanto diventavano bilingui.

Gli italo-albanesi, a un certo punto, si trovarono nella situazione di non poter scegliere, la diglossia era evidente, diventarono plurilingui, "diglossici" perché in genere le nuove generazioni parlano, oltre l'italiano letterario, anche un dialetto italiano[4].

L'influenza dell'italiano è tuttavia riscontrabile sul lessico della parlata arbëreshe anche al di là della terminologia in senso stretto, le basi lessicali nei numerosi prestiti italo-romanzi si combinano con la morfologia flessiva arbëresh in area calabrese[5],

[4] Camaj, 1976.
[5] Altimari, 2010.

come dimostrano alcuni esempi di variazione di uso di verbi, sostantivi, aggettivi e avverbi e l'introduzione di numerose espressioni figurate come *allura*.

Si presentano, qui di seguito, alcuni prestiti documentati nella parlata albanese di Frascineto[6] con il lemma nella prima persona singolare del presente per quanto riguarda i verbi e la forma indeterminata del nominativo per quanto riguarda i sostantivi, seguiti dalle forme attestate:

makin < varietà romanza italo-meridionale machina, italiano macchina, albanese standard *makinë*

orfane < italiano orfano, albanese standard *jetim*

kunill < varietà romanza italo-meridionale *cunigliu*, italiano *coniglio*, albanese standard *lepur*

evitoj < italiano *evitare,* albanese standard *shmang*

imitoj < italiano *imitare,* albanese standard *imitoj*

allura < italiano *allora,* albanese standard *atëherë*

i fort < italiano *forte,* albanese standard *i fort*

pillat < varietà romanza italo-meridionale *pilatu,* albanese standard *tullac*

manxhin < varietà romanza italo-meridionale *manginu*, italiano *mancino,* albanese standard *mëngjarash*

cikarett < italiano *sigaretta,* albanese standard *cigare*

cikarr < varietà dialettale italo-meridionale *zicarru*, italiano *sigaro,* albanese standard *duhan*

akuavit < italiano *acquavite,* albanese standard *raki*

gon < italiano *gonna,* albanese standard *fund*

vest < italiano *vestito,* albanese standard *fustan*

llunxuall < italiano *lenzuolo,* albanese standard *çafçak*

matarac < varietà dialettale italo-meridionale *matarazzu*, italiano *materazzo,* albanese standard *dyshek*

sita < varietà dialettale italo-meridionale *sita*, italiano *seta,* albanese standard *mëndafsh*

biçiklet < varietà dialettale italo-meridionale *bicicletta*, italiano *bicicletta,* albanese standard *biçikletë*

tren < italiano *treno,* albanese standard *tren*

konvend < italiano *convento,* albanese standard *manastir*

[6] I dati sono stati raccolti per mezzo di inchieste svolte presso la comunità di Frascineto con parlanti nativi dell'arbëresh e del dialetto romanzo e permettono una valutazione qualitativa, approssimativa ma realistica, della proporzione dei prestiti nei diversi domini lessicali.

papar < varietà dialettale italiano-meridionale *papara*, italiano *anatra,* albanese standard *rosë*

pullmun < varietà dialettale italo-meridionale *purmuni*, italiano *polmone,* albanese standard *autobus*

fjamifar < varietà dialettale italo-meridionale *fiammifaru*, italiano *fiammifero,* albanese standard *shkrep*

fiordallis < italiano *fiordaliso,* albanese standard *lule misri*

fikatal < italiano *fegato,* albanese standard *mëlçi*

llatrun < italiano *ladro,* albanese standard *hajdut*

llag < italiano *lago,* albanese standard *liqeni*

piligrin < italiano *pellegrino,* albanese standard *pelegrin*

markat < italiano *mercato,* albanese standard *treg*

piumb < italiano *piombo,* albanese standard *shpie*

nip < italiano *nipote,* albanese standard *nip*

birr < italiano *birra,* albanese standard *birrë*

burr < italiano *burro,* albanese standard *gjalpë*

vitjel < italiano *vitello,* albanese standard *gjedh*

kushun < italiano *coscia,* albanese standard *koshë*

llimun < italiano *limone,* albanese standard *limon*

tartarug < italiano *tartaruga,* albanese standard *breshkë*

te < italiano *te,* albanese standard *çaj*

tellefon < italiano *telefono,* albanese standard *telefon*

arkoballen < italiano *arcobaleno,* albanese standard *ylber*

fraghull < italiano *fragola,* albanese standard *dredhzë*

çikonj < italiano *cicogna,* albanese standard *lejlek*

tomb < italiano *tomba,* albanese standard *varrezë*

tavut < varieta dialettale italo-meridionale *tavutu,* albanese standard *varrim*

minester < italiano *minestra*[7]*,* albanese standard *supë*

rastjell < varietà dialettale italo-meridionale *rastiellu,* albanese standard *grabujë*

pllumb < varietà dialettale italo-meridionale *palumbu,* albanese standard *pëllumb*

pekurar < varietà dialettale italo-meridionale *pecuraru*

llim < italiano *lima,* albanese standard *skedar*

taullun < italiano *tavolone,* albanese standard *dërrasë*

rrot < varietà dialettale italo meridionale *rota*, italiano *ruota,* albanese standard *rrotë*

[7] Intesa come pranzo

skarpar < varietà dialettale italo-meridionale *scarparu*, italiano *calzolaio,* albanese standard *këpucar*

vakand < varietà dialettale italo-meridionale *vacande*, italiano *vuota,* albanese standard *bosh*

llurtmu < varietà dialettale italo-meridionale *urtimu*, italiano *ultimo,* albanese standard *i fundit*

tardu < italiano *tardi,* albanese standard *vonë*

kart < italiano *carta,* albanese standard *letër*

moc < italiano *mozzo,* albanese standard *qendër*

pekurarel < italiano *pastorella,* albanese standard *bareshë*

patan < italiano *patata,* albanese standard *patate*

ronx < varietà dialettale italo-meridionale *ronza*, italiano *pozzanghera,* albanese standard *pellg*

muzaroll < italiano *museruola,* albanese standard *surrat*

kanaroc < varietà dialettale italo-meridionale *cannaruazzu*, italiano *gola,* albanese standard *fyt*

fjang < italiano *fianco,* albanese standard *anë*

peturin < italiano *petto,* albanese standard *gjoks*

arxhent < italiano *argento,* albanese standard *argjend*

tabak < italiano *tabacco,* albanese standard *duhan*

aeroport < italiano *aeroporto,* albanese standard *aeroport*

amnisti < italiano *amnistia,* albanese standard *amnisti*

arkiv < italiano *archivio,* albanese standard *arkiv*

aromë < italiano *aroma,* albanese standard *aromë*

muzikand < italiano *suonatore,* albanese standard *lojtar*

sakramend < italiano *sacramento,* albanese standard *sakrament*

dokumend < italiano *documento,* albanese standard *dokument*

speçiallmende < italiano *specialmente,* albanese standard *veçanërisht*

pecende <italiano *pezzente,* albanese standard *lavire*

bronx < italiano *bronzo,* albanese standard *bronx*

çiment < varietà dialettale italo-meridionale *cimentu*, italiano *cemento,* albanese standard *çiment*

diamant < italiano *diamante,* albanese standard *diamant*

divan < italiano *divano,* albanese standard *divan*

kantin < italiano *cantina,* albanese standard *kantinë*

kollegj < italiano *collegio, kolegj*

Prestiti caratteristici della parlata albanofona di Acquaformosa:

abet < italiano *abete,* albanese standard *bredh*

tardu <italiano *tardi,* albanese standard *vonë*

e llurtmja < italiano *ultima,* albanese standard *e fundit*

augurarinj < italiano *augurare,* albanese standard *uroj*

vakand < italiano *vuota,* albanese standard *e zbras*

pitarinj < varietà dialettale italo-meridionale *pittano*, italiano *dipingere,* albanese standard *pikturoj*

fagu < italiano *faggio,* albanese standard *ah*

puxi < italiano *polso,* albanese standard *pus i dorës*

fishkarinj < italiano *fischiare,* albanese standard *fishkëlloj*

çikat < varietà dialettale italo-meridionale *cicatu*, italiano *cieco,* albanese standard *i verbër*

ralarinj < varietà dialettale italo-meridionale *ragliare*, italiano *nitrisce,* albanese standard *hingëlloj*

guerç < italiano *guercio*, albanese standard *i vëngër,* albanese standard *me një sy*

surd < varietà dialettale italo-meridionale *surdu*, italiano sordo, albanese standard *i shurdër*

tavut < varietà dialettale italo-meridionale *tavutu*, italiano *bara*, albanese standard *varrim*

msall < varietà dialettale italo-meridionale *misale,* italiano *asciugamano*, albanese standars *peshqir*

fauçun < italiano *accetta*, albanese standard *sakicë*

shakuarinj < italiano *sciacquare*, albanese standard *shpëlaj*

guadanjarinj < italiano *guadagnare*, albanese standard *fitoj*

xhellaret < italiano *si gela*, albanese standard *ngrihet*

kumandonj < italiano *comandare,* albanese standard *komandoj*

sparanjonj < varietà dialettale italo-meridionale *sparagnare*, italiano *risparmiare,* albanese standard *ruaj*

grasa < italiano *grasso*[8], albanese standard *dhjamë*

tavullun < italiano *tavolone*, albanese standard *dërrasë*

çiminer < varietà dialettale italo-meridionale *çiminera*, italiano *fumaiolo*, albanese standard *oxhak*

skallun < varietà dialettale italo meridionale scalune, italiano piolo, albanese standard *kryqësore*

finestr < italiano *finestra*, albanese standard *dritare*

[8] strutto

kanallet <varietà dialettale italo meridionale *canaletta*, italiano *grondaia*, albanese standard *shtjegull*

markat < italiano *mercato*, albanese standard *treg*

sexh < varietà dialettale italo meridionale seggia, italiano sedia, albanese standard karrige

nana < varietà dialettale italo meridionale *nanna*, italiano *nonna*, albanese standard *gjyshe*

oroloxh < italiano *orologio*, albanese standard *orë*

bambola < italiano *bambola*, albanese standard *kukull*

kart < italiano *carta*, albanese standard *letër*

primavera < italiano *primavera*, albanese standard *pranverë*

autun < italiano *autunno*, albanese standard *vjeshtë*

kosha < italiano *coscia*, albanese standard *kosha*

llabra < italiano *labbra*, albanese standard *buzet*

kavaluc < italiano *cavalluccio*, albanese standard *kali i vogël*

monakele < varietà dialettale italo-meridionale *monachella*, italiano *suora*, albanese standard *murgesha*

tartarug < italiano *tartaruga*, albanese standard *breshkë*

pullmunit < italiano *polmonite*, albanese standard *fruth*

te < italiano *te*, albanese standard *çaj*

akuavit < italiano *acquavite*, albanese standard *raki*

tabak <italiano *tabacco*, albanese standard *duhan*

kanap < italiano *canapa*, albanese standard *kerp*

gon < italiano *gonna*, albanese standard *fund*

llunxuall < italiano *lenzuolo*, albanese standard *çaçaf*

matarac < varietà dialettale italo-meridionale *matarazzu*, italiano *materazzo*, albanese standard *dyshek*

viaxh < italiano *viaggio*, albanese standard *udhëtim*

aropllan < italiano *aeroplano*, albanese standard *avjon*

skollar < italiano *scolaro*, albanese standard *nxënës*

llag < italiano *lago*, albanese standard *liqeni*

llatrun < italiano *ladro*, albanese standard *vjedhës*

libret < italiano *libretto*[9], albanese standard *fletore*

manxhin < italiano *mancino*, albanese standard *i majtë*

martjel < italiano *martello*, albanese standard *çekiç*

[9] Inteso come quaderno

picullun < varietà dialettale italo-meridionale *pizzuluni*, italiano *becco*, albanese standard *sqep*

puci me uj < varietà dialettale italo meridionale *puzzu*, italiano *pozzo*, albanese standard *pus*

qumb < varietà dialettale italo meridionale *chiumbu*, italiano *piombo*, albanese standard *plumb*

raxh < italiano *raggi*,albanese standard *rreze*

rastjel < italiano *rastrello*, albanese standard *rashqel*

sopraçilet < italiano *sopracciglia*, albanese standard *vetull*

spavendapaseri < italiano spaventapasseri, albanese standard dordolec

solldi < italiano *soldi*, albanese standard *para*

trifolza < italiano *trifoglio*, albanese standard *tërfli*

xhirasolli < italiano *girasole*, albanese standard *luledielli*

barbiar < italiano *barbiere*

bors < italiano *borsa*, albanese standard *çanta*

krudhu < italiano *crudo*, albanese standard

guanjun < varietà dialettale italo-meridionale *guagluni*, italiano *ragazzo*, albanese standard *djal*

kanaroc < varietà dialettale italo-meridionale *cannaruazzu*, italiano *collo*, albanese standard *qafë*

kuçin < italiano *cucina*, albanese standard *kuzhinë*

kunill < italiano *coniglio*, albanese standard *lepur i butë*

muzarollja < italiano *museruola*, albanese standard *hundore*

Esempi caratteristici della parlata albanofona di Pallagorio:

malu < varietà dialettale italo-meridionale *malignu*, italiano *cattivo*, albanese standard *keq*

brunz < italiano *bronzo,* albanese standard *bronx*

korqë < varietà dialettale italo-meridionale *corchia*, italiano *buccia,* albanese standard *lëkurë*

timbë < varietà dialettale italo-meridionale *timpa*, italiano *burrone,* albanese standard *hon*

kánav < italiano *canapa,* albanese standard *kërp*

mandiél < italiano *mantello,* albanese standard *mantel*

qíqar < varietà dialettale italo-meridionale *ciciaru*, italiano *cece,* albanese standard *qiqër*

pagumb < varietà dialettale italo-meridionale *palumbu*, italiano *colombo,* albanese standard *pëllumb*

kofshë < italiano *coscia,* albanese standard *koshë*

farisé < italiano *fariseo,* albanese standard *farise*

trappit < varietà dialettale italo-meridionale *trappito*, italiano *frantoio,* albanese standard *mulli të vajt*

putigar < varietà dialettale italo-meridionale *putigaru*, italiano *negoziante,* albanese standard *tregtar*

putigë < varietà dialettale italo-meridionale *putiga*, italiano *negozio,* albanese standard *dyqan*

karramunzë < varietà dialettale italo-meridionale *carramunza*, italiano *zampogna,* albanese standard *gajde*

pupë < varietà dialettale italo-meridionale *pupa*, italiano *bambola,* albanese standard *kukullë*

libër < italiano *libro,* albanese standard *libër*

tribunal < italiano *tribunale,* albanese standard *tribunal*

romanx < italiano *romanzo,* albanese standard *roman*

rivista < italiano *rivista,* albanese standard *rivistë*

purtun < italiano *portone,* albanese standard *hapësirë dere*

Si nota che qualche volta il fonema /ë/ diventa /e/ oppure /i/ in posizione atona e che l'arbëresh /th/ diventa /s/ e che /dh/ diventa a volte /d/ e altre volte /z/.

Gli apporti dialettali si riconoscono perché hanno la vocale in *u* dove in italiano si riscontra la *o* come nel caso di *kancun* (Shkurtaj, 1994), *purtun*, *kartun*, sarebbero passate dunque dal calabrese all'arbëresh.

Un elevato numero di prestiti, perchè provengono dalla stessa lingua, e come quella, hanno le stesse radici, si differenziano nella realizzazione fonetica, avendo, nelle parlate italo albanesi, impronta visibile nell'imposizione dei dialetti italiani da cui provengono.

Dall'analisi dei vocaboli in tabella, si rilevano lemmi di differenti ambiti che vanno da parti del corpo a animali, da miti a oggetti comuni. Il lessico dell'arbëresh, come dice Shkurtaj (1994), viene completato con le voci romanze, prese in prestito sia dall'italiano che dai suoi dialetti.

Savoia (2010) presenta le comunità arbëreshe come un insieme di fenomeni di mistilinguismo, di prestito, di convergenza e di ibridazione linguistica dovuti all'antica e prolungata situazione di bilinguismo fra albanese e dialetto romanzo.

Si rilevano alcuni particolari e significative tipicità come l'aggettivo *i bukur*, del patrimonio originario albanese che si è ben conservato, mentre, l'aggettivo opposto, *i shëmtuar* si è perso ed è perciò stato sostituito con la corrispondente forma romanza (*brutto* in italiano, *bruttu* in calabrese). Il prestito però è stato integrato sul modello morfologico albanese e così sul modello di *i/e/të bukur* è stato creato *i/e/të brut*, con l'elemento lessicale italiano-romanzo adeguato completamente al sistema albanese.

I prestiti aggettivali romanzi sono generalmente caratterizzati da una flessione *u* che per il più delle volte sono invariabili e privi dell'articolo preposto che ricorre con gli aggettivi del lessico di origine albanese, come nel caso di *krudhu*.

Shaban Demiraj (1994), a proposito della lingua degli italo albanesi, dice che si evidenziano delle differenze dalla lingua di Albania ma ne conserva la struttura grammaticale, anche se il lessico è fin troppo influenzato dall'italiano.

Dal punto di vista morfologico si può notare il caso di *finestr* (sostantivo indeterminato arbëresh, mutuato dall'italiano) che segue lo stesso processo del sostantivo *derë* (indeterminato albanese) che essendo di differente provenienza, presentano la stessa affinità strutturale e completano la forma determinata così come le parole del fondo lessicale albanese in *a* pertanto si hanno *dera* e *finestra*.

Ogni sostantivo preso dall'italiano o da un suo dialetto viene adattato al sistema flessivo dell'albanese.

Per quel che riguarda i verbi, gli elementi nuovi vengono integrati in coniugazioni già esistenti.

4. L'approccio sociolinguistico

Dal punto di vista sociolinguistico la descrizione di un repertorio precede un passo più complesso e più generale che sono l'analisi e la variazione linguistica, nel suo aspetto più complesso di variazione non solo di ogni singola varietà, ma dell'intero repertorio verbale di una comunità (intesa come comunità linguistica, per la quale sono note le difficoltà di definizione, soprattutto per l'impossibilità di prescindere dalla caratteristica di comunità insieme linguistica e socioculturale, (Hymes 1972).

Il mutamento linguistico, come sottolineano Marcellesi e Gardin nel 1974 è la funzione del rapporto tra le classi e tra le due diverse lingue a contatto, ne consegue che il legame con la struttura della società è soggetto alle variazioni di quel rapporto, cioè ad un forte quoziente di storicità.

La sociolinguistica, almeno parte di essa nella quale ci riconosciamo, riconduce ogni cambiamento e variazione linguistica essenzialmente a fattori sociali.

La norma sociolinguistica è caratterizzata dalla dinamicità di elementi individuali che poi si basano su vicende anche storiche che hanno dato ad ogni comunità un modello incentrato su un'organizzazione del lavoro e un rapporto tra le classi che sono in contatto con l'area urbana italiana. È una produttività linguistica che va ad alimentarsi a fonti diverse, a partire dal lessico (Alinei, 1977).

Essendo queste due aree contigue, l'italiano mira a estendere in maniera considerevole la sua influenza sulla lingua di contatto che avverte la necessità oggettiva di arricchire il lessico necessario per l'evoluzione della parlata in un contesto molto più sviluppato, in aree più industrializzate e su modelli consumistici sopraggiunti.

Questi fattori individuati si realizzano in spinte innovative che agiscono sulla geografia, sulla vita sociale e sulla vita culturale che caratterizzano i cambiamenti più significativi della lingua, per effetto soprattutto della rapida evoluzione socioculturale, ed anche delle pressanti esigenze della comunicazione rivolta ad un pubblico sempre più vasto, nonché per effetto dell'azione livellatrice dei mass-media e della scuola dell'obbligo.

Gli italianismi raccolti sinora sono più di 100, numero considerevole se se si tiene conto della consistenza del patrimonio lessicale caratteristico e distintivo dei dialetti.

Alcuni italianismi hanno rimodellato la forma originale arbëreshe influenzando il lessico che ha mantenuto la forma grammaticale. Come dice Bartoli, le cause delle innovazioni del linguaggio si risolvono, in ultima analisi, nell'imitazione di altri linguaggi, che abbiano maggior prestigio.

Gli influssi dell'italiano sull'albanese a livello sintattico sono sicuramente meno numerosi di quelli sul lessico, soprattutto perché la grammatica di una lingua, generalmente, oppone maggiore resistenza alle interferenze dall'esterno (Degano 2005), lo stesso cambiamento in due lingue diverse potrebbe infatti essere casuale e non il risultato di un'interferenza.

Difficile è quindi non trovarsi d'accordo con l'affermazione di De Mauro secondo cui "Il miglioramento delle conoscenze di lingue straniere in giro per il mondo va di pari passo con un più diffuso buon uso della lingua nativa". Ne consegue la necessità, non solo di un rafforzamento della didattica di secondo e terzo livello della lingua italo-albanese, fondato anche su un aggiornamento dei metodi didattici, ma anche di una difesa dell'identità e dell'integrità di essa.

5. Conclusioni

Il contatto linguistico tra italiano e arbëresh rappresenta un fenomeno importante della storia linguistica dell'albanese d'Italia. La diversità e la qualità dei fattori extralinguistici hanno condizionato le dinamiche del contatto.

In questa situazione linguistica si evidenzia da una parte una tendenza abbastanza rischiosa rispetto alla sua sopravvivenza e dall'altra un fenomeno piuttosto reattivo rispetto al grado di adattamento delle interferenze.

Malgrado le massicce innovazioni, frutto del lunghissimo contatto dell'arbëresh con l'italiano e il calabrese, la morfologia e la sintassi dell'arbëresh restano essenzialmente di tipo albanese.

Bibliografia

Alessio, G., (1954), *Concordanze lessicali tra i dialetti rumeni e quelli calabresi* - Taranto, Cressati.

Alessio, G., (1960), *Le lingue indoeuropee nell'ambiente mediterraneo* - Bari, Adriatica editore.

Alinei, M., (1977), Aspetti sociolinguistici del lessico italiano, in Simone-Ruggiero

Altimari, F., (1986), Profilo storico-letterari in *L'esilio della parola*, Pisa, ETS Editrice.

Altimari, F., (2010), *Sui prestiti dell'italiano e dei dialetti italo-romanzi, nel sistema verbale dell'italo-albanese*, Napoli, Liguori.

Beccaria, G. L., (1968), *Spagnolo e spagnoli in Italia. Riflessi ispanici sulla lingua italiana del Cinque e del Seicento*, Torino, Giappichelli.

Camaj, M., (1976), Il bilinguismo nelle oasi linguistiche albanesi dell'Italia meridionale, in AA: VV. Bilinguismo e diglossia in Italia, Pacini, Pisa

Coluccia, R., (1987), (a cura di), La cronaca figurata del Ferraiolo, analisi critica, Accademia della Crusca, Firenze.

Çabej, E., (1970), Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre, in *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike*, Tirana.

De Leo, P., (1981), Condizioni economico-sociali degli albanesi in Calabria tra XV e XVI secolo, in *Miscellanea di studi storici*, Università degli Studi della Calabria, Brenner, Cosenza.

Demiraj, Sh., (1994), L'importanza delle parlate arbëreshe d'Italia per la storia della lingua albanese, in *I dialetti italo-albanesi,* a cura di Altimari, F., e Savoia, L. M., Bulzoni Editore, Roma.

Shkurtaj, G., L'influenza dell'italiano sulle parlate albanesi d'Italia, in Dialetti italo-albanesi, Roma.

Savoia, L. M., *Prestiti lessicali e code-mixing nei sistemi arbëreshë*, Parole. Il lessico come strumento per organizzare e trasmettere gli etnosaperi, Rende (Cosenza), 2010.

Zolli, P., (1982), Il contributo dei dialetti all'italiano comune, Cultura e scuola, LXXXI, Bologna.

Emilia CONFORTI

ITALIANISM IN SOME ITALO-ALBANIAN VARIETIES IN CALABRIA

Abstract

Italo-albanian dialect is influenced by Italian language because they are in contact; Italian presence in arbëresh is about lexicon, about sintax and about the information structure.

It is historical linguistic minority idioma and it has different varieties with many different characteristics.

The Italian influence is substantial but it shows an important link with the original language, in fact, the loans have the Albanian grammatical structure.

A new linguistic code was formed.

Giovanni BELLUSCIO, Universiteti i Kalabrisë

VARIETETE/VARIANTE FONETIKE "TENDENCIALE" NË PËRDORIMIN E KONTROLLUAR TË SHQIPES STANDARDE NË NJË EMISION TELEVIZIV TË SOTËM

Abstrakt

Pyetjes "A ekziston një standard i folur të gjuhës shqipe?" me shumë vështirësi mund t'i jepet një përgjigje, edhe pse nga shumë anë dyshohet për vetë "standardin" si sistem gjuhësor real. Megjithatë ka shumë raste në jetën e përditshme ku mund të themi që shqipja shfaqet me një veshje të mirë dhe të çmuar, një model që gjuhëtarët (por jo vetëm gjuhëtarët) zgjedhin ta quajnë "standard".

Cilësitë e standardit deri sot i kanë shprehur/inkuadruar shumë mirë gjuhëtarë si Rexhep Ismajli, Anastas Dodi, Bahri Beci etj., bile dikush arriti edhe të japë përcaktimin e një normë drejtshqiptimore të shqipes standarde (Dodi 1981) por, siç dihet, sot për sot shqipja nuk e ka një normë të tillë; në të kundërtën shpeshherë pohohet që drejtshqiptimi i shqipes rrjedh drejtpërsëdrejti nga drejtshkrimi i saj. Por edhe ky pohim nuk del si i vërtetë, jo vetëm pse gjuha e shkruar ndryshon shumë nga gjuha e folur, por edhe pse rregullat e shqiptimit të lirë nuk kanë "ngurtësinë" e mirënjohur të shkrimit.

Nga ana tjetër mund të themi që në të gjitha traditat gjuhësore, përballë normës gjuhësore të sanksionuar nga rregullat dhe nga tradita, ka një prirje të formohet një përdorim më i lirshëm të gjuhës, që është pjesë e regjistrave joformale të të foluri. Ky përdorim përfaqëson nëvojën e komunikimit të një shtrese mesatare të popullsisë të së folësve dhe kjo gjë krijon dhe rrezaton përdorime që gjallërojnë deri sa të përhapen aq sa të kapërcejnë linjën e normës, duke u bërë pronë e të gjithë bashkësisë së të folësve. Kjo tendencë, në kontekste të tjera si Italia, u emërua prej gjuhëtarëve si "varietet i përdorimit mesatar" të gjuhës dhe ne, në rastin e shqipes, mund ta quajmë "shqipja e përdorimit mesatar". Dikush propozoi edhe termin "neostandard", por ky në kontekstin e shqipes nuk na duket i përshtatshëm për atë që sapo kemi shprehur më sipër. Më 1983 gjuhëtari italian Alberto Mioni përdori për herë të parë shprehjen "italishte tendenciale" dhe këtë emërtim mendojmë ta përdorim edhe ne në rastin e

shqipes së folur që në këtë kontribut po marrim në shqyrtim vetëm nga pikëpamja fonetike.

Materialin që kemi përdorur e kemi nxjerrë ngar një emision televiziv të regjistruar në prill të 2016 në një kanal shqiptar privat. Në këtë emision i propozohet publikut një bisedë midis një gazetare (me formin universitar) dhe tre pedagogëve të universitetit të Tiranës. Në studio tematika është gjuha shqipe dhe dialektet e saj, pra analiza jonë gjuhësore do të merret me të folurit të lirë dhe të kontrolluar, ose të kujdesur, i përdorur nga folës që jo vetëm në profesionin e tyre merren me gjuhën por që në kontekstin formal të televizionit flasin për gjuhën dhe ofrojnë një përdorim të kujdesur të shqiptimit të shqipes bashkëkohore, d. m. th. një model që të katër folësit "kujdesen" që të pasqyrojë sa më shumë një regjistër të lartë, d. m. th. "standardin e folur". Synimi i analizës është ai të verifikojë cilët janë prirjet shqiptimore të shqipes së sotme diamezike dhe diabrezore si edhe nëse është i mundshëm përcaktimi i tendencave (pikërishtë atë që nënkupton shprehja "shqipe tendenziale") që mund të ndjek gjuha e folur në të ardhmen.

Fjalë çelës: Shqipja bashkohore, fonetika, analizë akustike, drejtshqiptimi, "shqipja tendenciale"

1. Prirjet dhe "tendencat" në gjuhën e folur.

Evolucioni gjuhësor ka shumë ndryshore dhe transformimet në gjuhë mund të jenë të ndryshme, në shumicën e rasteve edhe të pajustifikueshme ose të papritura. Siç dihet ka vetëm një gjuhë e cila nuk dryshon kurrë dhe kjo është gjuha e ashtuquajtur e vdekur, siç janë p. sh. latinishtja ose greqishtja klasike. Gjuhësia, nga Saussure-i e këndej, është kryesisht gjuhësi përshkruese, në disa raste mund të jetë preskriptive por asnjëherë mund të jetë "parashikuese", së pari sepse ndryshimet gjuhësore janë afatgjata dhe, së dyti, sepse gjuha, si dukuri historike-shoqërore nuk udhëton e kushtëzuar brenda një hullie e cila bën që ajo të ndjekë një drejtim të parapërcaktuar. Megjithatë disa ndryshime, duke analizuar në hollësi situatën brenda dy-tri brezash, mund edhe të imagjinohen ose të pranohen si "të mundshme", sidomos kur konsiderohet aspekti fonetik i të foluri.

Po të marrim parasysh njërin prej aspekteve që kam analizuar, siç është p. sh. tendenca ë zhdukjes së fonemës /h/ në gjuhën shqipe, jemi në gjendje ta barazojmë me situata që u paraqitën në gjuhë të tjera. Latinishtja kish një tingull të tillë si në foljen *habeo* 'kam' e cila duhet të ketë pasur patjetër shqiptimin me frymëtim nistor ['habeo] por në gjuhët që dolën nga latinishtja /h/ u zhduk, (shiko ital. *avere*, ku *h*-ja

ngeli vetëm si shenjë grafike në trajtat *ho*, *hai, ha* 'kam, ke, ka' për të shmangur ngatërrimin me lidhëzen *o* 'ose, apo' dhe me parafjalën *ai*, si në *ai maestri* = mësuesve). Edhe greqishtja e vjetër kishte në sistem një frymëtim, të ashtuquajturin *spiritus asprus*, i cili mund të dilte vetëm në fillim të fjalës, gjurma e tij u zhduk që në periudhën bizantine dhe nuk është më e pranishme në greqishten e re. Përveç kësaj këtu na duket e dobishme të përmenden edhe realizimet të ndryshme të /h/ në dialektet e shqipes si edhe në të folmet arbëreshe të diasporës (Belluscio 1994) gjë që na tregon si kjo fonemë, megjithëse me ngarkesë funksionale relativisht të vogël, paraqet ndrishueshmëri të gjerë.

Nga ana tjetër kemi shembullin e Labov-it lidhur me qytetin e New York-ut në vitet 50-60 të shekullit të kaluar, ku, duke analizuar një kampion folësish, zbuloi kontekstin shoqëror ku ndryshimi gjuhësor paraqitej. Patjetër ndryshimi gjuhësor pritet në një shkallë të gjerë dhe, për këtë arsye, përfundimi se është e mundur të parashikohen rezultatet është i gabuar. Megjithatë, duke analizuar një kampion mjaft të gjerë informatorësh, me një sasi të madhe të dhënash, dhe duke krahasuar sadopak tre breza, kjo analizë dinamike mund të ofrojë mjete për të hipotizuar parashikime të cilat, është e natyrshme, do të mbeten vetëm, dhe gjithmonë, ne kushte thjeshtë probabilistike.

Pra, duke mos qenë e mundur që gjuha të evoluojë e kushtëzuar brenda një shtegu të caktuar, mund të priten ndërhyrje rrethanash me prejardhje jashtë sistemit të vetë gjuhës, të cilat mund të drejtojnë në shmangie të papritura, dhe në ndryshime të tjera, në rrugën e evolucionit në të cilën gjuha jeton.

Për sa u përket ndryshimeve, kuptohet vetiu se ka disa prej tyre që janë më të natyrshme dhe më të përhapura se të tjera, p. sh. është më normale që një sistem të thjeshtësohet sesa të ndërlikohet, pra ka më mundësi që një gjuhë me zanore hundore të ndjek rrugën e çhundorëzimit sesa të ndodhë e kundërta.

Atëherë, shenjat që na jep sot gjuha shqipe e folur ka të ngjarë që në të ardhmen të ngurosen dhe të bëhen sistematike, kjo gjë do të ndodhë brenda një ekuilibri i cili varet nga forcat që do të veprojnë brenda dhe jashtë saj. A do të jetë më e fortë shtytja nga poshtë apo ajo nga lartë? d. m. th. do të jetë më i fuqishëm ndikimi i bazilektit ose ai i akrolektit[1]?

Me sa duket, drejtimi i vektorit sot na tregon se ka sidomos një shtytje poshtë-lartë sesa lartë-poshtë, kjo do të thotë që është sidomos "neostandardi" që ushqehet nga gjuha popullore kurse "gjuha e lartë" ushtron më pak ose fare presion ndaj sistemit substandard. Situata gjuhësore e sotme në Shqipëri paraqitet ndryshe nga ajo

[1] Për këto dy koncepte dhe për çështjen e gjuhës shqipe të konsideruar si policentrike shih Prifti (2009).

italiane e viteve 60-70 kur presioni i mediave (sidomos i televizionit) bëri që italishtja "standarde" të përhapej edhe në shtresa të popullatës ku dikur ishte e pamundur një shpengim gjuhësor[2]. Fatkeqësisht për ndikimin e mediave mbi gjuhën në Shqipëri në këte çerekshekullin e fundit nuk kemi të dhëna as njohuri shkencore.

Ky kontribut, megjithëse aty këtu mund t'i afrohet ose mund ta kujtojë sociolinguistikën, nuk është një studimi i tipit sociolinguistik. Ai është kryesisht i tipit fonetik dhe merr parasysh analizën e disa ndryshorëve në të folurit spontan të tre pedagogëve universitarë dhe të një gazetare, i prodhuar gjatë një emisioni televiziv. Pra gjuha e përdorur pasqyron një regjistër të lartë të të folurit të kontrolluar i cili, sipas nesh[3] paraqet një prej zbatimimeve më formale të standardeve optimale të gjuhës së sotme shqipe.

2. Varietet, variant, ndryshore

Këto terma kanë një traditë të gjatë në fushën e gjuhësisë, dhe sidomos në degën e sociolinguistikës ku përdorimi i tyre është më i përhapur.

Për *varietet* gjuhësor kuptohet një prej shumë mundësive reale që kanë gjuhët për t'u shfaqur. Termi është disi neutral në barazim me kategoritë klasike gjuhë, dialekt, e folme, idiolekt etj. Zgjodha të përdor këtë term që kur kam lexuar Chambers dhe Trudgill (1987:18) të cilët e preferojnë pikërisht për faktin që secili sistem gjuhësor duhet konsideruar nga gjuhëtarët njësoj si të tjerët, pra gjuhë standarde dhe dialekt janë varietete të së njëjtës gjuhë.

Varianti është shfaqja e mënyrave të ndryshme në të cilat një gjuhë përdoret nga folësit, pra mund të kemi një "variant të lartë" si në rastin e gjuhës standarde ose të gjuhëve letrare apo zyrtare, si edhe një "variant të ulët". Variant mund të jetë edhe çdo trajtë në të cilën realizohet një ndryshore, *ndryshorja* është një element i gjuhës i cili paraqet variacion.

Këtu do të merrem me një varietet gjuhësor — shqipja e folur — i cili paraqitet në një variant të saj "të lartë", d. m. th. shqipja standarde (e kontrolluar) dhe do të analizoj disa ndryshore që paraqesin interes për të kontrolluar cilët janë prirjet e sotme të këtij varieteti gjuhësor në segmentin e tij fonetik. Kjo mund të tregojnë, duke u mbështetur në një model të përdorur para tri dekadash nga Sabatini (1980) dhe Mioni (1983), si "mund" të evoluojë standardi i folur në të ardhmen.

[2] Literatura për këtë çështje është e gjerë por mund të japim si shembull kontributin e Nora Galli de' Paratesi (1984) me bibliografi përkatëse.

[3] Ky mendim është mbështetur edhe nga autorë të tjerë brenda dhe jashtë trevës shqipfolëse (Munishi 2013:1667, Bell 1984).

3. Variacioni gjuhësor

Kur flasim për *përdorim të kontrolluar* të gjuhës nënkuptohet një variant i hipernyjëtuar nga pikëpamja fonetike, me një përdorim të trajtave gjuhësore më të mira dhe më të sakta, më një nivel sintaksor më të zgjedhur dhe më formal. Këto janë mirëfilli trajtat që karakterizojnë të ashtuquajturën "gjuhë të emetuar" (ose gjuha e radios dhe të televizionit), e cila është një (nën)varietet i gjuhës së folur[4].

Sipas Bell-it (1984) stili i të folurit lidhet drejtëpërdrejt me kontekstin (dhe me auditorin) në të cilin ai përdoret, pra kemi variacione në të folur të cilat mund të jenë të tipit "gjuhësor" dhe "jashtëgjuhësor", ashtu siç tregon grafiku në fig. 1. Kjo pemë e Bell-it jep në mënyrë figurative edhe kontekstet shoqërore që ndikojnë në prodhimin e gjuhës së folur, pra variacionet mund të jenë ti tipit stilistik, d. m. th. që i përkasin folësit (mosha e folësit, klasa shoqërore, marrëdhëniet me realitetin, gjinia e folësit, shkollimi, etj.) dhe shoqëror, të cilat i përkasin marrëdhënieve midis folësve (kujdesja në të folurit, marrësi(t), argumenti i trajtuar); në degën boshe në të djathë të këtij degëzimi të të fundit, në vend të trepikëshit mund të shtohet "konteksti" dhe, në rastin tonë, mund ta saktësojmë atë me "studio televizive".



Fig. 1 *Disa faktorë që ndikojnë në variacionin gjuhësor* (sipas Bell 1984)

[4] Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një koncept i cili është më i ndërlikuar se sa mund të duket. Në fakt edhe gjuha e emetuar prezanton disa trajta që bëjnë që ajo të ndahet në: a) të folur serioz (i cili përdoret në emisione divulgative, shkencore, politike), b) të folur bisedor (ai i emisioneve zbavuese, me lodra etj.) dhe c) të folur të ulët/lënë pas dore (si të folurit që përdoret në talk-show dhe reality show).

3.1. Qëllimi i këtij kontributi është të analizojmë gjashtë[5] dukuri fonetike të gjuhës shqipe standarde të folur të emetuar:

1. Përshpejtimi i nyjëtimit (Articulation Rate)
2. Shqiptimi i /e/ si /ə/ në kontekst hundor
3. Togu zanor /ua/
4. Kundërvënia /ɾ/ ~ /r/
5. Shqiptimi i /h/
6. Diftongu /ij/

3.2. Metoda

Për analizën e përshpejtimi të nyjëtimit (Articulation Rate), siç u tha më sipër, u zbatua e njëjta procedurë që u përdor në Belluscio (2012). Duke u nisur nga materiali i videoregjistruar, ai u transformua në dokument audio dhe, nëpërmjet programit Audacity®, u bë ndarja në segmente atje ku folësit morën frymë (pra 1 segment = 1 një njësi frymëmarrëse). Çdo segment i numëruar është klasifikur dhe ruajtur në një database, kështuqë operacionet e bëra mund të përsëriten për verifikime të mëtejshme. Të gjitha segmentet u transkriptuan duke pasqyruar shqiptimin real (d. m. th. nuk u bë një transkriptim ortografik por "fonologjik" me kuptimin që, p. sh., nuk u transkriptuan *ë*-të atje ku nuk dëgjohen, ose *rr*-ja kur ajo u shqiptua si *r*, u transkriptuan pauzat e plota, u shënuan me të zeza ndryshoret e zgjedhura etj. Për ta bërë më të lexueshëm materialin nuk e pashë të rastit të bëja transkriptimin fonetik). Për sëcilin segment u llogaritën rrokjet duke patur parasysh shqiptimin real dhe duke konsideruar si një rrokje të vetme zanoret e afërta që shqiptoheshin si të bashkuara etj. Në fund u bë analiza statistikore e të dhënave.

Për dukuritë fonetiko-fonologjike u mbështeta vetëm në vlerësimin dëgjimor duke përdorur të gjitha mundësitë që ofron *Audacity*® (seleksionimin dhe ridëgjimin e sinjalit, manipulimin, përmirësimin, dhe ngadalësimin etj.), modifikimet u aplikuan vetëm në fazën e dëgjimit, kurse i gjithë materiali është ruajtur ashtu siç është në origjinal.

3.3. Materialet

[5] Dukuritë 2 dhe 3 u zgjodhën edhe nga Shkumbini (2013), kurse e katërta nga Imajli (2003:78) dhe nga Hysenaj (2014). Siç mund të shihet disa pika paraqiten objektivisht si problematike.

Regjistrimi i një emisioni televiziv u shkarkua nga Youtube në internet. Emisioni u dha në prill të 2016 dhe zgjat një orë (ai përmban edhe një insert redaksional i cili nuk u mor në shqyrtim).

Emisioni është *live*, në studio të një televizioni privat. Pjesëmarrësit janë katër: një gazetare intervistatore (e cila mbaroj studimet universitare) dhe tre të ftuar, pedagogë të Universitetit të Tiranës (1 mashkull mbi 70 vjet, dhe dy gra 35-40 vjeçare)

Për këtë analyzë u përdorën vetëm 16 minutat e para të emisioni. Pjesëmarrësit përdorën një të folur të lirë, duke respektuar turnet dhe duke ndërhyrë në bisedë vetëm kur sëcilit i është drejtuar gazetarja. Subjektet janë: YY_gazetarja, AA_pedagogu, BB_pedagogia1, CC_pedagogia2. Trankriptimi i plotë i materialit jepet në shtojcë.

4. Përshpëjtimi i nyjëtimit[6] (Articulation Rate)

Jacewicz et al. (2009) vënë në dukje që ndryshueshmëria e shpejtësisë së të folurit varet nga disa ndryshore siç janë varieteti gjuhësor, mosha e folësit, gjinia dhe tipi i të folurit (i lexuar ose i folur). Për sa i përket ndryshueshmërisë midis sistemeve, në Belluscio (2012) kam dhënë disa rezultate lidhur me substratin gjuhësor të spikerëve të ndryshëm në shqiptimin e gjuhës shqipe radiofonike (në disa radio të Ballkanit).

Edhe Kendall (2009) thekson se frymëmarrja dhe gjatësia e pauzave janë ndryshore shoqërore që lidhen me vendin, me përkatësinë etnike dhe me gjininë e folësit; megjithatë përshpejtimi i të folurit (Speech Rate), më shumë sesa pauzat, duket që tregon një lidhje të drejtpërdrejtë me faktorët shoqërorë, çka vërtetohet edhe nëpërmjet zbulimeve në fushën e psikolinguistikës rreth ndryshueshmërisë së pauzave. Në rastin tonë kemi deri tani shumë pak material për të vërtëtuar me siguri situatën e shqipes në të folurën e emetuar. Megjithatë rezultatet që kemi në dorë na tregojnë patjetër një drejtim i cili përfaqëson nga njëra anë ndryshueshmërinë brenda dhe midis grupëve dhe nga ana tjetër varësinë nga faktorë që lidhen me karakteristikat e folësit.

Së fundi, duhet mbajtur parasysh edhe korelacioni midis pauzave (frymëmarrjeve) dhe gjatësisë së "shprehjes" (përdorimi i termit "shprehje" përdorët këtu në raport me termin origjinal anglisht "utterance"; në rastin tonë, lidhur me matjet që kemi bërë, është më i përshtatshëm termi "grup frymëmarrës"), është e

[6] Ka një ndryshim midis përshpëjtimit të nyjëtimit (Articulation Rate) dhe përshpejtimit të të folurit (Speech ose Speaking Rate), i pari llogaritet duke pjesëtuar numrin e rrokjeve me zgjatjen kohore të shprehjes (grup frymëmarrës) pa llogaritur pauzën bosh (= frymëthithjen) kurse i dyti duke shtuar edhe pauzat.

natyrshme që pas një shprehje (= grup frymëmarrës) të gjatë deri në 10 sekonda, folësi ka nevojë fiziologjike për një pauzë frymëmarrëse më të gjatë.

Në kampionin e analizuar u llogaritën në përgjithësi 124 grupe frymëmarrëse, 2690 rrokje për një zgjatje kohore 512,11 sekondash. Mesatarja e përshpejtimit të nyjëtimit për të katër subjektet është 5,25, që do të thotë pak më shumë se 5 rrokje për sekondë.

Situata e detajuar që paraqitet në Tab. 1 tregon që përshpejtimi i nyjëtimi më i ulët është ai i subjektit mashkull, megjithëse jo shumë i largët nga ai i subjekteve femra BB dhe CC. Ky rezultat është në kundërshtim më atë të Jacewicz-es, sipas së cilës nyjëtimi i subjekteve meshkuj del si më i shpejtë në barazim me atë të femrave. Por këtu duhet konsideruar edhe një ndryshore tjetër si mosha, e cila ndikon jo pak në uljen e kësaj vlere nyjëtimore.

Inf	**grupe frymëmëm.**	**koha**	**mesat.**	**rrokjet**	**mesat.**	**Articul. Rate**
YY	32	111,22	6,95	763	23,84	6,86
CC	19	73,80	3,88	362	19,05	4,90
BB	36	159,02	4,41	761	21,13	4,78
AA	37	168,07	4,56	734	19,83	4,36
Shuma	**124**	**512,11**		**2620**		

Tab. 1. Të dhëna për kohën, rrokjet dhe Speech Rate

Interes tregon edhe rezultati i llogaritjes së pështpejtimit të nyjëtimit të gazetares YY, në këtë rast ai largohet për më shumë se dy pika më nga vlerat mesatare e subjekteve të tjerë, që do të thotë gati 7 rrokje për sekondë. Ky rezultat është edhe pak më i lartë se ai i spikerëve të Radio Tiranës (Belluscio 2012) megjithatë mund të tregoj një afinitet midis të folurit të spikerëve profesionalë. Për saktësi duhet të nënvizoj që barazimi nuk është i plotë sepse për subiektin YY kemi analizuar të folurit të lirë, kurse për spikerët e radios të folurit është i lexuar. Edhe në këtë rast, sipar literatures për këtë çështje, ka ndryshime midis dy varianteve gjuhësore por nuk janë domethënëse nga pikëpamja e nyjëtimit.

Gazetarja e TV (2016)	6,86
Spikerët e Radio Tiranës (2012)	6,70

Një tjetër hipotezë bëri që të verifikohej edhe shpërndarja e gjatësisë së grupeve frymëmarrese dhe nëse kjo shpërndarje mund të kishte ndonjë vlerë domethënëse. Nga rezultate, që paraqiten në figurat 2 dhe 3, del që pjesa më e madhe shprehjeve ka një gjatësi midis 1 dhe 2 sekonda; vijnë pas ato me 3-4 dhe 4-5 sekonda. Në pozicion skajor kemi shprehjet më të shkurtra (< 1 sekondë) dhe më të gjatat (> 7 sekonda). Brenda folësve dalin disa tendenca personale por numri i shembujve në dispozicion nuk është i mjaftueshëm për të nxjerrë rezultate të sigurta.



Fig. 2. Shpërndarja e gjatësisë së grupeve frymëmarrëse sipas folësit



Fig. 3. Shpërndarja mesatare e gjatësisë së grupeve frymëmarrëse

5. Shqiptimi i /e/ si [ə] në kontekst hundor

Në /eN/ ka prirje të kalojë drejtë /əN/ ku /N/ është një tingull hundor. Në materialin e analizuar del që ruajtja e shqiptimit me /e/ bashkëekziston, edhe në të njëjtin folës, me ndryshimin në /ə/:

/e/ = 9. *Qendra*, 23 *ka qen*, 124 *gjendjen* (YY), 30 *kan' qen'*, 98 *qendrën*,

/e/ > /ə/ = 3 *duke qën'*, 5 *ka qën'*, 18 *t' vëndit*, 70 *kam qën'*, 106 *brënda*, 113 *përmëndura*;

Para tridhjetë vitesh Dodi (1985:117) shkruante: "La norme de l'albanais parlé se reflète dans les habitudes linguistiques du sujet parlant dont la réaction à l'égard des variantes differentes de la prononciation est un indice de son application juste. P. ex. les prononciations suivantes: *qën*, *e ënjte*, *shtrënjt*, *brija*, *gështeja*, *çqep*, provoquent actuellement une réaction chez les auditeurs et sont consideréréé comme des traits nettement dialectaux." sot, siç shkruan Shkumbini (2010) për sa i përket shqiptimit të *e*-së vlerësimi sociolinguistikë ka ndryshuar krejt: "Një shembull i zhvillimit konvergjent është p.sh. shqiptimi i fjalëve me *ë* dhe jo me *e* si p.sh. *vëndi*, *mëndja* etj. Ky tipar që nuk është i gjuhës standarde, por i toskërishtes, ka fituar prestigj duke qenë se ka hyrë nëpërmjet folësve nativë të toskërishtes dhe pastaj, duke qenë i markuar me prestigj, ka filluar të përdoret në të folurit standard edhe nga folësit që për varietet nativ e kanë gegërishten.". Kjo dukuri u shqyrtua edhe nga Hysenaj (2015:434) i cili e analizon lidhur me modelin gjuhësor të nomenklaturës komunistë të Shqipërisë dhe e konsideron si trajtë me "prestigj" duke u mbështetur në të dhëna statistike të nxjerra nga materiale të incizuara të kohës. Edhe në këtë rast kam vënë në dukje (Belluscio 2012).

6. Realizimi i togzanorit /ua/

Togzanori /ua/ (në kundërvënie me variantet gege /ue/ ~ /u/, prej të cilave i pari u pranuar në gjuhën standarde për formantet *-ues*, *-ueshëm*[7]) u zgjodh si njëri prej gjashtë ndryshoreve të përdorura nga Munishi (2013:171) për të monitoruar zbatimin e normës së gjuhës standarde në Kosovë.

Subjekti YY prezanton shqiptim të plotë në shtatë raste mbi shtatë (*studiuar*, *përvjuar*, *theksuat*, *quajm*, *caktuar*, *harruar*, *haruar*) poashtu edhe subjekti BB (në tetë raste mbi nëntë: *interesuar*, *përkufizuar*, *kufizuar*, *komunikuar*, *caktuar*, *orientuar*, *filluar*, *organizuar*, dhe me një monoftongim të vetëm në shembullin 69: *ndryshur*) dhe CC (2 raste: *munguar*, *trajtuara*). Subjekti AA, mbi 20 shembuj, paraqet një situatë të trefishtë: a) në tetë raste "ruajtje" (*gëzuar*, *ftuar*, *botuar*, *bashkpunuar*, *dua*, *t'e thuash*, *pothuaj*, *u botua*), b) në dhjetë raste "reduktim në *uë*"(*ideuër*, 2 herë, *realizuër* 3 herë, *botuër*, *duë t' ju…*, *skeduër*, *kaluër*, *filluër*) dhe c) në dy raste "monoftongim": 33 *studjus*, 56 *punur*. Në përgjithësi të

[7] Dodi (1983:114) shkruan: "Le group de voyelles *ue* dans la langue littéraire provient du guègue et il se rattache aux formations avec *-shëm* et *-s* du type *punueshëm*, *punues*, *kalues*, etc. Ainsi, on trouve dans la même structure *ua* et *ue*: *kaluar*, *kalueshëm*, *kalues*, [*punuar* G.B.] *i punueshëm*, *punues*." por nuk jep asnje vlerësim rreth shqiptimit të tij në standard.

katër subjektet me një përqindje të lartë (25 raste mbi 38 = 65,78%) ruajnë shqiptimin e plotë të togzanorit, kurse vetëm në tri raste (= 8,33%, mendojmë në momentet më pak të kontrolluara) kemi monoftongim. Me interes duhet konsideruar reduktimi *ua* > *uë*. Kjo dukuri, të cilën subjekti AA e paraqet dhjetë herë mbi 20 (= 50%), mund të konsiderohet si mungesë të *target*-it e lidhur me përkatësinë dialektore të subjektit, megjithatë i njëjti realizim u shfaq (edhe atje pa rregullsi) në të folurit e spikerëve të Radio Tiranës: *ftuër*, *zhvilluëra*, *u realizuën*, si edhe në shqiptimin e spikerëve të Radio Maqedonisë dhe të RTK-së në Turqi (Belluscio 2012:455).

7. Realizimi i togzanorit /ua/

Togzanori /ua/ (në kundërvënie me variantet gege /ue/ ~ /u/, me të parin që u pranuar në gjuhën standarde për formantet *-ues*, *-ueshëm*[8]) u zgjodh edhe nga Munishi (2013:171) si njëri prej gjashtë ndryshoreve të përdorura për të monitoruar zbatimin e normës së gjuhës standarde në Kosovë.

Ne materialin e analizuar subjekti YY prezanton shqiptim të plotë në shtatë raste mbi shtatë (*studiuar*, *përvjuar*, *theksuat*, *quajm*, *caktuar*, *harruar*, *haruar*) poashtu edhe subjekti BB (në tetë raste mbi nëntë: *interesuar*, *përkufizuar*, *kufizuar*, *komunikuar*, *caktuar*, *orientuar*, *filluar*, *organizuar*, me një monoftongim të vetëm në shembullin 69: *ndryshur*) dhe CC (2 raste: *munguar*, *trajtuara*). Subjekti AA, mbi 20 shembuj, paraqet një situatë të trefishtë: a) në tetë raste "ruajtje" (*gëzuar*, *ftuar*, *botuar*, *bashkpunuar*, *dua*, *t'e thuash*, *pothuaj*, *u botua*), b) në dhjetë raste "reduktim në *uë*"(*ideuër*, 2 herë, *realizuër* 3 herë, *botuër*, *duë t' ju*…, *skeduër*, *kaluër*, *filluër*) dhe c) në dy raste "monoftongim": 33 *studjus*, 56 *punur*. Në përgjithësi të katër subjektet me një përqindje të lartë (25 raste mbi 38 = 65,78%) ruajnë shqiptimin e plotë të togzanorit, kurse vetëm në tri raste kemi monoftongim (= 8,33%, gjë ka ndodhur patjetër në momentet më pak të kontrolluara të të folurit). Me interes duhet konsideruar reduktimi *ua* > *uë*. Kjo dukuri, e cila shfaqet dhjetë herë mbi 20 (= 50%) në të folurit e subjektit AA, mund të konsiderohet si mungesë të *target*-it e lidhur me përkatësinë dialektore të subjektit, megjithatë i njëjti realizim u shfaq (edhe atje pa rregullsi) në të folurit e spikerëve të Radio Tiranës: *ftuër*, *zhvilluëra*, *u realizuën*, si edhe në shqiptimin e spikerëve të Radio Maqedonisë dhe të RTK-së në Turqi (Belluscio 2012:455).

[8] Dodi (1983:114) shkruan: "Le group de voyelles *ue* dans la langue littéraire provient du guègue et il se rattache aux formations avec *-shëm* et *-s* du type *punueshëm*, *punues*, *kalues*, etc. Ainsi, on trouve dans la même structure *ua* et *ue*: *kaluar*, *kalueshëm*, *kalues*, [*punuar* G.B.] *i punueshëm*, *punues*." por nuk jep asnje vlerësim rreth shqiptimit të tij në standard.

8. Kundërvënia /ɾ/ ~ /r/

Këtu flasim për një kundërvënie e cila ka një ngarkesë funksionale shumë të vogël në sistemin e shiqpes. Kemi të bëjmë me ndryshore që në toskërishte[9] janë "variante alternative e jo konkurrente (Hysenaj 2014:434) dhe që sot në gjuhën e folur paraqesin një shqiptim që nuk ruan në një asnjë mënyrë trajtat fonetike të mirëfillta si bashkëtingëllore njëdridhëse dhe shumëdridhëse (Jubani 2012) duke u realizuar më shumë si bashkëtingëllore përafëruese[10]. Në materialin e analizuar vërehet një asimetri në favor të fonemës /ɾ/ e cila del 451 herë, kundër 15 rasteve të /r/. Probleme nyjëtimore paraqet vetëm fonema /r/ e cila në 8 raste mbi 15 (53%) shqiptohet nga subjektet si /ɾ/:

rr= subjekti YY: 20 *rrall'*, 60 *harruar*, 61 *(h)arruar*; sub. AA: 56 *terren*, 44 *burrat*, 50 *rrin*; sub. BB 76 *territorin;*

/r/ > /ɾ/ = 26 *teren*, 65 *harees'* (= harresë), 68 *thitur*, 101 *teren*, 102 *teren*, 107 *maar'*, 114 *ka mar'*, 122 *teren*). Shembujt tregojnë që gazetarja YY dallon mire dy fonemat (vetem në fragmentin 122 shqipton *teren*) poashtu edhe subjekti AA (mbi katër raste vetëm në 26 shqipton *teren*); subjekti BB mbi tre raste vetëm një e shqipton me rr (76 *territorin*) kurse subjekti CC neutralizon fonemat në katër raste mbi katër.

9. Shqiptimi i /h/

Një risi e standardit (por jo vetëm e standardit) e cila me sa di deri sot nuk është konsideruar si ndryshore[11] është prirja ndaj dobësimit në shqiptim deri në zhdukje të kësaj foneme. Edhe në këtë rast folësit u treguan të kujdesshëm dhe të kontrolluar.

[9] Ismajli 2003:78 saktëson situatën dialektore dhe shpjegon zgjedhjen e këtij tipari për standardin: "Kundërvënia r/R nuk ekziston më në shumë të folme toske, por as në disa të folme gege; metjithatë, dallimi përmes këtij tipari i një grup fjalësh të përdorura shpesh ishte baza për zgjedhjen e tij si tipar të shqipes standarde."

[10] Hysenaj (2009) i kushton një studim kësaj kundërvënieje në të cilin jep të dhëna për drejtshkrimin e këtyre dy tingujve dhe për dallimin e tyre nga ana e studenteve dhe të nxënësve. Nuk pajtohemi me autorin kur pohon se realizimi i sotëm konsiston në një neutralizim/rrafshim në favor të një nyjëtimi të ndërmjetëm që ai shënon me /ɾ́/"varianti i ndërmjetëm tingullor, që qëndron midis *r*-së dhe *rr*-së". EdheKuçi (2001:318) e zgjedh këtë kundërvënie si shembull për shmangiet nga norma në të folurit e spikerëve të televizionëve kosovarë.

[11] Ismajli (2003:78) bën fjalë për *h* (bashkë me *ll* dhe *j*) në variantet dialektore, por shënon vetëm "kanë pësuar zhvillime të mëtejme drejt *j*, *h*, *hj*, *gh*, sidomos tek arbëreshët". Në Belluscio (2015:283) kisha tashmë shkruar: "Oggi si nota la tendenza nel realizzare questo fonema in modo sempre più debole [ʾɲoʰuɾ] *njohur* 'conosciuto', fino alla sua cancellazione: [ezi'timi] *hezitimi* 'l'esitazione'."

Subjekti AA (14 raste) shfaqi gjithmonë një nyjëtim të plotë, poashtu edhe subjekti YY i cili mbi 17 raste vetëm një herë prezanton mosshqiptimin e /h/ 100 *duet*. Subjekti BB (mbi 13 raste) për 4 herë (tre në pozicion të afërt) 64 *gju'* (gjuhë), 68 *referoemi*, 68 *njoʰur* dhe 96 *gjuʰsor* ose nuk e nyjëton këtë fonemë ose prezanton një shqiptim mjaft të dobët të tij. Edhe më domethënëse është situata e paraqitur nga subjekti CC i cili mbi 7 raste për katër herë (edhe në pozicion nistor) nuk e realizon shqiptimin e /h/: 103 *furnizoet*, 111 *orientoʰeshin*, 111 *ulumtimin*, 121 *ulumtues*.

10. Tri risi të tjera

Përveç ndryshoreve që kemi parë sipër dua të shënoj edhe tri dukuri fonetike të tjera që sipas meje tregojnë interes. Këto dukuri mund të konsiderohen ende në bërthamë në barazim me ato që kam analizuar në paragrafët 5-8, por duke qenë që dy prej tyre shfaqën edhe në materialet që kam përdorur në Belluscio (2012) dhe sidomos në Belluscio (2015) atëherë prania në një kampion materialesh që vjen e zgjerohet bëhet edhe më shumë domethënëse. Flas së pari për shqiptimin e mbylltores /t/ me frymëtim të ndjeshëm, sidomos në pozicion fundor, dukuri që kam regjistruar në katër shembuj të prodhuar nga subjektet YY (59 *do tʰ... do tʰ ndalem*, 61 *ditʰ*), BB (65 *tjerëtʰ*) dhe CC (106 *vetʰ*), kurse ajo nuk del në asnjë rast në të folurit e subjektit AA, pra kjo duhet të konsiderohet patjetër si variacion diabrezor, risi fonetike e brezit më të ri[12]; së dyti për reduktimin (ose monoftongimin) e diftongut zbritës /ij/ për realizimin e të cilit ka sot një prirje për ta shqiptuar si /i/ me ose pa gjatësi. Shembujt në materialin e analizuar janë pak: 56 i ti (i *tij*), 72 *shtrüm'* (= shtrijmë), 116 e *ti* (e tij), jo sepse nuk paraqitet kjo dukuri por sepse ky tip diftongu nuk ka një përhapje të gjerë, megjithatë shembuj të tjerë janë regjistruar edhe në të folurit që kam analizuar në Belluscio 2015:285) ku vura në dukje për herë të parë këtë dukuri[13]; së fundi, edhe pse ka ende nevojë për t'u shqyrtuar dhe analizuar në thellësi, mendoj që është me interes shqiptimi i labërguar i zanoreve (sidomos /e a o/) në pozicion fundore të fjalës dhe, me sa duket, edhe në pozicion fundor të sintagmës ose të fjalisë, d. m. th. në kufi morfeme. Kjo dukuri shfaqet vetëm në të folmen e grave dhe tërheq vëmendjen jo vetëm për labërgimin por edhe për faktin që shqiptimin paraqet një trajtë fonetike që

[12] Edhe këtë aspekt e vura në dukje në Belluscio (2015:280) "Un aspetto innovativo della lingua sembra essere la sensibile presenza di aspirazione nella realizzazione delle occlusive sorde,soprattutto in posizione finale di parola: [e ˈʃtetitʰ] *e shtetit* 'dello stato', [əʃtʰ] *është* 'è', [uˈrimetʰ] *urimet* 'gli auguri'."

[13] "In posizione iniziale prima di /i/ e in fine di parola, quando preceduta da /i/, [gjysmëzanorja /j/]tende a non essere pronunciata: /vij/ → [vi(:)] *vij* 'vengo', [aˈtiˈ] *atij* 'a quello, a lui', [eˈipja] *e jipja* (*e jepja*) 'lo davo'"

quhet anglisht *creaky voice* (zë i krrokatur). Nuk më duket të jetë një trajtë stilistike, mendoj më shumë shoqërore dhe ndoshta tiranase. Ky "stil" del në shumë vende në materialin e analizuar por dëgjohet edhe në gjuhën e emetuar, sidomos në leximin e lajmeve.

11. Përfundime

Standardi i gjuhës shqipe po i afrohet dyzetvjeçarit të tij dhe sot folësit janë më shumë të ekspozuar ndaj ndikimit të tij sesa në të kaluarën. Nuk mund të thomi nëse ekspozimi është më shumë ndaj variantit të shkruar ose të folur por rritja e kanaleve televizive dhe të stacioneve radiofonike bëri patjetër që trajta e folur të bëhet më e pranishme në jetën e përditshme të folësve. Pra ndikimi i të folurit të emetuar, ashtu si edhe në realtitete të tjera, bën që ky varietet të bëhet model dhe të fitojë prestigj. Nuk duhet mohuar edhe fakti që nuk mund të flasim për një standard të vetëm. Po të konsiderohen varianti standard që flitet në Kosovë dhe ai që flitet në Shqipëri vërehet që, megjithëse kemi të bejmë me të njëjtën tipologji gjuhësore, me të njëjtin sistem, realizimet në të folur nuk janë të njejta. Pra pyetja vjen: a duhet të flasim për konvergjencë apo për divergjencë midis dy varieteteve? Unë jam i bindur që standardi i shqipes është duke u dyfishuar (ndoshta edhe trefishuar) dhe se jemi në një situatë policentrizmi gjuhësor, megjithatë një anketë që kam bërë midis dhjetë kolegëve, kosovarë dhe shqiptarë, ka dhënë si rezultat që drejtimi i shqipes standarde bashkëkohore po ndjek padyshim një proces ndaj konvergimit. Nuk kam të dhëna për situatën reale kosovare në një kontekst të afërt me atë që kam përdorur në këtë studim, pra jam i bindur që një analizë e tillë duhet bërë edhe për standardin e përdorur në Kosovë dhe ballafaqimi i rezultateve mund t'i japë përgjigje dhe mund tregojë drejtimin ndaj konvergjencës apo divergjencës.

Patjetër standardi "i Tiranës" (por ndoshta më shumë nënstandardi) është në lëvizje e këndej, dhe siç kam vën në dukje ai është duke evoluar nga pikëpamja fonetike. Folësit duke iu afruar standardit jo vetëm marrin prej tij por edhe ndikojnë në të duke krijuar dukuri të reja që në një të ardhme jo të afërt mund ta ndryshojnë.

Dhe këtu vjen fjala për prestigjin. Në botimet për vlerësimet "shoqërore" të standardit shpesh flitet për prestigjin e tij etj. por deri sot nuk kemi analiza që të merren me këte aspekt të gjuhës. Si sprovë empirike mendova për një anket "al volo" rreth prestigjit të disave prej dukurive që kam analizuar duke iu referura një kampioni të përzier folësish të shkolluar dhe kolegë të Tiranës, gjithësej pesë veta, dhe ata konfirmuan se shqiptimi i fjalëve *vend*, *brenda* etj. (me /e/ dhe jo me /ə/) konsiderohet krejt normal, kurse përdorimi i *rr*-së si e tillë (d. m. th. si shumëdridhëse, në vend të *r*-

së) "nuk do të ngacmonte vëmendjen e dëgjuësit", dhe në fund, shqiptimi i të gjitha *h*-ve dhe i togzanoreve të plota "do të ishte shqiptimi i sforcuar".

Situata e sotme tregon që trajta e shkruar gjuhës vazhdon të jetë më e ngulitur se sa trajta e folur, kështu që trajta e folur po largohet nga ajo e shkruar. Megjithatë ka dhe shembuj që vënë në dukje që disa trajta të të folurit janë duke dëpërtuar edhe në gjuhën e shkruar të përditshme, dhe kjo mund të verifikohet në përdorimin reale të gjuhës, si në rrugë ashtu edhe në *social media*. Më parë që të vija në Prishtinë për Seminarin isha në Pogradec dhe rastësisht më ra syri mbi një tabele dyqani ku trajta me *ë* në vend të *e*-së ishte zyrtarizuar: "mish vëndi" dhe kjo më bëri përshtypje sepse më shumë sesa një gabim drejtshkrimor ishte një dëshmi e përzierjes së të folurit me të shkruarit. Shembujt janë shumë dhe janë aty për të na treguar një fakt të natyrshëm, d. m. th. që gjuha shqipe është e gjallë dhe që është duke ndryshuar. Kush duhet ta marrë përsipër barrën e korrigjimit të gabimeve në të folur dhe në të shkruar? Shkolla? Familja? Shteti? Historia e *Appendix Probi* na tregon që nën presionin e latinishtes së folur mësuesi anonim që mundohej t'u mësonte nxënësve trajtat "standarde" të gjuhës nuk ia doli, sepse në ato gabime ishte në bërthamë ajo gjuhë që pastaj u bë italishtja. Nuk është kjo situata e shqipes së sotme, por si do të konsiderohej sot një mësues që përveç variantit të shkruar do të merrej edhe me atë të folur të shqipes? A do të ishte qesharake një tabelë si kjo këtu poshtë? Ndoshta po, sidomos për faktin që trajtat në krahun e majtë është e pamundur të shqiptohen ashtu siç janë shkruar edhe në Prishtinë edhe në Tiranë.

APPENDIX PROBI
2016

vendi	jo	vëndi
hulumtim	jo	ulumtim
vij	jo	vi
arkeolog	jo	arkeolok
mësues	jo	msus
harresë	jo	hares
njohur	jo	njour
ndryshuar	jo	ndryshur



Bibliografi

Bell Allan (1984), Language style as audience design. *Language in Society* 13, 145-204.

Belluscio Giovanni (2012), Si shqiptohet shqipja në Ballkan? *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 433-472.

Belluscio Giovanni (2015), Fonematica contrastiva italiano-albanese. M. G. Busà, S. Gesuato, *Lingue e contesti. Studi in onore di Alberto M. Mioni*, Padova: CLEUP, 277-292. <www.academia.edu/15480671/>

Chambers J. K., Peter Trudgill (1987), *La dialettologia*. Bologna: Il Mulino.

Dodi Anastas (1985), La langue littéraire albanaise parlée et sa norme phonétique a l'époque actuelle. *Studia albanica* 1, Tiranë, 109-119.

Hysenaj Haki (2009), Kundërvënia fonologjike /r/ /R/, rrafshim dhe reflekse në gjuhën e folur dhe të shkruar. *Aktet e Seminarit të XXVIII ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë, 403-408.

Hysenaj Haki (2015), Ndikimi i ideologjisë në varietet e shqiptuara të shqipes. *Aktet e Seminarit të XXXIII ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare* (Prishtinë 18-30 gusht 2014), Prishtinë, 439-439.

Ismajli Rexhep (2003), Kodi, norma dhe mësimdhënia e gjuhës. R. Ismajli, *Standarde dhe identitete. Histori, procese dhe lëvizje në fushë të gjuhës*. Pejë: Dukagjini, 153-158.

Ismajli Rexhep (2003a), Shqipja standarde dhe shkolla. R. Ismajli, *Standarde dhe identitete. Histori, procese dhe lëvizje në fushë të gjuhës*. Pejë: Dukagjini.

Jacewicz Ewa, Robert A. Fox, Caitlin O'Neill, Joseph Salmons (2009), Articulation rate across dialect, age, and gender. *Lang Var Change* 21(2), 233-256. www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC2790192/

Jubani Aljula (2013), *Manual i fonetikës akustike dhe i teorisë së fonologjisë*. Tiranë.

Mioni Alberto M. (1982), Variabilità linguistica e contrastività. D. Talleri e C. Marello (a cura di), *Linguistica contrastiva*, (Atti del XII Congresso internazionale di studi, Asti, 26-28 maggio 1979. Roma: Bulzoni, 339-357.

Mioni Alberto (1983), Italiano tendenziale: osservazioni su alcuni aspetti della standardizzazione. P. Benincà et al., *Scritti linguistici in onore di Giovan Battista Pellegrini I*. Pisa: Pacini, 494-517.

Munishi Shkumbin (2010), *Gjuha standarde shqipe dhe konvergjenca e gjuhës së folur* <linguasocio.blogspot.it/2010/01/gjuha-standarde-shqipe-dhe-konvergjenca.html>

Munishi Shkumbin (2013), Shqipja standarde e folur në Kosovë. Sh. Munishi, *Probleme të shqipes standarde në Kosovë*. Prishtinë: AIKD-99, 159-196.

Nencioni Giovanni (1976), Parlato-parlato, parlato-scritto, parlato-recitato. *Strumenti critici* 29, 1-56. <nencioni.sns.it/fileadmin/template/allegati/pubblicazioni/1976/SC_1976.pdf>

Kuçi Sedat (2001), Kultura e të folurit në televizion (RTK,TV21, KTV). *Aktet e Seminarit të XX ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare, vëll.* 1.Prishtinë, 315-318.

Prifti Elton (2009), Gjurmime variacionale mbi shqipen standarde një shekull pas Kongresit të Alfabetit. B. Demiraj (editor), *Der Kongress von Manastir – Herausforderung zwischen Tradition und Neuerung in der albanischen Schriftkultur*. Hamburg: Dr. Kovač, 114-129

Sabatini Francesco (1980), Linee di tendenza dell'italiano contemporaneo e problemi di norma. *Atti del I Convegno degli insegnanti di Italiano in Finlandia* (Turku 17-18 maggio 1979). Turku: Università di Turku, Sezione di italiano, Facoltà di Lettere, 73-92

Sorella Antonio (2010), *La "questione" della pronuncia italiana*. <italianlang.org/mondo-lingua-e/antonio-sorella>

Tyler Kendall (2009), Speech Rate, Pause, and Linguistic Variation: Evidence from North America. *New Ways of Analyzing Variation (NWAV)* 38. Ottawa, Ontario, Canada.

Thomaj Jani (1998), Marrëdhënie të standardit me nënstandardin në shqipen e sotme. *Letërsia shqipe dhe gjuha letrare* (Simpozium 1-2 nëntor 1996). Prishtinë: ASHAK.

Shtojca

Transkriptimi i 16 minutave të para të të folurit të emetuar
në të cilin është mbështetur ky studim

N.	Subje-kti	Zgjatja e Shpre-hjes në sekonda	<> shënon frymëthithjen | shënon një ndërprerje të të folurit, një pauzë, pa frymëthithje **t^{h}**: *t* e frymëtuar, me *shkronja të pjerrëta* jepen pauzat e plota ose fillimi i gabuar i të folurit; ndër kllapa () plotësohen fjalët të keqshqiptuara; shqiptimi i gjatë i zanoreve jepet me dyfishimin e zanores. # tregon ndërhyrjen e një folësi tjetër [ZZMM] mbivendosje zërash
1	YY	5,68	Mirmbrëma mirserdhët në Teempull jemi drejtpersdrejti ne niuz njëzedekaatër do t' flasim sonte për dialektet <>
2	YY	4,96	çfar' ndodh me variantet dialektore n' fakt çfar' ka ndoodhur si dhe sa jan' studiuar ato…<>
3	YY	4,92	*aa* përvijohet studimi i tyre duke qën' se gjuhaa… evoluon?<>
4	YY	7,16	*ë* dhe kjo është' normale jemi për t' folur për ç' kan' bër' studiuesit tan' për dialektet *nëë ndëër ëë* dekada në fakt <>
5	YY	8,40	profesor **AA** ka qën' njëri ndër hartuesit e atlasit të dialektologjis' t' gjuhës shqipe mirmbrëma faleminderit ç' jeni në studio <>
6	AA	1,55	mirmbrëma mir' se ju gjeta
7	YY	9,68	*aa* një tjetër studjuesee e lidhur ngùshtësisht me dialektet […] *bë-* e departamentit t' gjuhës shqipe *ee ëë* pran' universitetit t' Tiraanës zonja **BB** mirmbrëma mir' se erdhët <>
8#	BB		(…)
9	YY	8,44	tjedër *eëë* gjuhtare ktu në studio nga Qendra e studimve àlbanologjike në fakt sintaksologe *ëëë* zonja **CC** mirmbrëma mir' se erdhët <>
10	CC	1,16	mir' se ju gjeta <>
11	YY	5,06	në nisje do t'shkojm' në kt' inser(t) për t' hedhur le t' themi dy tre pyetje kryesore see <>
12	YY	6,23	për çfar' jemi sonte ktu pse ësht' e rëndsishme t' flitet për

			dialektet çfar' ësht' bër' dhe sigurisht çfar' duhet t' bëhet <>
13	YY	2,44	çfar' ësht' ajo | urgjenca e madhe <>
14	YY	6,80	ç' duhet t' bëhet me dialektet | me variantet tona dialektore | si pjes' shum' e rëndsishme e gjuhës shqipe | shkojm' në insert kthehemi <>
15	YY	6,92	jemi në studio natyrshëm vjen ta nisim bisedën bashk', profesor, pse do flasim në nisje sigurisht për një tradit' shum' t' vyer <>
16	YY	2,64	atë të studimeve *tëë* të dialektevee <>
17	YY	2,03	*ëë* të ktij atlasi ç'ësh' ktu<>
18	YY	5,86	*ë* t' një pune disavjeçare t' një ekipi studiuesish gjuhtarësh nga më t' mirët t' vëndit çë pak <>
19	YY	2,91	e diin ç'egzistoon n' qoft' se nuk je gjuhtaar' <>
20	YY	5,2 1	*ë* t' munt t' ndodh shum' rrall' që ta pikasësh ktë vepër <>
21	YY	6,28	*ëë*… pse e kemi kt' mosnjohje ndaj… ndaj… ndaj gjith' ksaj traditee… t' studimit t' dialekteve?
22	AA	7,45	unë jam *ëëë* i gëzuar që sonte në ktë emision që na keni ftuar <>
23	AA	8,20	flasim për nj' vepër qëë ka qen' e fshtir' për t'u ideuër… pë' t' u realizuër… dhe për t' u botuër <>
24	AA	5,28	për një arsye qëë ësht' e ditur nga vet' shkenca e dialektologjiis' <>
25	AA	9,26	gjuhtarët *stud*-… *hm* dialektologët jan' gjuhtaar edhe ata punojn' n' tavolin' sii | t' tjerët por | dialektologët jan' pak si arkeologët si etnografët <>
26	AA	1,13	duet t' skojn' edhe n' teren <>
27	AA	8,36	dheee… për hir' të së vërtetës | për atlasin dialektologjik | po edhe për punimet *ëë* dialektore monografit' dialektore q' jan' botuar në vite <>
28	AA	4,40	ma mer menia see *ëë* | duhet folur më shuum <>
29	AA	3,50	edhe uun' besoj | edhe në emër tëë kolegve qi nuk jan' mëë <>
30	AA	7,21	qi kan' bashkpunuar… | ose kan' qen' autor' | t'ndjerit Xheladin Gosturanii të Anastas Dodit | profesorit <>
31	AA	6,10	dhe Minella Totonit | po edhe t' profesor Jorgjit e t' Bariut qi jan' bashkautor' *k*-… n' ktë vepër <>
32	AA	4,09	duë t' ju fanderoj qëë | e sillni n'vëmendje ktë vepër të madhe <>

33	AA	6,87	e cila për mendimin tim *ëë* | jo thjesh' siii | bashkautor por si studjus i dialektologjis' <>
34	AA	3,63	hyn në vepratëë | shumvjeçaare ësht' nj' vepër afatgjaat <>
35	AA	7,20	dhee ësht' nj' vepër qëë | ësht' ideuër herët edhe nga profesor Çabej me synimin që të bëhej nji atlas <>
36	AA	5,93	kushtet ishin t' tilla që… lufta e dyt' botrore e pengoi realizimin e pyetsorit të profesor Çabejt<>
37	AA	1,81	mbeti për pas luftes dhe |
38	AA	2,54	Istituti i gjuhsis' dhe i letërsis' e ka pasur…<>
39	AA	5,17	siç përdorej at'her' emërtes' tëë *ëëë* akademiz' dhe t' kshillit (t') ministrave, praa…<>
40	AA	1,28	ishte nji vepër për t' cilën…<>
41	AA	0,89	u nxor fondi…<>
42	AA	5,91	që të shkohej nëpër ... pikat e ndryshme | qi nga Vermoshi dher' n' Konispol | nuk ësht' metafor' po ësht' realitet…<>
43	AA	6,55	dhe un' besoj see në qoft' se ka mbetur *d*-gjall' ndonji nga *ii-ëëë i-* informatorët…<>
44	AA	4,33	ataaa subjektet siç i themi n' dialektologji | burrat dhe graat qi na kan' shërbyer…<>
45	AA	1,59	dua t'i përshëndes sepseee…<>
46	AA	6,47	me shum mirpritje, me shum' bujari kan' nejt' | jo oor dit' të tëra për t' ju përgjigjur pyetjeve…<>
47	AA	1,16	t' cilat jan' t' shumta<>
48	AA	2,15	dhe ndojher' edhe pak t' bezdisshme sepseee…<>
49	AA	4,73	pastaj kur përsriten fjalët atij sigurisht i vjen që *ëb-*…<>
50	AA	9,21	do ta fillosh që n' mëngjes çfar' bën dielli kur… del edhe | nuk do t' i thuash a lind a nuk lind | ai do t' thot' lind dielli del diedhi rrin diedhi ra dielli… <>
51	AA	1,65	pra esht' një lodhje edhe për atë…<>
52	AA	2,78	ësht' e lodhur | pra ësht' nj' pun' e mundimshme për t' u realiz**uër**<>
53	AA	6,58	ësht' nj' pun' e mundimshëm në tryes | për të sked**uër** të gjitha fjalët që jan' në ktë atlas në form' hartash…<>
54	AA	3,27	kan' kal**uër** në dorën e sëcilit prej nesh q' i kemi mbledhur…<>
55	AA	3,42	dhe pastaj i kan i ka par' redaksia i ka par' kryedaktori. <>

56	YY+ AA	x	jo [*edhe*] më kot' ka zgjatur disa dhjetra vite hartimi i ti, ësht'… || e! e! ësht' një pun' pra | ka fill**uër**… *ke-* kemi punur nj' zet vjet për taa realiz**uër** kriteret parimet pyetsorin dhe anketat në terren<>
57	AA	4,94	dhe për fat t' keq u deshën *d-* pothuajse nj' zet vjet t' tjera në pritje që t' botohej dhe…<>
58	AA	x	kemi fatin e mir' që t' paktin u botua. <>
59	YY	0,71	do *tʰ-* do tʰ' ndalemi | do t' ndalemi profesor por ndërsa hynim në emision ju that' që…<>
60	YY	3,24	*ë-* n' fakt flitet për dialektologjiin' | ësht' harruar…
61	YY	6,61	e ju mendoni sigurisht q' nuk' ësht' arruar | pse ju çdo dithe me studentët punoni | çdo dit' jeni në kontakt *ëë*…<>
62	YY	2,97	*ëëë m* edhee | studioni apo jo ktë gjë? <>
63	BB	4,50	sigurisht | sepse të studiosh gjuhën do t' thotë tëë studiosh gjith' varietetet e saj. <>
64	BB	3,73	me thën' studendët *eee* gju' letërsis' jan' shum' të qart' për ktë<>
65	BB	3,83	arsya pse duket se të tjerëtʰ e kan' lën' në harees'…<>
66	BB	1,60	'përse pavarsisht se gjuhaaa…<>
67	BB	2,63	ësht' mjeti me t' cilin komunikojm' të gjith'…<>
68	BB	6,78	kur i referoemi studimeve të saj | jo të gjith' jan' të thirur dhe të interesuar për t' njoʰur detajet e studimit të gjuës…<>
69	BB	9,58	*ëëë* poor tashmë ka ndryshu- ka ndryshur mënyra sesi ne punojm' për studimin e këtyre varieteteve dhe un' nuk do t' thoja të vetëm dialekteve. <>
70	BB	9,14	*ëëë pë-… ë* që kur kam qën' studente | me i mund lekcjonet e profesorit që pikërisht njëri nga termat *dot-* … më t' vështir për t'u përkufizuar ësht' termi dialekt <>
71	BB	0,71	Edheee…<>
72	BB	6,33	unëë do t' thoja që | më mir' ta shtriim' në studimin e varieteteve të shqipes s' sotme…<>
73	BB	3,43	*ëë* sesa t' mbetemi të kufizuar vetëm tek dialektet.
75	BB	1,48	ai lidhet jo vetëm mee…<>
75	BB	4,86	*ëë* pasi çdo folës ësht' i lir' t' zgjedh variantin në t' cilin komunikon, <>
76	BB	6,02	*ëë* si *p-* pozicionin gjeografik | territorin ku *a-* ku ai është…

			ka lindur, jeton, <>
77	BB	1,95	por lidhet me stàtusin e tij social<>
78	BB	6,36	lidhet me kontekstin /*gh! gh!*/ t' gjitha kto që *ku-* kushtëzojn' n' nj' far' mënyre dhe variantin…<>
79	BB	2,60	q' zgjedh për t' komunikuar nj' folës i caktuar. <>
80	BB	6,58	*ëë* në rastet para viteve nëntëdhjet' studimi i dialekteve ishte […] i orientuar…<>
81	BB	8,21	ngaaa *ë* programet *n-* në planet e kërkimit shkencor të *institute-* institutit t' gjuhsis' dhe letërsis' departamentit të gjuhës…<>
82	BB	4,89	*ëë* pas viteve nëntëdhjet' ndryshon forma *ee* mënyra e organizimit t' ksaj pune <>
83	BB	5,29	*ëë* gjithmon' e më shum' kjo ësht' e lidhur me projektet *e ë* departamenteve por edhe me projektet individuale t' profesorve <>
84	BB	2,64	*ëëë* ne në departamentin e gjuhës…
85	BB	4,98	*ëëë ëë* që preej | kohën [*po* AA] kur profesori ka qën' shef i departamentit <>
86	BB	4,92	*ëëë ësht-* kan filluar projektet e para për studimin e emrave të para *ë-* për zbunimet <>
87a	AA	2,08	# edhe për zhvidhimin e kt'e dialekteve #
87	BB	3,25	për emërtimin *ee-* për fitonimiin'...[AA##]…e kshtu me raadh. <>
88	BB	4,94	Dhe më pas ne kemi pasur disa projekte shum' t' rëndsishme ku kemi përfshir' edhe studentet tan' <>
89	BB	3,06	kemi *ëë* organizuar me mbështetjen e*ee*…<>
90	BB	3,74	AKTit ne at' ko: | agjensis' *ëë* për kërkimin dhe teknologjin'<>
91	BB	2,84	një projekt shum' t' mir' për studime në Shqiprin' e mesme [hm] <>
91a	BB	5,29	e patëm nisur me një projekt më t' vogël për *Ti- ë-* zonën e Tiranës dhe e shtrim' më pas në Shqiprin' e mesme<>
92	BB	3,80	dhee në vitin dymijetrembdhjet' kem' pasur një tjetër projekt shum' t' mir' <>
93	BB	3,13	*ëë* për komunikimin ndëretnik në Ballkan | fal të cilit…<>
94	BB	5,30	*ëëë* patëm mundësi të bënim mëë… ndoshta ekspeditën e dyt' tek arvanitasit…<>

95	BB	5,74	*ëëë* e para shum' vite më par' | q' na ka dhën' nj' knajsi shum' t' madhe por dhe q' na ndihmoi t' mblidhnim material<>
96	BB	1,33	shum t' mir' gju^{h}sor [hm YY]
97	BB	3,56	i cilii ndoshta pas pak vitesh nuk do t' mund të gjëndet më. <>
98	YY	9,11	[ZZMM] në fakt *ëëm* ekspeditat jan' shum' t' rëndsishme | çfar' ndodh në qendrën e studimeve albanologjike | a mundeni ju t' kryeni ekspedita…<>
99	YY	5,37	çfar' mun' t' bëni ju | dhe pastaj do t' ndalemi sërisht tek atlasi për t' folur pak edhe me profesorin për atë çë… <>
100	YY	2,73	mun' t' jen' dhe disa mangësii jo pse duet [#sigurisht# AA] Po<>
101	CC	9,86	*aaa* me t' drejt' YY ju e ngrini ktë pyetje sepse n' fakt siç ju tha edhe profesori një nga || kriteret kryesore të punës s' një dialektologu ësht' puna n' teren. <>
102	CC	4,41	e pa punën n' teren ësht' si t' jet' si peshku pa uj' | për dialektologun. <>
103	CC	9,54	*ëë* e vërteta ësht' që ka shum vite qëë QëSëAja dhe instituti i gjuhsis' i cili ësht' pjes' e QëSëAs' ka vite që nuk… nuk furnizoet fare me fonde…<>
104	CC	1,50	për t' kryer ekspedita t' tilla. <>
105	CC	3,17	kshtuqë n' ktë aspekt mun' themi që jemi disi varfër<>
106	CC	8,16	megjithatë kjo nuk do t' thot' që kan' munguar përpjekjet personale të vet^{h} punonjsve shkencor' brënda institutit t' gjuhsis' dhe letërsiis'<>
107	CC	1,57	t' cilët jan' maar' me studimet *ee*…<>
108	CC	3,71	*ee* dialekteve t' ndryshme | madje n' shkollën ton' pasuniversitare<>
109	CC	0,77	ka qën' një ndër<>
110	CC	7,50	*ëë* një ndër prioritetet kryesore që studentët e mir' | t' cilët vinin për studime pasuniversitare dhe zhvillimin e tyre profesional <>
111	CC	2,78	'të oriento^{h}eshin në ulumtimin e mëtejshëm të…<>
112	CC	2,77	t' folmeve dhe varieteteve t' shqipes t' cilet…<>
113	CC	3,88	mun' t' kishin mbetur *t-* deri diku t' paa përmëndura ose pa trajtuara thellsisht…<>
114	CC	1,58	disa prej tyre i ka mar nën…

115	CC	1,02	nën udhheqjen…
116	CC	1,94	e ti shum' t' mir' profesorii…
117	CC	2,46	*ëë* dhe profesor' të tjer' që kemi n' institut.
118 a	YY	6,36	Do do do do t' mbetemi më von' | do mbetemi më von' tek projekti për për *vi-* për ta përvjuar bisedën me pyetjen…
118	CC	6,02	[*hm*] dhe përveç ksaj ne 'sa po kemi nisur një projekt për t' cilin mund flas dhe pak më von' ose tani n' qoft' se…
119	YY	2,80	pse jan' kaq shum' të rëndsishme | ju e theksuat çë…
120	YY	3,85	ne jemi pak arkeolook, pak etnograaf *ë* pak*ëë*…
121	YY	3,97	ulumtues tëë t' kulturës popullore sepse pa kto…
122	YY	5,21	gërmime në tereen | mun' t' i quajm' t' tilla edhe kur bëjm fjal' | kur flasim për…
123	YY	2,95	për fjal' të shqipes ësht' e pamundur q' ne tëë…
124	YY	7,11	konservojm' në nji- në nji moment t' caktuar gjendjen e varianteve dialektore që mun' t' jen.

Giovanni BELLUSCIO

"TENDENCIAL" PHONETIC VARIIETIES IN THE USE OF CONTROLLOED STANDARD ALBANIAN IN TV SHOW

Abstract

It is hard to give an answer to the question "Is there a spoken standard of Albanian language?", although in many ways the "standard" itself is put in question as a real language system. However, there are many cases in everyday life where we can say that Albanian is displayed with a good and precious clothing, a model that linguists (but not only linguists) choose to call "standard".

The qualities of the standard have been so far expressed very well by linguists such as Rexhep Ismajli, Anastas Dodi, Bahri Beci etc., and some even managed to define a standard Albanian norm (Dodi 1981) but, as is known, currently Albanian does not have such a norm; on the contrary, it is often claimed that Albanian pronunciation directly derived from its spelling. But this assertion does not come true, not just because the written language differs greatly from the spoken language, but even though the rules of free pronunciation do not have the well-known "hardness/rigidity" of writing.

On the other hand, we can say that in all linguistic traditions, in contrast to the normative norm enshrined in the rules and tradition, there is a tendency to form a much more free use of language, which is part of the informal registers of speech. This use represents the need of communication ofs an average level of speakers, and this creates and radiates vibrant uses until they are spread so as to overcome the norm line, becoming the property of the entire community of speakers. This tendency, in other contexts such as Italy, was named by linguists as "the variety of medium usage " of the language, and in the case of the Albanian, we can call it the "the Albanian of medium usage ". Someone also proposed the term "neostandard", but this in the context of Albanian does not seem appropriate to what we just said above. In 1983, the Italian linguist Alberto Mioni used the expression "Tendenciat Italian " for the first time, and this name we think that we can use in the case of spoken Albanian as well.

The material we used was issued by a TV show recorded in April 2016 in a private Albanian channel. The show proposes to the public a conversation between a journalist (with a university degree) and three university professors in Tirana. The subject in the studio is Albanian and its dialects, so our linguistic analysis will deal with free, controlled or caring speech, used by speakers who are not only in their profession dealing with language but in the formal context of television speech about language and offer a careful use of contemporary Albanian pronunciation, it means a

model that all four "cares" to reflect as much a top log, d.m.th. "The standard of speech". The aim of the analysis is to verify which are the pronouncing tendencies of today's dialectical and dialecic spoken Albanian as well as if it is possible to determine trends (i.e. what the term "Tendential Albanin" means that can be followed by the spoken language in the future.

Aljula JUBANI - Maklena ÇABEJ

IZOKRONIA, KLASIFIKIMI I SHQIPES MBËSHTETUR NË VEÇORITË TË ORGANIZIMIT KOHOR NË SHQIPE

Izokronia lidhet me ritmin e të folurit, në të cilin njësitë kanë prirjen të shqiptohen në intervale të rregullta kohore, pra çdo njësi shqiptohet në të njëjtin interval kohe.

Sa i takon organizimit kohor, ka studime të shumta mbi gjuhë të ndryshme, por për shqipen, studimi i parë i takon G.M. Belluscio-s, i cili në temën e tij të doktoraturës, por edhe në artikuj të mëvonshëm (me Romito-n dhe Mendiccino-n) ka marrë në shyrtim këtë argument për të sjellë klasifikimin e tij, mbështetur në analiza akustike dhe përsiatje teorike.

Idenë se gjuhët dallohen nisur nga veçori të ritmit e ka hedhur së pari Lloyd (1940), duke vënë në dukje se ritmi i spanjishtes ngjan me atë të një arme automatike, kurse ritmi i anglishtes ngjan me dërgimin e mesazheve me kodin Morse.

Pas rreth 4 vitesh, ishte Pike që nëpërmjet të dhënave empirike, solli argumente në mbështetje të dallimeve të izokronisë mes këtyre gjuhëve. Kështu, ai dallonte anglishten dhe spanjishten nisur nga identifikimi i kriterit të shqiptimit të segmenteve të barabarta kohore ose izokrone. Si rezultat, vuri në dukje se segmentet e barabarta në spanjisht bazohen në numrin e rrokjeve, kurse në anglisht bazohen në njësitë theksore.

Gjuhët dallohen në lloje, sipas organizimit të ndryshëm të njësive tingullore që ndjekin njëra-tjetrën në ligjërim: në izokroni theksore dhe izokroni rrokjesore. Sipas teorisë së përgjithshme mbi shpërndarjen e kohës në të folur, vërehet se gjuhët me izokroni theksore kanë këto karakteristika:

1) reduktimin e zanoreve të patheksuara, si në cilësi, ashtu edhe në kuantitet (në gjatësi), pra zanoret e patheksuara priren të jenë më të shkurtra, disi më qëndrore dhe mund të reduktohen; (prania apo mungesa e reduktimit zanor, ose qendërzimi i rrokjeve të patheksuara në schwa [ə], luan një rol të rëndësishëm për dallimin e klasave ritmike. (Bertinetto, 1981: 170 dhe Dauer, 1983: 57).

2) reduktim të shpejtësisë së të folurit, me pasojë jo vetëm reduktim zanoresh, por edhe rrokjesh të tëra të patheksuara;

3) mungesë të një përcaktimi të qartë të kufijve të rrokjes (Një rol i rëndësishëm i atribuohet strukturës rrokjesore, më saktësisht pranisë apo mungesës së grupeve

bashkëtingëllore komplekse (Bertinetto, 1981: 171 dhe Dauer, 1983: 55). Gjuhët me izokroni theksore dallohen për një strukturë komplekse të rrokjes, tipologji të shumta rrokjesh dhe kufijtë e rrokjeve nuk janë të qartë.)

4) vërehet prirje për spostimin e theksit dinamik, jo vetëm në fjalë të përbëra, por edhe në një shpërndarje të theksave dinamikë brenda frazës, reduktim cilësor dhe sasior të zanoreve fqinje të theksuara dhe të patheksuara. Theksi leksikor, apo theksi i fjalës, luan një rol të veçantë, duke qenë i pranishëm në të gjitha gjuhët me izokroni theksore, siç vëren edhe Dauer (1983: 58). Gjithsesi, ai shfaqet edhe në gjuhë me izokroni rrokjesore. Në këtë kuadër, ndikimi i theksit leksikor për dallimin e gjuhëve sipas izokronisë, lidhet me natyrën e tij: i ngulitur apo i lirë, lëvizshëm apo i palëvizshëm).

Gjuhët me izokoni rrokjesore janë të prirura të sillen krejt ndryshe

1) nuk vërehen reduktime të zanoreve të patheksuara, por edhe kur vërehet një reduktim i mundshëm i gjatësisë nuk ndodh reduktimi apo rënia e rrokjeve

2) po pati reduktim ai është proporcional në të gjitha rrokjet e thënies, por pa shkaktuar rënien e rrokjes

3) rrokjet në të tilla gjuhë nuk riorganizohen rreth një apo më shumë rrokjesh që mbajnë theksin dinamik;

4) nuk vërehet kurrë spostimi i theksit leksikor.

Në mënyrë të përmbledhur, veçoritë kryesore, jepen në tabelën e mëposhtme, bazuar tek Dauer (1983)

Veçoritë	Gjuhë me izokroni rrokjesore	Gjuhë me izokroni theksore
struktura rrokjesore	e thjeshte	komplekse
reduktimi zanor	i kufizuar	maksimal
vendi i theksit të fjalës	i pandryshueshëm	i ndryshueshëm

Objekt i analizës sonë janë bërë tri variante gjuhësore. Kemi përzgjedhur 2 folës të standardit, 2 folës së zonës së Matit dhe 2 folës së zonës së Pogradecit. Gjithsesi, kjo është vetëm fillesa e një projekti studimor, që duke u shtrirë më tej në të folme të tjera të shqipes, synon të japë edhe një hartë të plotë të shpërndarjes së kësaj dukurie në trevat shqiptare.

1. Kohëzgjatja e zanoreve, shkurtimi kompensator

"*Two indices of a segment's context-sensitivity are its duration (relative to a sometimes imaginary duration of the segment produced in isolation), particularly for vowels, and its coarticulatory relations with neighboring segments. Vowels are measured to shorten in the context of neighboring consonants, and to lengthen at syntactic boundaries; stressed vowels shorten in the vicinity of unstressed syllables. (Fowler 1981:35)*

Kemi marrë në analizë efektin e komprimit të zanores së theksuar shkaktuar nga një rrokje e patheksuar në të majtë ose në të djathtë të saj.

Duke ndjekur rrugën e analizës, si edhe Belluscio, kemi zbatuar formulën e Lindblom dhe Rapp (1973):

$$Do = \frac{Di}{(1 + a)^{\alpha} (1 + b)^{\beta_1}}$$

D_i është gjatësia e zanores së theksuar në një fjalë njërrokëshe; a është numri i rrokjeve që e ndjekin, b është numri i rrokjeve që i paraprijnë; α është koeficienti i komprimimit anticipator;

β është koeficienti i komprimimit prezervues.

Është treguar kujdes i veçantë në ndërtimin e korpusit, në funksion të analizës sonë, në mënyrë që të kemi fjalë me struktura rrokjesore që lejojnë masim efektet koartikuluese të lidhura me natyrën e strategjive të organizimit kohor në shqipe. Për llogaritjen e koeficientit α: a_o b_o ('BZ), a_1 b_o ('BZBZ), a_2 b_o ('BZBZBZ), a_3 b_o ('BZBZBZBZ), kurse për llogaritjen e koeficinetit β: a_o b_o ('BZ), a_o b_1 (BZ'BZ), a_o b_2 (BZBZ'BZ), a_o b_3 (BZBZBZ'BZ).

Të dhëna paraprake për vlerat e koeficentëve α dhe β për gjuhët me izokroni theksore gjejmë te Fowler (1981) në lidhje me anglishten, kurse të dhëna për gjuhët me izokroni rrokjesore mund të gjejmë te Vayra et al. (1983) në lidhje me italishten standard, si edhe Bertinetto (1977, 1981) Farnetari e Kori (1982, 1983), Vayra et al. (1987), Vayra e Fowler (1987), Bertinetto e Fowler (1988), Trumper (1989), Romito e Trumper (1989), Mendicino e Romito. Sa i takon shqipes, krahasimin e vlerave të analizës sonë do ta realizojme me rezultatet e Belluscio, si i pari studim, nga sa jemi në

[1] Zbërthimi i formulës, nëpërmjet gjetjes së logaritmeve përkatëse, për secilin prej konteksteve të sipërshënuara u realizuar falë ndihmesës bujare dhe të specializuar të studiuesit Antonio Mendicino, të cilin gjejmë rastin ta falënderojmë përzemërsisht.

dijeni, mbi startegjitë e temporale të shqipes, si edhe te Belluscio-Mendicino-Romito (1997).

Studime të tilla bazohen, mbi të gjitha, në teori kognitive e kompjuterike, të cilat parashikojnëplanifikim e paraprogramim, d.m.th. procese kompjuterike që kanë aftësinë, të përcaktojnë lëvizjen e çdo muskuli.

Nello studio di Fowler (1981), le aspettative prevedono che, durante la produzione dell'eloquio, la coarticolazione abbia effetti perseverativi, mentre l'accorciamento compensatorio anticipatori. Proprio sulla base di queste aspettative vengono postulati i due punti attraverso cui distinguere le lingue naturali nei due gruppi ritmici syllable- stress-timed: a) nelle lingue stresstimed (inglese e tedesco), gli effetti della coarticolazione sono perseverativi e scarsi mentre, gli effetti dell'accorciamento compensatorio sono anticipatori; b) nelle lingue syllable-timed (italiano e spagnolo), gli effetti della coarticolazione e dell'accorciamento compensatorio vanno nella direzione opposta, cioè sono anticipatori. Quindi, le lingue isosillabiche sono presumibilmente caratterizzate da uno sforzo articolatorio più distribuito che tende a non essere concentrato sulla sillaba accenta del piede. Romito–Trumper (1989: 90)

Duhet të kemi parasysh se reduktimi (shkrutimi) kompensator është një dukuri shumë e rëndësishme për të dalluar gjuhët me izokroni theksore nga ato me izokroni rrokjesore.

Ashtu siç thekson edhe Bertinetto (1989: 70), dallojmë dy lloje reduktimi kompensator: ndërrrokjesor brendarrokjesor. I pari përfshin komprimin e rrokjes së theksuar të një këmbe fonetike që lidhet me numrin e rrokjeve të patheksuar që ndjekin të theksuarën. I dyti parashikon komprimin e fonemave brenda një rrokjeje që lidhet me numrin e fonemave të asaj rrokjeje.

Fowler Izokroni theksore	Romito – Trumper	Belluscio
$0.4 < \alpha < 0.6$ β = shumë e ulët	$0.4 < \alpha < 0.6$ $0.2 < \beta < 0.4$	$0.265 < \alpha < 0.129$ $0.205 < \beta < 0.191$ $0.306 < \alpha < 0.206$ $0.22 < \beta < 0.07$

Tipo	Coeff.α	Coeff.β
Matera dial.	0.38	0.18
CS dial.	(-) 0.105	0.120
CZ dial.	(-) 0.260	0.105
Napoli dial.	(-) 0.458	0.324
Padova dial.	0.290	0.122
CS ital.	0.015	0.11
CZ ital.	(-) 0.04	0.186
Albanese		
Frascineto	?	/i/= - 0.107 /a/=0.308
Lungro	?	(-) 0.193
Spezzano	?	(-) 0.0143

Tab.2 Coefficienti di α e β riferiti ai tipi di italiano, dialetto e dialetti Albanesi.

Siç vënë re edhe Trumper e Romito (1989:99), por edhe studiues të tjerë që kanë trajtuar problemet e izokronisë, mund të thuhet se nuk kemi të bëjmë me një dallim të qartë mes tipave gjuhësorë me izokroni rrokjesore dhe izokroni theksore, por më shumë për një continuum vlerash përgjatë të cilit gjenden gjuhë të ndryshme dhe dialekte.

Më tej, autorët, duke iu referuar të folmeve arbëreshe, shprehen se edhe pa vlerat e α, duket se ato dëshmojnë një polarizim drejt grupit me izokroni theksore, që është e parashikueshme, nisur nga fakti se shqipja dallohet për reduktimin e zanoreve. (1989:100)

Në përfundim të analizës sonë, kemi marrë rezultatet e koeficientëve për variantet e shqyrtuara. Analiza akustike për të folmen e Matit shfaqi paqëdrueshmëri, që u pasqyrua në vështirësi të llogaritjes së koeficientë α dhe β nga të dhënat e përftuara. Ndoshta folësit kanë realizuar një shqiptim jo shumë të natyrshëm, që edhe na ka shpënë në modifikimin e parametrave akustikë, siç do ta shohim edhe në analizën e vlerave formantore.

Për dy variantet e tjera, po i rendisim rezultatet në tabelën e mëposhtme:

Shqipja standarde	E folmja e Pogradecit
$0.304 < \alpha < 0.132$	$0.276 < \alpha < 0.124$
$0.128 < \beta < 0.094$	$0.107 < \beta < 0.081$

2. Fusha e shpërndarjes së zanoreve

Dukuri si izokronia, rëgjimi i tingujve dhe fusha e shpërndarjes së zanoreve e prirja për qendërzim janë të lidhura mes tyre në mënyrë të ndërsjelltë. Në tabelën e mëposhtme kemi renditur të dhënat e dy formanteve të para, në vlera mesatare, për të gjitha zanoret.

Zanoret	Shqipja standarde				E folmja e Pogradecit				E folmja e Matit			
	Të theksuara		Të patheksuara		Të theksuara		Të patheksuara		Të theksuara		Të patheksuara	
	F_1	F_2	F_1	F_2	F_1	F_2	F_1	F_2	F_1	F_2	F_1	F_2
i	330	2045	319	2026	273	2028	285	2043	366	2010	366	2018
y	331	1641	331	1642	293	1669	338	1685				
u	342	856	337	849	284	888	366	842	356	846	355	798
e	454	1741	473	1760	502	1767	508	1758	497	1770	510	1736
ë	478	1192	543	1329	573	1325	541	1459				
o	478	938	484	977	502	1005	501	1106	499	1027	507	1005
a	763	1295	732	1227	619	1236	593	1219	602	1338	568	1385
ɒ									591	1207	545	1261

Vlerat e dy formanteve të para të zanoreve të theksuara dhe të patheksuara te të dy folësit

Siç vëren edhe Belluscio: *La centralizzazione delle vocali, e in questo caso, lo spostamento verso un elemento, fonemico oltre che fonetico dell'albanese, delle vocali periferiche è l'esito della situazione tipica dei sistemi linguistici ad isocronia accentuale, "riduzione delle vocali atone sia in senso qualitativo che quantitative (riduzione temporale implica perciò un cambiamento di "target", di uso dello spazio vocalico): le vocali atone tendono dunque ad accorciarsi e a centralizzarsi (ad occupare cioè la parte centrale dello spazio acustico), a subire bleaching" (perdita di qualità vocalica) ed in casi specifici ad essere eliminate (tendenza ll'erosione)"*

Bazuar në vlerat e F1 dhe F2 kemi ndërtuar grafikët e mëposhtëm, ku edhe më qartë mund të krahasojmë sjelljen e zanoreve të theksuar e të patheksuara, në lidhje me një prirje të pritshme për qendërzim të këtyre të fundit.



Fig. 1. Shqipja standarde



Fig. 2. E folmja e Pogradecit



Fig. 3. E folmja e Matit

Si përfundim, mund të themi se dukuria reduktimit sjell shpesh jo vetëm reduktimin e zanoreve të patheksuara, por edhe të rrokjeve të tëra në të folme, e veçanërisht në të folme gege.

Pra, vëmë në dukje një prirje të zanoreve të patheksuara për qendërzim, rënien e /ë/-së së patheksuar, madje edhe të rrokjeve që e përfshijnë.

Prania e theksit sintagmatik, realizimi i mirë i tij shpesh shkakton humbjen e theksit leksikor të fjalëve në njësi më të mëdha.

Ashtu siç e vumë re edhe kur analizuam reduktimin e gjatësisë, edhe në analizën e fushës së shpërndarjes së zanoreve, bazuar në vlerat e tyre formantore (F_1 dhe F_2), në të folmen e Matit rezultati është disi larg pritshmërive, duke qenë se qendërzimi i sistemit zanor është minimal. Kjo mund të lidhet me arsye të ndryshme që nga ndikime të tjera në ligjërimin e folësve tanë, deri te shqiptimi i tyre disi artificial dhe larg shqiptimit të natyrshëm etj.

Sidoqoftë, edhe me përjashtimet e vëna në dukje, shqipja me të folmet e saj duket se është e orientuar në grupin e gjuhëve me izokroni theksore. Për këtë mund të shohim jo vetëm rezultatet e analizës, por edhe duke arsyetuar në lidhje me argumentet e dhëna në hyrje të këtij punimi.

Bibliografi

Belluscio, G., A. Mendicino, L. Romito (1997), "L'albanese standard: vocalismo e strategie temporali", *Quaderni del Dipartimento di Linguistica* 8, Università degli studi di Firenze, Unipress

Bertinetto, P.M. (1981), *Strutture prosodiche dell'italiano*, Firenze: Accademia della Crusca

Bertinetto, P.M. (1989), "Reflections on the dichotomy „Stress" vs. „Syllable-timing"", *Revue de Phonétique Appliquée* 91/93

Dauer, R.M. (1983), "Stress-timing and syllable-timing reanalyzed", *Journal of Phonetics*, 11

Fowler, C. A. (1981), "A Relationship brtween Coarticulation and Compensatory Shortening", *Phonetica 38*

Trumper J. & Romito L. (1989), Un problema della coarticolazione: l'isocronia rivisitata, in Proceedings del XVII Convegno Nazionale dell'Associazione Italiana di Acustica.

Aljula JUBANI - Maklena ÇABEJ

ISOCHRONY, ALBANIAN LANGUAGE CLASSIFICATION BASED ON THE CHARACTERISTICS OF TIME ORGANIZATION

Abstract

According to R. L. Trask, isochrony is a kind of speech rhythm in which units tend to be pronounced at regular intervals, so each unit is pronounced at the same time interval. As far as time organization is concerned, there are several studies on different languages, but regarding the nature of Albanian, the first study is G.M. Belluscio who in his doctoral thesis, as well as in later articles (with Romito and Mendiccino), has taken into consideration this argument to come up with his classification based on acoustic analysis and theoretical analysis. The idea that languages are distinguished by the peculiarities of the rhythm is first claimed by Lloyd James (1940), emphasizing the fact that the Spanish rhythm resembles the one of an automatic weapon, whereas English rhythm is similar to sending messages with the Morse code. Subsequently, Pike considering empirical data brought arguments in support of differences in isochrony between these languages. Hence, he would distinguish between English and Spanish, starting from the identification of pronunciation criterion of equal time segments or isochrons. As a result, he pointed

out that Spanish equal segments are based on the number of syllables, while English ones are based on emphasis units, the same as in Albanian. We can also come to this conclusion based on the results of laboratory analysis.

Ledi SHAMKU-SHKRELI

JETA DHE POZICIONI I PASKAJORES NË GJUHËN SHQIPE. SHTEGTIM MES FAKTEVE GJUHËSORE DHE DOMENEVE KULTURORE

Humbja e paskajores dhe zëvendësimi i saj me një formë finitum (për shqipen në disa raste me lidhoren), është konsideruar si një nga tiparet themelore të Sprachbund-it ballkanik. Dhe në fakt në mënyrë të përsëritur, qysh nga Sandfeld e tutje, kjo humbje është quajtur si një nga ato pak tipare të pranishme te të gjitha gjuhët e Lidhjes Gjuhësore Ballkanike.

Pas mëse një shekulli nga përkufizimi i Sandfeldit, sot rasti i paskajores së shqipes mund të konsiderohet, për ta thënë me fjalët e Joseph "më shumë si një rast i vecantë i kontakteve gjuhësore sesa një ballkanizëm i mirëfilltë". Mjaft të mendohet se zëvendësimi i paskajores i kapton kufijtë ballkanikë dhe haset si i tillë edhe në varietetet italoromance të Jugut, sikundër ka dëshmuar Rholfs.

Në sferën e domeneve kulturore humbja e paskajores konsiderohet si ndikim i Greqishtes. Dhe kështu Rholfs saktëson se në jug të vijës së Jirecekut, humbja e paskajores u shkaktua drejtpërdrejt nga influksi i Greqishtes së vonë. Në veri të kësaj vije ndikimi i greqishtes qe i dobët, e kështu ndaj edhe paskajorja vende-vende mbijetoi. Më saktë akoma: sot paskajorja rezulton të jetë zëvenduar në greqishten e re, në bullgarishten, në maqedonishten, po ashtu edhe në rumanishten (hiq ndonjë formë të ngrirë) por nuk ka humbur në dialektet e saj perëndimore si tek istrorumanishtja; ka humbur në të folmet serbe sidomos tek ato juglindorepor jo në arealin perëndimor të tyre e aq më pak në kroatisht, ku paskajorja është bukur e pranishme në të gjitha kontekstet e koreferencës dhe lidhorja si alternativë shfaqet rrallë; dhe duke dalë të shqipja, ka humbur në toskërisht por aspak në gegnisht. Kjo paraqitje na shtyn përsëpari të mendojmë se zëvendësimi i paskajores i takon varietetit hapësinor, pra është dukuri e shenjuar në diatopì. Dhe nëse do t'i bashkangjitemi përkufizimit të lartpërmendur Rholfsit, mund të hedhim idenë se paskajorja foljore, me praninë e saj e me mungesën e saj, mund të konsiderohet si një "testimonial" gjuhësor i ndikimeve të dy domeneve kulturore në kuadër të vetë Lidhjes Gjuhësore Ballkanike: ndikimit grek dhe ndikimit roman. Le ta mbajmë në mend këtë ide, ndërkohë që përqëndrohemi tani në sistemin gjuhësor të shqipes, për ta shqyrtuar pozitën e paskajores së saj në të katër

boshtet e variacionit: diatopik, diamezik, diafazik dhe, përsa do mundemi, edhe diakronik.

Në literaturën ndërkombëtare, sa herë që shqipja përmendët si gjuhë me pozicion qendror në Lidhjen gjuhësore ballkanike, haset pak a shumë pohimi I përgjithshëm se "në këtë gjuhë paskajorja është zhdukur ose pothuajse zhdukur e se mbijeton vec në disa areale të dialektit gegë". Po si rezulton në të vërtetë paskajorja në distribucion diatopik? Areali gjuhësor shqipfolës ndahet në dy pjesë: në arealin gegë ku paskajorja dhe lidhorja bashkëjetojnë njëlloj sit e gjuhët romance, dhe në arealin gjuhësor toskë ku është në përdorim vetëm lidhorja sëbashku me një formë të ashtuquajtur paskajore, e njëjtë me atë të gjuhëve të tjera ballkanike ku paskajorja ka humbur. Pra: duke iu referuar tipologjisë së infinitit, dialekti gegë paraqitet tipologjikisht i afërt me gjuhët romane, ndërsa ai toskë avitet më fort me tipin gjuhësor ballkanik. Përvec hulumtimit në korpuset dialktore, vlen sigurisht të sjellim këtu të dhënat e përditësuara edhe nga një korpus tjetër i rëndësishëm i shqipes, i mëvetësishëm tash prej shekujsh, korpusi i traditës arbëreshe (parë kjo si traditë e shkruar dhe e folur). Studimet dhe përimtimet e tashme të kësaj tradite, të ndërmarra nga studiues si Altimari, Fortino etj., na dëshmojnë përdorimin e paskajores edhe aty. Natyrisht përdorimi i saj në arbërisht nuk paraqitet me intensitetin dhe koherencën që ajo ka në gegnisht, por vlen me thënë se kjo formë haset qoftë më shkrim te vjeljet (vepra letrare a proverba), qoftë edhe te të folmet e përditshme arbëresh. E megjithatë arbërishtja është një fraktal i dialektit toskë, është me matricë toske, pikërisht fraktal i atij dialekti në të cilin sot nuk haset paskajorja. A ka vallë një shpjegim kjo dallueshmëri tipologjike brenda të njejtit sistem? Le ta vemë mënjanë për tash këtë pyetje, të cilën do ta rimarrim kur të shqyrtojmë pozitën diakronike të paskajores sonë.

Meqë prapa përdorimit ose mospërdorimit të paskajores qëndrojnë bashkësi të tëra shqipfolëse, distribucioni i saj diatopik që përmendëm më lartdo shoqëruar edhe me një vlerësim kuantitativ të këtyre bashkësive. Nuk po ju ha kohë me cka tashmë dihet, por po mjaftohem duke konkluduar se dy të tretat e bashkësisë shqipfolëse përdorin paskajoren. Dyzet vjet edukim shkollor vetëm me standardin sigurisht e kanë ndikur fort shkrimin por jo dhe aq të folurin, sidomos atë gjysëmformal e formal, në të cilin gjallon qetësisht paskajorja foljore. Sa i takon Shqipërisë, folësit gegë ushtrojnë këtë diglosi paralele mes shkrimit dhe të folurit, apo ndryshe mes normës dhe përdorimit.

Vlen të përmendet poashtu se paskajorja në shqipe nuk haset vetëm si formë e mëvetësishme, poedhe si përbërës i kohës së ardhme. E kam fjalën për futurin analitik të gegnishtes që na shpie përsëdrejti tek latinizmi ballkanik, i ndërtuar me foljet ndihmëse "me pasë" o "me qenë" plus pjesore. Shpesh ky i fundit njihet edhe si

Futuro necesitatis. Toskërishtja e ka humbur këtë lloj future, duke e zëvendësuar me modelin grek të tipit "dua plus lidhore", apo ndryshe futuro voluntatis. Disa të dhëna interesante mund të sillen edhe për këtë argument. Përshëmbull: packa se sic u tha, gegnishtja nuk ka asnjë veshtirësi me e përdorë lidhoren, shqyrtimi i plotë landor i shkrimeve nga Meshari i Buzukute deri në dëshmitë e fillimit të Tetëqindës, nuk paraqet asnjë formë të modelit grek (voluntatis), përjashto vetëm një dalje të vetme te Buzuku. Dalin vetëm forma të tipit: kam me shkuo, kam me thashune, keni per me u paditune", etj. Në realitetet e sotme gjuhësore të gegnishtes bashkejtojnë të dyja modelet. Në toskërishte sic u tha, vetëm future voluntatis, por në disa të folme të vargmaleve të Labërisë (mes Vlonës e Himarës), hasen rrallë edhe disa forma conservative të kalesës të cilat janë një shartim mes modelit latin e modelit grek. Kështu gjenden struktura si "kam të shkonj, kam të them, jam të mbrrinj". Ndërsa në të folmet arbëreshe të Italisë gjenden ende në përdorim të dyja modelet, necesitatis dhe voluntatis, por kjo e dyta "kam e jam plus lidhore", por i dyti është tejet më I dendur në përdorim. Ad diem mund të pohohet se në sistemin gegë future necesitatis i modeli latin paraqitet më i dobësuarsesa paskajorja vetë e mëvetësishme si kategori.

Natyrisht të dhënat tona kanë mbajtur parasysh edhe gjuhën e folur krahas shkrimit, po afërmendsh kur flitet për tipologji e kategori gjuhësore, gjithnjë i referohemi diamezisë së plotë, e kjo është një cështje e sqaruar 100 vjet më parë me Saussure-in te prestigji i pameritуar i shkrimit (kujtojmë argumentin e tij: më mirë fotografinë e dikujt apo atë vetë?!). Vërej se cdo e dhënë që u është përcjellë dikur nga Shqipëria studimeve ndërkombëtare ballkanike, ka marrë parasysh vetëm karakteristikat e varietetit artificial standard. Koha me i korrigju ndërkombëtarisht të dhënat!

Kjo ishte edhe panorama e përditësuar e pranisë dhe shpërndarjes diatopike të paskajores në shqipe. Po deri këtu jemi ende te marrëdhëniet dialektore ose gjeodialektore. Sociolinguistika shkon përtej tyre, dhe merr në shqyrtim cfarë ndodh në qendrat urbane në krejt gamën e tyre hapësinore e socialkulturore, aty ku gjuha dhe ligjërimet, stilet e regjistrat, me o pa prestigj, përzihen duke thyer secili "l'esprit de clocher" të sho-shoqit. Po marrim në shqyrtim Tiranën, për vetë përqëndrimin e madh që ka. Si substrakt gjuhësor Tirana i përket gegnishtes qendrore, dhe si e tillë ruan dhe përdor paskajoren qoftë si formë e mëvetësishme e qoftë si përbërëse e futurit.Në Tiranë është formuar tashmë një varietet I Shqipes Popullore i cili imponon disa tipare karakteristike themelore të substraktit të saj te cdo lloj adstrakti gjuhësor që mbërrin aty, e ndërkohë ndikohet nga tipare më të vogla arketipore të të ardhurve. E gjitha zhvillohet nën një process që SL e quan "replikë e kompromisit", ku substrakti ka pjesën e luanit.Në këtë kuadër paskajorja është tipar themelor i substraktit që përcohet

dhe ndikon replikën e kompromisit. Të tilla sjellje gjuhësore të folësve janë mëse të pritshme, pasi Shqipja Popullore e përfaqësuar në masën më të madhe nga Substandardi i Metropolit, nuk është më një dialect por një Sociolekt, një sociolekt që lind e rritet në truall gjuhësor gegë, duke alkimizuar e përcjellë edhe forma të tjera gjuhësore të huaja për truallin. Forca ndikuese e një sociolekti të tillë është mëse e njohur.Mjaft të sillet ndërmend rasti i Francës – realitet i centralizuar sikundër ai i Shqipërisë, për të cilin Guiraud qysh në 1968 sjkruante se duhej marrë në konsideratë frengjishtja popullore e Parisit ngaqë kishte shumë për t'i ofruar frengjishtes letrare. Kështu krijuam një korpus me kampionaturë të gjerë shqipfolësish që kanë toskërishten si ligjërim familjar por janë lindë e rritë në Tiranë; këtij korpusi i shtuam edhe një grup tjetër shqipfolësish të moshës 20-25 vjec, të cilët kanë lindur në jug të Shqipërisë por kanë 10 vjet të shpërngulur në Tiranë. Vëzhguam ligjërimet e tyre sa i takon paskajores. Rezulton se paskajorja është formë e adoptuar në këtë korpus në masën 63.1%, ndonëse nuk është pjesë e arketipit të tyre gjuhësor. Kësisoj, në lëmë të diafazisë, po përjetojmë atë process në të cilin paskajorja ka kaptuar ndjeshëm kufijtë e dialektit duke hyrë në domenin e sociolektit, cka don të thotë rishpërndarje e saj përtej kufijve dialektorë. Pa dashur të bëjmë teleologji, me këto të dhëna mund të pohohet sidoqoftë se, duke u bërë pjesë e sociolektit, paskajorja sot i ka fuqizuar më tej pozitat e saj në Shqipe, së paku sa i takon ligjërimeve të folura.

Afërmendsh Shqipja është gjuhë e shkruar, ndaj ky fill arsyetimi grish të monitorohet edhe ususi i shkruar. Paskajorja nuk ofrohet nga kodi aktual i shkruar, ndaj pavarësisht se tre të katërtat e bashkësisë shqipfolëse e përdorin në mënyrë aktive në të folur, normativisht nuk do të mund ta përdornin në të shkruar. Por ka normë e ka edhe usus! Për të folur me shifra dhe të dhëna konkrete, ndërtuam edhe këtu një korpus me shkrimet shkollore të nxënësve, duke u përqëndruar në 5 qytete të mëdha: dy në Veri, Tiranën dhe dy në Jug. Theksojmë se asnjëra nga shkollat nuk është shkollë periferie. Korpusi u mendua me dy nënndarje: esetë e provimit të lirimit dhe esetë e maturës (ngaqë flitet për mosha të ndryshme dhe stade të ndryshme të edukimit shkollor). Në jug nuk hasëm asnjë prani të paskajores. Në Tiranë, për nëngrupin e 14 vjecarëve përdorimi i paskajores rezulton në masën 13.8% ndërsa për 18 vjecaret në masën 17.7%. Në very rezultatet janë: 36.6% për nivelin e 14-vjecarëve dhe 38.2% për 18-vjecarët. Kryesisht paskajoret janë nga folje të zgjedhimit të dytë e të tretë.Hasen mjaft edhe pjesore të shkurtuara të zgjedhimit të parë.

Korpuse të tjerë po për këtë qëllim i ndërtuam edhe me gazetat në Shqipëri e Kosovë, duke zgjedhur për focus rubrikën "Kronikë". Vërehet një prani e interesante e paskajores në gazetat e Shqipërisë, por gjithnjë në brendi të lajmit e sidomos kur perifrazohet i intervistuari. Mesa duket gazetari, duke ritregu intervistën e marrun me

gojë pra me zë e pra si ligjërim i folur, duket se nuk refuzon me përdorë paskajoren në shkrim, nonëse shkruan në standard. Muns të hamendësojmë edhe këtu se pikërisht Sociolekti i Substandardit të Tiranës, gjerësisht i pranuar tashmë, po luan në këtë rast në mendësisnë e gazetarit rolin e paqtorit për atë që i duhet të kthejë të folurin (intervistën) në të shkruar (artikull). Ndërsa në gazetat e Kosovës paskajorja e shkruar shfaqet ndjeshëm, në masën 41.2%të rasteve dhe madje haset edhe në testatat e gazetave apo titujt e lajmeve. Dua të theksoj se sa u takon gazetave të njëjtin korpus patëm ndërtuar në vitin 2008, por prania e paskajores në gazetat e Tiranës qe pothuajse e papërfillshme, ndërsa në Kosovë mjaft e paktë atbotë. Rritje e ndjeshme e paskajores në shkrim vërehet edhe në tabelat publicitare (reklamat) si në Prishtinë dhe në Tiranë. Vëmendje të vecantë lyp tash nga ne Netlekti (ligjërimet online, chat, forume, rrjete sociale). Nga një kampion i thjeshtë vërejmë se te Netlekti prania e paskajores është e madhe. Por mbetet gjithqysh për t'u vërejtë sa ka me qenë trysnia që Netlekti ka me ushtru në neostandard, përmes raportit të ndërsjellë që kjo formë e re diamezie ruan me Substandardin, e gjitha si pjesë e continuum-it gjuhësor të Shqipes.

Vijmë tash tek i mbrami dhe tejet interesanti shestim yni mbi paskajoren e shqipes: aspekti diakronik i saj, parë si rrugëtim ndikimesh e kulturash. Sic u tha qysh në fillim, shkak i humbjes së paskajores në gjuhë, dialekte apo të folme të Ballkanit konsiderohet ndikimi i greqishtes si gjuhë prestigji dhe gjuhë e liturgjisë ortodokse. Fetarisht pra edhe kulturalisht, trevat shqipfolëse, deri para ardhjeve osmane, ishin troje mes Orientit dhe Oksidentit, dhe kjo pak a shumë përkthehet kështu: Më së shumti ndikim latin në veri dhe në qendër dhe ndikim grek në jug. Këto ishin dy kontaktet kryesore ndërkulturore. Shenjat e këtyre dy makrondikimeve në gjuhë pakashumë përputhen: toskerishtja nuk e ka më paskajoren sic nuk e ka më greqishtja e re, maqedonishtja (madje edhe disa të folme shqipe në kufi me të folmet maqedone), sic nuk e ka më serbishtja, bullgarishtja, arumanishtja, me pak fjalë krejt bota ortodokse e përmbledhur rreth frymës ortodokse greke. Në serbishte humbja e paskajores vërehet në shek XVI, në rumanishte, në dëshmitë e saj të para që i takojnë pak a shumë shek. XVI, format e pashtjelluar dalin me një përdorim të kufizuar. Në shqip do vërejtur sic u tha se dalin ende në të folmet e shkrimet arbëreshe, ndonëse arbërishtja është për vete një fraktal i toskërishtes., saku toskërishtja modern e ka humbur krejt paskajoren. Kjo panoramë të dhënash dhe datash na shtyn drejt një tjetër lloj pyetjeje: ndikim i greqishtes, po i cilës greqishte? Dhe kur? Dhe ku? Këto pyetje shpien në shqyrtimin e diakronisë së paskajores te vetë greqishtja, si burim ndikimi. Rezulton se paskajorja ka humbur plotesisht vetëm në greqishten e re. Duke iu referuar studimeve të grecistëve, përmbledhtazi mund të thuhet se në greqishte

zhdukja e plotë paskajores si complement i predikatit mund të vendoset aty nga fundi i epokës bizantine, dhe sipas Bryan Joseph, pakashumë në shekujt XVI- XVII. Edhe pse dobësimi i saj kish nisur kohë më parë, studimet greciste na dëshmojnë se në mesjetën e vonë, që shkon nga shek XII deri në shek XVI, paskajorja greke ngjan të ketë qenë ende një kategori gjuhësore productive, ndonëse në të folme kish nisë me u rrudhë përdorimi i saj. Në një Kronikë të Moresë fjala vjen, manuscript i shek. XIV, gjejmë një përdorim të bollshëm të paskajores në greqishte. Pra, duke përmbledhë: në greqishte paskajorja mbijeton ende bukur mirë derisa zhduket krejt te neogreqishtja në shekujt XVI-XVII. Duke iu kthyer pranisë së paskajores në arbërishte ndonëse e dialektit toskë ajo, vlen të kujtojmë se eksodi i arbëreshve nis në shek. XIV dhe intensifikohet në shek XV. Kohë kjo në të cilën paskajorja sic u pa ishte ende aktive edhe në vetë greqishten. Qysh nga kjo kohë bashkësitë shqipfolëse arbëreshe (toske në thelb) e humbasin kontaktin e fqinjësisë me popullatat grekofone kufitare. Arbëreshët shndërrohen në diasporë, dhe i vetmi kontakt i tyre me greqishten mbetet kontakti dituror liturgjik, po edhe ky sic e don tradita ortodokse mbahet në greqishten bizantine, pra ende me paskajore. Për pasojë të folmet arbëreshe nuk e përjetuan si bashkësi kufitare mutacionin që pësoi greqishtja e re e cila e bori krejt paskajoren, duke ndryshuar për pasojë edhe morfosintaksën e vet, pasi nuk ishin më gjuhë e kultura në kontakt. Apo më saktë: humbja e plotë e paskajores në neogreqishte, process që u parapri nga ndryshime të shumta sintaksore në atë gjuhë, ndryshime që me siguri do të kenë ndikuar edhe në modelet sintaksore fqinje duke i përgatitur për novacionin, me gjasë shkaktoi si ndikim të njëjtin zëvendësim të paskajores në toskërishte. Areali tjetër shqipfolës (pjesa më e madhe) vijoi të mbëtëj gjithnjë e më pak nën influencën romance e gjithnjë e më tepër nën influencën osmane, por me gjuhën e kësaj te fundit pati interferenca thuajse vëtem në nivelin leksikor e dicka edhe në prapashtesim. E tash,si u mbrrit në këtë pikë, na mbetet edhe një pyteje e fundit, së cilës mund t'I gjegjemi hëpërhë vec më një hipotezë duke mos pasë ende të dhëna. Cështja e shpërndarjes dhe origjinës së paskajores shqipe, kësaj formës analitike që njohim sot (me plus pjesore), i ka ndarë albanistët në dy grupe: njëri grup që pohon se ky inovacion (inovacion krahasuar me formën e padëshmuar sintetike), ky inovacion pra ka pasur shpërndarje të plotë në krejt arealin shqipfolës, pra edhe në toskërishte, dhe mandej kjo e fundit e ka humbur prej ndikimit të greqishtes. Grupi i dytë mendon se ky inovacion është vetëm i gegnishtes dhe toskërishtja nuk e ka njohur kurrë. Cilit mund t'i japim të drejtë? Pas evidentimit të një pranie të konsiderushme qoftë të paskajores e qoftë të future necesitatis te të folmet arbëreshe me matricë toske, jemi më të prirur të hamendësojmë se ky inovacion është mbarëshqiptar e mandej mutacionet e greqishtes si gjuhë në kontakt me toskërishten të kenë shkaktuar si

ndikim edhe mutacione në vetë toskërishten që conin në lëkundjen dhe dobësimin e pozitave të paskajores aty. Diaspora arbëreshe dëshmon për të tillë nivel të dobësuar por gjithsesi gjallues.Me ikjen e tyre ata nuk u ndikuan më. Ndërsa toskërishtja vijoi ta humbasë këtë paskajore të ligështuar nën ndikimin e vijuar të Neogreqishtes. Ndaj edhe bashkohemi me perfundimin e Joseph i cili pohon se "cështja e paskajores në shqipe është më shumë një cështje kontaktesh gjuhësore sesa një ballkanizëm i mirëfilltë".

Thënë kjo, mund të pohojmë plot gojën se paskajorja e shqipes dhe vetë përdorimet apo mos përdorimet e saj, tjetër s'janë vecse një provë e cmuar gjuhësore se kultura shqiptare është ashtu sic e kanë përkufizuar gjithnjë: mes Përëndimit dhe Lindjes. Paskajorja jonë, parë në kuadrin e krejt arealit ballkanik, dëshmon bukur mirë për këtë aspect kapërcyellor kulturash të botës sonë shqiptare. Ndaj në fund pyes: mohuesit e saj a nuk tuten kur marrin përsipër fshirjen e një dëshmitareje kaq të vyer historiko-kulturore?!

Ledi SHAMKU-SHKRELI

LIFE AND POSTURE OF THE INFINITIVE VERBAL IN ALBANIAN LANGUAGE. EXCURSUS BETWEEN LINGUISTIC FACTS AND CULTURAL DOMAINS

Abstract

From a typological point of view, Albanian language is part of the Balkan Language League and this is already a known fact, at least by the Romanian linguist Alexandru Rosetti, who determined that the common linguistic features in grammar, syntax, lexic and phonology give the languages Balkans a special status of "League".

One of the common characteristics of the languages involved here is the reduction (or disappearance) of the infinitive verbal. When referring to Albania, the international scientific sources cite the absence of the descendants, expressing the following: complete disappearance in the Tosk dialect and its reduction in that gag. The same sources suggest that the main factor in the collapse or disappearance seems to be the influence of Greek as a high cultural prestige language in the area, also the frank language of the Orthodox liturgy - the dominant religion of the communities that formed the Balkan League again.

For our own, these considerations are fair, they may prove inadequate if compared to recent studies on the distribution and factual power of the Albanian language.

The publication of the Dialectological Atlas of Albanian Language, a detailed description of the subdivision grammar systems in the Albanian speaking areas, the latest studies of urban dialectology together with sociolinguistic studies that take into account the Albanian and Usus sub-standard, the philological publications of many manuscripts old Arbëresh but also statistical studies on the current state of Arbëresh's speeches have enabled the look of another scenario, much more detailed and concrete about the dynamics and position of the Albanian language in the Albanian language.

At this stage, we believe that the description of the Albanian language as the central language of the Balkan Language League raises some questions:

1. A less uniform scenario, does it lead to the theory of multiples fonts, which is based on the hypothesis that not all Balkanisms originate from the same source? In these statements, rather than the internal (lingual) elements of the system, is it appropriate to examine in parallel the external elements as well as the cultural and religious influences?

2. Being Arbëresh in itself a "fractal" of the Tosk dialect, what does the presence of the infinitive mean to it? Does this presence require the diachronic re-examination of the Greek influence itself? Which Greek, how, when, where and on what language community?

3. A more detailed view of the post-Albanian position in the Albanian language would then influence the "Balkanization Index" sketched by Jouko Lindstedt, who gives each Balkan language a particular location on the link, depending on the number of the common features that these languages share?

These questions and other issues related to them will also be the focus of our essay.

Maximiljana BARANČIĆ

SPEECH OF ARBANASI FROM ZADAR AND THEIR MASTERING IN THE CROATIAN LANGUAGE

Abstract

The speech of Arbanasi from Zadar and its influence on their language competency in their Croatian language mastering is analyzed. In order to understand the situation with three languages in contact (speech of Arbanasi, Croatian and Italian) the historical background of Arbanasi and their attitude to language is presented. Method of talk and recording with the oldest fellow-townsmen (between 55-85), middle-aged (30-55), and the youngest (to the age of 30), along with making comparisons with their present way of speaking with the one of 50 years ago, were used. Mastering in the Croatian language competency was researched according to age, sex, environment, profession and degree of education. Results have shown that only a small number of people speak Albanian, mainly older. People who worked, people with secondary school education, and a small number of those with academic degree, managed in mastering in the Croatian language competency at a larger scale, but even today the influence of the speech of Arbanasi is present. The survey of interlanguage features of the Croatian speech and that of Arbanasi is presented through research conducted at three levels: morphological, lexical, and phonological.

At morphological level, mistakes in using the case endings, prepositions, verb forms and possessivness, are presented. At lexical level, examples with dialect features, mainly Italian or Croatian borrowings, were given. At phonological level, some most outstanding examples of the speech of Arbanasi were compared with the Croatian phonological system.

Key words: *Croatian language, Croatian as a second language, speech of Arbanasi, interlanguage*

In this work we shall try to analyze to what extent the speech of Arbanasi from Zadar influenced on their language competency in their mastering in the Croatian language. We shall try to find the answer using the method of talk with the oldest

fellow-townsmen, middle-aged and the youngest, and comparing their present way of speaking with the one 50 years ago. The analysis of inter-language features of the Croatian and Zadar Albanian will be presented at different levels.

1. INTRODUCTION

First of all, we shall say a few words about the residence and surroundings of Arbanasi from Zadar in order to understand which factors could make it a condition of their present degree of mastering in the Croatian language.

Arbanasi from Zadar arived to the place where they live today (earlier the suburb of the city of Zadar, and today it is the part of the town) at the beginning of the 18th c., or to be more exact, in the period from 1726 until 1754, during the first two great migrations, from the territory of the Lake Skadar (three villages – Šestani, Briske and Livari). In the beginning the families spoke only Albanian - gegh dialect.

At the same time families with the surname Bajlo, from the island of Ugljan, settled there, and after some time completely assimilated with Arbanasi. They spoke mainly Croatian. Zadar was for a long time under Italy and in such a surroundings, where Arbanasi were forbidden to speak their language, especially in the period between two world wars, schools did not exist, in the community where three different language groups co-existed, speech of Zadar Arbanasi more and more gradually disappeared. Attitudes to language played an important role in the lives of people from Arbanasi. They influenced to a large extent the psychology of individuals and their language use. In the situation, where three languages in contact (speech of Zadar Arbaansi, Italian, Croatian) found themselves - negative attitudes of the majority group dominate toward the group without any power and prestige, so that Arbanasi, members of a minority group, degraded themselves even more than they were degraded by the dominant group. At this place I would like to mention the phenomenon of the parents, who, I could say, played a decisive role in teaching their children the "correct" language, so that they would not be stigmatized later in life and could advance in society (Barančić 2005:3).

That negative attitude resulted in language switching (transfer), the minority language is less and less used and only a small number of people speak Albanian (mainly older people). Attitude to language is one of main reasons explaining which language is learnt, used and which language is given preference by bilingual speakers (here trilingual).

2. AIM AND RESEARCH METHODOLOGY

We shall try to answer to what extent the Zadar Arbanasi speech influenced their language competency in their mastering in the Croatian language.

In bilingual environment, where two or more languages are involved (Croatian, Zadar Arbanasi, Italian), the situation is very complex. Method of talk and spontaneous recording was used. Afterwards the recordings were analyzed.

Number of examinees: 30 examinees of both sexes at the age of 25 to 85

Research of mastering in the Croatian language was examined according to

a) age

b) sex

c) environment

d) profession

e) degree of education

3. RESULTS AND ANALYSIS

During research, which covers the period of 6 months, using the method of talk and recording, the following was observed:

Mastering in the Croatian language in terms of language competency according to age was observed from three perspectives:

a) *the oldest* (between 55 to 85)

b*) middle-aged* (between 30 to 55)

c) *the youngest* (to the age of 30)

a) With persons between 55 years of age until 85 language competency differs a great deal. Here mastering in the Croatian language depends significantly on degree of education. Persons with an academic degree of education completely acquired proficiency in the Croatian language. However, even the oldest at the age of 75 up to 85 with an academic degree of education (who are in a small number) show the same mistakes, or deviations, as well as the ones with a lower degree of education at the age of 55. (Nediljka from the island of Silba speaks Zadar Arbanasi, Italian and Croatian, 98).

But generally, with persons between 55 to 85 years of age, language competency in the Croatian language is of medium-quality, whereas with those aged 70 and more, it is very weak. With the elderly examinees Zadar Arbanasi speech influenced most on their language competency in their mastering in the Croatian language. By using a

more detailed analysis we concluded that as the result of such a situation it was environment, profession, sex and degree of education.

In cases with an academic degree of education, where mistakes/deviations from the standard language were noticed, it happens mainly if the person lives in the environment where everybody speaks Zadar Arbanasi, if both parents are from Arbanasi.

In cases when a person does not spend much of the time in such a surrounding, mistakes are completely insignificant.

b) With middle-aged persons (between 30 to 55) situation is completely different. After having analyzed the conducted research with the examinees, we came to the following results:

mastering in the Croatian language is bigger which is the result of working environment with both sexes, profession and degree of education. Thanks to the fact that both sexes are more and more employed, professions differ from the ones of older generation (these are now for the most part jobs in public services), education is upgraded (the number of those with completed higher degree of education is increasing). Many families changed their environment. They do not live in the region of Arbanasi any more, but in Novi Bokanjac, Borik, Stanovi etc., as a result, their mastering in the Croatian language is bigger. As the consequence of that a very small number knows to speak Zadar Arbanasi. They are mainly those who continued to live in the same environment (maybe 10%). Among them is a great number of those (especially between 40 to 50) who understand Zadar Arbanasi speech, but they do not speak it (30%).

c) The youngest generation (to the age of 30) considerably acquired proficiency in the Croatian language thanks to the fact that almost none of them speaks Zadar Arbanasi speech (maybe all together 1 to 2 %). Only some of them understand a few words. Croatian is spoken at home, even though both parents are of Albanian origin. At this generation we notice that regardless of the surroundings (region of Arbanasi) their mastering in the Croatian language is very high. Zadar Arbanasi speech is not spoken at home at all, only Croatian. However, the influence of the Zadar Arbanasi speech is still felt with some individuals, which is the result of their degree of education. The youngest generation speaks ikavian dialect at home, in public places and at work they are trying to speak the standard Croatian language as much as possible.

4. VARIABLES OF RESEARCH

Research among the examinees was conducted at three leves: morphological, lexical and phonological.

a) Morphological level

At this level the following mistakes were noticed:

1. Wrong use of case endings
2. Wrong use of prepositions
3. Wrong use of verbal forms
4. Wrong expressing of possessiveness

1. Wrong use of case endings

For the purpose of explaining the appearance of mistakes in using case endings or omitting, along with the example the name and age of the examinee is given:

Examples:

Iša sam u sel-**u**. (Šimeto 67) *Idem na mor*-**u.** (Nadalina 65) *Idem u grad*-**u**. (Nilo 57)
Idem u fakultet or *fakultet*-**u**. (Ana 21) *Idem u mor*-**u**. (Tulia 75)
Bija sam u Ankon-**u**.(Šime 70) *Bija sam u Zagreb.*(Slobodan 59)
Iša sam u Rije-**ci**. (Franko 58) *Bija sam u Arbanasima*-**n**. (Milka 83)
Bija sam u Ankon-**u.** (Ruđer 49) *Idem kući u bicikl*-**u**. (Anita 65)

In the mentioned examples the case ending is wrong, or the case ending is omitted. After having analyzed the recorded talks we conclude that most mistakes are made in using the case endings, according to which Arbanasi are mostly recognized.

2. Wrong use of prepositions

In the following examples the preposition and case ending are misused, or the case ending is omitted. The way of expressing in the Croatian language is in fact a literal translation from Zadar Arbanasi speech. Here are some examples:

Zadar Arbanasi speech	Croatian
1. *Vota* ***në*** *fusha.*	*Idem* ***u*** *polje.*
2. Vota ***në*** *gjutet.*	*Idem* ***u*** *grad.*

Arbanas will, in the mentioned situations, make a mistake in using the case ending, so he will say:

1. Idem ***u*** *polj-****u****.* *2. Idem* ***u*** *grad-****u.***

Preposition **në** is translated in the Croatian language with the preposition **u.**That situation is repeated whenever we have in the speech of Arbanasi the preposition **në,** in Croatian it is **u** or **na.**

Zadar Arbanasi speech		Croatian
1.*Vota* ***në*** *det.*		*Idem* ***na*** *more.*
Arbanas will say: *Idem* ***u*** *more.*	or	*Idem* ***na*** *mor-****u****.*
2. *Ata kam po* ***në*** *televizije.*		*To sam vidio* ***na*** *televiziji.*
Arbanas will say: *To sam (san) vidija* ***u*** *televizij-***u**. or		*To sam vidija* ***u*** *televizij-****i.***

Some more similar examples**:**

U *zadnje smo pobijedili Francuze.* (Šimeto 67) Instead: ***Na*** *kraju ....*

Idem ***u*** *fakultet.* (Ana 21) Instead: *Idem* ***na*** *fakultet.*

This girl is aware of her mistake and she corrects herself the same moment, but she still makes mistakes in using a preposition and a case.

Autobus mi je pobjegao ***na*** *nos.* (Instead: **pred** nosom)

Mama mi je spremila dva jaja **u** očima**/n.** (Instead: **na** oko.)

The most frequent mistake is the use of accusative, locative and instrumental with the preposition **na** and **u.**

3. Wrong use of verbal forms

Arbanasi make mistakes in using verbal forms in the following situations:

a) 3rd person plural of present

*Oni govor-****u****, rad-****u,*** *vid-****u****.* Instead: *Oni govor-****e****, rad-****e****, vid-****e.***

In the third person plural of present they use the suffix-**u** instead of suffix - **e**.

b) active past participle of masculine gender

Table 1. Survey of morphological mistakes of active past participle of masculine gender

Chakavian	**Standard Croatian**
-a	-o/-ao
iša, doša, gleda	išao, došao, gledao
-ja	
bija, radija, stavija, vidija, živija	bio, radio, stavio, vidio, živio

Form of active past participle of singular masculine gender is formed in Chakavian by ending –**a/ja,** and in standard –**o/-ao.**

Without regard to the age, all examinees use Ikavian dialect or Štokavian colloquial non-standard form (**iša, doša, bija, radija** itd.). That is a deviation from norm (standard language) found in Ikavian dialect, but at the same time we can say that it is generalization.

4. Expressing possessiveness

When expressing possessiveness Arbanasi also make mistakes.

Here are several examples: *Sin* ***od*** *Pere Markučina. Pjat* ***od*** *juhe. Uspomena* ***od*** *tebe.*

In expressing possessiveness all examinees use the preposition ***od*** and a noun or a pronoun in genitive.'This way of expressing possessiveness appears in colloquial language of the Croatian speakers, but it does not represent the feature of any dialect, accordingly, it represents deviation from the norm of the Croatian language' (J.Kuvač. i L. Cvikić 2005:280).

Table 2. Total survey of all types of morphological mistakes in percentage according to the age

Age	**%**
55-85	85
30-55	30
-30	10

b) Lexical level

In recorded talks with the examinees, besides morphological, lexical dialectal features appear as well. Here are some examples:

Moram ići na ***pijacu/i.*** *Di si stavila* ***šugaman?*** *Donesi mi* ***pirun.*** *Ovo je* ***pjat*** *od juhe.*

These are mainly Italian loan-words. As they are not part of the standard language lexis, but there are substitutes for them (tržnica, ručnik, viljuška, tanjur), they are considered to represent deviation from the norm. Arbanasi resort to the use of Italian words in the absence of Zadar Arbanasi speech.

Sometimes it is a Croatian word to which Zadar Arbanasi suffix (*ën*) is added.

Here are some examples:

Zadar Arbanasi speech	Croatian
Vota më ble ***čestitk****-ën.*	*Idem kupiti čestitku.*

Ta kam zije ***blitv****-ën.* *Skuhala sam ti blitvu.*

E kam bir ***olovk****-ën.* *Izgubila sam olovku.*

In the absence of a corresponding lexem Arbanas will use a Croatian word to which he/she will add the Zadar Arbanasi suffix. Such examples are really many because the speech of Arbanasi from Zadar is almost lost and language vocabulary comes to several hundreds of words, therefore in the absence of corresponding words speakers use Croatian or Italian, switching from one code to another.Besides, in the absence of a corresponding word in plural they add the Albanian suffix to the loan-word (Croatian or Italian). For example: *stog-****jët****, balkun-****jët****, lopat-****ët*** (Croatian - *stog,* Italian - *balcone*, Croatian - *lopata*). Dialectal mistakes/deviations appear as a result of interference (from dialect into standard), from language 1 to language 2 (Požgaj-Hadži, V. I Benjak, M. 2005:419).

c) Phonological level

The question I always ask to myself and try to find an answer is: How do you know that I am from Arbanasi? It reminded me of a frequent saying while I was still a child, and for some people from Arbanasi that saying can be applied still today.

In this research our attention was not aimed at accents and intonation, but exactly those features play an important role in recognizing speakers from Arbanasi. What is the reason that Arbanasi (even those youngest) are not able to adopt the Croatian pronounciation equally, although they are of the same origin, the same first language and culture? I ask myself that question and have no right answer. Maybe that could be motivation, personality, effort, genetic preconditions and high degree of emotional connection with the language and culture.

In order to understand to a certain degree the difference between the Croatian speakers and those from Arbanasi we shall mention some differences by comparing the Croatian and Zadar Arbanasi phonological system.

Some features of Zadar Arbanasi speech which could influence on the pronounciation of the Croatian sounds as well:

Croatian **/l/** is harder, darker, therefore in Zadar Arbanasi speech we have ***L****u'bica*, and not ***Lj****ubica*, which is softer (and the accent shifts towards the end).

Such examples are:

*Dešpa****l,*** instead of *Dešpa****lj,*** *Nikpa****l,*** instead of *Nikpa****lj,*** *po****l****e*, instead of *po****lje,*** *vo****l****a*, instead of *vo****lj****a*.

An example in a sentence: *On produ****li*** ili *produ****gli*** *kad govori.*

(The sense is: *On odugovlači*. He is stalling.)

That softened */l/* does not influence the communication but has a significant role in a total impression which it leaves on Zadar Arbanasi speech. Another feature is the pronounciation of the sound **/s/.**

Example: *Pušti nek se ugrije.* Instead of **/s/** Arbanasi from Zadar use **/š/.**

Then the pronounciation of the sound **/đ/**, instead of **/d/.** Example: *Oni iđu.* Instead of: *Oni idu.*

The pronounciation with people from Arbanasi is different. Some sound changes most probably developed in the speech of Arbanasi after the first world war, conditioned with the influence of the phonetic system of the Croatian surroundings. Semi-vowel **/ë/** was most probably caused by the adaptation of the speech from Arbanasi to the Croatian sound system which has no knowledge of semi-vowels and passed into one of the vowels. Vowels are significantly longer and more closed (***a***- from Croatian passed into ***o***). That is perhaps one of the indicators which reveals Arbanasi. With loan-words of masculine and feminine gender accent of the original word is shifted towards the end, usually second-last and the last syllable. Analysis has been conducted based on listening to particular sounds. More thorough analysis would require special research of every particular sound. The most frequent examples in which the accent is shifted for one place to the right are:

*Arba'**na**si, au'**to**bus, tele'**fon*** etc.

Otherwise less attention is paid to the phonological level because it is believed that the pronouciation of the target language is not so important for the language competency i.e. communication. By comparing these two phonological systems I would like to add some facts which should be taken into consideration when we speak about interlanguage (in this case Zadar Arbanasi).

1. original language negatively influences on sound acquisition of the target language

2. speakers of the second language show a tendency to generalization

3. pronounced sounds of the second language are often only approximate

4. fossilized structures (fosilization) are frequent precisely at the phonological level, especially with older speakers.

6. CONCLUSION

Speech of Arbanasi from Zadar to a large extent influenced on their language competency in mastering in the Croatian language. By analyzing recordings of the conducted talks and recorded materials with the oldest fellow-townsmen, middle-aged

and the youngest, and comparing their present way of speaking with the one 50 years ago we conclude that a very small number of people still speak Zadar Arbanasi, they are mainly older, their Croatian is at the level of everyday speech and we can with certainty claim that Zadar Arbanasi speech to a large extent influenced on the degree of mastering in the Croatain language. It is particularly noticeable with those people from Arbanasi who were not employed but were doing agricultural jobs (men) and in household (women). Persons who worked, especially in public services, persons with secondary school education, and a small number of those with academic degree managed substantially to acquire proficiency in the Croatian language, but the influence of Zadar Arbanasi speech is still present. With the youngest, or we can say third generation (here I think of those to the age of 30) almost nobody speaks Zadar Arbanasi speech, even if both parents are from Arbanasi, just a few kept Zadar Arbanasi speech.Their language competency in mastering in the Croatian language is very high, but they can still be recognized for usual mistakes in the use of cases and prepositions even though to a lesser degree.

References

Barančić, M. (2005). " Code-switching i međujezik", u D. Stolac i sur. (ur.) *Jezik u društvenoj interakciji,* Zbornik radova sa savjetovanja održanog 16. i 17. svibnja 2005. u Opatiji, str. 1-14.

Kuvač. J. I Cvikić. L. (2005). " Dječji jezik između standarda i dijalekta", u D. Stolac i sur. (ur.) *Jezik u društvenoj interakciji,* Zbornik radova sa savjetovanja održanog 16. i 17. svibnja 2005. u Opatiji, str. 275-284.

Novak, J. (2003). "Kako znate da sam Amerikanac?", u D. Stolac i sur. (ur.) *Psiholingvistika i kognitivna znanost u hrvatskoj primijenjenoj lingvistici,* Zbornik radova sa savjetovanja održanog 18. i 19. svibnja 2001. u Opatiji, str. 513-524.

Požgaj-Hadži, V. I Benjak, M (2005) Standard i dijalekt u kontaktu, u D. Stolac i sur. (ur.) *Jezik u društvenoj interakciji,* Zbornik radova sa savjetovanja održanog 16. i 17. svibnja 2005. u Opatiji, str. 409-424.

Maximiljana BARANČIĆ

SPEECH OF ARBANASI FROM ZADAR AND THEIR MASTERING IN THE CROATIAN LANGUAGE

Abstract

In this work the speech of Arbanasi from Zadar and its influence on their language competency in the Croatian language mastering is analyzed. In order to understand the situation with three languages in contact (speech of Arbanasi, Croatian and Italian) the historical background of Arbanasi and their attitude to language is presented. During research methods of talk and recordings were used with the oldest fellow-townsmen (between 55-85), middle-aged (30-55), and the youngest (to the age of 30), and their present way of speaking is compared with the one of 50 years ago. Language competency in mastering in the Croatian language was researched according to the age, sex, environment, profession and degree of education. Results have shown that only a small number of people speak Albanian (speech of Arbanasi from Zadar), mainly older. People who worked, people with secondary school education, and a small number of those with academic degree, managed in mastering in the Croatian language competency at a larger scale, but even today the influence of the speech of Arbanasi is present. The survey of interlanguage features of the Croatian speech and that of Arbanasi is presented through research conducted at three levels: morphological, lexical, and phonological.

At morphological level, mistakes in using the case endings, prepositions, verb forms and possessiveness, are presented. At lexical level, examples with dialect features, mainly Italian or Croatian borrowings, were given. At phonological level, some most outstanding examples of the speech of Arbanasi were compared with the Croatian phonological system.

Maria PEEVA

E FOLMJA E MANDRICËS NË FJALORIN E PARË BISEDIMOR ME FJALORTH ME AUTOR MARIJA GEORGIEVA-PEEVA

Në vitin 2015 në tregun e librave doli Fjalori i parë bisedimor me fjalorth[1] i cili përshkruan të folmen e të vetmit fshat autentik shqiptar në Bullgari – Mandrica. Autorët e librit "Katër shekuj të pangjunëzuar" Muharrem Idrizi dhe Alush Kamberi e përcaktojnë fshatin e Mandricës si një fenomen në botën e diasporës shqiptare pasi që atje e folmja e shqipes është ruajtur dhe po flitet edhe në ditët e sotme.

Autorja e librit zonja Marija Georgieva – Peeva me profesion është mësuese e kimisë dhe fizikës. Është lindur në Mandricë në vitin 1945. Gjatë karrierës së saj profesionale ajo ka punuar si pedagoge dhe drejtoreshë shkolle në qytete të ndryshme të Bullgarisë. Aktualisht banon në qytetin e Vidinit. Në këtë libër të vogël, i cili u realizua me ndihmën e Shoqatës për Ringjalljen e Mandricës[2], ajo e ka regjistruar të folmen e Mandricës të vitit 2015. Megjithë se libri nuk ka nivelin e lartë akademik të studimeve të Bojka Sokollovës, ai mund të shërbejë si një vegël në duart e të gjithë akademikëve sepse është një burim për gjendjen aktuale të këtij varieteti të veçantë të shqipes.

Kurse ana akademike e botimit është siguruar nga ish-diplomati dhe studiues i gjuhës shqipe Ludmill Stankov. Vetë ai është autor i dhjetra botimeve dhe artikujve kushtuar shqipes, përfshi Gramatikën e Gjuhës Shqipe në gjuhën bullgare. Aktualisht ai ka përfunduar një studim bazuar mbi atë të Dhimitër Shuteriqit në Mandricë gjatë vitit 1959. Në studimin e ri të gjitha materialet janë përkthyer në gjuhën bullgare, përfshi këngët dhe përrallat dhe është zgjeruar Fjalori me prejardhjen e të gjitha fjalëve nga bullgarishtja, greqishtja dhe turqishtja, me shumë të dhëna etimologjike.

Ndikimet gjuhësore mbi varietetin e Madricës mund të shpjegohen nga historiku i këtij fshati. Ka disa supozime për themelimin e tij. Më e përhapura është

[1] *Marija Georgieva – Peeva, "Fjalor bisedimor bullgarisht-shqip me fjalorth", Sh.B. "Faber", Veliko Tërnovo 2015*

[2] *Që nga viti 2010 Shoqata për Ringjalljen e Mandricës organizon aktivitete të ndryshme për ringjalljen e jetës në fshat – si tubime folklorike, festa për fëmijë, takime fisnore, etj. http://mandritsa.com*

legjenda e cila kam dëgjuar nga vendasit gjatë vizitës sime në shtatorin e 2015-ës.[3] Sipas saj vendbanimi është themeluar nga tre vëllezër blegtorë të cilët kanë ardhur nga fshati Vithkuq i Korçës. Pas vendosjes ata kanë ndërtuar një baxho ose mandër, prej së cilës vjen edhe emri i vendbanimit. Viti i themelimit konsiderohet 1636-ta.

Profesori i gjuhëve klasike në gjimnazin nr. 1 të Sofjes Perikli Çili, i cili është me prejardhje nga Korça, e ka përshkruar Manricën në fillim të shekullit të kaluar në këtë mënyrë: "*Në pjesën lindore të maleve të Rodopeve në jugperëndim të Adrianopojës (Edrenesë), shtrihet fshati i thjeshtë shqiptar, i quajtur Mandrica. Par luftës ballkanike, ky fshat ka pasur 400 shtëpi me shqiptarë. Por, ndërkohë, nga Mandrica u shpërngulën shumë shqiptarë në Greqi, prapa kodrave të fshatit të tyre dhe edhe atje themeluan fshatin e tyre me po të njëjtin emër Mandres.*"[4]

Vendasit u martuan për gra nga fshatrat e afërta dhe kështu popullsia u rrit deri në 3500 banorë. Nuset e reja duhej të mësonin shpejt gjuhën shqipe. Mandricasit janë krishterë ortodoksë. Aktualisht në të ka dy kisha – "Shën Dimitri" dhe kisha e varrezave "Shën e Diela". Vendbanimi ka qenë kaq i pasur se kishte dy shkolla. Për të kaluarën e shkëlqyeshme flet edhe arkitektura e fshatit – akoma është ruajtur shtëpia madhështore e gjinekologut Atanas Pejkidis me tavanet e gdhendura, tarracat nga hekuri i farkuar dhe kolonat.

Kush mbjell mana – korr flori

Shtëpitë trekatëshe tregojnë edhe zanatin kyç të fshatit – rritjen e krimbit të mëndafshit për të cilin ishin të nevojshëm kultivimi i pemëve të manës dhe ngritja e katit të sipërm të shtëpive. Fshati ka qenë mes prodhuesve prijës të mëndafshit. Kultivimi i duhanit gjithashtu ishte shumë i përhapur në fshat, atje u zhvilluan edhe zanate të tjera. Ka pasur punishte për përpunim të lëkurëve, punishte për prodhimin e fuçive, për tahan, për shkrirje dhe prodhimin e kambanave etj.

Te veshjet popullore në çdo shtëpi rruhet fustani apo "ustani" femëror. Ai është përbërë prej leshi, bojë të zezë dhe të zbukuruar me gajtanë të kuq dhe vishet mbi këmishën e gjatë. Ka dhe dy të çara përmes të cilave nënat e reja u jepnin gji fëmijëve. Gratë mbajnë edhe kollan të zbukuruar me shqiponjën dykrerëshe në mes.

Pas këtij pasqyrimi të historisë së Mandricës do të kuptoni më mirë edhe zhvillimin e së folmjes së fshatit.

---

[3] *Vizita ime në fshat është përshkuar në artikullin "Mandrica – i vetmi fshat autentik shqiptar në Bullgari e fton botën për vizitë" për Emisionet e Gjuhës Shqipe të Radio Bullgarisë pranë Radios Kombëtare Bullgare http://bnr.bg/sq/post/100631268*

[4] *A. Kamberi, M. Idrizi "Katër shekuj të pagjunjëzuar", Sh.B. "Konica 95", Tetovë 1997, f.11*

Pas vizitës së tyre Dhimitër Shuteriqi dhe Mahir Domi bënë një vështrim të karakteristikave të shqipes vendase[5]:

"*Mjaft tipare e fenomene të së folmes së Mandricës, të shpijnë në veçori të zonës së Korçës, pikërisht të Devollit (parafjalët ndë, ndër përfunduar në dë e dër, trajtat e shumësit në të tanishmen e dëftores e të lidhores pa zanoren tematike-i, në Devoll – ngasëm, ngasën, kurse në Mandricë – hapmë, mbjellmë, disa trajta të përemrit pronor shumës, në Devoll – gishtërinjt tem, duart time, duart tënde, kurse në Manricë – timet vëllazëra, tëndet roba...*)"

Në të folmen e Mandricës ka ndikim nga bullgarishtja, turqishtja dhe greqishtja, mirëpo ky ndikim nuk e ka ndryshuar thelbin e gjuhës. Kjo mund të vërehet edhe në librin e Marija Georgieva-Peevës. Në gramatikën e shkurtër janë përshkruar mbiemrat, foljet, ndajfoljet. Çdo një fjalë është prezantuar në katër variante: në gjuhën bullgare, shqiptimi në bullgarisht, transkriptimi me alfabetin shqip dhe norma letrare e gjuhës standarde shqipe. Në fjalorin bisedimor gjenden fjalët dhe frazat më të përdorura nga jeta e përditshme e Mandricës të ndara në mënyrë tematike: njohja, vizita, përshëndetje dhe urime, profesione, moti, në pazar e në shtëpi, ushqime e pije, qyteti, udhëtimi etj.

Kostatimet e Dhimitër Shuteriqit për të folmen e Mandricës, tani po ripohohen edhe nga libri i ri Marija Georgieva – Peevës.

Në pjesën fonetike vërehet ruajtja e formave arkaike si **kl**, **gl**, **lk** si për shembull: *Unë **kl**lesha – unë **q**eshë*; *U**lk** – uj**k***; *U**kl**ishë – **k**ishë*. Ka ndërrim të bashkëtingëllorëve **dh** > **z** si për shembull: **Z**jetë – **dh**jetë, Trimbë**z**jet – trembë**dh**jetë.

Ndikimi nga bullgarishtja vërehet te vendosja e mbiemrave dhe përcaktorëve të tjerë para emrave: *Toftë ujë – ujë i ftohtë*; *Pjekor mish – mish i pjekur*; *Pulës mish – mish pule*. Si edhe te përdorimi i pjesëzës pyetëse "**li**" nga bullgarishtja në vend të "**a**": *Mund **li** të hap xhamnë? – **A** mund të hap dritaren?*; *Keni **li** raki? – **A** keni raki?* Tek emrat e muajve dhe bile të stinës së vjeshtës ka ndikim nga festat kryesore që bien brenda muajit si për shembull: maj – *Shingergitmvoj* (Dita e Shën Gjergjit më 6 maj); nëntor – *Shilmitritmvoj* (Dita e Shën Dhimitrit që sipas stilit të vjetër bie më 3 nëntor); vjeshtë – *Shilmitri*.

Fjalori i parë bisedimor me fjalorth me autor Marija Georgieva – Peeva është një dëshmi për ruajtjen e një varieteti të gjuhës shqipe. Mandrica është si një ishull i vogël në oqeanin e shqipes sepse pa pasur kontakte të drejtpërdrejta me Shqipërinë kjo e folma e shqipes akoma po flitet në këtë fshat piktoresk.

[5] *Prapë aty, f. 108*

Maria PEEVA

THE ALBANIAN DIALECT OF MANDRICA VILLAGE ACCORDING TO THE DICTIONARY OF MARIJA GEORGIEVA-PEEVA

Abstract

In the southeastern part of Bulgaria is situated the village of Mandrica - an authentic Albanian village where Albanian language is still spoken. According to a legend the settlement was founded in XVII century by three breeding brothers who came from Vithkuq village near Korça. After the placement they built a dairy, from which comes the name of the settlement (in Bulgarian dairy is "mandra"). The authors of the book "Four centuries non-aligned" Muharrem Idrizi and Alush Kamberi define the village of Mandrica as a phenomenon in the world of the Albanian diaspora since the Albanian language has been preserved and is still being talked about nowadays. In April 2015, Bulgaria's first Bulgarian-Albanian dictionary came out in the Bulgarian books market, which reflects the specific form of the Albanian Dialect of Mandrica village. The author is the local teacher Marija Georgieva-Peeva, while publishing consultant is a former diplomat and Albanian language scholar Ludmill Stankov. The book was published with the help of the Association for the Resurrection of the Mandrica. In more than 120 pages the author describes the Albanian language. The book is divided into six main parts: history of Mandrica, short grammar, colloquial vocabulary, Albanian alphabet, pronunciation of singers and consonants, literature. In the short grammar are described surnames, verbs, adverbs. Each word is presented in four variants: Bulgarian, pronunciation in Bulgarian, transcription with Albanian alphabet and literary standard of Albanian language. In the dictionary are the most popular words and phrases used in the daily life of Mandrica, which are divided in a thematic way: acquaintance, visit, greetings and congratulations, occupations, weather, shopping and home, food and drinks, city, travel. In the Albanian dialect of Mandrica, influences from Bulgarian, Turkish and Greek are noticed, but this impact has not changed the essence of language.

Key words: dialect, Mandrica, Bulgaria

Vjosa HAMITI

GJUHA SHQIPE E DEPUTETËVE NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Hyrje

Ky punim analizon gjuhën shqipe që përdorin deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës në komunikimet e tyre publike. Për mostër janë zgjedhur segmente nga katër seanca parlamentare të Kuvendit të Kosovës. Analiza gjuhësore është bërë duke krahasuar transkriptet zyrtare të seancave me xhirimet/incizimet e tyre, për të parë se cila është gjuha e tyre e gjallë (si performancë) dhe si del e transkriptuar në transkriptet zyrtare.

Me interes të veçantë në këtë analizë është gjuha e folur e deputetëve në Kuvend. Janë veçuar diskutimet e tyre kur nuk kishin përgatitur paraprakisht (me shkrim) fjalimet e tyre. Fjalimet e shkruara, që lexohen në seancë, nuk u morën në shqyrtim në këtë hulumtim, sepse sheshazi redaktohen paraprakisht. Kështu, ato dalin si diskurs publik në gjuhën standarde, dhe jo varietet lokal a tjetërfare i gjuhës shqipe që flasin aktualisht njerëzit, në këtë rast deputetët, në Kosovë.

Për krahasim e përqasje, por edhe për ilustrim të fenomenit, në këtë hulumtim krahas transkripteve të Kuvendit tonë, u analizuan edhe transkriptet dhe xhirimet/incizimet nga 4 seanca parlamentare të Bundestagut gjerman. Do përkujtuar se në të gjitha institucionet publike dhe private në vendet gjermanofolëse flitet gjuha standarde ('Hochdeutsch'). Përpos gjuhës si performancë, u analizua edhe përmbajtja e këtyre transkripteve në të dyja vendet.

Puna studimore për këtë punim nxori në shesh si kompetencën gjuhësore të deputetëve të Kosovës dhe të Gjermanisë, po ashtu edhe praktikat e ndryshme të trajtimit të gjuhës së shkruar të folësve nga institucionet kryesore legjislative në Kosovë dhe Gjermani.

2. Transkriptet

Në transkriptet e Bundestagut shënohen edhe komentet për ato që ndodhin në sallë (p.sh duartrokitje), por edhe çka flitet nga deputetët, edhe kur nuk dëgjohen në

mikrofonin zyrtar (të folësit që e ka fjalën). Shënohet madje edhe kush duartroket apo kush bën komente jashtë mikrofonit gjatë debatit. Shembujt e paraqitur, me përkthimin tim, janë nga seanca parlamentare e Bundestagut e mbajtur me 8. Qershor 2016.[1] P. sh.:

(Beifall im ganzen Hause) (Duartrokitje në gjithë sallën)

(Beifall) (Duartrokitje)

(Beifall beim BÜNDNIS 90/DIE GRÜNEN und bei der LINKEN)

(Duartrokitje nga BÜNDNIS 90/DIE GRÜNEN dhe nga LINKEN)

Përpos fjalimeve që mbahen, përshkruhen edhe veprimet e deputetëve, çka flasin ata, apo cili deputet e bën një veprim të caktuar edhe pse nuk dëgjohen në incizimet/xhirimet.[2] P.sh.:

(Katrin Göring-Eckardt [BÜNDNIS 90/DIE GRÜNEN]: Haben wir deswegen eine Sondersitzung? – Michael Grosse-Brömer [CDU/ CSU]: Vielen Dank für die Erinnerung!)

(Përkthimi: Katrin Göring-Eckardt [BÜNDNIS 90/DIE GRÜNEN]:Për këtë kemi sot seancë speciale? – Michael Grosse-Brömer [CDU/ CSU]: Faleminderit që po na e përkujtoni!)

Në transkriptet zyrtare të Kuvendit të Kosovës këto komente për veprime jepen gjithashtu, por pa e precizuar kush i bën. Kryesisht bëhen vetëm komente të përgjithshme, p.sh:

(Ndërhyrje); (Duartrokitje); (Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.) (Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.) (Ndërprerje nga regjia)

Nga kjo analizë krahasimtare, del që transkriptet e Bundestagut janë pasqyrim real i diskursit të pjesëmarrësve në seanca. Tekstet e tyre në variantin e shkruar nuk u nënshtrohen ndonjë lekture apo redaktimi gjuhësor. E vërteta është se deputetët gjermanë flasin në gjuhë standarde, ndonëse gjermanishtja njeh varietetet gjuhësore.(Dittmar 1997; Löffler 1994, Ammon 2006)

Kjo dëshmon se deputetët e Bundestagut gjerman kanë kompetencë të lartë gjuhësore. Në web-faqen e Bundestagut është edhe një rregullore që dëfton se çka përmban një transkript. Ndër të tjera aty thuhet që dy orë pas përfundimit të seancave plenare, deputetëve u shpërndahet transkripti, dhe folësi apo folësja mund ta shohë, por nuk ka të drejtë të ndryshojë atë që e ka thënë në seancë[3].

[1] http://dip21.bundestag.de/dip21/btp/18/18184.pdf

[2] http://.bundestag.de/mediathek/?isLinkCallPlenar=1&action=search&ids=6970742&instance=m187&categorie=Plenarsitzung&destination=search&mask=search

[3] http://.bundestag.de/dokumente/protokolle/.

Për dallim nga praktika e Bundestagut gjerman, transkriptet e Kuvendit të Kosovës u nënshtrohen jo vetëm një lekture por edhe një redaktimi gjuhësor. Transkriptet zyrtare janë të shkruara në shqipen standarde dhe kanë dallime të mëdha nga gjuha e folur e deputetëve. Për këtë hulumtim, i jam drejtuar Drejtorisë për Shërbime Gjuhësore të Kuvendit të Kosovës, për të kuptuar se a ekziston ndonjë rregullore për redaktimin dhe lektorimin e traskripteve të seancave plenare. Nuk kam mundur të vërtetoj ekzistencën e një rregulloreje të tillë. Në mënyrë të tërthortë, del se lektorimi i seancave plenare është pjesë e punës së tyre. Kjo dëshmohet nga tekstet e konkurseve të shpallura nga Kuvendi i Kosovës për vendet e tyre të punës. Në to ndër të tjera kërkohet që kandidati të bëjë lekturën e transkripteve të seancave plenare.[4]

3. Analiza

Këtu, në vazhdim, jepet një pjesë e korpusit të analizuar të paraqitjeve të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Në këtë pjesë janë përjashtuar deputetët e Bundestagut sepse të folurit e tyre ishte në gjermanishten standarde dhe mund të thuhet se ishte pasqyrim i saktë i tyre.

Së pari paraqitet transkripti zyrtar dhe pastaj transkripti që kam bërë unë. Duke shënuar edhe komentet për veprimet e akterëve që flasin. Është bërë përpjekje që të paraqitet në mënyrë sa më autentike të folurit e deputetëve në fjalë.

Transkriptimi zyrtar:[5]

1. DONIKA KADA-BUJUPI: [...]Dje jeni takuar me Listën serbe. A del Hashimi, që sot po pretendon të zgjidhet president, të na tregojë çka i ka premtuar dhe çfarë garancishu ka dhënë, se dje të njëjtit kanë thënë që ne nuk e votojmë Hashim Thaçin president, e sot në mëngjes po thonë e votojmë, çka u ke premtuar dje, cilat janë garancitë shtesë? Çka do të shesësh më shumë për ta marrë një post për vete? Ke shitur goxha shumë nëpërmjet privatizimit e nëpërmjet proceseve, ku duart tua kanë qenë thellë në korrupsion, e çka do të shesësh tani të fundit herë?

   Çka u ke bërë deputetëve të LDK-së? Me çka i ke shantazhuar, me çka i ke ble? Ku janëvotuesit e Rugovës sot, të cilët i kanë votuar me premtimin që 'kurë me Hashimin'. Janë jashtë me opozitën. Nuk janë duke festuar, se kjo nuk është festë. Jashtë është popullidukekundërshtuar zgjedhjen e Hashim Thaçit president. Nuk është duke festuar.

[4] http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,160,107

[5] http://.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans__2016_02_26_11_6334_al.pdf, faqe 9.

Transkriptimi im i incizimit/xhirimit:[6]

1.a) DONIKA KADA-BUJUPI:Dje jeni **taku** me Listën serbe. A del Hashimi, **qe** sot po pretendon me u **zgjedh** president, me **na tregu** çka **i** ka **premtu** edhe çfarë **garancionev ju** ka **dhanë**, se dje **te** njejtit kanë **thanë** që **na** nuk e votojmë Hashim Thaçin president, sot **natje** po thojnë e votojmë, çka ju ke premtu dje, cilat **jon garancionet** shtesë? Çka **do me shitë ma** shumë **për me** marrë **ni** post për vete? **Çka don me shitë? I ke shit** goxha shumë **përmes** privatizimit e **përmes** proceseve, ku **durt e tua jonkon** thellë në korrupsion, po çka **po do me shitë tasht'** fundit herë?
Çka **ju** ke **bo** deputetëve të LDK-së? Me çka i ke **shantazhu**, me çka i ke ble? Ku **jonvotust** e **Rugovs** sot, **t'cilt** i kanë **votu** me premtimin që '**kurrë** me Hashimin'. **Jon** jashtë me opozitën. Nuk janë **tu' festu, kjo** nuk **osht** festë. Jashtë **populli osht tu' kundërshtu** zgjedhjen e Hashim Thaçit president. Nuk **osht tu' festu.**

Transkriptimi zyrtar:[7]

2. DAUT HARADINAJ: Faleminderit! Po i dëgjoj disa kërrokama këtu. Faleminderit shume Melihate, më vjen mirë për qëndrimin tënd. Shumë mirë më vjen! Më vjen mirë që në -27 gradë ftohtë kur e keni varrosur Rugovën, këtu i keni njerëzit, që ua kanë lënë mbi dhe. Ku e keni pasur Gardën Kombëtare atë ditë? Ku e keni marrë, a e di? Ku është Agim Çeku, komandanti? Le të flasë. ThuajeNur! Çka ke thënë atë ditë, thuaje hapur, thuaje publikisht. Mos fyeni këtu...
KRYETARI: Ju kisha lutur për qetësi, dëgjojeni njëri-tjetrin, secili ka të drejtë të flasë.
DAUT HARADINAJ: Jo, hyjmë rend me emra që doni të flisni për atë punë, nuk është telashe. Nuk kam kurrgjë kundër këtijnjeriu, por nuk është president i unitetit.

Transkriptimi im i incizimit /xhirimit:[8]

2.a) DAUT HARADINAJ: **Falimneritshumë**! Po i **nij do krrokamaktu**. **Falimneritshumë** Melihate, **m'** vjen mirë për qëndrimin **ton**. Shumë më vjen mirë! **M' vjen** mirë **qi** minus 27 gradë **ftoft** kur e keni **vorros** Rugovën, **qetu** i keni **njerzt**, që ua kanë **lan mi** dhe. Ku **i** keni **pas** Gardën Kombëtare atë ditë? Ku **i** keni **marr**, a e **din**? Ku **osht** Agim Çeku,

[6] https://.youtube.com/atch?v=ooisdBSM0g 2:43:49-2:44:49.
[7] http://.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans__2016_02_26_11_6334_al.pdf; faqe 13.
[8] https://.youtube.com/atch?v=ooisdBSM0g 2:58:52- 2:59:43.

komandanti? Le t' **folë. Çu Nurë thuje**! Çka ke **than** atë ditë, **çu thuje hapun, thuje** publikisht.(Ndërhyrje nga salla. Dëgjohen të shara/ ky koment nuk është i shënuar në transkriptim zyrtar) Mos **fyniktu**...

KRYETARI: Ju kisha **lut veqqetsi**, **ndëgjone** njëri-tjetrin, secili **ka drejtë me folë.**

DAUT HARADINAJ: **Ju, hymë** rend me rend që doni **me folë** për atë punë, nuk **osht** telashe. Nuk **kom** kurrgja kundër **qetij njeri, po** nuk **osht** president i unitetit.

Transkriptimi zyrtar:[9]

3. MELIHATE TËRMKOLLI: Ju sot keni thënë, s'po dua të bëj polemika, nuk po përmend emër, që shqiptarët nuk e duan Amerikën. Tmerri i tmerreve ore çka flisni! Po ku ka shqiptar, jo veç në Kosovë, kudo në botë, që nuk qenka me Amerikën, me krejt botën demokratike, sepse baza e demokracisë në këtë Evropë, në këtë botë, janë në rrënjët dhe në themelet e këtij vendi dhe të këtij populli. Nuk mund ne të mos jemi me Amerikën, sepse Amerika është me ne. Mbylle ore, e mos fol! Sot, a jemi me shtetin, a jemi me kaosin? Ne jemi me shtetin. Nuk po dua të merrem me individë. Ne jemi me shtetin! Ne nuk jemi me kaosin. Me këtë shtet të pavarur dhe demokratik, për të cilin e kemi dhënë jetën, kemi sakrifikuar plot 100 vjet. Mos e rrënoni këtë shtet se kurrkush nuk ka të drejtë ta rrënojë këtë shtet dhe po më flisni ju sot për votat që LDK-ja po e bëka Hashimin president. Veç pak, dëgjoni! Durim, të mirat vijnë pastaj.

Transkriptimi imi incizimit /xhirimit:[10]

3.a) MELIHATE TËRMKOLLI:**Sot** keni **thanë**, s'po **du me ba** polemika, nuk po **përmendiemën**, që **shqiptart** nuk **e dojnë** Amerikën. **Po** tmerri i tmerreve, **more,** çka **folni ju**! Po **ku ka more** shqiptar, jo veç **t' Kosovës**, kudo **n' botë**, që nuk qenka me Amerikën, me krejt botën demokratike, sepse baza e demokracisë **n' ketë** Evropë, **n' ketë** botë, janë në rrënjët dhe në themelet e këtij **veni** dhe të këtij populli. Nuk **mujm na mos me kan** me Amerikën, **nuk mujm mos me kan** me **Amerikën**, sepse Amerika **asht** me ne. **Mshele more ! Hajt mos m' fol! Jemi, sot, sot a jemi me shtetin, a jemi me kaosin? Na** jemi me shtetin. Nuk po **du me u marr** me individë. **Na** jemi me shtetin! **Na** nuk **jem** me kaosin. Me **qet** shtet të pavarur **e** demokratik, **që kemi dhan** jetën, kemi **sakrifiku qe 100 vjet**.

[9] http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans__2016_02_26_11_6334_al.pdf. Faqe 12.

[10] https://www.youtube.com/watch?v=ooisdBSWM0g. 2:56:04-2:57:36.

Mos e rrënoni këtë shtet se **kërkush** nuk ka **t'** drejtë **me rrënu** këtë shtet dhe po **m' folni** ju **mu** sot votat që LDK-ja po e **bojka** Hashimin president. Veç pak, **ngoni bre**! Durim, **durim t'** mirat **vin** pastaj.

Transkriptimi zyrtar:[11]

4. ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues! Pajtohem me përpjekjet tua dhe tonat të gjitha të përbashkëta për të kontribuar, për të mos lejuar eskalimin e situatës, për të bërë përpjekje dhe për ta dhënë maksimumin tonë të mundshëm në fuqizimin e shtetit, në funksionalizimin dhe në mbështetjen e institucioneve tona, mirëpo kjo që është dukendodhur në Parlamentin e Kosovës dhe në vendin tonë tani e shtatë muaj rreshtështë diçka e paparë, është e kundërligjshme, është e papranueshme dhe është e dënueshme. Këtu në këtë institucion më të lartë të vendit vendimmarrës, këta deputetë e këto deputete i janë nënshtruar një dhune të paparë, ku u është rrezikuar edhe jeta e tyre, por e kanë dhënë maksimumin e mundshëm që të mos lejojnë tentimin e bllokimit dhe shkatërrimin e shtetit.

Transkriptimi imi incizimit /xhirimit:[12]

4.a) ADEM GRABOVCI: **Falemnderit**, kryesues! Pajtohem me përpjekjet **tuja** dhe tonat të gjitha të **përbashkta** për të **kontribu**, për mos **leju** eskalimin e situatës, për **t' bo** përpjekje dhe për **t' dhanë** maksimumin tonë **t'** mundshëm në fuqizimin e shtetit, në funksionalizimin dhe **n' mbshtetjen** e institucioneve tona, mirëpo kjo që **oshtka'ndodh** në Parlamentin e Kosovës dhe në vendin tonë **qe** shtatë muaj **rrjesht osht** diçka e paparë, **osht** e kundërligjshme, **osht** e papranueshme dhe **osht** e **denushme**. **Ktu n' ket** institucion **ma** të lartë **t'** vendit **vendimarrs**, **kta** deputetë e deputete **i jon shtruni** dhune të paparë, ku u **osht** rreziku edhe jeta e tyre, **po** kanë **dhanë** maksimumin e mundshëm që mos lejojnë tentimin e **bllokimit te shtetit dhe shkatërrimin e shtetit.**

Siç del në pah nga shembujt e përzgjedhur, e folmja e deputetëve të Kuvendit të Kosovës është larg standardit të shqipes. Vështirë ta cilësosh si varietet apo dialekt, a të folme lokale të deputetëve në fjalë. Si përfundim nga ky hulumtim del se një pjesë e madhe e deputetëve të Kuvendit të Kosovës kanë kompetencë të paktë gjuhësore.

[11] http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2016_03_10_10_6348_al.pdf. Faqe16

[12] https://www.youtube.com/watch?v=ooisdBSWM0g, 1:48:26-1:52:00.

Ndonjëherë, madje përpiqen që të folmen e vet larg gjuhës standarde ta paraqesin si diçka të drejtë. Dy shembujt në vijim e pasqyrojnë këtë situatë:

Transkriptimi zyrtar:[13]

5. ZAFIR BERISHA: Mua po më vjen keq që para se të fillojë kjo pikë e rendit të ditës ministri iku, dhe kam përshtypjen si të kryhet, ai kthehet prapë, dhe kjo e bën se sa serioz janë ministrat e këtij kabineti ose kjo është vazhdimësi e qeverisjes sëkaluar kur është në pyetje injorimi i deputetëve. Unë thjesht e kam pasur një pyetje shumë të lehtë për ministrin, por po e bëj publike dhe në fillim e përmenda si rast eklatant. Si ministër, ai është edhe anëtar i Këshillit Prokurorial dhe sa është ligjore një i dënuar për krim dhe korrupsion të ligjërojë para prokurorëve të shtetit. Këtë desha për ta ditur prej ministrit, por besoj ministri është duke na përcjell, siç e njoh unë çfarë 'mangupi' është, ai është diku në zyre duke na përcjell dhe po besoj...
   KRYETARI: T'u kisha lutur në fjalorin, deputet!
   ZAFIR BERISHA: Është në fjalorin e gjuhës shqipe fjala "mangup", përndryshe nuk është në kontekstin negativ siç e kuptoni ju. Faleminderit!

Transkriptimi imi incizimit/xhirimit:[14]

5.a) ZAFIR BERISHA:**Mu** po **m'** vjen keq q**e** para se **me fillu** kjo pikë e rendit të ditës ministri **iki**, dhe **kom** përshtypjen si të **kryhet**, ai kthehet **prap a di**, dhe kjo e **ban** se sa serioz **jon** ministrat e **ktij** kabineti ose kjo **osht** vazhdimësi e qeverisjes **kalume** kur **osht** në pyetje injorimi i **deputetve**. Unë thjesht e kam **pasnji pytje** shumë të lehtë për ministrin, por po e **boj** publike dhe në fillim e përmenda si rast **eklatont**. Si ministër, ai **osht** edhe **antar** i Këshillit Prokurorial dhe sa **o** ligjore një i **dënum** për krim dhe korrupsion **me ligjeru** para prokurorëve të shtetit. **Kto deshta me ditpej** ministrit, **po** besoj ministri **o tu** na përcjell, **siç** e njoh unë çfarë 'mangupi' **osht**, ai **osht** diku në zyre **tu** na përcjell dhe po besoj...
   KRYETARI: T'u kisha **lut** në fjalorin, **t'lutem** deputet!
   ZAFIR BERISHA: **Osht n'** fjalorin e gjuhës shqipe fjala "mangup", përndryshe nuk **oshtn'** kontekstin negativ siç e kuptoni ju. **Falemnderit**!

Deputeti Zafir Berisha me ngulm insiston ta paraqesë fjalën 'mangup' si fjalë të gjuhës shqipe. Shembulli në vazhdim është insistim i ngjashëm, por kësaj here nga

[13] http://.assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2015_02_12_10_5765_al.pdf; faqe 18.

[14] https://.youtube.com/atch?v=fTGuRHBNlo&index=31&list=PL1XNaVD3Cv1fnPTSevMjFOfLn88g3ZTj.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli. Madje edhe duke germëzuar vetë mbiemrin e deputetes Melihate Tërmkolli, kryetari i Kuvendit e lexon gabimisht me zë, duke insistuar se e ka lexuar drejt, me qeshje në fund, që pasohet edhe nga qeshje e zëshme nga salla e Kuvendit, sepse në vend se Tërmkolli, mbiemrin ia shqipton si Tërm**o**kolli, për herë të dytë:

Transkriptimi zyrtar:[15]

6. MELIHATE TËRMKOLLI: Zoti Kadri Veseli, endenuk po di mirë të ma thotë mbiemrin, pornuk ka problem. Nuk e kam atë problem, se problemi është se në ato listat e SHIK-ut me gjasë ashtu ma kanë mësuar dhe ka mbetur ashtu, prandaj rregullojeni, përmirësojeni dhe nuk e di a ju duhet më? Ndoshta ju duhet, prandajpërmirësojeni! Kadri Veseli, Azem Syla, Adem Grabovci thanë se duhet të hiqet Jablanoviqi. Shumë në rregull, shumë mirë! Por, folën krejt pa lidhje, sepse thanë që po t'i kishim fyerneserbët, do të kishim dhënë dorëheqje. Unë e di se ju kurrë nuk do t'i kishit fyer serbët dhe krejt e dimëkëtë, por ka shumë arsye të tjera që nuk duhet patjetër për t'i fyer serbët për të dhënë dorëheqje. Prandaj, ju kisha lutur shumë - jepni dorëheqje! Jepni dorëheqje, sepse ka shumë arsye. Mbi të gjitha, janë vrasjet politike për të cilat ende nuk keni thënëkurrgjë, e duhet të thoni.

   KRYETARI: Kërkoj falje, por emrin e kam të shkruar kështu: zonja T-ë-r-m-k-o-ll-i, e në gjuhën shqipe lexohet Tërmkolli. E dyta, kisha dëshiruar që foltoret zakonisht të mos përdoren për çështjet të cilat nuk na takojnë këtu.

   Transkriptimi imi incizimit/xhirimit:[16]

   6.a) MELIHATE TËRMKOLLI: **Zotni** Kadri Veseli, **hala s'podin** mirë **me** ma **thanë** mbiemrin, **s' ka** problem. Nuk e kam atë problem, problemi **osht** qe në ato listat e SHIK-ut me gjasë **qashtu** ma kanë **msu** edhe **kamet qashtu** mbiemri, kështu **që rregullone, përmirësone edhe** nuk e di a ju duhet më? Ndoshta ju duhet, po **përmirësone**! Kadri Veseli, Azem Syla, Adem Grabovci thanë **qe** duhet **mu hek ky** Jablanoviqi. Shumë në rregull, shumë mirë! **Po**, folën krejt pa lidhje, sepse thanë që po t'i kishim **fy na serbt,kishimmedhanë** dorëheqje. Unë e di se ju kurrë **s'i kishitfyserbt** dhe krejt e **dina qe kurr** si **kishitfyserbt**, **po** ka shumë arsye të tjera që nuk duhet patjetër për **me i fy serbt për të dhanë dorëheqje**. Prandaj, ju kisha **lut** shumë - **japni** dorëheqje! **Japni** dorëheqje, sepse ka

[15] http://.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2015_02_05_10_5751_al.pdf; faqe 10.

[16] https://.youtube.com/atch?v=8dLmFrf5cfs.

shumë arsye. Mbi të gjitha, janë vrasjet politike për **t'** cilat ende nuk keni **thankurrgja, e duheni me than.**

KRYETARI**:** Kërkoj falje, **po** emrin e kam **t' shkrum**: zonja **T-ë-rr-m-k-o-l-l-i,n'** gjuhën shqipe lexohet **Tërmokolli**. (Të qeshura nga Kryetari i Kuvendit) E dyta, kisha **dëshiru zakonisht foltoret** mos **t'** përdoren për **çështje** cilat nuk **i** takojnë **kty**.

Ky shembull është dëshmi sesi transkriptimi zyrtar i Kuvendit paraqet ndërhyrje jo vetëm në rrafsh të lektorimit të gjuhës, por bëhen edhe ndërhyrje redaktuese. Nga varianti zyrtar i transkriptimit, nuk del që kryetari Veseli ka bërë ndonjë shkarje të qëllimshme a të paqëllimshme gjuhësore gjatë dialogut me deputeten Tërmkolli. Kjo e nxjerr të pakuptimtë diskutimin paraprak të deputetes dhe vërejtjen e saj për shqiptimin e pasaktë të mbiemrit të saj. Kjo ndërhyrje në transkriptimet zyrtare të Kuvendit të Kosovës është e tepërt, sepse del edhe përtej redaktimit gjuhësor. Është pasqyrim i pasaktë.

4. Përfundim

Ky punim ka bërë analizë gjuhësore të të folurit të deputetëvetë Kosovës dhe të Gjermanisë, duke krahasuar transkriptimet zyrtare të seancave me xhirimet/incizimet e tyre, për të parë se cila është gjuha e tyre e folur (e performuar) dhe si del e transkriptuar në transkriptimet zyrtare. Hulumtimi ka nxjerrë në pah ekziston e politikave të pashkruara (por që zbatohen zyrtarisht) për redaktimin sistematik gjuhësor të fjalimeve të deputetëve e të qeveritarëve në transkriptimin zyrtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kjo politikë dhe praktikë është e kundërt me praktikën e Bundestagut gjerman. Në Gjermani, transkriptimet janë pasqyrim i vërtetë i performancës ligjërimore të deputetëve. Në Kosovë, me redaktime dhe lektorime gjuhësore të fjalimeve në Kuvend, autenticiteti i ligjërimit preket ndjeshëm.

Ky punim gjithashtu dëshmon se kompetenca gjuhësore e politikanëve tanë varion. Një pakicë e tyre zotëron shqipen mirë, qoftë edhe nëse nuk e praktikon standardin sistematikisht në të folur. Fjala është për ata që komunikojnë me një përzierje të standardit dhe të gegnishtes, ose alternativisht në standard apo gegnisht. Problem nuk janë këta. Problemi kryesor nuk është moszbatimi i standardit, por gjuha shqipe e dobët e tyre, gjuha e nivelit nëndialektor e krahinor (ndonjëherë e nivelit të mëhallës!) të një pjese të deputetëve.

Në Kuvendin e Kosovës është adresuar një kërkesë për një ligj për mbrojtjen e shqipes standarde, iniciativë e Institutit Albanologjik të Prishtinës, që parasheh gjoba

për shkelësit e këtij standardi. Disa gjuhëtarë në Prishtinë kanë ironizuar me idenë. Madje Drejtori i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prof. Asoc. Dr. Rrahman Paçarizi, ka shtruar pyetje publike në lidhje me idenë e ligjit për shqipen: "Prej kujt me e mbrojtë gjuhën shqipe? Prej atyre që e flasin, a?"[17]. Po të miratohej e të hynte në fuqi ky ligj, gjobat për shkeljet e shumta gjuhësore të deputetëve do të mbushnin buxhetin e Republikës së Kosovës, ka përfunduar ai!

Literatura

Löffler, Heinrich, Germanistische Soziolinguistik.- Berlin : Erich Schmidt, 1994.

Ammon, Ulrich (Hg.): Perspektiven der Soziolinguistik = Perspectives of sociolinguistics. - Tübingen : Niemeyer, 2006.

Dittmar, Norbert: Grundlagen der Soziolinguistik: Ein Arbeitsbuch mit Aufgaben. Tübingen: Niemeyer, 1997 (Konzepte der Sprach- und Literaturwissenschaft; 57).

Vegëzat e përdorura nga interneti:

https://.youtube.com/atch?v=8dLmFrf5cfs
http://.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2015_02_05_10_5751_al.pdf;
http://dip21.bundestag.de/dip21/btp/18/18184.pdf
http://.bundestag.de/mediathek/?isLinkCallPlenar=1&action=search&ids=6970742&instance=m187&categorie=Plenarsitzung&destination=search&mask=search
http://.bundestag.de/dokumente/protokolle/.
http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,160,107
http://koha.net/?id=&l=75053
http://.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans__2016_02_26_11_6334_al.pdf,
https://.youtube.com/atch?v=ooisdBSM0g
http://.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans__2016_02_26_11_6334_al.pdf;
https://.youtube.com/atch?v=ooisdBSM0g
http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans__2016_02_26_11_6334_al.pdf.
https://www.youtube.com/watch?v=ooisdBSWM0g.

[17] http://koha.net/?id=&l=75053

http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2016_03_10_10_6348_al.pdf.
https://www.youtube.com/watch?v=ooisdBSWM0g,
http://.assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2015_02_12_10_5765_al.pdf;
https://.youtube.com/atch?v=fTGuRHBNlo&index=31&list=PL1XNaVD3Cv1fnPTSevMjFOfLn88g3ZTj.

Vjosa HAMITI

VARIETIES OF ALBANIAN USED IN THE PARLIAMENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Abstract

This paper shall examine the Albanian language used in the Parliament of the Republic of Kosovo in a bid to investigate the use of Albanian language varieties in this institution. The corpus for this paper consists of four selected parliamentary sessions. Official transcripts, but also the recordings, of the sessions will be examined to compare and contrast the spoken and written language in the transcripts. Of special interest will be the spoken language of the members of Parliament. Written speeches (which are read out in the sessions) will not be featured in this paper for the simple reason that they are generally edited/proof-read in advance and this shuts out the varieties of Albanian the people, in this case the MPs, actually speak in Kosovo. For comparison, and to illustrate the phenomenon, besides Albanian language varieties, this paper will examine the varieties of German in the German Bundestag, drawing upon the latter's transcripts and recordings of parliamentary sessions. The research work that has gone towards completing this paper will expose both the linguistic competence of the Kosovo (and German) parliamentarians, and the different practices of the treatment (the editing process involved) of the spoken language of speakers coming from the major legislative bodies in Kosovo and Germany.

Teuta ABRASHI

BASHKËVEPRIMI I DOMENIT EMËROR DHE FOLJOR

Analiza e strukturës sintaksore e sintagmës nominale (NP) si dhe interpretimi i saj semantik dëshmojnë se forma e kësaj strukture dhe interpretimi semantik nuk është e përcaktuar vetëm nga elementët e brendshëm të saj, por forma dhe interpretimi varen edhe nga ndikimi i elementëve të tjerë, të cilët janë pjesë e sintagmave të tjera. Ngjashëm është edhe me sintagmën verbale (VP). Por, sintaksa dhe interpretimi semantik i sintagmave, të cilat gjinden për rreth, apo në afërsi të sintagmës nominale apo sintagmës verbale, varen po ashtu nga elementët e këtyre të fundit. Pra, ekziston një bashkëveprim. Nëse afër sintagmës nominale gjendet sintagma verbale, dhe ato bashkëveprojnë, atëherë themi se kemi një bashkëveprim të sintagmës nominale dhe sintagmës verbale. Por, meqë në këtë bashkëveprim ndikim ka edhe rrethina e këtyre sintagmave, pra secila prej tyre ka një 'territor ndikues', atëherë mund të themi se ekziston një bashkëveprim ndërmjet domenit nominal dhe domenit verbal. Domeni nominal është domen i një sendi, ose domen i një individi apo entiteti, kurse domeni foljor është domen i një ngjarje, pra një veprim apo një aktivitet i një sendi apo individi. Meqë pjesë e ngjarjeve janë individët dhe individët krijojnë ngjarje, atëherë është e vetëkuptueshme që ky bashkëveprim ndërmjet domenit të individëve dhe domenit të ngjarjeve të jetë i pranishëm edhe në gjuhë. Në vijim do të paraqesim disa nga këto bashkëveprime të cilat manifestohen në rrafshin morfo-sintaksor dhe në rrafshin pragmatiko-semantik të gjuhës shqipe.

1. Bashkëveprimi në rrafshin gramatikorë

Manifestimi më i dallueshëm i këtij bashkëveprimi vërehet te kongruenca apo përshtatja ndërmjet gjymtyrëve kryesore të fjalisë: kryefjalës dhe kallëzuesit. Zakonisht nëpër librat e gramatikave të gjuhës shqipe, si p. sh. te Sintaksa e Çelikut thuhet: kryefjala përcakton formën e kallëzuesit kurse kallëzuesi përcakton interpretimin semantik të fjalisë. Një pohim i tillë është pjesërisht i vërtetë, sepse tiparet gramatikore të kryefjalës: gjinia, numri dhe veta pasqyrohen te mbaresa e foljes. Më poshtë do të shohim se në përcaktimin e formës dhe interpretimit, rol të rëndësishëm ka edhe konteksti. Por para kësaj, të rikujtojmë se mbaresa e foljes në esencë është

gramatikalizim i përemrit vetor që paraqet kryefjalën e rimarr, pra ngjashëm siç është edhe rimarrja e kundrinës. Mirëpo, përderisa kundrina e rimarr (qëndron edhe për arsye të tjera) është klitik dhe ende nuk është në stadin e fundit të gramatikalizimit, kryefjala e rimarr është e gramatikalizuar dhe paraqitet në formë të sufiksit. Kështu ndodh edhe te gjuhët e tjera indo-evropiane, prandaj edhe supozohet se një gramatikalizim i tillë ka ndodh qysh në gjuhën indo-evropiane dhe kjo pastaj është bartë edhe në të gjitha gjuhët e këtij grupi. Pyetja e shtruar se përse ndodh kjo rimarrje, ka një përgjigje të thjesht: për të siguruar pjesëmarrjen gjegjësisht bashkëveprimin e individit me ngjarjen. Për këtë arsye mbaresat e foljes, apo përemri i gramatikalizuar, i përcjellë tiparet e brendshme apo semantike të kryefjalës. Për të ilustruar ndikimin e kontekstit në përcaktim të formës, po veçojmë tiparin e vetës. Jo rrallë ky tipar konsiderohet një kategori gramatikore e foljes. Kjo është e vërtetë, por vetëm në rrafshin morfologjik, për shkak se ajo manifestohet te përemri i gramatikalizuar gjegjësisht mbaresa e foljes e jo edhe te vet kryefjala. Në fakt, sikurse numri, ashtu veta është një tipar semantik i emrit. Po të ishte kryefjala një emër në formën e vet më të përgjithshme, i pashquar dhe i pa paraprirë nga ndonjë përcaktor, siç është p. sh. nyja e pashquar *një*, apo dëftori *ky*, numri dhe veta te mbaresat e foljes nuk mund të licencohen dhe rrjedhimisht emri në këtë formë nuk mund të kualifikohet për të fituar statusin e kryefjalës. Thënë ndryshe, kjo ndodh kur emri nuk i referohet ndonjë individi të caktuar apo specifik. Mirëpo, referenca e emrit është një kategori pragmatiko-semantike dhe se ka raste kur ajo nuk manifestohet te kryefjala, por për shkak të kontekstit ajo nënkuptohet dhe rrjedhimisht ndërmjet kryefjalës dhe kallëzuesit përshtatja është e mundshme. Po e ilustrojmë një dukuri të tillë me shembullin si në vijim:

(1) Sekretarja ime dhe bashkëpunëtorja jote **është** gati për tu nisur.
(2) Sekretarja ime dhe bashkëpunëtorja jote **janë** gati për tu nisur.

Në shembullin (1) sekretarja dhe bashkëpunëtorja shënojnë të njëjtin individ, kurse në (2) sekretarja dhe individi shënojnë individë të ndryshëm. Përderisa gjuhë të tjera (si p.sh. gjuha gjermane) përdorin mjete të tjera për të kodifikuar numrin e referentëve (apo individëve) në një ngjarje[1] si në këtë shembull, në gjuhën shqipe vetëm nëpërmjet kongruencës kontekstuale të foljes **jam** mund të konkludojmë se a është sekretarja dhe bashkëpunëtorja personi i njëjtë (1) apo dy persona të ndryshëm (2). Prandaj themi se pjesërisht mund të pajtohemi me ato libra gramatikorë se

[1] Në gjuhën gjermane kur është fjala për një individ, shfaqet vetëm një nyjë e shquar, kurse në rastin e dy individëve nyja e shquar shfaqet dy herë.

"qendra drejtuese në rrafshin formal gramatikor"[2] është kryefjala. Pra, mund të themi se bashkëveprimi ndërmjet domenit emëror dhe foljor gjatë kongruencës është i pranishëm, por ky bashkëveprim varet jo vetëm nga manifestimet gramatikore, por edhe nga konteksti i ngjarjes.

2. Bashkëveprimi në rrafshin semantik

Të shohim tani se si qëndron çështja me konstatimin e dytë: " përbërësi kallëzues është qendra kryesore në rrafshin semantik"[3]. Në këta libra gramatikorë thuhet: folja-kallëzues sipas natyrës së saj semantike kërkon e kufizon semantikisht krahas kundrinorëve, edhe kryefjalën[4]. Secila folje, kur përfshihet në ligjërim, hap pozicionet (sikurse elementet kimike) për tu lidh me plotësat e veta, numri i të cilëve varet nga specifika leksikore e foljes. Në shembullin:

(3) Agimi e hëngri mollën.

Janë dy plotësa, sepse në ngjarjen e ngrënies të domosdoshëm janë dy participantë: ngrënësi dhe i ngrënshmi. Kufizimi semantik nënkupton se rolin e ngrënësit (shkaktarit) mund ta ketë vetëm *Agimi*, kurse rolin e të ngrënshmit (apo të pësuarit) mund ta ketë vetëm *molla*. Dhënia alternative e roleve, ku Agimi është i pësuari e molla është shkaktari, si p. sh.:

(4) Molla e hëngri Agimin.

përjashtohet sepse ajo mund të ndodh vetëm në ndonjë botë imagjinare, në rrethana surrealiste, në ndonjë planet tjetër apo civilizim jashtëtokësor. Mirëpo, në gjuhën e shkruar, por edhe në gjuhën e folur në media elektronike (radio, TV) këto rrethana apo kontekste alternative nuk janë të pamundshme. Të marrim këtë aforizëm të Kafkës:

(5) Ein Käfig ging einen Vogel suchen.

---

[2] Çeliku, Mehmet (2012:8): *Sintaksë e gjuhës shqipe-përbërësit sintaksorë*, ILAR, Tiranë

[3] Çeliku, po aty

[4] Krahaso p. sh. (i) *Beni theu dritaren* dhe (ii) *Beni theu këmbën*. Roli semantik i Benit në (i) dhe në (ii) dallojnë: i pari është shkaktari, kurse i dyti i pësuari. Kjo ndodh pavarësisht faktit se folja dhe kryefjala janë identike si në (i) ashtu edhe në (ii). Dallon vetëm kundrina. Rrjedhimisht, mund të thuhet se kufizimi i kryefjalës nuk varet nga folja, por nga folja + kundrina gjegjësisht VP (sintagma verbale) apo kallëzuesi.

(6) Një kafaz shkoi të kërkonte një zog.

Pra, edhe për bashkëveprimin e domenit emëror dhe domenit foljor, i cili manifestohet te rolet semantike gjegjësisht interpretimi semantik, varet gjithashtu nga konteksti i ngjarjes.

Të shohim tani në vijim disa shembuj te të cilët interpretimi varet drejtpërdrejt nga kallëzuesi:

(7) A janë letrat në dollap? - Po, një.
(8) A janë letrat të përziera? - *Po, një.

Në shembujt (7) dhe (8) fjala është për të ashtuquajtura letra me të cilat luhen lojëra të ndryshme të fatit (brixh, poker, remi etj.). Përgjigjja në (7) është kuptimisht korrekte, sepse njëra nga letrat mund të jetë mbetur në dollap kur të tjerat p. sh. në një moment të caktuar janë ç'vendos në një vend tjetër. Kurse, përgjigjja në (8) kuptimisht është jo korrekte. S'përputhja ndërmjet përgjigjes në (7) dhe (8) në nivel të sintagmës verbale (VP): *janë në dollap* kundruall *janë të përziera*. Predikatit në shembullin (7): *janë në dollap* i nënshtrohet secili pjesëtar i grupit *letra*, sepse secili pjesëtar i grupit mund të jetë apo mungon në dollap, kurse predikatit *janë përzier* në (8), i nënshtrohet grupi si tërësi, sepse vetëm grupi mund të përzihet e jo një pjesëtar i vetëm i tij. Në semantikë, predikatet të cilave u nënshtrohen të gjithë pjesëmarrësi e një ngjarje, quhen predikate

distributive, kurse predikateve të cilëve u nënshtrohet grupi si tërësi, quhen predikate kolektive.

(9) Nita dhe Agimi flenë. (predikat distributiv)
(10) Nita dhe Agimi u takuan me njëri tjetrin. (predikat kolektiv)

Kështu në (9) predikati flenë është distributiv sepse (9) mund të parafrazohet si *Nita fle* dhe *Agimi fle*, kurse për shembullin (10) një parafrazë e ngjashme është e pamundshme, sepse nuk mund të thuhet *Nita u takua me njëri tjetrin* dhe *Agimi u takua me njëri tjetri. Takimi me njëri tjetrin* kërkon dy persona. Por, ka predikate të cilat janë njëkohësisht distributive dhe kolektive. Ato quhen predikate të përziera dhe lejojnë në disa raste më shumë se një interpretim:

(11) Tre burra e kërkuan sot Agimin.

Shembulli (11) ka dy interpretime: (i) interpretimin distributiv, i cili nënkupton që Agimin sot e kërkuan tre burra veç e veç, dhe (ii) interpretimin kolektiv, me ç'rast nënkuptojmë se të *tre burrat* bashkërisht, e jo ndaras, *e kërkuan sot Agimin*.

Ngjashëm është edhe me të ashtuquajturit koncepte funksionale, të cilët në esencë janë emra interpretimi i të cilëve varet nga sintagma verbale (VP) dhe na tregon funksione të ndryshme të po të njëjtit nocion. Kështu p. sh. nëse thuhet:

(12) Temperatura do të ngrihet.

atëherë temperatura shënon një funksion të konceptit *temperaturë*, por nëse thuhet se:

(13) Temperatura është 37 gradë.

atëherë ajo shënon vlerën e një funksioni të këtij koncepti. Ngjashëm është edhe me konceptin *parlament*. Nëse thuhet

(14) Puçistët shfuqizuan (abroguan) parlamentin.

atëherë fjala është për një funksion të parlamentit, kurse nëse thuhet:

(15) Puçistët shpërndanë parlamentin.

Në (15) fjala është për një çështje të caktuar në kuadër të funksionit të parlamentit, pra flitet për një vlerë të caktuar të një funksioni të caktuar të parlamentit. Kështu, në rastin (14) nuk priten zgjedhje të reja sepse parlamenti nuk ekziston më, kurse në (15) priten zgjedhje të reja, sepse aktet përkatëse juridike kërkojnë shpërndarjen e parlamentit para zgjedhjeve të reja.

Se a do të jetë një shprehje gjeneralizuese apo individualizuese, varet nga struktura dhe forma e kallëzuesit:

(16) Patat**ja** erdhi nga Amerika Jugore.
(17) Patat**ja** përmban kryesisht hidrate të karbonit.

Në literaturën e mëhershme, jo vetëm ndërkombëtare por edhe shqiptare[5] supozohej se nyja shquese ka funksion gjeneralizues. Madje, kështu supozohej edhe për nyjën jo shquese **një**:

[5] Shiko p. sh. Riza, Selman (1979: 170): *Studime Albanistike*, Rilindja, Prishtinë

(18) **Një** luan zakonisht konsiderohet **një** kafshë agresive.

Mirëpo, nëse në shembullin (17) foljen *përmban* e zëvendësojmë me foljen *rrokulliset*:

(19) Patatja rrokulliset drejt dollapit.

atëherë gjasat janë shumë reale se fjala është për një patate e cila (eventualisht) ka rënë nga tavolina dhe folësi i tregon dëgjuesit, i cili nuk e sheh patateN, se ajo rrokulliset drejt dollapit. Pra, duke ndërruar foljen, e jo nyjën, interpretimi gjeneralizues i shprehjes shndërrohet në një shprehje individualizuese. Prandaj, pohimi se nyja ka edhe funksion gjeneralizues nuk qëndron, Tek e fundit gjuha shqipe, por edhe gjuhë të tjera nuk kanë një nyje apostafat për të krijuar shprehje gjeneralizuese.

Se interpretimi i një shprehje gjeneralizuese shndërrohet në një shprehje individualizuese duke modifikuar (20) gjegjësisht duke ndryshuar vetëm formën e foljes së kallëzuesit (21), tregojnë shembujt në vijim:

(20) Zogu këndon. (Shprehje gjeneralizuese)

i cili nëse modifikohet me një ndajfolje kohore:

(21) Sot zogu këndon më shumë. (shprehje individualizuese)

shndërrohet në një shprehje individualizuese. Një gjë e tillë mund të bëhet edhe duke e zhvendosur ngjarjen në kohën e shkuar:

(22) Zogu këndoi. (shprehje individualizuese)
(23) Zogu këndonte. (shprehje individualizuese)

Përveç ndikimit të foljes në domenin emëror i pranishëm mund të jetë edhe ndikimi i domenit emëror në domenin foljor:

(24) Nita (e) hëngri mollën.
(25) Nita (e) hëngri një mollë.
(26) Nita (*e) hëngri mollë.

Në shembujt (24) dhe (25) bëhet fjalë për ngjarje të cilat kanë një fillim dhe një fund, pra janë të kufizuara apo të caktuara. Kurse në shembullin (26) ngjarja nuk ka fund. Numri i mollëve të ngrëna nga Nita nuk është një mollë si në (24) dhe (25), por është një numër i pacaktuar i mollëve, prandaj një ngjarje e tillë gjithsesi e ka një fillim, por nuk ka një fund të caktuar pasi numri i mollëve është i pakufizuar. Rrjedhimisht, ngjarja është e pacaktuare. Në literaturë ngjarjet të cilat kanë fund quhen **telike** (nga greqishtja *telos* që do të thotë *cak*), kurse ato pa kufizuar quhen **atelike**. Në shembujt e mësipërm vërejmë se struktura e sintagmës emërore drejtpërdrejt ndikon se a është një ngjarje telike apo atelike. Në shembujt telikë (24) dhe (25), te sintagma emërore është e pranishme nyja shquese *-n* (24) gjegjësisht nyja jo shquese *një* (25), kurse në shembullin atelik (26) sintagma emërore shfaqet pa nyja. Në fakt disa gjuhëtarë[6] pohojnë se emri mollë nuk është fare kundrinë, por thjesht një predikat me tiparet tipike të mollëve. Një evidencë për një pohim të tillë është edhe mos aftësia në shembullin (26) për të bërë rimarrjen e kundrinës. Te kjo sintagmë emërore mungon tipari i numrit dhe vetës, prandaj klitiku ***e*** i kundrinës së rimarrë nuk mund të licencohet.

Kur flitet për kufizimin apo jo kufizimin e ngjarjeve, flitet në fakt për aspektin e po të njëjtës ngjarje. Te disa gjuhë, si p. sh. ato sllave, ky dallim bëhet në rrafshin morfologjik, nëpërmjet prefiksit (*iz-*) të foljes, ashtu që të dy format janë të shënuara si fjalë të veçanta të këtyre gjuhëve. P. sh. në gjuhën bullgare:

Pacaktuar	Caktuar	
(27) jam (po ha)	iz-jam (përfundova së hëngri)	e tashme
(28) jadjah (po haja)	iz-jadjah (haja)	e pakryera
(29) jadoh	iz-jadoh (hëngra)	aoristi[7].

Kurse, në gjuhën shqipe, ngjashëm sikurse te gjuhët romane, aspekti në rrafshin morfologjik është ruajtur vetëm te strukturat temporale të së kaluarës: imperfekti/aoristi, p.sh. flisja-fola, këndoja-këndova. Këto forma nuk njihen si fjalë të veçanta, por si pjesë e eptimit të foljeve përkatëse. Mirëpo, siç e pamë më lart (24-25), në gjuhën shqipe kategoria semantike e aspektit realizohet edhe nëpërmjet kompozicionalitetit, thjesht duke vendosur apo mos vendosur nyjën te kundrina e drejtë. Lidhur me këtë, disa gjuhëtarë[8] pohojnë se nyja dhe aspekti janë dukuri

[6] si p. sh. Kallulli (1999): *The Comparative Syntax of Albanian. On the Contribution of Syntactic Types to Propositional Interpretation*. Doctoral dissertation. University of Durham

[7] Gjuha bullgare është gjuhë e vetme sllave te e cila përdorimi i aoristit është ende i pranishëm (shiko: Kabakçiev (2000: 6): *Aspect in English*. Dordrecht: Kluwer)

[8] Përveç Kabakçiev shiko p. sh. edhe Leiss, Elisabeth (2000): *Artikel und Aspekt. Die grammatischen Muster von Deffnitheit,* de Gruyter, Berlin

ekuivalente gramatikore. Evidencë për një pohim të tillë janë gjuhët me sistem të zhvilluar të aspektit, te të cilat individualizimi i shprehjeve bëhet nëpërmjet aspektit. Këto gjuhë, hiç bullgarishten dhe maqedonishten, zakonisht nuk kanë nyja. Madje, këta gjuhëtarë shkojnë edhe më larg. Ata pohojnë shfaqja e nyjave në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera nuk u bë vetëm për shkak të rrafshimit të rasave, por edhe për shkak të zhbërjes së sistemit morfologjik të aspektit dhe zhdukjes së kundrinës adverbale në gjinore.

Teuta ABRASHI

INTERACTION OF THE NOMINAL AND VERBAL DOMAIN

Abstract

Traditionally, regarding the category of aspect, an event is considered completed or uncompleted by the presence or absence of an affix to the verb, codifying it on the morphological level. Codification however can be done alternatively: through interaction of the nominal and verbal domain. As a consequence, in some languages which already lost their aspectual marking at verbal ending, aspect is accomplished in the syntactic and semantic level, using instead the compositionality principle. This article shows that Albanian, compared to German and other Anglo-Saxon languages, which use only so called compositional aspect, have a hybrid system. That is, on the specific temporal dislocation of an event characterized through the verb, its aspect is coming into effect compositionally or morphologically, an occurrence which is present in Roman languages as well.

Haki HYSENAJ

VARIETETI NË ZHDUKJE, RASTI I SË FOLMES SË RUGOVËS

Abstrakti

Qëllimi i këtij studimi është përshkrimi i varietetit gjuhësor të Rugovës së Pejës. Ky varietet paraqet kontinum të gegërishtes veriperëndimore. Në dy deceniet e fundit ka pësuar ndryshim të madh gjuhësor. Migrimi i popullatës në qytetin e Pejës me rrethinë, ndryshimi i rrethanave shoqërore, si dhe kontakti i përhershëm me folës të gegërishtes verilindore, janë faktorë që kanë ndikuar në këtë ndryshim gjuhësor.

Ndryshimi dëshmohet me matjet e hulumtimit të bërë në terren, në pjesën e parë të vitit 2016. Analiza e korpusit tregon se vetëm brezi i vjetër ende e përdor këtë varietet, ndërsa dy brezat e tjerë, i mesmi dhe i riu, e flasin varietetin e gegërishtes verilindore, me pirje të theksuara të përdorimit gjithnjë e më të madh të varietetit standard të shqipes.

Studimi tregon se e folmja e Rugovës është në fazën e fundit të zhdukjes për përdoruesit e saj.

Fjalë kyçe: *e folmja e Rugovës, varieteti gjuhësor, gegërishtja veriperëndimore, gegërishtja verilindore, zhdukja e varietetit.*

Sfondi teorik

E folmja e Rugovës së Pejës është kontinum i gegërishtes veriperëndimore. Paraqet një të folme konservative të këtij nëndialekti.

E gjendur vetëm 5 kilometra larg qytetit të Pejës, banorët e këtij visi malor ishin në kontakt të përhershëm me folës të gegërishten verilindore. Sipas autorit të monografisë se vetme për këtë të folme, ndikimet nga kosovarishtja megjithatë qenë minimale (Hajdaraj, 1996: 14).

Monografia e Hajdarajt është botuar para migrimit masiv të banorëve të këtij visi në qytetin e Pejës me rrethinë. Migrimi ka ndodhur pas luftës së fundit në Kosovë. Paralelisht zhvendosjes ndodhen edhe ndryshime dinamike në varietetin gjuhësor të kësaj popullate. Ky varietetet sot flitet nga një numër i vogël folësish.

Për këtë varietet gjuhësor ka disa punime shkencore. Ka shkruar Desnickaja, Begolli, Kelmendi (cituar sipas Hajdaraj, 240: 242). Ndërkaq, studimi ynë përshkruan zhvillimet gjuhësore të gjuhës së folur të folësve të këtij varieteti pas migrimit të tyre në Pejë dhe përreth saj.

Pas luftës së fundit në Kosovë (1998/1999) rugovasit pasivisht u shpërngulën në qytetin e Pejës dhe fshatrat përreth. Në vendbanimet e reja u përballen me rrethana të reja socio-kulturore. Në këtë realitet edhe varieteti i tyre gjuhësor ra nën trysninë e varietetit vendës, gegërishtes verilindore. Gradualisht rugovishtja u zëvendësua me varietetin e banorëve vendës.

Hulumtimi ynë tregon se vetëm gjenerata e vjetër ende e flet këtë varietet. Siç thekson Coupland (Coupland, 2007: 3), brezi i vjetër edhe në rrethana të reja e përdor qëllimshëm varietetin e vet gjuhësor për t'u dhënë kuptim takimeve sociale. Ndonjëherë, për qëllime të ngjashme, njësoj veprojnë edhe folësit e gjeneratës së mesme, të cilët janë të lindur në Rugovë, por të rritur në vendbanime të reja. Ndërkaq, brezi i mesëm i folësve me origjinë rugovase ndodhet në situatë diglosie. Informatorët tanë janë shprehur se janë të vetëdijshëm për dy varietetet që i flasin njëkohësisht. Kanë përmendur situatat folëse, pjesëmarrësit në bisedë, përshtatjen më rrethin dhe faktorë të tjerë gjuhësorë e jogjuhësorë që ndikojnë në sjelljen e tyre gjuhësore. Në pyetjen se kur e flasin rugovishten janë shprehur se vetëm kur gjenden "***brenda llojit***" dhe kur duan qëllimshëm të shprehin identitetin e tyre regjional. Përjashtim ka bërë vetëm një informator, i cili gjithmonë ka folur varietetin nativ.

Siç do të shihet në vijim, fëmijët e lindur e të rritur në Pejë nuk e flasin këtë varietet. Brezi i ri nuk e di fare, sepse nuk e ka mësuar asnjëherë. Kjo situatë tregon se ky varietet është në zhdukje për komunitetin rugovas. Në Rugovë jetojnë vetëm edhe 14 familje me gjithsej 70 anëtarë. Edhe atje vërehen prirje të ndryshimit gjuhësor të këtij varieteti.

Zhdukja e këtij varieteti ngjason me procesin e zhdukjes e gjuhëve e të varieteteve edhe të gjuhëve të tjera. Ky proces në literaturën shkencore njihet me termin ***"vdekje e gjuhës"***.

Lyle Campbell dhe Martha C. Muntzel (1989), duke folur për këtë proces përmendin ***vdekjen e papritur të një gjuhe a varieteti*****,** e cila shkaktohen nga shfarosja e një bashkësie folëse, ***vdekjen radikale***, që është rezultat i shtypjes deri në përmasat sa folësit e një gjuhe pranojnë gjuhën e pushtuesit për të mbijetuar; ***vdekjen graduale***, që është rezultat i dominimit të gjuhës me prestigj, dhe së fundi ***vdekjen e gjuhës sipas modelit të latinishtes.*** E folmja e Rugovës mendojmë se është duke përjetuar tipin e tretë të "***vdekjes***".

Ndërsa, Norman Denison (Denison, 1977: 13-22) shpjegon se vdekja e gjuhës dhe e varietetit ndodh kur folësit përkatës ndodhen në rrethana të detyrimit të ndërrimin e kodit të tyre gjuhësor. Po ashtu, shpjegon se shpesh vetë folësit nuk e ndiejnë më të nevojshme të përdorin varietetin nativ për faktin se e kanë kuptuar se edhe fëmijët e tyre nuk janë të interesuar për të fituar kompetencë aktive nga një gjuhë apo varietet të cilit i mungon konotacioni pozitiv. Në këto rrethana edhe varieteti gjuhësor (njëjtë si edhe gjuha) tërhiqet gradualisht nga përdorimi, derisa një ditë zhduket krejtësisht (Ibid.).

Fishman (1991) përmend faktorët demografikë, ekonomikë, identitarë dhe masmediet si kryesorët që ndikojnë në ***ndryshimin gjuhësor***. "***Faktori demografik është ndër vendimtarët për fatin e një gjuhe***", (Černŷ, 2010: 54). Sipas këtij autori, ky faktor përcakton nivelin e rrezikshmërisë së një gjuhe a varieteti, nivelin e tkurrjes dhe zhdukjen e tërësishme të tij.

Ne mendojmë se për varietetin gjuhësor të Rugovës nuk mund të përdoret termi ***vdekje***, sepse një gjuhë, sipas David Crystal (Cryistal, 2000: 11), konsiderohet e vdekur kur asnjë folës i saj nuk e flet më. Ndërsa e rrezikuar konsiderohet në rastin kur numri i folësve është më i vogël se 100 persona (2000: 13). Këtë status e ka edhe varieteti për të cilin po flasim. Shënimet nga terreni saktësojnë se sot përafërsisht janë vetëm 100 rugovas që e flasin varietetin gjuhësor të vendlindjes.

1. Vështrim i shkurtër socio-historik i Rugovës

Rugova shtrihet në perëndim të qytetit të Pejës. Nga ana veriperëndimore paraqet vazhdimësi gjeografike të Bjeshkëve të Nemuna, me sa mund të kuptohet, edhe degëzim apo vazhdim të Malësisë së Madhe (Kelmendi, 1979: 304). Përbëhet nga 13 katunde.

Studimet tregojnë se ky lokalitet malor ishte i banuar edhe para shpërnguljeve të dhunshme të kelmendasve, në shekullin e XVIII (Hajdaraj, 1996: 20). Vetë rugovasit veten e cilësojnë si kelmendas. Deri në përfundim të luftës së fundit në Kosovë 13 fshatrat e Rugovës kanë qenë të banuara gjatë tërë vitit. Sipas regjistrimit të fundit zyrtar të ish-Jugosllavisë (1981), në këtë krahinë jetonin 2275 banorë, ndërsa sipas një studimi të Selman Lajçit[1], më 1992, Rugova kishte 178 familje të përhershme me 1477 banorë. Po sipas këtij autori, gjatë verës Rugova kishte 541 familje me 4507 banorë. Diferenca në shifrat e popullatës flasin për procesin e migrimit të kësaj popullate edhe para luftës së fundit.

[1] Selman Lajçi, *Numri i familjeve të Rugovës më 1991, dorëshkrim i cituar sipas A. Hajdarit*

Në vitin 2016 vetëm katër fshatra kanë ende banorë të përhershëm. Në fshatin Shkrel jeton 1 familje me 5 anëtarë, në Kuqishtë 3 familje me 25 anëtarë, në Drelaj 5 familje me 25 anëtarë dhe në Shtupeq të Madh 5 familje me 25 anëtarë., që do të thotë 14 me gjithsej 70 banorë. Në Drelaj funksionon shkolla fillore "Përparimi", në të cilën 18 nxënës i vijojnë mësimet fillestare në klasa të përziera.

Sipas Mirko Bajraktareviçit, Rugova me 13 fshatrat e veta shtrihet në 193 kilometra katrorë [2].

2. Përshkrim i shkurtër i së folmes së Rugovës

Desnickaja konstaton se ky varietet kishte ruajtur karakterin konservativ edhe pse i shkëputur nga varieteti që i takonte, gegërishtja verilindore (Desnickaja, 1972: 70-73). Shumë vite më vonë, Hajdaraj konstaton se e folmja e këtyre banorëve, kryesisht e brezit të vjetër, ruan karakteristikat themelore të së folmes së Veriperëndimit të Malësisë së Madhe (Hajdaraj,: 21).

Studimet e konsultuara dhe hulumtimi në terren vënë në pah këto tipare gjuhësore të këtij varieteti:

1. Ruhen seritë e zanoreve hundore dhe të gjata
2. Në rrokje të mbyllur zanoret gjithmonë realizoheshin të shkurtra
3. Në shumë raste në fund të fjalës bashkëtingëlloret e zëshme shurdhohen
4. Ruhet togu zanor **ua** në pjesoret e foljeve (pun**ua**, shk**ua**...), si dhe te koha e tashme e dëftores: d**ua**
5. Grupet e vjetra konsonantike realizoheshin si k**i̯** dhe g**i̯**
6. Grupet konsonantike **mb**, **nd**, **ng** dalin në variante të ndryshme, përafërsisht si në varietetin e Malësisë së Madhe, dhe në fushë të morfologjisë:
7. përdoret infinitivi i tipit të vjetër: me shk**ua**, me pun**ua** (Hajdaraj,: 22).

Në vijim do të merremi me trajtimin e këtyre tipareve. Hundorësia dhe gjatësia e zanoreve nuk janë përshkruar, sepse nuk dallojnë nga gjegjëset e tyre në gegërishten verilindore. Tiparet e tjera përshkruhen sipas përndarjes së tyre në funksion të variacionit gjuhësor. Hulumtohen në korrelacion me faktorët jashtëgjuhësorë, siç janë: mosha, gjinia, niveli i arsimimit dhe vendbanimi.

[2] Dr. Mirko Barjaktarević, *Rugova i njeno stanovništo,* Beograd, 1960, f. 168 (cituar sipas A. Hajdaraj)

3. Puna në terren dhe metodologjia

Për të realizuar këtë punim është dashur hulumtimi në terren. Mbledhjen e të dhënave e kemi filluar ne muajin prill dhe e kemi përfunduar ne fund të majit të vitit 2016. Takimeve me informatorë, në Rugovë dhe në Pejë, u kanë paraprirë kontaktet më të hershme që kemi pasur me folës të këtij varieteti, prandaj në shumë raste nuk e kemi pasur të vështirë mbledhjen e materialit të synuar. Shumë informatorë janë ndierë të relaksuar gjatë intervistave dhe bisedave të bëra, prandaj të folurit e tyre nuk ka qenë i kujdesshëm, gjë që kërkohet në studimet e këtij lloji.

Gjatë mbledhjes së materialit kemi shfrytëzuar intervista sociolinguistike, biseda dhe ritregime. Ritregimi është përdorur me fëmijët, si formë reale e nxjerrjes së të dhënave të synuara. Ndërsa, për hartimin e intervistës jemi shërbyer me mostrat e Tagiamonte, Sali A. (2006), të Váradi, Tamás (1998) dhe të Viliam Llabovit (1984). Varësisht nga rrethanat e realizimit të intervistës, ka ndodhur të reduktojmë ose edhe të ndryshojmë disa pyetje.

Ndonjëherë të dhënat janë nxjerrë sipas modelit Llabovian, i aplikuar për rastin e New York-ut (Labov, 1972), prandaj në intervistë janë përfshirë edhe pyetje që kanë zgjuar emocione të subjekteve folëse, si përjetimet nga lufta e fundit, kujtime nga martesat dhe kujtime të tjera nga jeta idilike.

Kemi vënë re se këto pyetje kanë nxitur të intervistuarit të rrëfejnë pa i vënë kujdes të folurit, situatë kjo që shpërfaqë të folurit natyral të informatorëve. Ndërsa, për të zhdukur **"*paradoksin e vëzhguesit*"**, siç e quan Labov, shpesh kemi mbledhur të dhënat e synuara nga bisedat spontane midis informatorëve, folës nativë të të njëjtit varietet gjuhësor.

Intervistat me gratë e moshuara kanë qenë më të vështira dhe në disa raste kanë dështuar. Ishte hezitimi i tyre për t'u intervistuar nga një i panjohur, prandaj jemi detyruar që dy intervista të tilla t'i realizojmë me ndërmjetësim. Këtë punë e ka bërë studentja sime, Shqiponjë Nikçi.

Nga ana tjetër, nuk jam krejtësisht i sigurt nëse kam arritur të nxjerr gjuhën e përditshmërisë të brezit të ri. Analiza e materialit të incizuar tregon se ata nuk e flasin varietetin e prindërve. Përgjigjet i kanë dhënë vetëm në varietetin e gegërishtes verilindore me elemente të shumta të gjuhës standarde.

Këta fëmijë nuk e kanë mësuar gjuhën e prindërve, sepse janë rritur në një ambient ku flitet një varietet tjetër e që ka prestigj. Ndërsa, prirja e tyre për t'u përgjigjur vetëm në gjuhën standarde mendojmë se është tregues i saktë i përdorimit konstant të këtij varieteti. Po me këtë varietet janë përgjigjur edhe 18 nxënësit e Rugovës, banorë të përhershëm atje.

Siç do të shihet më vonë, rasti i fëmijëve të Rugovës del pak më kompleks. Ata rrjedhin nga martesa të përziera. Babanë e kanë rugovas, ndërsa nënën nga fshatra të Pejës ose edhe të komunave të tjera afër.

Për të përshkruar statusin gjuhësor të këtij varieteti, në këtë mes tkurrjen e tij përdoruese deri në përmasat e zhdukjes së plotë, kemi shfrytëzuar materialet e incizuara me 14 subjekte. Për qëllime studimi subjektet folëse janë të ndarë në grupe sipas moshës, gjinisë, nivelit të arsimimit dhe vendbanimit.

Aplikimi i kriterit të fundit ka qenë i domosdoshëm, sepse ndërrimi i varietetit gjuhësor nga ky komunitet shpjegohet me procesin e migrimit të tij.

Klasifikimi i subjekteve në grupe, sipas kritereve të përmendura, duket kështu:

14 folës	Gjinia	Mosha	Arsim.	Vendb.	Gjinia	Mosha	Arsim.	Vendb.
	m.	83	4 vjet	Rug-Pejë	f.	75	4 vjet	Pejë
	m.	76	4 vjet	Rugovë	f.	72	4 vjet	Rrethinë
	m.	55	Fakulteti	Pejë	f.	25	studente	Pejë
	m.	43	Fakulteti	Pejë	f.	18	studente	Pejë
	m.	16	Nxënës	Pejë	f.	14	nxënëse	Rugovë
	m.	14	Nxënëse	Pejë	f.	13	Nxënës	Rugovë
	m.	10	Nxënës	Pejë	f.	9	nxënëse	Rugovë

Materiali i incizuar shtrihet në 3 orë e 45 minuta dhe i tëri, për qëllime studimi, është transkriptuar. Subjektet folëse i kemi koduar me shifrat SM1, SM2 deri SM7 (për subjektet meshkuj) dhe SF1, SF2 (për subjektet femra të brezit të vjetër); SSF1 e SSF2 për studentë dhe SNM1, SNM2; SNF1, SNF2 dhe SNF3 për nxënësit.

4. Provat e gjetura

Për të përshkruar gjendjen aktuale të përdorimit të këtij varieteti gjuhësor dhe prirjet e ndryshimit të tij kemi hulumtuar dendurinë e përdorimit të 6 ndryshoreve kryesore të kësaj të folmeje. Në realitetin e ri gjeografik e gjuhësor të folësve të këtij varieteti ne kemi regjistruar prezencën e mundshme të këtyre varianteve, duke i parë edhe në nga aspekti i frekuencës së përdorimit.

Transkriptimi i materialit të incizuar ka reflektuar gjithsej 249 ndryshore të përdorura në gjuhën e folur të 14 subjekteve tona folëse. Këto gjetje janë shfrytëzuar si prova për hulumtim. Janë nxjerrë nga intervistat dhe bisedat e bëra me brezin e vjetër (4 subjekte folëse, dy meshkuj e dy femra) dhe nga intervistat e bëra me 2

subjekte të tjera, që përfaqësojnë brezin e mesëm. Dy subjektet e para të brezit të vjetër jetojnë në Rugovë, ndërsa 2 të tjerat në në Pejë.

Ndryshoret gjuhësore të rugovishtes dalin në gjuhën e brezit të vjetër. Brezi i mesëm i përdor vetëm në situata të caktuara.

Nga numri total i provave 191 janë variante tipike të varietetit të së folmes së Rugovës, ndërsa 58 të tjera janë variante të varietetit që flitet në Pejë me rrethinë. Shprehur me përqindje raportet janë: 77% ndaj 23 %. Përqindja e dytë përfaqëson variacionin fonetik të së folmes së Pejës me rrethinë, që rezulton edhe në gjuhën e informatorëve tanë. Ky ndryshim ka ardhur nga ndërveprimi dhe kontakti gjuhësor. Te brezi i vjetër i folësve të rugovishtes ndryshimi ka përparuar ngadalë, pasi që, sipas Holmes, pjesëtarët e këtij komuniteti kanë ruajtur lidhje të ngushta mes vete (Holmes, 2015:261).

Transkriptimi i gjuhës së folur të 7 subjekteve të tjera, që u takojnë brezave të rinj, 2 studentë dhe 6 nxënës, nuk ka dhënë prova për përshkrimin varietetit gjuhësor të prindërve të tyre.

Në pyetjen se pse nuk e flisni gjuhën e prindërve nxënësit me prejardhje nga Rugova janë përgjigjur se e dinë dhe se njëkohësisht nuk duan të dallohen nga bashkëmoshatarët e tyre. Në gjuhësi ky faktor njihet si ndjenjë ***e mosstigmatizimit shoqëror***. Prandaj, ky brez, siç shprehet Labov, identifikon gjeneratën e parë që ka flakur varietetin nativ për ta zëvendësuar me varietetin e rrethit të ri shoqëror. Ndërkohë që përgjigjet e nxënësve rugovas, që jetojnë në Rugovë, të vënë në dilemë nëse "*format e reja mund të krijojë prestigj prej medies*" (Ibid,:264). Thonë se e kanë mësuar më mirë varietetin që përdoret ne medie.

5. Rezultatet e interpretimit të provave

Siç u tha më lartë, përshkrimi i ndryshoreve gjuhësore të 6 folësve të varietetit gjuhësor të Rugovës, që përfaqësojnë brezin e vjetër dhe të mesëm, ka dhënë shifrën prej 249 ndryshoresh dialektore. 191 prej tyre, ose 77%, i takojnë varietetit të Rugovës, ndërsa 58 të tjera, ose 23%, janë variante alternative të përvetësuara nga kontakti gjuhësor me folës të gegërishtes verilindore.

Bazuar në dendurinë e përdorimit të këtyre varianteve rezulton se varieteti gjuhësor rugovas, i përdorur edhe në vendbanimet e raja të këtij komuniteti, me kohë ka inkorporuar në sistemin e vet edhe ndryshore fonetike të dialektit në kontakt. Numri i tyre nuk është i madh për faktin se ndryshimi gjuhësor për këtë brez është i ngadalshëm falë ruajtjes së lidhjeve farefisnore midis pjesëtarëve të këtij komuniteti.

Bazuar në studimet ekzistuese ky ndryshim gjuhësor kishte nisur në përmasa shumë më të vogla edhe në kohën kur migrimet ishin sporadike (Hajdaraj, 1966).

Ndryshimi gjuhësor duhet konsideruar si një fillim i konvergjencës dialektore, ndërkohë që intensifikimi i kontakteve midis bashkësive gjuhësore ka ecur paralelisht me zhvillimet industriale dhe teknologjike (Munishi, 2010: 2). Nga ana tjetër, dinamika e pranimit të tipareve të varietetit tjetër është shtuar varësisht nga ritmi dhe vëllimi i migrimit të popullatës.

Në vendbanimet e reja dhe në kushte të reja ka lindur brezi i parë i folësve që nuk e di varietetin gjuhësor të prindërve të tyre. Sipas mësimeve të Labovit, ky brez përfaqëson fundin e përdorimit të një gjuhe të caktuar.

Dy brezat e tjerë, i mesmi dhe i vjetri, varietetin e tyre nativ e përdorin në situata të ndryshme. Brezi i vjetër e përdor në mënyrë besnike varietetin nativ me pak ndryshore të varietetit në kontakt, ndërsa brezi i mesëm gjuhën native e përdor vetëm në situata të veçanta, shpesh për të shpërfaqur aktin identitar.

Ndryshoret gjuhësore të përshkruara në këtë hulumtim janë parë edhe në korrelacion me komponentët sociolinguistikë, si: mosha, gjinia, niveli i arsimimit dhe vendbanimi. Këto raporte, siç do të shihen në vijim, reflektojnë variacion gjuhësor të tri grup-moshave të këtij studimi.

Gjenerata e vjetër (70 deri në 90 vjeç) e flet varietetin nativ në të gjitha situatat. 32 ndryshore gjuhësore, përkatësisht 35, që përdorin këto dy subjekte (SM1 dhe SM2) e reflektojnë origjinalitetin e varietetit të tyre nativ. Ato përfaqësojnë tiparet themelore të rugovishtes së pastër.

SM1 përdor 28 variante tipike të së folmes së Rugovës, 7 të tjera të gegërishtes verilindore, të cilat dalin si variante alternative. Shprehur në përqindje informatori i parë (SM1) 80% të tipareve gjuhësore i ka të varietetit nativ, ndërsa 20% të gegërishtes verilindore. Përqindja e dytë është rezultat i kontaktit gjuhësor të këtij subjekti folës me folës të qytetit të Pejës. SM1 dimrin e kalon në qytet, prandaj përdor më shumë variante alternative nga varieteti në kontakt.

Folësi i dytë (SM2) përdor gjithsej 32 ndryshore të varietetit nativ dhe asnjë të varietetit të Pejës me rrethinë. Ky folës jeton tërë kohën në Rugovë dhe merret me blegtori. E folmja e tij është rugovishte e pastër. Të dy informatorët, (SM1 dhe SM2), janë me përgatitje të njëjtë arsimore. Kanë të mbaruar shkollën e dikurshme fillore 4-vjeçare. Situatë gati e njëjtë del edhe me dy subjektet femra të këtij brezi. Ato janë të koduara si SF1 dhe SF2.

Informatorja e parë (SF1), 75-vjeçare, banore e Pejës, përdor 40 ndryshore dialektore, prej të cilave 37 ose 92% janë të varietetit gjuhësor të Rugovës. Vetëm 3

ndryshore, ose 8%, janë të gegërishtes verilindore. Edhe këto ndryshore nuk janë alternante konstatnte të ndryshoreve themelore të varietetit që jemi duke e përshkruar.

Informatorja e dytë (SF2), 72-vjeçare, banore e Pejës, përdor gjithsej 42 variante të varietetit nativ, ose 77%, ndërsa 10 të tjera, ose 8%, janë të gegërishtes verilindore.

Në të dy rastet ndryshoret e gjuhës në kontakt nuk kanë arritur në fazën e konsolidit në kuadër të sistemit fonetik të përdorur nga këto subjekte. Dalin vetëm si variante alternative, pa përdorim sistematik.

Informatorja e parë (SM1) ka jetuar në katundin Pecaj deri më 1999. Prej këtij viti jeton në qytetin e Pejës. Informatorja e dytë (SM2) ka jetuar në Bogë deri në vitin 1980. Prej këtij viti jeton në Pejë. Kanë të mbaruar shkollën fillore 4-vjeçare. Pavarësisht se jetojnë në Pejë ato përfaqësojnë brezin e vjetër të folëseve të varietetin të tyre nativ. Ndonëse në kontakt për disa decenie me folës të një dialekti tjetër ato e ruajnë shumë të pastër varietetin e tyre gjuhësor, që do të thotë se krahasuar me meshkujt e moshës së njëjtë në aspektin gjuhësor ato janë më konservative, që do të thotë se gratë e këtij brezi, ndonëse në rrethana të reja, nuk i prijnë procesit të ndryshimit gjuhësor. " ***Ka bashkësi ku gratë nuk i prijnë ndryshimit gjuhësor***" (Holmes,:260). Femrat e brezit të mesëm me origjinë rugovase janë prijëse në përdorimin e varietetit standard, prandaj e kemi pasur shumë të vështirë gjetjen e këtyre informatoreve.

Këtu duhet theksuar se në Rugovë nuk kemi mundur të gjejmë subjekte folëse femra të brezit të mesëm e të vjetër. Gratë e mbetura atje nuk janë me origjinë rugovase. Ato në familje flasin varietetin verilindor, prandaj fëmijët rugovas besohet se nuk e kanë mësuar varietetin e baballarëve të tyre. Megjithatë, konsiderojmë se ky realitet paraqet interes për studime gjuhësore të karakterit sociolingistik. Ne nuk jemi marrë me këtë problematikë.

Për të parë situatat përdoruese dhe ndryshimin eventual gjuhësor të këtij varieteti kemi hulumtuar edhe gjuhën e brezit të mesëm. Ky brez është i moshës 30-55 vjet. Jeton në Pejë dhe në rrethinën e saj. Kemi përzgjedhur dy subjekte folëse, të dytë meshkuj. Janë koduar me shifrat (SM3 dhe SM4). Kanë përgatitje të lartë shkollore. Niveli i shkollimit është faktor ndikues në përzgjedhjen gjuhësore të folësve. Njëri është në marrëdhënie pune në Kuvendin Komunal, ndërsa tjetri i papunë.

Informatori me shifrën SM3 (43-vjeçar) nuk e përdor varietetin e tij nativ. Pranon se e di varietetin e gjuhës native, por thotë se është i prirë ta akomodojë të folurit e tij me bashkëbiseduesit e përditshëm. Varietetin e Rugovës e flet në situata të caktuara, si akt për të shpërfaqur identitetin personal. Ka të kryer fakultetin dhe Pejë në jeton.

Gjuha e informatori i dytë të këtij brezi (SM4) del komplekse për studime të kësaj natyre. Ndonëse në Pejë ka ardhur në moshën 12 vjeçare, thotë se nuk "e ka mësuar" ose nuk do ta flasë varietetin e ri. Në gjuhën e tij 90 % e të gjeturave janë të varietetit rugovas. I pyetur pse e flet gjithnjë varietetin e origjinës, kur të gjithë rugovasit e tjerë të gjeneratës së tij e kanë ndërruar kodin ligjërimor, është përgjigjur se "***ôʃt gjuha jeme qe m'vjen shum let me foːl***".

Incizimi i intervistës së këtij informatori përmban gjithsej 35 ndryshore dialektore. 31 prej tyre janë tipike të varietetit të Rugovës, ndërsa 4 të tjera janë variante alternative nga nëndialekti në kontakt. Shprehur me numra 80% të ndryshoreve janë të varietetit nativ, ndërsa 10% të varietetit të vendbanimit të ri.

Ndërkaq, brezi i ri nuk e di varietetin e prindërve të vet. Për këtë qëllim kemi intervistuar dy studente dhe 2 nxënës, banorë të përhershëm në Pejë. Përpos subjektit me kodin SNM1, që përdor dy trajta me togun **ua**, gjithë të tjerët e flasin rrjedhshëm varietetin standard me elemente të gjuhës së qytetit të Pejës. Edhe në provën për të ritreguar dy tregime nuk kanë dhënë shenja se e njohin varietetin e prindërve të tyre.

Situata del më e komplikuar me 3 nxënësit e shkollës fillore në Drelaj të Rugovës. Në dy provat tona, që kishin synim vjeljen e materialit për këtë studim, druajmë se nuk kemi arritur të nxjerrim të vërtetën për varietetin gjuhësor që e përdorin këta fëmijë. Informatorët e kësaj moshe me kodet SNF1, SNF2 dhe SNF3, të gjitha përgjigjet i kanë dhënë në gjuhën standarde, pa asnjë element fonetik a morfologjik të varietetit që flitet në Rugovë. E njëjta gjë është përsëritur edhe kur kanë ritreguar përrallën "*Luani dhe dhelpra*". Në pyetjen se pse nuk flisni si në familje këta nxënës janë përgjigjur se gjithnjë flasin në variantin në të cilin pak çaste më parë kishin dhënë përgjigjet e kërkuara e të cilin thonë se e kanë mësuar nga masmediet dhe në shkollë. E pritshme ishte që të reflektonin një varietet të përzier me tipare të gegërishtes veriperëndimore dhe verilindore, pasi që prindërit e tyre u takonin varieteteve të ndryshme gjuhësore.

Mbase, është dashur të intervistoheshin jashtë objektit të shkollës dhe pa praninë e mësuesve dhe të nxënësve të tjerë për t'u çliruar nga presioni i mundshëm i faktorit socio-psikologjik. Tashmë, kur ekziston një distancë nga momenti kur janë incizuar, besoj se po të veprohej kështu rezultatet do të ishin të tjera, ngase më duket se mund të ketë ndikuar mbi ta faktori socio-psikologjik, i cili ***është rezultat i ndërveprimit komunikues ballë për ballë midis folësve të ndryshë***m (Munishi, 2010).

Përfundime

1. E folmja e Rugovës është kontinum i gegërishtes verilindore, që po pëson ndryshim gjuhësor radikal.
2. Para luftës së fundit në Kosovë (1998-1999) Rugova kishte 13 fshatra me 178 familje dhe 1477 banorë të përhershëm, ndërkohë që në vitin 2016 ka vetëm edhe 14 familje me gjithsej 70 anëtarë, të shpërndarë në vetëm 4 fshatra.
3. Varieteti gjuhësor i banorëve të mbetur, pas një periudhe shumë të gjatë të konservatorizmit të tij, tashmë është "***hapur***" dhe nuk paraqet ndonjë unitet gjuhësor.
4. Studimi ynë tregon se rugovasit e rënë në Pejë dhe në fshatrat përreth kanë filluar tkurrjen dinamike të përdorimit të varietetit të tyre nativ.
5. Përshkrimi i materialit të incizuar ka dhënë prova se vetëm brezi i vjetër, pavarësisht vendbanimit të ri, e ruan dhe e flet besnikërisht varietetin e nativ. Ky brez identifikohet si brezi i fundit i folësve besnikë të këtij varieteti.
6. Kontakti gjuhësor ka ndikuar që ndonjëherë edhe këta folës të përdorimin disa ndryshore gjuhësore të varietetit në kontakt. Përdorimet rrinë në raporte konkurruese. Në situata të tilla nuk dalin asnjëherë tri tiparet themelore të kësaj të folmeje: ***ua*** (në pjesoret e foljeve), infinitivi i vjetër me grupin ***ua*** dhe grupet konsonantike k**i** dhe g**i.**
7. Brezi i mesëm e përdor rugovishten vetëm në situata "***identitare***", ndërsa brezi i ri nuk e di fare.
8. Rasti i varietetit të folur nga fëmijët rugovas, që jetojnë tërë vitin në Rugovë, kërkon hulumtim të posaçëm.
9. Bazuar në studimet gjuhësore për statusin e gjuhëve të rrezikuara, në këtë mes edhe të varieteteve, për rugovishten mund të themi se ka kaluar fazën e tkurrjes përdoruese. Ajo është në fazën e zhdukjes së tërësishme për pjesën më të madhe të këtij komuniteti.
10. Crystal një gjuhë e sheh si shumë e rrezikuar nëse flitet nga më pak se 100 persona. Të dhënat e këtij punimi tregojnë se sot nuk janë as 100 folës aktivë të varieteti rugovas.
11. Gjenerata e re, nuk e di fare varietetin gjuhësor të prindërve të vet. Bazuar në mësimet e Labovit, kjo gjeneratë identifikon brezin e parë që ka flakur tërësisht varietetin e origjinës, dhe ky është momenti kur një gjuhë ose edhe varietet gjuhësor konsiderohet se është në zhdukje të plotë.

12. Prandaj, mbi bazë të këtij studimi mund të përfundojmë se varieteti i së folmes së Rugovës nga paslufta e këndej ndodhet në fazën kritike të zhdukjes së tërësishme për një pjesë të caktuar të folësve të saj, të cilët tashmë kanë krijuar vendbanime të reja jashtë gjeografisë së gegërishtes verilindor.

Referencat

Hajdaraj, Adem (1996). *E folmja e Rugovës*. Etruria. Prishtinë.

Coupland, Nikolas (2007). *Style, Language Variation and Identity*, Cambridge University Press.

Campbell, Lyle&Muntzel, Marth, C. (1989). *The Strucstural Consecuences of Language Death*, Cambridge University Pres.

Norman, Denison (1977, nr. 12). *Language Death or language Mode*, në Internacional of the Sociology of Language.

Fishman, Joshua (1991). *Reversing Language Shift*. Clevedon: Multilingual Matters.

Černỳ, Miroslav (2010). *Language Death versus language Survival*: A Global Perspective, University of Ostrava Czech Republic, në: http://conference.osu.eu/globalization/publ/06-cerny.pdf.

Crystal, David (2000). *Language death*. Cambridge University Press.

Desnickaja, Agnia (1972). *Gjuha shqipe dhe dialektet e saja*, Prishtinë.

Tagiamonte, Sali A. (2006). *Analysing Sociolinguistic Variation*, Cambridge University Press, New Yourk. në: http://www.cambridge.org/linguistics/....

Váradi, Tamás (1998). *Manualof the Budapest Sociolinguistic Interwiev. Data*, Linguistic Isntitue Academy of Sciences, Hyngary. Gjendet në: http://www.jstor.org/stable/4168935

Labov, Wiliam (1984). *Fiel Methods of the projects on Linguistic Change and Variation*, në: http://www.ling.upenn.edu

Labov, Wiliam (1972). *Sociolinguistic Patterns*. University of Pennsylvania Press. Gjendet, në: http://www.upenn.edu/pennpres/book/

Holmes, Janet (2015). *Hyrje në sociolinguistikë,* Pegi, Tiranë.

Munishi, Shkumbin (2010). Gjuha standarde shqipe dhe konvergjenca e gjuhës së folur, Language and Society.

Haki HYSENAJ

VARIETY IN EXTINCTION: THE CASE OF RUGOVA'S SPEECH

Abstract

The purpose of this study is to describe the linguistic variety of Rugova area of Peja. This variety represents the continuum of Northwestern Gegë variety. In the last two decades there has been a great lingering change of this variety due to population migration in the city of Peja and its surroundings as well as changes of social circumstances, and permanent contact with Northeastern Gegë speakers which are main factors that have affected this linguistic change.

The change is evidenced by field research surveys which were conducted in the first part of 2016. The analysis of the corpus shows that only the old generation still uses this variety, while medium and young generation speak Northeastern Gegë variety, with pronounced tendencies of greater use of standard Albanian variety.

The study shows that Rugova's speech is at a final phase of extinction for its users.

Key words: Rugova's speech, linguistic variety, Northwestern Gegë, Northeastern Gegë, variety extinction.

Adelina ÇERPJA

ÇINTEGRIMI I ASNJANËSIT DHE MBETJE TË TIJ NË TË FOLME TË SHQIPES

Në gjuhën shqipe, kategoria semantiko-gramatikore e gjinisë është shndërruar në kategori kryesisht gramatikore: gjinia asnjanëse është shmangur shkallë-shkallë dhe kjo ka çuar në procesin gradual të reduktimit të sistemit trigjinish (mashkullore, femërore e asnjanëse) në sistem dygjinish (mashkullore e femërore).

Sipas *Gramatikës së Akademisë*, sot konsiderohen si asnjanës në gjuhën shqipe: "Disa emra të nyjshëm prejfoljorë, që kanë dalë nga emërzimi i pjesoreve: *të ardhur-it, të ecur-it, të folur-it, të menduar-it, të ngrënë-t, të shtypur-it* etj., si dhe pak emra të nyjshëm që kanë dalë nga emërzimi i mbiemrit të gjinisë asnjanëse, i cili karakterizohej nga nyja *të* e kësaj gjinie: *të errët-it, të ftohtë-t, të kuq-të, të mugët-it, të nxehtë-t, të verdhë-t, të zi-të*."[1]

Ndërsa një grup emrash konkretë, kryesisht emra lënde, si: *brumë, drithë, dyllë, dhjamë, grurë, gjalpë, lesh, miell, mish, mjaltë, vaj* etj, që kanë qenë emra asnjanës në gjuhën shqipe, sot përdoren kryesisht si emra mashkullorë. Pikërisht ky grup emrash, që janë quajtur dhe asnjanës të mirëfilltë apo primitivë, i japin kësaj gjinie dhe një karakter mbeturinor.

Në *Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe*[2] i është kushtuar një vëmendje e veçantë këtij grupi emrash që dikur ishin në gjininë asnjanëse, ndërsa sot përdoren kryesisht në gjininë mashkullore, ndonëse nuk mungojnë përdorimet edhe në gjininë asnjanëse dhe në pak raste edhe në femërore. Të tillë emra janë: *ujë, mish, djathë, lesh, mjaltë, dyllë*. Duke pasur parasysh se vjeljet për këtë *Atlas* janë bërë në periudhën kohore 1980-1989, kemi menduar të bëjmë një vjelje në të folme të ndryshme të shqipes për këta emra, për të parë gjendjen aktuale të këtyre përdorimeve, që do të na krijonte mundësinë të vërenim ndryshimet e ndodhura gjatë këtyre 30 viteve në përdorimin e asnjanësit dhe prirjen e këtij grupi emrash për të kaluar në gjininë mashkullore ose femërore.

[1] *Gramatika e gjuhës shqipe*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1995. f. 93.

[2] *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*. *Vëllimi I*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Università degli Studi di Napoli L'Orientale, Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale. Napoli, 2007, f. 209-214.

Me anë të një pyetësori të hartuar posaçërisht për këtë grup emrash mund të krijohet një përfytyrim më i saktë dhe objektiv për një prej dallimeve morfologjike dialektore të shqipes, konkretisht të gjinisë asnjanëse, duke saktësuar kështu më mirë kufijtë e shtrirjes së saj në hapësirë e në shtresa të ndryshme shoqërore.

Krahas parashtrimit teorik të kësaj kategorie dhe të ndryshimeve historike që kanë ndodhur në të, më poshtë do të japim të dhënat e nxjerra nga ADGJSH lidhur me këtë kategori, e më pas do të bëjmë një paraqitje të pyetësorit të hartuar posaçërisht për asnjanësin. Më tej do të analizojmë të dhënat e nxjerra nga ky pyetësor, duke sjellë kështu edhe të dhëna statistikore e rezultate konkrete për gjendjen aktuale të përdorimit të asnjanësit në gjuhën shqipe.

Asnjanësi në studimet gramatikore të gjuhës shqipe

Në përgjithësi, gjuhëtarë të ndryshëm e kanë veçuar në studimet e tyre kategorinë e gjinisë, si kategori semantiko-gramatikore, nga kategori të tjera, si numri, rasa, shquarsia, që janë kategori të mirëfillta gramatikore, e kjo veçanërisht në grupin e emrave që emërtojnë frymorë.

Ekzistojnë dy mendime të ndryshme për klasifikimin e emrave në gjini: një grup gjuhëtarësh mendojnë se në një fazë më të hershme kundërvënia dypalëshe ishte midis emrave të frymorëve nga njëra anë, të cilët u ndanë më vonë në mashkullorë e femërorë, dhe emrave të jofrymorëve nga ana tjetër, që janë emrat e gjinisë asnjanëse. Ndërsa një grup tjetër mendojnë se klasifikimi dy gjinish në një fazë më të hershme mbështetej në kundërvënien mashkullore – femërore dhe gjinia asnjanëse ka dalë nga një bigëzim i gjinisë mashkullore. Ajo çka i bashkon dy grupet e studiuesve është se sistemi trigjinish është një zhvillim i mëtejshëm i një sistemi dygjinish.

E megjithatë nuk mungon dhe një numër i vogël gjuhëtarësh të cilët e kanë vënë në dyshim praninë e asnjanësit në gjuhën shqipe, si p.sh. Desnickaja, e cila është për zhdukjen e hershme të asnjanësit në gjuhën shqipe dhe përpiqet t'i klasifikojë këta emra sipas një kategorie tjetër, së ashtuquajturës "kategori të masës së përcaktuar"[3].

Siç ka shpjeguar dhe studiuesi K. Topalli, sistemi trigjinish i pranishëm që në kohët e lashta, është krijuar nga një sistem më i hershëm, qysh në periudhën parahistorike, me dy klasa, duke u dalluar në njëjtën klasë emrat e frymorëve pa dallim gjinie (mashkullore e femërore), kurse në klasën tjetër emrat e jofrymorëve.[4]

[3] Për më shumë: *Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*, UT, FHF, Tiranë, 1973, f. 280.
[4] Topalli, K. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Botimet Albanologjike. Tiranë, 2011, f. 201.

Sh. Demiraj vë në dukje se thjeshtimi i këtij sistemi trigjinish është kryer në përgjithësi me mënjanimin e atyre kundërvënieve që kanë qenë më pak të mbështetura si semantikisht, ashtu edhe gramatikisht, duke arritur në përfundimin se "gjinia, në krye të herës, në daç të jetë mbështetur në kundërvënien frymor – jofrymor, në daç në kundërvënien mashkullore –femërore, duhet të ketë qenë një kategori semantike"[5].

Evolucioni që ka pësuar kategoria e gjinisë është pasojë e shndërrimit gradual të kësaj kategorie në kategori gramatikore. Duke theksuar dhe rolin e madh që ka luajtur analogjia në kalimin e emrave asnjanës në dy gjinitë e tjera, studiuesi E. Likaj e sheh këtë proces të lidhur ngushtë me zhdukjen e botëkuptimit "të stërlashë animist mbi sendet"[6].

Çështja se kur ka nisur dobësimi i gjinisë asnjanëse dhe integrimi i tyre në gjini të tjera është e vështirë të përcaktohet. Një përfundim në të cilin vijnë gramatikanë të gjuhës shqipe është se në gjuhën shqipe gjinia asnjanëse ka karakter indoevropian. Në të vihet re se integrimi i huazimeve nuk ka respektuar gjininë e gjuhëve dhënëse, por është bërë sipas faktorëve të brendshëm të shqipe.

K. Topalli e sheh shqipen si më të ruajtur në krahasim me gjuhë të tjera, duke ruajtur përgjithësisht dallimin e gjinive me fundoret e emrave[7], ndërsa sipas Sh. Demirajt "Me ruajtjen e pjesëshme të gjinisë asnjanëse gjuha shqipe në gjëndjen e saj të sotme zë një pozitë të ndërmjetme midis atyre gjuhëve ie që e kanë ruajtur mirë dhe atyre që e kanë humbur fare asnjanësin"[8].

Kalimi nga sistemi trigjinish në sistem kryesisht dygjinish, pra dobësimi i vazhdueshëm i asnjanësit në gjuhën shqipe, është shpjeguar me disa argumente: nga njëra anë me shndërrimin e hershëm të gjinisë në një kategori gramatikore në gjuhët ie, dhe nga ana tjetër me evolucionin e hershëm të tingujvet fundorë në këtë gjuhë i cili krijoi një fushë të lirë për veprimin rrafshues të analogjisë, pa lënë mënjanë dhe faktin se vetë ndjenja e asnjanësit në ndërgjegjen gjuhësore popullore e kish humbur kuptimin e lashtë ie dhe ishte dobësuar së tepërmi.[9]

N. Veselaj në studimin e tij për këtë kategori gramatikore shprehet se ky tip asnjanësi: "... edhe pse nuk ka ndërtim analitik, po sintetik ka pësuar dhe po pëson çintegrim, sepse nuk e ka të specifikuar nënfushën e veçantë semantike, ngase për të

[5] Demiraj, Sh. *Çështje të sistemit emëror*, UShT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Katedra e gjuhës shqipe, Tiranë, 1972, f. 178.
[6] Likaj, E. *Analogjia gramatikore në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe*, UT, FHF, Tiranë,1984, f. 65.
[7] Topalli, K. *Gramatikë historike*..., f. 204.
[8] Demiraj, Sh. *Çështje të sistemit emëror*..., f. 263.
[9] Për më shumë: Demiraj, Sh. Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, UT, FHF, Tiranë, 1973, f. 283.

njëjtat nënfusha semantike konkurrojnë tashti me sukses edhe disa tipa a nëntipa emrash të gjinive të tjera aktive gramatikore, sidomos të gjinisë mashkullore.[10]

Kjo gjini ka qenë e pranishme në të gjitha të folmet e shqipes, duke përfshirë edhe ato të diasporës. Megjithatë, asnjanësi duket më i fuqishëm në Jug, ku ka zona që e kanë ruajtur më mirë këtë gjini. Këto janë sidomos disa të folme të zonave periferike dhe të krahinave malore të izoluara, si çamërishtja e labërishtja, kurse zonat qendrore, që dallohen për evolucione dhe ndryshime më të mëdha, e kanë ruajtur më pak këtë gjini.[11]

Asnjanësit e mirëfilltë përdoren më shumë në formën e asnjanësit në shprehje frazeologjike dhe fjalë të urta, të cilat në përgjithësi ruajnë forma arkaike më shumë se në ligjërimet e tjera.

Paraqitja në *Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe*

Në *ADGjSh* janë pasqyruar të dhëna për përdorimin në gjini të ndryshme, ndër të cilat njëra asnjanëse, të 6 emrave të lëndës: *ujë, mish, djathë, lesh, dyllë* dhe *mjaltë*. Nga shqyrtimi i hartave të paraqitura për këta emra vihet re kjo shtrirje e përdorimit të këtyre emrave në gjini të ndryshme e paraqitur në përqindje (M. për mashkullore, A. për asnjanës dhe F. për femërore).

Emri	Harta	Faqja	M. %	A. %	F. %
ujë	139	209	60	35	5
djathë	141	211	95	3	2
lesh	142	212	90	10	-
mish	140	210	90	10	-
dyllë	143	213	90	5	5
mjaltë	144	214	80	5	5

[10] Nuhi Veselaj, *Rreth identitetit të gjinisë asnjanëse në shqipen e sotme*. Prishtinë, 2015, f. 51.
[11] Topalli, K. *Gramatikë historike...*, f. 224.



Pyetësori

Për të krijuar një ide rreth gjendjes aktuale të përdorimit të këtyre emrave në gjini të ndryshme, hartuam një pyetësor me në qendër 6 emrat për të cilat ka të dhëna edhe në Atlas, e konkretisht për emrat: *ujë, djathë, lesh, mish, dyllë, mjaltë*.

Pyetësori është i ndarë në 2 pjesë: në grupin e parë të shembujve subjektit i kërkohet të plotësojë vetë në fjali në formën e duhur emrin e dhënë në kllapa, i cili duhet të jetë në rasën emërore ose kallëzore të numrit njëjës, në trajtën e shquar, pra pikërisht në format tipike ku asnjanësi është i dukshëm.

- *(**ujë**) _____ para shtëpisë është mbledhur në një pellg.*
- *Sa shumë më shijon (**djathë**) _____ në makarona!*
- *Ku e ke blerë (**lesh**) _____ që ke mëpër duar?*
- *(**mish**) _____ që bleve dje nuk kishte fare dhjamë.*
- *Nuke e duronte dot _____ (**dyllë**) në vesh.*
- *Nga ka ardhur _____ (**mjaltë**) që është mbi banake?*

Në grupin e dytë të shembujve subjektit i kërkohet të zgjedhë formën e duhur të emrit midis formave të gjinive të ndryshme. Edhe në shembujt e grupit të dytë, emri është në rasën emërore ose kallëzore të numrit njëjës, në trajtën e shquar.

- *Brenda kësaj jave duhet bërë gati **leshtë / leshi** për qilimin e ri.*
- ***Dylla / dylli / dyllët / dyllë** është i mirë për të pastruar mobilet.*
- *E ke futur **djathët / djathën / djathin** në shëllirë?*
- *Ishte mësuar me **mjaltët / mjaltën / mjaltin** që në mëngjes.*
- *Më duhet të pjek dhe **mishin / mishtë** para orës 7.*
- *Në cilën orë vjen **ujtë / ujët / uji / uja**?*

Për të pasur të dhëna sa më të sakta, në pyetësor janë shmangur shprehjet frazeologjike ose fjalët e urta, të cilat për nga natyra janë më konservative dhe përdoruesit kanë prirje t'i përdorin me format e tyre të dikurshme. Gjithashtu janë mënjanuar format rasore të zhdrejta e ato të shumësit (që nuk paraqesin dallime formale sipas gjinisë).

Për pyetësorin përzgjodhëm 180 subjekte që u përkasin moshave të ndryshme, kanë vendlindje dhe vendbanime të ndryshme, si dhe kanë nivele të ndryshme arsimimi. Mosha e subjekteve të përzgjedhura është nga 11-63 vjeç, prej të cilëve 41% janë me arsim 8-vjeçar, 11% janë me arsim të mesëm dhe 48% janë me arsim të lartë. Vendlindja e subjekteve ofron një shtrirje relativisht të mirë gjeografike: Tiranë, Kukës, Dibër, Burrel, Lushnjë, Pogradec, Tropojë, Shkodër, Shijak, Pukë, Mat, Mallakastër, Librazhd, Laç, Korçë, Kavajë, Has, Gjirokastër, Fushë-Krujë, Elbasan, Durrës, ndonëse do të kishim dashur që të kishim subjekte edhe nga zona të tjera, e veçanërisht nga Kosova, Maqedonia e Mali i Zi.

Analiza e të dhënave të pyetësorit

Nga 180 pyetësorët e plotësuar, në 54 prej tyre këta emra mashkullorë hasen me forma në gjininë femërore ose asnjanëse. Prej tyre: 36 subjekte kanë gabuar me 1 emër, 12 përdorues me 2 emra, 2 përdorues me 3 emra, 3 përdorues me 4 emra dhe 1 përdorues me 11 emra.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në përqindje përdorimet e këtyre emrave në gjini të ndryshme sipas të dhënave të pyetësorit tonë dhe sipas ADGJSH-së.

Sipas pyetësorit			**Emri**	**Sipas *Atlasit***		
M. %	**A. %**	**F. %**		**M. %**	**A. %**	**F. %**
82.7	15.5	1.6	***ujë***	60	35	5
96	2.7	1.1	***djathë***	95	3	2
91	9	-	***lesh***	90	10	-
97.8	2.2	-	***mish***	90	10	-
95.6	2.2		***dyllë***	90	5	5
94.4	1.7	3.9	***mjaltë***	80	5	5

Le t'i marrim me radhë emrat.

1. Për emrin ***ujë*** është ulur ndjeshëm përdorimi i tij në gjininë asnjanëse nga 35 në 15.5%. Sipas të dhënave të nxjerra nga pyetësori, përveç zonave të tjera të paraqitura në *Atlas*, format asnjanëse të emrit *ujë* përdoren edhe në Durrës e Shijak. Po ashtu vihet re një reduktim i përdorimit të këtij emri në gjininë femërore nga 5 në 1.5 %, duke çuar kështu në rritjen e konsiderueshme të përdorimeve në gjininë mashkullore nga 60 në 82.7 %.



Në përgjigjet e pyetësorit dalin dhe 2 raste të emrit *ujë* në gjininë mashkullore, por si emër i lakimit të dytë (***uj-u***) dhe jo i lakimit të parë, forma këto që nuk janë paraqitur në *Atlas*. Po ashtu në *Atlas* nuk ka të dhëna për përdorimin e emrit *ujë* në gjininë femërore ***uja*** të ndeshura në përdorues nga Kukësi, Mati dhe Elbasani.

2. Për emrin ***djathë*** gjendja paraqitet pothuaj e njëjtë. Ka një rënie të lehtë të përdorimeve në gjininë asnjanëse (nga 3 % në 2.7 %) dhe femërore (nga 2 % në 1.1 %), në favor të përdorimeve në gjininë mashkullore (95 % në 96 %).



Edhe në këtë rast ka disa të dhëna të ndryshme nga *Atlasi* për përdorimin e tij në gjininë femërore prej subjekteve nga Kukësi e Dibra, si dhe për përdorimin e formave asnjanëse në Pogradec, Laç, Kukës e Dibër.

3. Gjendja paraqitet pothuaj e njëjtë edhe për emrin ***lesh***. Ka një rënie shumë të lehtë të përdorimeve në gjininë asnjanëse (nga 10 % në 9 %), në favor të përdorimeve në gjininë mashkullore (nga 90 % në 91 %).



Forma të asnjanësit për këtë emër dalin dhe në zona të tjera përveç atyre të dhëna në *Atlas*, e konkretisht në Pogradec, Kukës, Elbasan e Lushnjë.

4. Për emrin ***mish*** vihet re një rënie e konsiderueshme e numrit të përdorimeve në gjininë asnjanëse (nga 10 % në 2.2 %), në favor të përdorimeve në gjininë mashkullore (nga 90 % në 97.8 %).



Pak subjekte kanë dhënë dhe forma të asnjanësit për emrin *mish*, tre prej të cilëve janë nga Pogradeci, Kukësi e Shkodra, zona këto në të cilat sipas *Atlasit* nuk përdoret asnjanësi i këtyre emrave.

5. Përqindja e përdorimit të gjinisë asnjanëse dhe femërore për emrin ***dyllë*** është përgjysmuar (nga 5 % në 2.2 % për secilën), në favor të përdorimeve në gjininë mashkullore (nga 90 % në 95.6 %).



Disa pika të reja, që nuk paraqiten në *Atlas* për këtë emër janë: Laçi, në të cilën është përdorur ky emër në gjininë femërore, dhe Shkodra, Kukësi, Tirana e Pogradeci, ku ky emër ka dalë në gjininë asnjanëse.

6. Te emri ***mjaltë*** vihet re një rënie e ndjeshme e përdorimeve në gjininë asnjanëse (nga 5 % në 1.7 %), një rënie e lehtë e përdorimeve në gjininë femërore (nga 5 % në 3.9 %), duke shtuar kështu dukshëm numrin e përdorimeve të këtij emri në mashkullore (nga 80 % në 94.4 %.



Ndryshe nga emrat e tjerë që përmendëm më sipër, për emrin *mjaltë* një përputhje të mirë të të dhënave për format e gjinisë femërore të këtij emri, por jo për format e gjinisë asnjanëse, të cilat sipas të dhënave të pyetësorit hasen edhe në Tiranë, Laç e Pogradec.

Përfundime

- Nisur nga numri i subjekteve në total që kanë plotësuar pyetësorin (180), dhe nga numri i subjekteve që kanë dhënë forma të asnjanësit për këtë grup emrash (54), të cilët qëndrojnë në raportin 70 % me 30 %, themi me siguri se procesi i çintegrimit të emrave të mirëfilltë asnjanës në gjuhën shqipe është ende aktiv.
- Për secilin prej emrave vihet re pakësim në shkallë të ndryshme i përdorimeve në gjininë asnjanëse.
- Me pakësimin e përdorimit të asnjanësit për këta emra në gjuhën shqipe rritet numri i përdorimeve të tyre në gjininë mashkullore.
- Në grupin e emrave të marrë në shqyrtim, bie në sy se ka ardhur duke u zvogëluar shumë numri i përdorimeve të emrit *ujë* në gjininë asnjanëse, ndoshta dhe për shkak të dendurisë së madhe të përdorimit të këtij emri në ligjërimin e përditshëm.
- E kundërta mund të thuhet për emrin *lesh*, i cili ka një luhatje të papërfillshme në përdorimin e formave të gjinisë asnjanëse, e kjo mund të jetë ndikuar dhe nga shprehje frazeologjike që hasen shpesh në të folurin e përditshëm, në të cilat ky emër përdoret në gjininë asnjanëse: *pagoi leshtë e kokës, leshtë e barkut, la leshtë* etj.
- Me anë të këtij pyetësori u përpoqëm të krijonim një përfytyrim më të saktë e aktual për një prej dallimeve morfologjike dialektore të shqipes, konkretisht të gjinisë asnjanëse, duke saktësuar kështu më mirë kufijtë e shtrirjes së saj në hapësirë e në shtresa të ndryshme shoqërore.
- Megjithatë duhet thënë se ky ishte vetëm një hap, pasi duhen bërë studime e anketime më të organizuara, institucionale dhe ndërinstitucionale, të shtrira në të gjitha hapësirat shqipfolëse, për këtë dhe për dukuri të tjera gjuhësore të shqipes, duke krijuar kështu një tablo më të saktë të gjendjes së përdorimit të saj sot, sidomos pas ndryshimeve të mëdha demografike që kanë ndodhur.

Bibliografi

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe. Vëllimi I. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Università degli Studi di Napoli L'Orientale, Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale. Napoli, 2007, 464 p. + harta me ngjyra.

Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme. Redaktor përgjegjës: Mahir Domi. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1972, 335 p.

Çështje të gramatikës së shqipes së sotme. Tiranë, 1975, 264 f.

Demiraj, Shaban: *Çintegrimi i gjinisë asnjanëse në gjuhën shqipe*. - *Studime rreth historisë së gjuhë shqipe*. Universiteti Tiranës. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. Katedra e gjuhës shqipe. Tiranë, 1973, 427 p., f. 272-318

Demiraj, Shaban: *Gramatikë historike e gjuhës shqipe (Botim i përmbledhur)*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2002, 512 p.

Dialektologjia shqiptare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë. Tiranë, 1971, 1974, 1975.

Domi, Mahir: Shqipja dhe struktura e saj gramatikore. - *Studime filologjike,* 2001, 3-4, 5-18.

Gramatika e gjuhës shqipe, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1995.

Gjinari, Jorgji: Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe. - *Gjuha jonë* 2/1982, 50-55.

Gjinari, Jorgji: *Dialektologjia shqiptare.* Tiranë.

Gjinari, Jorgji: Sprovë për një klasifikim strukturor të dallimeve morfologjike të dialekteve të gjuhës shqipe. - *Studime filologjike* 1984, 3, 89-103.

Likaj, Ethem: *Analogjia gramatikore në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe.* Tiranë, 1984, 135 f.

Pedersen, Holger: Gjinia asnjanëse në gjuhën shqipe. - *Studime rreth historisë së gjuhë shqipe*. Universiteti Tiranës. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. Katedra e gjuhës shqipe. Tiranë, 1973, 427 p., f. 264-271.

Topalli, Kolec: *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Botimet Albanologjike. Tiranë, 2011, 1737 p.

Veselaj, Nuhi: *Rreth identitetit të gjinisë asnjanëse në shqipen e sotme*. Prishtinë, 2015.

Adelina ÇERPJA

THE DISINTEGRATION OF NEUTER GENDER AND ITS REMAINS IN ALBANIAN SPEECHES

Abstract

In Albanian language, the semantic-grammatical category of gender has become mainly a grammatical category: the neuter gender has been scaled-down and this has led to the gradual process of reducing the triple gender system into a dual gender system.

The neutral gender in today's Albanian is very wrinkled and unstable. Although it has been a gender used throughout the Albanian language, in nowadays we can speak about remains of this gender.

In *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe* (The dialectal atlas of Albanian language), special attention has been paid to the group of nouns that were once in the neuter gender, while today they are mainly masculine nouns, although there are a few cases when these nouns are used as neutral or female nouns. Such nouns are: *ujë* (water), *mish* (meat), *djathë* (cheese), *lesh* (wool), *mjaltë* (honey) etc. Since the collection of the examples was made during 1980-1989, we thought to make another process of collecting these examples in different Albanian speeches , in order to study the current usage of these uses, which would give us the opportunity to note the changes that have occurred during these 30 years in the use of neuter gender in nouns and the tendency of this group of nouns to be used as male or female nouns.

Majlinda BREGASI

NDAJFOLJET E QËNDRIMIT NË GJUHËN E FOLUR

Kur flasim për 'subjektivitetin' kemi parasysh kapacitetin e folësit/es për ta vendosur veten si 'subjekt' (Benveniste, 1971 [1966]:224). Vetëm nëpërmjet gjuhës njeriu mund ta ndërtojë vetveten si një subjekt, sepse gjuha e vendos konceptin e egos në realitet (Caffi, 2007). Në gamën e elementëve që e ndërtojnë këtë subjektivitet, do trajtoj vetëm ndajfoljet e qëndrimit në gjuhën e folur. Ndajfoljet e qëndrimit na interesojnë për disa arsye, e para se meritojnë një klasifikim më të detajuar brenda llojit, jo vetëm mbi fushën e tyre semantike, por edhe mbi efektin që kanë në diskursin e folësit/es. Nëpërmjet tyre (por edhe elementëve të tjerë) folësi/ja pozicionohet për përgjegjësinë mbi diskursin e tij/saj. Elementët e qëndrimit paraqesin edhe dimensionin etik mes *të thënit e të bërit*. Pozicionet që ndajfoljet marrin në sistemin e bisedës i bëjnë edhe më interesante si nga ana funksionale, ashtu edhe ajo semantike e pragmatike.

Ky artikull trajton rolin e ndajfoljeve të qëndrimit në një radhë të bisedës, veçmas si elementë parahyrës e paspërmbyllës. Të dyja këto seksione, rëndomë përputhet edhe me zonën e tranzicionit, karakterizohen nga një element i theksuar ndërpersonal. Nëse hyrjet synojnë të paraqesin kuptimin e radhës, përmbylljet shprehin përgjithësime, vlerësime, nxitje etj. Për të bërë një analizë të suksesshme në objektin tonë të hulumtimit kërkohet një intergim i disa qasjeve studimore si analiza e bisedës, pragmatika, retorika tradicionale, stilistika dhe teoria e akteve gjuhësore. Metodologjikisht nisem nga analiza e bisedës.

Interesi për bisedën si forma bazike e organizimit të të folurit në ndërveprim është gjithmonë e në rritje në hulumtimet shkencore. Biseda për humanët duket të jetë forma dalluese e jetës sociale (Schegloff, 1996:54). Duke u nisur nga supozimi i themeluesve të analizës së bisedës se struktura të ndryshme të gjuhës janë projektuar pikërisht për t'i shërbyer bisedës, atëherë, përpara gjuhëtarëve hapet një fushë e rëndësishme për studim (Sacks, Schegloff e Jefferson, 1994, Schegloff 1996, 2007, Ford & Thompson, 1996, Selting 2005, Auer 200o, 2005, Lindström, 2006, Bregasi, 2015, 2016 etj).

Tipari themelor i bisedës është se ajo ndërtohet nga radhë në të folur. Një nga arritjet e deritanishme të studimeve mbi bisedën është se janë zbuluar pika të

rëndësishme të lidhjes mes organizimit të njësive të ndërtimit të radhës (NjNR) dhe sintaksës së fjalisë. Në analizat e deritanishme që kemi bërë mbi një korpus debatesh televizive (Bregasi, 2015) dalim në përfundimin se organizimi i radhëve në bisedë është interaksionalisht i ndjeshëm ndaj përshkrimit sintaksor të strukturës së fjalisë në shqipe.

Pjesë të veçanta të strukturës gramatikore mund të përdoren nga folësit për të kryer veprime të veçanta në sistemin e marrjes së radhës (turn-taking system). Synimi ynë këtu është të kapim pikat ku "gjuha dhe bota takohen" – nëse ato vërtetë mund të jenë të ndara gjatë ekzekutimit të akteve gjuhësore (Weinrich, 1966: 17). "Kjo do të thotë se gjatë ekzekutimit të thënies folësi/ja jo vetëm e vendos veten në një pozicion ndaj një përmbajtjeje (një fjalie) apo merr një rol social të njohur dhe indeksuar nga mjetet ilokutive forcë-treguese (p.sh. kur dikush pyet, urdhëron, jep një këshillë, jep kompliment etj), por gjithashtu jep një imazh të vetvetes (p.sh. të sjellshëm, por të ndarë nga profesionalizmi etj). Me një fjalë ai/ajo është përgjegjëse për imazhin e bartur në diskurs" (Caffi, 2006:44).

Pjesë të veçanta të ligjëratës mund të përdoren nga folësit/et si elementë hyrës, lidhës, nxitës etj. Më poshtë japim modelin e njësisë së ndërtimit të radhës të krijuar nga Lindström (2006:83) e cila është mbështetur te udhëzimet e Schegloff (1996) dhe te tipologjia e marrjes së radhës praqitur nga Steensig (2001):

Sacks, Scheglof e Jeferson (1974) propozuan një strukturë tri pjesëshe të një radhe në bisedë "njëra e cila e adreson lidhjen e radhës me atë paraprijëse, njëra që merret më atë që zhvillohet në radhën aktuale dhe e treta që adreson lidhjen e radhës me atë që do ta pasojë (Sacks, Schegloff e Jefferson, 1994:722)". Ky është tipari më i dukshëm i radhës, që na shpie drejt strukturës themelore të saj me elementë të indentifikueshëm hyrës e përmbyllës.

Një njësi e mundshme e bisedës		
Segment i paravendosur që lidh NJNR me radhën paraprijëse	NJNR pjesa kryesore Fillimi para)Plotësia	Segment i prapavendosur që lidh NJNR me radhën e ardhshme
Yeah, so	I say that would bum you out then,	Hunh

Kjo është një strukturë orientuese që u shërben folësve për të zhvilluar një bisedë. Na intereson në këtë punim për shkak të pozicionit që zënë ndajfoljet në këtë strukturë, pozicion që rrjedhimisht lidhet edhe me funksionin e tyre.

Elementët parahyrës e paspërmbyllës qëndrojnë sintaktikisht në ekstrapozicion me radhën dhe dallojnë nga nisja e vërtetë dhe përmbyllja e mundshme e saj (Sacks etj., 1974:719). Ata kanë një status sintaksor të izoluar në fjalinë ku gjenden, por kanë funksion lidhës mes radhëve, shërbejnë për të marrë fjalën ose për ta adresuar atë te folësi tjetër (Bregasi, 2016). Këta elementë janë të shumëllojshëm, por ne do të përqendrohemi te ndajfoljet, për arsyen e vetme se në analizat tona ndajfoljet na dalin të shpeshta në këto pozita e me funksione të ndryshme.

Është një konflikt i përhershëm mes nevojës për t'u kuptuar nga të tjerët dhe nevojës për të shprehur emocionet, nga njëra anë, dhe nevojës për të qenë i /e qartë dhe për t'i dhënë vetes liri për t'u shprehur (Spitzer, 1922; Terracini, 1963, Caffi, 2007). Do të ndalem te ato ndajfolje që në anglishte quhen stance. Mbi këtë koncept në literaturë sot ekzistojnë disa emërtime si *evaluation* (Hunston and Thompson, 1999), *evidentiality* (Chafe and Nichols, 1986; Nuyts, 2001), *hedging* (Salager-Meyer, 1994; 1995; Hyland, 1996; 2000), *modality* (Palmer, 1979; Hoye, 1997) and *metadiscourse* (Hyland, 2005) etj.

Stance (qëndrimi) është një ndërtim gjuhësor i cili referon te lidhja komplekse që krijohet mes kuptimit literal, figurativ dhe atij funksional në diskurs (Precht, 2003:239). Stance pra, apo qëndrimi, është një akt publik i performuar nga aktorë social, që realizohet nëpërmjet dialogëve për të shprehur vlerësime të objekteve, për t'i pozicionuar e rreshtuar ato në lidhje me objektet e tjera, duke mbajtur parasysh dimensionin e heshtur të fushës sociokulturore.

Ndajfoljet e qëndrimit Fairclough (2003:171) i klasifikon si markues, si qëndrime vlerësuese të prodhuesit të fjalisë nëse ajo që thotë është e dëshirueshme apo jo. Ato shprehin vlerësime mbi objektet me interes, pozicionojnë aktorët socialë në lidhje me ato objekte dhe me rreshtimin e atyre objekteve përçojnë të ashtuquajturin sistem të vlerave sociokulturore (Du Bois, 2007, p.139).

Në italishte këto ndajfolje quhen modale e klasifikohen në epistemike e deontike. Modaliteti është një formë e pjesëmarrjes së folësit në aktin gjuhësor. Pra modaliteti rrjedh nga ajo që e quajmë funksion ndërpersonal të gjuhës (Halliday, 1970, (1976)[1987, 311]).

Meqënëse nocioni i modalitetit mbetet i vagët dhe lë të hapur mundësinë për një numër përkufizimesh të mundshme (Palmer, 1986, 1), për shqipen propozoj të quhen ndajfolje të qëndrimit, pasi shprehin gjykimin, vlerësimin, pozicionimin, prekin anën emocionale dhe mënyrën e të shrehurit që folësi përzgjedh për të ndërtuar

thënien e tij. Pra ndërlidhin komunikuesin me informacionin që po jep (Benveniste 1970, Givon 1984) në disa dimensione. Të njëjtim propozim e ka bërë edhe Rugova, B., (2015) duke dhënë një klasifikim të ri të mbiemrave në shqipe, pasi "klasifikimi i mbiemrave në gramatikat e shqipes nuk i merr parasysh konceptet e gramatikës së tekstit". Kur të merret parasysh nocioni i këndvështrimit të tekstit, duke e parë përfaqësimin në tekste objektive dhe subjektive, ndarja në mbiemra cilësorë dhe marrëdhëniorë nuk mjafton (Rugova, L., 2009, 2010, 2011, 2012).

Ky propozim mbështetet te përkufizimi i këtyre ndajfoljeve te gramatika e Biber etj. (1999) Conrad e Biber (1999), Precht (2003) etj që i interpretojne ndajfoljet *stanc*e si shprehje të "ndjenjave personale, qasjeve dhe vlerësimeve apo gjykimeve". Gjithashtu mbështetem te po këta autorë edhe për skemën teorike të përshtatur këtu përsa i përket kategorizimit semantik të këtyre ndajfoljeve markuese të diskursit në epistemike, të vlerësimit (këndvështrimit) dhe stilit.

Meqënëse këto ndajfoje janë elementë mjaft të ndjeshëm ndaj kontekstit, frekuenca e tyre është matur rast pas rasti.

Ndajfoljet e qëndrimit epistemike dhe të vlerësimit kanë të bëjnë me përmbajtjen e një njësie të radhës në bisedë. Markuesit epistemikë shprehin gjykimin e folësit mbi shkallën e vërtetësisë së radhës në bisedë.

Përveç besueshmërisë apo limitimit të saj, ato kanë të bëjnë edhe me burimin e informacionit që folësi/ja ka. Ndajfoljet e vlerësimit paraqesin pozicionimin e folësit/es ose gjykimin e tij/saj mbi përmbajtjen e fjalisë. Ndajfoljet e stilit përshkruajnë mënyrën e të folurit (Biber *et al.* 1999:854).

Ndajfoljet **epistemike**, që shprehin qëndrimin e folësit/es mbi shkallën e vërtetësisë së thënies, shprehin një sërë kuptimesh si 1) *dyshim e vërtetësi,* 2) *aktualitet e realitet*, 3) *burim të dijes*, 4) *limitim* të saj, 5) *këndvështrim*.

Në shembullin e mëposhtëm, një intervistë e transmetuar në RTK, ku i intervistuari ka për qëllim të bindë publikun, ndajfolja me frekuencën më të lartë është *absolutisht*, ose në variantin tjetër që përdoret normalisht në Kosovë *absolut (7 her*ë*).*

Transkriptë 1.

55. A: [Edhe] ti ju ke bind asaj?
56. B: =**Absolu**t ne kemi qen kjo ka zgjat ky sistem i punës ka zgjat bukur gjat
281. A: Ti prokurorit i ke tregu drejt?
282. B: **Absolutisht**.

289. A: Dhe aty ti e ke marr si me inat këtë punë.
290. B: **Absolut**. Une i kam provat. Dhe jam ka shkoj me prova.

Ndërkohë që edhe gazetari e rimerr këtë ndajfolje për të shprehur qëndrimin e vetë.

241. A: S'je ka m'bind qëtash **absolut**

Sikurse shihet gazetari e ka vendosur ndajfoljen si element paspërmbyllës, pasi njësia e radhës mund të ishte përmbyllur pas ndajfoljes qëtash. Në këtë rast ndajfolja e qëndrimit absolut, përveç shprehjes së shkallës së vërtetësisë nga folësi shërben edhe si element nxitës për të intervistuarin. Gazetari këmbëngul për më tepër informacion duke përdorur pikërisht përsëritjen si mjet strategjik i efektshëm në angazhimin e tij konversacional (shih Bregasi, 2015).

Ndajfoljet e qëndrimit vlerësuese apo emocionale shprehin reagimin e folësit apo emocionet e tij mbi një përmbajtje e cila konsiderohet e vërtetë. Studimi i kësaj fushe të mjegullt mes komunikimit dhe emocioneve kërkon një hulumtim kompleks ku të ndërlidhen të dhënat psikologjike, sociologjike dhe gjuhësore. Deri tani këto ndryshore janë studiuar dhe trajtuar në sisteme të ndara, pa një referencë sistematike me lidhjen e tyre të heshtur, ndarjen, neutralizimin apo bashkëveprimin (shih Caffi, 2007).

Në shembullin e mëposhtëm kemi ndajfoljet *mirë*, *ani* dhe shkallët sipërore *boll mirë* e *shumë mirë*, që përdoren nga folësja C si elementë paranisës në tri radhë të njëpasnjëshme të saj.

Transkriptë 2.

C: [**Jo:: ani**] pse mos me ∠dit *?* =
D : =Ka:: zemër çerdhe [për gra të mbuluara. pa pare ja :n.=]
C : [**ani boll mir** që paska]
C: = ∠**Shum mir**. paska bë dikush nji vepër humanitare sepse duke qen të diskriminuara e pa pun s=kan s=munden me pagu ato nji çerdhe sikur ju

Këtë ndajfolje në dy variantet e saj, mirë dhe ani, që përdoret rëndom në Kosovë, folësja C e përdor edhe si mjet mbrojtjeje ndaj sulmeve të folëses kundërshtare D. Në radhën e parë kjo ndajfolje vjen menjëherë pas formave të përgjigjes tipike po, jo, të cilat nuk përfshihen në NjNR. Qëndron në ekstrapozicion sintaksor me njësinë e radhës, por ka funksion semantik të qënësishëm për gjithë radhën, që nuk e bën këtë element më pak të rëndësishëm se elementët e tjerë që qëndrojnë 'brenda njësisë'.

Kombinimi i dy trajtave mirë dhe ani është element i përdorur në funksion të

akomodimit gjuhësor si edhe për të përfituar publikun duke u paraqitur si njëra prej tyre. Folësja është nga një zonë e Shqipërisë ku nuk njihet fare kjo trajtë, por qëndrimi në Kosovë dhe realizimi i debatit në televizionin publik të Kosovës e bëjnë këtë përzgjedhje mjet strategjik të angazhimit në bisedë.

Ndajfoljet e stilit janë ato që përdoren më së paku gjatë bisedave të traskriptuara. Ndajfoljet e stilit janë ato që shprehin mënyrën e të folurit, si psh.

Transkriptim 3.
B: Kjo është nji pytje pak don nji analiz ma t'madhe po unë po t'përgjigjna **shkurt**
A: Jo tregona çka ke bo gjat vitit nëdhet e tet
B: Kam marr pjes n'arrestimin e njerzve. Si **më shkurt** se
[Bllaca gjithmon fol pa]
A: [Cilët njerz i ke arrestu?]

Përveç rolit stilistik, ndajfoljet e stilit në këtë rast janë qartë mjete strategjike për të shmangur dhënien e përgjigjes. Gjë që tregon se folësi ka vënë në veprim procesin e working-face të Goffman, që na risjell edhe një herë te analiza e detajizuar e Caffi-t (2007), ku këmbëngul te një analizë e ndërlidhur mes qasjeve studimore gjuhësore, psikologjike dhe sociale. Biseda është një dukuri mjaft komplekse dhe e qenësishme për qenien njerezore, ndaj është e natyrshme që shfrytëzimi i qasjeve të ndryshme teorike e metodologjike të sjellë rezultate më të arrira.

Tabelë statistikore

normalisht	5	ndoshta	1
natyrisht	6	pikërisht	5
gjithmone	3	realisht	5
sigurisht	4	momentalisht	1
kurre	4	përafrsisht	1
ashtu	1	faktikisht	2
kadal	2	pavarësisht	1
absolutisht	8	shkurt	2
publikisht	1	sinqerisht	1

Nga tabela duket që ndajfoljet e qëndrimit epistemike janë më të shpeshta në traskriptimet tona dhe kjo gjë ishte e pritshme, pasi kemi të bejmë me një korpus debatesh televizive, ku folësit duan të paraqiten të besueshëm mbi të gjitha, pra ato janë në funksion të rolit që debatuesit zgjedhin për veten e tyre. Rolet sociale që ne

aktivizojmë përkohësisht ndikohen dhe ndërlidhen me egot e ndryshme, qëndrimet subjektive, ndjenjat dhe emocionet (Caffi, 2006). Analiza më të detajuara mbi gjuhën e folur do të ishin me mjaft interes për gjuhësinë dhe do të na shpinin drejt ndërtimit të një gramatike të gjuhës së folur, të cilën e shoh si një nevojë imediate në studimet tona.

Bibliografia

ASHRSH, 1995, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë.

ASHRSH, 1997, Gramatika e gjuhës shqipe II, Tiranë.

Austin, J., 1962, How to do things with words, Oxford University Press, Oxford-London.

Auer, P. and **Aldo di Luzio** (eds.), 1992, The contextualization of language. Amsterdam, Philadelphia: Benjamins.

Baldi, B. & Savoia, L., 2010, Metafora e ideologia nel linguaggio politico, te Lingua e società, : M. Arcangeli. *Lingua Italiana d'Oggi*. p. 119-165, Roma: Bulzoni.

Biber et al., 1999, Longman Grammar of Spoken and Written English, Harlow: Pearson Education Limited.

Benveniste, E., 1966, Problèmes de linguistique générale. Paris: Gallimard. English translation by M. E. Meek, Problems in general linguistics. Coral Gables, Florida: University of Miami Press, 1971.

Bregasi, 2015, Përtej debatit politik – analizë e bisedës, Kolegji Dardania.

Bregasi 2016, Sintaksa e një radhe në bisedë – njësitë përbërëse të radhës, Shejzat, Le Pleiadi, Romë.

Chafe, Wallance L., 1982, Integration and involvement in speaking, writing and oral literature. Spoken and written language: Exploring orality and literacy, ed. By Deborah Tannen, 35- 53. Norwood, NJ: Ablex.

Drew, P. & Heritage, J., 1992, Talk at Work: Interaction in Institutional Settings, Cambridge: Cambridge University Press.

Fairclough, N., 2003, Analysing Discourse, Routledge.

Ford, C. & Thompson, S., 1996, Interactional units in conversation: Syntactic, intonational, and pragmatic resources for the management of turns, in E. Och, E. A. Schegloff and S.A: Thompson, interaction and grammar, Cambridge, Cambridge University Press (134-86).

Garfinkel, H. & Sacks, H., 1970, On formal structures of practical actions, in J. C. McKinney and E. A. Tiryakian, Theoretical Sociology, New York: Appleton-Century- Crofts (337-66).

Goffman, E., [1967]1988 Il rituale dell'interazione, In Mulino.

Goodwin, M., & Heritage, J., 1990, Conversation analysis, Annual Review of Anthropology, 19 (283-307).

Grice H.P., 1993 [1957], Il significato, te Logica e conversazione, Saggi su intenzione, significato e comunicazione (219-231), G. Moro, il Mulino, Bologna.

Halliday, Michael A. K., 1970, "Language structure and language function", in J. Lyons (ed.), New horizons in linguistics. Harmondsworth: Penguin, 140-165.

Hutchby I., **Wooffitt R**., 1998, Conversation Analysis, Cambridge, Polity Press.

Hymes, D., 1979 [1972], La competenza comunicativa: F. Ravazzoli, Universali linguistici, (212-243), Feltrinelli, Milano.

Hymes, D., 2000, Verso un'etnografia della comunicazione: l'analisi degli eventi comunicativi, nw Linguaggio e contesto sociale, Giglioli, P. P. dhe Fele, G. im Mulino.

Levinson, **S.**, 1985[1983] Pragmatics, Cambridge, Cambridge University Press.

Lerner, **G.H.,** 1991, On the syntax of sentences-in-progress' Language in Society, vol 20 (441-58).

Lindström, J., 2006, Grammar in the Service of Interaction: Exploring Turn Organization in Swedish, 1996; Research on Language and Social Interaction, 39(1), 81-117, Cambridge University Press.

Ochs, E., Schegloff, E. & Thompson, S., 1996, Interaction and Grammar, Cambridge University Press.

Rugova B., Rugova S., L., 2015, hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe, Prishtinë.

Sacks, H., Schegloff, E., & Jefferson, G., 1974, A Simplest Systematics for the Organization of Turn-Taking for Conversation, Language, Vol 50, No. 4, Part 1 (696-735).

Schegloff, E., 1979b, The relevance of repair for syntax-for-conversation, in T. Givón (ed), Discourse and Syntax, New York: Academic.

Schegloff, **E**., 1988c, Presequences and indirection: Apply speech act theory to ordinary conversation, Journal of Pragmatics, 12 (55-62).

Schegloff, **E**., 1996, Turn Organisation: one intersection of grammar and interaction, Interaction and Grammar, Elinor Ochs, Emanuel A. Schegloff and Sandra Thompson, Cambridge University Press.

Selting, **M,**. 2005, Syntax and prosody as methods for the construction and identification of turn-constructional units in conversation, in A. Hakulinen & M. Selting (Eds), Syntaks and Lexis in conversation: Studies on the use of linguistic resources in talk-in-interaction (17-44), Amsterdam: John Benjamins.

Spitzer, L., 1922, Italienische Umgangssprache. Bonn, Leipzig: Kurt Schröder Verlag.
Terracini, B., 1963, Lingua libera e libertà linguistica. Torino: Einaudi.

Majlinda BREGASI

GRAMMAR IN SERVICE OF LANGUAGE INTERACTION
Evaluative adverbs in Albanian dialects

Abstract

This paper is a contribution to build a functional grammar of spoken language. I propose a model of the next construction unit in conversation related to the syntax of the sentence structure in Albanian. The comparison between them suggests that there are important points between syntax and interactional organization. Specific parts of speech are used by interlocutors in order to accomplish specific actions during the conversation. Based on this, the role of adverbs functioning as token in the the spoken language is going to be discusses from the aspect of the link between the opinion, the evaluation and the experience of speakers about what he/she says. I propose the usage of the term evaluative adverbs as well a classification of them in Albanian taking into account the classification of stance adverbials in English. The paper in hand is based on a corpus of real conversations in both dialects of Albanian.

Julie KOLGJINI

(RI)VALORIZIMI I FORMAVE TË STIGMATIZUARA KONKURUESE: MUNDËSIA E EMANCIPIMIT TË SHQIPES BASHKËKOHORE

1.0 Prej ngurtësise tek rrjedhshmëria: Ripozicionimet përtej kulturës së gjuhës standarde

Shqyrtimi i elementeve të ndryshme të ideologjisë dhe kulturës së gjuhës standarde është i rëndësishem kur marrim në konsideratë gjendjen aktuale të gjuhës. Ashtu siç kanë vu në dukje studiues të ndryshëm (p.sh. Woolard & Schieffelin 1994, Cameron 1995, Pennycook 1998, Ricento 2000, Shohamy 2006, Agha 2007, Heller 2008, Otsuji & Pennycook 2010, Milroy & Milroy 2012, Armstrong dhe Mackenzie 2013), përpjekjet standardizuese janë të shoqëruara shpesh me nocionet e homogjenitetit, uniformitetit, si dhe purizmit gjuhesor, në mesin e komponentëve të tjerë të ideologjisë së gjuhës standarde. Ato janë shpesh të iniciuara nga institucionet qeveritare që të caktojnë një grup të zgjedhur të individëve për hartimin e politikave gjuhësore të ngurta të quajtura format "legjitime" gjuhësore që duhet të përhapen nga gardianët e gjuhës së zgjedhur me kujdes që synojnë një audiencë të caktuar (p.sh. nxënësit; burokracinë qeveritare, redaktorët e gazetave, të librave, revistave akademike, të televizioneve, si dhe ata të transmetimeve të lajmeve në radio, e kështu me radhë); në këtë mënyrë, këta protagoniste pritet t'i përmbahen rregullave ortolinguistike. Kjo politikë gjuhësore orienton kahjen nga lart-poshtë, ku devijimet nga norma e përcaktuar dekurajohen, sidomos praktikat gjuhësore jo-standarde. Në disa raste strukturat devijante (jo-standarde) u fshinë, sidomos format që dikur ishin të përhapura u ndaluan si të papranueshme në masën që ato (edhe sot) mezi pervidhen në shtyp dhe nuk janë të mirpritura apo sanksionuara që të shfaqen apo transmetohen në sfera të caktuara publike. Siç shpjegon Elspaß-i (2007:4): "Variantet dhe 'devijimet' e tjera gjuhësore nga 'standardi' i pre-supozuar, shpesh janë pritë me ngritje supesh si gjuhë e 'keqe' (krh. Davies dhe Langer 2006) dhe diskualifikuar si të pavlefshme ose thjeshtë 'gabim'...Varianti 'jo-standard'...ishte konsideruar si korruptues dhe i rendomtë, në mënyrë që në aktin e 'purizmit sanitar', keto forma jostandarde u pastruan në masë nga tekstet shkollore (Milroy 2005:324)," duke përfshi edhe sferën kërkimore gjuhësore. Në vitet e fundit, megjithatë, është vendosë konsiderueshëm

theksi në rishikimin e praktikave të përditshme gjuhësore të njerëzve të zakonshëm, si dhe në rolin vendimtar që ata (shih Deumert 2010:260) luajnë në evolucionin e gjuhës, përkatësisht në ndryshimin nga poshtë (Elspaß 2007:6). Vërejmë rastin e anglishtes, në lidhje me paskajoren e ndarë (p.sh. **to **boldly** go* krh. *to go **boldly***), ku pavarësisht përdorimit të gjerë jo-standard, shumë gardianë të gjuhës ende kembengul(n)in në një formë që është modeluar simbas latinishtes. Fischer-i (2007: 264) shkruan: "Meqenëse paskajorja latine nuk mund 'të ndahet', gramatikanët arsyetuan se as në anglisht nuk duhet të ndahet." Fischer-i shenon se në përdorimin e gjuhës bashkëkohore, në të folme e të shkruar të anglishtes, mbijetojnë të dyja format, përkatësisht njëra e ardhur nga poshtë, dhe ajo e imponuar nga lart (shih gjithashtu Davies 2012:50).

Kritikat lidhur me standardizimet gjuhësore sillen rreth politikave që mbrojnë zbatimin e ngurtë dhe nocionin e sistemeve të mbyllura gjuhësore, që shpesh reflektojnë pabarazi në zgjedhjet gjuhësore. Ricento (2000:200-203) shpjegon se, afër fundit të shekullit të XX, ishte e qartë që planifikimet e ndryshme hegjemoniste të gjuhës dhe vendimet politike që kanë të bëjnë me zgjedhje të centralizuara të gjuhës si pjesë e padrejtësive sociale dhe ekonomike, përfshijnë pabarazinë gjuhësore, ku ata që nuk e zbatonin dhe nuk i përmbaheshin rregullave strikte të gjuhës dhe/ose variantit dominues, margjinalizoheshin, çka është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur bëhet fjalë për një standard monocentrik. Deumert-i dhe Vandenbussche-i (2003:4-5) shtjellojnë se, ndërsa standardet monocentrike kanë tendencë për të disfavorizuar variacionet gjuhësore, ku vetëm një dialekt shërben si themel i standardit, ato policentrike kanë tendencë për të përqafuar ndryshueshmërinë duke i pa varietetet si faktorë përbërës. Supozimet dhe implikimet e ndryshme të këtyre politikave gjuhësore, megjithatë, filluan të shqyrtohen, problematizohen, dhe të sfidojnë, në lidhje me idetë e "gjuhës si një entitet diskret, i caktuar" (Ricento 2000:201), ku rrjedhshmëria gjuhësore nuk inkurajohej dhe perceptimi i gjuhëve, në rastet e standardeve monocentrike "si sisteme homogjene të mbyllura" mbizotëronte (Davies 2012:58). Në këtë klimë të re të diskursit kritik, ekologjia gjuhësore Gramshian-e, duke përfshi diversitetin gjuhësor, heteroglosinë Bahktin-esque, si dhe të drejtat gjuhësore të njeriut u vendosën në qendër të vëmendjes (shih Ricento 2000, Heller 2008, Otsuji & Pennycook 2010). Njohja, toleranca, dhe madje edhe pranimi i ndërthurjeve të kodeve dhe regjistrave gjithashtu u bë më i përhapur. Praktika të tilla të gjuhës heteroglosike, ku forma të ndryshme gjuhësore dalin në sipërfaqe mbrenda kufijve të shprehjeve, si në të folme ashtu edhe në të shkruar, shpesh përfshijnë forma jo-standarde që rehatohen në strukturat standarde; struktura të tilla përzierjesh shpesh ishin përceptuar si turbullime për kulturën hegjemoniste të gjuhës standarde, të cilat në shumë raste

ishin të (pa)qëllimshme (shih Pennycook 1998, Otsuji & Pennycook 2010, Blackledge & Creese 2014).

Praktika të ndryshme gjuhësore heteroglosike, në veçanti ajo e bazuar në përdorues-centrik, shplojnë tendencat destandardizuese, të cilat mund të ndikojnë në ndryshimet gjuhësore. Lehtësimi i rregullave ortolinguistike të variantit standard nga përdoruesit me prejardhje të ndryshme gjuhësore, arsimore dhe socio-ekonomike, mund të përfshijë lëvizjen drejt forcave periferike centrifugale dhe tendencat destandardizuese, të cilat mendohet se kanë qenë - dhe vazhdojnë të jenë - të pranishme në shumë gjuhë evropiane (p.sh. në suedishte, gjermanishte, hollandishte, danishte, italishte, ndër të tjera, shih Deumert & Vandenbussche 2003, Elspaß 2007, Deumert 2010, Davies 2012, Cerruti & Regis 2014, Rutten 2016), duke u pa si produkt i proceseve të ndryshme të standardizimit (shih Auer 2005, Ludi 2012), sidomos kur kodet e ndryshme (p.sh. jo-standarde dhe variante standarde) kanë qenë në kontakt për një periudhë të konsiderueshme kohore (shih Lofti 2007, Tagliamonte 2011). Davies-i (2012:50-51) shpjegon: "Koncepti 'de-standardizim' (term i cili na çon mbrapa tek Daneš-i (1968/1982) për çekishten) del në pah shpesh në diskutimet rreth situates së sociolinguistikës bashkëkohore në vende të ndryshme evropiane. Ky koncept zakonisht i referohet dy proceseve të ndryshme: (i) ndryshueshmërisë së madhe strukturore mbrenda variantit standard dhe (ii) dukshmërisë dhe pranueshmërisë më të madhe të varianteve jo-standarde në sfera të rezervuara më parë për standardin." D.m.th, destandardizimi lejon variacionet gjuhësore, ku strukturat jo-standarde dhe lokalizmat dalin në sipërfaqe vazhdimisht (shih Auer 2005:25, Rutten 2016:8). Me fjalë të tjera, komponenteve të ndryshme gjuhësore të ndaluara, të konsideruara shpesh të stigmatizuara dhe periferike, u jepet *thumbs up* në ndërthurjen me variantin standard. Siç vihet në dukje nga Deumert-i (2010:244): "[Sh]ume shoqëri me standard-gjuhësor, aktualisht po dëshmojnë...*destandardizimin*, d.m.th. dobësimin e normës, një lëvizje centrifugale e cila rrit heterogjenitetin sociolinguistik (Lenz 2010). Në terminologjinë e Pennycook-ut & Makoni-t (2007), jemi duke vëzhguar *disinvencionet* e standardit." Ky gërshetim i formave konkuruese zhvendos theksin nga homogjeniteti i ngurtë në konstrukte të ndryshueshme fluide. Ndërsa standardizimi përforcon nocionin e forcave preskriptiviste centralizuese (centripedale) të kontrollit të gjuhës së planifikuar, destandardizimi lejon aktivizimin e repertorëve gjuhësore që nuk përfillin kufij të fiksuar, pjesërisht duke e liruar gjuhën prej lakut nga kodifikimet e tilla joelastike, të centralizuara nga epokat e kaluara, duke perfshi rolin e përdoruesit të gjuhës së përditshme dhe ndryshueshmërinë e saj. Ndërsa forcat hegjemoniste të standardizimit kanë tendencë për të detyruar vendosjen e rregullave ortolinguistike nga lart, destandardizimi i hap udhe evoluimit të vazhdueshëm të elementeve elastikë nga

poshtë duke i vu folësit në timonin e drejtimit (shih Deumert 2010:244, Tagg 2016:61-62). Deumert-i dhe Vandenbussche-i (2003:10) komentojnë se ndryshimi i gjuhës nga optika Bakhtinian-e përfshin "ndërveprimin në vazhdimësi të forcave diversifikuese dhe unifikuese," ku përpjekjet e planifikuara të standardizimit përfaqësojnë "lëvizje rrethore, duke e zhvilluar një spirale të forcave centripetale dhe centrifugale," ku presioni i forcave periferike dhe qendrore bashkëveprojnë.

Gjithashtu kur flasim per ndërthurjen e elementeve centrifugale me standardin është i rëndësishëm nocioni i diaglosisë dhe repertorëve diaglosik. Koncepti i diaglosisë shpesh është vleresuar si meritë e Auer-it (2005), i cili ofron një tipologji të "konstelacionit dialekt/standard" (Rutten 2016:6). Ai (2005:22) shkruan: "Repertori diaglosik karakterizohet nga variante të ndërmjetme mes standardit dhe (bazes) dialektit," duke "heqë dikotominë e nënkuptuar nga diglosia dialekt/standard" (Rutten 2016:7), ku variantet, e ulta (U) dhe të larta (L) dhe/ose gjuhët konkurojnë në një peisazh të dhënë gjuhësor (p.sh. schwiezerdeutsch dhe hochdeutsch). Diaglosia ka marrë hov të veçantë në gjuhët e Europës së sotme, ku "repertorët diaglosik bien në sy...nga Norvegjia në Qipro e nga Polonia në Spanjë (Auer 2005)" por që janë vërejtë qysh (më së herëshmi) në mesjetën e vonshme në Angli (Rutten 2016:7-8). Diaglosia paraprihet nga një fazë kalimtare diglosike. Rutten-i (2016:8) shpjegon: "Faza diglosike karakterizohej fillimisht nga një standard eksoglosik siç ishte latinishtja, sllavishtja kishtare apo arabishtja dhe variantet e të folmeve vernakulare...Pastaj kaloi në tranzicion drejt situates me një standard endoglosik, i cili është strukturalisht i lidhur me vernakularin." Gjendje gjuhesore të tilla, ku situata diglosike përfshin një standard eksoglosik dhe më vonë endoglosik si variant/gjuhë e lartë, paraprin kontekstin drejt diaglosisë. Gjatë fazave të ndryshme të diaglosisë elementet e varianteve (rajonale) jo-standarde mund të konvergjojnë dhe/ose divergjojnë me standardin e dhënë, "në ç'rast elementet rajonale tolerohen gjithnjë e më shumë në standard (Auer 2005:25)" (Rutten 2016:8). Kur një standard me bazë-endoglosike (L) nuk pengon prurje nga jo-standardi dhe (nen)variantet (U), mund të thuhet që ka premisa zhvillimi të diaglosisë. Ngjashëm me destandardizimin, në repertorët diaglosik variantet standarde spërkaten me karakteristika rajonale. Rutten-i (2016:7) përmend se në lidhje me "format e ndërmjetme të vendosura në mes të dialekteve bazë dhe gjuhëve standarde, diaglosia varet nga përcaktimet e dialektit dhe standardit," ku sipas Auer-it (2005, 2011), "standardi ka tre karakteristika të rëndësishme…: s'ka variacion, ka prestigj dhe është i kodifikuar." Në mënyrë që variantet standarde të kualifikohen për diaglosinë, duhet të kalojnë testin e lakmusit të Auer-it për homogjenitetin, prestigjin dhe kodifikimin. Ai (2005:22) shpjegon se, diaglosia përfshin "hapsirën midis dialektit…dhe standardit," ndërsa, Rutten-i (2016:7-8) shkruan se "është e mbushur me forma të ndërmjetme që

nuk janë të dallueshme as si dialektore, as si standarde." Kështu, këto konstrukte të reja hibride shpesh i mundësojnë folësit të krijojë dhe të shpreh një identitet të vetin që nuk është i prangosur në mënyrë strikte në ndarjen jo-standard apo standard. Rutten-i (2016:8), duke cituar Auer-in, shpjegon: "Forma të tilla të ndërmjetme u mundësojnë përdoruesve të gjuhës 'që të përfaqësojnë, në kontekstet e duhura, një identitet i cili nuk mund të simbolizohet përmes dialekteve bazë (prej të cilave mund të ketë konotacione përçmuese si ruralë, të prapambetur ose i të pa arsimuar), e as me anë të standardit kombëtar (i cili mund të japë shijen e formalitetit dhe jo-natyralitetit dhe/ose humbjen e origjinalitetit për të shprehur përkatësinë rajonale). (Auer 2005:23)." Jo ndryshe prej destandardizimit, struktura të tilla të ndërfutura në repertorë diaglosik i vënë elementet centrifugale të folësve në qendër, por jo pa lënë hapësirë frymëmarrjeje për elementet centripedale. Kalimi i kufijve standard/jostandard në mënyrat e shprehjes diaglosike është remenishencë e tensioneve centrifugale dhe centripedale në tendencat destandardizuese dhe heteroglosike të tjera, ku diaglosia shërben si një ombrellë e përgjithshme për nocione të tilla (Rutten 2016:7). Diaglosia njeh dhe pranon prezencën e shumllojshmërisë në praktikat e përditshme gjuhësore në ndërveprimet njerëzore. Më tej, Auer-i (2005:31) përmend se "shumë repertorë diaglosik janë mjaft të qëndrueshëm, me regjiolektet shpesh edhe duke fituar epërsi mbi variantet standarde, madje nganjëherë edhe duke futur variacion të ri." D.m.th, diaglosia gjuhësore nuk përjashton stabilitetin gjuhësor, qoftë edhe kur elementet jo-standarde leshojnë bajagi hije mbi ato standarde.

2.0 Praktikat heteroglosike në gjuhën shqipe: E kaluara dhe e tashmja

Praktikat heteroglosike gjuhësore kanë ekzistuar në gjuhën shqipe qysh të paktën prej disa shekujve të fundit, nëse jo më herët, siç është dokumentuar në tekstet e e hershme, alfabetet, përshkrimet e ndryshme gjuhësore dhe fjalorët, ndër të tjera. Ato janë të dukshme në zgjedhjet e grafemave në zhvillimin e disa alfabeteve shqipe si dhe në shkrimet e hershme, si p.sh. të Pal Engjëllit dhe Buzukut në shekujt e XV dhe XVI (shih, Çabej 1968, Elsie 1995, Trix 1997, 1999, Osmani1999, Riza 2002, Ismajli 2005). Edhe pse shumica e përzgjedhjes drejtshkrimore të gjuhës së Buzukut tek Meshari është e ndikuar nga latinishtja-dhe grafema me bazë italishte të shkrimit romak, dijetarë të ndryshëm sugjerojnë se mund të jenë përdorë elemente nga gjuhë të tjera në mënyrë që të përshtateshin më mirë në realitetin fonologjik të shqipes (Çabej 1968, Osmani 1999:35). Elementet e ndryshme cirilike nga sllavishtja, p.sh. boshnjakishtja, mendohet se janë përfshi në disa grafema, të tilla si mbylltoret qiellzore të zëshme dhe të pazëshme, të cilat gjithashtu mund të jenë përdorë pjesërisht për

shkak të kufizimeve të opsioneve të mundshme të shtypit në dispozicion, pa përjashtuar faktorë të tjerë kulturor dhe politik (Çabej 1968:46, Trix 1997, Osmani 1999:36).

Duke u hedhë në shekujt XIX dhe XX, shkrimtarët vazhdojnë të përdorin skripte të ndryshme në gjuhën shqipe, p.sh. romake, greke dhe arabe, ndër të tjera (Trix 1997). Në Kongresin e Manastirit në vitin 1908, kur do të zgjedheshin grafemat që do të përfshiheshin në një alfabet të vetëm të shqipes, u vu në pah kombinimi i kodeve të ndryshme të nderthurura së bashku në përpjekje për të arritë konsensus në mënyrë që të krijojë një drejtshkrim të përbashkët të shqipes, p.sh. <c> nga alfabeti i Stambollit (që përmbante elemente të ndryshme romake, greke dhe cirilike) dhe alfabeti i Agimit; <ç> me një shenjë diakritike të përhershme nga Stambolli; dhe diagrafet <dh>, <xh>, <sh> dhe <th> prej alfabetit të Bashkimit (Trix 1997:6, 12-13, 19), shumë prej të cilave ishin ndikuar nga "mjedisi skriptal" me diversitetit të gjerë gjuhësh, qëndrime të ndryshme gjuhësore, dhe qendra si Londra, Vjena, Stambolli, dhe Bostoni, nga vendim-marrësit e Komisionit të Manastirit (Trix 1997:16).

Më tej, në lidhje me përshkrimet gjuhësore të shqipes, në publikimin e Sheperit në 1927 edhe pse fokusi kryesor ishte sigurimi i të dhënave mbi dialektin tosk, bien në sy edhe të dhëna të konsiderueshme të elementeve të gegnishtes, p.sh. në aspektin e veçorive morfo-sintaksore dhe fonologjike. Sheperi i kushton hapësirë pjesores gege (p.sh. *shkrue*(*m*), *la*(*m*), *fal-un*, *falë*, *çelë* 86-87), duke dhënë shpjegime dhe shembuj të konteksteve të ndryshme ku është përdorë nga shumë foles, p.sh. me paskajoren e shkurtë perifrazike (*duhet me shkrue*, *kërkon me shkrue* 167); mbrapa shënuesit të përcjellores gege *tue* (krh. *duke* 88); si dhe në kohën e ardhme për të shprehë domosdoshmërinë (p.sh. *kam me shkrue*, krh. *do të shkruaj*, shih, 85, 92, 107, 167). Sheperi gjithashtu paraqet dallimet e tjera në mes gegnishtes e tosknishtes, p.sh. *vo~va* (p.sh. *voj~vaj* 30); zanoreve hundore në gegnishte (p.sh. *asht*, krh. *është*; *kambë*, krh. *këmbë* 30); dhe një histori të shkurtë të rotacizmit, ku shumë forma të gegnishtes janë të pranishme me mbylltore nazale intervokale (p.sh. *m* ose *n*), ndërsa forma toske përmban elementin e rotacizmit, p.sh. *Vlonë~Vlorë* dhe *i shkruem~i shkruar* (32); e të tjera. Në mënyrë të ngjashme gramatika shqipe e Mann-it e vitit 1932 përfshin të dy variantet, gegnishte dhe toskerishte ku gegnishtja merr hapsirën kryesore. Gramatika e Camajt e vitit 1984, gjithashtu paraqet një qasje policentrike, ku gegnishtja, tosknishtja, dhe arbërishtja shfaqen krah për krah gjatë gjithë tekstit; përpjekjet në tekstin e Camajt për ti paraqitë audiencës një qasje të balancuar ndaj varianteve të ndryshme të shqipes, devijohet në gramatikën e shqipes nga Newmark-u, Hubbard-i, dhe Prifti (1982), duke u fokusuar në variantin monocentrik të ShNjL-së (kupto toskërisht), me veç sperkatje të vogla të jo-standardit (kupto gegnisht) dhe format e gjuhës së folur (p.sh. me

paskajoren perifrazike jo-standarde, 64, 98; formimin e së ardhmes të tipit *kam* + *me* + pjesoren e shkurte, 50).

Lidhur me fjalorët e ndryshem të shqipes, p.sh. mbas vitit 1945, në mesin e publikimeve të tjera policentrike, *Fjalori i gjuhes shqipe* të 1954 nga Cipo, Çabej, Domi, Krajni dhe Myderrizi përfshin prurje të shumta, nga të dyja variantet, gegnishtja dhe toskerishtja; për shumë nga prurjet gege, definicioni dhe/ose pranë-ekuivalentja ofrohet në toskërishte (p.sh. *ambel* (*i*, *e*) mb. *i embel* 8; *andërr-andrra* ef. shm. *andrra ëndër* 10; *tambël – tambli* em. *qumësht* 554; *venë-a* ef. *verë* 602); vini re se për prurjet toske, nuk janë ofruar gjithmonë spjegimet ose pranë-ekuivalentet në gegnishte (p.sh. për fjalën *turp,* sinonimi *marre* nuk është dhënë); edhe pse dukshëm më shumë prurje ekzistojnë prej toskërishtes, megjithate ky fjalor ende permban një piperosje të lehtë me gegizma. Fjalori (anglisht-shqip) i Mann-it (1957) paraqet policentrizëm të konsiderueshëm, ku elementet leksikore të shqipes janë dhënë shpesh si në gegnisht, ashtu dhe toskërisht (p.sh. *asht~është* 203; *voj~vaj* 259; *ven*ë*~ver*ë 427; megjithatë, *turp*, po, por jo dhe *marre* 338). Ndërsa, *Fjalori i shqipes së sotme* i vitit 1984, ka një numur shumë më të zbehtë të arsenalit të gegnishtes; disa nga të paktat prurje prej gegnishtes janë *tambël,* krh. *qumësht* (1220); *tëlyen*, krh. *gjalpë* (1236); *cucë*, krh. *vajzë* (145); *çikë*, krh. *vajzë* (160); (357); *bathë*, krh. *fasule* (71). Të gjitha këto tekste por edhe të tjera të mëhershme, që nuk u përmendën këtu, paraqesin shkallë të ndryshme të policentrizmit në lidhje me gjuhën shqipe, ndërsa, *Fjalori i shqipes së sotme* i vitit 1984 paraqet një mungesë të konsiderueshme të jo-toskërishtes dhe jo-(të ashtuquajtures) letrares së unifikuar shqipe (të vitit 1972). Fjalori (shqip-anglisht) i Newmark-ut i vitit 1999 megjithatë, përmban një sasi në rritje të formave policentrike jashtë ShNjL-së (iv, iv, p.sh. *hanë*, krh. *hënë* 300; *mbrenda*, krh. *brenda* 504; *bâ*, krh. *bë* 37; shih gjithashtu http://seelrc.org:8080/albdict/).

Ngjashëm me prirjet që vihen re në gjuhë të tjera në Evropë (shih Auer 2005, Everhart 2013, Rutten 2016), praktikat gjuhësore që përfshijnë destandardizimin dhe tendencat diaglosike, gjithashtu mund të vërehen edhe në shqipe kur merren parasysh peisazhet aktuale gjuhesore në lidhje me proceset e ndryshme historike të standardizimit të dekadave të mëparshme.

Duke reflektuar mbi veprat e letërsisë shqipe që janë botuar në dekadat e fundit, bien në sy ato që ofrojnë për lexuesit shembuj heteroglosik që pasqyrojnë në shumë mënyra se si përdoruesit e zakonshëm e aplikojne gjuhën, përkatësisht kur vërehen elemente destandardizuese dhe diaglosike. Për ilustrim po përmendim vetëm dy shkrimtarë, Sulejman Didën (2014) dhe Petrit Palushin (2006), përkrah shumë të tjerëve, të cilët nuk janë përmendë shpesh për këtë temë. Në raste të shumta pjesorja gege, duke përfshi formën e shkurtë (shih Morina në Gashi 2010, Gjuka 1913 në

Morina http://plisi.org/gjuhsi/shkrim-mocem-pjesoren-shkurtuar/; Mjeku http://plisi.org/gjuhsi/ndryshon-shqipja-Standarde/), e gjen rrugën e saj në mjedisin e gjuhës së njësuar letrare, si në përfshirjen e konstruktit të përcjellores, p.sh. *duke afru* (Dida 2014:3 krh *duke afruar, tue afrue*), *duke dalë* (16 krh. *duke dalur*, *tue dalë*), *duke lexu* (22 krh. *duke lexuar*, *tue lexue*), *duke bërtitë* (201 krh. *duke bërtitur*, *tue bërtitë*), në mesin e shembujve të tjere të shumtë. Tek Dida, forma të tilla të shkurtuara, paraqiten kryesisht kur karaktere të ndryshme në tekste letrare shprehin mendimet e tyre. Në mënyrë të ngjashme, tekstet e Palushit gjithashtu përmbajnë raste të shumta të tendencave të tilla diaglosike. Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë ndërthurjen e përcjellores së ShNjL-së (standardit) me pjesoren (nganjëherë të shkurtë) gege në shkrimet e tij, p.sh. *duke fjetë* (27 krh. *duke fjetur*, *tue fjetë*), *duke u kujtue* (37 krh. *duke u kujtuar*, *tue u kujtue*), and *duke u kthye* (70 krh. *duke u kthyer*, *tue u kthye*), e kështu me radhë. Vepra e Palushit ofron sasi të konsiderueshme gegizmash, p.sh. me pjesore gege (të shkurta e të gjata) në kontekste të shumta morfo-sintaksore, duke përfshi edhe paskajoren perifrazike, p.sh. *me mbledhë* (32) si dhe kohën e ardhme, p.sh. *kemi me shkue* (33) e tj. Mund të thuhet se shkrimet e këtyre autorëve (e shumë të tjereve) reflektojnë ate që po ndodh në praktikat e përdorimit të përditshëm gjuhësor në lidhje me tendencat diaglosike perfshi destandardizimin edhe në gjuhën shqipe.

Mediat e hapësirave digjitale ofrojë raste të panumurta të karakteristikave destandardizuese dhe diaglosike të tilla në gjuhën shqipe (shih Leppänen et al. 2009, Tagg 2016). Postimet e ndryshme nepër mediat sociale dhe faqet e rrjeteve, si p.sh. video dhe inçizime intervistash, sigurojnë sasi të bollshme shembujsh heteroglosik ku ShNjL-ja i toleron *infiltrimet* e tilla nga forma jo-standarde dhe rajonale të shqipes. Në disa hapsira shqiptare, elementet jo-standarde fitojnë pozitë dominuese, siç mund të vërehet në (ri)vleresimin e formave të ndryshme të stigmatizuara më parë, të tilla si pjesorja gege, duke përfshi formën e shkurtë, p.sh. në paskajoren perifrazike, përcjelloren, kohën e kryer, si dhe të ardhmën. Për shembull, postime të shumta videosh, transmetimet e lajmeve aktuale të rëndësishme, sidomos informacionet që përfshijnë avancimet në teknologji, shfaqin forma të ndryshme jo-standarde dhe të arealeve rajonale mbrenda-shqipfolëse. Shembujt nga një video në internet, na paraqesin se si pjesorja (gege), në formën e saj të shkurtë, përshfaqet në struktura të shumta morfo-sintaksore e spërkatur me lokalizma të ndryshëm (shih shembujt në tabelën 1 tek fusnota 1)[i]. Mysafiri i ftuar, ku kompania start-up e të cilit sapo kishte fituar çmimin TIK (ICT) në Tiranë (Shqipëri), shqiptoi disa nga shembujt e mëposhtëm: *duke ngritë*, *me punu*, *kemi vujtë*, *keni me pa*, e kështu me radhë. Folësi është një i ri i shkolluar në fushën e TI (IT). Siç mund të shihet në tabelën 1, në formën përcjellore, paraqiten hibride të reja duke përfshi ndërthurjen, ku shënuesi *duke* prej

ShNjL-së paraprin pjesoren (e shkurtë). Gjithashtu, në strukturat e përdorura të pjesëzes lokale të së kryerës *kena* varion me *kemi*. Po ashtu vihet re përdorimi i pjesores *ba* në formën lokale: *bo* (krh. *bërë*). Gjuha e intervistuesit shkon në linjë përshtatjeje me valorizimin e këtyre formave të përdorura nga i ftuari, por duke përdorë edhe struktura të tjera, si elementet e rotacizmit, p.sh. *Shqip(ë)ri* (krh. *Shqipni*) dhe *hyrja* (krh. *hymja*). Mysafiri dhe intervistuesi janë dy të rinj të cilët kanë jetuar dhe punuar në Prishtinë në kohën kur është bërë videoja; duke pasë parasysh këtë sfond, përdorimi i formave të lokalizuara dhe jo-standarde, nuk është për t'u çuditë (shih Tagliamonte 2011); të shprehurit e tyre gjuhësor në video është llokoçitë herë-mbas-here me elemente të gjuhës së *overt prestige*-it si *duke* edhe me plot rotacizma.

Duke u përqendruar në numrin e madh të portaleve në internet, vërejmë plot kryqëzime të formave hibride me shkallë të ndryshme dialekt/standard. Në një tjetër video[ii], përsoni që intervistohet është një grua e moshës së mesme në Shkodër, ku praktikat e saj gjuhësore shfaqin karakterizime të ngjashme, por ku janë përdorë më pak forma jo-standarde, që nuk është befasuese në bazë të studimeve ndër-gjuhësore sociolinguistike (shih Tagliamonte 2011). Vëreni jo-standardizmat në fjalën e saj të mëposhtme: *katërdhetë e katër* (krh. *dyzet e katër*), *nanqin(d) e nan* (krh. *nëntëqind e nëntë*), *kemi paraqitë* (krh. *kemi paraqitur*), *ka pasë* (krh. *ka pasur*), e kështu me radhë. Gjithashtu, po të merren parasysh tekstet e këngëve të postuara nëpër internet, shembuj të ngjashëm janë të panumurt, p.sh. *duke nejt* (Cyanide ft Rebel, Unikkatil) në *veq edhe i herë* dhe *duke punu* (Eroll Murati) në *Ah moj nënë*. Gjithashtu, në artikuj të ndryshëm të lajmeve në internet[iii], mjaft forma heteroglosike shpërfaqen, ku vetëm forma *duke punu,* përseritet shumë herë në një tekst fare të shkurtë. Më tej, kur përdoruesit shkruajnë komente në mediat sociale (p.sh. facebook), në mesin e platformave të tjera online[iv], praktikat destandardizuese gjithashtu janë edhe më të dukshme, sidomos integrimi i pjesores jo-standarde të shkurtë në mjedisë të shumta morfo-sintaksore, duke u përfshi edhe në paskajoren perifrazike, p.sh. *duke punu*, *duke lyp*, *duke kërku*, *paska than*, *don me i rujt*, *ish dasht me restauru*, *nuk kisha pushu*, *t'ish rrxu*, *me e rrxu*, *me promovu*, *për me pritë*, *kanë vlejtë me i pritë*; *me draftu*, e të tjera. Forma të ngjashme të heteroglosisë dominojnë edhe në blogje të shumta, ku vlen të veçohen shkrime nga gjuhetarë të shkolluar e të respektuar, si p.sh. nga Gazmend Bërlajolli, ku hibridizimi është i qëllimshëm; në të tilla raste elementet e ndryshme centrifugale, p.sh. *nji* (krh. *një*), vihen përbri formave centripedale me rotacizëm, p.sh. *qëndrueshmëri* (krh. *qëndrueshmëni*); neologjizmat, si. *risimet* (krh. *risi-të)* dhe *besojmat* (krh. *besimet*); dhe kod-nderthurjet, p.sh. *është kry* (krh. *është kryer*, *asht kry(e)*, shih. http://plisi.org/gjuhsi/standardi-gegnishtja/). Nga këta shembuj të mediave digjitale, pjesorja gege (sidomos ajo e shkurta) është e pranishme, në disa raste më shumë se të

tjerat. Gjithsesi, prania e dendur e këtyre formave mund të krijojë premisa të (ri)valorizimit duke i de-stigmatizuar ato.

Prej të dhënave nga korpusi i gjuhës shqipe[v], u kontstatuan shembuj të ngjashëm të formave rajonale dhe jo-standarde. Edhe pse disa përdorime me pjesore të shkurtë dolen, ishte e vështirë për të gjetë ndërtime të ndryshme hibride të paraqitura më lart, çka e ilustron tabela 2 (në fusnotën 6)[vi]. Në këtë korpus online, janë përfshi kryesisht materiale burimore të ShNjL-së/toskërishtes me një numër tepër të kufizuar të gegnishtes si dhe prej autorëve më të rinj bashkëkohor.

Kur karakteristika të tillë destandardizuese dhe diaglosike që përfshijnë elemente jo-standarde, penetrojnë (s'paku nga disa përdorues) në standard duke u shpërfaqë në fusha të ndryshme të shqipes, në agjensinë gjuhësore reflektohet kalimi i pushtetit gjuhësor, nga disa individë të zgjedhur në kullat e fildishta tek vetë shqipfolësit. Praktika të tilla gjuhësore lejojnë përdoruesit e gjuhës të "gjejnë zërin e tyre përmes shfrytëzimit, kontestimit dhe ri-theksimit të qëndrimeve ideologjike që shoqërojnë shenjat që përdorin" (Tagg 2016:59). D.m.th. kur folësit përdorin forma të tilla që ekspozojnë kryqëzime të ndryshme standard/dialekt, ofrojnë kritika metalinguistike duke gjeneruar bashkeshkrirje strukturash të rindertuara. Në hapësira të tilla gjuhësore "konfrontimi, me rrënjë në thellësi në të shprehurit e së kaluarës" (Deumert 2014:32), duke përfshi edhe "akt[e] kundershtuese," mund të kontribojë në krijimin e një sensi fuqizues (Tagg 2016:70), kur përdoren forma të standardizuara (riformuluara, ventrilokuizuara, imituara dhe shpesh të ngarkuara ideologjikisht), të cilat nënkuptojne padrejtësitë e ndryshme të përballuara prej shumë folësve për tu artikuluar me stilet dhe regjistrat e jo-standardit, sidomos duke pasë parasysh se "tensionet sociale dhe ideologjike mund të formësojnë...përdorimin e gjuhës" (Tagg 2016:70). Praktika të tilla gjuhësore në gjuhën shqipe që përfshijnë vendosjen krah për krah të këtyre regjistrave, shenjave dhe stileve divergjente mund të përbëjnë "zgjedhje nën-koshiente gjuhësore, si dhe performanca të qellimshme" (Tagg 2016:74), ku diversiteti gjuhësor në ndërveprimet njerëzore nuk është vetëm i qenësishëm, por gjithashtu edhe normë (79; Labov 1969:728 në Tagliamonte 2011:2).

Praktika të tilla gjuhësore mund të jenë kontribuese në zhvillimin e emancipimit të shqipes bashkëkohore që është në proces të përballjes me padrejtësitë gjuhësore të së shkuares. Hapjet e tilla emancipuese shpesh u mundësojnë njerëzve të margjinalizuar, pjesëmarrje aktive në zgjedhjet gjuhësore, duke përfshi variantet që u disfavorizuan dhe e humbën pozitën prestigjioze gjatë përzgjedhjes së kodeve në fazat fillestare të standardizimit (shih Lindgren 2013:13, Byron 1976, 1985). Në disa raste superioriteti i imponuar i standardit, dhe rezultati margjinalizues, veçanërisht i atyre që perdor(n)in format jo-standarde dhe rajonale - të tilla si rastet gjatë diglosisë ku

varianti standard monocentrik është ngritë në prestigj me koston e fshirjes së varieteteve të tjera konkuruese - kanë kontribuar në pafuqinë e konsiderueshme të shumë përdoruesve, praktikat gjuhesore të të cilëve nuk shfaqinin besnikëri ndaj normes së imponuar të standardit. Pra, forma të stigmatizuara më pare, mund të dalin në dritë, kur qëndrimet shoqërore ndaj kulturës së gjuhës standarde rishikohen në atë masë sa që format dikur-të palejuara, të gëzojnë statusin e ngritur, duke përfituar prestigj të lartë në sferat publike (Lindgren 2013:16). Lindgren-i (2013:17) thekson: "Çlirimi nga stigmatizimi i purizmit gjithashtu mund të jetë pjesë e një procesi emancipues të statusit të ulët...të varieteteve." Mbetjet e tendencave puriste të kultures hegjemoniste të gjuhës standarde, megjithatë, duhet të adresohen në mënyrë që format të çlirohen nga qendrimi dhe perceptimi shoqëror përçmues. Lindgren-i (2013: 25) shpjegon se emancipimi i tillë "inkurajon...ngritjen e pozitës së një...dialekti në kontekst me peshë të ndryshme...(King, 2011)," jo i rezervuar vetëm për sfera private, ku "procesi emancipues nuk është kthim në situatat e mëparëshme, por një proces që krijon diçka të re" (26) siç mund të shihet në (ri)vlerësimin e formave të stigmatizuara më parë, që janë vërejtur në raste të destandardizimit dhe diaglosisë. Ky proces i emancipimit gjuhësor lejon folësit e zakonshëm - jo vetem disa individë të zgjedhur e të izoluar nga realiteti i praktikave gjuhësore të përditshme - për të marrë një rol aktiv në zgjedhjet e gjuhës, duke përfshi këtu ndryshimet gjuhësore, ku strukturat alternative rajonale dhe jo-standarde mirëpriten në standard.

3.0 Konkluzione dhe drejtimet e ardhshme

Ngjashëm me atë që është vërejtë në gjuhë të tjera të kultivuara, duke përfshi të dy anët e Atlantikut (p.sh. anglishten dhe gjermanishten), tipare të ndryshme të destandardizimit dhe diaglosisë në shqip aktualisht po anashkalojnë strukturat hierarkike hegjemoniste dhe institucionet e epokës së kaluar. Megjithëse disa besojnë se diskutimet konstruktive në lidhje me nëse standardi aktual duhet të vazhdojë t'i nënshtrohet reformave të centralizuara apo jo, duke thënë se janë "bllokuar nga qendrimet e vjetra të pakapërcyeshme" (Bouchard 2012:57) të kulturës së gjuhës standarde, zgjedhjet gjuhësore prej folesve të përditshëm përherë e me shumë janë duke treguar se *mutacione* të gjuhës tashmë janë duke u zhvilluar; ndryshime të cilat janë duke u udhëhequr nga poshtë, nga vetë përdoruesit e shqipes. Ata, përdoruesit e gjuhës, janë vepruesit aktivë në ringjalljen e gjuhës, sidomos brezat e rinj, duke përfshi femrat, të cilat historikisht janë risimtare në ndryshimet gjuhësore (shih Tagliamonte 2011, Davies 2012:55, Clyne 1991:455, 459). Byron-i (1985:83) parashikonte së rrethanat socio-politike të shqipes standarde në peisazhe të ndryshme gjuhësore, duke

përfshi hapsirat ku shërben si variant endoglosik, priten divergjenca gjuhësore, siç pasqyrohet në praktikat e tanishme të përdorimit të përditshëm të folësve shqiptarë. Në vend që forma të tilla të ndryshme të shihen si devijime që duhen korrigjuar në mënyrë që të jenë plotësisht në përputhje me ShNjL-në e vitit 1972, duhen pa thjesht si përqafim i formave diaglosike prej pjesës më e madhe të përdoruesve shqipfolës.

Hetimet e ardhshme në lidhje me destandardizimin dhe tendencat diaglosike në gjuhën shqipe mund të përqendrohen në qasjen e mëtejme në kahjen variacioniste, duke përdorë analizën e ndryshueshmërisë kuantitative (shih, p.sh. Tagliamonte 2011) për të hetuar më tej praninë e pjesores gege, duke e përfshi në standard: si në a.) ndërtimin e përcjellores (p.sh. *duke*/tue *lexu*(*e*/*ar*); *duke*/*tue dalë*), b.) paskajoren perifrazike (p.sh. *me lexu*(*e*), krh. *për të lexu*(*e*/*ar*), *të lexoj*; *me dalë*, krh *për të dalë*, *të dal*), dhe c.) kohën e ardhme (p.sh. *kam me shku*(*e*/*ar*), krh. *do të shkoj*), ndër të tjera, duke përdorë korpuse nga rrjete të ndryshme, të shumëllojshmërisë së stileve, regjistrave, dhe varianteve (me shkallë të ndryshme të (in)formalitetit) nëpër periudha të ndryshme kohore, si dhe mënyrat e llojllojshme të komunikimit (p.sh. në të folme dhe të shkruar, pa përjashtuar komunikimet digjitale, shih, Tagg 2016:80). Përqendrimi në studimet e sasiprurjeve-informuese do të mundësojë pamje më të saktë të thelbit dhe për të mbështetë heterogjenitetin e strukturuar të të dhënave të variablave sociolinguistik në shqyrtim, veçanërisht kur të folmet si dhe platformat e reja të medias, me gjasë, po ecin me hapa shumë më të shpejtë se ato tradicionale, duke shërbyer si pararojë e mundshme e ndryshimeve evolutive gjuhësore (për gjeneratat) në progres në lidhje me difuzionin, përvetësimin dhe (ri)forcimin sociolektor të formave jo-standarde dhe rajonale. Gjithashtu, përdorimi i elementeve gjuhësore nga femrat që aplikojnë thjeshtimin (p.sh. monoftongizimin në pjesore, e cila në bazë të teksteve të shkruara është shfaqur që në fillim të shekullit të 18-të, shih Topalli 2005:71), së bashku me hibridizimin (p.sh. *duke shkru*) mund të paraprijë dobishëm në çlirimin e këtyre formave të stigmatizuara (shih Tagliamonte 2011:63), duke kontribuar kështu në (ri)vlersimin e tyre.

4.0 Referenca

AGHA, ASIF. 2007. *Language and social relations*. Cambridge: Cambridge University Press.

ARMSTRONG, NIGEL, and IAN E MACKENZIE. 2013. *Standardization, ideology, and linguistics*. Basinstoke: Palgrave Macmillan.

AUER, PETER. 2005. Europe's sociolinguistic unity, or: A typology of European dialect/standard constellations. *Trends in Linguistics. Studies and Monographs [TiLSM]: Perspectives on variation: Sociolinguistic, historical, comparative*, ed. by Nicole

Delbecque, van der Auwera Johan, and Dirk Geeraerts, 7–42. Berlin/Boston, DE: De Gruyter Mouton.

BLACKLEDGE, ADRIAN, and ANGELA CREESE (eds.). 2014. *Heteroglossia as practice and pedagogy*. Dordecht: Springer.

BOUCHARD, GÉRARD. 2012. Collective destigmatization and emancipation through language in 1960s Quebec. *Du Bois Review* 9.1.51–66.

BYRON, JANET LEOTHA. 1976. *Selection among alternatives in language standardization: The case of Albanian*. The Hague: Mouton.

BYRON, JANET LEOTHA. 1985. An overview of language planning achievements among the Albanians of Yugoslavia. *International Journal of the Sociology of Language* 52.93–109.

CAMAJ, MARTIN. 1984. *Albanian grammar*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz.

CAMERON, DEBORAH. 1995. *Verbal hygiene*. London: Routledge.

CIPO, KOSTAQ; EQREM ÇABEJ; MAHIR DOMI; ANTON KRAJNI; dhe OSMAN MYDERRIZI. 2005 [1954].

Fjalori i gjuhës shqipe. Tiranë: Çabej.

CLYNE, MICHAEL, 1991. Epilogue. *Contributions to the Sociology of Language [CSL]: Pluricentric languages: Differing norms in different Nations*, ed. by Michael Clyne, 455–465. Berlin/Boston, DE: De Gruyter Mouton.

ÇABEJ, EQREM. 1968. *Meshari i Gjon Buzukut (1555): Botim kritik*. Tiranë: Universiteti shtetëror i Tiranës Instituti i Historisë e i Gjuhësisë.

DAVIES, WINIFRED V. 2012. Myths we live and speak by: Ways of imagining and managing language and languages. *Standard languages and multilingualism in European history*, ed. by Matthias Hüning, Ulrike Vogl, and Olivier Moliner. 45–69. Amsterdam, NLD: John Benjamins Publishing Company.

DEUMERT, ANA. 2014. The performance of a ludic self on social network(ing) sites. *The language of social media: Identity and community on the internet*, ed. by Philip Seargeant and Caroline Tagg, 23–45. Basingstoke, U.K.: Palgrave Macmillan.

DEUMERT, ANA. 2010. Imbodela zamakhumsha – reflections on standardization and destandardization. *Multilingua* 29.243–264.

DEUMERT, ANA. 2003. Bringing speakers back in? Epistemological reflections on speaker-oriented explanations of language change. *Language Sciences* 25.15–76.

DEUMERT, ANA and WIM VANDENBUSSCHE. 2003. Standard languages: Taxonomies and histories.

Germanic standardizations: Past to present, ed. by Ana Deumert and Wim Vandenbussche, 1–14. Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. 1973. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së

Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.

ELSIE, ROBERT. 1995. History of Albanian literature UNESCO Collection of Representative Works European Series. Social Science Mongraphs. 2 vols. New York: Columbia University Press.

ELSPAß, STEPHAN. 2007. A twofold view 'from below': Perspectives on language histories and language historiographies. *Studia Linguistica Germanica: Germanic language histories 'from below' (1700-2000)*, ed. by Stephan Elspaß, Nils Langer, and Joachim Scharloth, 3–9. Boston, US: De Gruyter, 2007.

EVERHART, EDWIN KEELY. 2013 *Dialect Valorization and Language Shift in Northern Japan* University of California, Los Angeles Master's Thesis. Ann Arbor: ProQuest.

FISCHER, ROSWITHA. 2007. To boldly split the infinitive – or not? Prescriptive traditions and current English usage. *Studia Linguistica Germanica: Germanic language histories 'from below' (1700-2000)*, ed. by Stephan Elspaß, Nils Langer, and Joachim Scharloth, 259–273. Berlin/Boston, US: De Gruyter.

GASHI, SHKËLZEN. 2010. *Gjuha e këputun e shqipes: Përmbledhje intervistash mbi mundësinë e hapjes së shqipes standarde*. Prishtine: Rokullia.

HELLER, MONICA. 2008. Language and the nation-state: Challenges to sociolinguistic theory and practice. *Journal of Sociolinguistics* 12.4.504–524.

ISMAJLI, REXHEP. 2005. *Drejtshkrimet e shqipes*. Pristinë: Akademie e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letersisë (Libri 29).

KOSTALLARI, ANDROKOLI (red.). 1984 *Fjalor i shqipes së sotme*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe i Letersisë.

LEPPÄNEN, SIRPA; ANNE PITKÄNEN-HUHTA; ARJA PIIRAINEN-MARSH; TARJA NIKULA; and SAIJA

PEUROEN. 2009. Young people's translocal new media uses: A multiperspective analysis of language choice and heteroglossia. *Journal of Computer-Mediated Communication* 14.1080–1107.

LINDGREN, ANNA-RIITTA. 2013. What is language emancipation? Norwegian and other Nordic experiences. *Sociolinguistic Studies* 7.1.11–32.

LOFTI, SAYAHI. 2007. Diglossia and contact-induced language change. *International Journal of Multilingualism* 4.1.38–51.

LÜDI, GEORGES. 2012. Traces of monolingual and plurilingual ideologies in the history of language policies in France*. *Standard languages and multilingualism in European history*, ed. by Matthias Hüning, Ulrike Vogl, and Olivier Moliner, 206–230. Amsterdam, NLD: John Benjamins Publishing Company.

MANN, STUART E. 1932. A short Albanian grammar. London, UK: David Nutt.

MANN, STUART E. 1957. An English-Albanian dictionary. Cambridge, UK: Cambridge University Press.

MILROY, JAMES, and LESLEY MILROY. 2012. *Authority in language: Investigating Standard English* (4th ed.). Florence, Ky: Routledge.

NEWMARK, LEONARD. 1999. Albanian-English dictionary. New York, NY: Oxford University Press.

NEWMARK, LEONARD; PHILLIP HUBBARD; and PETER PRIFTI. 1982. Standard Albanian: A reference grammar for students. Stanford, CA: Stanford University Press.

OSMANI, TOMOR. 1999. *Udha e shkronjave shqipe: Histori e alphabetit*. Shkodër: Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi Sektor Shkencor i Albanologjisë.

OTSUJI, EMI, and ALASTAIR PENNYCOOK. 2010. Metrolingualism: Fixity, fluidity and language in flux. *International Journal of Multilingualism* 7.3.240–54.

PENNYCOOK, ALASTAIR. 1998. The right to language: Towards a situated ethics of language possibilities. *Language Sciences* 20.1.73–87.

PENNYCOOK, ALASTAIR. 2010. *Language as a local practice*. London: Routledge.

RICENTO, THOMAS. 2000. Historical and theoretical perspectives in language policy and planning. *Journal of Sociolinguistics* 4.2.196–213.

RIZA, SELMAN. 2002. *Vepra 3*. Prishtinë: Akademie e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letersisë (Libri 19).

RUTTEN, GIJSBERT. 2016. Historicizing diaglossia. *Journal of Sociolinguistics* 20.1.6–30.

SHEPERI, ILIA DILO. 2001 [1927]. *Grammatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe: Sidomos e toskënishtes*. Tiranë: Albin.

SHOHAMY, ELENA. 2006. *Language policy: Hidden agendas and new approaches*. New York, NY: Routledge.

TAGG, CAROLINE. 2016. Heteroglossia in text-messaging: Performing identity and negotiating relationships in the digital age. *Journal of Sociolinguistics*. 21.1.59–85.

TAGLIAMONTE, SALI, A. 2011. Language in society: Variationist sociolinguistics: Change, observation, interpretation. Hoboken, GB: Wiley-Blackwell.

TOPALLI, KOLEC. 2005. *Bazat e foetikës historike të gjuhës shqipe*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.

TRIX, FRANCES. 1997. Alphabet conflict in the Balkans: Albanian and the Congress of Monastir. *International Journal of the Sociology of Language*, 128.1–23.

WOOLARD, KATHRYN A., and BAMBI B. SCHIEFFELIN. 1994. Language ideology. *Annual Review of Anthropology* 23.55–82.

Julie KOLGJINI

COMPETING (RE)VALORIZATIONS OF FORMERLY STIGMATIZED FORMS: THE CASE OF AN EMANCIPATED CONTEMPORARY ALBANIAN

Abstract

Various usage-based languagetendencies that surface in daily interactions are often considered (un)felicitous language choices that shapeand reflect language change and evolution. Similar to other vibrant languages in constant states of development, the dynamic language practices of Albanian languagers must alsobe considered, particularly regarding what constitutes legitimate linguistic elements worthy of being employed in multiple public and private domains.The current multifaceted linguascapes of Albanian, includingtraditional and new mediaas well as spoken utterances, provide numerous illustrations of competing valorizations of linguistic arrangements (see Agha,2007), particularly given the diversity of constructions in the various (sub)varieties of the language (Byron, 1976). While some of these competing forms represent(in)complete and fractured (dis)alignmentswith the current standard (Unified Literary Albanian), others containrecycled components from previous standards.When employing such alternative linguistic trajectories through meshing an expansive array of semiotic and polycentric mechanisms, such as codecrossing (e.g. *duke punu*; see Morina in Gashi, 2010), many languagers endeavor to produce authentic representations of self and the other. This paper focuses on how current evolutionary processes in Albanian appear to tolerate the coexistence of such transhistorical, truncated, and translocal elementsin the linguistic ecosystem, where rather thanacquiescing to strict allegiance to standard language ideology of bygone eras, ULA is often sidelined, thereby presenting a green light to languagers to embrace their agentive roles as active participants in shaping and emancipating the language (see Lindgren, 2013), as is observed invarious diaglossic repertoires exhibiting destandardizationtendencies, including in contemporary Europe (Rutten, 2016).

Key words: Albanian, language ideology, heteroglossia, codemeshing, diaglossic repertoires, destandardization

[i] Video 1: "Ora 7 - Rron Çena, krijues i printerit 3D 'Formon Core' - Klan Kosova" (youtube) https://www.youtube.com/watch?v=LrM_CgZ6QHE. Shembujt e dhënë nuk janë shterues, por vetëm ilustrime të disa formave të ndryshme gjuhësore që u shfaqen në video.

Tabela 1: Shembuj të ndryshëm të pjesores së jashte-standardit në kontekste të ndryshme (Video 1, i ftuari)

paskajorja	**percjellorja**	**koha e kryer**	**koha e ardhme (**domosdoshmëri**)**
me punu (1:30)	*duke ngritë* (1:00)	*kemi renovu*	*keni me pa* (12:27)
me desajnu (2:32)	*duke pa* (4:27)	*kemi vujtë* (10:23-4)	*ka me bo* (12:30)
me fokusu		*kena marrë* (11:32)	
me funksionu (2:34)		*kena shfrytzu* (11:33)	
me thjeshtu		*kemi marrë* (11:40)	

Shih dhe Videot nga Hoxhë Enver Azizi, e.g. **"**Dëgjoj Kuran me iPhone rrugëve, në autobus, duke shku në shkollë" (09/03/2013) dhe "Pse nuk falesh (Jemi duke punu - Jemi duke mbajtë familje)," respektivisht. Intervistuesi: *duke shku*; Hoxhë Enver Azizi: *duke ecë, duke bazu*, *duke udhëtu*, *duke ndejtë*, *kena pa*, *duke udhëtu*, *duke marrë*, *duke u falë*; *duke punu*, etj. Shih edhe: VIDEOLAJM/Rama: "Nuk më ka shku mendja me u feju, as me marr një ulqinake."

[ii] Video 2: Ekspozitë e abetareve të gjuhës shqipe http://www.zeriamerikes.com/a/ekspozite-e-abetareve-te-gjuhet-shqipe-/3307006.html. Shembujt e dhënë nuk janë shterues, por vetëm ilustrime të disa formave të ndryshme gjuhësore që u shfaqen në video.

[iii] http://www.gazetaexpress.com/lajme/shpend-ahmeti-deri-tani-ka-punesuar-50-persona-me-kontrata-mbi-veper-thote-hamiti (05 /11/14). Marrë prej një citimi nga kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti; http://ferizajpress.com/bahtiri-durimit-ti-vij-fundi/ (20/06/14). Marrë prej një citimi nga kryetari i Mitrovicë, Agim Bahtiri;
http://www.kosovapress.com/sq/arsim/mijera-te-papune-me-bachelor-e-master-32478/ (04/01/2015). Argumentet e marra nga një citim i drejtores së arsimit të lartë të MASHT-it, Drita Kadriu; http://botapress.info/beatrisa-pista-demiri-paralajmeron-se-hetuesit-jane-afer-zbardhjes-se-vrasjes-se-elvisit-video/ (23/03/16). Bisedë e marrë nga Pista-Demiri.

[iv] http://forumi.iphonealbania.net/problem-me-wifi-ne-6-1-3-td5003093.html;
http://kekompjuter.blogspot.com/2012/02/shkarko-lojra-me-utorrent.html

[v] http://web-corpora.net/AlbanianCorpus/search/?interface_language=sq.

[vi] Tabela 2: Numri i shembujve të përzgjedhur të pjesores (ShNjL/toskërishte, gegnishte) në kontekste të ndryshme nga KGjSh-ja (korpusi i gjuhës shqipe)

format pjesore		**n**		**n**		**n**		**n**		**n**
	shkruar	3,295	*punuar*	2,424	*shkruar*	3,295	*kthyer*	3,099	*qenë*	22,523
	shkue	61	*punue*	28	*shkrue*	41	*kthye*[vi]	22	-------	22,523
	shku	47	*punu*	17	*Shkru*	3	*kthy*	1	-------	22,523
paskajore	*me shkue*	42	*me punue*	23	*me shkrue*	28	*me kthye*	20	*me qenë*	202
	me shku	22	*me punu*	12	*me shkru*	1	*me kthy*	1	------- -	-

percjellore	*duke shkuar*	229	*duke punuar*	526	*duke shkruar*	117	*duke kthyer*	326	*duke qenë*	1,468
	tue shkue	1	*tue punue*	1	*tue shkru(e)*	0	*tue kthy(e)*	0	*tue qenë*	7
	duke shku(e)	0	*duke punu(e)*	0	*duke shkru(e)*	0	*duke kthye*	2	*duke qenë*	1,468
pjesore	*dalur*	98	*pasur*	11,326	*Gjetur*	3,600	*pritur*	2,092	*bërë*	36,068
	dalë	5,139	*pasë*	301	*Gjetë*	50	*pritë*	166	*ba*[vi]	122
paskajore	*me dalë*	128	*me pasë*	83	*me gjetë*	21	*me pritë*	16	*me ba*	113
	--------	-	--------	-	--------	-	--------	-	-------	-
percjellore	*duke dalur*	4	*duke pasur*	1,059	*duke gjetur*	95	*duke pritur*	406	*duke bërë*	2,207
	tue dalë	0	*tue pasë*	12	*tue gjetë*	0	*tue pritë*	2	*tue ba*	9
	duke dalë	178	*duke pasë*	7	*duke gjetë*	0	*duke pritë*	1	*duke ba*	0

Anila ÇEPANI

ANALIZË GJUHËSORE E SHQIPES SË PËRDORUR NË RRJETET SOCIALE, RASTI I FACEBOOK-ut

Hyrje

Prania e internetit ka shpalosur një platformë të re të komunikimit duke luajtur një rol të rëndësishëm në jetën moderne të qenies njerëzore. Njerëzit në të gjitha anët e botës komunikojnë më shumë me anë të rrjeteve sociale të tilla si Facebook (FB), Twitter, Instagram, Mesazhimi i çastit (Instant Messaging - IM), Skype, E-mail dhe Dhoma bisedash (chat-room), si një mënyrë më e shpejtë, më e lehtë dhe më e përshtatshme. Këto mënyra të reja komunikimi, të cilat studiuesit i emërtojnë me termin *Computer Mediated Communication - CMC* (komunikim i ndërmjetësuar nga kompjuteri), kanë ndryshuar mënyrën se si e përdorim gjuhën, duke mundësuar forma të reja të ligjërimit me karakteristika të dallueshme. CMC-ja është përkufizuar si një proces i komunikimit njerëzor që realizohet përmes përdorimit të një ose më shumë pajisjeve elektronike të lidhura në rrjet.

Në thelb CMC-ja mund të ndahet në dy kategori kryesore: komunikimi sinkron dhe komunikimi asinkron. Komunikimi sinkron përfshin përdoruesit që shkëmbejnë ide e opinione në kohë reale përmes dhomave të bisedës (chat room), mesazhuesve të çastit (instant messengers) ose videokonferencave (video conferencing). Pjesëmarrësit në komunikime të tilla postojnë mesazhe të shkruara, të cilat shfaqen në ekranin e kompjuterit dhe vetëm mund të lëvizin poshtë e lart në dritaren dialoguese për të parë çfarë është shkruar më parë, pa pasur mundësi që ta ndryshojnë atë. Ndërkohë që në komunikimin asinkron, të tillë si *e-mail, blogjet në ueb, rrjete sociale* etj. ndërveprimi nuk ka nevojë të jetë i njëkohshëm. Përdoruesit kanë më shumë kohë për të kuptuar, reflektuar dhe për t'iu përgjigjur me shkrim mesazheve ose komenteve të postuara.

Fjalë kyç: *rrjet social, komunikim virtual, fjalëformim, morfosintaksë, tipare prozodike*

Objekti i kumtesës

Komunikimi sinkron dhe asinkron ndeshet në një nga faqet më të njohura të rrjeteve sociale, Facebook-u. Ai është përdorur si mjet i ndërveprimit social ku njerëzit nga vende e kultura të ndryshme përbashkojnë informacione, interesa dhe aktivitete që i lidhin ata në jetën sociale. Përdoruesit të cilët krijojnë komunitetin në Facebook janë të prirur të kenë mënyrën e tyre për të shprehur idetë dhe mendimet ku gjuha përbën kodin kryesor që u shërben për të përcjellë atë që ata kanë për qëllim të thonë. Në këtë lloj komunikimi virtual nëpërmjet internetit, në përputhje me kontekstin e veçantë, përdoruesit shfrytëzojnë forma dhe veçori gjuhësore që janë të ngjashme si me gjuhën e folur, dhe me atë të shkruar.

Kjo kumtesë synon të shqyrtojë disa nga këto veçori gjuhësore, si tiparet prozodike të gjuhës së folur (intonacioni, ritmi dhe theksi) me anë të të cilave përdoruesit përcjellin gjendjet e ndryshme emocionale; shenjat e ndryshme të pikësimit; përdorimin e shkronjës së madhe; proceset e ndryshme fjalëformuese, si shkurtimet, shkurtesat, kombinimet e shkronjave dhe të numrave, emotikonat etj.; elemente morfosintaksore; llojet e fjalive etj.

Ndryshe nga komunikimi në dhomën e bisedave që përbën komunikimin sinkron në Facebook, në komentet dhe postimet (komunikimi asinkron) autori dhe lexuesi mund të jenë në kohë të ndryshme dhe kanë mundësi ta rishohin atë që kanë shkruar si nga ana përmbajtësore, ashtu edhe nga ana gjuhësore duke treguar kështu më shumë kujdes. Nisur nga ky fakt mund të ngremë hipotezën se gjuha e përdorur në komente dhe postime është më formale dhe më e kujdesshme se gjuha e përdorur në dhomat e bisedës.

Korpusi dhe metodologjia

Korpusin e të dhënave për analizën tonë e përbëjnë postimet dhe komentet në Facebook nga përdorues të ndryshëm, i cili është krijuar me anë të aplikacionit të posaçëm *Post and Comments Extractor V1.0*. Ky aplikacion bën të mundur mbledhjen e të gjitha komenteve dhe postimeve të përdoruesve në një skedar Excel-i për një kohë shumë të shkurtër. Sasia e të dhënave është shumë e madhe, gjë që i bën edhe më të besueshme rezultatet e analizës sonë.

Pjesë e korpusit janë edhe fragmente bisedash në dhomën e bisedave në Facebook, të cilat janë siguruar duke shfrytëzuar komandën në Facebook që ofron shkarkimin e një kopjeje të të dhënave për secilin përdorues. Përveç të dhënave personale në këtë kopje të ruajtur si arkiv janë të regjistruara në një skedar të veçantë

të gjitha bisedat e realizuara midis përdoruesit dhe shokëve të tij. Ruajtja e të dhënave në një kopje arkivi është pjesë e privatësisë së përdoruesit, ndaj iu kërkua në mirëbesim disa vullnetarëve që të vinin mesazhet e tyre personale në shërbim për analizën tonë gjuhësore.

E gjithë baza e të dhënave të krijuar u fut në programin e konkordancës, me anë të të cilit u bënë analiza statistikore për shpeshtësinë e përdorimit të elementeve të ndryshme karakteristike në komunikimin në rrjete sociale e kryesisht në Facebook

Një element i rëndësishëm i analizës sonë gjuhësore është pyetësori i realizuar me pyetje rreth disa çështjeve të përgjithshme në lidhje me përdorimin e Facebook-ut dhe pyetje specifike për gjuhën e përdorur në Facebook. Ky pyetësor u plotësua nga 80 subjekte që u përkisnin moshave dhe statuseve të ndryshme sociale, kulturore e gjinore. Me anë të programit për statistikat *IBM SPSS Statistics 21.0* u analizuan të dhënat e pyetësorit dhe u bë interpretimi i tyre që shërbeu në nxjerrjen e disa përfundimeve.

Analiza e të dhënave

Në komunikimin ballë për ballë (Face to Face - FTF), bashkëbiseduesit përdorin një gamë të larmishme të strategjive komunikuese për të përcjellë idetë dhe mendimet e tyre. Por ndryshe ndodh në komunikimin nëpërmjet pajisjeve kompjuterike, ku për shkak të mungesës së kontekstit social orientues (bashkëbiseduesit nuk mund të ndjejnë dhe të shohin shprehjet e fytyrës së të tjerëve, gjestet, intonacionin e zërit, tonin, ritmin, pamjen etj.), është e vështirë të interpretohen deklarata të ndryshme dhe të jepen përgjigje të drejta në lidhje me to duke u bazuar vetëm në informacionin gjuhësor dhe paragjuhësor që u parashtrohet. Shpesh për të përshpejtuar shkëmbimin e informacionit, bashkëbiseduesit vënë në përdorim shkurtime dhe elemente grafike e prozodike për të shprehur e përcjellë fjalë, shprehje dhe emocione të ndryshme. Po ashtu fjalitë e përdorura janë të shkurtra, shpesh me mungesën e një ose disa gjymtyrëve kryesore apo të dyta. Pra, tekstet e shkruara, qoftë si postime e komente, qoftë si pjesë e mesazheve në dhomat e bisedave, janë amalgamë e fjalëve aktuale me akronime, shkurtesa, shkurtime, modifikime, elipsa, zhvendosjen e përbërësve nga pozicionet e tyre sintaksore etj. karakteristikë dalluese këto i këtij lloj komunikimi.

I. Elemente prozodike

Njësitë prozodike theksi, tonet, ritmi, kuantiteti *dhe* intonacioni *me përbërësit e tij, janë elemente të rëndësishme të gjuhës së folur, të cilat në të shkruar zëvendësohen me konvencione ortografike si shenjat e pikësimit (presje, pikëpresje, pikëpyetje etj.) dhe stilizimet tipografike për theksim (trashëzim, pjerrëzim, nënvizim). Këto elemente prozodike formojnë një pjesë integrale të ndërveprimeve tona sociale, sepse reflektojnë tipare të ndryshme të folësit dhe të fjalisë, si gjendjen emocionale, praninë e ironisë, sarkazmës, llojet e fjalisë, tipare të cilat nuk vihen në dukje vetëm me zgjedhjen e fjalëve. Përdoruesit e Facebook-ut, përveç konvencioneve të mësipërme, përdorin strategji të veçanta, mënyra të reja tekstuale, si përsëritjen e pikësimit, përsëritjen e fjalëve, zanoreve ose bashkëtingëlloreve, emotikonat, zëvendësimin e fjalëve ose të një pjese fjale me simbole të ndryshme ose numra, germat kapitale në mes të fjalëve ose në të gjithë fjalën, në mënyrë që të ndërveprojnë midis tyre dhe të përcjellin përjetime të ndryshme emocionale.*

Shenja pikësimi të përsëritura

Tradicionalisht, shenjat e pikësimit janë parë si shenja gramatikore që përdoren në shkrim për të ndarë fjalitë a pjesët e një fjalie, për të shënuar ndalesa gjatë leximit dhe anë të tjera të ligjërimit që nuk mund të jepen me anë të shkronjave. Në bazën e të dhënave të krijuar prej nesh, por dhe nga rezultatet e pyetësorit, shenjat e ndryshme të pikësimit nuk janë përdorur vetëm për këtë qëllim; rregullat e përdorimit të tyre janë modifikuar nga përdoruesit për të realizuar nevojat e komunikimit. Me anë të përsëritjes së shenjave të pikësimit, bashkëbiseduesit arrijnë të shprehin elemente të ndryshme prozodike si një mënyrë për të kompensuar mungesën e gjesteve të fytyrës, gjuhën e trupit dhe rrethana të tjera kontekstuale të hasura zakonisht në një bisedë ballë për ballë. Më shpesh ndeshet përsëritja e pikëpyetjes, pikëçuditjes dhe pikës, hera-herës të alternuara me njëra-tjetrën.

Përdorimi i disa pikëpyetjeve rresht shfaq ngulmimin e përdoruesit për të përforcuar pyetjen e tij:

– Bukur me selfie-n! U kenaqet? Udherrefyesi ne krye te detyres ee😉.

– Udherrefyesi ne krye te detyres, por edhe prapavija nuk te ka faj,por embelsiren ku e kini ????

Por në komentin:

– Po prepotencen, Nga e kuptoi kjo ???? Apo gili vili kjo.....

bashkëbiseduesi përdor 4 pikëpyetje për të shprehur ndjenjën e ironisë dhe disa pika për të treguar vazhdimësinë e ironisë së tij.

Kur biseda bëhet e pakuptueshme, bashkëbiseduesi, në vend të pyetjes me fjalë, zgjedh të vendosë disa pikëpyetje rresht:

– A te thash qe nuk punon instalusi

– ??????????

– lol???

Shpesh përsëritja e pikëpyetjes ose e pikëçuditjes ndeshet për t'i tërhequr vëmendjen bashkëbiseduesit i cili nuk është aktiv në bisedë:

– Si jeni???

– o erlaaaaaa?????????

Shpeshherë pikëpyetjet e përsëritura shoqërohen nga pikëçuditje të përsëritura për të përforcuar ndjenjën e habisë, si më poshtë:

– Kjo esht mace jo qen…… Po Te ishte qen do e kisha frik 😆😆

– Frik nga qenet????!!!! Nga njerzit do te thuash.

Zakonisht pikëçuditja përsëritet në rastet e urimeve të ndryshme për të shprehur ndjenjën e kënaqësisë së veçantë ose të habisë:

– Une vdes per lobimet!!!! 😉

– Marshalla grupi. Fitore paçi ngahera!!! 😄😄😄

– I ke te dy si engjej fëmijët. Te pershendes !!!!!!!!!

– Ua sa mire, edhe ju qenkeni ne Tirane!!! ! Shpresoj te lidhemi ndonje dite e te flasim me gjate.

por edhe për shfaqur zhgënjimin ose pakënaqësinë e përdoruesit:

– Degjenerim masiv!!!:) Teksa po e lexoja mu nevrikos pitbulli po i shndrisin dhembet: me duket se po me kerkon adresen.....

– Po nvend qe tbeja kte I bera reset TE GJITH LAPTOPIT!!!!

Shumë shpesh është përdorur pika, por duke e kapërcyer funksionin e saj kryesor si tregues kryesisht i mbarimit të fjalisë, por në formë të përsëritur, për të treguar se përmbajtja e mesazhit vazhdon më tej, ose nuk është e lehtë për t'u shprehur nga bashkëbiseduesi, kështu që ai i lë kohë të mendojë e në të njëjtën kohë kërkon përfshirjen e tij emocionale me anë të përgjigjes në vazhdim:

– Ca historie....un rash ne tok fillova te bertisja....mir qe ste paska ber lapidar aty 😂😂*; un kam marr bllokun dhe po mbaj shenime:p*

– Shum e dhimbshme....Eshte tragjedi te humbesh nje njeriun tend te shtrejnt...cdo gje qe ke me te mbeten aty...je mesuar dhe e ke te veshtir ta pranosh qe ai nuk eshte me ka ikur...me vjen keq

Pra, përsëritja e tepruar e shenjave të pikësimit tregon shkallën e intensitetit të ndjesive për ato që po thuhen në bisedë. Sa më i madh numri i shenjave të pikësimit, aq më të forta janë përjetimet e bashkëbiseduesve. Kjo ka krijuar një stil të veçantë të të shkruarit dhe shërben si modë që të çon te sinjalet e komunikimit.

Zanore ose bashkëtingëllore të përsëritura

Një tjetër mënyrë për shprehjen e gjendjeve të ndryshme emocionale nga përdoruesit e Facebook-ut është përsëritja e zanoreve ose e bashkëtingëlloreve. Kjo ka të bëjë me përforcimin e ngarkesës emocionale të fjalëve me anë të theksit emocional, që realizohet kryesisht me zgjatjen e zanores së theksuar dhe me ngritjen e tonit themelor në atë zanore. Në mesazhet e shkruara kjo bëhet e dukshme duke e përsëritur disa herë të njëjtën zanore që spikatet nga theksi emocional. Sipas studimeve, theksi emocional në fjalët ose thëniet që shprehin emocione negative zakonisht realizohet me zgjatimin e bashkëtingëllores së parë të fjalës.

Nga të dhënat e korpusit tonë vihet re se përsëritja e disa zanoreve ose bashkëtingëlloreve të caktuara përdoren në mënyrë kreative në shumë situata për të shprehur qëndrimet emocionale, si lumturinë, gëzimin, zhgënjimin, mërzitjen etj. pa i dalluar në emocione negative apo pozitive.

– *Saaa bukurrr, nje dite dua tjem ne kto vende*

– *Ahahahhahaahhaha besojjjj ja ka vleejtur sado dukeen cmenduri esht bukur kur arrin ne ate qe deshiroon.*

– *Keshtu qeee me kembe ne toke se ne ket jettttt gjithckaa te rrin permbi koke dhe vjen nje dite qe ajo gjithckaaa te shembett edhe merr funddd kjo e gjithaa qe kishe.*

– *Te rekomandddddddoj nje vizite tek pesa se te ka zen semundja e selfies*

Përdoruesit e Facebook-ut përzgjedhin në mënyrë rastësore zanoren që përsëritin pa e menduar nëse kjo është zanorja e theksuar, ose, përveç bashkëtingëllores së parë, përsëritin edhe bashkëtingëllore në pozicione të tjera të fjalës.

– *Kete micken e logel, sa vjece e ke.. Me duket llastice kjo si vajzat e mia.. Ke dhe djaaaaleee tiiii, pooor vaajzat jaane me te miraaa.*

– *Sa bukkkkkkur paska ddddale mojjjjj!!!*

– *Me pelqqqqqqen optimizmi yt...me frymezon edhe mua.*

Për nga shpeshtësia, më shumë përsëriten zanoret sesa bashkëtingëlloret, sidomos në llojet e ndryshme të përshëndetjeve, urimeve dhe falënderimeve, ku, përveç fjalës që mbart domethënien e frazës dhe që ndodhet në pozicione të ndryshme, ndeshen me zanore të përsëritura edhe fjalët që ndodhen në fund.

– *Te peeershendes pas shuuuuume vitesh.*

– *Eee daaashuur po kuuu jeee.*

– *Shuuumë urime për botimin e libriiiiit!*

– *Shuuume nostalgji kaaam*

– *Rrooofsh e daaaashur.*

Nga të dhënat e pyetësorit na rezulton që përdoruesit përdorin më shpesh përsëritjen e pikësimit për të theksuar atë që duan të shprehin dhe pothuaj 10% më pak përdorin përsëritjen e germave të ndryshme. Vetëm 17.5% prej tyre përdorin të dyja mënyrat e theksimit.



Germa kapitale

Në komunikimin verbal folësit prodhojnë efekte të fuqishme duke ndryshuar melodinë, gjatësinë dhe forcën tingullore, ndërsa në të shkruar e arrijnë pjesërisht këtë edhe me anë të përdorimit të germave kapitale. Në korpusin e komenteve dhe të postimeve vihen re disa fjalë me germa të mëdha ose ndonjëherë i gjithë mesazhi. Kjo është një zgjedhje e bashkëbiseduesve për të vënë në pah fjalën që duan të theksojnë më tepër dhe për të rritur gjendje emocionale të tilla si gëzim, kënaqësi, neveri, frikë etj.

- Pamje mbresëlënëse e DASHURISË dhe PËRKUJDESJES së vëllait për motrën e vet të vogël!

- Nje foto shume e bukur kur keni marre titullin PRINDER me djalin bukurosh se e kam pik te dobet.

- KOMISIONI me i mire dhe shume korekt. Ju falenderojme per punen tuaj.

- ME JETE TE GJATE, TE JETE E LUMTUR DHE T'JU BEJE TE LUMTUR!

- ESHTE SI ENGJELL TE KETE JETEN E GJATE!

Përdoruesit zgjedhin të përdorin shkronja kapitale për shkak se ato janë vizualisht më të dallueshme në krahasim me shkronjat jokapitale dhe shprehin rritjen e intonacionit për të nxjerrë në pah fjalët që duan të theksojnë më shumë ose të gjithë

thënien. Germat e mëdha ndeshen në pozicione të ndryshme të thënies, në varësi të vendndodhjes së fjalës që mbart kuptimin e thënies së bashkëbiseduesit.

Pasthirrma emocionale

Mjaft të përdorshme dhe që zënë një vend të gjerë në të folurën e përditshme janë pasthirrmat emocionale që shprehin ndjime, ndjenja a vullnetin e folësit, por pa i emërtuar. Po ashtu ato përdoren dendur në mesazhet e Facebook-ut.

Bëhet fjalë këtu jo vetëm për pasthirrmat e parme që janë tinguj të veçantë, por dhe për grupe pasthirrmash jo të parme që formohen prej pjesësh të tjera të ligjëratës, të cilat, pa qenë gramatikalisht pasthirrma të mirëfillta, luajnë rolin e pasthirrmave. Këto të fundit përdoren shpeshherë me tingujt fundorë të përsëritur (*dreqqqqq, faleminderiiiiiit, mirupafshiiiiim, qyqjaaaa*).

– ***Hahahaah*** *sa sy lesh jan gazetaret* ***moreee***
– ***Aaa*** *sa bukur* ***aaa*** *mashallah:*)
– ***hahaaa*** *te e premtja calon puna:p te përqaputh o zemër.*
– ***Uaaaa*** *sa bukur.....dhe ky modeli i flokëve, që i shkoka kaq shumë*
– ***Obobooo****, keto kafshet... sa na pelqejne:*)

Siç shihet nga grafiku i mëposhtëm i realizuar me përgjigjet e subjekteve në pyetësor, pasthirrmat përdoren prej tyre kudo (komente, postime, bashkëbisedime) në gati 64%. Disa prej tyre diferencojnë përdorimin e pasthirrmave sipas llojit të mesazhit. Janë të paktë ata (5%) që përdorin pasthirrma vetëm në postime e komente dhe jo në bashkëbisedime në dritaren e dhomës së bisedave në Facebook (Messenger). Një pjesë e vogël e subjekteve (8.8%) nuk përdorin asnjë lloj pasthirrme në mesazhet e tyre. Nga këto të dhëna duket se pasthirrmat janë një element i rëndësishëm për përdoruesit që përshfaqin qëndrimet e tyre emocionale gjatë komunikimit në Facebook.



Disa nga pasthirrmat e ndeshura në mesazhe, një pjesë prej të cilave me variante të ndryshme duke përsëritur elementet e tyre përbërëse janë: *aaa, aaaah, aahhh, ahaha, ahahahah, ahh, ahhahahaa, aiii, allah, aman, amannnnn, apapaaaa, bahh, bobooo, bohhhh, boooh, braaaaaavo, bubu, eeeeee, eeeeeh, eeehhhh, eehhh, ëhhë, ehhhh, ehu, ehuuu, epoooo, gaga, haaa, hahaaa, hahah, hahahaah, hahahah, hahha, hahhahah, heeeeee, heyyyy, hihihi, hola la, iiiiiiiiiiii, marshalla, miiiiiiiiii, moooj, moooo, moreee, mwahahh, ncncnc, oboboooo, ohuu, ooooo, oreee, ouu, pahh, pfff, pupupu, te falaaaa, të lumtë, uaaa, uaauaaa, uauuuuu, ububu, uee, uffff, uheee, uhhh, uou, uuu, uuuuuuuuu, waa, wauuu, wehhh, wow, wowowowow, wuuuu, wwwwaaaaaawwwww, xaxa, xaxaxaxa, yeahhhhh, yyyy* etj.

Siç shihet edhe nga lista e pasthirrmave, për të dhënë sa më qartë intonacionin me të cilin shqiptohet pasthirrma, autorët dyfishojnë ose shumëfishojnë shkronjat e tingujve të një pasthirrme a një pasthirrmë të tërë dhe gjithashtu i shoqërojnë me shenjat të ndryshme pikësimi. Por megjithatë, vetëm në një shkallë të vogël pasqyrohen veçoritë e intonacionit të një pasthirrme dhe kjo duket me faktin se pavarësisht se disa prej këtyre pasthirrmave janë të përcaktuara për të shprehur *kënaqësi, entuziazëm, gëzim, admirim* e disa të tjera *dhimbje, keqardhje, pakënaqësi, habi, zemërim, frikë* etj. përdoruesit nuk e bëjnë këtë diferencim, por përdorin të njëjtën pasthirrmë për ndjesi të ndryshme.

Çdo gjuhë ka në përbërjen e saj pasthirrma që kuptohen e përdoren prej të gjithëve, por në komente e postime vihet re që nuk huazohen vetëm fjalët nga gjuhët e tjera, por edhe pasthirrmat, si në shembujt:

– ***Wowowowow*** *goca sa bukur...:)))*
– ***xaxaxaxa*** *ca thu mi...mallengjoke veten*
– ***Wehhh*** *si neper filmaa qfar dashuriee* 😍😝😝
– *Ke të drejtë bejbi,* ***yeahhhhh***
– *Sa mama e zonja, paske arritur ta vesh ne krevat,* ***braaaaaavo***
– ***uauuuuu****, sa bukur paske dale dreq:)))*
– ***Wuuuu*** *moj e kozmait po ne ty te kemi si cupen ton....*
– ***wwwwaaaaaawwwww****, lere qenin moj vajzë por shiko rrugën ku kalon*

II. Elemente takografike (tachography) dhe morfosintaksore

Elemente takografike

Takografia (nga greqishtja ταχύ - i shpejtë dhe γραφή - shkrim) është, në përgjithësi, arti i të shkruarit shpejt duke përdorur shkurtime, shkurtesa dhe shenja konvencionale. Elementet takografike janë përdorur gjerësisht në mesazhet telefonike dhe mesazhimet e çastit (msn hotmail, yahoo messenger etj.). Për shkak të kufizimit kohor dhe hapësinor (teksti i një sms-je duhet të ishte afërsisht 160 karaktere), bashkëbiseduesit ishin të detyruar të gjenin mënyra të reja për të shkëmbyer sa më shumë informacion në një mesazh duke përdorur shkurtime fjalësh me anë të heqjes së disa germave ose kombinimit të germave dhe shifrave. Kufizimet teknike të teksteve të mesazheve kanë çuar në zhvillimin e formave të shkurtuara të fjalëve dhe shprehjeve të cilat përdoren gjerësisht edhe në ditët e sotme në rrjetet sociale, pavarësisht se këto kufizime janë minimizuar ose pothuaj nuk ekzistojnë fare. Madje këta përdorues i kanë zhvilluar edhe më tej këto forma të shkurtuara të komunikimit duke i kombinuar edhe me simbole e shenja grafike konvencionale në vend të fjalëve përkatëse. Në ndihmë u vjen anglishtja, që me përdorimin e saj masiv në dhomat e bisedave në mbarë botën, ka propozuar gjithmonë zgjidhje, që janë përvetësuar menjëherë nga gjuhët e tjera.

Në korpusin tonë janë ndeshur të gjitha mënyrat e shkëmbimit të informacionit nga përdoruesit e Facebook-ut në mënyrë të shpejtë dhe të shkurtër, siç janë emotikonat, logogramet, shkurtimet, shkurtesat apo akronimet.

Emotikona

Sipas fjalorit të Oksfordit, emotikoni është përfaqësim i një shprehjeje të fytyrës (p.sh. *buzëqeshje* apo *ngrysje* etj.), krijuar nga kombinime të ndryshme të karaktereve të

tastierës që përdoret në komunikimet elektronike për të përcjellë ndjenjat e përdoruesit. Dallimi midis dialogëve verbalë dhe komunikimit në internet qëndron në faktin se kur shkruajmë, në mungesë të intonacionit, nuk mund t'i shprehim qëndrimet emocionale dhe kështu mesazhet mund të jenë të dykuptimshme ose të paqarta. Funksioni i emotikonave ose të quajtura ndryshe 'smileys' është mënjanimi i paqartësisë duke kombinuar shenja të ndryshme pikësimi me karaktere dhe shifra për të krijuar imazhe të fytyrës që shprehin ndjenja të larmishme si *lumturi, trishtim, habi, frikë* e shumë të tjera. Emotikonat i përkasin kategorisë së piktogrameve, që do të thotë se shenja grafike paraqet vizualisht konceptin ose informacionin e shkëmbyer.

Sipas statistikave të përgjithshme, por edhe nga të dhënat e korpusit tonë, si dhe nga përgjigjet e subjekteve në pyetësor, emotikonat janë elementet më të përdorura në Facebook.



Sipas grafikut, nga 80 subjekte që morën pjesë në pyetësor, 83.54% e tyre i përdorin emotikonat në komentet dhe postimet e tyre.

Efekti i tyre është i menjëhershëm sepse e shprehin qartë ndjesinë e bashkëbiseduesit, p.sh. nëse ai është i gëzuar, përdorimi i emotikonës  e përcjell drejtpërdrejt gëzimin te tjetri. Disa emotikona që shprehin gëzim, frikë, zemërim kanë frekuencë përdorimi më të madhe sesa emotikonat e tjera që janë të shumta në numër.

Logogramet

Një mënyrë tjetër për të shkëmbyer sa më shumë informacion në sa më pak kohë është përdorimi i logogrameve, të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e simboleve

ose germave të vetmuara për të përfaqësuar fjalën apo një pjesë të saj kur emërtimi i një simboli tingëllon ngjashëm me një rrokje të fjalës, si *x (për* ose *puthje), vër8 (vërtetë), me1herë (menjëherë), ça ka 3 (çfarë ka të re), l8er (later 'më vonë'), b4 (before 'para')* e shumë të tjera të cilat shpeshherë kombinohen me mënyra të tjera shkurtimesh duke u bërë pjesë e një akronimi siç do ta shohim më poshtë. Pra, është shqiptimi i simbolit ai që ka rëndësi në rastin e logogrameve dhe jo forma vizuale e tij dhe kjo e bën të dallueshëm logogramin nga emotikona në të cilën kuptimi është i lidhur ngushtësisht me formën e simbolit apo shenjës.

Në të dhënat tona kemi vënë re pak shembuj logogramesh me fjalë të shqipes, sepse përdoruesit përdorin më shumë logograme të fjalëve të anglishtes. Duke qenë se shqipja ka një sistem shkrimi që karakterizohet nga parimi fonetik, përdoruesit e saj në internet nuk kanë mundësi të përdorin germa të vetme shqiptimi i të cilave do të ngjasonte me një fjalë të plotë siç ndodh fjala vjen me anglishten ku shqiptimi i fjalëve *see* dhe *you* përkojnë me germat *c* dhe *u* dhe shprehja *see you later* mund të përfaqësohet nga logogrami *c u l8r*. Ndër simbolet që përdoren për të zëvendësuar një ose më shumë rrokje janë &, @ dhe disa numra, shqiptimi i të cilëve përkon me ndonjë fjalë ose pjesë fjale.

*– As**1**herë nuk i dihet udhëtimit **& (dhe)** ndaj ndihem **5**imist **(pesimist) x** orarin e kthimit.*

*– Artis Agjenci Kre**@**ive **(Kreative)**. Ne kemi hapur 1 **(një)** aktivi8 **(aktivitet)** organizim festash, ku perfshijme, dekorin e festes (ditelindje etj), pikturojme fytyr**@** **(fytyrat)** e femijeve, ofrojme biskot**@** **(biskotat)** si & **(dhe)** tort**@** **(tortat)** pastel.*

*– Pse nuk i **3**gove **(tregove)** te gjitha postimet, apo kishe **2**shime.*

*– Me ekuacion e zgjidha edhe une, por... duhet t'u për**7**emi **(përshtatemi)** të vegjëlve.*

*– E paske qare, moj vajzë, mjesh**3** **(mjeshtre)** e vertete. Ta hani gezuar **& (dhe)** qofte viti i mbare me te gjithe te mirat!*

Emërtime të shkurtuara

Nën këtë term përfshihen të gjitha njësitë e ligjërimit shkrimor edhe atij bisedor, të mëvetësishme ose jo, që krijohen nga procesi i shkurtimit në mënyra të ndryshme, si *shkurtimet*, *shkurtesat* ose *akronimet*. Dukuria e emërtimeve të shkurtuara nuk është një proces i ri që lidhet me gjuhën e internetit në ditët e sotme, pasi ato janë përdorur në gjuhë prej kohësh dhe janë trajtuar si një mënyrë fjalëformimi, ndonëse më pak prodhimtare.

Shkurtime

Përveç shkurtimeve tradicionale që janë të larmishme dhe që ndeshen gjerësisht në tekste të ndryshme, si: km «kilometër», d.m.th. «domethënë», p.sh. «për shembull» etj. në postime dhe në komente bashkëbiseduesit përdorin shumë shkurtime të reja, duke i reduktuar fjalët në një nga pjesët e tyre pa ua ndryshuar kuptimin për t'i shkruar ato më shpejt dhe në më pak vend. Këto shkurtime, ndryshe nga të mësipërmet që janë bërë pjesë e gjuhës standarde të shkruar, janë të pastandardizuara dhe gjejnë vend vetëm në komunikimet përmes pajisjeve elektronike. Fjalët shkurtohen duke hequr ndonjë pjesë në fillim, në mes ose në fund të tyre, por shumë më e përhapur është metoda e largimit të të gjitha zanoreve përbërëse dhe të ndonjë bashkëtingëllore e shurdhët fundore dhe pavarësisht nga kjo ato mbeten të kuptueshme nga bashkëbiseduesi.

Të rinjtë shkurtojnë natyrshëm emrat e lëndëve të tyre ose procese që lidhen me mësimin, si: *let* për *letërsi*, *mat* = *matematikë, bio* = *biologji, tekno* = *teknologji, leks* = *leksion, sem* = *seminar*, por kjo është një praktikë e njohur edhe më parë gjatë mbajtjes shënim të leksioneve ku gjenin vend mënyra të ndryshme të shkurtimit të fjalëve, duke përfshirë edhe gjuhë të tjera ku ajo fjalë ishte e shkurtër.

Në bazën tonë të të dhënave janë ndeshur më pak fjalë të shkurtuara duke hequr pjesën nistore ose fundore të tyre (*astron* = *astronominë, artik* = *artikullin, busi* = *autobuzin, celi* = *celular, dok.* = *dokumentash, drejtshk* = *drejtshkrimit, gjes* = *mirëmëngjes, hist* = *histori, info* = *informacion, konf* = *konfirmoj, konferencë, lapi* = *laptop, ligj* = *ligjeratë, pacim, pcm* = *mirpafshim, pant* = *pantallona, pas.* = *pasaportën, pëlq* = *pëlqej, përc* = *përcaktoj, perg* = *pergatit, përgj* = *përgjigje, përt* = *përtoj, puc* = *puthje, sem* = *seminare, shkelq* = *shkelqyer, shoq* = *shoqeruar, sit* = *situatë, teknol.* = *teknologjia, tung* = *tungjatjeta, zhvill* = *zhvilloj*), ndonjë prej të cilave konsiderohet si fjalë normale prej tyre me mbaresa të ndryshme rasore (*infon, infos, infoja* etj.)

Siç e theksuam, lista e fjalëve të shkurtuara me heqjen e zanoreve dhe të ndonjë bashkëtingëlloreje është shumë e gjerë. Më poshtë po rendisim të gjithë këta shembuj, ku vihet re se në disa raste për të njëjtën fjalë ka shkurtime të ndryshme (mirëmbrëma = *mbr, mrb, mrbr, mrbrm; megjithëse* = *mgjs, mgjse, mgjths; bukur* = *bukr, bkr*):

akm = *akoma*
aplkm = *aplikim*
argmnt = *argumenteve*
ath = *atehere*
bukr
bkr = *bukur*
bzqsh = *buzeqesh*
çkm = *çkemi*
çph = *ç'po bën*
dmsd = *domosdoshme*

dmth = domenthënë
dprsn = depressioni
dprtm = departamenti
drg = dërgoj
drz = dorëzoj
dt = datë
dtl = ditëlindje
fb, fcb = facebook
fix = fiksoj
flm = faleminderit
fts = ftesë
funks. = funksionojë
gjthç = gjithçka
gjthsht = gjithashtu
gr = grupi
km = kam
kmpjt, komp = kompjutër
kpt = kupton
krk = kerkon
ktl = kokëtul
lzt = lezetshëm
mbr, mrb, mrbr, mrbrm = mirëmbrëma
mgjes, mgj, mrmngjs = mirëmëngjes
mgjs, mgjse, mgjths = megjithëse
mgjt, mgjtht = megjithatë
mhb = muhabetin
mnjher = menjëherë
mqs, mqse = meqenëse
mrd = mirëdita
mrrshvj = marreveshjet
mrz = merzitur
mszh = mesazh
ndrsht = ndershmërisht
ndsh = ndoshta
njs = nejse
njs = njësh
nj-tj = njera- tjetri
nk = nuk
nrm = normale
nsr = nesër
ntn = natën
pacim, pcm = mirpafshim
plq = pëlqen
pqf = përqafim
prb, prbl = problem
prdt = paradite
prfks = perfeksioni
prgjthsh = pegjithshme
probl, prbl = problem
prp = prapë
prs = përse
prsh, persh = përshëndetje
prv = provoj
psh = për shembull
pst = pastaj
rrfsh = rrofsh
rsp = respekte
sdq = sidoqoftë
sh, shm = shumë
shkr = shkruaj
shkrsht = shkurtimisht
shnt
shnet = shëndet
shtrnj = shtrenjtë
srz, serz = seriozisht
sts = status
thm = them
tjt = tjetër
trz = terezi
txt = tekst
vrt = vërtetë
vtm = vetëm
zbkr = zbukuroj
zmr = zemër

Shkurtesa ose akronime

Tradicionalisht në grupin e shkurtesave futen fjalët e shkurtuara të formuara nga bashkimi i shkronjave ose tingujve nistorë të fjalëve që janë pjesë e emërtimit të organizatave, shoqatave, ndërmarrjeve, institucioneve etj., si ATSH (Agjencia Telegrafike Shqiptare), TVSH (Televizioni Shqiptar, por edhe "tatim mbi vlerën e shtuar"), OKB (Organizata e Kombeve të Bashkuara). Në gjuhën e komunikimit në internet koncepti i shkurtesave merr një zhvillim të ri, pasi nuk shkurtohen vetëm emërtimet e ndryshme, por edhe shprehje e fjali të zakonshme duke i rrudhur ato në 3-4 bashkëtingëllore. Germat, ndonjëherë të kombinuara me simbole dhe shenja të ndryshme, shkruhen së bashku, pa hapësirë, pavarësisht se janë tregues i një fjale apo nyje të veçantë. Kuptohet që këto shkurtesa janë kontekstuale dhe gjejnë përdorim vetëm në këto lloj komunikimesh, ndryshe nga shkurtesat e emërtimeve të institucioneve që përdoren si të tilla duke marrë mbaresa të ndryshme rasore. Shpesh dialogë të tillë si:

– *Ckb.*
– *Hic & un anej njug nca ishuj e pst prp nsr mpelq tiki nfshat prz.*
– *Na mrz me kto gjona nuk e kpt se scl ka jeten e tij dhe nuk na intereson sh.*

janë të kuptueshëm vetëm kur je në brendi të bisedës ose të duhet kohë ta deshifrosh.

Për shprehje tipike të shprehjes së urimeve ose të ndjenjave të ndryshme përdoren vetëm germat e para dhe tashmë shkurtesa të tilla si, *tdsh, tkshxh, tkz, klb, klm* janë bërë klishe dhe gjenden kudo nëpër biseda të ndryshme. Pavarësisht se i takojnë gjuhës së shkruar, ndonjë prej këtyre shkurtesave është bërë pjesë e komunikimit të përditshëm, jashtë kufijve virtualë nga të rinjtë, por jo vetëm (*klb, klm, flm*).

Nga të dhënat e pyetësorit, por dhe nga korpusi ynë, del se këto lloj shkurtesash përdoren më shumë në bashkëbisedimet në dhomat e bisedave sesa në komente apo postime:

amkpt = a më kuptove; ckb = çfarë ke bërë, ç'ke bërë; ckm = ç'kemi; çpb = çfarë po bën; dd = dy dashuri; gz dtl=gëzuar ditëlindjen; klb=kalofsh bukur; klm = kalofsh mirë; klsmm = kalofsh sa më mirë; mmsh =më mungon shumë; nqs = në qoftë se; ntrz = në terezi; përqafort =të përqafoj fort; prz, pz = për zotin; puç, puq= të puth; qkam = që kam; skgj = s'ka gjë; spk =si po kalon; sps = s'ka për se; tdsh = të dua shumë; tfs = të fala satëme; tkshxh = të kam shumë xhan; tkxh=të kam xhan; tkz = të kam zemër; tlt = të lutem; tltsh = të lutem shumë; tmsu = duke mësuar (tuj msu); tpf =të puth fort; tplq = të pëlqen; tpys = të pyes; tvij=të vij etj.

Përdorimi i shkurtimeve dhe i shkurtesave është një zhvillim i natyrshëm i gjuhës së komunikimit nëpërmjet pajisjeve kompjuterike. Ato komunikojnë

informacion në mënyrën më të shpejtë të mundshme duke kursyer kohë dhe hapësirë, por kur përdoren në gjuhën e folur ato përdoren në formën e tyre të gjatë me ndonjë përjashtim të rrallë.

Elemente morfosintaksore

Është e dukshme se stili i strukturës së fjalës dhe të fjalisë në gjuhën e FB është thelbësisht i ndryshëm nga ai i gjuhës standarde. Për t'iu përshtatur kontekstit të komunikimit online, bashkëbiseduesit përdorin një gjuhë ku vihet re prirja për reduktimin e formave të fjalëve, thjeshtimin e strukturave, përdorimin e fjalive të shkurtra e të paplota, madje pjesët e fjalive të përbëra ndahen në fjali të shkurtra, pavarësisht se janë të varura nga njëra-tjetra, shmangien nga rendi i drejtë i gjymtyrëve në fjali. Ashtu si dhe në gjuhën e folur, tipike është përdorimi i së ardhmes pa pjesëzën "të". Në korpusin tonë nga 1370 forma të së ardhmes, vetëm rreth një e treta janë në variantin e plotë. Në disa raste, siç e pamë më sipër, fjalitë përfaqësohen nga disa struktura komplekse ku lihen jashtë elemente të saj përbërëse, të tilla si nyja dhe fjalë të tjera funksionale. Shumë shpesh në këto fjalë funksionale (nyjat, parafjalët, pjesëzat dhe trajtat e shkurtra) që bëhen njësh me fjalët pasardhëse, të cilat shkurtohen gjithashtu duke i hequr zanoret, vihet re dukuria e elizionit (bie zanorja /ë/) dhe nuk përdoret apostrofi sipas rregullës në vend të zanores që elidohet (*mfal = më fal, mkan = më kanë, nkimi = në kimi, nkrs = në kurs, nmuaj = në muaj, nshkoll=në shkollë, tbjm = të bëjmë, tbkr = të bukur, tduhet = të duhet, tfala = të fala, tikim=të ikim, tkalume = të kalume, tlagjes = të lagjes, tndihmoft = të ndihmoftë, ttjerat = të tjerat, tvecant = të veçantë* etj.):

– *Cpb?*
– *Hahahaahahha shkoj pr* ***tmsu****. Po* ***nkls*** *shum* ***tmir****, normaleeee*
– ***Stkm*** *morr vesh asi llaf, klb*

Prania e fjalive të përbëra është shumë e rrallë, vetëm në postimet e gjata. Në komente të ndryshme këto fjali copëzohen në pjesët e tyre përbërëse si fjali të thjeshta:

– *Sakrifikojme per ju ne. Qe tju kenaqim me shume. Por perseri sna e vleresoni sakkrificen.*

Kjo bëhet qëllimisht, pasi fjalitë e gjata me më shumë se dy rreshta janë të lodhshme dhe komunikimi bëhet i bezdisshëm për bashkëbiseduesin.

Edhe nga përgjigjja për pyetjen përkatëse në pyetësor del se vetëm 27.5% e subjekteve përdorin fjali të gjata në tekstet e tyre.



Fshirja është një operacion sintaksor që largon përbërës nga një strukturë e caktuar dhe për këtë arsye ai nuk shfaqet në strukturën sipërfaqësore. Shumë e zakonshme është dukuria e elipsës sidomos në komentet e postuesve ku heqja e një gjymtyre ose e më shumë gjymtyrëve të nënkuptueshme në një fjali nuk e vështirëson kuptimin dhe mendimi shprehet sa më shkurt.

Vihet re elipsa e llojeve të ndryshme të gjymtyrëve të fjalisë, kryesore apo të dyta; elipsa e një sintagme emërore, foljore ose edhe e një fjalie të tërë.

Rastet e elipsës së fjalisë lidhen me procesin e pyetje-përgjigjeve në bisedat midis përdoruesve në dhomat e bisedave ku ndeshet elipsa e gjithë fjalisë, ose e një pjese të saj.

– *Lol, cpb? E bëtë prv e informatikës*
– *E bëmë*
– *A kishte pyetje të vështira*
– *po. bomb fare*

Elipsa e sintagmave emërore vihet re kryesisht në mospraninë e kryefjalës, gjë që është e natyrshme për shqipen, pasi përbën një veçori të organizimit të strukturës së saj gramatikore. Por nuk mungojnë rastet e mungesës së kundrinës, sepse në rrethana të diskursit bashkëbiseduesit nën një kontekst të caktuar kufizojnë disa informacione për të cilat janë në brendi dhe kanë njohje për objektin në fjalë.

– *Isha andej nga Tegu sot.*
– *E more...*
– *Llaf është ai, ptj.*

Interesante është elipsa e sintagmës foljore që haset jo vetëm në dialogët në dhomat e bisedave, por edhe në postime e komente të ndryshme.

– *Rrofsh zemër! Edhe ti si drita të dy!*

– *Kujtime te paharrueshme e mbreselenese per nje familje te lumtur.*
– *Kur të mundesh nja dy foto nga libri i gramatikës së vajzës*

Në gjuhën shqipe rendi i fjalëve është relativisht i lirë: gjymtyrët e fjalisë mund të vendosen në vende të ndryshme pa e ndryshuar funksionin e tyre sintaksor. Në fjalitë dëftore rendi i zakonshëm është *kryefjalë + kallëzues + kundrinë + rrethanor.*

Nga të dhënat e korpusit vihet re se herë pas here se del në krye edhe kallëzuesi ose kundrina, por edhe rrethanori, për t'u vënë më në dukje a për t'u theksuar ajo që është më e rëndësishme për bashkëbiseduesin.

– *E para here qe me pelqeu kjo mua...dashuria familjare mbi te gjitha:)*
– *Nderkohe qe dosjen e kishte gati ajo qe ne korrik...*

Përfundime

Nga sa pamë në analizën tonë, mund të themi se gjuha e përdorur në Facebook dhe në përgjithësi në internet shfaq elemente që janë të ngjashme si me gjuhën e folur, dhe me atë të shkruar, por më shumë vihet re prirja për të ndjekur modelin e gjuhës së folur. Për të plotësuar mungesat e një komunikimi verbal (ndryshimi i intonacionit, gjestet etj.), përdoruesit e Facebook-ut shfrytëzojnëmënyra të reja e të larmishme tekstuale, të cilat u mundësojnë që të shprehin ndjesitë e tyre. Është mjaft e qartë se të gjitha këto karakteristika të gjuhës së Facebook-ut justifikohen me përdorimin e tyre në kontekste të caktuara, por nuk mund të zhvendosen në mediume të tjera komunikimi. Duke pasur parasysh se çdo situatë komunikuese kërkon llojin e vet të gjuhës ose regjistrin e gjuhës, këto elemente nuk kanë asgjë të gabuar dhe, nëse përdoren siç duhet, nuk e varfërojnë gjuhën. E rëndësishme është të dish të zgjedhësh për çdo situatë gjuhën më të përshtatshme.

Në paragrafin për objektin e kumtesës sonë ne ngritëm hipotezën se gjuha e përdorur në komente dhe postime është më formale dhe më e kujdesshme se gjuha e përdorur në dhomat e bisedës. Por nga analiza e hollësishme dhe e veçuar për secilën kategori na rezultoi se nuk ka ndonjë ndryshim thelbësor midis tyre. Bashkëbiseduesit në dhomat e bisedave përdorin të njëjtat veçori si dhe komentuesit në postime, përjashtuar shkurtesat që gjejnë më pak vend në këto të fundit.

Po ashtu, pavarësisht se nuk u ndalëm te problemet gjuhësore të gjuhës së Facebook-ut, pasi nuk ishte ai synimi i kumtesës sonë, vumë re se si në postime e komente, edhe në dhomat e bisedave kujdesi për gjuhën ishte shumë i ulët, pavarësisht se përdoruesit i ofrohet mundësia për ta redaktuar postimin ose komentin edhe pasi e ka publikuar.

Anila ÇEPANI

LANGUAGE ANALYSIS OF ALBANIAN USED IN SOCIAL NETWORKS, CASE OF FACEBOOK

Abstract

The rapid development of communication technology has influenced not only the alternatives and opportunities of community participation but also the use of language, enabling new forms of discourse. People communicate more through social networks such as Facebook (FB), Twitter, Instagram, Instant Messaging - IM, Skype, E-mail, and chat rooms. These new ways of interpersonal communication, for which is used the term *Computer Mediated Communication* - CMC from the researchers, have changed the way we use language, enabling new forms of discourse with distinct features. Users use language forms and features that are similar to both spoken and written language in this kind of virtual communication via the Internet, in accordance with the particular context.

This paper intends to examine some of these features: the prosodic features of the spoken language (intonation, rhythm and emphasis) through which users conveys different emotional states; different punctuation marks; use of the capitals; various word formation processes, such as abbreviations, acronyms, combinations of letters with numbers, emoticons, etc.; morphosyntactic elements; types of sentences etc.

The corpus of the data for our analysis consists of posts and comments on Facebook from different users created using the special application *Post and Comments Extractor V1.0*. This application makes it possible to collect all comments and postings of users in an Excel file for a very short time. The amount of data is very large, which makes the results of our analysis even more credible. The entire database was introduced into the concordance program, through which were made statistical analysis on the frequency of use of various characteristic elements in communication on social networks and mainly on Facebook.

An important element of our language analysis is the questionnaire conducted with questions about some general issues about using Facebook and specific questions about the language used on Facebook. This questionnaire was completed by 80 subjects pertaining to different social, cultural and gender ages and statuses. The questionnaire data was analyzed using the statistics program *IBM SPSS Statistics 21.0* and their interpretation was used to draw some conclusions.

Key words: social networking, virtual communication, word formation, morphosyntactic, prosodic features.

Anila KANANAJ

REALIZIMI I KRYEFJALËS NË VARIETETE TË SHQIPES: TË DHËNA GJUHËSORE NATYRALE NGA FOLËS AMTARË

1.1. Objekti i studimit dhe motivimi i tij

Objekt i këtij studimi është realizimi i kryefjalës në fjali mbështetur në të dhëna gjuhësore natyrale nga folës amtarë të varieteteve më përfaqësuese të shqipes. Hetimi i tipareve sintaksore të shqipes së folur, e për më tepër i varieteteve të saj, nuk ka tërhequr shumë vëmendjen e studiuesve. Hulumtimet në këtë drejtim janë detyrë parësore për gramatikanët dhe albanologët. Për këtë arsye, ky studim përqendrohet pikërisht në aspektin sintaksor të shqipes së folur në variete. Duke pasur parasysh që nën presionin e vazhdueshëm të varietetit standard, variantet dialektore të shqipes po vijnë duke u rrudhur, sidomos në brezat e rinj, është e rëndësishme të dokumentohet sintaksa dialektore para se ajo të jetë zhdukur. Hulumtimet në sintaksë dialektore japin të dhëna me vlerë për historinë e gjuhës, por edhe për gjuhëtarët, në mënyrë që ata t'i përdorin të dhënat dialektore për të mbështetur teoritë e tyre gjuhësore. Gjithashtu, njohja e sintaksës dialektore ka rëndësi për arsimin dhe shoqërinë shqiptare dhe për politikat gjuhësore që ndiqen në to.

Të dhënat gjuhësore të këtij studimi vijnë nga 20 folës amtarë që u përkasin varieteve më përfaqësuese të shqipes. Të dhënat janë regjistruar, transkriptuar dhe analizuar në përputhje me objektin e studimit. U përzgjodh si objekt hulumtimi kryefjala për arsyen se nuk ka studime të dedikuara në lidhje me tiparet gramatikore që shpalos ajo në varietetet e folura të shqipes. Tiparet morfo-sintaksore të kryefjalës të nxjerra nga të dhënat që kanë ofruar folësit, janë krahasuar me njëri-tjetrin dhe janë përgjithësuar. Disa prej këtyre tipareve paraqiten uniforme, ndërsa disa të tjera shpalosin variacion. Për secilin prej tipareve të marra në shqyrtim do të jepen shpjegime, përfundime dhe sugjerimet përkatëse.

1.2. Metoda e studimit

Janë regjistruar, transkriptuar dhe analizuar 20 folës amtarë të toskërishtes dhe gegërishtes, të cilët tregojnë në mënyrë të vullnetshme një narrativë. Për të analizuar

tiparet gramatikore të kryefjalës, janë analizuar me metodën analitiko-statistikore rreth 500 fjali nga secili nëndialekt. Konkretisht, u analizuan 507 fjali për gegërishten veriore, 502 fjali për gegërishten jugore, 504 fjali për toskërishten veriore dhe 512 fjali për toskërishten jugore, duke arritur në një total prej mbi 2000 fjalish. Pjesëmarrësit në këtë studim janë:

- 10 folës amtarë të toskërishtes (5 meshkuj, 5 femra):
  - 5 folës të toskërishtes veriore (2 meshkuj, 3 femra)
  - 5 folës të toskërishtes jugore (3 meshkuj, 2 femra);
- 10 folës amtarë të gegërishtes (6 meshkuj, 4 femra):
  - 5 folës të gegërishtes veriore (4 meshkuj, 1 femër)
  - 5 folës të gegërishtes jugore (2 meshkuj, 3 femra).

Folësit u përzgjodhën nga zona të ndryshme brenda varietetit përkatës me qëllim që të jepet një paraqitje sa më e plotë e varietetit të synuar. Subjektet janë në përgjithësi të moshës së tretë, kryesisht nga 54-90 vjeç[1]. Mosha mesatare e subjekteve është 71 vjeç. 30% e tyre ose 6 subjekte kanë vetëm arsimin fillor, 1% e tyre ose 2 subjekte nuk kanë as arsimin fillor, 30% e tyre ose 6 subjekte kanë arsimin shtatëvjeçar, 25% ose 5 subjekte kanë mbaruar shkollën e mesme, dhe vetëm 0.5% e tyre ose 1 subjekt ka arsim të lartë[2]. Arsimimi i subjekteve arrin mesataren me 7 klasë shkollë. Të dhënat e detajuara për folësit paraqiten në tabelën vijuese.

Geg V	**Vjeç**	**Klasë**	**Vendlindja & vendbanimi**	**Nr. fjalive të analizuara**
Subjekti 1	79	7	Pejë	106
Subjekti 2	59	7	Mirditë	104
Subjekti 3	75	7	Kukës, Novosej	97
Subjekti 4	56	16	Tropojë, Lekurgaj Geghysen - Tropojë, Bajram Curri	97
Subjekti 5	64	7	Lezhë Kallmet	103
Geg J	**Vjeç**	**Klasë**	**Vendlindja & vendbanimi**	**Nr. fjalive të analizuara**
Subjekti 1	90	0	Tiranë, Petrelë	90
Subjekti 2	75	4	Tiranë, Qafëmollë	114

[1] Është vetëm një subjekt në moshë të re, i cili është përfshirë për arsye se nuk u arrit të gjendej një subjekt tjetër në moshë më të rritur. Në çdo rast, subjekti plotëson kriteret për një studim dialektor.

[2] Subjekti me arsim të lartë ka treguar narrative në dialektin e vet amtar i pandikuar nga gjuha standarde.

Subjekti 3	71	4	Kavajë, Luz i Vogël	120
Subjekti 4	39	12	Elbasan, Godolesh - Elbasan, Labinot Fushë (mbi Shkumbin)	89
Subjekti 5	20	12	Durrës, Manëz	89
Tosk V	**Vjeç**	**Klasë**	**Vendlindja & vendbanimi**	**Nr. fjalive të analizuara**
Subjekti 1	79	4	Lushnje, Krutje e Sipërme	110
Subjekti 2	73	7	Korçë, Sul - Korçë, Miras	93
Subjekti 3	70	12	Berat	114
Subjekti 4	54	12	Devoll, Vishovicë	130
Subjekti 5	72	7	Fier, Libofshë	57
Tosk J	**Vjeç**	**Klasë**	**Vendlindja & vendbanimi**	**Nr. fjalive të analizuara**
Subjekti 1	72	4	Vlorë, Kuç	110
Subjekti 2	70	4	Gjirokastër, Kurvelesh	93
Subjekti 3	74	4	Çamëri, Arpice - Vlorë	101
Subjekti 4	71	12	Sarandë, Konispol	107
Subjekti 5	87	2	Përmet, Malëshovë, Labëri	101

1.3. Informacion për narrativat

Në këtë studim janë përfshirë 20 narrativa, të cilat plotësojnë kushtet për një studim dialektor. Ato janë marrë nga folës amtarë të varietetit përkatës. Pjesa më e madhe e tyre kanë lindur dhe kanë banuar tërë jetën e tyre në të njëjtën zonë, por një pakicë kanë lëvizur më së shumti brenda zonës që përfshin varietetin e vet dialektor. Subjektet u zgjodhën në moshë sa më e madhe dhe me sa më pak arsim për të marrë të dhëna më të pastra dialektore. Subjekteve u është kërkuar të tregojnë një ngjarje nga jeta, traditat ose nga ngjarje që lidhen me zonën e tyre. Narrativa është treguar në mënyrë të vullnetshme subjektet nuk janë paguar për to. Regjistrimi është bërë nga një i afërm i tyre, kryesisht nip ose mbesë, që ishte student në universitet[3]. Regjistrimi ka zgjatur 2.5-5 minuta dhe disponohet në formë audioje në CD, i shoqëruar me të dhënat përkatëse sociolinguistike, si: vendlindja, vendbanimi, nëse ka lëvizje

[3] Falënderoj kolegen A. Ndoja dhe studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, viti akademik 2014-2015, për bashkëpunimin dhe ndihmën e dhënë për regjistrimin e subjekteve.

demografike, mosha, arsimi dhe gjinia[4]. Narrativat u transkriptuan prej nesh sipas kërkesave të një studimi dialektor, d.m.th. fjalët dhe fjalitë janë shkruar ashtu siç shqiptohen dhe dëgjohen realisht, e jo të konvertuara në shqipe standarde. Të dhënat nga narrativat i koduam, i analizuam dhe i përgjithësuam duke përdorur programin Excel, si dhe kriteret sintaksore të përzgjedhura prej nesh për qëllimet e këtij studimi.

1.4. Kriteret e kodimit në nivel fjalie

Fjalia është konceptuar si njësi gramatikore që organizohet rreth një foljeje të shtjelluar ose të pashtjelluar. Ajo përkon me atë njësi që në literaturën gjuhësore në gjuhën angleze njihet me termin *clause*. Kryefjala mund të jetë e realizuar fonetikisht, por mund të jetë dhe kryefjalë logjike e nënkuptuar e një foljeje të shtjelluar (*pro*) ose e një foljeje të pashtjelluar (PRO). Fjalitë ekzistenciale të tipit:

(1) Kishte shumë njerëz atje.

janë analizuar me kryefjalë *pro* në përputhje me analizën që bën për shqipen Moro (1997:163).

Foljet modale të paeptueshme *mund, duhet, do* + *pjesore* janë marrë si një njësi e vetme kallëzuesore[5]. Kur këto folje modale kanë qenë të eptueshme, atëherë janë marrë si predikat i veçantë nga folja që i ndjek. Janë analizuar si dy elemente predikative ato njësi foljore që në Gramatikën e Akademisë (Çeliku et al., 1996) trajtohen si kallëzues të përbërë. Ky vendim u mbështet nga fakti se këto segmente që njihen si "kallëzues të përbërë", në të dhënat tona dialektore paraqesin variacion sintaksor, ato nuk kanë të njëjtën paradigmë, në mes të tyre realizohen kategori të tjera sintaksore fjalësh dhe nuk shfaqin tiparet e ndërtimeve të qëndrueshme. Kjo vërtetohet nga shembujt në vijim:

[4] Numri i narrativave nëpër CD arrin në 300, por u përzgjodhën dhe u analizuan prej nesh vetëm 20 që plotësojnë kriteret për këtë studim në sintaksë dialektore. Pjesa tjetër e narrativave u skualifikua për arsye se nuk plotësonin kriteret shkencore të regjistrimit, p.sh., biseda në gjuhë të huaj, pyetje-përgjigje që nuk përbëjnë narrativë, intervista teatrale në formën e një emisioni televiziv dhe në një masë të konsiderueshme CD bosh apo të montuara me muzikë në sfond. Në shumë raste kishte lëvizje demografike të subjekteve në zona ku fliten varietete tjera ose kishin jetuar jashtë vendit për një kohë të konsiderueshme ose mungonin të dhënat sociolinguistike për subjektin e intervistuar.

[5] Në këtë punim ato janë trajtuar si një predikat i vetëm, por nevojiten studime të mëtejshme për shqipen për të vendosur nëse këto njësi duhen trajtuar si dy predikatë apo si një predikat i vetëm.

(2) *se nuk* ***munen me bo*** *gjonat (Geg J, Durrës)*
(3) *s'po* ***muj me mbajt*** *mend (Geg V)*
(4) *T' vej inot e un* ***zuna tu qa*** *kur i shihja dhit n'uj ashu. (Geg J, Tiranë)*
(5) *Tash un* ***due me t'kallxue*** *për Islam Demushin. (Geg V, Tropojë)*
(6) *Ashtu siç ka patur ai për mua të mira dhe fjal e afërsin e tij, ashtu* ***dua që të kaloj*** *në jet dhe të jet ashtu siç ka qën. (Tosk J, Kurvelesh, Gjirokastër)*
(7) *E ndezëm zjarrë në mes të shtëpisë atje e* ***zumë po qanim*** *neve. (Tosk J, Përmet, Labëri)*
(8) ***Filluanë pastaj e ndanë*** *me ashtu, me zona. (Tosk V, Devoll)*
(9) *Po e kanë me këngë,* ***fillojnë këndojnë*** *të dy palët. (Tosk V, Korçë)*
(10) ***E filluanë ta rregullojnë*** *edhe lumën ce lumi ikte nga i bënte koka atij. (Tosk V, Devoll)*
(11) *Dim që ky fshat ka qen bosh deri diku deri në një koh në fillim po me ardhjen e familjarve të njerzve që* ***filluan****, të* ***bujqve****,* ***të investonin, të mbillnin*** *e* ***t'korrnin*** *e njerën tjetrën. (Tosk V, Lushnje, Myzeqe)*
(12) ***...duhet*** *që kta* ***t'****ia* ***çoj*** *fmive (Geg J, Durrës)*
(13) ***U duke*** *vjera qa* ***thojke****: mbas vjerës* ***u dushna me shku me msu*** *prej vjerës. (Geg V, Pejë)*
(14) *Na* ***u duke me vesh*** *tunihere. (Geg V, Pejë)*
(15) *Burrat jan ata që zgjedhin shkolln e fmive që* ***dun me fillu*** *apo që s'dun ata.(Geg J, Durrës)*

Kryefjala në ndërtimet *determinant + emër* (p.sh., *dy njerëz, çdo njeri* etj.), është trajtuar si sintagmë emërore, sipas trajtimit të SE në studimet sintaksore në frymë gjenerative të shqipes. Kryefjala e shprehur me përemër është analizuar si kategori më vete. Është analizuar kryefjala e shprehur me fjali të nënrenditur.

Për të parë përshtatjen e kryefjalës me foljen, është hetuar fleksioni i foljes së fjalisë.

Është shqyrtuar rendi kryefjalë-folje dhe anasjelltas, si dhe funksioni i fjalisë ku realizohet kryefjala për të parë nëse ka ndonjë korrelacion.

Forma të pashtjelluara janë konsideruar infinitivi, mohorja, përcjellorja dhe pjesorja, p.sh., *për me dhan, për me çarmatos, me fol, tu përdor, pa dal, për pa shkue, për të folur, duke folur, pa folur*. Pjesorja si kallëzues i fjalisë është marrë në ndërtime si më poshtë:

(16) *(Knej po knej po, përpara po, na ishim n'mes.)* ***Da*** *keq. E damja shum e keqe. (Geg J, Tiranë)*

(17) ***Çuar*** *nga mbrapa automatik ata, bam dhe përsipër kapërxyllit. (Tosk V, Lushnje, Myzeqe)*

1.5. Rezultatet dhe interpretimi i tyre

1.5.1. Pozicioni i kryefjalës

Rendi kryefjalë – folje shfaqet në masën 18% në gegërishten veriore, 20% në gegërishten jugore, 17% në toskërishten veriore dhe 16% në toskërishten jugore. Rendi folje – kryefjalë paraqitet në shifrat 10% në gegërishten veriore, 18% në gegërishten jugore, 17% në toskërishten veriore dhe 16% në toskërishten jugore. Këto të dhëna ilustrohen në grafikun e mëposhtëm.



Të dhënat dëshmojnë se në përgjithësi rendet kryefjalë – foljen dhe folje-kryefjalë paraqiten në shifrën 20%. Rendi kryefjalë-folje realizohet në masën 18% në gegërishten veriore, në masën 20% në gegërishten jugore, 17% në toskërishten veriore dhe 16% në toskërishten jugore. Rendi folje-kryefjalë realizohet në masën 10% në gegërishten veriore, 18% në gegërishten jugore, 17% në toskërishten veriore dhe 16% në toskërishten jugore. Me përjashtim të gegërishtes veriore ku ka një diferencë prej 8% midis dy rendeve (sundon rendi i drejtë), ka një diferencë të vogël midis dy rendeve në gegërishten jugore dhe asnjë diferencë midis tyre në toskërishten veriore dhe në toskërishten jugore. Në përgjithësi, rendi i anasjellë folje-kryefjalë realizohet në masë të konsiderueshme, gati-gati në masën 50%. Për të shpjeguar këtë fenomen, u morën në konsideratë fjalitë pyetëse, kushtore dhe kohore, të cilat kërkojnë rendin folje – kryefjalë. U vu re se ato realizohen në masën 3-4%, përqindje e cila nuk mund të shpjegojë shifrat e rendit të anasjellë folje – kryefjalë. Mund të provojmë të shpjegojmë pozicionin e kryefjalës në fjali nëpërmjet faktorëve gramatikorë, si p.sh., fjali dëftore, kushtore, pyetëse etj., por nga një analizë e thuktë u vu re se rol të dorës

së parë luajnë faktorët pragmatikë dhe të diskursit. Intonacioni luan rol të rëndësishëm për të interpretuar funksionin pragmatiko-sintaksor të kryefjalës në ligjërim. Nga vëzhgimi i të dhënave duket se kryefjala që shpreh Fokusin (*Focus*) ose është pjesë e sintagmës Fokus është gjithmonë e realizuar fonetikisht. Gjithashtu, në narrativat e treguara u vu re se rol primar në realizimin fonetik të kryefjalës luan Kontrasti (*Kontrast/Contrast*), d.m.th. kryefjala që shpreh informacion të kontrastuar është gjithmonë e realizuar fonetikisht, qoftë kjo Temë (*Topic*) ose Fokus (*Focus*)[6]. Për variabëlin Kontrast, në literaturën për shqipen ka shkruar mjaft Kallulli (1995, 1999) dhe Rista-Dema (2006). Kapia (2013) gjithashtu mbështet idenë e diferencimit të Kontrastit si kategori e veçantë. Sidoqoftë, për të shpjeguar në mënyrë të shterueshme faktorët që luajnë rol në rendin e kryefjalës në sintaksën dialektore të shqipes, nevojitet një studim i veçantë që hulumton në thellësi rendin e kryefjalës në lidhje me foljen në fjali, si dhe lidhjen e këtij rendi me variablet *Fokus, Temë* dhe *Kontrast.*

1.5.2. Realizimi i kryefjalës sipas kategorive morfo-sintaksore

Kategoritë morfo-sintaksore me të cilat realizohet kryefjala paraqiten si në grafikun më poshtë.



Kryefjala e shprehur me një fjali të nënrenditur paraqitet në shifrat 2% në gegërishten veriore, 1% në gegërishten jugore, 0% në toskërishten veriore dhe 1% në toskërishten jugore. Kryefjala e shprehur me këtë kategori sintaksore është në shifra të

[6] Në këtë studim nuk mund të ofrojmë të dhëna statistikore në lidhje me këtë çështje, e cila do të jetë objekt i një studimi të veçantë në të ardhmen.

papërfillshme dhe diferenca prej 1% më shumë në gegërishte shpjegohet nga ajo që infinitivi në këtë dialekt merr kryefjalë me fjali të nënrenditur, gjë që nuk shihet në toskërishte.

Kryefjala shprehet me një sintagmë emërore të shquar në masën 15% në gegërishten veriore, 24% në gegërishten jugore, 17% në toskërishten veriore dhe 15% në toskërishten jugore. Mesatarja e këtij tipari për gegërishten është 19.5%, ndërsa për toskërishten 16%, pra kryefjala e shprehur me një sintagmë emërore të shquar parapëlqehet në masën 3% më shumë në gegërishte, kur kulmon gegërishtja jugore me diferencë të dallueshme nga të gjitha varietetet e tjera të marra në shqyrtim.

Kryefjala e realizuar me një sintagmë emërore të pashquar paraqitet në shifrat 2% në gegërishten veriore, 3% në gegërishten jugore, 3% në toskërishten veriore dhe 2% në toskërishten jugore. Nuk ka dallime midis dialekteve në lidhje me këtë tipar. Edhe dallimet brendapërbrenda nëndialekteve janë të papërfillshme. Mesatarja e realizimit të kryefjalës me një sintagmë emërore të pashquar është 2.5%, çka tregon se ajo nuk parapëlqehet në gjuhën e folur, veçanërisht nëse e krahasojmë edhe me të dhënat për kryefjalën e shprehur me sintagmë emërore të shquar, me përemër, me kryefjalë logjike të parealizuar fonetikisht (PRO dhe *pro*).

Kryefjala e shprehur me përemër realizohet në masën 15% në gegërishten veriore, 13% në gegërishten jugore, 15% në toskërishten veriore dhe 16% në toskërishten jugore. Nuk ka dallime të ndjeshme midis nëndialekteve dhe dialekteve në lidhje me këtë tipar.

Kryefjala e shprehur me PRO është në masën 15% në gegërishten veriore, 6% në gegërishten jugore, 2% në toskërishten veriore dhe 1% në toskërishten jugore. Ka dallime të mëdha midis dialekteve sa i takon këtij tipari. Gjithashtu, PRO realizohet 2.3 herë më shumë në gegërishten veriore sesa në atë jugore. PRO në toskërishte paraqitet në masë shumë të vogël në të dy nëndialektet e saj.

Kryefjala e shprehur me *pro* realizohet në shifrat 51% në gegërishten veriore, 53% në gegërishten jugore, 64% në toskërishten veriore dhe 65% në toskërishten jugore. Ky tipar duket i stabilizuar brendapërbrenda dialekteve. Kështu, nuk ka dallime të ndjeshme në lidhje me *pro* midis gegërishtes veriore dhe gegërishtes jugore. Po ashtu, shifrat janë të përafrëta në toskërishten veriore dhe në toskërishten jugore. Ndërkaq, ka dallime nga njëri dialekt te tjetri. Ky tipar realizohet në masën 12% më shumë në toskërishte në krahasim me gegërishten. Kjo mund të shpjegohet me atë që fleksioni i foljeve është më i zhvilluar në toskërishte sesa në gegërishte, gjë që mundëson përdorimin e një kryefjale logjike referenciale si *pro*.

Në përgjithësi, mund të pohohet se *pro* përdoret në masën mbi 50% në të gjitha varietetet në fjalë, çka do të thotë se kryefjala parapëlqehet të realizohet fonetikisht në

masën 50%. Përqindja kaq e lartë e realizimit të kategorisë *pro* mund të shpjegohet me atë që kryefjala *pro* është gjithmonë Temë (Topic). Ajo ka karakter anaforik dhe shpreh informacion të njohur. Me informacion të njohur kuptohet një informacion i dhënë në fjalinë paraprijëse, një informacion i dhënë më parë brenda të njëjtit tekst/narrativë/bashkëbisedim, një informacion që nënkuptohet si i njohur nga folësi, ose një informacion që prezantohet në fjalinë vijuese. Ajo mund t'i referohet folësit (unë), bashkësisë ku përfshihet folësi (ne), bashkëbiseduesit (ti), por edhe të jetë e nënkuptuar nga konteksti ose nga folësi.

Kundërvënia kryefjalë e realizuar fonetikisht vs. kryefjalë e parealizuar fonetikisht është ilustruar në grafikun më poshtë.



Shohim se kjo kundërvënie paraqitet uniforme në të dyja dialektet, ku kryefjala e realizuar me një sintagmë emërore ose një përemër është në shifrat 35-36% dhe kryefjala e realizuar me një kategori të zbrazët sintaksore, e cila mund të jetë PRO ose *pro*, paraqitet në masën 62-65%. Në këtë të fundit, vendin më të rëndësishëm e zë kategoria PRO, të cilën e kemi analizuar edhe sipas funksioneve të fjalive ku ajo realizohet. Kryefjala e realizuar me kategorinë PRO paraqitet në një përqindje më të konsiderueshme në të folmet gege, sidomos në gegërishten veriore ku vërehet se është në masën 15%. Në përpjesëtim të drejtë me këtë, edhe funksionet e fjalive ku realizohet PRO në këtë nëndialekt janë më të larmishme, siç duket edhe në grafikun vijues.



	Fj. Kundrinore	Fj. Kallëzuesore	Fj. Përcaktore	Fj. Qëllimore	Fj. Kohore	Fj. Shkakore	Fj. Kushtore
Geg V	4%	2%	0%	5%	0%	1%	0%
Geg J	1%	1%	1%	1%	0%	0%	0%
Tosk V	0.19%	0%	0.19%	0.19%	0%	0%	0%
Tosk J	0.19%	0%	0.19%	0.39%	0%	0%	0%

Në aspektin e përvetësimit të gjuhës, prania ose mungesa e fleksionit janë dukuri shumë të rëndësishme, të cilat nuk realizohen njësoj në vetëdijen e folësit. Sipas gramatikës gjenerative, realizimi i fleksionit kërkon një operacion sintaksor më të ndërlikuar, çka do të thotë se ky fakt duhet mbajtur parasysh në hartimin e teksteve dhe në mësimdhënien e shqipes standarde në shkollë. Të dhënat dëshmojnë që folës të varieteteve të ndryshme hasen me vështirësi të ndryshme në lidhje me këtë çështje, prandaj nevojiten politika gjuhësore më të përshtatshme me qëllim që të lehtësohet dhe të mundësohet përvetësimi më i mirë i varietetit standard në shkollë.

1.5.3. Përshtatja e kryefjalës me kallëzuesin

1.5.3.1. Tipare të përgjithshme të përshtatjes së kryefjalës me kallëzuesin

Kryefjala që realizohet me një emër përmbledhës zakonisht përshtatet me një folje në shumës në të dy dialektet, p.sh.:

(18) E të shtunën, të premten, që të enjten gjer të premten këto dy dit e ***ka rinia*** *që* ***mblidhen****. (Tosk V, Korçë)*

(19) Pastaj të shtunën ***mblidhen miqësia.*** *(Tosk V, Korçë)*

(20) Kta tesha t'anës ton, sikur i ***bajn rinia*** *tash, i shoqnoshim edhe me unaza. (Geg V, Lezhë)*

Kryefjala e shprehur me disa emra të bashkërenditur të cilët janë në numrin njëjës, mund të përshtatet me një folje në numrin njëjës, p.sh.:

(21) Atje e rrethoi ***ushtria dhe policia dhe ushtart****. (Tosk V, Lushnje)*

Por ajo mund të përshtatet edhe me një folje në numrin shumës, p.sh.:

(22) ***Plaku, kunati tjetër, dy çupat dhe un*** *mbetëm. (Tosk J, Malëshovë, Përmet*)

Kur dy sintagmat emërore të bashkërendituara që shprehin kryefjalën janë në numra të ndryshëm, folja mund të përshtatet me kryefjalën që ka më afër, p.sh.:

(23) ***Kta dy vllezrit*** *nga Krutja* ***dhe ai Lam Milja*** *s'donte t'bashkohesh. (Tosk V, Lushnje)*

Në ndonjë rast të rrallë kryefjala që i referohet një frymori të jetë në numrin njëjës dhe folja në numrin shumës, p.sh.:

(24) Na ndihmoi kunati. ***Ishin*** *në lagjen tjetër* ***burri motrës madhe****. (Tosk J, Malëshovë, Përmet)*

Në këtë shembull, kjo mund të shpjegohet me atë folësi nënkupton familjen e kunatit, pra në vetëdije ka një emër përmbledhës, prandaj dhe folja është në numrin shumës megjithëse kryefjala është në numrin njëjës.

Në përgjithësi, kryefjala përshtatet me folje të shtjelluara. Ajo mund të përshtatet edhe me forma të pashtjelluara foljore. Kryefjala që përshtatet me forma të pashtjelluara foljore është një kategori e zbrazët (PRO), por në një masë të vogël (1%), kryefjala e një forme të pashtjelluar foljore mund të shprehet edhe me kategori gramatikore të realizuara fonetikisht, si emër dhe përemër. P.sh.:

(25) E moj nan, për sha me t'fol ***un****? (Geg V, Lezhë)*
(26) Veç ish fshtir shum me lon vllaun atje, m'u nda ***na****. (Geg V, Pejë)*
(27) Thojke moter i du prej teje me gatu ***ti****. (Geg V, Pejë)*
(28) Ai edhe ka dal heret n'Shypni pa u mshel ***rruga****. (Geg V, Pejë)*

Karakteristike për gegërishten është që kryefjala e infinitivit mund të jetë edhe në rasën kallëzore, p.sh.:

(29) Edhe u duke heret ***fmit*** *m'i shti n'gjum për m'u qu heret nesër me shku n'shkoll. (Geg V, Pejë)*

1.5.3.2. Kategoria e eptimit dhe mënyra e foljes me të cilën përshtatet kryefjala

Duket si karakteristikë e narrativave që kryefjala përshtatet në një masë të madhe me një folje të eptueshme, e cila është kryesisht në mënyrën dëftore, me mbi 83%. Pas mënyrës dëftore, parapëlqehet një folje në lidhore, e cila vjen në rritje në gegërishten jugore (me 4%), në toskërishten veriore paraqitet në masën 7% dhe ka përqindjen më të madhe në toskërishten jugore me 11%. Mënyrat e tjera të foljeve kanë pasur shifra shumë të vogla realizimi (nën 1%), prandaj nuk janë përfshirë në grafikun ilustrues, i cili është dhënë më poshtë.



Një vend të rëndësishëm duket qartë që e zënë foljet e paeptueshme, të cilat realizohen kryesisht me kategorinë e infinitivit, por mund të dalin edhe në formën e pashtjelluar mohore ose përcjellore. Kryefjala e infinitivit në përgjithësi është e parealizuar fonetikisht, por ka raste në gegërishten veriore ku ajo realizohet me një kategori morfologjike si sintagmë emërore ose përemër vetor. Përqindjen më të lartë folja-infinitiv, ashtu siç pritej, e ka në gegërishten veriore me 14%, e ndjekur nga gegërishtja jugore me 4%. Ndryshe nga sa pritej, folja-infinitiv realizohet vetëm në masën 1% në toskërishte, ku paraqitet e unifikuar. Kjo dëshmon se në lidhje me këtë tipar, dialekti tosk dallon edhe nga varianti standard i shqipes në të cilin infinitivi realizohet në shifra të konsiderueshme.

Një pyetje me interes që lind këtu është nëse mund të pohohet se foljet-infinitiv dhe foljet në lidhore janë të ndërkëmbyeshme (komplementare), pra që aty ku nuk përdoret njëra kategori, përdoret tjetra? Të shohim çfarë thonë të dhënat:



Të dhënat tregojnë se nuk mund ta pohojmë natyrën komplementare të këtyre kategorive. Shuma lidhore + infinitive nuk është e njëjtë nëpër nëndialekte. Gjithashtu, nuk shohim që aty ku rritet infinitivi, përqindja e realizimit të lidhores të ulet në të njëjtën masë. Edhe e kundërta nuk rezulton e vërtetë, pra, në atë masë që rritet lidhorja, në atë masë ulet infinitive nëpër nëndialekte. Kjo shpjegohet nga të dhënat, ku shihet se shumë funksione që në shqipen standarde kryehen nga mënyra lidhore, nëpër dialekte kryhen edhe nga mënyra dëftore.

1.6. Përfundime dhe sugjerime

Rezultatet që u sollën këtu i referohen një numri të kufizuar folësish, por gjithsesi numri prej 20 i folësve dhe shifra prej 2000 e fjalive të analizuara nga narrativat e tyre, janë të konsiderueshme dhe tregojnë prirje dhe zhvillime të caktuara të varieteteve të folura të shqipes.

Në përgjithësi, mund të pohojmë se sintaksa e varieteteve të shqipes së folur, me përjashtim të kategorisë së eptimit, paraqiten mjaft të afërta, çka sjell evidenca për tezën që ndarja dialektore e shqipes nuk duhet të jetë shumë e hershme.

Sa i takon kategorisë së përshtatjes së kryefjalës me një folje të eptueshme ose të paeptueshme, ku duket se janë dhe dallimet më të mëdha midis varieteteve të shqipes, të dhënat dëshmojnë që folës të varieteteve të ndryshme hasen me vështirësi të ndryshme në lidhje me këtë çështje, prandaj nevojiten politika gjuhësore më të përshtatshme me qëllim që të lehtësohet dhe të mundësohet përvetësimi më i mirë i varietetit standard në shkollë.

Ky studim ofroi të dhëna me rëndësi, megjithatë, për të përgjithësuar këto rezultate nevojiten studime dhe projekte të një karakteri më të gjerë dhe më të thellë.

Bibliografi

Agalliu, F. 1988. *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: Shtypshkronja "Mihal Duri".

Buxheli, L. 2007. Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe. Tiranë: Neraida.

Buxheli, L. 2011. *Foljet njëvetore në gjuhën shqipe.* Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Botimet Albanologjike.

Carnie, A. 2006. *Syntax: A Generative Introduction. Second edition*. Oxford: Wiley Blackwell Publishers.

Chomsky, N. 1995. *The Minimalist Program.* Cambridge, London: The MTI Press.

Chomsky, Naom. 1981. Lectures on government and binding: the Pisa lectures, Holland: Foris Publications.

Çeliku, M.; Domi, M.; Floqi, S.; Mansaku, S.; Përnaska, R.;Prifti, S. & Totoni, M. 1997. *Gramatika e Gjuhës shqipe: Vëllimi II Sintaksa.* Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Haegeman, L. 1994. *Introduction to Government and Binding Theory.* Oxford UK & Cambridge USA: Blackwell.

Kallulli, D. 1995. *Clitics in Albanian*. University of Trondheim Working Papers in Linguistics 24. Dragvoll: University of Trondheim [Cand.Philol. thesis, 120 pages]

Kallulli, D. 1999. *The Comparative Syntax of Albanian: On the Contribution of Syntatic Types to Propositional Interpretation. Ph*D thesis.

Kananaj, A. 2015. *Rrethanori në gjuhën shqipe.* Monografi. *Qendra e Studimeve Albanologjike.* Tiranë: QMKSH.

Kapia, E. 2013. *Rema dhe kontrasti në gjymtyrëzimin actual të fjalisë.* Në *Studime Filologjike*, Nr. 1-2, f. 63-72.

Kiss, K. É. 1998. Identificational focus versus information focus. *Language* 74: 245 – 73.

Koleci, F. 2013. *Frazat relative të shqipes parë në këndvështrimin gjenerativist*. Monografi. Tiranë: Shkronjë pas Shkronje.

Koleci, F., Turano, G. 2011. *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes.* Tiranë: shblu.

Krifka, M., Musan, R. (eds.). *The expression of information structure*. Berlin/Boston: De Gruyter Mouton.

Lambrecht, K. 1994. *Information Structure and Sentence Form: Topic, Focus and the Mental Representation of Discourse Referents*. Cambridge: Cambridge University Press.

Landau, I. 2004. *The scale of finiteness and calculus of control.* Natural Language & Linguistic Theory 22: 811–877. Kluwer Academic Publishers. Printed in the Netherlands.

Memushaj, R. 2008. *Gjuhësia Gjenerative.* Botim i dytë i përmirësuar. Tiranë: shblu.

Mita, J. 2005. *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes.* Prishtinë: Shpresa.

Mita, J. 2008. Rendi i fjalëve dhe gjymtyrëzimi aktual i fjalive të varura kohore dhe vendore. Në *Studime Filologjike.* Nr. 1-2.

Moro, A. 1997. *The Raising of Predicates: Predicative Noun Phrases and the Theory of Clause Structure*. Cambridge: Cambridge University Press.

Palmer, F. R. 1986. *Mood and Modality.* Cambridge: CUP.

Përnaska, R. 1986. *Gjymtyrëzimi aktual dhe mjetet e shprehjes së tij në gjuhën shqipe.* Në: *Gjuha dhe letërsia në shkollë.* Nr. 16, Tiranë.

Rista-Dema, M. 2006. *Inverse-order Constructions in Albanian English*: *Discourse and Prototype Effects*. Front Cover. [Bloomington, Ind.]: Indiana University, Department of Linguistics.

Riza, Selman. 1994. *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*. Tiranë.

Rrushi, Th. 1983. *Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe*. Në *Studime Filologjike*. Nr. 4, f. 47-56.

Savoja, L. & Manzini, R. 2003. Pjesorja dhe paskajorja në të folmen e Shkodrës. Në *Studime Filologjike*. Nr. 3-4. Tiranë.

Spenser, A. 1997. *Morphological* Theory: *An Introduction to Word Structure in Generative Grammar*. Oxford UK & Cambridge USA: Blackwell.

Turano, Giuseppina. 1994. *Syntactic Dependencies in Albanian*. Ph.D. dissertation, University of Florence, Florence.

Vallduví, E; and Vilkuna, M. 1998. *On rheme and kontrast*. In: *The Limits of Syntax*, Peter Culicover; and Luise McNally (eds.), San Diego: Academic Press, p. 79-108.

Zubizarreta, M.L. 1998. *Prososdy, Focus and Word orden*. Cambridge, MA: the MIT Press.

Anila KANANAJ

SUBJECT REALIZATION IN SPOKEN ALBANIAN VARIETIES: NATURAL DATA FROM NATIVE SPEAKERS

Abstract

This paper investigates subject realization in spoken Albanian varieties with natural data from native speakers. The investigation of the syntactic features of spoken Albanian and its varieties has not attracted much attention among researchers. For this reason this study focuses precisely on the syntax properties of spoken Albanian varieties.

The dataset for this study was created from the *free conversation* portions of the *interviews* of a subset of 20 native *speakers aged* 54 - 90 years (average 71 years), (11 men and 9 women), 5 for each variety, selected according to the dialectological criteria from the study corpus created for the purposes of this study. The conversations were recorded by means of smart phones and *were* subsequently transcribed, coded and analyzed. Each interview averaged 5 minutes in length and was associated with personal information regarding the subject and the consultant that held the interview and recorded the conversation. All the consultants were native speakers of the corresponding Albanian variety. The final dataset contained approximately 2000 clauses (≈ 500 clauses for each variety) with 10061 tokens in total (2536 tokens in Northern Geg variety, 2372 tokens in Southern Geg variety, 2643 tokens in Northern Tosk variety and 2510 tokens in Southern Tosk variety).

Specifically, the study focuses on the position of the subject in relation to the verb, the morpho-syntactic categories that express the subject in the clause, the subject expressed by *pro* and PRO and the agreement of subject with the verb. The results show that with the exception of the PRO subject, generally there in not much of a difference regarding these variables in the data obtained from spoken Albanian varieties. Also, these findings serve as a further support to the assertion that Albanian dialectal division may not have happened at a very early stage.

Merita PLANGARICA - Tomorr PLANGARICA

VARIACIONI GJUHËSOR SI OBJEKT SHQYRTIMI NË SHKENCAT E LIGJËRIMIT

(*Analiza e diskursit *si bashkëplotësuese e shqyrtimeve në* Sociolinguistikë*)

Abstrakti

Shqyrtimet më me ngulm të variacionit gjuhësor (varieteteve gjuhësore e ligjërimore) në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe përvijimi i disa disiplinave a kahjeve të shqyrtimit të kësaj problematike në gji të shkencave të ligjërimit u përftua në bazë të një tradite të përvijuar epokë pas epoke, ndërsa përkujdesja ndaj dukurive gramatikore lidhej ngushtë me shqyrtimet për normën gjuhësore dhe metodologjitë e shqyrtimit të teksteve ; ndërsa përvijimi i dialektologjisë dhe filologjisë më tej mundësoi nxitje për përvijimin e dijes sociolinguistike e analizës së diskursit, dy disiplina që synojnë të njëjtën hapësirë shqyrtimi : studimin e praktikave diskursive e ligjërimore. Gjithsesi, parashtrimet në këtë trajtesë nuk synojnë vështrimin diakronik, por synojnë të nxjerrin në pah kryesisht kontributet e analizës së diskursit, si plotësim i përpjekjeve të sociolinguistikës në studimin e aspekteve të caktuara që lidhen me varietetet gjuhësore, në mënyrë të veçantë në ligjërimin e shkruar. Duke patur parasysh se si synim i analizës së diskursit është përgjithësisht shqyrtimi i produktit që përftohet prej procesit të të thënit të një organizimi tekstor dhe një situate të komunikimit (ndërkohë që sociolinguistika do të interesohet me përparësi për studimin e praktikave ligjërimore autentike në një kontekst të caktuar social), në këto parashtrime do të synohet të përvijohen prirjet e analizës së diskursit në kontekstin e studimeve për gjuhën shqipe dhe praktikat e saj diskursive, për të mundësuar analiza funksionale të varieteteve të ndryshme gjuhësore, sidomos në realitetet shkrimore, por edhe më gjerë.

Përcaktimi sa më i plotë i kontekstit epistemolgjik në të cilin përvijohen dijet për variacionin në gjuhë mundëson shqyrtim më të plotë të dukurisë

Nëse do të pranojmë se për të shqyrtuar në mënyrë sa më të efektshme një objekt të çfarëdoshëm studimi në një fushë të caktuar të dijes gjuhësore (e më gjerë), do të duhet të përcaktojmë sa më qartë problematikën që ai shfaq në një kohë të

caktuar, të përcaktojmë gjithashtu dinamikën e zhvillimit në atë kohë, metodologjinë më të suksesshme dhe tërësinë e koncepteve të përpunuara për të mundësuar shqyrtimin, atëherë objekti i kërkimit të këtij *Seminari* do të na çojë natyrshëm te një dukuri bashkëshoqëruese e gjuhës/ligjërimit, *variacioni*, që në kohë dhe etapa të caktuara të zhvillimit të mendimit gjuhësor arrin të shqyrtohet më plotë e në mënyrë më sistemore; objekti i studimit do të na çojë në kërkimin e metodologjive më funksionale për shqyrtimin e variacionit në gjuhë, në kërkimin e vendit dhe statusit të varieteteve në fushën e studimeve gjuhësore e më gjerë, në kuptimësimin e nocionit të varieteteve në kontekstin e displinave të ndryshme që përfshihen në shkencat e ligjërimit, apo në teoritë që ndriçojnë profile të ndryshme të tyre, por edhe vetë konceptualizimin e atij objekti në një kohë të caktuar. Përcaktimi i disiplinave që interesohen më drejtpërdrejt për shqyrtime të thelluara, përcaktimi i kapaciteteve të tyre për shqyrtim dhe i lidhjeve të natyrshme ndërdisiplinore, është pa dyshim një përbërës i pamënjanueshëm në këtë proces.

Dhe në këtë kontekst epistemologjik, ndër hapësirat më të pranishme shkencore ku integrohet natyrshëm problematika që lidhet me variacionin në gjuhë dhe varietetet gjuhësore janë *sociolinguistika* dhe *analiza e diskursit*.[1]

[1] *Analiza e diskursit* është një disiplinë shkencore që studion ligjërimin si aktivitet i mbështetur dhe i lidhur ngushtë me një kontekst që ndikon në përftimin e njësive përtejfrazore. Duke pasur si qëllim përfundimtar interpretimin e kuptimit, kjo disiplinë është një aktivitet kognitiv i analizës dhe sintezës, i bazuar në kompetenca që e tejkalojnë nivelin gjuhësor dhe që realizohen shkallë-shkallë, sa në nivelin e thënies, po aq edhe në një nivel më tërësor, në nivelin e tekstit-diskursit (Vasile, 2005:73). Ajo parakupton një larmi mënyrash trajtimi, që kanë për emërues të përbashkët hipotezën sipas së cilës (1) domethënia e shenjës nuk është e dhënë një herë e përgjithnjë, por duhet të jetë e përcaktuar sipas kontekstit, dhe (2) aktiviteti ligjërimor e tejkalon nivelin e shenjës dhe të frazës (Angermuller, 2013:11).
Ajo është pjesë e këndvështrimit më të gjerë të gjuhësisë, pjesë e një "gjuhësie të diskursit", e cila "synon të kalohet prej një paraqitjeje frazore ose ngushtësisht tekstore të objektit në shqyrtim, në një paraqitje diskursive, që integron dimensione gjuhësore, tekstore dhe situacionale" (E. Roulet, 1999:6).
Në variantin e shkollës franceze të kësaj disipline (por që përfshin gjithsesi edhe studiues belgë, zvicerianë, kanadezë e nordikë) u kushtohet vëmendje e veçantë *lëndës gjuhësore* dhe *gjurmëve të enonciacionit* (anaforës, modalizimit, dukurive të referencës, deiktikëve, etj.; *diskurseve 'të kultivuara*' dhe *organizimit* të tyre *tekstor*, përballë të folurit spontan; *rregullave* të përftimit të diskurseve të tilla, si ai i rubrikave të caktuara televizive, diskursit politik, të shkencave sociale, diskurseve të përvijuara në mjedise të caktuara institucionale, e po ashtu edhe tipave të diskurseve si argumentativ, përshkrues, rrëfimtar, shpjegues etj.; *përftimit të diskursit* në lidhje me diskurset e tjera, pra *interdiskursit*, si hapësirë e gjerë e përzgjedhjeve të mundshme në brendësi të së cilës subjekti tregon opsionin e tij; u kushtohet vëmendje po ashtu *pozicionimit ideologjik*, duke nxitur kërkimin në analizën e diskursit politik, analizën e ligjërimit të medias, të publicitetit, të diskursit akademik, por edhe të bashkëbisedimeve të zakonshme (shih Vasile, 2005:73-74, 75; Maingueneau 2014:17-25, Angermuller, 2013:5-28).

Synimi ynë në këtë trajtesë nuk është të ndriçojmë profilet e këtij objekti studimi (variacionit dhe varieteteve gjuhësore), e as të përshkruajmë konceptet dhe metodologjitë e përftuara në këto dy disiplina në lidhje me objektin e studimit në fjalë, por të theksojmë disa aspekte që lidhen me kapacitetet e mundshme të këtyre dy disiplinave, specifikat e tyre në shqyrtime dhe sidomos bashkëlidhjet mes tyre drejt përftimit të shqyrtimeve ndërdisiplinore, e pse jo, edhe shumëdisiplinore. Do t'i shmangemi me vetëdije analizave empirike, për t'u përqendruar në përshkrimin dhe interpretimin e veçantive të këtyre disiplinave dhe prirjes për shqyrtime ndërdisiplinore.

Duke përshkruar hapësirat e shqyrtimit në këto dy disiplina, por edhe territoret me të cilat ato lidhen përmes bashkëmarrëdhënieve me disiplina të tjera fqinje, synimi ynë është të nxisim vëmendjen për një përkujdesje sa më të madhe për këtë objekt studimi, të shndërruar në objekt kërkimi për ekipe më të gjera sesa ato që formohen me specialistë thjesht nga fusha e sociolinguistikës, qofshin ata edhe tejet të mirinformuar për problemet e gjuhësisë variacioniste.

Ndërdisiplinariteti, ose shumëdisiplinariteti përbën aktualisht një prirje të suksesshme në disiplinat që kanë formësuar shkencat e ligjërimit, dhe dukuri të tilla si variacioni në gjuhë, e më përkatësisht varietetet gjuhësore me natyrë diastratike, duke qenë se në natyrën e ngjizjes së tyre kanë përbërës që lidhen me aspekte të larme diskursive, sociale, etj., e kanë të nevojshëm edhe këtë këndvështrim ndërdisiplinor a shumëdisiplinor.[2]

[2] Duke e konsideruar variacionin në gjuhë si dukuri bashkëshoqëruese të vetë ekzistencës së gjuhës, të pandashme nga zhvillimi i saj, duke pranuar se gjuhët variojnë/ndryshojnë sipas tri akseve të mëdha, *hapësirës*, *shoqërisë* dhe *kohës* (siç dihet, tashmë, variacioni sipas aksit të hapësirës është quajtur nganjëherë *variacion diatopik* ose *topolektal*, *variacioni social* është quajtur *diastratik* – në të bashkëshoqërohen variacioni stilistik ose diafazik, variacioni sipas aksit të kohës është cilësuar si i *diakronisë*), objekti ynë i shqyrtimit përqendrohet vetëm në problematikën që shfaq variacioni social.

Nisemi nga pohimi se « gjuha mund të ndryshojë në të njëjtin moment dhe në të njëjtin vend në funksion të faktorëve socialë ». Përmbledhtazi mund ta vëmë theksin në dy faktorë të rëndësishëm socialë, ndikues në përzgjedhjet gjuhësore :

a) situata sociale e folësve, e cila ndikon në përvijimin e varieteteve të ndryshme gjuhësore ose sociolektet (flitet në këtë rast edhe për dialekte sociale) ;

b) konteksti i komunikimit që parakupton *kontekstin social* (një tërësi situatash, vendesh dhe rrethanash që përcaktojnë një tip të caktuar të shprehjes gjuhësore – p.sh., fjala e Presidentit në TV, diskurset në Akademi, kurset universitare, etj) ; *konteksti instrumental* (i përvijuar prej kushtëzimeve teknike që ndikojnë në komunikim, për shembull, kanali i komunikimit që përcakton përzgjedhjet gjuhësore) ; *konteksti referencial*, i përvijuar nga vetë brendia e komunikimit – në funksion të temës dhe qëndrimeve sociale mbizotëruese ndaj subjektit bëhet edhe përzgjedhja e mjeteve gjuhësore). (Shih më gjerë Klinkenberg, 1999 :29-55.)

Siç mund të vërehet, profilet e objektit të synuar për shqyrtim janë të larmishme, prej nga nxitet këndvështrimi ndërdisiplinor a shumëdisiplinor. Ndërkohë, problemet e përvijuara në lidhje me

Të mëtosh parashtrimin e argumenteve në dobi të një shqyrtimi ndërdisiplinor të një dukurie si variacioni gjuhësor, ose të produkteve të përftuara si pasojë e variacionit, të varieteteve gjuhësore, për të cilat bihet përgjithësisht në një mendje që kanë zotëruar hapësirat qendrore të një disipline të veçantë siç është *sociolinguistika*, kërkon paraprakisht të parashtrosh disa çështje që në aspektin epistemologjik do të justifikojnë mëtimin fillestar: - a është shqyrtimi ndërdisiplinor një mundësi për të thelluar njohjen për objektin e shqyrtuar apo është thjesht një zgjerim horizontal që nuk e bën të mundur thellimin në lidhje me njohjen e atij objekti? – a e parakupton shqyrtimi i "gjuhës/ligjërimit" aktualisht këtë bashkëmarrëdhënie ndërdisiplinore dhe a janë thelluar në njohje aspekte të ndryshme të konceptualizimit të "gjuhës" dhe "ligjërimit"? – përse mëtohet shqyrtimi i marrëdhënieve të *sociolinguistikës* me *analizën e diskursit*, ndërsa diskutohet për variacionin në gjuhë dhe varietetet gjuhësore? – ç'qëndrime do të mbahen në lidhje me variacionin në gjuhë, dhe për cilat varietete gjuhësore shqyrtimet e sociolinguistikës dhe analizës së diskursit mund të jenë më të efektshme? – mbi cilat metodologji të përpunuara tashmë në përvojat europiane e më gjerë mund të mbështeten kërkimet gjuhësore për këtë problematikë të gjuhës shqipe?

Përmbledhtazi mund të themi se epoka e tanishme nxit prirjen drejt ndërdisiplinaritetit në shqyrtime, madje shumëdisiplinaritetit në studimin e gjuhës/ligjërimit, sepse pjesë e kontekstit epistemologjik janë bërë edhe të tjera kategori, si enonciacioni/tw thënët, subjekti, konteksti, situata komunikative, etj.; sepse kërkohen edhe të tjera funksione që përmbushen përmes përdorimit të gjuhës, jo thjesht ato paraqitës, informues ..., por sidomos edhe veprues, shndërrues; sepse vetë objekti i studimit "gjuhë" vërehet në një shumësi profilesh (në të synohet të shqyrtohen jo thjesht njësitë e nënsistemeve të ndryshme nga tingulli-fonemë e deri te fjalia, por edhe produktet e përftuara në procesin e përdorimit të atyre njësive, produkte të kushtëzuara më së tepërmi edhe nga faktorë jashtëgjuhësorë, kontekstualë, situativë, të cilët kushtëzojnë kuptimet e bartura dhe të përçuara; sepse vetë gjuhësia është integruar natyrshëm në një hapësirë më të gjerë shqyrtimesh e bashkëlidhjesh, që i mundësojnë shqyrtime të aspekteve të pashqyrtuara më parë; sepse epoka e sotme mundësoi të fitojnë ekzistencë tejet të shfaqur e të mirëformësuar edhe ato veti të bartura potencialisht në ligjërim e të shfaqura si të tilla në një kohë të caktuar – një ndër këto veti bashkëshoqëruese të ekzistencës e zhvillimit të gjuhës është edhe *variacioni* në gjuhë.

variacionin social, në aspekte të ndryshme të shfaqjes së tyre, janë brenda interesimeve të *analizës së diskursit*.

Shtjellimet në vijim do të bëhen duke patur në mendje edhe këto çështje, të cilat të mundësojnë të shohësh më larg dhe në një perspektivë më të qartë temën në diskutim.

Shqyrtimi ndërdisiplinor, prirje që mundëson shqyrtime më të thelluara dhe gjithëpërfshirëse

Në fushën e gjuhësisë, shekulli XX përcaktoi në thelb dy karakteristika qenësore të gjuhësisë: nga njëra anë, autonominë e saj si shkencë, si dije shkencore; nga ana tjetër, natyrën shumëprofilëshe të objektit të studimit, e cila bënte të detyrueshme një përmasë po ashtu shumëprofilëshe e të shumëfishtë të atij mendimi, që prirej drejt një vështrimi shumëdisiplinor.

Vështrimi i kësaj dialektike të ekzistencës së objektit "gjuhë/ligjërim" mundësoi në gjysmën e dytë të shekullit XX një konceptim më të gjerë të kësaj hapësire shumëdisiplinore ku mund të vihej objekti i studimit (madje në përvojat franceze të studimit, edhe një emërtim po ashtu më të gjerë të asaj hapësire, "shkencat e ligjërimit", që parakuptojnë një rivështrim dhe ripozicionim të gjuhësisë në lidhje të ngushtë me fusha të ndryshme shkencore që përcaktohen në këtë hapësirë studimi). [3]

Në fakt, gjysma e dytë e shekullit XX solli një tregues të ri që ridimensionoi përmasat e objektit të studimit në fushën e gjuhësisë: shfaqjen e subjektit në objektin gjuhë/ligjërim : tashmë i duhej dhënë vendi i duhur në shqyrtim njeriut, folësit, thënësit, i cili do të shfaqet si qenie biologjike e sociale, në kontekste të caktuara të ndryshme që kushtëzojnë përftimin e produktit gjuhësor, dhe që kërkojnë të tjera këndvështrime në shqyrtim (po ashtu edhe të tjera koncepte teorike dhe të tjera metodologji).

Shfaqja e kësaj problematike dhe shqyrtimi i saj bëhej i mundur veçse kur gjuhësia do të përdorte aspekte plotësuese shqyrtimi që vinin prej shkencave të tjera. Prurjet e gjuhësisë tashmë janë edhe për problemet që shfaqen përpara njeriut, ndërsa ai përballet me gjuhën, ligjërimin në shoqëri; për më tepër, për lidhjet që përvijohen mes "gjuhës" nga njëra anë, dhe ngarkesave sociale, nga ana tjetër, të cilat ndikojnë në përftimin e diskurseve të ndryshme në përditshmëri, të variacionit dhe varieteteve të caktuara ligjërimore/gjuhësore në komunikim.

[3] Emërtimi « shkencat e ligjërimit » shfaqet në vitet 1980, në *Konferencat* e gjuhësisë që u mbajtën në Sorbonë në qershor 1982 ; dhe më tej mori të drejtën dhe statusin e një emërtimi të gjithëpranuar prej gjuhësisë në numrin 1 të revistës që paraqitet më 1984, BUSCILA (Bulletin de l'Association des Sciences du Langage/Buletini i Shoqatës së Shkencave të Ligjërimit) që propozon një përmbledhje tekstesh të prodhuara përgjatë ose në kohën e funksionimit të Konferencave (shih më gjerë Mazière, 2005 :67).

Aparati përshkrues, sado i sofistikuar dhe i përsosur qoftë në shqyrtimet strukturaliste, në analizat fonologjike, morfologjike, sintaksore, leksikore e semantike (të përftuara nga shqyrtimi i dimensionit "të brendshëm" të gjuhës në kuptimin sosyrian, në shqyrtimin e gjuhës *më vete dhe për veten*), do të duhej të plotësohej nga shqyrtimet dhe legjitimimi i folësve të këtyre idiomave, mjedisit, etj., duke mundësuar njëherazi një rinovim epistemologjik të kuptimit të koncepteve të trashëguara "gjuhë" dhe sidomos "të folur/parole", duke përvijuar në këtë mënyrë ndërlidhje të reja në faktet gjuhësore me kontekstin e prodhimit të *diskurseve*[4] (shih më gjerë Boutet&Maingueneau, 2005:17-21; Angermuller, 2013: 11-15).

Dije në kryqëzim disiplinash, disiplina në kryqëzim dijesh

Edhe pse dukuri të ndryshme gjuhësore mund të jenë të pranishme në gjuhë prej kohësh, vëmendja ndaj tyre dhe, për më tepër, shqyrtimi i tyre fillon dhe përvijohet në një kohë të caktuar, kur krijohen kushte teorike, dije, koncepte dhe metoda të përshtatshme për ta shndërruar atë dukuri, atë objekt, në objekt studimi: kështu, për shembull, vëmendja dhe preokupimi për studimin e variacionit gjuhësor

[4] Termi "diskurs" është ndër më polisemikët në fushën e gjuhësisë. Për gjuhëtarët që përqasin tradicionalisht sistemin gjuhësor me aktualizimin e tij në kontekst, diskursi është përcaktuar përgjithësisht si *gjuha në përdorim* ; shtohet në disa raste në përkufizim edhe një dimension komunikues, duke e përcaktuar diskursin si ligjërimin përtej fjalës, grupit të fjalëve dhe fjalisë, i mataruar në mënyrë të tillë që të arrihet një komunikim i efektshëm. Nocioni i *language in use*, i përdorur dendur në literturën anglofone si parafrazë për "diskurs" bashkëshoqëron dy opozicionet që mund të vërehet diskursi : *tekstore* (diskurs vs frazë) dhe *kontekstuale* (diskurs vs gjuhë). Kështu diskursi është përcaktuar shpesh në dy mënyra : një tip i veçantë njësie gjuhësore (përtej frazës) dhe një përqendrim në përdorimin e gjuhës.
Përtej gjuhësisë, në kahje e rryma të ndryshme teorike në përbërje të shkencave humane e sociale, nocioni i *diskursit* është plotësuar me të tjera veti. Në ato kontekste : diskursi është një organizim përtej frazës, që mobilizon struktura të një natyre tjetër nga fraza ; është një formë veprimi mbi tjetrin dhe jo vetëm një paraqitje e botës ; është ndërveprues, pra angazhon dy a më shumë partnerë ; është i kontekstualizuar, pra jashtë kontekstit nuk mundt t'i jepet kuptim një thënieje, merret ngarkim nga një subjekt ; funksionon në përshtatje me norma të caktuara ; merr kuptim veçse në brendësi të një hapësire më të gjerë diskursesh dhe e ndërton kuptimin brenda praktikave sociale të caktuara. (Maingueneau, 2014 :17-25).
Në praktikat tona studimore për *diskurs* përdoret përgjithësisht termi *ligjëratë* (ne kemi parapëlqyer "përftesë ligjërimore") ; gjithsesi termi ka qenë propozuar në kontekste të tjera, kryesisht në kuadër të gjuhësisë së tekstit, kontekste që nuk janë domosdoshmërisht të barasvlershme me kuptimet që ne e përdorim në kuadër të analizës së diskursit ; në propozimet që janë bërë më parë janë bartur njëherazi edhe ngarkesat kuptimore plotësuese të shkollave a kahjeve teorike të cilave ato u referohen, e po ashtu edhe një tradite tonës në trajtimin e atyre dukurive, ose të dukurive të afërta me to.

shfaqet më e fortë në shekullin XX, kur shfaqet më me forcë një përkujdesje e veçantë ndaj normës dhe metodologjive të studimit të teksteve.

Gjithsesi, duhet theksuar që qoftë përkujdesja ndaj normës, qoftë ajo ndaj metodologjive të studimit të teksteve vërehen shumë e shumë kohë më parë, madje qysh në Antikitetin e largët, veçanërisht në periudhën aleksandrine në shekullin IV-I para erës sonë. Studiuesit vënë në dukje se prirja e shqyrtimet më intensive për aspektet gramatikore në gjuhë në atë kohë, nuk ndahej gjithsesi nga përvijimi i një norme dhe studimi i teksteve. Po aq e hershme është edhe përkujdesja ndaj "diskursit". Madje "analiza e diskursit është e vonë veçse në emër, sepse rrënjët e saj shkojnë në Antikitetin e largët me veprën e Aristotelit... Të habit "moderniteti" i qëndrimeve të atyre kohëve përsa i përket ndërgjegjësimit në lidhje me diskursin, i parë si vlerë themelore e shoqërisë, edhe më e rëndësishme se pushteti ose paraja" (Vasile, 2005:66).

Shumë kohë më vonë, në shekullin XIX, spikatën në mënyrë të veçantë dy kahje shqyrtimesh, duke përvijuar studime në fushën e dialektologjisë nga njëra anë dhe të filologjisë, nga ana tjetër, "një filologji me synime shkencore, të shoqëruara me teknika të hulumtimit dhe analizës specifike" (Boutet&Maingueneau, 2005:15).

Krijohen në këto kahje studimi korpuse dijesh të cilat mundësojnë, në gjysmën e dytë të shekullit XX, aty nga vitet 1960, të përvijohen dy disiplina shkencore: *sociolinguistika* dhe *analiza e diskursit*. Mes përcaktimeve të shumëllojta, produkt i pikëvështrimeve të ndryshme në lidhje me dijen e përftuar dhe funksionin e saj në fushën përkatëse, do të theksonim se bëhet fjalë për dy disiplina të cilat synojnë të shqyrtojnë një dimension të ri të gjuhës/ligjërimit, të zgjeruar tashmë prej treguesve situacionalë në përdorim dhe socialë në natyrë.

"Ajo çka quhet sociolinguistikë, nuk është... një fushë ose një nën-fushë, por më shumë është një pikëtakim midis tri çështjeve me origjinë të ndryshme: çështjes *sociologjike* të vendit të ligjërimit në shoqëritë njerëzore dhe në procesin social; çështjes *gjuhësore* e variacionit ligjërimor dhe problemeve që ky i fundit (i supozuar mirëfilli i përshkrueshëm në terma sociologjikë) parashtron në teorinë gjuhësore; çështjes *praktike* të përdorimit social të ligjërimit (të mësuarit dhe pedagogjia, normalizimi, terminologjia, përkthimi në situatë, planifikimi gjuhësor, etj.)" (P. Achard, 1986:5); dhe këtë këndvështrim do ta gjenim më të përmbledhur në pohimin që sociolinguistika është "studimi i praktikave ligjërimore autentike në kontekstin social" (F. Gadet, 2003:5).

Dhe ja një ndër pohimet e përdorura rëndom për analizën e diskursit: "...ajo që e bën të funksionojë analizën e diskursit, është të kuptosh diskursin si një ngërthim të një teksti dhe një vendi social, domethënë që objekti i saj nuk është as organizimi

tekstor, as situata e komunikimit, por ajo çka i lidh ato përmes një mekanizmi të enonciacionit specifik, njëherazi verbal dhe institucional" (Maingueneau, 1995:7)[5].

Siç vërehet edhe nga pohimet e mësipërme, kemi të bëjmë me dy disiplina që jo vetëm mund të përshihen në një fushë të përbashkët studimi, por edhe kanë në përdorim koncepte e kategori të përbashkëta që mund të përdoren më tej për profile më specifike shqyrtimi. Për më tepër, edhe vetë ato aspekte e dukuri më specifike shqyrtimi i bashkon përvijimi dhe prania e tyre e gjithëkohshme në një kategori të përbashkët që përbën qendrën e interesimeve të të dy disiplinave: *praktikave diskursive* dhe *ligjërimore*.[6] (shih më gjerë, Boutet&Maingueneau, 2005:16).

Konteksti i përbashkët epistemologjik që nxiti përvijimin e dijes në fushat e *sociolinguistikës* dhe *analizës së diskursit* nuk pengonte gjithsesi që çdonjëra nga disiplinat të kishte veçantitë e saj në shqyrtim, e çka është po aq e rëndësishme, të kishte edhe interesime më të veçanta për aspekte të caktuara të praktikave ligjërimore e diskursive në shqyrtim. Por, nga ana tjetër, veçantia në objektin e shqyrtimit nuk i shndërron këto disiplina në dije me status vetmitari; përkundrazi, thellimi dhe zgjerimi në shqyrtimin e profil-it/-eve përkatës/-e veçse i afron kufijtë me hapësirat e disiplinave të tjera, veçse i pranëvë këto disiplina me njëra-tjetrën.

Në kufijtë e një paraqitjeje të kursyer, të vësh përballë njëra-tjetrës këto dy disiplina, për më tepër të mëtosh t'i shqyrtosh ato në tërë hapësirën ku ato kultivohen, dhe të vëresh larminë e këndvështrimeve që janë përvijuar tashmë në atë hapësirë, duke përftuar natyrshëm kahje shqyrtimesh me një mori autorësh, sigurisht që do të ishte e pamundur, por le të parashtrojmë disa linja të kësaj problematike për të nxitur debatin e mëtejshëm.

---

[5] Probleme të caktuara të analizës së diskursit janë përfshirë dhe shqyrtuar në literaturën tonë gjuhësore, kryesisht në kuadër të *stilistikës gjuhësore*, por edhe të *gjuhësisë së tekstit* ; po ashtu disa nga konceptet me të cilat ngjizen këndvështrimet teorike në analizën e diskursit gjenden në trajtesat e ndryshme të studiuesve tanë të emërtuar me terma të tjerë ; ndërsa një pjesë tjetër termash ende nuk kanë hyrë në përdorim.

Për t'iu shmangur paqartësive të vetvetishme që hasen kur u referohesh në mënyrë rastësore përvojave dhe terminologjisë së përdorur në disa rryma a kahje shqyrtimi, ne kemi përdorur vetëm atë terminologji që është më e përdorur në këtë fushë studimi në këto përvoja të cilave u jemi referuar. Për më tepër, që "analiza e diskursit është një shembull i dukshëm i përvijimit të koncepteve pa gjenealogji, ndërkohë që kjo gjenealogji mund të vërehet veçse në dhe nga historia e disiplinës" (Mazière, 2005:63). Jemi të ndërgjegjshëm për problemet që lindin në përqasjet e shkollave të ndryshme, ndaj e konsiderojmë edhe këtë përpjekje tonën si pjesë të një diskutimi shumë më të gjerë e më të thelluar që s'duhet të vonojë.

[6] *Praktikat diskursive* - aktivitetet që lidhen me përdorimin e gjuhës, ose diskurset në përgjithësi. Emërtim i përdorur për të nënvizuar që diskursi është një veprim social.

Praktikat ligjërimore – shfaqjet a demonstrimet e ndërveprimit të faktorëve të ndryshëm gjuhësorë, psikologjikë, sociologjikë, kulturorë, eukativë, emocionalë… në përdorimin e gjuhës.

Edhe pse datimi në vitet 1960 nuk shënon hershmëri (pavarësisht se gjurmët e interesimeve vërehen shumë më parë), në të dyja disiplinat është përvijuar një traditë që duhet shqyrtuar me kujdes kur dëshiron të vëresh më tej marrëdhëniet ndërdisiplinore të përftuara në ndriçimin e një objekti të caktuar studimi prej tyre; një traditë e përvijuar në një kontekst interesimesh ku në qendër janë praktikat ligjërimore dhe diskursive, që nxisin përvijimin e dijeve komplekse që në ato vite do të shfaqeshin në fusha të ndryshme studimi më të përafërta a më të largëta me njëra-tjetrën, por që, gjithsesi, të gjitha do të përqendroheshin në profilet në të cilat gjuhësia nuk kishte mundur të hidhte ndriçim më parë: vëmendja nuk përqendrohej më vetëm tek elementet a njësitë e sistemit gjuhësor, por edhe te veti, tregues, kategori të procesit përdorimor të gjuhës, në lidhje të ngushtë me vendin, situatat, folësin a folësit e saj.

Analiza e diskursit, si mundësi për shqyrtim të aspekteve të caktuara të praktikave diskursive

Në përvojat studimore, sidomos të Europës Perëndimore dhe të Shteteve të Bashkuara, të rrymave të ndryshme, e shpesh të pavarura nga njëra-tjetra, duke nisur nga gjysma e dytë e shekulit XX u tregua një përkujdesje e veçantë sidomos për problematikën e gjerë që ngërthente çështja e aktivitetit ligjërimor dhe e tekstualitetit në produktet verbale, të vështruara ndryshe nga mënyra që ishin parë këto çështje në mënyrë klasike nga gjuhësia.

Shfaqet një pamje me reliev tejet të larmë: është një larmi jo thjesht brenda hapësirës së një fushe studimi, por e pranishme në një hapësirë ku ofrohen kontribute në shqyrtimin e dukurive gjuhësore, letrare, filozofike, etnologjike, antropologjike, pragmatike, enonciative, kulturologjike, etj.; një hapësirë shqyrtimesh po ashtu e larme, kur vëren që shfaqet me ngjyrime origjinale në Europë, madje me tepër veçanti në shkollën franceze a gjermane; ose në SHBA, me të tjera pikëvështrime, të mbështetura edhe ato në të tjera tradita. Do të vlerësohen veçanërisht në këtë hapësirë shqyrtimet e drejtpërdrejta të diskursit nga shkolla franceze e analizës së diskursit, e frymëzuar prej prurjeve filozofike të Althusser-it, me figurën më përfaqësuese të saj, M. Pêcheux-në. Do të jenë bashkëplotësuese të atyre këndvështrimeve kontributet e përftuara në kuadër të gramatikës së tekstit, apo të teorive të enonciacionit a pragmatikës.

Por do të jetë e një tjetër natyre pamja në hapësirën shqyrtuese anglo-saksone, ku dijet e përftuara në etnografinë e komunikimit do të priren më së tepërmi drejt fushave të sociolinguistikës dhe antropologjisë, duke e ngjyruar në një mënyrë tjetër traditën e përftuar dalëngadalë në ato studime, më larg tekstit të shkruar dhe më pranë gjuhës së folur. Dhe plotësohen më tej ato këndvështrime edhe nga shqyrtimet e

sociologëve atje, që duke synuar shqyrtime në etnometodologji, përafrohen po ashtu edhe në studimin e bashkëbisedimeve.[7] Dhe emra të tillë si D. Hymes a J. Gumperz (në etnografinë e komunikimit), H. Garfinkel ose H. Saks (në etnometodologji apo analizën e bashkëbisedimit) do të jenë pranë kontributeve të mendimtarëve që lëviznin lirshëm në të dyja hapësirat dhe që praktikat diskursive i çuan në interpretime më të mirëfillta filozofike, semiotike a kulturologjike, si M. Foucault-ja, M. Bakhtin-i ose G. Bateson-i. Relievi mbetet tërësisht i larmë ngaqë të gjitha rrymat, kahjet a disiplinat në përvijim e sipër "nuk kanë përftuar gjithsesi një përputhje doktrinore" (Boutet&Maingueneau, 2005:32).

Në studimet e shumta tashmë për analizën e diskursit theksohet se në Europë lindja dhe zhvillimi i kësaj disipline u bë në kushte krejt të tjera nga ato që ekzistonin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në Europë, ecuria e përvijimit të mendimit në këtë disiplinë vërehet kryesisht në tri faza:

në një fazë të parë, në vitet 1960, kur përmes nxitjes që sillte strukturalizmi në gjuhësi, shfaqeshin një sërë problemesh të tjera në diskutim edhe në fusha të tjera, si në studimin e letërsisë (u përvijua një dije e natyrës strukturaliste në studimin e tekstit letrar), në atë të semiologjisë (fymëzuar nga prurjet e M. Greimas-it) ose në atë të historisë dhe filozofisë (analiza e diskursit frymëzuar nga prurjet e Lacan-it dhe Althusser-it), po kundërshtoheshin mënyrat tradicionale të leximit, kuptimit e interpretimit të teksteve. Përftohet në këtë fazë jo vetëm një prirje e re në leximin e interpretimin e diskurseve/teksteve të shkruara, kryesisht të natyrës historike e politike, por edhe një tërësi konceptesh të reja të cilat kuptimësohen pikërisht në atë korpus dijeje;

në një fazë të dytë, duke filluar nga gjysma e dytë e viteve 1970, kur në këtë fushë shqyrtimesh ndikojnë dhe luajnë rol të rëndësishëm edhe shkencat e ligjërimit, përmes disiplinave të tilla, si gramatika e tekstit, teoritë e enonciacionit, pragmatika, me mjetet e tyre konceptuale dhe metodologjike në shqyrtim; po ashtu në këtë periudhë ndikojnë edhe prurjet e fushave të reja, të tilla si studimi i gjuhëve të specialitetit, veçanërisht kahjet e shumta të përvijuara në studimin e mediave; me ndikim ka qenë gjithashtu edhe referenca në veprën e M. Bakhtinit të "rizbuluar", me konceptet e "dialogizmit" a të "gjinive të diskursit";

[7] "Në një këndvështrim të përgjithshëm, tek anglo-saksonët, *analiza e diskursit* i korrespondon *analizës së bashkëbisedimit*, që i kushton vëmendje studimit të ndërkëmbimeve verbale të folura ose të shkruara, me aksiomën që çdo diskurs është mirëfilli ndërveprues" (Paveau, Sarfati, 2011 :194).

dhe në një fazë të tretë, duke nisur prej viteve 1980, kur përthithen edhe prurjet e studimeve amerikane dhe dija përfton një natyrë ndërdisiplinore, por edhe ndërkombëtare, me një ndërveprim të shprehur ndaj objektit të shqyrtuar, si gjuhë e folur apo e shkruar, me tipe të diskurseve apo teksteve që e kapërcejnë ndarjen tradicionale për t'u shqyrtuar vetëm në fakultetet e letrave, apo veçmas në ato të shkencave sociale (Boutet&Maingueneau, 2005:16-19; Mazière, 2005:26-41; Angermuller, 2014:13-28).

Theksohet në këtë mënyrë prirja për studime me karakter ndërdisiplinor, zgjerohet korpusi në shqyrtim, integrohen natyrshëm në përvojat shqyrtuese gjuha e folur dhe ajo e shkruar, dhe në përqasjen e këtyre realiteteve gjuhësore shtohen mundësitë për shqyrtime dhe interpretime të variacionit në gjuhë; për më tepër, të varieteteve që mundësojnë veçantitë e ngjizjes së diskurseve/korpuseve të analizuara.

Sociolinguistika, si mundësi për shqyrtim të aspekteve të veçanta të produkteve verbale, pranë një shumësie vështrimesh të përafërta

Pikërisht në këtë kontekst epistemologjik, brenda këtyre parametrave të gjykimit të përmasave të produkteve verbale, të diskurseve të folura a të shkruara, përftohet edhe dija në fushën e sociolinguistikës. Madje "në botën anglo-saksone ngërthimi mes sociolinguistikës dhe *discourse analysis* është i ngushtë dhe kufijtë nganjëherë të vështirë për t'u ravijëzuar" (Boutet&Maigueneau, 2005:20).

Është bërë zakon që përvijimi i kësaj fushe studimi të lidhet në nisje me kontributet dhe shqyrtimet e W. Labov-it, dhe në fakt, interesimet e tij vunë në qendër pikërisht praktikat komunikative, diskursive e ligjërimore (të të rinjve me ngjyrë apo të dialogimit mjek-pacient), për të analizuar karakteristikat gjuhësore të lidhura me ato mjedise sociale e profesionale; e duke dhënë në këtë mënyrë një pamje domethënëse që përafronte këta gurë themeltarë të sociolinguistikës e gjuhësisë variacioniste me hapësirat dhe sinorët e analizës së diskursit.

Madje këto përafrime mundësojnë edhe më shumë zgjerimin e problematikës së shqyrtuar brenda dijes sociolinguistike, bërë përmes kahjeve plotësuese të saj që ngjizeshin njëherazi në përvojat anglo-saksone, si *sociologjia e ligjërimit*, *etnografia e komunikimit*, etj.; po ashtu, emërtime bashkëplotësuese dhe kahje shqyrtimi bashkëplotësuese vërehen edhe në shkollën franceze të gjuhësisë, në të cilën qysh në fillime haset termi "sociologji e ligjërimit" (vepra e M. Cohen-it "Për një sociologji të ligjërimit", 1956), dhe gati njëzet vjet më vonë do të përdoret emërtimi "sociolinguistikë", me veprën e J.-B. Macelles-it dhe B. Gardinit "Hyrje në

sociolinguistikë" (1974), megjithë praninë në të të emërtimeve "gjuhësi sociale" ose edhe "etnolinguistikë".

Gjithsesi, vijon edhe sot e kësaj dite të diskutohet në lidhje me kufijtë ose hapësirat "brendafamiljare" të sociolinguistikës, sociologjisë së ligjërimit dhe etnolinguistikës; madje vëren të botohen njëherazi vepra të emërtuara herë "sociolinguistikë" ose herë "sociologji e ligjërimit".

Në këtë kontekst shumëprofilësh nuk mungojnë edhe propozimet për këndvështrime më përgjithësuese në atë larmi emërtimesh (për shembull, A. Tabouret-Keller-i hedh idenë e ndërtimit të një disipline përbashkuese, të cilën ajo e emërton "antropologji e ligjërimit" (1977); ndërsa G. Varro është i mendimit se sot "*sociolinguistika e ligjërimit* do të jetë një sektor i sociologjisë, *sociolinguistika* një sektor i gjuhësisë (një lloj gjuhësie (1999:127) (shih Boutet&Maingueneau, 200522-23).

Gjithsesi, këto interpretime, me përgjithësimet dhe specifikimet e bartura veçse të nxisin më tej idenë se heterogjeniteti dhe ndërdisiplinariteti përftohen në shqyrtime, sepse vetë objektet e studimit shfaqen heterogjene në përbërje dhe të ndryshueshme në përmasa.

Madje mund të pohohet se "sociolinguistika dhe analiza e diskursit zhvillohen në një hapësirë të praktikave diskursive e ligjërimore të përforcuar nga shkencat e ligjërimit, përmes një ndërveprimi të përvijuar me fushat e tjera të shkencave sociale dhe humane... ... specialistët e analizës së diskursit, të sociolinguistikës, analizës së bashkëbsedimit etj., kanë të përbashkët një numër të caktuar aksiomash dhe burimesh konceptuale dhe metodologjike; është e kuptueshme, gjithsesi, që këto aspekte të përbashkëta duhen menduar më shumë sipas këndvështrimit të familjes vitgenshtejane sesa sipas mënyrës tjetër, të kushteve të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'i përkitur një klase"[8] (Boutet&Maingueneau, 2005:24).

Ndërdisiplinariteti/shumëdisiplinariteti në shqyrtim parakupton pozicionime dhe organizime të reja të procesit të kërkimit

Dukuritë që kanë të bëjnë me diskursin, bëjnë, pra, të interesuara për to disiplina të ndryshme shkencore në hapësirën e shkencave të ligjërimit. Po ashtu, edhe

[8] Vitgenshtejni përdor togun « ngjashmëritë familjare » dhe parakupton me këtë term ngjashmëri për të cilat nuk mund të përcaktohet elementi që krijon ngjashmërinë. Anëtarët e së njëjtës familje mundet që të kenë që të gjithë një "pamje/fizionomi të familjes", pa arritur të përcaktohet, pa u dalluar gjithsesi ajo çka i bën që të kenë këtë pamje të familjes. Kjo mënyrë kategorizimi binte ndesh me atë të përcaktimit të kushteve të nevojshme e të mjaftueshme që vinte qysh prej Aristotelit, ku kërkohet të përcaktohen qartazi elementet a tiparet që i mundësojnë një sendi të bëhet pjesë e një klase të caktuar.

problematika që ngërthen variacioni në gjuhë, e shqyrtuar me përparësi në fushën e sociolinguistikës, me problemet e përftuara në formën e varieteteve të ndryshme gjuhësore është pjesë e shqyrtimeve edhe në analizën e diskursit.

Përkatësia e objektit të studimit ose e aspekteve të caktuara të tij në njërën a tjetrën disiplinë, nga njëra anë, apo shqyrtimi njëherazi nga dije dhe metodologji që vijnë nga disiplina të ndryshme, e po ashtu edhe nga ekipe heterogjene me përkatësi nga fusha të ndryshme formimi, nga ana tjetër, përbëjnë sot dy pirjet kryesore të shqyrtimit edhe në këtë hapësirë që po flasim.

Mund të vërehet që variacioni, për shembull, përbën objektin e privilegjuar në një disiplinë si *sociolinguistika*; po ashtu, mund të konsiderohen objekte të mirëfillta të shqyrtueshme prej saj produktet verbale në mjediset familjare me prindër me përkatësi gjuhësore të ndryshme, ligjërimet e grupeve të të rinjve në mjedise të ndryshme, shkollore ose jashtëshkollore, në gjimnaze a universitete; vendet e punës dhe praktikat e ndryshme ligjërimore atje; problemi i krijueshmërisë së grupeve sociale, i ndryshimeve gjuhësore në rastin e përzierjes së gjuhëve në kuadër të sociolinguistikës urbane ose të punës, etj. ; mund të vërehet nga ana tjetër, që gjinitë e diskursit do të jenë në qendër të shqyrtimeve të një *analize të diskursit*; që ndryshimet a dallimet mes seksesve do të reflektojnë edhe qëndrime të diferencuara ligjërimore, probleme që do të interesojnë në veçanti studiues në kuadër të *analizës kritike të diskursit*.

Por, po ashtu, vërehet një prirje e përkundërt, vërehet që disiplinat a dijet në disiplina të ndryshme përdoren në shqyrtimin e problemeve nga më të ndryshmet, pa 'ruajtur' përparësinë e përqendrimit në "objektet klasike" të përvijuara tradicionalisht, duke e konsideruar të tepërt kërkesën për inkuadrimin e problemit të caktuar në përkatësinë e drejtpërdrejtë të tij në sociolinguistikë, në analizën e bashkëbisedimeve, në analizën e diskursit, etj. Boutet dhe Maingueneau theksojnë: "...nuk duhet të kënaqemi duke bërë harta përkatësish sipas disiplinave të studimeve mbi aktivitetin ligjërimor, të presupozimeve teorike dhe metodologjike. Por duhet parë mundësia dhe duhet rezervuar vendi edhe për një mënyrë tjetër të grupimit të studiuesve, të lidhur ngushtë me mënyrat e të punuarit e në veçanti me praktikën e ndërdisiplinaritetit ose të shumëdisiplinaritetit: këto janë *territoret* e përcaktuara nga pjesa e një *objekti të njëjtë studimi*, si për shembull, diskursi televiziv, diskursi administrativ, të folmet e të rinjve, diskurset në situatat e punës, etj." (Boutet&Maingueneau, 2005, 37-38).

Shumëdisiplinare për nga natyra, këto grupime të lidhura në mënyrë pak a shumë të drejtpërdrejtë me një kërkesë sociale ose politike mundësojnë bashkëpunimin në mënyra të ndryshme të disiplinave të cilave u përkasin. Krijimi i ekipeve të studiuesve që grupohen përreth të njëjtit objekt (le të themi të njëjtit territor

pa i përkitur së njëjtës disiplinë nuk është diçka anësore; kjo pirje po merr gjithnjë e më shumë rëndësi në shqyrtimet e shkencave të ligjërimit.

Variacioni gjuhësor, veçanërisht produktet e përftuara në formën e varieteteve në gjuhë përbëjnë objekte të tilla që e parakuptojnë këtë mënyrë shqyrtimi. Ligjërimi dhe diskurset në mediat pamore, ligjërimi e diskurset përmes teknologjive të reja të komunikimit, ligjërimi dhe të folmet e grupmoshave ose profesioneve të ndryshme, ligjërimi e diskurset në vende dhe mjedise të caktuara të punës, të gjitha këto hapësira ku variacioni gjuhësor është tejet i pranishëm dhe ku përftohen varietete a regjistra gjuhësorë të ndryshëm, ku përftohen mesazhe e korpuse ligjërimore që duhen studiuar për të mundësuar më tej edhe më shumë efektshmëri në komunikim, përbëjnë sot sfida të hapura përpara studiuesve të shkencave të ligjërimit edhe në mjedisin tonë shkencor, por edhe më konkretisht, të ekipeve që do të duhej të krijoheshin me përpërje heterogjene për të qenë më të suksesshëm.

Vetë objektet e mësipërme të studimit, me natyrën që shfaqin aktualisht si pasojë e zhvillimeve të vrullshme sociale e teknologjike e zhvlerësojnë praktikimin e një shqyrtimi të diskurseve thjesht *në vetvete e për vetveten*, sepse "ligjërimi është i prirur gjithnjë drejt një synimi final, drejt një veprimi për t'u përmbushur, për t'u kryer, për t'u përfunduar – për t'u gjetur një zgjidhje, për t'u rregulluar një mangësi, për t'u kuptuar a interpretuar një diagramë. Nga ana tjetër, ligjërimi veçse në raste të rralla është i pavarur prej një universi teknik, i përbërë prej makinerive, mjeteve të punës, objekteve. Këto universe teknike formatojnë madje në mënyrë detyruese aktivitetet e ligjërimet e përdoruesve (A. Borzeix et al., cituar nga Boutet&Maingueneau, 2005:42).

Në mbyllje

"Kur flasim për gjuhën, përkundër asaj që imagjinohet, përdorim njëjësin thjesht për kollajllëk: në fakt, frëngjishtja, kinezishtja ... nuk ekzistojnë aspak; ajo çka ekziston, janë frëngjishtet, kinezishtet...", (J. –M. Klinkenberg-u, 1999:29).

E bart ky pohim në formë tejet të përmbledhur ngarkesën heterogjene që përfton problematika e variacionit në gjuhë; janë në të të pranishme këndvështrimet që shquajnë dhe vlerësojnë varietetet gjuhësore; është e pranishme gjithashtu në pohim përmasa tjetër në nocionin gjuhë/ligjërim, ku të pranishme janë edhe folësi individual a kolektiv që jo thjesht zotëron kapacitetet për të ngjizur gjuhësisht e dekodifikuar përmes shenjave gjuhësore e njësive gjuhësore, por është i aftë të zotërojë diskursin e tij si mjet për të shndërruar a vepruar përmes atij diskursi.

Për një mori arsyesh që lidhen me specifikat e sotme të zhvillimit të shoqërisë, zhvillim që ka imponuar raporte të reja të shoqërisë me thëniet e përftuara në

përditshmëri, aktualisht jemi në një periudhë (megjithëse në nisje të saj) kur tërësinë e produkteve verbale, në shumësinë e shfaqjes së tyre, mund t'i bëjmë objekte studimi. Objekti i shndërruar në objekt studimi është më tej më lehtësisht i përdorshëm, është më lehtësisht i zotërueshëm. Një zotërim më shumë, është një përmasë shtesë për qenien njerëzore, një plotësim domethënës i saj.

"Që njeriu është një qenie e ligjërimit, ja çka nuk pushojmë së thëni qysh prej një kohe të gjatë; që ai të jetë një njeri i diskursit, ja kalimi në një tonalitet të ri i pohimit, rëndësia e të cilit është ende e pamundur të matet, por që prek gjithsesi diçka thelbësore" (Charaudeau&Maingueneau, 2002:12).

Dhe ky njeri i diskursit ndoshta do ta ketë më të kollajshme të kundërtën e asaj që kemi sot jo të lehtë të imagjinojmë, të ketë më të kollajshme të pranojë se flet frëngjishtet, anglishtet, shqipet...

Nëse me shqyrtimet ndërdisiplinore a shumëdisiplinore të variacionit, a varieteteve të përftuara tashmë a në përftim e sipër, ndikojmë në rritjen e këtij ndërgjegjësimi, studiuesit në shkencat e ligjërimit e më gjerë do t'i përforcojnë sinjalet e së ardhmes së dukurisë, çka e kanë edhe si detyrë, edhe si mision.

Bibliografia

Achard P. (1993) *La sociologie du langage*, Paris, P.U.F., Que Sais-Je.

Angermuller J. (2013) *Analyse du discours poststructuralist, Les voix du sujet dans le langage chez Lacan, Althusser, Foucault, Derrida, Sollers,* Editions Lambert-Lucas.

Boutet J., Maingueneau D. (2005) *Sociolinguistique et analyse de discours: façons de dire, façons de faire*, Langage et société 2005/4 (n° 114), faqe 15-47.

Charaudeau P., Maingueneau D. (2002) *Dictionnaire d'analyse du discours*, Edition du Seuil.

Klinkenberg J.-M. (1999) *La variété linguistique ; Des langues et des hommes*, Paris, Bruxeles, Duculot 2-e éd. faqe 29-55.

Ledegen G., Léglise I. (2013) *Variations et changements linguistique*, in Ëarton S., Simonin J. *Sociolinguistique des langues en contact*, ENS Edition, faqe 315-329.

Maingueneau D. (2014) *Discours et analyse du discours, Introduction*, Armand Colin.

Maingueneau D. (1995) *Les analyse du discours en France, Introduction*, Langages, n° 117.

Mazière F. (2005) *L'analyse du discours*, Que sais-je PUF (Presses Universitaires de France).

Paveau M.-A., Sarfati G.-E. (2011) *Les grandes théories de la linguistique, De la grammaire comparée à la pragmatique*, Armand Colin.

Roulet E. (1999) *La description de l'organisation du discours, Du dialogue au texte*, Didier.

Vasile S.-I. (2005) *L'analyse de discours Essai de rétrospective théorique*, Dialogos 2005/12, faqe 66-78.

Merita PLANGARICA & Tomorr PLANGARICA

THE LINGUISTIC VARIATION AS A PART OF THE SPEECH SCIENCES STUDIES
(Discourse analysis as a complementary topic in Sociolinguistic studies)

Abstract

This paper aims at highlighting the contribution of the *discourse analysis* (as complementary to the studies made in the field of sociolinguistics) in studying certain aspects of the language variations, the written discourse in particular. Considering that generally the main goal of *discourse analysis* is to study the outcome obtained in the process of conversational exchanges or written texts (while sociolinguistics is focused primarily in studying genuine speaking examples in a certain social context), this paper presents the discourse analysis tendency in the context of Albanian language studies and its discourse patterns, in order to enable functional analysis of different language variations, mainly of written texts, but not limited to them.

Idriz METANI

E FOLMJA E SKRAPARIT NË DRITËN E TË DHËNAVE TË ATLASIT DIALEKTOLOGJIK TË GJUHËS SHQIPE (ADGJSH)

Skrapari, në vështrimin fiziko-gjeografik, bën pjesë në *Krahinën malore jugore*[1], e cila, sipas studimeve gjeografike[2] shqiptare të këtyre dhjetëvjecarëve të fundit, dallohet prej tri krahinave të tjera të Shqipërisë, pra, prej *Alpeve shqiptare, Krahinës malore qëndrore* dhe *Ultësirës bregdetare* nga disa tipare të rëndësishme themelore që kanë të bëjnë, përvec të tjerave, me **pozitën gjeografike, ndërtimin gjeologjik, relievin, klimën, ujërat** dhe **me florën e faunën**. Ndërsa në vështrimin administrativ, Skrapari, me dy qendra kryesore, Corovodën e Policanin, që ndodhen gjegjësisht gati 30 dhe 50 km larg qytetit të Beratitt, kufizohet nga Lindja me Oparin e Vithkuqin e Korcës, nga Veriu me Gramshin e Elbasanit, nga Perëndimi me Nahijen e Beratit dhe nga Jugperëndimi e Jugu me Këlcyrën e Dangëllinë e Përmetit.

E folmja e Skraparit bën pjesë në grupin e të folmeve të Toskërishtes Veriore[3]. Ajo është bërë objekt studimi për herë të parë nga dialektologu i njohur Jorgji Gjinari[4]

[1] Në botimin e qendrës së studimeve gjeografike të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë me titull "*Gjeografia fizike e Shqipërisë"*, Tiranë, 1991, jepet skema e rajonizimit fiziko-gjeografik të vendit tonë, sipas të cilës Shqipëria ndahet në katër krahina të mëdha me tipare të përgjithshme fiziko-gjeografike vetanake: *Alpet shqiptare, Krahina malore qëndrore, Krahina malore Jugore dhe Ultësira bregdetare*.

[2] Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, qendra e studimeve albanologjike, Gjeografia fizike e Shqipërisë, Tiranë, 1991, f. 287-297

[3] Brenda Toskërishtes Veriore, studiuesit dallojnë të paktën dy grupe të folmesh: grupin e të folmeve të anës perëndimore ku, përveç të folmes së Skraparit, bën pjesë e folmja e Myzeqesë, e Beratit dhe e Mallakastrës si dhe grupin e të folmeve të anës lindore (pjesa më e madhe e qarkut të Korcës: Opar, Gorë, Pogradec, Fusha e Korcës, Devolli). Shih për këtë, ndër të tjera, Gjinari Jorgji, *Toskërishtja Veriore dhe grupimi i të folmeve të saj,* Konferenca I e Studimeve Albanologjike, në "Studime për gjuhën shqipe e dialektet e saj", Tiranë, 2015. f. 261-270

[4] Në korrik të vitit 1956, pra para pak më shumë se 60 vjetësh, Jorgji Gjinari vihet në krye të ekspeditës së parë dialektologjike të organizuar në krahinën e Skraparit nga Instituti i Historisë e i Gjuhësisë së asaj kohe në gjashtë fshatra të kësaj krahine dhe me lëndën e mbledhur prej saj boton dy vite më vonë, d.m.th. në vitin 1958 artikullin "E folmja e Skraparit", i cili, duhet thënë, se është i pari dhe i vetmi artikull i botuar deri më sot për këtë të folme në dialektologjinë shqiptare

në artikullin[5] me të njëjtin titull, të botuar përpara afro 60 vjetëve, në të cilin ai mëton të japë, sic pohon në hyrje të tij "një pamje të të folmes së Skraparit" duke e vështruar atë në rrafshin fonetik, gramatikor e leksikor. Ndërkaq, artikulli ynë synon të ravijëzojë shkurt profilin dialektor të kësaj të folmeje mbështetur në të dhënat që sjell për të Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe[6] (më tutje ADGJSH) (pa mëtuar një analizë të plotë e aq më pak shteruese të këtyre të dhënave) për të vënë në dukje **vendin që zë e folmja e Skraparit në izoglosat fonetike, gramatikore e leksikore të kësaj vepre të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare.**

Në ADGJSH e folmja e Skraparit pasqyrohet me dy pika dialektologjike: *Gjerbësin* që ndodhet në Tomorricë, në Lindje të Corovodës, qendrës së Skraparit, pak më shumë se 35 km larg saj, në rrjedhën e djathtë të lumit Osum dhe *Muzhakën* që ndodhet në rrjedhën e majtë të Osumit, në Jugperëndim të Corovodës afro 20 km larg saj.

Duke e kundruar të folmen e Skraparit në dritën e të dhënave që sjell ADGJSH, mund të nxjerrim disa tipare kryesore të përgjithshme që e dallojnë këtë të folme, jo vetëm nga grupi i të folmeve toske të anës perëndimore të cilave ajo, sic e thamë edhe më lart, u përket, por edhe nga grupi tjetër i të folmeve toske të anës lindore. Si të tilla mund të përmendim:

Së pari, sipas të dhënave që sjellin 12 hartata fonetike të ADGJSH për fonemat zanore të theksuara[7] të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur edhe në hartën gjegjëse përgjithësuese[8], del se e folmja e Skraparit i përket arealit me një seri fonemash zanore të theksuara për të dyja pikat dialektologjike me të cilat ajo identifikohet në veprën për të cilën po flasim: vetëm me serinë e zanoreve gojore të shkurtëra, ndërsa një tjetër hartë përgjithësuese[9] për numrin e fonemave zanore të theksuara, tregon se numri i tyre për këtë të folme kap shifrën shtatë: i-y-e-a-o-u-ë. Ndërkaq, të dhënat që japin hartat 30, 31, 33.a dhe 33.b, 34.a, 34.b, 35, 36.a dhe 36.b, 38.a[10] për variantat fonetike të fonemave zanore a, e, ë, o që ndodhen para, pas a pranë bashkëtingëlloreve të ndryshme, si dhe dëshmitë që sjellin hartat 38.b/1., 38.b/2., 39, 40.a, 40.b, 40.c, 40.c, 41.a, 41.b, 42.a, 42.b, 42.c, 42.c, 43.a, 43.b, 44.a, 44.b, 44.c, 44.c/1, 44.c/2, 45.a, 45.b,

[5] Gjinari Jorgji, E folmja e Skraparit, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore, 1958, 1, f. 86-107

[6] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, *Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe*, vëllimi I, Univerisiteta degli Studi di Napoli L' Orientale, Dipartimento di studi dell' Europa Orientale, 2007

[7] Shih hartat: 1.a, 1.b, 1.c, 1.c, 1.d, 1.dh, 1.e; 2.a, 2.b, 2.c, 2.c, 2.d të ADGJSH, f. 69-80

[8] Harta 1.a-2d, ADGJSH, f. 87

[9] Harta 1.a-7, ADGJSH, f. 86

[10] Hartat 30, 31, 33.a dhe 33.b, 34.a, ADGJSH, f. 125-128

45.c, 46, 47.a/1, 47.a/2, 47.a/3, 47.b, 48.b, 48.c, 48.c, 49.a, 49.b, 50.a, 50.b, 50.c[11] për fonemat zanore në përbërjen fonetike të fjalëve, flasin, përvec të tjerave, për një unitet gati të plotë të folmes së Skraparit brenda vetes gjë që duket tek dallimet pothuajse të papërfillshme që kanë ndërmjet tyre pika dialektologjike e Gjerbësit dhe ajo e Muzhakës.

Së dyti, sa u përket fonemave bashkëtingëllore: *h, rr, ll, th, dh, c, xh, q, gj, nj* të dhënat e të cilave jepen gjegjësisht prej hartave fonetike 8, 9, 10, 11.a, 11.b, 12.a, 12.b, 13.a, 13.b, 14, 15.a, 15b[12] e folmja e Skraparit karakterizohet nga mungesa e sonantes mesgjuhore *(ngusht, kungull, trung, lëng)* dhe sonantes prapagjuhore **(nder, këndoj, tund)** si dhe nga prania në këtë të folme të fonemave bashkëtingëllore **ll** (vëlla, diell), **th** (them), **dh** (dhi), **c** (caj, vic), **xh** (xhep, oxhak), **q** (qafë), **gj** (gjak). Po kështu, grupet e bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng, ngj,** sipas dëshmive që japin hartat gjegjëse[13] ekzistojnë në të gjitha kushtet fonetike, pra në fillim, në fund e në trup të fjalës *(mbiell, kumbull, thumb; nder, këndoj, shkund; ngutem, kungull, trung, cung; ngjyej, ngjesh, ngjall).* Të njëjtën gjë, d.m.th. ekzistencën në të gjitha kushtet fonetike, pohojnë hartat fonetike 20, 21, 22.a[14] dhe 22.b, 22.c, 23.a, 23.b, 23.a dhe 23.b[15] për grupet përkatëse të bashkëtingëlloreve **tj** dhe **dj** *(tjerr, i djathtë),* **mj (mjekërr, mjaltë),** ***pl*** *(plak)* dhe **bl** *(ble),* **fl** *(fle),* **fsh** *(kofshë, lafshë, mëndafsh; punofsh, lafsh, shkofsh).*

Takimin e bashkëtingëlloreve në kufi të morfermave dhe konkretisht: të bashkëtingëlloreve **ll**, **dh, r, z, n, t, k** me bashkëtigëlloren **n**; të bashkëtingëllores **q** me **t, m, n** dhe të bashkëtingëllores **gj** me **t**, ADGJSH e jep përmes hartave 27.b, 27.c, 27c, 27.d, 27.dh, 27.e, 27.ë; 28.a, 28.b[16], që tregojnë praninë në të folmen e Skraparit e një vargu kombinimesh fonemash bashkëtingëlloresh, ndër të cilat po përmendim: a) ll+zanore+n në emra dhe **ll** në folje *(buallin, dualë)*; b) dh+zanore+n në emra *(gardhin)* dhe **dh** në folje *(drodhe,druadhë, druadh)*; c) dh+zanore+n në emra **e** në folje *(gardhin, drodhën)*; d) dh+zanore+n në emra *(gardhin)* **dhn** në folje *(drodhnë)*; dh) z+zanore+n në emra **e** në folje *(orizin, ndezën)*; e) r+zanore+n në emra *(gurin)* **rr** në folje *(muarr)*; ë) z+zanore+n në emra *(orizin)* **z** në folje *(ndez)*; f) z+zanore+n në emra e në folje *(orizin, ndezën*); g) n+zanore+n *(duhanin)*; gj) t+zanore+n *(detin)*; h) k+zanore+n *(mikun)* etj.

Së treti, izoglosat morfologjike për gjininë e emrave *ujë, mish, djathë, lesh, dyllë, mjaltë*, që pasqyrohen përkatësisht në hartat 68/1, 68/2, 68/3, 68/4, 68/5, 68/6[17] dhe

[11] ADGJSH, f. 135-167
[12] ADGJSH, f. 89-98
[13] Hartat 16, 17, 18, 19, ADGJSH, f. 91-95
[14] ADGJSH, f. 103-105
[15] ADGJSH, f. 105-108
[16] ADGJSH, f. 115-123
[17] ADGJSH, f. 209-214

në mënyrë të përmbledhur në hartën përgjithësuese 68/1-68.6[18], tregojnë se, në të folmen e Skraparit, nga gjashtë emrat e përmendur më lart, vetëm emri *ujë* përdoret ende në gjininë asnjanjëse. Kjo e dhënë e fut të folmen që kemi bërë object studimi në grupin e atyre të folmeve të anës perëndimore të toskërishtes veriore ku gjinia asnjanjëse e emrave është rrudhur në një shkallë tepër të lartë. Nga shqyrtimi i të dhënave që sjellin hartat morfologjike 71.a, 71.b, 71.c/1, 71.c/2, 71.c/1, 71.c/2, 71.d/1, 71.d/2, 71.dh, 71.e, 72.a, 72.b, 72.c, 73.a, 73.b, 74.a, 74.b, 74.c, 75/1, 75/2, 76.a, 76.b, 77.a, 77.b, 78/1, 78/2, 78/3, 79.a, 79.b, 80.a, 80.b, 80.c, 80.c, 80.d, 80.dh, 81, 82.a, 82.b, 82.c, 83.a, 83.b, 83.c[19] për variantet e mbaresës së shumësit dhe të morfemës-temë të shumësit të disa emrave rezulton se të dyja pikat dialektologjike të të folmes së Skraparit kanë mospërputhje në pjesën më të madhe të varianteve që përmendëm më lart. Kështu, p.sh., shumësi i emrave *ushtar, doktor, bri, kulac, bosht, thelb, drapër, gisht, prift* që në pikën dialektologjike 130 (Muzhakë) del në trajtat *ushtarë, doktora,brir,kaulacë, boshtra, drapre, gishtra, prifta* pëkundrejt varianteve *ushtar, doktorë, brirë, kulec, boshtinj, drapринj (por edhe dërpënj, drapinj, dërpinj), gishtrinj (gishtinj), priftërinj (priftinj)* në pikën tjetër dialektologjike atë me numër 135 (Gjerbës)

Së katërti, meqënëse numri i hartave sintaksore në ADGJSH është i vogël në krahasim me numrin e hartave fonetike, morfologjike e leksikore (janë nëntë harta të tilla, aq sa është edhe numri i pyetjeve nga fusha e sintaksës që mbart pyetësori i hartuar për të mbledhur lëndën gjuhësore në terren) do të përpiqemi t'i shqyrtojmë tërësisht të dhënat e tyre për të nxjerrë disa vecori sintaksore të të folmes së Skraparit. Kështu tri hartat sintaksore 139, 140, 141[20], që mbartin të dhëna për parafjalët shoqëruese të emrave dëshmojnë se në të folmen e Skraparit emri kur tregon prejardhjen nga një vend *(nga mali, prej malit)* ose shkakun e një veprimi a të një gjendjeje *(nga vapa)*, shoqërohet prej parafjalës **nga**, e cila del edhe me variantet **na, ga, ka**, kurse, kur tregon marrëdhënie vendore *(e takoi në rrugë)* emri paraprihet nga parafjala **në** që del edhe në varianin pa **ë**.

Kurse hartat sintaksore 142, 143, 144 dhe 145[21] që sjellin të dhëna për format mënyrore të foljeve tregojnë se në të folmen për të cilën po flasim mënyra lidhore del si: a) formë mënyrore e foljes në një sintagmë ku tregon fillim veprimi *(filloi të pijë*); b) formë mënyrore e një foljeje-kallëzues në fjali pyetëse ku vjen pas ndajfoljes së vendit **ku** *(ku të shkoj);* c) formë mënyrore e foljes që vjen pas një foljeje modale *duhet* ose pas foljeve *eci shkoj* në një fjali nxitëse të pavarur dhe kryesore, me funksion detyrimi *(duhet*

[18] ADGJSH, f. 215
[19] ADGJSH, f. 219-260
[20] ADGJSH, f. 427-429
[21] ADGJSH, f. 430-433

të punosh, shko të punosh); d) formë mënyrore e një foljeje që përdoret me funksione qëllimore *(vete të presë dru).*

Ndërkaq, hartat 137 dhe 138[22] me informacionin që sjellin tregojnë se në të folmen e Skraparit emrat mashkullorë që marrin e në numrin shumës ndërrojnë gjini *(male të larta),* ndërsa emrat e shoqëruar me parafjalën *tej* ose *matanë* përdoren në rasën rrjedhore *(matanë gardhit, tej gardhit)*

Së pesti, numri i hartave leksikore në ADGJSH kap shifrën 273[23] pjesa më e madhe e të cilave, gjithsej 175, tregojnë se varianti leksikor i të folmes së Skraparit përputhet me variantin normë të shqipes standarde, kurse numri i hartave leksikore ku njëri prej dy varianteve leksikore të të folmes së Skraparit nuk përputhet me variantin normë të gjuhës standard shkon në 27, përkundrejt 22 hartave të tjera që tregojnë se asnjëri prej varianteve leksikore të dy pikave dialektologjike me të cilat e folmja e Skraparit, sic thamë që në krye të këtij artikulli, përfaqësohet në ADGJSH, nuk përputhet me varintin normë të standardit.

Si përfundim mund të themi se studimi i të folmeve të shqipes në dritën e të dhënave që sjell ADGJSH është i domosdoshëm për të parë se çfarë është arritur deri tani në studimin e tyre e çfarë duhet bërë më to në të ardhmen.

Idriz METANI

THE LANGUAGE VARIETY OF SKRAPAR BASED ON THE DATA OF THE DIALETHOLOGICAL ATLAS OF ALBANIAN LANGUAGE

Abstract

Skrapar is a mountainous region that is located about 50 km southeast of Berat and bordered by the East with Oparin and Vithkuq of Korca, from the North with Gramsh of Elbasan, from the West with Nahije of Berat, South West with Këlcyra and the Dangëllinë of Përmet.

Skrapar's variety belongs to the group of North Tosk Albanian varieties. It has become object of study for the first time by prof. Jorgji Gjinari in the article with the same title, published nearly 60 years ago, in which he intends to give, as he writes in its introduction "a view of Skrapar's variety". Whereas our paper intends to give a fuller profile of Skrapar's variety based on the data provided by the Albanian Dialectal Atlas (further ADGJSH), cosidering the place that occupies this language variety in the

[22] ADGJSH, f. 425-426

[23] Gjinari Jorgji, Studime për gjuhën shqipe dhe dialektet e saj, Tiranë, 2015, f. 316-319

phonetic, lexical and grammaical isoglosses of this important work of Albanian linguistics.

Berton SULEJMANI

GJUHA E DOKUMENTACIONEVE TË SHKOLLAVE TË SHKUPIT

*Në këtë punim do të paraqesim gjendjen e tanishme të përdorimit të gjuhës shqipe në dokumentacionet e shkollave, duke filluar nga ditarët (regjistrat e klasave), dëftesat, librat amzë, vërtetimet etj. Por nuk do t'i lëmë pa i hulumtuar edhe mbishkrimet e ndryshme të kabineteve, vitrinave, këndeve etj. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të vëmë në pah gjendjen e sotme të gjuhës standarde shqipe në këto institucione arsimore. Veç kësaj, edhe gjuha e mësimdhënësve do të jetë pjesë e hulumtimit tonë. Është për t'u çuditur se te një numër i mësimdhënësve kemi vërejtur një nivel shumë të ulët të zotërimit të normës gjuhësore. Gjatë shkrimit të orës mësimore në regjistrat e klasave, ata shpesh thyejnë normën drejtshkrimore të gjuhës shqipe. Aty gjejmë edhe nga këto shkarje gjuhësore, si: *Matematik (emër i lëndës) për: Matematikë, *Artë figurativ për: Art figurativ; *Artë muzikor e *Art muzikorë për: Art muzikor; *festa shtetërore: "Dita e drunit" për: "Dita e drurit"; *"Përfundimë i gjysëmvjetori të parë" për: "Përfundimi i gjysmëvjetorit të parë". Në shpalljet e ndryshme nga ana e mësimdhënësve gjejmë edhe nga këto: *Sot ne garat Shteterore , ne kategorine per solo kendim , nxenesit e mi I.V. u shperblye me qmim special (100 pike) dhe Arta Jashari me qmim te II - te. Ju falemderit qe me bet krenare; për: Sot në garat shtetërore, në kategorinë e këndimit solo (ose edhe solo këndimit), nxënësit e mi morën shpërblime, edhe atë: I.V. u shpërblye me çmimin special (me 100 pikë) dhe A.J. me çmimin II. Ju faleminderit që më bëtë të ndjehem krenarë. Pjesë e hulumtimit tonë do të jenë kryesisht shkollat e mesme, por do të përfshijmë dhe ndonjë shkollë fillore të qytetit të Shkupit.*

Në punimet e seminarit të vitit të kaluar, nëpërmjet kumtesës sime paraqita nivelin e zotërimit të shqipes standarde nga nxënësit e shkollave të mesme të Shkupit.[1] Sivjet, në punimet e Seminarit XXXV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare do të paraqesim rezultatet e hulumtimit tonë rreth gjuhës shqipe, përkatësisht standardit gjuhësor të shqipes në dokumentacionet e shkollave, duke filluar nga ditarët (regjistrat e klasave), dëftesat, librat amzë, vërtetimet etj. Por, duke mos i lënë anash e pa i hulumtuar edhe mbishkrimet e ndryshme të kabineteve, vitrinave, këndeve, shkollave etj.

[1] Berton Sulejmani, *Shqipja standarde në shkollat e mesme të qytetit të Shkupit*, materialet e punimeve të Seminarit XXXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 17-28. 08. 2015, f. 319-328.

Pas Kongresit të 1972-ës si brenda, ashtu edhe jashtë trevave shqiptare, nëpër të gjitha nivelet e arsimit, mjeteve të informimit, institucionet shtetërore e private filluan t'i përdorin rregullat e shqipes së njësuar (shqipes standarde). Shqiptarët në Maqedoni, ndërkaq, në të gjitha nivelet e arsimit e mësojnë dhe e studiojnë shqipen. Hapja e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në kuadër të Universitetit të Shkupit, themelimi i Universitetit të Tetovës (1994, zyrtarizimi në vitin 2004) brenda së cilës funksionon edhe Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, themelimi i Institutit të Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve "Pjetër Bogdani" (2007) janë ngjarje shumë të rëndësishme që lidhen me shqipen në Maqedoni. Por, duhet ta pranojmë një fakt se rrethanat shoqërore, politike etj., nuk qenë të njëjta për përvetësimin apo zotërimin e normës gjuhësore në trekëndëshin shqiptar Tiranë – Prishtinë – Shkup.

Dy-tri fjalë për shqipen standarde në Maqedoni pas vitit 2004, përkatësisht pas themelimit të Këshillin Ndërakademik për Gjuhën Shqipe (i themeluar në Tiranë, më 27 tetor 2004). Me nismën e dy akademive shqiptare, ASHSH-së dhe ASHAK-ut, u themelua Këshillin Ndërakademik për Gjuhën Shqipe i cili ka për detyrë që të merret me të gjitha çështjet e shqipes standarde, por pa mandat për të marrë vendime, qofshin të drejta, a të panevojshme. Me gjithë qëndrimet pozitive apo negative që u dhanë dhe po jepen për këtë iniciativë, kujtoj që edhe ne duhet të gjejmë rrugët tona për të ecur përpara, si në të gjitha fushat e tjera të jetës, ashtu edhe në atë të gjuhësisë. Nëse është vlerësim i pranuar se gjuha nuk është një proces i përfunduar (një ergon), por (një energjia), strukturë e hapur në kuptimin modern të konceptit të Humboldit, duke kuptuar me këtë punën që duhet bërë në vazhdimësi në fushën e planifikimit gjuhësor, me zbatimin e një strategjie të re, e cila do të marrë parasysh të gjithë faktorët e rinj gjuhësorë e shoqërorë, ndihmues e pengues, gjithnjë me qëllim të përpunimit e të përparimit të saj. Mendojmë se disa çështje, duhet të kihen parasysh me rastin e ndërhyrjes në këtë standard, qoftë nga Këshilli Ndërakademik (i krijuar në Tiranë, më 27 tetor 2004, nga 15 anëtarët e tij: nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia etj), qoftë nga institucionet e tjera kombëtare shkencore. Duke u mbështetur botimet e ndryshme për standardin gjuhësor nga ekspertë të kësaj fushe, që sot, për fat të mirë nuk janë të pakta, edhe intervistat, edhe opinionet e tyre, p.sh.: si ajo e prof. Shaban Demirajt që nuk e ka thënë kot se *"edhe për gjuhët që kanë tradita më të vjetra, shtrohet kërkesa për përmirësime"*[2]. Fundja edhe në *Parathënien* e botimit të parë të *Fjalorit drejtshkrimor* thuhet: "natyrisht, ka edhe mungesa e zbrazëti". Me studimet e mëtejshme shkencore e me ndihmën e masës së gjerë, këto

[2] Shaban Demiraj, në "Seminarin XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", Tiranë, 1995, f. 740.

mungesa e zbrazëti do të plotësohen në botimet e ardhshme"[3], duke vazhduar më pas me konstatimin se: "studiuesit e shqipes standarde do të kenë për detyrë që të përcaktojnë prirjet e zhvillimit në ndërthurje të varieteteve të gjuhës së folur mbi bazën e gjuhës së shkruar unike dhe të mundësojnë që të përfshihen në normë ato elemente që ndihmojnë që gjuha standarde të fitojë gjithnjë në spontanitet e t'i pasurojë mundësitë e saj shprehëse"[4].

Por, nga ana tjetër, diku-diku, nga disa individë është krijuar "një zhurmë të pandershme" siç do të thoshte I. Kadareja, dhe nga kjo, në disa pjesë të arealit gjuhësor shqiptar e ka lëkundur "respektin" për standardin e gjuhës. Këtë lëkundje po e ilustroj me fjalët e një studiuese e cila shqipen e kishte mësuar në një seminar nga një shtet i Evropës nga i cili vinte dhe gjatë leximit të kumtesës së saj në kuadër të Seminarit XXXIII të Albanologjisë tha: " nga përvoja ime erdha në përfundim dhe po marr guximin të propozoj që të përpilohet një fjalor shqip – kosovarisht. Arsyetimi i saj ishte ky: kur isha në Shqipëri merresha vesh shumë mirë në të gjitha kontaktet që kisha, ndërsa në Kosovë jo, tha studiuesja. Absurd i madh thashë me veten. Edhe këtë gjë po e dëgjoj në një seminar të albanologjisë. Fjalor shqip – kosovarisht. Nuk munda pa reaguar dhe i thashë: kjo që ju po e thoni është e pamundur, ne jemi një komb dhe kemi një gjuhë, pra edhe një standard gjuhësor. Dallime mes kryedialekteve të shqipes ka, por jo deri në atë shkallë që të mos mund të merren vesh një gegë dhe një toskë.

Po ju jap një të dhënë për trevat shqiptare në Maqedoni, nga edhe vij. Në Maqedoni, shqiptarët kanë probleme të zotërimit të standardit të gjuhës shqipe (me fjalën probleme nuk dua të them se nuk mund ta mësojnë), por edhe kanë arritje në këtë drejtim. Megjithatë, "respekti" për të, dëshira për ta zotëruar dhe përpjekjet e të gjithëve, e çdo intelektuali dhe mësimdhënësi në veçanti, për ta ngritur nivelin e zotërimit të rregullave drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore që u vendosën në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972, prore vazhdojnë ta bëjnë. Kjo gjë shihet qartë në të gjitha institucionet arsimore (çerdhe, shkolla fillore e të mesme, universitete), media (elektronike dhe të shkruara), administratë etj. Me fjalë tjera, nga qarqet intelektuale nuk mungon dëshira për ta përmirësuar gjendjen e zotërimit të shqipes standarde dhe deri më sot s'është dëgjuar për ndonjë refuzim, ndërsa qarqet politike vazhdojnë të punësojnë kuadro që do t'ua rritnin numrin e votuesve e jo ta përmirësonin, në këtë rast, ngritjen e nivelit të zbatimit të shqipes standarde. Madje, dëmin që ia kanë bë arsimit, vështirë se mund t'u falet.

Mbishkrimet i disa shkollave të qytetit të Shkupit dhe shkrimi cirilik. Edhe pse me ndryshimet e fundit pas Marrëveshjes së Ohrit, që u bënë në

[3] *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 9.
[4] *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 27.

Kushtetutën e Maqedonisë, statusin e gjuhës shqipe do ta kërkojmë duke deshifruar përqindjet në formulimin e nenit 7 të kësaj kushtetute: *Në tërë territorin e R. së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik. Gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve, gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj, siç është përcaktuar me këtë nen.* Emërtimi *gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e shtetasve...* dhe *shkrimi i saj* në fakt i referohen gjuhës shqipe dhe shkrimit latin. Pra, edhe qyteti i Shkupit gjuhë zyrtare i ka dy: shqipen dhe maqedonishten. Krahas kësaj, me alfabet cirilik janë edhe shumë shkolla të mesme, ku ka edhe paralele në gjuhën shqipe, si psh.: С.У.Г.С. „Владо Тасевски“ – Скопје; Д.С.У. „Георги Димитров“; СУГС Гимназија „Орце Николов“ – Скопје; Државно средно хемиско-технолошко училиште „Марија Кири – Склодовска“; Гимназија „Јосип Броз Тито“ (Në shkollat e mesme ku drejtorët janë shqiptarë, shkruhen në dy gjuhë).



Fotografia numër 1. Shkollat e mesme të Shkupit në të cilat nuk respektohet dygjuhësia e garantuar me ligj.

Thyerjet e normës gjuhësore nga mësimdhënësit. Nga ana e mësimdhënësve të lëndëve të ndryshme ndodh që të bëjnë gabime gjuhësore gjatë plotësimit të ditarëve, regjistrimit të nxënësve në regjistër, plotësimin e orëve mësimore, raportet e mbledhjeve prindërore etj. Këto thyerje të normës gjuhësore më së shumti i vërejmë te profesorët që shkollimin e mesëm dhe studimet i kanë mbaruar në gjuhën maqedonase (ose vetëm studimet). Por, thyerje të normës gjejmë edhe tek ata që të gjitha nivelet e arsimimit i kanë bërë në gjuhën shqipe.



Fotografia numër 2



Fotografia numër 3



Fotografia numër 4



Fotografia numër 5



Fotografia numër 6



Fotografia numër 7



Fotografia numër 8

Gabime në ditarët (regjistrat) e paraleleve

Po e ilustrojmë vetëm me disa shembuj: gjatë kontrollit të një ditari (regjistri të nxënësve) të gjimnazit "Zef Lush Marku" të Shkupit vërejmë këto thyerje të normës së gjuhës shqipe, si: SH.M.Q.SH. "Zef Lush Marku", Shkup[5] (në vend që shkurtesën Shkolla e Mesme e Qytetit të Shkupit ta shkruan pa pika në mes, pra: SHMQSH "ZLM", Shkup). Në të njëjtin regjistër i gjejmë edhe këto gabime, si: java e IV, java e III (në vend të java IV, java III) për kohën kur është mbajtur hartimi me shkrim[6]. Vërejtëm edhe disa orë mësimore të shkruara me shkronja të shtypit[7], disa si, p.sh.: **Logjika dhe shkencat e tjera* në vend të Logjika dhe shkencat tjera etj. Gabime tjera (këto të mëposhtmet i kemi nxjerrë nga ditarët elektronik):

[5] Ditari (regjistri) i paralelës IV-5, v.sh. 2013-2014, f. 1, 3.
[6] Po aty, f. 13.
[7] Po aty, f. 40.



Fotografia numër 9



Fotografia numër 10



Fotografia numër 11



Informatikë - Besnik Berisha	Fizikë - Gjyltene Rexhallari	Gjuhë shqipe dhe letërsi - Nurie Nexhipi	Biologji - Hava Jakupi	Ora e bashkësisë së klasës	Matematikë - Behije Hoxha-Bajrami
Cikleti e ndërthurura 52	Detyra numerike 52	Lexim dhe komentim i poezisë seBogdanit 104	Perseritje dhe ushtrim-mardheniet ne ekosistem 51	Analize e suksesit ne tremujorin e pare 28	Jobarazimi linear me nje ndryshore 77
Gjuhë gjermane - Besim Abazi	Histori - Bekim Trolli	Art figurativ - Sami Ametaj	Gjuhë Angleze - Aroma Sulejmani	Kimi - Ajten Xhaferi	Gjeografi - Burim Aliju
Propositionen 52	Jeta dhe kultura ne mesjeten e hershme 52	Kopertina ballina tempera 52	Writing an essay 79	Kriperat 52	Perforcim imaterialit te kaluar 52
Sport dhe aktivitete sportive - Nigjare Nagavci	Matematikë - Behije Hoxha-Bajrami	Gjuhë shqipe dhe letërsi - Nurie Nexhipi	Kimi - Ajten Xhaferi	Gjuhë Angleze - Aroma Sulejmani	Gjuhë maqedone për bashkësite - Elizabeta Jegeni
Perforcim- vp. Shota	Ushtrime dhe detyra	Perseritje mbi letersine e vjeter	Ushtrime dhe perseritje	Dvd mars rovers	Книжевни центри во Македонија

Fotografia numër 12

Kështu e kemi hasur:	**duhet:**
Pylltarija	Pylltaria
vazhdim i mesim	Vazhdimi i mësimit
Korigjim i provimit me shkrim	Korrigjimi i …
Lavërtarija	Lavërtaria
kontrollim i pun	Kontrollim i punës
Pjesemarja e substances ne tretje	Pjesëmarrja …
Pejsazh	Peizazh
Fest	Festë
Puna e avansuar me grafikonet	Puna e avancuar me grafikonet
Tipet e adaptimeve	Tipat …
kompozi gjusem i hapur	Kompozim gjysmë i hapur
Matje e peshes dhe lartesis te nxenesit	Matja e peshës dhe lartësisë së nxenesit
Matematik	Matematikë
Artë figurativ	Art figurativ
Artë muzikor	Art muzikor
Feste shtetrore 1 Majit	Festë shtetërore: 1 Maji

Përfundimë i gjysëmvjetori të parë	*Përfundimi i gjysmëvjetorit të parë*
Artë muzikorë	Art muzikor
Dita e drunit	"Dita e drurit"
Ekskuzijon njëditorë në Sarj	Ekskursion njëditor në Saraj etj.

Shpalljet dhe njoftimet e mësimdhënësve. Në shpalljet e ndryshme nga ana e mësimdhënësve gjejmë edhe nga këto: **Sot ne garat Shteterore , ne kategorine per solo kendim , nxenesit e mi I.V. u shperblye me qmim special (100 pike) dhe Arta Jashari me qmim te II - te. Ju falemderit qe me bet krenare; për:* Sot në garat shtetërore, në kategorinë e këndimit solo (ose edhe solo këndimit), nxënësit e mi morën shpërblime, edhe atë: I.V. u shpërblye me çmimin special (me 100 pikë) dhe A.J. me çmimin II. Ju faleminderit që më bëtë të ndjehem krenarë.

Mospërdorimi i –ë-së. Në faqet e ditarit elektroniok mospërdorimi i shkronjës –ë dhe përdorimi i –e-së në vend të saj vërehet shumë (shih fotografitë me numrat 9, 10, 11 dhe 12). Madje në një faqe të ditarit, nga 32 orë mësimore, vetëm 2 nga to vërejmë se është përdorur shkronja –ë. Për fat të keq edhe në orët e lëndës Gjuhë dhe letërsi shqipe mungon. Fjala është për ditarët elektronik. Për dikë kjo gjë ndoshta nuk çon peshë ose edhe mund të arsyetohet se nuk e kemi në tastierë shkronjën në fjalë. Por si është e mundur që për lëndën e gjermanishtes ta gjejnë shkronjën –ä, p.sh.: Präpositionen etj., e për shqipen jo.

Përdorimi i –ë-së. Në orët e ditarëve elektronik kemi gjetur edhe përdorimin e kësaj shkronje (shih fotografinë me numër12). Edhe pse në raste shumë të rralla. Dashamirët e shqipes e përdorin. Fjalë miradije për ta. Ja disa shembuj: *Përsëritje tematike Festë shtetërore, Struktura për përsëritje të ciklit deri në plotësimin e kushtit, Ushtrime-Struktura për përsëritje të ciklit deri në plotësimin e kushtit* etj.

Përfundim dhe propozim

Nga gjithë kjo pasqyrë e mësipërme, detyrimisht lind pyetja: Çfarë duhet të bëjmë që të dalim nga kjo situatë? Mendojmë:

1. Të organizohen kurse të kulturës gjuhësore me mësimdhënësit e të gjitha lëndëve mësimore, posaçërisht me mësimdhënësit që studimet i kanë mbaruar në gjuhën maqedonase (e ndonjë tjetër);

2. Do të ishte shumë mirë që të punësuarit në shkolla, duke përfshirë edhe punonjësit e administratës të furnizohen me fjalorë drejtshkrimorë, shpjegues, terminologjik etj. Fundja, pse të mos hartohet një fjalor i shkurtër drejtshkrimor për nevojat e shkollave tona. Në të do të përfshiheshin rregullat e shkrimit të termave, lëndëve, emërtimeve të ndryshme, mbishkrimet e tabelave të shkollave etj.

3. Gjuhëtarët jo vetëm që duhet rregullisht të takohen dhe të bashkëpunojnë me arsimtarët e lëndëve të ndryshme, te të cilët, siç edhe pamë, shpesh hasen thyerje të normës gjuhësore, por edhe në shtyp e televizione të trajtojnë dhe të shpjegojnë probleme të kulturës gjuhësore nga ana e tyre;

4. Mësimdhënësit e lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi duhet të jenë shembull i mirë për të tjerët. Mospërdorimi i shkronjës –ë dhe thyerjet e normës gjuhësore nga ta janë gabime që peshojnë shumë rëndë. Arsyetime të tipit, nuk mund të gjej shkronjë –ë e –ç në tastiere, kujtoj se janë të një niveli të ulët.

Berton SULEJMANI

THE STATE OF STANDARD ALBANIAN LANGUAGE USED IN INSCRIPTIONS AND REGISTERS OF ALBANIAN CLASSES IN SECONDARY SCHOOLS IN SKOPJE

Abstract

The aim of this research paper is to point out the actual state of Standard Albanian Language in these educational institutions. Apart from this, teachers' language will be a part of our research. It is strange, but we have noticed that a great number of teachers possess a very low level of the language norm. When they write their lesson in class registers they often brake the spelling norms of Albanian language. We can find the following linguistic slippages: **Matematik (Maths) a subject name in stead of Matematikë,*Artë figurativ i*n stead of*: Art figurativ; *Artë muzikor* and **Art muzikorë* in stead of*: Art muzikor; *festa shtetërore: "Dita e drunit"* in stead of*: Festë shtetërore: "Dita e drurit"; *"Përfundimë i gjysëmvjetori të parë"* in stead of*: "Përfundimi i gjysmëvjetorit të parë"*. In number of various pronouncements made by teachers, we have the following examples of linguistic slippages*: *Sot ne garat Shteterore, ne kategorine per solo kendim, nxenesit e mi I.V. u shperblye me qmim special (100 pike) dhe Arta Jashari me qmim te II - te. Ju falemderit qe me bet krenare;* in stead of*: Sot në garat shtetërore, në kategorinë e këndimit solo (ose edhe solo këndimit), nxënësit e mi morën shpërblime, edhe atë: I.V. u shpërblye me çmimin special (me 100 pikë) dhe A.J. me çmimin II. Ju faleminderit që më bëtë të ndjehem krenarë.*

Key words: standard Albanian Language, teachers', linguistic slippages, pronouncements.

Merima KRIJEZI

PROBLEMET KRYESORE DHE LLOJET E GABIMEVE NË MËSIMDHËNIEN E SHQIPES SI GJUHË E HUAJ

Abstrakt

Punimi merret me shqyrtimin e gabimeve dhe analizën e problemeve, me të cilat ballafaqohen studentët e gjuhës shqipe, që nuk e kanë shqipen si gjuhë amtare, në procesin e përkthimit nga shqipja në serbisht dhe anasjelltas. Suksesi i procesit të përkthimit varet nga faktorët e shumëllojshëm, midis tjerash do veçuar njohjen e mirë të sistemit gjuhësor (sistemit gramatikor dhe leksikor) të gjuhës burimore, por edhe të gjuhës në të cilën përkthejmë, njohja e realitetit jashtgjuhësor dhe kontekstit. Qëllimi i punimit është analiza e atyre elementeve të sistemit gjuhësor që janë mbajtësit e intencës (qëllimit) në këto dy gjuhë dhe ndriçimi i marrëdhënieve midis kategorive leksikore dhe gramatikore të gjuhës shqipe dhe asaj serbe, që mund të jenë arsyeja e gabimeve potenciale dhe e gabimeve gjatë procesit të përkthimit. Në punim do t'i analizojmë disa shembuj të gabimeve që janë karakteristike për nivelet fillestare, por edhe për nivelet më të larta të njohjes së shqipes – gabimet që u krijuan si rezultat i mospërqasjes të kategorive korresponduese gjuhësore, siç janë: trajta e shquar dhe e pashquar e emrave, mospërqasja në gjini te emrat korrespondues, korrespondenti me shtrirjen më të gjerë kuptimore etj.

Fjalët kyç: *përkthim, metodë kontrastive, kodi gjuhësor, gabimet në procesin e përkthimit*

Mësimdhënia e gjuhës së huaj, në kuptim metaforik, është një ambient krijues, që përveç katër elementeve kyç, siç janë: mësimdhënësi, nxënësi a studenti, inputi, interaksioni dhe feedback-u, nënkupton ekzistencën edhe të një elementi tjetër, si shoqërues i detyrueshëm dhe konstant i procesit të mësimit dhe përvetësimit të gjuhës së huaj. Elementi i pestë është gabimi ose të bërit e gabimit. Në teorinë e

përvetësimit/mësimit të gjuhës së huaj (SLA (SLL))[1] bëhet dallimi midis gabimit që përkufizohet me termin *error* (që nënkupton mungesën e kompetencës gjuhësore) (shih Richards 1974; Brown 1994; Richards and Schmidt 2002) dhe gabimit që përkufizohet me termin *mistake* (që përfaqëson një fenomen performativ e nënkupton vetëdijen për bërjen e gabimit).[2] Gjuhëtari Edge (1989) përdor termin "learning steps" për të gjitha gabimet në procesin e mësimit të gjuhës së huaj në vend të të dy termave të përmendur.

Sipas kësaj teorie, termi *gabim* përkufizohet si nocion ambivalent që ka dy konotacione: konotacionin negativ dhe atë pozitiv, të cilët nuk përjashtojnë njëri tjetrin dhe janë me vlerë të barabartë për vetë procesin e mësimit të gjuhës, mësimdhënësin dhe teorinë e mësimit. Konotacioni negativ e konsideron gabimin si devijim, çrregullim a largim nga gjuha burimore, që patjetër duhet të shmanget në çdo pikëpamje (Corder 1967) dhe konotacionin pozitiv, te i cili shohim provën dhe vërtetimin e ekzistencës së procesit të mësimit (Gass and Selinker 1984; Abi Samra 2003; Richards 2002; Alhaysony 2012).

Me vijimin e procesit mësimor, gabimet mund të ndahen në gabime që ndikojnë në kompetencën linguistike (gabimet gramatikore) dhe ato që ndikojnë në kompetencën komunikative (gabimet komunikative). Gabimet gramatikore janë konstituentet minimale në fjali, që nuk ndikojnë në të kuptuarit, madje individi mund të jetë fluent, i rrjedhshëm, edhe pse bën gabime gramatikore (Gomez Mrtinez 2006:2; Day 1977), ndërsa gabimet komunikative ndikojnë në të kuptuarit e fjalisë, paragrafit a fjalimit.

Në literaturën linguistike, në kuadrin e *analizës kontrastive* (CA) dhe *analizës së gabimeve* (EA), operohet me dy terma, që perceptohen si bazikë, fjala është për gabimet interlinguale dhe intralinguale (shih Richards 1974). Interlinguale janë gabimet që bëhen gjatë interferencës së elementeve nga L1 (gjuha burimore), derisa individi të përdorë gjuhën e synuar (Latiff & Bakar, 2007; McLaughlin, 1987); kurse gabimet intralinguale përkufizohen si gabime, që shkaktohen nga vetë L2 si gjuhë e synuar dhe ato mund të jenë të llojeve të ndryshme.[3]

Nga përvoja jonë shumëvjeçare në mësimdhënien e gjuhës shqipe si gjuhë e huaj, kemi vërejtur që gjatë procesit të mësimit dhe përvetësimit të kësaj gjuhe, bëhet

[1] Për përdorimin e termave SLA (Second Language Acquisition) SLL (Second Language Learning) shih R. Ellis (1994:6,14) dhe Mitchell & Myles (2004:6). Në punimin do ta përdorim termin SLA duke mbështetur në përkufizimin dhe shpjegimet që i dha R. Ellis (1994).

[2] Ndyshimi në kuptimin e këtyre dy termave është bazuar në ndryshimin që përmend Chomsky (1965) midis termave "competence" (kompetencë) dhe "performance" (performancë).

[3] http://tujournals.tu.ac.th/thammasatreview/detailart.aspx?ArticleID=171, (aksesuar më 20 korrik 2016)

problematike ekzistenca e atyre njësive gramatikore, që nuk ekzistojnë ose nuk janë ekuivalente me njësitë e gjuhës serbe, gjuhës amtare të pjesës më të madhe të studentëve tanë. Do të përpiqemi të japim shembuj të të gjitha atyre njësive gramatikore, që pak a shumë hasen në procesin e mësimit të gjuhës shqipe, si gjuhë e huaj dhe që ndikojnë në vetë procesin e përkthimit, konkretisht në dukurinë e gabimeve në përkthim.

Së pari, do përmendim kategorinë gramatikore të trajtës së emrit. Në serbisht emrat përkufizohen si fjalë, që kanë lakim dhe kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës dhe animizimit, dhe që mund të formojnë gjymtyrët jokallëzuesore të fjalisë (Piper & Klajn 2010: 53). Kategoria e trajtës së emrit nuk ekziston në gjuhën serbe, ndërsa në shqip emrat posedojnë të gjitha kategoritë gramatikore të përmendura, si dhe kategorinë e trajtës së shquar dhe të pashquar. Kjo kategori është shumë e rëndësishme në gjuhën shqipe dhe u referohet edhe emrave të përveçëm, pra, emri i përveçëm mund të shfaqet në të dyja trajtat.[4] Çdo emër në gjuhën shqipe ka lakim për trajtën e pashquar dhe trajtën e shquar njëjës dhe shumës (duke përjashtuar emrat e kategorisë *singularia tantum*, *pluralia tantum* dhe disa emra të gjinisë asnjanëse),[5] format rasore të emrit cilësojnë mbaresat që janë të caktuara me normë. Dallimi i emrave, ndarja e tyre në lakime dhe vetë lakimi i tyre nuk është ajo që përbën problem në përvetësimin e kësaj kategorie gramatikore, por vetë koncepti i përdorimit të emrit në trajtën e pashquar ose të shquar. Gramatika normative e shqipes jep 20 rregulla të përdorimit të trajtës së shquar dhe 15 të trajtës së pashquar të emrit.[6]

Edhe pse studentët i mësojnë shumë shpejt të gjitha këto rregulla, ata ballafaqohen me situata që shpesh manifestojnë pasiguri në përdorimin e trajtës së shquar apo të pashquar të emrit të përdorur në një konstrukt, ose në një fjali në përgjithësi. Këtë mëdyshje përfaqësojnë rastet që i quajmë përjashtime, por edhe rastet kur përdorimi i saktë i trajtës së emrit është diçka që ka lidhje me "ndjenjën gjuhësore"[7] dhe do të thonim, praktikën gjuhësore. TPGJS do të shënonte këtë gabim si gabimin intralingual.

[4] Në trajtën e pashquar vetëm në thirrore dhe në konstrukcione me foljen *quhem*, si edhe në rastet kur emri i përveçëm është pjesë e apozicionit.

[5] Kryesisht emrat e gjinisë mashkullore dhe femërore, ndërsa situata me emrat e gjinisë asnjanëse është pak më specifike. Emrat e këtij grupi mund të kenë vetëm lakim për një trajtë, në shumicën e rastëve për trajtën e shquar (të njëjësit dhe të shumësit).

[6] Agalliu et al., *Gramatika e gjuhës shqipe I .Morfologjia.* Tiranë, 2005, fq. 120-132.

[7] Këtë term përdor Stevanović në *Funkcije i značenja glagolskih vremena*, Beograd, 1967. Duke shpjeguar arsyet e përdorimit të gabuar të së parkyeres midis serbfolësve në pjesën më të madhe të Serbisë, thekson që problemi shumë i madh përfaqëson mungesa e "ndjenjës gjuhësore" për përdorimin e kësaj kohe foljore.

Ja disa shembuj:

1. *Živim u Tirani.* 1.a. *Živim na Novom Beogradu.*

2. *Zovem se Špetim.*

3. *Italija, masovni protesti u Rimu protiv reforme rada* (titulli i një artikulli gazete)

Në përkthim në shqip:

1. *Jetoj <u>në Tiranë</u>.* 1.a. *Jetoj <u>në Beogradin</u> e Ri.*

Në fjalinë e parë emri Tiranë është përdorur në trajtën e pashquar sepse para tij qëndron parafjala në, emri nuk është kundrinor i drejtë dhe nuk e ndjek ndonjë përcaktor. Në fjalinë e dytë emri është në trajtën e shquar sepse pranë tij qëndron një përcaktor.

Studentët tanë të nivelit A1 dhe A2 shpesh bëjnë gabim dhe thonë: *Jetoj në* <u>Beogradi</u> ose *Jetoj në <u>Beogradin</u>*.

Këtë gabim gjithashtu tregon mosnjohjen e rregullave gramatikore e që ndjenjë për përdorimin e trajtës së emrit ende nuk është zhvilluar.

2. *Quhem <u>Shpëtim</u>.*

Edhe pse bëhet fjalë për një emër të përveçëm *Shpëtim*, ky emër duhet të jetë përdorur në trajtën e pashquar, sepse ka foljen *quhem* pranë (që ndikon në trajtën e emrit; shih fusnotën 4).

Këtë fjali mund ta përkthejmë: *Unë jam <u>Shpëtimi</u>*, dhe në këtë rast emri duhet të jetë në trajtën e shquar sepse ka pranë foljen *jam* dhe tregon a shënon një person konkret.

Megjithatë, folja *jam* shpesh është pjesë e përcaktorit kallëzuesor në fjali dhe si pjesë e një konstrukti të tillë, ndikon në trajtën e emrit. Emri që është konstituenti i dytë i këtij konstrukti duhet të jetë në trajtën e pashquar, si për shembull: *Unë <u>jam studente</u>* (*<u>italiane</u>*, *<u>gazetare</u>*...). *(Ja sam studentkinja (Italijanka, novinarka...).*

Konstruktet në të cilat folja *jam* është pjesë e përcaktorit kallëzuesor detyrojnë përdorimin e emrit në trajtën e pashquar, në rastin e studentëve tanë përfaqësojnë model, që më vonë transferohet edhe në konstruktet që nuk kanë këtë formë dhe kërkojnë përdorimin e emrit në trajtën e shquar.

3. *<u>Itali</u>, manifestime masive në Romë kundër reformës së punës*

Një nga rregullat e gramatikës normative të shqipes tregon që emrat që tregojnë entitete unike, siç janë trupat qiellorë, stinët, muajt e vitit, etj., duhet të jenë në trajtën e shquar. Në fjalinë e sipërpërmendur përdoret emri i shtetit, që është unik; e dimë që nuk ekzistojnë disa shtete me këtë emër, dhe, duke u bazuar në rregullat e përshkruara të normës, emri do të duhej të ishte në trajtën e shquar. Por, nuk ndodh kështu. Kur

bëhet fjalë për një emër që në përgjithësi tregon vend, lokalitet, emri duhet të jetë në trajtën e pashquar. Studentët tanë fjalitë e këtij tipi shumë shpesh i përkthejnë: *Italia, manifestime masive në Romë*, që është gabim.

Në numrin më të madh të rasteve përdorimi i drejtë i trajtës së emrit do të varej nga të kuptuarit e drejtë të kontekstit, në radhë të parë, jashtëgjuhësor, kontekstit të situatës, por edhe nga konteksti tekstual. Shembulli i mëposhtëm mund ta ilustrojë më mirë:

Pastaj ai ia dha vrapit dhe doli në xhade, se pa që larg një autobus. Autobusi mbërriti në kthesën e parë dhe frenoi pranë tij. ***Shoferi*** *dhe* ***pasagjerët*** *u çuditën.* (Zatim je potrčao i izleteo na put, jer je u daljini video autobus. Autobus je stigao do prve krivine i zaustavio se pored njega. **Vozač** i **putnici** su se začudili.) (Agalliu et al.:122).

Lidhja logjike midis dy fjalive të para dhe fjalisë së tretë, por edhe konteksti i situates, kanë ndikuar që emrat në fjalinë e tretë të përdoren në trajtën e shquar (*shoferi*; *pasagjerët*). Është logjike që autobusin e nget një person d.m.th. shoferi, në këtë rast fjala është për një autobus urban, në të cilin janë pasagjerët. Ky fakt ndikon që emrat të jenë në trajtën e shquar.

Një dukuri tjetër, që përfaqëson një problem të madh për studentët tanë, është dyfishimi i kundrinorit, si edhe bashkimi i trajtave të shkurtra të peramve vetorë. Dyfishimi i kundrinorit në gjuhësinë ballkanike, del në pah si cilësi gjuhësore gjithëballkanike, tipike edhe për gjuhën shqipe (si edhe për gjuhën rumune, bullgare e greke), ndërsa në gjuhën standarde serbe vihet re mungesa e kësaj dukurie gjuhësore, ndërkohë që në përdorim mund të jetë vetëm trajta e shkurtër ose e plotë e përemrit vetor, por asnjëherë të dyja trajtat njëkohësisht ose të bashkuara. Në shqip bashkimi i trajtave të shkurtra nënkupton bashkimin e trajtës së shkurtër të përemrit në dhanore (veta e I, II ose e III njëjës ose shumës) dhe trajtës së shkurtër të përemrit në kallëzore (vetëm veta e III njëjës ose shumës).

Studentët tanë përvetësojnë shpejt konceptin e bashkimit të trajtave të shkurtra të përemrave vetorë, por gjatë procesit të përvetësimit të gjuhës drejt përsosjes së mëtejshme, kanë probleme me këtë njësi gramatikore. Prandaj, mendojmë që ky fenomen lidhet thellësisht me dyfishimin e kundrinorit. Ja disa shembuj:

Fjalinë -1. *Danas sam svima podelio pozivnice za pozorište*, shumica e studentëve tanë do ta përkthejnë: *Sot i shpërndava të gjithëve ftesat për në teatër.*

Duke harruar faktin, që në fjali kemi dyfishim të dyzuar - dyfishimin e kundrinorit të drejtë dhe të zhdrejtë – *të gjithëve* (*svima*) dhe *ftesat* (*pozivnice*), fjalinë duhet ta përkthejnë:

1.a. Sot *ua* shpërndava *të gjithëve ftesat* për në teatër. (Danas sam *im* (*svima*) + *ih (pozivnice) podelio svima pozivnice za pozorište.)*

Fjalinë - 2. *Juče sam pokazala pismo Orjelji,* studentët do ta përkthejnë:

2.a. Dje *i* tregova letrën Orjelës, e jo si duhet: Dje *ia* tregova *letrën Orjelës*. (Juče sam *joj+ga* pokazala *pismo Orjelji*.).

Duke analizuar fjalinë më saktë, përkthimin e saj, vihet re se studentët kanë dyfishuar një kundrinor, në rastin tonë kundrinorin e zhdrejtë, që është në dhanore, dhe kanë anashkaluar dyfishimin e kundrinorit në kallëzore d.m.th. kundrinorin e drejtë. Kjo situatë na tregon qartë pasigurinë e tyre lidhur me përdorimin e trajtës së shkurtër. Ata nuk janë të sigurt në se dyfishohet vetëm trajta në kallëzore apo vetëm trajta në dhanore ose të dyja së bashku. Jemi të mendimit se këto gabime bëhen për shkak të ndikimit të gjuhës amtare, që nuk njeh dyfishimin e kundrinorit; po ashtu edhe një arsye tjetër: përqendrimit vetëm në një kundrinor i shprehur me trajtën e shkurtër të përemrit vetor.

Gabimet që ndeshim gjatë punës sonë me studentët në orët e përkthimit, kanë të bëjnë edhe me mospërqasjen me gjininë e emrave korrespondues. Përveç materialit autokton, leksik në korpusin e saj, shqipja përmban një numër të madh të emrave me prejardhje të huaj, disa prej tyre kanë temë të ngjashme ose gati të njëjtë me ata (emrat) në serbisht.

Një situatë e tillë ka ndikuar deri diku, që studentët të bëjnë gabime që i referohen përdorimit të emrit në gjininë e gabuar. Ja disa shembuj:

Emri i gjinisë mashkullore në shqip – emri korrespondues i gjinisë femërore në serbisht: *planet, i* (planeta); *grup, i* (grupa); *ekip, i* (ekipa); *plazh, i* (plaza); *livadh, i* (livada); *garazh, i* (garaža); *krem, i* (krema; 2. krem[8]); *pallat, i* (1. palata; 2. zgrada[9]); *sezon, i* (sezona); *komision, i* (komisija); *turné, u* (1. turneja; 2. turnir[10]); *laborator, i* (laboratorija)...

Një nga rastet më të shpeshta të mospërqasjes me gjininë e emrave korrespondues, tek të cilët nuk ekziston ajo në formën e temës, është emri *libër* (*knjiga*). Ky emër në shqip është i gjinisë mashkullore, ndërsa në serbisht është i gjinisë femërore. Nëse nga studentët tanë kërkohet që të formojnë një fjali ose të përdorin një sintagmë, pjesë e së cilës është emri *libër*, në një numër të madh të rasteve kjo fjali ose sintagmë do të jetë e pasaktë, nën ndikimin e gjuhës së tyre amtare. Këtij emëri ata do t'i vënë një përemër dëftor ose mbiemër të gjinisë femërore, dhe do të thonë:

1. *Kjo (*ndonjëherë përdorin edhe *ky) është* ***një libër interesante***. (Në vend të fjalisë: *Ky është* ***një libër interesant***.; *Ovo je interesantna knjiga*.)

2. *Mbi tryezë janë* ***libra te reja***. (Në vend të fjalisë: *Mbi tryezë janë* ***libra të rinj***.;

[8] Kuptimi tjetër – 1. *krem, šlag*; 2. *krem boja*

[9] Kuptimi i tretë *dvorac*.

[10] Kuptimi i dytë që mund të ketë këtë emër në shqip është *turnir*. Në këtë rast bëhet fjalë për përqasjen në gjini të emrave korrespondues.

Na stolu su nove knjige.)

Sfera e kuptimit të një fjale në një gjuhë, kurrë nuk është absolutisht identike me sferën e kuptimit të fjalës së ngjashme në një gjuhë tjetër (shih Nida 1975; Hlebec 2009). Ajo që mund të përbënte problem shtesë në vetë procesin e përkthimit nga gjuha burimore në gjuhë të synuar, është dallimi i sferës së kuptimit të mundshëm të një fjale brenda frazës/frazave dhe brenda sintagmës ose konstruktit. Një shembull interesant nga mësimi, është ai i përdorimit të fjalës shqipe (emrit me prejardhje turke) *inat* që ka perimetër më të gjerë kuptimor në krahasim me barasvlerësen e saj në serbisht, fjalën *inat*. Emri shqip i*nat* ka dy semema: 1. zemërim, mëri; 2. kokëfortësi, kryeneçësi, brenda frazës dhe konstruktit ky emër merr edhe disa kuptime të ndryshme, si për shembull:

E ka inat.	E urren. (Mrzi ga.)
Sa inat!	Sa keq! (Baš šteta!)
Më vjen shumë inat.	(Krivo mi je.)

Fjala *inat* është turqizëm që ka hyrë në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Studentët e marrin si fjalë të njohur, duke harruar se flitet për sfera kuptimore të ndryshme në këto dy gjuhë. Për studentët tanë kuptimi kryesor i kësaj fjale është *sfidë*/*inat* ose *kokëfortësi*, edhe pse fjala *inat* në serbisht ka kuptim: *namerno, izazivačko postupanje protiv nečije volje; prkos; svada; zavada* (veprim provokues me dashje kundër vullnetit të dikujt; sfidë/ inat; grindje; zënkë) (PMC: 452). Në shqip ky emër ka më shumë kuptime. Gjatë përkthimit nga shqipja në serbisht, dhe anasjelltas, studentët e përkthejnë atë vetëm si *inat*, kurse konstruktet që nënkuptojnë përdorimin e kësaj fjale me kuptime të ndryshme, i bëjnë ata (studentët) të ndihen të pasigurt dhe të bëjnë gabime në përkthim. Fjalinë *E zuri inati*, studentët kryesisht e përkthejnë gabim, si: *Inatio se*, në vend të – *Naljutio se*; *Pobesneo je*.

Fjalinë *Ia nxori inatin*, e përkthejnë: *Isprovociorao ga je*; në vend: *Iskalio je svoj bes na njemu.*

Po ashtu, në vazhdim mund të tregojmë edhe për disa emra të tjerë, që kanë statusin e sllavizmave ose turqizmave në shqip. Studentët i njohin kuptimet e tyre disi në mënyrë intuitive, sepse janë pjesë e korpusit të gjuhës së tyre amtare, por njëkohësisht i lidhin me një kuptim, kuptim që këto fjalë kanë në serbisht. Ja disa shembuj:

- *Nevojë* (në shqip fjalë me tri semema: **1.** nevojë (çdo gjë e domosdoshme për të plotësuar kërkesat e jetës; **2.** hall; varfëri (mungesë e diçkaje ose gjërave kryesore për jetesë) dhe **3.** nevojë (nevojë e madhe dhe e vogël) (FGJSH 2006: 675)

Ekuivalenti i saj në serbisht është emri *nevolja*, që ka këto kuptime: **1.a.** e keqe;

fatkeqësi; telash, vështirësi; varfëri; **b.** *pezh.* fukara, i fatkeqi; **2.** gjë e domosdoshme, nevojë; (PMC: 673).

Kam *nevojë* për ndihmën tënde. (*Potrebna* mi je tvoja pomoć.)

Miku njihet në *nevojë*. (Prijatelj se u *nevolji* poznaje.)

Bëri *nevojën*. (Obavio je *nužđu*.)

Studenët tanë gjithmonë përqendrojnë vetem te kuptimi i parë të fjalës – *potreba* (*nevojë*). Ose fjalët e mëposhtme:

- *Prashit* (në shqip fjalë me tri semema: **1.** rrëmoj tokën rreth bimëve dhe qëroj barërat e këqija;

2. mbath bimët me dhe; 3**.** *fig. keq*. flas kot; llomotit) – ekuivalenti i saj në serbisht është fjala *okopavati* jo *prašiti*.

- *Dyshek* (fjala që përveç kuptimit: shtrojë e trashë dhe e butë mbi diçka; kallëf i madh prej pëlhure, i mbushur me lesh, me pambuk etj., i cili shtrohet kur flemë;) në shqip ka edhe një kuptim: *dyshek gjimnastikor*, serb. *strunjača*.

Në fund, do të donim të theksonim një problem që është i lidhur me përdorimin e saktë të parafjalëve në gjuhën shqipe, si edhe përdorimin e barasvlerësve të tyre në serbisht në procesin e përkthimit. Marrëdhëniet e njëjta hapësinore, kohore dhe marrëdhëniet e ngjashme të tyre në këto dy gjuhë, shprehen me konstrukte parafjalore-rasore të ndryshme. Një nga specifikat e gjuhës shqipe është përpikmëria pothuajse matematikore në dallimin e rasave duke u bazuar në parafjalën që përdoret në konstruktin konkret. Një parafjalë mund të përshtatet nga pikpamja semantiko-sintaksore vetëm me një rasë (përjashtim bëjnë parafjalët: *për*, *ndaj, me anë* dhe *në mes*, që janë parafjalët e vetme që mund të përshtaten nga ana semantiko-sintaksore me dy rasa).[11] Në shikim të parë, duket se mjafton që të mbajmë mend përfaqësimin skematik të parafjalëve dhe rasave, me të cilat përshtaten në rrafshin semantiko-sintaksor dhe të përfundojmë që në procesin e përkthimit nuk mund të bëhet gabim, nëse kjo skemë është mësuar dhe përvetësuar nëpërmjet praktikës gjuhësore.

Megjithatë, në procesin e përkthimit bëhen gabime, për shkak të tri elementeve me rëndësi të barabartë: ndikimit të gjuhës amtare (kopjimit të konstrukteve dhe formimit të sintagmave sipas modelit të konstrukteve nga gjuha amtare), mosnjohjes e semantikës së plotë të parafjalëve dhe kontekstit. Çdo parafjalë nga shqipja dhe serbishtja, si ekuivalent, mund të ketë më shumë se dy fjalë. Përdorimi i saktë i kësaj njësie gramatikore kryesisht varet nga kompetenca, që nënkupton njohjen e plotë të

[11] Duhet të theksojmë që mendimet rreth kësaj çështjeje ndryshojnë. Autorët e gramatikës shqipe *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Agalliu et al.: 2005) janë të mendimi se dhanorja nuk përdoret me parafjalët (duke përjashtuar vetëm katër parafjalët lartpërmendura), Sh. Demiraj (Demiraj: 1971) dhe M. Çeliku (Çeliku: 1998) janë të mendimi se gjuha shqipe ka disa parafjalë që mund të përkohen semantiko-sintaksor edhe me rrjedhoren e dhanoren.

semantikës, që një parafjalë mund të ketë brenda një konstrukti parafjalor-rasor. Ja disa shembuj: Ekuivalentit të parafjalës *nga* në shqip, i përgjigjen parafjalët *od* dhe *iz* në serbisht, por në varësi nga konteksti edhe parafjalët *kroz*, *ka*, *sa*. Nëse studentëve u është dhënë detyrë ta përkthejnë këtë fjali:

1. *Izašla sam iz prodvanice i krenua kući*, ata do ta përkthejnë saktë: 1.a. Dola *nga* dyqani dhe u nisa për në shtëpi.

Por fjalinë: 2. Ai u kthye *nga* unë. (në përkthim në serbisht: Okrenuo se *ka* meni), do ta përkthejnë: 2.a. Okrenuo se *od* mene, sepse gjatë përkthimit do të përqendrohen vetëm te kuptimi i parë i parafjalës, d.m.th. *od* dhe *iz*.

Përfundim

Përkthimi është një proces shumë kompleks që nënkupton transferimin e dy llojeve të ndryshme të përmbajtjes, gjuhësore dhe jashtgjuhësore, njohjen e thellë të gramatikës dhe sistemit leksikor, të të dy gjuhëve që shërbejnë si gjuhë burimore dhe gjuhë e synuar. Në rastin e studentëve tanë, gjatë studimeve të tyre, problemet kryesore në mësimdhënien dhe procesin e përkthimit janë ato të njësive gramatikore, që nuk ekzistojnë në serbisht, si ato që theksuam më lart: kategoria e trajtës së shquar dhe të pashquar të emrave, përvetësimi i përdorimit të drejtë të trajtës së emrit, dyfishimi i kundrinorit (ndonjëherë, përveç kundrinorit të drejtë edhe kundrinorit të zhdrejtë) si dhe bashkimi i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë.

Gabimet e studentëve tanë, gjatë procesit të përvetsimit të gjuhës së huaj, u referohen dy grupeve të mëdha të gabimeve, interlinguale dhe intralinguale. Jemi të mendimi që një ambient krijues, siç është klasa apo auditori, ku mësohet ajo, domethënë gjuha e huaj, nuk mund të jetë pa gabime. Ato janë të rëndësishme për mësimdhënësin si tregues i nivelit të arritur në procesin e mësimit dhe përvetësimit të gjuhës së huaj të çdo individi, janë sinjal që dëshmon pikat më të dobëta të këtij procesi, duke shërbyer njëkohësisht si provë, që procesi i mësimit/përvetësimit të gjuhës, është në progres.

Bibliofrafia

Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj Sh. et al. (2005). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shipërisë/Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Alhaysonzy, M. (2012) An Analysis of Erros among Saudi Female EFL Students: A Case Study. file:///Downloads/20759-67717-1-SM%20(2).pdf (aksesuar më 15 qershor 2016)

AbiSamra, N. (2003). An analysis of errors in Arabic speakers' English writing**.** In Mourtaga, K. (Ed.), *Investigating writing problems among Palestinian students studying English as a foreign language.* Unpublished doctoral dissertation.

Brown, H.D. (1994). *Principles of language learning and teaching.* Englewood Cliffs, NJ: Prentice Hall.

Corder, S. (1967). The significance of learners' errors. In Richard, J. (Ed.), *Error analysis: Perspectives on second language acquisition* (pp. 19-27). London: Longman.

Chomsky, N. (1965). *Aspects of the theory of syntax.* Cambridge, MA: MIT Press.

Çeliku, M. (2001). *Çështje të shqipes standarde*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.

Day, R. S. 1977. Systematic individual differences in information processing. In: P. G. Zimbardo;F. L. Ruch (Eds.). *Psychology and life. Research Frontier section*. Glenview ILL: Scott, Foresman, 5A-5D.

Demiraj, Sh. (1971). *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Edge, J. (1989). *Mistakes and Correction.*. Longman Keys to Language Teaching. Harlow: Longman.

Ellis, R. (1997). *SLA research and language teaching.* Oxford: Oxford University Press.

Gass, S., & Selinker, L. (1984). *Language transfer in language learning.* Rowley, MA: Newbury House.

Gómez Martínez, S. (2006). *Should we correct our students errors in l2 learning?* http://www.encuentrojournal.org/textos/16.8.pdf (askesuar më 25 qershor 2016)

FGJSH (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë/Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Hlebec, B. (2009). *Opšta načela prevođenja*. Beograd: Beogradska knjiga.

Latiff, R. A. & Bakar, A. N. (2007). Interference of Bahasa Malaysia (L1) in English (L2) essay writing among rural Malay Secondary school students in Malaysia. *Malaysia Journal of ELT Research, 4,* 72-102.

MacLaughlin, B. (1987) Theories of Second Language Learning. Edward Anorld Publishers: London.

Mitchell, R.; Myles, F. (2004). *Second language learning theories*. Second edition. London: Hodder Arnold.

Nida, E. (1975). *Language Structure and Translation*. Stanford: Stanford University Press. Piper, P. & Klajn, I. (2014). *Normativna gramatika srpskog jezika*. Novi Sad: Matica Srpska.

Richards, J.C (ed.) (1974). *Error analysis: Perspectives on second language acquisition*. London: Longman. Richards, J. (2002). *Longman dictionary of applied linguistics*. London: Oxford University Press.

Richards, J. C. & Schmidt, R. (2002). *Dictionary of language teaching and applied linguistics (3rd ed.)*. London: Longman.

РМС (1967). Речник српскохрватског књижевног језика (1967-78). Нови Сад-Загреб: Матица Српска/Матица Хрватска.

Stevanović, M. (1967). *Funkcije i značenja glagolskih vremena*. Beograd: SANU.

Merima KRIJEZI

MAIN PROBLEMS AND THE TYPES OF ERRORS IN TEACHING ALBANIAN AS FOREIGN LANGUAGE

Abstract

The paper is devoted to the study of errors and analysis of problems faced by students of the Albanian language, which are not native speakers of Albanian, in the process of translating from Albanian to Serbian and vice versa. The success of the process, which we call translating, depends on many factors, among which good knowledge of the language system (grammatical and lexical) of both languages, source as well as target language, including the knowledge of the out language reality and the context, take a crucial place.

The aim of the paper is to analyze those elements of the language system that are the bearers of the intent in these two languages and to clarify the relationship between the lexical and grammatical categories of the Albanian and Serbian languages, which may be the cause of possible mistakes and problems in translation. In this paper, we are analyzing examples of errors that are characteristic for the beginner levels, as well as higher levels of mastering the Albanian language - errors that arose as a result of the discrepancy between the corresponding language categories (indefinite and definite article of the noun, the inconsistency of the genus of correspondent nouns, the correspondent with the broader meaning range, etc.).

Key words: translation, contrastive approach, language code, errors in the translation process

Tanja TRAJKOVIĆ

FRAZEOLOGJIZMA ME KOMPONENTËT E ZOTIT DHE DJALLIT NË GJUHËN E SOTME SHQIPE DHE SERBE

Frazeologjia si „disiplina e shumëllojshme gjuhësore e kulturore“ përfshin edhe frazeologjizma biblikë, ekspresivitetit të së cilës posaçërisht kontribuojnë ata të cilët në përbërjen e tyre kanë komponentët e Zotit (*serbisht: Bog, Gospod; shqip: Zot, Perëndi, Allah, Hyjni*) dhe djallit *(serbisht: djavo, vrag; shqip: djall, shejtan, dreq)*. Sipas Rançiqit, botë e përsorur dhe e harmonizuar kuptohet si vepra e Zotit në të cilën gjithçka që prish harmoninë e saj është shpallur si e keqe dhe e padëshirueshme, kurse të gjitha ato fuqi të cilat shqetësojnë dhe dobësojnë vetëdijen e kthejnë kah ambivalencës dhe papërcaktimit janë simbolizuar në personazhin e djallit. Këtë këndvështrim kushtëzoi paraqitjen e jo vetëm numrit të madh të njësive paremike, por edhe paraqitjen e kolokacioneve frazeologjike e frazemave në përbërjen e të cilave janë këto dy absolute të kundështuara. Në lidhje me këtë, synimi themelor i këtij punimi është analiza e njësive të shtruara nga aspekti strukturor e leksiko-semantikor (ndërtime parafjalore-rasore, ndërtime foljore-emërore e sintagma), klasifikimi i tyre sipas fushave semantiko-frazeologjike në dy grupe: frazeologjizma që referohen njeriut e cilësive të tij dhe frazeologjizma në të cilët është shprehur qartë simbolizmi i Zotit dhe djallit, përkatësisht i të së mirës e të së keqes. Fondin frazeologjik përbëjnë (76) njësi në shqip dhe serbisht, ku ato me komponentin e Zotit në të dyja gjuhët janë më të shumta. Me korpusin e përzgjedhur janë zbuluar barasvlerës frazeologjikë të cilët mund të ndihmojnë përkthyesit e sidomos studentët në përvetësimin dhe zhvillimin e drejtë të kompetencës frazeologjike, meqë kjo ka shumë rëndësi sepse ende nuk ekziston asnjë fjalor frazeologjik shqip-serbisht. Njëkohësisht është kushtuar vëmendje më e madhe hulumtimit kontrastiv-komparativ të frazeologjizmave të gjuhës shqipe dhe serbe.

Fjalët çelëse: *frazeologji komparative, gjuha shqipe, gjuha serbe, Zot, djallë, strukturë*

1. Hyrje

Nga cili bregdet u ankorova, o, I fuqishmi,
Në atë mëngjes si në fillimin e poemës?

E çka kontribuon madhësisë sate,
Ai atomi im i hedhur në shkëlqimin e një dite? /.../
Zot, i cili më mbolli dhe ndien keqardhje,
Pse isha i nevojshëm në botë dhe regjiment,
E gjeta rrugën e pashë gjithçka përveç teje,
Por kur anohet anija ime, dorën tënde e gjej („Këngë Zotit" – Jovan Duçiq)

Mendimi hyrës i Duçiqit i shprehur në vargje tregon qartë që njeri duke ditur natyrën e paprekshme të Zotit brenda vetes e duke kërkuar përmbajtje hyjnore të jetës është në rrugë të madhe deri mbretërinë e Zotit, duke theksuar njëkohësisht me metaforë biblike që „Zoti askujt nuk impenjohet[1]", dhe „që çdo njeri në shpirtin e tij ka Zotin i cili do t'i afrohet ndonjëherë[2]". Gjithashtu, në përputhje me rolin, funksionin e tij, të vepruarin në Univers, natyrë, botë, e zemrën e njeriut, me emra biblikë përshkruesë qyhet edhe I plotfuqishmi, I pakuptueshmi, Shpëtuesi, Mbrojtësi, Krijësë jashtëtokësore, Krijues, në të cilët është simbolizuar edhe një nga energjitë e tij të shumta të parealizuar – bukuri, mençuri, e drejtë, e vërtetë, mëshirë, ndershmëri, pastërti, fuqi, dashuri, sinqeritet. „Sipas filozofisë së isihazmit i cili është në thelbin e të kuptuarit të krishterë të Zotit, ai është gjithëpranishëm në qenësinë e tij dhe në të gjitha energjitë e tij.[3]" Duke qenë se botë e përsorur dhe e harmonizuar kuptohet si vepra e Zotit nga një anë, e për të përshtatur kësaj bote edhe ato pjesë të cilat janë shënuar me cenat e tyre apo me të keqen nga ana tjetër, secila nga këto religjione përdor dualizmin e fshehur (apo në rast të bogomilizmit të pafshehur) – ajo që nuk përputhet me doktrinën e botës së drejtë të cilën e krijoi Zot i mirë, që prish harmoninë e botës së përsosur është shpallur si e keqe dhe e padëshirueshme (Ранчић 1997: 45-46). Në këtë mënyrë krijohet vend për të gjitha ato fuqitë të cilat shqetësojnë, dobësojnë vetëdijen dhe e kthejnë kah ambivalencës dhe papërcaktimit, janë simbolizuar në personazhin e djallit, i cili është „qendra e natës", dhe është në kundërshtim „me Zotin i cili është qendra e dritës dhe ditës". Njëri djeg në botë nëntokësore, e tjetri shkëlqen në qiell" (Chevalier–Gheerbrandt 1987: 143). Djalli është krijesë mitologjike e cila është pjesë e religjioneve abrahame dhe ka rolin e sfiduesit, detyron njerëzit në të keqen për të parë besimin e tyre, e ata të cilët pranojnë dhe i shoqërohen shfrytëzon për të bërë të keqen më të madhe shoqërisë (Muchembled 2010: 30). Emrat me të cilët paraqitet janë: Sotona, Lucifer, Shejtan, por

[1] Шевкунов, Тихон. (2013). *Несвети а свети и друге приче*. Београд. Информатика. faqe 87.
[2] Шевкунов, Тихон. (2013). *Несвети а свети и друге приче*. Београд. Информатика. faqe 125.
[3] Вера Георгијевска në Мршевић-Радовић, Драгана. (1997). *Бог заштитник у српској фразеологији*. Српска књижевност и Свето писмо. faqe 297.

edhe ata të frymëzuar me disa demona: Bellzebub, Belijaj, Levijatan, kurse emra të kanonizuar referohen funksioneve të cilat kryen, përkatësisht emra përshkruesë si Fantazmë e Keqe, Sulmuesi, Antikrisht. Frika nga djalli si krijesë transferohet edhe në frikë nga emri, e për këtë arsye për të njerëzit në popull kanë shumë eufemizma siç janë: „njëri i keq ", „zezak i madh", „Princi i kësaj bote", „gjarpër i vjetër", etj. Mbrapa emrave të ndryshëm si krijesë mitologjike fshihen karakteristikat e tij kryesore: sulmuesi, kundërshtari, armik, i pamoralshmi, i mallkuari. Është qartë se këto karakteristika grupohen rreth polit negativ duke përshkruar krijesë e cila krijohet me personifikimin e së keqes, përkatësisht me personifikimin e gjithçkaje që është kundër botës së mirë, qoftë kozmike, shoqërore apo njerëzore (Ранчић 1997: 16). E keqja është e vetmja gjë para së cilës një krijues popullor është memec, pa vullent të bëjë shaka, i shtangët që para diçkaje është i pafuqishëm, që fuqia e fjalës së tij nuk është aspak e madhe. Vetëm në disa fjalë të urta ndihet ndonjë tingull, nëse jo të toneve ironike, të paktën të toneve disi gazmore, të ngjashme me pranimin e telashit të jetohet me të keqen dhe që fat i keq duhet të durohet pa kundrështim (Јовановић 2005: 158).

2. Lënda, qëllimi e metodologjia e punimit

Duke marrë parasysh faktin që „fjalët e urta na ndihmojnë të kuptojmë botën, përkatësisht, si vetë natyrën e njeriut po ashtu edhe njeriun, e si vetë realiteti është i larmishëm e ndonjëherë edhe kontradiktor, kjo kontradiktë shprehet edhe në paremi[4]." Për këto arsye, në thelbin e hulumtimit është synimi të paraqitet në mënyrë sa më ekspresive dhe interesante njësitë me këta dy komponentë, bashkë me barasvlerësit e tyre gjuhësorë të vendndodhjes së vogël apo të madhe semantike, përkatësisht frazeologjizma që referohen njeriut e cilësive të tij dhe frazeologjizma në të cilët është shprehur qartë simbolizmi i Zotit dhe djallit, apo i së mirës dhe i së keqes në fusha leksikore-semantike me anë të teknikës së diferencialit semantik të Çarls Ozgudit (Charles E. Osgood, 1967). Korpusi[5] përfshin 76 njësi frazeologjike gjuhësore të ngulitura dhe të pangulitura të cilat sipas kuptimit dhe vlerës përdoruese komunikative mund të renditen në disa grupe: mallkime, ofendime, betime, kërcënime, thënie, falënderime, këshilla, përgëzime, adhurim, dëshira etj. Gjithashtu janë përfshirë edhe frazeologjizma të cilët në vend të leksemës Zot a djall kanë mbiemra hyjnor a djallzor, përkatësisht djavolji dhe bożji, siç është rast me shembuj: ***prej gojës sate në***

[4] Amando de Miguel në Пејовић, Анђелка. (2015). *Контрастивна фразеологија шпанског и српског језика.* Крагујевац. Филолошко-уметнички факултет.
[5] Трајковић, Тања. (2017). Албанско-српски фразеолошки речник. (në dorëshkrim).

veshët e Zotit □ iz tvojih usta u božje uši, ***në kopshtin e Zotit linden shumë engjëj dhe djaj*** u božjoj bašti razne tikve rastu, ***drejtësia e Zotit*** □ božja pravda, ***jepi Cesarit atë që është e Cesarit dhe Perëndisë atë që është e Perëndisë*** □ dajte carevu carevo / Cezaru Cezarovo a Bogu što je božje; ***me ndihmën e Zotit*** □ uz božju pomoć, ***ndëshkimi i Zotit*** □ božja kazna, ***dhuratë e Perëndisë*** □ božji dar; ***të gabosh është njerëzore, të falësh është hyjnore*** □ ljudski je grešiti a božanski praštati, ***njeri hyjnor*** □ božji čovek, ***fjala e Zotit*** □ božja reč, ***mbretëria e Zotit*** □ božje kraljevstvo, ***punët e djallit*** □ djavolja posla;

Në përputhjen me pjesën e dytë të punimit njësitë do të analizohen edhe nga aspekti strukturor (ndërtime parafjalore-rasore, ndërtime foljore-emërore e sintagma) ku janë shënuar edhe dy frazeologjizma me strukturë krahasuese (***qëndron si shkëmb*** □ stajati kao drveni Bog, ***largohet si shejtani nga tamjani*** □ bežati kao djavo od krsta). Në varësi nga mjedisi gjuhësor, përkatësisht konteksti, është shënuar që shumica prej shembujve mund të kenë më shumë se një barasvlerës përkthimor. Në këtë rast është dhënë edhe përkthim drejtpërdrejtë nga serbishtja, meqë bëhet fjalë për njësi të cilat nuk përputhen as nga aspekti kuptimor as edhe formal me ato njësi në gjuhën shqipe (***nuk ka shtënë në Zotin me gur*** □ nismo Boga hulili, nismo Boga kamenom gadjali, ***pas shpinës së Zotit*** □ Bogu iza ledja, Bogu iza nogu, Bogu iza taraba, tamo gde je i Bog rekao laku noć / zbogom, ***Zoti thotë hidhu të të hedh*** □ Bog pomaže onome ko i sam sebi pomaže, ko se sam čuva i Bog ga čuva; ***largë qoftë Zotit!*** □ ne daj Bože! ne dao Bog! ne čuo Bog! Sačuvaj Bože i sakloni! ***ka lindur përpara shejtanit*** □ i djavola bi na ledu potkovao, djavolu je ispod čekića utekao), po ashtu edhe disa njesi të cilat në gjuhën shqipe apo serbe në përbërjen e tyre nuk kanë leksema Zot a djallë (***qëndron si shkëmb*** □ stajati kao drveni Bog, ***rron si pashë*** □ živeti kao mali Bog, biti rođen u svili i kadifi, sa zlatnom kašikom u ustima, ***e drejta vonon por nuk harron*** □ Bog se možda i zabavi, ali ne zaboravi, pravda je spora ali dostižna; ***Zoti të mbyll një derë (portë) hap një tjetër*** □ kad se jedna vrata zatvore, druga se otvore, ***nxjerr ujë në vatër*** □ uhvatiti Boga za bradu; ***mbys dikë së rrahuri*** ubiti Boga u kome, odrati koga kao vola u kupusu; ***nuk lëviz as gishtin*** □ ne raditi ništa pod milim Bogom, krasti Bogu dane, ***u nda nga jeta*** □ predati dušu Bogu; ***cjapi mish e dhia tavë, dhia mish e cjapi tavë*** □ nije đavo nego vrag, nije šija nego vrat, ***ide të reja në forma të vjetra*** □ jedan te isti djavo; ***situata u bë më serioze*** □ vrag je odneo šalu; ***situata u bë më e keqe*** □ djavo je umešao prste; ***agjëron ditën e vjedh natën*** □ biti danju andjeo a noću djavo, ispod mire sto vraga vire, ***e di ku pjell pula*** □ znati gde djavo spava, ***ka pirë gurin e gjakut*** □ patiti / mučiti se kao djavo u plitkoj vodi, ***po të përzihesh me krunde, do të të hanë pulat*** □ ko s djavolom tikve sadi, o glavu mu se lupaju, ***e di ku pjell pula*** □ znati gde djavo spava).

3.1. Analiza leksikore-semantike e korpusit

3. 1. 1. Бог, Gospod / Zot, Perëndi, Allah, Hyjni (26 fushë semantikore)

ndryshueshmëri / dallueshmëri; largësi, mbrojtje, shpresë / lutje; drejtësi, bezdi / mërzitje; mëkat, mungesë vetëdije; mendjemadhësi, ndëshkim, mundësi / shansë / rast; mirënjohje, ndihmë, egoizëm, betim, dhuratë, mirësi, pasuri / bollëk; fuqi / forcë; falje, rrahje / goditje; idhull, rëndësi, dembelizëm, ngurtësi, vdekje, dëshpërim;

shpresë, lutje:

Prej gojës sate në veshët e Zotit □ iz tvojih usta u božje uši; ***Nuk ka shtënë në Zotin me gur*** („nije Boga kamenom pucao“) □ nismo Boga hulili, nismo Boga kamenom gadjali

mbrojtje:

Zot, më ruajtë nga miqtë se nga armiqtë ruhem vetë □ Bože, čuvaj me od prijatelja, od neprijatelja ću se sam čuvati

largësi:

Pas shpinës së Zotit □ Bogu iza ledja, Bogu iza nogu, Bogu iza taraba, tamo gde je i Bog rekao laku noć/zbogom

ndryshueshmëri, dallueshmëri:

Në kopshtin e Zotit linden shumë engjëj dhe djaj („u božjoj bašti radja se mnogo andjela i djavola“) □ u božjoj bašti razne tikve rastu

drejtësi:

Drejtësia e Zotit □ božja pravda; ***E drejta vonon por nuk harron*** („pravda kasni ali ne zaboravlja“) □ Bog se možda i zabavi, ali ne zaboravi, pravda je spora ali dostižna; ***Jepi Cesarit atë që është e Cesarit dhe Perëndisë atë që është e Perëndisë*** □ dajte carevu carevo / Cezaru Cezarovo a Bogu što je božje; ***Ka Zot*** □ ima Boga;

bezdi, mërzitje:

Është bërë i bezdishëm edhe te Zoti („postati i kod Boga dosadan“) □ dosaditi i Bogu i narodu

mëkat, mungesë vetëdije:

Falu o Zot, se nuk dine ç'bëjnë □ oprosti im Bože, ne znaju šta čine

ndihmë:

Me ndihmën e Zotit □ uz božju pomoć; ***Zoti thotë hidhu të të hedh*** („Bog kaže baci da bi te bacilli) □ Bog pomaže onome ko i sam sebi pomaže, ko se sam čuva

i Bog ga čuva; ***Sebep prej meje, derman prej Zotit*** („uzrok / povod od mene, lek / spas od Boga“) □ od mene toliko, a od Boga više

mirënjohje:

Lavdi Zotit □ Bogu hvala

mundësi, shansë, rast:

Zoti të mbyll një derë (portë) hap një tjetër („Bog ti zatvori jedna vrata, ali ti otvori druga“) □ kad se jedna vrata zatvore, druga se otvore

ndëshkim:

Ndëshkimi i Zotit □ božja kazna

mendjemadhësi:

E beson veten Perëndi („veruje za sebe da je Bog“) □ umislio da je Bog; ***Nxjerr ujë në vatër*** („izvaditi vodu na vatru “) □ uhvatiti Boga za bradu;

egoizëm:

Prifti më përpara bekon mjekrën e tij („Bog je najpre sebi bradu blagosilja“) □ Bog je najpre sebi bradu stvorio

betim:

Pasha Zotin □ Bogom se kunem

mirësi, pasuri, bollëk:

Rron si pashë („živeti kao paša “) □ živeti kao mali Bog, biti rođen u svili i kadifi, sa zlatnom kašikom u ustima

bekim:

Zoti ju (të) bëfkofte □ Bog te / vas blagoslovio; ***Dhuratë e Perëndisë*** □ božji dar;

fuqi, forcë:

Kush ka Zotin me vete, nuk ka nevojë për miq („ko ima Boga uza se, nema potrebu za prijateljima“) □ kad je Bog s tobom, ko može biti protiv tebe; ***Forca nuk e lut Zotin*** □ sila Boga ne moli; ***Është në dorë të Zotit*** □ biti u božjim rukama; ***Vetëm Zoti mund të më gjykojë*** □ samo Bog može da mi sudi; ***Njëriu mendon, Zoti vendon*** („čovek misli, Bog odlučuje“) □ čovek snuje, Bog odlučuje; ***Le të na ruajë Zoti*** □ neka nas Bog sačuva; ***Secili për vete, Zoti për të gjithë*** □ svako za sebe, a Bog za sve; ***Siç më jep Zoti*** („kako mi Bog da“) □ kako / šta mi Bog da; ***Një Zot di*** („samo jedan Bog zna “) □ samo dragi / mili Bog zna; ***Nëse Zoti lejon*** („ako Bog dozvoli“) □ ako Bog da; ***Largë qoftë Zotit!*** („daleko bilo od Boga“) □ ne daj Bože! ne dao Bog! ne čuo Bog! Sačuvaj Bože i sakloni! ***Njëriu bën plane, Zoti qesh*** □ čovek pravi planove, Bog se smeje; ***Zoti e di sa*** □ Bog zna koliko;

falje:

Të gabosh është njerëzore, të falësh është hyjnore □ ljudski je grešiti a božanski praštati

idhull:

E ka si Perëndi („ima ga kao Boga“) ▱ gledati koga kao da je sam Bog, kao u Boga

rrahje, goditje:

Mbys dikë së rrahuri („udaviti koga od batina“) ▱ ubiti Boga u kome, odrati koga kao vola u kupusu

rëndësi:

Njeri me peshë (rëndësi) („čovek od značaja, koji ima težinu“) ▱ biti Bog i batina, biti krupna zverka

dembelizëm:

Nuk lëviz as gishtin („ne pomera ni prst“) ▱ ne raditi ništa pod milim Bogom, krasti Bogu dane

ngurtësi:

Qëndron si shkëmb („stoji kao stena“) ▱ stajati kao drveni Bog

vdekje:

U nda nga jeta („odvojio se od života“) ▱ predati dušu Bogu; ***Vdeksh ishalla!*** ▱ crko da bog da!

dëshpërim:

Zoti e di nga □ pitaj Boga odakle

Zoti e di kur □ pitaj Boga kad

As vetë Zoti □ ni sam Bog

3. 1. 2. Djavo, Vrag / Djall / Dreq / Shejtan (17 fushë semantikore)

mundim, përkeqësim, ngjashmëri, njëtrajtshmëri; shtrenjtë, e keqe, arrastisje, mashtrim, tradhti, ndërhyrje, përzierje; shqetësim, telash, provokim, i (e) zi (zezë), dinakëri, zemërim;

ngjashmëri, njëtrajtshmëri:

Cjapi mish e dhia tavë, dhia mish e cjapi tavë („jarčevo meso i kozina tepsija, kozina meso i jarčeva tepsija“) ▱ nije đavo nego vrag, nije šija nego vrat; ***Ide të reja në forma të vjetra*** („nove ideje u starim formama“) □ jedan te isti djavo

përkeqësim:

Situata u bë më serioze („situacija je postala ozbiljna“) □ vrag je odneo šalu; ***Situata u bë më e keqe*** („situacija je postala još gora“) ▱ djavo je umešao prste

shtrenjtë:

Kushton një djall (një dreq) e gjysmë □ koštati djavo i po, kao svetog Petra kajgana

e keqe:

Është mishëri (dredha) i vetë djallit □ biti oličenje samog djavola; ***I ka hyrë djalli (dreqi, shejtani, macja, maçoku)*** □ ušao djavo u koga; ***Bën paktin me djallin*** □ sklopiti pakt s djavolom; ***Ia shes shpirtin shejtanit*** □ prodati dušu djavolu; ***Ka lindur përpara shejtanit*** („rodio se pre djavola ") □ i djavola bi na ledu potkovao, djavolu je ispod čekića utekao; ***I shtie (e fut) shejtanin (djallin) në shishe*** („staviti djavola u bocu") □ ispasti djavolu iz torbe

mashtrim, tradhti:

Engjëll në rini djall (shejtan) në pleqëri □ andjeo u mladosti, djavo u starosti; ***Agjëron ditën e vjedh natën*** („postiti danju a krasti noću") □ biti danju andjeo a noću djavo, ispod mire sto vraga vire

arrastisje:

Largohet si shejtani nga tamjani □ bežati kao djavo od krsta

mundim:

Ka pirë gurin e gjakut („piti kamenovu krv") □ patiti / mučiti se kao djavo u plitkoj vodi

ndërhyrje, përzierje:

Po të përzihesh me krunde, do të të hanë pulat („pomešaš li se sa mekinjama, poješće te kokoške") □ ko s djavolom tikve sadi, o glavu mu se lupaju

shqetësim:

Shejtani nuk fle kurrë □ djavo nikada ne miruje / spava

telash:

E kërkon belanë („tražiti nevolju") □ tražiti djavola

zi:

I zi si katran („crn kao katran") □ crn kao djavo; ***Djalli nuk është kaq i zi*** □ nije djavo uvek tako crn

dinakëri:

E di ku pjell pula („gde kokoška polaže jaja") □ znati gde djavo spava

zemërim:

Dreqi e mori □ vrag ga odneo!

Çfarë dreqin e ke? □ koji ti je vrag/djavo?

Vafsh në djall! □ idi do djavola! do vraga!

3.2. Analiza strukturore e korpusit

3.2.1. sinagma:

Njeri hyjnor □ božji čovek, ***Fjala e Zotit*** □ božja reč, ***Ndëshkimi i Zotit*** □ božja kazna, ***Mbretëria e Zotit*** □ božje kraljevstvo, ***Dhuratë e Perëndisë*** □ božji dar, ***Drejtësia e Zotit*** □ božja pravda, ***Punët e djallit*** □ djavolja posla

3.2.2. ndërtime parafoljore-rasore të tipit me, prej, pas, për + emër:

Me ndihmën e Zotit □ uz božju pomoć; ***Prej gojës sate në veshët e Zotit*** □ iz tvojih usta u božje uši; ***Pas shpinës së Zotit*** □ Bogu iza ledja, Bogu iza nogu, Bogu iza taraba, tamo gde je i Bog rekao laku noć/zbogom; ***Me Zotin përpara*** □ s Bogom napred; ***Për hir të Zotit, Për Zotin*** □ za Boga miloga, za milost božju;

3.3.3. ndërtime foljore-emërore të tipit folje + emër (një ndërtim krahasues i tipit folje + si + emër):

Qëndron si shkëmb („stoji kao stena ") □ stajati kao drveni Bog; ***Nuk lëviz as gishtin*** („ne pomera ni prst") □ ne raditi ništa pod milim Bogom, krasti Bogu dane; ***U nda nga jeta*** („odvojio se od života ") □ predati dušu Bogu; ***Largohet si shejtani nga tamjani*** □ bežati kao djavo od krsta; ***Kushton një djall (një dreq) e gjysmë*** □ koštati djavo i po, kao svetog Petra kajgana; ***I ka hyrë djalli (dreqi, shejtani, macja, maçoku)*** □ ušao djavo u koga; ***Bën paktin me djallin*** □ sklopiti pakt s djavolom; ***Ia shes shpirtin shejtanit*** □ prodati dušu djavolu; ***Ka lindur përpara shejtanit*** („rodio se pre djavola") □ i djavola bi na ledu potkovao, djavolu je ispod čekića utekao; ***I shtie (e fut) shejtanin (djallin) në shishe*** („staviti djavola u bocu ") □ ispasti djavolu iz torbe;

4. Përfundim

Frazeologjia si „disiplina e shumëllojshme gjuhësore e kulturore[6]" përfshin edhe frazeologjizma biblikë, ekspresivitetit të së cilës posaçërisht kontribuojnë ata të cilët në përbërjen e tyre kanë komponentët e Zotit (*serbisht: Bog, Gospod; shqip: Zot, Perëndi, Allah, Hyjni*) dhe djallit *(serbisht: djavo, vrag; shqip: djall, shejtan, dreq)*. Dy parime të kundërshtuara dhe mbartësit e tyre – Zoti si krijuesi e mbrojtësi i së mirës dhe djalli si propagandist i së keqes – ndërpriten e kryqëzohen në hapësirë jetësore në të cilën është gjykuar njeri. Ata bëjnë atë hapësirë të paqëndrueshme dhe të pasigurt, plot me rreziqe dhe ndryshime të shpeshta (Јовановић 2005: 158). Botë e polarizuar paraqitet

[6] Fink-Arnovski, Željka. (2002). *Poredbena frazeologija: pogled izvana i iznutra.* Zagreb. FF PRES faqe 5.

si e ndarë midis gjuhës së keqes dhe gjuhës së mirës, midis librit të Zotit dhe librit të djallit, por edhe midis luftës së përjetshme të fantazmës së mirë dhe fantazmës së keqe. Pothuajse çdo njeri gjatë jetës tokësore në pamje shpirtërore përpiqet të shpëtojë veten, ngjitet deri lartësitë dhe dritën e Zotit, por meqë kjo është „rrugë e vështirë e dyer janë të ngushta[7]“ është i detyruar me aktin e tij të vetëdijes në luftë me botë të ftohtë dhe me të keqen e cila për arsye vetjake të pashpjegueshme me forcën e saj të keqe sfidon, frikëson, huton, nxi jetën dhe çon botë dhe individë deri gjendjen e dëshpërimit, pashpresë dhe humbjen e besimit. Për këto arsye qëllimi kryesor i punimit ishte të tregohet me anë të analizës leksikore-semantiko dhe strukturore se si antipode leksikore korrespondojnë me njësi paremike dhe shprehje idiomatike në gjuhën e sotme serbe dhe shqipe duke treguar njëkohësisht statusin e tyre proporcional në kulturën e tyre por edhe lidhje interesante me dihotominë e mira-e keqe. Me korpusin e përzgjedhur i cili përfshin njësi të cilat komponentin e Zotit në të dyja gjuhët janë më të shumta (Zot - 52, djallë - 24), por edhe ato të gradës së ulët apo të lartë ekspresive të komunikimit të përditshëm, janë zbuluar barasvlerës frazeologjikë të cilët mund të ndihmojnë përkthyesit e sidomos studentët në përvetësimin dhe zhvillimin e drejtë të kompetencës frazeologjike ku qëllimi kryesor duhet të jetë nivel i lartë bisedor i folësve. Njëkohësisht është kushtuar vëmendje më e madhe hulumtimit kontrastiv-komparativ të frazeologjizmave të gjuhës shqipe dhe serbe, por këtë herë edhe nga aspekti i gjuhësisë kognitive.

Literatura e cituar

Chevalier, Jean; Alan Gheerbrandt. (1987). *Rječnik simbola: mitovi, sni, običaji, geste, oblici, likovi, boje, brojevi*. Zagreb: Nakladni zavod MH.

Дучић, Јован. (1989). *Песме.* Нови Сад. Матица српска.

Fink-Arnovski, Željka. (2002). *Poredbena frazeologija: pogled izvana i iznutra.* Zagreb. FF PRES

Ильин. Иван. (2010). *Загледан у живот.* Београд. Бернар-Тихи глас.

Јовановић, Јелена. (2005). *О тематици пословица.* Зборник Матице српске за књижевност и језик. Књ. 53, св. 1/3. стр. 144-206.

Мршевић-Радовић, Драгана. (1997). *Бог заштитник у српској фразеологији*. Српска књижевност и Свето писмо. 297-304.

Muchembled, Robert. (2010). *Đavo od XII do XX stoljeća. Jedna priča*. Zagreb: Naklada Pelago.

[7] Ильин. Иван. (2010). *Загледан у живот.* Београд. Бернар-Тихи глас. faqe 191.

Пејовић, Анђелка. (2015). *Контрастивна фразеологија шпанског и српског језика.* Крагујевац. Филолошко-уметнички факултет.

Rančić, Jasminka. (1997). *Đavo u mitologiji Južnih Slovena*. Beograd: Idea, Beograd.

Шевкунов, Тихон. (2013). *Несвети а свети и друге приче*. Београд. Информатика.

Трајковић, Тања. (2017). *Албанско-српски фразеолошки речник* (në dorëshkrim).

Tanja TRAJKOVIĆ

PHRASEOLOGISMS WITH THE COMPONENTS OF GOD AND DEVIL IN MODERN ALBANIAN AND SERBIAN LANGUAGE

Abstract

Phraseology as a "multilingual and cultural discipline" includes expressive biblical phrases that have the components of God *(Serbian: Bog, Gospod; Albanian: Zot, Perëndi, Allah, Hyjni*) and Devil *(Serbian: djavo, vrag; Albanian: djall, shejtan, dreq).* According to Ranchic (Rančić / Ранчић), the harmonious and perfect world is understood as the creation of God where everything that discomfort harmony is proclaimed as evil and undesirable, and all those powers that disturb and weak consciousness and turn them to ambivalence and undetermination are symbolized in the devil's character. This kind of view conditioned the appearance of not only the large number of paremic units, but also the phraseological phrases that in their composition have these two absolute opposites. With that beeing said, the purpose of this paper is the analysis of the units introduced from the structural and lexical-semantic aspects (preposition, verbal and noun constructions and syntagms), their classification by semantic-phraseologycal fields in two groups: phraseologisms referring to man and his qualities and phrases in which the symbolism of the God and Devil is clearly expressed. The phraseological fund consists of (76) units in Albanian and Serbian, where those with the God component in both languages are the most numerous. Selected corpus of units consist of their equivalents in Serbian and this can help interpreters and especially students in the acquisition and proper development of the phraseological competence. This is important because there is no Albanian-Serbian vocabulary dictionary yet. At the same time we paid more attention to the contrastive and comparative research of Albanian and Serbian phraseologisms.

Key words: contrastive phraseology, Albanian, Serbian, structure, God, Devil

Evalda PACI

ÇËSHTJE TË RECEPTIMIT TË TEKSTEVE TË VJETRA SHQIPE NË PROGRAMET UNIVERSITARE SHQIPTARE

Çështja e receptimit të teksteve të vjetra shqipe në programet shqiptare cek njëherësh dhe problematikën e studimit shkencor të tyre, edhe domosdoshmërinë e brendësimit të duhur nga ana e studentëve tanë, të parët destinatarë të cilëve u ofrohet një perspektivë pak më e ndryshme në pikëpamje të qasjes me përmbajtjen e tyre.

Në programet shkollore parauniversitare tradicionalisht janë përzgjedhur pjesët që në njëfarë mënyre përfaqësojnë një lloj tipologjie tekstore dhe përmbajtësore nga vepra. Një fakt i tillë dëshmohet me fragmentet që përzgjedh Justin Rrota në vëllimin *Letratyra shqype*(1925), E.Çabej në vitet '30 të shekullit të kaluar[1], apo dhe në ndonjë përmbledhje tjetër pasuese, po që ruan të njëjtën prirje tematike dhe shkencore. Nëse do të orientoheshim ndaj një qasjeje që synon kah historiku i reflektimit të këtyre pjesëve, do të vërenim se jo përherë prirja për trajtimin e këtyre teksteve ka qenë e njëjtë, pavarësisht se përpiluesit e teksteve ndaj pjesëve të përzgjedhura kanë ruajtur një lloj tradicionaliteti në të pasqyruarit e tyre.

Duhet vënë re pa dyshim që pas gjysmës së parë të shekullit të kaluar ka pasur dhe prirje për të nënvizuar në mënyrë të veçuar elemente (fjalë e lema) nga këto tekste, duke u distancuar në njëfarë mënyrë nga tematika e mirëfilltë e tyre, që anon nga përmasa fetare për vetë destinacionin dhe qëllimin e përpilimit konkret që kishin. Devijimi që në këtë drejtim vihet re në disa tekste shkollore tonat nuk përkon me disa studime të thukëta, por mjaft domethënëse që realizohen në përvjetorë jubilarë, siç është dhe ai i lindjes së Pjetër Budit në vitin 1966 e që u shoqërua me botimin e disa shkrimeve në lidhje me gjuhën dhe veprimtarinë e këtij prelati të historisë dhe letrave shqipe. E njëjta gjë mund të thuhet dhe nëse i referohemi ndonjë sprove nga grupe autorësh e që kanë objekt të vetin historinë e letërsisë së shkruar shqipe. Veçanërisht gjatë regjimit të kaluar shtetëror nuk gjurmohet një linearitet i mirëfilltë sa i takon qoftë mënyrës së trajtimit të autorëve të kësaj letërsie, ashtu dhe kontekstualizimit të letërsisë së vjetër shqipe në një kuadër sa historik, aq dhe socioletrar. Qasja me tekstet

[1] Çabej E., *Elemente të gjuhësisë dhe literaturës shqipe (me pjesa të zgjedhura për shkollat e mesme),* Tiranë, 1936.

e kësaj letërsie sigurisht që ka dallimet e veta në çdo periudhë të receptimit të tyre në shkollat tona, por në radhë të parë dhe në studimet tona.

Pavarësisht këtyre vërejtjeve që kanë të bëjnë me botime të caktuara e që jo gjithmonë janë të caktuara për nivelet universitare, në vitet 50-60' të shekullit të kaluar arrin të përvijohet një prirje e qartë që shënohet nga riprodhime të plota në dimensione botimesh kritike të papërsëritshme si nga pikëpamja e shkollës filologjike që përfaqësojnë, ashtu dhe nga pikëpamja e përafrimit shkencor që arrihet me anë të pajisjes së botimit me një aparat kritik plotësues ndaj përmbajtjes së veprës në fjalë.[2]

Sigurisht u referohemi në radhë të parë botimeve përkatëse të librit të Gjon Buzukut(1555), një pararojë arritjesh në një lamije aspak të lehtë për filologët dhe studiuesit e historisë së letërsisë së shkruar shqipe. Si Namik Ressuli, autor i botimit të *Mesharit* në variantin e vitit 1958 në Romë, ashtu dhe Eqrem Çabej, realizues i botimit kritik dyvëllimësh të këtij libri(1968), janë autorë studimesh që kanë të bëjnë edhe me tekstet e vjetra shqipe, por dhe me botimin e veprave përkatëse. Namik Ressuli analizoi më së miri dhe shkrimet që tradicionalisht i konsiderojmë si parabuzukiane, duke i përmbledhur në një vëllim unik trajtesat e tij në lidhje me këto dokumente shkrimore të rëndësishme. [3]

Një platformë e mirëfilltë pikëpamjesh por dhe që shtron qartë dhe në mënyrë më se objektive vështirësitë reale në leximin dhe interpretimin e teksteve të vjetra shqipe paraqitet nga Eqrem Çabej(1958-1959), ndërsa trajtohen me radhë çështjet e dallimit konceptual mes transliterimit dhe transkribimit, rëndësisë që paraqet veçanërisht në rastin e këtyre autorëve çështja e njohjes së inkoherencave grafike dhe ortografike në të shkruarit e tyre.[4] Po ky studiues nuk mungon të parashtrojë në studime që pasojnë njëri-tjetrin rëndësinë që ka për mjaft disiplina gjurmimi i mëtejmë i burimeve të panjohura që mund dhe të përkojnë në pikëpamje kronologjike me veprat që njiheshin asokohe dhe për të cilat sa herë tërhiqej vëmendja ndaj gjendjes së tyre në biblioteka evropiane, po aq herë nënvizohej dhe fakti që mund të kishin kësomblla të ngjashme apo ribotime të përafërta nëpër arkiva. Gjurmimet e sipërpërmendura të Eqrem Çabejt përkojnë në të vërtetë dhe me realizimin prej tij të botimit kritik të librit të Gjon Buzukut, pavarësisht se ky i fundit sheh dritën e botimit të fund të viteve '60.

Rëndësia e studimit të këtyre teksteve qëndron përherë në shkallën e një prioriteti të padiskutueshëm. Jo më pak të rëndësishme do të thoshim shfaqen

[2] Në studimet që i introduktojnë të tilla botime rimerret çështja e autorësisë dhe e referencialitetit ndaj burimeve gjegjëse në gjuhë të tjera, duke u cekur kësisoj thelbi i metodës së studimit të teksteve të vjetra në gjuhën shqipe.

[3] Ressuli N., *I più antichi testi albanesi*, Torino, 1978.

[4] Çabej E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në *BUSHT,* n.2, 1959.

kontribute të shkruara në gjuhën latine që me gjithë natyrën edhe historiografike, edhe deskriptive në thelb të konceptimit të tyre, mbeten monumente shkrimore që u bënë dhe në vitet e fundit burim referimi për studiues që ishin të interesuar të saktësonin rrethana, ngjarje, por dhe vende e momente nga një periudhë e rëndësishme e historisë së kombit tonë. Kemi parasysh faktin se të tilla vepra bëjnë të mundur një rikthim në çështjet e rindërtimit të gjeografisë së mesjetës së vonë, onomastikës e toponomastikës përkatëse, por dhe burimeve historiografike gjegjëse e që vënë në diskutim dhe metodën e studimit dhe brendësimit të teksteve të këtyre veprave.

Këto tekste përfaqësojnë njëherësh përballjen me një të kaluar të shënuar nga ngjarje decizive në historinë e Evropës dhe Ballkanit. Institucione të rëndësishme të besimit fetar përfshihen në një problematikë që kërkonte pa dyshim reflektim dhe rishikime të teksteve më themelore të praktikës së liturgjisë.

Tekstet e vjetra shqipe nuk janë pa rëndësi dhe pa interes në një kontekst të tillë. Qasja me burime të duhura referenciale në veçanti në rastin e shqipërimeve që përmbahen te *Meshari* dhe në veprën e Pjetër Budit mbetet dëshmi kyçe jo vetëm e faktit që të tilla vepra nuk u përpiluan pa vështirësi konkrete, por dhe e rrethanave të tjera, në të cilat do të veçonim pikërisht adaptimin e modelit të librit të orëve në praktikën e liturgjisë së përditshme si dhe atë të Doktrinës së Kërshtenë që në kontekstin tonë(në lidhje me Pjetër Budin në veçanti) përkon me atë të Bellarminos.

Një perspektivë e tillë sigurisht që përforcon një kuadër dhe të studimit tekstor e filologjik të këtyre veprave në programet universitare e në veçanti në ato pasuniversitare. Qasja mes variantesh në dy gjuhë, kryesisht latinishtes në të cilën shkruheshin asokohe librat e orëve dhe shqipes sonë bën të mundur një reflektim më konkret dhe objektiv ndaj brendisë së teksteve në fjalë dhe një përafrim më origjinal që në këtë rasë përshtatet më shumë me profilin e studimit në nivelin e studimeve pasuniversitare. Një regjistër krejt specialistik ndërtimesh e termash, një larmi përdorimesh që anojnë dhe nga literaliteti e shprehësia, një prirje normëzimi sa u takon paradigmave të caktuara dhe një shkallë jo e papërfillshme e elementeve bazike të leksikut të krishterë merr formë gradualisht duke u shfaqur dhe më konkret në realizime të mëvona të varianteve kateketike të shkruara në gjuhën tonë. Të mos harrojmë në këtë trajtesë përmendjen e varianteve a fragmenteve nga *Libri i Urtësë*(Liber Sapientiae), apo pjesë të tjera nga Besëlidhja e Vjetër që dallojnë mirëfilli në pikëpamje tematike e tekstore nga ato të Besëlidhjes së Re. Ndjekja e kësaj vijimësie në tekstet e Pjetër Bogdanit(1685) në veçanti bën të mundur plotësimin e një diakronie vështrimesh që iniciohet te *Meshari* e merr përmasa të mëtejme në vepra të mëvona.[5]

[5] Në variantet kateketike pjesët nga Ungjilli nuk mungojnë, por mbizotërojnë natyrshëm në to tekste lutjesh që lidhen pazgjidhshmërisht me praktikën e përditshme liturgjike. Vetë

Vetë leksiku i këtyre teksteve është bërë objekt evidentimi, por dhe studimi më të thelluar nga gjurmuesit e teksteve të vjetra shqipe. Vetë përmbajtja specifike e tyre ka mundësuar dhe sistemime jo thjesht evidentuese të leksikonit përkatës nga këto vepra. Nga ana tjetër, me kalimin e kohës dhe përmasa e vështrimit diakronik arrin një qasje përherë e më domethënëse, që do të konkretizohej më së miri dhe në përpilimin e një fjalori (thesaurus) gjithëpërfshirës të veprave të autorëve të letërsisë së vjetër shqipe. Sigurisht, kjo tematikë dikton patjetër një kufi kohor të përfshirjes së veprave në fjalë, duke ditur që edhe trashëgimi i mjaft përdorimeve vihet re dhe në periudha të mëvona kohore.

Nga ana tjetër, një traditë studimesh më se e mirënjohur në ditët tona rikonfirmon se qasja ndaj teksteve të vjetra shqipe ka qenë përherë një prirje jo vetëm për të nënvizuar rëndësinë e studimit të historisë së shkrimit shqip, trajtimin në disa pikëpamje të rrethanave historike që shoqëruan lindjen e një letërsie me një tematikë të tillë në shqipe, por dhe një synim metodologjik ndaj gjurmimit përmbajtësor dhe tekstologjik të brendisë së tyre. Që në sprovat më të para që sollën në trajtë të përshtatur apo mirëfilli të transkribuar pjesë nga këto vepra, qasja tekstologjike dhe sqarimi i lemave të caktuara mbetet një synim krejt i qartë dhe një linjë komode sa i takon studimit të tyre prej studentit dhe lexuesit. Diversiteti metodologjik por dhe përkimet në disa pikëpamje të përzgjedhjes së teksteve në fjalë nuk mbeten fakte të parëndësishme duke pasur parasysh se studiuesit tanë njihnin mirë dhe modele analoge të realizimit të librave të ngjashëm në gjuhë të tjera dhe vise të afërta.

Pavarësisht diferencimeve të qarta që bien në sy çdo herë që krahasohen mes tyre të tilla paraqitje të teksteve të vjetra shqipe nga studiues të ndryshëm, përzgjedhja e tyre përforcon një mendim të tillë, dhe pse nuk përjashtohet ndikimi nga të parët gjurmues që i promovuan ato në botimet shkollore apo në antologjitë e përmbledhjet që pasuan kontributet e tyre në këtë fushë studimi.

Nga ana tjetër, konsultimi i varianteve tekstore që janë të caktuara si për një auditor shkollor, ashtu dhe për të qëndruar në përmasat e një botimi kritik e filologjik, ofrojnë mundësi për një gradualitet të përafrimit me përmbajtjen e vetë teksteve të vjetra shqipe, shkalla e studimit të të cilave vërtet duhet të pasqyrohet në këtë linjë në disa nivele të studimit nëpër shkollat shqiptare.

Studiuesit e teksteve të vjetra shqipe i promovuan ato dhe në momente mjaft të rëndësishme që kanë të bëjnë me vetë historinë e Shqipërisë dhe të vlerave kulturore

konceptimi i një doracaku kateketik bën të mundur të mbizotërojnë në të variante lutjesh që mund të ndiqen nga një botim në tjetrin me modifikime përmbajtësore që tërheqin vëmendjen e filogut dhe tekstologut. E themi një gjë të tillë që të nënvizojmë faktin që natyra e tekstit që ofrohet për t'u studiuar kushtëzohet nga natyra e tipologjia e vetë veprës që merret në shqyrtim.

të trashëgimisë së kombit tonë. Vlen për t'u përmendur rimarrja e tyre në mjaft të përkohshme të kohës në fillim të shekullit të kaluar e që qenë nxitje e mirëfilltë për të veçuar më tej e sjellë nëpër revista shkencore pjesë nga këto vepra, në veçanti nga libri i Gjon Buzukut. Promovimi i kësaj trashëgimie u bë kësisoj në dy linja, nga të cilat rimarrja e pjesëve të caktuara në këndvështrime shkencore mbetet e një rëndësie të veçantë për historikun e studimit të këtyre veprave.

Ky gradualitet vihet në dukje dhe gjatë vijimësisë së traditës së studimeve që patën objekt të gjurmimit të tilla vepra. Dhe në kontekstin e studimit tekstologjik të tyre nuk humbet rëndësinë vëzhgimi i qasjeve që botimet më të para të tyre ofrojnë për studentin, qoftë dhe në pikëpamje të sprovave për t'i përshtatur ato në variante tekstore të lexueshme në alfabetin e sotëm të shqipes.

Çdo rimarrje e çështjes së receptimit të teksteve gjegjëse të letërsisë së vjetër shqipe ritërheq vëmendjen ndaj faktit që mbeten dhe sot e kësaj dite mjaft studime për t'u thelluar e nuk mjaftohemi kësaj radhe vetëm me nënvizimin e rëndësisë së studimit tërësor të nënsistemeve themelore të morfologjisë së këtyre veprave.

Ka gjithmonë vend për të cekur çështjen e saktësimit të kontekstit tipografik të realizimit të veprave të caktuara e një prirje e tillë na çon drejt burimesh evropiane të bibliofilisë dhe historisë së librit në periudha të caktuara. Konteksti evropian që ndikoi në atë ballkanik në lidhje me realizimin e veprave të tilla mbetet një faktor përherë i marrë në konsideratë nga filologët dhe iniciuesit e gjurmimeve të teksteve të vjetra shqipe, që nga Mario Roques(1932) e për të vijuar me të tjerë studiues që në platformat e vëzhgimeve të tyre risollën një gjeografi të hulumtimit të realizimit të teksteve të vjetra shqipe.

Ky pasion gjurmimi dalloi Justin Rrotën, Pal Skiroin, Filip Fishtën, Martin Camajn, Namik Ressulin, Jak Marlekajn e në mënyrë të veçantë Eqrem Çabejn, që shfrytëzoi metodikisht dhe shkencërisht burime referenciale mjaft të përshtatshme në lidhje me botimin filologjik e kritik të librit të Gjon Buzukut. Në veçanti çështja e gjurmimit të këtyre modeleve e burimeve mbeti një linjë sa e ndërlikuar, aq dhe parësore në pikëpamje të një hulumtimi metodologjik e shkencor ndaj teksteve të këtyre veprave.

Mjaft disiplina studimore shërbehen dhe sot e kësaj dite me përmbajtjen e teksteve të vjetra shqipe. Kriteret e riprodhimit të tyre dhe përshtatja e tyre në kushtet e mësimdhënies lejon shfrytëzimin e mjaft burimeve, qofshin ato dhe arkivore.

Paraqesin një interes jo të vogël kopjet e shkëputura të sprovave për të sjellë pjesë nga këto vepra, që më tej dhe u pasqyruan në të përkohshmet e kohës. Shfrytëzimi maksimal i botimeve kritike e filologjike që disponojmë jo vetëm bën të

mundur një qasje të përshtatshme me këto tekste, por dhe dallimin e shkollave të caktuara filologjike që u adaptuan në proces të përpilimit të secilit.

Fusha të tëra semantike dhe elemente kulturore të një trashëgimie të hershme gjurmohen në studimet etimologjike të traditës studimore albanologjike, në fjalorë dhe leksikone që në më të shumtën e herës janë përvijuar dhe në periudha të përafërta me promovimin e vlerës e rëndësisë së këtyre teksteve. Kategori të rëndësishme të nënsistemeve gjuhësore të shqipes gjejnë dokumentimin më të hershëm në këto vepra; përdorime gjuhësore që drejtpërdrejt lidhen me një fond kulturor të qëndrueshëm në jetën mendore të popullit tonë dëshmohen pikërisht në këto vepra e në këto botime të vyera. Një areal i gjerë, jo thjesht gjeografik, por që shpie drejt konceptimit të një etnosi origjinar e të një lidhjeje të hershme mes kulturash e visesh shpaloset në çdo rasë të evidentimit të një pasurie të pamatë të reflektuar në doktrina, katekizma, fjalorë(të njohur e të panjohur), variante dorëshkrimi e shtypshkrimi që dhe sot e kësaj dite presin të saktësohen e të bëhen objekt qasjesh me të tjera modele e botime të ngjashme.

Çdo trajtesë apo qasje e natyrës tekstore e filologjike me këto tekste e ka të domosdoshëm dhe saktësimin e një konteksti në parim sa më konkret e që ka të bëjë pikësëpari me rrethanat e lindjes së një vepre që e përmban atë. Nga ana tjetër, pa iu larguar këtij diskutimi konkret që ka lidhje dhe me tekstin, dhe me veprën në fjalë, përafrimi me kritikën tekstore të tekstit biblik është më se i prekshëm dhe orienton ndaj një perspektive mjaft interesante dhe po aq të hapur nëse është fjala për përkime me të tjera tradita, në veçanti në pikëpamje historike. Kihet parasysh natyra e burimeve që mbajnë prioritet në raste përqasjesh, gjuhët përkatëse me të cilat krahasimi është më se i volitshëm dhe i arsyeshëm.

Për këtë arsye dhe njohja sa më e mirë e rrethanave të sipërpërmendura bëhet dhe më decizive dhe më orientuese. Në rastin e librit të Gjon Buzukut, do të kujtojmë sa herë vlerësimin e Eqrem Çabejt që të dhënat që ofron vetë përmbajtja e tij na shpien drejt deduktimesh e arsyetimesh mbi tekstin dhe nëntekstin që merret në shqyrtim. Vetë literatura e burimet bibliografike me të cilat Çabej informon në përfundim të parathënies së vëllimit të parë të botimit kritik të vitit 1968 mbi këtë libër na tregon më së miri se ai e kishte mjaft të qartë linjën e orientimit sa i takon studimit dhe brendësimit të teksteve përkatëse të këtij libri.

Studimet mbi historinë e përkthimit dhe shqipërimit të teksteve biblike në shqipe përmbajnë natyrshëm dhe çështje të studimit dhe evidentimit përmbajtësor të elementeve nga këto vepra.

Bashkë me to mbetet krejt i qartë dhe fakti që ndikimi nga kultura jo të njëjta shkrimore në proces të gjenerimit dhe konsolidimit të tyre ka bërë të mundur që dhe

mozaiku i studimit të tyre të mbetet përherë i larmishëm dhe me mundësi të shumta për hulumtime të mëtejme shkencore.

Bibliografi

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe I,* Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi, Shkodër, 1996.

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe II,* Tiranë, 1998.

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe III,* Tiranë, 2000.

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV,* Camaj-Pipa, Shkodër, 2002.

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe V,* Shkodër, 2009.

Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe VI,* Shkodër, 2012.

Bardhi Sh./(M.Kruja), *Mbi Fjalorin e Frangut të Bardhë*, në *Shêjzat,* I, n.2-3, 1957.

Bogdani P., *Cuneus prophetarum*, (*botim kritik i përgatitur nga A.Omari)*, Tiranë, 2005.

Borgia N., *Pericope evangelica in lingua albanese del secolo XIV (da un Manoscritto Greco della Biblioteca Ambrosiana),* Grottaferrata, 1930.

Budi P, *Poezi (1618-1621), (botim kritik përgatitur nga R.Ismajli),* Rilindja, Prishtinë, 1986.

Budi P., *Poezi, (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R.Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.

Camaj M., *Il « Messale » di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi,* Shêjzat, Romë, 1960.

Çabej E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, n.2, 1959.

Çabej E., *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe,* BUSHSHT, n.3, 1963.

Çabej E., *Studime gjuhësore VI(Gjon Buzuku dhe gjuha e tij),* Botime Rilindja, Prishtinë, 1977.

Çabej E., *Shqipja në kapërcyell-Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut,* Botime Çabej, Tiranë, 2006.

Çabej E., *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura,* ASHAK, Prishtinë, 2008.

Demiraj B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe "doktrina" e tij,* ASHAK, Prishtinë, 2006.

Demiraj B., *Dictionarium latino-epiroticum(Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum,* Botime Françeskane, Shkodër, 2008.

Demiraj B., *Jeta dhe trashëgimia e Gjon P.Nikollë Kazazit,* Botime Françeskane, Shkodër, 2013.

Demiraj B., *Studi filologici arbëreshë*, në *Albanistica 5,* Comet Editor Press, 2015.

Demiraj B., *Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. I.Frang Mark Bardhi (1606-1643),* në *Hylli i Dritës*, n.1, 2016.

Elsie R., *Letërsia shqipe. Një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë, 2006.

Fishta F., *Nder gjurmimet e veprimit "De propaganda fide" në Balkan*, në *Hylli i Dritës*, n.7-8, 1932.

Fishta F., *Mario Roques për filologjinë, kërkimet arkivale dhe historike të vendit tonë,* në BUSHT, n.3, Tiranë, 1962.

Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Botime Dukagjini, 2000.

Lacaj H., *Pjetër Budi, vjershëtor i parë i letërsisë shqipe,* në *Studime filologjike*, n.4, 1966.

Marquet O., *Pjetër Bogdani, letra dhe dokumente*, Shkodër, 1997.

Marlekaj L., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo,* Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.

Matranga L., *E mbsuame e krështerë,(a cura di M.Mandalà),* Salvatore Sciascia editore, 2004.

Matzinger J., *L'ordine dei nomi dei santi nella litania di Ognissanti nel Manuale Pastorale("Messale") di Gjon Buzuku,* në *Hylli i Dritës*, n.4, 2010.

Mulaku R., *Gjuha e shkrimeve të vjetra shqipe(Shek.XV-XVIII),* Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012.

Paci E., *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare,* në *Hylli i Dritës*, n.2, 2011.

Paci E., *Për një vështrim tekstologjik të Mesharit të Gjon Buzukut*, në *Hylli i Dritës*, n.3, 2011.

Paci E., *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut,(punim monografik),* Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011.

Paci E., *Franciscus Blanchus: Dictionarium Latino-Epiroticum, Romæ 1635,* në *CERCETĂRI ISTORICE (Serie nouă),* Editura Palatul Culturii, Iaşi, 2011.

Paci E., *Kolofoni në Mesharin e Gjon Buzukut*, në *Hylli i Dritës*, n.1, 2012.

Paci E,, *Le Missel de Gjon Buzuku, un ouvrage fondamental pour l'histoire des écrits anciens albanais,* në *Studia Albanica*, n.1, 2012.

Paci E., *Cenni ed osservazioni linguistiche sul primo libro scritto in lingua albanese(1555),* në *Studia Albanica*, n.1, 2014.

Paci E., *Gjurmime rreth leksikut të liturgjisë në Mesharin e Gjon Buzukut*, në *Shêjzat,* n.1-2, 2016.

Paci E., Një traditë studimesh dhe botimesh mbi Fjalorin latinisht-shqip të Frang Bardhit(1635), në *Hylli i Dritës,* n.1, 2016.

Petrotta G., *Popolo, lingua e letteratura albanese(a cura di M.Mandalà),* Edizioni Mirror, Palermo, 2003.

Ressuli N., *I più antichi testi albanesi,* në *Shpirti Shqiptar*, nr.3, 1955.

Ressuli N., *Il "Messale di Giovanni Buzuku", (riproduzione e trascrizione),* Biblioteca Apostolica Vaticana, Romë, 1958.

Ressuli N., *Shkrimtarët shqiptarë,I,(nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë),* Botime Pakti, Tiranë, 2007.

Riza S., *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe,* Botime Toena, Tiranë, 2002.

Riza S., *Vepra 4,* Prishtinë, 2004.

Riza S., *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2009.

Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Librairie orientaliste P.Geuthner, Paris, 1932.

Roques M., *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera*, (*perkthye nga frengishtja e pajisë me shenjime plotësuese nga W.Kamsi),* Botime Françeskane, Shkodër, 2011.

Rrota J., *Per historín e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhesore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2005.

Sciambra M., *Bogdanica (studi su Bogdani e l'opera sua), saggio sul lessico scientifico e culturale del Bogdani,* Casa editrice Pàtron, Bologna, 1965.

Schirò G., *Storia della letteratura albanese*, Nuova Accademia, 1959.

Sedaj E., *Shqipja arbërore(në fillimet e filologjisë shqiptare)*, Prishtinë, 2002.

Svane G., *Formimi i gjuhës letrare te « Speculum Confessionis » e Budit,* në *Studime filologjike,* n.2, 1986.

Zamputi I., *Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit*, në *Buletin për Shkencat Shoqërore,* 1954, n.3.

Zamputi I., *Qëmtime mbi Pjetër Bogdanin*, në *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, n.2, 1963.

Zamputi I., *Ricerche su Pjetër Bogdani,* në *"Rassegna di studi albanesi",* Romë, 1964, n.1.

Zamputi I., *Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit*, në *Buletin i Universitetit shtetnor të Tiranës,* Seria shkencat shoqërore, 1958, n.2.

Zamputi I., *Mbi rrethanat historike të botimit të Mesharit të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, në *Studime filologjike*, n.3, 1986.

Zamputi I., *Les circostances historiques de la parution du "Missel" de Gjon Buzuku et sa place dans la littérature albanaise*, në *Studia Albanica*, n.1, 1988.

Zamputi I., *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 1995.

Evalda PACI

THE PERCEIVING OF OLD ALBANIAN TEXTS IN THE ALBANIAN UNIVERSITY PROGRAMS

Abstract

Old Albanian texts in the tradition of the albanologic studies;

Issues of the inclusion and interpretation of old Albanian Texts in studies and the endeavours on the history of the written Albanian literature (templates and respective publications).

The position of the works with a historiographic character (mainly by Marin Barleti): the tradition of their translation in Albanian and their approach in Albanian university studies and textbooks; the respective contributions of Henrik Lacaj and Stefan Prifti; the necessity of re-inclusion of M. Barleti's work in critical and philological publications.

The perceiving of old Albanian texts in the Albanian university programs: biblical texts and exegesis; hymns and liturgical songs; Colophons and similar textual models in the authors of the old Albanian literature (Gj.Buzuku, P.Budi, F.Bardhi, P.Bogdani); referral cases to reference models in biblical variants and in the liturgy of the hours.

Special use of Albanian in specific texts of old Albanian literature.

The importance of using critical publications in function of efficient incorporation of old Albanian texts (E.Çabej, N.Ressuli, R.Ismajli, M.Mandalà, B.Demiraj, A.Omari etc.)

Agron GASHI

ALTERGRAFIA DHE AUTOBIOGRAFIA

Altergrafia është shkrim për *tjetrin*, është plotës i autobiografisë. Sipas poetikës strukturale, autobiografia *unin* e vendos në qendër të tekstit, ndërsa në periferi, *tjetrin*. Kështu, ikja apo kthimi në qendër të tekstit, nuk vë në pyetje kufijtë e tekstit, por është hapje e zhanrit duke shkelur 'rregullat' e veta. Kjo na çon te pyetja e Derridas: Çfarë i takon *së brendshmes* dhe çfarë i takon *së jashtmes*?

Qyshdoqoftë, teksti e ruan statusin e vet kategorial, vetëm se i ekspozohet më shumë (s)provës së verifikimit, përderisa thur histori (tregim) për *tjetrin*.

Në prozën bashkëkohore autobiografike shqipe, *altergrafia* është ikje nga subjektiviteti për hir të objektivitetit, por edhe për shkak të *prozopografisë* së tjetrit. Koncepti i fundit e justifikon një lloj narracioni alternues, i cili funksionalizohet përmes *ligjërimit të përemrave*. A s'eshtë kjo një hyrje edhe në *gramatikën narrative të tekstit*, konkretisht të prozës autobiografike shqipe?! Kujtojmë Nolin, i cili autobiografinë e shkroi në vetën e tretë. Veta e tretë, nuk ishte *tjetri*, por vetë autori, një maskë kjo e *alter egos* që shpesh thuhet për hir të objektivtitetit, e ne konsiderojmë që një lojë të tillë e bën me qëllim të ngritjes së mitit të *homo narransit* tek sa shkruan autobiografinë sikur shkruan për tjetrin.

Russell duke folur për memorien flet për një seri stadesh, apo fazash nëpër të cilat kalon *homo narrans-i*, si: *imazhet*, të cilat i cilëson si fenomene mneomike, kujtesë e mjegullt, e që sipas nesh prodhon diskursin dëshmues *të tjetrit* për ne, *memoria – zakon (habit memory)*, kur kujtimi i një *storie* është i saktë, por që autori, në rastin tonë, autori autobiografik a narratori autodiegjetik harron *kur* dhe *ku* ka ndodhur, përderisa *rikujtimi i vërtetë* (*true recollection)* si një prej formave të memories që proklamon Russell, kërkon besimin në të kaluarën. Ky besim i të kaluarës thotë, varet se sa i kushtojmë vëmendje tjetrit, se sa flasim për tjetrin.

Autori, duke qenë një *machina memoralis*, zbulon jetën, subjektivitetin e tij. Ai mund dhe duhet ta shpikë një rrëfim. Ky rrëfim, në mënyrë që të jetë pak a shumë objektiv, duhet ta këtë së paku një personazh që e vë *unin* në qendër, të cilin teoria narrative e njeh si *personazh egocentrik*.

Ky soj personazhi, edhe pse është i definuar që të vendoset në qendër të tekstit, si një bosht prej nga sillen biografemat e seleksionuara, në momente kur të tillat pushojnë,

zhvendosen në periferi të tekstit, duke i lënë hapësirë *tjetrit,* qoftë për hir të dëshmisë kronologjike, qoftë për hir të deskripcionit duke forcuar *prozopografinë*, përshkrimin e portreteve të të tjerëve.[1]

Siç do të shohim më vonë, kjo zë vend te proza autobiografike e Petro Markos, te autobiografia eseistike e Kadaresë dhe, sidomos të kujtimet e At Zef Pllumit, ku autori ka mision dëshminë.

Genette-i thoshte se rrëfimi nuk konsiston aq në një ligjërim se sa në ligjërime duke iu referuar Bakhtin-it për *dialogizmin*[2] dhe *polifoninë*, apo edhe *evedinetimin* e Doleželit, sipas të cilit rrëfimi konsiston në dy tekste, ku njëri prej tyre është fakultativ, pothuajse gjithmonë i shumëfishtë: *tekst i rrëfimtarit* dhe *tekst i personazheve*.[3]

Te *Kronikë në gur,* teksti i narratorit fëmijë është ligjërim koherent, ndërsa ligjërimet e personazheve janë shpërbërës të strategjemës autobiografike, aty ku diskursi autoreferencial kalon në diskurs referencial. Në rastin konkret, te *Kronika...*, *logos*-i është i njësishëm, sepse narrator është personazhi. Tekstet e personazheve të tjera janë detaje që plotësojnë *faktet fiktive*.

Kreu i parë i *Kronikës...Unë* i përmbledh *storiet* e secilit, duke pasuar *actio*-n herë te njëri, e herë te tjetri, si kurs i memories në të cilin marrin trajtë autobiografemat.

Biologemat shfaqen te *të tjerët*, përmes të cilëve perftojnë imazhe të një *realizmi magjik*, besime e besëtytni, kultura e subkultura. Krejt kjo në sytë e Kadaresë fëmijë, të fëmijës narrator. Ka raste kur ngjarjet duket se *rrëfehen vetë*, kështu ndodh kur provohet e vërteta, përmes të cilës autori mëton të shndërrohet në prodhues të *iluzionit mimetik*, të cilin Genette-i e quan si artin e Jams-it.[4] Ndonëse në kapitullin e dytë, narratori ndërron rolin; nga narratori personazh kalon në një personazh vëzhgues dhe vrojtues të rrëfimeve dhe përshkrimeve të të tjerëve. Kjo i jep autorit karakter funksional dhe prozës karakter fiksional, duke e shndërruar narratorin në një dëshmues dhe dyshues të paradokseve psikosociale, të cilat në autobiografi funksionojnë herë si 'oaza', herë si 'brigje' të shkrimit të jetës.

Autori krijon parabola fiksionale dhe i shumëfishon rrëfimet e tipit *heterodiegjetik*. Në raste të tilla, lexuesi harron formën, modusin. Ai i rreket përmbajtjes dhe kënaqet duke rrëfyer përvojat e të tjerëve.

K*apitulli i dytë,* autori nuk lidhet për *kronologosin*, por për ndodhinë: ka rend fabular, rend rrëfimi, por edhe kapërcime. Biografemat mbulohen me historitë e të tjerëve. Autobiografia merr karakter *altergrafie*. Së këndejmi, kemi një shkrim dydimensional:

[1] Roland Barthes, *Aventura semiologjike,* Dukagjini, Pejë, 2008, f. 404
[2] Mikhail Bakhtin, *Dialogic Imagination*, Austin, University of Texas Press, 1990
[3] Geraard Genette, *Diskurs i ri i rrëfimit*, Dy lindje & perëndime, Tiranë, 2004, f. 7
[4] Gerard Genette, *Narrative Discourse: An Essay in Method,* Cornell Universiteti Press, Ithaka, New York, 1980

shfaqet edhe *alter egoja* e autorit. Tutje, pluralizohet rrëfimi, situatat koreferohen dhe ngadalë shpalohet *aventura autobiografike*.

Përveç dialogëve, rrëfimi i të tjerëve, kur teksti duket më i ngarkuar me autodiegjetikën, ai shkarkon atë nga autobiografemat dhe funksionalizon *analepsat e jashtme* si minirrëfime heterodiegjetike, të cilat dalin si parabola mitike. Në raste të tilla, autobiografema bëhet filozofemë, narratori autodiegjetik bëhet *narrans* i tipit *hetero*, një ikje kjo nga dëshmia dhe hyrje në autofiksion.

Kadare, për dallim nga dy romanet e para autobiografike, në të cilat për asnjë çast nuk na lë të harrojmë praninë e tij, *edhe pse prania e autorit nuk mund të merret si shkak për të plotësuar vlerën e tregimit që na thotë,*[5] te *Muzgu...,*ai decentralizon rrëfimin autodiegjetik dhe i përkushtohet *tjetrit,* si te rasti i Pastërnakut. Këtu inkorporohen referenca nga kronika, informacione gazetash dhe komente personalitetesh *contra* literaturës dhe *pro* censurës. Altergrafia është e theksueshme.

Ndërsa, kur autori zgjedh ta përmbledhë dhe të dorëzojë faktet, ai është në rrezik t'i dorëzohet historisë, duke e humbur rrëfimin për veten. Shpëtim i bëhet Lida, personazh që vjen e shkon, duke e kthyer kështu rrëfimin kah subjekti. Përpjekje të tilla, siç na mëson poetika narrative, bëhen për të përforcuar normat e zhanrit, qoftë ai edhe i padeklaruar nga ana e autorit.

Proza autobiografike *Çështje të marrëzisë* hap shumë çështje të tjera që teorizon poetika moderne në krye me Derrida-n, e që i përfol Smith, ndaj në kapitullin e fundit të këtij romani, autobiografia shndërrohet në *thanatografi*, një lloj tregimi autobiografik që përshkruan vdekjen *e tjetrit*. A nuk ndodh kjo në përmbyllje te *Ikën Babazoti? Po jo enigma e tij,* që shenjon vdekjen e tjetrit, e që tjetri është pjesë e shkrimit të tij të jetës.

Ndonjëherë nga pikëvështrimi *i tjetrit,* autori veten e nënshkruan me iniciale I. K., shenjë kjo e objektivitetit me një provë modestie, por edhe për një pakt të narratorit të shpallur me lexuesin e nënkuptuar – *narraterin.*

Ky modus theksohet edhe te tregimi autobiografik *Lufta e Rostandit*, tregim ky i figuruar, në të cilin "Lufta" e kafenesë Rostand është *luftë* e *gjuhës vetëdëftuese* për autobiografinë e autorit dhe biografinë e të tjerëve.

Tregimi për *tjetrin* zhvillohet në formë *kallëzimi* nga vetë personazhi real, siç ndodh me portretin e Angjelin Preljocajt, personazh i cili bart një pjesë të rrëfimit.

* * *

Platoni, mendimin e konceptoi si kuvendim të njeriut me vetveten, *teetet sofisti*, nocion i cili për herë të parë u duk në truallin e mistikës. Thuhet se rrënjët e këtij nocioni

[5] Wayne Booth, *The Rhetoric of Fiction*, University of Chicago Press, 1961, Kap. 7

janë lindor. Me këtë rast, mendimi si *bisedim me vetveten*, sipas të kuptuarit të Platonit, kurrsesi nuk kupton ndonjë raport të posaçëm ndaj vetvetes (i ndryshëm nga raporti ndaj tjetrit). Bisedimi me vetveten drejtpërdrejt kalon në bisedimin me *tjetrin*, këtu as që mund të flitet për çfarëdo kufijsh parimor.[6]

Në këtë rast, *tjetri* është *alter egoja* e autorit, siç ndodh me prozën autobiografike të Petro Markos *Retë dhe gurët - Intervistë me vetveten,* mbase modeli i vetëm i prozës autobiografike bashkëkohore shqipe, ku strukturimi i tekstit si dialog është një lloj majeutike personale.

Autori shfaqet me status të dyfishtë: ka statusin e intervistuesit dhe të intervistuarit. I pari i shtron pyetje të dytit. Duke qenë po i njëjti autor hyjmë në një majeutikë *sui generis.*

Te Petro Marko më mirë se ku autobiografia bashkëjeton me altergrafinë.

Ky fenomen më mirë venerohet te proza e Bashkim Shehut *Loja, shembja e qiellit*, e cila thuret mbi të dhënat e shkruara e të kallëzuara nga tjetri si bashkëvuajtës, i cili merr statusin edhe të koautorit.

Bashkim Shehu, në kuptimin e Barthes-it rindërton një tjetër gjuhë të kujtimeve, duke e zhvendosur rrëfimin nga *unë* te *ai* dhe *ata*.

Thënë në gjuhën e poetikës intertekstuale, autori mbi *gjuhën ushtron një punë rishpërndarjeje.*

Që në paratekst, rrëfimi, shkrimi kategorizohet si *histori moderne*, me status *hipertekst,* e që për *hipotekst* ka kujtimet e Pllumit, ndërsa referenca tjetër i koreferohet tjetrit si *bashkëvuajtës* të tij.

Autori paralajmëron në mënyrë eksplicite për në bashkautorësi, ndërtimin e dy teksteve, të vetin dhe të personazhit të tij. Kjo na rikthen te teoricieni Lubomir Doležel, sipas të cilit rrëfimi formësohet mbi dy tipa tekstesh: teksti i rrëfimtarit dhe teksti i personazhit.[7]

Kështu, teknikat e rrëfimit variojnë për faktin se në të njëjtën kohë ekzistojnë dy narratorë, autori si ego dhe personazhi si alter ego. I pari rrëfen për veten dhe të dytin, ndërsa i dyti kallëzon vetëm rrëfimin e vet.

Në këtë plan lëvizin edhe figurat e rrëfimit nga *analepsa e brendshme*, te *analepsa e jashtme*. Po ashtu, ndodh edhe më rrëfimin: nga autodiegjetiku te ai heterodiegjetik. Madje, kur jemi te figurat, përderisa thur një *analepsë të brendshme*, posa kalon në të jashtmen, theksohet edhe diskursi prolektik; lajmëron vdekjen *e tjetrit*, në mënyrë që lexuesi ta ndjekë përherë një rrëfim që mund të ndodhë edhe në tashmen, si histori e përfunduar altergrafike.

[6] Mikhail Bakhtin, *U romanu*, Nolit, Beograd, 1989, f. 246
[7] Gerard Genette, *Diskurs i ri i rrëfimit*, Idem, f. 7

Kësisoj, Bashkim Shehu krijon një dysi të objektit dhe një *trini të rrëfimit,* i cili ndjek shembullin prustian (*zgjatja, rendi, koha* etj.).[8]

Brenda kësaj skeme, duke qenë që objekti dhe subjekti këtu nuk janë gjithmonë një, ashtu siç ndodh te proza autobiografike klasike, bazuar edhe në referencat e të tjerëve, qoftë si empiri jetësore, qoftë si shkrim-rrjet intertekstual, sugjeron edhe një pikëvështrim tjetër brenda një modeli, siç është *heteroautobiografia.*

Nga autobiografia në *heteroautobiografi*

Heteroautobiografia është koncept i Lejeune-it, i cili është rifunksionalizuar nga Genette.[9] *Hetero*, sepse funksionalizon shkrimin për *tjetrin, auto*, sepse vetë autori është i involvuar në historinë, jetëshkrimin e tjetrit. Ndaj edhe rrëfimi *auto* dhe *heterodiegjetik* shpesh janë të njëkohshëm dhe të bashkëpranishëm gati gjatë gjithë veprës.

U pa, shkrimi nis si jetëshkrim për tjetrin, si kujtim për të dhe rrëfim për veten. Jetëshkrimi shfaqet me statusin e *shënimeve fragmentare* nga burgu, ndërsa teksti *i tjetrit* vjen si *riprodhim*, dëshmi gojore që kontekstualizon rrëfimin, i cili funksionon si amëz e romanit, që endet në tri shkallë kujtimesh:

- *kujtimet e autorit,*
- *kujtimet dhe dëftimet e personazhit dhe*
- *kujtimet e priftit.*

Trinomi: Shehu – Aleksi – Shtjefni përbëjnë gjithë strukturën përmbajtjesore dhe narrative të romanit. Siç shprehet edhe vetë autori, rrëfimi për mikun dhe bashkautorin e tij hipotetik shtrihet edhe përtej *mnemos*-it, gjë të cilën ia mundëson Shtjefni. Rrëfimi i personazhit të dytë dhe *storia* e të parit përbëjnë strumbullarin historisë së Aleks Krastës. Duke qenë që ky i fundit paradoksalisht 'ngelet rrugës', rrëfimin e vazhdon pater Shtjefni, si fill i nisur brenda dorëshkrimit. Aleksi është personazh i Shehut, pater Shtjefni personazh i Aleksit dhe, që të dy, bartës të krejt *stories* narrative, pa përjashtuar herë pas here implikimet e autorit autobiografik në formën e shpjegimit e të komentimit:

> *Mund të thuhet se, ndërsa këto radhë që po i shkruaj, dhe të tjerat që do t'i shkruaj në vetën e parë duke ndërhyrë vende-vende, janë njëfarë kornize e rrëfimit të Aleks Krastës, rrëfimi i këtij të fundit është një farë e atij të pater Shtjefnit.*

Siç shihet, nyje në mes dy rrëfimeve: të autorit dhe personazhit është Prifti, një zinxhir që sa vjen e shtjellohet në vijim, përderisa diskursi merr faqe tjetër, 'bëhet' diskurs eseistik me shenja të autometatekstit:

[8] Gerard Genette, Idem, f. 8
[9] Gerard Genette, Idem, f. 86

Ato dhjetëra fletë që kishte mbushur me shkrimin e tij të dendur, aty-këtu të palexueshëm, ishin më pak se një rrëfim në kuptimin tjetër të fjalës dhe ishin diçka më tepër. Një rrëfim letrar i mundshëm. Një roman letrar, 'literary novel', sipas një terminologjie të vonë të kritikës amerikane, për të mos thënë poezi, sikurse emërtohej krejt letërsia para dyqind e ca vjetësh për t'u dalluar nga gjërat e tjera të shkruara.

Diskursi narrativ hap dilemat rreth pozicionit të autorit në raport me tjetrin, me të cilin provohet një *marrëveshje tekstuale* prej nga do të zhvillohet rrëfimi. Deri tash dihet se autori herë shkruan në vetën e parë njëjës, herë në vetën e tretë, por edhe në vetën e parë shumës, *ne*.

Pra, rrëfimi singular pluralizohet sipas kërkesës për dëshmi. Hë për hë fiksioni mbetet jashtë loje. Atë e penalizon informata, komenti i zgjeruar deri te (s)provat autobiografike, autometatekstuale.

Në këtë mënyrë, romani *Loja*.., duke qenë se ka një koreferim dhe i nisur si autobiografi ndërron kahjen, kthehet në *heteroautobiografi*, një model ndryshe nga ai që lexuesi semiotik pretendon që po e shfleton në fillim.

Nga analepsa e shkallës së parë, integrohet analepsa e shkallës së dytë. E para është autoriale, e dyta koautoriale, sepse provohet një bashkautorësi, qoftë edhe e stisur.

Deri tani ndjekim diskursin, jo *alegorezat*. Kësisoj, ato bashkëveprojnë si analepsa *auto* dhe *heterodiegjetike*.

Sidoqoftë, esenciale është që loja konsiston në një *analepsë të gjerë.*[10] Dhe, si rrjedhojë, duke synuar hapjen ndaj lexuesit, një metesë kjo për *pakt referencial*, shpërthejnë edhe *analepsat metadiegjetike.*[11]

Në një pjesë të romanit *rrëfimi ka karkter sa egopo aq edhe ekscentrik*, por shpejt autori infiltrohet, jo si narrator autodiegjetik, por si narrator homodiegjetik dhe provon neutralitetin përmes vetëdëftimit në vetën e tretë:

Aty ndodhej në vitet tetëdhjetë edhe autori i këtyre radhëve që i përket rrëfimit të një tjetri. Duke kaluar në vetën e parë, kujto se një rast, për njëzet ditë, u ndodh pranë dom Jozefit, por pa e takuar dot, ndërsa deri atëherë kishim qenë të veçuar në sektorë të ndryshëm të burgut.

Kështu, hymë në skemën *heteroautobiografike,* aty ku nuk synohet dëshmia për veten, madje edhe kur shpalon *storiet* personale. Qëllimi është tjetri dhe të tjerët. Definitivisht, autori me këtë roman krijoi një prozë autobiografike, në të cilën loja intertekstuale kthehet në model altergrafie, ku romani shfaqet përbrenda romanit, altergrafia përbrenda autobiografisë dhe drama e autorit përbrenda dramës së të tjerëve.

[10] Gerard Genette, Idem, f. 16
[11] Gerard Genette, Idem, f. 15

Agron GASHI

ALTERGRAPHY AND AUTOBIOGRAPHY

Abstract

Altergraphy is writing for the other, it is complementary to autobiography. According to structuralist poetics, the autobiography puts its own self in the center of the text while on the periphery puts the other. Thus, escaping or returning to the center of the text does not question the boundaries of the text, but it is the opening of the genre by violating its 'rules'. This leads us to Derrida's question: What belongs inside and what belongs outside? However, the text retains its own categorial status, only being exposed more to trial verification, while weaves history (story) for the other. In contemporary autobiographical Albanian prose, the alterography is escaping from subjectivity for the sake of objectivity, but also because of prosopography of the other. The latter concept justifies some kind of alternating narrative, which is functionalized through lecturing pronouns. Is this not an introduction to the narrative grammar of the text, concretely of the Albanian autobiographical prose?! This remains to be proven through our research.

Key words: altergraphy, autobiography, subjectivity, objectivity, narrative grammar, lecturing pronouns, I, the other, etc.

Xhavit BEQIRI

GJUHA STANDARDE DHE DIALEKTET – RASTI I SHQIPES

Në çdo ideologji, në çdo regjim, ka një mënyrë të veçantë të perceptimit të shkrimit, të kuptimit dhe vlerës së fjalëve. Secila kohë e ka ligjërimin e vet (formë gjuhësore/mendim), kurse puna e parë, së cilës i rreket një pushtet i ri është "përmbysja" e rendit ekzistues të ligjërimit dhe funksionit të tij. Kuptohet, për ta vënë në fuqi një "ligjërim të ri", sipas interesave të veta.

Varieteti aktual standard i shqipes është *ligjërim i ri*, sepse, duke qenë arbitrar, siç është çdo standard, ai përmbysi ligjërimin/ligjërimet e mëparshme.

Gjuha standarde i qëndron gjithmonë karshi gjuhës së natyrshme. Meqenëse është një ndërhyrje e jashtme, arbitrare, në rrjedhën normale të gjuhës, ajo i rrafshon diversitetet ekzistuese të një gjuhe dhe sado që ka tendenca për ta cilësuar si "e vetmja gjuhë e vërtetë", prapëseprapë mbetet vetëm njëra nga shumë varietetet e gjuhës[1].

Në rastin e shqipes "gjuha e vërtetë", të paktën nëse mbështetemi në kompetencën komunikative sipas **gjuhësisë së zbatuar**, po del që nuk është aq *e vërtetë*! Ndonëse po bëhen gati 45 vjet që nga Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972, varieteti standard i shqipes, apo Gjuha e Njësuar Letrare (GjNjL), siç e cilësonin gjuhëtarët e ish-sistemit komunist, mbetet ende "gjuhë e re", "gjuhë zyrtare" (G. Orwell). Ky varietet, prandaj, është më tepër *gjuhë specialistësh*, pasi që folësit e zakonshëm të shqipes nuk zotërojnë kompetencë komunikative në përputhje me normën/standardin.

Përmasë e prestigj

Në sociolinguistikë nuk ekziston asgjë absolute në dallimin që bëhet zakonisht midis gjuhëve dhe dialekteve. Megjithatë, ka një dallim **përmasash**, sepse një gjuhë është më e madhe, sesa një dialekt, një varietet i quajtur gjuhë përmban më shumë *njësi gjuhësore,*sesa një varietet i quajtur dialekt. Në këtë kuptim, shqipja përmban të gjitha

[1] Varietetin gjuhësor sociolinguistët e përkufizojnë si *"një tërësi njësish gjuhësore me përhapje shoqërore të ngjashme"*.

dialektet (po edhe nëndialektet e të folmet), kurse gjuha standarde s'është tjetër veçse një dialekt midis të tjerëve.

Kundërshtia midis "gjuhës" dhe "dialektit" lidhet, po ashtu, me çështjen e **prestigjit** (namit) më të lartë që ka një gjuhë në raport me një dialekt, pasi që në botëkuptimin e përgjithshëm të njerëzve, jo të specialsitëve, nga prestigji që ka ka një varietet i caktuar, varet nëse ai do të quhet gjuhë apo dialekt. Sipas Hudson-it, "për pjesën më të madhe të njerëzve kjo është shumë e qartë dhe varet nga fakti nëse përdoret ky varietet në shkrimin formal".

Në rastin e shqipes standarde, problemi i mosnxënies së saj, sidomos në arealin gjuhësor gegë, duhet të kërkohet pikërisht te largësia e këtij varieteti të sotëm standard me tëfolurit dialektor, përkatësisht me *gjuhën native* të gegës. Kur e them këtë kam parasysh jo vetëm *sjelljen individuale të folësve*, por *vetë strukturën gjuhësore* të varietetit gegë të shqipes.Ndaj, në këtë kontekst, besoj se do të na ndihmonte po të merrej parasysh Roland Barti, i cili i dallonte qartë konceptet Gjuhë/ të Folur: "Gjuha, po të doni, është ligjërim pa *të Folurit*: ajo është njëherësh institucion social dhe sistem vlerash"[2].

Individi nuk mund ta përdorë gjuhën pa e zënë më parë, ngase ajo ka rregullat e veta, të cilave secili duhet t'u shtrohet në tërësi.

"Përballë gjuhës, institucion dhe sistem, të Folurit në thelb është akt individual i zgjedhjes dhe aktualizimit", mendon Barti duke dhënë atë përfundimin tashmë klasik: "S'ka *Gjuhë* pa *të Folur*, dhe s'ka *të Folur* jashtë*Gjuhës"*[3].

E, pasi që të Folurit është sinjal i identitetit shoqëror, teoricienët e kanë vështruar atë edhe nga aspekti i kategorive shoqërore jomarrëdhëniore.

"Me sa duket, çdo gjuhë përmban disa njësi që pasqyrojnë karakteristika shoqërore të folësit, të dëgjuesit ose të mërrëdhënieve midis tyre. Si pasojë, një*akt gjuhësor* që përman këto njësi, e informon dëgjuesin se si i sheh folësi këto karakteristika dhe përdorimi i pasaktë i tyre përbën shkelje të normave gjuhësore"[4], shkruan R. Hudson.

Idetë e para për një shqipe të përbashkët

Përpjekjet për krijimin e një varianti të përbashkët të shqipes morën jetë që në kohën e *Rilindjes*, krahas formësimit të idesë për liri kombëtare. Në vitet '70 të shekullit XIX, në faqet e revistës *Fjamuri i Arbërit*, Jeronim de Rada hodhi idenë e krijimit të gjuhës standarde shqipe duke u bazuar në arbërishten. Por, siç vëren Sh. Munishi,

[2] Roland Bart, "*Aventura semiologjike*", ShB "Rilindja", Prishtinë, 1987, fq. 98.
[3] Po aty.
[4] Richard A. Hudson, *Sociolinguistika*, ShB "Dituria", Tiranë, 2002, fq. 137.

"veçoritë gjuhësore arkaike të arbërishtes së Italisë nuk ofronin as më të voglën mundësi që kjo e folme e diasporës të ngrihej në shkallën e një gjuhe standarde gjithëshqiptare"[5].

Ideja e një shqipeje të përbashkët u përkrah nga të gjithë intelektualët e krijuesit më të shquar të kohës, ndër të cilët edhe Sami Frashëri (në një letër dërguar De Radës më 1881) dhe Faik Konica (më 1897, në revistën e tij me ndikim, *Albania).*

"Mendimi për njësimin e gjuhës shqipe del edhe në vitet 1904–1912, diskutohet në revistën "Albania" të Faik Konicës, përfshihet në vendimet e Kongresit të Elbasanit në shtator 1909 e më pas etj. Komisia Letrare e formuar në Shkodër (1916-1918) bëri hapat e parë të rëndësishëm për kodifikimin e gjuhës letrare dhe përpunimin e saj. Ajo afroi drejtshkrimin e dy varianteve të gjuhës letrare që përdoreshin, duke u përpjekur t'i japë një trajtë të përbashkët e të thjeshtë mënyrës së shkrimit të gjuhës sonë. Vendimet e kriteret e kësaj komisie u miratuan edhe nga Kongresi i Arsimtarëve, që u mbajt më 1920 në Lushnjë"[6], shkruajnë A. Jashari dhe B. Kryeziu.

Është thënë tashmë me të drejtë se formimi i Komisisë Letrare të Shkodrës është hapi i parë i vetëdijshëm për "realizimin e një politike gjuhësore dhe për planifikimin gjuhësor të mirëfilltë".

"Në pikëpamje të zgjedhjes së bazës dialektore të gjuhës, politika gjuhësore e Komisisë Letrare mbështetej në arsye praktike, por edhe në arsye kompromisi; gegërishtja e mesme ose e folmja e Elbasanit, në pikëpamje të normës gjuhësore ishte sistemi më i afërm e i përbashkët për të dy dialektet e shqipes, ose për variantet e shkruara mbi baza dialektore. Kjo zgjidhje ishte në frymën e idesë për formimin e gjuhës së përbashkët përmes konvergjencës ndërmjet varianteve të shkruara, që si ide ishte përcjellë nga Rilindja Kombëtare Shqiptare"[7], thekson Munishi.

Mirëpo, pikërisht kjo qasje kompromisi e Komisisië nuk pëlqehet nga studiuesi Arshi Pipa, i cili mendon se *Komisia*... "u ndje e detyruar për t'i bërë lëshime të rëndësishme toskërishtes, për hatër të afrimit të dialekteve, çfarë shpresohej, se do të çonte te një shqipe e përbashkët letrare".

"Parimi kryesor i Komisisë ishte ai fonetik, që do të thotë se grafema e një fjale duhet të përputhet me shqiptimin e saj. Ky parim funksionon mirë për toskët, kurse për gegët jo, të cilët (a) nuk i shqiptojnë *ë* fundore, por shpesh edhe të ndërmjetme: *Mria*, *kndoj*, *vâsh*, *puntōr*, *rān*; (b) jo vetëm ka zanore të gjata, por kompenson për

[5] Shkumbin Munishi, *Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe*, ZeroPrint, Prishtinë, 2013, f. 25.
[6] Prof. dr. Ali Jashari & Bahtijar Kryeziu, *Gjuhë amtare / Njohuri për gjuhën – Fonetikë, Morfologji, Sintaksë*, Universiteti i Prishtinës, 2010, fq. 21.
[7] Munishi, vep. e cit., po aty, f. 31.

bjerrjen e një *ë* duke zgjatë zanoren në rrokjen paraardhëse; (c) nazalizon një seri zanoresh që në toskërisht dëgjohen si gojore; (d) i ka bjerrë diftongjet *ue*, *ie*, *ye,* të cilët në toskërisht ruhen (*ua*, *ie*, *ye*); dhe (e) i asimilon grupet bashkëtingëllore *mb*, *nd*, *ngj* në *m*, *n*, *nj* (*Ŋ*)"[8], shkruan A. Pipa.

Sipas këtij studiuesi (citoj), "me këto lëshime që bëri Komisia letrare, në fakt e shkatërroi parimin themelor të projektit të saj reformues. Me fjalë të tjera, zelli patriotik dominoi mbi rreptësinë shkencore. Rrjedhojë e kësaj qe se, ndërsa shkrimtarët gegojugorë (shumica prej Elbasani dhe të udhëhequr nga Xhuvani) zbatuan rregullat e Komisisë Letrare, shkrimtarët shkodranë (Fishta e Mjeda ndër ta, se Gurakuqi iu përmbajt rregullave) vazhduan t'i shënojnë zanoret e gjata me shenjën diakritike /´/, ndërsa përgjithësisht iu përmbajtën rregullave të vendosura prej Komisisë Letrare"[9].

Zytarizimi i toskërishtes si gjuhë standarde shqipe

Standardi i sotëm i shqipes u sanksionua në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, të mbajtur në Tiranë, më 1972. Meqenëse vendimet e tij ishin arbitrare e *të panatyrshme,* siç janë të gjitha ndërhyrjet e jashtme në rrjedhën e gjuhës, nga përfundimet e këtij kongresi një pjesë mbeti (dhe mbetet) e kënaqur, ndërsa pjesa tjetër, kur më shumë, e kur më pak e kundërshtoi këtë standard.

Ndonëse lëshimet ndaj toskërishtes ishin shumë evidente, gjatë gjithë procesit të planifikimit gjuhësor të shqipes standarde, apo siç cilësohej *shqipes letrare*, prijatarët e qarkut gjuhësor zyrtar të Tiranës nuk u maftuan me kaq. Ata, *në krye me* marksistin e vetëdeklaruar Androkli Kostallari, në Kongresin e vitit 1972, e çuan edhe më tej eleminimin e dialektit të veriut nga jeta (zyrtare) shoqërore, duke e zyrtarizuar toskërishten si gjuhë standarde shqipe. Ato pak elemente gege që iu ndajngjitën variantit standard, krejtësisht me të drejtë, janë vlerësuar me "funksion përplotësues e zbukurues". Së këndejmi, kur flasim për shqipen standarde, është krejtësisht anakronike të mendojmë për çfarëdo sinteze a konvergjence të dialekteve të shqipes, sepse qarqet gjuhësore të Tiranës të viteve '70 e anashkaluan faktin se qysh Komisia Letrare dhe Kongresi i Lushnjës kishin sugjeruar elbasanishten si bazë të gjuhë së unisueme shqipe dhe favorizuan dialektin e toskërishtes. Të yshtura për ta bërë turravprar standardin, këto qarqe nuk i morën parasysh as vërejtjet e gjuhëtarëve më eminentë të kohës në Shqipëri, si A. Xhuvani e E. Çabej.

[8] Arshi Pipa, *Politika e Gjuhës në Shqipninë Socialiste*, Botimet Princi, Tiranë, 2010, fq. 24.
[9] Po aty.

Xhuvani, kundërshtar i ndryshimeve "revolucionare" në zhvillimin e gjuhëve, "e quajti përdorimin e një abetareje toske nga shkollarët gegë si "antipedagogjike" dhe, madje, "antifiziologjike", për sa kohë që kjo e dhunon aparatin e tyre të të folurit për t'iu përshtatur një fonetike për të cilën nuk është gatuar"[10], ndërsa Çabej, formula e të cilit ishte "diversitet në unitet", angazhohej për "afrim të vijueshëm të dy dialekteve të shkruara", koncept ky që binte tërësisht ndesh me projektin e ShNjL-së së Kostallarit dhe Shuteriqit me kompaninë e tyre marksiste-leniniste.

Favorizimi i toskërishtes, sipas Pipës, nisi me "hartimin e një liste të zezë shkrimtarësh, pjesa më e madhe e të cilëve ishin gegë, të gjallë apo të vdekur, shumë sish të pushkatuar ose të burgosur për gjoja krime kundër popullit, por në fakt për shkak të rezistencës, ose thjeshtë mospëlqimit të komunizmit"[11].

"Politikat e Stalinit për rusifikimin e BS, me rusishten si "gjuhë e tij zonale", e ka gjegjësen e vet në miniaturë në politikën e toskëzimit të aplikuar mbi gjuhën shqipe, nën parullën e "Shqipes së Njësuar Letrare (ShNjL)", një politikë aktivisht e promovuar prej udhëheqjes komuniste shqiptare e, kryekreje, prej udhëheqësit të saj numër një, Enver Hoxha. Kjo politikë u vu në lëvizje pa zhurmë, fill pas marrjes së pushtetit prej komunistëve. Gegërishtja letrare nuk u handakos menjëherë dhe për këtë shkak shkrimtarët gegë arritën ta përdorin dialektin e tyre edhe për disa kohë. Por toskërishtja u imponua si gjuhë zyrtare e kombit. Toskërishtja ishte dialekti i folur prej shumicës së anëtarëve të byrosë politike dhe anëtarësisë së komitetit qendror, prej anëtarëve të qeverisë dhe ofiqarëve të lartë të administratës si dhe prej personelit të rangut të lartë, që shërben në ushtri dhe në sigurimin e shtetit. Shtypi në përgjithësi dhe tekstet për shkollat e të gjitha niveleve ishin në toskërisht, që ishte edhe gjuha e mediave radiotelevizive"[12], shkruan Arshi Pipa.

Përfundim

Paksa në mënyrë *arbitare*, tekstin po e mbyll këtu, duke e rikujtuar George Orwell-in, i cili, në *Shtojcën* e romanit me shumë ndikim *1984*, nëpërmjet magjisë së fiksionit, demaskonte kështu fytyrën e diktaturës, pra edhe planifikimin gjuhësor nga partia: "Qëllimi i Gjuhës së Re nuk ishte vetëm ofrimi i një mjeti për të shprehur pikëpamjet mbi botën dhe zakonet mendore të përshtatshme për të përkushtuarit e Anglocosit, por edhetë bënte të pamundur mënyrat e tjera të mendimit. Synohej që kur Gjuha e Re të që përshtatur njëherë e përgjithmonë, ndërsa e folmja e vjetër të qe

[10] Shih: Pipa, vep. e. cit., fq. 168.
[11] Po aty.
[12] A. Pipa, vep e cit., fq. 162.

harruar, do të ishte e pamundur të kishte mendime heretike **-** mendime të kundërta me parimet e Angolosocit - të paktën mendime që kërkonin përdorimin e fjalëve. Fjalori i saj ishte ndërtuar në mënyrë të tillë që të jepte kuptimin e saktë dhe herë-herë shprehje shumë të detajuara, të cilat do të përdoreshin nga çdo anëtar i Partisë, duke përjashtuar të gjitha mendimet e tjera dhe mundësinë e mbërritjes te këto mendime me metoda jo të drejtpërdrejta. Kjo qe arritur pjesërisht me shpikjen e fjalëve të reja, por kryesisht me anë të eleminimit të fjalëve me kuptime të rrezikishme dhe, brenda mundësive, me pastrimin e fjalëve të mbetura nga mendimet dytësore të çdo lloji!"[13].

Xhavit BEQIRI

STANDARD LANGUAGE AND DIALECTS - ALBANIAN CASE

Abstract

In any ideology, in every regime, there is a special way of perceiving the writing, the meaning and the value of words. Each time has its own speech (language form/thought), and the first job that a newGovernment embarkson is to'overthrow' the existing order of speech and the function thereof so as to introduce a 'new speech', which suits its own interests of course.

The current standard Albanian variety is a*new speech*, because, being arbitrary, as any standard is, it has overturned the previous speech/discourse.

Standard language always stands against natural language. Beingan external, arbitrary interference with the normal course of language, it overrides the existing diversities of a language, and, despite tendencies to qualify it as the 'the only true language there is', it only remains one of the many language varieties.

In the Albanian case, at least in terms ofcommunicationcompetencyas per applied language, it turns out that the 'true language'is not that'true'! 45 years on from theAlbanian Congress of Spelling of 1972, the standard Albanian variety, or the Unified Standard Language (USL), as the linguists of the former communist system use to dub it, remainsa 'new language', an 'official language' (G. Orwell). This variety, therefore, is more a language ofpractitioners, for ordinary Albanian speakers do not have the communicationcompetencythat complies with the norm, with the standard.

Key words: Standard language, dialect, competency, speech, norm, variety!

[13] Goerge Orwell, *1984*, ShB "Zenit", Tiranë, 2005, f. 299.

Rijetë SIMITÇIU

MARRËDHËNIET BRENDA FAMILJES SHQIPTARE TE FJALËT E URTA SHQIPE

Në këtë studim do të paraqitet vlerësimi i prespektivës socio-kulturore të marrëdhënieve brenda anëtarëve të familjes në bazë të fjalëve të urta dhe proverbave shqiptare. Proverbat bartin filozofinë dhe etikën e popullit, pasurojnë mendimet dhe idetë e njerëzve prandaj janë pasuria më e madhe e urtësisë popullore.

Metodat e vëzhgimit të drejtpërdrejtë të korpusit të fjalëve të urta shqipe bashkë me një analizë strukturore të tyre do të përdoren për të paraqitur një pasqyrë të plotë sociolinguistike.

Si rezultat do të përzgjedhen e fjalëve të urta që flasin për marrëdhëniet e secilit anëtarë të familjes veç e veç. Përveç kësaj përzgjedhjeje do të bëhet edhe veçimi i fjalëve të urta sinonimike të përdorura në treva të ndryshme që përmbajnë turqizma ose jo. Pra, do të paraqitet frekuenca e përdorimit të turqizmave në territoret e ndryshme shqiptare.

Në këtë punim pritet të trajton marrëdheniet e anëtarëve të familjes të pasqyruar në fjalë të urta dhe në të njëjtën kohë përdorimit të turqizmave brenda tyre. Mund të jetë i dobishëm për ata që do të merrem me studime sociolinguistike e leksikologji.

Fjalët kyçe: *fjalë të urta, proverba, familja, sociolinguistika, turqizmat.*

Hyrje

Korpusi gjuhësor i analizuar në këtë punim është vëllimi "Fjalë të urta të popullit shqiptar" përgatitur nga Jorgo Panajoti dhe Agron Xhagolli. Vëllim, i cili paraqet një kurorëzim të përpjekjeve për grumbullimin e fjalëve të urta që zënë fillin qysh nga fjalori "Latinisht - Shqip" (1635) i Frank Bardhit e gjer më sot. Meqenëse objekti i studimit më ka kufizuar në analizimin e fjalëve të urta që janë përdorur brenda familjes, në korpusin e tonë janë përfshirë 793 fjalë të urta nga kapitulli "Familja, farefisi dhe fqinjësia" (Panajoti & Xhagolli 1985:5).

Nga këndvështrimi i fjalëve të urta shqipe do të pasqyrohen: vlerat e familjes shqiptare në të gjithë arsenalin e saj të traditave, zakoneve dhe tipologjinë e marrëdhënieve midis pjesëtarëve të saj; qëndrimet konservatore në tipologjinë e vjetër të familjes shqiptare; mekanizmi e teknologjia e raporteve dhe marrëdhënieve midis brezave; ndërtimi piramidal i pozicioneve e roleve të pjesëtarëve të saj, si dhe "arti i vjetër" i prindërimit autoritar.

1. Fjalët e urta dhe proverbat

Proverba quhen thënie të organizuara strukturalisht si fjali dhe me pohim tashmë të përmbyllur. Ato shprehin një mendim të plotë, të figurshëm e të mbrehtë që përgjithësojnë përvojën e shumë brezave dhe zakonisht përmbajnë një mësim të urtësisë popullore për jetën e për dukuritë e ndryshme të saj. Filozofi i famshëm anglez Francis Bacon ka thënë: 'Gjeniu, urtësia dhe shpirti i një kombi duket në proverbat e tij' (Ramadani 2006:13).

Në tërësinë e tyre ato përbëjnë një encikolopedi më vete të filozofisë, të mendimit, të psikologjisë e të ndërgjegjes artistike estetike. Në të njëjtën kohë ato përbëjnë kodin bazë të normave etiko-morale popullore. Proverbat synojnë të përgatisin njeriun e popullit për jetën, ta mësojnë e ta udhëheqin atë në punë, në sjelljet, në veprimtarinë, në përpjekjet e veta si qytetar dhe pjesëtar i një kolektivi apo të një shoqërie të caktuar (Panajoti & Xhagolli 1985:10).

Çdo popull në proverbat e veta paraqet karakteristikat kulturore dhe shoqërore të veta, por njëkohësisht edhe elemente të përbashkëta me proverbat e popujve të tjerë. Idetë, mendimet, tematika, leksiku, figurat, të cilat bëhen edhe burim studimi për shumë studiues të shkencave filologjike, sociologjike, psikologjike dhe historike. Ngjashmëritë e proverbave tregojnë sesa afër janë në mendime dhe ide popujt midis tyre (Lama 2008:86). Krahasimi i disa prej tyre apo përshtatja në natyrën e gjuhës tjetër është me domethënie dhe vlerë të posaçme, ngase shihet qartë kuptimi, lashtësia, aféria, dallimi dhe natyra autoktone (Ramadani 2006:12).

2. Familja shqiptare dhe marrëdhëniet brenda antarëvetë saj në fjalët e urta shqipe

Familja shqiptare, edhe sot e kësaj dite, mbetet një "qendër sociale", në të cilën bëhet zhvillimi dhe lidhja e individit me jetën sociale dhe institucionet organike.Nuk ka institucion tjetër social që të mund të luajë ato role, të kryejë ato misione, për të cilat është krijuar dhe ngarkuar në mënyrë ekskluzive familja. Ajo ka fuqi të bëjë çdo

pjesëtar të saj qytetar të lirë që respekton veten, tjetrin, shoqërinë, institucionet e jetës, traditat, zakonet dhe vlerat e jetës (Tushi 2012:163).

Fuqinë e ndikimit të familjes, në familjen shqiptare, teformimi i personalitetit të individit dhe marrëdhënieve brenda antarëve të familjes e gjejmë te fjalët e urta shqipe. Finesa e formimit të familjes është padyshim martesa, prandaj edhe një numër mjaft i madh i fjalëve të urta i dedikohen martesës, si: *Kush u martua e s'u gëzua* (Përmet), duke mos e përkrahur beqarinë[1]. Rëndësi të veçantë kishin martesat e qëlluara: *Ditën e martesës, o të çilet, o të mbyllet dera*(Shkodër), zgjedhja e krushqisë: *Në marrshi kudo, del shkado* (Kosovë), martesa në moshë të re shikohej si diçka pozitive[2]: *Të hash mëngjes dhe të martohesh i ri, pishman mos ji*(Jug), *Mos të zëntë dimri pa dru dhe pleqëria pa gru* (Shqipëri e mesme), martesat për arsye të pasurisë: *Arka plotë, sytë me lotë* (Jug) apo të bukurisë: *Bukuri e nuses - një muaj gjë* (Jug) etj.

2.1. Marrëdhënia burrë - grua

Një rol i padiskutueshëm është lidhja me marrëdhëniene ngushtë ndërpersonale që ekziston ndërmjet burrit dhe gruas (bashkëshortësi - martesë) që duket se është pika e burimit (bërthama) e familjes.

Në formimin e familjes bërthamë marrëdhënia burrë - grua vije në plan të parë, si: *Gruaja me burrin e ndan hallin dhe mallin* (Jug) apo *Burrë e grua - mish e thua* (Vlorë). Në raport me burrin gruaja del me më shumë veti pozitive se sa burri: *Gruaja e mirë bën burrin e mirë* (Arbreshët e Italisë) apo *Gruaja - si nuri, burri - si furri* (Nivicë-Vlorë). Pastaj rëndësia e prezencëssë burrit në jetën e gruas, si: *Gruja me burrë asht mret më vete* (Elbasan). Edhe pse ka raste që janë bërë martesa me dy e më shumë gra për arsyje të të pasurit fëmijë (djalë) apo edhe për arsyje të pasurisë. As edhe një fjalë e urtë shqipe nuk është gjetur që e përkrah një dukuri të tillë, përkundrazi: *Insoni niherë martohet* (Strugë), *Nji burrë për nji grua, nji grua për nji burrë* (Shkodër) apo *Gruaja e mirë ja do thotë fjalën, ja do bëj djalën* (Labëri).

[1] Për martesën na dalin 78 fjalë të urta ndërsa për beqarinë vetem 3, edhe atë dy prej tyre beqarinë nuk e shohin si diçka pozitive. Më intersantja është se që të dy këto fjalë të urta u dedikohen djemëve *Beqari-qyqari* kurse ajo që ka mesazh pozitiv për beqarinë i referohet vajzave *Gocni - mbretni*. Përderisa e njëjta fjalë e urtë, bëhet fjalë për këtë të fundit, në kulturën turke i kushtohet djemëve *Bekârlık sultanlıktır* (edhe pse turqishtja nuk e ka kategorinë e gjinisë).
[2] Mirëpo jo martesat në djep: *Martesa në djep - e zeza e të vet.*

2.2. Familja bërthamë

Familja bërthamë nënkupton bashkëshortët dhe fëmijët e tyre. Kjo bërthamë marrëdhëniesh paraqitet me karakteristika të ndikuara fuqimisht nga faktorët e shumtë të vetë kontekstit socio-kulturor me anë të cilave familja merr formën konkrete.

Në fjalët e urta shqipe na del në shesh autoriteti i prindërve në marrëdhënie me fëmijët e tyre, në këtë rast vije në shprehje respekti dhe përkushtimi i fëmijëve ndaj prindërve: *Babë e nanë - diell e hanë* (Thumanë-Krujë) apo *Kush s'do nënën e babën, nuk e do as vatanë* (Skrapar). Një ndër marrëdhëniet e veçanta në këtë studim është edhe ajo babë e bir apo nënë e bijë: *Kush ka bir e bi, ta lidhin gojën me shami* (Shkodër), *Baba qi e le djalin e mirë, nuk des* (Guci) apo *Amë e bijë - sheqer në tepsi* (Kosovë). Dihet se deri në një moshë prindërit kujdesen për fëmijët e tyre edhe në aspektin material por pas një moshe këta të fundit duhet të bëhen të zot të vetvetës: *Kur i jep babai djalit, qeshin hëm babai, hëm djali, kur i jep djali babait, qajnë hëm djali, hëm babai* (Berat). Ka raste kur fëmija nuk është i hairit., atëherë: *Më mirë djepi thatë, se dreqi brënda* (Dukat-Vlorë).

2.3. Familja dhe farefisnia

Historia e familjes shqiptare ka kurbën e vet të zhvillimit, e cila përbën formën më të lashtë të familjes së madhe patriakale, që ka përshkuar një periudhë të gjatë historike të jetës së vet duke qenë lloji më tradicional i "familjes kolektive" (Lepori 2011:15). Familja e zgjeruar mund të përfshijë tre ose katër gjenerata. Këta mund të jetojnë dhe punojnë së bashku në një ekonomi të përbashkët shtëpiake, ose si një bashkësi fisnore e gjerë, që lidhet nëpërmjet marrëdhënieve shoqërore. Format më të shpeshta të famijes së zgjeruar në shoqërinë shqiptare janë të modelit : tre breza (fëmijë, prindër dhe gjysh e gjyshe, më rrallë edhe xhaxhallarë e halla) nën një çati ose në një oborr ose pranë njëri tjetrit.

Kjo marrëdhënie në mes të vëllezërve apo vëlla - motër në fjalët e urta shqipe na del mjaft fortë e mbështetur në shtyllën e familjes shqiptare: *Ma i keqi vëlla ta merr hakin* (Kosovë) si dhe *Motr'e vulla, mier kush ng'i ka* (Molise-Itali). Mirëpo kemi raste kur kemi rivalitet ndoshta edhe "armiqësi" në mes të vëllezërve: *Vëllai është ortak* (Përmet) apo *Ma mirë i damë, se i vramë* (Krujë).

Marrëdhënia vjehërr - nuse më është e ditur, madje ajo është transferuar në një frazologji. Pra, ndeshemi përballë një lidhjeje të ftohtë dhe indiferente, si: *Kur mora renë, mori gazi dhenë* (Veri). Ndërsa për dhëndërinë është treguar respekt i veçantë, si: *Pasha pashë â kanë e, kur i ka ardhë dhanri, â çue në kamë* (Krasniqe-Kosovë).

Në tarditën e familjes shqiptare trashëgimi i brezit është pika kyqe kështu që lidhja gjysh-baba-nip është e pashmangshme: *Sa e do gjyshi nipkën? - Më shumë se djalën. Pse? - Se ay do t'i marrë hakën* (Korçë). Po ashtu nuk mund të anashkalohen edhe marrëdhëniet me anëtarët e tjerë të familjes si xhaxhallarët, dajat, hallat e tezet: *Nipi për dajë asht si pllumi bardhë* (Kosovë) e *Halla ke shkalla, tezja ke mezja* (Kavajë).

			Nr.	Përq.
Martesa		Beqaria	3	0.38%
		Martesa	78	9.84%
		Krushqia	7	0.89%
			88	**11.1%**
Bashkëshortësia		Burri	29	3.66%
		Gruaja	66	8.32%
		Burrë & Grua	22	2.77%
			117	**14.75%**
Familja bërthamë	Prindërit	Babai	12	1.51%
		Nëna	34	4.29%
		Baba & Nënë	19	2.4%
			65	**8.2%**
	Fëmijët	Fëmija	134	16.9%
		Djali	49	6.18%
		Vajza[3]	15	1.9%
			198	**24.97%**
	Prind & Fëmijë	Prind & Fëmijë	50[4]	6.3%
		Babë & Bir	35	4.41%
		Babë & Bijë	3	0.38%
		Nënë & Bir	6	0.76%
		Nënë & Bijë	12	1.51%
		Njerka	18	2.27%
		Jetimi	7	0.89%
			131	**16.52%**
Familja & Farefisnia	Vëlla& Motër	Vëllai	31	3.91%
		Motra	4	0.51%

[3] Përsa i përket emrit vajzë, ky emër me të njëjtën formë *vajzë* na del në Sarandë, Kavajë e Shkodër. Sinonimet e tij na dalin si *çikë* në Podrime, *cucë* në Dibër, *çupë* në Devoll, Korçë, Tiranë, Vlorë, Sarandë e Skrapar, *gocë* në Elbasan e Krujë ndërsa vetëm në Sarandë na dalin dy forma *vajzë* e *çupë*.

[4] Te nëntë prej fjalëve të urta shqipe figura e djalit del me veti negative ndërsa vajza me veti pozitive, si: *Kush kadjem, pi zeher; kushkaçupa, ha sheqer.*

		Vëlla & Vëlla	8	1%
		Vëlla & Motër	3	0.38%
			46	**5.8%**
	Vjehër& re	Vjehrra[5]	7	0.89%
		Nusja	11	1.39%
		Vjehërr & Re[6]	13	1.64%
			31	**3.91%**
		Gjysh & Nip	4	0.5%
		Gjysh & Baba & Nip	12	1.51%
		Dajë & Nip	8	1%
		Dajë & Mbesë	3	0.38%
		Halla	4	0.5%
		Hallë & Teze	2	0.25%
			33	**4.16%**
		Dhëndri	10	1.26%
		Baxhanaku	2	0.25%
		Kunata	1	0.13%
		Nusja e vëllait	1	0.13%
			14	**1.76%**
	Rendi i shtëpisë	Plaku[7]	10	1.26%
		Plaka	2	0.25%
			12	**1.51%**
Miqësia & Fqinjësia	Miqësia	Krushku	7	0.89%
		Miku	16	2.02%
	Fqinjësia	Fqiu	35	4.41%
			58	**7.31%**
Totali			**793**	**100%**

1. Tabela e fjalëve të urta shqipe - marrëdhëniet Brenda antarëve të familjes shqiptare.[8]

[5] Katër prej tyre pasqyrojnë këndvështrimin e vjehrrës në raport me djalin dhe nusen: *Fjala e djalit - si zana e malit; fjala e resë - si kokrra e rrfesë.*

[6] Në raprot me nënën dhe gruan shfaqen 5 fjalë të urta, burri nënën e sheh si karakter negativ ndërsa gruan si karakter pozitiv: *Nënë - balta, e nuse - mjalta.*

[7] Te gjashtë prej fjalëve të urta "shtëpia" na del si emërtim i *familjes shumanëtarshëshe* (Xhemaj 2005:9): *Shtëpi pa halle nuk ka.* I kam vënë te grupi i fjalëve të urta te "plaku" duke u bazuar se në kulturën shqiptare plaku i shtëpisë është përgjegjës për rendin e shtëpisë.

[8] Statistikat e dhëna në këtë tabelë janë bërë në bazë të matjes së të dhënave te "Fjalët të urta shqipe", të përgatitur nga autorët Jorgo Panajoti dhe Agron Xhagolli (1985:763-812), respektivisht është përfshirë pjesa 'Familja, farefisi dhe fqinjësia'.

3. Turqizmat te fjalët e urta shqipe

Gjurmët që turqishtja ka lënë në gjuhët e Ballkanit janë të shumta nga pikëpamja sasiore dhe të rëndësishme nga pikëpamja cilësore. Jo më kot ato përbëjnë një nga tiparet mbi të cilat ngrihet lidhja gjuhësore ballkanistike (Mandalà 2011:227). Turqizmat sipas Desnickajas (2006) përbëjnë një shtresë mjaft të rëndësishme në leksikun e shqipes. Përveç aspektit historiko-kulturor që paraqet interes të madh për leksikologjinë historike të gjuhëve ballkanike dhe aspektit strukturor-gramatikor, meriton vëmendje gjithashtu aspekti stilistik i përcaktimittë rolit të turqizmave në sistemin e stileve të ligjërimit të gjuhës bashkëkohore.

Norbert Boretzky në veprën e botuar mbi turqizmat në shqipe dëshmon se, së pari, shpërndarja e turqizmave në shqipe është homogjene për sa u përket dialekteve. Së dyti, kjo dukuri nuk ka qenë e izoluar dhe nuk ka hasur asnjë pengesë në viset e banuara kryesisht nga katolikë në Veri dhe ortodoksë në Jug (Mandalà 2011:227-228). Edhe në studimin e bërë lidhur me fjalët e urta në këtë punim haset e njëjta gjë. Prej 793 fjalëve të urta që i përkasin kapitullit të familjes dhe farefisnisë qëpërfshinanë e kënd trojet shqiptare. Numri i fjalëve në këtë kapitull është 5169, numri i turqizmave është 170 ose 3.29% e fjalëve në përgjithësi. Prej numrit të përgjithshëm të turqizmave që janë aty, numri i veçantë i tyre është 98 fjalë.

R.	**Viset**	**Nr.**	**Turqizmat**	**R.**	**Viset**		**Turqizmat**
1.	Jug	**25 14.7%**	Baxhanak, dajë, evlat, grua-xhani, gjynah, hall, hajdut, hyzmet, jetim, kapak, kojshi, kusuremadh, mall, mëhallë, ortakëri, oxhak,pishman, pazar,qorr, sokak, tallaz, tenxhere, zahmet, zeman.	16.	Gjirokastër	**3 1.76 %**	Komshi, piperkëza, sevda.
2.	Shkodër	**19 11.18 %**	Dajë,filan, hall, horr, horrllek, hurma, jetim, kojshi, konak, mashë, misër, nafakmadh, nafakzi, nam, rahati, sergji, shamata, temel, zinxhir.	17.	Krujë	**3 1.76 %**	Kanak, rybe, shejtan.
3.	Vlorë	**14 8.23%**	Avllia, belaja, dynja, hall, hallë, hesap, karashti, nur, piperkëza, qese, revani, sokak, teze, xhenet.	18.	Prizren	**3 1.76 %**	Evlad, razi, rahati.

4.	Kosovë	**11 6.47%**	Dajë, dushman, evlad, hak, hall, hesap, jetim, kojshi, mall, nafakë, sheqer, tepsi.	19.	Kurveles h	**2 1.18 %**	Hallë, zullum
5.	Kavajë	**10 5.92%**	Bahçe, bela, dyrjanë, hallë, hanëm, hardalli, hyzmetçi, lezet, mysafir, teze.	20.	Strugë	**2 1.18 %**	Emirat, inson.
6.	Korçë	**10 5.88%**	Allishverish, derman, evlat, kurbet, mall, mëhallë, hak, sevap, zeher, zorrak.	21.	Labëri	**2 1.18 %**	Behar, hak.
7.	Elbasan	**10 5.88%**	Bela, bilbil, dajë, hall, hallë, harb, hatër, misër, raki, xhenet.	22.	Lumë	**2 1.18 %**	Jetim, pazar.
8.	Skrapar	**8 4.7%**	Baxhanak,buxhaku, dert, evlat, mall, nazëtore, okë, vatanë.	23.	Myzeqe	**2 1.18 %**	Qese, sherr.
9.	Veri	**7 4.12%**	Hise, hyzmet, konak, kojshi, mashë, pazar, themel.	24.	Pukë	**2 1.18 %**	Oxhak, pazar.
10.	Berat	**6** 3.55%	Hall, hallë, hallëmadhi, lanet, rahmet, sëkëlldi.	25.	Arbreshë t e Greqisë	**1 0.59 %**	Pasha.
11.	Dibër	**6** 3.53%	Dajë, dynja, merakçi, qejf, qese, saçmalli.	26.	Gjakovë	**1 0.59 %**	I pahajr.
12.	Tiranë	**5 2.94%**	Hall, medet, qese, shyqyr, zeher.	27.	Podrime	**1 0.59 %**	Sakak.
13.	Përmet	**5 2.94%**	Aksham, allishverish, hallal, mall, ortak.	28.	Pogradec	**1 0.59 %**	Pilaf.
14.	Devoll	**4** 2.35%	Dollap, hatër, mëhallë, qese.	29.	Tropojë	**1 0.59 %**	Kojshi.
15.	Sarandë	**4** 2.35%	Konak, hambar, sherxhi,behar.			**170 100 %**	

2. Tabela e turqizmave te fjalët të urta shqipe

Përfundimi

Duke bërë një analizë të veçantë studiuese thesarit të fjalëve të urta shqipe hasim në etni të veçantë dhe majft të pasur.Pavarësisht anën formale strukturore apo gjuhësore këto krijime luajnë rolin shoqëror, artistik dhe etiko-moral të proverbit shqiptar.

Si përfundim në bazë të analizës së fjalëve të urta shqipe, të autorëve Panajoti dhe Xhagolli në përmbledhjen e tyre të botuar në 1985, marrëdhëniet e antarëve të familjes në familjen shqiptare na dalin me këto rezultate: Rëndësi parësore i është dhënë martesës e cila është themel për krijimin e familjes. Raport po ashtu shumë delikat i është dedikuar marrëdhënies burrë-grua, ku roli i gruas në familjen shqiptare është i pazëvendësueshëm edhe pse roli i burrit apo edhe i babit është autoritar. Nëse bazohemi te të dhënat statistikore do të shohim se dukshëm vërehet numri i fjalëve të urta që i është kushtuar gruas në raport me burrin. Jo vetëm kaq por aty dallohet edhe marrëdhënia nënë-baba, përsëri nëna është në epërsi. Ndërsa numri i fjalëve të urta për femrën është më i madh, ajo në fjalët e urta shqipe trajtohet më shumësi *grua* se sa si *nënë*. Tjetra është marrëdhënia e prindërve me fëmijë shumë e dukshme është marrëdhënia baba dhe bir, si dhe nënë e bijë (djali e ka për model babain ndërsa vajza nënën). Vajza (bija) na del me më veti pozitive se djali (biri). Djali tregohet për punën që bën, sjelljet dhe respektin që tregon, si mburrje e babait e familjes. Ndërsa vajza për nderin dhe sjelljen që tregon kur martohet, ajo vetëm në shtëpi të burrit mund ta tregojë veten dhe nderin e familjes se nga vjen. Në bazë të fjalëve të urta shqipe, shihet edhe në tabelën e parë, në familjen shqiptare kryesisht ana e babait ka peshë më shumë.

Literatura

Desnickaja, A. V. (2006). Mbi funksionin stilistik të turqizmave në poezinë shqipe. Perla. Viti XI, Nr. 4 (43), fq. 126-134. Tiranë.

Lama, Irena (2015). Frazeologjia - një pasuri e rëndësishme e trashëgimisë kulturore. Historiku i zhvillimit të saj dhe vlera praktike e paremiologjisë shqiptare. Aktet e Takimit Vjetor, Vëll. II, Nr. 1. Tiranë.

Lepori, Mauro Giuseppe (2011). Familja vend i mirëpritjes dhe besimit që gjeneron shpresë. SHIS. Tiranë.

Mandalà, Matteo (2012). Mbi turqizmat në të folmet Arbëreshe. ASHAK. Prishtinë.

Panajoti, Jorgo dhe Agron Xhagolli (1985).Fjalët të urta shqipe. Rilindja. Prishtinë.

Ramadani, Ramadan H. (2006). Proverba të shqipes dhe të gjuhëve neolatine. Fidani. Prizren.

Tushi, Gëzim (2012). Martesa Familja Seksualiteti. Natyra. Tiranë.

Rijetë SIMITÇIU

ALBANIAN FAMILY RELATIONSHIPS WITHIN THE CONTEXT OF ALBANIAN PROVERBS

Abstract

This study presents the analysis of the socio-cultural perspective of relationships within family members based on Albanian proverbs and idioms. Proverbs carry forward philosophical and ethical perspectives of a society, as well as enriching the thoughts and notions of the people. Therefore, they are one of the greatest assets of popular wisdom.

Methodologically, the corpus of Albanian proverbs along with their structural analysis is done in order to present a complete sociolinguistic overview. As a result, the selected proverbs are examined in terms of interpersonal relationships of every single family member with each other. In addition, synonymous loan words used in different Albanian territories are classified and analysed to demonstrate whether they contain any Turkish expressions. Consequently, the frequency distribution of Turkish loan words in different Albanian territories are presented.

This paper intends to address family member relationships that are reflected in proverbs as well as using Turkish expressions within them. It might also be useful for researchers who deal with sociolinguistics and lexicology.

Key words: Proverbs, idioms, family relationships, sociolinguistics, Turkish loan words.

Rifat KRASNIQI

GJUHA DHE DISKURSI AKADEMIK

Abstrakti

Ky punim është një përpjekje për të përshkruar dhe për të vlerësuar gjuhën dhe diskursin që zhvillohen në orët mësimore të edukatës shoqërore në klasën e dhjetë të një shkolle të mesme në Prishtinë. Parimisht gjuha e përdorur në klasë është gjithmonë akademike sikur që janë edhe vetë përmbajtjet dhe diskursi i cili zhvillohet gjatë procesit mësimor. Punimi, ndërkaq, konstaton se gjuha e përdorur gjatë orës mësimore dallon shumë nga gjuha e përdorur në tekstin mësimor. Në punim përshkruhet dhe vlerësohet mënyra në të cilën diskursi prodhohet dhe kontrollohet nga mësimdhënësi si edhe mjetet linguistike të cilat përdoren për ndërtimin e kohezionit dhe të koherencës. Përdorimi i shënjuesve diskursiv si dhe i strategjive diskursive të cilat përdoren për të lehtësuar të kuptuarit janë po ashtu pjesë e këtij punimi.

Shprehjet dhe fjalët kyçe: *gjuhë akademike, diskurs akademik, analizë e diskursit, kohezion, koherencë, orë mësimore, nxënës, mësimdhënës.*

Hyrje

Pjesa më e madhe, për të mos thënë e tërë përmbajtja, e lëndës së edukatës qytetare është përmbajtje akademike dhe është rezultat i hulumtimeve të bëra në fusha dhe disiplina të ndryshme të shkencave shoqërore. Është e qartë se shpjegimi por edhe të mësuarit e përmbajtjeve akademike kërkojnë gjuhë akademike e cila përdoret në një diskurs akademik. Gjuha e cila përdoret si nga ana e mësimdhënësit ashtu edhe nga nxënësit në orët e edukatës qytetare të regjistruara lë shumë për të dëshiruar për të qenë një gjuhë akademike, e ngjashme me atë që përdoret në tekstin mësimor. Gjuha akademike nganjëherë definohet thjeshtë si gjuha e cila përdoret në shkollë dhe, nëse e kemi parasysh gjuhën e cila përdoret në shkollat e Kosovës në përgjithësi, kjo sigurisht që është gjuhë akademike, dhe është e tillë edhe për faktin se, megjithatë, dallon mjaft nga gjuha e cila përdoret në jetën e përditshme. Është, gjithashtu, e kuptueshme që

konteksti i gjuhës së folur në orët mësimore nënkupton përdorimin e një gjuhe e cila nuk ka nevojë dhe nuk pritet që të jetë vetëm akademike. Megjithatë, një dallim i madh në mes gjuhës akademike të përdorur në libra dhe gjuhës akademike të përdorur në diskursin e folur në shkolla, sugjeron se ka probleme të theksuara në nxënie dhe probleme akoma më të mëdha për zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik të nxënësve.

Schleppegrell thotë se "tekstet akademike krijojnë kuptim në mënyra të cilat janë të ngjeshura me informacion dhe paraqiten në mënyrë autoritative" (Schleppegrell, M. J. f. 44). Si gjuha e mësimdhënësit ashtu edhe gjuha e nxënësve në orët mësimore të cilat i kam observuar mëtojnë t'i plotësojnë këto dy kritere mirëpo e arrijnë këtë vetëm pjesërisht për kriterin e dytë e madje edhe më pak sa i përket kriterit të parë. Mësimdhënësi në raste të rralla bën përpjekje të zbehta për ta zbërthyer gjuhën të cilën ai e përdor apo gjuhën e përdorur në tekstin mësimor të cilin e përdorin por këtë e bën më shpesh kur nxënësit përgjigjen në pyetjet e shtruara nga ai.

Gjuha e mësimdhënësit

Nevoja që mësimdhënësit e të gjitha fushave të pajisen me njohuri elementare në fushën e analizës së diskursit për të qenë në gjendje për ta përmirësuar performancën e tyre është identifikuar nga disa autorë. Karakteristikë e gjuhës së mësimdhënësit, orët e të cilit i kam observuar, është përdorimi shumë i kursyer i shënjuesve të diskursit që mund të jetë një ndër karakteristikat kryesore të gjuhës akademike. Radhën e të folurit për nxënësit e paralajmëron ose me pyetje ose duke e lënë ndonjë fjali të papërfunduar, me ç'rast fjalën e fundit e thekson me një intonacion të ngritur, ndërsa shënjuesit të cilët do të ndihmonin për të ndërtuar kohezionin dhe për të kuptuar raportin ndërmjet fjalive mungojnë pothuajse tërësisht në diskursin e mësimdhënësit. Edhe kur i përdor i përdor gabimisht, siç ishte përdorimi i *domethanë* për të treguar ekuivalencën e fjalëve *kushtetutë* dhe *ligj,* apo në një rast tjetër kur e përdor prapë këtë fjalë gjoja për të treguar se fjalia e parë është fjalia e varur kurse fjalia e dytë është fjalia kryesore e periudhës: *Domethanë, në kuadër të drejtave të tyre, çdo qytetar që i gëzon të drejtat e veta ka edhe përgjegjësi* e cila jo vetëm se nuk e ndihmon të kuptuarit por e ngatërron edhe më shumë, duke lënë të kuptohet se përgjegjësitë e qytetarëve janë pjesë e të drejtave të tyre, në vend se këto dy koncepte t'i kundërvihen njëra tjetrës gjë që do të ndihmonte të kuptohej elementi kryesor semantik i tyre, i cili tek *të drejtat* është diçka që i jepet apo i ofrohet qytetarit ndërsa tek *përgjegjësitë* është diçka që kërkohet nga qytetari.

Vetë fraza, ndërkaq, ka një formë karakteristike të gjuhës akademike duke filluar nga shënjuesi i diskursit *domethanë,* që është mjaft i shpeshtë në diskursin akademik, pretendimi për të krijuar një raport nënrenditjeje ndërmjet dy fjalive të frazës, gjë që sikur të bëhej si duhet do të mund të ndihmonte në të kuptuarit e marrëdhënies ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësive, si edhe përdorimi i foljes *gëzon* për të drejtat dhe foljes ndihmëse *ka* për përgjegjësitë, gjë që bëhet me qëllim të paraqitjes së kundërshtisë semantike të këtyre dy koncepteve gjë që nuk arrin ta bëjë më herët kur përdor gabimisht shënjuesin diskursiv *domethanë*. Përdorimi formal i gjuhës akademike në këtë rast mund të jetë përpjekje e mësimdhënësit për të kompensuar përmbajtjet të cilat dështon t'i sjellë para nxënësve. Në përvojën time edhe si nxënës apo student, por edhe si mësimdhënës, më ka rënë shpesh të shoh praktika të tilla diskursive me anën e të cilave nxënësit apo studentët mundohen që mungesën e përmbajtjes ta kompensojnë me formë. Fakti që një praktikë e tillë përdoret shpesh mund të jetë edhe tregues se përdorimi i saj deri diku rezulton me "sukses".

Struktura e ligjëratës së mësimdhënësit kryesisht përshkohet me informata të cilat jepen në formë të sekuencës, domethënë informatat renditen njëra pas tjetrës, pa ndonjë strukturë logjike e cila do të ndihmonte në organizimin më të mirë të informatës, dhe do të lehtësonte mbajtjen e saj në mend për një kohë më të gjatë. Ndonjëherë ofron edhe përshkrime të cilat janë të dobishme për ilustrimin e përmbajtjeve mësimore, si edhe krahasime apo kundërvënie jo shumë të suksesshme, si ato që u përmendën më sipër, mirëpo mungojnë pothuajse tërësisht shpjegimet e tipit shkak-pasojë apo problem-zgjidhje. Pikërisht dy llojet e fundit të diskursit, ndërkaq, janë më të rëndësishmet për zhvillimin e të menduarit në nivele më të larta si edhe për zhvillimin e aftësisë së të menduarit kritik.

Në anën tjetër, mësimdhënësi është mjaft i aftë për të përdorur strategjitë e ndryshme të cilat kanë për qëllim që nxënësve t'ua kujtojnë përmbajtjet nga njësitë mësimore të cilat janë shpjeguar më parë. Edhe strategjitë për lehtësimin e të kuptuarit i përdor mjaft shpesh, mirëpo jo me të njëjtin sukses. Përsëritja dhe përmirësimi i kontributit dhe përgjigjeve të nxënësve si edhe parafrazimi i tyre:

1	N:	mun ëëë ose, trafikim me qenie njerzore XXXXXX jan fëmijët dhe
2		personat të cilët ë
3	M:	Janë ma t'rrezikuar,
4	N:	Më t'rrezik...
5	M:	Por kur, n'cillat raste, kur kemi një trafikim që përdoret, asht si fazë më e
6		shpeshtë, më s'shumti?

7 N: Në fazën e tranzicionit apo ndryshimet të cilat bëhen në...
8 M: Në tranzicion të shteteve apo në ndryshime, se me kanë çdo herë e njejtë e
9 njejtë ku me ditë çka bahet

Në ndërhyrjen e parë mësimdhënësi e përfundon mendimin e nxënësit, i cili duket të ketë hasur në vështirësi për arsye se edhe vetë e sheh se nuk është duke u përgjigjur në pyetjen e cila i është drejtuar, kurse në ndërhyrjen e dytë mësimdhënësi, duke përdorur lidhësen kundërshtuese *por,* e bën nxënësin me dije se ajo nuk ishte përgjigja që kërkohej prandaj ia përsërit pyetjen të riformuluar, në të cilën nxënësi përgjigjet më mirë por prapë me një formulim jo mjaft të qartë. Formulimi i paqartë nga nxënësi është jo vetëm pasojë e paqartësive të cilat ai i ka në lidhje me përmbajtjen mësimore për të cilën pyetet, por edhe pasojë e formulimit jo të qartë të vetë pyetjes nga mësimdhënësi, i cili duke dashur të pyes se kur paraqitet dukuria e trafikimit me qenie njerëzore, pyet *kur kemi një trafikim që përdoret,* dhe duke dashur të pyesë se në cilat faza të zhvillimit të shoqërisë paraqitet kjo dukuri më shpesh pyet *(kur) asht si fazë më e shpeshtë, më s'shumti?* Edhe ndërhyrja e fundit e mësimdhënësit nga kjo sekuencë nuk është as më e qartë, as më logjike, dhe as më e rregullt, madje as në pikëpamje gramatikore. Duke dashur të thotë se kjo dukuri paraqitet më rrallë në shoqëritë stabile dhe të konsoliduara ai thotë: *se me kanë çdo herë e njejtë e njejtë ku me ditë çka bahet* duke përdorur kështu një diskurs fare jo akademik, madje me përsëritjen e fjalës *e njejtë* e zbret nivelin e diskursit edhe më poshtë në një nivel madje foshnjor. Sigurisht që kjo përdoret edhe me qëllim të relaksimit të atmosferës në klasë por gjithsesi se nuk i kontribuon zhvillimit të aftësisë së nxënësve për t'u shprehur në mënyrë të qartë. Një formulim i tillë i pyetjeve apo i ndërhyrjeve nga mësimdhënësi sigurisht nuk mund të prodhojë apo të rezultojë me përgjigje të qarta dhe të argumentuara nga nxënësit. Edhe pasuria por edhe varfëria gjuhësore e mësimdhënësit reflektohet drejtpërsëdrejti tek nxënësit. Për më tepër, aftësitë shumë të kufizuara gjuhësore të nxënësve në rastin tonë, me siguri, janë rezultat dhe tregues i aftësive të kufizuara gjuhësore edhe të mësimdhënësve tjerë e jo vetëm të mësimdhënësit të edukatës qytetare. Me shumë arsye mund të supozohet se kualiteti i komunikimit nuk mund të jetë shumë më i mirë as në orët e gjuhës shqipe apo në orët tjera.

Sa i përket fjalorit të përdorur nga mësimdhënësi mund të thuhet se i përmbush kriteret e fjalorit akademik sa i përket terminologjisë së lëndës sepse përmban mjaft fjalë e shprehje specifike për lëndën e edukatës qytetare si: *përgjegjësitë e qytetarëve, të drejta, përmbushje e detyrave dhe përgjegjësive, të përcaktuara, të rregulluara me, ligj, kushtetutë, përshtaten, nënshtrohen, njohja dhe respektimi i ligjit, rregullore, organet kompetente, organet e*

qeverisë, qeveria, zbatimi apo ekzekutimi i ligjeve, parlamenti, ndryshim, përmirësim apo propozim ligji, iniciativë për ndryshim ligji etj. Të gjitha këto fjalë përdoren brenda një pjese të shkurtë të ligjëratës mbi përgjegjësitë e qytetarëve, ndonëse nuk është mjaft e qartë se sa i kuptojnë nxënësit dhe mësimdhënësi nuk ndalet në shpjegimin e kuptimit të tyre. Edhe në këtë rast mund të supozohet se përdorimi i termeve specifike synon të përmbush formën akademike të diskursit, dhe në të njëjtën kohë të kompensojë mungesën e formulimeve të qarta akademike dhe organizimit logjik të përmbajtjeve.

Në anën tjetër, mësimdhënësit i mungon shumë leksiku akademik i cili përdoret për të ndërtuar diskursin akademik siç janë shënjuesit e diskursit apo lidhëzat bashkërenditëse si: *po, por, kurse, megjithatë, ndërsa, megjithëkëtë, teksa* etj. të cilat do të tregonin marrëdhënien bashkërenditëse ndërmjet pjesëve të ndryshme të diskursit dhe sidomos mungojnë lidhëzat nënrenditëse si: *se, që, në, nëse, sepse, derisa, meqenëse, meqë, ngaqë, me qëllim që, sa, se sa, sikurse, po qe se, sa që, kështu që, megjithëse, ndonëse, edhe pse* etj. të cilat janë jo vetëm të zakonshme në diskursin akademik, por edhe të domosdoshme për të treguar varësinë ndërmjet pjesëve të diskursit por edhe ndërmjet koncepteve specifike të qytetarisë.

Duke pasur parasysh stilet e ndryshme të të mësuarit tek nxënësit, do të ishte shumë e dëshirueshme që mësimdhënësit të përdorte ndonjëherë edhe tabelën për të paraqitur në mënyrë vizuale qoftë koncepte të caktuara apo marrëdhënie të caktuara ndërmjet ideve të ndryshme brenda ligjëratës së tij por kjo nuk ndodh asnjëherë. Përdorimi i tabelave të ndryshme, diagrameve apo mjeteve tjera për vizualizimin e pjesëve të caktuara të ligjëratës është karakteristik për diskursin akademik, dhe i ndihmon nxënësit shumë edhe për t'i kuptuar më mirë ligjëratat, edhe për t'i mbajtur ato në mend por edhe për të krijuar mendimin e vet kritik rreth ligjëratës. Apo edhe më i mirë se sa përdorimi i tabelës do të ishte përdorimi i mjeteve teknologjike si kompjuteri me projektor, gjë që do ta bënte të mësuarit më atraktiv dhe më të kapshëm për shumë nxënës, kur dihet se tashmë shumica e nxënësve janë përdorues të rregullt të teknologjisë informative dhe e njohin dhe e kuptojnë mjaft mirë gjuhën digjitale. Teksti mësimor, siç e kemi përmendur, përmban mjaft ilustrime dhe tabela të cilat e lehtësojnë orientimin e nxënësve në aspektet më të rëndësishme të përmbajtjeve mësimore.

Gjuha e nxënësve

Në një ambient siç është shkolla, në të cilën mësimdhënësi në përgjithësi e dominon jo vetëm prodhimin por edhe zhvillimin e tërësishëm të diskursit, nuk mund të pritet që gjuha e nxënësve të jetë shumë më ndryshe se gjuha e mësimdhënësit. Në

një ambient në të cilin nxënësit nuk inkurajohen që të kenë mendimin e vet në lidhje me çështjet të cilat mësohen kjo mund të ndodhë aq më pak. Përkundrazi, mund të pritet që gjuha e nxënësve të jetë tepër e ngjashme me gjuhën e mësimdhënësit. Në shumë raste shohim se nxënësit imitojnë jo vetëm format e drejta gjuhësore të mësimdhënësit por edhe format e gabueshme apo, thënë më mirë, fjalitë, frazat apo në përgjithësi mendimet e pa përfunduara në mënyrën në të cilën ato prodhohen nga mësimdhënësi. Madje, edhe niveli i diskursit përtej fjalisë apo përtej frazës tregon ngjashmëri shumë të mëdha me diskursin e prodhuar nga mësimdhënësi. Këtë diskurs kaq të ngjashëm e përcakton, në radhë të parë, qasja e njëjtë e mësimdhënësit dhe e nxënësve e cila mund të cilësohet si qasje praktike 'për të kryer punë'. Domethënë, edhe mësimdhënësi edhe nxënësit të mësuarit e marrin si një obligim i cili duhet të përmbushet gjithsesi, me ç'rast cilësia është më pak e rëndësishme se sa sasia dhe forma e këtij obligimi.

Nxënësit nuk duket ta kenë problem të folurit publik, e madje as përdorimin e termeve apo edhe të gjuhës standarde, kur përgjigjen apo kur kontribuojnë gjatë ligjëratave të mësimdhënësit. Krijimi i ambientit miqësor në të cilin nxënësit ndihen të lirë për t'u shprehur mund të jetë një ndër meritat e mësimdhënësit edhe pse ata, megjithatë, hezitojnë shumë të thonë diçka për të cilën nuk ndjehen të sigurt se është e pranueshme për mësimdhënësin. Mu për këtë arsye përgjigjet e tyre janë shumë të shkurtra dhe nuk elaborojnë pothuajse aspak.

Kohezioni dhe koherenca e diskursit

Në teorinë e analizës së diskursit thuhet se kohezioni dhe koherenca duke i dhënë teksturën e duhur bëjnë që një tekst të perceptohet si tekst. Derisa kohezioni ndërlidh njësitë më të vogla gjuhësore të një teksti dhe shprehet me mjete linguistike eksplicite koherenca ndërlidh në pikëpamje kuptimore dhe logjike pjesët më të mëdha të diskursit dhe i organizon në mënyrë që teksti të formojë një tërësi diskursive. Kohezioni gjithashtu kontribuon në koherencën e tekstit.

Halliday dhe Hasan e shohin kohezionin si një koncept semantik i cili "referon tek marrëdhëniet e kuptimit të cilat ekzistojnë brenda tekstit, dhe e definojnë atë si tekst" (Halliday dhe Hasan, f. 4) për të konstatuar më tutje se kohezioni realizohet me mjete gramatikore ose leksikore. Ata kanë identifikuar pesë lloje të mjeteve kohezive: referencën, zëvendësimin, elipsën, lidhëzat dhe kohezionin leksikor. Ligjërata e cila shquhet me kohezion të qartë dhe e cila i përdor si duhet sidomos mjetet leksikore të kohezionit të cilat ndikojnë edhe në ndërtimin e koherencës së tekstit kuptohet shumë më lehtë dhe mbahet në mend më lehtë. Rrjedhimisht mund të thuhet se edhe

reflektimi kritik mbi përmbajtjet e komunikuara në mënyrë të tillë është më i lehtë dhe më efikas sepse nxënësit nuk kanë nevojë për shumë kohë për të vendosur dhe për të përcaktuar nëse informata të cilën e përcjell mësimdhënësi ka kuptim dhe është e arsyeshme dhe e pranueshme.

Ligjëratat e mësimdhënësit si edhe i tërë komunikimi që ndodh në orët mësimore të edukatës qytetare të cilat janë vëzhguar për nevojat e këtij hulumtimi lënë shumë për të dëshiruar në pikëpamje të mjeteve linguistike të cilat përdoren për të krijuar kohezion të mjaftueshëm dhe të natyrshëm të diskursit. Duke u munduar që të jetë më eksplicit dhe më i qartë mësimdhënësi shpeshherë nuk i përdor përemrat anaforik por e përdor për shembull emrin *përgjegjësi* tri herë brenda të njëjtës periudhë, një përsëritje e cila gjithashtu është një mënyrë për të realizuar kohezion më të fuqishëm të tekstit: *cillat janë përgjegjësitë e qytetarëve, pse i kem, pse ekzistojnë këto përgjegjësi, kujna i jipen këto përgjegjësi?*

Kohezioni, ndërkaq, realizohet edhe me anë të shënjuesve të diskursit apo lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse gjë që gjithashtu lë shumë për të dëshiruar në rastin të cilin e kam analizuar. Siç është përmendur edhe më parë shënjuesit e diskursit jo vetëm që përdoren në mënyrë fare të kursyer nga mësimdhënësi por, çuditërisht, ata mungojnë edhe në vetë tekstin e edukatës qytetare i cili përdoret si burim kryesor i informatave lidhur me lëndën. Shënjuesit kryesor të diskursit të cilët i përdor mësimdhënësi janë *pra*, *domethanë*, *nuk do t'thotë*, *çka do t'thotë* etj të cilët kryesisht përdoren për të treguar pjesa në vazhdim është parafrazim i asaj që është thënë më parë. Përdorimi adekuat i tyre ndihmon shumë edhe të kuptuarit e fjalisë apo periudhës së thënë por, në shumë raste, edhe të kuptuarit e fjalisë apo periudhës e cila do të thuhet në vijim të ligjëratës për shkak se e ndihmon dëgjuesin që të pozicionohet si duhet për ta kuptuar atë. Ja, për shembull, si i përdor mësimdhënësi lidhëzën nënrenditëse shkakore *për shkak se* dhe lidhëzën nënrenditëse ftilluese *nëse* kur përgjigjet në pyetjen: *për çka kem thanë se përgjegjësia e njohjes dhe respektimit të ligjit për çka asht kjo, pse ekziston kjo si parim themelor, si kryesor?* të cilën e ka shtruar vetë:

10 M: Për shkak se, qytetarët nëse gëzojnë të drejta, kanë përgjegjësi, ata duhet
11 të bazohen dikun, t'njoftohen të informohen për të drejtat e tyre.

Fjalia kryesore në këtë rast do të jetë fjalia "*ata duhet të bazohen dikun, t'njoftohen të informohen për të drejtat e tyre*" e cila paraprihet me lidhëzën nga fillimi i periudhës *për shkak se* ndërsa fjali e nënrenditur do të jetë fjalia "*qytetarët nëse gëzojnë të drejta, kanë përgjegjësi"* që fillon me lidhëzën *për shkak se*. Deri sa është në rregull që përgjigja të

fillojë me këtë lidhëz vazhdimi me fjali kushtore e ngatërron shumë marrëdhënien ndërmjet fjalive. Periudha do të ishte shumë më e kuptueshme dhe më e natyrshme nëse fjalia kryesore do të kishte lidhëzën *dhe* para elementit "*të informohen për të drejtat e tyre*" dhe nëse fjalia e nënrenditur do të kishte edhe lidhëzën *dhe* para elementit të shtuar "*kanë përgjegjësi*" dhe nëse e tërë fjalia do të vendosej pas fjalisë kryesore. E parafrazuar kjo periudhë do të mund të organizohej kësisoj: *Për shkak se, nëse gëzojnë të drejta dhe kanë përgjegjësi, qytetarët duhet të bazohen dikun, t'njoftohen dhe të informohen për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre*. Edhe si e tillë kjo periudhë lë shumë për të dëshiruar për arsye se mësimdhënësi bazohet në supozimin se nxënësit e dinë se si njoftohen qytetarët rreth ekzistencës së ligjeve të cilat e rregullojnë fushën e të drejtave dhe përgjegjësive të qytetarëve.

Zgjedhja e fjalëve dhe fjalori i cili përdoret në tekst gjithashtu shërben për realizimin e kohezionit të tij. Sikur që kemi parë edhe më herët mësimdhënësit shpeshherë ka problem të bëjë dallimin ndërmjet fjalëve të afërta për nga kuptimi siç bën kur fjalët *kushtetutë* dhe *ligj* i përdor në mënyrë sinonimike. Në të vërtetë repertori i fjalëve si edhe zgjedhja e tyre janë pika më e dobët e diskursit në orët mësimore. Ndryshimi i një strukture shumë tradicionale të diskursit siç është struktura IPV mund edhe të ketë qenë një detyrë tepër e vështirë për sistemin aktual arsimor të Kosovës mirëpo zgjerimi dhe pasurimi i fjalorit të nxënësve e sidomos të mësimdhënësve është një obligim i cili ka mundur të përmbushet me shumë më shumë sukses. Sekuenca e mëposhtme është një shembull i cili e ilustron pothuajse tërë elokuencën e mësimdhënësit në të gjitha orët mësimore. Duke u përgjigjur, prapë, në pyetjen e shtruar nga vetë ai mësimdhënësi thotë:

12 M: Me ligj, me kushtetutë domethanë, sa ma shumë, t'gjitha ato përgjegjësi
13 dhe t'gjitha ato detyra apo të drejta që i kanë qytetarët bazohen,
14 rregullohen me diçka dhe duhet tu përshtaten apo tu nënshtrohen. Cilat
15 janë disa përgjegjësi që i kem përmen XXX një përgjegjësi prej
16 qytetarëve, që kanë përgjegjësi. Urdhno ti, cilla munet me qenë ajo
17 përgjegjësi?

Kjo periudhë nuk ka nevojë të analizohet apo të komentohet. Kjo na kujton fjalinë e famshmetë Noam Chomskyt *Idetë e gjelbra të pangjyra vrapojnë furishëm.* Vetëm se, për dallim prej fjalisë së Chomsky-t, kjo periudhë jo vetëm që nuk ka kuptim por nuk është korrekte as në pikëpamje gramatikore. E kam përmendur edhe më herët, se me

disa përjashtime, gjuha e nxënësve do të pasqyrojë gjuhën e mësimdhënësit në çdo aspekt e, rrjedhimisht, edhe në aspektin e përzgjedhjes së fjalëve apo të pasurisë së fjalorit me të cilin operojnë. Prapë, si tek gjuha akademike, nuk ka kuptim të fajësohet vetëm mësimdhënësi i edukatës qytetare. Varfëria e mjeteve gjuhësore të cilat i kuptojnë dhe mund t'i përdorin duket t'i karakterizojë gjeneratat e reja në përgjithësi dhe fajtorët për këtë do të duhej të kërkohen së pari në sistemin arsimor, por, pa dyshim, edhe jashtë këtij sistemi për arsye se ka mjaft indikacione se edhe dinamikat e ndryshme të jetës moderne e sidomos përdorimi i telefonave mobil, i internetit dhe i rrjeteve të ndryshme sociale mund ta kenë hisen e vet të fajit në këtë mes. Një zgjidhje e mundshme e kësaj situate, të paktën në lëndën e edukatës qytetare do të mund të ishte reduktimi i kurrikulës dhe përqendrimi në konceptet dhe idetë kryesore të qytetarisë. Kjo do të mundësonte që së pari vetë mësimdhënësit t'i kuptojnë këto koncepte më mirë, por kjo do të mundësonte gjithashtu që mësimdhënësit dhe nxënësit të kenë më shumë kohë në dispozicion për të diskutuar lirshëm mbi të gjitha këto koncepte të cilat nganjëherë duket sikur vijnë nga një botë tjetër. Jo vetëm në klasat me rreth 50 nxënës, sikur që ishte në rastin tonë, por edhe në klasat me numër shumë më të vogël të nxënësve nuk mund të zhvillohen diskutime e aq më pak debate të mirëfillta nëse duhet gjithsesi të plotësohet obligimi i cili vjen nga kurrikula për trajtimin e të gjitha njësive mësimore nga libri. Ç'është e vërteta mësimdhënësi i redukton ato njësi mjaft shumë mirëpo nuk arrin që ta bëjë të kuptueshme as esencën e tyre dhe deri në fund të vitit edhe ashtu bëhet një numër tepër i madh i temave të ndryshme të cilat është e pamundur të mësohen si duhet dhe të mbahen në mend nga nxënësit e mos të flasim për nivelet më të larta të të mësuarit siç janë analiza, aplikimi, sinteza apo vlerësimi i tyre.

Sa i përket koherencës së diskursit të mësimdhënësit, në dy njësitë mësimore të cilat i shpjegon mësimdhënësi është vështirë të konstatohet ekzistimi i një strukture të mirëfilltë narrative e cila do të kishte një fillim të qartë i cili do të nxiste interesimin e nxënësve, një mes ku do të elaborohej tema e njësisë mësimore dhe një përfundim i cili do t'i theksonte çështjet kryesore të temës dhe do t'i linte nxënësit me dëshirën për ta hulumtuar dhe mësuar më tutje këtë temë. Për shembull hyrja për njësinë mësimore mbi përgjegjësitë e qytetarit fillon në këtë mënyrë:

18 M: Vazhdojmë me përgjegjësitë e qytetarëve. A i kini librat [pauzë] 10
19 sekonda]. Kush po XXX çka po m'tregon dikush çka do t'thotë, cillat janë
20 përgjegjësitë e qytetarëve, pse i kem, pse ekzistojnë këto përgjegjësi,
21 kujna i jipen këto përgjegjësi [pauzë 5 sekonda], çka kem thanë, se

22 qytetarët kanë të drejta, çdo qytetar ka të drejta, në kuadër të drejtave?

Ndërsa hyrja për shpjegimin e njësisë mësimore mbi trafikimin e qenieve njerëzore, siç e pamë edhe në sekuencën e mëhershme rreth shpjegimit të njësisë së re mësimore, është edhe më e drejtpërdrejtë dhe fillon në këtë mënyrë:

23 M: Kem, trafikimi i qenieve njerëzore. Çka kem thanë se kush mund t'jet
24 trafikim apo çka mund t'jet trafikim i qenieve njerëzore. Që asht një
25 dukuri shum e ndishme sot te ne. Hajde ti!
26 N: Trafikim apo viktimë me qenie njerëzore mund të jenë njerëzit e pasur, të
27 varfër por edhe personat e rinj dhe të vjetër.

Në të vërtetë kjo e dyta nuk mund të konsiderohet fare si hyrje për një njësi të re mësimore sepse mësimdhënësi menjëherë shtron një pyetje e cila lidhet drejtpërdrejtë me përmbajtjen e kësaj njësie mësimore. Ngatërrimi i subjektit, predikatit dhe objektit të fjalisë është pothuajse i zakonshëm jo vetëm në ligjëratën e mësimdhënësit por edhe në diskursin e nxënësve. Tek pjesa e parë e pyetjes së shtruar nga mësimdhënësi subjekti është *viktimë* dhe ai në të vërtetë mungon fare sepse ai dëshiron të dijë se kush mund të jetë viktimë e trafikimit e jo kush mund të jetë trafikim ndërsa në përgjigjen e nxënësit vërehet në përpjekje për ta përmirësuar këtë kur subjekti përmendet edhe në mënyrën e gabueshme të përdorur nga mësimdhënësi (trafikim) por edhe në mënyrë të drejtë (viktimë) edhe pse edhe nxënësi pastaj e harron objektin e fjalisë dhe thotë "*viktimë me qenie njerëzore*" në vend të "*viktimë e trafikimit me qenie njerëzore*".

Me fjalë tjera, të dy ligjëratat më shumë duken si përmbledhje periudhash të cilat kanë të bëjnë më shumë a më pak me temat të cilat trajtohen se sa si diskurse koherente të cilat mund të mbahen në mend nga nxënësit si njësi të veçanta diskursive. Bazuar në parimin e Grice-it mbi bashkëpunimin nxënësit do të bazohen në kohezionin leksikor të tekstit dhe do të bëjnë përpjekje për ta kuptuar ligjëratën mirëpo mënyra e tillë e të ligjëruarit do të kërkojë nga ata më shumë përpjekje të tilla dhe më shumë kohë ndërsa qëllimi i ligjëratës do të duhej të ishte mbarështimi i kuptueshëm i cili do të lehtësojë të kuptuarit e temës mësimore si një njësi kuptimore.

Halliday e sheh tërë të mësuarit si një proces i kontekstualizimit të vazhdueshëm ku "secili element në diskurs, qoftë edhe vetëm një periudhë apo një kapitull apo libër i tërë, ka vlerë (1) si tekst, në vetvete, dhe (2) si kontekst, për tekstin tjetër që pason" (Halliday, M. A. K. & Hasan, R. 1989, f. 32) dhe thotë se "ne jemi të

prirë të mendojmë për të mësuarit si proces kognitiv dhe të shpërfillim aspektet linguistike të tij" (po aty) mirëpo nëse e interpretojmë të mësuarit si proces linguistik dhe nëse mësimdhënësit e kuptojnë rolin kritik të gjuhës në procesin e të mësuarit atëherë do të kemi një teori e cila do t'i plotësojë modelet e deritashme kognitive. Duke sjellë në vëmendjen e lexuesve një qasje shumë interesante e cila mund të dëgjohet nga autorë të ndryshëm se "koherenca në fund të fundit mbështetet në supozimin se kur folësit flasin ata thonë gjëra të cilat kanë lidhje të natyrshme ndërmjet tyre Ruqaiya Hasan thotë se pajtohet se ne vërtetë bëjmë supozime të tilla mirëpo ajo mendon se këto supozime bazohen diku dhe për të dëshmuar këtë ajo thotë se një aspekt i rëndësishëm i edukimit është prodhimi i diskursit koherent dhe se "është përvoja e mësimdhënësve në të gjitha nivelet – duke mos i përjashtuar universitetet – se diskursi i hershëm i nxënësve në një fushë të re është relativisht më pak koherent se sa diskursi i tyre i më vonshëm" (Halliday, M. A. K. & Hasan, R. 1989, f. 55).

Edhe në orën e vlerësimit të diturisë së nxënësve hasim në raste interesante të humbjes së rrjedhës së dialogut ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësve siç ndodh, bie fjala, kur temat e dialogut ndërrohen pa kurrfarë arsyeje apo paralajmërimi si nga ana e nxënësit po ashtu edhe nga ana e mësimdhënësit:

M: Cillat janë sfidat e zhvillimit t'biznesit kosovar deri sot? kanë sfida t'shumta por prap zhvillohet ni biznes i tillë,
N: Sfidat janë, ëëë
M: Duke u bazuar, n'çka kem thanë?
N: Duke u bazuar nëë
M: [mësimdhënësi troket në tavolinë për t'i qetësuar nxënësit tjerë]
N: Naty, nëë, ka domethanë
M: Ka një natyrë
N: Një natyrë të maa, të cillat
M: Pasuri natyrore të pazbuluara, që mendohet ku me dit çka po s'po merrum
me to, shumë pak, ka ni traditë
N: Traditë të ma, historike [nxënësit tjerë pëshpëritin për ta ndihmuar]

Pra, kemi një sekuencë të një dialogu tërësisht jo koherent që duket sikur të ishte një dialog i cili zhvillohet ndërmjet dy personave të cilët nuk e dëgjojnë njëri tjetrin. Fillon me temën e sfidave të biznesit dhe përfundon me të kundërtën e sfidave përkatësisht me kushtet të cilat e favorizojnë zhvillimin e biznesit siç janë pasuritë

natyrore apo tradita e pasur. Kjo mund të ndodhë edhe për shkak të prishjes së qetësisë nga nxënësit e tjerë po mund edhe të jetë imponuar me përpjekjet e nxënësit për të spekuluar. Në të vërtetë ky ishte një rast i mirë për të inkurajuar elaborimin nga nxënësi dhe për ta orientuar atë nga përpjekjet për spekulim në përpjekjen për të dhënë një përgjigje të përafërt dhe për ta ruajtur koherencën e diskursit mirëpo praktika e zakonshme në këtë klasë është që kërkohen përgjigje të sakta kurse përgjigjet e përafërta nuk janë të pranueshme kështu që nga nxënësi më parë mund të pritet një përpjekje e pa suksesshme për të spekuluar se sa një përpjekje për të elaboruar me terme të afërta me temën e pyetjes.

Një mënyrë tjetër për ndërtimin e kohezionit dhe të koherencës është edhe strukturimi i temave të reja të cilat paraqiten në diskurs gjatë orës mësimore. Derisa në biseda të zakonshme është normale që tema të ndryshme të negociohen ndërmjet bashkëbiseduesve dhe në mënyrë spontane të kalohet nga një temë në një temë tërësisht të ndryshme në diskursin e orës mësimore pritet që të ketë më shumë kujdes gjatë paraqitjes së ideve the temave të reja dhe të elaborohen mirë para se të kalohet në një temë tjetër e cila prapë do të duhej të jetë e ndërlidhur me temën paraprake në mënyrë që zhvillimi i diskursit të respektojë parimin e paraqitjes së informatës së vjetër para të resë. Diskursi i cili zhvillohet në orët mësimore të cilat i kam observuar nuk u përmbahet parimeve të lartpërmendura. Edhe pse tema kryesore e njësisë mësimore paraqitet në fillim të ligjëratës mësimdhënësi nuk heziton që shpesh herë të kalojë në fusha tjera dhe të elaborojë tema të ndryshme të cilat nuk është e thënë se kanë shumë lidhje me temën e cila trajtohet nga ligjërata. Në të vërtetë kjo mund të paraqesë problem për disa nxënës të cilët mund të mos arrijnë ta përcjellin ligjëratën për shkak të mungesës së koherencës mirëpo për disa nxënës tjerë mund të jetë edhe e dobishme për shkak se një zhvillim i tillë i diskursit e zgjeron kontekstin përmbajtjesor dhe u ndihmon nxënësve të shohin dhe të kuptojnë marrëdhënie të ndryshme ndërmjet koncepteve të cilat në shikim të parë mund të duket se nuk kanë shumë gjëra të përbashkëta. Problemi është se mësimdhënësi përdor shumë pak shënjues të diskursit me të cilët do të tregonte se po kalon në një temë tjetër si edhe do të tregonte marrëdhënien e kësaj teme të re me temën e posa diskutuar.

Përfundim

Gjuha e mësimdhënësit karakterizohet me mungesë të theksuar të shënjuesve të diskursit edhe pse këta shënjues janë karakteristikë e gjuhës akademike ndërkohë që fjalori i përdorur nga mësimdhënësi mund të thuhet se i përmbush kriteret e fjalorit akademik sepse përmban mjaft fjalë e shprehje specifike për lëndën e edukatës

qytetare. Nxënësit nuk duket ta kenë problem të folurit publik, e madje as përdorimin e termeve apo edhe të gjuhës standarde, megjithatë, hezitojnë shumë të shprehen lirshëm dhe për këtë arsye përgjigjet e tyre janë shumë të shkurtra. Shumë herë gjuha e tyre duket si një imitim mekanik i gjuhës së mësimdhënësit. I tërë komunikimi që ndodh në orët mësimore lë shumë për të dëshiruar në pikëpamje të mjeteve linguistike të cilat përdoren për të krijuar kohezion të mjaftueshëm dhe të natyrshëm të diskursit. Ngatërrimi i subjektit, predikatit dhe objektit të fjalisë është pothuajse i zakonshëm jo vetëm në ligjëratën e mësimdhënësit por edhe në diskursin e nxënësve. Problemet me koherencën janë akoma më të theksuara dhe është pothuajse e pamundur të konstatohet një strukturë e mirëfilltë narrative me një fillim të qartë i cili do të nxiste interesimin e nxënësve, një mes ku do të elaborohej tema e njësisë mësimore dhe një përfundim i cili do t'i theksonte çështjet kryesore të temës dhe do t'i nxiste nxënësit për ta hulumtuar dhe mësuar më tutje temën.

Referencat

Halliday, M. A. K. & Hasan, R. (1976). *Cohesion in English*. Longman Group Limited London.

Halliday, M. A. K. & Hasan, R. (1989). *Language, text, and context: aspects of language in a social-semiotic perspektive*. Oxford University Press.

Schleppegrell, M. J. (2004). *THE LANGUAGE OF SCHOOLING A Functional Linguistics Perspective***.** LAWRENCE ERLBAUM ASSOCIATES, PUBLISHERS Mahwah, New Jersey London.

Rifat KRASNIQI

ACADEMIC LANGUAGE AND DISCOURSE

Abstract

This paper is an attempt to describe and assess the language and discourse that takes place in classes of citizenship education in the tenth grade of a high school in Pristina. Basically, the language used in the classroom is always academic as are the contents and the discourse developed during the education process. The paper, however, concludes that the language used in the class differs greatly from the language used in the textbook. The paper describes and assesses the manner in which discourse is produced and controlled by the teacher as well as linguistic tools used to

build cohesion and coherence. The use of discourse markers as well as discourse strategies that are used to facilitate understanding are also subject matter of this paper.

Key words and phrases: academic language, academic discourse, discourse analysis, cohesion, coherence, classes, students, teachers.

Anton PANÇEV

KONCEPTET E KOLONISË SHQIPTARE NË BULLGARI RRETH STANDARDIT DHE ALFABETIT TË SHQIPES NË FILLIM TË SHEK. XX

Hyrje

Dihet mirë se në fillim të shekullit të XX në kryeqytetin bullgar kanë gjetur strehë jo pak shqiptarë. Kolonia shqiptare në Bullgari, kryesisht në Sofje, por edhe në qytete të tjera, ka zhvilluar aktivitete të ndryshme në fushën e arsimit, të kulturës, të gazetarisë. Në këtë mënyrë, Sofja u kthye në qendër me rëndësi të gjithanshme për Rilindjen shqiptare. Rilindësit shqiptarë në Bullgari zhvilluan aktivitete të mëdha letrare, publicistike, përkthyese, politike. Sofja u bë qendër e rëndësishme edhe për emigracionin politik shqiptar. Ata nuk i injoruan çështjet e mëdha kombëtare të lidhura ngushtë edhe me zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare[1].

Në gazetat dhe në librat e botuar janë përdorur alfabete të ndryshme mbi bazën e latinishtes. Ndonëse mërgimtarët shqiptarë në Bullgarinë ishin kryesisht ortodoksë nga rajonet e Korçës dhe të Rekës, pra nën ndikimin e shkollave greke dhe respektivisht bullgare, nuk gjenden botime shqipe, të cilat kanë përdorur alfabetin grek dhe atë bullgar.

Njëra prej temave kryesore, e cila u vu në diskutim nga rilindësit shqiptarë, ishte ajo e përdorimit të varieteteve të shqipes në fusha të ndryshme publike. Shumica e veprimtarëve shqiptarë në Bullgari kanë qenë nga trojet juglindore shqiptare dhe për këtë arsye ata i kanë përdorur varietetet e toskërishtes në shkrimet e tyre dhe kanë përkrahur ngritjen e standardit të shqipes mbi veçoritë e këtyre varieteteve. Në domenin publik bullgar janë përdorur edhe disa varietete të gegërishtes. Shembulli më i mirë ka qenë veprimtaria letrare dhe publicistike e Josif Bagerit.

Punimi bazohet mbi hulumtimin e gjuhës së gazetave shqiptare si "Drita", "Shqypeja e Shqypënisë", mbi burime arkivore dhe veprat e rilindësve shqiptarë, të botuara në Bullgari në këtë periudhë. Nga fundi i shekullit të XIX dhe në

[1] Shih Бобев, Боби и Тома Кацори. Близката и непознатата Албания. София, 1998; Гюзелев, Боян. Албанци в Източните Балкани. София, 2004.

pesëmbëdhjetë vitet e para të shekullit të XX në Bullgari u botuan mbi 50 libra shqiptarë. Ata janë burim të çmueshëm jo vetëm me përmbajtjen e tyre dhe me trajtimin e çështjeve të ndryshme të politikës, të arsimit e tjera, por edhe me anën e tyre gjuhësore. Hulumtimi i gjuhës së shkruarit do të pasurojë varietetet e shqipes dhe bazës së saj dialektore. Rëndësi të veçantë në këto hulumtime kanë abetaret dhe gramatikat e shqipes, të cilat u botuan në Bullgari në këtë periudhë. Nuk duhet ta harrojmë punimet e Bojka Sokolovës në këtë fushë dhe kontributin e saj të çmueshëm veçanërisht me librin "Shtypi shqiptar i Rilindjes në Bullgari"[2]. Një punim tjetër me rëndësi për këtë temë është hulumtimi i Sokolovës për përkthimet dhe punimet letrare nga autorë shqiptarë në Bullgari[3].

Qëndrimet për alfabetin e shqipes

Rilindësit shqiptarë në Bullgari i kanë njohur mirë sistemet grafike dhe alfabetet e ndryshme, të cilat i kanë përdorur bashkëkombësit e tyre. Është fakt i njohur se autorët shqiptarë në Bullgari, qoftë gazetarë, qoftë shkrimtarë, përkthyes, kanë përdorur në shkrimet e tyre kryesisht Alfabetin e Stambollit. Ende në fund të shekullit XIX në Bullgari ka filluar botimi i abetareve të gjuhës shqipe nga shtypshkronja "Mbrothësia"[4]. Me Alfabetin e Stambollit është botuar abetarja e parë shqiptare në Stamboll dhe përdorej prej shoqatave në Bukuresht dhe në Sofje për botimet e tyre. Ky alfabet është përdorur kryesisht për tekstet shkollore, të cilat u kanë shërbyer shkollave të para shqiptare.

Natyrisht, ka pasur dallime në shkronjat e përdorura dhe variante të ndryshme të alfabetit, por baza e alfabeteve të përdorura buronte prej Sami Frashërit. Rilindësit shqiptarë në Sofje e kanë argumentuar përdorimin e këtij alfabeti. Në artikullin e tij "Shkrimi, këndimi, abetare e gjuhës shqipe" në gazetën "Drita" Shahin Kolonja ka prezantuar historinë e alfabeteve më të rëndësishme shqiptare dhe ka mbrojtur fuqishëm alfabetin e Sami Frashërit. Sipas tij, meritat më të mëdha të këtij alfabeti ka qenë origjinaliteti i tij, sepse Sami Frashëri ka përdorur 24 shkronja latine dhe ka shtuar 8 shkronja greke dhe sllave[5]. Njëri prej argumenteve, sepse Alfabeti i Stambollit duhej të bëhej alfabet kombëtar, sipas autorit, që ai ka pasur përhapje edhe në pjesët veriore të Shqipërisë.

[2] Соколова, Бойка. Албански възрожденски печат в България. София, 1979.
[3] Sokolova, Bojka. Roli i kolonisë shqiptare të Sofjes për zhvillimin e letërsisë shqipe në kohën e Rilindjes. Seminari mbi kulturën shqiptare për të huaj. Përmbledhje e ligjëratave të mbajtura në Seminarin e vitit 1977. Prishtinë, 1978, f. 233-245.
[4] S. H. F. Abetare. Sofje, 1899.
[5] Gazeta "Drita" 18 dhe 21 nëntor 1903, cituar sipas Bojka Sokolovës, f. 163-164.

Në këtë artikull Shahin Kolonja "veçonte tre faktorë që do të ndihmonin në përhapjen e shkrimit dhe të këndimit te shqiptarët e konkretisht:

- një palë shkronja të mira e të plota për gjuhën shqipe;
- vjersha të bukura e mësime të mira e të lehta që të merrem vesh e të pëlqehen;
- njerëz që t'i përhapin.

Sh. Kolonja kërkonte që alfabeti i shqipes të mos kishte asnjë lidhje dhe asnjë përngjasim me sistemet shkrimore të tjera. Për autorin "e mira e të mirave do të qe që gjuha shqipe të kishte një palë shkronja të veçanta, të mos kishin afërim as me shkronjat greko-latine, as me të tjerat, siç janë të armenëvet"[6].

Kolonia shqiptare në Sofje ka qenë mjaft aktive në përgatitjet dhe në zhvillimet e punimeve të Kongresit të Manastirit. Ata i kanë shprehur pikëpamjet e tyre rreth alfabetit në këtë forum kaq të rëndësishëm për kulturën shqiptare. Pjesëmarrës prej Sofjes kanë qenë personalitete të shquara si Dhimitër Mole, Adam Shkaba, Thoma Avrami. Nuk duhet të harrojmë se edhe Mithat Frashëri, Shahin Kolonja, Grigor Cilka, Kristo Luarasi dhe të tjerë ka qenë të lidhur me koloninë shqiptare në Sofje, kanë jetuar në kryeqytetin bullgar, kanë botuar libra dhe gazeta atje. Përfaqësuesit e kolonisë shqiptare në Bullgari i kanë pranuar vendimet e Kongresit të Manastirit, por kanë vazhduar të përdornin varietete të ndryshme të alfabetit të Stambollit[7].

Gazeta "Shkypeja e Shkypënis" ka publikuar materiale teorike në faqet e saj, në të cilat bëheshin karakteristika për situatën gjuhësore dhe për çështjet e alfabetit pas "Kongresit të Alfabetit" në Manastir. Ndiqej fati i të dyja alfabeteve të pranuara në këtë Kongres, çështja për afirmimin e tyre dhe shkalla e adaptimit të njërit ose të tjetrit variant.

Për zhvillimet rreth çështjes së alfabetit pas Kongresit të Manastirit gazetat shqiptare në Bullgari janë një burim i çmueshëm. Unanimisht gazetat shqiptare në Sofje e kanë përkrahur alfabetin mbi sistemin latin dhe kanë shprehur kategorikisht kundër përpjekjeve për përdorimin e shkronjave arabe. Faqet e gazetave kanë qenë të plota me lajme prej trojeve shqiptare për luftën e popullit në mbrojtje të alfabetit shqiptar.

Qëndrimet për standardin e gjuhës

Çështjet dhe problemet e standardizimit të gjuhës shqipe gjithashtu kanë zhvilluar diskutime të shumta në koloninë shqiptare në Bullgari. Mund të bëhen disa përfundime rreth arritjeve të këtyre debateve:

[6] Cituar sipas Tomor Osmanit. Shtypi shqiptar për njësimin e alfabetit të shqipes 1888-1908. 100-vjetori i Kongresit të Manastirit. Tiranë, 2009, f. 76.

[7] Соколова, Бойка. Албански възрожденски печат в България. София, 1978, f. 164.

1) Në faqet e gazetave shqiptare në Bullgari realizohej një veprimtari sistematike për konsolidimin e gjuhës amtare; formuloheshin rregullat e drejtshkrimit; ka pasur thirrje për evitimin e formave të skajshme dialektore; ka pasur debate rreth dallimeve dialektore, huazimeve prej gjuhëve të huaja, neologjizmave. Ndonëse kanë përkrahur kryesisht dialektin jugor (tosk), gazetat shqiptare në Bullgari kanë publikuar materiale, të shkruara në dialekte të ndryshme. Botuesit nuk i kanë ndryshuar dhe redaktuar nga karakter gjuhësor dhe në gazetat publikoheshin në formën e tyre origjinale gjuhësore. Këto gazeta e kanë përkrahur dialektin jugor, si edhe në shumë materiale kanë diskutuar rreth veçorive të tij më karakteristike dhe kanë bërë thirrje për përdorimin e këtyre të folmeve.

2) Vetëm gazeta "Shkypeja e Shkypënis" është shkruar plotësisht në të folmen gegërishte dhe e ka propaganduar dialektin verior. Në faqet e kësaj gazete shprehej qartë tendenca të imponoheshin të folmet gege.

3) Mbrojtja e idesë për përdorimin e elbasanishtes si baza e standardit, sepse "kuptohej nga të gjithë".

Me rëndësi të madhe për kuptimin e ideve të rilindasëve shqiptarë në Bullgari rreth standardizimit janë disa artikuj në gazetën "Drita". Në artikullin "Për ruajtjen e gjuhës" gazeta "Drita" ka vënë si detyrë kryesore "anashkalimi i dallimeve dialektore dhe bashkimi i dialekteve" (31 mars 1902). Në këtë material është bërë thirrje që të mos përdoreshin format e skajshme dialektore edhe nga jugu (si *di, ill, ilver*), edhe nga veriu (si *kam dash, mret*). Autori ka përkrahur përdorimin e formave gege pa rotacizëm (venë, ardhur), por ka qenë në mendim se gjuha shqipe duhej të bazohej kryesisht mbi dialektin tosk. Ka bërë thirrje që të shkruhet kështu si po flitet, pra të përdoret transkribimi fonetik i gjuhës shqipe, si të përdoret gramatika e Sami Frashërit. Në këtë artikull janë prezantuar disa rregulla gramatikore, të cilave duhej t'u përmbaheshin bartësit e gjuhës shqipe: 1. Pas përemrave të pacaktuar ca, disa, një përdoret gjithmonë forma e pacaktuar: pash një njeri; 2. Mbiemrat e nyjshëm duhet gjithmonë të përdoren me nyjat: mali i lartë, fusha e gjerë, derisa ka përdorime prej disa autorëve pa nyjat e nevojshme; 3. –Ë- e patheksuar të shkruhet në fund të fjalës: pinë, hanë, rrojnë.

Në artikullin "Gramatika shqiptare" autori ka refuzuar ekzistimin e një dallimi të madh mes të dyja dialekteve shqiptare dhe drejtshkrimit të tyre (Drita, numër 35, 1903). Mbrohet teza se pavarësisht nga kushtet e ekzistimit të popullit shqiptar në epokën e pushtimit osman, gjuha shqipe e ka ruajtur bashkësinë e saj dhe veçoritë e dialekteve nuk janë me rëndësi. Sipas autorit, të folmet e gegërishtes kanë qenë më të diferencuara sesa format jugore, dhe ky fakt ka qenë në favor të standardizimit mbi të folmet e toskërishtes. Objekt i Analizës kanë qenë edhe dallimet mes dialektit gegë të qytetit të Shkodrës dhe formave të katundeve gege.

Janë bërë edhe disa supozime për zhvillimin e gjuhës: 1. Të mos shkruhen zanore të dyfishta për shënimin e zanoreve të gjata; 2. Për numrin shumës: bari-barinj (jo barij), i ri-të rinj (jo të rij); 3. Foljet joveprore të formojnë kohën e kryer me foljen ndihmëse jam dhe jo me kam; 4. Parafjala prej të përdoret në këtë formë por jo me formën preje.

Në gjashtë artikuj të njëpasnjëshme me titullin e përbashkët "Gramatika shqiptare" dhe "Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe" është dhënë morfologjia e gjuhës shqipe. Faktikisht kjo ka qenë gramatika e Sami Frashërit por me shumë plotësime, përpunime dhe opinione për shumë çështje të filologjisë. Theksi në këta artikuj ka qenë mbi formimin e numrit shumës të emrave. Janë analizuar kategoritë e ndryshme gramatikore sipas dialektit tosk, por në përgjithësi këto kanë qenë edhe rregullat e dialektit verior, sepse në këtë periudhë dallimet gramatikore mes të dyja dialekteve kanë qenë të parëndësishme, derisa dallimi mes tyre ka qenë kryesisht në fushën e fonetikës. Dallimet në format gramatikore mes dialekteve janë analizuar në hollësi. Janë refuzuar disa forma të gegërishtes: reduktimi i zanores së patheksuar –ë- në fund të fjalës, asimilimi i –mb- në –m (mb>m), formimi i formës së shquar të emrave mashkullorë në g, k, h me nyjën shquese –i- në vend të –u-, etj.

Në shumë shkrime dhe artikuj është mbrojtur parimin e pastërtisë së gjuhës shqipe. Pastrimi i fjalëve të huaja të panevojshme shihej si detyrë kryesore nga rilindësit shqiptarë në Bullgari. Ata ishin në mendje, se gjuha duhet të pasurohet dhe të zgjerohen mundësitë e saj shprehëse kryesisht përmes krijimit të neologjizmave sipas "rregullave të filologjisë", pra të formohen fjalë të përbëra sipas rregullave të brendshme të gjuhës. Ata kanë mbështetur pasurimin e gjuhës përmes fjalëve nga dialektet e shqipes, sepse, shumë fjalë prej gegërishtes nuk i kanë ditur banorët e krahinave toske dhe të kundërtën. Sipas tyre, kjo pasuri leksikore duhet të përdoret për zhvillimin e standardit.

Përpjekjet për hulumtime dhe shpjegime shkencore

Në këto rrethana shoqërore dhe kulturore kanë filluar edhe përpjekjet e para te shqiptarët e Bullgarisë për zhvillimin e hulumtimeve shkencore në fushën e gjuhësisë. Pranimi i alfabetit dhe debatet rreth standardit të gjuhës shtynin gazetarët dhe publicistët shqiptarë të kërkonin shpjegime për origjinën e gjuhës shqipe, për lashtësinë e saj, për lidhjet me gjuhët e tjera ballkanike dhe indoevropiane, për burimet e gjuhës etj. Këtu mund ta përmendim emrin e Lazar Siljanit, shqiptar prej Rekës, i cili ka shkruar disa libra në fushën e gjuhësisë: „Кои са днешните албанци и техния език", София, 1910 ("Cilët janë shqiptarët e sotëm dhe gjuha e tyre") në bullgarisht

që ta njihte publikun bullgar me shqiptarët dhe "Aferimi i bulgarishtea sotme me gjuhen shqip", Sofja, 1911 në shqip. Ai ka bërë përpjekje për shpjegimin e gjuhës shqipe dhe për lidhjet e saj me gjuhët e tjera indoevropiane. Në veprat e tij Siljani e ka përdorur alfabetin latin, pa shkronjën "rr", por me shkronjën "sht" dhe "ch" në vend të "ç". Sipas Siljanit, gjuha shqipe ka qenë gjuha e racës ariane dhe përmes shqipes mund të shpjegoheshin shumë fjalë dhe emërtime të lashta. P.sh.: arian – ar-injë (pra "bujq") – f. 8, Azia – a zi-ja (pra "e zeza"), E-gjypet – gjyp (pra "rom"), Memfis – mëm-fis (pra "fisi i nënës") – f. 10, far-e jôn (pra "faraon"), pellg-as – pellg – f. 11, Epër – Epir – f. 12, E Madheja – Maqedonia, Ar-bënës – arbër (pra "bujk"), Trashë – Thrakës, Delës – ishulli Delos (pra "del")[8].

Natyrisht, këto ishin shpjegime shumë naive dhe joshkencore, por kanë qenë të rëndësishme për zhvillimin e interesimit rreth prejardhjes së gjuhës shqipe dhe lidhjeve të saj me gjuhët e tjera indoevropiane dhe ballkanike. Autori ka përkrahur konceptin se vetëm me hulumtime krahasimtare mund të zhvilloheshin studimet e mirëfillta të shumë çështjeve të gjuhës shqipe.

Përfundime

Në këtë punim është bërë përpjekje për prezantimin dhe analizimin e pikëpamjeve të rilindësve shqiptarë në Bullgari rreth alfabetit dhe standardit të gjuhës shqipe në fillim të shek. XX. Ata kanë krijuar një pasuri të madhe prej shkrimeve në fusha të ndryshme të arsimit, publicistikës, kulturës. Një vend të rëndësishëm kanë zënë diskutimet për gjuhën shqipe dhe për alfabetin. Rilindësit shqiptarë në Bullgari herët kanë kuptuar nevojën prej një standardi të përbashkët dhe për alfabet të njësuar. Pikëpamjet e tyre rreth këtyre çështjeve, të shprehura drejtpërdrejt, ose përmes gjuhës së gazetave, të librave të tyre, të cilët botoheshin në Bullgari, kanë pasuruar dhe kanë ndihmuar proceset unifikuese në këtë fushë. Është e kuptueshme se qëndrimet e intelektualëve shqiptarë për standardin e nevojshëm, kanë qenë të lidhura ngushtë me prejardhjen e tyre krahinore dhe me kontaktet e tyre me kolonitë shqiptare në Stamboll dhe në Bukuresht. Intelektualët shqiptarë në Bullgari e kanë përdorur dhe e kanë përkrahur Alfabetin e Stambollit të Sami Frashërit. Botimi i shpeshtë dhe i vazhdueshëm i gazetave shqiptare në dialektin tosk në Bullgari, bashkë me veprimtarinë në fushën e gjuhës si edhe shumë faktorë të tjerë, kontribuan për krijimin e një baze të gjerë të dialektit tosk me përfshirjen e elementeve të gegërishtes[9]. Përveç kontributeve në fushën e gjuhës shqipe, nuk duhet ta harrojmë edhe punën e tyre për

[8] Силяни, Лазар. Кои са днешните албанци и техния език. София, 1910, f. 8-12.
[9] Соколова, Бойка. Албански възрожденски печат в България. София, 1978, f. 173.

mbrojtjen e kauzës shqiptare. Me veprimtarinë e kolonisë shqiptare opinioni bullgar njihej me problemet dhe me arritjet e çështjes shqiptare jo vetëm në fushën e politikës por edhe në sferën e kulturës, të arsimit, dhe të shkencës.

Kolonia shqiptare në Bullgari i pushoi aktivitetet e tyre pas Shpalljes së Pavarësisë të Shqipërisë sepse shumica e shqiptarëve u kthyen në Shqipëri për të punuar për shtetin e pavarur shqiptar. Por punimet e tyre dhe veprimtaria e tyre publicistike, shkencore, letrare etj., vazhdon të jetë thesar i madh për albanologjinë.

Bibliografi

Бобев, Боби и Тома Кацори. Близката и непознатата Албания. София, 1998.

Гюзелев, Боян. Албанци в Източните Балкани. София, 2004.

Силяни, Лазар. Кои са днешните албанци и техният език. София, 1910.

Соколова, Бойка. Албански възрожденски печат в България. София, 1979.

Berani, Shaqir. Gjuha e Josif Bagerit. Prishtinë, 1988.

Grammatica apo folmarmja shqype per shkolla te para te shqypnise: Prej Shoqnise "Dija" ne Vjene Sofia: shtyp. Mbrothesija, 1912.

Osmani, Tomor. Shtypi shqiptar për njësimin e alfabetit të shqipes 1888-1908. 100-vjetori i Kongresit të Manastirit. Tiranë, 2009.

S. H. F. Abetare. Sofje, 1899.

Skendo, Lumo. Metode praktike per te mesuare shpejt me lehte / Franz Ahn ; Gjuha inglisht. Shqiperuare prej София : Mbrothesija, 1908.

Sokolova, Bojka. Roli i kolonisë shqiptare të Sofjes për zhvillimin e letërsisë shqipe në kohën e Rilindjes. Seminari mbi kulturën shqiptare për të huaj. Përmbledhje e ligjëratave të mbajtura në Seminarin e vitit 1977. Prishtinë, 1978, f. 233-245.

Shtojca

S. H. F. Abetare. Sofje, 1899.



ABECEJA GQIII

L'ALFABET ALBANAIS

TO AABANIKON AAΦABHTON

Gqip.	Fren.	Greq.	Gemb.
A, a	a	α	ar
B, b	b	μπ	bar
C, c	ts	τσ	cope
Ç, ç	tch	τς	çap
D, d	d	ντ	daɛ
Ð, ð	dh	δ	ðê
E, ɛ	é	ɛ	ɛðɛ
Ë, e	e	η	enɡeλ
F, f	f	φ	frike
G, g	g	γ[α]	gale
Γ, ɣ	gue	γɛ	ɣarper
H, h	h	χ	hale
I, i	i	ι	i mire
J, j	ya	ι	jave
K, k	k	κ	kiɛe
L, l	l	λ[ɛ]	laker
Λ, λ	lh	λα	λambe
M, m	m	μ	meme

Gqip.	Frɛn.	Greq.	Gemb.
N, n	n	ν	nate
И, ɳ	gn	νι	ɳɛri
O, o	o	ο	ore
П, p	p	π	pule
Q, q	q	χ[ɛ]	qɛn
R, r	r	ρ	rip
P, p	rr	ρρ	pap
S, s	s	σ	sy
Ш, ɕ	sch	σσ	ɕale
T, t	t	τ	trim
Θ, ð	th	θ	ðane
U, u	ou	ου	uše
V, v	v	β	vaðe
X, x	dz	ντς	xbaðure
Ж, ж	dj	δς	жami
Y, y	u	υ	yλ
Z, z	z	ς	zemere
Ƶ, ƶ	j	ςι	ƶapik

Grammatica apo folmarmja shqype per shkolla te para te shqypnise: Prej Shoqnise "Dija" ne Vjene Sofia: shtyp. Mbrothesija, 1912.



Të dy alfabetat shqyp.

Të dorës e të shtypit, të vogla e të mbëdha.

I bashkumi				I njejti				I bashkumi.				I njejti.			
a	*A*	a	A	*a*	*A*	a	A	*n*	*N*	n	N	*n*	*N*	n	N
â		â						*nj*	*Nj*	nj	Nj	*ɲ*	*И*	ɲ	И
b	*B*	b	B	*b*	*B*	b	B	*o*	*O*	o	O	*o*	*O*	o	O
c	*C*	c	C	*c*	*C*	c	C	*ô*		ô					
ç	*Ç*	ç	Ç	*ç*	*Ç*	ç	Ç	*p*	*P*	p	P	*p*	*P*	p	P
d	*D*	d	D	*d*	*D*	d	D	*q*	*Q*	q	Q	*q*	*Q*	q	Q
dh	*Dh*	dh	Dh	*đ*	*Ꮷ*	đ	Б	*r*	*R*	r	R	*r*	*R*	r	R
e	*E*	e	E	*e*	*E*	e	E	*rr*	*Rr*	rr	Rr	*rr*	*Rr*	rr	Rr
ê		ê						*s*	*S*	s	S	*s*	*S*	s	S
ë	*Ë*	ë	Ë	*ɛ*	*Ɛ*	ɛ	Ɛ	*sh*	*Sh*	sh	Sh	*ɕ*	*Ꮯ*	ɕ	Ꮯ
f	*F*	f	F	*f*	*F*	f	F	*t*	*T*	t	T	*t*	*T*	t	T
g	*G*	g	G	*g*	*G*	g	G	*th*	*Th*	th	Th	*ā*	*Ꮎ*	ā	Ꮎ
gj	*Gj*	gj	Gj	*ɡ*	*Ꮐ*	ɡ	Г	*u*	*U*	u	U	*u*	*U*	u	U
h	*H*	h	H	*h*	*H*	h	H	*û*		û					
i	*I*	i	I	*i*	*I*	i	I	*v*	*V*	v	V	*v*	*V*	v	V
î		î						*x*	*X*	x	X	*x*	*X*	x	X
j	*J*	j	J	*j*	*J*	i	J	*xh*	*Xh*	xh	Xh	*ɤ*	*Ꮧ*	ɤ	Ꮧ
k	*K*	k	K	*k*	*K*	k	K	*y*	*Y*	y	Y	*y*	*Y*	y	Y
l	*L*	l	L	*l*	*L*	l	L	*ŷ*		ŷ					
ll	*Ll*	ll	Ll	*ƛ*	*Ʌ*	ƛ	Λ	*z*	*Z*	z	Z	*z*	*Z*	z	Z
m	*M*	m	M	*m*	*M*	m	M	*zh*	*Zh*	zh	Zh	*ʒ*	*Ꮓ*	ʒ	Ꮓ

Kjo librë âsht shtypun me alfabetin e bashkumun.

Anton PANÇEV

THE CONCEPTS OF ALBANIAN COLONY IN BULGARIA ABOUT THE ALBANIAN LANGUAGE STANDARDISATION AND ALPHABET AT THE BEGINNING OF THE XX CENTURY

Abstract

The Albanian colony in Bulgaria, mainly in Sofia, but also in other cities, has developed various activities in the field of education, culture as well as journalism. Thus, Sofia became a center of imense importance for Albanian Renaissance. One of the main topics discussed was the one raised by Albanian Renaissance activists about using varieties of Albanian in various public areas. Most of the Albanian activists in Bulgaria have been from the southeastern part of Albanian; therefore, they used the Tosk varieties in their writings and supported the rise of the Albanian standard above the characteristics of these varieties. Some varieties of Gheg Albanian are used in the Bulgarian public domain, too. The best example was Josif Bager's literary and publicist activity. This paper presents and analyzes the views of Albanian Renaissance activists in Bulgaria about the alphabet and standard of Albanian language at the beginning of the XX century. The paper is based on the research of the language of Albanian newspapers such as "Drita", "The Albanian Language of Albania", etc., on archival sources and works of Albanian Renaissance activists published in Bulgaria during this period.

Ardita BERISHA - Kadire BINAJ

DO TË PUNOJ DHE *DO PUNUAR* – MODALITETI DHE REFERENCAT KOHORE

Abstrakt

Folja modale *do*mund t'i ndërtojë dy struktura foljore *do* + folja në lidhore: *do të punoj* dhe *do* + pjesore: *do zgjidhur*. Ndonëse të dyja strukturat foljore paraqesin referencë kohore të futurit, në gramatikën e shqipes (ASHASH, 2001) si e tillë trajtohet vetëm e para. Duke qenë se paraqesin futuritet, ato janë të shenjuara edhe për nuancat modale që i përmbajnë. Kështu fjalia *Genci do tëmarrë pjesë në garë.,* shenjon një veprim ireal, veprim që pritet të aktualizohet pas momentit të ligjërimit. Në rrafshin modal folja modale *do*mund të interpretohet në disa mënyra: - si epistemike, duke e shprehur bazën e vërtetësisë për vlefshmërinë e këtij propozicioni,folësi e shpreh një përfundim të tij duke u nisur nga njohuritë që i kapër faktorët kontekstualë: *Genci do të marrë pjesë në garë (meqë çdo herë merr pjesë në gara të tilla),* por ajo mund të interpretohet edhe si deontike, si detyrim – kur subjekti (Genci) detyrohet që të marrë pjesë në garë. Nëse në këtë fjali folësi është ai që e lejon subjektin që të marrë pjesë në garë, atëherë fjalia mund të interpretohet si deontike që shpreh lejim.Në fjalinë *Genci do ta kalojë Agonin në garën* e *vrapimt* – folja*do*shpreh modalitet dinamik, aftësinë e Gencit për ta kaluar Agonin. Megjithatë, struktura foljore *do të punoj,* jo çdo herë përmban referenca të futurit: *(Tani) Ajo do të jetë në shtëpi* (meqë makinën e ka në oborr). -folësi shpreh një hamendësim, duke u mbështetur në disa të dhëna të njohura për të. Presupozohet një bazë vërtetësie, por është në nivel supozimi – rrjedhimisht, shprehet modalitet i dobët epistemik.Të qenurit e saj në shtëpi i referohet momentit në të cilin ai është duke folur d.m.th.shprehet referencë kohore e së tashmes. Sintagma *dozgjidhur*shpreh gjithnjë shpreh referencë kohore të futurit: *Kjo çështje do zgjidhur shpejt* – veprimi do të aktualizohet në të ardhmen. Duke qenë se në këtë fjali folja *do* thekson domosdoshmërinë e faktit se çështja duhet zgjidhur ajo shenjon modalitet deontik, e brenda deontikut gjithnjë shenjon detyrim.

Fjalët çelës: *do*, *modalitet, futur, epistemik, deontik, dinamik*

Folja modale *do*

Në këtë studim synohet që të paraqitet modaliteti dhe referencat kohore që shenjohen me anë të këtyre dy strukturave foljore: *do të punoj* dhe *do punuar.*

Do – në strukturën *do* + lidhore do të trajtohet si folje modale, ashtu si në strukturën *do* + pjesore. Në gramatikat e gjuhës shqipe (ASHASH, 2002; Demiraj; 1994, Beci, 2002; etj)*do* konsiderohet si pjesëz prejfoljore modale, e cila shërben për ta ndërtuar trajtën gramatikore të kohës së ardhme: *do* + lidhore.Kjo trajtë e së ardhmes ka dalë nga gramatikalizimi i perifrazës *dua* + lidhore: *dua të punoj – do të punoj* (B.Bokshi, Sh. Demiraj, K.Topalli, Likaj, Mansaku, Ajeti, B. Demiraj etj.).

Në strukturën *do* + lidhore, në përdorimin më tipik të saj, *do* shpreh vullnet, dëshirë:

1. *Ne **do të shkojmë** në Londër vitin e ardhshëm.*
2. *Ne **mund të shkojmë** në Londër vitin e ardhshëm, por nuk e dime se a do të nai japin vizat.*
3. *Ne **duhet të shkojmë** në Londër vitin e ardhshëmqë të marrim pjesë në garë.*

Kështu, kur e krahasojmë strukturën *do* + lidhore me strukturat e ndërtuara me foljet e tjera modale *mund* dhe *duhet*, do të shohim se ato dallojnë nga njëra tjetra vetëm për nuancat modale të ndryshme që i shprehin, por si strukturalisht ashtu edhe semantikisht ato janë të afërta me njëra - tjetrën.Të tre shembujt e marrë e ilustrojnë shprehjen e parashikimit/qëllimit/ dëshirës së folësit për një veprim që pritet të aktualizohet, shoqëruar me nuanca të ndryshme modale.

Në shembullin 1 veprimi që parashihet të ndodhë në të ardhmen është i shoqëruar me dëshirën apo vullnetin e folësit (zgjedhja që folësi të shkojë në Londër dhe jo në Paris varet nga vullneti i tij dhe mund të interpretohet si një përfundim ivullnetshëmi tij); në shembullin 2 parashikimi i folësit për aktualizimin e veprimit është i shoqëruar me pasigurinë e tij(ne ndoshta mund të shkojmë në Londër, por ende nuk e dimë sigurt), ndërsa në fjalinë 3 shkuarja në Londër tanimë është një vendim i prerë që domosdoshmërisht duhet të realizohet (p.sh. duhet të shkojmë atje, sepse jemi të obliguar). Përderisa në shembujt 1 dhe 2 shprehet modalitet epistemik, shembulli 3 shpreh modalitet deontik.

1.1. *Do* + pjesore dhe *do* + lidhore, referencat kohore dhe modaliteti

Folja *do*me foljen *duhet* janë shumë të afërta edhe për faktin se të dyja mund të lidhen edhe me lidhoren edhe me pjesoren:

4. *a) do* + pjesore
Ajo çështje do zgjidhur që sonte.
b) do + lidhore
Ajo çështje do të zgjidhet që sonte.
c) duhet + pjesore
Ajo çështje duhet zgjidhur që sonte.
ç) duhet + lidhore
Ajo çështje duhet të zgjidhet që sonte.

Ndonëse të dyja strukturat paraqesin referencë kohore të futurit, në gramatikat e shqipes (Demiraj, 1995; ASHASH, 2001, Beci, 2002,) si e tillë trajtohet vetëm e para:

5. *Genci* ***do të marrë*** *pjesë në garë.*
6. *Ajo çështje* ***do zgjidhur*** *shpejt.*

Në të dyja fjalitë strukturat foljore të ndërtuara nga modalja *do* paraqesin veprime ireale, që pritet të aktualizohen pas momentit të ligjërimit. Rrjedhimisht këto struktura foljore shërbejnë si shenjuese të futurit.

Fakti që në rastin e futurit kemi të bëjmë me pritje/parashikim/planifikim të folësit për diçka që do të ndodhë në të ardhmen dëshmon që këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me referencë kohore. Pritja, parashikimi apo planifikimi që të ndodhë diçka janë të shoqëruara me dëshirë e vullnet, me dyshime e pasiguri. Për këtë arsye shumë gjuhëtarë (Lyons, 2001:284; Huddleston, 2002:108; Bybee, Perkins & Pagliuca, 1994:244; Palmer, 2001:286) futurin nuk e konsiderojnë kohë.

Pasi që futuri gjithnjë bart nuanca të caktuara modale (si mundësi, domosdoshmëri) Lyonsi (2001:286) thotë se në rastin e tij kemi të bëjmë me gërshetimin e të dy kategorive, aq sa kemi të bëjmë me kohë, po aq kemi të bëjmë edhe me mënyrë.

Futuri është më pak kategori e kohës, por që përmaban në vete implikime të rëndësishme kohore dhe qëndron më afër kategorive të tilla siç është kategoria e modalitetit e orientuar nga folësi dhe e modalitetit epistemik (Bybee, Pagliuca, 1994:280, Dahl, 1985).

Huddleston (2002:208) po ashtu këtë kategori nuk e konsideron pjesë të sistemit tresh të kohës por e trajton si modalitet.

Së këndejmi, strukturat foljore *do të punoj*dhe *do punuar* duke qenë se shenjojnë veprime që priten/parashihen/planifikohen të aktualizohen në të ardhmen janë të shenjuara edhe për nuancat e tyre modale që i përmbajnë.

Përderisa në strukturën *do* + pjesore*, do* gjithnjëe shpreh domososhmërinë për kryerjen e veprimit që d.t.th. se ajo realizohet si një deontike e fortë, në strukturën *do të shkojë*, *do* mund të shprehë nuanca të ndryshme modale, varësisht nga konteksti.

Do +pjesore gjithnjë shpreh referencë kohore të futurit. Në rrafshin modal, duke qenë se shpreh domosdoshmëri, folja modale *do* në këtë strukturë realizohet si deontike. Këtu ajo është e afërt me strukturën *duhet* + pjesore qoftë në rrafshin modal, qoftë për referencat kohore që i shpreh.Përderisa struktura *do* + pjesore është karakteristike më shumë për gjuhën e folur, struktura *duhet* + pjesore është karakteristike më shumë për gjuhën e shkruar.Këtë e mbështet edhe fakti që në korpusin qëështë hulumtuar *do* + pjesore në gazetë nuk është përdorur asnjëherë, ndërsa në dramën "Loja e mbasdrekës", e cila ka karakteristika të gjuhës së folur, meqë realizohet në formëtë dialogëve, është përdorur 5 herë. Edhenë romanin "Djella" do + pjesore është gjetur vetëm 1 herë:

7. *Por ata që u kandej mishi i pjekun e rakia i thanë se fjala e të vdekunit* ***do përmbushë (= duhet përmbushë***). (Loja e mbasdrekës, 2012:74)
8. *Por* ***do vue*** *(= duhet vue) në detyrë mirë se, sikur Zeka qe shkaktar i parë në* …(Loja e mbasdrekës, 2012:110)

Foljet modale karakterizohen nga polisemia semantike.Duke pasur parasysh këtë fakt Badran (2002:114-115) për interpretimin e modaleve propozon qasje të cilat mbështeten në kontekst siç është qasja funksionale e Hallidayt (1970) dhe e Johannessonit (1978).

Mirëpo, kjo polisemi e tyre varet edhe nga anëtarët e tjerë të strukturës. P.sh. foljet modale *do* dhe *duhet*kur bashkohen me pjesore gjithnjë shenjojnë modalitet deontik, por kjo nuk ndodh çdo herë kur ato bashkohen me lidhoren. Kështu, folja modale *do* në strukturën *do* + lidhore mund të shprehë modalitete të ndryshme. Në qoftë se i analizojmë shembujt e paraqitur mëposhtë, do të shohim se në rrafshin modal struktura *do* + lidhoremund të interpretohet në disa mënyra:

9. *Shkolla e restauruar* ***do të jetë*** *aset plotësues për gjimnazin "Loyola" … (f. 13*)

Si epistemike, duke e shprehur bazën e vërtetësisë për vlefshmërinëe propozicionit.Në shemb. 9 folësi me anë të strukturës *do* + lidhore shpreh përfundimin e tij duke u nisur nga njohuritë që i ka për faktorët kontekstualë: duke qenë se ekziston gjimnazi "Loyola", shkolla e restauruar do të jetë aset plotësues për të.Në rrafshin kohor shprehen referenca të futurit.

Nisur nga fakti që në korpusin e hulumtuar struktura *do* + lidhore si epistemike, si përfundim i folësit është gjetur 99% të rasteve mund të thuhet se kyështë përdorimi

tipik i saj. Nëse i referohemi Palmerit (2001:24), në këtë rast kemi të bëjmë me një konkluzion, ndërsa sipas termeve të Hallidayt (1970), duke qenë se kemi të bëjmë me presupozim që është rrjedhojë e konkluzioneve të caktuara, kemi të bëjmë me një shkallë të lartë të bazës së vërtetësisë.

Do + lidhore kur shpreh referencë kohore të futurit apo të një futuri të së shkuarës mund të shprehë edhe supozim kur bashkëvepron me një pjesëz modale dyshuese si *ndoshta*, *mbase* etj. Në të tilla përdorime baza e vërtetësisë për atë që e thotë folësi është në shkallëmëtë ulët, nëshkallë supozimi:

10. ***Ndoshta*** *nuk* ***do t'i jetë dukur*** *si shtëpia e fëmijërisë, por tani e tutje ajo është pikë refernce për vizitorët në Gjirokastër. (f. 22)*
11. *(Sipas pohimeve)version i kartelës grafike për laptopët nuk* ***do të duhej*** *të dallojë shumë sa u përket performancave.(f. 34)*

Fakti se ajo nuk do t'i jetë dukur si shtëpia e fëmijërisë është një parashikim i folësit, rrjedhojë e njohurive të tij kontekstuale, meqë shtëpia e fëmijërisë së tij ndryshonte nga ajo e renovuara, por është ndajfolja *ndoshta* që jep karakter supozimi. Këtu paraqitet një supozim i pavërtetuar me referencë kohore në të shkuarën.Pastaj, shemb. 11 paraqetnjë supozim: *nuk do të duhej* = megjithatë, pritet të shihet se si do të jetë.

Ndërsa në shemb.12 *do* + lidhore në apodozën e kësaj strukture kushtore shpreh një veprim të ardhshëm në të shkuarën i cili varet nga kushti i paraqitur në protazë.Rrjedhimisht, paraqitet një veprim i parealizuar, meqë kemi të bëjmë me një kusht të mbyllur, të paplotësuar në të shkuarën. Sipas Huddlestone (2002:85) këtu kemi të bëjmë me largësi modale (remote):

12. *Po të doja të arsyetoja një sjellje të këtillë* ***do të thosha*** *se kemi të bëjmë me njerëz të akomoduar me jetën ushtarake… (f. 10)*

Megjithatë, *do* + lidhore mund të interpretohet edhe si deontike, si detyrim që buron nga një faktor i jashtëm për kryerjen e veprimit të caktuar (Palmer, 2001:71-77; Huddlestone & Pullum, 2002;). Këtu,(shemb. 14) folësi e urdhëron subjektin që ta realizojë një veprim të caktuar:

13. *Këtu****do të ndaloni*** *të gjithë …. tha ai prer*ë.

Do në strukturën *do*+ *lidhore* në shumicën e përdorimeve të saj në korpusin e hulumtuar(në 90% të rasteve) realizohet si epistemike duke shprehurgjendje faktike të situatës. Kështu, ajo e shpreh një shkallë të lartë të bazës së vërtetësisë, por për modalitetin që e shpreh është më e dobët se sa modalet e tjera *mund* dhe

duhet.Huddlestone (2002:176-177) flet për fuqinë semantike dhe fuqinë pragmatike të modaleve. Kështu, modalja *must* që në pëdorimin tipik të saj është një modale e fuqishme semantikisht (kur shpreh urdhër, detyrim) (a), kur përdoret për të shprehur një propozim, atëherë ajo pëson një dobësim pragmatik (b):

a) *You must come in immediately.*

b) *You must have one of these cakes.*

Në këtë mënyrë edhe modalja *do*në rastet si në shembullin e 13-të, ku *do* + lidhore shpreh një urdhër,ajo ka pësuar një forcim pragmatik.

Halliday (te Badran, 2002:85) e bën dallimin midis modalitetit dhe modulimit. Kjo shprehje e detyrimit, sipas termave të Hallidayt konsiderohet si modulim. Kështu, përderisa termi modalitet i referohet vlerësimit të folësit për propabilitetin (i cili përfshin mundësinë dhe sigurinë) dhe parashikueshmërinë, modulimi nuk ka të bëjë me qëndrimin apo përfshirjen e folësit në aktin e të folurit, por ka të bëjë me shprehjen e dëshirës së tij ndaj diçkaje e cila pastaj përmban në vete koncepte të tilla si aftësi, prirje, leje, detyrim apo edhe shtërngim për të bërë diçka.

Te modulimi, sipas termeve të Hallidayt, hyn edhe lejimi.Ndërsa sipas Palmerit (2001:71-77), Huddlestonit (2002), lejimi është pjesë e modaliteti deontik. Në strukturën *do* + lidhore,*do* mund të shprehë lejmimin e folësit për subjektin që ta bëjë një veprim të caktuar:*Do të hysh kur të lejoj unë*. Edhe pse, e njëjta fjali mund të interpretohet edhe si urdhër e detyrim:

14. Gjyqtari:

Ashtë e drejtë e tyne, leni! (Në tallje) Do të thom unë se kur ***do të hysh****(=kur t*ë lejoj të hysh) *në veprim! Rri qetë e mpreh thikat e tua… (f.72)*

Megjithatë, me strukturën foljore *do të punoj* jo çdo herë shenjohen referenca të futurit. Lyonsi (2001:289) duke folur për futurin në gjuhë si anglishtja, gjermanishtja etj.thotë se foljet modale si *will*, *shall* dhe *werden* nuk duhet t'i referohen patjetër së ardhmes. Përdorim karakteristik i tyre është edhe shprehja e hamendjes: *He will be quite a big boy now.*

Kështu, edhe në gjuhën shqipe *do* në*do* + lidhore mund tëpërdoret edhe për të shprehur referenca kohore jofuture, referencëtë së tashmes. Ajo që e shpreh folësi në këtë rast duket si një parashikim i sigurt, një pasojë:

15. Ajo ***do të jetë*** *kthyer tani.* (meqë, ka kaluar një kohë e gjatë prej se ka dalë)

Përfundime

Në korpusin e hulumtuar, i cili përbëhet nga një numër i gazetës Koha ditore (23 korrik 2016), drama "Loja e mbasdrekës" dhe romani "Djella" tëM. Camajt, strukturat e ndërtuara nga folja modale *do* si shenjuese të futurit janë gjetur 332 herë. Struktura *do* + lidhore është gjetur në 359 raste: 240 herë në gazetë, 40 herë në dramë dhe 52 herë në roman.Ndërsa struktura *do* + pjesore është gjetur5 herënë dramë dhe 1 herë në roman. Përderisa struktura *do* + lidhore është karakteristike për gjuhën standarde, edhe në përdorimin e folur e edhe në atë të shkruar, struktura *do* + pjesore është karakteristike më shumë për gjuhën e folur e më pak për atë të shkruarën. Këtë e dëshmon edhe fakti që kjo strukturë nuk është përdorur në gazetë dhe është përdorur vetëm 1 herë nëroman, por është përdorur në dramë, e cila duke qenë se realizohet në dialogë mes personazheve ka karakteristika të gjuhës së folur.*Do* + lidhore në korpus është gjetur vetëm në 2 raste si deontike që shpreh lejim (në dramë e në roman), ndërsa në 330 raste është realizuar si epistemike që shpreh përfundime apo parashikime.

Struktura *do* + pjesore gjithnjë realizohet si deontike dhe shpreh referenca kohore të futurit, ndërsa struktura *do* + lidhore në përdorimin e saj më tipik shpreh modalitet epistemik dhe referenca kohore të futurit, megjithëse, ajo varësisht nga konteksti mund të realizohet edhe si deontike e dinamike. Struktura *do* + pjesore është karakteristike më shumë për gjuhën e folur e më pak për të shkruarën. Këtë e dëshmon edhe fakti që kjo strukturë nuk është përdorur në gazetë, është përdorur 1 herë nëroman, por është përdorur në dramë, e cila duke qenë se realizohet në dialogë mes personazheve ka karakteristika të gjuhës së folur. *Do* + lidhore në korpus është gjetur vetëm në 2 raste si deontike që shpreh lejim (në dramë e në roman), ndërsa në 357 raste është realizuar si epistemike që shpreh përfundime apo parashikime.

Bibliografia

ASHSH. (2002). Gramatika I. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Shqipërisë. Tiranë.

ASHSH. (2002). Gramatika II. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Shqipërisë. Tiranë.

Badran, D. (2002*) Ideology throught Maodality in Discourse Analysis*. The Nottingham Linguistic Circular.

Beci B. (2004). Gramtika e gjuhës shqipe për të gjithë. Tiranë.

Demiraj Sh. (1995). Gramatika historike e gjuhës shqipe. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.

Demiraj Sh. (2002). Gramatika historike e gjuhës shqipe. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

Bybee J, PerkinsR&Pagliuca W (1994). The evolution of grammar. Tense, aspect and modality in the languages of the world. Chicago: University of Chicago Press.

Halliday, M.A.K. (1973) *Explorations in the Functions of Language*. London: Edward Arnold.

Huddelston R, Pullum G. K. (2002) *The Cambridge Grammar of the English Language*. Cambridge University Press, UK

Ismajli B. (200) *Modaliteti dhe mënyra në studimet gramatikore të shqipes*. Në: Semianri i 28 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë: Universiteti i Prshtinës, Fakulteti i Filologjisë.

Lyons, J. (1977) *Semantics*. Cambridge: Cambridge University Press.

Nuyts J. (2001) *Epistemic Modality, Language and Conceptualazation – A Cognitive-Pragmatic Perspective*. Amsterdam/Philiadelphia: John Benjamins Publishing Company.

Palmer F.R. (1996). *Mood and Modality*. Cambridge University Press, Cambridge.

Palmer F.R. (1996). *Mood and Modality*. Second Edition. Cambridge University Press, Cambridge.

Palmer. F. R. (1990) *Modality and the English Modals*. London and New York: Longman.

Tahiri L. (2009). Rrëfimi impersonal i Kadaresë, Shkup: Panteon.

Rugova L. (2015) *Ideologjia e shprehur nëpërmjet modalitetit në studimet për "pastërtinë e shqipes"*. Në: Seminari e 33-të Ndërkombëtar për gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë: Universiteti i Prshtinës, Fakulteti i Filologjisë.

Simpson P. (1993) *Language, Ideology and Poin of View*. London: Academc Press.

Ardita BERISHA & Kadire BINAJ

DO TË PUNOJ **AND** ***DO PUNUAR*****- MODALITY AND THE TIME REFERENCES**

Abstract

Modal verb *do (will)* can construct two verbal structures: do + verb in subjunctive: *do të punoj* and *do* + past participle: *do zgjidhur*. Although both the verbal structures represent the reference of the future time, being such a structure only the

first one is treatedin the Albanian Grammar (ASHASH, 2001). Since they are futuristic, they are well marked for the modal nuances they contain.

Hence, sentence *Genci do të marrë pjesë në garë.,* marks an unreal action, which is expected to happen after the moment of speech. In the modal aspect, the modal verb *do* can be interpreted in several ways: - as epistemic, expressing the basis of authenticity for the validity of this proposition, the speaker expresses a conclusion from the knowledge acquired by the contextual factors: *Genci do të marrë pjesë në garë* (since he always participates in such competitions) but it can also be interpreted as deontic, as a compulsory action, - when the subject (Genci) is forced/ordered to participate in the race. If the speaker is the one who allows the subject to participate in the contest, then the sentence may be interpreted as a deontic modality that expresses allowance. In the sentence *Genci do ta kalojë Agonin në garën e vrapimit* (Genci will surpass Agon in the running race) - the verb *do* expresses dynamic modality, Genc's ability to surpass Agon. However, the verbal structure *do të punoj*, does not always contain future reference: (Tani) ajo do të jetë në shtëpi ((Now) She will be home) (since the car is in the yard). -The speaker expresses a speculation, based on some of the information known to him. There is a presupposed truth basis, but it is on a supposition level - therefore, a weak epistemic modalityis expressed. Being at home refers to the moment of his talking which expresses a time reference for the present. The structure *do zgjidhur* always expresses the time reference of the future: *Kjo çështje do zgjidhur shpejt* (This issue will be solved quickly) in which the action will happen in the future. Since the verb *do* in this sentence emphasizes the necessity of the fact that the matter needs to be solved, it indicates deontic modality, and within deontic it always signifies compulsion.

Key words: *do (will),* modality, future, epistemic, deontic, dynamic

Helena GRILLO - Kledi SHEGANI

PRIRJE ZHVILLIMORE TË GJUHËS PËRMES VARIETETEVE

Marrëdhëniet e ndërsjellta me variantet jo standarde të gjuhës kanë qenë dhe mbeten rrugët kryesore për pasurimin e zhvillimin e gjuhës. Në rrethet e gjuhëtarëve shpesh janë trajtuar problematika të caktuara mbi raportet e dialektit me gjuhën, kahe të lëvizjes kryesisht leksikore. Kontaktet e gjuhës standarde me variantet dialektore lindin diskutimet e dy filozofive të papajtueshme me njëra-tjetrën: filozofia e përfshirjes në standard e të gjithë vlerave gjuhësore kombëtare nga njëra anë dhe teoria e mospërzierjes së sistemeve nga ana tjetër.

Ky punim synon që duke marrë nën vëzhgim varietetet e gjuhës së folur e të shkruar, të japë kontributin e vet në hulumtimin e thellë të varieteteve, kahet e lëvizjeve kryesisht leksikore dhe realitetet gjuhësore që pasqyrojnë këto lëvizje, duke u mbështetur në pikëpamjen e Çomskit se gjuhët janë të brendshme dhe individuale, të harmonizojë analizën paralele të varieteve.

Për arsye metodologjike dhe qasje kërkimore do të hulumtojmë prirjet e lëvizjeve leksikore dhe veçoritë përkatëse, për të analizuar nëse prirjet dialektore shkojnë në të njëjtin kah dhe si orientohen në lidhje me leksikun aktiv dhe prirjet e zhvillimit të gjuhës standarde. Proceset e zhvillimit gjuhësor janë të ngadalshme dhe shumë të komplikuara. Ato jo çdo herë përputhen me zhvillimin historik të kombit dhe të popullit. Në çështjen e standardizimit ndërthuren funksioni i gjuhës dhe i shoqërisë, me formën e gjuhës dhe të shoqërisë. *Mendohet se zhvillimi i një gjuhe ndodh në rrethana krejt rastësore, në nënvetëdijen e folësve, gjuhët standarde janë produkt i një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë dhe të paramenduar nga ana e shoqërisë*[1].

A. Kostallari shprehet: "*Qëndrueshmëri të përjetshme, absolute nuk ka as në gjuhë; pra as në drejtshkrim nuk mund të ketë rregulla përfundimtare në kuptimin absolut të fjalës. Në këtë rrugë do të ecet në të ardhmen për të bërë përmirësime të mëtejshme, duke u udhëhequr nga përparimi i gjuhës sonë letrare kombëtare dhe nga analiza gjithnjë e më e thellë shkencore e strukturës së saj*"[2]. Shpesh qëndrueshmëria e gjuhës shihet në format e fjalëve e fjalë që përpiqen të

[1] Ç. Bidollari, *Çështje të monitorimit dhe pasurimit gjuhësor,* në "Dukuri të shqipes bashkëkohore" Maluka , Tiranë 2006, f. 43.

[2] A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, në "Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhë s Shqipe", 20-25 nëntor 1972, f. 132.

ruajnë statusin e tyre. Nga denduria e përdorimit dhe statusi që mbartin këto njësi vlerësohet dhe domosdoshmëria e tyre në standard. Pikërisht, elementet që e kanë humbur statusin normativ dhe elementet e reja që ende nuk janë ngritur në normë, përbëjnë variantet e normës.

Saussure pohon se "*përhapja e fakteve të gjuhës i nënshtrohet të njëjtave ligje të një zakoni tjetër çfarëdo, fjala vjen të modës. Në gjithë shoqërinë veprojnë prore, njëkohësisht dhe me kahe të kundërta dy forca: nga njëra anë vepron mendësia e izolimit, e krahinës dhe nga ana tjetër forca e marrëdhënieve, e cila krijohet nga komunikimet ndërmjet njerëzve*"[3]. Në punimin tonë vërejmë cdo varietet tenton veprimin e ndërsjelltë të dy forcave. Në të folmet jugore vërejmë larmi gjuhësore, si dhe njësim me të folme më të mëdha, por jo në të gjitha tiparet.Sa për ilustrim të shohim disa shembuj të kategorive të ndryshme të cilët paraqesin variante në gjuhën e sotme standarde shqipe.

*(**Leksik**): Plaku i Vitit të Ri /Babagjyshi/* ***Babadimri, dritare*** */parathire /penxhere, pagure/botile/qelqe/* ***shishe*** *, potere/shamata/* ***zhurmë***, koca/kosa/ **gërshet**, *muslluk/neroqit/* ***enëqë mban ujë****, patiqe, papuce leshi/* ***shapka, llozhëra/ plehra*** *, firaun/qafir/* ***njeri i keq, cetur/bishtor/ garuzhde, cezve/*** *kukume etj.*

Në një nga punimet e mëparshme "*Vendi i së folmes së Himarës në dialektin jugor të shqipes*"[4] në analizën mbi leksikun kemi klasifikuar leksikun sipas; emërtime nga fusha e botës bimore, emërtime nga bota shtazore, emërtime për përdorim të përditshëm, fjalë me kuptime që nuk i hasim në shqipen standard, fjalë e trajta të vjetra fjalësh që i gjen qysh te autorët e vjetër, trajta fjalësh të përbashkëta me të folmet e tjera të dialektit jugor, Çamëri, Kurvelesh, Bregu i Poshtëm, trajta të gegërishtes, huazime nga greqishtja. Ndryshimet shoqërore dhe demografike kanë lënë gjurmë në fjalësin e situatën gjuhësore në të folmet jugore të shqipes, si pjesë e Labërishtes. Nga klasifikimi i leksikut nënvizojmë huazime nga greqishtja: *mirgale* - μιργαλε-bajame*, adhjas (boshatis), anapodhi (prapësi), anapodhiar/e, dheks (pranoj), epinem (këmbëngul), fanarosem (shfaqem), ksafis (hidhem përpjetë nga frika), ormis (përgatis), parakseni (trill, tek), paraponi (ngushëllim), qerdhes (fitoj), toidhio (* toidhio-i njëjtë, njësoj GR o ἰδιος-i, e njëjtë το ἰδιο-njësoj), *aguridhe (e papjekur), dhoros (darovit), gremis (rrëzoj), oktapodh, proshqefall (jastëk), sendon, tromaks* (τρομάςω-frikësoj)*, zahar.*

*(**Fonologji**) hubap/hutaq, baluke/balluke, llozhura/llozhëra*

*(**Morfologji**) Sado largvajtëse të jenë risitë, ndryshimet dhe zëvendësimet që pëson sistemi i së folmes tradicionale në brezat aktivë, në çdo variant të ri do të mbetet një substrat dialektor, i cili në shkallë të ndryshme të intensitetit, vihet re edhe në shtresat e ndryshme të të folurit qytetar, madje edhe*

[3] F. de Saussure, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme,* Tiranë, 2002, f. 273.

[4] R. Memushaj; H. Grillo, "*Vendi i së folmes së Himarës në dialektin jugor të shqipes*" në Studime filologjike, NR 1, 2009, Tiranë.

në të folurit e atyre që i kanë përvetësuar mirë normat e sotme të gjuhës letrare kombëtare apo standardit[5].

Interesante është formimi i fjalës *ujëvarë*. Vërejmë dysinë *kataraktis - katarakt*. (καταραχτης-katarakt); petazmë – ujëvarë - vend që vërvit ujin. Forma petazmë mendoj se vjen si ndikim grek : το πέταγμα-*petaksje-flakje, hedhje*. Kjo dëshmon zhvillimin gjuhësor në këtë të folme, dhe pasurimin e fjalësit të së folmes me mjetet gramatikore të shqipes.

Prapashtesa e shumësit -(**ë**)**ra** përdoret më shumë në këtë të folme se në të folmet e tjera fqinje. Me të e bëjnë shumësin emrat asnjanës, mashkullorë e femërorë që tregojnë lëndë, ku shumësi ka kuptimin e llojit: *djathëra*, *gjalpëra*, *drithëra*, *vajra*, *pambukëra*, *plëhëra*, *gjakëra*, *gjellëra*, *kashtëra*, *llozhëra* etj.; **Në këtë rast pirja është e përbashkët me standardin**. Emrat mashkullorë *fshatra, kopshtra* (edhe kopshtëra), *drëra* (drëre), *detra* (edhe detyra), *lumra* (edhe lumëra); si dhe emrat femërorë që dalin me temë më *i* ose *e* të theksuar, të cilët kanë edhe një trajtë shumësi që përputhet me njëjësin: - *tepsi/tepsira*, *prapësi/prapësira*, *fole/folera*, *kusi/kusira* etj.

Rrafshimi i formave te përemrat vetorë në këtë të folme ka ecur më përpara se në shqipen standarde. Kjo duket te përemrat e dy vetave të para në rrjedhore nuk i kanë trajtat e dhanores *meje*, *teje*, *nesh*, *jush*, duke përdorur në vend të tyre format e dhanores: *mua*, *tij* (ty), *neve*, *juve*, gjë që duket kur shoqërohen me parafjalë të rrjedhores: *pas mua*, *pas tij* (teje), *përpara neve*, *prapa juve*. Siç shihet, përemri vetor *ti* në rasat e zhdrejta del me trajtën *ti:j*: *Kush jam u për tij, Kam ardhur përpara ti:j* (teje) *u:*. Këto forma e përdorime janë të përbashkëta për të gjitha të folmet e labërishtes.

(Sintaksë) kalon rrugën / *kalon n' rrugë,, etj. Struktura sintaksore e shqipes standarde vepron si një sistem i mbyllur e i plotë, që zhvillohet sipas ligjësive të veta. Me punën e shumë brezave, gjuha ka arritur një shkallë të lartë përpunimi e përsosjeje, që është shoqëruar me rritjen e numrit të mjeteve sintaksore , me përcaktimin e kuptimeve të tyre dhe të sferës së përdorimit*[6].

Dihet se shqipja është gjuhë sintetiko-analitike me mbizotërim të tipareve të sintetizmit, por me prirje drejt analitizmit. Mjetet e shprehjes së sintetizmit janë të pranishme edhe në format analitike, qoftë në një përbërës të tyre. *Për të shprehur marrëdhëniet përcaktore dhe rrethanore bashkëjetojnë e konkurrojnë sintagma joparafjalore emër ose folje + emër në rasën rrjedhore të tipit: bukë gruri, vdiq urie, që përfaqësojnë një gjendje të ruajtur e të trashëguar të gjuhës shqipe, me sintagma parafjalore të tipit bukë prej gruri, vdiq nga uria etj., që lidhen me zhvillimin e sistemit të parafjalëve dhe prirjen e ngadalshme drejt rrëgjimit të lakimit emëror.*

[5] Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika,* Tiranë, 1999, f. 220.

[6] M. Domi, *Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme*, SF,1984/4, f. 60.

Nëse vëzhgojmë prirjen e së folmes konstatojmë se marrëdhënia përcaktore shprehet me togfjalëshin: bukë e misërt dhe në ndonjë përdorim edhe për ekonomizëm gjuhësor – *e misëre, këtë misëre.* Në këtë këndvështrim mendojmë **se e folmja ka prirje drejt analitizmit**.

Si prirje të përgjithshme gjuhësore konstatojmë:

Ekonomizmin gjuhësor si dhe analitizmin gjuhësor, që vërehet në gjuhët e familjes indoevropiane.

Prirja e zhdukjes së disa tingujve, kur nuk shkaktojnë keqinterpretim në ligjërim. Bëhet fjalë për të ashtuquajturën /ë/ të heshtur me një përdorim të gjerë në mbarë shqipen.

Prirja e zhdukjes së formave të parregullta dhe zëvendësimi i tyre me forma të rregullta për analogji. Në standard kjo prirje është aktive dhe vepron si në sistemin emëror dhe atë foljor.

Zhvillimet sintaksore të shqipes, të marra qoftë në kuptimin e gjerë si ndryshime, qoftë në kuptimin më të ngushtë si ndryshime që çojnë në përsosjen e sistemit, në rrafshin gjuhësor përcaktohen nga tipologjia e gjuhës dhe nga prirjet e përgjithshme të zhvillimit historik dhe të sotëm[7].

Gjuhëtari gjerman Hugo Shuhart (Hugo Schuchardt) pohonte se asnjë gjuhë nuk është krejtësisht e pastër. Pra, s'ka gjuhë të ndonjë populli të qytetëruar që s'ka elemente të gjuhëve të tjera. Në dy rrafshet gjuhësore gjendja nuk është e njëjtë: në rrafshin e përgjithshëm të gjuhës shqipe huazimi zotëron mbi standardizimin dhe kjo është e kuptueshme, por në rrafshin e gjuhës së njësuar kombëtare është standardizimi që zotëron mbi huazimin. Në rrafshin e përgjithshëm të shqipes, mbeten fusha e nivele gjuhësore të paprekura nga huazimi (si leksiku i të folmeve, pra leksiku dialektor e krahinor jokufitar me etni të tjera). E folmja e Himarës karakterizohet nga ndikime si rezultat i përdorimit të dygjuhësisë.

Një pjesë e të folmeve jugore të shqipes karakterizohen nga një situatë gjuhësore interesante, si rezultat i përdorimit të dygjuhësisë (shqip - greqisht).

Situata gjuhësore në këto të folme realizohet me ndërkëmbim të njërës apo tjetrës gjuhë. Ky ndërkëmbim nxit prurje të reja gjuhësore e leksikore dhe ne e shohim jo si faktor frenues, po zhvillimor.

Bilinguizmi nxit zhvillimin gjuhësor në pranëvënien e dy formave sinonimike.

[7] S. Mansaku, *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma,* në Konferenca Shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Tiranë, 2003, f. 110.

Helena GRILLO & Kledi SHEGANI

THE DEVELOPMENT TRENDS OF THE LANGUAGE THROUGH THE VARIETIES

Abstract

The reciprocal relations with the non standard variations of the language have been and are still the main ways to enrich the language development. In the circles of the linguists very often are treated various issues on the relations of the dialect with the language, mainly in the lexical direction.

The contact of the standard language with the patois variants raises the discussion of two philosophies which are incompatible with each other: on one hand is the philosophy of including all the national linguistic values in the standard language, and on the other hand the theory of non mixing both systems. This study aims to give its contribution into the deep research of the varieties of the spoken language, by researching the spoken language directly, by studying the directions of the movement mainly those lexical and the linguistic reality that present these movement, based on Comsky's view, who states that languages are internal and individual. According to Comsky, the language does not have a scientific reality, but is an entity with a general meaning, and there are no criteria to identify both variants of language, identical or different, as there does not exist "one language", "one linguistic standard" external for the individuals, as all languages are internal and individual.

At the end of the study, the analyses of the dialect trends help us to directurw the movement direction related to the active lexicon and the trends of development of the standard language.

Migena BALLA

LIGJËRIMI NË ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Abstrakt

Në 20 vitet e fundit, është shtuar shumë numri i organizatave të shoqërisë civile të cilat veprojnë në Shqipëri. Duke patur parasysh numrin e të të punësuarëve në këto organizata dhe ndikimin në jetën e shoqërisë shqiptare, duket se ato përbëjnë një sektor më vete të kësaj shoqërie, madje, do të guxoja ta quaja, një profesion më vete. Ligjërimi në këto organizata duket se ka natyrën e një varieteti funksional a nënkodi i cili karakterizohet nga një leksik i veçantë, por që në përbërjen e tij gjejmë edhe varietete të tjera të shqipes. Në këtë varietet bie shumë në sy dhe dukuria e përzierjes së kodeve shqip- anglisht, në disa raste edhe në mënyrë të tepëruar. Duke i konsideruar të punësuarit në këto organizata si një grup shoqëror që i lidh puna (vijnë nga profesione të ndryshme) mund ta konsiderojmë edhe si një sociolekt.

Por, cila është natyra e këtij ligjërimi?

Pas viteve `90, në Shqipërinë e izoluar nga bota që e rrethonte u shfaqën shumë probleme në të gjitha fushat e jetës shoqërore të cilat nxitën interesin e Evropës dhe SHBA të cilat filluan të kërkonin mënyra për të ndërhyrë në zbutjen apo zgjidhjen e këtyre problematikave. Kështu, nisi të formësohej një formë e re organizatash të cilat nuk kishin lidhje as me parti e as me shtetin ndaj, si fillim, u quajtën OJQ (organizata joqeveritare) dhe më vonë do të quheshin OJF (organizata jofitimprurëse). Sipas statistikave, numërohen rreth 2500 organizata jofitimprurëse lokale dhe ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë. Të gjitha këto organizata jofitimprurëse konsiderohen si një sektor më vete aktiviteti, shërbimi dhe punësimi. Me përafërsi (nuk munda të gjej një të dhënë zyrtare për numrin e të punësuarve në OJF), mendohet se mund të jenë rreth 20 mijë të punësuar.

Përvoja shumëvjeçare në një OJF kishte ngacmuar herë pas here vetëdijen sociolinguistike për një analizë të ligjërimit që përdoret në këto organizata.

Tek flasim për një varietet gjuhe patjetër do të interesohemi "Kush flet?". Të punësuarit në OJf janë kryesisht me arsim të lartë, me njohje të mirë të gjuhës së huaj (kryesisht anglisht) dhe me aftësi të mira menaxhimi të marrëdhënieve me njerëzit me të cilët do të punojnë. Repertori gjuhësor i përdoruesëve të këtij ligjërimi, pra i

punonjësve të OJF-ve, përbëhet nga ***varianti standard*** (temat e mbajtura në tryeza dhe takime lokale dhe kombëtare, deklaratat e ndryshme në median e shkruar dhe vizive etj.); ***e folmja e zonës*** ku punohet dhe ndërhyhet dhe ***gjuha e donatorit*** (anglishtja ose ndonjë gjuhë tjetër). Përveç këtyre, duhet të ketë dhe aftësi të përdorë nivele të ndryshme të regjistrave të ligjërimit për t`ia përshtatur situatave të ndryshme dhe grupeve të ndryshme shoqërore.

OJF-të e kanë të lidhur ekzistencën e tyre me projektet të cilat financohen kryesisht (rreth 95 %) nga organizata ose shtete të huaja. Donatori (organizata ose shteti që financon projektin) dikton dhe gjuhën e përdorur (përveç shqipes) në aktivitetin e OJF-së. Në shumicën e rasteve, gjuha e aplikimit të projektit është anglishtja. Edhe raportimet gjatë zbatimit të projektit kërkohen të shkruhen në anglisht. Në organizatat vendase, sigurisht që komunikimi bëhet në shqip, por ndikimi i anglishtes ndjehet mjaftueshëm si në variantin e shkruar edhe në atë të folur. Për rrjedhojë, edhe kur raportet apo komunikimi i brendshëm i organizatës bëhet në shqip, si në shumë fusha të tjera, por sidomos në këtë sektor, vihet re një mpleksje e shqipes me anglishten, në shumë raste, e panevojshme. Gjenden në ligjërimin e këtyre organizatave fjalë a grupe fjalësh të tilla si: *network, workshop, session edukimi, gender, facilitator, advokim, lobim, fokus-grup, target-grup, retreat, stakeholder, integrated security, Peer, outcame, output, input, job description apo shkurtime si TOT (training of trainer), TOR (), VOT (victim of trafiking) etj.* Disa prej tyre gjenden ndonjëherë të përdorura edhe në shqip si: *lehtësues (facilitator), përshkrim pune (job description), VT (viktimë trafikimi) (VOT), VMT (viktimë e mundshme trafikimi), barazi gjinore (gender) etj.,* ndërsa të tjerat jo vetëm që nuk iu është gjendur gjegjësja në shqip, por vazhdojnë të shkruhen si në anglisht *network, workshop, gender, retreat, stakeholder, integrated security, Peer, outcame, output, input etj.*

"*Gjuha e donatorit*" ndikon shpeshherë edhe në përdorimin e njërit term në vend të një tjetri. P.sh. në fushën e Planifikimit familjar një organizatë ndërkombëtare UNFPA, nuk përdor termin *pacient*, por *klient,* ndërkohë një tjetër i konsideron si *përfituese*; donatorë të tjerë, nisur nga politikat gjinore, propozojnë përdorimin e grupeve të fjalëve *të rinjtë dhe të rejat* ose *vajzat dhe djemtë* në vend të fjalës *të rinjve;* për të mos diskriminuar dhe për të zbutur ngjyrimin negativ të disa fjalëve propozohen disa të tjera, nga *prostitutë* u kalua në *punonjëse seksi* dhe, së fundi, përdoret *vajza të trafikuara* ose *viktima trafikimi;* nuk përdoret *i droguar* por *përdorues droge,*nuk përdoret fjala *homoseksual* por MSM etj

Në ligjërimin e këtij sektori gjejmë përzierje të disa varieteteve gjuhësore që kanë të bëjnë me gjuhët sektoriale të fushave ku ndërhyjnë këto organizata. P.sh. një OJF që ka në fokus gratë dhe vajzat ofron për to shërbime mjekësore, shërbime juridike dhe psiko-sociale. Në ligjërimin e kësaj organizate gjejmë gjuhën e mjekësisë

kur flitet për "asistencën shëndetësore" të përfitueseve të kësaj organizate si: *kanë rezultuar me patologji të thjeshta, infeksione, antibiotikë, sifiliz, medikamente* etj.; gjuhën e drejtësisë kur bëhet fjalë për "asistencë ligjore" në procese të ndryshme gjyqësore: *zgjidhje martese, heqje e përgjegjësisë prindërore, urdhër mbrojtjeje, urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje* etj.; të punës sociale dhe atë të psikologjisë: *përmirësim i gjendjes emocionale, paqëndrueshmëri të humorit, agresivitet, përmirësim i marrëdhënieve me familjarët, biseda në grup, teste psikologjike* etj.

Përveç varieteve funksionale (gjuhët sektoriale), në ligjërimin e këtyre organizatave lipset nevoja për njohje dhe përdorim edhe të sociolekteve të ndryshme sepse në fokus të tyre janë grupe shoqërore të ndryshme (të papunët, përdoruesit e drogës, punonjëset e seksit); grupe etnike (romët, egjyptianët); grupet sipas seksit (gratë, homoseksualët); grupet sipas brezave (të rinjtë dhe të rejat, moshat e treta) etj. Shpeshherë njohja dhe përdorimi i këtyre sociolekteve nga ana e punonjësve të organizatës është një ndihmë shumë e madhe në vendosjen dhe funksionimin e marrëdhënieve të mira me këto grupe e komunitete. Në gjuhën e këtyre organizatave këto grupe quhen target-grup. Sa më mirë ta njohësh sociolektin e tyre aq më bashkëpunues do të jenë me përfaqësuesit e këtyre organizatave e aq më e suksesshme do të jetë puna e tyre në përmbushje të qëllimeve dhe objektivave të projekteve. Kur flitet me përdoruesit e drogës, përdoren shpesh fjalë që janë pjesë e zhargonit të tyre si: *mall* në vend të fjalës *drogë,vizë ose hundore* në vend të *drogat që merren nga hunda, e kuqe, një alumini* etj.; kur flitet me të rinjtë për shëndetin seksual dhe riprodhues përdorim fjalë si: *kapuç ose këlluf, paracetamol, puçi-puçi, llapë, dru* etj.; apo kur bisedohet me vajzat e trafikuara përdoren gjithashtu fjalë e shprehje karakteristike për zhargonin e tyre etj.

Njohja dhe përdorimi i regjistrave të ndryshëm gjuhësor është, gjithashtu një domosdoshmëri për punonjësit e këtyre OJF, sidomos ata që janë në terren, drejtpërdrejt me personat që vijnë nga shtresa të ndryshme të shoqërisë: të varfër, analfabetë, me problem sociale etj. Kështu, nëse një punonjësi i duhet të komunikojë me targetgrupin e grave dhe vajzave që punojnë në një rrobaqepësi, nuk mund të përdorë regjistrin e ngritur për t`i njohur me të drejtat e tyre; ose kur duhet t`i flasin për planifikimin familjar dhe IST, nuk mund të përdoret gjuha mjekësore e pastër, por duhet sjellë me fjalë më të thjeshta dhe emërtime popullore. Kur duhet përdorur emërtimi *dhuna me bazë gjinore* përdoret më shumë fjalia *kur burri rreh gruan, nënën apo vajzën ose anasjelltas* dhe kur flitet për *ushtrim të dhunës fizike* përdoren foljet *rreh, godet, ha dru ose zhdëp në dru;* në vend të *zgjidhje martese* përdoret *ndarje*; kur bëhet fjalë për emërtime mjekësore përdoren gjithashtu fjalë dhe shprehje më të thjeshta si: në vend të *vaginozë bakteriale* përdoret *infeksion nga poshtë;* në vend të fjalës *kontraceptivë,* shpesh përdorim *kokrra për të mos mbetur shtatzanë ose me barrë* etj.

Varietet krahinore janë gjithashtu një mjet që ka rezultuar i dobishëm në marrëdhënie me komunitetet me të cilat punojnë organizatat. Nëse shkon të flasë me gratë e një fshati në Vlorë një person që është nga Tirana, nuk do të jetë më i suksesshwm se një nga Vlora, dhe aq më pak se ndonjë që e njeh të folmen e tyre.

Duke e konsideruar si një sektor më vete sektorin e organizatave jofitimprurëse, pjesë e shoqërisë civile, do të shohim se ligjërimi i tyre ka dhe një shtresë të veçantë e cila ka lidhje me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtyre organizatave dhe gjuhën e projekteve. Kjo shtresë mund të konsiderohet si gjuhë sektoriale?

Gaetano Berruto duke iu referuar gjuhëve të specialitetit flet për nënkodetntë cilat i përcakton si varietete të karakterizuara nga një leksik i veçantë dhe të përdorura për të komunikuar argumente të lidhura me aktivitete të caktuara profesionale. Në brendësi të nënkodeve Berrutto dallon: - *Gjuhët e veçanta*, në sensin e ngushtë të fjalës, nënkode të mirëfillta të cilat dallohen nga një leksik i veçantë dhe nga një morfosintaksë dhe tekstualitet karakteristik; - *Gjuhët e veçanta* në kuptimin e gjerë, ose gjuhët sektoriale, të cilat nuk kanë një leksik të caktuar specifik, por janë të lidhura gjithsesi me fusha përdorimi të veçanta jashtëgjuhësore.

Nisur nga ky klasifikim mund të themi se ligjërimi në OJF ka njëfarë leksiku që mund të konsiderohet si leksik karakteristik i cili ka një numër jo shumë të madh fjalësh si p.sh: *projekt, donator, financim, targetgrup, aktivitete, komunitet, ndërgjegjësim, trainim, ëorkshop,organizata partnere* etj. por shihet që këto fjalë i përkasin dhe përdoren edhe në fusha të tjera të jetës shoqërore. Pra, gjuha e OJF-ve mund të konsiderohet si një nga ato gjuhë sektoriale, të cilat i përkasin sektorëve dhe fushave të punës, jo specialistike, nuk kanë një leksik të vetin specifik, as rregulla të veçanta, por importojnë nga gjuha e zakonshme fjalë, shprehje, metafora e teknicizma.

Diferenca më thelbësore mes gjuhëve të specializuara dhe gjuhëve sektoriale, sipas Sobreros, qëndron në nivelin më të lartë apo më të ulët të leksikut të specializuar, veçori kjo e cila lidhet me modalitetin dhe qëllimet e përdorimit të tyre. (*Dalipi 632 AKTET Vol. V, Nr 4, 2012*). Mesazhet e gjuhëve sektoriale përhapen në pjesën më të madhe të tyre nga masmedia: grada më e ulët e specialitetit të leksikut i detyrohet faktit të kuptimit të tij nga ana e një publiku më të gjerë, kurse gjuhët e specializuara ruajnë një terminologji lartësisht të specializuar pasi edhe qarkullimi i mesazheve është më i kufizuar dhe i destinuar për ekspertët e fushës. Ligjërimi në këto organizata, në fakt, i ka të dyja nivelet. Siç e kemi përmendur dhe më lart, këtu përdoret edhe një gradë më e ulët e spëcialitetit të lëksikut në mënyrë që mesazhi që përcillet te publiku i gjerë apo targetgrupi i synuar të kuptohet prej tyre, edhe një terminologji e specializuar kur raportohet te donatori ose në tryeza e takime mes specialistëve të fushës (shembull: të drejtat e grave, çështje të planifikimit familjar, dhuna, trafikimi etj.)

N.q.se personat që merren me menaxhimin e projektit, shkrimet e projekteve, shkrimet e raporteve do t`i konsideronim si një grup shoqëror që vijnë nga profesione të ndryshme por që i lidh puna që bëjnë (e cila nuk ka lidhje me profesionin e tyre) dhe vendi i punës a mund ta shihnim ligjërimin e tyre si një sociolekt? Përmasa diastratike e varieteteve gjuhësore lidhet jo vetëm me shtresimin shoqëror, por edhe me ndryshorë të tjerë si me grupin shoqëror, grupin etnik, seksin, ndarjen sipas brezave. Termi *sociolekt* përdoret nga disa studiues pikërisht për varietetin diastratik në përgjithësi, ndërsa disa të tjerë e përdorin këtë term në një kuptim më të ngushtë. Numri i përdoruesve të këtij ligjërimi dhe mungesa e një "gjuhe" që i dallon nga grupet e tjera nuk na ndihmon në përfundimin se është një sociolekt.

Si përfundim, në përbërje të këtij ligjërimi vihet re prania e disa varieteteve ku dallohen varietete të larta dhe të ulëta, varietete të përziera, të cilat duken sikur shkrihen me njëra-tjetrën në disa raste. Ky ligjërim pra, na vjen me pamjen e një *continuumi (një koncept që mendohet të jetë dhënë nga Reinecke-Tokimasa (1934) në studimin e anglishtes kreole të Hawaiit, Berry (1961), Mioni (1979)*, ku përzihen dhe bashkëjetojnë varianti standard i shqipes, një gjuhë e huaj, një përzierje e tyre, variant dialektor a një e folme e caktuar, gjuhë sektoriale dhe gjuhë të specializuara të fushave të veçanta ku veprojnë OJF-të.

Migena BALLA

LANGUAGE IN CIVILE SOCIETY ORGANIZATIONS

Abstract

In the last 20 years, the number of civil society organizations operating in Albania has increased. Taking into consideration the number of employees in these organizations and the impact on the life of Albanian society, it seems as if they are a separate class of this society, and even I would dare call it a separate profession. In these organizations, discourse looks as if it has the nature of a functional variety or a sub-code which is characterized by a special lexis, but in its composition we find other varieties of Albanian language. In this variety, it is really noticeable even the fact of Albanian-English code-mixing, in some cases it is even redundantly used. Considering employees as a social group in these organizations, due to their work-related nature, (they come from different professions) we can consider it as a sociolect.

But what is the nature of this discourse?

Anila HIMA

"KONVERSACIONALIZIMI" I LIGJËRIMIT FEMËROR NË POLITIKËN SHQIPTARE

Abstrakt

Dukuria e "konversacionalizimit" të gjuhës njihet si zhvendosja e ligjërimit politik drejt stilit bisedor, joformal e spontan për të krijuar përshtypjen e një bashkëbisedimi të zakontë me publikun. Duke marrë për analizë një korpus të gjerë fjalimesh politike të mbajtura në trirrethana ligjërimi, kur politikanet janë në pozita pushteti, në opozitë dhe në rrethana personale, ky punim synon të nxjerrë në pah dukurinë e "konversacionalizimit" në ligjërimin femëror në politikën shqiptare. Me anë të analizës cilësore dhe asaj krahasuese synohet të shqyrtohen pyetjet: *në ç'formë, në ç'rrethana*dhe*me ç'qëllim shfaqet kjo dukuri në ligjërimin femëror?* Nga analiza cilësore dhe ajo krahasuese, rezultonse prirja drejt ligjërimit bisedor e ndonjëherë edhe atij të shkujdesur, së pari, shfaqet në ligjërimin politik në rrafshin morfologjik, sintaksor, leksikor e fonetik; së dyti, nuk shprehet në mënyrë të njëtrajtshme e të qëndrueshme në ligjërimin politik, por mbizotëron në fjalimet e mbajtura nga ligjërueset në kushtet e opozitës; dhe së treti, synon një kuptueshmëri sa më të lartë prej publikut për të fituar sa më shumë popullaritet me qëllim që të sigurohet mbështetja dhe përkrahja e tyre.

Fjalë kyç: *ligjërim femëror, politikë, konversacionalizim, rrethana ligjërimi, popullaritet.*

Hyrje

Ligjërimi politik karakterizohet nga një gërshetim tiparesh të ligjërimit libror me të ligjërimit bisedor. Ligjërimi libror është ai lloj ligjërimi "në të cilin norma zbatohet në mënyrën më të plotë e të ngurtë, pa lejuar lëkundje e shmangie, me kufizime të ndjeshme për përdorimin e stilemave dhe me parapëlqimin për mjete e ndërtime më të ndërlikuara, jo të zakonshme për gjuhën e folur, " ndërsa në ligjërimin bisedor "norma zbatohet në mënyrë elastike, me disa lëkundje, pa kufizime të ngushta në përdorimin e stilemave" (Lloshi, 2012: 181).

Faktorët jashtëgjuhësorë që ndikojnë në përzgjedhjen e tipareve të ligjërimit libror në ligjërimin politik janë të shumta. Megjithëse një formë komunikimi e folur, ligjërimi politik nuk është i drejtpërdrejtë, në kuptimin që reagimet e publikut nuk e ndërpresin rrjedhën e ligjëratës, prandaj mund të mendohet si një ligjërim i ndërmjetuar, prandaj ka natyrë librore. Një tjetër faktor jashtëgjuhësor që ndikon në zgjedhjen e ligjërimit libror është masa e gjerë e publikut. Sa më e madhe të jetë kjo masë, aq më e madhe është prirja për të përdorur normën letrare të shqipes. Koha për ta përgatitur fjalimin është e mjaftueshme për ta zgjedhur e rizgjedhur formën më të mirë të shprehjes, për ta parë e riparë të gjithë ndërtimin e tekstit në mënyrë që të mos përmbajë gabime. Si pasojë, fjalimi do të jetë më pranë normës letrare të gjuhës.

Nga ana tjetër, ndër faktorët jashtëgjuhësorë që ndikojnë në përzgjedhjen e ligjërimit bisedor është fakti që ligjërimi politik është mjet komunikimi i folur para një mase të gjerë njerëzish, ndaj, ka në dispozicion edhe mjete ndihmëse të komunikimit, si: gjestet, mimika, intonacioni e toni i zërit. "Sa më të pranishme të jenë ato gjatë komunikimit, aq më tepër mbizotërojnë tiparet bisedore" (Lloshi, 2012: 163). Edhe pse në dukje është monolog, në fakt ligjërimi politik ka një ndërtim dialogues, ku edhe pse nuk priten përgjigje nga publiku, ato shpesh nënkuptohen, por edhe orientohen e drejtohen nga ligjëruesi. Një fakt me rëndësi për përdorimin bisedor është synimi i këtij ligjërimi për një publik sa më të gjerë, një kuptueshmëri sa më të lartë prej tyre, për të fituar sa më shumë popullaritet e për të treguar barazi e solidaritet me publikun. Ligjërimi politik priret drejt ligjërimit bisedor për vetë faktin se "gjuha e folur letrare shqipe sot është më afër me ligjërimin bisedor, ndryshe nga gjuhë të tjera, si p.sh. frëngjishtja, në të cilën është më afër ligjërimit libror" (Lloshi, 2012: 181).

Kohët e fundit në mbarë botën është vërejtur një zhvendosje e ligjërimit politik drejt stilit bisedor, e quajtur dukuria e 'konversacionalizimit'[1] të gjuhës politike, e zhvilluar nga Norman Fairclough. Konversacionalizimi nënkupton ristrukturimin e kufirit mes ligjërimit publik e atij privat – një kufi tejet i paqëndrueshëm në shoqërinë bashkëkohore i karakterizuar nga ndryshime e tensione të vazhdueshme. Kjo dukuri ka të bëjë me kufijtë zhvendosës mes gjuhës së folur dhe asaj të shkruar dhe me një rritje prestigji e statusi të gjuhës së folur (Fairclough 1994). Prof. Lloshi e shoqëron formalitetin e madh që shprehet me anë të ligjërimit libror me njëfarë depersonalizimi të komunikimit. Për këtë arsye publicistika, mjetet e komunikimit masiv dhe letërsia kanë ecur drejt pakësimit të tipareve librore (Lloshi, 2012: 189). Të tjerë studiues (Kress 1986) kanë vërejtur se ligjërimi i medias po merr gjithmonë e më shumë një natyrë bashkëbiseduese që shënon një zhvendosje drejt informalitetit të gjuhës. Kjo mund të ketë ardhur ndoshta si rezultat i marketizimit të ligjërimit publik. Ligjërimi

[1] Ang. < *conversationalization of language*.

publik modern po bëhet gjithnjë e më shumë pjesë e demokratizimit të jetës publike. Klasat shoqërore, të cilat, më parë, nuk merrnin pjesë në jetën publike, tani e kanë këtë mundësi që më parë nuk ishte e disponueshme për ta (Giddens 1991). Prandaj ligjërimi publik tanimë është më përfshirës edhe për klasat e ulëta.

Në këtë punim do të analizohet dukuria e 'konversacionalizimit' nëligjërimin politik, e më saktë në ligjërimin femëror në sferën politike. Me anë të analizës cilësore dhe krahasuese do të hulumtohen pyetjet: në ç'formë shfaqet kjo dukuri në ligjërimin politik, në ç'rrethana ligjërimi e me ç'qëllim?

Përzgjedhja e subjekteve të analizës

Për të analizuar ligjërimin femëror në politikë janë zbatuar kriteret e ligjërimit politik të përkufizuara nga Wilson-i, si "gjuha e përdorur në situata politike formale dhe joformale me aktorë politikë që operojnë në mjedise politike për të arritur qëllime politike" (Wilson 2001). Autoret e ligjërimit që janë zgjedhur për analizën ligjërimore janë dy figura të fuqishme e të suksesshme të politikës, pra, me profesion politikane. Ato janë znj. Atifete Jahjaga e znj. Jozefina Topalli.

Korpusi

Për analizën tonë është përpiluar një korpus me ligjërimin e dy figurave politike të prodhuar në tri situata të ndryshme ligjërimi: në rrethana pushteti, në rrethana opozite dhe në rrethana personale. Përrrethanat e pushtetit janë përzgjedhur fjalime të mbajtura nga dy subjektet e analizës kur janë në pushtet. Ato janë: 10 fjalime të mbajtura nga znj. Topalli në periudhën 2009-2013, periudhë e cila përfshin ligjërimin e znj. Topalli në pushtet në cilësinë e kryetares së Kuvendit; dhe 15 fjalime të mbajtura nga znj. Jahjaga në cilësinë e presidentes së Republikës së Kosovës në periudhën 2011 - 2015. Për rrethanat e opozitës janë përzgjedhurfjalimet e mbajtura nga znj. Topalli në foltoren e Kuvendit, në cilësinë e deputetes në opozitë në periudhën tetor 2013 – prill 2014. Për rrethanat personale janë përzgjedhur dy intervista televizive rreth jetës personale e familjare të znj. Topalli e znj. Jahjaga.

Analiza

Nga analiza cilësore rezulton se në fjalimet e mbajtura në rrethana pushteti nga të dy subjektet e analizës, norma e gjuhës letrare është ruajtur rreptësisht.

Moszbatime apo shkelje të normës letrare, duke përdorur një stil bisedor që të krijon përshtypjen e bisedave mes miqsh a të njohurish, i gjejmë nërrethana personale në dy intervistat shoqërore, si edhe në fjalimet e mbajtura në rrethanat e opozitës nga znj. Topalli. E veçantë për këto fjalime është ndërthurja e pandërprerë e ligjërimit libror me ligjërimin bisedor e shpesh edhe me ligjërimin e shkujdesur, ku spikat qëndrimi akuzues, goditës e polemizues.

Në ligjërimin politik në rrethanat e opozitës gjurmohen tipare të ligjërimit bisedor në nivel morfologjik, sintaksor, leksikor e fonetik.

Vërehen tipare të ligjërimit bisedor në aspektin **morfologjik**, me forma të pasakta foljesh (Mos *flit* pa leje! Jo vetëm që *do paguani* më shumë, por kush punon më shumë, do të paguajë edhe më shumë) dhe forma dialektore foljesh (Me këtë buxhet të zi biznesi fillon nga marsi *me mbyll* dyert. Por ti nuk je as Totoja, more zotëri, ti nuk të bën as *me qesh!)* përdorimi i vazhdueshëm i vetës së dytë njëjës '*ti'* në vend të shumësit '*ju'*(*Nuk do dëgjosh* më duartrokitjet e 1 milion shuplakave, siç *të* pëlqen *ty ta quash*).

Në aspektin **sintaksor,** fjalitë janë të thjeshta, të shkurtra të njëpasnjëshme, por edhe të përbëra, kryesisht, me lidhje bashkërenditjeje ku mbizotëron përdorimi i veprores kundrejt pësores (Tani është finishi… dhe kjo punë duhet të mbyllet. Nuk ka kohë për të humbur. Sesioni po shkon drejt mbylljes. Kufizimi i imunitetit duhet të votohet po ashtu. Është koha. Është koha për të vepruar. Është koha tani. Shqiptarët duan statusin, ata e meritojnë. Ata nuk e falin bllokimin. Dhe këtë e kanë treguar. Unë jam besimplote). Në aspektin **leksikor**, gjejmë fjalë e shprehje të ligjërimeve të folura popullore si edhe huazime orientale (Vetëm një të *zalisuri***,** mund t'i kalojë nëpër mend që të dyfishojë deficitin. Premtimet ishin pa *hesap*. Ju të gjithë bashkë do ta keni *taksirat* për të votuar kundër premtimit tuaj. Ju sigurisht që keni një plan për *bahçen* tuaj të klientëve. *Ju qofshi,* por keq e keni! *Gënjeshtër me bisht!* "Edhe ju duhet të *shtrëngoni rripat* dhe *të rrini urtë aty ku jeni",* - thotë Kryeministri me paketën që ka sjellë sot në parlament. Ndaleni përpara se *t'ju lidhë për bukën e gojës. Kam parë dhe s'kam parë,* por si ky Kryeministër nuk kam dëgjuar kurrë!). Shpesh, fjalimet në rrethanat e opozitës i afrohen ligjërimit të shkujdesur, sepse karakterizohen nga një gjuhë politike e ngarkuar me akuza personale, tone të ashpra, qëndrime kundërshtuese, një nivel i lartë i retorikës dhe nga një shpalosje e një fjalori të rëndë si shkelje e normës letrare. Shpesh gjuha është e ngarkuar me akuza personale që e kërcënojnë, e sfidojnë dhe e ulin kundërshtarin (kryeministri *më i pafytyrë, injorant*, *qesharak*, *rrenacak, mashtrues, i paburrë, i pandershëm, ti nuk je burrë*).

Dy intervistat me dy zonjat politikane na kanë mundësuar të analizojmë edhe aspektin fonetik të ligjërimit të tyre. Edhe në nivelin **fonetik** janë vërejtur moszbatime dhe shkelje të drejtshqiptimit.

Në variantin dialektor të znj. Topalli dallojnë veçori fonetike e gramatikore. Tiparet fonetike përfshijnë: rënien e /ë/-së së patheksuar si në trup të fjalës, ashtu edhe në pozicion fundor: *ku:rr, vshtira, fmij, shpi;* mungesën e mbaresës *ë* në trajtën e shquar shumës të emrave mashkullorë, si edhe *ë*-ja e temës në trajtën e shquar njëjës të disa emrave femërorë: *kulturs, shkencs, Tirans, dhuns, shoqris;*zanoret e gjata në fonemat zanore të theksuara, veçanërisht kur ndiqen nga një rrokje me /ë/ fundore të patheksuar: *shu:m, ka:ng, mshu:m, a:t, na:t;* /â/-ja hundore në vend të /ë/-së në serinë e zanoreve të theksuara: *bâhen, mrâm, nântdhjet, ândrrat, mâ, nân, kânga, e bâjn, dhân* në vend të *bëhen, mbrëmë, është bërë, nëntëdhjetë, ëndrrat, më, nënë, këngë, e bëjnë, dhënë;* monoftongimi i togjeve zanore /ua/>/u/, /ye/>/y/ dhe /ue/>/u/, si p.sh., *grun, s'kisha provu, e kam adhuru, për me msu, duhet të kem fillu, më ka impresionu; pyt, kry t'punës; e mrekullushme;* asimilimi i grupeve të bashkëtingëlloreve /mb, nd, ng/ në /m, n, n/: *s'mahen, me myt kohën, menoja, knojn, nryshëm, noshta, nejt,* por gjejmë edhe shqiptim të /nd/ si p.sh., *kam qëndis;* ndërrimet e /th/>/dh/ si p.sh., *të gjdha*; afrikatizimi i qiellzoreve /q/>/ç/ si p.sh., *keç, aç,* /dh/>/ll/ si p.sh., *llunohen, lle, e malle, periulla* dhenjëdridhësja /r/ >shumëdridhëse /rr/ si p.sh., *rrealisht.* Në strukturën gramatikore shfaqen variante të ndryshme dialektore, si: forma e paskajores *me myt*, në vend të *për të mbytur;* pjesorja pa mbaresë në vend të pjesores së zgjeruar me -ur: *kam dash, kam pas, për të vra,* në vend të *kam dashur, kam pasur, për të vrarë;* forma e së pakryerës së foljeve veprore si p.sh., *i pëlqejshin* në vend të *i pëlqenin;* eliminimi i nyjes së rasës gjinore, p.sh. *salla pritjes;* shumësi i emrave me -a: *shpiat.*

Pritej që në situatën personale për jetën publike dhe personale të znj. Jahjaga të shfaqej një tjetër variacion gjuhësor, më i natyrshëm, me kahje drejt ligjërimit bisedor. Ndërkohë, ligjërimi i saj gjatë intervistës televizive, edhe pse një intervistë e një natyre shoqërore, i përmbahet më së miri normës letrare të folur. Është një ligjërim i kujdesur, me zbatim të lartë të normës letrare të shqipes, me disa lëkundje të drejtshqiptimit në lidhje me variacionin dialektor geg. Lëkundjet e normës letrare të folur që ndeshen në ligjërimin e znj. Jahjaga prekin aspektin dialektor në rrafshin fonetik e më pak sintaksor. Në variantet fonetikepërfshihen:bjerrja e ë-së fundore të fjalëve, si p.sh., *jan, pjes, sfid, ësht, un, këthough, zyr;*hundorësia e zanoreve: *gâsi, mâ e madhe;*monoftongimi i togut të zanoreve /ua/ > /u/: *ke mendu, gru;* ndryshimi i theksit të fjalës nga oksiton në paraoksiton me bjerrjen e ë-së fundore: *ké't, á't moment, pá't thelluar,* por që e gjejmë edhe në kushte të tjera pa praninë e ë-së fundore, si p.sh., *á'i ka qenë, tash.* Megjithatë, përpjekja për t'iu përmbajtur sa më shumë drejtshqiptimit bën që ligjërimi i znj. Jahjaga të jetë i artikuluar mirë dhe qartë e madje të tingëllojë si i segmentuar në rrokje, sidomos në rastet kur fjalët përmbajnë /ë/ si në rastet: *atë, duhet të jetë, këtë vit, këto vite këtyre, çdo sfidë të jetës;* afrikatizimi i qiellzoreve /q/ > /ç/ si në

fjalët: *aç, çenë, e kënaçur, çë, e fuçishme;* dhe /gj/ > /xh/*: përxhexhsi.* Në strukturën sintaksore shfaqen variante të ndryshme dialektore, si p.sh., forma e së pakryerës së foljeve veprore si p.sh., *dejshim, gjejshim, lexojsha* në vend të *donim, gjenim, lexoja.*

Përfundime

Zbatimi i rreptë i normës gjuhësore me përafrime të ligjërimit libror vërehet në situatën e pushtetit në cilësinë e kryeparlamentares dhe të presidentes. Në bazë të analizës sonë del se: në pozicione politike të pushtetshme, dy politikanet e zbatojnë me rreptësi normën letrare të gjuhës dhe me anë të saj mëtohet të tregohet pushtet e forcë e palëkundshme si edhe një formalitet institucional i cili tregon distancë mes ligjëruesës dhe publikut. Siç shprehet edhe prof. Lloshi, gjuha librore synon të shprehë më shumë autoritet me anë të një formaliteti më të madh (Lloshi 2012: 189).

Përdorimi i ligjërimit bisedor, por me kapërcime të shpeshta në ligjërimin libror në situatën e opozitës dëshmon nevojën e ligjërueses për më tepër afrimitet me publikun. Duke kërkuar mbështetjen dhe përkrahjen e publikut në pozicionin e deputetes në opozitë ligjërimi shpesh merr trajta bisedore. I afrohet më tepër publikut sepse jep përshtypjen e bashkëbisedimit apo dialogut duke zvogëluar distancën mes ligjëruesës dhe publikut, duke folur një gjuhë më të kuptueshme me të, duke folur gjuhën e publikut, për të treguar se ligjëruesja është në krahun e tyre, madje është zëri i tyre. Pra, duke u nisur nga analiza jonë mund të themi se shkelja e vetëdijshme e normës letrare është tregues i kërkimit të pushtetit nga ligjëruesja.

Ndërsa, ligjërimi bisedor në situatën personale nga të dyja politikanet është i natyrshëm për vetë formatin e intervistës, e cila zhvillohet në trajtën e një dialogu a bisede të lirë. Megjithatë, ajo që bie në sy në ligjërimin e tyre në rrethanat personale është përpjekja nga ligjërueset për t'i qëndruar sa më pranë gjuhës letrare.

Për sa i përket ligjërimit të shkujdesur, analiza e ligjërimit zbulon përdorimin e saj në raste ekstreme polemizuese dhe agresiviteti në rrethanate opozitës.

Në lidhje me përdorimin e variantit dialektor, vërehet një lëkundje mes drejtshqiptimit të normës letrare dhe të folmes së krahinës, ashtu siç shprehet edhe prof. Shkurtaj se në çdo gjuhë, çdo dialekt a të folme, "ndeshim vazhdimisht dy rrjedha: një paravajtëse apo të risive (inovacioni) dhe një ruajtëse, frenuese, mbajtëse e së vjetrës (konservacioni)", apo siç na e sjell prof. Shkurtaj thënien e Laroshëfukoit: "Theksi i vendit ku ke lindur jeton në shprehje dhe në zemër, ashtu si edhe në të folur" (Shkurtaj 2012: 16).

Në përfundim mund të themi se dukuria e konversacionalizimit apo e informalizimit të gjuhës është tendencë e ligjërimit politik në ditët e sotme. Nga

analiza cilësore dhe ajo krahasuese, rezulton se: së pari, prirja drejt ligjërimit bisedor e ndonjëherë edhe atij të shkujdesur, shfaqet në ligjërimin politik në të gjitha nivelet e gjuhës, në rrafshin morfologjik, sintaksor, leksikor e fonetik; së dyti, nuk shprehet në mënyrë të njëtrajtshme e të qëndrueshme në ligjërimin politik, por mbizotëron në fjalimet e mbajtura nga ligjërueset në kushtet e opozitës; dhe së treti, synon një kuptueshmëri sa më të lartë prej publikut për të fituar sa më shumë popullaritet me qëllim që të krijohet afrimitet me publikun si edhe të sigurohet mbështetja e përkrahja e tyre.

Burimet online të korpusit të analizës

http://www. parlament. al/web/Sesioni_i_pare_15722_1. php– 10 fjalime të mbajtura nga znj. Topalli në periudhën 2009-2013 [tërhequr në qershor 2014].

http://www. president-ksgov. net/?page=1, 8– 15 fjalime të mbajtura nga znj. Jahjaga në cilësinë e presidentes së Republikës së Kosovës në periudhën 2011 - 2015[tërhequr në tetor 2014].

http://www. parlament. al/web/Drejtues_te_Legjislativit_ne_Shqiperi_1146_1. php – fjalimet e mbajtura nga znj. Topalli në foltoren e Kuvendit, në cilësinë e deputetes në opozitë në periudhën tetor 2013 – prill 2014 [tërhequr në qershor 2014].

https://www. youtube. com/watch?v=zkVTD_hOe1YIntervista me znj. Topalli drejtuar nga gazetarja znj. Rudina Magjistari në RTV Klan në 13 shkurt 2013 [tërhequr në qershor 2014].

https://www. youtube. com/watch?v=5IKQjwA0TlAIntervista me znj. Jahjaga drejtuar nga gazetarja znj. Rudina Magjistari në RTV Klan në 17 shkurt të 2014 [tërhequr në qershor 2014].

Referencat

Bourdieu, P. (1991) *Language and Symbolic Power*. Cambridge: Polity.

Giddens, A. (1991) *Modernity and Self Identity: Self and Society in the Late Modern Age*. Stanford, CA: Stanford University Press.

Kress, G. (1986) "Language in the media: The construction of the domains of public and private". In: *Media, Culture and Society 8*; Fowler, R. (1988) Orality models in the press. In *Oracy Matters* (eds.) by Maclure, M., Philips, T., and Wilkinson, A.

Shkurtaj, Gj. (2012) *Dialektet e Shqipes: Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore sipas hartave të ADGJSH-së, Të folmet shqipe të diasporës*. Tiranë: Morava.

Wilson, J. (2001) "Political Discourse". In Schiffrin, D. et al (eds.) (2001*) The Handbook of Discourse Analysis,* USA: Blackwell Publications.

Fairclough, N. (1994) "Conversationalization of Public Discourse and the Authority of the Consumer. " *The Authority of the Consumer*, edited by Russell Keat, Nigel Whiteley, and Nicholas Abercrombie. Routledge.

Lloshi, Xh. (2012) *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*. Tiranë: Albas.

Anila HIMA

CONVERSATIONALIZATION IN THE DISCOURSE OF ALBANIAN FEMALE POLITICIANS

Abstract

The tendency of conversationalization in the public discourse is known as shifting boundaries between written and spoken discourse practices, shifting the public discourse towards a more conversational, informal and spontaneous style to create the impression of a casual conversation with the public. Analyzing a wide range of political speeches held in three discourse contexts - when politicians are in power, in opposition and in the personal context - this paper investigates the phenomenon of conversationalization in the discourse of Albanian female politicians. Using a qualitative and comparative analysis, we aim to examine the form, the context and the purpose of conversationalization in the political discourse of the female politicians. The results are that the tendency towards a conversational and sometimes rather casual discourse is documented on the morphological, syntactic, lexical and phonetic levels; secondly, it is not expressed constantly and consistently in the political discourse analyzed, but prevails in the speeches held by female politicians in the context of the opposition; and thirdly, its purpose is as much public understanding as possible, to gain more popularity in order to secure public understanding, sympathy and support.

Key words: female politicians, political discourse, conversationalization, popularity.

Mensur VOKRRI

SISTEMI RASOR I SHQIPES NË KËNDVËSHTRIMIN HISTORIK

Abstrakt

Me këtë punim mëtohet të jepet sistemi rasor i shqipes shikuar nga aspekti historik nëpër të cilin ka kaluar. Kjo nënkupton se ky sistem rasor do të kundrohet duke u mbështetur në mendimet dhe në teoritë e studiuesve të ndryshëm lidhur me çështje të ndryshme që hyjnë në kuadër të këtij sistemi.

Në këtë kuadër do të shihen çështje të caktuara, si: përkufizimi i rasave, numri i tyre, origjina, trajtat, shkrirja formale, reduktimi, diferencimi formal-funksional, si dhe ndikimi ndërgjuhësor, në njërën anë, dhe trashëgimi i sistemit rasor nga indoevropianishtja apo zhvillimi gjuhësor i këtij sistemi brenda shqipes, në anën tjetër.

Sistemi rasor do të vështrohet brenda gjithë sistemit emëror, por më në veçanti do të trajtohen emrat, që njëherësh janë edhe pjesa thelbësore e këtij sistemi. Sistemi rasor i shqipes së vjetër, qoftë të dokumentuar, ose jo, do të pasqyrohet mbi bazën e sistemit të sotëm rasor të shqipes, përmes rindërtmit të trajtave rasore të dikurshme, qoftë me burim indoevropian, qoftë si zhvillime brenda shqipes së dëshmuar. Nisur nga aspekti sinkronik shqipja është gjuhë me një sistem rasor të përbërë prej pesë rasash, dy nga të cilat cilësohen si të drejta (emërorja e kallëzorja), dhe tri të tjera si të zhdrejta (gjinorja, dhanorja dhe rrjedhorja). Nëse flitet për kohën qysh nga dokumentimi i parë me shkrim i shqipes, sistemi rasor i atëhershëm i saj, sigurisht, nuk ka qenë si ky i sotmi. Ky fakt gjuhësor lidhet me karakterin dinamik të gjuhës dhe evoluimin-zhvillimin e saj nëpër kohë. Gjendjes së sotme gjuhësore të sistemit rasor të shqipes i ka paraprirë një gjendje tjetër gjuhësore me një sistem rasor me më shumë rasa, të trashëguar nga gjuha ie. Ardhja e këtij sistemi deri në gejndjen e sotme, me gjithë zhvillimet gjuhësore, përbën edhe thelbin e hulumtimit të këtij punimi.

Fjalët çelës: *sistem rasor, i shqipes, këndvështrim historik, rasa, sistem emëror*

Hyrje

Sistemi rasor i shqipes së sotme, sipas shumicës së studiuesve, është i përbërë nga pesë rasa, për dallim nga gjuha indoevropiane prej së cilës rrjedh, sistemi rasor i së cilës ka pasur në përbërjen e vet tetë rasa, përcaktim me të cilin janë pajtuar studiuesit gjerësisht.

Koncepti dhe termi i rasës në gjuhët indoevropiane

Në shpjegimin e konceptit të rasës J. Lyons-i përkufizonte se termi latin *casus* (dhe fjala greke, përkthimi i së cilës është edhe termi latin) do të thotë "rënie" ose "shmangie". (Lyons,:2010; 271). Se cili është shkaku i përdorimit metaforik të këtij termi nga teoria e gramatikës (me siguri që për këtë nuk janë të gjithë të një mendjeje), tani dihet: ndryshimet e formës së një lekseme sipas sintaksës së gjuhës mbahen si shmangie nga forma e "drejtë" normale. Te stoikët fjala "casus" mori një kuptim të veçantë, të cilin e ruan në terminologjinë gramatikore qysh atëherë. Rasa ishte kategoria më e rëndësishme eptimore e emrit, siç ishte koha te folja. Është për t'u shenjuar që termi "casus" (burimisht pak a shumë sinonim me atë që më vonë u quajt "flexion") u kufizua në një kategori eptimore. Arsyeja duket se qëndron në rrethanën që shumica e kategorive të tjera: gjini, numër, kohë, vetë etj. mund të nxirreshin nga një parim semantik klasifikimi. Çdo rasë e emrit u pajis me një emërtim, i cili tregonte, së paku, një funksion shumë të rëndësishëm semantik (p.sh., "dhanorja" ishte rasa, e cila vendosej në lidhje me konceptin e "dhënies", "rrjedhorja" kishte të bënte me "largimin" etj.) dhe, megjithatë, nuk ishte e mundur të paraqitej një përkufizim i përgjithshëm dhe i kënaqshëm për vetë kategorinë e rasës brenda semantikës. Së fundi, përkufizimet e trashëguara të kategorisë së rasës për latinishten dhe greqishten (dhe për gjuhë të tjera indogjermane) nuk tregojnë më shumë se ç'vijon: nga dy kategoritë e eptimit emëror, njëri është numri (i cili është i përkufizueshëm në rrafshin e semantikës dhe që mund të lidhet me kategorinë sasiore aristoteliane), tjetri është rasa. Kategoria e rasës ishte, si të thuash, kategoria gramatikore më rrënjësore ndër katëgoritë eptimore tradicionale, sepse ajo nuk pati asnjë përgjegjëse në shkencat simotra: logjikë, epistemologji dhe metafizikë. (Lyons: 2010)

Sistemi rasor i gjuhës indoevropiane dhe mbaresat rasore të këtij sistemi

Gjuha e lashtë ie. është karakterizuar nga një sistem rasor prej tetë rasash. Sistemi rasor i kësaj gjuhe përbëhej nga këto rasa: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore,

rrjedhore, thirrore, vendore dhe instrumentale. (E. Çabej, 1986: 95; S. Riza, 2002: 20-22; K. Topalli, 2009: 45)

Meqë po flasim për rasat dhe numrin e tyre në gjuhën ie., le t'i shohim ato me mbaresat e tyre përkatëse në paraqitjen e tyre tabelare.

Rasa	Njëjës	Shumës	Dual
Emërore	-s, -ø	-es	-e, -ī / i
Thirrore	-ø	-es	
Kallëzore	-m / -m	-ns / -ns	
Gjinore	-es / -os / -s	-om / -ōm	-ous, -ōs
Rrjedhore	-es / -os / -s -ed / -od	-bh(y)os, -mos	-bhyō, -mō
Dhanore	-ei	-bh(y)os, -mos	-bhyō, -mō
Vendore	-i	-su	-ou
Instrumentale	-e / -o, -bhi / -mi	-bhis / -mis, -ōis	-bhyō, -mō

1. Tabela e sistemit rasor të gjuhës ie. me mbaresat rasore përkatëse. (Topalli: 2009; 46-47)

Funksioni i rasave në gjuhën ie.

Rasat në gjuhën ie. kanë pasur funksione të ndryshme, me të cilat shpreheshin lidhjet e emrit me gjymtyrë të tjera në fjali. Funksionet e rasave dihen përgjithësisht dhe këtu vetëm do të jepen më kryesoret në formë të përmbledhur. Rasa emërore ishte rasa e kryefjalës, e kallëzuesit emëror dhe e kallëzuesorit të kryefjalës. Rasa thirrore shprehte thirrorin. Kallëzorja shprehte kundrinën e drejtë dhe kallëzuesorin e kundrinës së drejtë. Rasa gjinore shprehte përcaktorin emëror. Dhanorja shprehte kundrinën e zhdrejtë. Rrjedhorja shprehte rrethanorin e vendit e të kohës, sidomos kur tregonte largim nga një pikë e caktuar. Edhe rasa vendore shprehte rrethanorët e vendit e të kohës. Kurse instrumentalja shprehte rrethanorët e mjetit e të shoqërimit (Çabej, 1986: 95; Bokshi, 2005: 339-340); Topalli, 2009: 47; J. Lyons, 2010: 271-276).

Mjetet dalluese të rasave në gjuhën ie.

Mjetet me të cilat dalloheshin rasat e ndryshme në gjuhët ie. kanë qenë: mbaresat rasore, këmbimet apofonike të zanoreve të temës dhe lëvizja e theksit, nga të cilat më të rëndësishmet mbaresat rasore. (Topalli: 2009; 46)

Koncepti dhe termi i rasës në gjuhën shqipe

Duke e shpjeguar konceptin e rasës dhe termin me të cilin përdoret ajo, Gramatika e gjuhës shqipe 1 e AShSh-së, në kuadër të njohurive të përgjithshme, jep këtë përkufizim: "Ermi në fjali përdoret në funksione të ndryshme sintaksore, në rolin e gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë. Në varësi nga kjo ndryshon edhe forma e tij. Këto forma të emrit, me anën e të cilave shprehen lidhjet e tij me fjalët e tjera në fjali, quhen *rasa"*. (Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe 1: 2002; 105). Sipas saj, kur flitet për rasat si kategori gramatikore, kihen parasysh forma të caktuara të emrit dhe kuptimet gramatikore që shprehen me anë të tyre. Tërësia e gjithë ndryshimeve që pëson emri, kur përdoret në rasa të ndryshme, quhet lakim. (Gramatika e Akademisë: 2002)

Kuptimet dhe funksionet kryesore të rasave në shqipen

Sa u përket kuptimeve dhe funksioneve të rasave në gjuhën shqipe do të mjaftohet të shihet se cilat prej rasave nuk kanë funksione të njëjta nga shqipja e vjetër deri në shqipen e sotme, pa u ndalur këtu në hollësi, për shkak të natyrës së punimit. Këtu do të mjaftohet të thuhet se shumica e rasave në shqipen i kanë trashëguar kuptimet dhe funksionet kryesore nga gjuha indoevropiane, siç u pa më lart, derisa për paraqitje më të plotë të tyre në gjendjen e sotme gjuhësore të shqipes, këto mund të shihen më gjerësisht te Gramatika e gjuhës shqipe 1 e AShSh-së. Për sa u përket ndryshimeve të rasave në kuptimet dhe në funksionet e tyre që nga shqipja e teksteve të vjetra e deri në shqipen e sotme të shkruar, Rizës i dalin dy rasa që i paraqesin këto ndryshime dhe ato janë dhanorja e rrjedhorja. Sipas tij, në shumicën e gramatikave të shqipes së sotme dhanorja e teksteve të vjetra në bashkëvajtje të detyrueshme me parafjalën prej vështrohet patjetër si një rasë e veçantë, e pikërisht si një rrjedhore e re, makar analitike, por e mirëfilltë, siç e quan ai. (Riza: 2002; 104) Për më tepër, vazhdonte ai, në të njëjtat gramatika, dhanorja e teksteve të vjetra vështrohet si rrjedhore e mirëfilltë edhe atëherë kur kjo përdoret në bashkëvajtje p.sh. me parafjalën mbas (pas). Në këtë pië Riza vëren se në këto gramatika vazhduesja në shqipen e sotme e dhanores së teksteve të vjetra vështrohet në një anë si dhanore e në anën tjetër si rrjedhore, duke hetuar se në kalimin nga shqipja e teksteve të vjetra në shqipen e sotme letrare, qenka zhvilluar një ndryshim jo në kuptimet e dhanores, por në vetë dhanoren, e cila, në një anë, paska mbetur dhanore, e në anë tjetër, qenka bërë rrjedhore. (Riza: 2002; 104). Ai jepte idenë se J. Rrota në "*Analyzimi* etj." dhe ai vetë në punimin "*Emrat në shqipe, Sistemi i rasave dhe tippet e lakimit*" kanë mbrojtur tezën se mënjanimi i konstruktit: "*prej (mbas) doret* etj." në të mirë të konstruktit: "*prej (mbas)*

dorës etj." përbën një shndërrim jo rase emrash, por reksioni parafjalësh; e për pasojë se, edhe brenda konstruktit të dytë, emri mbetet që mbetet në dhanore. Sipas kësaj teze, kuptimet e rrjedhores së teksteve të vjetra i ka trashëguar dhanorja e shqipes së sotme; e për pasojë vazhduesja në shqipen e sotme e dhanores së teksteve të vjetra kuptimeve vetjake, përkatësisht përdorjeve vetjake, u ka mbishtuar kuptimet përkatësisht përdorjet e rrjedhores së teksteve të vjetra (e cila, siç dihet, ka dalë jashtë përdorimit të përgjithshëm në shqipen e sotme). (Riza: 2002; 105). Kur bëhet fjalë për rjedhoren e teksteve të vjetra, e cila ka dalë nga përdorimi në shqipen e sotme, duhet parë nëse ajo shfaqet në formë reliktore apo jo. Për Rizën, kjo rrjedhore shfaqet në një mënyrë makar kryesisht reliktore. Mirëpo, për këtë çështje, Riza shtronte një pyetje thelbësore, e cila ka të bëjë me atë nëse kuptimet e vetë rrjedhores në tekstet e vjetra, si të thuash, kuadrojnë apo jo me kuptimet e relikteve të saj në shqipen e sotme. Përpara se t'i jepet përgjigje kësaj pyetjeje, Riza shtronte një cështje tjetër, po ashtu thelbësore, me të cilën do të dalloheshin reliktet e rrjedhores në të cilat emri është plotës dallimi i një emri tjetër, nga reliktet e kësaj rase ku emri në të është plotës rrethane i një foljeje. Sipas Rizës, në situatën e parë sintaktike, ku rrjedhorja e teksteve të vjetra në paraqitjen e shkruar të shqipes së sotme njeh një përdorim vërtet kryesisht reliktor, por prapëseprapë mjaft të gjerë e madje në zgjerim e sipër, duke thënë që nuk ka mundur të konstatohet asnjë moskuadrim kuptimor në këtë mes. Ndërsa, në situatën e dytë sintaktike, ku rrjedhorja e shqipes së teksteve të vjetra përbën në shqipen e sotme, si të shkruar ashtu edhe të folur, një relikt nga më të rrallët, duke konstatuar një moskuadrim kuptimor makar të pjesshëm. Për ta përmbyllur mbi kuptimet e rrjedhores, Riza konstatonte tezën, sipas së cilës, sa herë që kuptimet e kësaj apo asaj rase në tesktet e vjetra nuk kuadrojnë me kuptimet e së njëjtës rasë në reliktet e sotme, aq herë kemi të bëjmë jo me sintaksën e mirëfilltë të gjuhës shqipe në epokën përkatëse, por përkundrazi me kopjime të thjeshta nga sintaksa latine përkatësisht italiane. Lidhur me këtë çështje, Riza e kishte ngritur këtë tezë duke u bazuar në autorët e vjetër të shqipes, më së shumti duke u mbështetur sidomos në tekstin e Buzukut, në një anë, dhe të Bogdanit, në anën tjetër. Për Buzukun arsyeja që paraqiste Riza ishte se autori i parë i shkrimit të shqipes kishte një formim kulturor të përgjithshëm dhe gjuhësor të veçantë tepër modest për kohën e vet. Si rezultat, Buzuku në vend që tekstin origjinal të huaj ta shqipëronte fjali për fjali ose togfjalësh për togfjalësh, mjerisht një numër të mirë herësh e ka shqipëruar përkundrazi fjalë për fjalë, e madje morfemë për morfemë. Ndërsa, për Bogdanin, arsyet që sillte Riza kishin të bënin me virtuozitetin e tij si poliglot duke ia topitur jo pak ndjenjën gjuhësore si shqipfolës, pastaj me atë se duke qenë lëvrues sistematik i letrarishtes shqiptare as për së largu nuk u proekupua për pastërtinë e gramatikës sa u pasionua për pasurimin e

fjalorit e më në fund, siç shprehet Riza, Bogdani, i cili në përpilimin përfundimtar të veprës së vetme të mbarë jetës së tij e udhëhoqi një prirje vërtet gjithnjerëzore, por veçanërisht shqiptare, prirje që duket gjithmonë e frymëzuar nga mbrothësia, por që në fakt është tepër shpesh pjellë e padurimit, e pikërisht prirja për të bërë një udhë e dy punë. (Riza: 2002; 105-110)

Sistemi rasor i shqipes së dokumentuar dhe asaj së sotme me mbaresat rasore

Ndryshe nga sistemi rasor indoevropian, shqipja, qysh prej dokumentimit me shkrimet e para, përgjithësisht mendohet se në sistemin e saj rasor ka pasur shtatë rasa: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore thirrore dhe vendore (kjo e fundit siç parapëlqehet nga Riza të quhet kallëzore parafjalore). (Riza: 2002; 22) Ndërsa në gjendjen e sotme gjuhësore shqipja vazhdon të ketë pesë rasa të mirëfillta (Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe 1: 2002; 106), plus një dytësore (dikur vendore, tash kallëzore parafjalore), pa thirroren (Riza: 2002; 22). Disa gramatika të shqipes, sipas Gramatikës së AShSh-së, e njohin si rasë të veçantë edhe thirroren, duke u nisur si nga kuptimi ashtu edhe nga pjesëza pasthirrmore *o*, që mud të vihet edhe para edhe pas emrit: o bir! dhe biro! Mirëpo, arsyetimin e mospranimit të thirrores si rasë të veçantë në shqipen, Gramatika e AShSh-së e jep përmes dy fakteve. Njëri fakt lidhet me përdormin e thirrores kryesisht në trajtën e pashquar, e cila duke mos pasur tregues tjetër përveç *o*-së, që edhe mund të mungojë, del e njëjtë me trajtën e emërores: Dëgjo, **baba**! Fakti i dytë ka të bëjë me mbiemrat dhe fjalët e tjera përcaktuese që i përshtaten emrit në rasë, kur ky emër përdoret në funksionin e thirrorit, plotës këta që kanë trajtën e emërores: ***Vëlla i dashur****, dëgjo edhe nga unë një fjalë.* Pra, sistemi rasor i shqipes së sotme, sipas Gramatikës së gjuhës shqipe 1 të AShSh-së, hartuar nga grup autorësh, del me këto rasa: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore.

Sipas Bokshit, kategoria e rasës në shqipen e dokumentuar paraqitet në këto forma:

-ø, -ë, -i, -u, -e, -ve, -sh

me këtë lidhje paradigmatike rasore:

a) 1. → nom. –akuz. √ *-ø, -ë*

2. → gen. –dat. –abl. √ [2] *-i, -u, -e*

→ gen. –dat. √ *-e, -ve*

2. → abl.: *-sh*

Nga kjo paradigmë dalin këto raporte me nominativin:

b) 1. → -ø √ [4] *–i, -u, -e, -ve, -sh*

2. → -ë √ *-i, -e*

Mbaresa rasore përmban edhe kuptimin e numrit, prandaj paraqitet me këtë paradigmë numri:

c) → njëjës √ 4 *–ø, -ë, -i, -u, -e*
→ shumës √ 3 *–ø, -e, -ve, -sh*

Përveç këtyre, është edhe paradigma e gjinisë, që realizohet vetëm brenda elementit të njëjësit në mbaresën e gen. –dat. –abl.:

d) → gjinia m. √ *-i, -u*
→ gjinia f.:*-e* (Bokshi: 2005; 115)

Sistemi rasor i shqipes trashëgim nga gjuha ie. apo zhvillim e riformim i brendshëm i saj?

Krahasuar me sistemin rasor të indoevropianishtes, shqipja ka bërë ndryshime të mëdha dhe sistemi rasor i kësaj të fundit shfaqet tërësisht i riorganizuar, duke mbetur shumë pak gjë nga sistemi i vjetër. (Topalli: 2009; 48) Përveç reduktimit të numrit të rasave nga gjuha ie. në shqipen, sipas shumë studiuesve, edhe mbaresat nuk janë të gjitha të trashëguara, madje, sipas Bokshit, asnjë nga mbaresat rasore të shqipes së fazës së dokumentuar nuk janë reflekse të mbaresave rasore të gjuhës ie., por zhvillime e formime të veçanta brenda shqipes. Këtë përcaktim të natyrës dhe të origjinës së mbaresave rasore të shqipes Bokshi e nxirrte nga analiza e niveleve sinkronike nëpër vertikalen e gjatë diakronike të temave emërore në gjuhën shqipe në veprën monografike Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes. (Bokshi: 2005)

Nga të gjitha rasat e indoevropianishtes, në shqipen dokumentohen emërorja, gjinorja, dhanorja, kallëzorja, rrjedhorja dhe vendorja dikur, ose sot kallëzorja parafjalore, nga të cilat kjo e fundit në shqipen e sotme nuk del në trajtën e mëhershme, si p.sh. në malt, por përfaqësohet nga rasa e ashtuquajtur kallëzore parafjalore, e cila e zëvendëson formën e vjetër në të gjitha rastet. Ndërkaq, në shqipen nuk dalin dy rasa, të cilat i ka pasur gjuha ie., e të cilat janë thirrorja e instrumentalja. Funksionin e thirrores e kryen emri pa mbaresë, pra emërorja e pashquar, kurse funksionet e instrumentales i kryejnë kallëzorja parafjalore e po ashtu edhe rrjedhorja. (Topalli: 2009)

Mjetet e shqipes për krijimin dhe dallimin e mbaresave rasore

Për sa u takon mbaresave rasore, meqenëse shumica e mbaresave të trashëguara ka rënë për shkak të veprimit të fuqishëm të theksit dinamik, sipas Topallit, shqipja ka krijuar mbaresa të reja. Për krijimin e tyre një rol të dukshëm kanë luajtur nyjat e prapme, me të cilat krahas shprehjes së një kategorie të re që s'e ka pasur gjuha ie. (shquarsisë), shqipja shpreh kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit e rasës. Me këtë ajo ka zhvilluar më tej karakterin sintetik, pasi nyjat e prapme u ngjiten emrave duke zënë po atë pozicion që kanë pasur mbaresat në gjuhën ie. Një mjet tjetër që ka krijuar shqipja për të dalluar rasat është nyja e përparme, me të cilën dallohet rasa gjinore nga dhanorja. Ky mjet i ri i dallimit rasor, që ka karakter sintaksor, është tipar analitik, që është karakteristik për të gjitha gjuhët e sotme që e kanë humbur pjesërisht ose tërësisht sistemin e vjetër të lakimit. Mjeti tjetër sintaksor që ka zhvilluar shqipja për dallimin e rasave janë edhe përcaktorët. Pra, në rasat gjinore e dhanore të numrit shumës, ku është zhdukur dallimi i trajtës së shquar nga e pashquara, ky dallim bëhet vetëm me antë të përcaktorëve, që janë të pranishëm në trajtën e pashquar (*fjalët e* ***këtyre*** *burrave*), por mungojnë në trajtën e shquar (f*jalët e burrave*). Edhe ky mjet është zhvillim i mëtejshëm i analitizmit. Për sa u takon mjeteve të tjera që ka pasur gjuha ie. për të dalluar rasat, apofonia me të dy llojet, nuk ka lënë gjurmë në sistemin rasor të shqipes. Gjatë lakimit të emrit tema e tij mbetet e pandryshuar. Por disa ndryshime të vjetra zanoresh me karakter apofonik dalin në dallimin e temës së njëjësit nga ajo e shumësit, khs. nj. *grua ~ gra*. Edhe ndryshimet e zanoreve me karakter metafonik, që janë zhvillim i brendshëm i "nënës" së shqipes në një periudhë mjaft të hershme, shfaqen në temën e shumësit, duke e dalluar atë nga tema e njëjësit; khs. *plak ~ sh. pleq, atë ~ etër* etj. Përkundrejt këtyre ndryshimeve të lashta, disa ndryshime të tjera të zanoreve, që shfaqen në paradigmat e numrit njëjës, kanë ndodhur në periudha të mëvonshme, për shkak të pranisë së nyjave në trajtën e shquar dhe mungesës së tyre në të pashquarën (khs. *ftua ~ ftoi, kapruall ~ kaprolli* etj.). ndërsa, sa i përket theksit, lëvizja e të cilit ka qenë një mjet i dallimit rasor në indoevropianishte, në gjuhën shqipe rastet e lëvizjes së tij kanë mbijetuar vetëm në rastet e dallimit të temës së njëjësit nga shumësi (khs. *dhëndër ~ dhëndurë, gjarpër ~ gjarëpërínj, lumë ~ luménj* etj.). Ndërsa brenda paradigmave të lakimit, në rasa të ndryshme, theksi i fjalës mbetet i palëvizshëm duke qëndruar gjithnjë mbi një zanore të temës. Ai nuk zhvendoset asnjëherë në mbaresat rasore. (Topalli: 2009; 49-50)

Ndryshime të tjera rasore të shqipes brenda zhvillimit të saj

Përveç zhvillimeve gjuhësore të përmendura më lart, Topalli mendon se shqipja në zhvillimin e saj të brendshëm ka bërë edhe ndryshime të tjera në sistemin rasor, krahasur me tipin e lashtë indoevropian, nga të cilat vihen në dukje:

Sinkretizmi (bashkimi ose shkrirja e rasave të ndryshme në të njëjtën formë). Në shqipen sinkretizëm përbëjnë gjinorja me dhanoren e më vonë këtyre u është bashkuar edhe rrjedhorja dhe kallëzorja e pashquar me emëroren. Në këtë pikëpamje shqipja ka reduktuar numrin e rasave dhe, si edhe gjuhë të tjera të kësaj familjeje, e ka thjeshtuar sistemin rasor të trashëguar;

Krahas pakësimit të numrit të rasave me anë të sinkretizmit të tyre, ka ndodhur procesi i kundërt, numri i formave rasore është shtuar me krijimin e nyjave, që i kanë dyfishuar paradigmat e lakimit në të pashquar e të shquar. Edhe në këtë drejtim shqipja ka ecur përkrah disa gjuhëve të tjera, që kanë krijuar një sistem të tillë rasor me anë të nyjave të prapme (sidomos rumanishtes);

Forma rasore e emërores shumës shërben si temë për të gjitha rasat e tjera, të cilat i marrin mbaresat rasore në një mënyrë aglutinative (khs. em. *plak-ī* > *pleq,* gjin. *pleq-(v)e-t*, rrj. *pleq-sh*;

Numri i rasave është shtuar edhe nga krijimi i ndonjë forme të re rasore, siç është kallëzorja parafjalore, si zhvillim i brendshëm i shqipes;

Numri i formave rasore nuk është i barabartë si për njëjësin, ashtu edhe për shumësin. Në njëjës është ruajtur dallimi formal i formave rasore sipas gjinive; kurse në shumës ka vepruar sinkretizmi duke krijuar mbaresa të përbashkëta për të gjitha gjinitë;

Sinkretizmi nuk është kurdoherë i njëjtë si për trajtën e pashquar, ashtu edhe për të shquarën. Kështu p.sh., sinkretizmi i emërores dhe kallëzores ka prekur trajtën e pashquar dhe të dyja trajtat e shumësit të shquar, por ka lënë të paprekur të shquarën e njëjësit. Edhe sinkretizmi i rrjedhores me gjinoren e dhanoren ka prekur njëjësin, por jo edhe shumësin. Funksionet kryesore të rasave shqipja i ka ruajtur, por shpeshherë ato kanë kaluar prej njërës rasë tek tjetra. Në zhvillimin e saj të brendshëm shqipja ka krijuar edhe funksione të tjera të formave rasore. (Topalli, 2009: 50-51)

Mjetet gramatikore të shqipes për ndërtimin e formave gramatikore të sistemit razor

- Mbaresat rasore (*një lis**i**, një nën**e**, male**sh***);
- Nyjat e prapme (*lis**i**, nën**a**, male**t***);

- Nyjat e përparme (***i*** *lisit,* ***e*** *nënës*);
- Prapashtesat trajtëformuese (*lis**a**, mal**e***);
- Ndërrimet fonetike në temë (*d**a**sh* ~ *d**e**sh, mi**k*** ~ *mi**q***);
- Rëniet e fonemave (*zã* / *zë* ~ *zani* / *zëri*);
- Zanoret anaptitike (*nxënës-**i**-t*);
- Bashkëtingëlloret që zhdukin hiatin (*be-**j**-a, dhi-**v**-e*);
- Nyja joshquese (***një*** *lis*);
- Përcaktorët përemërorë (*gjethet e* ***ca*** *lisave*);
- Parafjalët (***në*** *malit*);
- Pasthirrmat (*djal**o**, nën**o**,* ***or*** *djalë,* ***moj*** *nënë*) (Topalli, 2009: 58-59)

Kriteret për përcaktimin e rasave në gjuhë të ndryshme

Përgjithësisht, përcaktimi i rasave në gjuhë të ndryshme bëhet duke marrë parasysh ndryshimet e formave gjatë lakimit. Dy forma rasore u përkasin rasave të ndryshme kur ato kanë forma të veçanta për secilën rasë, p.sh.: lat. *lupus* (em.) ~ *lupum* (kall.). Ky kriter është zbatuar edhe për shqipen. Kështu p. sh., emërorja në të pashquarën dallohet nga dhanorja, për mbaresat e kësaj të fundit *–i / -u* për gjininë mashkullore (khs. *(një) lis* ~ *(një) lisi, (një) mik* ~ *(një) miku*; ose emërorja e shquar dallohet nga kallëzorja përkatëse, pasi e para ka mbaresat *–i, -u* ~ *-a*, sipas gjinisë përkatëse, ndërsa e dyta ka mbaresën *–në.* (Topalli: 2009: 52)

Kriteret për përcaktimin e numrit të rasave në gjuhën shqipe

Në përcaktimin e numrit të rasave të sistemit rasor të shqipes, sipas Topallit, janë marrë parasysh tri kritere bazë: **morfologjik, sintaksor e funksional**. (Topalli, 2009: 56)

Sipas kriterit morfologjik, që është kriteri themelor, rasa kallëzore merret si rasë më vete për shkak të trajtës së shquar numër njëjës *(malin)*, që ndryshon nga rasat e tjera (khs. *mali* ~ *malit* ~ *malin*), kurse në trajtën e pashquar ajo ka rënë në emërues të përbashkët me emëroren përkatëse *(një mal)*. Rrjedhorja merret si rasë e veçantë për hir të trajtës së pashquar shumës *(malesh)*, që ndryshon nga rasat e tjera *(male* ~ *meleve* ~ *malesh)*, kurse në njëjës edhe kjo është bërë një me gjinoren e dhanoren *(një mali)*. Mirëpo kriteri morfologjik plotësohet edhe nga dy kriteret e tjera. (Topalli, 2009: 57)

Sipas kriterit sintaksor, gjinorja, megjithëse ka rënë në emërues të përbashkët në të gjitha format me dhanoren, merret si rasë më vete për hir të nyjës së përparme që e merr ajo. Gjithnjë sipas këtij kriteri, e pashquara e gjinores e dhanores shumës dallohet

nga e shquara e të njëjtave rasa nga fjalët përcaktuese që merr *(leshi i këtyre deleve)*, në një kohë që trajta e shquar, e cila del me të njëjtën formë, nuk merr përcaktorë të tillë *(leshi i deleve)*. Në këtë rast dallimi i trajtave e pashquar ~ e shquar ka karakter sintaksor. (Topalli, 2009)

Kriteri funksional ndërhyn kur përkatësia rasore e një emri nuk zgjidhet me dy kriteret e para. Kështu, p.sh., në fjalinë *dimrit bën ftohtë*, kurse *verës bën vapë*, emrat *dimrit* e *verës*, që kanë të njëjtën formë për rasat dhanore e rrjedhore, do të merren si të rasës rrjedhore, sepse funksioni i shprehjes së kohës është atribut i rrjedhores. Po kështu, në fjalinë *shëtiste gjithnjë maleve*, emri *maleve*, që ka formë të njëjtë për dhanoren e rrjedhoren, do të merret si i rasës rrjedhore, meqenëse shprehja e vendit është funksion i rasës rrjedhore e jo i dhanores. (Topalli, 2009)

Kundërthëniet lidhur me kriteret e përcaktimit të rasave në shqipen

Kontradiktat lidhur me kriteret e përcaktimit të rasave Topallit i dalin si vijon:

- Gjinorja, kur nuk merr nyjë të përparme, mund të përzihet me dhanoren, që ka të njëjtat mbaresa; p.sh.: *krijuesi* ***ujit*** (Bogdani CP I 32, 1) çam.: *djali* ***pashait*** (Pedersen AT 9). Në të tilla raste, edhe në mungesë të nyjës, emri do të merret i gjinores për hir të funksionit të tij, pasi ai shërben si përcaktor i një emri tjetër duke u vendosur gjithnjë prapa tij. (kujto funksionin e emrit në dhanore si kundrinë e zhdrejtë e jo përcaktor); - Në disa raste funksionin e gjinores e ka marrë rrjedhorja. Në sintagmat *ujë mali, mish kau*, emri i dytë funksionalisht është në gjinore dhe historikisht ka qenë i tillë, sepse ai shërbën si përcaktor i një emri tjetër, por ai ka marrë formën e rrjedhores, meqenëse del pa nyjë të përparme, si rrjedhim, në shumës merr mbaresën *–sh* të kësaj rase *(ujë malesh)*; - Funksionin e rrjedhores e shpreh forma e dhanores. Kështu, në fjalitë *ecte rrugës*; *kalo anës* emri ka formën e dhanores, mbasi rrjedhorja do të ishte *rruget, anet*, por funksioni i emrave në këtë rasë është ai i rrjedhores, pasi tregohet vend dhe folja nuk mund të marrë forma të patheksuara përemrash, që janë karakteristike për dhanoren. Kjo ndodh edhe në shumës, ku shprehjet *prej maleve*, *përtej kodrave* funksionalisht janë rrjedhore, pasi shprehin vend, por ato janë shpehur me formën e dhanores (rrjedhorja do të ishte malesh, kodrash). Edhe në shprehjen *pas dy vjetëve* emri ka formë dhanore (rrjedh. *vjet-sh*, khs. jam *dy vjeç* nga *vjet-sh*), por është në funksion të rrjedhores, gjë që e dëshmon edhe parafjala që ka përpara; - Në disa raste forma rasore e së shquarës është zhdukur dhe funksionet e saj i kryen e pashquara. Kështu, në shumës, ndërsa emërorja e ka ruajtur dallimin ndërmjet këtyre dy trajtave (khs. *male* ~ *malet*), në gjinore e dhanore ky dallim është shlyer, meqenëse ka rënë nyja shquese duke e neutralizuar dallimin formal ndërmjet këtyre trajtave (*maleve*). Një dukri

e tillë ka ndodhur edhe në rrjedhore, ku trajta e shquar e kësaj rase ka dalë nga përdorimi dhe është zëvendësuar nga forma e dhanores *(*maleshit = maleve)*; - Trajta e pashquar ka zëvendësuar të shquarën edhe në rasën kallëzore parafjalore. Në fjalitë *po shkoj në shtëpi*, *po dal në oborr* etj., megjithëse emrat formalisht janë në të pashquarën, ata janë të përcaktuar, domethënë kryejnë funksionin e emrave të shquar, pasi këtu flitet për një shtëpi a oborr të njohur, duke nënkuptuar *"po shkoj në shtëpinë time" (khs. Po vij nga shtëpia)* ose *"po dal në oborrin e shtëpisë sime"*. Këtë e tregon edhe fakti se, po të përdoret nyja joshquese *një* përpara emrave në ndërtime të tilla me parafjalë *(po shkoj në një shtëpi)*, do të ndryshonte krejtësisht kuptimi. Te Buzuku raste të tilla shprehen përgjithësisht me trajtën e shquar të kallëzores parafjalore, p.sh.: *E hipi Moiseu̧ mbë malt, e malnë e mbëloi nięgulla* (XLIV/2a); - Forma e emërores së pashquar shërben për të kryer edhe funksionin e thirrores. Kështu, emrat e rasës thirrore kanë vetëm një formë, që del pa mbaresë (o Shqipëri). Kjo formë fonetikisht pajtohet me emëroren e pashquar, por, në këtë rast, ajo shpreh një emër të përcaktuar, domethënë funksionalisht të shquar. Ndërtimet e thirrores me një emër në të shquarën janë të pamundura *(**o Shqipëria, **o djali)*, përveç rasteve kur ky emër i shquar ndiqet nga ndonjë gjymtyrë plotësuese *(khs. o Shqipëria ime, o djali i nënës)*; - Një kontradiktë tjetër krijohet ndërmjet dy trajtave të shumësit në rrjedhore. Nëse forma *malesh* merret si trajtë e pashquar dhe forma *maleve* si e shquar (ashtu sikurse veprohet përgjithësisht në gramatikat e sotme), atëherë forma *maleve*, kur paraprihet nga një përcaktor dhe është në funksion të rrjedhores *(p.sh., ai shëtiste gjithnjë këtyre maleve)*, duhet të merret si rrjedhore e pashquar, ashtu si në gjinore e dhanore, për arsye se, kur ka një përcaktor përpara, emri mund të përdoret vetëm në të pashquarën *(khs. në njëjës këtij mali)*. Në këtë rast rrjedhorja e pashquar do të dilte me dy forma: *malesh* dhe *maleve*, gjë që do të krijonte kontradiktë të hapur me parimin morfologjik. (Topalli, 2009: 53-56)

Origjina e mbaresave rasore të rasave të shqipes

Për origjinën e mbaresave rasore të shqipes gjuhëtarët kanë shprehur mendime të ndryshme. Disa nga ta (Meyeri, Pederseni) e mbështesin qëndrimin se mbaresat rasore të sistemit të shqipes burojnë nga mbaresat rasore të gjuhës së lashtë ie. Disa të tjerë (Çabej, Riza, Demiraj, Topalli) e mbrojnë mendimin se mbaresat rasore të shqipes vetëm pjesërisht kanë origjinë nga mbaresat rasore të gjuhës ie. Në fund, ka edhe të tillë që mendojnë dhe kanë provuar ta vërtetojnë se mbaresat rasore të shqipes nuk rrjedhin nga mbaresat përkatëse të indoevropianishtes (Bokshi), por janë krijuar në një fazë më të hershme të zhvillimit të shqipes si gjuhë e veçantë.

Rasat emërore e kallëzore

Sinkretizimi në shqipen e dokumentuar nuk është i trashëguar nga faza para rënies e reduktimit të tingujve fundorë, por është krijuar më vonë, kur u krijuan mbaresat rasore. Emërorja e kallëzorja mbetën me mbaresa të ndryshme vetëm në njëjës të emrave mashkullorë e femërorë, ndërsa në shumës dhe në gjininë asnjanëse kishin dalë sinkretike më përpara. Ky përfundim u arrit në bazë të gjendjes në shqipen e dokumentuar, ku vetëm trajta e shquar e njëjësit të emrave të gjinisë mashkullore e femërore del me *–n(ë)*, të cilën, që nga Pederseni, e nxjerrin të analizueshme në mbaresë rasore të kallëzores *–m* a *–n*. (Bokshi: 2005; 122). Sa i përket kësaj dukurie, pra sinkretizmit, Riza mendonte se nuk bëhet fjalë për sinkretizëm të mirëfilltë, por për bashkëndeshje tingullore ose koincidencë fonetike. Prandaj edhe në historinë e shqipes paraletrare, sipas tij, barazia morfologjike e kallëzores së një emri (qoftë mashkullor, qoftë femëror) me emëroren përkatëse ka përbërë pikërisht një shfaqje jo sinkretizmi të mirrëfilltë, por bashkëndeshjeje tingullore, si rezultat i zhdukjes përkatësisht dobësimit të tingujve fundorë të trajtave përkatëse. (Riza, 2002: 23). Këtë çështje Riza e shpjegonte dhe e arsyetonte me dy fakte të rëndësishme, ku njëri fakt ka të bëjë me zhdukjen e një rase nga sistemi i lakimit të një gjuhe, funksionet e së cilës i kalojnë në mbingarkesë një rase tjetër dhe, fakti tjetër, si rezultat i të cilit dy rasa të veçanta e barabar ekzistuese, si rrjedhojë efekti fenomenesh thjesht fonetike, janë njëjtësuar në paraqitjen e tyre morfologjike. Në këto fakte Brugmani (Kurze vergl. Gram. der indog. Sprachen, f. 418-419), cituar sipas Rizës, kishte parë një shfaqje të sinkretizmit rasor (Kasussynkretismus), koncept dhe term të cilin J. Marouzeau (Lexique de la terminologie linguistique, f. 220) me të drjetë e kishte rezervuar vetëm për faktin e parë. Me të drejtë, për Rizën, sepse në vetvete këto dy fakte janë kryekëput e gjithandej të tjetërllojshme, e, si të tilla, duhen dalluar edhe në të quajturit e tyre. (Riza: 2002; 23)

Nyja shquese *–n(ë)* historikisht mendohet të jetë mbaresë-nyjë. Ky mendim, i shprehur së pari nga Pederseni, u pranua në parim si i pakundërshtueshëm nga të gjithë studiuesit. Pederseni e solli *–n(ë)*-në nga *–am* + *tam* nëpër fazat: *-mt* > *-nd* > *-n*. Këtij procesi La Piana, Domi e Çabej ia shtojnë edhe fazat *–nt e –nn*. Duke e lënë plotësisht të pacenueshme saktësinë e tezës së Pedersenit se kallëzorja e shquar e shqipes së sotme p.sh., *nusen(ë)* … ka dalë nga bashkimi i kallëzores së pashquar të shqipes së dikurshme *nusen* … me nyjën e prapme (ndërkohësisht të zhdukur): *-të*, Riza i ka bërë kësaj teze korrigjimin që pason: aglutinimi i nyjës ka ndodhur në kohën kur mbaresa *–m* e akuzativit kishte kaluar spontanisht në *–n* dhe kur nyja ishte të, pra *nusen* + *të* > *nusentë* > *nusen(ë)*. Etimologjinë e Pedersenit, sipas Bokshit, vetëm Skoku e

konsideroi me të drejtë inkonsekuente e prandaj të paqëndrueshme, për shkak se për rrethana të njëjta fonetike i sugjeron të pranueshme reflekset aq të ndryshme, siç janë: akuz. *–ŏm + tŏm > -në, -ām + tam > -në; gen. –dat. –ŏm + tŏm > -vet*. Edhe Skoku pramendoi një origjinë të kësaj nyjeje që ka mbetur, me të drejtë, e papranueshme. (Bokshi: 2005; 142-143)

Në shqyrtimin e mbaresave rasore, sipas Bokshit, del se *–n(ë)* e kallëzores së shquar nuk rezulton nga bashkimi i mbaresës së vjetër *–m* a *-n* me nyjën në formën e kallëzores, sepse kjo mbaresë ishte flakur nga përdorimi si të gjitha të tjerat shumë përpara se të aglutinohej nyja. Këtu mund të shtohet se barazimi i sotëm i nom.-akuz. të shquara të shumësit tregon se diferencimi i supozuar i këtyre rasave në njëjës deri në kohën e aglutinimit të nyjës nuk do të ishte imponuar nga nevoja për të shprehur funksionet e ndryshme, por do të kishte mbetur vetëm për arsye fonetike, që do të thotë se nuk do të ishin varur nga numri, kështu që *–n-ja* do të kishte dalë edhe në shumës *(*-ns > -n: -n + të > -në)*. (Bokshi: 2005; 143-144)

Rasat gjinore dhanore e rrjedhore

Sipas Torpit, cituar nga Demiraj, mbaresa rasore /-i/ e ka burimin te mbaresa e lokativit i.e. */-eį/. Njëjtë ka menduar edhe Pederseni. Për mbaresën /e/ mendimi i fundit i Pedersenit është që ajo e ka burimin te mbaresa i.e. e rasës dhanore */-āį/. (Demiraj: 2015; 99)

Sa u përket mbaresave /-i/ ~ /-u/ dhe /-e/, Sh. Demiraj mendonte se po të mbahet parasysh përbërja fonetike e mbaresave rasore i.e. të rindërtuara dhe, nga ana tjetër evolucioni i tingujve të trashëguar i.e. në shqipen, atëherë mund të nxirret përfundimi që këto mbaresa të shqipes së dokumentuar, sipas gjithë gjasash, rrjedhin nga një mbaresë e përbashkët rasore. Ajo duhet të jetë shkrirë me fundoren e temës */-o/ të emrave mashkullorë dhe asnjanës, përkatësisht me fundoren */-a/ të emrave femërorë. Pra, mund të pohohet që mbaresa rasore /-i/ e emrave mashkullorë e asnjanës është përftuar nga shkrirja e fundores së temës */-o/ me mbaresën i.e. të rasës dhanore */-i/ < */-eį/, d.m.th. */-o/ + */-i/ kanë përfunduar në mbaresën rasore /-i/ të shqipes së dokumentuar. (Demiraj: 2015; 100)

Edhe mbaresa rasore /*-e*/ e emrave femërorë është përftuar nga shkrirja e fundores së temës */*-ā*/ me mbaresën e rasës dhanore */*-i*/ < */*-eį*/, d.m.th */*-ā*/ + */*-i*/ kanë përfunduar në mbaresën rasore /*-e*/ të shqipes së dokumentuar. Po sipas Demirajt, nuk përjashtohet mundësia që këto dy mbareasa rasore të jenë përftuar nëpërmjet shkrirjes a kontraksionit të fundores së temës */*-o-*/ , përkatësisht */*-ā-*/ me mbaresën e rasës vendore i.e. duke iu referuar Szemereneyit (1980) dhe Beekes

(1995). Pra, në këtë rast është fjala për një sinkretizëm të rasave dhanore e vendore (kjo e fundit e përdorur me kohë edhe në funksionin e rrjedhores). (Demiraj: 2015; 100)

Sipas Demirajt, në formën rasore të tipit *lule-j-e*, *kala-j-e* etj. midis zanores fundore të temës së emrit dhe mbaresës rasore është shtuar edhe një /*-j-*/ kundër hiatit, për të cilën pajtohen edhe studiuesit e tjerë.

Mbaresa rasore /*-u-*/ *(khs. një mik-u)*, sipas Demirajt e të tjerëve, nuk lidhet drejtpërdrejt me asnjë mbaresë rasore i.e.; ajo është shfaqur gjatë evolucionit të shqipes. Sipas mendimit mbizotërues, ajo është një variant i mbaresës rasore /-i-/, përftuar në kushte të caktuara fonetike. Në krye të herës varianti /-u-/ duhet të jetë shfaqur tek ata emra, tema e të cilëve mbaronte me grykoren /-k-/, ose /-g-/, për të mënjanuar qiellëzorëzimin e këtyre bashkëtingëlloreve, që do të krijonte homonimi me format gjegjëse të temës së shumësit, khs. mik-u në vend të *mik-i, zog-u në vend të *zog-i (trajtat *mik-i dhe *zog-i do të kishin dhënë *miq, përkatësisht *zogj, ashtu si në numrin shumës). E përftuar në këtë mënyrë, kjo mbaresë më pas me rrugë analogjike është shtrirë edhe tek emrat me fundoren /-h-/, përkatësisht /-í/, /-é/ dhe pjesërisht edhe tek ata me temë në /-á/ si p.sh. *krah-u* (në vend të **krah-i*), *mi-u* (në vend të **mi-i*), *dhe-u* (në vend të **dhe-i*), *ka-u* (në vend të **ka-i*); por nga ana tjetër *vëlla-i* (më rrallë *vëlla-u*), *aga-i*, *pasha-i* etj. (Demiraj: 2015; 100-101) Mendimi i Skokut që mbaresat rasore /-i/ dhe /-u/ e kanë burimin te disa forma të përemrit dëftor, sipas Demirajt, nuk del i mbështetur. E njëjta vlen edhe për supozimin e Bariçit, sipas të cilit, mbaresa rasore /-u/ buron nga */-ōu̯/, si dhe për mendimin e Rizës, sipas të cilit mbaresa /-u/ është përftuar nga */-vi/ (Riza: 1965), ku /-v-/ ka qenë një tingull kundër hiatit. Kundërshtinë e Demirajt sa i përket kësaj etimologjie të Rizës –u < -v-i për mbaresë të dativit, ashtu edhe për nyjë të nominativit e theksonte edhe Bokshi. Sipas tij, vërejtjet e Demirajt do të ishin të qëndrueshme vetëm po të mendohet se mbaresa është refleks i mbaresës ie. dhe se aglutinimi i nyjës është proces paralatin i shqipes, siç mendon Demiraj. Kështu, ndaj tezës së Rizës për mbaresën e dhanores njëjës *–u* vërejtjet e Demirajt janë të qëndrueshme, sepse edhe Riza këtë mbaresë rasore e konsideronte të trashëgimisë ie. për nyjën *–u* vërejtjet nuk qëndrojnë, sepse Riza aglutinimin e nyjës e sheh proces të vonshëm (të Mesjetës së hershme). Në këtë kohë *–ái (ká-i)* dhe *–éi (dhé-i)* nuk përbëjnë diftong, prandaj nuk do të kishte pengesë të ndërhynte tingulli antihiatizues *(ka-v-i)* e të bëhej kalimi *–vi* > *-u*. Mendimi se *–v-* intervokalike do ta pësonte fatin e mediave (cubitum > kuët etj.) bie poshtë nga fakti se kemi të bëjmë me një alternim të vonshëm jo larg kohës kur mediat e pësonin evoluimin e shënuar. Meqë, për ne, jo vetëm aglutinimi i nyjës, thoshte Bokshi, por

edhe krijimi i mbaresës është relativisht i ri, kuptohet se vërejtjet e Demirajt mbeten të papraneshme edhe për mbaresën –u të dhanores (Bokshi: 2005; 363-364)

Sa u përket këtyre mbaresave Bokshi ka mbrojtur qëndrimin se forma e gjinore-dhanores së shquar njëjës është përftuar në sintagma të tipit **të thellë i të pus*, ku u zhvillua një nyjë shquese e paravendosur *(i, të)* para emrit pus. Sipas shpjegimit të tij, nga një sintagmë e tillë u zhvillua sintagma tjetër **të thellitë pus* dhe më në fund *pus-i-të*, kur emri përdorej pa mbiemër. Ndërsa për formën e gjinore-dhanores së pashquar njëjës ai mendon se është përftuar në sintagma të tipit **i këtij pus i të thellë > i këti pusi të thellë > këtij pus-i*. një proces të ngjashëm ka menduar ai në veprën e tij (1980) edhe për formën e gjinore-dhanores njëjës të emrave femërorë. Por këto rindërtime të Bokshit, që nuk kanë paralele në evolucionin e asjë gjuhe tjetër i.e., sipas Demirajt, nuk janë të argumentuara bindshëm. (Demiraj: 2015; 101)

Origjina e mbaresës së përbashkët të rasave gjinore e dhanore /-e/ ~ /-ve/, sipas Pedersenit, e ka burimin te mbaresa e i.e. e rasës gjinore shumës */-ōm/ nëpërmjet evolucionit të */-ō/ > /-e/, mendim të cilin e përkrah edhe Demiraj. Mendimi i Meyerit se mbaresa /-ve/ është zhvilluar nga mbaresa i.e. */-bhyas/, sipas Demirajt, nuk mbështetet nga të dhënat e fonologjisë historike të shqipes. Vërejtja e njëjëtë vlen edhe për mendimin e Skokut se kjo mbaresë e ka prejardhjen te gjinorja shumës **(o)vōm* e përemrit dëftor *ovb*, të ruajtur në gjuhët sllave. Origjinën e kësaj mbarese Bokshi e mendon të përftuar njësoj sikurse mbaresa përkatëse e njëjësit. Edhe mendimi i Durantes që kjo mbaresë është zhvilluar nga */-ōi̯s/, nuk duket i mbështetur, kur dihe se evoluimi i difongut */ōi̯/ në shqipe mbetet i pasqaruar bindshëm. (Demiraj: 2015; 103

Edhe mbaresa rasore /-sh/ e rrjedhores së pashquar shumës paraqet problem në përcaktimin e origjinës së saj. Sipas Bopp-it, cituar nga Demiraj, /-sh/ është burimisht një mbaresë e rasës gjinore që mund të krahasohet me gjinoren përemërore /sām/ të sanskritishtes dhe me /-son/ të prusishtes së vjetër. Kurse, për Pedersenin, sipas Demirajt, kjo mbaresë "e së astuquajturës rrjedhore" e ka burimin te mbaresa e rasës vendore i.e. */-su/. Ky mendim i Pedersenit është miratuar nga Demiraj e disa të tjerë. Ndërsa, Bariçi mendon se në këtë rast kemi të bëjmë me një përzierje (kontaminim) të dy mbaresave të ndryshme: */-su/ të rrjedhores dhe */sōm/ të gjinores. Për Skokun dhe Bokshin mbaresa /-sh/ është zhvillim i brendshëm i shqipes. Skoku këtë mabresë e sjell nga /-sish formë e dëftorit kë-sish, ndërsa Bokshi mbaresën /-sh/ e sjell me burim nga format e dëftorit /so/ dhe /si/ në përdorime të tipit *Mora një tufë lule *so të mira*. Këto mendime të fundit nuk i sheh të mbështetuta Demiraj. (Demiraj: 2015; 105)

Përfundime

Me anë të punimit të pranishëm mendohet se mund të krijohet një pasqyrë e qartë dhe e plotë për sistemin rasor të shqipes, si të atij të shqipes së teksteve të vjetra, ashtu edhe të atij të shqipes së sotme.

Nga shqyrtimi i kësaj tematike rezultojnë një varg përfundimesh, nga të cilat, më kryesoret mund të vihen në dukje, si vijon:

Sistemi rasor i shqipes së vjetër ose, më saktë, i shqipes së teksteve të vjetra, kishte në përbërjen e vet shtatë rasa, për dallim nga sistemi rasor i shqipes së sotme, i cili përfaqësohet nga gjithsej pesë rasa të mirëfillta. Pra, sistemit rasor të shqipes së hershme i kanë takuar këto rasa: emërorja, gjinorja, dhanorja, kallëzorja, thirrorja dhe vendorja. Ndërsa, sistemit rasor të shqipes së sotme i takojnë vetëm pesë rasat e para, pra: emërorja, gjinorja, dhanorja kallëzorja dhe rrjedhorja. Të dyja këto sisteme, krahasuar me sistemin rasor të gjuhës indoevropiane që kishte tetë rasa (të gjitha rasat e cekura te sistemi i shqipes së vjetër, plus instrumentalja (mjetorja)), dalin me numër më të vogël rasash, pra me një reduktim, i cili është më i vogël në sistemin rasor të shqipes së hershme, porse më i madh në sistemin rasor të shqipes së sotme.

Mund të thuhet që rasat e shqipes, qoftë asaj të vjetër, qoftë asaj së sotme, nuk dallojnë për nga kuptimet dhe funksionet kryesore me rasat e indoevropianishtes, me përjashtim të zgjerimit të atyre funksioneve dhe të shtimit të funksioneve të reja. Ndër funksionet kryesore të rasave të shqipes mund të përmenden këto: emërorja konsiderohet rasë e kryefjalës, gjinorja shpreh përcaktorin emëror, dhanorja shpreh kundrinën e zhdrejtë, kallëzorja shpreh kundrinën e drejtë, rrjedhorja shpreh rrethanorin e vendit e të kohës, sidomos kur tregon largim nga një pikë e caktuar.

Mjetet kryesore dalluese të rasave në gjuhën shqipe, sikur edhe në gjuhët e tjera indoevropiane, janë mbaresat rasore, krahas edhe mjeteve të tjera që e bëjnë këtë dallim. Mjetet gramatikore të ndërtimit të sistemit të rasave janë: mbaresat rasore (*një lis**i**, një nën**e**, male**sh***), nyjat e prapme (*lis**i**, nën**a**, male**t***), nyjat e përparme (***i** lisit, **e** nënës*), prapashtesat trajtëformuese (*lis**a**, mal**e***), ndërrimet fonetike në temë (*d**a**sh ~ d**e**sh, mi**k** ~ mi**q***), rëniet e fonemave (*zã / zë ~ zani / zëri*), zanoret anaptitike (*nxënës-**i**-t*), bashkëtingëlloret që zhdukin hiatin (*be-**j**-a, dhi-**v**-e*), nyja joshquese (***një** lis*), përcaktorët përemërorë (*gjethet e **ca** lisave*), parafjalët (***në** malit*), pasthirrmat (*djal**o**, nën**o**, **or** djalë, **moj** nënë*)

Kategoria e rasës në shqipen e dokumentuar dhe të sotme paraqitet në këto forma ***-ø, -ë, -i, -u, -e, -ve, -sh,*** me këtë lidhje paradigmatike rasore: 1. → nom. – akuz**.** √ ***-ø, -ë;*** 2. → gen. –dat. –abl. √ [2] ***-i, -u, -e;*** → gen. –dat. √ ***-e, -ve;*** → abl.: ***-sh***

Tri kriteret kryesore mbi të cilat përcaktohen rasat e veçanta (pra, të ndryshme nga njëra-tjetra) në gjuhën shqipe, sikur edhe në gjuhë të tjera, janë: kriteri morfologjik (forma e veçantë e emrit), sintaksor (nyjat e përparme të gjinores) dhe ai funksional (funksioni i ndryshëm, krahas formës së njëjtë), të cilat, në shumë raste, shkojnë bashkë e, në raste të caktuara, kur nuk mund të zgjidhet përkatësia rasore me dy kritere, ndërhyn i treti për përcaktimin e nevojshëm, duke e plotësuar pra njëri-tjetrin.

Dukuria e sinkretizimit në shqipen e dokumentuar nuk është e trashëguar nga faza para rënies e reduktimit të tingujve fundorë, por është krijuar më vonë, kur u krijuan mbaresat rasore. Emërorja e kallëzorja mbetën me mbaresa të ndryshme vetëm në njëjës të emrave mashkullorë e femërorë, ndërsa në shumës dhe në gjininë asnjanëse kishin dalë sinkretike më përpara. Kjo dukuri që e karakterizon sistemin rasor të shqipes, sidomos për rasat e lartpërmendura, nga ndonjë autor (Riza) nuk shihet si sinkretizëm, pasi sinkretizëm për të d.m.th. bartje funksioni a funksionesh nga një rasë, në rast zhdukjeje të ndonjë rase tjetër a rasash të tjera brenda sistemit. Kështu, kjo më mirë do të quhej bashkëndeshje tingullore sesa sinkretizëm, pasi në shqipen, siç dihet, nuk kemi shkrirje a zhdukje funksionesh, por vetëm përputhje trajtash rasore.

Krahasuar me sistemin rasor të indoevropianishtes, shqipja ka bërë ndryshime të mëdha dhe sistemi rasor i saj shfaqet tërësisht i riorganizuar, duke mbetur shumë pak gjë nga sistemi i vjetër (Topalli) e duke përbërë riformim në këtë të fundit. Përveç reduktimit të numrit të rasave nga gjuha ie. në shqipen, sipas shumë studiuesve, edhe mbaresat nuk janë të gjitha të trashëguara, por vetëm pjesërisht (Çabej, Riza, Demiraj, Topalli etj.), sipas të tjerëve (Pederseni, Meyeri) thuajse të gjitha mbaresat rasore të shqipes së sotme janë reflekse të atyre të gjuhës ie., madje, ka të tillë (Bokshi) që asnjë nga mbaresat rasore të shqipes së fazës së dokumentuar nuk i sheh reflekse të mbaresave rasore të gjuhës ie., por zhvillime e formime të veçanta brenda shqipes.

Literatura

Bokshi, Besim (2005). *Rruga e fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botime të veëanta LXII. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Libri 26. Prishtinë.

Çabej, Eqrem (1986). *Studime gjuhësore VII, Hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indoevropiane Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Rilindja. Prishtinë.

Demiraj, Shaban (2015). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.

Grup autorësh, (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 1*. Vëllimi I Morfologjia. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.

Lyons, John (2010). *Hyrje në gjuhësinë teorike*. Dituria. Tiranë.

Riza, Selman (2002). *Emrat në shqipe. Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botime të veëanta XLIV. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Libri 19. Prishtinë.

Topalli, Kolec (2009). *Sistemi rasor i emrave të shqipes*. AShSh. Plejad. Tiranë.

Mensur VOKRRI

CASE SYSTEM OF ALBANIAN LANGUAGE IN HISTORICAL VIEW

Abstract

With this work, it is claimed the case system of Albanian language viewed from its historical aspect, whichit has passed through. This means that this case system will be contemplated by the support of different thoughts and theories of different researchers related to different issues that come within this system.

In this context will be viewed particular issues, such as: the definition of cases, their number, origin, form, formal merging, reduction, formal-functional differentiation, as well as the inter-linguistic impact in one hand, and the heritage of the case system from Indo-European languages or the linguistic development of this system within the Albanian language on the other hand.

The case system will be observed within all the nominative system, but with special treatment in nouns, which at once are the essential part of this system as well. The case system of old Albanian language, whether documented or not, will be rendered based on the current case system of Albanian language, through the restoration of former case forms, whether with Indo-European source, or as developments within the proven Albanian language.

Initiated from the synchronic aspect, the Albanian language is a language with a case system that is comprised from five cases, two of which are considered as direct (the nominative and accusative case), and three others as indirect (genitive, dative and ablative cases). If spoken about the time since the first written documentation of Albanian language, the case system of that time certainly was not as the current one.

This linguistic fact is related with the dynamic character of language and the evolution-development of it through time. Current linguistic state of case system of Albanian language was preceded by another linguistic state with a case system with more cases, inherited by Indo-European language. The ascent of this system until this current state, with all linguistic developments, constitutes the essence of this study.

Key words: case system, Albanian language, historical view, case, nominative system.

Bahri KOSKOVIKU

KONCEPTI PËR PARAFJALËT NË GJUHËSINË MODERNE

Për realizimin e këtij punimi janë lakuar disa nga emrat kryesorë të gjuhësisë moderne, gramatikat e tyre dhe një numër studimesh, që kanë si objekt studimi kategorinë e parafjalëve, të cilat do të na shërbejnë si referencë kryesore për mbarështrimin teorik dhe konceptual të kësaj kategorie gjuhësore nga aspekte të ndryshme të teorisë sintaksore.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të shtrojmë problemin e kategorisë së parafjalëve, në një rrafsh më të gjerë të analizës gjuhësore, përtej atij studimi margjinal të gjuhësisë tradicionale, që e kufizon rolin e parafjalëve vetëm mbi bazën e veçorive funksionale, në funksionin e një rasëshënuesi apo të një elementi përmes të cilit realizohen raportet sintaksore varësie midis elementeve konstituente të një sintagme. Këto praktika studimore rezultojnë ose me mosnjohjen e ndërtimeve me parafjalë si përbërës i veçantë në strukturën e fjalisë, çështje që lidhen me konceptin e gjymtyrës në fjali ose në kuadër të një sintagme parafjalore roli i parafjalëve kufizohet zakonisht me shënjimin e funksionit të një emri që i prin (funksionalizmi) dhe fjalët e tilla nga pikëpamja kategoriale, varësisht nga konteksti marrin role të shumëfishta si parafjalë, ndajfolje apo lidhëz.

Ky punim shkencor, niset nga premisa që mbështetet në konceptin gjenerativist se parafjalët janë kokë leksikore e një përbërësi sintagmatik. Sintagmat parafjalore janë entitete të veçanta dhe jo ekstensione të një sintagme emërore dhe se parafjala është elementi që determinon natyrën dhe strukturën e një përbërësi sintagmatik në një fjali. Në të vërtetë, parafjalët janë një kategori shumë më e hapur, nga ajo që përshkruhet në traditën e studimeve sintaksore në përgjithësi. Një qasje e tillë ka në nismë *Gramatikën e strukturës së sintagmës* të N. Çomskit, i cili parafjalët i konsideron njërën prej katër kokave leksikore në nivel me emrin, foljen dhe mbiemrin, me çka koncepti për studimin e parafjalëve evoluon tërësisht në raport me studimet e deritanishme për këtë kategori fjalësh.

Tashmë edhe në studimet sintaksore në shqipe është braktisur koncepti që del nga kuadri i ngushtë teorik i teorisë së togfjalëshit dhe konsiderohet i kapërcyer përkufizimi i tyre në kategorinë e fjalëve shërbyese që shpreh raporte gramatikore midis gjymtyrësh në strukturën e një togfjalëshi (Gramatika e gjuhës shqipe 2); se

objekt i sintaksës janë vetëm fjalët emërtuese (M. Çeliku,2012:1); se *Struktura e një togfjalëshi karakterizohet nga fakti se organizohet rreth një fjale të plotkuptimshme, që është strumbullari saj si nga ana kuptimore ashtu edhe formale"* (M. Domi, Vepra 1. Studime sintaksore: 123);

Strukturalizmi, duke pasur si procedurë fillestare përshkrimin strukturor të një gjuhe në modelin e tyre teorik, në rrafsh të analizës gjuhësore, vlerësojnë se edhe fjalët funksionale sikundër janë parafjalët mund të karakterizojnë një përbërës sintagmatik, duke u bazuar në veçorinë themelore të saj, atë të shenjimit rasor të fjalës që i prin, ndërsa sipas terorisë së strukturës së sintagmës të N. Çomskit parafjalët janë një nga katër kokat leksikore: E, F, Mb, P, veçoritë e së cilës përcaktojnë strukturën e një sintagme. Më vonë sipas teorisë X-bar, një variant më i thjeshtuar i teorisë së strukturës së sintagmës, X është një variabël që merr vlera të ndryshme si: E, F, M, P, të cilat realizohen në tri nivele projektimi, në këtë kuadër edhe parafjalët si kokë leksikore realizohen në tri nivele projektimi (G. Graffi, 2003: 198).

Në bazë të këtij mbarështrimi të përgjithshëm konceptual, në gjuhësinë moderne ende është i hapur diskutimi se ku duhen vendosur parafjalët si një kategori joflektive më vete, në radhën e kategorive funksionale apo kategorive leksikore apo kërkohet një zgjidhje e tretë që vë në dukje të dy këto aspekte. Në gjuhët si anglishtja parafjalë e thjeshta *to* dhe *of* janë funksionale dhe problemi shtrohet nëse ato mund të hyjnë në një grup me lokucionet parafjalore që janë leksikore, si: *in accordance with, by means of* etj., dhe kërkohet ndarja e tyre së paku në dy grupe kryesore: në parafjalë funksionale dhe në parafjalë leksikore, duke i përkufizuar parafjalët si njësi gjysmëleksikale apo gjysmëfunksionale. Një ndarje e tillë ka për bazë vështirësitë që dalin në përkufizimin dhe inventarizimin e parafjalëve, duke marrë parasysh natyrën e tyre mjaft heterogjene në planin semantik dhe funksional.

Analiza e parafjalëve mbi bazën e një taksinomie formale, që bën zakonisht gjuhësia tradicionale duke i ndarë në parafjalë të parme, komplekse dhe lokucionet gramatikore, është tërësisht e pamjaftueshme për një analizë të mirëfilltë të kësaj kategorie fjalësh, prandaj studimi i tyre orientohet më tepër në rrafshin semantik-funksional. Duke qenë se kategoria e parafjalëve karakterizohet nga dikotomia që i sheh ato si njësi me shkallë të ndryshme funksionaliteti dhe leksikaliteti, janë kërkuar edhe zgjidhje që përafrojnë modelet e analizës gjuhësore strukturale dhe gjenerative.

Në gramatikat moderne ekzistojnë tri modele të analizës që janë të ndryshme në rrafshin konceptual: koncepti i analizës funksionale, që vë theksin te marrëdhëniet gramatikore të parafjalëve, koncepti i analizës leksikore, ku parafjalët analizohen si një kategori leksikore dhe koncepti i analizës hibride, i cili parafjalët i sheh si një njësi gjysmëleksikale, të cilat shprehin shkallë të ndryshme të funksionalitetit dhe të leksikalitetit.

Koncepti i analizës funksionale

Vë theksin te marrëdhënia gramatikore e parafjalëve. Përgjithësisht parafjalët analizohen si shënjues rasorë të fjalës që i prijnë, zakonisht të një emri a përemri.

Ky koncept duhet parë në dy rrafshe: i pari bazohet në kriteret logjike e semantike dhe nuk i njeh parafjalët si njësi të afta në rrafshin semantik dhe funksional për të formuar dhe karakterizuar një gjymtyrë në strukturën e fjalisë. Kjo analizë ka për bazë teorinë e gjymtyrëve, koncepti për gjymtyrën si fjalë emërtuese e mëvetësishme gramatikisht dhe strukturalisht, përjashton ndërtimet me parafjalë. Një koncept i tillë i karakterizon studimet sintaksore në shqipe. E dyta, shkolla strukturale dhe drejtimet e ndryshme të saj, mendojnë se edhe frazat (bëhet fjalë për sintagmën, *phrase* nga anglishtja) funksionale mund të formojnë dhe karakterizojnë një përbërës në fjali, por roli i tyre kufizohej me shënjimin rasor të fjalës që i prin.

Kjo ka bërë që disa autorë ndërtimet me parafjalë t'i shohin si nënklasa të sintagmave emërore apo sintagma pa kokë. Studiues, si Grimshaw (*Extented Projection:*1991), Van Rejmsdik (1990, 1998), i cilësojnë sintagmat parafjalore si një ekstension të sintagmave emërore dhe determinativ. Andre Martinet bën ndarjen e njësive gjuhësore në dy grupe të mëdha: në *monema leksikore* që u takojnë inventarëve të pakufizuara dhe në *monema gramatikore* që u takojnë inventarëve të reduktuar. Brenda kësaj ndarjeje, duke i parë parafjalët, si një kategori e reduktuar, i inventarizon në radhën e monemave gramatikore dhe i përkufizon si *monema funksionale që shërbejnë për të shenjuar funksionin e një moneme tjetër* (1974:143). P.sh, ndërtimet: *me veturë, me valigjet e mia*

Përfaqësues të strukturalizmit bashkëkohor si *Rodney Hoddleston dhe Geoffrey Pullum* në gramatikën e tyre *The Cambridge Grammar of the English Language*, duke i zëvendësuar termat emër e përemër me termin sintagmë emërore, e trajton parafjalën si kokë të sintagmës duke e vënë, në rrafshin sintagmatik, në të njëjtin nivel me emrin, foljen dhe mbiemrin; ky ndryshim në koncept bën që të zgjerohet kjo klasë fjalësh edhe me njësi tjera që gjuhësia tradicionale i konsideron si ndajfolje ose lidhëza:

1. *Brenda në sallë të ftuatit i prisnin të tjera surpriza. (Pasardhësi, I.Kadare)*
2. *Duhet të votoni "për" ose "kundër" gjykatës, e cila do të shqyrtojë akuzat për krime lufte.* (Lajmi.net, 26: 2015)
3. *Megjithatë, nuk ia kishte fshehur se po flijohej për karrierën e babait. (Pasardhësi,)*
4. *Yt atë po zgjidhet për Prijës të ardhshëm. (Pasardhësi)*
5. *Përpara se ajo të pyeste "Ç'po bëhet"ai tregoi me krye nga dera e dhomës. (Pasardhësi)*

Kjo bën që kategoria e parafjalëve të mos shihet një klasë tërësish e mbyllur, por prapëseprapë parafjalët në krahasim me emrin, foljen, mbiemrin janë *një klasë relativisht e mbyllur* (2002:603).

Në gramatikat shqipe roli i parafjalëve shpjegohet brenda teorisë së togfjalëshit: si *fjalë që shprehin marrëdhënie sintaksore të varësisë midis një emri, një numërori ose një përemri në një rasë të caktuar dhe një gjymtyrë tjetër në një togfjalësh* Gramatika e gjuhës shqipe I(Morfologjia) *(* 2002:381 *). S'kanë kuptim leksikor më vehte dhe shërbejnë për të bërë dhe treguar lidhjet e ndryshme midis fjalëve me kuptim leksikor më vehte* (S. Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe: 26).

7. *Të nesërmen shkuam me Artanin në fshat.*

Shkuam me Artanin, shkuam në fshat.

Parafjalët *me* dhe *në,* lidhin emrat *Artanin* dhe *fshat* me foljen *shkuam* në togfjalëshat *Shkuam me Artanin* dhe *Shkuam në fshat*. Sipas kriterit funksional parafjalët kategorizohen si fjalë shërbyese, roli i të cilave është të lidhin dy gjymtyrë të një togfjalëshi. Ato nuk mund të formojnë një togfjalësh, sepse nuk janë fjalë emërtuese dhe ekzistenca e tyre është e varur gramatikisht nga një fjalë-gjymtyrë, kryesisht nga një emër a përemër, e më rrallë nga një mbiemër a ndajfolje.

Koncepti i njësisë sintaksore në gramatikat shqipe mbështetet në kriterin e mëvetësisë gramatikore dhe duhet të përmbushë përgjithësisht këto rregulla:

1. Fjala shënon një koncept
2. Njësi e mëvetësishme gramatikore është vetëm njësia sintaksore (gjymtyra) që është e pavarur gramatikisht në fjali.
3. Elementet funksionale nuk formojnë gjymtyrë fjalie, sepse janë të kushtëzuara gramatikisht.
4. Fjalët funksionale që shprehin kuptime, por që nuk janë të pavarura gramatikisht, nuk përbëjnë bazën e një njësie sintaksore.

Këto rregulla përjashtojnë ndërtimet me parafjalë, ato kategorizohen si fjalë shërbyese që vënë në dukje natyrën e dyfishtë të shqipes si sintetike dhe analitike, rrjedhimisht ato nuk përbëjnë bazën e një njësie gramatikore dhe nuk mund të kenë statusin e një njësie sintaksore të mëvëtsishme.

Koncepti i analizës leksikore

Shkolla gjenerativiste i dallon katër kategori leksikore: *Emrin, foljen, mbiemrin dhe parafjalën* Jackendof (1973). N. Chomsky (1981), Rizzi (1988). Tiparet themelore që e përcaktojnë parafjalën si kokë leksikore janë:

a. Drejtimi – shënjon rasën e plotësorit të saj.
b. Përzgjedhja – aftësia për të pëezgjedhur objekte të ndryshme dhe aftësia e tyre për të shënjuar funksionin semantik të këtyre objekteve si e të parafjalëve.

c. Valenca – parafjalët janë fjalë njëvalente.
d. Kalimtaria dhe jokalimtaria- plotësori i parafjalëve është i domosdoshëm për strukturën e parafjalëve, por ndonjëherë mund të jetë opcional.

Kjo ka bërë që të tërhiqet një paralelizëm midis parafjalëve dhe foljes në kuptimin që të dy janë elemente rasëcaktuese, përcaktojnë funksionin e përbërësit sintaksor si argument i brendshëm i saj dhe së fundi dhe nocioni i kalimtarisë. Në këtë pikë konvergjon plotësisht me Pullum-in dhe Huddleston-in.

Kjo veçoria e fundit bazohet në njërin prej parimeve të Çomskit se në strukturën e një sintagme koka është i vetmi element që duhet të shfaqet detyrimisht në çdo përbërës të një kategorie të caktuar. Fakti që koka të jetë e shoqëruar apo jo nga elemente të tjera, varet nga klasa leksikore sëcilës i përket vetë koka. (G.Graffi,1994:111). Kjo sygjeron që në shembullin në vijim : *Me të kuptuar se pasardhësi po hynte* ***brenda,*** *Ana, e frikësuar, doli jashtë. Brenda dhe jashtë* janë parafjalë dhe jo një ndajfolje sikundër e karakterizon gjuhësia tradicionale. G.Graffi thotë se parafjala *brenda* përbën kokën e një lloj sintagme të tillë, që mund të shoqërohet ose jo nga një sintagmë emërore sipas përdorimit të saj kalimtar apo jokalimtar, mbështetur në rregullën e mësipërme se prania e kokës është një kusht i mjaftueshëm për të formuar një sintagmë (1994:111).

Nga studiues të shqipes viteve të fundit, Koleci dhe Turano i trajtojnë parafjalët nga këndvështrimi gjenerativist sipas teorisë X-bar sipas programit parime dhe parametra, ku një SP përbëhet nga tri nivele projektimi: projeksioni maksimal, i ndërjetmë dhe projeksioni minimal apo projeksioni zero.



(F. Koleci dhe G.Turano)

a. Parafjalët kanë aftësinë për të shenjuar funksionin e një sintagme tjetër, gramatikisht të varur nga koka parafjalore.
b. Parafjalët kanë aftësinë të përzgjedhin tipa të ndryshëm të komplementësh, njësoj si çdo kategori tjetër leksikore në përbërjen e një sintagme.

c. Parafjalët, duke qenë njësi të kuptimshme të gjuhës, u japin role theta komplementëve të saj.

c. Koncepti i analizës hibride

Duke qenë se parafjalët i karakterizon dikotomia: leksikore dhe funksionale, studiuesi rumun A. Mardale i konsideron parafjalët si njësi gjysmëleksikore që shfaqin njëkohësisht veti leksikore dhe funksionale dhe mbi këtë bazë, mbështetur në kriteret teorike- formale arrin në përfundimin se parafjalët janë një kategori heterogjene, ku midis tyre dallon dy grupe: më leksikore dhe më funksionale. Mardale, A. (2011). *Prepositions as a semilexical category*: —Bucharest Working Papers in Linguistics, 13, 2, fq. 35-50.

Thelbi i kësaj teorie është se brenda kësaj kategorie ka fjalë që kanë shkallë të ndryshme leksikaliteti ose gramatikaliteti. Pra, parafjalët janë fjalë që lëvizin përgjatë një segmenti që fillon me përdorimet më leksikore dhe përfundon me ato më gramatikoret ku përfshihen ndarjet e mëposhtme.

Leksikore gjysmëleksikore funksionale
←-------→.....<----------→.....<---------------------------→
Em, F, Mb Pa SP, Lidhëza, mbaresa

Kjo teori sygjeron ndarjen e parafjalëve së paku në dy grupe: në parafjalë funksionale dhe leksikore. Duke e përkrahur këtë teori H. Littlefield, thotë: "Nëse parafjalët trajtohen si kategori hibride, atëherë problemi nuk qëndron te karakteristikat kontradiktore të parafjalëve, por te trajtimi i parafjalëve si një kategori e vetme monolite." (Lexical and Functional Prepositions in Acquisition, 2005:56). Sipas tij klasa e parafjalëve është një kategori hibride që karakterizohet nga veti funksionale dhe semantike. H. Littlefield-i, duke marrë për bazë anglishten, mbështetur sikundër thotë në fakte empirike, është për një ndarje të parafjalëve: në leksikore dhe funksionale. Përderisa *Of* e anglishtes është funksionale apo edhe *To,* mendojmë se në rastin e shqipes, ndryshe nga gjuha angleze, ky është një parametër që realizohet me mjete të tjera të karakterit funksional: shqipja për gjenitivalin përdor me këtë vlerë një formant gramatikor (nyjën), ndërsa rasa dhanore konsiderohet si joparafjalore.

Përfundime

Nga ky përshkrim konceptual në rrafshin teorik për kategorinë e parafjalëve nxjerrim këto përfundime për parafjalët:

- Nuk janë fjalë ndërmjetëse apo shërbyese në strukturën e një përbërësi;
- Duke qenë në funksion të kokës sintaksore, ndërtimet me parafjalë janë autonome në strukturën e fjalisë;
- veçori sintaksore e saj është drejtimi, licencimi, licencimi dhe kalimtaria;
- Përcakton natyrën e një njësie sintagmatike;
- Duke qenë në funksion të kokës leksikore, u cakton funksionet komplementeve të saj;
- Parafjalët përzgjedhin tipa të ndryshëm komplementesh si çdo njësi tjetër sintagmatike;
- shënojnë marrëdhënie të caktuara semantike, si: vend, kohë, hapësirë, mënyrë, mjet, shoqërim, mungesë etj.
- Meqë janë fjalë joflektive nuk kanë determinerë.

Bibliografia

Grup autorësh (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. ASHSH,Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë. Tiranë.

Grup autorësh (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2*. ASHSH. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

Prifti, Stefan (1971). *Sintaksa e gjuhës shqipe. ETMMK*. Prishtinë.

Domi, Mahir (1971). *Sintaksa e gjuhës shqipe***.** ETMMK. Prishtinë.

ASHARSH (1995). Instituti i Gjuhësisë. *Gramatika e Gjuhës Shqipe* (Morfologjia). Tiranë.

ASHARSH, (1997). Instituti i Gjuhësisë. *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*.

Quirk, Randolph (1985). A comprehensive grammar of the English language. Neë York.

Huddleston, Rodney and Pullum, Geoffrey (2007). *English Grammar*. Cambridge University press.

Çeliku, Mehmet (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*. Tiranë.

Lyons, John. *Hyrje në gjuhësinë teorike* (Përkthim i vitit 2010). Sh.B. " Dituria"

Koleci, Flora dhe Turano, Giuseppina, (2011), *Hyrje në sintaksën gjenerative,*Tiranë, SHB e Librit universitar.

Graffi, Giorgio (2003). *Sintaksa.* Tiranë. SHB Dituria.

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (2010). Universiteti i Prishtinës. Fakulteti i Filologjisë. Universiteti i Tiranës. Fakulteti i Historisë – Filologjisë. Prishtinë.

Martinet, Andre (1974). Elemente të gjuhësisë së përgjithshme (përkthim nga Rexhep Ismajli). Prishtinë. Rilindja.

Abrashi, Teuta (2012). Pikëpamjet dhe kontributi i Hilmi Aganit lidhur me teorinë e *togfjalëshit dhe rasën gjinore në gjuhën shqipe.* Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë.

Bahri KOSKOVIKU

THE CONCEPT ABOUT PREPOSITION IN MODERN LINGUISTIC

Abstract

In this scientific paper we intend to make theoretical analysis about the prepositions category within modern linguistic framework as a very contradict category in the term of categorization, due to their specific nature.

Our approach will be relay on the descriptive and analytic plan. We will reflect all the concepts in the conceptual plan, beginning with traditional grammar, including Albanian syntactic studies to see advancements in the study of this category within modern linguistic framework specifically on structuralism and generativism direction.

The main issue being discused in this paper is the categorization of preposition as a functional or lexical words. Problems in this area are related to the criteria that what is considered a lexical category and what is a functional category. In general, we are based on A. Martinet criteria that classify all grammatical unit in open category an functional category.

The functionalism define prepositions as a functional element that serve to determines the other function element (1974). G. Pullum treat the prepositions as a headword of phrases comparable to those headed by verbs, nouns, adjectives and adverbs.Generativism define the preposition category as a lexical head that, like every other lexical headword, can license and govern dependents of many different sorts.

Recent years, viwieng prepositions as a very contradictory category has been given new proposals. According to new linguistc analysis concept, A. Mardale defines prepositions as hybrid and semilexical category characterized by semantic and grammatical features.

In Albanian grammar there are quite a few studies for this category, they are treated in the context of the phraseology theory, seen as syntaxes, as well as

morphological means to express the relationships between the limbs in the sentence. Taking into account only the criterion of relevance, generally in Albanian grammars no prepositional constructions are accepted.

Key words: Preposition, semilexical category, functional element, governing category.

Mustafa IBRAHIMI

VARIETETET GJUHËSORE NË MJEDISET E NDRYSHME SOCIOLINGUISTIKE TË SHQIPES

Hyrje

Marrë në përgjithësi standardizimi policentrik, që paraqet zhvillimin e raporteve mes variacioneve standarde gjuhësore në të ardhmen mund të jetë e mundshme të kalojë në tre skenarë, atë të: a) stabilitetit, b) konvergjencës dhe c) divergjencës (Bugarski 2002:53).



a) *stabiliteti*, do të thotë se ndryshimet mund të zgjasin për një periudhë më të gjatë; Një raport të tillë midis variacioneve gjuhësore mund ta vërejmë midis gjuhës kombëtare britanike dhe asaj amerikane, raporte që një kohë shumë të gjatë janë kryesisht stabile.

b) *konvergjenca*, zvogëlimi i ndryshimeve, me një perspektivë të kalimit nga standardizimi policentrik në atë monocentrik. Këtë tendencë konvergjente më së shumti e plotëson *International English ose World English.*

c) *divergjenca*, kur variantet largohen shumë, përfundojnë në gjuhë të ndryshme, siç janë gjuhët neolatine kundrejt latinishtes, gjuhët sllave kundrejt serbokroatishtes etj. Sidomos përshtypje më të madhe lë rasti me anglishten, sot gjuha më e përhapur në botë, e cila zbatohet në variante të ndryshme kombëtare (p.sh. . *varianti standard i anglishtes "evropiane" dhe "amerikane", varianti standard i gjermanishtes "austriake" dhe*

"gjermane", varianti standard i spanjishtes "së Amerikës jugore" me atë "spanjolle, varianti standard i frëngjishtes evropiane me atë të frëngjishtes kanadeze etj.

Nga pikëpamja jonë, gjuha shqipe si një dukuri e gjerë, e cila ka një bërthamë të qëndrueshme e shfaqur në evoluim gjatë gjithë historisë, paraqet një tërësi variantesh, ku për shkaqe dhe faktorë të ndryshëm ka dominuar tendenca konvergjente, duke i bashkuar dy dialektet në një gjuhë të përbashkët, duke reflektuar kështu skenarin (b). Ky skenar më i theksuar ka qenë tek shqiptarët e ish-Jugosllavisë të cilët këtë tendencë e ndoqën jo aq nga motivet gjuhësore sesa nga ato shoqërore, që nënkuptonte ndjenjën e fortë kombëtare në funksion të qëndresës antisllave. (Shamku – Shkreli 2007:247).

Megjithatë, varësisht nga ajo se çfarë funksioni luan gjuha në shoqëri dhe kulturë, për çfarë teme kumton, kush flet dhe shkruan me të, me kë, ku, kur dhe për çfarë shkaku përdoret, cili është qëllimi i tij etj, janë krijuar kritere, gjegjësisht ndryshime të caktuara të gjuhës, si ato: **stilistike, dialektore, sociolektore, zhargonike, idiolektore** etj. Këto ndryshime u bënë më të dukshme me formimin e qendrave të mëdha kulturore, ekonomike dhe politike në kuadër të rajoneve të njëjta gjuhësore (si p.sh. në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Shkodër, Prizren, Vlorë, Tetovë, etj.), ku gjuha dhe jeta e përbashkët lindin nevojën e komunikimit, me ç'rast nga njëra anë zbuten dallimet më të dukshme të dialekteve të caktuara që sipas Jespersenit, së pari humbin ato dukuri dialektore të cilët njerëzit zakonisht i vërejnë dhe bëjnë shaka me ta. (Jespersen 1970:44), nga ana tjetër *gjuha standarde nëpërmjet sistemit arsimor, mjeteve të informimit etj. kontribuon në mënjanimin e dallimeve dialektore, kurse dialektet nga ana tjetër, përsëri përkrahin e ndihmojnë në vendosjen e formave dalluese të shtresimit të gjuhës, gjegjësisht ndihmojnë gjuhën standarde. Në kushte kur ekzistojnë dy ose më shumë variante të gjuhës standarde mund të paraqiten fusha për përhapjen e varianteve të ndërsjella. Nga ky aspekt variantet gjuhësore, si dhe dialektet, duhet t'i vështrojmë si dukuri sociolinguistike e jo si dukuri të pastra linguistike.*

Në zbatimin dhe realizimin e normës letrare shqipe në qendrat përkatëse kulturore, ekonomike dhe administrative dhe paraqitja e shtresimeve të ndryshme të gjuhës, ende nuk kemi analiza të thelluara shkencore, madje dukuritë e standardizimit të shqipes letrare janë vëzhguar fare pak ose aspak. Nëse duam të bëjmë planifikim të përbashkët në standardizimin e kristalizimin e gjuhës letrare në arsim dhe në fushat e tjera, atëherë çdo zgjidhje gjuhësore që propozohet duhet t'i nënshtrohet analizës profesionale-shkencore dhe verifikimit shoqëror.

Kriteret sociolinguistike të përdorimit të gjuhës shqipe

Gjuha, qoftë në atë të shkruar apo në atë të folur ndryshon në inventar, në zgjedhjen dhe përdorimin e mjeteve me të cilët disponon. Nga teoria e gjuhësisë, janë paraqitur katër lloje kriteresh gjuhësore: ai **funksional**, **social**, **territorial** dhe **individual**. (Ibrahimi 2012:102).



Por gjatë shqyrtimit të koncepteve të raporteve midis gjuhës standarde dhe ligjërimeve dialektore, shumë autorë, gjatë klasifikimit kanë përzier këto kritere. P.sh. A. Kostallari përzien **kriterin funksional me kriterin territorial-hapësinor. Kjo përzierje vërehet gjatë klasifikimit të sistemit të varianteve të shqipes së sotme** i cili dallon trajtën *e shkruar* të gjuhës letrare, trajtën *e folur,* që "përfshin gjuhën e *ligjëratave botore të pashkruara* dhe *ligjërimin letrar-bisedor* të njerëzve më të shkolluar", *"ligjërimin e zakonshëm të bisedave të përditshme* në qytete" dhe *të folmet* e veçanta, kryesisht të zonave fshatare". (Kostallari 1985:29).

Të gjitha këto dhe dukuritë tjera gjuhësore, të manifestuara në formë variantesh kanë rëndësi dhe karakter relativ dhe thjesht pa marrë parasysh se cilit variant i takon është e pamundur t'i shkyçësh nga përdorimi gjuhësor i çdo individi – si folës dhe përfaqësues të gjuhës standarde shqipe, andaj sipas kësaj pikëpamjeje toleranca gjuhësore paraqitet si qëndrim i arsyeshëm dhe udhëzim i vetëm për sjellje gjuhësore dhe shoqërore.

3. Variacionet në fushën e terminologjisë

Terminologjia me veçoritë e zhvillimit të saj në standardin e shqipes hyn në të edhe me *parametrin e mbarëkombëtarisë*, që lidhet me përdorimin e terminologjive të ndryshme të fushave të dijes edhe në trevat e tjera shqipfolëse, si në Kosovë (ku gjuha

shqipe është gjuhë amtare) e në Maqedoni (si gjuhë e dytë zyrtare). Kjo nxjerr si detyrë për terminologjinë dhe njësimin e saj në këtë rrafsh. Më poshtë po sjellim një varg shembujsh të kategorive të ndryshme që pasqyrojnë gjendjen e terminologjisë shqipe në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoni (listë definitive për këto dallime deri tani nuk ka, shumica e shembujve janë marrë nga studimet e: Xhevat Lloshit, Ledi Shamku – Shkrelit, Agron Duros, Vilma Prokos etj.

Përdorime të ndryshme në terminologjinë leksikore			
Shqipëri	**Kosovë / Maqedoni**	**Shqipëri**	**Kosovë / Maqedoni**
argjendari	*artari*	*lavanteri*	*pastrim kimik*
autolimar	*autollamarinist / teneqepunues,*	*lavazh*	*autolarje/larje veturash*
autostradë	*autorrugë / autoban*	*luleshtrydhet*	*dredhëza*
axhustator	*bravar / mashinobravar*	*makinë*	*kerr / qerre / veturë*
dosje	*fasciкël / papkë*	*medikamente*	*ilaçe / barna*
drita jeshile	*drita e gjelbër*	*pallat*	*ndërtesë*
farmaci	*barnatore / aptekë*	*parukeri*	*frizer / floktore*
film i animuar	*film i vizatuar*	*pastiçeri*	*ëmbëltore*
furrë buke	*bukëpjekës*	*pema e Vitit të Ri*	*bredhi i Vitit të Ri*
gelateria	*akullore*	*pjesë këmbimi*	*auto pjesë*
gjela të detit	*biban / quran*	*Plaku i Vitit të Ri*	*Babadimri*
grila të brendshme	*roletar*	*publicitet*	*reklamë*
kaçavidë	*shtrafciger*	*qiellgërvishtësit*	*rrokaqiejt*
karotrec	*merimangë / kaçubet*	*serbator*	*rezervuar*
këmbim valutor	*këmbim valutash / këmbimore*	organizator	organizues / organizativ
kopsht i fëmijëve	*çerdhe fëmijësh / foshnjore*	*recensues*	*recensentë*

Të gjitha këto dhe dukuri të tjera gjuhësore, të manifestuara në formë variantesh, kanë rëndësi e karakter relativ dhe thjesht pa marrë parasysh se cilit variant i takon, është e pamundur t'i shkyçësh nga përdorimi gjuhësor i çdo individi – si folës dhe përfaqësues i gjuhës standarde shqipe, prandaj, sipas kësaj pikëpamjeje, toleranca gjuhësore paraqitet si qëndrim i arsyeshëm dhe udhëzim i vetëm për sjellje gjuhësore e shoqërore.

Nga ana tjetër duhet të kihet parasysh edhe *Parametri i kombëtarësisë,* si një veçori tjetër qenësore e terminologjisë, që duhet të mbështetet në ruajtjen e frymës amtare

edhe në këtë fushë të leksikut, në të cilën ndërkombëtarësia e përmbajtjes çon jo rrallë në përfshirjen në të të termave të huaj (ndërkombëtarë ose jondërkombëtarë), çka bën të nevojshme përshtatjen e formës së termave të natyrës së shqipes, sidomos në nivelin fonetiko-fonemor e morfologjik. Mendojmë se përshtatja e tyre natyrës së shqipes në dy nivele më kryesore, fonetiko-fonemor dhe morfologjik, do të ishte rruga më e drejtë për standardizimin e tyre.

4. Aspekte ligjore për statusin e gjuhës shqipe

Shumë çështje territoriale, shtetërore, ligjore (kushtetuese) lidhur në funksionimin e disa shteteve, si ai i Maqedonisë, i Malit të Zi dhe i Serbisë, janë në proces të ridefinimit, gjegjësisht të definimit përfundimtar. Statusi i gjuhës shqipe në këto shtete nuk është në nivelin e duhur. Kushtetutat e tyre kanë bërë hapa, por jo të mjaftueshëm për zbatimin e shqipes si gjuhë zyrtare me status ekskluziv. Në Maqedoni, të themi, gjuha shqipe, edhe pse është rregulluar me ligj, mund të përdoret vetëm në komunat me mbi 20% popullsi, por jo edhe në tërë territorin. Mund të thuhet se gjuha shqipe në këtë a atë mënyrë luan edhe rolin e ndërmjetësuesit të tipit *lingua communis*, kjo gjë ndodh kryesisht në Shqipëri dhe Kosovë, por jo edhe në Maqedoni, në komunat me shumicë shqiptare, ku maqedonasit nuk janë të detyruar të mësojnë shqipen.

Tani kur kemi dalë nga një fazë me organizim tjetër, pavarësimi i Kosovës dhe statusi në ndryshim e sipër i shqipes në Maqedoni kanë sjellë realitete të reja në raportet e komunikimit me Shqipërinë. Nëse politikën e gjuhës e përmbledhim në një tërësi veprimesh racionale institucionale, jo në një grumbull veprimesh të veçanta, në fushën e hapësirës së komunikimit shtrohet pyetja: cila është politika e formësuar e gjuhës?

Sa i përket statusit, gjuha shqipe është në një dinamizëm të gjerë. Neni 14 i Kushtetutës së Shqipërisë sanksionon: "Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja", ndërsa neni 59 shton: "Shteti synon /…/ mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe". Asgjë më shumë në dokumentacionin juridik të vendit të shqipes që do t'i dilte zot gjuhës së vet, ndërkohë që të gjitha vendet përreth, edhe në tërë Evropën kontinentale, kanë ligje të veçanta për gjuhën nga sistemi arsimor e deri te mbrojtja e konsumatorëve, p.sh., po cekim që Ligjin polak për gjuhën kërkon madje edhe mbrojtjen e dialekteve. Kushtetuta e Kosovës, nga ana e saj, sanksionon se "gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe". Në paragrafin 5.2. saktësohet: "gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në

përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligjin". *Ligji për përdorimin e gjuhëve* nr. 02./L-37 i vitit 2006, në nenin 2.1. ka shpallur që "gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë", ndërsa në paragrafin 3. të këtij neni, Ligji ka specifikuar: "në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën së paku 5% të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë", për të vazhduar në të njëjtin paragraf diçka tjetër: "Pavarësisht kësaj që u tha më lart, në mënyrë të veçantë, në komunën e Prizrenit gjuha turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare". Në komunat ku një bashkësi etnike përfaqësohet nga më shumë se 3% e popullatës, gjuha e saj do ta ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar. Siç shihet dispozitat e këtilla ligjore të Kosovës janë në një pozitë të ndryshme nga vendet e rajonit sa u përket standardeve për gjuhët e minoriteteve. Mbi këtë bazë, ta zëmë, boshnjakishtja në Kosovë ka status të *gjuhës në përdorim zyrtar*. Në Maqedoni shqipja flitet nga mbi 25% e popullatës së shtetit, por është gjuhë zyrtare vetëm në komunat ku popullata shqiptare përbën mbi 20%. *Ligji për përdorimin e gjuhës maqedonase*, neni 2, sanksionon: "Përdorimi i gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare është e drejtë dhe detyrë e qytetarëve të Republikës". Në Luginën e Preshevës dhe në Mal të Zi statusi i shqipes është i gjuhës minoritare me përdorim zyrtar; në Itali arbërishtja konsiderohet si pakicë gjuhësore, kurse në Greqi pa status fare.

Diglosia - një situatë gjuhësore relativisht e qëndrueshme

Diglosia është e patjetërsueshme në bashkësitë shumëgjuhësore. Kur janë në pyetje "krizat" e mundshme, ato mund të paraqiten në Maqedoni, në Mal të Zi e në Serbi, kryesisht rreth statusit të shqipes në ato shtete. Ç. Fergusoni e përkufizon diglosinë si "një situatë gjuhësore relativisht e qëndrueshme në të cilën, krahas dialekteve parësore të gjuhës (të cilat mund të përfshijnë një dialekt standard dhe dialektet rajonale), ekziston një varietet shumë i ndryshëm, tepër i kodifikuar (shpesh më i ndërlikuar gramatikisht, i mbivendosur, i cili shërben si mjet shprehjeje për letërsinë e shkruar qoftë të një periudhe të mëparshme, qoftë të një bashkësie tjetër gjuhësore, dhe që përvetësohet kryesisht nëpërmjet edukimit formal dhe përdoret në ligjërimin formal të shkruar e të folur, por që nuk përdoret nga ndonjë segment i bashkësisë në ligjërimin e zakonshëm." (Ferguson 1971:16).

Siç shihet, Fergusoni pranon diglosi vetëm në rastet kur kemi kundërvënie midis "dialekteve parësore të një gjuhe", të cilat dalin në rolin e një varianti të ulët (Low), dhe të një varianti të lartë (High), i cili nuk përdoret në ligjërimin e zakonshëm, d.m.th. raporti variant standard -dialekte të tjera bashkekzistuese nuk klasifikohet si

diglosi prej tij. Por më vonë përkufizimet për diglosinë zbuten. Kështu, J. Fishmani thotë se për diglosi mund të flitet "jo vetëm në shoqëritë që njohin zyrtarisht disa "gjuhë" dhe jo vetëm në shoqëritë që përdorin dialekte vendëse dhe klasike (si p.sh. dialektet arabe dhe arabishtja klasike sot - *shën. ynë),* por edhe në bashkësitë që përdorin dialekte a regjistra të ndryshëm ose variante gjuhësore të diferencuara funksionalisht, të çdo lloji qofshin ato". (Fishman 1971:74).

Varietet e gjuhës së përbashkët shqipe

Në kushtet e sotme, kur kërkohet të përdoret një gjuhë e përbashkët në krejt arealin shqipfolës, si në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni etj., norma standarde paraqet gjendje të ndryshme socialinguistike të shqipes. Çfarëdo lloj përpjekjeje elementare për të parë pak rend në këto çështje, nxjerr në shesh dallimin ndërmjet një bërthame ballkanike me vazhdimësi të trashëguar e gjeografike, ku hyjnë Shqipëria e Kosova si shtete të pavarura, Maqedonia me pjesët e saj shqiptare, Lugina e Preshevës, bashkësia shqiptare në Mal të Zi, diaspora e re në vendet e Evropës Perëndimore, sidomos në Gjermani, Zvicër, Austri, Itali, vendet Skandinave e posaçërisht në Greqi, në SHBA, Australi me lidhjet e gjalla me trungun, dhe diaspora historike në Itali, Greqi, Turqi, Ukrainë e Zarë. Këto dallime ndodhin sepse e njëjta normë zbatohet në mjedise të ndryshme sociokulturore, me formacione shoqërore dhe me sisteme jo të njëllojta ekonomike, politike etj., Kjo ndikon që gjuha të pësojë ndryshime fonologjike, morfologjike, leksikore e sintaksore. Pikërisht sociolinguistika fokusimin e saj e ka drejtuar në problematikën e politikës dhe planifikimit gjuhësor.

Duhet të ndërgjegjësohemi dhe të shtrojmë pyetjen si hynë shqipja në mijëvjeçarin e ri, kjo shtron kërkesën e përpunimit të një politike të re gjuhësore. Sepse duhet të jemi të vetëdijshëm se pas nënshkrimit të rezolutës së vitit 1972, gjuha standarde ndodhet në një kontekst tjetër kulturor nga koha kur u nënshkrua. Normimi i gjuhës letrare, standardizimi si dhe kultivimi i saj mbeten ndër detyrat kryesore e parësore të gjuhëtarëve, të punëtorëve dhe të intelektualëve tjerë kulturorë, duke u bazuar në 10 fazat kryesore.

Klasifikimin që e propozojmë këtu jemi inspiruar nga diskutimet dhe zgjidhjet që ofrojnë shumë sociolinguistë që merren me këtë problematikë, si: A.Haugen, J.V. Neustupni, Xh.Fishmen, V.Tauli, P.L.Garvin, C.A. Ferguson etj. Të dhëna më të plota në këtë fushë të hulumtimit na ofron përmbledhja *Advances in Linguage Planning, 1974, sidomos në pjesën hyrëse të studimit (15-124): (1)* seleksionimi (=zgjidhje) e normave; *(2)* Deskriptimi (= përshkrimi); *(3)* Kodifikimi (=vënia e rregullave); *(4)* Elaborimi (=përpunimi); *(5)* Akceptuazimi (=pranimi); *(6)* Implementimi (=zbatimi); *(7)*

Ekspanzimi (=zgjerimi); *(8)* Kultivimi (=përkujdesje); ***(9)*** **Evoluimi (=vlerësimi) dhe *(10)* Rekonstruktimi (=rindërtimi).** (Shih Figura 3).



Gjuha e normuar duke kaluar nëpër të gjitha fazat, ajo medoemos duhet t'i nënshtrohet edhe vlerësimit të patjetërsueshëm dhe të vazhdueshëm (9). Në këtë mënyrë krijohet mekanizëm për kontrollimin dhe vlerësimin e shkallës së adaptimit të gjuhës standarde me nevojat e shoqërisë, kulturës, individit dhe kolektivit. Nëse megjithatë paraqitet nevoja për ndryshimin e normës, atëherë bazohemi në fazën e fundit sipas fazave të përshkruara, për rikonstruktimin e normës (10).

Përfundime

Edhe përpos urbanizimit, arsimimit, komunikimit, lëvizjes etj., variantet e një gjuhe nuk zvogëlohen dhe nuk zhduken, por zakonisht ndodh e kundërta, ato zgjerohen e zhvillohen, si p.sh. variantet standarde të anglishtes "evropiane" dhe "amerikane"; të gjermanishtes "austriake" dhe "gjermane"; ose të spanjishtes "së Amerikës jugore" me atë "spanjolle."

Gjatë realizimit të kësaj faze, të ashtuquajtur planifikim gjuhësor, nuk duhet të marrin pjesë vetëm gjuhëtarët, por edhe shumë faktorë tjerë pa të cilët organizimi dhe puna e këtij lloji nuk do të ketë sukses (si p.sh. shkollat, institucionet kulturore dhe shkencore, shtëpitë botuese, mjetet e informimit, shoqatat gjuhësore etj.). Këtu duhet të kemi kujdes, sepse gjuha paraqet një nga elementet kryesore në listën e simboleve kombëtare të një bashkësie me të cilin shërbehet duke u mbështetur në ndonjë gjuhë standarde si një instrument të tij komunikues dhe krijues. Norma duhet të ketë kujdes për të gjitha shtresat gjuhësore, d.m.th edhe ndaj variacioneve të cilat paraqiten si

pasojë e veprimeve të proceseve të caktuara në gjuhë (dialektet, variantet, sociolektet, stilet etj.). Gjithashtu ajo duhet të merr parasysh edhe rregullat për zgjedhje dhe përdorim të variacioneve të caktuara gjuhësore në mjediset ku paraqitet dukuria e diglosisë, por duhet të mbahet kufizimi i qartë midis standardit dhe substandardit. Përveç fazave të përmendura në kushtet që një variacion gjuhësor bëhet e normuar duhet të merren parasysh edhe shumë faktorë tjerë gjuhësor, jogjuhësor dhe kulturor-historik, sepse, shqipja ashtu si çdo gjuhë letrare normative e karakterizojnë disa veçori specifike, si: historiku i saj, baza dialektore a karakteri popullor i saj, marrëdhëniet e saja me gjuhë të tjera veçanërisht në thesarin leksikor, parimet e drejtshkrimit të saj, standardizimi policentrik i saj, normëzimi inveriabil (pa variante të trajtave) etj. (Mulaku 1989:6).

Si përfundim, mund të themi se tek individët folës gjuha standarde dhe e folmja nuk mund të bashkekzistojnë si dy sisteme gjuhësore të pavarura e me të njëjtin status, por të kultivohet vazhdimisht gjuha standarde e një gjuhe, e cila gjatë përdorimit dhe shqiptimit të tingujve dhe të folurit nga ata njerëz, nuk mund t'i dallojmë nga cili rreth vijnë. Një ide të tillë e gjejmë të formuluar nga gjuhëtari gjerman Ulrich Ammon, i cili, në mbështetje të mendimit të tij, sjell faktin që emisionet e radios dhe të televizionit kuptohen gjithandej në Gjermani (Barbour 1987: 233).

Referencat

AJETI, Idriz (1989). *Çështje të gjuhës letrare shqipe,* në "Studime gjuhësore në fushë të shqipes". Prishtinë: Rilindja.

BARBOUR, S. *(1987)*, *Dialects and the Teaching of a Standard Language. "Langue in Society", nr.16, 1987.*

BECI, Bahri (1995). *Gjuha letrare shqipe dhe baza e saj dialektore.* "Albania", 3 nëntor. Tiranë.

BUGARSKI, Ranko (2002). Lica jezika. BIGZ: Beograd.

BUGARSKI, Ranko (2005). Jezik i kultura. BIGZ: Beograd. (74-75)

DOMI, M. – Ajeti I (1992) *Gjuha letrare shqipe në dritën e zhvillimeve të reja poltike dhe kulturore në botën shqiptare.* Në konferencën "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot". Prishtinë.

FERGUSON, Ch. (1971). *Diglossia,* "Language Structure and Language Use", Stanford.

FISHMAN, J. (1971). "Sociolinguistics", Rowley, Massachusetts.

IBRAHIMI, Mustafa. (2012). *Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike.* Interlingua, Shkup.

ISMAJLI, Rexhep. (1991). *Gjuhë dhe etni.* Rilindja:Prishtinë

ISMAJLI, Rexhep. (2005). *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh.* Tiranë.

JESPERSEN, Otto (1970). *Čovječanstvo, narod i pojedinac* sa lingvističkog stanovišta. Sarajevo.

KALVE, Luj Žan (1995). *Rat među jezicima.* Beograd (92, 93, 94, 295)

KOSTALLARI, A. (1988). *Gjuha letrare shqipe dhe epoka jonë.* Tiranë.

KOSTALLARI, A. (1985). *Gjuha letrare kombëtare dhe epoka jonë,* "Gjuha jonë". Tiranë.

LLOSHI. Xhevat (2001). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika.* SHBLU:Tiranë.

LLOSHI. Xhevat (2003). *"Shqipja – gjuhë e hapur dhe dinamike".* Në Konferenca Shkencore – shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot. Tiranë.

MEIDANI, Rexhep (2004). *Një "iniciativë" për shqipen standarde.* Marrë nga interneti http://www.forumishqiptar.com/archive/index.php/t-36410.html, më datën 16/07/2004

MULAKU, Latif. (1989). *Disa çështje aktuale të standardizimit të shqipes letrare.* "Gjuha në shkollë", Prishtinë. f.3-11.

MURATI, Qemal (2004). *Gjuha shqipe sot- prirje të reja "evropianizuese".* Në 50 vjet studime albanologjike. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.

PAÇARIZI, Rrahman. (2005). *Raporti standard/dialekt dhe rrezikshmëria e shqipes në raportet globale.* Në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. 24/1, Prishtinë.

PALMER, Harold (1924). *A grammar of Spoken English.* Kembrixh.

RADOVANOVIÇ, Milorad (1979). *Sociolinguistika.* BIGZ:Beograd.

ROT, Nikola (2004). *Znakovi i značenja.* Beograd: Plato.

SHAMKU-SHKRELI, Ledi. (2007). *Standard dhe substandard.* Çabej: Tiranë.

SHKURTAJ, Gjovalin (2003). *Sociolinguistikë.* Tiranë.

Mustafa IBRAHIMI

LINGUISTIC VARIETIES IN DIFFERENT SOCIOLINGUISTIC ENVIRONMENTS OF THE ALBANIAN LANGUAGE

Abstract

Despite urbanization, education, communication and the frequency of people etc., varieties in the framework of a language, don't get smaller or don't disappear, but usually happens the opposite, they wake up and develope (e.x: the standard variety of the "european" and "american" english, the variety of standrad deutch of "germans" and "austrians", the variety of standard spanish of the "Nothern America" and

"Southern America". The impact of relationships between a standard language and dialect, is two sided, their relations are mutual, the standard language through the educational system, information tools etc., contributes on elemination of dialectal differences, and dialects from the other side, again support and help on setting new forms of stratification of the language, respectively help the standard language. In some cases where there exists two or more versions of the standard language can happen that new versions may come out. From this aspect the linguistic version, also the dialects, should be treated as a sociolinguistic occurance, and not as a clear linguistic occurance. In todays conditions, when it is required to use one common language in the albanian regions, like Kosovo, Albania and Macedonia., the standard rate shows a different situation of the sociolinguistics of albanian language. It happens that the same rate is used in some different socio-cultural areas, with a social formations and different economic and political systems., for undergoing phonetical, morphological, lescival and syntatic changes.

Kew words: varities, standard language, dialect, sociolinguistics

Elvis BRAMO

SHQIPJA E VANGJEL MEKSIT NË SHEKULLIN E XIX

Abstrakti

Fillimi i shekullit të XIX, me hovin që i dha letrave shqipe, solli me vete edhe ngarkesën gjuhësore të kohërave, të ndërkallur në gjuhën shqipe për arsye historiko-kulturore e socialo-ekonomike. Realiteti kulturor duke qenë se shprehet përmes gjuhës, në trajtën e tij më të lartë, se në çdo fushë tjetër, mundëson në rastin e përkthimeve të Vangjel Meksit, përcjelljen e trajtave leksikore të kohës, në veprat që ai përkthente në gjuhën shqipe. Problematika komplekse, mundëson, që studimi leksikologjik i brendisë së gjuhës së përdorur, të na drejtojë në fakte të qenësishme në lidhje me përdorimin e zotërimin e gjuhës shqipe të asaj kohe, e kryesisht të dialektit të toskërishtes ashtu sikundërse rezulton në përkthimin e Dhiatës së Re nga mjeku i Ali pashë Tepelenës, Vangjel Meksi. Duke qenë se përkthimet fetare në të gjithë botën kanë ndikuar mbi formësimin e teorive të përkthimit për secilin vend respektiv, kështu do të shohim se çfarë ndodh edhe me shqipen e sjellë nga Vangjel Meksi në përkthimin e tij në toskërisht të Dhiatës së Re. Sfidat dhe arritjet e përkthyesit, por edhe të gjuhës që ai përdori do të përpiqemi t'ju sjellim në këtë punim, nën dëshirën e të kuptuarit të vlerave, paçka se të përmbysura, nga fuqi të huaja e të mëdha, ndaj shqipes së shkruar e të folur të periudhës në fjalë.

Fjalë kyçe: *Përkthimi, shqipja shek.XIX, huazimet, dygjuhësia funksionale, sfidat gjuhësore.*

Çështë e vërteta, çdo gjuhë është si një lumë që rrjedh i pashkëputur[1]. I tillë është edhe rasti i shqipes, me variantin e saj të toskërishtes që ka përdorur Vangjel Meksi[2] në përkthimin e tij të Dhiatës së re të 1827-ës[3], një tekst ky tepër i plotë në

[1] Shprehje e gjuhëtarit të madh zviceran Ferdinand de Sossyre.

[2] Varfi, Gj. 2000. *Heraldika Shqiptare*, Dituria, Tiranë, f.91. *(Familja fisnike Meksi përmendet në dokumentet historike në shek.XV. Pas pushtimit osman, Meksajt luftojnë si stratiotë nëpër repartet e ushtrive të Venedikut. Një degë e kësaj familjeje u vendos në Dalmaci që më 1449. Më 1553 Meksajt i gjejmë në katalogun e familjeve fisnike të Kotorrit, i cili ishte nën Republikën e Venedikut).*

kakarteristika tekstuale, sa që vështirë se mund të thotë dikush se lindi nga hiçi. E themi këtë sepse në dialektin e toskërishtës nuk ekziston një traditë e mirëfilltë tektesh të mëparshme të shkruara në formatin e librit me të cilat mund të krahasojmë gjerësisht këtë material me përmbajtje fetare. Duke qenë pra se gjuha është një lumë që rrjedh pashkëputje, kështu edhe shqipja, gjuha jonë amtare ka rrjedhur qysh nga arbërit e është formësuar ndër shekuj duke u mbrujtur me fjalë e shprehje nga populli ynë. Pikërisht se ka pasur një traditë përdorimi të gjuhës së folur më të theksuar se përdorimi i gjuhës së shkruar, Meksi u detyrua të formësonte një alfabet origjinal të tijin dhe ku brenda pothuajse pesëmbëdhjetë muajve do të arrinte të përkthente të gjithë tekstin e Dhiatës së re, një punë kjo voluminoze të cilës do t'i trembej kushdo përkthyes profesionist akoma edhe sot.

Sikundërse edhe në rastin e shumë gjuhëve të tjera, ashtu edhe në rastin e gjuhës sonë amtare, historia e shkrimit të saj lidhet me përdorimin e përpjekjet që gjuha të mund të përdoret fillimisht në tekstet e hapësirat fetare e pastaj të mund të mendohej ndoshta për diçka më tepër. Vlen këtu të kujtojmë një shprehje të Konstandin Kristoforidhit që thotë[4]: *"...Po ndë mos u shkroftë gjuha e shqipes edhe sot mbë këtë ditë, nukë do të shkojnë shumë viet, edhe nukë do të ketë më Shqipëri ndë faqe të dheut, as nukë do të shënonetë më emri i Shqipërisë ndë hartët të botësë, as nukë do të përmendetë më bir shqiptari a bijë shqiptari pas kësaj jete..., sepse një gjëndje (λαός) që s'ka gjuhë të shkruarë, e vivlia në gjuhë të s'ëmësë, e skolira n'atë gjuhë që flet vëndi, nukë njihet për komp, po do ta trashëgojën'e do ta pushtojën' ata kombet'e tierë që gjendenë rreth e rotullë..."*.

Ndikimet e huazimet të greqishtes mbi shqipen e kohës, por edhe të turqishtes[5] mbi toskërishten e shekullit të XIX shfaqen haptazi në përkthimin e Vangjel Meksit, ky dygjuhësia funksionale e përkthyesit nuk rreshtet së ndërkalluri në vijimësinë e tekstit të tij. Përkthyesi, shpesh herë meqenëse i lindur në Labovë të Gjirokastrës ku shqipja, greqishtja dhe turqishtja përdoreshin rëndom mes shtresave të gjera të popullatës e ka vështirë në periudhën që jetoi të bënte dallimin leksikor të qartë mes shqipes e greqishtes, mes shqipes e turqishtes, duke ndërtuar kështu fjali me fjalë të të trija këtyre gjuhëve e duke ju dukur se po fliste e shkruante në një shqipe të kulluar, sikundrsë kërkonte Shoqëria Biblike, në mënyrë që teksti përfundimtar të ishte gjerësisht i kuptueshëm nga shumica e shqiptarëve. Kjo ishte dhe sfida më e pakapërxyeshme për përkthyesin tonë.

Në kopertinën e doreshkrimit të përkthimit p.sh. ai shkruan:

[3] Shih për më tepër: Disertacionin e Bramo, E. *Përqasja e shqipes me greqishten në botimin e parë të Dhiatës së re, 1827*, Tiranë 2016, nën udhëheqjen e prof. dr. Xhevat Lloshit.

[4] Haxhi, A. Topalli, T. 2012. *Leksikon Gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë*, Fiorentia, Shkodër, kopertina thëniet nga pas.

[5] Haxhi, A. – Topalli, T. 1999. *Histori e gjuhës së shkruar shqipe*, Shkodër, f.86.

Të kthyerit'ë e shenjt Mattheut Evangjelistiut

Ndë gjuhë shqipe ngaha *jatro* Vangjel Meksikoi.

Shohim se fjalën *jatro* që do të thotë sot *mjek*, Vangjeli e ndjente se ishte shqip, pasi në zonën ku u rrit kështu përdorej.

Në përkthimin e Meksit, shohim se në Shqipërinë e kohës kanë qenë tri gjuhët e huaja që përdoreshin për përmbushjen e nevojave të tri komuniteteve më të mëdha fetare që ushtronin veprimtarinë e tyre në vendin tonë. Latinishtja përmbushte nevojat e katolicizmit, greqishtja përmbushte nevojat e ortodoksisë dhe osmanishtja e turqishtja nevojat e fesë muslimane.[6] Ende sot këto besime e gjuhë bashkëjetojnë me shqipen sipas stilit funksional të gjithsecilës. Ajo që na tërheq vëmendjen në shprehjet fetare është se nën frekuencën e lartë të përdorimit të tyre ato kthehen disi në pasthirrma ose fjalë të ndërmjetme, e si rrjedhojë nuk arrijnë t'i nënshtrohen rregullave gramatikore të gjuhës shqipe. Pikërisht kjo gjë përbën edhe arsyen se përse këto shprehje fetare nuk fitojnë qytetarinë e tyre në leksikun e gjuhës shqipe akoma edhe sot e kësaj dite.

Kjo do të thotë se çdo gjuhë ka veçantitë e saj. Duke kaluar nga një gjuhë e huaj në një tekst shqip jemi të detyruar t'u nënshtrohemi rregullave të sintaksës dhe të logjikës së shqipes[7]. Nga ana tjetër edhe leksiku i gjuhëve nuk përputhet pikë për pikë. Ka fjalë të huaja të cilave nuk ju gjendet përgjegjësja shqipe dhe ndaj ndodh huazimi. Madje ka fjalë që rrjeta leksikore e shqipes nuk e mbulon nocionin përkatës dhe anasjelltas. P.sh.: dallimin e shqipes mes *supit* dhe *shpatullës* nuk e kanë të gjitha gjuhët evropiane. Madje edhe kur një fjale të huaj i përgjigjet një fjalë e shqipes, jo gjithmonë përmbajtja semantike e tyre është e njëjtë. (tjetër pasta ashuto në italisht e tjetër në shqip). Të gjitha këto së bashku e bëjnë përkthimin një veprimtari jo të thjeshtë e cila kërkon jo vetëm njohjen e mirë të gjuhëve, të thesarit, të veçorive të tyre, por shpesh kërkon dhe një mjeshtri të veçantë që është mjeshtria e përkthimit[8]. Kjo do të thotë një aftësi për të prodhuar një tekst në gjuhën shqipe, i cili mundësisht të jetë sa më besnik kundrejt origjinalit. Vetëkuptohet që çdo përkthim ka në këtë mënyrë një pjesë të origjinalitetit të përkthyesit, por në veçantinë e shqipes, në këtë fushë duhet përmendur një tjetër faktor, faktori historik. Rrethanat historike dhe kulturore në të cilat gjendur përkthyesit e ndryshëm shqiptarë kanë qenë të tilla, që nuk kanë lejuar të kishin një vazhdimësi të pandërprerë të shqipes së shkruar, jo vetëm nga ana historike, por edhe nga ana gjeografike e kulturore. Ka ndodhur disa herë që përkthyesit e

[6] Shih për më tepër: Lloshi, Xh. 2012. *Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit*, Onufri, f. 125-153.

[7] Topalli, T. 2011. *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa e fjalisë*, Shkodër, f.220.
Kokona, V. 2003. *Mbi përkthimin, me përkthyesin*, botimet Kokona, f.8-9.

[8] Tupja ,E. 2000. *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë, f. 19-20.

autorët shqiptarë e shekullit të XIX nuk e kanë njohur traditën e mëparshme, madje ka kujtuar ndonjëri prej tyre se ka qenë i pari që po shkruante shqip, siç është rasti i Nezim Frakullës në shekullin e XVIII.

Duke u përpjekur Vangjel Meksi me gjithë vështirësitë e kohës të sillte një tekst të qëndrueshëm dhe me koherencë e kohezion arriti ta bënte këtë duke përdorur fjalë të huaja e huazime nga të trija gjuhët që përdoreshin në territorin e Shqipërisë së kohës duke formësuar një tablo filologjiko-historike[9]. Pavarësisht këtyre, dy ishin problemet më të mëdha që ai si përkthyes haste: së pari çështja gjuhësore, d.m.th. cila ishte tradita ekzistuese dhe si ishte trajtuar më përpara kjo problematikë në lëvrime tekstesh analoge, dhe e dyta çështja dogmatike ku përkthyesi duhej t'i përmbahej me rreptësi origjinalit. Në këtë pikë në përgjithësi konfesione të ndryshme fetare kanë zbatuar një praktikë shumë të thjeshtë: kanë ruajtur gjuhën origjinale në të cilën janë hartuar për herë të parë tekstet e tyre të shenjta. P.sh.: kisha katolike e ka ruajtur tekstin latin deri në 1962-shin kur e ka quajtur të lejueshëm përkthimin në gjuhë të tjera. Kurani p.sh.: për shkak të karakteristikave të tij krejt të veçanta të arabishtes që përdor, është quajtur se nuk mund të përkthehet në gjuhë tjetër e për këtë arsye disa herë përkthimet e tij janë quajtur "një hije e origjinalit". Kjo është edhe arsyeja se përse në gjuhën shqipe Bibla dhe Kurani dalin të përkthyera shumë vonë dhe se askush nuk kishte të drejtë për arsye të ndikimit dogmatik të bënte një përkthim të lirë.

Meksi i rritur në fshatrat e Gjirokastrës, ndikohej nga greqishtja, i shkolluar në Itali për mjekësi me urdhër të Ali pashës ndikohej nga Italishtja e nga përkthimi i biblës nga Diodati[10] (fjala *consiglio*- vjen tek Meksi këshill, ndërkohë redaktohet nga Grigor Gjirokastriti si *kuvend*, fjala *campi* vjen nga Meksi si *fushësë* e zëvendësohet nga Gjirokastriti *arave* i ndikuar ky i fundit nga fjala greqisht *livadh* etj. si këto), duke jetuar në oborrin e Ali pashës ndikohej nga çamërishtja dhe arbërishtja e Greqisë d.m.th. nga bashkëatdhetarët e tij, me të cilët siç përmend edhe studiuesi Xhevat Lloshi, jetonte me ta në një babiloni gjuhësore që e rrethonte në oborrin e Ali pashës.

Përtej gjithë sa më sipër, një gjë Vangjel Meksi nuk e ndryshonte dot me lehtësi, faktin që duhej t'i qëndronte sa më besnik tektit origjinal meqënëse ishte tekst fetar e nuk lejonte hamendësime a tjetërsime. Kjo gjë duket lehtësisht edhe në ruajtjen sintaksore të gjymtyrëve të fjalive në shqip me bazë normat e greqishtes të tekstit burimor nga ku formësohej përkthimi. Kështu parë historikisht, ajo që bie në sy tek sintaksa e të gjitha përkthimeve biblike, edhe te Ungjilli i Mateut prej Vangjel Meksit,

[9] Shih për më tepër: Lloshi, Xh. 2013, *Periudhat historike të shqipes*, Logos A, Shkup, f. 8-9.
[10] Giovanni Diodati, teolog italian nga Zvicra, profesor i hebraishtes dhe i teologjisë, përktheu biblën italisht në 1607. Shih Lloshi, Xh. 2012 "Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit", Onufri, Tiranë, fq. 132-3.

janë bashkimet e fjalive me parataksë. Kjo ndodh sepse strukturat me hipotaksë në njësitë e mëdha ligjërimore si njësi-fraza, dalin më të vona se ato me parataksë, mbasi shënojnë edhe një zhvillim psikolinguistik të gjuhës, si prirje drejt abstragimit dhe shprehjes së mendimeve më të ndërlikuara[11]; p.sh.: *"E ju qas edhe së ditit,// e i tha edhe atij,// ashtu e ai ju përgjigj//, e i tha:// Unë Zot, nuk vate" (f 292). Profesor Eqerem Çabej[12], kur analizon sintaksën historike të gjuhëve indoevropiane (paralelizma me shqipen), vëren se "lidhur me bashkërenditjen dhe me nënrenditjen duhet të themi se në periodat e para mbizotëronte bashkrenditja, koordinimi kur kemi të bëjmë me disa fjali." P.Sh.:* fjali nga Krijesa: Edhe gjithë dheu kishte një gjuhë e një za. **Edhe** kur u nisnë prei së lemesë diellit, gjetnë një fushë ndë dhet të Shinarit, **edhe** ndenjënë atie. Etj. etj.

Këto forma lidhjesh fjalish me lidhëza bashkërenditëse, të cilat sot mund të gjeneroheshin të kombinuara me bashkimet që do të kërkonin edhe lidhëza nënrenditëse shpjegohen duke njohur natyrën e gjuhëve burimore satem, në të cilat u shkruan tektet biblike e nga ku u përkthyen në shumë gjuhë të botës.

Në nivel fjalie vërejmë mjaft tipa fjalish: ndër më të dendurat dalin fjalitë dëftore, që në masën më të madhe nisin me lidhëzën "e", "dhe", "edhe", si p.sh.:

Edhe Iisui i tha. E ai nuk u përgjigj asaj asnjë fjalë. E gruaja i falej atij. Zot ndihmë mua. Edhe ajo tha. E erdhnë nde ai shumë botë. Edhe Iisui u tha atyre. Këto janë të gjitha fjali dyshe me Subjektin dhe Predikatin dhe rendi i zakonshëm del: S+P, S+P+O1, S+P+O2 por edhe me rend të anasjelltë Predikat + Subjekt. (O1= objekti)

Ajo që dallojmë në përkthimin e Meksit është se lëvrimi i shqipes së shkruar që në fillimet e veta e deri në ditët e sotme është mbështetur në gjuhën e gjallë të folur. Autorë e përkthyes të ndryshëm që atëherë e deri më tani mbeten të përqëndruar në ruajtjen e natyrës së shqipes dhe përpunimin e saj për arsye funksionale e estetike. Ndërkaq, sot, gjuha e shkruar i zgjeron në mënyrë të jashtëzakonshme sferat e veprimtarisë njerëzore që pasqyron dhe prandaj gjuha nuk mund të kufizohet vetëm tek burimi i gjuhës së folur. Rrugëzgjidhja e parë është krijimi i fjalëve të reja për nevojat e këtyre fushave të gjera, duke u mbështetur në temat e shqipes. P.sh.: në dorëshkrimin e tij V. Meksi ka turqizmin *hambari* të cilën më pas në veprën për botim e korrigjon dhe e bën *arkëzë,* ndajfoljen e gjuhës së folur *ateje* e bëri *prej andej*, gjë që edhe sot tingëllon mjaft mirë. Rasti i fjalës arkëzë është një neologjizëm që nuk zuri vend, por që dëshmon se si përkthyesi përpiqej për gjetjen e diçkaje sa më të drejtë[13]. Nga folja *trembem* bëri neologjizmin *tremblak* dhe *trembarak,* që edhe këto tingëllojnë jo fort keq në gjuhën shqipe. Njëkohësisht, për nevojat e një mendimi më të ndërlikuar

[11] Demiraj, Sh. 1985. *Gramatika historike e gjuhës shqipe,* Tiranë, f. 39-40.
[12] Çabej, E. 2008. *Hyrje në indoevropianistikë (Leksionet e Prishtinës),* Tiranë, f. 228.
[13] Umberto, E. 2006. *Të thuash gati të njëjtën gjë (Përvoja përkthimi),* Dituria, Tiranë, f. 193-196.

dhe të një gjuhe më shprehëse autorët e përkthyesit kërkojnë e krijojnë struktura të reja sintaksore, por përsëri edhe kjo është e pamjaftueshme. Ndaj rrugëzgjidhja mbetet tek arritjet gjuhësore dhe kulturore që ne i njohim falë përkthimeve nga gjuhët e tjera.

Turqizmat dhe greqizmat[14] janë fjalë të leksikut që gjenden më së shumti në veprën e përkthyer. Turqizma si: avlli, asqer, bajalldis, aferim, borxh, çadër, çati etj. etj.të shumtë vërtetë në numër mbetën në tekstin përfundimtar edhe për shkak të redaktimit të këtij të fundit nga Grigor Gjirokastriti i cili përdorte shumë turqizma syresh sepse jetoi gjatë në Eube, zonë kjo e rrahur shumë nga turqit që atëherë quhej Negroponte e ishte nën sundimin osman, ku kishte detyrën e arkimandritit dhe të kryepeshkopit, fakt ky që i jepte atij autoritetin e autorizimit të anës dogmatike të miratimit të përkthimit e të redaktimit, që më pas teksti të dilte për botim. Ndërkohë greqizmat dhe përdorimi i tyre ishte një thjeshtëzim i pandjerë shpesh herë për arsye të rritjes së V. Meksit pranë Gjirokastrës ku fjalët greke përdoreshin rëndom e ndaj në tekst hasim shpesh fjalë si: adhinato, kolas, poliandhisi, trivol, sillois, llogarismo, anomi etj.

Përfundime

Përkthimet nga gjuhët e tjera kanë dhënë një ndihmesë të rëndësishme si për zgjerimin e leksikut të shqipes, po ashtu edhe për pasurimin me ndërtime sintaksore dhe forma shprehjesh të reja. Në këtë mënyrë edhe shqipja përmes përkthimeve dhe kontaktit me gjuhë të tjera ka arritur të tregojë se nuk ka ç'ti ketë zili gjuhëve të tjera, kur arrin të përkthejë në gjirin e saj vepra madhore e kur ka përkthyes të zotë që sfidojnë kohërat ku jetojnë me prurjet e tyre. I tillë ka qenë edhe përkthyesi i parë i Dhiatës së re në toskërishten e shekullit të XIX, Vangjel Meksi i cili mundësoi me këtë vepër të dëshmonte për kohën ekzistencializmin e gjuhës shqipe me vepra, sepse kështu shqipja e shkruar në letër të shtypur zuri vendin e saj përballë opinionit filologjik evropian nga ku nisën pastaj shumë albanologë të interesoheshin duke i dhënë fund periudhës së dyshimit dhe të pasigurisë së ekzistencës së gjuhës shqipe dhe të popullit që e fliste atë sikundëse tha edhe J. Ksilander më 1835-ën.

[14] Shih për më tepër gjithë korpusion e vjelë të turqizmave dhe greqizmave në disertacionin e Bramo, E. 2016 *Përqasja e shqipes me greqishten në botimin e parë të Dhiatës së re 1827*, Tiranë, f.56-65.

Bibliografia

Çabej, E. 2008. *Hyrje në indoevropianistikë* (Leksionet e Prishtinës), Tiranë.
Disertacion Bramo, E. 2016 *Përqasja e shqipes me greqishten në botimin e parë të Dhiatës së re 1827,* Tiranë.
Demiraj, Sh. 1985. *Gramatika historike e gjuhës shqipe,* Tiranë
Haxhi, A. – Topalli, T. 1999. *Histori e gjuhës së shkruar shqipe*, Shkodër.
Haxhi, A. Topalli, T. 2012. *Leksikon Gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë*, Fiorentia, Shkodër
Kokona, V. 2003. *Mbi përkthimin, me përkthyesin*, botimet Kokona, Tiranë.
Lloshi, Xh. 2012 Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit, Onufri, Tiranë.
Lloshi, Xh. 2013, *Periudhat historike të shqipes*, Logos A, Shkup.
Tupja, E. 2000. *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë.
Topalli, T. 2011. *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa e fjalisë*, Shkodër,
Umberto, E. 2006. *Të thuash gati të njëjtën gjë* (Përvoja përkthimi), Dituria, Tiranë.
Varfi, Gj. 2000. *Heraldika Shqiptare*, Dituria, Tiranë.

Elvis BRAMO

THE ALBANIAN LANGUAGE OF VANGJEL MEKSI IN THE XIX-th CENTURY

Abstract

The beginning of the XIX-th century, with the leap that it gave to Albanian literature, took with it the linguistic load of the time, related with the Albanian language for the historical-cultural and social-economic reasons. Since the cultural reality is expressed through language, in its highest form, than in other field, it enables the convey of the lexicological forms of the time, in the works he translated in Albanian. The complex problematic, enables that the lexicological study of the language used, leads to important facts related with the use and owning the Albanian language of that time, especially in the Tosk dialect, as it results in the translation of the New Testament from the doctor of Ali pashë Tepelena, Vangjel Meksi. Since the religious translations all around the world affected over the creation of the translation theories for the respective countries, here we will observe what happens with the Albanian language brought by Vangjel Meksi in his Tosk translation of the New Testament. The challenges and the achievements of the translator, and the language he used, we will try to bring in this paper, with the desire of understanding the values,

though overthrown, from big foreign powers, towards the written and spoken Albanian language of the period in question.

Key words: Translation, albanian language, XIX-th century, borrowings, functional bilingualism, linguistic challenges.

Elsa SKËNDERI-RAKIPLLARI

KËNGË DASHURIE NË DY KOHË

Abstrakti

Gjuhësia e korpuseve dhe Analiza Kritike e Diskursit (së këndejmi AKD) kanë nisur të konsiderohen si dy disiplina të cilat mund të ndërthuren më së miri, për të analizuar varietete të ndryshme gjuhësore. Nga njëra anë korpusi shërben si "një përmbledhje tekstesh gjuhësore, të përzgjedhura për të karakterizuar një gjendje ose një varietet të një gjuhe" (Sinclair 1991), ndërsa nga ana tjetër, për AKD-në çdo varietet gjuhësor "është historik dhe mund të kuptohet vetëm në lidhje me kontekstin, ndaj AKD-ja iu drejtohet koncepteve jashtëgjuhësore si *kultura, shoqëria* dhe *ideologjia*." (Wodak, Meyer 2002) Ky studim synon të hetojë gjurmët e ideologjisë në tekstet e këngëve të dashurisë, të shkruara e kënduara në dy kohë e në dy realitete të ndryshme sociale e politike. Për mbledhjen e të dhënave u ndërtuan dy korpuse, njëri prej të cilit me tekste këngësh dashurie, të paraqitura në Festivalin e Këngës në RTSH, gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri dhe tjetri, me tekste këngësh dashurie të post-komunizmit, të paraqitura në Festivalin "Kënga Magjike". Të dhënat sasiore që vijnë nga krahasimi i frekuencave të fjalëve në dy korpuset e lartpërmendura tregojnë qartësisht se ndonëse këngët e dashurisë i referohen të njëjtit realitet ndjesor, i cili në thelb është i pandryshueshëm, për sa kohë ndjenjat dhe përjetimi i tyre janë universale, prapëseprapë tekstet e këngëve të dashurisë bartin gjurmë të ideologjisë së kohës kur janë kënduar. Për AKD-në ideologjia e diskursi janë ngushtësisht të lidhur (Fowler *et al.* (1979), Van Dijk (1995) (1996), Hodge, Kress (1993) Wodak, Ludwig (1999) Chouliaraki, Fairclough (1999), etj.) dhe të gjitha diskurset janë të formësuara nën ndikimin e ideologjisë. Ky argument na shpie në hullinë e pohimit determinist se "gjuha e bën njeriun", duke i ofruar atij një prerje të caktuar realiteti, *këtu* nën ndikimin e ideologjisë dhe se ndonëse realiteti i ndjenjave si dashuria, në mos "objektiv", është realitet universal, ai gjuhësohet ndryshe në dy kohë e dy kontekste politiko-shoqërore të ndryshme përmes skemash të ndryshme konjitive.

Fjalët kyçe: *Analizë kritike e diskursit, Gjuhësi e Korpuseve, ideologjia, skema konjitive, Festivali i Këngës, Kënga Magjike*

HYRJE

Studimet për diskursin, qofshin ato kritike ose jo, kryhen shpesh me ndihmën e korpuseve gjuhësore. Kjo lloj qasjeje përligjet nga fakti se korpuset përbëhen nga një fjalës i caktuar, që i korrespondon një referenti të caktuar, i cili nga ana tjetër ndikohet nga koncepte jashtëgjuhësore si *kultura, shoqëria* dhe *ideologjia.* Në studimin në fjalë, gjuhësia e korpuseve dhe analiza kritike e diskursit (AKD) ndërthuren për të analizuar tekstet e këngëve të dashurisë, duke u nisur nga premisa se çdo fragment diskursi nuk mund të shihet i shkëputur nga konteksti të cilit i përket. Këngët e dashurisë, ndonëse i referohen të njëjtit realitet ndjesor universal (që në mos *ante rem,* është *in rebus,* ose edhe *post res*), reflektojnë realitetin social e politik të kohës kur janë shkruar e kënduar.

Nevoja për një qëmtim të teksteve të këngëve lindi jo veç prej hipotezës se këto tekste përbëjnë një "varietet gjuhësor që është historik dhe kuptohet në lidhje me kontekstin" Wodak, Meyer 2002), por edhe prej një qëndrimi të sotëm disi paragjykues, se tekstet e muzikës së sotme shqiptare janë "pa kuptim, pa fabul të mirëfilltë, të stisura", ndryshe nga "këngët e bukura të dikurshme, që kishin një mesazh e një tekst të mirëfilltë". Leksemat e teksteve të këngëve të kënduara gjatë komunizmit dhe pas komunizmit, hedhin dritë mbi mënyrën se si gjuhësohet realiteti social e politik dhe se si ideologjia mund të depërtojë në mënyrë të vetëdijshme ose jo, deri edhe në tekstet e këngëve të dashurisë. Stubbs-i (1996: 107), me të drejtë pohon se "nuk ka terma neutralë. Zgjedhja e fjalëve shpreh një qëndrim ideologjik".

Tekstet e këngëve më përfaqësuese të dashurisë, të kënduara në Festivalin e Këngës në Radio-Televizionin Shqiptar, gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, u bënë pjesë e një korpusi me 5130 types dhe 5621 tokens. Veç tij, një korpus tjetër me 7124 types dhe7868 *tokens* u ndërtua me tekste këngësh dashurie, të kënduara në Shqipëri, në një tjetër festival kënge, pas viteve të komunizmit.

KORNIZA TEORIKE

Muzika si identitet

Për shumë studiues (Little dhe Zuckerman 1986, McCown *et al.* 1997, Gowensmith dhe Bloom 1997, McNamara dhe Ballard 1999) muzika është jo vetëm e lidhur ngushtë me personalitetin e atyre që e dëgjojnë, por edhe një formë shprehjeje e identitetit social. "Kjo lidhje e muzikës me identitetin është përkrahur edhe më tej nga Knobloch-i dhe Mundorf-i (2003) që nënvizojnë se preferencat muzikore janë në fakt një mjet për të komunikuar dhe shprehur identitetin." Pas një hulumtimi të po kësaj natyre, autorët Pettijohn e Sacco (2008) mbërritën në përfundimin se në kohëra të

vështira ekonomike dhe sociale, tekstet e këngëve kishin prirje të kishin më shumë fjalë për fjali, të përqendroheshin më tepër te e ardhmja dhe të ishin më kuptimplota, më ngushëlluese dhe më romantike njëherazi.

Së këndejmi del në pah rëndësia e qëmtimit të teksteve të këngëve, të cilat "janë një formë e rëndësishme komunikimi, që u shërben një sërë qëllimesh, siç është dokumentuar edhe në psikologjinë e literaturës gjuhësore. Tekstet tregojnë histori dhe komunikojnë me audiencat në mënyrë të ngjashme me atë se si njerëzit bisedojnë me njëri-tjetrin. Kur shoqërohen me fjalë, këngët na lejojnë të komunikojmë emocione, të tregojmë ngjarje dhe madje të shprehim mendimet e qëndrimet tona" (Pettijohn, Sacco 2009: 297).

***State of art*: Studime për tekstet e këngëve, bazuar në korpuse**

Studimet e derimëtanishme për tekstet e këngëve, që bazohen mbi korpuse të ngritura me këto tekste, kanë qenë me qëllime të dyanshme. Ato herë janë nisur nga interesi për të hulumtuar një zhanër të caktuar muzikor, përmes potencialit analitik të gjuhësisë së korpuseve dhe herë të tjera nga interesi për të zbuluar paralelet që mund të hiqen ndërmjet "strukturave tekstuale të gjuhës dhe strukturave muzikore të këngëve". (Kreyer, Mukherjee 2009: 32) I këtij tipi është, për shembull, studimi i autorëve Johnson dhe Larson (2003), "*Something in the way she moves: Metaphors of Musical Motion*", ku teoria e metaforës konceptuale shihet e ndërlidhur me lëvizjen muzikore dhe me ritmin. Interest të veçantë paraqesin edhe studimet e natyrës psikolinguistike që qëmtojnë lidhjen mendore mes muzikës dhe gjuhës, që, për shembull, "mund të ndihmojë të shpjegohet përse, siç është vënë re shpesh, të sëmurët me Parkinson, mund të jenë të paaftë për të folur, por të aftë për të kënduar (kur kanë një bazë muzikore)" (Kreyer, Mukherjee 2009: 32).

Në këtë hulli të dytë interesi për të analizuar gjuhën e teksteve të këngëve, gjuhëtarët kanë përshkruar gjuhën e teksteve të këngëve për të zbuluar në to se si diskurse të caktuara, që i kanë rrënjët në kontekste të caktuara socio-kulturore, shërbejnë për të ndërtuar realitetin, identitetin social dhe/ ose për të projektuar ideologjinë, ky i fundit interes, kryesisht i Studimeve të diskursit të asistuara nga Korpuset (*CADS- Computer-Assisted discourse studies*).

Ndër studimet që mund të përmenden në këtë lëmi janë: "Le të flasim muzikë: Një relacion i bazuar në korpus, i lëvizjes muzikore" (Perez-Sobrino, Julich 2014), "Konceptualizimi i muzikës: Metaforat e muzikës klasike" (Šeškauskienė, Levandauskaitė 2013), , "Diçka në mënyrën se si ajo lëviz: Metaforat e lëvizjes muzikore" (Johnson, Larson 2003), për të vijuar me "Një studim gjuhësor korpusi për

kontekstet në këngët angleze të rrymës pop", "Një studim i gjuhësisë së korpuseve për tekstet e këngëve të Bollivudit në kornizën e Teorisë së Rrjetit Kompleks" (Behl, Choudhury 2011), "Kohë të vështira, muzikë me kuptim, këngëtarë të matur: këngët e famshme të Billbordit dhe preferencat për këngëtarët nëpër kushtet sociale dhe ekonomike në SHBA" (Pettitjohn, Sacco 2009), "Stili i tekstit të këngëve pop: një studim pilot i gjuhësisë së korpuseve" (Kreyer, Mukherjee 2009) etj., etj.

Në studimet tona, me sa dijeni kemi, qasja ndaj teksteve të këngëve mund të ketë qenë letrare e stilistike, por nuk është bërë fjalë për qasje të mirëfillta gjuhësore, e aq më pak të kryera me ndihmën e gjuhësisë së korpuseve. Ndaj, punimi në fjalë mund të shërbejë për të hapur një rrugë të re për studime të ngjashme të cilat do të kenë në fokus këtë ndërlidhje disiplinash.

Bashkërendimet analiza diskursi- analiza kompjuterik

Për teoricienët e Analizës Kritike të Diskursit (CDA), përpara se të kryhet një analizë e kësaj natyre, lipset të bëhet dallimi mes fijeve të diskursit dhe mes fragmenteve të tij, prandaj në funksion edhe të këtij studimi, duhen veçuar dy koncepte teorike. së pari, koncepti i *fijeve të diskursit* (discourse strands) të cilat janë "procese diskursive të cilat janë tematikisht uniforme", çka do të thotë se kanë si bosht të njëjtën temë.. Çdo fill diskursi ka një përmasë sinkronike dhe një përmasë diakronike (Wodak, Meyer 2002: 47). Kësisoj tërësia e teksteve të këngëve të dashurisë përbën një fill diskursi. Nga ana tjetër koncepti *fragment diskursi* përdoret për t'iu referuar "një teksti ose një pjesë teksti që ka të bëjë me një temë të caktuar." Çdo fill diskursi përbëhet nga fragmente diskursi. Në punimin në fjalë tekstet e këngëve të kënduara gjatë komunizmit përbëjnë fragmente diskursi, po ashtu si tekstet e këngëve të korpusit të dytë.

Ndër pikëpamjet teorike të CDA-së, që shërbejnë për të analizuar të dhënat e korpuseve të këngëve, është ajo se "të gjitha diskurset janë historike, ndaj mund të kuptohen në lidhje me kontekstin e tyre. Në përputhje me këtë, CDA-ja iu drejtohet faktorëve të tillë jashtëgjuhësorë si kultura, shoqëria dhe ideologjia. Në çdo rast nocioni i kontekstit është thelbësor për CDA-në, përderisa ky i fundit përfshin në mënyrë eksplicite përbërës socialo-psikologjikë, politikë dhe ideologjikë." Përtej përligjes së qasjes interpretuese, bazuar në kontekstin se kur këngët janë kënduar, CDA-ja vjen në ndihmë edhe për qëndrimin teorik që mbahet kur bëhet fjalë për raportet mes gjuhës dhe shoqërisë, të cilat janë marrëdhënie ndërmjetësimi, jo thjesht deterministe.

Sa i takon procedurës që ndiqet gjatë një analize kritike diskursi, ajo i përngjan një procesi hermeneutik: "krahasuar me shpjegimet (shkakësore) të shkencave natyrore, hermeneutika mund të kuptohet si metoda e përkapjes dhe prodhimit të marrëdhënieve kuptimore" (Wodak e Meyer 2002:16). Të qenit hermeneutik gjatë analizës parakupton përzgjedhjen e metodave kualitative të hulumtimit. Veç kësaj, analizat përgjithësisht kryhen duke shfrytëzuar korpuse të vogla, që janë tipike të një diskursi të cakuar.

Bashkërendimi i analizës së diskursit, së cilës i intereson konteksti për të interpretuar të dhënat dhe e cila zbaton metoda cilësore hulumtimi, me analizën e korpuseve, e cila "nuk merr në konsideratë kontekstin social, politik, historik dhe kulturor të të dhënave" (Baker *et al. 2008:* 293) dhe që mbështetet në metodat sasiore të hulumtimit, mund të duket e panatyrshme. Por në të vërtetë, studimet e diskursit të asistuara nga gjuhësia kompjuterike janë të dobishme për analistin e diskursit, pasi i vijnë atij në ndihmë që ta kuptojë më mirë përdorimin e gjuhës nga folësit.

I këtij mendimi është edhe studiuesi gjerman Jörn Stegmeier*,* i cili nënvizon se "analistët e diskursit i kanë përdorur korpuset në një mënyrë të përgjithshme, jostatistikore, falë metodave hermeneutike dhe formimit të thellë gjuhësor, kanë qenë në gjendje të marrin njohuri për punimet e diskursit. Duke vepruar kështu, është themeluar një traditë hulumtimi e motivuar filologjikisht, që një metodologji e analizës së diskursit, asistuar nga kompjuteri nuk duhet të përpiqet ta zëvendësojë në asnjë mënyrë me masat statistikore dhe/ ose automatizmin". Ndaj metodat e gjuhësisë kompjuterike janë përplotësuese në raport me metodat e studimeve të diskursit dhe bashkërendimi i tyre të të vërtetë nuk është i panatyrshëm, por frytdhënës. (Stegmeier 2012: 94)

METODOLOGJIA

Ndërtimi i korpuseve

Për të dhënat empirike të këtij studimi, u nevojit krijimi i një korpusi 5621-fjalësh (tokens), që përbëhej nga tekstet e 35 këngësh dashurie, të kënduara në Festivalin e Këngës në Radio-Televizionin Shqiptar, gjatë viteve (-), kohë kur në Shqipëri ishte në fuqi regjimi diktatorial komunist. Këngët u përzgjodhën mbi bazën e kriterit tematik, ndërsa më tej u zbardhën e u kompjuterizuan duke krijuar bazën e të dhënave të korpusit.

Korpusi i dytë me 7868 njësi (tokens), i këngëve të dashurisë, të kënduara në Festivalin e Këngës Magjike gjatë viteve (-) në Shqipërinë postkomuniste, u ndërtua në bazë të të njëjtit kriter dhe në të njëjtën mënyrë dhe përmban tekstet e 35 këngëve.

Këngët e dashurisë, më së shumti në formën e baladave të dashurisë, në këtë festival janë më të shumta në numër, ndaj përzgjedhja e tyre u bë në mënyrë të rastësishme, por sigurisht duke pasur parasysh kriterin tematik.

Korpuset nuk përbëhen nga këngë të të njëjtit festival, ndonëse Festivali i Këngës në RTSH, organizohet ende në mënyrë të përvitshme, me qëllim krahasimin e dy tipologjive tekstore sa më të ndryshme. Festivali i Këngës, gjatë komunizmit organizohej në kujdesin e vigjilencën e veçantë të regjimit të kohës, duke qenë se ishte një ndër ngjarjet më të rëndësishme kulturore në vend dhe më me ndikim ndër masa. Sot ky festival organizohet ende nën kujdesin e një institucioni shtetëror, ndaj për të shmangur sa të jetë e mundur gjurmë të mundshme të ideologjisë shtetërore, u pa e arsyeshme të ndërtohej një korpus këngësh që ishin kënduar në një festival joshtetëror dhe ku gjasat për tekstshkrues që kishin shkruar tekste edhe gjatë komunizmit edhe pas, të ishin të pakta.

Duhet theksuar se teknikalitetet e përpunimit kompjuterik të të dhënave, nuk janë objekti parësor i punimit tonë, pasi ideja e punimit është të parashtronte një ndërthurje metodash me anë të shfrytëzimit të programeve kompjuterike, për t'u ardhur në ndihmë studimeve të diskursit.

Përpunimi i të dhënave u bë me anë të programit kompjuterik Sketch Engine (https://www.sketchengine.co.uk), që u mundëson përdoruesve, jo vetëm përdorimin e korpuseve ekzistuese, por edhe krijimin e tyre, bazuar mbi të dhënat që ata vetë zotërojnë, si dhe me anë të software- it Text Analyzer (http://www.online-utility.org/text/analyzer.jsp). Për paraqitjen e shpërndarjes së fjalëve u përdor aplikacioni Tagxedo (http://www.tagxedo.com/app.html), që shërben për kthimin e fjalëve në një re fjalësh, ku madhësia e fjalëve tregon frekuencën e përdorimit të tyre në një korpus. Për të kryer testet e domethënies statistikore të frekuencave të fjalëve që shfaqen në të dy korpuset, u shfrytëzua programi kompjuterik R (https://www.r-project.org/)

Kur krahasohet denduria e një leme në dy korpuse me madhësi të ndryshme, lipset që frekuencat të normalizohen. Frekuencat e papërpunuara nuk thonë shumë në lidhje me vlefshmërinë e një hipoteze. Nëse në një korpus 30 000 fjalësh, lema DASHURI shfaqet p.sh. 42 herë, ndërsa në një korpus 28 000 fjalësh, lema DASHURI shfaqet 57 herë, ç'do të thotë kjo, që fjala është përdorur shpesh apo rrallë? Në vijim po paraqesim mënyrën se si janë normalizuar frekuencat në secilin korpus për fjalën dashuri. Në korpusin e këngëve të RTSH-së, lema DASHURI shfaqet 43 herë (duke përfshirë të gjitha fjalëformat ekzistuese në korpus, të fjalës dashuri, si: dashuria, dashurisë, dashurinë), ndërsa në korpusin e Këngës Magjike (KM) 50 herë. Shifrat 43 dhe 50 përbëjnë frekuencat e papërpunuara (*raw frequencies*)

43·1000 / 5621= 7,64

50·1000 / 7868= 5,84

Ndërsa frekuencat e normalizuara të lemës DASHURI janë 7.74 dhe 5.84. Pas normalizimit të frekuencave mund të bëhen krahasimet e nevojshme rreth shpeshtësisë së fjalëve në korpuse.

Fjalët kyçe

Koncepti i fjalëve kyçe, është një ndër teknikat që kemi përdorur për të bërë interpretime rreth domethënies së frekuencave të fjalëve. Scott-i (1999) i përkufizon fjalët kyçe si fjalë të cilat kanë një frekuencë të pazakontë, të lartë ose të ulët në një tekst të caktuar, krahasuar me frekuencën që kanë në një korpus reference. Korpusi i referencës (ndonëse jo i mirëfilltë) i shfrytëzuar prej nesh, është OPUS2 Albanian, i krijuar nga Jörg Tiedemann dhe i ofruar nga SE (https://the.sketchengine.co.uk/bonito/corpus/corp_info?corpname=preloaded/opus2_sq), i cili ka 55.099.328 *tokens* dhe 46,304,346 *types*.

Gjatë analizës së diskursit, studiuesi e ka të përligjur përzgjedhjen dhe trajtimin e disa veçorive të tekstit, të cilat, sipas tij, dëshmojnë se ndodhen aty prej kontekstit dhe prej faktorëve social-politikë e deri edhe ideologjikë. Ndonëse me frekuencë të ulët, në korpusin RTSH, vihen re një sërë fjalësh si *aksion, fabrikë, uzinë, e re/ i ri, fusha, grurë, shok, shoqe, miniera* të cilat janë tregues të gjurmëve të ideologjisë së kohës në tekstet e këngëve.

Për ilustrim po paraqesim mënyrën se si leksema të ngjashme me këto, janë cilësuar si fjalë kyçe. Nëse kërkohet fjala aksion në korpusin RTSH, rezultatet janë si vijon në figurën nr. 1.



Figura nr. 1 *Frekuenca e fjalës aksion në korpusin RTSH*

Programi vetë bën një normalizim të frekuencës dhe për çdo një milion fjalë *aksion* do të jetë 533.71 herë. Ndërsa në korpusin OPUS 2 Albanian, frekuenca e normalizuar e fjalës aksion është shumë herë më e vogël, 5.63 herë, siç duket edhe në

figurën nr. 2 dhe zvogëlohet edhe më shumë, po të kemi parasysh që pjesa më e madhe e këtyre përdorimeve në OPUS 2 Albanian, nuk janë me kuptimin e *aksion*it si "veprimtari e gjallë, me pjesëmarrjen e masave punonjëse, për të kryer në mënyrë luftarake e me frymë revolucionare, brenda një kohe të shkurtër, një detyrë të rëndësishme politike, shoqërore ose ekonomike; vepër e ndërtimit socialist, që kryhet me pjesëmarrjen vullnetare të masave të gjera punonjëse" (Fjalori i Gjuhës Shqipe 1980), kuptim me të cilin e gjejmë këtë fjalë në tekstet e këngëve të korpusit RTSH.



Figura nr. 2 *Frekuenca e fjalës aksion në korpusin OPUS 2 Albanian*

ANALIZA STATISTIKORE

Në gjuhësinë e korpuseve, zakonisht përdoret një tabelë 2x2 (kur kemi vetëm dy njësi) për të krahasuar frekuencat e fjalëve ose tiparet e tjera gjuhësore mes dy korpuseve. Testi i zakonshëm statistikor është Pearson's Chi-squared test dhe ai është i aplikueshëm ndaj një tabele të zakonshme me *r* rreshta dhe *s* shtylla" (Baron, Rayson, Archer 2009: 44).

Hipoteza nul (null) H_0 është se frekuenca e fjalëve nuk varet nga korpusi të cilit ato i përkasin, por se është e tillë në mënyrë rastësore. Arritja e domethënies statistikore në nivelin 95%, ose 99% e refuzon hipotezën nul, dhe provon se frekuencat e fjalëve varen nga korpusi përkatës të cilit i përkasin fjalët. Në rastin tonë, pragu i domethënies u caktua në 0.01, pra për të pasur domethënie statistikore në rast se vlera p do të ishte $p< 0.01$.

Me anë të programit R, mund të ndërtohet edhe një grafik i quajtur assocplot (shih fig. 5), në të cilën sipërfaqja e secilës kuti është proporcionale me diferencën mes frekuencave të vrojtuara dhe atyre të pritshme. Drejtkëndëshat në secilin rresht janë të vendosur përkundër vijës bazë (base line) dhe nëse frekuenca e vrojtuar e një qelize është më e madhe se frekuenca e pritshme, kutia ngrihet mbi vijën bazë, përndryshe

kutia bie nën vijën bazë. Nga ana tjetër shtrirja e secilës kuti, është tregues i efektit anësor. (Johansson 2012:15)

REZULTATE E PËRFUNDIME

Pikënisja e interpretimit të një analize diskursi, që bazohet mbi të dhëna kuantitative, është lista e frekuencës së fjalëve. Në tabelën nr. 1 janë paraqitur frekuencat e papërpunuara të 20 njësive me denduri më të lartë në dy korpuset tona.

	RTSH	**frekuenca**	**KM**	**frekuenca**
1	të	247	të	405
2	e	232	e	321
3	në	182	më	270
4	me	98	**ti**	168
5	dhe	82	s	144
6	më	79	një	128
7	i	79	**unë**	126
8	**unë**	62	nuk	125
9	**ne**	62	me	122
10	një	61	dhe	122
11	do	57	i	120
12	për	54	do	98
13	**ti**	54	në	89
14	o	48	**ty**	85
15	si	48	që	83
16	s	45	se	71
17	**ty**	41	jo	71
18	që	37	dua	70
19	dy	36	je	63
20	sa	36	si	61

Tabela nr. 1 *20 njësitë me frekuencë më të lartë në korpuset RTSH dhe KM*

Siç shihet nga tabela një pjesë e madhe e këtyre njësive janë fjalë shërbyese/ funksionale dhe kjo është një prirje normale e çdo lloj korpusi jo vetëm të gjuhës shqipe,por edhe të gjuhëve të tjera.

Veç tyre, bie në sy shfaqja e përemrave vetorë **unë, ti (ty),** si dhe e foljes **dua/ do** në të dy korpuset. Kjo lloj dukurie është dëshmi e karakterit personal e intim të teksteve që përbëjnë korpuset në fjalë. "Këto dukuri gjuhësore reflektojnë ndërveprimin mes folësit dhe dëgjuesit, si dhe mendimet e ndjenjat e tyre" (Biber 1991:73). Lirika e këngës së dashurisë e ka ndërveprimin një karakteristikë të natyrshme, sa kohë që vetë dashuria a akti dashuror lipset të ketë marrës e dhënës që ndërveprojnë.

Paraqitja vizuale të fjalëve më të shpeshta të dy korpuseve, na shpalos se çfarë është e rëndësishme dhe me peshë në secilin korpus, e rrjedhimisht në secilin kontekst kulturor e social, kur flitet për dashurinë. Figura 1 dhe figura 2 paraqesin vizualisht njësitë me frekuenca më të larta dhe fjalët që janë më të afërta me njëra-tjetrën në tekst. Nga një vështrim i parë, në renë e fjalëve të këngëve të dashurisë, të kënduara në Festivalin e Këngës, në RTSH, fjalët si *këngë, jetë, njeri, dritë, diell, çel, bashkë, plot*, *pranë* duket se janë tipike të këtij korpusi, përkundër fjalëve *lamtumirë, fjalë, besoj, vetëm, mos, shumë*, të korpusit të këngëve të kënduara në Festivalin "Kënga Magjike". Pra, duket se dashurisë i është kënduar *njësoj* në të dyja kohët, me jo shumë ndryshime në fjalës dhe në nëntema dhe kjo dukuri është krejt e natyrshme, po të kemi parasysh se kemi të bëjmë me fragmente diskursi që i përkasin të njëjtit fill diskursiv.



Figura nr.3 *Reja e fjalëve nga korpusi "RTSH"*



Figura nr.4 *Reja e fjalëve nga korpusi "KM"*

Megjithatë duhet të risjellim në vëmendje se korpuset, ndonëse kishin një numër të barabartë këngësh, nga 35 secili, nuk kanë pasur një numër të barabartë njësish, kjo prej gjatësisë së disa teksteve, krahasuar me të tjerat.

Në tabelën nr. 2 janë paraqitur 10 emrat me frekuencë më të lartë në të dy korpuset.

	Korpusi i teksteve RTSH			**Korpusi i teksteve KM**		
Nr.	Lema	Frekuenca e panormalizuar		Lema	Frekuenca e panormalizuar	
1	JETË	52	9,25	ZEMËR	65	8,26
2	DASHURI	43	7,65	DASHURI	50	6,35
3	SY	33	5,87	FJALË	28	3,56
4	ZEMËR	31	5,52	DITË	28	3,56
5	LULE	26	4,63	JETË	25	3,18
6	KËNGË	23	4,09	FUND	24	3,05
7	DRITË	23	4,09	HERË	23	2,92
8	PRANVERË	20	3,56	LAMTUMIRË	18	2,29
9	GRURË	15	2,67	SHPIRT	16	2,03
10	VAJZË	13	2,31	SY	11	1,39

Tabela nr. 2 *Emrat me frekuencë më të lartë në korpusin RTSH dhe korpusin KM*

Siç shihet nga tabela në 10 emrat me frekuencë më të lartë, katër prej tyre janë të njëjtët në të dy korpuset. Siç e kemi përmendur dhe më herët, kjo dukuri është normale sa kohë që bëhet fjalë për tekste që i përkasin të njëjtit fill diskursi, atij të diskursit të dashurisë.

Analiza statistikore shërbeu për të vërtetuar se ndryshimi i frekuencës së një fjale nga një korpus te tjetri është domethënës. Rezultatet e testit *chi-square* për frekuencat e fjalëve të përbashkëta në dy korpuset treguan një diferencë statistikisht domethënëse në nivelin 99%.

Vizualisht, frekuencat dhe prirjet e tyre për fjalët që nuk përfshihen në të dy anët e tabelës nr. 2 janë paraqitur në figurën nr. 5.



Figura nr. 5 *Asoccplot e 10 lemave*

Testi statistikor , χ^2 –test (chi-squared test) i kryer me programin **R**, për të krahasuar frekuencat 10 lemave (JETË, DASHURI, SY, ZEMËR, DRITË, FUND, DITË, LAMTUMIRË, PRANVERË, LULE), tregoi se frekuencat e fjalëve varen nga korpusi të cilit ato i përkasin. χ^2 (9df) = 22.14; $p < 0{,}01$.

Lemat e paraqitura në tabelën e mësipërme, *inter alia* shërbejnë për të hetuar gjurmët e ideologjisë në tekstet e këngëve. Termi ideologji në këtë kumtesë është përdorur më tepër në kuptin e këndvështrimit për botën. Van Dijk e përkufizon ideologjinë si "komplekse përfaqësimi dhe sjelljesh të organizuara skematikisht në lidhje me disa aspekte të caktuara të botës shoqërore" (1993), ngjashëm, më herët teoricienët Hodge, Kress e Jones nënvizonin se "ideologjitë janë tërësi idesh që përfshihen në renditjen e përvojës, në të kuptuarin botës. Sistemet e ideve që përbëjnë ideologjintë janë të shprehura përmes gjuhës. Gjuha bën furnizimin me modele dhe kategori mendimi, dhe përvoja e njerëzve për botën pjesërisht vjen prej gjuhës" (1979: 81). Përmes gjuhës së teksteve të këngëve, në mënyrë të pavetëdijshme, receptuesit e këngëve të të dyja korpuseve, në dy kohë të ndryshme, pajisen me botëkuptime për dashurinë e mënyrën e të dashuruarit.

Lemat me frekuencë të lartë, por edhe fjalët kyçe na vijnë në ndihmë për të përvijuar për secilin rast *skemën konjitive,* që është një lloj korrnize ku brendashkruhen qëndrimet, opinonet e këndvështrimet të cilat në thelb kanë "natyrë ideologjike" (van Dijk 1998 : 71). Skema konjitive përfaqëson njohjen që dikush ka për botën dhe formësohet prej njohurive e përvojave të mëparshme (për Teorinë e Skemës, *shih më tej* Axelrod 1973). Kjo do të thotë se përmes teksteve të këngëve, publikut të tyre i përçohet një skemë konjitive për dashurinë. Skema konjitive e historisë së dashurisë gjatë komunizmit, do të ishte kjo: "Të dashuruarit i drejtohen njëri-tjetrit me "shok" dhe "shoqe, takohen/ njihen në aksion ose fushave me grurë, duan të jetojnë në këtë jetë të re, ditë të re, me një motiv të ri, dhe jetojnë të lumtur në këtë vend plot me fabrika, uzina, miniera e dritë!". Në këtë skemë, me frymë idilike e deri diku patetike, ideologjia e komunizmit është e dukshme dhe bëhet edhe më e efektshme prej emocionalitetit të këngëve të dashurisë, duke formësuar kështu identitetin social të atyre që i dëgjojnë e i këndojnë ato.

Po të risjellim në mendje studimin e Pettijohn e Sacco (2008), tekstet e këngëve të shkruara e kënduara në kohë të vështira, kanë prirjen të jenë më romantike dhe të përqëndrohen te e ardhmja. Në korpusin e këngëve të kohës së komunizmit, një ndër fjalët kyçe që ilustron këtë lloj prirjeje, është lema I RI, E RE, ku mbiemri shërben si cilësor i *kohës* së re, *jetës* së re, *dashurisë* së re dhe i *motivit* e *premtimit* të ri (shih tabelën nr. 4). Të gjitha këto janë në përputhje me skemën ideologjike të njeriut të ri komunist, që mbizotëronte në të gjithë diskursin e komunizmit e që rrjedhimisht hyn e gjëllon dhe në fragmentet e diskursit të dashurisë. "Njeriu i ri nuk është një njeri intelektual (ai që di), por një njeri që karakterizohet nga sjellje të përcaktuara nga morali komunist (ai që bën)… As familja nuk shpëtoi nga kontrolli i rreptë i shtetit. Sipas Angjelit, familja nuk është një çështje personale. Familja duhet të përgatisë fëmijë që do të jenë kandidatë të denjë për t'u bërë njerëz të rinj" (Nikolla 2012).

sa vjen njëri-tjetri shkon. **motiv i ri** lalala, lalalala lala laa sot një motiv
lalalala lala laa sot një **motiv të ri** po fishkëlloj mbi torno tuj punu për ju
mori jeta plot lumturi, dhe u lind **motiv i ri** vrapon tek unë, unë fluturoj tek ti flutoroj
supe borë, lodhjen shkund me të **vitin e ri** shokët punëtorët sjellin midis nesh gjithnji
në sy e zemrat pranë me një **premtim të ri** gjithmonë ta mbushim plot dritë ne jetën
jam vajzë e vij nga fusha me **mall të ri** o zemrën plot me fllad ç'e mbusha
fushat tona i përshkon ku shpërthen **jetë ere** lalala, lalala
ne krahë për krahë do ecim, **jetën tonë të re** do ngrehim

të të tjera, por në mes nesh **e diela e re** do mbetet për lumturinë tonë
ne pranë e pranë të dy dielli lind **ditë e re** përshëndet jetë e re vrulli i saj më fton
ne pranë e pranë të dy dielli lind ditë e re përshëndet **jetë e re** vrulli i saj më fton
flokë e dielli në re rritu, rritu **dashuri e re**! lulëzo mimozë e çelu në çdo stinë
lulëzon dhe rritet mbetet **gjithmonë e re**. gjurmët vizatojnë lule plot shkund dëborën
zambakë të bardhë çeli për ne kjo **dashuri, e re**. jo s'e harroj, me mall kujtoj
rrahin si një zemër në kraharorin e **jetës së re**. mes dritash, ishim shokë
shtigjeve ku rend rinia çel si gonxhe **dashuri e re**. ngrohtësi në shteg të malit mbrëmja
lulëzon mes dritash kjo **ëndrra** jonë **e re** o sa shpesh të kujtoj për liri të shikoj
nesh shohim agimin se për ne, nis **jetë e re**, mes shokëve, mes shoqeve në bulevard
fëmijët si bredhat krahët shtrijnë viteve **të rinj**. kështu fëmijët endin jetën rriten te kjo

Frekuenca e papërpunuar e mbiemrit i ri në korpusin e festivalit KM, është 2. Dashurisë nuk i këndohet për ndonjë arsye të re. Nuk duhet lënë pa theksuar se edhe në këtë korpus, megjithëse nuk kemi të bëjmë me gjurmë të ideologjisë shtetërore, komuniste, prapësepraprë ndërtohet një skemë konjitive për raportin dashuror. Marrëdhënia mund të shkojë mirë, ajo është shpirtërore e kur këndohet për të motivet bëhen edhe sensuale, por ajo duket se është më efemere, mund edhe të marrë fund, mund të thuhet edhe lamtumirë , rrjedhë që nuk përvijohet në fragmentin diskursiv të këngëve të kohës së komunizmit.

Korpusi i teksteve RTSH	**Korpusi i teksteve KM**
ne të dy lumturia s'do të ishte kështu, **dashuria gjithashtu** kaq e bukur pa ata vogëlushë	**humbi dashuria** më të madhe e bën largësia eja zemër netët
ënde rrite dashurinë. çel **si gonxhe dashuria**. erdha tek ty me dritë në sy asnjë fjalë	**dashuria nis me ty**, me ty mbaron je kuptimi që merr
çel pranvera më të bukurat lule, i çel **kjo dashuria** këngë të shtrenjta ndër ara ndër miniera	ndezur këtë botë e ta djeg unë sot eo **rroftë dashuria** eo syri le të plasë,
pastër si kjo kaltërsi në qiellin tonë pa re **dashuria jonë** e lumtur çel. të dashuroj e çdo çast	kur **dashuria vdes** me kilometra e kilometra shekuj vetmie

lulëzon mes dritash kjo ëndrra jonë e re	thes kur ne dy koka bashkë mbi nënkresë
dashuria jonë po vijnë të gjithë sot miq	kur **dashuria vdes**. vetëvrasëse është kjo
edhe shokë	qetësi rreth
fashuam ne zemrat tona, rrënjat aty i ka	se jeta e tij nuk je më ti. ku jeton
kjo **dashuria jonë**, si dhe shokët tanë sot,	**dashuria ime** zonjë e dashur, sot jam
atë ditë të	plakur e as
nëpër flokë e dielli në re rritu, rritu	frikë kur e tija s'jam.. ku **jeton dashuria**
dashuri e re! lulëzo mimozë e çelu në çdo	ime, dashuria e jetës sime ku jeton, ku
stinë	
në ditët e mia për herë të parë **ndjeva**	**dashurinë e vesha** këtë natë si fustan e
dashuri, e bukur është ajo si vetë rinia,	stolisa hireplot
me jetë	
lumturinë tonë. me **dashuri për tokën** me	jam mjeshtër i puthjeve. **rroftë dashuria**
dashuri për jetën, kjo koha jonë ne o	stolisa hireplot nuk e kam për jetë e mot
përgjithmonë	**dashurinë e hodha** unë në fund si një
	gotë për ta
ç'lumturi na dha kjo jetë në asnjë vend,	kur mos të jem më merrni zemrën si
dashuri si kjo jo s'mund të ketë. e lashtë	inxhi **dashurinë e drodha** këtë natë si
tokë	duhan dhe e ndeza
ndezi drita kudo dhe çdo dritare mban **një**	**dashurinë e hodha** unë me fund si një
dashuri kjo dritë e bukur vjen në sy dhe	gotë për ta
qëndron	
çelu në çdo stinë! me aromën tënde **rrite**	behar vetëvrasëse ka kohë qe s'ledhatova
dashurinë. ka çdo njeri në jetë një ëndërr	**dashurinë e parë** shoqe e keqe na ish
të vërtetë	vetmia e rënd
kur të shikoj, veten time tek ty e gjej.	
dashurinë e kënduam, zemrat tona dhe	
rininë dhe kjo	
kjo tokë ngado që shkuam na dha **prush**	tija s'jam..! ku jeton dashuria ime,
për dashurinë. ç'lumturi na dha kjo jetë	dashuria e jetës sime ku jeton,
në asnjë vend	
moj sa të dua unë në vend të shkesit	
vumë dashurinë vajzë o yll i bukur moj	
trëndelinë nëpër	
ndahesha nga ty si majë kurorave në shpirt	përsëritet historia na **ka dënuar**
tani **dashurinë e ndjej** që po më vlon, më	**dashuria** jam gjysma jote, je gjysma ime
vlon mëngjesin	të ndarë

the me njëherë pranvera lulëzon **lulet e dashurisë** s'i shkund dot era është e përjetshme në era, era e vjeshtës më zgjoi **kujtimin e dashurisë** fjalën të dua zemra i tha për ty dritat mbledhin grurë grurë edhe këngë. **stacion i dashurisë** në	

Tabela nr. 5 *Bigrama dhe trigrama të lemës DASHURI në korpusin RTSH dhe në korpusin KM*

Tabela nr. 5, me shembuj të nxjerrë nga dy korpuset e këngëve të dashurisë kënduar në dy kohë të ndryshme, është një ilustrim i fillit të diskursit të dashurisë. Çdo diskurs është i interpretueshëm në lidhje me kontekstin historik, social e politik dhe siç e trajtuam dhe më lart, përmes një forme artistike siç janë këngët, formësohen e riformësohen skema konjitive e ideologjike. (Prej tabelës 5, por dhe më tej prej korpuseve mund të përvijohen edhe një sërë metaforash konceptuale si p.sh. DASHURIA ËSHTË LULE, DASHURIA ËSHTË BASHKIM, DASHURIA ËSHTË OBJEKT, DASHURIA ËSHTË UDHËTIM etj., por duke qenë se fokusi i punimit tonë nuk ishte aq i gjerë nuk po i trajtojmë me detaje këto metafora konceptuale dhe skenarët metaforikë që i bashkëshoqërojnë).

Nëse për deterministët "gjuha e bën njeriun", për analasistët kritikë të diskursit gjuha luan një rol ndërmjetësues mes njohurive për botën dhe praktikave sociale. Për Fairclough-in (1989) këto praktika sociale jo vetëm formësojnë diskursin, por edhe formësohen prej diskursit. Cilindo qëndrim të mbajmë ndaj këtij raporti, duhet pranuar fakti se realiteti i ndjenjave si dashuria, në mos "objektiv", është realitet universal, ai gjuhësohet ndryshe në dy kohë e dy kontekste politiko-shoqërore të ndryshme. Provën për këtë na e japin fjalët e këngëve të dy kohëve, të cilat kanë forcën e nevojshme për të ndikuar. "Me fjalët... ushtrojmë ndikim dhe në një masë të madhe kontrollojmë ngjarjet e së ardhmes. Është pikërisht për këtë arsye që shkrimtarët shkruajnë, predikuesit predikojnë, punëmarrësit, prindërit e mësuesit qortojnë, propagandistët lëshojnë deklarata të reja, burrat e shtetit mbajnë fjalime. Të gjithë këta, për arsye të ndryshme, po rreken të ndikojnë sjelljen tonë- ndonjëherë në të mirën tonë, ndonjëherë në të mirën e tyre." (Hayakawa 1978: 91)

Referencat

Axelrod, R. (1973) *Schema Theory: An Information Processing Model of Perception and Cognition* Vol. 67, Nr. 4, faqe 1248-1266.

Baker, P., Gabrielatos, C., Khosravinik M., Anowski M., Mcenery T., Wodak R. (2008) *A useful methodological synergy? Combining critical discourse analysis and corpus linguistics to examine discourses of refugees and asylum seekers in the UK press* Discourse & Society, Vol 19(3), faqe 273- 306.

Baron, A., Rayson, P., Archer, D. (2009). *Word frequency and key word statistics in corpus linguistics*. Anglistik, 20(1), faqe 41-67.

Behl, A., & Choudhury, M. (2011). *A corpus linguistic study of bollywood song lyrics in the framework of complex network theory*. Proceedings of ICON-2011: 9th International Conference on Natural Language Processing Macmillan Publishers.

Chouliaraki, L., Fairclough, N. (1999). *Discourse in late modernity: Rethinking critical discourse analysis*. Edinburgh University Press.

Fairclough, N. (1989) *Language and power*. Londër: Longman.

Hayakawa, S. I., Hayakawa, A. R. (1990). *Language in thought and action*. Houghton: Mifflin Harcourt.

Hodge, B., Kress, G. and Jones, G. (1979). *The ideology of middle management*. në R. Fowler et al. Language as ideology, faqe 81-93.

Johansson, Ch. (2012) *Elementary Statistics in the Cognitive Sciences*. Bergen: Universitetet i Bergen.

Kreyer, R., Mukherjee, J. (2009) *The Style of Pop Song Lyrics: A Corpus-linguistic Pilot Study*. Anglia - Zeitschrift für englische Philologie. Volume 125, Issue 1, faqe 31–58

Little, P., Zuckerman, M. (1986). *Sensation seeking and music preferences*. Personality and Individual Differences, 7, faqe 575–577.

McCown, W., Keiser, R., Mulhearn, S., Williamson, D. (1997). *The role of personality and gender in preferences for exaggerated bass in music*. Personality and Individual Differences 23, faqe 543–547.

McNamara, L., Ballard, M. E. (1999). *Resting arousal, sensation seeking, and music preference*, Genetic, Social, and General Psychology Monographs, 125, faqe 229–250.

Nikolla, A. (2012) *Njeriu i ri shqiptar*. Tiranë: Onufri.

Paula Pérez-Sobrino & Nina Julich (2014) *Let's Talk Music: A Corpus-Based Account of Musical Motion*, Metaphor and Symbol, 29:4, faqe 298-315.

Pettijohn, Terry F., Sacco, Donald F. (2009) *The Language of Lyrics : An Analysis of Popular Billboard Songs Across Conditions of Social and Economic Threat*. Journal of Language and Social Psychology, faqe 280: 297.

Šeškauskienė, I., Levandauskaitė, T (2013). *Conceptualising Music: Metaphors of Classical Music*. Studies about Languages. 23 NR http://dx.doi.org/10.5755/j01.sal.0.23.5268.

Stegmeier, J. (2012) *Toward a computer-aided methodology for discourse analysis*, Stellenbosch Papers in Linguistics, Vol. 41, faqe 91-114.

Stubbs, M. (1996). *Text and corpus analysis: Computer-assisted studies of language and culture*. Oxford: Blackwell.

Van Dijk, T. A. (1998). *Ideology: A multidisciplinary approach*. Londër: Sage.

Van Dijk, T. A. (1995). *Discourse semantics and ideology*. Discourse & Society, 6(2), faqe 243-289.

Van Dijk, T. A. (1996). *Discourse, power and access*. Texts and practices: Readings in critical discourse analysis, faqe 84-104.

Wodak, R., Meyer, M. (2002). *Methods of Critical Discourse Analysis*. Londër: Sage Publications.

Wodak, R., Ludwig, C. (1999). *Challenges in a Changing World*. Passagen Verlag.

Elsa SKËNDERI-RAKIPLLARI

LOVE SONGS IN TWO EPOCHS - A CRITICAL ANALYSIS OF TWO CORPORA

Abstract

Corpus linguistics and Critical Discourse Analysis (henceforth CDA) are being considered as two disciplines that may be matched together, to analyse various linguistic varieties. On one hand corpus is "A collection of naturally occurring language text, chosen to characterize a state or variety of a language" (Sinclair 1991), on the other hand, CDA considers every language variety as being "are historical and can therefore only be understood with reference to their context. In accordance with this CDA refers to such extralinguistic factors as culture, society, and ideology" (Wodak, Meyer 2002). The present paper aims to look into the traces of ideology in the texts of love songs, written and sang in two different epochs and two different social and political realities. For the collection of the data two corpora were built. A corpus of texts of love songs performed in "Festivali i këngës në RTSH" (Song festival on the Albanian State Television), and another one with post-communist love

songs, performed in another festival that of "Festivali Kënga Magjike" (Festival of Magical Song). The statistical data coming from the corpora clearly reveal that although the love songs refer to the same reality of feelings, which is basically unchanging as it involves universal experiences, yet there love songs texts contain traces of the ideology of the time when they were performed. In the viewpoint of CDA discourse and ideology are tightly intertwined (Fowler et. al (1979), Van Dijk (1995) (1996), Hodge, Kress (1993) Wodak, Ludwig (1999) Chouliaraki, Fairclough (1999) etc.) and all the discourses are shaped in a way or another by ideology. This argument might suggest the deterministic position that "language shapes a person", by offering him/her a certain way of categorising the reality, in this case, due to the effect of ideology. The reality of feelings as love, although is not an objective one, it is linguistically shaped differently in two different epochs and socio-political contexts through various cognitive schematas.

Key words: Critical Discourse Analysis, Corpus linguistics, ideology, cognitive schemata, Festivali i Këngës, Kënga Magjike.

Dedë QOKAJ

SHQYRTIME ONOMASTIKE NGA TREVA E NIKAJ – MËRTURIT

Abstrakt

Treva e Nikaj - Mërturit ka një leksik onomastik mjaft të pasur dhe që ka interes për disa disiplina, si: dialektologjia, leksikologjia, etnografia e të folurit dhe fusha të tjera të albanologjisë.

Materiali ynë onomastik synon ta kundrojë lëndën gjuhësore, që sjell qëmtimi i kujdesshëm onomastik në tërë gjerësinë e saj, duke u ndalur kryesisht tek toponimet, oikonimet, oronimet dhe hidronimet.

Zona ka dymbëdhjetë fshatra si njësi administrative, të njohura edhe më parë, por që kanë edhe disa toponime që u bashkëngjiten duke shtuar numrin e mëhallëve, të cilat duhen bërë objekt studimi onomastik.

Parë në tërësi do të bëhen shqyrtime semantike, të fjalëformimit, por edhe etimologjike popullore dhe shkencore, sipas parimit, histori populli, histori gjuhe.

Mëtimi ynë do të reflektojë një portret shumëpërmasor të hapësirës nikajmërturase të toponomisë në veçanti duke shkrirë qëmtimin në terren në përqasje me interpretime gojore dhe dokumentare, sipas shkallares: makrotoponime dhe mikrotoponime.

Së fundi, do të jepet edhe një tregues i përgjithshëm i emrave dhe leksemave të përdorura në kumtim.

Fjalët kyçe: *onomastikë, toponime, oikonime, oronime, hidronime, semantikë, leksemë.*

1. Hyrje

Onomastika nikajmërturase është shumë e gjerë dhe e larmishme, si: toponime (oikonime dhe etnonime), antroponime, patronime, hidronime dhe oronime.[1] Objekt shqyrtimi do të jetë tërë onomastika e trevës, duke pasur si metodë studimi kryesisht

[1] Shih klasifikimin dhe procedurën tek prof. dr. Gjovalin Shkurtaj në "Onomastikë dhe etnolinguistikë", Botime universitare "Albas", Tiranë, 2015, f. 18; Dr. Bahtijar Kryeziu, "Onomastika e Hoshanisë", Prishtinë 2000, f. 9, 148 - 156; Prof. asc. dr. Begzad Baliu, "Onomastikë dhe identitet", ShB, "Era", Prishtinë, 2012, f. 21 - 24, 27 -29.

atë krahasuese, përqasëse, areale, semiotike, psikologjiko - gjuhësore, po në ndonjë rast edhe etimologjike, aq sa na lejon dija gjuhësore. Si metodikë do të shqyrtojmë elementet onomastikë sipas një shkallëzimi makro dhe mikrotoponime, sipas vendndodhjes së fshatrave, me historik të shkurtër, duke u ndalur tek toponimet, antroponimet, hidronimet dhe oronimet e çdo njësie brenda arealit gjuhësor.

2. Shtresimi onomastik

Si njësi gjuhësore, hapësira e trevës përmbledh dy fise të mëdha: *Nikaj* dhe *Mërtur*. Si makrotoponime do të marrim toponimet kryesore, të cilat, për nga formimi, mbartin kuptime dhe ndërkallje të ndryshme, sipas fiseve. Kështu fisi *Nikaj* përfshin fshatrat: *Curraj i Epërm, Qereç - Mulaj, Curraj i Poshtëm, Peraj, Gjonpepaj dhe Lekbibaj*, ndërsa fisi *Mërtur*: *Bëtoshë, Shëngjergj, Tetaj, Palç, Salcë, Brisë*. Fshati *Rajë*, fis mërturi ka qenë ndarje administrative më vete.

Brenda këtyre ndarjeve administrative ka edhe nënndarje të tjera, si oikonime apo patronime. Është një trevë në të cilën, dy fiset e lartpërmendura, nga ka marrë emrin edhe zona, bashkëjetojnë që prej 15 brezash, duke pasur parasysh edhe tabelën gjenealogjike, por edhe sipas transmetimit gojor.[2] Shqyrtimi onomastik i kësaj treve, përveç obligimit profesional, shpirtëror, është edhe një ndriçim dokumentar gjuhësor, edhe pse provincial, ngaqë "…onomastika mbetet si "arkivi gojor" i historisë dhe i lashtësisë së kulturës sonë në hapësirën ballkanike"[3]

Toponimi *Nikaj* del që më 1330[4]. Si fshat me emrin *Nikijt* pjesë e Pultit të sotëm, del edhe më 1485, si nahije nën zotërimin e Pjetër Spanit, me 7 shtëpi, 350 të ardhura.[5] Është një oikonim që ka dalë nga patronimi *Nikë*, që del edhe si emër përmbledhës për tërë fisin.

Brenda këtij emërtimi kemi një larmi toponimesh: *Curraj i Epërm*, që ndodhet në pjesën më veriore të trevës, por edhe *Curraj i Poshtëm*, në rrëzë të *Rrasës Curraj* dhe *majës së Rrukut*, nga i cili u shkëputën dy të parët, themeluesit e fshatit Curraj i Epërm: *Mirash Marku* dhe *Gjeq Dema*. I pari mori nishanin dhe i dyti tokën më të mirë.[6] Si oikonim *Curraj i Epërm* del që më 1627, 1685. Më 1671 del me tri shtëpi, 50 frymë[7]. Ka

[2] Sipas një kumtimi të Rrok Zojzit në 'Etnografia shqiptare I", Tiranë 1962, f. 35; *Pal Neçaj* "Udhë brezash" , Botues, ASD - Studio, Tiranë, 2012, f. 23; Progni, D, - Doda, Z, : "Nikaj - Mërtur", Vështrim historik, Shkodër, 2003.
[3] Prof. dr. Shkurtaj, "Onomastikë dhe etnolinguistikë", vepër e cituar, f. 44.
[4] Revista "Hylli i Dritës" 1/1932, f. 5-12.
[5] Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, vëllimi I, Tiranë, 1974, f. 146.
[6] Si fakt i përcjellë gojë më gojë nga më të vjetrit e katundit, por trajtuar edhe në "Hylli i Dritës", cituar më.
[7] Hylli i Dritës, vepër e cituar, 1/1932, f. 12.

një etimologji popullore pejorative, gjoja, si toponim del nga patronimi *Curr Magjupja*[8], nga ka rrjedhën tërë fshati, çka nuk është e vërtetë historikisht dhe etimologjikisht. Fjala "*curr*", fjalë e moçme e shqipes, përdoret dendur në kuptime të ndryshme, si: *veshprerë*, *i curruem*, *curroj veshët* (ngrej përpjetë), por *curr* edhe *shkëmb, thepa, shpate, vend i pjerrët.*[9] Pra, *Curraj*, vend me shkëmbinj, curra, vend i pjerrët, i cili u popullua nga kjo racë aktuale rreth 250 - 270 vjet më parë, duke shpërngulur një popullsi tjetër, gjurmët e së cilës gjenden në toponimi të ndryshme që ekzistojnë ende, si: *Marin, Dedgjon, Ndrekol, Gjovel, Ndërgere, Paterpangja, Shytëza, Pjaja,*[10] *Luzâja, Kisha e Luzâjës* në Curraj të Poshtëm, *Mavriq*[11] (shtëpi 20, mullinj hasa 1, të ardhura 1800) etj.

Emërvendi *Curraj i Epërm* përfshin këto vëllazëri: *Prebibaj, Nikbibaj, Vatnikaj, Mrishaj, Vukaj, Qokaj, Përpepaj, Ndrevataj, Mehmetaj, Hysenaj* dhe *Zhivanaj*. Në lidhje me formimin, vijnë nga emra të përveçëm, (antroponime dhe patronime) me përngjitje. Oikonimi, si grup emëror, *Curraj i Poshtëm*, katundi *Luzajë më* 1535, Kisha e *Luzajës* po në këtë oikonim, aktualisht përbëhet nga vëllazëritë: *Prekperaj, Palnikaj, Martinaj*, *Geci~aj, Hasa~j, Hajdarkolaj, Zhivanaj*, si antroponime plus prapashtesë dhe patronime me përngjitje.

Po ashtu oikonimi *Qereç*, që del edhe si *Qerem*[12], (besojmë, patjetër, se është ngatërresë me *Qerem*, në kufi me Kosovën, në Malësinë e Gjakovës), *Qiresh, Qeresh, Qireq.*[13] Ky oikonim, si qendër banimi, kishte 12 shtëpi me dy mëhallë, *Mirashmarkaj (një pjesë edhe në katundin Curraj i Epërm)* dhe *Gecaj (*Malndreaj në Kuç dhe Stakndreaj në lagjen Qereç), që quhen edhe të *Prebiba*j, shkëputur nga fshati Curraj i Epërm rreth 120 vjet më parë. Si toponim thuhet se ka qenë vend ku piqeshin furra gëlqereje, pra *qireq, qereç* (gëlqere), si apelativ, nga ka marrë emrin toponimi, *Qereç.* Oikonim i kësaj hapësire gjeografike është edhe lagjja *Kuç*, *Kuqa* në Mesjetë, që mban patronimin *Gecaj*, një pjesë edhe në lagjen Qereç, të dalë nga lagjja Kuç. Është një oikonim që, si fjalë homonime, është i shpërndarë gjithandej, nga Mali i Zi deri në Vlorë.

[8] Emil Lafe, E folmja e Nikaj - Mërturit, "Studime filologjike", 3/1964, f. 137.
[9] Prof.Eqrem Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, Bleu III, C - D, Tiranë, 1987, f. 68 - 69.
[10] "PLAJA DI MAULICHI", sipas një dokumenti të vitit 1774, te "Hylli i Dritës", Dokumenta të pabotuem 1 - 3, shtypshkronja françeskane 1943, f. 72. Burimi i lumit të Currajve të Epërm, si hapësirë gjeografike quhet lumi i Pjasë, pra ka qenë banuar nga Pjajët.
[11] Defteri…, vepër e cituar, f. 149.
[12] "100 vjet pavarësi e shtetit shqiptar", Dokumenta arkivorë të akteve zyrtare për toponiminë, ShB "ARBËRIA", Tiranë, 2012, f. 117.
[13] "100 vjet pavarësi e shtetit shqiptar", Dokumenta arkivorë të akteve zyrtare për toponiminë, ShB "ARBËRIA", Tiranë, 2012, f. 117.

Si emërvend kemi edhe lagjen *Mulaj*, pjesë e fisit Mërtur, shkëputur nga fshati Shëngjergj, hapësirë nën juridiksionin e tij, si vend bjeshke. Ka qenë i përfshirë në ndarjen administrative, fshati *Qereç-Mulaj*, për arsye largësie nga Shëngjergji. Si oikonim ka marrë pagëzimin nga patronimet e vëllezërve *Lekë Mula* e *Tafë Mula.*[14]

Oikonimi *Gjonpepaj*, ka dalë nga emri familjar me anë të përngjitjes. Te "Hylli i Dritës" e gjejmë *Gjon ~Pepaj,* me vëllazëritë: *Dakaj, Doçaj, Gjergj~Ndrejaj, Mar'~Vataj, Ndré-Pepaj* dhe *Stakaj*[15]*, Marvataj, Gjeloshaj, Gjonaj.* Me Gjonpepajt është edhe emërvendi *Kapit,* formuar nga apelativi *kapt (*që s'duket, jo ballë për ballë), që ka dy vëllazëri*: Dedaj* e *Niklekaj,* [16] njëri toponim që vjen nga një emër njeriu, ndërsa tjetri si patronim*,* populli e ardhur që i është bashkëngjitur fisit Nikaj, si dhe *Vrana* (*Vrana e Madhe dhe Vrana e Vogël),* në krahun e djathtë të *Lugut të Ndërmajës Nikaj* dhe në rrëzë të shpatullës së qafës së *Mërrethit*, që ndan me katundin Curraj i Epërm, në jugperëndim të tij.

Po ashtu edhe *Peraj,* që del edhe *Bieshka,*[17] (apelativ) është shndërruar në oikonim nga antroponimi *Perë-a,* lagje e bajrakut të fisit, me vëllazëritë: *Përpali, Gjonpali, Pervataj, Martincanaj, Neçaj dhe Kolbuçaj*. Këtu kemi edhe lagjen *Mëserr*, me patronimin *Neçaj*. Si emërvend shpjegohet "*Mbi Sterr*", sterr i zi , sterrë e zezë, shkallë sipërore, me asimilim ka dalë emri *Mëserr*[18] (Mserr në shqiptim).

Qendra kryesore e Nikaj - Mërturit është lokaliteti *Lekbibaj*, edhe si komunë deri më 21 qershor 2015. Si toponim ka dalë nga antroponimi te emri familjar (patronimi) me anë të përngjitjes, formuar nga djali i madh i Bibë Nikës, *Lekë Biba*. Gjysma e emërvendit Lekbibaj janë edhe lagjet *Varg* dhe *Nikprendaj*, njëri emërtim vjen nga apelativi, Varg, njëri pas tjetrit, ndërsa tjetri nga përngjitja antroponim plus patronim.Vëllazëritë kryesore të Lekbibajve, formuar nga antroponimi plus patronimin me anë të përngjitjes janë: *Paplekaj, Aliaj, Imeraj, Pecnikaj, Meshaj, Rosaj, Susaj dhe Bushati.*[19]. Përsa u takon emrave, si apelativ, *Rosaj, Bushati, Neçaj* nuk lidhen me emër njeriu, duket se kanë ngelur si toponime të një populli së më të hershme se ajo e Nikajve.

Emërvendi *Mërtur* si makrotoponim përfshin 6 fshatra. Fshati *Rajë* me emërtimet *Shkamb, Bregu i Lumit* është pjesë e një njësie tjetër administrative, ish -

[14] Dedë Rrustemi - Mulaj, Amaneti i pashkruar, Kujtime, refleksione, Botimet "ENJA", Tiranë, Tetor 2014, f. 16.
[15] Revista "Hylli i Dritës", 1942/3-4, f. 178; Fletorja Zyrtare, 26 gusht 1938, nr.64, f. 18 është *Gjonpepaj*.
[16] Pal Neçaj, vepër e cituar, f. 48.
[17] Shih burim i cituar më lart, Fletorja Zyrtare, 26 gusht 1938, nr. 64, f. 18.
[18] Pal Neçaj, vepër e cituar, f. 52-53.
[19] Pal Neçaj, vepër e cituar, f. 52.

komuna Dushaj, Fierzë. Emërtimi i fisit *Mërtur*, sipas traditës gojore të historianëve popullorë, burimeve të shkruara, ka dalë nga antroponimi "*Mërtusi*"[20], *Mërtur*, edhe sot si antroponim, i cili ka kaluar në oikonim që emërton një fis të tërë. Është ndër fiset më të mëdha e më të moçme ndër male, i cili i përket fisit shumë të vjetër të Berishës, me shtrirje nga Kuçi i Malit të Zi, Liqeni i Shkodrës, në zona të Pukës, Dibrës, Rekë e Kosovë. I është bashkëngjitur fisit *Nikaj*, shpërngulur nga *Mërturi i Gurit*, kufi me katundet e fisit *Berishë*, Pukë, aty nga fillimi i shekullit XVII.[21]

Toponimet kryesore brenda fisit janë: *Bëtosha, Shëngjergji, Tetaj* (dalin dhe quhen edhe me emrin *Mlaka*[22]*, Biake, Bjake*), *Palç, Salcë, Brisë*, që i gjejmë edhe në Defterin e Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485[23].

Sa i takon formimit, vërehet se *Bëtoshë* vjen nga një emër ilir *Bato, Batosh, Betuçi*[24] *Butosha* (Botosha),[25] sot Bëtoshë, por si etimologji duhet marrë me rezervë. Ka pesë vëllazëri: *Ukcamaj, Pjetërgjokaj, Bushgjokaj, Kolgjokaj dhe Markgjokaj*, si emra familjarë, formuar me anë të përngjitjes.

Në vijueshmëri të fisit Mërtur vjen oikonimi *Shëngjergj*, i cili është thirrur edhe *Bjake,* bashkë me Tetaj, siç duket, si toponim i një popullsie tjetër, si të thuash, ajo e vjetra, e moçmja, e plakura, me ndërrim të tingullit nistor nga i shurdhët në të zëshëm, dukuri të shpeshta në të folmen dialektore të zonës. Aktualisht toponimi *Shëngjergj* është emër shenjtori[26], festë që lutet më 22 prill si Shëngjergj i Ri dhe 6 maj si Shëngjergji plak. Ka këto vëllazëri: *Malaj, Mulaj, Kolpreçi Pjetërnikaj, Sokoli, Vatnikaj dhe Vukaj*, formime nga emra njerëzish, plus prapashtesë dhe, si emra familjarë, me përngjitje.

Në vazhdim të fisit Mërtur kemi emërvendin *Tetaj* (*Bllakë*, 1485),[27] që vjen nga një antroponim, përbërë nga vëllazëritë: *Gjokli, Malaj, Markaj, Vukaj*, si patronime.

Toponimi *Palç*, më 1485[28] (Defteri…, vepër e cituar), është i njohur, i cili më vonë do të popullohet nga fisi *Mërtur*, i ardhur nga *Mërtishë*[29] (Mërturi i Gurit, Pukë) që

[20] "Vepra pijore", Kalendari i Vjetës 1926. Dokumenti i dytë, f. 55. Shkruar më 8 tetor 1909.
[21] Gjon Markokaj – Siman Ramaj, Raja, Rrënjët dhe degët e një trungu të moçëm, "Kristalina KH", Tiranë, 2005, f. 10 - 12.
[22] Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, f. 1006.
[23] Defteri…, vepër e cituar, f. 147, 148, 167.
[24] Ndue Ukcam Leka, Btosha, Tiranë: Dardania 2006, f. 7.
[25] Defteri…, vepër e cituar, f. 167.
[26] Prof. dr. Gjovalin Shkurtaj "Onomastikë dhe etnolinguistikë", vepër e cituar, f. 201, 203, 204.
[27] Prof. dr. Selami Pulaha, Studime për epokën e Skënderbeut, vëllimi i parë, Tiranë, 1989, f.338, me 8 vatra, 500 akçe.
[28] Selami Pulaha, vepër e cituar, f. 338
[29] Selami Pulaha, po aty, f. 338.

do të ishte edhe mbajtësi i Bajrakut, i cili më vonë do t'i shkonte Shëngjergjit. Sot oikonimi *Palç* posedon patronimet: *Gecaj, Malaj, Doda, Beka, Preka, Muslia, Kuka, Lori, Ndreaj, Gjoli, Ndou - Ndoja, Buja, Kolpepaj, Faslia* dhe *Sokoli*, si antroponime me parapashtesën përkatëse, por edhe si llagape mëhallësh, patronime, si: *Varosh, Papdedaj, Palmelaj, Papmelaj, Kotec, Ndreaj, Gjolmelaj* etj.

Në pjesën jugperëndimore të trevës nikajmerturase janë dy toponime: *Salcë* dhe *Brisë,* që i gjejmë edhe në Defterin e Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485[30]. Si term *Salcë* lidhet kuptimisht me llojin e tokës: *tokë gri, si ngjyrë salce,* aktualisht, ndërsa *Brisë* lidhet me fjalën, *brinjë, shpat, vend brinjë, i pjerrët*, që bie thikë e në lumin Drin, pra, si toponime vijnë nga apelativat përkatës. *Salca*, si emërvend, përbëhet nga vëllazëritë, *Dedndreaj, Lekndreaj, Prognaj dhe Steaj*, formuar me përngjitje si patronime, por edhe si antroponime plus prapashtesë. Ndërsa oikonimi *Brisë* që ndodhet në pjesën më skajore të Nikaj - Mërturit ka vëllazëritë, *Mhillaj, Kolndreu* dhe *Martinprekaj* (e fundit, aktualisht në Kosovë), edhe këto si patronime me përngjitje.

Fis i veçantë i Mërturit është katundi *Rajë* "…që freskon këmbët mbi Drin e Valbonë (sot liqeni i Komanit), e me kokën mbështetur mbi Koren e Mërturit, vezullon që nga Mesjeta"[31] dhe është më vete nga pjesa tjetër e Nikaj - Mërturit. Si oikonim shpjegimin e saktë etimologjik e ka dhënë prof. Eqrem Çabej: "Emri i fshatit Rajë shpjegohet me fjalën paraturke "ARANJO - Rrënjë – rrënjë fisi". Gjatë regjimit të mbretit Zog, zyrtarisht thirrej me emrin "Shkamb".[32] Emërtimet sipas vëllazërive të katundit janë: *Gjonmemaj, Pepkolaj, Markokaj, Maklekaj, Kurtprekaj*, patronime me përngjitje, ndërsa *Ramaj, Kukaj, Macaj, Rrahaxhi*, dalin si antroponim me prapashtesë. Mikrotoponimet në këtë areal gjuhësor janë të shumta dhe me shumë interes.[33]

3. Antroponimia, etnonimet dhe oronimet

Me interes janë antroponimet në këtë trevë, ku zënë vend emra të vjetër vendas, që lidhen me emra të përgjithshëm kafshësh, shpendësh, trupa qiellorë[34] etj, si p.sh: *Ujkë, Dash, Cjap, Pulë, Bjeshkë, Borë, Hanë, Dilë, Dalinë, Dritë, Diella, Gjelinë, Gjelosh, Lulë, Sokol, Zogë, Pllum, Petrit, Shegë, Fllanxë, Luan, Gofile, Bardhe, Shotë, Galë, Macë, Groshe, Sutë, Zhujë,* por edhe emra me lidhje fetare, hyjnore, si: *Dedë, Zef, Jozef, Mhill, Pjetër, Prendë, Gjin, Gjon, Nikollë, Filip, Ndue, Lazër, Martin* etj.

[30] Defteri…, vepër e cituar, f.148-149. Fshati *Salça* del me shtëpi 8, të ardhura 400, ndërsa *Brisha* me 10 shtëpi, të ardhura 1000.
[31] Raja, vepër e cituar, f. 5.
[32] Fletorja Zyrtare, burim i cituar, f. 18.
[33] Raja, vepër e cituar, f. 22-25.
[34] Prof. dr. Gjovalin Shkurtaj, vepër e cituar, f. 125-126.

Dendur përdoren edhe etnonimet e paranyjëzuara: *i Qereças, i Curraj, i Gecaj, i Mulaj, i Shëngjergjas, i Tetaj, i Palçnuer, i Brisor, i Qokaj, i Prognaj, i Vukaj, i Malndreaj, i Stakaj, i Përpepaj* etj.

Një larmi më vete për dendurinë e madhe të përdorimit zënë edhe oikonimet shoqëruar me emrin e banorit, që tregon përkatësi, posedim: *ara e Bejtes, ara e Ndrekolit, ara e Gjovelit, Sukullari i Palinës, ara e Zmal Avdisë, roga e Stak Ndreut, varri i Fratit, qafa e Fratit, rogat e Dedushit, quku i Ndërgeres, livadhi i Paterpangjës, roga e Bjeshkagjes, kodra e Ukës, arat e Marinit, çeta e Dedë Miftarit, stanet e Gecajve, Boshi i Mar Lulës, fieraja e Ukcamës, guri i Kaurrit, verrat e Arushës,* etj.

4. Hidronimet, llojshmëria

Gjejnë një përdorim të dendur, anekënd trevës, në bjeshkë e vërri, kudo ku buron një pike ujë: në një rrasë guri, në rrëzë të një shkëmbi, shpelle, buzë një lisi, në një rudinë a livadh, duke i vënë secilit nga një emër, lidhur me pozicionin, ndodhinë apo pronarin e tij, sepse uji, kroi janë me orë dhe janë ndorja e Zotit thuhej. Kështu që fjalët kyçe që shoqëronin hidronimet përkatëse ishin mjaft të larmishme.

Hidronime me fjalën lumë: *lumi i Pjasë, lumi i Currajve, lumi i Mërturit, Lumi i Vogël, lumi i Kuçit* etj.

Hidronime me fjalën *krua, gurrë, gurrec, përrua, lkê, pus*: *kroi i Hajdar Metës, kroi i Musës, kroi i Vatë Mirashit, kroi i Gjatkave, kroi i Pikut, gurra e Hasa Gashit, te Gurrat, te Gurreci, gurreci i Vogël, përroi i Qokajve, përroi i Serrës, përroi i Bëtoshës, lkêni i Ponarit, lkêni i Markajve, pusterri i Rajës, Kroi i Gurit, kroi i Marvatës, kroi i Kangjilit, kroi i Qafave, kroi i Gëlqeres, shpella e Çilikokëve, lugu i Thive, quku i Borës, rrasa e Marketës, quku i Mhillit, ara e Malës, grezda e Lulash Nikës, ara e Buçanit, rrahi i Picakut, kroi i Valungës, kroi i Lopës së Gjeqës* etj.

5. Stilema toponimike

Toponime të lidhura me gjeografinë: *qafa e Agrit, maja e Hekurave, maja e Alshinës, maja e Gavnit, maja e Rrodhes, maja e Kores, qafa e Kolçit; shkëmbi i Zi, thepi i Tortës, thepi i Krapesë, lugu i Zajkut, logu i Çobanit, logu i Zharit, thepi i Pistit, shpella e Kusiave, shpella e Prekperës, shpella e Ndërgeres, shpella e Gunit, shkambi i Kuq, roga e Shurdht, lugu i Zanave, kalaja e Lekës*.

Ndërtimi i toponimeve (apelativ plus mbiemër) që tregon ngjyrë ose cilësi tjetër: *shkëmbi i Kuq, Thepi i Zi, livadhi i Gjatë, Roga e Gjatë, roga e Kuqe, lugu i Keq, guri i Gjatë,*

Togfjalësh me emër që tregon veçori topografike plus emër i gjinores: *Bira e Zezë, rrënja e Lerës, logu i Pllumave, logu i Qershiave, çeta e Diellit, rrahi i Dardhës.*

Realitet topografik (grup emëror, ku përcaktori tregon lloj, pronësi në raport me emrin bërthamë): *Gjytetzat e Mulajve, ashta e Listramit, logu i Ashtës, mrizat e Rrathtorëve, rrathtorët e Mbasmajës, karriget e Mulajve, terla e Lëpjeshtës, logu i Zharit*.

Mikrotoponime me fjalët kyçe *kaproll, dele, dash*: thepi i Krapesë, shtegu i dhenve, shtegu i Dashit.

Emërvendi me fjalën *edh, dhi, vjetë*: *Shtegu i Edhave, Maja e Dhive, Quku i Vjetave.*

Toponim me emrin *kalë*: *Qafa e Kolçit, rrugës Kalit, Drumi i kualëve, Shkalla e Kalit.*

Oikonim me fjalën *pëllumb*: *Logu i pllumbave.*

Toponim me emër *insekti*, *rrëshqanori*: *Thepi i Bietës* (bletës), *Maja e Gjarpnit.*

Toponim me fjalën "mollë", si fitotoponim: *te Molla e Kuqe, te Molla e Epër.*

Emërvendi me *ah, ashtë*: *te Ashta, logu i Ashtës*, kalimi në patronim nuk vërehet në Nikaj-Mërtur.

Toponim me *fier*: *fierishtë, quku i Fierajës*.

Oikonim me fjalën *frashër/frashën*: *Quku i Frashnajës*.

Toponim me *gështenjë*: *Kshtajza* (Mulaj).

6. Përfundim

Përmes kumtimit tonë sintetik, pohojmë me bindje se, onomastika nikajmërturase është një galerë leksikore që paraqet një larushi të madhe gjuhësore, dialektore, etimologjike, sociolinguistike, me rëndësi për gjeografinë onomastike shqiptare, ku, ërmes një hulumtimi shterrues, nxjerr në sipërfaqe një ajsberg etnolinguistik dhe onomastik njëkohësisht, që do të përbënte një arritje gjuhësore për disa disiplina të kësaj lëmie në përgjithësi dhe disiplina të tjera të përafërta, hulumtim që e kemi marrë përsipër ta shprishim në gjithë gjerësinë e tij.

Fjalor onomastik i oikonimeve të arealit gjuhësor nikajmërturas:

Curraj i Epërm, fis *Nikaj*, oikonim në pjesën veriore të trevës, kufi me *Curraj i Poshtëm*, në veri të tij, me *Rrasën e Currajve*, në vazhdim *Maja e Rrukut*, *Piku i Currajve, Qafa e Mërrethit, Kakia e Nikajve, Qafa e Derëzave*, kufi me hapësirën gjeografike të Thethit, *Qafës së Boshit*, teposhtë *Çobanit*, *Lugut të Zajkut*, poshtë terlës së *Gjokolit*, *Lumi i Pjasë, Drelë, Maja e Qokajve, Qafa e Qereçit*, *Shkëmbi i Forcës*, *Qafa e Marinit*, duke zbritur deri ku bashkohen lumi i *Kuçit* me atë të *Currajve*.

Curraj i Poshtëm, fis *Nikaj*, fshat në rrëzë të *Rrasës së Currajve* dhe *Majës së Rrukut* të Nikajve, me kufij ndarës *lumin e Mërturit* dhe *lumin e Vogël*, kufi me *Gjonpepaj*.

Bëtoshë, fis Mërturi, fshat në rrëzë të qafës së Kolçit dhe Kores së Mërturit, kufi me Shëngjergjin.

Brisë, fis Mërturi, oikonim në pjesën më jugore të trevës, mbi lumin Drin, kufi me Salcën dhe Toplanën.

Bushat, mëhallë e Nikajve, oikonim i qendrës Lekbibaj.

Gjonpepaj, fis Nikaj, mes Përroit të Serrës dhe Lumit të Vogël, në formë *V* – je, që përfshin Kapit, Vranë e Madhe dhe Vranë e Vogël deri në lugun e Ndërmajës.

Luzajë, vendbanim i hershëm në Curraj të Poshtëm, rrrëzë Rrasës së Currrajve.

Kapit, mëhallë në veri të fisit *Nikaj*, mes *Perajve* dhe *Gjonpepajve*, prej fundit të shkëmbit të *Kodërplakës* në jug dhe deri te *Thepi i Rrënjës* në veri.

Kotec, fis Mërturi, pjesë e fshatit Palç, me këmbë që i lagen në lumin Drin, përballë me Apripën e Gurit, në ngjitje deri rrëzë kodrës së Palçit, si pjesë e kësaj mëhalle, kufi me të dhe lagjen Varg, fisi Nikaj.

Kuç, fis Nikaj, mëhalla *Gecaj*, 100 m, poshtë lagjes *Qereç*, nga ish shkolla e Qereçit, teposhtë, *Rruga e Madhe, Lugu i Grisë*, deri te *Kodra e Selbicës*, poshtë *Prapshtijave*, *Mëhallat,* zbret në lumë, *Gërbyelli,* në jug të lagjes, *shkëmbi i Dedgjoni*t, *Shkëmbi i Krysë, Kryja, Dedgjon*, deri te *qafa e Marinit*, kufi me Curraj i Epërm, në një luginë, në formën e një grope të madhe, ndarë në mes nga lumi i Qereçit.

Lekbibaj, qendër e kahershme administrative e Nikaj – Mërturit, me kufij ndarës, lumi i Mërturit, Lumi i Vogël, Përroi i Serrës, lagjja Kotec. Përbëhet nga vëllazëritë: *Paplekaj, Aliaj, Imeraj, Pecnikaj, Meshaj, Rosaj, Susaj* dhe *Bushati.*

Malndreaj, patronim në lagjen Gecaj (vëlla që është ngulur në lagjen Qereç).

Markaj, lagje e fisit Mërtur, pjesë e fshatit Tetaj, kufi me të, që shtrihet deri te shkëmbi i Rajës, me këmbë në lumin Drin.

Mërtur, njëri prej dy fiseve që ka treva me emërtimin toponimik, *Nikaj - Mërtur*, i vendosur në të majtë të lumit të Mërturit duke filluar me *Mulaj, Bëtoshë, Shëngjergj, Tetaj, Markaj* dhe pastaj në të djathtë të lumit të Mërturit me *Kotec, Palç*, *Salcë* e *Brisë.*

Mëserr, lagje e rrethuar nga *Përroi i Qershisë*, *Përroi i Vovës* dhe *Përroi i Kshotit*, pjesë e fshatit *Peraj.*

Mulaj, lagje e fisit *Mërtur*, në rrëzë të qafës së *Pipit* dhe *Mollës së Epërm*e, me kufij gjeografik, *Lugu i Selbicës, Shtegu i Dashit, Mleja*, në vazhdim, poshtë *Varrit të Fratit* deri në *Qafën e Pjasë*, kufi me fshatin *Bëtoshë*, lumin *Curraj* gjer ku bashkohet me atë të *Kuçit*, poshtë *Kshtajzave.*

Nikaj, njëri prej dy fiseve të mëdha të trevës, që shtrihet në anën e djathtë të lumit të Mërturit, lumit të Vogël, të Kuçit, në lindje dhe verilindje, deri në *malin e Kaponit*, *qafën e T'thermes, Guri i Fushës së Madhe e qafa e Ndërmajës* në perëndim e

veriperëndim duke vazhduar në veri me *bjeshkët e Kakisë, qafën e Boshit, majën e Zezë* e deri në *shtegun e Dashit*, kufi me lagjen Mulaj.

Nikprendaj, lagje e fshatit Lekbibaj, në jug, poshtë qendrës me të njëjtin emër, në rrëzë të lumit Mërtur, përballë fshatit Tetaj (lagjes *Qehaja*).

Palç, fshat i fisit Mërtur, në të djathtë të lumit Drin, në shpat mali, deri në Kodërpalç, pjesa juperëndimore e trevës.

Peraj, fshat afër Paplekajve të Epërm, mbi Gjonpepaj, deri në logun sipër *Shkëmbit të Briculit*, mëhallë e bajraktarit të Nikajve, Deli Sokolit dhe Sokol Delisë, si trashëgimtarë të fundit.

Qereç, fshat brenda fisit Nikaj, në verilindje të fshatit Curraj i Epërm, me kufij ndarës *qafën e Qereçit, Verrishtën, majën e Rrodhes, shpatin e Rrodhes, Mbasmaje, qafa e Fratit, Vashqefën, maja e Gavnit, Quku i Frashnajës, thepat e Zharit, lugu i Tahir Malës, thepi i Pistit, qafa e Droçkës, Kodra e Zharit, Alshina, thepi i Bietës* (Bletës) deri tek *shtegu i Dashit,* mbi *Drumin e Prapshtijave,* me kufi lugun e Selbicës*,* që të çon për në lagjen Mulaj.

Rajë, fis Mërturi, që shtrihet në krahun e djathtë të lumit *Valbonë* dhe *Drin*, në shpatin lindor të malit, *Korja e Mërturit*. Në lindje kufizohet me oikonimin *Dushaj*, që i ndan lumi Valbonë, në jugperëndim me fshatin Tetaj apo drejtpërdrejt me lagjen Markaj, në kufi ndarës *Lugu i Zanave*, në mesin e shkëmbit të Rajës. Në veriperëndim kufizohet me katundin Shëngjergj, në veri me katundin Bëtoshë, që ndahen nga kurrizi i malit Korja e Mërturit. Në verilindje kufizohet me katundin *Selimaj* të *Geghysenit*, me vijë ndarëse *Lugun e Kores*, deri në breg të lumit Valbonë.

Salcë, fshat i fisit Mërtur, mes Palçit dhe Brisës, me këmbë që i lagen në Drin, në perëndim të rrjedhës së tij, në shpat mali deri në qafën e Agrit, kufi me Shalën, në juglindje të saj.

Stakndreaj, patronim në lagjen Gecaj (vëlla i ngulur në lagjen Kuç, me 5 shtëpi).

Shëngjergj, oikonim që vjen nga emër shenjtori, fis mërturi, mëhallë e bajraktarit Tunxh Miftari. Del edhe si Mlaka, Bjake. Ndodhet në pozitë ndërmjetëse mes fshatit Bëtoshë dhe Tetaj, buzë lumit të Mërturit deri në rrëzë të Kores së Mërturit, përballë me fshatin Curraj i Poshtëm.

Stakaj, lagje e fshatit Gjonpepaj.

Tetaj, fshat i fisit Mërtur, që shtrihet nga pjesa fundore e kurrizit të majës së Kores, përroi i Tetajve deri në lumin e Mërturit, kufi me kodrën e Markajve dhe kufi me këtë lagje, që përfshihet në fshatin Tetaj.

Varg, lagje e lokalitetit Lekbibaj, në pjesën juglindore, deri në kufi me Kotecin e Palçit.

Vranë e Madhe, lagje e vogël e fshatit Gjonpepaj, në verilindje, në formë lugine, rrëzë qafës së Mërrethit dhe kufi me lugun e Ndërmajës, deri në rrëzë të majës së Kakisë.

Vranë e Vogël, lagje e vogël, në verilindje të fshatit Gjonpepaj, në një luginë të ngushtë, rrëzë shpatit të qafës së Mërrethit, majës së Rrukut, në jugperëndim të tyre.

Fjalor onomastik i patronimeve kryesore, anekënd trevës së Nikaj – Mërturit:

Aliaj, patronim i një mëhalle të fshatit Lekbibaj.
Beka, patronim i një mëhalle të fshatit Palç.
Buja, patronim i një mëhalle të fshatit Palç.
Bushati, patronim i një mëhalle të fshatit Lekbibaj.
Dakaj, patronim i një mëhalle të fshatit Gjonpepaj.
Dedaj, patronim i lagjes Kapit, fshati Peraj.
Dedndreaj, patronim i një mëhalle të fshatit Salcë
Doçaj, patronim në fshatin Gjonpepaj.
Doda, patronim në fshatin Palç.
Faslia, patronim i lagjes Kotec të fshatit Palç.
Gecaj, patronim në lagjen Kuç, Curraj i Poshtëm dhe fshatin Palç
Gjeloshaj, patronim në fshatin Gjonpepaj.
Gjergjndreaj, patronim në fshatin Gjonpepaj.
Gjoli, patronim në fshatin Palç.
Gjonaj, patronim në fshatin Gjonpepaj.
Gjonmemaj, patronim në katundin Rajë.
Gjonpali, patronim në fshatin Gjonpepaj.
Hajdarkolaj, patronim në fshatin Curraj i Poshtëm.
Hasa, patronim në fshatin Curraj i Poshtëm.
Hysenaj, patronim në lagjen Prebibaj, fshati Curraj i Epërm.
Imeraj, patronim në lokalitetin Lekbibaj.
Kolbuçaj, patronim në fshatin Peraj.
Kolndreu, patronim në fshatin Brisë.
Kolpepaj, patronim në lagjen Kotec, fshati Palç.
Kolpreçi, patronim në fshatin Shëngjergj.
Kuka, patronim në fshatin Palç.
Kukaj, patronim në katundin Rajë, një mëhallë e vogël, poshtë kishës së fshatit.
Kurtprekaj, patronim në katundin Rajë.
Lekndreaj. patronim i një mëhalle të fshatit Salcë

Lori, patronim në fshatin Palç.

Macaj, patronim në katundin Rajë.

Maklekaj, patronim në katundin Rajë.

Malaj, patronim në fshatin Shëngjergj dhe Palç.

Markokaj, patronim në katundin Rajë.

Martini/aj, patronim në fshatin Curraj i Poshtëm.

Martincanaj, patronim në fshatin Peraj.

Martinprekaj, patronim në fshatin Palç, aktualisht në Kosovë.

Marvataj, patronim në fshatin Gjonpepaj.

Mehmetaj, patronim në mëhallën Prebibaj, në Curraj të Epërm.

Meshaj, patronim në lokalitetin Lekbibaj.

Mhillaj, patronim në fshatin Brisë.

Mirashmarkaj, patronim i një mëhalle në Qereç dhe Curraj i Epërm, përbërë nga tre vëllezërit: *Ali Mirashi*, *Ndue Mirashi* dhe *Musë Mirashi*.

Mrishaj, patronim në fshatin Curraj i Epërm.

Mulaj, patronim në lagjen Mulaj, fshati Shëngjergj.

Muslia, patronim në fshatin Palç.

Ndou, Ndoja, patronim në lagjen Kotec, fshati Palç.

Ndreaj, patronim në fshatin Palç.

Ndrépepaj, patronim në fshatin Gjonpepaj.

Ndrevataj, patronim në fshatin Curraj i Epërm.

Neçaj, patronim në lagjen Mëserr.

Nikbibaj, patronim i një mëhalle në Curraj të Epërm.

Niklekaj, patronim i lagjes Kapit, fshati Peraj.

Palnikaj, patronim në fshatin Curraj i Poshtëm.

Paplekaj, patronim në lokalitetin Lekbibaj.

Pecnikaj, patronim në lokalitetin Lekbibaj.

Pepkolaj, patronim në katundin Rajë.

Përpali, patronim në fshatin Peraj.

Përpepaj, patronim në fshatin Curraj i Epërm.

Pervataj, patronim në fshatin Peraj.

Pjetërnikaj, patronim në fshatin Shëngjergj.

Prebibaj, patronim në fshatin Curraj i Epërm.

Preka, patronim në fshatin Palç.

Prekperaj, patronim në fshatin Curraj i Poshtëm.

Prognaj, patronim në fshatin Salcë.

Qokaj, patronim në Curraj të Epërm, i cili i është vënë edhe mëhallës *mirashmarkaj*, padrejtësisht, sepse në fakt në tabelën gjenealogjike janë vëlla tjetër.

Ramaj, patronim në katundin Rajë.

Rosaj, patronim në qendrën e zonës, Lekbibaj.

Sokoli, patronim në fshatin Palç dhe Shëngjergj.

Steaj, patronim në fshatin Salcë.

Susaj, patronim në lokalitetin Lekbibaj.

Vatnikaj, patronim në Curraj të Epërm dhe Shëngjergj.

Vukaj, patronim që përdoret në Curraj të Epërm, në Shëngjergj (në *Fushë-Fier*, në breglumin e Mërturit) dhe Tetaj.

Zhivanaj, patronim i një mëhalle në Curraj të Epërm dhe Curraj të Poshtëm.

Referencat

Baliu, B., (2012). *Onomastikë dhe identitet*, ShB, "Era", Prishtinë.

Çabej, E., (1987). *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Bleu III, C - D, Tiranë.

Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, vëllimi I, (1974), Tiranë.

FESH, (1985), Tiranë.

Hylli i Dritës, (1932).

Hylli i Dritës, (1938).

Hylli i Dritës, (1943).

Kryeziu, B., (2000). *Onomastika e Hoshanisë*, Prishtinë.

Lafe, E., (1964). *E folmja e Nikaj-Mërturit*, Studime filologjike, Tiranë.

Markokaj, Gj., – Ramaj, S., (2005). *Raja, Rrënjët dhe degët e një trungu të moçëm*, "Kristalina KH", Tiranë.

Neçaj, P., (2012). *Udhë brezash*, Botues, ASD - Studio, Tiranë.

100 vjet pavarësi e shtetit shqiptar, (2012). Dokumenta arkivorë të akteve zyrtare për toponiminë, ShB "ARBËRIA", Tiranë.

Progni, D., - Doda, Z., (2003). *Nikaj - Mërtur*, Vështrim historik, Shkodër.

Pulaha, S., (1989). *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëllimi i parë, Tiranë.

Rrustemi, D., (2014). *Amaneti i pashkruar, Kujtime, refleksione*, Botimet "ENJA", Tiranë.

Shkurtaj, Gj., (2015). *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Botime universitare "Albas", Tiranë.

Ukcama, Nd., (2006). *Btosha*, Tiranë: Dardania 2006.

Vepra pijore, Kalendari i Vjetës 1926. Dokumenti i dytë, f. 55. Shkruar më 8 tetor 1909.

Zojzi, Rr., (1962). *Etnografia shqiptare I*, Tiranë.

Dedë QOKAJ

ONOMASTIC STUDIES FROM THE REGION OF NIKAJ - MERTUR

Abstract

The territory of Nikaj - Mertur has a very rich onomastic lexicon and has interest in some disciplines of linguistic such as dialectology, lexicology, speech ethnography and other fields of albanology.

Our onomastic material intends to observe the content of the language, which provides careful onomastic research throughout its width, focusing mainly on the toponyms, oikonyms, oronyms and hydrons. The area has twelve villages as administrative units, which are known even before, but that have to do also with some toponyms that are attached by adding the number of vicinages which should be made a particular onomastic study object.

First of all, semantic studies of word-forming, but also in etymological folks and scientific researches need to be conducted, according to the principle, the history of the people and the history of the language.

Our research will reflect a multi-dimensional portrayal of the toponymic space of Nikaj - Mertur in particular, melting the searches in the fieldwork, in accordance with verbal and documentary interpretations, according to the scale: macrotoponyms and microtopics.

Finally, a general indication of the names and lexemes used in the proclamation will also be provided.

Key words: onomastics, toponyms, oikonims, oronyms, hydronyms, semantics, lexemes.

Teuta DHIMA

BASHKËJETESA E VARIETETEVE TË SHQIPES GJATË LËVIZJEVE MIGRUESE TË POPULLSISË BRENDA VENDIT RASTI I TË FOLMES SË MUHURRIT TË DIBRËS DHE TË FOLMES SË QYTETIT TË DURRËSIT DHE RRETHINAVE TË TIJ

Abstrakt

Lëvizjet migruese të popullsisë brenda vendit pas viteteve 90-të, kanë sjellë pranëvënien e popullsisë nga zona të ndryshme gjeografike të vendit. **Qëllimi** i punimit tim është të evidentoj ndryshimet që ndodhin si rezultat i bashkëjetesës gjuhësore mes varieteteve gjeografike. Çfarë ndodh me këto varietete të gjuhës kur kufijtë gjeografikë fshihen dhe popullsia bashkëjeton si rezultat i lëvizjeve migruese brenda vendit? Origjina ime prej **Muhurrit të Dibrës**, si dhe kontakti me të ardhurit nga kjo zonë në qytetin ku unë jetoj, **Durrës**, më ngacmoi të shkruaj këtë punim i cili do të bazohet kryesisht në rrafshin sociolinguistik (ndërlidhjet midis të folurit dhe shoqërisë). Këta individë, pjesë të familjeve të tyre, me shkëputjen nga krahina, kanë mbartur me vete veçoritë e tyre gjuhësore, veshjet, zakonet, mënyrën e jetesës. Përpos zhvendosjes gjeografike, ata tanimë pjesë e një bashkësie të re shoqërore, janë përballur edhe me ndryshimin e rolit në bashkësinë shoqërore dhe shpesh herë, të klasës shoqërore. Duke qenë se, grupe të ndryshme shoqërore përdorin varietete të ndryshme edhe marrëdhëniet gjuhë-shoqëri kanë ndryshuar. Familjet e shpërngulura kanë gjetur mbështetjen e njëra-tjetrës dhe janë pranëvendosur, duke mos zbehur plotësisht lidhjet me krahinën nga këto familje janë shpërngulur.

Metodat e përdorura

Intervista - si një metodë cilësore është realizuar me banorë të fshatit Muhurr të cilët tanimë jetojnë në Durrës dhe rrethina si edhe banorë të Durrësit.

Metoda e anketimit: anketa përmban disa pyetje të cilat sjellin informacion për vitin e shpërnguljes, moshën dhe sjelljen gjuhësore të këtyre individëve.

Fjalët çelës: *Muhurr- Peshkopi, migrimi,gjuha shqipe, sociolinguistika, dialektet.*

Lëvizja migruese e fshatarëve në përgjithësi e sidomos e asaj të maleve, të luginave malore e kodrinave në veçanti e ngulja në vendet urbane e gjysmë – urbane, në rrethina të qyteteve, pranë rrugëve të mëdha është një fakt që meriton vëmendje e studim. Këto lëvizje kanë filluar që para viteve 1991-1992për të marrë përmasa më të mëdha pas vitit 1995. Para së gjithash theksojmë që këto lëvizje kanë qenë të vullnetshme për popullsinë e shpërngulur,me të vetmin qëllim: sigurimin e një jete më të mirë në të gjitha aspektet.

Qendra banimi si psh: në fushat e Durrësit, Elbasanit, Peqinit, Lezhës që kanë qenë krejt boshe; janë mbushur plot duke bërë që Durrësi që nuk ka në territorin e tij fshatra malorë, të ketë 497.5 frymë për km²duke zënë kështu vendin e parë si frymë për km².[1] Në këto lëvizje migruese kemi bashkësitë shoqërore që shpërngulen, bashkësitë pritëse dhe bashkëjetesën e këtyre dy bashkësive.Si metodë pune kam përdorur intervistën dhe anketën, të realizuara këto me banorë të fshatit Muhurr të cilët tanimë jetojnë në Durrës dhe në rrethina, si edhe banorë të qytetit të Durrësit dhe të rrethinave. Të intervistuarit i përkasin fashës moshore 10 - 70 vjeç.

Vendi nga janë shpërngulur: Muhurri i Dibrës

Komuna Muhurr është njësi administrative që përfshihet në prefekturën e Dibrës të Republikës së Shqipërisë. Pozita gjeografike: 41⁰ 67'82',53" Veri dhe 20⁰33',02" Lindje. Komuna e Muhurrit përbëhet nga 7 fshatra të vendosura në pellgun e mësëm të Drinit të Zi.Kufizohet nga lindja me komunën Kastriot e me komunën e qendrës (Peshkopi), në jug e jugpërëndim me komunën Luzni e Selishtë dhe në veri me komunën e Arrasit.[2]

Komuna Muhurr përbëhet nga këto fshatra: Muhurr, Fushë-Muhurr, Vajmëdhej e Rreth-Kale që ndodhen në ultësirën e Drinit të Zi me një lartësi mbi nivelin e detit mbi 400m dhe fshatrat Hurdhë- Muhurr, Shqath e Bulaç që janë vendosur në shpatin lindor të malit të Muhurrit me majën më të lartë në Majën e Runjës 2047 m.

Lumi Drini i Zi përshkon terrritorin e komunës në lindje të saj në një gjatësi mbi 5 km. Drini i zi bashkë me degën e tij lumin Murrë, kanë ndikim me rëndësi në jetën e banorëve të zonës. Tokat e pasura në ultësirë e pyjet e kullotat e shumta kanë ndikuar në karakterin bujqësor dhe blegtoral të fushës dhe pjesës malore sipas veçorive përkatëse.

[1] Tirta, Mark, *Lëvizje migruese të Shqiptarëve të brendshme e në popujt më afër*, ASH, Tiranë 2013, f. 155.

[2] Doda, Sami, *Dritë diturie në Muhurr*, Botimet M&B, Tiranë, 2014, f. 15.

Vendi ku janë vendosur ardhësit: Durrësi dhe rrethinat, kryesisht: lagjja Nr.18, lagjja Nr.13Plazh(pas shinave të trenit), Spitallë, Porto-Romano, Sukth, Arapaj etj. Rrethi i Durrësit ndodhet ndërmjet 41^0 e 36' deri 41^0 e 15' gjerësi gjeografike veriore dhe 19^0 e 15' deri 19^0 e 38' gjatësi gjeografike lindore. Nga këto kordinata Durrësi ndodhet pothuajse në mes të territorit të Republikës së Shqipërisë (baraslarguar si nga veriu dhe nga jugu).[3] Qyteti i Durrësit ka një popullsi prej 210.285 banorë. Popullsia e Durrësit në dhjetëvjeçarët e fundit, është rritur me ritme të shpejta. Në të u vendosën mjaft fshatarë të ardhur nga fshatrat përqark tij, si krutanë, tiranas, shkodranë, çamë, beratas dhe dibranë. Durrësi i ditëve tona është një mozaik shumëngjyrësh përsa i përket përbërjes së popullsisë. *Në këtë popullsi me prejardhje heterogjene dallohet një bërthamë e mirë vendësish, ku përfshihen edhe fiset e ardhura disa breza përpara nga fshatrat përqark. Kështu fise të vjetra të Durrësit mbahen: Dakoli, Troci, Çelkupa, Cërloi, Kacani, Rexha, Koka, Lugu, Nallani, Mëshketi, Bumçi, Truja, Dovana, Bakalli. Lagjet më të vjetra të qytetit që mbahen mend nga të moshuarit janë:Dakoli, Stani, Kumini, Roçajt, Troci, Kërtusha.*[4] Sot qyteti ka 18 lagje.Banorët e qytetit të Durrësit janë marrë kryesisht me tregti, zejtari, peshkim, nëpunësi dhe me bujqësi.Durrësi sot është një nga qytetet më të pëlqyer për të jetuar dhe një nga portet më të rëndësishëm të vendit. Në pjesën perëndimore, Durrësi laget nga deti Adriatik, duke pasur një vijë bregdetare të thyer. Përgjatë vijës bregdetare dallojmë: Brryli i currilave, Kallmi, Porto- romano, Bishti i Pallës, Gjiri i Lalzit dhe Kepi Rodonit.Durrësi gëzon një pozitë gjeografike të favorshme, e cila e ka ndihmuar dhe e ndihmon për zhvillimin ekonomik, sepse ai ndodhet në kryqëzimin e rrugëve të mëdha tregtare midis lindjes dhe perëndimit dhe anasjelltas si dhe midis veriut e jugut dhe anasjelltas.*Ndër këto rrugë veçojmë Durrës- Ohër-Manastir-Sofje- Stamboll; Durrës-Elbasan-Korçë- Follorinë- Selanik etj.Strategët ushtarakë i kanë quajtur trevat shqiptare Dera e Adriatikut në Ballkan dhe pa mëdyshje kanali kryesor i kësaj dere është Durrësi*[5]*. Sipas të dhënave statistiskore, të ardhurit në Durrës që pas viteve '90 deri në 2014, shënojnë 46.958 banorë.*[6]Objekti i studimit tonë janë të shpërngulurit nga Muhurri i Dibrës pas viteve 1990.Për secilin nga ne, ajo çfarë do kërkojmë të bëjmë kur shpërngulemi, është komunikimi në bashkësinë e re shoqërore ku jemi vendosur.

[3] Xaxa, Ilir & Shuka,Anesti, *Vështirm gjeografiko – ekonomik,* Globus R, 2004, f. 6.
[4] Çeliku, Mehmet, *Dialektologjia shqiptare VI,* ASH, 1990, f.286.
[5] Xaxa, Ilir& Shuka, Anesti,*Vështirm gjeografiko – ekonimik, Globus.R.,* 2004, f. 7.
[6] http://durres.gov.al/images/pdf/buletini_2014.pdf (parë për herë të fundit 31.07. 2016).

Cila është situata gjuhësore?

Si e folmja e Muhurrit që iu përket të shpërngulurve dhe e folura e Durrësit që iu përket bashkësisë pritëse,i përkasin të njëjtit dialekt të gjuhës shqipe: dialektit gegë. Prof. Dr. Mehmet Çeliku ka bërë një studim për të folmen e Durrësit dhe rrethinave të tij ku ndër të tjera thekson se: *E folmja e Qytetit të Durrësit dhe rrethinave të tij është një e folme përfaqësuese tipike e gegërishtes jugperëndimore.*[7]*Në të folmen e Durrësit sikurse në të gjitha të folmet gege jugperëndimore,* vërehen mjaft reduktime qualitative edhe në rradhët e zanoreve të patheksuara:

- A-ja e patheksuar gojore në rrokje nistore priret të kalojë në e: bariu<beriu, makinë< meqin, akrep<ekrep etj.
- **0-**ja e patheksuar gojore nërrokje nistore kalon në a: korrik< karrik, gomar< gamor, kotec<katec etj.
- **U-** ja e patheksuar kalon në a: Kuptoj<capto, kurris< karris, ose në I: fuqi< fiqi, fuçi<fiçi
- **Ë-**ja në pozicionin paratheksor kalon në disa raste në a: këndoj< kanoj.

E folmja e Durrësit ka edhe disa tipare të vetat që nuk i kanë të folmet e tjera gege jugperëndimore:

- Një hundorëzim analogjik dytësor në shumë fjalë: tagjî, tepsî, kusî, kutî, saksî etj.
- Burorëzimi i a-së gojore që prihet nga m, n: mars< mors, mal< mol, mall<moll, mjalt< mjo:lt.
- Bashtingëllorja dh dë gjohet e reduktuar ose kalon në rr a ll: livadh< livall.
- Grupet pl, bl, fl janë zhvilluar përkatësisht në pj, bj, fj: plesht< pjesht, plak< pja:k, pjatë< pjot, fjo:k.
- E pakryera nuk ka larmi formash, ajo paraqitet më uniforme sin ë njëjës edhe në shumës përdoret rregullisht ajo më sh.
- E ardhmja e tipit kam + paskajoren gege takohet më shpesh në të folmet fqinje.[8]

E folmja e Muhurrit të Dibrës: Për të folmen e Muhurrit nuk kam ndeshur në studime të veçanta, por, Prof. Dr. Bahri Beci ka studiuar të Folmen e Reç- e – Dardhës së Dibrës dhe të Luznisë. Mendoj që këto studime do të jenë një mbështetje e fortë për rastin tonë. *Pleqtë thonë që Luznia dhe Muhurri janë vëllezër.Afërsia territoriale dhe*

[7] Çeliku, Mehmet, *Dialektologjia shqiptare VI,* ASH, 1990, f. 288.
[8] Po aty, f. 325.

mungesa e pengesave natyrore të veçanta u ka dhënë mundësi këtyre krahinave të mbajnë lidhje të vazhdueshme; ato marrin e japin më tepër me njëri –tjetrin.[9]

E folmja e Muhurrit bën pjesë në të folmet e gëgërishtes qendrore. *Të folmet e gegërishtes qendrore kanë tiparet dalluese të gegërishtes në përgjithësi, si edhe disa tipare që i veçojnë ato si njësi më vete brenda gegërishtes si:*

- *zbërthimi i i-së së theksuar në diftongje dytësore: ai et, ëi, oi etj. që kanë përfunduar herë-herë në a, e etj. (mir< mair, meir, mëir " mirë" (shpi<shpai, shpei, shpoi " shtëpi"),*
- *zhburorëzimi i y-së së theksuar në i dhe diftongimi i saj yll< ill, aill "yll"*
- *qiellorzimi i bashtingëllores prapagjuhore g në gj: gur<gjur, goj<gjoj etj.*
- *qiellorzimi i grupeve bashtingëllore tj, dj, përkatësisht në bashtingëlloret mesgjuhore q, gj: tjetët< qetër, djal< gjal etj.*
- *formimi i vetës së tretë njëjes së kohës së tashme të mënyrës lidhore të foljeve që mbarojnë me zanore, me mbaresën – (j)e: (ai t' punoje, t'filloje, etj.*[10]

Banorët e shpërngulur në dy dekadat e fundit në Durrës dhe rrethinat e tij sigurisht që iu janë përgjigjur dhe kanë qenë aktiv ndaj ndryshimeve me të cilat iu është dashur të përballen. Kultura shoqëria, mënyra e të jetuarit kanë ndryshuar dhe këto, kanë bërë të mundur që edhe gjuha e tyre të pësojë ndryshime, vetëmse, ndryshimet në gjuhë ndodhin më ngadalë dhe janë më pak të dukshme.*Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaj thekson se ndryshimi gjuhësor është i perceptueshëm si hyrje e elementeve të reja, që përmbajnë kalimin e gjuhës nga disa karakteristika në disa të tjera.*[11] *Nga studimet e bëra rezulton se ndryshimet në nivelin e morfosintaksës dhe të fonologjisë janë më të ngadalshme dhe më të graduale se ato të nivelit leksikor që siç e kemi parë janë më të dukshme.*[12] **Ndryshimin gjuhësor të të shpërngulurve në do ta shohim në rrafshin leksikor, në ligjërimin bisedimor dhe frazeologjinë e kësaj të folmeje.Ajo në të cilën do të ndeshemi menjëherë, që në intervistat dhe anketat e para, është bilingiuzmi dialektor.**

Bilinguizmi dialektor

Të shpërngulurit Muhurrakë janë gjetur përballë një mozaiku shumëngjyrësh të folmesh: së folurit të Durrësit, të folmeve të të ardhurve të tjerë nga Berati, Korça, Kruja dhe Standardit, apo gjuhës së shtetit siç quhet ndryshe. Një nga pyetjet e anketës drejtuar të shpëngulurve ishte: - *nëse do të duhej të ndryshoje të folmentënde, cilën do të flisje më*

[9] Beci, Bahri, *Dialektologjia shqiptare II*, ASH, 1974, f. 223.
[10] Beci, Bahri, Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre, Dituria, 2002, f. 17.
[11] Shkurtaj Gjovalin, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2005, f. 133.
[12] Po aty, f. 134.

me kënaqësi, të folmen e Durrësit apo variantin standardose gjuhën e shtetit? Pothuajse të gjithë të anketuarit janë përgjigjur se *para një ndryshimi të tillë, do të zgjidhnin variantin standard të gjuhës.* Të ardhur tashmë në një qytet si Durrësi dhe rrethinat e tij me një kulturë dhe nivel ekonomik shumë më të lartë sesa vendi ku ata jetonin më parë dhe me një gjuhë shumë pranë gjuhës standarde, ua do puna të përdorin gjuhën letrare zyrtare. *Në mjedise, shtresa dhe madje, individë të ndryshëm ndikimi dhe realizimi pratik i gjuhës letrareshfaqet nëforma të ndryshme.*[13]Ndryshimin gjuhësor, ndikimin e gjuhës letrare tek të shpëngulurit muhurrakë dhe risitë që shfaqen para tyre ne do t'i shohim të lidhura ngushtë me:**Ndarjen moshore.**Sipas grupmoshave duke i grupuar folësit në tri grupe: brezi i vjetër, brezi i mesëm dhe brezi i ri. Lidhur me këtë Jorgji Gjinari shkruan: *Veprimi i gjuhës letrare mbi dialektet nuk është i njëjtë në në shtresa të të ndryshme shoqërore të populllsisë* së*një vendi: ndryshe vepron ajo në brezin e vjetër e ndryshe në brezin e ri, ndryshe në njerzit e arsimuar e ndryshe në ata pa arsim, ndryshe në ata që lëvizin dhe janë në kontakt me botën.*[14]

Brezi i vjetër janë të shpërngulurit e fashës moshore postaktive mbi: 65 vjet. Këta të shpëngulur kanë ndryshuar vetëm pozicionin gjeografik dhe klimatik. Nga një vend malor kanë ardhur në një vend bregdetar. Në pozitat e gjyshërve të shtëpisë, ato nderohen e respektohen në krye të vendit. Për vetë moshën që kanë, nuk janë në marrëdhënie pune, ndaj kalojnë kohën me bashkëmoshatarë po të krahinës së tyre, ose duke rritur nipër e mbesa në kushtet e shtëpisë.Niveli i tyre i shkollimit nuk është i lartë. Në vendin e tyre ata kanë qenë bujq, blegtorë apo ndërtues të mirë. Interesi i tyre për t'ju afruar gjuhës letrare ka qenëi pakët, madje në këtë pikë, ata bëhen edhe më nostalgjikë duke ruajtur me fanatizëm të folmen dhe zakonet e tyre.

Në një nga familjet në të cilat shkova për intervistë, gjyshi i shtëpisë më priti duke më pyetur: - *Të je sugjarja e shpais*?Buzëqesha dhe me një lëvizje të kokës i dhashë të kuptoj se unë isha vajza më e vogël në familjen time. Në ato momente m'u kujtua shprehja e Atë Justin Rrotës dhe vizioni i i tij i shëndoshë për dygjuhësinë dialektore, sipas së cilit, *folësi duhet të jetë i aftë me e dredhë gjuhën në dialekt dhe anasjelltas, për të folur në gjuhën letrare kur e lyp nevoja*[15]

Një nga karakteristikat e brezit të vjetër është e ashtëquajtura Alegori Dibrane. *Të folurit alegorik në Dibër eshtë një veçori e dialektit lokal, një stil i vecantë, i figurshëm i gjuhës popullore. Baza e kësaj specifike janë të ashtuquajturat mesele, tregimet alegorike ose të sajuara, që pas paraqitjes së drejtëpërdrejtë fshehin kuptimin domethenës.Një nga vlerat e alegorisë është se ajo ka shërbyer si rregullator ne jetën e njerzve, ka ndikuar pozitivisht në mardhëniet ndërmjet tyre.*Autori Sakip Cani në dy librat e tij:*Rrëfime popullore dibrane* (2006) dhe *Dibra*

[13] Shkurtaj, Gjovalin, *Sociolinguistika*, Toena, 2005, f. 136.
[14] Po aty
[15] Shkurtaj Gjovalin, *Sociolinguistikë e shqipes*, Morava, 2009, f. 30.

nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit" (2010), ka sjellë bujarinë e dibranëve, autoritetin moral e shpirtëror, traditën e mikëpritjes, por dhe zgjuarsinë, inteligjencën dhe mençurinë e tyre nëpër shekuj. E ka bërë këtë, duke qëmtuar e hulumtuar nëpër dasma e morte, në kuvende, në ceremoni fejesash e lindjesh, ku shpaloset mençuria e famshme, po dhe ajo që quhet *alegoria dibrane. Sipas etnologut të njohur Mark Tirta, është mjaft domethënëse formula e mirënjohur e proverbiale që thotë se "Mendja", "Urtia" ka le në Dibër…*[16]

Brezi i mesëm janë të shpëngulurit e moshës ekonomikisht aktive 20- 64 vjet.Brez ky që e ndjen më shumë trysninë e ndryshimit gjuhësor. Ky brez duhet të zgjedhë *gjuhën e bukës apo gjuhën e shtetit* dhe të përdorë në mjedise më intime *të folmen e zemrës.* Duke qenë në marrëdhënie pune, tek ky brez kanë ndodhur edhe ndryshime që i përkasin profesionit të tyre. Shumë prej të anketuarve janë përgjigjur se kanë pasur një tjetër profesion para se të vinin në Durrës. Kryesisht kanë qenë bujq, blegtorë apo ndërtues, ndërsa në Durrës iu është dashur që në shumë raste të ushtrojnë tregtinë për të siguruar jetesën.

Ndryshimi i profesioneve sjell krijimin e termave dhe teknika të reja, përdorimi i të cilave do të çojë në zbehjen e termave të vjetra deri në mënjanimin e tyre. Psh: një grua që punonte në bujqësi e niste ditën me *fjalët, shat, lopatë, mbjellje, farë*; ndërsa në Durrës, ajo ka filluar punë në rrobaqepësi. Ka krijuar të tjera marrëdhënie shoqërore, ka ndryshuar edhe bashkësinë shoqërore edhe klasën e saj. Një i shpërngulur me profesion ndërtues, ka punuar dhe ka hapur një pikë tregtimi të veglave të ndërtimit duke u bërë i kamur. Ai ka ndryshuar edhe bashkësinë shoqërore dhe klasën e tij.

Durrësi është një krahinë bregdetare ndaj shumë ardhës i janë drejtuar punës në peshkim ku do të përballen me një sërë fjalësh të reja *si ba:rk; lundër; fullu:g (10-15 m e gjatë shërben për të mbajtur gurë), sanall (barkë e vogël me rrema); daname(anije e vogël)apo emra peshqish si qefull, levrek, bërbu, pullum etj.*[17]Ardhësit që punojnë në bujqësi edhe në Durrës, do të përballen edhe me disa emra fiqsh si *shja, cin, rrotllar* etj.

Ka nga ata që nuk e kanë ndërruar profesionin, por gjithsesi mbeten të hapur ndaj ndryshimeve për faktin e të qenit bashkëkohorë në profesion. Brezi i mesëm është i interesuar më shumë t'i afrohet standardit, pasi ia kërkon puna. Por me gjithë përpjekjet, përsëri vihen re ngjyrimet dialektore të cilat nuk i shpëtojnë as edhe një bashkëbiseduesi të thjeshtë, i cili nuk mund t'i rezistojë pyetjes:- *nga vjen*? Një pyetje kaq e zakonshme në kohën e një lëvizshmërie shoqërore si kjo e jona.

16 http://www.arkivalajmeve.com/Filozofia-popullore-dibrane-ne-rrefimet-e-Sakip-Camit.1047087651 (parë për herë të fundit datë 07.08.2016).

17 Beci, Bahri, *Dialektologjia shqiptare VI*, ASH, 1990, f. 320.

Ruajtja e këtyre ngjyrimeve dialektore ndodh *sepse nuk ka variacion gjuhësor krejt të lirë. Secili varietet ligjërimor, në çdo rast e rrethanë, është pjesë e sjelljes shoqërore dhe si i tillë, do të jetë përherë ilidhur dhe i markuar nga pikëpamja shoqërore.*[18]

Për konkretizim po sjellim një pjesë nga intervista me Hasime Çikun, vendlindja: Shqath (Muhurr), ditëlindja: 20.08.1969, larguar nga Muhurri me familjen e saj 18 vite më parë.Gjatë intervistës me Hasimen, ajo thotë se *është në gjendje të flaës edhe gjuhën letrare, por pa vetëdije,në punë e sipër, më vjen më natyrshëm të flas të folmen e Muhurrit.*

Shqethi asht' nj katun i vogël i rrethum në tri anët me mal. Këtë vend dilli nuk e shef gjismën e ditës, por prap se prap asht' nji vend shum prodhus. Jeta në këtë fshat asht' disi e fshtir sepse ka problem me rrugjen, nuk kalojn kurr maqina. Edhe ato pak njerz që kan met aqe po vujn edhe sot e ksaj dite. Ata jetojn me ato prodhime bujqsore dhe me gjat e gjella si dhajt e dhent. Ndër prodhimet më të zakonshme që përdoren jan gjiz, tlin, qumsht, kos ene tamel. Me punt e shpajs merren gret, me punt e krahut ma shumë merren burrat po ne gret i fajsin në kshu punsh. Jeta aqe asht' shum e vështir dhe sdo kthehesha t'jetoja aqe për niqind vjet. Bujqsia dhe bagtia jan e vetmja menir me jetu aqe. Edhe shkolla asht cop-cop.Veq nji shkoll fillore ekziston aqe gja tjetër nuk ka. Venin tim e du se aqe kam lind po s'kam shum kujtime të majra aqe. Edhe ato di rraqe që vishja i kam pas me pakic ndërsa set kam nji jet shum të majr e të qet.

Ndryshimi gjuhësor dhe gjinia

Tek ardhësit, vëmë re që përsa i përket afrimit të tyre me variantin standard, ka diferencë midis burrave dhe grave. Gruaja nga natyra, është më e lidhur me vatrën, gatimet, veshjet, dasmat, vajtimet, këngët e djepit e përkëdhelitë e fëmijëve. Pjesa më e madhe e grave të ardhura, të shkëputura nga Muhurri, edhe pse janë në moshë pune, bëjnë shtëpiaket, duke u marrë me atë pak kopsht që kanë në oborr, me fëmijët dhe gatimet tradicionale. Ato kanë ndryshuar bashkësinë shoqërore por, kanë mbetur disi të veçuara dhe pak në kontakt me jetën e qytetit të Durrësit. Ndodh e kundërta me gratë që punojnë, sidomos në qytetin e Durrësit. Tek ato, ngjyrat dialektore në të folur janë më pak të gjalla dhe shumë fjalë në leksikun e tyre, janë zëvendësuar me ato të gjuhës standarde.

Le të sjellim disa shembuj të mbledhur nga intervistat me ardhësët gra:

Fjalë përkëdhelëse: **Gjeli(**djali) i nans (d> gj; a>e; bjerrja e ë-së mes dy bashtingëlloreve);

deshi i nans(a>e); **florini i nans** (; pllumi i nans (rënia e ë-së mes dy bashtingëlloresh dhe mb > m);

Saj ziu i nans(y>a);

[18] Shkurtaj, Gjovalin, *Sociolinguistikë e shqipes*, Morava, 2009, f. 59.

Lum nana për gjelin; dallnajsha(dallëndyshe) e nans;menarja(e mençura) e nans;e hishmja e nans

Këngë djepi:

Luli luli nana geli
gjelin ta përkuni, gjelin ta përkuni
o gjelin t'ma zan gjumi.
O mor gjum o gjum i amel si përshesh me tamel.
Luli luli gjelin tem, rrajtu vrajk t'qojm n'mal me dhen.

Karakteristikë në të folmen e grave janë edhe eufemizmat e shumta. Ja disa shembuj të tyre:

T'rrajt zoti- të raft e mira! O zot o gjeli i nans u bafsh mret! O zot oj bija e nans t'bafsha nuse! T'mort dita e dill!

Këngë dasmash:

Kur bëjnë një mik të mirë, i këndohet nuses kështu:

I kërkova Reç e Dardh,

gjeta nj'majk me façe t'berdh, (rënia e ë-së tek numërori; i> aj; q>ç (façe); a>e (berdh -bardh)

majku jën pilef orizi, (o>ë tek përemri pronor jën- jonë (; a>e (pilef- pilaf)

për kurgja nuk na bezdisi, **(ë**>a kurrgja-kurgjë)

s'na bezdisi e sna tha gja(ë >a gja- gjë)

veq çish deshëm me i dhan na.(**ç**>q (veq-veç); (çish- çfarë); ë>a (dhan- dhënë); e>a (na-ne)

Nëse nusja që merrnin ishte e dobët dhe nuk u pëlqente i këndonin kështu kur vinte:

Paske hangër hajrrën e dhajve, (hangër- ngrënë)

*t'paskan ra vallet e sajve,(*ra-rënë;) y> aj sajve-syve

paske hangër shllajn t'ftoft, (bjerrja e ë-së mes sh-së dhe ll-së, i>a, r>n shllajn-shëllirë); h>f, rënia e ë-së fundore (ftoft- ftohtë(

qanke ba si mac e coft.(ë>a qanke-qenke); (rënia e e-së fundore mac-mace); (ur>t coft-cofur)

Përsa i përket burrave ata krijojnë më shpejt marrëdhënie në grupin e ri shoqëror ku tanimë bëjnë pjesë. Si kryetarë të familjes, ngarkuar me përgjegjësi, ata janë në kontakte të vazhdueshme pune në qytet. Shumë prej tyre, duke qenë ndërtues të mirë, plotësojnë nevojat e familjeve në qytetin e Durrësit dhe janë në kontakt të ngushtë me mënyrën e tyre të jetesës. Megjithatë, afrimi me standardin është edhe individual. Ai ndryshon edhe nga një person në një tjetër dhe është çështje zgjedhjeje.

Në intervista, disa ardhës janë përgjigjur se pavarësisht se kanë ardhur në Durrës, atyre iu pëlqen të flasin të folmen e tyre. *Si t'foli hooll si t' foli trash*, - thotë njëri prej tyre, *unë arrij të merrem vesh me njerëzit dhe të punoj.*

Brezi i ri

Në kërkimet e shkallëzuara moshore rreth ndryshimit gjuhësor, i është dhënë rëndësi ligjërimit të brezit të ri,*sepse atje shfaqen "filizat" e prirjeve të rrafshimeve të mëtejshme gjuhësore nën ndikimin e arsimit, kulturës shoqërore dhe të sistemit të gjuhës standarde*,[19] - thekson Shkurtaj. Pjestarët e brezit të ri duhen parë e studiuar në marrëdhëniet e tyre në:

- *sferën familjare:* Së pari, varet sa pranë gjuhës letrare janë prindërit, si pikë referimi për fëmijët. Nëse fëmija do të rritet me nënën në shtëpi, pa frekuentuar çerdhe, kopësht e parashkollor, deri sa të futet në shkollë ai do të jetë nën ndikimin e fuqishëm të së folmes dialektore.
- *sferën shkollore, sferën shoqërore komunikimi me shokë e moshatarë:*Mësues të ciklit fillor, në intervistat e tyre kanë pohuar se *Ardhësit, nxënës të ciklit fillor kanë një të folme me ngjyra të gjalla dialektore dhe kjo jo vetëm në të folur, por edhe në shkruar.Gjithsesi ata arrinë të komunikojnë fare mirë me anëtarët e tjerë të grupit shoqëror dhe nuk izolohen.Janë të zgjuar dhe të përkushtuar.*[20]

Me kalimin e tyre në ciklin 9-vjeçar dhe atë të mesëm, nën shembullin e moshatarëve, ata janë të prirur t'i afrohen më shumë variantit standard. Deri tani janë bërë shumë studime për dygjuhësinë ku ajo është konsideruar si një avantazh, një palestër për trurin. Së fundmi Napoleon Katsos, një studiues në Universitetin e Kembrixhit, dhe kolegët e tij në Universitetin e Qipros, kanë bërë një studim për efektet e biblinguizmit dialektor.*Një 'surprizë të vogël,* - shkruan Katsos në revistën amerikane Kuarc*, - fëmijët shumëgjuhësh dhe ata bi-dialektor kanë treguar një avantazh mbi ata njëgjuhësh, kujtesë më të mirë, vëmendje dhe fleksibilitet.*[21]

Kur flasim për bashkëjetesë varietetesh dhe ndryshim gjuhësor, duhet të marrim parasysh edhe **Sferën fetare**: Toleranca dhe mirëkuptimi i dibranëve, i ka rrënjët thellë në historinë dhe organizimin e brendshëm të vetë Dibrës, në mënyrën e administrimit të këtyre trevave, zakoneve, mikpritjes e bujarisë, në odat dibrane. Populsia e Dibrës është përgjithësisht e besimit mysliman dhe një pakicë e besimit të krishterë e ritit katolik e ortodoks. Rreth 97% e popullsisë së Dibrës është e besimit

[19] Shkurtaj,Gjovalin, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2005, f. 139.
[20] Nga intervistat me mësuesen e ciklit fillor, G. Hoxhallari dhe atë të ciklit 9-vjeçar Merita Thartori.
[21]http://www.repubblica.it/scienze/2016/06/09/news/cervello_parlare_i_dialetti_lo_allena_al_pari_del_bilinguismo-14149082.

Islam, e ky besim ka ndikuar ndjeshëm me përmbajtjen e tij paqësore e tolerante. Për sa u përket besimeve në Dibër, ato kanë një të vërtetë të shkëlqyer sepse ato kurrë s'patën vëllavrasje fetare. Për këtë ndërgjegje të lartë mirëkuptimi e tolerance fetare, rrallë se gjen rreth tjetër në Shqipëri si Dibra. *Besimi në Dibër e sidomos ai Islam, detyron vëllazërimin fetar, por ndalon kategorikisht urrejtjen, grindjen, luftën me njerëz të besimeve të tjera dhe përqafon tolerancën në drejtim të tyre. Për sa i përket raportit të besimeve të tjera me atë Islam të shpërndarë në Dibër është ky: në Herbel ka 5-6 familje ortodokse dhe ato të ardhur, në Kërçisht të Epërm 7-10 familje ortodokse dhe shumë pak ortodoks në qytetin e Peshkopisë*.Por toleranca dhe bashkëjetesa e paqtë fetare nuk është karakteristikë vetëm për dibranët. Edhe Durrsakët janë mjaft tolerant në këtë pikë. Myslimanë, ortodoksë e katolikë, jetojnë në paqe të plotë me njëri- tjetrin.Në një intervistë me bashkëshortët Hidri: historiani Sali Hidri shprehet: **-** *Në familjen tonë kurrë nuk është përmendur emri jabanxhi. Dibranët kanë qenë gjithmonë njerëz të nderuar dhe zanatalinj***.** Durrësi si qytet, gjithmonë ka qenë mikpritës dhe tolerant, por ashtu siç ka qenë tolerant, ashtu ka përfshirë brenda tij, ardhësit. E ka bërë këtë si ato valët e lehta përfshijnë bregun, duke e bërë pjesë të tyre.

Martesat: Gjatë këtyre 25 viteve bashkëjetesë sigurisht që janë kombinuar edhe shumë martesa midis vendasve (durrsakë) dhe ardhësve (dibranë - muhurrakë). Përzierja fillon që në ceremonialet e dasmave ku secili dasmor kërkon këngët e krahinës së tij. Këngë karakteristike durrsake si*: "Vika deti oj tallaz-tallaze"; "Për midis pazarit t'Durrsit" janë tepër të njohura.* Në dasma gratë eftuara i këndonin bukurisë së nuses me vargje*: "Ulu mal-o, të dali hona"etj.*[22] Ndërsa në Dibër, bukurisë së nuses i këndojnë kështu:

O moj nushe oj kojdoshe, qanke di pllam përmaj shoqe.
O moj nuse na patën than shtat jët nj' pëllam,
o shiqir që na doli meraku, shtati jët si shtat bajraku.

Në intervistat e bëra me katër çifte bashkëshortësh durrsakë-dibranë, është vënë re se:*në rastet kur bashkëshortja është vendase, bashkëshorti i është afruar më shumë gjuhës letrare, ndërsa kur bashkëshortja është e ardhur, ajo tenton të ruajë për një kohë më të gjatë ngjyrat dielektore të së folmes së saj.* Gjithashtu ajo sjell me vete edhe një sërë fjalësh të sferës së guzhinës dhe të ushqimit. Kjo sferë në vetvete është shumë ruajtëse pasi lidhet me gatimet tradizionale(përmendim këtu jufkat e famshme, byrekun dhe bukën në saç etj.).

Emrat e farefisnisë dhetë marrëdhënieve familjare në të folmen e Muhurrit: *Emrat e farefisnisë dhe përgjithsisht familjarë kanë qenë mbështjellë gjithmonë me një tis*, *eufemizmi. Në Malësi dhe në trevat qendrore të Shqipërisë, burri dhe gruaja nuk e zinin në gojë*

[22] Sula, Ali,*Reminniscenze Durazzine,* Acustica, 1991, pp 93.

emrin e njëri-tjetrit,por e zëvendësonin atë me përemrat: ti, ajo. Ai nieri, ajo gruaja, rahmetliu, ky, kjo.[23] -shprehet Shkurtaj

Në dibër thuhet se "grueja vitin e parë të martesës i thotë burrit ***ki(ky),*** *pasi kalojnë dy vjet e thërret* ***ai****, ndërsa në pleqëri e thërret* ***stërgjish***[24]**.**

Gjatë intervistave, gratë shpreheshin: - *Prit se tani vjen aj* (bashkëshortin).Ose: - *Ku është nana* ***jëte****?- A paska erdh* ***mixha*** *jët?* Në familjen e origjinës së nënës time, nusen e djalit të shtëpisë të gjithë e thërrisnin **Nousja e Faliut (nusja e Faliut).** Më këtë emër ajo hyri në këtë familje dhe kështu u thirr deri sa ndërroi jetë në Tiranë, dy vite më parë.

Shpesh herë kur duan të shprehin marrëdhënie të afërta e plot dashuri: **po t'kam naip (**të kam **nip), hajde njer ke daxha jët (eja njëherë tek daja jot, bija e shpais (bija e shpais) etj.** Këta lloj emrash farefisnorë, ende ruhen në marrëdhëniet familjare të ardhësve duke sjellë pak konfuzion tek ata që frekuentojnë pasi tek vendasit, (durrsakët) çdo njeri identifikohet me emrin e tij personal.

Për të treguar banorët e një vendi emrave të vendeve u shtohen nyja e përparme i, e dhe prapashtesat on, an**: i dibron, i murrak, i manjon, vajzë e Çeke (vajzë e fisit Çiku).**

Si Përfundim: Gjatë bashkëjetesës së dy varianteve të dialektit gegë: të folmes së Durrësit, përfaqësuese tipike të gegërishtes jugperëndimore dhe të folmes së Muhurrit, pjesë e gegërishtes qendrore do të ketë prioritet, e folmja qëështë më pranë standardit dhe sigurist vetë standardi. Ndryshimi gjuhësor tek ardhësit është i ngadaltë dhe më i dukshëm në fushën leksikore. Afrimi i ardhësve me gjuhën standarde duhet parë i lidhur ngushtë me: moshën, formimin dhe kulturën, profesionin dhe gjininë. Në rastin e lëvizjeve demografike, folësi duke u shpëngulur gjeografikisht është vendosur në territore që nga ana gjuhësore janë më pranë gjuhës standarde duke e kryer tanimë komunikimin e tij në rrethana më të ngritura nga ana shoqërore dhe kulturore. Si rrjedhim, ai vetëzgjedh dhe parapëlqen fjalët që e afrojnë atë me gjuhën standarte.

Folësi i dialektit, për shkak të trysnisë së vashdueshme të gjuhës letrare nëpërmjet shkollës, shoqërisë, formave të informimit publik etj., heq dorë ose lë prapa njësi dialektore dhe përvetëson ato të gjuhës letrare, pra sistemi dialektor vetë nuk shndërrohet, ai vjetërohet dhe kalon në shtresën pasive.[25] Pra për ndryshimin gjuhësor të tij folësi është i vetëdijshëm dhe zgjedh në përputhje me situatën dhe kushtet, duke përzgjedhur gjithmonë ato që për atë, janë më të favorshmet.

[23] Shkurtaj, Gjovalin, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2005, f. 296-297.
[24] Po aty.
[25] Thomai, Jani, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme, ASH, Tiranë, 2001, f. 83.*

Burimet

Beci, Bahri, *Dialektologjia shqiptare VI*, ASH, 1990, f. 320.

Beci, Bahri, *Dialektologjia shqiptare II*, ASH, 1974, f. 223.

Beci, Bahri., *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre*, Dituria, 2002, f. 17.

Çeliku, Mehmet, *Dialektologjia shqiptare VI,* ASH, 1990, f. 288.

Çeliku, Mehmet, *Dialektologjia shqiptare VI,* ASH, 1990, f. 325.

Çeliku, Mehmet, *Dialektologjia shqiptare VI,* ASH, 1990, f.286.

Doda, Sami, *Dritë diturie në Muhurr*, Botimet M&B, Tiranë, 2014, f. 15.

Nga intervistat me mësuesen e ciklit fillor, G. Hoxhallari dhe atë të ciklit 9-vjeçar Merita Thartori.

Shkurtaj, Gjovalin *Sociolinguistika*, Toena, 2005, f. 136.

Shkurtaj, Gjovalin, *Sociolinguistikë e shqipes*, Morava, 2009, f. 59.

Shkurtaj, Gjovalin, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2005, f. 133.

Shkurtaj, Gjovalin, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2005, f. 139.

Shkurtaj, Gjovalin, *Sociolinguistika*, Toena, Tiranë, 2005, f. 296-297.

Shkurtaj, Gjovalin, *Sociolinguistikë e shqipes*, Morava, 2009, f. 30.

Thomai, Jani, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme,*ASH, Tiranë, 2001, f. 83.

Thomai, Jani, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme, ASH,* Tiranë, *2001, f. 74.*

Tirta, Mark, *Lëvizje migruese të Shqiptarëve të brendshme e në popujt më afër*, ASH, Tiranë 2013, f. 155.

Xaxa, Ilir & Shuka, Anesti,*Vështrim gjeografiko – ekonimik,* Globus.R.,2004, f. 6

http://durres.gov.al/images/pdf/buletini_2014.pdf (parë për herë të fundit 31.07. 2016).

http://www.arkivalajmeve.com/Filozofia-popullore-dibrane-ne-rrefimet-e-Sakip Camit.1047087651(parë për herë të fundit datë 07.08.2016).

Teuta DHIMA

THE COEXISTENCE OF ALBANIAN VARIETIES DURING THE MIGRATION MOVEMENTS OF THE POPULATION WITHIN THE COUNTRY. THE CASE OF THE VERBS OF MUHURRI OF DIBRA AND THE VERBS OF THE CITY OF DURRËS AND ITS SUBURBS

Abstract

The migratory movements of the population within the country after the 1990s have brought about the proximity of the population from different geographical areas of the country. The purpose of my paper is to note the changes that occur as a result of linguistic coexistence between geographical varieties. What happens to these language varieties when geography borders are deleted and the population coexist as a result of migration flows within the country?

My origin from Muhurri of Dibra, as well as contact with the arriving from this area in the city where I live in Durres, made me excuse to write this paper which will be based mainly on the sociolinguistic level (interrelations between speech and society). These individuals, part of their families, with the separation from the province, have carried with them their linguistic features, wardrobe, habits, and lifestyle. In addition to geographic shift, they are already part of a new social community, they have also faced the changing role in the social community and often of the social class. Because different social groups use different varieties, language and society relationships have changed. The displaced families have found support from each other and are close to their neighbors, not completely weakening the ties with the province from these families being displaced.

Methods used: Interviewing a qualitative method was conducted with residents of the village of Muhurr, who now live in Durrës and the surrounding area as well as residents of Durres.

Survey Method: The survey contains some questions that bring information about the year of displacement, age, and language behavior of these individuals.

Key words: Muhurr-Peshkopi, migration, Albanian language, sociolinguistics, dialects.

Vaide KQIKU-HOXHA

LEKSIKU I SHQIPES LETRARE TË SHEKUJVE XV-XVII

Ky studim mëton hulumtimin e leksikut të shqipes letrare të shekujve XV-XVII. Si një nga mëtimet kryesore të këtij punimi është pasqyrimi i lidhjes së fjalorit të shqipes së sotme me atë të shekujve XV-XVII, për krijimin e një fjalësi të shqipes sipas materialit të dokumentuar. Korpusi përbëhet nga **11991** fjalë, të vjela nga leksiku i autorëve të vjetër. Nga 11991 fjalë 5932 ose 49% janë pjesë e fjalorëve të sotëm, ndërsa 6059 ose 51% nuk përdoren më ose kanë pësuar ndryshime grafike – tingullore. Korpusi ka shërbyer të evidencojmë përdorimin e parë të fjalëve sipas autorëve të vjetër, duke regjistruar fjalët e para shqipe të dokumentuara. Hulumtimi i leksikut të shqipes letrare të këtyre shekujve shërben edhe si korpus për regjistrimin e parë leksikor të shqipes, duke mundësuar shënimin e burimit të përdorimit të parë të njësive leksikore në fjalorët e sotëm. Fjalori themelor i gjuhës shqipe është mirë i dokumentuar, pasi dëshmia më e mirë e dokumentimit të fjalorit themelor janë autorët e letërsisë së vjetër. Shkrimet dhe veprat e tyre dhanë kontribut për krijimin e një fjalori themelor të gjuhës shqipe. Ky kontribut do të lidhej me krijimin e një fjalësi, në të cilin do të shënohej edhe përdorimi i parë i fjalës nga autorët. Ka rëndësi të madhe për t'u studiuar leksiku i shqipes letrare të shekujve XV-XVII, sepse tregon gjendjen e shqipes në shekujt XV-XVII dhe mundëson trajtimin diakronik të shqipes, si një pikë e lidhjes mes së sotmes dhe së shkuarës si dhe regjistrimin e këtij leksiku historik të gjuhës shqipe. Leksikun e shqipes letrare e ka shqyrtuar dhe trajtuar thelbësisht Kolë Ashta, i cili e ka nxjerrë leksikun e plotë në aspektin strukturor dhe funksional. Ai e studioi jetën dhe veprën e tyre në mënyrë të thukët dhe nga këndvështrimi i tij, përveç të tjerash, bëri përpjekje për studime të anës letrare të veprës, solli në pah disa veçori dalluese të gjuhës së tyre. Vepra e Kolë Ashtës do të jetë gjithmonë pikë e referimit për studim (hulumtim) që do të bëhet për dokumentet e para shqipe, përkatësisht leksikun. Kontribut dhanë edhe studiues të tjerë shqiptarë dhe të huaj, si: N. Resuli, E. Çabej, N. Jokli, S. Riza, M. Camaj, V. Fidler, E. Lafe, S. Mansaku, R. Ismajli etj. Në këtë hulumtim synojmë që të regjistrojmë fjalën e parë, duke filluar nga dokumentet e para të shqipes. "Formula e pagëzimit", Pal Engjëlli 1462, "Fjalorth..." Arnold von Harff 1492, "Perikopeja ungjillore" në përkthimin shqip, (shek. XV ose fillimi i shek. XVI). "Meshari" i Gjon Buzukut, 1555, Lekë Matrënga 1592, Pjetër Budi 1618-1622,

Pjetër Mazreku 1633, Frang Bardhi 1635, Pjetër Bogdani 1685 etj. Leksiku i autorëve të vjetër pasqyron leksikun e kohës, kur janë krijuar. Në organizmin e leksikut të tyre ka edhe fjalë të huazuara nga gjuhët e ndryshme: greqishtja, latinishtja, italishtja, sllavishtja, turqishtja.

"Formula e pagëzimit" (1462) e shkruar latinisht e shqip nga Pal Engjëlli është kjo, së cilës po i shtojmë edhe transkriptimin:[1] Teksti latinisht i Pal Engjëllit:"*Ego te Baptizo in nomine Patris es filij spiritus Sancti"* Teksti shqip i Pal Engjëllit*:"vnt" paghesont premenit Atit et birit et spertit senit".* Transkriptimi:"*Un të pagëzonjt premënit (të) Atit e t Birit e t Shpertit shenjt*". Nga ky fragment mund të vërtetojmë qartë mënyrën, si shkruhej shqipja atëherë; d.m.th. se ishte krejt sipas alfabetit latin. Fragmenti është i përbërë nga nëntë fjalë. 1.atit, 2. birit, 3. emër, 4. pagëzoj, 5. në, 6. shenjtë, 7. shpirtit, 8. të, 9. unë.



Leksiku i Von Harffi (1492) ka gjithsejt 67 fjalë, 6 ose 10% prej tyre janë fjalë që nuk përdoren më, si: fjalën **mirenstrasse dhe myreprama**, (mirëprama) për fjalën mirëmbrëma**, go-(njëmijë)** për fjalën njëmijë. Ndërsa, 60 fjalë ose 90% janë format e ruajtura si: **kjo, krypë, pulë, mirë, kafshë** etj. Fjalët e mbledhura prej Von Harffit i përkasin një përdorimi praktik për t`u marrë vesh për nevojat e para të udhëtimit. Fjalët e tij kanë të bëjnë me sferën e ushqimit, në radhë të parë, të pijes, fjetjes, të blerjes, përshëndetjes dhe e pyetjes për të kërkuar diçka etj. Von Harffi përdori për herë të prë fjalët si: **mish, djathë, peshk, pesë, shtatë,** etj. Harffi është autori i parë i përdorimit të këtyre fjalëve. Në vazhdë të punimit do të sjellim leksikun e plotë të Von Harffit sipas radhës alfabetike.

"Perikopeja ungjillore" nga fundi i shekullit XV ose nga fillimi i shekulli XVI

Ky dokument i shqipes ka gjashtë radhë të shkruara greqisht, por me luhatje formash, të meta ortogarfike e pasiguri në përdorimin e theksave, e ndonjë fjale i

[1] Ashta, Kolë, "*Leksiku historik i gjuhës shqipe"* vëllimi I, Shkodër, 2002, fq 34

ndahen rrokjet. "*Perikopeja ungjillore*" e përkthyer shqip: ka gjithsej 100 fjalë, 58 ose 58 % prej tyre janë fjalë që përdoren edhe sot, ndërsa 42 ose 42% nuk përdoren më. Format e ruajtura janë si: **dhuruar, gur, pasur, natë, ngjallur, etj.** Fjalët që nuk përdoren si: **kustodhi/a –kujdes/roje, etj.** Perikopeja ungjillit përdori për herë të parë fjalët si: **ata, ditë, natë, gur, kujtuar, pjekur** etj. Në vazhdë të punimit do të sjellim leksikun e plotë të "Perikopesë ungjillore" sipas radhës alfabetike.

"Meshari" i Gjon Buzukut (1555) dhe leksiku i tij

Si vepër e parë shqipe e njohur, "Meshari" ka rëndësi të madhe për historinë e kulturës, në mënyrë të veçantë për historinë e shqipes së shkruar dhe të letërsisë shqiptare. Është dëshmi e shqipes në shek. XVI, në një fazë kur nuk ishte zhvilluar ende një pjesë e dallimeve dialektore të mëvonshme. Me gjuhën në një masë të mirë të standardizuar e të kodifikuar, si koine letrare që u ngjit e u zhvillua me veprat e autorëve të Veriut në shekujt XVI - XVIII, vepra e Gjon Buzukut hapi një etapë të re në lëvrimin e shqipes si gjuhë e shkruar kulture. *"Meshari"* ka rëndësi gjuhësore, sepse na jep një pasqyrë të nivelit gjuhësor të kohës kur është shkruar. Në "Meshar" numri i përgjithshëm i fjalëve është 2672, prej tyre 700 fjalë ose 26% kanë ruajtur formën, 1232 ose 46% kanë ndryshuar formën, 524 ose 20% prej tyre nuk përdoren më dhe 31 ose 1% kanë ndryshim kuptimi. Format e ruajtura janë si: **ambël, autore, baltë, katund, human, kujdes** etj. Fjalët qe nuk përdoren më janë si: **enmbrama, fshamë, manzi, mënerë** etj. Buzuku përdori pë herë të parë fjalët si: **aromë, apetit, bagëti, balsam, hangër, tridhjetë, besë ngadhnjim, etj.**

Lekë Matrënga (1592) dhe leksiku i tij

Vepra e Matrëngës është e botuar më 1592.Vepra e Lekë Matrëngës njihet si: "**E mbsueme e chraesterae**" (*E mbsueme e krështerë).* Leksiku i Matrëngës ka 428 fjalë, 178 ose 42 % janë fjalë që nuk përdoren si: **vuli –qellim greq. jatri** etj., ndërsa 250 ose 58% janë forma të ruajtura si: **botë, detyrë, lot, meshë, mos, etj**. Matrënga përdori për herë të parë fjalët si: **burrë, bekim, faqe** etj.

Pjetër Budi (1618-1622) dhe leksiku i tij

Leksiku i Pjetër Budit, është i përafërt me leskikun e autorëve të tjerë. Te këta autorë hasim huazime nga gjuha latine, italiane, dhe më pak huazime nga turqishtja dhe sllavishtja. Leksiku i Pjetër Budit përbëhet nga 2450 fjalë, 834 ose 25% janë fjalë

që nuk përdoren më si: **fëdigë, remorë,** etj., ndërsa 1616 ose 75% janë forma të ruajtura si: **frikë, bukur, fjetunë, drita** etj**.** Budi përdori për herë të parë fjalët si: **mend, vertyt,** etj.

Pjetër Mazreku (1633) dhe leksiku i tij

Leksiku i Mazrekut është i huazuar nga gjuha latine dhe italiane, por i përdorshëm edhe sot. Leksikun e tij e përbëjnë 32 fjalë. Prej tyre 19 ose 59% janë fjalë që përdoren edhe sot, ndërsa 13 ose 41% prej tyre nuk përdorem më. Fjalët që përdoren si: **kangë, lepur(ë), bukë etj.** dhe që nuk përdoren: **fagje/ja ital. faccia, pellag/u ital. (lesh),** etj.

Frang Bardhi dhe leksiku i tij " Fjalori latinisht-shqip" *(1635)*

Leksiku i Bardhit ka gjithsej 2492 fjalë në pjesën shqipe, duke hequr huazimet, mendojmë se pasuria vendëse arrin mbi 1300 fjalë. Në aspektin e grafisë kishte vazhduar segmentin e Budit. Në fjalorin latinisht shqip gjejmë disa fjalë që ndoshta sot na duken si forma të reja si: **këshilltar, kërkues etj.** Bardhi përdori për herë të parë fjalët si: **gjukata (gjykata), qet (ë),** etj.

Pjetër Bogdani (1685) dhe leksiku i tij

Leksiku i Pjetër Bogdanit përbëhet nga 4170 fjalë, 2620 ose 63%, janë forma të ruajtura si: **bjeshkë, bletë, festë, kafshë, mik**, etj. 1282 ose 31% kanë ndryshuar format si: **bashkuem, idhultari/a,** etj., forma që nuk përdoren më janë 124 ose 3% si: **hadum, fosë,** etj. dhe 144 ose 3% janë forma të tjera. Bogdani përdori për herë të parë fjalët si: **bilbil, mite etj**.

Leksiku i Von Harffit (1462)

1. a-pj. pyetëse[2].
2. ai- përem.
3. ardhunë-fol.
4. "meretzewen" (mirë se vjen).
5. ashtu-shtu, ndajf.
6. blem-fol.

[2] Ashta, Kolë, "*Leksiku historik i gjuhës shqipe"* vëllimi I, Shkodër, 2002, fq 61

7. bukë/a-em.
8.dashunë, i-mb.
9. denar/i – denar, em.
10. djathë(ë)-i, mb,
11. dreq/i-em.
12. dy-num.
13. dhjetë-num.
14. elbë/i-em.
15. fjetunë,i-mb.
16. grou/a,-grua-em.
17. gja/ja-gjëkafshë-em.
18. gjashtë-num.
19. jo-pj.
20. kafshë/a-em.
21. kale/i-em.
22. kater-num.
23. këmishë/a.
24. kështu-shtu-ndajf.
25. kjo-pj.
26. krishti-em.
27. krypë/a-em.
28. ky-kjo-përem.
29. lam.
30. mbrama-prama,-em.
31. me-pj.
32. mijë-num.
33. mirë,(i) – mirë,i-mb.
34. "mirenstrasse"
35. mishë/i-(mischc)-em.
36. nandë-num.
37. neshtrashë/a-em.
38. ngranë-fol.
39. nier-njeri,-em.
40. një-num.
41. go-(njëmijë)-num.
42. njëmijë-num.
43. njëqint-num.

44. njeqint-num.
45. pasunë-fol.
46. pesë-num.
47. peshk/u-em.[3].
48. pine/pi-fol.
49. prama/e mbrama.
50. pulë/a-em.
51. qint-num.
52. qiri/u-em.
53. qish-përem.
54. ri (i)., mb.
55. se.
56. shtatë-num.
57. shtu-pjes.
58. tavernë. Ital-em.
59. tetë –num.
60. të-pjes.
61. tri-num.
62. ujë/i-em.
63. uthëll/a-em.
64. venë/a-em.
65.vëljyem-fol.
66. vij-ardhunë-fol.
67. voe/ja-em

Leksiku i Perikopesë së Ungjillit (XV-XVI)

1. ai=e, oi=i janë nyje e greqishtes.
2. albanitikon-arvanitikón,-em.
3. alvanitikón-arvanitikón.
4. arvanitikón-allvanitikon.
5. ashtu-ndajf.
6. ata, përem.
7. ditë/a, em.
8. dhuruar-Greqisht[4]. dhóron

[3] Po aty, fq 64
[4] Ashta, Kolë, "*Leksiku historik i gjuhës shqipe"* vëllimi IV, Shkodër, 2002, fq 96

9. e- edhe, lidh.
10. edhe, lidh.
11. evan (gjel)-i-e.
12. është (klenë)
13. farisáioi. Greq.
14. farisej/të. Greq.
15.farisè/u. Greq.
16. gur/i, em.
17. gjall(ë).
18. gjell/i. Lat. Qiell.
19. gjellsi-gjiell/i, em.
20. gjiellshi-gjiell/i,-em.
21. gjithë-përem.
22. i-nyje.
23. ishtë-klenë?
24. (j)an(ë)-klenë?.
25. kejni-pasurë.
26. keni-pasurë.
27. keq-kejq.
28. klenë-ishin.
29. krishti.
30. kujtuar.
31. kur.
32 kustodhi/a-kujdes roje.
33. laus-llausi
34. llausi.
35. ma-më e –ndajf.
36. madh,i-mb.
37. matheu.Greq.
38. mathitia.
39. mathite-dishepull.
40. mathitis.
41. mbëledhur.
42. mbëljedhur.
43. mbillur.
44. me-parafj.
45. më parafj.

46.mort/ja.Latinisht. mort.
47. mos-ndajf.
48. natë/a,em.
49. ndrit-dritë/a,em.
50. nesër, ndajf.
51.ngrehur-ngritur.
52. ngjallur.
53. ntit-ditë
54. nun/i-Greq.
55. o- nyje.
56. para-ndajf.
57. pasur.
58. pat-pasur.
59. përierë-fol.
60. pilat-Greq.
61. piqej-në-pjekur.
62. pjekur.
63. pllan.
64. pra.
65. prapa.
66. prej.
67. prempte/ja,e- e premte.
68. prë-parafj.
69. pri-parafj.
70. priftëri/a.
71. prirë.
72. qenë-klenë
73. që-përem. lidhor.
74. se.
75. së-nyje e përparme.
76. sfragjisur-Greq.sfragizo
77. shintë-shenjt.
78. shkelur.
89. shum-ndaj.
80. ta-parafj.
81. të-është nyje
82. të-pj.

83. tit-ditë/a
84. tre-num.[5]
85. tha-fol.
86. thanë-fol.
87. thonë.
88. u- është shkurtim i përemrit.
89. ungjill-greqisht[6].
90. urdhëruar.
91. vajtur-fol.
92. var/i.
93. var(r)i,vorri-em.
94. votur-vajtur.
95. vdekur,i-mb.
96. venë- me kuptim shkojnë.
97. rrjedhur.
98. vjet/i-em.
99. vojtun-vajtur.
100.zot/i-em

Përfundim

Tekstet e këtyre autorëve të vjetër janë me interes për studime dhe hulumtime, pasi pasqyrojnë realitetin gjuhësor të shqipes në shekujt XV-XVII, etj. Dallimet mes leksikut të autorëve të vjetër nuk janë edhe aq të theksuara, por megjithatë kanë dallime. Këto vepra, këto fraza, këta fjalorë, fjalorth të hershëm janë thesari më i çmuar i gjuhës, i shkrimit, i artit, kulturës shqiptare. Leksiku i Pal Engjëllit përbëhet nga një frazë, leksiku i Von Harffit përbëhet nga 67 fjalë, leksiku i Perikopesë Ungjillore përbëhet nga 100 fjalë, leksiku i "Mesharit" të Gjon Buzukut përbëhet nga 2672 fjalë, leksiku i Pjetër Budit përbëhet nga 2450 fjalë, leskiku i Frang Bardhit përbëhet nga 2492 fjalë, kurse fjalori i tij përmban 5000 fjalë, leksiku i Pjetër Mazrekut përbëhet nga 32 fjalë, leksiku i Pjetër Bogdanit përbëhet nga 4170. **Shembuj krahasues të fjalëve të regjitruara sipas periudhës:** Ndajfoljen ***ashtu*** – për herë të parë e ka përdorur Harffi, pastaj Perikopeja Ungjillit, Buzuku, Matrënga, Budi, Bardhi dhe Bogdani, emri **bukë** u përdor nga Von Harffi, Buzuku, Matrënga, Mazreku dhe Bogdani, përem. **ajo** u përdor nga Buzuku, Matrënga, Budi, Bogdani, Bardhi, ndërsa **ai**

[5] Ashta, Kolë, "*Leksiku historik i gjuhës shqipe"* vëllimi I, Shkodër, 2002, fq 102
[6] Ashta, Kolë,*"Leksiku historik i gjuhës shqipe"* vëllimi IV, Shkodër, 2002, fq 106

e përdori Von Harfi, Perikopeja (anonimi), Buzuku, Matrënga dhe Budi. Fjalori themelor i gjuhës shqipe është mirë i dokumentuar, pasi dëshmia më e mirë e dokumentimit të fjalorit themelor janë autorët e letërsisë së vjetër, por edhe autorët e mëvonshëm. Shkrimet dhe veprat e autorëve të vjetër dhanë kontribut për krijimin e një fjalori themelor të gjuhës shqipe. "Meshari" i Gjon Buzukut 1555 është vepra e parë e shkruar e gjuhës shqipe, për të vazhduar më pas me shkrimet dhe veprat e autorëve si Lekë Matrënga, Pjetër Budi, Pjetër Mazreku, Frang Bardhi, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani që dhanë kontribut për një fjalor themelor të gjuhës shqipe të dokumentuar historikisht. Autorët e vjetër nuk kanë dallime të theksuara leskikore, që të gjithë autorët kanë huazuar fjalë nga gjuhët: latine, italiane, greke, sllave, turke, gjuhët biblike, gjithashtu kanë huazuar apo kanë shkruar në alfabetet e gjuhëve të sipërpërmendura. Dallimi leksiko-fonetik mes të autorëve është diftongu **uo** që e përdor Buzuku, Von Harffi, Budi. Bogdani e përdor diftongun **ue** dhe Matrënga **ua.** Shembuj: Harffi vetëm në një rast e përdor diftongun ***uo*** te fjala *groua.* Gjon Buzuku përdorte diftongun ***uo,*** si, p.sh: *besuom, ngalkuom,* Bogdani diftongun ***ue*** si, p.sh: *ndivënuem, përluftuem*[7]*, përvëluem*, etj. Bardhi në leksikun e tij përdor diftongun **ue,** si, p.sh**:** arëtuem, cbuluem, bubulluem, dimënuem, dishkuem etj. Matrënga në ndërtimin e leksikut të tij përdor diftongun **ua** si, p.sh: agjëruarë, bëkuam, gjumuarë, paguajturë, zbuam, zhbuam, dbuam, shpejtuarë, urdhëruarë. Në vazhdën e punimit do të sjellim shtojcën e leksikut të plotë të Von Harffit dhe Perikopeja Ungjillillit të sistemuara me renditje alfabetike, qw është regjistri i parë i fjalës shqipe.

Literatura

Ashta, Kolë, *Leksiku Historik i Gjuhës Shqipe vëllim. I-VI, Universiteti i Shkodrës, Sektori Shkencor i Albanologjisë,"Luigj Gurakuqi"* Shkodër, *2000.*

Ajeti, Idriz, *Pjetër Bogdani, në Jeta e Re,* Prishtinë, *1951.*

Bariç, Henrik, *Hymje në historinë e gjuhës shqipe, Shtëpia Botuese "Mustafa Bakija",* Prishtinë, 1955.

Bogdani, Pjetër, *Çeta e profetëve, I-II, Shtëpia Botuese* "Drita", Prizren, 1997.

Bokshi, Besim, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes,* Prishtinë, 2005.

Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1988.

Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore, vëllimet I-IX,* Prishtinë, 1986.

Elementet e gjuhësisë e të literaturës shqipe, Tiranë, 1936.

Çabej, Eqrem, *Disa faza më të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje*, në '*Studime rreth historisë së gjuhë shqipe'*, Tiranë. 1973.

[7] Po aty, fq 303

Çeliku, Mehemet,*Pjetër Bogdani- patriot dhe autor i rëndësishëm i letërsisë shqipe të shek. XVII, në Bashkimi*, Tiranë, 1962.

Ducrot, Oswald – Tzvetan Todorov, *Dictionnaire encyclopedique des sciences dulangage*, Seuil, Paris, 1972.**Gjini, Niko,** *Fjalor shqip-greqisht,* Tiranë, 1971.

Hudson, A. Richard, *Siciolinguistika, Prishtinë, 2002.*

Ismajli, Rexhep, *Tekste të vjetra,* "Dukagjini", Pejë, 200.

Gjuhë dhe etni "Rilindja", Prishtinë, 1991.

Shenjë dhe ide, Rilindja, Prishtinë, 1974.

Shumësia e tekstit, Rilindja, Prishtinë, 1980.

Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706), Rilindja, Prishtinë, 1985.

Standarte dhe identitete, Dukagjini, Pejë, 2003.

Mulaku, Ragip, *Sistemi foljor në gjuhën e shkrimtarëve të vjetër verior*, Prishtinë, 1987.

Nuhiu, Veseli, *Ndikimet ndërgjuhësore*, Prishtinë, 1990.

Riza, Selman, *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe,* Toena, Tiranë, 2002.

Rrota, Justin, *Latratyra shqype,* Shkodër, 1925.

Gjuha e shkrume ase dhe vërejtje gramatikore, Shkodër, 2006.

Rrahmani, Zejnullah, *Letërsia e mesjetës*, Faik Konica, Prishtinë, 2002.

Sedaj, Engjëll, *Pjetër Bogdani, Çeta e profetëve I,* Prishtinë, 1982.

Shuteriqi, Dhimitër, *Shkrimet shqipe 1332-1850*, Rilindja, Prishtinë, 1978.

Autorë dhe tekste, Tiranë, 1977.

Historia e letërsisë shqipe, për shkollat e mesme, Prishtinë.

Shkrimet shqipe 1332-1850, Tiranë, 1976.

Thomai, Jani, *Leksikogjia e gjuhës shqipe,* SHBLU, Tiranë, 2002.

Teksti dhe gjuha, 1992.

Leksikolgjia e gjuhës shqipe, "Toena", Tiranë, 2006.

Vaide KQIKU-HOXHA

THE LEXIS OF LITERARY ALBANIAN OF THE XVI - XVIII CENTURIES

Abstract

This study focuses on the research of the lexis of the official Albanian language of the centuries XVI-XVIII. One of the main goals of this paper is to compare today's Albanian vocabulary with that of the XVI-XVIII centuries, in order to create a dictionary as product deriving from the documented material. This contribution

would be linked to the creation of a dictionary which enlist the initial use of words. It is of crucial importance to study the lexis of the official Albanian language of the XVI-XVIII centuries because it shed light on the state of Albanian language in the XVI-XVIII centuries and makes it possible to deal with the language from a diachronic point of view, serves as a link between the past and the present and documents the historical lexis of the Albanian language. The lexis of the old authors is, among other things, a document of the official Albanian language in different periods of time in history, which provides documented material that would create a historical dictionary of the Albanian language. Besides the importance of studying the linguistic language of the Albanian language of the centuries XVI-XVIII, the research of the official Albanian lexis of c. XVI-XVIII also serves as a corpus for the first lexical documentation of the Albanian language, thus marking the source of the first use of lexical units in today's dictionaries. Nevertheless, taking into consideration the lexical and phonetical changes that may have occur in a period of more than 450 years.

Key words: lexis, literary Albanian, diachrony, old literature, centuries, words.

Nertila KËLLIÇI-GOGA

NDIHMESA E GJUHËTARIT POLAK JAN HANUSZ NË HISTORINË E ALBANOLOGJISË

Jan Hanusz, jeta dhe studimet universitare

Jan Hanusz-i lindi në vitin 1858 në një fshat të Galicisë lindore në Poloni dhe vdiq më 26 korrik 1887 në Paris. Studimet e mesme i kreu me rezultate të shkëlqyera, dhe po kështu, studimet e larta në Universitetin e Krakovit (1877-1881), në Fakultetin e Filozofisë, ku iu kushtua veçanërisht shkencave filologjike. Doktor në filozofi, Jan Hanusz-i studioi të gjitha gjuhët indoeuropiane, por ishte i interesuar veçanërisht për gjuhët më pak të njohura, ndër to dhe gjuhën shqipe. Ai mësoi të fliste rrjedhshëm shqipen[1]. Hanusz-i kreu studime të tjera për gramatikën e krahasuar të gjuhëve indoeuropiane në Universitetin e Berlinit, e më pas dha mësim si Profesor në Universitetin e Vjenës. Në fillim të vitit 1887 shkoi në Francë, Angli dhe Itali. Mblodhi tregime e përralla të ndryshme dhe studioi të folmet e arbëreshëve të vendosur në Italinë e Jugut. Udhëtoi fshat më fshat, studioi të folmet shqiptare dhe mblodhi rrëfenja e këngë popullore. Prej këtej lindi shkrimi "*Shqipja në Pulja*" ("*L'albanais en Apulie*"), të botuar në frëngjisht në revistën "Studime të Shoqërisë së Gjuhësisë së Parisit" VI[2], në vitin 1888, në Paris, f. 263-267.

San Marzano di San Giuseppe dhe e folmja e saj

Cili është ky vendbanim i arbëreshëve që tërhoqi në mënyrë të veçantë vëmendjen e Hanusz-it?

Në këndvështrimin etnokulturor, San Marzano është sot një fshat me rreth 10 mijë banorë në provincën e Tarantos në Pulja, komuniteti i të cilit gjendet në formën e një ishulli etnik në lidhje me pjesën tjetër të kësaj province joniane, pasi vijon të ruajë zakonet dhe kulturën e vendit të origjinës, sidomos të folmen arbëreshe. Ndryshe nga

[1] Remzi Përnaska, "Jan Hanusz-i, indoeuropianist dhe albanolog", 'Shejzat', 2016, n° 1-2, f. 109-118.

[2] "Mémoires de la Société de Linguistique de Paris", 1888, f. 263-267.

shumë ngulime të tjera shqiptare, ku gjuha shqipe është bjerrë, arbëreshët e San Marzano-s vazhdojnë të përdorin gjuhën e tyre amtare.

Profesori i gjuhës, fonetikës dhe dialektologjisë arbëreshe dhe shqiptare, Giovanni Belluscio, së bashku me kolegen e tij, Monica Genesin, në studimin mbi të folmen e San Marzano-s, "*La varietà arbëreshe di San Marzano di San Giuseppe*"[3], vënë në dukje se larmia e këtij fshati arbëresh, është sot e vetmja dëshmi gjuhësore ende e gjallë e një ishulli me një gjuhë tjetër në Puglia, ndërsa në vende të tjera, gjendja e ruajtjes së gjuhës duket se është më komplekse dhe më në rrezik. Kjo e folme, sikurse dhe llojet e tjera të diasporës së Italisë së Jugut, bën pjesë në grupin e dialektit tosk, duke paraqitur karakteristika të shumta të përbashkëta, veçanërisht me dialektet shqiptare të zonave të skajshme jugore[4].

Në San Marzano, arbëreshët kanë asimiluar plotësisht ritmin, ndonëse shprehen në gjuhën shqipe. Gjuha arbëreshë është kryesisht një gjuhë e folur. Gjuha e shkruar nuk ka qenë shumë e përhapur dhe ende sot është e kufizuar me botime të veçanta kulturore. Ajo është pasuruar me fjalë të reja italiane, të panjohura në gjuhën shqipe. Ka nga këto fjalë që sot konsiderohen pjesë e gjuhës së "vërtetë" arbëreshe[5].

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, duke iu referuar shkrimit të gjuhëtarit polak "Shqipja në Pulja", San Marzano ndodhej rreth 20 kilometra nga Taranto, dhe ishte i vetmi vendbanim shqiptarësh në Pulje, ku të gjithë flisnin ende shqip. Hanusz-i shprehte keqardhjen që në fshatrat e tjerë pranë tij, edhe këta me origjinë shqiptare, nuk flitej më shqip, por vetëm italisht. Po këtë gjendje të gjuhës shqipe tregonte në atë kohë edhe princi Louis-Lucien Bonaparte, në studimin e tij "*Shqipja në Tokën e Otrantos*" ("*Albanian in Terra d'Otranto*"), të publikuar në *"Ndërveprimet e Shoqërisë Filologjike"* ("Transactions of the Philological Society"), në Londër, në nëntor 1884, f. 492-501. Ai shprehej se shqipja flitej ende më shumë se italishtja vetëm në San Marzano di S. Giuseppe, disi më pak në gjashtë fshatrat e tjerë të dioqezës së Tarantos.

Studimi "Shqipja në Pulja" i Jan Hanusz-it

Pas udhëtimeve dhe hulumtimeve nga afër që kishte bërë në pjesën më të madhe të vendbanimeve shqiptare në Italinë jugore, Hanusz-i shkruajti dhe botoi studimin e tij, ku, që në krye vë në dukje, se qëllimi kryesor ishte paraqitja e disa

[3] Giovanni Belluscio, Monica Genesin, "La varietà arbëreshe di San Marzano di San Giuseppe", L'IDOMENEO, 2015, n. 19, f. 221-243.
[4] Po aty, fq. 222.
[5] Carmine de Padova, "San Marzano di S. Giuseppe: Storia, tradizioni, folklore dell'unico paese albanese di Puglia", 1998, f. 89.

shënimeve që do të shërbenin "*për të plotësuar, pjesërisht për të korrigjuar materialet e publikuara nga princi Bonaparte*"[6].

Hanusz-i renditi disa prej veçorive fonetike më tipike që karakterizonin të folmen e San Marzano-s gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX, si vijon:

1- Bashkëtingëllorja fërkimore (frikative) ndërdhëmbore ***dh***[7] është zëvendësuar në fillim të fjalëve nga bashkëtingëllorja ***t***, në brendësi dhe në fund të fjalëve nga bashkëtingëllorja ***d***; psh: a) ***t****ē* (dhè), ***t****ęmb* (dhëmb), ***t****ęndr* (dhëndër); në të folme të tjera: ***δ****ē, **δ**ęmb, **δ**ęndr*; - b) *dàr**d**-a* (dardha), *ū**d*** (udhë), *ma**d*** (madh), *bar**d*** (bardhë), dhe gjetkë: *dàr**δ**-a, ū**δ**, ma**δ**, bar**δ***.[8]

2- Bashkëtingëllorja e zëshme **g**[9] është zëvendësuar në fillim të fjalëve, ashtu si në shumë të folme të tjera, nga ***h*** (më rrallë nga ***f***), (në brendësi dhe në fund të fjalëve nga **g**; p.sh.: a) ***h****ōr* (qytet), ***h****ęn* (hënë), ***h****èkur* (hekur), *u **h****āń* (unë ha), ***h****ap* (hap), ***h****īr* (hyr); në shumë fshatra të Kalabrisë[10]: ***γ****ōr, **γ**ęnęz, **γ**èkur, u **γ**ā, **γ**ap! **γ**īr!*, por ***γ****ùnd* (hundë), ***γ****ùδęr* (hudhër), shqiptohen në San Marzano: ***f****und, **f**ùdęr;* gjetkë: ***h****und,**h**ùδęr*; b) *ù šò**g*** (unë sho**h**), *ju nì**g**ni* (ju dini); gjetkë: *ù šòγ*, *šò**χ***[11], *šò**h**, šō*; apo: ***ju nìγni, nìhni***.

3- Bashkëtingëllorja e shurdhër ndërdhëmbore ***th***[12] është shpesh e zëvendësuar nga ***h*** apo ***f***; p.sh.: *u **h****om* (unë them, flas), ***h****ik* dhe ***f****ik* (thikë), në shumë fshatra të Kalabrisë: *u **ϑ****om*, ***ϑ****ik*, po kështu në rajonet e

---

[6] Jan Hanusz, "L'albanais en Apulie", 1888, Paris, f. 264.

[7] Autori e ka shënuar grafikisht sipas alfabetit të greqishtes /***δ***/

[8] Që në vëzhgimet e para të Bonaparte-it, vërehet shndërrimi i ***δ***-së në **t**, po kështu edhe tek Hanusz-i, si psh. tek fjala ***matə*** - ma**dh**. Tek Bonaparte-i vërehet gjithashtu shndërrimi i ***δ***-së në **d**, apo i **d**-së në **t**: *bar**də*** (*bar**dh**ë*), Spirti Šén**di**di = shë(n)j**ti**t. Ndryshe nga të folme të tjera arbëreshe, në të cilat vihen re bashkëtingëlloret e pazëshme në fund të fjalës, në të folmen e San Marzano-s, një fenomen i tillë duket i panjohur.

Studiuesit e spikatur të të folmes arbëreshe, Giovanni Belluscio dhe Monica Genesin, në studimin e tyre mbi të folmen e San Marzano-s: "La varietà arbëreshe di San Marzano di San Giuseppe", L'IDOMENEO, 2015, n. 19, f. 221-243, tek të folmet rastësore të regjistruara prej tyre gjatë vitit 2014, vërejnë se: "*Ndryshe nga të folme të tjera arbëreshe në të cilat ndeshet një pazëshmëri (thuajse) e rregullt e bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës, në të folmen e San Marzano-s, një fenomen i tillë është i panjohur, edhe sepse pjesërisht pengohet nga ndërfutja e elementëve vokalë*". Profesor Belluscio shprehet se pajtohet plotësisht me gjuhëtarin italian të gjuhësisë së përgjithshme, Leonardo M. Savoia "*kur e konsideron një fenomen të tillë si një proces të ndryshueshëm që varet nga 'stile të shqiptimit dhe faktorë të jashtëm gjuhësorë*'".

[9] Autori e ka shënuar grafikisht sipas alfabetit të greqishtes /***γ***/

[10] Autori përmend këtu fshatrat e vizituara prej tij, si: St-Sophia d'Epiro (Shën Sofia në të folurën arbëreshe), St-Demetrio Corone (Shën Mitri në të folurën arbëreshe), Cosmo-Strigàr (Strigàri në të folurën arbëreshe, San Cuòsimu në të folurën kalabreze), Macchia, Vacarizzo, etj.

[11] Fonema e greqishtes ***χ*** = në shqip i korrespondon ***h***

[12] Autori e ka shënuar grafikisht sipas alfabetit të greqishtes /***ϑ***/

Basilicata-s dhe Molise-s; ***ϑ****rròn* (stol), *ù****ϑ****ul* (uthull), *gì****ϑ*** (gjithë), *bà****ϑ*** (bathë); por, tek princi Bonaparte, lexojmë: ***f****inja* (thonja), *ba****f*** (bathë)[13].

4- Grupet fonetike ***pj, bj, fj*** bëhen, si në shumë të folme të tjer*a*: ***plj, blj, flj;*** p.sh: ***plj****òt* (plot), *u* ***blj****èń* (unë blej), u **flj**eń (unë fle); po kështu në Basilikata dhe në fshatrat kufitare të Kalabrisë, Civita, Plataci, Farneta dhe Castroreggio; dhe gjetkë në Kalabri: ***pj****òt, u* ***bj****èń, u* ***fj****ō*ⁿ. *"Natyrisht, grupi* ***lj*** *duhet të shihet si një* ***l*** *qiellzore*" - thotë Hanusz-i. Një nga dukuritë karakteristike të të folmes së San Marzano-s dhe përgjithësisht të të folmeve të tjera arbëreshe është mënyra e nyjëtimit të fonemës ***l***, e cila realizohet në mjaft raste si qiellzore anësore[14]. Nyjëzimi i saj është afërsisht si grupi i italishtes **gl**: **lj**u:g, i **lj**ig, **ulj**emi, etj.

5- Grupet fonetike ***kj, gj*** bëhen ***klj, glj***, p.sh: ***klj****ûš* (kishë), *u* ***klj****èva* (unë isha), ***glj****ûšt* (gisht), ***glj****ùg* (gjuhë); në shumicën e vendbanimeve të Kalabrisë: ***kj****ûš, u* ***kj****èva,* ***gj****ûšt,* ***gj****ùg. "Përveç kësaj, bëhet fjalë këtu për fshatrat e përmendura më lart, në Basilicata dhe në Molise, ashtu si në San Marzano. Me thënë të drejtën, ne nuk kemi këtu grupe fonetike* ***kj****,* ***gj****, por vetëm qiellzoret (palatalet)* ***ḱ****,* ***ǵ***" - thekson Hanusz-i[15].

6- Mes *m-r* shfaqet zakonisht një ***b*** e fshehur, p.sh: *èm****b****r* (emër), *zèm****b****r* (zemër); në të folme të tjera: *èmr*, *zèmr*.

Hanusz-it i tërhoqi vemendjen edhe formimi i numëroreve, duke vënë në dukje se, duke filluar nga numri 30, ata formohen me numërorin *dhjetë*: 30, *tre-****djèt***; 40, *kater-****djèt***; 50, *pes-****djèt****;* 60, *ǵašt-****djèt****,* etj. Në të folme të tjera, dhjetat që janë teke formohen me numërorin "dhjetë", ndërsa dhjetat që janë çift formohen me numërorin "njëzet": 30, *tre-****djèt****;* 40, *di-****zèt****;* 50, *pes-djèt* ose *dizèt-djèt;* 60, *tri****zèt****,* etj.

[13] Tek studimi i gjuhëtarëve italianë Giovanni Belluscio dhe Monica Genesin, janë regjistruar rastet: ai tha [ai **h**a], më kanë thënë [mkaⁿ·əˈ**h**ən:ə], thom [**h**əm], kam thënë u [kam **h**əˈn:u], thotë se [**h**ɔt ə ʂɛ], por tek grupi i fjalëve "thonë gjithë" del me **θ = th** [θə nə ɟiθ:]. Është e nevojshme të sillet në vëmendje se në shkrimin e parë "Shqipja në Tokën e Otrantos", të vitit 1884, Bonaparte paraqiti rastet e përdorimit të bashkëtingëllores **f** në vend të **th**-së: **f**inja (**th**onja) dhe ba**f** (ba**th**), të cilat u korrigjuan në shkrimin tjetër të tij të vitit 1890: bat**th**, git**th**ə, etj; dhe këtyre fjalëve ai u shtoi dhe të tjera: **f**unjə (**h**unj), **f**und (**h**undë), ma**f**iér (ma**h**jere)-thikë.

[14] Gjovani Shkurtaj, "Ligjërimet arbëreshe", 'Gjuha e bukës' dhe 'gjuha e zemrës'", Shqyrtime dalektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë, Tiranë, 2006.

[15] Jan Hanusz, "L'albanais en Apulie", 1888, Paris, f. 265.

Gjithashtu, Hanusz-i bëri një paraqitje të leksikut të San Marzano-s, ashtu siç e kishte prekur vetë në terren: "*në një formë pak të ndryshme nga ajo e dhënë nga princi Bonaparte"* - tek kënga: *'Romanca e të Fejuarve' ('Romance of the Betrothed')*"[16].

Rreth fjalëve të izoluara të shqipes "Isolated Albanian Words " të Bonaparte-it, Hanusz-i theksoi se i kishte dëgjuar si vijon: *Bekùami* (Krishti, "le Christ[17]"), si: "***bénit***"; *Bekùamja* (Shën Mëria, "Notre Dame"), si "***bénite***"; fjalën *brem* (mbrëmë "soir",) si "***mbrę̀m****"; kampàra* (këmbanë "cloche") si "***kumbòr****"* ose si "***kęmbòr***"; tek fjala *mma* (mama, "mère"), sipas Hanusz-it, ***m****-ja* e parë jep një rrokje, por më saktësisht duhet të shkruhet "***mę̀ma***"; *Rusja* (e fejuara "la fiancée" është me siguri gabim ortografik, në të shkruar, për të treguar fjalën "***Nusja***"; *zìmbra* do të duhej të shkruhej në mënyrë më të rregullt "***zę̀mbra***". Fjala ***štępija*** duket të jetë fjalë më e vjetër se ***špija***, nisur nga të folme të tjera shqiptare të Italisë jugore. "*Për më tepër, në këtë të folme të San Marzano-s ka më shumë fjalë që përdoren rrallë në të folme të tjera*, p.sh.: ***mafjèrja*** (thikë, "couteau"), që natyrisht vjen nga greqishtja μάχαιρα ; ***u kušiloń*** (unë kështilloj, "je parle"); ***kęšilommi nd gljùg jònni*** (të flasim në gjuhën tonë, "parlons dans notre langue"). *Kjo është arsyeja pse shqiptarët e San Marzano-s mezi e kuptojnë shqipen e Kalabrisë*"[18] – arsyetonte Hanusz-i.

Autori i spikatur polak paraqiti gjithashtu një ***sunèt*** (sonetë, 'sonetto'), ku shprehej se, tek të folmet e tjera e ndeshte këtë fjalë si: *vjèrš* (varg, "verse")[19].

Hanusz-i e mbylli shkrimin duke nënvizuar se për veçanti të tjera të kësaj të folme, por dhe për të folme të tjera, do të botonte, nëpërmjet një studimi gramatikor, një shkrim tjetër tek "*Comptes rendus de l'Académie des Sciences de Cracovie*", ("*Raportet e Akademisë së Shkencave të Krakoviit*"), këtë radhë përmbledhës, për të folmet e ngulimeve arbëreshe në Italinë e Jugut. Por që mund të mos ia ketë arritur dot. Puna e tij shkencore mbeti në mes për shkak të humbjes së jetës në moshë të re nga një

[16] Kënga e plotë arbëreshe e San Marzano-s në variantin e Hanusz-it: *ϑìńa, sè ngę te dèna, e ìši panzàn,/ Kundzędrò ti zę̀mbra ìmę./ Pęrpàra tę škòda ńaj me bùz,/ Kljève pę greštèra, čę ngę te vrèta./ U kàm e ljèn, ku ìše mir dèńa,/ Tę̀ t' màr ti, zę̀mbra ìme./ Nanì prìremi ne dìa, se ne dùgemi,/ Šòkje mę ka tę jèseš, čę dȍ Krìšti.*Në frëngjisht nga Hanusz: *Je simulais que je ne t'aimais pas, et c'était un mensonge,/ Tu as pénétré mon cœur./ Devant toi je marchais un peu fâché,/ C'était pour les homes que je ne t'ai pas regardée./ Je l'ai laissé où il était, l'amour,/ Pour te prendre, ô mon cœur./ Alors tournons-nous tous deux, si nous nous aimons,/ Afin que tu sois ma femme, ce que Dieu veut*. Varianti i Bonaparte-it në të folmen arbëreshe: *Thinja kə u ngə denja, ma iši panzán,/ Ma ti e dinjə pendzierin' immə./ Pərpara tə škoda me buz./ Klevvi pə də krəštératə tšə ngə tə hava mir dit./ Kamə lən kušə denja mirə,/ Də dúa mirə, zenbra immə./ Nani, pierrimi tə duákimi mirə;/ Sə ti šokkja immə ka-tə-jessesə, tšə do I Bekkuámi.*

[17] Hanusz-i ka dhënë kuptimin e fjalës në frëngjisht tek shembujt e marrë në shqyrtim.

[18] Jan Hanusz "L"albanais en Apulie", f. 266

[19] *Dìe mbrę̀mb škòda è ngę tę pȅu,/ E ti bùkęra ìme, nd' argalì,/ Ngà kopanè, č'ìpńe nd' ajò kàš,/ Me škandogše zę̀mbra pę ti.* E përkthyer në frëngjisht: *Hier soir j'ai passé et je ne t'ai pas vue,/ Et toi, ma beauté, au métier à tisser,/ Chaque coup que tu donnais dans cette caisse,/ M'a brisé le cœur pour toi.*

sëmundje e pashërueshme, kur ishte vetëm 29 vjeç. "*Ka shumë mundësi që Hanusz-i të ketë lënë dorëshkrime, ndër to, edhe për të folmet arbëreshe, në formë shënimesh të imtësuara ose edhe dokumentesh të mbledhura në vend. Do të ishte me shumë interes shkencor që të kërkohej nëpër arkiva të Varshavës, Krakovisë, Vjenës, Berlinit etj, që të hulumtohej për të rënë në gjurmë të këtij studimi dhe dorëshkrimeve për arbëreshët*"[20].

Hanusz-i gjykonte se studimet gjuhësore duhet të bazoheshin mbi hetimin e thelluar të dialekteve dhe të folmeve të gjalla, dhe për këtë duhej të mësoheshin sa më shumë gjuhë. Ai shfaqi interes për të gjitha gjuhët indoeuropiane, veçanërisht ato më pak të studiuara, në të cilat bënte pjesë dhe gjuha shqipe, dialektet dhe të folmet e saj. Kjo mund të ketë qenë një nga arsyet kryesore që e çuan atë të zbulonte, studionte dhe mësonte gjuhë shqipe. "*Ai fliste lirshëm lituanisht dhe shqip. Karriera e tij ishte e shkurtër, por e frytshme*" – kështu shkruante, në parathënien e studimit të Hanusz-it, Louis Léger, dijetar francez i gjuhëve sllave dhe qytetërimeve.

Kontributi albanologjik i Louis-Lucien Bonaparte-it dhe interesi shkencor i Jan Hanusz-it për studimin e tij "Shqipja në Tokën e Otrantos"

Louis-Lucien Bonaparte-i ishte nipi i Perandorit të Francës, Napoleon Bonaparte-it. Ai lindi në Angli, jetoi dhe studioi në Itali për kimi. Pasioni për gjuhët e bëri specialist të gjuhëve finlandeze, baske, të dialekteve të anglishtes dhe gjuhëve romane. Pra, megjithëse kishte studiuar shkenca natyrore dhe nuk ishte gjuhëtar profesionist, Princi Bonaparte u mor gjerësisht me studimin e disa gjuhëve, kryesisht në fushën e dialektologjisë. I përkushtuar dhe për gjuhësinë krahasuese, Louis-Lucien Bonaparte-i studioi gjuhët e folura në Itali dhe u ndal në mënyrë të veçantë tek shqipja, të cilën e kategorizoi tek gjuhët ishullore.

Akademiku i shquar, Eqrem Çabej e ka njohur ndihmesën albanologjike të Bonaparte-it, të cilin e ka cituar mëse dhjetë herë në disertacionin "Studime italoshqiptare" ("Italoalbanische Studien") për të folmet italo-shqiptare, të hartuar në gjermanisht në vitet 1932-1933 dhe të mbrojtur në 7 tetor 1933 para një jurie gjuhëtarësh të mëdhenj botërorë si Kretschmer, Patsch e Jokl[21]. Po kështu, ai ka njohur vërejtjet që gjuhëtari Hanuzs i ka bërë botimit të parë të studimit të Bonaparte-it "Shqipja në Tokën e Otrantos", si dhe angazhimin rigoroz të gjeniut polak për të folmet arbëreshe.

[20] Remzi Përnaska, "Jan Hanusz-i, indoeuropianist dhe albanolog", Shejzat, 2016, n° 1-2, f. 118.

[21] Remzi Përnaska, "Jan Hanusz-i, indoeuropianist dhe albanolog", 'Shejzat', 2016, n° 1-2, f. 109-118.

Interesi i veçantë për studimin shkencor mbi të folmet e arbëreshëve të Princit Bonaparte, e nxiti gjuhëtarin polak, Hanusz të paraqiste disa vërejtje ndaj shkrimit të tij. Nëse Hanusz-i kishte qenë në terren, kishte bërë hulumtime dialektologjike në shumicën e ngulimeve arbëreshe të Italisë jugore, Bonaparte-i kishte transkriptuar materialet shqip që i ishin dërguar me korrespondencë, nga drejtshkrimi italian në atë fonetik, dhe kishte zëvendësuar përkthimin italisht me një përkthim në anglisht. Ndoshta, për këtë arsye Bonaparte-i do të shprehej se "*fjalët shfaqeshin në një formë më të prishur se sa fjalët e izoluara të listës*"[22]. Nga ana e tij, Hanusz-i do të vërente se këto "fjalë të izoluara" nuk ishin shkruar gjithmonë saktësisht dhe numri i tyre ishtë shumë i vogël, ato nuk mund të jepnin një ide të qartë të kësaj të folme[23]. Për këtë studim, Bonaparte-i kishte marrë materiale nga autori i mirënjohur i historisë së Tarantos, prifti Domenico Ludovico De Vincentiis, i cili i pati siguruar ato nga një vendas i San Marzano-s. Si rrjedhojë, këta shembuj që përfaqësonin dëshmitë e para nga Bonaparte-i, dhe që i mori me korrespondencë nga prifti Domenico Ludovico De Vincentiis, nuk mund të konsideroheshin shumë të besueshme. Ato ishin: "*një listë me nja dyzet fjalë, tri fjali, një këngë mjaft të shkurtër". "Këto tri dokumente,* - do të pranonte më vonë Bonaparte-i, - *janë qortuar dhe ndryshuar mjaft në botimin e dytë, pas leximit me kujdes të artikullit të shkëlqyer "L'Albanais en Apulie", nga i ndjeri Dr. John Hanusz, botuar në 'Mémoires de la Société de Linguistique de Paris'*". Kështu, gjashtë vite më vonë, në vitin 1891, po në përmbledhjen *Ndërveprimet e Shoqërisë Filologjike*, f. 335 - 376, u botua një tjetër shkrim i Princit Bonaparte me titull "*Shqipja, greqishtja e re, galo-italishtja, provensalishtja, dhe ilirishtja ende në përdorim (në 1889) si ishuj gjuhësorë në krahinat napolitane dhe siciliane të Italisë*"[24]. Ai vlerësoi vërejtjet e bëra nga Hanusz-i, e rimori përmbajtjen e shkrimit të mëparshëm, e hetoi në terren dhe me bashkëpunëtorë të ditur, e korrigjoi dhe e plotësoi më tej. Në këtë studim të dytë, Bonaparte-i dha një listë të gjuhëve që fliteshin në 69 provincat e Italisë, si dhe një material të detajuar me emrat e fshatrave ku shqipja arbëreshe flitej akoma në fundshekullin e 19-të, duke specifikuar se cili dialekt apo e folme përdorej në zona të caktuara. Ai paraqiti gjithashtu një tabelë të simboleve fonetike shqiptare, një minifjalor, të shoqëruar me shpjegime për mënyrën e formimit të gjinisë femërore dhe mashkullore në gjuhën shqipe, disa fraza të njëjta biblike në të gjitha të folmet e marra në studim, etj.

[22] Jan Hanusz, "L'albanais en Apulie", 1888, Paris, f. 265, fjalia në anglisht: "*The phrases appear in a more corrupted form than the isolated ëords of the list*".
[23] Po aty, f.265.
[24] Louis - Lucien Bonaparte, "*Albanian, modern greek, gallo-italic, provencal, and Illyrian still in use (1889) as linguistic islands in the Neapolitan and Sicilian provinces of Italy", "Zeitschrift für Romanische Philologie*", Band 15, 1891, f. 546-550.

Veçori të tjera gjuhësore të të folmeve arbëreshe, kryesisht të të folmes së San Marzano-s në këndvështrimin e Hanusz-it, Bonaparte-it dhe gjuhëtarëve të tjerë

- Inventari fonologjik i kësaj të folme, si dhe i pjesës më të madhe të të folmeve arbëreshe, përbëhet nga gjashtë fonema zanore, dy fonema gjysmëzanore dhe 26 fonema bashkëtingëllore[25].

- Hanusz-i zbuloi dhe transkriptoi raste të gjatësisë vokale: ***tē*** (= dhè), ***ūd*** (udhë), ***hōr*** (qytet), ***u hāń*** (unë ha), ***hīr*** (hyr), etj.

- Në botimin e dytë, Bonaparte-i solli këtë realizim: ***bekkuàmi***, ***bekkuàmia*** (për i bekùari, dhe e bekùara), shembuj që ishin kundërshtuar më parë nga Hanusz-i, i cili kishte regjistruar realizimin origjinal të këtyre fjalëve: ***Bekùami***, ***Bekùmia***. Materialet e mbledhura nga Hanusz-i nuk i kundërvihen në fakt të dhënave të publikuara nga Bonaparte-i në vitin 1884, por atyre të një prifti që nuk ishte arbëresh, as gjuhëtar, dhe mbi të gjitha, pa asnjë njohuri mbi gjuhën shqipe[26].

- Tek të folmet e San Marzano-s është karakteristike reduktimi vokal i /**ë**/-së së patheksuar, kryesisht në mes ose në fund të fjalës; ndërsa në fillim të fjalës, kjo zanore del e theksuar, çka dëshmon përkatësinë e të folmes së San Marzano-s në dialektin e toskërishtes. Profesor Gjovalin Shkurtaj shpjegon se "*Të gjatat, në përgjithësi, dalin në ato pozicione ku në të folmet e gegërishtes ka zgjatim kompensator pas rënies së* ***ë****-së fundore*: mena:të, va:pë, i ho:llë, i njo:më, etj., ndërsa në të folmen e San Marzano-s, *zanorja* ***ë*** *fundore, herë bie, herë ruhet ose dëgjohet e rrëgjuar, ndërsa gjatësia është kudo e pranishme*[27]".

- Në shkrimin e Hanusz-it dhe në botimin e parë të Bonaparte-it të vitit 1884, grafema [**ə**] paraqitet sipas transkriptimit fonetik schwa (shua), ndërsa në botimin e dytë të vitit 1890 të Bonaparte-it, tek disa fjalë të marra si shembull prej tij, vihet re edhe me një formë tjetër përdorimi e grafemës /**ë**/: **njërí** (njeri), **përnakokkə** (kajsi), **glënbə** (gjemb), etj. Mesa duket, ky fakt tregon se Princi Bonaparte ka hasur në atë periudhë në shkrime në gjuhën shqipe, ku përdorej edhe ky variant i dytë i zanores /**ë**/ tek të folmet arbëreshe. Albanologu i njohur, profesori arbëresh, Francesco Altimari, në veprën e tij "Urat e Arbërit", tregon se që nga fillimi i shekullit XVIII, lindi kjo ***grafemë-flamur***, nga Seminari arbëresh i Palermos, i themeluar nga Atë Gjergj Guxeta (Giorgio Guzzeta) më 1734, i cili u bë vatra e parë ideologjike dhe kulturore arbëreshe, që zhvilloi disa tipare alfabetike homogjene, një prej të cilëve ishte

[25] Giovanni Belluscio, Monica Genesin, "*La varietà arbëreshe di San Marzano di San Giuseppe*", L'IDOMENEO, 2015, n. 19, f. 224.
[26] Po aty, f. 231.
[27] Gjovalin Shkurtaj, "*Shënime për të folmen arbëreshe të San Marcanos*", Ligjërimet arbëreshe, Tiranë, 2006, f. 163.

përdorimi i grafemës <***ë***>[28]. Për herë të parë kjo shkronjë u përdor nga Atë Guxeta në veprën e tij mbi historinë civile dhe fetare të arbëreshëve "*De Albanensium Italiæ ritibus excolendis ut sibi totique S. Ecclesiæ prosint*" (rreth periudhës 1730-1756), e më pas nga Imzot Zef Krispi, rektor i Seminarit, nga personaliteti i shquar i kulturës arbëreshe, Nikollë Keta, nga shkrimtari dhe filologu arbëresh De Rada, etj.

Si përfundim, mund të themi se, me këtë punim kemi synuar të paraqesim të plotë analizën gjuhësore të të folmeve arbëreshe të Italisë së Jugut në studimin "Shqipja në Pulja" të gjuhëtarit polak Jan Hanusz, i cili duket të jetë ende pak i njohur e pak i studiuar në mjediset albanologjike. Shkrimi përmban të dhëna të rëndësishme gjuhësore të fonetikës dhe të leksikut të të folmes arbëreshe të San-Marzano-s të fundit të shekullit XIX dhe përfaqëson një përpjekje të rëndësishme të gjuhëtarit të ri polak Jan Hanusz për të nxjerrë në pah vlerat dhe veçantitë gjuhësore të shqipes tek të folmet e arbëreshëve. Përkushtimi i tij shkencor për të bërë vërejtjet e duhura gjuhësore në shkrimin e studiuesit francez, Princit Louis-Lucien Bonaparte, "Shqipja në Tokën e Otrantos", tregon interesin e madh që Hanusz-i po shfaqte për gjuhën shqipe, dialektet dhe të folmet e arbëreshëve.

Kërkimet shkencore të këtij studiuesi të ri e të apasionuar pas gjuhës shqipe, megjithëse figurojnë tani për tani vetëm në këtë botim jo voluminoz, përbëjnë një dokument mjaft të vlefshëm për studime të mëtejshme në fushën e albanologjisë dhe leksikologjisë së shqipes së fundit të shekullit të 19-të, si dhe për të studiuar shqipen e vjetër të mbartur nga arbëreshët në Itali që prej shpërnguljeve të tyre kryesisht në mesjetë nga vitet 1400 e në vazhdim, e të trashëguar brez pas brezi deri tek arbëreshët e 1900-ës.

Bibliografia

Altimari, F., *Urat e Arbërit*, Studime filologjike dhe kritiko-letrare midis botës arbëreshe dhe botës shqiptare, Tiranë, 2015.

Altimari, F., *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*, Prishtinë, 2002.

Belluscio, G., Genesin, M., *La varietà arbëreshe di San Marzano di San Giuseppe*, L'IDOMENEO, 2015, n. 19, f. 221-243.

Bonaparte, L.-L., *Albanian in Terra d'Otranto*, Transactions of the Philological Society, Londres, 1884, f. 692-501.

[28] Francesco Altimari, "*Urat e Arbërit*", Studime filologjike dhe kritiko-letrare midis botës arbëreshe dhe botës shqiptare, Tiranë, 2015, f. 71.

Bonaparte, L.-L., *Linguistic Islands of the Neapolitan and Sicily Provinces of Italy, still existing in 1889,* Hertford 1890.32S. (Aus den Transactions of the Philological Society). Bonaparte, L.-L., *Albanian, modern greek, gallo-italic, provencal, and Illyrian still in use (1889) as linguistic islands in the Neapolitan and Sicilian provinces of Italy*, Zeitschrift für Romanische Philologie, Band 15, 1891, f. 546-550.

De Padova, C., *San Marzano di San Giuseppe: Storia, tradizioni, folklore dell'unico paese albanese di Puglia*, 1998.

Hanusz, J., *L'albanais en Apulie*, Mémoires de la Société de Linguistique de Paris, VI, 1888, f. 263-267.

Meyer, G., Besprechungen, L.L. Bonaparte, *Linguistic Islands of the Neapolitan and Sicily Provinces of Italy,* Zeitschrift für Romanische Philologie, Band 15, 1891, f. 546-550.

Përnaska, R., *Jan Hanusz-i, indoeuropianist dhe albanolog*, Shejzat, 2016, n° 1-2.

Përnaska, R., *Louis-Lucien Bonaparte, gjuhëtar dhe dialektolog krahasues*, Hylli i Dritës, n° 3, 2011.

Savoia, L. M., *La parlata albanese di San Marzano di San Giuseppe: appunti fonologici e morfologici*, Zjarri, 27, 1980, f. 8-26.

Shkurtaj, Gj., *Ligjërimet arbëreshe*, *'Gjuha e bukës' dhe 'gjuha e zemrës'*, Shqyrtime dalektologjike dhe sociolinguistike në ngulimet arbëreshe të Italisë, Tiranë, 2006.

Nertila KËLLIÇI-GOGA

CONTRIBUTION OF THE POLISH LINGUIST JAN HANUSZ IN THE HISTORY OF ALBANOLOGY

Abstract

The paper will give a full presentation of the Polish linguist Jan Hanusz, "L'albanais en Apulie", published in French in the magazine "Mémoires de la société de Linguistique de Paris", VI, 1888, p. 263-267.

In this paper are included important linguistic data of the phonetics and lexicon of the Arbëresh speeches of San-Marzano in Puglia, Italy, in the second half of the XIXth century. According to the author, this was the only Arbëresh settlement, where everyone was still speaking Albanian, while in other surroundings villages, always with Albanian roots, the native language was lost. After dialect researches in locations on most Arbëresh settlements in southern Italy, in a few pages, Hanusz aimed to fill in and correct some language inaccuracies, mostly in phonetics, that he noted in the study of French linguist Louis-Lucien Bonaparte, "Albanian in Terra d'Otranto" (1885).

The paper will aim at identifying and analyzing the phonetic and lexical characteristics of San-Marzano's Arbëresh speeches in the XIXth century, in a comparative overview with the study of Bonaparte linguist. It will be realized through theoretical research, which will be based on the scientific literature of foreign and local scholars for Arbëresh's speeches and the history of the Albanian language.

The study represents an important effort of the author to highlight the Albanian language values and particularities in Arbëresh's speeches; It is a valuable document for further studies in this area, of this young passionate researcher for the Albanian language who could no longer pursue his scientific researches after he passed away at the age of 29.

Key words: phonetics, lexicon, dialect, Arbëresh speeches, albanology.

Lendita KRYEZIU

NDËRRIMI I KODEVE GJUHËSORE NË SHQIP NË RRJETET SOCIALE

Abstrakti

Nëse jeni përdorues aktiv i rrjeteve të ndryshme sociale si: Facebook, Twitter, Instagram, Snapchat, WhatsApp, Viber apo Tumblr, do të keni rastin të shihni se shumë përdorues përdorin gjuhën angleze si medium i shkruar për të shprehur mendimet e tyre, dëshirat, idetë edhe në rastet kur gjuha e tyre amtare nuk është anglishtja.

Ndryshimi i kodeve gjuhësore është përdorimi alternativ i dy gjuhëve në të njejtën shtrirje diskursi nga një folës dygjuhësh (bilingual). Me fjalë të tjera, ndryshimi i kodeve gjuhësore përdoret për të identifikuar alternimet e varieteteve gjuhësore brenda të njejtës bisedë.

Kjo dukuri nuk është e re në Kosovë. Leksiku i gjuhës shqipe për shkak të shumë faktorëve si: pushtimet e shumta, afërsia gjeografike me vendet tjera dhe globalizimi, është pasuruar me fjalë të huazuara nga greqishtja antike dhe moderne, latinishtja, turqishtja, gjuha italiane, gjuhët sllave ballkanike dhe së voni nga anglishtja.

Jo vetëm që janë huazuar fjalët, por shpesh herë folësit e gjuhës shqipe dhe gjuhëve të tjera kanë kaluar nga një kod gjuhësor në tjetrin.

Është një fakt i pamohueshëm që në vitet e fundit anglishtja është bërë një gjuhë globale dhe si e tillë, përdoret rreth e rrotull në botë nga njërëzit profesional dhe akademikë në takimet ndërkombëtare. Anglishtja është një gjuhë zyrtare e kompanive ndërkombëtare, ndërmarrjeve, unioneve dhe konferencave akademike, dhe mbi të gjitha, eshtë gjuhë e internetit.

Sot, ne jemi dëshmitarë të përdorimit të gjerë të rrjeteve sociale të lartëpërmendura nga një pjesë dërrmuese e popullatës, sidomos të rinjëve që kalojnë orë të tëra duke biseduar me shokë dhe kolegë të tyre. Në këto biseda, ata shumë shpesh kalojnë nga një kod gjuhësor në tjetrin. Jo vetëm kjo, por ka edhe raste kur ata postojnë statuset apo komentet e tyre në anglisht. Arsyet që e bëjnë këtë mund të jenë të natyrës së ndryshme: për të kaluar në një kod të gjuhës më prestigjioze, të kuptohen

vetëm nga rrethi i shokëve/ shoqeve, për tu shprehur më lehtë dhe pa ndonjë arsye të veçantë.

Në këtë punim do të hulumtohen dhe analizohen rastet e ndryshimit të kodeve në këto rrjete sociale dhe sidomos në Facebook.

1. Hyrje

Përdorimi i disa kodeve gjuhësore brënda një shtrirje të njëjtë diskursi në të folur nuk është fenomeni i ditëve të fundit. Një fenomen i tillë ka qënë prezent edhe në të kaluaren në Kosovë edhe para zhvillimit të internetit si metodë e re e komunikimt masiv.

Në komunitetet ku janë folur disa gjuhë,në qëndrat ku ka pasur përdorues të gjuhës shqipe, boshnjake, serbe, kroate, maqedonase,turke dhe ku folësit kanë zotëruar të pakten dy apo tri gjuhë, kanë ndodhë shumë shpesh kalime nga njëri kod në kodin tjetër gjuhësor. Këto kalime nga njëri kod në tjetrin janë bëre në diskursin e folur si në nivelin ndër fjalor ose ndërmjet fjalive (inter sentential dhe intra sentential). Rastet më të shpeshta kanë qenë në nivelin strukturor në mes fjalive e jo brenda fjalive.

Me zhvillimin e teknologjisë se komunikimit masiv, internetit, rrjeteve sociale komunikuese, ky ndërrim i kodeve gjuhësore ka filluar të bëhet një dukuri mjaftë e shpeshtë edhe në formën e shkruar, gje që nuk ka qenë prezente me parë.

Ndërrimi i kodeve gjuhësore apo përdorimi i dy apo më shumë gjuhëve ka ndodhur në Kosovë sepse Kosova ka qenë dhe është një shoqëri multietnike që si popullatë ka pasur pjestarë serb, boshnjakë, turq, romë dhe shumë kanë zotëruar dy apo më shumë gjuhë.Dhe kur gjuhët janë në kontakt me njëra tjetren, ato ndikojnë të njëra –tjetra me huazime interferime dhe modifikime.

Në kohën e para dhe pas luftës, për shkak të realitetit të ri socio-politik, gjuha serbe e humbi prestigjin që e pat gëzuar dhe gjeneratat e pasluftës nuk e njihnin këtë gjuhë. Kjo gjuhë u zëvëndësua me gjuhën angleze e cila gëzon një status dhe pikpamje pozitive nga të gjithë përdoruesit.

Në ditët e sotme kalimi nga një kod gjuhësor në tjetrin ndodh edhe në të folur edhe në të shkruar. Për të hulumtuar këtë dukuri, përkatësisht në formen e shkruar janë bërë identifikimi i rasteve kur përdoruesit e rrjeteve socialesi Facebook-u, Twiter, Whats up etj pavetëdije kalojnë nga një kod i shkruar gjuhësor në një kod tjetër.

1.1 Hipotezat dhe pyetjet hipotetike

Duke u mbështetur në të gjitha këto të dhëna dhe dukuri lind hipoteza së

1. Të rinjte gjatë komunikimit në rrjetet sociale nderrojnë kodet gjuhësore në shumicen e rasteve edhe në diskursin e shkruar.

2. Arsyet që ndikojnë në ndërrimin e kodit gjuhësor gjatë një shtrirje diskursi janë: solidariteti, statusi social, afeksioni, tematika dhe bindjet e qëndrimet e folësit.

Pyetjet hipotetike lidhur me këtë studim janë:

1. A ndryshojnë të rinjtë kodin gjuhësor gjatë komunikimit në rrjetet sociale si Facebook edhe në diskursin e shkruar?

2. Cilat janë rastet dhe arsyet kur të rinjtë shqiptarë ndërrojnë kodin gjuhësor në diskursin e shkruar në rrjetin social Facebook në grupet e ndryshme të publike të hapura për anëtarët e grupit.

2.0 Metodologjia e punimit

Duke qenë të vetëdijshëm se kohëve të fundit gjuha angleze ka një impakt të fuqishëm tek të rinjtë qofshin ata kosovarë apo shqiptarë dhe e përdorin atë gjithnje e më shumë qoftë në medie e në rrjetet sociale, për të venë në pah këtë dukuri jemi marre me hulumtimin nëse kjo ndodhë edhe gjatë komunikimit të shkruar në disa nga grupet e këtyre rrjeteve sociale.

Për të realizuar këtë punim, korpusi është zgjedhur nga rrjeti social Facebook, respektivisht nga grupi shoqëror 'feminizmi shqipëtar' ku janë mijëra anëtarë nga trevat shqipfolëse si Kosova, Maqedonia, Shqipëria po ashtu edhe nga diaspora.

Është hulumtuar korpusi i publikuar dhe janë identifikuar rastet kur kanë ndodhur këto ndërrime të kodit gjuhësor nga antarët e ndryshëm. Eshtë treguar kujdes që të selektohen rastet e ndryshme dhe të grumbullohen mostrat nga sa më shumë anëtarë të këtij grupi, që do të thotë të përfshihen sa më shumë mostra nga burime të ndryshme.

Pasi që grupet e ndryshme të rrjeteve sociale janë publike dhe të hapura në momentin që antarësohesh, ka qenë një lehtësi për të bërë hulumtimin dhe pasi që qasja në korpus është bërë pa ndonjë shkelje etike.

Emrat apo inicialet nuk do të publikohen dhe do të përdoren mostrat për analizë gjuhësore kur kjo dukuri e ndërrimit të kodit është prezente dhe ilustron hipotezat apo ofron përgjigjje në pyetjet hipotetike.

3.0 Çfarë kuptojmë më ndërrim të kodit.

Ndërrimi i kodeve gjuhsore nënkupton përzierjen e dy apo më shumë gjuhëve në diskurs pa u ndërruar tema e bisedës apo bashkëbiseduesit. Këto ndërrime mund të ndodhin në cilindo nivel të strukturës gjuhësore, brenda fjalës, fjalisë, paragrafit apo tekstit.

Ndërrimi i kodeve ka qenë fenomen i kahmotshësm i shoqërive bilingualedhe ka filluar të zgjojë vëmendje së fundmi të shumë gjuhëtarëve dhe studiuesve në zhvillimin e sociolinguistikës si disciplinë e re gjuhësore.

Në procesin e një interaksioni shoqëror, folësi mund të kalojë tëresisht nga njëra gjuhë në tjetren. Ky kalim ne kontekstet shoqërore ku gjuha angleze është dominante është i pavetëdijshëm dhe ka si qëllim bërjen e bisedës mbi të gjitha më intime dhe të bësueshme. (Trudgill, 2000)

John J. Gumperz sqaron me tutje së "nderrimi i kodit gjuhësor si mbivendosje brënda nje shkembimi të pasazheve të të folurit që i takojnë dy sistemeve apo nënsistemeve gramatikore ….ose kur folësi përdorë një gjuhë të dytë për të përseritur mesazhin apo për tu përgjigjur një qëndrimi të tjetrit" (Gumperz, 1982).

3.1 Disa nga arsyet qe mendohet së të rinjtë ndryshojnë kodin gjuhësor gjatë komunikimit

Ndryshimi i kodit gjuhësor është pra një fenomen që vjen si rezultat i bilingualizmit apo multilingualizmit. Sociolinguistet kanë qenë gjithmonë të interesuar të dijnë shkaqët që shtyjnë folësit të nderrojnë kodet gjuhësore branda një shtrirje diskursi qoftë ai i folur ose i shkruar. Si faktorë mund të numerohen: solidariteti, statusi social, afeksioni, tematika dhe bindjet e qëndrimet e folësit.

Siç u diskutua edhe më lartë, njërëzit e sidomos të rinjë gjatë komunikimit qoftë të folur apo të shkruar ndërrojnë kodin gjuhësor dhe arsyet që e bëjnë këtë veprim qoftë më vetëdije apo pa te janë të shumta por për arsye praktike ne do të përmendim vetëm disa: për të treguar solidaritet me ndonjë grup shoqëror; të shquajnë veten e tyre; të marrin pjesë në takime, biseda; të diskutojnë ndonjë temë qoftë tabu apo diskutabile; të tejkalojnë përkufizimet dhe limitimet gjuhësore; të impresionojnë audience; të tregojnë se kanë një intelekt gjuhësor; të shprehin ndjenjat dhe qendrimet e tyre.

3.1.1 Të tregojnë solidaritet

Folësi mund të kaloj në një gjuhë tjeter si sinjal i antarësisë së grupit apo etnicitetit me të adresuarin apo pranuesin (Holmes, 2000). Ndërrimi i kodit gjuhësor mund të paraqesë solidaritetin ndërmjet njerëzve të grupeve të të njejta apo të ndryshme etnike

Në të kaluarën por edhe në të tashmen kur në një grup ka pasur njërëz që i përkasin etnive të ndryshme edhe pse gjuha e mazhorancës ka qenë gjuha shqipe në pjesen me të madhe të rastëve është kaluar në kodin tjetër për të treguar një lloj solidariteti me grupin me minoritar.

Në ditët e sotme, me intervenimin e organizatave ndërkombëtare dhe me afirmimin e gjuhës angleze, kontaktet me këtë gjuhë janë intensifikuar dhe qasjet me njërëz nga përkatësi të ndryshme etnike janë shpeshtuar më shume prandaj gjuha angleze eshtë bërë një gjuhë ndërmjetsuese e përafruese, pandaj edhe kalimi gjuhësor nga gjuha shqipe në atë angleze është bërë nje fenomen shumë i shpeshtë edhe për arsye prakticiteti edhe solidariteti.

Kjo bëhet edhe në kanalin e shkruar, në rrjetin social në facebook, në grupe të ndryshme publike të huaja ku postimet apo temat janë të ndryshme por në gjuhën angleze, edhe pse anëtarët janë të vendeve të ndryshme të botës për tu kuptuar në mes veti shkruajnë dhe komentojnë në gjuhën angleze.

Mirëpo edhe në grupet publike shqiptare, në rastin konkret në grupin feminizmi shqiptar, ku të gjithë anëtarët janë shqiptarë ose mund të ketë të huaj që e njohin shqipen janë rastet kur postimet apo statuset shkruhen nga folës shqip në gjuhën angleze. Në të tilla raste edhe shumica e komenteve që bëhen në atë postim janë në gjuhën angleze; kjo për të treguar një solidaritet më personin që e ka shkruar atë status apo post në një kod tjetër gjuhësor

3.1.2 Për të treguar statusin shoqëror

Çdo herë e më shumë nëpër media, e sidomos në ato shqiptare hasim ne moderatorë që në të folur përdorin huazime si italiane, greke apo angleze, fjalë që kanë fjalë të barasvlershme në gjuhën shqipe po megjithatë folësi huazon fjalë apo shprehje për të treguar së njeh ato gjuhë nga të cilat i huazon ato. Pra, shpesh here folësit tentojnë të përdorin gjuhë të huaja për të paraqitur një status shoqëror ose për të vecuar veten e tyra nga një klasë tjetër shoqërore. Me fjalë tjera për të tingëlluar si me prestigjioz, elitarë apo trendi.

Kjo mund të shpjegohet me qëndrimin se: "Ndërrimi i kodit gjuhësor bartë ne vete një prestigj të fshehur që del ne pah vetem nga kendveshtrimi apo qëndrimi i folësit" (Auer, 2002)

Një folës i cili mund të kalojë nga njëri kod gjuhësor në tjetrin nënkupton në vete se ai person është i arsimuar dhe është kompetent në më shummë së dy gjuhë të huaja. Kështu që kjo mund të shihet edhe si tendencë e atij folësi për të rënë në sy apo të shquajë veten.

3.1.3 Tema

Tema në anën tjetër mund të jetë një arsye tjetër pse folësi do të këtë prirje për të ndryshuar kodin gjuhësor në tjetrin kod. "Njërezit mund të kalojnë nga njeri kod në tjetrin Brenda një diskursi për të diskutuar një temë të caktuar (Holmes, 2000)

Kështu që folësit kanë tendencë për të përdorur më shumë së një gjuhë Brenda një fjalie varësisht nga tematika e bisedës. Në shumë situate përsoni që njeh disa gjuhë do të ketë afinitet për të përdorë kodet gjuhësore i ndikuar nga tematika. Fjalet dhe temat tabu janë ato që më së shumti e nxisin folësin të kalon në një kod tjetër se sa të shprehen në gjuhën amtare.

Janë identifikuar rastet dhe janë selektuar shembujt kur për ti ikur perdorimit të fjalëve të ndryshme, si sharjet, ofendimet apo shprehjet tabu edhe në këto grupe publike në rrjetet sociale janë përdorë gjuhët qe nuk janë gjuhë amtare e folësit, si gjuha angleze apo italiane. Për të ilustruar këtë dukuri është identifikuar rasti kur atë që nuk mund ta shprehë në gjuhen amtare e shprehë në gjuhen angleze si:

A: Një Shënjëtore në shtëpi një k… në…

B: Nuk e njoh proverbin të lutem plotësoje

A: Variacioni mbi temen" A lady in the living room and a whore in the bedroom"

Shembuj të tjerë perdorimi fjalësh tabu apo sharjesh në një kod tjetër gjuhësor janë më sa vijon:

"Kjo ska lidhje me fe por me traditat. ***Disgusting and sick***"

"Si njërëzit si feja, ***same shit"***

"Mos u bo ***kid,*** në secilin koment, nëse do me mbind për hir të informimit këtu ***then just fucking do it, othervise go on and be a kid again"***

"Në fillim me shqetësojshin këto komente, e tash I'm like: "***Anyway I don't give a fuck, you can't disturb my peace.***

"Bye & edhe mos harro me godit veten në kokë pak, nashta të bjen truri n'vend. ***Disgusting homophobic rat"***

"Mesimin e madh jetësor, ***my ass***. Kjo gjyshja supozon që kjo të ndryshojë diqka pasi që po e tradhton. ***What kind of bullshit?"***

"23 kam menduar edhe unë; ***I don't give a crap about getting married now***"

"And yes we should love our bodies, we can be whatever the fuck we wanna to"

"Wow, % më të madhe të përgjigjjes e kanë grate, ***O shit"***

"S'pajtohem, ***fuck kindness"***

3.1.4 Afeksioni

Ndërrimi i kodit gjuhësor te bilingulet apo multilingualet ndodhë shumë shpesh në rastet kur folësi shpreh disa ndjenja të ndryshme si gëzimi, emocionet, dhe qëndrimi. Shpesh folësit kalojnë nga njëri kod gjuhësor në tjetrin për shfaqur lumturinë, urrejtjen, nervozizmin, pikellimin etj.

Sipas Janet Holmes, ndërrimi i kodit gjuhësor bëhert shpesh kur njeriu shpreh mospajtim. Kështu pra, njerezit ndërrojnë kodin gjuhësor sepse janë të hidheruar (Holmes, J; 2000; 40).

Ajo me tutje tregon një rast: "Në një familje imigrante kineze në veriperendim të Anglisë, kinezishtja është gjuhë që përdoret në shtëpi.Kur nëna kalon në anglishte për të pyetur djalin e saj pse nuk i ka bërë detyrat, ai e kupton se në mënyrë indirekte po i thuhet që është më mire t'i kryej detyrat para se të fillojë të luajë ne kompjuter."

Dialogu më poshtë pasqyron kalimin nga njëri varietet i anglishtës që është më intim e miqësor në një stil me formal të anglishtes që e distancon folësin nga marrësi në mënyrë që të kërcënojë atë:

Father: Tea's ready Robbie. (Robbie ignores him and carries on skate-boarding.)

Father: Mr Robert Harris if you do not come in immediately there will be consequences

Disa nga ndërrimet e kodit gjuhësor nga shqipja në anglisht ose anasjelltas kur folësi është nën afekt janë në shëmbujt e mëposhtëm:

a) Kur personi është i gëzuar: You go girl, ***nuk kemi pse ndalojmë!***

b) Kur përsoni është i hidhëruar: Nope, not part of the problem. You are part of a problem ***se në vend që të merresh me shërimin e racizmit të njëmendet merresh me shuarjen e dashurisë ndaj vetes.***

Auuq, ***my eyes are bleeding reading this***

Dhuna ndaj gruas eshtë e gabuar. ***Does it ring a bell?***

c) Kur përsoni shprehë befasi: Pse kanë mbiemer të ndryshëm se kuptoj, hahaha budallallëku ***taken to the next level***

Oh no, ky e paska njet të gjithve me na shkru. ***Ignorant and stupid people, apocalypse is coming.***

Someone finally said it! Unë mendova se ishte thjeshtë status me marrë disa ***like*** aty. ***Seriously?!***

ç) Kur përsoni debaton me dike:Nietzche ska ardhë kurrë në kësi konkudimi, **If anyone should read Nietzche than it's you.**

Kur thua s'ke kohë ti, ***you always end up writing 30 comments, get your head clear mate!***

3.1.5 Shkalla e lehtësisë (borrowing)

Bilingualet shpesh e ndërrojnë kodin gjuhësor kur nuk mund të gjejnë fjalën e duhur apo shprehjen e caktuar ose kur në gjuhën e bisedës nuk ekziston një fjalë e caktuar nuk ekziston ajo shprehje e caktuar.

Këto mund të shpjegohen si huazime dhe mund të ilustrohen me shembujt e meposhtëm:

Ec bre çele një ***real account*** njëherë tani jep mendime personale.

Kush është i margjinalizum a diskriminum, se ka luksin me qene ***average human***.

Një shoqe e simë bije tregon se shoku i saj e ***stalkon*** (huazim, adaptim)

Po të përshendes e po pres pak me tepër. ***Beast mode activated***

Pure work of science këto komente.

Konsideroje me ***leave*** grupin.

O hajgare bre. ***Chill out!***

Haters le të lehin, gjërat të ecin përpara!

Like e ki për ***caption***, m'ka shti me kesh.

Buzëqeshja është ***make upi*** më i mire që një femër mund të vej.(huazim, adaptim)

Mua me pëlqen qikjo si ***hashtag***.

Ideja e saj është ***appealing***.

Ku e ka shkrimin t'i bëjmë një ***shere*** të denjë (huazim, adaptim)

Vendosa me e nda edhe unë një lajm që qarkullon në ***newsfeedin*** tim. (huazim, adaptim)

Është në radhë të parë për të mirën e tyre të jenë ***autosuficient.***

Këto ***life skills*** më kanë hyrë shumë në punë kur kam studiuar jashtë shtetit.

Ose me listë, ***tick this tick that*** sipas radhës.
Thumbs up për nana si kjo
Djemtë zakonisht e kanë një ***self-entitlement*** që e dijnë se nga vjen.

4.0 Llojet e nderrimit të kodit

Duke u nisur nga Poplack (1980), lloji i pare i ndërrimit të kodit është ndërrimi i ashtuquajtur ndërmjet fjalive, që do të thotë se ndërrimi ndodhë në kufirin e fjalisë së thjeshtë apo të përberë, ku njera prej tyre është në njëren gjuhë e tjetra në gjuhën tjetër. (Romaine.1995: 122).

Për me tepër ky lloj i ndërrimit të kodit kërkon më së paku integrim sepse ndërrimi i kodit ndodhë ndërmjet fjalive. Do ta marrim si shembull mjaftë perfaqësues të ketij tipi nga Poplack Sometimes I'll start a sentence in English y terminó en espanol. (Ndonjëherë filloj fjalinë në Anglisht dhe e përfundoj në spanjollisht)

Lloji i dytë i ndërrimit të kodit është ndërrimi i etiketuar që kërkon vetem pak integrim të dy gjuhëve. Ky hulumtim do të bazohet kryesisht në Poplack dhe do të aplikojë shprehjen ndërrimin e etiketuar në vend të ndërrimit të kodit nga jashtë, kur bëhet fjalë për këtë lloj të ndërrimit të kodit që nuk është as inter as intra fjalive. Ky ndërrim përfshinë insertimin e një etikete në një fjali që përndryshe është në një gjuhë tjetër. (Romaine.1995:122). Kjo ndodhë sepse ky lloj ndërrimi nuk ka ndonje kufizim sintaksor. Shprehjet mund të insertohen lirshëm gati kudo në fjali të thjeshtë apo të përberë pa e prishur strukturen gramatikore (Poplack, 1980: 589). Për të ilustruar këtë më së miri i marrim shembujt në gjuhën angleze:***you know, you mean***, etj.

Lloji i tretë i ndërrimit të kodit është ndërrimi brënda fjalisë, ndërrim ky që kërkon mjaftë integrim dhe përkon më shumë me bilingualët fluent. Ndërrimi brënda fjalisë kërkon një sfidë më të madhe sintaksore meqë fjalët ose shprehjet nga një gjuhë insertohen brënda strukturës së fjalisë në një gjuhë tjetër. Pasi që dy gjuhët janë të përziera brenda një fjalie, poashtu në shprehje vijnë edhe dy gramatikat qe do të thotë se folësi duhet t'i njohë dy gramatikat në mënyrë që të krijojnë fjali janë të sakta. (Poplack 1980: 589)

4.1. Shembuj të ndërrimit të kodit gjuhësor ndërmjet fjalive nga korpusi

Në mënyrë që të analizojmë llojët e ndërrimit të kodit gjuhësor në nivelin strukturor ndërmjet fjalive të thjeshta apo të përbëra është hulumtuar korpusi nga grupet e ndryshme publike, kryesisht nga grupi feminizmi shqipëtar ne rrjetin social facebook.

Janë identifikuar raste shumë të shpeshta të ketij lloji të ndërrimit të kodit gjuhësor, dhe për arsye praktike do të shënojmë vetem ato më përmbajtësore e më përfaqsuese:

Sa e bukur kjo! ***Still they say we are the weaker sex!*** – (Matrix Lang-Alb, Embedded lang-Eng)

I shared it, ***se i kam n'facebook plot qe kanë mizen pas veshi.*** (Matrix-Eng, Embedded-Alb)

NN, you should stand for the truth. ***Ketu e ke gabim.*** (Matrix-Eng, Embedded- Alb)

Duket sikur të gjithë jemi në kërkim. ***Ain't this the aim?*** (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

Po u nise nga ky aspekt, ***you have no idea.*** (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

S'kam nevojë me t'i shpjegue. ***Return to my revious comment!*** (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

Are you kidding me? Kur boni gol Xherdan Shaqiri kerkush nuk e përmendi kend e ka trajner po u fokusoheshin ne suksesin e tij si individ. ***Behind every successful woman is herself.***

Unë isha me ty deri në qastin kur me the: Merr ndonje qëtsues. ***You crossed the line there***.

What's wrong with you people? ***Cfarë ka fjala femër?*** (Matrix- Eng, Embedded-Alb)

Kam pasë fatin me e pa një vajzë që e kishte një bluzë të tillë. ***The amount of judgement was to damn high.***

Lëre, lëre se u bëre xheloze, ***diamonds are the girl's best friends!***

Mirë është kur kanë me marrë shëmbuj për të mire. ***You should be proud of that!***

It's called irony. I was being ironic. ***Normalisht që nuk mendoj diqka të tillë***. It's purely sympathetic to your cause. (Matrix Eng, Embedded- Alb)

E përfundimsht ***we should start moving on***, se shkoj jeta. (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

4.2 Shëmbuj të ndërrimit të kodit gjuhësor të etiketuar (Tag switching and habitual)

Edhe ky lloj i ndërrimit të kodit gjuhësor është mjaftë prezent në diskursin e folur dhe në atë të shkruar. Për të ilustruar këtë po paraqesim disa nga shembujt nga korpusi i zgjedhur.

Masi e paske edhe në fakultet, ***you know what I mean***. (Tag në Ang)

Unë e bëj për veten dhe për paqën në botë, ***of course***. (Tag në Ang)

A janë të gjithë amerikanët që veshin bluza e mbajnë kapele racis? ***Common*** (Tag në Ang)

Çfarë deshtimi, ***OMG!*** (Tag në Ang)

S'dua të gjykoj po, ***really?***

Jo, ***well,*** hiq ca protestantë e hebrenjë.

You wish, jo nuk është e vërtetë.

Feminizmi nuk është vetëm për të drejtat e gruas. ***Just saying***.

Oh god, sa shumë kohë që paskëni, ***relax people!***

Well, Akoma nuk ia fal vetes që këto kryevepra i kam ruajtur me naivitetin e moshës.

Kind of, varet së cfarë kupton me ***strength***. (tag, borrowing)

Come on, me duket se nuk kanë më cfarë të merren njerëzit.

Ose e zgjatë heshtjen e saj, ***well***.

Right, Referencat i kanë në trurin e tyre të pazhvilluar.

Dhe të gjithë komentuesit e mbështesin, e komentojnë, ***WTF!***

Askush nuk kemi lindur të mësuar, kemi mësuar dhe na mësojnë. ***Peace.***

Shumë energji negative paska mrena ktij posti…***open up folks!***

Nëse nuk iu pëlqen mund ta hiqni, ***simple as that.***

By the way, dhe fjalitë e sforcuara i kishte.

Anyway, njërëzit janë katastrofë.

Wow mbresëlenëse ***anyway.***

Që e bën edhe pak si të mosbesueshëm në profilin prej feministi ***as well.***

4.3 Shembuj të ndërrimit të kodit brenda fjalisë

Siç u përmend edhe më lartë, lloji i tretë i ndërrimit të kodit është ndërrimi brënda fjalisë, që kërkon mjaftë integrim dhe është më shumë me prezente të ata persona që flasin rrjedhshëm të dy gjuhët., Ndërrimi brënda fjalisë kërkon një sforcim më të madh për përdoruesin meqë fjalët ose shprehjet nga një gjuhë insertohen brënda strukturës së fjalisë në një gjuhë tjetër. Shembuj të këtillë të ndërrimit gjuhësor do të paraqiten si më poshtë:

Shumica e sulmeve bëhen nga të njohur e jo ***strangers in elevator***. (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

Dudes and chicks***….menyra ime e të shprehurit nuk është kjo***. (Matrix-Eng, Embedded-Alb)

Total win ***për ekstremistet.*** (Matrix- Eng, Embedded-Alb)

Ku janë akuzat mor jahu? ***You see*** akuza…***too bad*** që qenkëni kaq të dobët. (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

Thankfully not. Not that I know off, ***gjithsësi***. (Matrix- Eng, Embedded-Alb)

Çfarë komenti ***stupid.*** (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

Kjo quhet ***'hate speech'*** dhe denohet me ligj (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

Mundesh me i lexu ***replay*** te komenti i NN (Borrowing, error (reply)

Otherwise ***do të ishim shuar si njërez***. (Matrix- Eng, Embedded-Alb)

Well that's obvious; ***por që*** I'm just saying I'm more of a Bernie kind of girl.

Ky tipi tu u mundu me u duke ***cute.*** (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

Kur si përfundim ajo merr lekë aty. ***Hello, Logics? (***Matrix-Alb, Embedded -Eng)

Uaaa sa ***sweet*** qënkan. (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

Është ***funny*** por çdo të ky grup? (Matrix-Alb, Embedded -Eng)

It sounds ***bash pa lidhje.***

Më preke me këtë ***driving thing***-un se jam katastrofë.

Ore, ***occupied territories***, seriozisht?

Të luftosh për idealet e tua ***with a good heart, soft but strong***

Gratë i shohin si ***shitty persons*** ose ***less better persons***

She wears the word slut with so much pride ***sa që*** it doesn't even sound bad any more.

Mund të jetë aktrim por prap është ***super cool***.

Me neither, ***ama realiteti është i tillë***

OK strong girl, por nuk jam dakord më këtë.

5.0. Përfundim

1. Të rinjtë gjatë komunikimit në rrjetet sociale ndërrojnë kodet gjuhësore në shumicën e rasteve edhe në diskursin e shkruar.
2. Arsyet që ndikojnë në ndërrimin e kodit gjuhësor gjatë një shtrirje diskursi janë: solidariteti, statusi social, afeksioni, tematika dhe bindjet e qëndrimet e folësit.
3. Ndërrime të kodit guhësor ndodhin më shumë në rrafshin inter sentential së sa në atë intrasentential e tag switching.

Referencat

Gumperz, J. 1982, Language and social identy. CUP

Holmes. J. 2008**.** An introduction to sociolinguistics, Routledge

Poplack, Sh. 1980. Sometimes I'll Start a Sentence in Spanish Y TERMINO ESPANOL: Toward a Typology of Code-switching.*Linguistics*. Vol. 18, Nos 7/8. 581-618.

Romaine, S. 1995. *Bilingualism*. 2nd edition. Oxford: Blackwell.

Trudgill, P., 2000. Sociolinguistics, An Introduction to language and society.

Lendita KRYEZIU

CODE-SWITCHING ON SOCIAL NETWORKS IN ALBANIAN LANGUAGE

Abstract

If you happen to be an active user of different social networks like: Facebook, Twitter, Instagram, Snapchat, WhatsApp, Viber or Tumblr, you will be able to see that many users use English as a written medium to express their thoughts, wishes, ideas even when their native language is not English.

Code-switching is the alternating use of two languages in the same stretch of discourse by a bilingual speaker. In other words, code-switching is used to identify alternations of linguistic varieties within the same conversation.

In Kosova, this phenomenon is not new. The lexicon of Albanian language because of many factors such as: many conquests, geographic proximity to other countries and the subsequent globalization has been enriched with loanwords from Ancient and Modern Greek, Latin, Turkish, Italian, the Balkan Slavic languages and later on from English.

Not only words were borrowed but frequently speakers of Albanian and other languages in contact used to shift codes from one language to another one.

It is a broadly acknowledged fact that in recent years English has become a global language and as such, it is used all around the world by professionals and scholars in international meetings. English is often the official language of international companies, enterprises, Unions and Academic Conferences, and above all, it is the language of the internet.

Nowadays, we are witnesses of the widespread use of the above mentioned social networks by the majority of people, specifically young people who spend many

hours conversing with their friends and peers. In these conversations, they often switch from one language to another one. Not only this, but there are also cases when they post their statuses or comments using English language. The reasons for doing this might be of different nature: To code- switch into a high prestige language, to be understood only by their circle of friends, for easier expression and for not a specific reason.

In this paper the cases of code-switching occurring on these social networks and mostly on Facebook will be researched and analyzed.

LETËRSI / LITERATURE

Sabri HAMITI

MËSIMI I LETËRSISË

I. Komunikimi

Rëndësia e ligjërimit dhe mësimit të letërsisë në Universitet nuk ka humbur kurrë edhe nuk do të humbet, qoftë e provokuar rëndë me ndryshimin e mënyrës së komunikimit në modernitet. Kjo rëndësi provohet me vlerë kulturore të letërsisë si thesar dituror e estetik dhe me shpalosjen e kësaj vlere nga një brez te tjetri. Problemi shtrohet në nivel të teorizimit dhe në nivel praktik: rimarrja e vlerave letrare dhe metoda e bartjes, duke e vënë në sprovë edhe ligjëruesin si aktant të parë. Në këtë komunikim ku aktantë janë ligjëruesi (profesori), materia (njësia e dijes) e klasa (studentët, ndëgjuesit), pajtimi apo harmonia e këtyre përbërësve të komunikimit premton sukses në secilin proces të marrjes e dhënies së dijes si proces i nxënies. Në të kundërtën komunikimi mund të rrëshqasë në mosmarrëveshje, e cila ndodh edhe më lehtë kur ligjërohet për letërsinë e cila nuk e ka të matshme në mënyrë absolute vlerën, porse vlera e saj mund të shtrihet apo të mblidhet në këtë proces, e kushtëzuar nga rrethana sociale e sensibilitete të kohës. Pra, kemi parasysh mësimin e letërsisë për të provuar e për të prodhuar një *dije* e jo për të zhvilluar një *doktrinë*.

Rëndësia e studimit të letërsisë si art i fjalës e si njohje e botës është e madhe kudo, mirëpo studimet letrare në kulturën shqipe marrin peshë të veçantë, sepse në këtë kulturë, deri më sot letërsia ka qenë edhe bazë e njohjeve në disiplinat historike e humanitare. Prandaj këtu merr një peshë të veçantë programi i mësimit, si trashëgimi që kalon nga një brez te tjetri, si kulturë e vlerë e përhershme. Kjo në programet letrare specifikohet si rend vlerash, veprash të njohura letrare, kryeveprash që më së shpeshti përkufizohet si histori letrare. Përbërës i rëndësishëm në këtë mënyrë të komunikimit letrar hyn ligjëruesi, bota e tij personale, njohjet paraprake, dhe në këtë rast mund të shënohet në parantezë.

II. Paranteza

1. Si student i letërsisë, për një decenie të plotë kam ndëgjuar ligjërimet e mësimet e profesorëve: Eqrem Çabej, Idriz Ajeti e Anton Çetta në Fakultetin Filozofik të Prishtinës; Zdenko Shkreb, Aleksandar Flaker, Ivo Frangesh e Milivoj Solar, në Fakultetin Filozofik të Zagrebit; Roland Bart, Zherar Zhenet e Pjer Brynel në

Universitetin e Parisit. Dhe domenet e studimeve letrare kishin këtë rend: gjuhë e letërsi shqipe; letërsi botërore e komparativistikë; semiologji e teori e formave letrare; mitologji letrare e tematikë.

2. Si profesor letërsie ne universitet kam kaluar më tepër se dy decenie: ligjërues i letërsisë moderne shqipe e i poetikës historike në Universitetin e Prishtinës dhe profesor i ftuar në Universitetin e Tiranës.

3. Gjatë gjithë kësaj kohe kam qenë shkrimtar e studiues i letërsisë, duke botuar letërsi imagjinative e diskursive në shqip e në gjuhë të tjera.

4. Student, profesor e shkrimtar, statuse të provuara për më tepër se katër decenie në vende e në kultura të ndryshme, mund të krijojnë profilin e një njohësi të letërsisë dhe dëshminë e ligjëruesit të letërsisë në një nivel të besueshmërisë së komunikimit.

III. Leximi e shkrimi

Mësimi i letërsisë, si ligjërim i letërsisë ka si detyrë e si qëllim mësimin *me lexue* e *me shkrue* letërsi, pra mësimin e leximit e të shkrimit letrar. Këto dy nocione në shqip përmbajnë saktësisht vështrimet kuptimore të rrënjës së tyre latine: *lego, légĕre* – (mbledh, zgjedh, lexoj) dhe *scribo, scribĕre* – (shkruaj, hartoj), duke paraqitur procesin nëpërmjet paskajores e duke prodhuar nocionin nëpërmes emrit; *me lexue*: lexim; *me shkrue:* shkrim. Por, detyra dhe qëllimi i mësimit kërkon vetvetiu, në proces, një raport kontraktual ndërmjet mësuesit e nxënësit, i cili raport në letërsi nuk është prodhimtar si raport i detyrimit, por bëhet prodhimtar si raport i dëshirës dhe i kënaqësisë. Prandaj, raporti ideal në mësimin e letërsisë është nëse ligjëruesi u drejtohet vetjeve dhe subjekteve që e zgjedhin, ndërsa ligjëron atë që e zgjedh vetë. Në këtë nivel ngjitet e bashkohet dëshira për komunikim letrar në letërsi. Po iu kthyem nocioneve themelore të përparme do të kemi derivimet e reja: *lexim i shkrueshëm* dhe *shkrim i lexueshëm*. Lidhja e këtyre emrave duke u vënë në raport mbiemrash me njëri-tjetrin prodhojnë jo detyrimin, po kënaqësinë e ligjërimit letrar, kënaqësinë e shkrim/leximit të letërsisë. Në këtë mënyrë jemi më gjurmët e Niçes që pohonte se nocionet e konceptet kanë origjinë metaforike.

Atëherë, si të lexohen klasikët e modernët në të njëjtën kohë, mbasi programi i mësimit institucional i merr të dyja palët si vlera të sistemuara në shkalloren e një letërsie: duke renditur vlerësimet e rekomandimet e përparme (atë që dihet e që është thënë) apo duke ndërhyrë në mënyrë subjektive në këto argumentime, qoftë për të prodhuar një ligjërim të ri, të tashëm (çka mund të thuhet). Kjo shpie te dramatika e zgjedhjes si detyrim apo e zgjedhjes si dëshirë. Të lexosh njëherësh klasikët e modernët para studentëve të një brezi, në një auditor, ky është proces i mendimit, nuancimit e klasifikimit për të artikuluar universalitetin e letërsisë nëpërmjet dialogimit të brezave e të shkrimeve. Kjo mund të duket, po u vu në logjikën e këtij sistemi

klasikët e modernët: Virgjili, Dante, Karduçi, e Montale, apo Rasini, Bodleri e Apolineri, apo Shekspiri, Poe e Elioti, apo Gëte e Stefan George, apo Servantesi, Lorka e Borhesi, apo Bogdani, Naimi, Mjedja e Poradeci… po universaliteti letrar, po kënaqësia estetike, po fuqia njohëse. Mirëpo, universaliteti letrar lidhet me gjuhën, me shpirtin, me identitetin, dhe del tjetërfare ligjërimi për një letërsi nacionale, mbasi edhe këtu ballafaqohet në sistem përhershmëria me individualitetin, një e përgjithshme me një të veçantë.

Lexuesit e ligjëruesit e provuar të letërsisë, teoritë e veta universale e universalizuese i prodhojnë nëpërmjet kryeveprash të letërsive nacionale, duke konsideruar që aty njohja e tyre letrare është më e plotë, më e thellë. Mihail Bahtini duke teoretizuar romanin shumëzërësh mbështetet në romanet e Dostojevskit, duke na ndjellë që ta lexojmë edhe ne Dostojevskin. Zherar Zheneti ligjëson narratologjinë, duke lexuar *Duke kërkuar kohën e humbur* të Marsel Prustit, e na bën ta lexojmë Prustin edhe ne. Rolan Barti duke hulumtuar semiologjinë e romanit mbështetet në romanet e Prustit e na bën ta lexojmë prapë Prustin. Ivo Frangesh, duke lexuar poezinë e modernistit kroat Vlladimir Vidriq, projekton në fatin e tij dhe në poezinë e tij tragjedinë nacionale (kur çmendet më i bukuri, më i miri, më i dituri). Pra, kemi këtu një sprovë universale të letërsisë, që ngrihet në shpalimin e vlerave për t'i monumentalizuar vlerat e letërsisë së gjuhës së vet. Këtë fenomen e kemi përpara edhe kur Ibrahim Rugova bën leximin e veprës së Bogdanit apo edhe Rexhep Qosja kur lexon veprën e Naim Frashërit. Deri më sot leximet më të fuqishme janë bërë në kuadër të gjuhëve e letërsive nacionale.

Këto njohje e bëjnë edhe më të ndërgjegjshëm edhe një ligjërues të letërsisë shqipe, se duke shkruar e lexuar letërsinë nacionale hap dritaret e njohjes së saj së mbrendshmi, si koncentrat të një gjuhe e të një shpirti, që me identitetin e vet prodhon shenjat e universalitetit të botës, së jashtmi. E këtu kthehemi prapë te detyrimi, që kërkon të bashkohet me kënaqësinë e këtij ligjërimi, si njohje letrare që don të bëhet njohje e botëve. Një ligjërim i tillë flet për veten edhe kur flet për botën, duke pranuar rolin e dëshmitarit, porse të dëshmitarit që dëshmon nëpërmjet imagjinimeve letrare, të cilat ngjallen e funksionojnë në gjirin e letërsisë edhe duke i parë të përafruar Naimin me Lamartinin, Mjedjen me Karduçin, Lasgushin me Georgen, Kutelin me Markesin, Migjenin me Vidriqin apo Anton Pashkun me Xhojsin.

IV. Prova e klasikut

Moti është pohuar që shembulli është përkufizimi më i mirë. Ndre Mjedja, lirik klasik. Lirikat e para i botoi në të njëjtën kohë me botimet e Naimit në shqip, ndonëse është një brez më i vonë. Lirikat e fundit i botoi njëkohësisht me Lasgushin, ndonëse është një brez më i vjetër. Sistematizuesit e letërsisë shqipe kanë një shekull që

përpëliten t'i bëjnë vend: në romantizëm, në postromantizëm, në modernë. Çështja shtrohet rishtas duke e lexuar poezinë e tij: strukturën e domethënien e saj, fjalorin e sintaksën poetike, formën e rimën, një sistem të mëvetësishëm të shqipes poetike me gramatikën e vet. Më tej: ëndrrën e jetës, ëndrrën e lirisë, ëndrrën e identitetit duke krijuar një figurë ikonë, *shqypen arbnore*, si ritual të përsëritjes. Dhe ai shikim i botës nga maja e Traboshit për të përthekuar hapësirë e kohë: *o Tarabosh i mnért', ndêja hyjnore,* duke lidhur poetikisht topikën e vendit me botën shpirtërore, si shenja të përjetësisë. Dëshmia e kalimit të poezisë me nxitje të rastit në poezi të kohëve e bën poezinë e tij unike edhe pse të shkruar e të botuar në kohë të ndryshme, si vlerë që nuk e robnon momenti e si provë e komunikimit të përhershëm. Në një lexim relacional mbrenda letërsisë shqipe, *ndêja hyjnore* e Mjedjes duket variant i *Mrizit të zanave* të Fishtës, kurse në një lexim relacional përtej kësaj letërsie *Juvenilia* e odat klasike të Mjedjes janë të krahasueshme me *Juvenilian* dhe *Odat barbare* të Karduçit.

Diskutimi e leximi letrar, në orët e mësimit të letërsisë hapin aventurën e njohjes të jodomosdoshmërisë të vendosjes së poetit në kufijt e një formacioni letrar. Si të përthekohet liriku i jezuitëve në fantazmagoritë romantike?

Edhe më tronditëse bëhet aventura kur hyn në lojën e rileximeve të sistemit paradoksi i poetit modern me tërësinë e zjarrmisë së ndryshimit.

V. Mënyra e ligjërimit

Shkrimi për letërsinë e ligjërimi për letërsinë kanë dallime të ndjeshme. Shkrimi është thurje individuale, që kur e kërkon lexuesin e lyp një lexues ideal e të barasvlershëm me dije e me shije, porse të panjohur. Ligjërimi (i folur) i paraqitet ndëgjuesit real, një kolektiviteti individësh, dijesh e moshash të ndryshme. Të folurit herë është konceptual e herë është emocional, duke parashkruar një dramatikë, prandaj ligjërimi në auditor përgjithnjë merr një karakter teatraliteti, edhe kur qendër e komunikimit pretendon të bëhet ligjëruesi, edhe kur qendër e komunikimit pretendon të bëhet ndëgjuesi. Interpretimi është një *lego* – si lexim (si zgjedhje), ndërsa mësimi si ligjësim (legjislator) që përfundon në normim; përderisa *scribo* –shkrimi si hartim kujdeset për të krijuar bukurinë e ligjërimit. Në këtë proces, njohja është detyrim, pa dëshirë, dhe e prodhon *rregullimin*, kurse zbulimi si pëlqim e kënaqësi e prodhon *çrregullimin*. Kërkimi i të vërtetës, absolutes në fushën e virtuales, kërkimi i një bote përmes botës letrare është aventura e paditur që neutralitetin (nuk po themi objektivitetin) e bën copë e grimë duke e kaluar nëpër interpretimin personal, që bëhet zotërues pa u pas hetuar. Kjo është çështje edhe më e ndjeshme kur mbrendashkruhet raporti pedagogjik: që shqipton dallimet ndërmjet ligjërimit i cili shfaqet si solilokuium dhe *ushtrimit* që shfaqet si dialog. Cili është më i miri nuk mund të dihet. Solilokuiumi nuk është pushtet i raportit të obligueshëm, madje bëhet i dëshirueshëm, në qoftë se ndëgjimi kthehet në kënaqësi aktive. Në anën tjetër, nuk është e dëshirueshme nëse

prishet kursi vetëm për të bërë një dialog të shpifur interaktiv. Teatraliteti i mësimit të letërsisë shfaqet në shprehjen e *zërit* të ligjëruesit, në gjuhën e trupit, ku mund të lexohet presja, pikëpresja apo pikëçuditja; variacionet e zërit, frymëmarrja, pauza, ritmi, regjistrat e emotivitetit; shikimi i fiksuar në mendime (në një pikë të jashtme) apo shikimi që lëviz mbi fytyrat e ndëgjuesve për të regjistruar mirëkuptim e gjendje. Teatraliteti i ndëgjuesit duket në gjestet: që nga përqendrimi, mohimi me shikim të tretur, deri te shenjimi i kolegut për të rënë në sy, për marrëveshje solidariteti.

Mirëpo dramaticiteti i mësimit të letërsisë shtohet më shumë së mbrendshmi dhe ka të bëjë më rrethana që lidhen me dijen e shijen e ndëgjuesit, me kulturën letrare, në fund të fundit me perceptimin e ndjeshmërinë e kohës e të brezave. Këtu mund të prodhohet moskuptimi apo variacione të moskuptimit. Le të nisim nga Figura. *Lulet e verësë* është libër i Naimit. *Lulet e egra* është titull i një libri bashkëkohor. *Lulet në ballkon* është antologji e poezive të një brezi. *Lulet në Facebook* është komunikimi më i fundit. Ja pra si kalon *Lulja* si metaforë, në rrethana e në struktura tekstore, në metonimi, madje në dëftim neutral si paraqitje. Le të vazhdojmë me tema e tematizime, si dashuria. D*o të shtrihem të venitem*... këndon e rënkon Naimi. *Flm për SMS* është përgjigja e sensibilitetit aktual të një ndëgjuesi. Fjalë dashurie me zanore të tretura, për të dëshmuar, qoftë pa e ditur, që dashuria e gjuhës janë bashkëtingëlloret sepse ato artikulojnë kuptimin e parë, veçanërisht kur gjuha është e sinkopuar. Kjo është stereotipia e margjinalitetit apo stereotipia e jostereotipisë: grupi margjinal si këngë dashurie! Këtë fenomen të subversivitetit kundrejt autoritetit letrar e pat hetuar At Zef Pllumi kur po merrte mundin të aktualizonte mesazhin frymëzues të *Lahutës së Malcís* të Fishtës para brezit aktual. Dhe përfundoi shqyrtimin e vet At Zef Pllumi me një ironizim me tone vajtuese: Okej?!

VI. Disiplina e nxënies

1. Çështja është që ligjërimi e mësimi i letërsisë zhvillohen në një ndeshje të drejtpërdrejtë ndërmjet retorikës e poetikës, me rrezik që në këtë ndeshje të bjerë viktimë letërsia.

2. Çështja është që mësimi i letërsisë në katedra universitare është tepër i rëndësishëm, mbasi interpretimi e sistematizimi nëpërmjet disiplinimit të nxënies bën që për letërsinë (kolektivisht) kryesisht dihet e flitet ajo që bëhet në katedra; ajo kryesisht mbahet në mend.

3. Kjo është arsyeja që mësimi letrar bëhet çështje kulturore e sociale. Prandaj ka kaq rëndësi mësimi i letërsisë në universitet: edhe kur sistemon dije të përparme, edhe kur bëhet personal duke u përpjekur të vërë në krizë dijet e përparme.

4. Kemi lexuar Konicën ta shihte Naimin apostull të shqiptarizmës (në vështrimin e prijësit), pastaj ta cilësonte të pamoralshëm se e bëri grua kunatën; Naimin, moralizatorin lirik më të madh shqiptar.

5. Kam dëgjuar Zdenko Shkrebin ta mbarojë diskutimin e heroikës e të madhështisë (të madhërishmes) letrare me një fjali në formë të maksimës: *Heroi nuk çkulet*. Kjo në kuptimin metaforik e në kuptimin moral.

6. Këto "skandalizime" ligjërimore për letërsinë vetëm sa zgjojnë interesin për leximin e saj me dituri e sensibilitete të ndryshuara në kohë, deri në nivel të identifikimeve të habitshme. Një koleg imi para shumë vitesh e theu biçikletën në të cilën udhëtonte. E theva – tha, se Migjeni u sëmur nga tuberkulozi se udhëtonte me biçikletë. E ky kolegu im ishte mësues e poet.

7. Është provuar që ligjërues të njohur të letërsisë, interpretues të veprave letrare, nuk kanë mbërritur të shkruajnë vepra letrare edhe pse në botën e tyre ky mall ka ardhur gjithnjë duke u shtuar. Kjo i ka ngjarë edhe Bahtinit të fundit, Bartit të fundit, Zhenetit të fundit. Po edhe ligjëruesve e ligjtarëve të letërsisë shqipe. Një dëshmi se me sa dashuri e adhurim janë marrë me letërsinë.

VII. Pa mbarim

Ligjërata e sotme, e menduar dhe e gatuar me pretendime për të diskutuar normën e formën e mësimit të letërsisë, duke u mbështetur në përvoja e praktika të përparme, pa dashur domosdoshmërisht, po merr trajtën e një konfesioni letrar. Nisja e ligjërimit letrar si normë e si detyrim me pretendim për të kaluar në ligjërim letrar si dëshirë, pëlqim e kënaqësi, flet vetvetiu për një hyrje si dalje apo për një dalje si hyrje në leximin letrar. Aq më tepër kur shkrimtari bëhet ligjërues për të kaluar pastaj ligjëruesi në shkrimtar, me konsekuenca për të dy statuset.

Prandaj, kjo ligjëratë apo një e ngjashme, do të mund të mbahej edhe në nisje para dy deceniesh: sprovimi i normave e i formave, nëpërmjet idesë së ndryshimeve e jo të përmbysjeve.

Kur u pranova për të ligjëruar letërsinë moderne shqipe dhe teorinë dhe analizën e formave letrare në Fakultetin Filologjik të Prishtinës, isha shkrimtar e studiues i letërsisë, e para kësaj student i letërsisë në universitete të ndryshme. Në këtë kohë, pra më 1993, studimet në Prishtinë ishin përmbysur në kuptimin organizativ (pushtuesi i përzuri studentët nga auditorët). Tashmë studimi si rebelim kundër normës, vetvetiu u kthye në rebelim e kundërvënie, në qëndresë kundër pushtimit e shprishjes, si akt heroik i vetënjohjes e identitetit, si rrezikim për t'i shpëtuar rrezikut. Libri u bë rrezik në ekstrem, në mënyrë të veçantë libri i kulturës identitare, ashtu siç është shembullor libri letrar për shqiptarët.

Mësimi bëhej në shtëpitë mësonjëtore të qytetit, apo në klasat e shkollave fillore. Kush nuk i kujton pamjet sureale të përzierjes të studentëve njëzetvjeçarë me fëmijët shtatëvjeçarë, që në ambiente të ftohta e të ngushta mësonin abc-në e shkrimit e të jetës? Sa për veti kujtoj dhe dëshmoj për një afri, një respekt e një dashuri të dyanshme ndërmjet profesorëve e studentëve; një dashuri e përkushtim për nxënie e

provuar në bisedime diturore e letrare në kushte jokonvencionale, në kafe a në ambient të hapur. Mendoj që nga të dy palët ka midis jush sot këtu, pjesëmarrës e dëshmitarë. Nuk po them se vetëm me troha të kujtimeve do të krijohen ëndrrat, por po them se vullneti për dije është thelbi, ndërgjegjja e cogito-s. Ndryshimet i bëjnë vullnetet e rrethanat.

Se thashë: kjo ligjëratë mund të mbahej në fillim e në fund, si rrëfim për procesin kulturor, krijues e dramatik, të kalimit nga shkrimi në ligjërim dhe të kalimit nga ligjërimi në shkrim. Te librat e lexueshëm për të prodhuar libra të shkrueshëm, duke pranuar e njohur pushimin e ndalesën, por jo fundin, mbarimin.

Një lamtumirë si tungjatjeta.

Sabri HAMITI

THE TEACHING OF LITERATURE

Abstract

In this paper, initially delivered as a lecture, I dwell on the universal value of teaching literature at the University, drawing on my own experience as a writer and literary scholar, as well as student and professor, having studied in Kosovo, Croatia, and France, and taught in Kosovo and Albania. I advance the idea of generating a *scholarship* and not developing a *doctrine* as the province of teaching literature. The literature curriculum – and indeed the teaching of literature – is all the more significant in the Albanian literary environment, because in this culture literature has for a long time underpinned knowledge in the fields of history and the humanities in general. The teaching of literature/lecturing on literature aims at instruction on the *reading* and the *writing* of literature, that is teaching literary reading and writing. This leads to a *writerly reading* and a *readerly writing*, and ultimately generates the pleasure of lecturing on/about literature and the pleasure of writing/reading literature. I argue in the talk/paper that experienced and trained readers and lecturers of literature generate their universal and universalizing theories through the close study of masterpieces of their national literatures, e.g. the Russian scholar Mikhail Bakhtin through Dostoyevsky's fiction, French scholars Roland Barthes and Gérard Genette through Proust (*In Search of Lost Time*) and other French writers, Ibrahim Rugova, anAlbanian scholar from Kosovo, through Pjetër Bogdani's work, and his colleague Rexhep Qosja through Naim Frashëri's oeuvre. The concluding part of the paper draws on my experience as a University professor of literature in Kosovo, including during the 1990s, when the Albanian-language University of Prishtina operated in exacting circumstances, as an underground university, in the Serbian-occupied country.

Key words: teaching, literature, national (Albanian) literature, masterpieces, University, Kosovo

Kujtim M. SHALA

***DON KISHOTI*: AUTENTIKË E UNIVERSALITET**

I

Don Kishoti i Mançës, i Miguel de Cervantes Saavedra-s, është kryevepra letrare që u rrit e u universalizua në fillin e *autentikes* së parë të saj, të lidhur me një hero e me një ambient tipik, dhe, paradoksalisht, kur u hap në semantikën universale, e provoi *auteniken* e parë si *universalje* të fundit.

Autentik(j)a e *Don Kishotit të Mançës* provohet në esencën e saj, me kastiliançen, si gjuhë të epokës së autorit, ndërsa rrëfimi letrar, një temë të vendit e kthen në temë universale, të provueshme e të identifikueshme në kohë e ambiente të tjera, përtej gjuhës së parë, në kulturat e shekujve të veprës së Servantesit.

Kështu, *Don Kishoti i Mançës* kthehet në provë të *autentikes* që universalizohet, projektuar nga pyetja themelore për shekujt e leximit të veprës: Pse lexohet *Don Kishoti* (edhe) sot? Kjo pyetje hyn në rrjetin e çështjeve të lidhura me letërsinë, leximin, kulturën e kurorëzohet me kulturën identitare, si rrafsh në të cilin sprovohen e provohen, madje kryqëzohen, *përkatësitë*: autentikja (e jona e diferencuar) e universalja (e përbashkëta humane).

Kalorësi i arratisur, Don Kishoti, hero i rrëfimit të Servantesit, siç e shenjon titulli i veprës, është i Mançës, përcaktim që shenjon poetikën e romanit kalorsiak, parodinë e të cilit do të bëjë autori, e ambientin e heroit, pra të rrëfimit e të ndodhive të rrëfyera. Kështu lidhen përkatësitë poetike e identitare, që çështja të ndërliqësohet e të kthehet në rrëfim letrar, të cilin e lexojmë, sepse i besojmë. Servantesi e thur parodinë, si *status teksti* e si pozicionim ideologjik, nga emrat te situatat, në të cilat etiketat kthehen në situata e situatat lidhen në *ndodhi*, pastaj në kuptime e në ideologji.

Teksti i tillë del i *strukturuar* e i *rrëfyer* dhe i provon poetikën e ideologjinë si dy faqe të veprës letrare, ndërsa rrëfimin si të përftuar e, njëherit, si trezor të tyre. Kjo do të thotë se vepra bëhet kur shkruhet e bëhet sërish në lexim, në pamjet më autentike të saj, të lidhura me tekstin, aq sa me lexuesin e kulturën e tij, madje me jetën. Kështu, *universaljet* e veprës kthehen në *autentika* të leximit e në shenja themelore të leximit me shkrim, pra të dijes letrare. Ky duket si një mësim letrar që mban e që jep *Don Kishoti i Mançës* për ne e për të tjerë, në pikën që kryqëzon *universaljen* me *autentikat*, prandaj mësimi përsëritet e merret edhe kur nuk vërehet, sepse vepra shenjon e kështu mëson, ndërsa leximi mëson e kështu shenjon.

Don Kishoti i Mançës është shkruar në kastiliançe, e dhënë që idiomin e dialektin i provon si gjuhë, kur gjuha kapet si funksion, e bëhet shenjë identitare që shenjon autor, vend, kohë e rrëfim letrar. Gjuhët e tjera të veprës së Servantesit e kanë shumëfishuar atë në katër shekujt e saj, në pamje e në kultura autentike, si provë për universalitetin e autentikes së parë e të leximit në gjuhë të tjera. Rrjeti i gjuhëve e *bën Don Kishotin e Mançës*, siç e ka provuar historia letrare, vepër të lexueshme dhe në kultura të tjera.

II

Por, katër shekuj pas, pse e si e lexojmë *Don Kishotin e Mançës*?

Kjo pyetje lidhet me pyetje të tjera që, së bashku, kthehen në një *çështje të* madhe: Pse kjo traditë e leximit të veprës?

Lexuesi ynë i parë me shkrim i Servantesit, Fan S. Noli, thotë, sepse Don Kishoti është si ne dhe ne gëzohemi për vuajtjen e tij, meqë s'duam të jemi si jemi. Por, kjo është një ideologji e kthyer në *ideologjikë*, që do të thotë e provueshme në gjithë veprën e Nolit, e cila projekton sa herë që krijon apo që interpreton.

Çështja është e natyrës kulturore e estetike dhe i shenjon veprat si zgjedhje kulturore (të *formimit*), madje universale e estetike (të *pëlqimit*). Kjo na kthen te leximi si mësim, pëlqim e identifikim, por s'e kap edhe leximin që refuzon e nuk pëlqen. Kështu, problemi mbetet i hapur dhe shpjegohet me trashëgiminë, pra me veprën si trashëgimi e si klasikë.

Por, *Don Kishoti i Mançës* ka krijuar traditë të rrallë të leximit me shkrim dhe kjo veprën klasike të *lexuar* e kthen në vepër të *shkruar*, në *temë* të madhe letrare e, përfundimisht, në një *mit letrar*. Kështu, rrjeti i diskursit për *Don Kishotin e Mançës* ndjek rrjetin që vepra ka shtrirë në letërsi të vendeve e të kulturave të *tjera*. Tjetri është hapur për *Don Kishotin e Mançës*, ndërsa vepra është kthyer në zbulesë të hapur, prandaj shkrimi vijon sprovën dhe vetë i bën provat e vjetra e të reja të një *monumenti letrar*.

Shekujt e Don Kishotit të letërsisë e kthejnë traditën në provë *vlerësie* dhe vepra hapet e çliruar nga ideologjia e parë e epokës e kështu provohet *Don Kishoti i Mançës* si një *vepër e mbyllur* (klasike) që lexohet si *vepër e hapur* (U. Eko). Tradita e leximit të kësaj vepre provon se leximi shkon përtej klasemave e tipologjive dhe se vepra e lexuar dhe e rilexuar trashëgohet e krijon trashëgimi të re, e cila klasohet edhe vetë, por harku i leximit mbetet i hapur.

Katër shekuj pas, *kujtesa* e Don Kishotit kapet e strukturuar dhe e provuar, pra me të gjitha shenjat e evidencat, por e hapur. Edhe shenja më autentike e saj kthehet në shenjues të universalitet të frymës e të rrëfimit të Servantesit, si provë për universalitetin e klasikes autentike.

Pyetja fillestare kthehet në çështje të re: çfarë kujtojmë si *autentike* e çfarë si *universale*, madje çfarë si *tonën*?

Ndërsa, kjo na kthen te *Don Kishoti* ynë, për ta parë veprën në gjuhën e në kulturën tonë, madje të lidhur me kulturën e sjelljes, që do të thotë me jetën tonë.

III

Në shqipe, Pjesën e parë të *Don Kishotit të Mançës* e ktheu Noli, në toskërishten e tij, si gjuhë të veprave autoriale, të mbushur leksik vendi e turqizma, *praktikë* që tek ai kthehet në *ideologjikë*, d.m.th. në metodë e në mësim ideologjik.

Leximi krahasues e provon se Noli shkurtoi e shtoi dhe se pjesë të tëra janë interpretime të tekstit të Servantesit që e ruajnë rrëfimin dhe ideologjinë e shqipëruesit e bëjnë rrëfim të Servantesit. Kjo ka të bëjë me filologjinë e me domethënien e veprës dhe kthehet në çështje të autentikes, të provës për tekstin e parë e për *Don Kishotin* e Nolit si përftesë gjuhësore, kulturore e ideologjike, përfundimisht identitare.

Shqipërimi i *Don Kishotit të Mançës*, me gjuhën, figurat, përftesat e idetë, e provon *poetikën* e *ideologjikën* e Nolit, në një nga leximet më autentike e më të çuditshme, por që i bashkohet traditës së leximeve ideologjike të Servantesit, të shenjuar nga vetë kultura autentike e veprës.

Në leximin e tillë, Don Kishoti propozohet për shqiptarët, ndërsa Noli pretendon se ata e kuptojnë më së miri, meqë e njohin të gjallë (më së miri). Vërtet, Don Kishoti i Nolit, *Fisniku* (hidalgo) i kthyer në *Sojli*, vishet me rrobat e me sjelljen që do Noli, së pari si përcaktim ideologjik e pastaj si zgjedhje poetike dhe, nga *personazh*, kthehet në një *person* të ambienteve shqiptare.

Kështu nis e thuret kultura e shkruar e shqiptarëve me *Don Kishotin e Mançës*, përmjet zbulesash, përftesash, projeksionesh e identifikimesh, të cilat marrin në vete edhe jetën e gjallë shqiptare, të matur me fenomenin universal të *donkishotizmit*, që provohet me vepra e me interpretime, përfundimisht strukturuar në trajtën *Don Kishoti te shqiptarët* (A. Aliu).

Shqipërimi e interpretimi i Nolit kthehen në paradigma të leximit shqiptar, me shenja të ambientit e të *kulturës sonë*, të lidhur rreth Don Kishotit *tonë*. Kjo e provon ndërliqësinë e raportit të *autentikes* me *universalen*, të shenjuar në fillim të tekstit, si dhe *donkishotizmin* si fenomen universal, përftuar te leximi, shkrimi e te sjellja. Nga një dramë, *autentik(j)a* e *Don Kishotit të Mançës* provohet si një *universalje* e jetës humane, ndërsa kultura e shkruar vetëm sa bën evidencat si vetëdije për të.

* * *

Por, historia "e vjetër" e autentike e shqiptarëve me Servantesin është e kulturës gojëdhanore, e lidhur me rrëfime, vërtetësia e të cilave s'është e provueshme.

Rrëfimi thotë se Servantesi qe zënë rob nga një pirat shqiptar, i quajtur Arnaut Mami, të cilin emri "e bën" shqiptar. Spanjolli i ditur u mbajt rob, edhe pse miq (të

famshëm) të tij ofruan e paguan rëndshëm për të. Në rrëfimet shqiptare, Servantesi u mbajt rob në Ulqin. Aty njohu një dashuri të madhe, emrin e secilës fikson Dulcinj që zgjedh Don Kishoti për zonjë të zemrës.

Për rrëfimet e kësaj natyre, prova janë kërkuar edhe në histori, edhe brenda tekstit të Servantesit, duke kërkuar shenja që, në interpretimet e tilla, bëhen provë për pretendimet e rrëfyera. Në të dy variantet, Servantesi del i zënë rob nga pirati shqiptar Arnaut Mami dhe i burgosur në Ulqin.

Edhe historia spanjolle ka variantin e vet të robërisë së Servantesit, të përshkruar si një aventurë, në të cilën dalin bashkë pirati shqiptar dhe vitet e robërisë të kaluara në Algjer.

Këto rrëfime e pretendime marrin kuptim në rrafshin *biografik* të autorit, ndërsa në rrafshin letrar janë krejt dytësore. Vërtet, Servantesi nuk u bë i njohur pse luftoi, u zu rob nga piratët, kaloi vite të gjata burgimi në Ulqin apo në Algjer, por se, pasi u kthye në atdhe, shkroi *Don Kishotin*, kryeveprën e tij.

Don Kishoti, siç kanë nënvizuar e provuar studiues të letërsisë e të kulturës, ka një histori kulturore (të shkruar) me shqiptarët, të filluar me përkthimin e pjesës të parë të *Sojliut mendjemprehtë Don Kishoti i Mançës* prej Fan Nolit e të publikuar në trajtë libri, më 1933. Rreth një shekull histori me Don Kishotin, që provon shekuj të tërë *donkishotizmi*. Kësaj historie i bashkohet ajo e receptimit të Don Kishotit si temë apo si figurë letrare në tekstin letrar shqip, variantet e tij, autorët që zgjodhën atë dhe trajtat në të cilat e dhanë.

IV

Më 1933, i mundur e i humbur, Fan S. Noli, një nga figurat më të njohura të kulturës e të jetës politike shqiptare, botoi në shqip Pjesën e parë në shqip të *Sojliu mendjemprehtë Don Kishoti i Mançës* të Servantesit. Vërtet, pjesë-pjesë ai e kishte botuar që më 1931, te revista *Republika* e Bostonit. Edhe vëllimi i parë i *Sojliut* doli po në Boston Mass. Noli provohej me gjuhën e Servantesit, me kastiliançen/spanjishten e tij, të epokës së tij, në formën e gjerë të romanit të madh të Servantesit.

Në tekstin e shqipëruar të Servantesit gjejmë aq shumë kontekst e jetë shqiptare e kjo forcohet kur leximin e fillojmë me *Introduktën* e tij për *Don Kishotin*, e cila është një lexim i hapur ideologjik i kontekstit shqiptar, lexim i jetës politike shqiptare përmjet tekstit të Servantesit, madje edhe i veprimit politik të Nolit, ish-kryeministër iShqipërisë. Këto janë shenja për të lexuar edhe këtu, edhe një herë, *Introduktën* e njohur të Nolit, dhe duke parë se si ka lexuar Noli, vërtet, ata që kanë mall, do të mësojnë edhe se si ka *shqipëruar* ai. Ndërsa, të dy këto mësohen më së miri, duke e parë se si kthehet *Hidalgo*-ja i Servantesit në *Sojli* të Nolit, përmjet *ideologjisë* e *poetikës*, pra përmjet *ideologjikës* noliane.

Vetë titulli, i lidhur me nuancat gjuhësore e ambientale të *Sojliut*, jep shenjat e para të motivimit të shqipëruesit, të parimit të *shqipërimit* dhe të natyrës së interpretimit të tekstit. *Introdukta*, e vënë si paratekst i veprës së Servantesit, anticipon *Sojliun* ashtu si e përfton *shqipërimi* i Nolit, teknika e bërë ideologji *përkthimi*. Vetë Noli do që përmjet interpretimit të orientojë leximin, të përgatisë lexuesin për ta takuar *Sojliun* e tij në ngjyrat që i dha ashtu si do vetë.

Që Noli u largua nga teksti autentik i Servantesit, në rrafshin tekstor, por dhe të interpretimit, duket e thuhet ngado. Ka që kërkojnë përkthim të ri të *Don Kishotit*, për të rigjetur Don Kishotin e *fshehur* nga Noli (A. Tufa). Ndërsa, është krejt e dukshme që ideologjia me të cilën *veproi* Noli, prodhoi Don Kishotin e tij, të stisur për ballkanasit e për shqiptarët, një pasqyrë në të cilën do të gjenin fytyrën e tyre në ambientin e tyre.

Vërtet, Don Kishoti, Kalorësi i Fytyrës së Vrerosur, ka marrë *fytyra* të ndryshme, në vende e kultura të ndryshme, qoftë kur është interpretuar, qoftë kur është (ri)shkruar. Në të dy rastet, ai është kthyer në *mjet* përdorimi, në figurë që humb qenësinë e parë (estetike) e që lidhet me etikat e ideologjive të vendeve e të kohëve, ndërsa, edhe brenda kulturës së vendit, ai është lexuar për t'u *përdorur*, si figurë që mban simbolikën e "reaksionarit" apo të "revolucionarit", madje të një misionari të krishterë universal që lidh religjionin me monarkinë. Ky është qarku ideologjik e politik, madje "laku" që i kanë lidhur rreth qafës Don Kishotit lexuesit e tij (me shkrim).

Një lexues është edhe Noli ynë, i mësuar me paradigmat për të cilat po flasim. Ai vetëm sa ua shton këtyre paradigmave një kontekst të ri, që s'ka si t'i pasurojë, meqë vetë është reduksionist. Të gjitha leximet kontekstuale cenojnë natyrën universale të shkrimit e të leximit. Reduksionisti Fan Noli fisnikun e vjetër, e bëri Sojli të ri, të zakonshëm për ambientet e Shqipërisë së tij.

V

Introdukta e Nolit hapet me të dhëna biografike për Servantesin, përfshirë klasën sociale. Në këtë pikë, ai lidh nyjë autorin e veprën dhe shenjon tipin e interpretimit të tij. Poetika që ka përftuar *Sojliun mendjeprehtë* tretet në interpretimin ideologjik të Nolit, mbushur retorikë e etiketa, që u ngjiten klasëve sociale, të cilat më parë se në tekstin e Servantesit, introduktori i gjen në kontekstin shqiptar të epokës së tij. Don Kishoti e Sanço Pança, të lidhur me "kllasët" e "bejlurçinës" e të "larove", pronarë e shërbëtorë, që Noli i gjen ngado hapësirave të Ballkanit e fshatrave të Shqipërisë, janë "klasët e rëna", që kanë humbur bazën e jetës dhe punën dhe ëndërrojnë të kthejnë kohët e tyre. Këta janë "reaksionarët" që portretizon e që projekton Noli në tekstin e Servantesit. Në leximin e nuancuar fort ideologjikisht, ngatërrohen idetë e shqipëruesit, figurat e jetës shqiptare dhe idetë e figurat e spanjollit të madh.

Noli mëson se për të kuptuar rrëfimin e Servantesit, duhet të kuptojmë klasët sociale të epokës së shkrimtarit, fisnikun e vogël, të rënë e të mbaruar, dhe fshatarin e varfër e të paditur, që ndjek mjeshtrin e tij. Vërehet klasifikimi social që njeh dhe dallimet kulturore *i ditur / i paditur*. Por, që të dy bëhen bashkë, jashtë kohës së tyre, të mbaruar e të harruar, ndaj mbahen fort në aventurën e madhe për të kthyer çfarë nuk ka si kthehet më.

Duke ndjekur ideologjinë e Nolit, që figurat e klasët e tilla i projekton në jetën e gjallë shqiptare, është lehtësisht e dallueshme se *me kënd e ka*. Ashtu si Don Kishoti kërkon Spanjën e lënë në Spanjën moderne, Don Kishotët shqiptarë kërkojnë kthimin e kohës së tyre që, në leximin e Nolit, është kohë e Perandorisë Osmane. Nga këtu, duke lexuar ashtu si na mëson Noli, kalohet te ngjyrimet politike që u jep përftesave të veta në tekst apo në ambient. Ai bën portretin (ekspresionist) të Shqipërisë, në kërkimin e projektimin e shenjave të zeza të jetës sociale e politike të saj.

Noli, në ngushticat e leximit të tij, pranon popullaritetin e *Don Kishotit*, por argumenti është i vjetri: të tillët, "bejlurçina" e "laroja", janë ngado dhe përherë kanë qenë qesharakë emë qesharakë bëhen, kur nisin aventurën e pangjarë për të kthyer rrotën e historisë. Qesharakja kurorëzohet me përfundimin e njohur të tyre. "Kur bëhen qesharakë dhe hanë dru, doemos këndonjësit gëzohen, se në fytyrën e tyre bëhen qesharakë dhe hanë dru dy kllasët shoqërore më të urryera dhe më prapavajtëse, kllasi i bejlurçinës dhe kllasi i larove. Se këta i ka patur mileti mbi kokë si oficerë, si nëpunës, si ushtarë, si zaptie, si komitaxhinj, si hajdutë, si qehajanj, shkurt si vegla dhe agjentë të feodalëve e të shtetit feodal. Kur rrihen këta, mileti ndien atë gëzim që quajnë gjermanët Schadenfreude, se i ngjan një mjerim armikut", shtrin ideologjinë e interpretimit Noli, të njohur edhe si lexim "origjinal" (A. Plasari).

Por, edhe vetë Noli, nën pushtetin e *kujtesës së tekstit* të Servantesit e të leximeve të tjera, *kujtohet* se *Don Kishoti* nuk është një vepër vetëm për të qeshur, por edhe për të qarë, sepse Don Kishoti është një idealist, në gjithë kuptimin e fjalës, që të gjitha i bën për të mirën e njerëzimit dhe jo nga ndonjë interes vetjak. Noli vajton se këto shkojnë kot, meqë janë vënë në shërbim të "reaksionit". Kështu shmanget përfundimisht bota simbolike e *Don Kishotit*, e mbruajtur nga fisnikëria e nga shpirti i lartë, e lidhur përjetë me luftën për drejtësi.

Me ngjyrat, madje me nuacat e kësaj ideologjie klasore e bën Noli portretin e *Sojliut* të tij, si një hije në jetën shqiptare të Don Kishotit që ka parë ai te Servantesi. *Sojli* i rënë, i varfëruar e i harruar, një "anakronizmë ambullante", shoqëruar, në aventurën e marrë për të kthyer çfarë ka perënduar përjetë, nga sejmeni i papunë e i paditur. I lidhur fort për *Sojliun* e tij, me shenjat që jep në *Introduktë*, Noli e zbulon ideologjinë që ka përftuar tekstin e *Don Kishotit* në shqip. Interpretimi i jashtëm i Nolit, i thurur tek *Introdukta*, si ai i brendshmi i shqipërimit (brendashkruar tekstit të Servantesit), në përftesa stilistike/ideologjike, shenjojnë paradigmën shqiptare të leximit (josimbolik) të *Don Kishotit*.

VI

Kalorësi i Fytyrës së Vrerosur, *autentik*, *universal* apo *i yni*, është luftëtar i së drejtës dhe i së vërtetës së humbur, hero tragjikomik, ëndërrimtar i pandreqshëm, që herë na kujton kotësinë e virtuales e herë na çon nga ajo si drejt shpëtimit. Një figurë e madhe dhe e dashur e kulturës, përjetë shoqëruar nga gazi e dhemshuria.

Don Kishoti i Servantesit është *Fisniku* me mendje në ethe, luftëtari i gjasmuar, heroi pa asnjë armik konkret, që shpik e trillon kundërshtarët dhe që do të kthejë kohët e historitë që s'kthehen.

Historia është unike, ndërsa *narrativa* e *Don Kishotit* përsëritet pakufi, kudo e kurdo përmbushim natyrën humane që kërkon të ketë ato që nuk i ka, kurdo që qenia i jep krah imagjinatës pafund, për ta parë e për ta jetuar veten ashtu siç duam, pra ashtu siç nuk jemi.

Vërtet, ky është një manifestim i idealit që ndjek njeriu, ashtu siç Kalorësi i arratisur gjasmon njerëz e sende, kohë e vende, për të plotësuar "detyrën" e tij, të rikthejë drejtësinë e humbur.

Vetëm një kalorës i një kohe tjetër do të mund ta bënte këtë, ndaj Don Kishoti, *fisniku i rënë*, e kujton të shkuarën si të sotme. Në cep të këtij leximi, do të hapnim simbolikën e pavërejtur të dëshpërimit të thellë, meqë drejtësia e nderi janë të pamundura dhe nuk kanë si të kthehen, kanë mbetur prapa, në një kohë tjetër dhe vetëm në *fiksione* mund të gjenden. Ndërsa, kur dalim në jetë, gjithçka kthehet në parodi e në tallje.

Një Don Kishot kësilloj do të na thërriste që të lexonim *librat* që ka lexuar ai, në një raport, aspak të *kohës*, por krejt *autentik*, prandaj të ndërliqshëm.

Por, a do të ishte ai Don Kishoti ynë?

Kjo është një çështje tjetër e për një rast tjetër.

Kujtim M. SHALA

THE OTHER HISTORY OF ALBANIAN (A SKETCH)

Abstract

The other history of Albanian forms the outline of the parallel history of Albanian literature, related to phenomena such as the other language, Albanian themes of other languages, universal genres, all of which are interconnected as issues of the identity of literature once we ask if identity is determined by language, by theme or by genre, or whether these intersect. Thus, the other History problematized the first History of Albanian (the History of Albanian literature) which is related to language or

ethnicity/nationality and opens itself into universality as knowledge which reads Albanian literature in the circles of other literatures. Presented in sketch form, the issue is raised and proposed, it provides signs of evidence and then evidence of another view of Albanian literature. At the origin of the phenomena that the other History marks is found the language of the other, attempted in literary variants of universal themes, a problem that appears early in orality and which literality repeats in its history. The variant of the discourse of the other History moves beyond the point of view of influences and recognizes the universality of literary themes, first marked as bilinguality, delineated in ambient and national themes as literary and identity signs. Thus, the other History regards literature in the form of variants, based on the knowledge that the variation that is most authentic will prove the greatest universality. Conclusively, the other History is marked as an authentic History of Albanian, in the landmark in which it meets the universal literary History.

Muhamet HAMITI

SHEKSPIRI NË 400-VJETORIN E VDEKJES

Jeta: si u bë Shekspiri Shekspir

"E gjithë bota është skenë/Dhe gjithë burrat dhe gratë thjeshtë aktorë". ("All the world's a stage/And all the men and women merely players.", *As You Like It*, II, vii.139) thotë Zhaku (Jacque) në *Si ta doni*, dhe kjo "E gjithë bota është skenë" bëhet një metaforë e teatrit dhe e jetës njëkohësisht. Po flasim për Shekspirin sot.

"He was not of an age, but for all time!" (Ai nuk ishte i një epoke, por i të gjitha kohërave") shkruante poeti e dramaturgu anglez Ben Xhonson (Johnson), bashkëkohaniku i Uilliëm Shekspirit (William Shakespeare) në poezinë "Në kujtim të mjeshtrit tim të dashur Uilliëm Shekspirit dhe asaj që na ka lënë", në vitin 1623, shtatë vjet mbas vdekjes së shkrimtarit, me rastin e botimit të përmbledhjes së 36 të dramave të tij në një vëllim, që njihet si 'Folio e Parë', që doli nën përkujdesjen e dy miqve dhe anëtarëve të ansamblit të tij teatror, "The King's Men" (Njerëzit e Mbretit), Xhon Heminxhis (John Hemminges) dhe Henri Kondell (Henry Condell).

Të dhënat për jetën e Shekspirit janë të pakta. Uilliëm Shekspiri ka lindur me gjasë më 23 prill 1564 dhe ka vdekur më 23 prill 1616. Data e vdekjes duket më e sigurtë, ndërsa e lindjes derivohet nga pagëzimi që është regjistruar në famulli më 26 prill. Zakonisht pagëzimi bëhej tri ditë mbas lindjes në atë kohë.[1] Arsyeja e vdekjes së tij në moshën e hershme 52-vjeçare nuk dihet, ndonëse mendohet se ka lënguar nga sëmundja për kohë të gjatë. Si mundësi e shkaktarit të drejtpërdrejtë përmendet pija e tepërt në një ndejë në Stratford me miqtë e kolegët e tij, Ben Xhonson dhe Majkëll Drejtën (Michael Drayton).[2] Është martuar në moshën 18 vjeçare, me En Hethëuejn (Ann Hathaway), tetë vjet më e moçme se ai. Martesa s'duket të ketë qenë e lumtur. Një vajzë, Suzana (Susanna), i lindi më 1583, ndërsa binjakët Hamneti dhe Judita (Judith) më 1585. Hamneti, djali i tij i vetëm, i vdiq më 1596. Shekspiri shkoi në Londër ndoshta më 1587, ku punoi fillimisht si aktor. Për herë të parë si shkrimtar përmendet në vitin 1592, kur ishte 28 vjeç. Ka shkruar ekskluzivisht për kompaninë teatrore "Lord Chamberlain's Men" (Njerëzit e Lordit Çembërlen), më vonë "The King's Men" (Njerëzit e Mbretit), në të cilën shërbente si dramaturg dhe mbante edhe

[1] Stephen Greenblatt, *Will of the World: How Shakespeare Became Shakespeare*, W. W. Norton & Company, New York – London, 2004, f. 18.
[2] Harold Bloom, *Shakespeare: The Invention of the Human*, Fourth Estate, London, 1999, f. 397.

aksione. Për dallim nga kolegët e tij dramaturgë, Shekspiri ia doli mirë ekonomikisht, madje të blinte një nga shtëpitë më të mira në qytetin e tij të lindjes; poashtu edhe tokë. Shekspiri ka bërë çmos dhe ia doli mbanë ta kthejë statusin e familjes si derë e madhe, që kishte rënë një kohë. Me këtë edhe të drejtën me pasë stemë të familjes dhe burrat me e quejtë veten zotërinj (gentlemen). Nuk janë ruajtur dorëshkrime të tij, përveç njërit,[3] testamentit,si dhe ndonjë nënshkrimi në dokumente të natyrës juridike-civile. U kthye të jetonte në Stratford më 1610, ndërsa pas vitit 1613, kur shkroi *Dy kushërinj të fismë* (bashkë me Xhon Fleçerin) mbylli karrierën si dramatist. Dramat e tij për *Henrin VI* me gjasë janë veprat e tij të para, po të mos merret parasysh mundësia që ai ta ketë shkruar *Hamletin* e parë (*Ur-Hamlet*), e jo Tomas Kidi (Thomas Kyd), siç mendohet përgjithësisht, dikund në mes viteve 1589-1593). Sonetet i shkroi në mes viteve 1593-1609. *Hamletin*, kryeveprën e tij, dramën më të gjatë, me gati 4000 vargje, e shkroi në vitet 1600-1601, mbasi që një vit më parë (1599) kishte shkruar tri, *Henri V*, *Jul Cezari* dhe *Si të doni*. *Othello*, *Mbreti Lir*, *Makbethi* dhe *Antoni dhe Kleopatra* i shkroi në vitet 1604-1606, që dëshmon për intensitet të hatashëm pune krijuese në këtë kohë.

Uilliëm Shekspiri (1564-1616) ishte varrosur në qytezën Stratford-upon-Avon, në vendlindjen e tij, dhe jo në 'këndin e poetëve' në Abacinë e Uestminsterit (Westminster Abbey) në Londër, aty ku ishin varrosur Xhefri Çoseri (Chaucer) dhe Edmund Spenseri më herët, kurse Ben Xhonsoni më vonë, ndoshta pse shoqëria bashkëkohore nuk e shihte madhështinë e tij sikur kolegu i vet Xhonson. Një përmendore në këndin e poetëve i kanë ngritur vetëm në vitin 1741. Kur vdiq Shekspiri shihej si njëri nga yjet në yllësinë teatrore dhe jo si ylli më i shndritshëm.

Shekspiri dhe rivalët e tij

Shekspiri ka shkruar në një epokë të artë të poezisë dhe dramës angleze. Pjesa e madhe e shkrimtarëve kanë qenë njerëz me arsimim universitar; por jo Shekspiri. Dramaturgu më i madh për të gjallë të tij ka qenë autori i *Dr. Faustit*, Kristofer Marlou (Christopher Marlowe), moshatar i tij. I njohur si krijues i dramës së hakmarrjes është Tomas Kidi. Edhe Ben Xhonsoni hyn në radhën e shkrimtarëve rivalë të tij. Shekspiri është matur me ta dhe i ka mundur. Më vështirë e ka pasur të dalë prej orbitës së Marlout.

[3] Janë ruajtur tri faqe të një dorëshkrimi të një drame për Sër Tomas Morin (Thomas More), autorin e *Utopisë*së famshme, që janë identifikuar si të Shekspirit në bazë të dorëshkrimit, vokabularit, ortografisë dhe imazheve dhe ideve që shpreh. Vepra ishte shkruar fillimisht nga Entoni Mandei (Anthony Monday) ndërmjet viteve 1596-1601. Shekspiri dhe tre dramaturgë të tjerë rishikuan tekstin, mbasi që censura nuk e kishte lejuar shfaqjen e dramës, nga frika e trazirave qytetare në rrugët e Londrës. Kontributi i Shekspirit përfshin 147 vargje në mes të syzheut, kur Morit i kërkohet t'i drejtohet një turme anti-imigrantësh.

Vrasja e Marlout në një pijetore më 1593 ka qenë me gjasë ekzekutim, i urdhëruar nga shteti. Marlou ka qenë pjesëtar i shërbimit sekret të shtetit. Edhe Tomas Kidi ishte torturuar nga shteti. Kidi kishte shkruar veprën e tij të njohur, *Tragjedia spanjolle*, dramë e hakmarrjes, në mes viteve 1588-1592. Një dorë studiuesish mendojnë se kjo tragjedi ka ndikuar te *Hamleti*. Një supozim më racional është të mendosh se Hamleti i parë i Shekspirit ka ndikuar te *Tragjedia spanjolle*, simbas Harold Bllumit, i cili njxerr këtë përfundim të habitshëm duke parë vlerën minore të *Tragjedisë* karshi *Hamletit*.[4]

Fati i Marlout dhe i Kidit ka bërë që Shekspiri të ishte shumë i kujdesshëm në raportet e tij me pushtetin.

Shekspiri me të tjerët: burimet dhe syzhetë

Shekspiri ka bashkëpunuar me dramaturgë të tjerë në fillim dhe në mbarim të karrierës së tij. Mendohet se një nga veprat e tij më të mëdha, *Makbethi*, në variantin aktual, është rishikuar nga Tomas Midëllton (Thomas Middleton). Me Xhon Fleçerin (John Fletcher) ka shkruar *Henrin e VIII-të* (fillimisht me titull *Gjithçka është e vërtetë* – *All Is True*), sikurse edhe *Dy kushërinj të fismë* (Two Noble Kinsmen), bazuar në Çoserin (Geffrey Chaucer, "The Knight's Tale"), dhe *Cardenio*, dramë e humbur, që, prej titullit, mendohet të jetë bazuar në episode nga pjesa e parë e *Don Kishotit* të Servantesit. Poashtu mendohet se ka redaktuar dramën *Sër Tomas Mori*, shkruar nga Enthoni Mandei (Anthony Munday) dhe Henri Çetëlli (Henry Chettle), mbasi drama kishte pasur probleme me censurën, siç u vu re në fusnotën numër 3.

Shekspiri shfrytëzoi të shumtën e herëve materiale që ishin në qarkullim për syzhetë e veta. Vetëm tri vepra të Shekspirit (*Shtrëngata*, *Mundimet e humbura të dashurisë* dhe *Një ëndërr vere*) nuk bazohen në ndonjë burim parësor. "Shpikja e syzheut nuk ishte dhunti e Shekspirit; natyra ia kishte mohuar këtë talent dramatik", konstaton Harold Bllum.[5]

Shkrimtari anglez njohu veprën e bashkëkohanikut të tij të madh, spanjollit Servantes. Romani i Servantesit *Don Kishoti* (pjesa e parë, botuar së pari më 1605) u botua në anglisht më 1612. Më 1613 Shekspiri dhe kolegu i tij më i ri Xhon Fleçeri nisën dramatizmin e historisë së Kardenios (Cardenio) të çmendur prej dashurie që ishte thurur në aventurat e kalorësit të lojtur mendsh të Servantesit. Kjo dramë ka humbur.

Disa nga vendndodhjet e dramave të Shekspirit janë: Sicilia, Venediku, Roma, Qiproja, Elsinori (Danimarka), Anglia rurale, Egjipti, Tiri, Bohemia, por edhe Iliria.

[4] Bloom, po aty, f. 392.
[5] Bloom, po aty, f. 149.

Përmenden disa piratë të Mediteranit në dramat e Shekspirit. Te *Henri VI*-të, Pjesa e Dytë, përmendet "Bargulsu the strong Illyrian pirate' (4.1.110). Në *Natën e Dymbëdhjetë*, që vendoset në Iliri, Antonio akuzohet se është pirat. Në *Masa për masë*, vdekja në burg e një 'Ragozine, a most notorious pirate' (4.3.54) i jep fund syzheut. Emri i tij të kujton Raguzën (tash Dubrovnik), qytetin port në territorin e Ilirisë së dikurshme.[6]

Shkrimtar anglez apo britanik?

Uilliëm Shekspiri njihet si shkrimtar universal; vepra e tij trashëgimi e mbarë njerëzimit. Mirëpo, a është shkrimtar anglez apo britanik në radhë të parë? Gjatë sundimit të Mbretëreshës Elizabeta (deri më 1603) ai e shihte veten anglez. Kishte shkruar drama me tematikë nga historia e Anglisë. Në dramat historike që shkroi në dekadën e mbramë të shekullit XVI, Shekspiri i referohej vendit të vet si Angli. Mirëpo, nën sundimin e Xhejmsit VI-të të Skotlandës (tash edhe Xhejmsi I i Anglisë) dramaturgu shkruan edhe për tematikë 'britanike', sidomos te *Simbelini* (Cymbeline), i njohur edhe si *Simbelini, Mbreti i Britanisë*, e shkruar në vitin 1610, një imagjinim i historisë së lashtë britanike për Kunobelinin (Cunobelin). Shekspiri krijon një fantazi historike që trajton trashëgiminë e moçme të kurorës britanike, e lidhur me mbretin e hershëm kelto-britanik, mbretin vasal të Perandorisë Romake.

Mbreti skocez, që u bë edhe mbret i Anglisë, mëtonte të krijonte një shtet britanik. Entiteti i ri ishte 'Britania e Madhe' në përbërje të së cilës ishin Anglia, që kishte tashmë nën sundim Irlandën dhe Uellsin, dhe Skocia. Unioni i plotë Angli – Skoci do të ndodhte nja njëqind vjet më vonë, më 1707.

Kulti i Shekspirit

Kulti i Uilliëm Shekspirit është kthyer në një besim shekullar në këto 400 vjet të përjetësisë së tij. Autor i tridhjetë e nëntë veprave dramatike (numri varion prej 36 deri në 39, në varësi të atribuimeve të veprave, disa syresh si bashkëpunim me të tjerë) e i 154 soneteve, poet e dramatist, por edhe prozator (Falstafi ta zëmë flet në prozë, ndërsa Hamleti në poezi, nëse marrim dy karakteret kryesore të tij). Mjeshtër i gjuhës, sipëror madje ndaj të mëdhenjve në anglisht pas tij, Xhon Miltonit (John Milton) në shekullin XVII dhe Xhejms Xhojsit (James Joyce) në shekullin XX. Ai na ka mësuar të kuptojmë natyrën njerëzore, pohon Harold Bllumi (Bloom), që e sheh si qendër të palëvizshme të kanonit perëndimor dhe e quan "zot vdektar"; herë tjetër të tillë zota i sheh karakteret më të njohur të tij Falstafin dhe Hamletin, si ndërgjegje më tërësore në

[6] Jonathan Bate & Dora Thornton, *Shakespeare: Staging the World*, The British Museum Press, London, 2012, f. 235.

gjithë letërsinë, por edhe Jul Cezarin.[7] Ky kritik amerikan (transcendentalist, gnostik me orientim, siç thotë për vete, kundërshtar i madh i modës së vonshme të studimeve kulturore dhe i praktikës teoriko-letrare franceze të shekullit XX) ka nxitur kundërshtimin e shumë dijetarëve të letërsisë kur ka thënë se Shekspiri na ka shpikur. *Shekspiri: Shpikja e njerëzores*, vepra e tij madhore për Shekspirin, është botuar në vitin 1999. Bardolatria e tij shkon deri aty sa të konstatojë së ai ishte shkrimtari i parë universal dhe se ai kishte formësuar anglishten e hershme moderne.[8] Kjo anglishte për dikë shihet si pengesë sot, madje në radhë të parë për lexuesit në origjinal. Nganjëherë flitet për nevojën që Shekspiri të përkthehet në gjuhën e sotme angleze. Ata që e lexojnë Shekspirin në përkthime kanë përparësi ndaj lexuesve në origjinal, sepse përkthyesit ua lehtësojnë kuptimin lexuesve në gjuhët e botës.[9]

Shekspiri është letërsia e tij, poezia dhe veprat dramatike: komeditë, dramat historike, tragjeditë. Shekspiri është shkrimtari që krijoi galerinë më të madhe të personazheve në letërsinë angleze: mbretër, princa, nëpunës e shërbëtorë. Shkroi për aristokraci e vulg; kënaqi elitën dhe argëtoi të pashkollët. Krijoi disa nga personazhet duke pasur parasysh aktorët që kishte në dispozicion, duke përfshirë veten. Krijoi Hamletin, kryepersonazhin e tij letrar, një nga mitet e mëdha moderne, figura më e cituar e ndërgjegjes perëndimore pas Jezu Krishtit, siç e thotë kritiku amerikan Harold Bllum. Shekspiri ka bërë regjinë e veprave të veta dhe është e sigurtë që ka luajtur vetë Fantazmën te *Hamleti* dhe plakun Adam te *Si ta doni*.

Shfaqjet në kohën e Shekspirit jepeshin në dritë të ditës, mbasditeve, në teatro nën qiell të hapur. Kemi parasysh Teatrin "Globi" që u ndërtua më 1599 dhe u bë shkrumb e hi nga zjarri në qershor të vitit 1613, teksa luhej *Henri VIII*. U rindërtua shpejt, këtë herë me kulm të mbuluar me tjegulla (fillimisht i kishte me kashtë), por u mbyll më 1642, kur administrata puritane angleze mbylli të gjithë teatrot. U rrënua dy vjet më vonë për t'u lëshuar vend ndërtesave të banimit. "Globi" u ringrit në fund të mileniumit të kaluar, më 1997, dhe funksionon si i tillë – teatër me skenë nën qiell të hapur, njësoj replike e "Globit" të parë.

---

[7] Bloom, po aty, ff. 3-4, f. 113.

[8] Bloom, po aty, f. 10.

[9] Shkrimtari ynë Ismail Kadare thotë se Fan S. Noli i ka dhënë gjuhës shqipe "një ndër më të bukurit, në mos më të bukurin përkthim të *Hamletit* në botë". (Ismail Kadare, *Hamleti, princ i vështirë*, Onufri, 2006, f. 114). Edhe kjo e Kadaresë, si e Bllumit, është bardolatri sipërore, natyrisht. (E pamundshme është të nominohet përkthimi më i mirë në botë. Sepse, kush është në gjendje të krahasojë e përqasë krejt përkthimet?) Më tej në këtë sprovë, Kadare thotë se gjatë gjithë shekullit XX, *Hamleti* ishte ndoshta, vepra më popullore ndër shqiptarë. "Shprehje si e famshmja 'to be or not to be', që në shqip, ' të rrosh a t mos rrosh', tingëllonte pothuajse si në origjinal, përdoreshin gjerësisht në gjuhën e përditshme. Në letrat e dashurisë së djemve të rinj, ofshamat e Hamletit për Ofelinë: 'thuaj yjet s'janë zjarr' etj, ishin kthyer gati-gati në formula, që mbushnin letrat e dashurisë" (f. 119). Në të vërtetë Hamleti e mohon se e ka dashur ndonjëherë Ofelinë, dhe Harold Bllumi i beson. (Bloom, f. 88). Sido që të jetë, formula dashurore ka mbetur!

Historia e ngritjes së Shekspirit në piedestal në shekujt e fundit, por edhe gjeografia e shtrirjes së veprës së tij gjeniale është e pakundshoqe. Në Evropë francezët i kanë rezistuar më së shumti kësaj ngritjeje të 'gjeniut barbar', siç i kanë thënë në kohën e Klasicizmit. Dramaturgu Xhon Drajden (John Dryden) te *Eseu mbi artin dramatik* (1688) mbrojti praktikën krijuese të Shekspirit në fund të shekullit XVII, në një bisedë të imagjinuar ndërmjet katër miqve që, teksa lundrojnë mbi Temzë, diskutojnë për meritat e dramës antike greke, të dramës bashkëkohore (të Restoracionit në Angli), të dramës neo-klasike franceze të shekullit XVII, si dhe të dramës së epokës së fundit (Shekspirit). Neander (alias Drajdeni) mbron Shekspirin ndaj akuzave se ka përzier zhanret (në tragjikomedi). Ka shterpësi të syzheve franceze, karshi llojllojshmërisë dhe bollëkut të syzheve angleze, thotë ai,dhe konstaton: "Syzhetë tona janë thurur në avlëmende angleze". Kritiku anglez i gjysmës së dytë të shekullit XVIII, Semjuëll Xhonson (Samuel Johnson), kishte përgatitur veprën e Shekspirit dhe thoshte në Parathënie se ai po fitonte më në fund 'dinjitetin e një shkrimtari të lashtë', mbasi kishte kaluar shekullin e testit të meritave letrare. Ligjërata për Shekspirin ka mbajtur romantiku anglez S.T. Kolrixh (Coleridge), i cili në veprën e madhe testonte teorinë e vet për 'fantazinë' dhe 'imagjinatën', si dhe 'formën mekanike' dhe 'formën organike'. Më i riu i romantikëve anglezë, Xhon Kits (John Keats) farkëtoi termin 'aftësi negative' teksa përkufizonte aftësinë e njeriut për 'të qenë në pasiguri, mistere, mëdyshje, pa kërkuar me ngulm faktin apo arsyen' ("Negative Capability, that is, when man is capable of being in uncertainties, mysteries, doubts, without any irritable reaching after fact and reason"). Poeti i aftësisë negative bëhet poeti objektiv, impersonal, në terminologjinë e shekullit XX. Kritiku ndoshta më i madh i Shekspirit është edhe sot, pas njëqind vjetësh, Endru Sesil Bredli (A.C. Bradley) jo vetëm me veprën e tij kapitale *Tragjedia shekspiriane* (ligjërata për *Hamletin*, *Othellon*, *Mbretin Lir* dhe *Makbethin*), botuar në vitin 1904, por edhe me ese të tjera për Shekspirin.

Ndërsa francezët i kanë rezistuar Shekspirit për një kohë të gjatë, gjermanët me Gëten (Goethe) e kanë përqafuar dhe kooptuar në kulturën e vet. Kështu kanë bërë shumë kombe. Kështu kanë bërë edhe shqiptarët, nëse përjashton epokën e diktaturës së Enver Hoxhës, e cila e shihte me dyshim krijimtarinë që ishte në kundërshtim me doktrinën e realizmit socialist. Megjithatë nuk kanë mundur ta ndalojnë krejt, ndërsa përkthimet në shqip kanë bërë jetën e vet të gjallë në Shqipëri e në Kosovë. Fan Noli ynë është poaq i identifikueshëm me Shekspirin sa me *Historinë e Skënderbeut*, apo poezinë e vet. Shqipja ka dëshmuar fuqinë e vet kur ka kthyer anglishten e Shekspirit në gjuhën tonë amtare.

Shekspiri në raport me politikën, pushtetin dhe religjionin

Mbetet e panjohur se cilat kanë qenë qëndrimet politike të Shekspirit, përkatësia e tij religjioze a pikëpamjet e tij filozofike. Njëfarë leximi i *Jul Cezarit* të jep me kuptue se të dyja palët në luftën civile pas vrasjes me atentat të Cezarit janë më të këqija se Cezari vetë, njëfarë tirani i mirë. Diçka si Mbretëresha Elizabeta, do të mund të thuhej po të perspektivizohej drama në kohën e tij. Shekspiri nuk donte të rrokej me pushtetin. As në lidhje me religjionin. Babai i tij me gjasë ishte katolik. Shekspiri mund të ishte një kriptokatolik. Katolikët ishin të persekutuar në Angli atëherë.

Ishte krijues që veproi afër rrethit mbretëror, si në kohën e Mbretëreshës Elizabeta I ashtu edhe të Mbretit Xhejms I. Censura e teatrit ishte e fuqishme në atë kohë dhe për shumë kohë më vonë. Mbretëresha Elizabeta I dhe Mbreti Xhejms nuk kanë parë shfaqje në hapësirë publike teatrore. Teatri ka shkuar tek ata, për raste ceremonish, natyrisht. "The King's Men" ishin në shërbim të Mbretit.

Ndoshta lavdin më të drejtpërdrejtë Mbretëreshës Elizabeta shkrimtari ia ka bërë te *Një ëndërr vere*, me fjalët e Oberonit: 'fair vestal, throned by the west" (II.i. 159) (virgjine e papërlyer, kurorëzuar nga perëndimi) ['vestal' nga Vesta, mbretëreshës së virgjër romake të vatrës, shtëpisë dhe familjes]. Shigjeta e Kupidit nuk e plagos Mbretëreshën e Virgjër në këtë fantazi përrallore të Shekspirit. Mbretëresha nuk u martua, as la trashëgimtar. Si rrjedhojë, mbreti Xhejmsi Skocisë u bë edhe mbret i Anglisë.

Tregtari i Venedikut është një vepër anti-semite, ndonëse vështirë të thuhet se Shekspiri ka qenë anti-semit apo filo-semit vetë. Çifutët ishin përzënë nga Anglia më 1290 me dekret të Mbretit Eduardi I, ndërsa u pranuan sërish pas revolucionit kromuellian në mes të shek. XVI. Studiesi i letërsisë Northrop Fraj e quante këtë dramë të krishterë për një publik të krishterë. Si Shajlloku (Shylock), Shekspiri ka qenë njeri që ka dhënë para hua, dhe i zoti në punët e biznesit.

Temat aktuale politike dhe fetare mund të trajtoheshin vetëm tërthorazi për shkak të kufizimeve ligjore. Një proklamatë e vitit 1599 ndalonte shfaqjet që trajtonin "çështje fetare apo të qeverisjes' sepse këto mund të diskutoheshin vetëm prej "njerëzve me autoritet (pushtet), dije dhe urtësi![10]

Sonetet

Të 154 sonetet që shkroi Shekspiri u dedikohen një Zonje hijerëndë (Dark Lady) dhe Mr. W. H., që mund të ishte Henri Rajothesli (Henry Wriothesley), konti i Sauthemptonit (3rd Earl of Southampton), apo Uilliëm Herbert (William Herbert), patron/sponsorizues në zë, konti i Pembroukut (3rd Earl of Pembroke), me të cilin

[10] Stanley Wells, *Shakespeare & Co.*, Pantheon Books, New York, 2006, f.5.

Shekspiri kishte relacion. Të 126 sonetet e para i dedikohen një djali të ri, kushdo të ketë qenë, sepse argumenti që shkon kundër teorisë se u kushtohen këtyre të dyve është se aristokratët nuk mund të adresoheshin me Mr. (zotni), ndërsa 28 të tjerat kësaj zonje. Sonetet që i dedikohen mashkullit kanë nxitur studiuesit që të shohin elemente homoseksuale në këto sonete. Me elemente më të drejtpërdrejta seksuale janë sonetet që i kushtohen Zonjës Hijerëndë, emrin e të cilës nuk e di askush.

Hamleti – interpretimet artistike të Gëtes dhe të Xhojsit

Kronikani danez i shekullit XII Sakso Gramatikus (Saxo Grammaticus) dhe kallëzimi i francezit Belleforest (*Histoire Tragiques*, shekulli XVI) e emërtojnë personin si Amleth.[11] Shekspiri e ka bërë Hamlet. Ai iu shmang burimit edhe te emri i babait të Princit. Atje është Horvendil, ndërsa shkrimtari babë e bir i pagëzon me të njëjtin emër, Hamlet. Në katër aktet e para Hamleti është rreth njëzet vjeç, student në Universitetin e Vitenbergut, ndërsa në të pestin, mbas një intervali prej disa javësh në veprimin dramatik, është tridhjetë vjeç (simbas varrmihësit). Ndoshta shpërputhja ka mbetur nga varianti i hershëm i *Hamletit*.

Kryevepra e Shekspirit, *Hamleti,* ka frymëzuar vepra letërsie e arti përgjithësisht. Te romani i Gëtes *Vilhelm Majsteri: Vitet e formimit* (*Wilhelm Meisters Lehrejahre*, 1795-6) zhvillimi i një personaliteti fin lidhet me Hamletin si në rrafsh dramatik ashtu edhe teorik. Identifikimi me Hamletin është fazë në mësimin e jetës nga Vilhelmi, që duhet ta bëjë duke hequr dorë nga pasioni për teatrin. Te *Uliksi* (1922) i Xhejms Xhojsit, miti i Hamletit i mbivendsoet mitit të Odisesë.[12]

Hamleti është djali ideal i Shekspirit, simbas Xhejms Xhojsit. Stivën Dedalusi i tij tek *Uliksi*, në skenën te Biblioteka (në episodin e nëntë të romanit), mëton se Shekspiri ishte i interesuar personalisht të luante Fantazmën e Hamletit. Studiuesit e kanë parë të motivuar emrin Hamlet nga Hamneti, i biri i dramaturgut, që kishte vdekur pesë-gjashtë vite para se të shkruhej tragjedia. Stivën Dedalusi, një shkrimtar aspirant, në dialog me të tjerë, rishkruan jetën dhe veprën e Shekspirit, sidomos kryeveprën e tij *Hamleti*, për t'ia përshtatur situatës së tij. Xhojsi e bën *Hamletin* te *Uliksi* dramën e vet brenda dramës. Stivëni bëhet kështu Hamleti irlandez i Xhojsit. Gjatë gjithë ditës, Stivëni i kthehet rolit të Hamletit. Te *Uliksi*shohim relacionin në mes të babait dhe të birit siç paraqitet tek *Odiseja*, te Shekspiri, por edhe në teologjinë e krishterë.

[11] Emri Amleth rrjedh nga gjuha e vjetër nordike për një idiot, apo një budalla që shtihet se është idiot. (Bloom, f. 390). Në versionin e Belleforestit Amlethi në fund ia del mbanë të marrë fronin e Danimarkës, mbasi vret t'ungjin e tij, Fengonin, dhe pritet si mbret nga popullata daneze. (Bloom, f. 399).

[12] André Lorant, "Hamlet", në *Companion to Literary Myths, Heroes and Archetypes*, edited by Pierre Brunel, Routledge, London, ff. 517-520.

Jul Cezari

Jul Cezari ka qenë udhëheqës i madh romak, por edhe shkrimtar. Ekziston Cezari i historisë, por edhe Cezari i Shekspirit, që jo rallë, në imagjinatën e njerëzve, i mbivendoset Cezarit historik. Çka thotë një lexim i mundshëm i kësaj vepre?

Viktima të njëmendta të tragjedisë *Jul Cezari* janë Bruti dhe Kasi, jo Cezari. Fitues nuk janë Mark Antoni dhe Oktavi. Cezari dhe Shekspiri janë fitues, pohon Harold Bllumi, duke cituar vargjet më të famshme të kësaj vepre, fjalët e Cezarit në bisedë me të shoqen, Kalfurnjen:

Cowards die many times before their deaths;
The valiant never taste of death but once.
Of all the wonders that I yet have heard,
It seems to me most strange that men should fear,
Seeing that death, a necessary end,
Will come when it will come. [II.ii.32-37][13]

Shekspiri: si shfaqje dhe lexim

Shkrimtari dhe eseisti Çarls Lemb (Charles Lamb) – autor, bashkë me motrën e tij, Meri Lemb (Mary Lamb), i*Tregimeve nga Shekspiri* (Tales from Shakespeare, 1807) - mendonte se më mirë është të lexohet Shekspiri sesa të shihet i luajtur në teatër, për çka është denigruar. Harold Bllumi, si duke u pajtuar me të, konstaton se kur e lexon, i bën vetë regjinë, e luan dhe e interpreton vetë" (natyrisht edhe me ndihmën e kritikëve më të mirë, ndër të cilët, si pararendës të tij si shekspirologë ai rendit Hazlitin (Hazlitt), Semjuëll Xhonsonin (Johnson), Bredlin (A.C. Bradley) dhe Harold Godardin (Goddard). "Në teatër, interpretimin ta bëjnë ty, ndërsa ti viktimizohesh nga modat politike aktuale", sepse, "si regjisor madje edhe Shekspiri duhet të zgjidhte të theksonte një perspektivë apo tjetër, kufizim i çdo regjisori dhe çdo aktori ".[14]

Shekspiri shqip

Shekspiri 400-vjeçar ka një jetë 100-vjeçare në shqip. *Othello* e tij, përkthyer nga Fan Noli, u botua më 1916. Tri veprat e tjera, *Hamleti*, *Makbethi*, *Jul Cezari,* Noli i botoi më 1926, duke u paravënë edhe introduktat e tij, që janë shkrime që paraqesin e

[13] Në përkthim të Fan Nolit: "Frikaçi vdes përpara vdekjes shpesh:/Po trimi kurrë s'vdes, veçse një here,/Besoj, m'e madhja prej çudive është/ Që njerëzit ia kanë frikën vdekjes./Kur dinë q'është fund i domosdoshëm/ Dhe do t'na vijë, kur na ka për t'ardhur./" Shekspiri, *Jul Cezari*, përktheu nga origjinali Fan S. Noli, Onufri, 2005, f.56.
[14] Bloom, po aty, ff. 720-721.

interpretojnë veprat, por, në njëfarë mënyre, edhe i perspektivizojnë në ambientin shqiptar.

Skender Luarasi ka përkthyer *Mbretin Lir, Rikardi II*, *Rikardi III*, *Tregtarin e Venedikut*, *Komedinë e keqkuptimeve*, dhe *Si ta doni*.

Vedat Kokona ka përkthyer *Timonin e Athinës* dhe një numër sonetesh.

Alqi Kristo ka përkthyerdramat *Antoni e Kleopatra*, *Romeo dhe Zhulieta*, ndësra Perikli Jorgoni veprat *Shtrëngata* dhe *Mundimet e humbura të dashurisë*

Kristaq Traja ka përkthyer *Timoni nga Athina*, *Simbelin*, dhe *Masa për masë*.

Hamit Kokalari ka përkthyer komedinë *Zbutja e kryeneçes*.

Bekim Bejta ka përkthyer e botuar më 2014 në Prishtinë *Hamletin*, *Tit Andronikun* dhe *Venusi dhe Adonisin*.

Sonetet e Shekspirit në shqip i kanë përkthyer Napoelon Tasi, Kristaq Traja, Mihal Hanxhari e ndonjë tjetër.

Shfaqja e parë në Teatrin Kombëtar në Prishtinë pas luftës, në nëntorin e vitit 1999, ka qenë *Hamleti*. Më vonë, më 2014, këtu është dhënë shfaqje e Globe Theatre-it të Londrës, në anglisht, në kuadër të festimeve dyvjeçare në vigjilje të 400 vjetorit të vdekjes së shkrimtarit universal.

Në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar, *Hamleti* është luajtur në Teatrin (atëherë) Krahinor të Kosovës. Ka pasë bërë bujë atëherë edhe për faktin se fillimisht qe planifikuar që rolin e Hamletit ta luante Bekim Fehmiu, aktori i madh shqiptar i teatrit dhe i filmit që jetonte e punonte në Beograd. Kjo nuk ndodhi për arsye që dalin përtej fokusit të kësaj fjale për Shekspirin, dhe kësaj paraqitjeje telegrafike për Shekspirin në shqip.

Muhamet HAMITI

THE WRITER FOR ALL TIME: THE 400TH ANNIVERSARY OF SHAKESPEARE'S DEATH

Abstract

"He was not of an age, but for all time!" wrote poet and playwright Ben Johnson, a contemporary of Shakespeare, in his poem "To the Memory of My Beloved the Author, Mr. William Shakespeare" in 1623, on the occasion of the publication of the great author's plays (The First Folio), edited by two members of his "The King's Men". William Shakespeare (1564-1616) was buried in the small town of Stratford-upon-Avon, his hometown, and not in the 'Poets' Corner' at Westminster Abbey in London, where Chaucer and Spenser had been buried earlier, whereas Ben

Johnson later, arguably because the society of the time had not recognized the Bard's greatness.

Data about Shakespeare's life are scant. Shakespeare is his literature, his poetry and plays; his comedies, historical dramas, tragedies. Shakespeare is the writer who produced the largest gallery of characters in English literature. He wrote for the aristocracy and the commons; he satisfied the elite and entertained the uneducated.

Four hundred years on, Shakespeare is viewed as the first universal writer, the writer who invented the human, whereas Hamlet, his pre-eminent literary character, one of the great modern myths, 'the most quoted figure of Western consciousness after Jesus Christ', according to American scholar Harold Bloom.

The lecture dwells on the universality and originality of Shakespeare's oeuvre beyond the tendency of the recent decades (Marxist, Structuralist, Historicist, Feminist) which see it not the result of his genius, but rather of prevailing social circumstances and the relations between word (language, discourse) and power. Likewise, discarding patriotic English ideas that his work was subversive to power. Shakespeare had patrons, and lived and worked close to the royal circles during the reins of Queen Elizabeth I and King James I. Censorship of the theatre was vigorous at the time.

The lecture shall outline the history of the rise of William Shakespeare to the pedestal in the last couple of centuries, but also the geography of the outreach of his works. It was the French who resisted most of all in Europe the rise of the 'barbaric genius', as they branded him in the age of Classicism. With Goethe, the Germans co-opted him in their culture. This is what many nations have done. This is true for the Albanians too, except for the era of Enver Hoxha's dictatorship, which looked suspiciously towards literature that was at odds with the dogma of Socialist Realism. The dictatorship could not ban him outright, though, and Albanian translations of Shakespeare lived abundantly in both Albania and Kosovo. Albanian writer Fan Noli is as identifiable (as translator) with Shakespeare, as he is with his own poetry and "The History of Scanderbeg". The rendering of Shakespeare in our mother tongue has demonstrated the power of Albanian language.

Key words: Shakespeare, genius, originality, humanity; universal writer, plas

Nysret KRASNIQI

LETËRSIA DHE HEGJEMONIA

1. Indicie

Letërsia shqipe, shikuar në prapavështrim, ka ndërtuar një raport imanent me tjetrin, qoftë si komunikim kulturor, qoftë si rrjedhë e vonuar e integrimit të formave, por edhe si intencë për të krijuar *semiotikën nacionale*, e cila, mbi filozofinë e gjuhës, shpërthen në sforcimin e koloritit nacional. Por, në këtë udhë, siç vërehet nga modelet themelore letrare, letërsia shqipe gjithnjë përballet me *frikën e hegjemonisë*.

Hegjemonia, nocion ky i lashtësisë greke, i rikuptimësuar në faza e etapa të ndryshme të kulturës perëndimore, nënkupton dominancën, fobinë, urrejtjen, presionin e hapur dhe latent, politikën supreme të tjetrit ndaj tjetrit, qoftë ky mision i synuar nëpërmjet sistemit doktrinar ideologjik apo sistematikës fetare-kulturore e dominancës gjuhësore. Kësaj fuqie të presionit dhe represionit, pra kësaj *frike*, letërsia shqipe i kundërvihet me *refuzim* duke e krijuar në vijimësi identitetin e vet gjuhësor e kulturor. Se cilat janë disa nga raportet e ndërliqshme të frikës nga hegjemonia, të transformuara në tekstin letrar shqiptar si refuzim polisemantik, në vetëdijen dhe ndërdijen e autorit shqiptar, do të shihet në vijimësinë e kësaj trajtese.

Mbi konceptin e modeleve do të hetohen tekstet letrare, të cilat reflektojnë frikën nga hegjemonia, qoftë kur ajo është reale, qoftë imagjinare dhe intencën e tyre mbrojtëse e identitare. Variantet e frikës hegjemonike janë pjesë e ontologjisë së letërsisë shqipe!

2. Frika

Frika është fenomen qenjësor i njeriut. Trajtat e ndërliqshme të pranisë së saj i shënon mitologjia, por edhe bota e shkrimit, që nga zbulimi i tij. Me që, frika, si e tillë, jeton si prani e *psiko-somatikes* njerëzore, letërsia, e cila në esencë është *ontos* i po kësaj psiko-somatike, domosdo e etablon si njerën nga përbërëset themeltare të saj. Mirëpo, sikur trajtat e frikës ashtu ekzistojnë edhe trajtat e këngëtimit dhe shkrimit letrar. Nëse një tekst letrar ka për temë frikën e një individi, qoftë nga natyra apo misteret e universit, teksti i tillë nuk ka ndonjë relacion kauzal me hegjemoninë, e cila më shumë projektohet si një "gogol" që rri mbi "kokën" e një ideje apo vizioni të një kolektiviteti si *zoon politicion*. Ky gogol, në konceptimin e tij si frikë, është përzierje e emotivitetit,

efektit, fuqisë ndikuese, i cili vështirë se largohet nga mendja njerëzore, sepse si i tillë shtyn në pranimin apo jo të *filozofisë së resktriksionit*. Dhe bota shqiptare, kundruar në historinë e saj, gjithnjë është përpëlitur në aureolën e *restriksionit*.[1] Vrojtuar mbi këtë kauzalitet, a mund të thuhet se shkrimi letrar shqiptar u kushtëzua nga bota restriktive shqiptare? Në njëfarë mase mund të themi se po! Pra, ky është raporti i ndërliqshëm i letërsisë sonë me hegjemoninë, e cila nëpër lakorën historike nacionale ka marrë dhe merr trajta të ndryshme restriktive. Nga kjo del se raporti ynë me tjetrin nuk ka të bëjë me *relacionet e brendshme*, sepse resktriksioni, sidomos në kohë të krizave të vazhdueshme, e ka ndihmuar forcimin dhe sforcimin e *kompaktësisë etnike-nacionale* qoftë edhe duke përjetuar në vijimësi restriksionin. Për ne, *tjetri* është *i largëti, i jashtmi, represuesi e okupuesi*, madje *vrasësi*. Me që, këtu nuk kemi të bëjmë me fuqinë tonë *për zbulime të tjetrit*, siç, ta zemë, ka ndodhur zbulimi i tokës amerikane nga pjesëtarët e tokës evropiane,[2] ne, tjetrin e kemi gjetur këtu, tek ne, të sapoardhur, të befasishëm, në format e ndërliqshme të pranisë hegjemonike të tij. Përjashtim nga kjo "gjetje" mëngjesore me tjetrin në oborr, përbën vetëm fatumi historik i shpërnguljes së dhunshme të shqiptarëve, të cilët, të ndjekur nga vendi i tyre e kanë gjetur tjetrin në vendet e huaja, ta zëmë, sikur arbëreshët e trojeve tashmë historike të tyre. Pra, tjetrin e kemi parë si konfrontim të unit tonë me 'ofertën' e tij hegjemonike. Me gjithë vetëdijën e imanencës së komunikimit ndërnjerëzor, pra ndërkulturor, prapë "oferta" e tjetrit, gjithnjë, përkthehet, më së paku, me drojë e shpeshherë me frikë, e cila, sidomos kur përplaset me shenjat e konsoliduara identitare, shtyn drejt refuzimit.

Refuzimi nuk është masa e fuqishme mbrojtëse, e cila nuk lë asgjë për të ndodhur, sepse, qoftë edhe duke refuzuar, në *psikenë* njerëzore mbesin gjurmët e komunikimit dhe të ndërkomunikimit. Ajo që nuk tretet është frika, e cila në raport me hegjemoninë del të jetë *frikë nga tjetërsimi*. Frika e tjetërsimit është permanencë e mbrojtjes identitare, qoftë edhe kur në procesin e formësimit identitar, madje pavetëdijshëm, merret e jepet në kuadër të fushës së gjerë interkulturore. Shkurt, identiteti, si *psike kolektive*, mbrohet edhe atëherë kur pahetueshëm tjetri behët unë dhe unë bëhëm tjetri! Mirëpo, kjo tendencë kurrë nuk e përjashton psikenë e veçantisë, e cila përcillet më frikën dhe si e tillë shtyn drejt sforcimit të shenjave qenësore, por edhe të menduara identitare. Se si është reflektuar ky proces në verbin letrar shqiptar do të provojmë të shohim në disa hetime fenomenologjike të modeleve letrare klasike shqiptare.

[1] Për më tepër shih: Gani Bobi: *Sprovimet e modernitetit*, Rilindja, Prishtinë, 1982, ff. 5-51.
[2] Për më tepër shih: Tzvetan Todorov: *Konkuista e Amerikës*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, ff. 11-12.

3. Modelet

3.1. Këngët legjendare

Ne të gjithë e dimë se prania më e theksuar e tjetrit në kulturën shqiptare, qoftë edhe si *përplasje e qytetërimeve*, të përdorim një nocion modern, ndodh në kulturën popullore. E kemi fjalën veçanërisht për këngët legjendare-kreshnike, të cilat kryesisht lidhen me figurën e Mujit,[3] i cili gjithnjë shndërrohet në simbol të njeriut vendës që mbron nga tjetri. Nëse hetojmë në variantet e shfaqjeve të kësaj bote mrekullitare folklorike, venerojmë se çdo rrëmbim, martesë, peng e luftë ndërlidhet me refuzimin e tjetrit, më një frikë permanente nga tjetri, ta zëmë nga *Krali i Kotorreve*, i cili vjen në trojet e Mujit nëpërmjet hegjemonisë ushtarake, duke bërë presion me *tre rradhë ushtarësh*, që t'ia *zaptojë kullën*. Kjo shtyn trimin që të nis mbrojtjen e saj si koncept të mbrojtjes identitare, e cila gjithnjë, simbas skemës së legjendarizimit nis me luftime dhe përfundon me të ashtuquajturin përfundimin lumturak fitues. Raportin, të themi, të frikës nga tjetri, e veneron edhe Maximilian Lambertz, i cili konstaton se eposi kreshnik sforcohet sidomos *nga dyndja e sllavëve nëpër Danubin e Poshtëm rreth viteve 700-800*.[4] Nëse temë themeltare e këtij eposi ishin kullosat, pronat, rrëmbimet e grave, më vonë, në kontinuitetin e tyre nis e hetohet edhe elementi i hegjemonisë masive të tjetrit, i cili shtyn drejt refuzimit deri në shkallën kur epika legjendare merr premisa të historicitetit.

Mirëpo, duhet të theksojmë se megjithë faktin e refuzimit, megjithatë komunikimi ndodh sepse në të shumtën e rasteve, boshtet opozitare të përfshira në mohime, refuzime e luftime, në fund të fundit, marrin dhe japin në kuadër të raporteve të ndërliqshme që krijohen vetvetiu!

3.2. Pjetër Bogdani: Cuneus Prophetarum

Siç e dimë nga historia kulturore nacionale, por edhe nga historia letrare shqiptare, nën maksimën e ruajtjes së identitetit dhe dinjitetit gjuhësor e fetar, Pjetër Bogdani, autori i Kosovës, botoi veprën dygjuhësore teologjike-letrare, *Çeta e profetëve* (1685). Kjo vepër, e kundruar në prizmin e komunikimit me tjetrin, jep shembullin tipik të refuzimit të një hegjemonie, të themi lindore, e cila po vinte në hapësirat shqiptare për të krijuar dhe instaluar njeriun e ri osman, sipas koncepteve të përzierjes

[3] Shih: Donat Kurti dhe Bernardin Palaj: *Visaret e kombit, I-XI*, Provinca Françeskane, Shkodër, 2005-2007. Mirëpo, figurën e Mujit si simbol të mbrojtjes nga tjetri e hetojmë edhe në variantet e kënduara nga rapsodët eminentë të Kosovës, zëri i të cilëve mund të dëgjohet edhe sot.

[4] Shih: Maximilian Lambertz*: Epika popullore e shqiptarëve* në *Çështje të folklorit shqiptar* 6, IKP, Tiranë, 1998. Me këto problematika të eposit tonë popullor, në Kosovë, është marrë gjatë studiuesi Zymer Neziri.

hegjemonike kulturore dhe fetare. Pjetër Bogdani, shkruan veprën, ndër të tjera, me dy funksione esenciale: të mbrojë filozofinë kristiane dhe të refuzojë imponimin e tjetrit. Kjo bindje, madje ky detyrim, e shtyri që shpeshherë të përdorte diskurs agresiv retorik, me të vetmin synim, që në rolin e bariut, të ndikonte në bindjen e grigjes që të mos e lëshonte udhën e salvimeve kristiane për të mos iu bashkuar hegjemonisë osmane, e cila gradualisht po përhapej në këtë pjesë të Evropës.[5] A mund të pandehet ky diskurs retorik si produkt i frikës nga hegjemonia osmane? Kur dihet se islami ishte shndërruar në fe zyrtare perandorake dhe madje ishte berë mjet për forcimin pushtetor duke e blatuar Sulltanin edhe me funksionin e mbrojësit të fesë islame, Bogdani nëpërmjet refuzimit të tij, në fakt refuzon kulturën e tjetrit, e cila përpiqet të shartohet në kulturën etnike-nacionale.

Ky libër imi i varfër, i shkruar në përmbytjen e pabesisë orientale, (ku unë, qysh prej tridhjëtë vjetësh, po mundohem megjithëse më kot në detyrën e ipeshkvit) po vjen si pëllumbi në arkën e mbrojtjes dashamirëse të Hirësisë Suaj. E quaj pëllumb, sepse nuk flet për gjë tjetër, veçëse për mishërimin, jetën e vdekjen e Zotit tonë Jezu Krisht, Mbret paqësor, i nënkuptuar me ullirin, dhe për Virgjëreshën shumë shenjte Mari nënën e tij, pëllumbeshë mistike, e ruajtur nga përmbytja e përbashkët e fajit. E meriton gjithashtu emrin e pëllumbit për qëllimin për të cilin u dërgua në shtyp, domethënë për t'u njoftuar parimet e fesë së shenjtë katolike, fushë pjellore të vërtetash hyjnore dhe virtytesh qiellore, atyre shpirtërave, të cilët, të lindur në shkretëtirat e myslimanizmit, kanë aq nevojë për ushqimin shpirtëror të doktrinës së krishterë.[6]

Amalgami i kulturës etnike dhe fetare ishte themeli i refuzimit bogdanian, i cili e çoi edhe në kryengritje, si pasojë e së cilës vdiq e më vonë edhe u zhvarros në zemër të Prishtinës!

3.3. Pashko Vasa e Naim Frashëri (O moj Shqypni... dhe Bagëti e bujqësia)

Në valën e Rilindjes Nacionale, kur fillojnë e zbehën intencat e mbrojtjes identitare nëpërmjet prizmit fetar, pra kur kërkohet ngritja e vetëdijes se nacioni themelohet edhe duke ruajtur diversitetet besimtare, qoftë të imponuara më herët apo më vonë, kërkesat e mbrojtjes nga hegjemonia marrin forma të tjera, duke u përqëndruar në gjuhën nacionale si aureolë të sforcimit të identitetit partikular. Dhe pikërisht gjuha shndërrohet në filozofi, në kombinimin e saj *langage* dhe *parole*, për të theksuar e sipërtheksuar shenjat përbashkuese të nacionit, të cilat bëhen të nevojshme për dy efekte: shmangien e frikës dhe forcimin e identitetit mbi *utopinë* dhe *topinë* e autoktonisë. Shembuj të kësaj filozofie janë dy autorë, dy vepra, Pashko Vasa me poemën *Moj Shqypni...* dhe Naim Frashëri me poemën *Bagëti e bujqësia*.

[5] Shih: Noel Malcolm: *Vepra e Pjetër Bogdanit "Cuneus Prophetarum" dhe konteksti i saj fetar*, ligjëratë inauguruese me rastin e pranimit të tij anëtar i jashtëm i ASHAK-ut, 2006.
[6] Pjetër Bogdani: *Cuneus Prophetarum*, botim kritik i përgatitur nga Anila Omari, ASHSH, Tiranë, 2005, ff. IV-V.

Parola e Pashko Vasës është thirrje nga frika, e cila prodhon lidhje të forta me shenjat e largëta dhe të afërta identitare. Frika ndërlidhet me hegjemoninë e gjatë osmane, e cila në perceptimin autorial mendohet se e ka vënë në krizë *shtresën identitare*, krizë e cila duhet domosdo të mënjanohet mbi "rikujtimin" e shenjave, qoftë edhe të sforcuara, nga e kaluara veçuese identitare. *Mori Shqypni, e mjera Shqypni,/kush të ka qitun më krye në hi?/Ti me ke pas ken nji zonj' e randë,/që burrat e dheut të quejshin nanë;*[7]- nënkupton pikërisht *figurën e idesë* se dominanca hegjemonike ka mundur të zbehë shenjat identitare nacionale. Ky diskurs poetik funksional bëhet më se valid sidomos kur hetohet shthurja e një sistemi të madh dominant, i cili mundëson buthtimin e identiteteve partikulare nacionale. Por, gjithsesi është frika e humbjes së shenjave, e cila mbi intencën autoriale përkthehet në kërkesë për gjetjen e tyre, qoftë edhe për ta ringjallur mitin e madhështisë, i cili në mos më shumë krijon vetëdijen e veçimit për të jetuar me ikonat e veta, të cilat domosdo çojnë nga kultura në luftë, duke e parë luftën si vijim kulturor.

Ngjashëm bën edhe Naim Frashëri, i cili duke njohur mendimet e idealet e Lidhjes së Prizrenit, shkroi poemën *Bagëti e bujqësia*, e cila, sipas formimit arki-psikologjik të autorit, s'bën asgjë tjetër përveç se *himnizon* (Sabri Hamiti) shqiptarët dhe gjeografinë e tyre, duke krijuar një *indeks* të këndshëm poetik të shenjave të mitit, gjuhës, kulturës dhe të jetës së shqiptarëve, gjithnjë duke pranuar e vlerësuar diversitetin mbrenda llojit, pra duke e krijuar hartën shpirtërore dhe fizike të tyre nëpërmjet funksionalitetit poetik. Ky ideal prap merr dy funksione: frikën për njësinë, të themi mundësinë e copëtimit të saj, gjë që edhe ka ndodhur, si dhe frikën nga devijacioni identitar. Nëse shenjat identitare me gjithë *intelegjibilitetin* e tyre janë të gjalla, po u lanë në harresën e lidhjes së tyre me mitet e intencat kulturore të përbashkëta, gjithsesi shkojnë drejt separacionit filozofik e biologjik.

Dellëndyshe bukuroshe! që thua mijëra fjalë,
Dhe të k'ënda vahn' e lumën, që vjen me vrap e me valë,
A mos vjen nga Shqipëria? apo vjen prej Çamërije
Me këto mijëra fjalë e me gjuhë perëndije?
Apo vjen nga Labërija, pra më duke kaqë trime?
Edhe fjalëtë që thua, më gëzojnë zëmrën t'ime,
Q'është thyer, bërë mijë copë, posi një pasqirë,
Duke këputur nga spangu, që s'e kanë vartur mire;
Apo vjen nga fush'e Korçës, nga vënd' i mir' e i gjerë,
Pe zembrësë Shqipërisë, që del gjithë bot' e ndjerë?
A më vjen pej Malësije, pej Skrapari, pej Dobreje,
Nga Vijosa, nga Devolli, pej Vlor' e prej Myzeqeje?
Të mundjam të fluturonja e të kishnjam krahë si ti!

[7] Pashko Vasa: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1989, poema *Mori Shqypni, e mjera Shqypni*, f. 73.

Me gaz të madh dot' i vinjam Shqipërisë brënda në gji!
Për me marrë drejt Shkumbinë edh' Elbasan' e Tiranën;
E me ardh ke ti, o Shkodrë, të shof Drinin e Bujanën,
Kostur, Përlep, Fëllërinë, Dibrë, Ipek e Jakovën,
Mat' e Ysqyp e Prështinë dhe Mirëdit' e Tetovën;
Krojënë e Skënder-Beut, q'i ka pas dhan ner Shqypnís,
Tue bam me trimni luftë, e m'e munt Mbrëtin e Tyrqisë.[8]

Duke shfrytëzuar figura të këngëtimit popullor, të cilat domosdo e përmbajnë *elecution* e *invention* retorike, qoftë për të mos e harruar asnjë çast funksionin bindës, Naim Frashëri, nëpërmjet dallëndyshës, si ideo-identifikim me autorin (siç bën edhe Filip Shiroka nga Misiri) flet me trojet e veta, krijon indeksin e tyre për të markuar hapësirën e vet.

Është interesante të observojmë se si Pashko Vasa ashtu edhe Naim Frashëri këto thirrje anti-hegjemonike me funksion rilindës i bëjnë pikërisht nga *oborri osman*. Mirëpo, nëse cilësimi *interesant* është epitet ambig, për ne, sa i përket filozofisë së hegjemonisë dhe luftimit të tjetrit del si veprim më se i natyrshëm dhe plotësisht atdhetar e vizionar. As Pashko Vasa, as Naim Frashëri nuk e patën ndjenjën e inferioritetit, e cila shkatërron që në nisje çdo ëndërr identitare! Duke qënë njohës të mirë të kulturalitetit perëndimor dhe lindor, madje duke shërbyer shpeshherë në sistemin perandorak nuk u habitën nga forcat centrifugale të tij, por bënë thirrje për krijimin e vetëdijës partikulare, e cila në udhën e saj të endrrës krijimtare çlirimtare e ndërton njësinë e vet etnike-kombëtare.

3.4. Gjergj Fishta: Lahuta e Malcis

Frika nga zvetënimi identitar, sikur edhe tek të gjithë françeskanët e tjerë shqiptarë, të cilët u shkrinë për palcën shqiptare, e ka formësuar gradualisht dhe shumë fuqishëm intencën e përhershme të Gjergj Fishtës që në latimin e çdo forme letrare të forcojë e sforcojë shenjat identitare nacionale. Duke e njohur thellë hegjemoninë osmane disashekullore, por edhe sllave, e cila po mësynte tokat shqiptare pikërisht kur hegjemonia turke po dobësohej, Gjergj Fishta, edhe nga dëshira e krijimit të një monumenti të idealitetit shqiptar, por gjithsesi edhe nga frika e zvetënimit identitar, shkroi epin *Lahuta e Malcis*. Madje kur frigohej për krizat identitare të shqiptarëve nuk ngurronte të vajtonte së bashku me Zanën e tij duke artikuluar vargje

[8] Naim Frashëri: *Bagëti e bujqësija*, Drita, Bukuresht, 1886. Në botimin e Rilindjes së vitit 1986, i përgatitur nga Rexhep Qosja, në këtë pjesë të tekstit të poemës *Bagëti e bujqësia* mungojnë vargjet: *Kostur, Përlep, Fëllërinë, Dibrë, Ipek e Jakovën,/Mat' e Ysqyp e Prështinë dhe Mirëdit' e Tetovën;*. Shih: Naim Frashëri, *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1986. f. 126.

të dhembjes së tipit *Mbaroi Malcija! Lekë mâ sot nuk kâ*!,[9] te vepra e lirikës *Mrizi i zanavet*. Ndërkaq, te *Lahuta e Malcis*, në idealin e tij të forcimit identitar, qoftë edhe mbi parime neo-romantike e paramoderne me integrimin e bindjeve të autorit në tekst, barazon kundërshtarët në fuqinë e tyre për t'i mbajtur krah anës së vet, palcës etnike-identitare si refuzim ndaj tjetrit. Ky refuzim duket të jetë pakëz neobogdanian, mbi parimin filozofik *atme e fe*, sipas së cilit nuk kërkohej ndonjë ndryshim faktik, por lidhje për rrënjët identitare shqiptare. Megjithatë, sa i përket komunikimit literar me tjetrin mund të themi se Gjergj Fishta, i cili akuzohej për nacionalizëm, ndërtoi jo raportin e pranimit hegjemonik, por raportin e dialogimit letrar e kulturor, në kuptimin që i jepte Gëte me propozimet e tij për *Ëeltliteratur*.

3.5. Letërsia e shkrimtarit aplikues - realizmi socialist

Letërsia e cila më vonë mori epitetin kombinues *realizëm socialist*, pra ideologji e pasqyrë, nuk ndërtoi dialog me tjetrin, madje nuk u përpoq të refuzojë hegjemoninë e utopisë komuniste, por si e tillë u shndërrua në mjet të forcimit të saj. Shkrimtari i kësaj forme u shndërrua në aplikues të doktrinës dhe përforcues të saj. Me që kaplimi i madh i utopisë hegjemonike rrafshoi thuajse në tërësi verbin e dallueshëm letrar, *distopia letrare* u bë e pamundur. Kjo pamundësi u pa më shumë në letërsinë që krijohej mbrenda hartës letrare të Tiranës, sepse harta letrare e Prishtinës po ndiqte një formë më të butë të aplikimit të hegjemonisë komuniste. Mirëpo, në esencë shkrimi letrar socrealist nuk ndërtoi komunikim, apo dialog me tjetrin, por maksimë të tij pati gjykimin letrar të tjetrit, sidomos të asaj që cilësohej kulturë imperialiste perëndimore në planin e shkrimit letrar. Ndërsa, kritika denigruese për vlerat perëndimore e ndihmonte etablimin e utopisë në çdo grafemë letërsie. Pra, me gjithë përpjekjet e sforcimit të diskursve të rralla alegorike, letërsia e distopisë, në esencë, u shkrua me furi vetëm mbas rënies së doktrinës, e cila e mbajti gjallë realizmin socialist, për fatkeqësinë e kulturës shqiptare. Prandaj, shikuar nga prizmi i sotëm, padyshim se në kuadër të kësaj forme shkrimtarie nuk kemi në esencë autorë, por shkrimtarë. Autori merr përgjegjesi e shkrimtari është në funksion. Nga kjo filozofemë del se autor i letërsisë socrealiste ishte sistemi aparatist komunist, ndërsa shkrimtari aplikues skematik letrar i tij! Madje, sa i përket frikës, shkrimtari i oborrit jetonte në panikën permanente se mos diku ka gabuar dhe ka shkelur në "dërrasën e kalbur" të tij, për të përfunduar në gjyqësinë e sistemit-autor! Frika nga tjetri ishte projektuar brenda sistemit, brenda kornizave, të cilat nuk guxonin të tejkaloheshin!

[9] Gjergj Fishta: *Mrizi i Zanavet*, Botime Françeskane, Shkodër, 2007, f. 38.

3.6. Letërsia e Kosovës

Në kuadër të observimit sistematik të letërsisë shqipe në Kosovë, në shekullin e saj si hartë e ndarë letrare, por jo edhe trashëgimore, vërejmë një raport të ndërliqshëm me hegjemoninë, pra me frikën dhe idetë letrare që burojnë nga ajo. Në kuadër të këtij kushtëzimi historik, letërsia e Kosovës deshi apo jo, e ka krijuar identitetin dhe dinjitetin e vet. Mirëpo, mbas një leximi sistematik të saj, lidhur me këtë dimension, mund të vërejmë se në kuadër të saj hetojmë letërsinë ideologjike, të përshtatjes, të refuzimit dhe të prizmave të thyera, epitete këto të cilat japin edhe shenja të raportit të saj me tjetrin.

Letërsia e ideologëve, pra e funksionarëve komunistë, të cilët shkruan prozë e poezi nuk e pranoi largimin nga idetë e formimit të tyre ideologjik. Kështu që, ngjashëm si në letërsinë socrealiste në Shqipëri pranuan fshirjen autoriale dhe u gëzuan të jenë besnikët e parë të aplikimit të autorësisë së sistemit. U ekzaltuan nga e reja dhe mbi këtë parim edhe letërsia e tyre mbeti në suazat e jetës së re komuniste. Tjetri i tyre ishte okupatori, perëndimori e mohuesi i partizanëve, i cili domosdo duhej të ndëshkohej. Feja anakronizëm e tradita e dalë boje! Refuzimi i filozofisë së gjuhës, pra nëpërmjet saj edhe jetës autentike e thau deri në rixhiditet verbin e letrarëve ideologë.

Ndërkaq, *lertërsia e përshtatjes*, duke u çliruar sadopak nga gufimi nistor ideologjik u fokusua në përcjelljen apo *kronosin* e zhvillimeve sociale-politike duke u përpjekur të gjejë rrugën e mesme apo të simbiozës me avancimin gradual të njeriut shqiptar drejt një rehatie, e cila bazohej në utopinë e jetës së gjatë të krijesës artificiale të bashkim-vëllazërimit. Pra, raporti i kësaj letërsie me tjetrin ishte harmonia e popujve ku paradoksalisht personazhet duhet të skematizoheshin në formën arbitrare një shqiptar një sllav për ta dëshmuar vëllazërinë. Tjetri rrafshohej në ne qoftë edhe me vetëdijen se nuk na ngjet!

Letërsia e refuzimit ngjalli format më të ndërliqshme të shprehjes letrare, iu kthye traditës të cilën e rievaluoi, ngjalli përgjegjësinë autoriale, pra largoi përfundimisht *autorin sistem* për ta forcuar *autorin e shkallës së parë* në mohim të rreptë të *shkrimtarit funksional*. Raporti me tjetrin u zhillua në komunikm normal *dialogues*, i cili ndikoi në shkollimin e formave letrare, të cilat të përcjella me kritikën afirmative e shkencore, po e shndërronin letërsinë e Kosovës në markë të krahasueshme me veprat moderne evropiane. Nuk ka asnjë dyshim se kjo furi e zhvillimit letrar e kulturor ka qenë shtytja themelore e avancimit të kërkesave shqiptare për identitet kulturor e politik, me vetëdijën e plotë të një "emancipimi modern" për kërkesat e mohuara historikisht të hapësirës shqiptare të Kosovës.

Letërsia e prizmave të thyera ndërkaq vjen si pasojë e tronditjeve politike. Ne nuk jemi të prirur që kreacionin autorial ta lidhim fort me rrethanat, por në kohën e vlimeve të viteve 90-të në botën lindore, por edhe në ridizajnimet politike mbrenda botës perëndimore u bënë modë *autorë të distopive* si dhe *autorë të mohimit të kanoneve*. Kjo

filozofi ndikoi që komunikimi me ta të bëhet si mjet i refuzimit ideologjik, kanunor poetik, gjë që ndikoi në sforcimin e të ashtuquajturës poetikë e postmodernizmit, e cila u hetua te disa autorë. Pra, komunikimi me tjetrin u zhvillua si dëshirë e përngjasimit, por edhe e adhurimit. Nëse temat e kësaj letërsie ishin shqiptare, modelet ishin me tone komplemetare.[10]

4. Letërsia e Kosovës dhe hegjemonitë e sotme

Pa asnjë ndjenjë inferioriteti dhe pa tendencë shkatërruese të mohimit të dialogimit kulturor, por edhe me pranimin natyral të principit dialogjik, mund të theksojmë se identiteti e dinjiteti i krijuar kulturor i Kosovës edhe sot përballet me hegjemoni, nëse jo të hapura, gjithsesi latente dhe të ridizajnuara me perfiditet. Kjo dukuri është "normale", sepse hegjemonitë vetëm ndërrojnë format, por si të tilla jetojnë në vazhdimësi në vorbujt e ndryshëm etno-centrikë të cilët posedojnë në vijimësi nervin hegjemonik.

Në krizën e vazhdueshme të konsolidimit shtëtëror të Kosovës hetohet edhe dyndja e madhe e botëkuptimeve për artin letrar mbi parimin e ndërtimit të urave të komunikimit kulturor. Kjo ide është shumë e mirë dhe e këndshme si parim njohjeje me tjetrin. Por, a nuk përmban kjo një tendencë hegjemonie ndaj kulturës tradicionale të Kosovës në përgjithësi dhe përvijimit të saj në kulturën letrare në veçanti? Mendojmë se rreziku ekziston! Në observimin e sjelljes së grupacioneve letrare e kulturore në Kosovë pa dyshim njeriu vëren disa fenomene, të cilat rrezikojnë dialogun normal të letërsisë dhe të kulturës me tjetrin.

Ta zëmë, ithtarët e nostalgjikët e jugosllavizmës, në emër të elementit letrar të universalitetit, shkruajnë e promovjnë me ndjenjen e një kosmopolitizmi qesharak, i cili s'është asgjë tjetër vetëm padituni e tendencë për etablimin e shenjave specifike në kulturën shqiptare në Kosovë. Nuk e kuptojnë se shkrimi letrar universalitetin e tij e fiton pikërisht duke qenë markë e vendit, gjuhë e tij. Si rrjedhojë, kaplohen nga yshtja e modes duke e vënë në krizë identietin e letërsisë shqipe në Kosovë e duke u bërë pjesë e një hegjemonie neo-jugosllave, qoftë edhe si utopi e kohës sonë. Kjo dukuri assesi nuk mund të konsiderohet dialogim kulturor, por inferioritet ndaj një ish-utopie.

Ndërkaq, në anën tjetër, mbi parimin se kultutra e letërsia e Kosovës na qenka një "xhep" i kulturës së përgjithshme shqiptare, "vëllai i madh", i cili gjithnjë ka qëndruar larg vetmisë shekullore shqiptare të Kosovës, merr guximin e mohimit, por realisht e në masë të madhe pa e njohur letërsinë e Kosovës. Hegjemonia arbitrare "e vëllait të madh" është raport i një nomenklature të vjetër shqiptare, e cila, e ridizajnuar si hegjemoni e re, apriori nuk pranon zhvillimin normal nacional letrar e kulturor. Në tendencën për vazhdimësinë hegjemonike çdo fokusim në autorë e vepra të letërsisë së

[10] Për më tepër shih: Nysret Krasniqi*: Letërsia e Kosovës: 1953-2000*, AIKD, Prishtinë, 2016

Kosovës si studim imanent i tyre etiketohet e shpeshherë përçmohet. Duhet të kuptohet përgjithmonë se letërsia dhe kultura nacionale formohet nga shuma e pjesëve të saj. Totaliteti ideal i kontrollit të saj është ideologji utopike.

Letërsia shqipe e Kosovës nuk ka nevojë të jetojë me frikën nga hegjemonitë. Si pjesë e pandarë e trashëgimisë letrare shqiptare ajo ka të drejtë, madje është imanencë primordiale, të fokusohet pikë së pari në fenomenologjinë e njeriut të saj. Ne, nëpërmjet këtij pohimi, nuk kërkojmë detyrë as funksion nga autori kosovar, madje nuk kërkojmë ndonjë shmangie të dialogimeve kulturore, të cilat janë të pashmangshme. Ne nuk kërkojmë as mohimin e dëshirës për ta parë letërsinë si medium kosmopolitesk apo edhe si aventurë metafizike, kozmogonike e filozofike. Por, letërsia e Kosovës pikë së pari është lokalitet e spiritualitet kosovar. Të themi me një figurë popullore është "buka që gatuhet në këtë vend", e cila me dashmirësi i ofrohet tjetrit, qoftë ky edhe i ngjashëm. Përçmimi arbitrar me tendencë hegjemonie apo edhe me frikën e lakminë se "buka e tjetrit" është më e mirë, nuk përben kulturë të lartë, madje kthehet në mungesë të vetëdijes letrare. Kështu që, autori dhe lexuesi i Kosovës duhet të jenë të lirë, sepse e aspirojnë lirinë. Liria është lidhja primordiale me gjuhën e vendin, me njeriun tonë, e cila është mbrojtja më e mirë nga hegjemonitë e ridizajnuara të kohës së re dhe e cila natyrshëm ndërton dialogun kulturor, pra komunikimin valid dhe normal me tjetrin.

Letërsisë së Kosovës, qoftë e traditës së saj letrare, qoftë e zërave të rinj që dalin përditë në ambientin tonë letrar, nuk i duhet kurrëfarë *konkuiste*. Madje tendenca për një veprim të tillë është më së e pambërrijtshme!

Literatura

Gani Bobi: *Sprovimet e modernitetit*, Rilindja, Prishtinë, 1982

Tzvetan Todorov: *Konkuista e Amerikës*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015

Donat Kurti & Berndardin Palaj: *Visaret e kombit, I-XI*, Provinca Françeskane, Shkodër, 2005-2007

Maximilian Lambertz*: Epika popullore e shqiptarëve* në *Çështje të folklorit shqiptar* 6, IKP, Tiranë, 1998

Noel Malcolm: *Vepra e Pjetër Bogdanit "Cuneus Prophetarum" dhe konteksti i saj fetar*, ligjeratë inauguruese, ASHAK, 2006

Pashko Vasa: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1989

Nysret Krasniqi*: Letërsia e Kosovës: 1953-2000*, AIKD, Prishtinë, 2016

Gjergj Fishta: *Lahuta e Malcis*, Buzuku & Dija, Prishtinë, 1999

Gjergj Fishta: *Mrizi i Zanavet*, Botime Françeskane, Shkodër, 2007

Naim Frashëri: *Bagëti e bujqësija*, Drita, Bukuresht, 1886

Pjetër Bogdani: *Cuneus Prophetarum*, ASHSH, Tiranë, 2005

Nysret KRASNIQI

MODES OF HEGEMONY IN THE ALBANIAN LITERATURE

Abstract

As we know literature in all cultures is not isolated phenomenon. Examining on Albanian history of literary writing we can observe many ideological and intentional poetical and narrative forms which are embodied by fear of hegemony. The main purpose of this paper is identifying the concept of hegemony, as the very notion indicates based on the roots of ancient and modern connotations, in romantic and pre-modern literary forms. Discussing hegemony in Albanian writing of those formations validated it's presence as a collective physiological haunting transmitted in the philosophy of creative processes especially as an authorial intentionality. This intention is based on the fear of diminishing of particular identity. Authors like Naim Frasheri, Pasko Vasa, Gjergj Fishta are well known of the historicizing nation with images of the past with the aim of continuity in the present with the psyche of the fear of hegemony. As a result we have many literary *strata* which indicate refusing certain forms of oppression and in this domain *structure of restriction* and the concept of the *fear of the other*. Restriction dictated establishing *legendary figures* which the crucial aim was to defend well known heritage but lacking of new perspectives and broader communications between cultures. Moreover, fear of the other as a potential hegemony gained higher basis on the so called *socialist realism* literature. Political doctrine of dictating literature on how to be sympathetic against foreign modes of expression realized one type of literature which is very aggressive toward accepting the other as an objective and valuable bridge of experiences and cultures. Thus, in those thematic units this paper analyses various modes of identity-formation such as restriction, symbolic representation of national identity, images of the other as a construction of identity as a fear of hegemony.

Key words: history, hegemony, restriction, the other, national identity, construction, communication, modernism and social realism in literature.

Lindita TAHIRI

KONCEPTI DIALOGJIK NDAJ *TJETRIT* NË VEPRËN E KADARESË

Përmbledhje

Ky punim synon të nxjerrë në pah konceptin dialogjik ndaj "tjetrit" që e shpërfaq Kadareja në veprën e vet, si mënyrë për të krijuar art universal dhe për t'i bërë ballë regjimit të egër komunist. Përmes përfshirjes dhe metaforizimit të "tjetrit" Kadare arrin të shpërthejë jo vetëm izolimin shqiptar por edhe kufijtë stilistik dhe shterpësinë letrare të realizmit socialist. Në një mjedis që përpiqej të shpërfytyrojë letërsinë përmes veprave të porositura në shërbim të interesave ditore të politikës, përmes vizionit të tij për "tjetrin" Kadare arrin të dëshmojë epërsinë e artit, në radhë të parë duke e shpëtuar gjuhën dhe mendimin e lirë nga zvetënimi orvelian.

Këtë vizion të Kadaresë do ta shohim përmes përzgjedhjeve tematike në krijimtarinë e tij siç janë bota e përtejme, bota e ëndrrave, e së kaluarës, e misterit, por edhe përmes këndvështrimit të të rrëfyerit, i cili në vend që të synojë rrëfimin objektiv, që e transmeton të vërtetën e plotë, transmeton versione të papërfunduara dhe të kufizuara të ngjarjeve, me personazhe të vagullta e të papërkufizuara saktë që i kalojnë kufijtë e "tjetrit".

Koncepti i "tjetrit" në këtë studim do të ndërlidhet me pikëpamjen postmoderne të Derrida-s për kundërshtitë konceptuale në të cilat mbështetet metafizika perëndimore, sipas së cilës njëri nga konceptet kundërshtuese gjithmonë shfaqet si i privilegjuar dhe e përkufizon *Tjetrin* si inferior. Rrjedhimisht, vetja shndërrohet në burim final të kuptimit dhe kjo shkakton të menduarit logocentrik, apo bindjen për burimin përfundimtar të së vërtetës. Në këtë studim do të analizohet narracioni dialogjik i Kadaresë që e çliron lexuesin prej prangave të gjykimit përfundimtar, mendimit të prerë dhe gjuhës dogmatike.

Fjalët çelës: *Kadare, rrëfimi panoptik, kritika letrare kognitive, empatia*

Letërsia si panoptikon

Në librin e tij "Mite dhe demonë në veprën e Kadaresë", Shaban Sinani (2016) bën një periodizim kronologjik të 'demonizimit' të *tjetrit* në veprat e Kadaresë. Fillimisht ky tjetër i demonizuar ishte imperializmi, më pastaj perandoria osmane,

sovjetike, kinezët, e kështu me radhë, për të shpërfaqur sindromin e armikut, i cili është karakteristik sidomos për letërsinë gojore të ballkanasve. Koncepti stereotip i "tjetrit" nuk është vetëm dukuri e mjediseve ballkanike, apo si thotë Derrida metafizika perëndimore mbështetet në kundërshtitë konceptuale sipas skemës ku njëri nga konceptet kundërshtuese gjithmonë shfaqet si i privilegjuar dhe e përkufizon *Tjetrin* si inferior. Ndërkaq, si vëren Sinani, Kadare, gradualisht e zvogëlon dozën e steriotipizimit të *tjetrit*, për të aritur, sidomos në dekadat e fundit, ta shfaqë *tjetrin* me empati për lexuesin. Pikërisht kjo shpërfaqje e tjetrit të çliruar, e bën edhe më të fuqishëm denoncimin e totalitarizmit, që në fakt është thelbi i veprimtarisë të Kadaresë.

Përzgjedhjet tematike në krijimtarinë e Kadaresë zakonisht e synojnë t*jetrin*, si për shembull e kapërthejnë botën e përtejme, ëndrrat, të kaluarën, misterin. Por, veçantia e stilit të tij del përmes këndvështrimit të të rrëfyerit, i cili në vend që të synojë rrëfimin përfundimtar që e transmeton të vërtetën e plotë, transmeton versione të papërfunduara dhe të kufizuara të ngjarjeve, me personazhe të vagullta e të papërkufizuara saktë që i kalojnë kufijtë e *tjetrit*. Është kjo veçanti që i mundësoi atij të shpërthejë kufijtë stilistikë të realizmit socialist dhe të çlirojë lexuesin e sistemit të egër komunist prej prangave të gjykimit përfundimtar, mendimit të prerë dhe gjuhës dogmatike.

Kritikët letrarë e kanë shfrytëzuar modelin panoptik të Foucalt (1975) për shoqëritë e disiplinuara, ku shkollat, burgjet, dhe institucionet e tjera, kontrollohen nga mbikqyrësit të cilët vetë janë të padukshëm, për ta përshkruar në mënyrë të ngjashme letërsinë realiste, duke e parë atë si zhanër që ushtron kontroll total në jetën e personazheve dhe në mendimet e tyre. Ngjashëm me shoqërinë, rrëfimi realist shihet si një burg ku personazhet mbikëqyren nga rrëfyesi i gjithëpushtetshëm dhe i gjithëdijshëm i cili i vëzhgon ata nga kulla e vet. Madje, autorja Sulieman (1993) e sheh romanin ideologjik si zhanër dhe manifestim të letërsisë realiste dhe didaktike.

Për disa studiues, narracionet që dallojnë për nga këndvështrimi, korrespondojnë me orientime të ndryshme ideologjike (Cohn: 1978:177). Përkatësisht, në rastet ku rrëfyesi është moralizues, vlerësues, gjykues, dhe autoritar, lexuesi i përket një shoqërie të zhytur në propaganda për vlera absolute, ndërkaq në rastet kur rrëfyesi ka qëndrim jondërhyrës, ai i mundëson lexuesit t t'i kuptojë këndvështrimet e ndryshme të të tjerëve, dhe njëkohësisht të bëhet i vetëdijshëm për pikëpamjet dhe mënyrën e vet të të menduarit. Rrjedhimisht, letërsia e këtillë e cila lejon kuptime të shumëfishta dhe fleksibilitet rrëfyes, e përgatit lexuesin që ta shohë me dyshim pretendimin e cilitdo ligjërim për dije absolute. Ndërkaq Bakhtini (1982) shfaqet në një pozicion ndryshe, dhe e koncepton romanin si një "polifoni" ideologjike e cila nuk arrin ta indoktrinojë lexuesin. Ai e ka theksuar faktin se gjuha e tjetrit, apo të folurit dhe të menduarit e personazheve në letërsi mundëson një dialogjizëm, dhe ky dialog i

gjuhëve në çdo moment të rrëfimit, i mundëson autorit shmangien nga një gjuhë e njëtrajtshme, e vetme dhe unike.

Vetvetja si Tjetri dhe tjetri si vetvetja: empatia

Kritika e orientuar kah lexuesi filloi të shfaqet kah vitet 30 dhe kulmoi në vitet 70 të shekullit të kaluar, duke vazhduar edhe sot të ndikojë në kritikën bashkëkohore letrare. Teoritë e orientuara kah lexuesi, fillimisht ishin reagim ndaj ideve formaliste të autoritetit të tekstit, dhe përqendroheshin tek interpretimet personale të lexuesit. Teoria e reagimit të lexuesit e zhvendos autoritetin nga teksti tek lexuesi, duke ia veshur shumëkuptimësinë vlerësimeve subjektive të lexuesit. Ajo që sot e tërheq interesimin sidomos të kritikës letrare kognitive, është procesi i leximit dhe ndëraktiviteti i lexuesit, që e nënkupton vetëdijen e lexuesit për bashkëpunimin me tekstin dhe për prodhimin e kuptimeve përmes iniciativës dhe vendimeve personale. Një nga reagimet që shquhet në këtë rast është empatia, apo bashkëndiesia për personazhet, dhe ndikimi i ligjeratës së zhdrejtë të lirë në ritjen e empatisë.

Studuesit e narratologjisë kognitive Fletcher dhe Monterosso (2016) hulumtuan reagimin e lexuesve pas ndryshimit të raportit mes ligjeratës së zhdrejtë të lirë dhe raportimit të mendimit, si dy teknika të ndryshme të transmetimit të botës të brendshme të përsonazheve. Ata konstatojnë se rritja e përdorimit të ligjeratës të zhdrejtë të lirë e nxit përfshirjen emocionale të lexuesve dhe i bën ata të bashkëndiejnë me personazhet. Kësaj teknike të transmetimit të botës të brendshme të personazheve i është kushtuar më shumë vëmendje nga kritika bashkëkohore, edhe për arsyen se perspektivizmi i brendshëm si teknikë rrëfimi është dukuri relativisht e re dhe nuk ka qenë tipar i rrëfimit letrar deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

Ndërkaq studiuesja Keen (2006) thekson se edhe pse kritika letrare e ka lidhur perspektivizmin e transmetimit të botës së brendshme të personazheve me empatinë/bashkëndiesinë dhe është trajtuar nga narratologë si Booth (1983), Stanzel (1984), Bannfield (1982) për forcën e ndikimit te lexuesi, megjithatë reagimet varen nga kompetenca narrative e lexuesve dhe ky raport ka një dozë subjektivizmi. Ajo e tërheq vërejtjen se korrespondenca një me një i teknikave të caktuara letrare me efektin tek lexuesi mund të shkaktojë thjeshtëzim të hulumtimeve lidhur me nxitjen e bashkëndiesisë të lexuesit.

Rrëfimi joautoritar i Kadaresë

Për të ilustruar teknikën jondërhyrëse dhe joautoritare të Kadaresë, të shohim fragmentin që në fakt është teksti përmbyllës i romanit të tij *Prilli i thyer*, duke e analizuar mënyrën e transmetimit të botës të brendshme të personazhit:

Krahu i tij, me një lëvizje të beftë, deshi të hiqte pushkën nga krahu, por ngritja e krahut u përzie me fjalën "qyqes", gjysma e mbiemrit të urryer, që arriti turbull në ndërgjegjen e tij. Gjorgu pa tokën të lëvizte, pastaj tabani i saj u ngrit furishëm vertikalisht, duke iu përplasur në fytyrë. Ishte rrëzuar.

Një grimë bota u shurdhua krejt, pastaj përmes shurdhërisë së saj ai dëgjoi ca hapa. Ndjeu dy duar që diçka po bënin me trupin e tij. Po më kthejnë mbarë, mendoi. Po në atë çast diçka e ftohtë, ndoshta tyta e pushkës, i preku faqen e djathtë. O zot, krejt sipas rregullave. Ai u përpoq të hapte sytë. Nuk kuptoi nëse i hapi dot apo jo, veçse në vend të gjakësit pa ca njolla të bardha bore që ende s'kishin shkrirë dhe përmes tyre kaun e zi që s'po shitej dot. Kjo është e gjitha, mendoi, madje shumë u zgjat.

Dëgjonte akoma hapat që po largoheshin dhe dy-tri herë pyeti veten: të kujt janë vallë ? Iu dukën si hapa të njohur. Ah, po ata ishin krejt të njohur, ashtu si dhe duart që e këthyen mbarë... Janë tamam të miat, tha me vete. Në shtatëmbëdhjetë mars, udha pranë Brezftohtit.... Një çast e humbi ndërgjegjen, pastaj prapë dëgjoi kumbimin e hapave dhe përsëri iu duk se ata ishin krejt hapat e tij dhe ishte ai vetë e askush tjetër, që po vraponte kështu, duke lënë pas, të shtrirë midis rrugës, trupin e vet, që porsa e kishte vrarë.

(fq. 184-185)

Në fragment vërehet roli i dyfishtë i personazhit si kryefjalë dhe kundrinë. Roli i gjymtyrëve të Gjorgut si kryefjalë (krahu i tij... deshi të hiqte pushkën nga krahu, por ngritja e krahut u përzie..) sugjeron pamundësinë e kontrollit fizik dhe humbjen e vetëdijes shqisore, që gjithandej në tekst shquhet si cilësi e mjedisit që e rrethon personazhin. Personazhi nuk arrin të kontrollojë veprimet e veta: 'krahu' njerizohet me foljen 'deshi' si veprues dhe si pësues njëkohësisht (nga krahu), dhe përfshihet në një aktivitet të emërzuar e të ngurosur (ngritja). Humbja e kontrollit dhe vetëdijes të personazhit kontrastohet me veprimin e ambientit (pa tokën të lëvizte), dhe ky aktivitet i jashtëm përforcohet gradualisht derisa shndërrohet në veprues ndaj personazhit viktimë (u ngrit furishëm vertikalisht, duke iu përplasur në fytyrë).

Personazhi nuk është pësues vetëm në raport me mjedisin e jashtëm, por edhe në raport me procesin e zhvetëdijësimit, siç del për shembull nga fjalia 'Ishte rrëzuar', e cila me shkurtësinë e vet e përforcon rrafshin përmbajtësor të fjalisë. Koha më se e kryer e foljes e thekson përfundimin e veprimit para një çasti në të kaluarën- pra, personazhi e vetëdijesohet për ndryshimin e gjendjes së vet fizike pasi ajo të ketë përfunduar, njëlloj si të ishte shikues e jo pësues. Efektin e shpërqendrimit nda lëvizjet dhe përjetimet konkrete të personazhit e përforcon edhe trajta joveprore e foljes – efekti i trajtës veprore për shembull 'kishte rënë', nuk do të nxiste konotacione të njëjta, sepse do t' i referohej kryerjes së veprimit, dhe jo vetëm pasojave të tij, apo vetëdijen e vonuar për këto pasoja.

Personazhi përjeton jashtë-vetëdijshëm veprime nga një veprues anonim, të cilësuar me pashquarsi dhe me përemra të pacaktuar. Përdorimi i përemrit vetvetor e shquan dysinë e brendshme të personazhit, sidomos me kundërvënien e tij ndaj përemrit vetor në fund të tekstit. Dysia e brendshme e arrin kulmin kur njëra pjesë e personazhit del si kryefjalë- veprues i foljes kundrinë e së cilës është pjesa tjetër, vetja tjetër e personazhit (ai vetë e askush tjetër.... trupin e vet, që posa e kishte vrarë).

Ajo pjesë e personazhit që është viktimë, dhe që shfaqet në rolin e pësuesit, artikulohet me emrin konkret 'trupi', që sugjeron konotacione të jetës konkrete shqisore, e cila përfundon dhe shkatërrohet nga veprimet e një qenieje abstrakte të dytë brenda personazhit, nga veprimet e vetes të pakontrolluar dhe jashtëvetëdijësore. Veprimi i vrasjes i shënuar me më se të kryerën (kishte vrarë) del si pasojë - më shumë se sa si kryerje aktuale e veprimit. Efektin e veprimit personazhi e ndjen të vonuar, në një moment të konkretizuar kohësisht me ndajfoljen 'porsa', kur përfundimisht shkatërrohet dhe merr fund vetja-pësues, vetja që ishte e paaftë dhe e viktimizuar, në të njëjtën mënyrë siç kishte qenë viktimë edhe i vrari i aktit gjakmarrës së Gjorgut.

Roli i dyfishtë i Gjorgut ndaj foljeve, me alternimin e tij prej kryefjalës në kundrinë dhe anasjelltas shënon individualitetin e tij të përçarë në dysh që e përshkon tërë gjuhën e tekstit, si përpjekje për t'u vetëpërkufizuar e për t' u formësuar si identitet, që përfundon me vetëzhdukje dhe me asgjësim. Këto tipare gjuhësore të rolit veprues të personazhit transmetohen me një kombinim të ligjeratës së zhdrejtë të lirë dhe mendimit të raportuar (në rastet kur përdoret pjesa lajmëruese si 'pyeti veten', 'mendoi', 'tha me vete', etj.)

Ashtu si thekson Sh, Sinani (2016), ligjërimi dhe mjedisi në veprën "Prilli i thyer" janë etnografike, por nuk është e tillë vepra stilistikisht, dhe nuk e madhështon Kanunin, por në të kundërtën, e shfaq peshën totalitare të tij. Përmes perspektivizmit të brendshëm të personazhit, arihet që ai të portretohet si viktimë e shtypjes dhe tëhuajsimit që ia shkakton Kanuni i gjithpushtetshëm.

Përfundim

Raportet formale mes rrëfyesëve dhe personazheve letrare shpesh janë tregues edhe të ideologjive të caktuara në një shoqëri, meqenëse si çdo lloj tjetër diskursi, letërsia është reprodukim i strukturave autoritare të shoqërisë që e prodhon dhe njëkohësisht e konsumon atë letërsi. Kadare arrin t'i shpërthejë kufizimet stilistike të realizmit socialist duke i flakur privilegjet tradicionale të narratorit të gjithëdijshëm dhe duke e tërhequr në prapavijë veten që rrëfen për ta vënë në plan të parë veten që përjeton. Kështu Kadare arrin të krijojë art universal edhe brenda regjimit të egër komunist. Përmes transmetimit joautoritar dhe mosndërhyrës të botës së brendshme të personazhit ai nxit bashkëndiesinë e lexuesit dhe e inkurajon interpretimin e lirshëm, kritik, e të pavarur nga tutela e autorit didaktik e moralizues.

Referencat

Banfield, Ann.1982. "*Unspeakable Sentences*", Routledge & Kegan Paul

Bakhtin, M.M. 1982.T*he dialogic Imagination.* Translated by Caryl Emerson and Michael Holquist. University of Texas Press.

Booth, Wayne C. 1983.*The Rhetoric of Fiction.* 2nd ed. Chicago: Univ. of Chicago Press

Derek, Allan. 2001. *Literature and Reality. Journal of European Studies*, Vol. 31, No. 2

Cohn, Dorrit. 1978. *Transparent Minds: Narrative Modes for Presenting Consciousness in Fiction.* Princeton:Princeton Univ. Press. 1999. "The Distinction of Fiction". John Hopkins University Press

Fletcher, Angus, and John Monterosso. "The Science of Free-Indirect Discourse: An Alternate Cognitive Effect." *Narrative* 24.1 (2016): 82–103.

Keen, Suzanne.2007. *Empathy and the Novel.* New York and Oxford: Oxford Univ. Press

Sinani, Shaban. 2016. Mite dhe demonë në veprën e Kadaresë. Tiranë: Naimi

Stanzel, Franz K. *A.1984.Theory of Narrative.* Translated by Charlotte Goedsche. Cambridge: Cambridge Univ. Press

Suleiman, Susan Rubin. 1993." *Authoritarian Fictions. The ideological Novel as Literary Genre*". Columbia University Press

Lindita TAHIRI

THE DIALOGIC CONCEPT TOWARD THE OTHER IN THE WORKS OF KADARE

Abstract

This article aims at emphasizing the dialogic concept toward 'the other' as depicted by Kadare in his work as a way of creating universal art and facing the severe communist regime. Through the inclusion and metaphorization of 'the other', Kadare manages to erupt not only Albanian isolation but also the stylistic boundaries and the literary infertility of socialist realism. In an ambiance which attempted to dissemble literature through appointed works in service of daily political interests, through his vision of 'the other' Kadare managed to prove the superiority of art, firstly by saving language and thought from Orwellian deterioration. This vision of Kadare will be seen through thematic selection in his oeuvre such as the world beyond, the world of dreams, the world of the past, of mistery, but also through the point of view of the narration which, instead of aiming at an objective narrative which transmits the full truth, it transmits unfinished and limited versions of events, through vague and

undefined characters that go beyong the limits of 'the other'. The concept of 'the other' in this study will be interrelated to the postmodern view of Derrida regarding the binary oppositions in which Western metaphysics relies upon and in which one of the oppositions is priviledged and defines The Other as the inferior element. Consequently, the self turns into the final source of meaning, thus creating a logocentric mode of thinking or the assumption of a final source of the truth. This study analyzes the dialogic narration of Kadare which liberates the reader from the cuffs of a final assumption, of a decisive thought and of dogmatic language.

Ag APOLLONI

TJETRI SIPAS TË TJERËVE TE *GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR*

Titulli i këtij punimi është ambiguitiv: së pari, tjetri domethënë armiku siç e kanë parë të tjerët dhe këtu Kadare është krahasuar me Eskilin dhe, së dyti, tjetri domethënë shqiptari siç e kanë parë të tjerët. Pra, në fillim tjetri është ai që s'është si ne, pastaj tjetri, sipas të tjerëve, jemi ne që s'jemi si ata.

Tjetri sipas Eskilit dhe Kadaresë

Eskili është një ndër autorët që Kadare e çmon më së shumti dhe për të cilin ka shkruar një libër eseistik. Sipas Kadaresë, Eskili është autori i parë që ka trajtuar temën e *Gjeneralit*:

> *Shkrimtari i parë në botë që ka shkruar për këtë subjekt është Eskili. Kur shkrova "Gjeneralin" nuk e dija ende që edhe ai kishte shkruar për kthimin e një ushtrie të vdekur. Më vonë vura re se tek Orestia, kishte një faqe që ngjasonte në mënyrë të çuditshme me këtë histori. Eskili ka përmendur ushtarët e nisur për në Trojë, prej të cilëve kthehen më pas vetëm arkëmortet, brenda të cilave ndodhej hiri ose eshtrat e ushtarëve. Përshkruan zinë që pllakosi në Greqi, mbërritjen e arkëmorteve dhe ceremonitë e varrimit. E gjitha është shumë moderne dhe ka rindodhur në tërë luftërat e mëpasshme.*
>
> (Faye, 2007: 80-81)

Tek *Agamemnoni* (pjesa e parë e trilogjisë *Orestia*) tashmë Eskili nuk flet për ushtri të huaj pushtuese, por për ushtrinë e vet pushtuese, e cila ishte nisur për të pushtuar Trojën. Tash greku është pushtuesi dhe Eskili e di që pushtuesi do t'i mbledhë eshtrat e veta:

> Që kur iku nga Greqia
> Ushtëria helenike,
> Një zi që të djeg në zemër
> Ka mbuluar çdo shtëpi.
> Gjithë zemrat kanë plagë,
> Se kushdo e di ç'dërgoi
> Por se kthehen në shtëpi

Jo më njerës, jo më burra:
Vetëm arka plot me hi.

(Eskili, 1982: 155)

Këto arka jo me njerëz, por me hi dhe me eshtra, përsëriten në çdo luftë dhe shfaqen shumë shekuj më vonë te *Gjenerali*. Kthimi i ushtrisë së vdekur në Greqinë antike dhe kthimi i ushtrisë së vdekur në Italinë moderne është identik, aq më shumë kur në të dy rastet ushtria e vdekur duhet të kalojë detin.

Edhe hyji Ari
Që këmben me ar
Trupa vdekëtarësh,
Që mban ndër betejat
Nëpër duart peshën,
U dërgon nga Troja
Miqve plot me helm
Disa mbeturina
Q'i ka mbledhur vetë
Përmbi zjarr të luftës:
Enë plot me hi
Enë plot me shpuzë.
Qajnë, lavdërojnë
Ca atë që pati
dije ushtarake,
ca të tjerë trimin
që ra në betejë.

(Eskili, 1982: 155-156)

Këta që qajnë e lavdërojnë te *Gjenerali* janë "kthyer" në veteranë të luftës, që presin riatdhesimin e të vdekurve që vdiqën në dhé të huaj.

Ca të tjerë prapë
Nga rinija trime,
Varret rreth i kanë
Mureve të Trojës.

(Eskili, 1982: 156)

Eskili tregon se lufta që bënë grekët në Trojë ishte e padrejtë, prandaj ai që e nxiti atë luftë (Agamemnoni) do ta paguajë shtrenjtë (do të vritet nga e shoqja), siç do ta paguajnë shekuj më vonë edhe Hitleri dhe Musolini:

Është' i rëndë zëri
Që lëshon një popull
Fort i zemëruar;
E paguan shtrenjtë
Robi mbi të cilin
Turret ky mallkim.

(Eskili, 1982: 156)

Fjalët e korit te tragjedia e Eskilit, duket sikur më vonë do të krijojnë dëshpërimin e gjeneralit, i cili me lista në duar numëron eshtrat e bashkatdhetarëve të rënë në dhé të huaj:

Ay q'është i gjallë
Pse t'i numrojë njerëzit e vrarë
Dhe pse të helmohet për fatin e keq?

(Eskili, 1982: 162)

Këto vargje te *Gjenerali* bëhen revoltuese: *Unë mblodha humbjet tuaja, gjeneralë të këqij*! Ndërsa, thënia eskiliane se *vdekja është m'e ëmbël sesa tirania*, ilustrohet shkëlqyeshëm me Nik Martinin, i cili porsa sheh ushtrinë pushtuese merr pushkën dhe lufton i vetëm kundër një ushtrie.

Edhe pse mund të gjenden lidhje mes *Agamemnonit* dhe *Gjeneralit*, ngjashmëritë më të dukshme janë mes tragjedisë *Persët* dhe *Gjeneralit*.

Persët nuk është tragjedi mitike, por tragjedi satirike me një ironi shkatërruese. Tema aktuale, ideja politike[1] dhe diskursi elegjiak, dëshmojnë për prezencën e satirës gjithandej në vepër, ku diskursi elegjiak i personazheve nënkupton himnizimin e publikut (popullit) grek. Në këtë tragjedi, që është tragjedi për persët e himn për grekët, nuk ka madje as heronj, çka do të duhej të kishte në një tragjedi të mirëfilltë, sipas poetikës aristoteliane, por ka qyqarë e qaramanë. Prandaj, edhe katarsisi i kësaj vepre është katarsis *sui generis*: pësimet e armikut pers e kënaqin spektatorin grek dhe e bëjnë të ndihet krenar dhe kështu ai lartësohet nëpërmjet një katarsisi krejt ndryshe

[1] Thuhet se para Eskilit, Friniku, tragjediograf nga Athina, shkroi tragjedinë "Marrja e Miletit", e cila u shfaq më 484 para Krishtit dhe pastaj u dënua rëndë, sepse trajtonte temë aktuale, madje imitonte ngjarje që ua kujtonte grekëve disfatën e tyre nga persët.

nga ai për të cilin fliste Aristoteli. Vaj në skenë, gëzim në publik - ky duket si katarsis sadist, por meqë derivon nga humbja e pushtuesit, ka thelbin humanist.

Identik me modelimin dhe funksionin e kësaj tragjedie është edhe romani i Kadaresë. Trualli i vështirë, malet e shumta, kodrat e larta e përbëjnë tokën shqiptare që u ndihmon vendësve në luftën kundër të huajve pushtues, ashtu si u ka ndihmuar edhe grekëve toka e tyre. Prandaj edhe korrespondojnë me njëra-tjetrën dy tekste të kohëve të ndryshme, antike dhe moderne. Toka shqiptare dhe toka greke u ndihmojnë të vetëve për ta mundur pushtuesin italian, apo persian.

DARI :
Mos bëni luftë me grekët kurrë,
e sikur t'jetë shumë m'e fortë
ushtria perse; sepse atyre
u ndih në luftë dhe toka vetë.

(Eskili, 1982: 47)

Kjo këshillë e Darit has në vesh të shurdhër dhe Kserksi niset për ta pushtuar Greqinë, por kthehet i turpëruar, me humbje shumë të mëdha. Skenat ku vajtohet humbja e ushtrisë pushtuese, janë të ngjashme me *Gjeneralin*. Për shembull, vargu *gratë burrat i vajtojnë* (Eskili, 1982: 7) të kujton konteshën dhe Betin. Po ashtu edhe vargjet në vazhdim:

Shtretet janë qull
Nga lotët që derdhen
Pse mungojnë burrat;
Çdo grua persane
E shtënë në zi,
Me që ka përcjellë
Burrin e saj trim,
Trim e luftëtar,
Mbet në shtratin vetëm
Dhe nga mall'i burrit
Tretet e venitet

(Eskili, 1982: 12)

Te *Gjenerali*, njëra nga ato gra është Beti që qan për kolonelin Z. Gratë italiane dhe gratë persiane nuk e dinë tamam se në ç'vend u kanë shkuar bijtë dhe burrat.

Tashi, o miq, dua të mësoj
në ç'vend të tokës ndodhet Athina

(Eskili, 1982: 17)

Te *Gjenerali* kjo mosnjohje e vendit të pushtuar, kulmon me një plakë që vjen te gjenerali për të kërkuar të birin:

- Kam djalin atje, - tha me zë të pafuqishëm, - djalin e vetëm, - dhe nxori rizën e nisi ta shpaloste me duart që i dridheshin. Prej andej nxori një telegram të zverdhur nga koha dhe ia zgjati. Ai e lexoi shprehjen e zakonshme të komandës ushtarake, që lajmëronte vdekjet dhe sytë i mbetën te fjalët e fundit "ra për atdhe, në Stalingrad".
- Zonjë, - i shpjegoi ngadalë, - unë do të shkoj në Shqipëri, nuk do të shkoj në Rusi.

(Kadare, 2011: 50)

Pastaj tregohet sesi pushtuesit, sado të përkushtuar ndaj mbretit të tyre dhe sado të lindur trima, vdesin me turp në dhé të huaj.

Ata nga Persët q'ishin më trima,
Më guximtarë, tepër fisnikë
Dhe më besnikë ndaj mbretit tyre,
Gjetnë një vdekje jo të lavdishme

(Eskili, 1982: 28)

Këto vargje, të shkruara para mijëra vjetësh, u shkojnë për shtati edhe ushtrive naziste e fashiste. Ato flasin për vdekje të palavdishme, për çfarë flet edhe *Gjenerali*. Vdekja e kolonelit Z, vdekja e dezertorëve etj., janë vdekje me turp. Ushtria italiane, si edhe ajo persiane, bënë luftë të padrejtë, prandaj edhe u ndëshkuan nga fati dhe nga shkrimtarët e vendeve fitimtare.

Gjenerali i ushtrisë së vdekur, duke paraqitur humbjen e një ushtrie pushtuese, zgjon krenarinë e shqiptarëve. Publiku shqiptar, ashtu si publiku grek para dy mijë e pesëqind vjetësh, përjeton katarsisin nëpërmjet krenarisë kombëtare. Prandaj, për nga rëndësia që paraqesin për letërsitë përkatëse, Eskili dhe Kadare janë në të njëjtin nivel, kurse për nga ideja dhe funksioni veprat e tyre janë motërzime. Sa më të turpëruar Kserksi e gjenerali, aq më krenarë grekët dhe shqiptarët. Sa më i madh pikëllimi i persëve dhe i italianëve, aq më e madhe kënaqësia e grekëve dhe e shqiptarëve.

Si në të gjitha romanet e Kadaresë, edhe te *Gjenerali* funksioni i romanit vetëkomentohet:

> - Ata besoj do të vinë, me përjashtim të grave dhe të pleqve, që e kanë për gjynah të hapin varre.
> - Mbase do të vijnë edhe gratë dhe pleqtë. Ndoshta kjo punë u jep një kënaqësi të fshehtë.
> - S'e besoj, - tha gjenerali. – E kush mund të ndjej kënaqësi duke hapur varre?
> - Për ta kjo është njëfarë hakmarrjeje e vonë.
>
> (Kadare, 2011: 90)

Apo edhe në një shembull tjetër i dhënë nëpërmjet pyetjes retorike:

> A ka shpërblim më të madh për një luftëtar të vjetër, sesa nxjerrja nga varret e ish-armiqve të tij.
>
> (Kadare, 2011: 99)

Ky është gjithashtu një rast i rrallë kur të tri qëllimet, për të cilat flet Umberto Eco, janë në përputhje të plotë me njëri-tjetrin: qëllimi i autorit, qëllimi i tekstit dhe qëllimi i lexuesit. Ismail Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dhe lexuesi shqiptar janë një trini meqë synojnë të njëjtin qëllim. Romani manifeston besnikërisht qëndrimin e autorit dhe duartrokitet nga publiku.

Shqiptari sipas të tjerëve

Derisa për ta paraqitur tjetrin si armik, Kadare ndjek modelin e Eskilit, për ta paraqitur shqiptarin si tjetër ndjek të tjerët që kanë shkruar për shqiptarin. Autori, duke u munduar ta shohë Shqipërinë me syrin e të huajit, në rrëfimin e tij ka derdhur gjithë informacionin që ka pasur në dispozicion nga shënimet e mëparshme të të huajve mbi shqiptarët. Ai edhe patriotizmin e shqiptarëve, që është ngjyra më e dukshme e romanit, e ndërton me mendimet e të huajve për ta, madje shpesh edhe duke parodizuar. Hipoteza mbi origjinën italiane të emrit shqiptar nga fjala italiane *schioppetto*, që do të thotë pushkë (Çabej, 1988: V, 70), parodizohet nëpërmjet Nik Martinit, i cili i pret italianët me pushkë.

Në ditarin e ushtarit dezertor Shqipëria krahasohet me Zvicrën dhe ky krahasim nuk është i pabazë. Francezi Ami Boué ka shkruar për këto ngjashmëri:

> Në se Shqiptari ka cilësitë fizike të Zvicerianëve dhe Tirolezëve, nëse ai është

> ashtu si ata nji rrugëtar i patrembur, duke iu ngjitur maleve me pushkën hedhur mbi supe, ashtu si dhitë, gjithsesi ai ka më shumë se ata gjallërinë dhe harenë e viseve jugore, të bashkuar me një mendjemprehtësi të jashtëzakonshme dhe të castit. Është, ashtu si grekët, popull që në vecanti i ka përgjigjet e lezecme në majë të gjuhës. Krenaria kombëtare tregohet edhe nëpërmjet fjalëve më të parëndësishme të Schkipetares (Shqiptarëve), nga gjestet, nga ecja e tyre e lehtë apo madje teatrale. Guximi i tyre është i lindur, ndërsa kur janë të qytetëruar, në vend që të jenë Zviceranët e Lindjes ata janë Francezë, d.m.th. janë nga ata popuj, të cilëve iu buzëqeshin më shumë fitoret.Jeta aventureske është aq shumë element i tyresa ata harrojnë t'i venë në balancë të këqiat e shkaktuara nga luftrat.
>
> (Boué, 2011: 27)

Ky citat mund të ilustrohet lehtë me ironinë e mullisit dhe me krenarinë e Nik Martinit. Për teatralitetin dhe kurajën e shqiptarit flet edhe prifti që e shoqëron gjeneralin. Madje prifti është ai që e shikon dhe e interpreton Shqipërinë dhe shqiptarin si *tjetër*. Në priftin janë derdhur shumë ide të të huajve që kanë folur për shqiptarët. Të gjitha këto mendime të të huajve i shkojnë priftit, siç është mendimi i historianit Herbert Louis:

> Një nga përshtypjet më të forta që të lë një pjekje e gjatë me popullsinë shqiptare është sigurisht kjo që te çdo Shqiptar shohim një njeri që vepron me kokë të tij,
>
> (Cit. sipas: Çabej, 1988: V, 115)

Krejt çka flet prifti ka një bazë, herë shkencore, herë pseudoshkencore. Fjalët e tij, duke qenë informative, natyrisht e ngadalësojnë ritmin, prandaj mungesa e tyre do t'ia shtonte tensionin dramatik romanit. Mirëpo, inkorporimi i informatave të priftit dhe etnografizmi autorial, alternojnë përplasjen e dy perspektivave: si na shohin të huajt dhe si jemi ne në të vërtetë. Ato që i thotë Kadare për shqiptarët, i kanë thënë edhe më parë të huajt: George Byron, Herbert Louis, J. F. Fallmerayer, Ami Boué etj., të cilët fillimisht publikut shqiptar iu ofruan prej dy miqve të Ismail Kadaresë: Eqrem Çabejt dhe Skënder Luarasit.

Gjenerali i ushtrisë së vdekur, prandaj, është një model për t'i ikur diskursit patetik dhe nacionalo-narcistik. Kadare lavdëron shqiptarin vetëm aq sa e kanë lavdëruar shkrimtarët dhe historianët e huaj dhe e urren armikun ashtu siç e kanë urryer edhe shkrimtarët e tjerë të mëdhenj botërorë.

Bibliografia

Ami Boué, *Shqipëria*, Plejad, Tiranë, 2011
Aristoteli, *Poetika*, Rilindja, Prishtinë, 1984
Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore* – V, Rilindja, Prishtinë, 1988
Eric Faye, *Tri biseda me Kadarenë*, Onufri, Tiranë, 2007
Eskili, *Tragjedi*, Rilindja, Prishtinë, 1982
Ismail Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Onufri, Tiranë, 2011
Umberto Eco, *The Limits of Interpretation,* Indiana University Press, 1991

Ag APOLLONI

THE OTHER ACCORDING TO THE OTHERS IN *THE GENERAL OF THE DEAD ARMY*

Abstract

Trying to see Albania with the stranger's eye, Ismail Kadare in his novel *The General of the Dead Army* has shed all the information that was available from the foreigners' documents on Albanians. Even the patriotism of Albanians, which is the most visible color of the novel, builds up with the opinions of the others. Then all what the Italian priest speaks has a base, scientific or pseudo-scientific. The incorporation of the priest's information and the Albanian ethnography, alternate between two perspectives: how the others see us and how we are actually. What Kadare tells about Albanians has been said by foreigners: George Byron, Herbert Louis, J. F. Fallmerayer, Ami Boué etc.

Key words: patriotism, glorification, narcissistic, hypothesis, catharsis, ethnographic

Dije DEMIRI-FRANGU

TË TJERËT DHE FIKSIONI SHQIPTAR

Abstrakti

Letërsitë janë plot me të *tjerë,* me të *huaj*, ato funksionojnë përmes oponencës, qoftë asaj fizike apo konceptuale. Vepra ka sistem personazhes, hierarki që krahas rolit strukturor, ndihmojnë në krijimin e diferencës, kontrastit e të shpeshtën edhe krijimin e konfliktit, dhe atë përmes *tjetrit*. Letërsia jonë, vonë ka nisur konfliktin me të "tanët", pos në rastet e luftës ndaj traditave joaktuale dhe zakoneve të dëmshme e ndonjë ideologjie - sidomos në letërsinë shqipe të realsocializmit, konfliktin e krijon ai *tjetri*, që vjen nga diku me një qëllim jo të mirë, me një strategji, që të rrënojë tënden dhe të ndërtojë atë *tjetrën* - të tijën ose-ose, oponenca ndërtohet edhe përmes *tjetrës që shfaqet si* ideologji, si koncept dhe si qasje. Në këtë rast, fiksioni përmes elaborimit *të tjetrit*, është bërë mjet - qoftë edhe nxitës për ndryshime.

Tjetri ose *i huaji* -është një status tjetër, është hierarkia që krijon ultra-njerëzoren, në kontekstin shoqëror, krijon kastën që ndërton e ruan marrëdhënie të caktuara, statuse të caktuara kombëtare e shoqërore.

Këta të tjerët janë shumë, dhe të ndryshëm.

Është interesante edhe pozita jonë si *të tjerë*, që zakonisht jepet përmes figurës madhore të Skenderbeut, si te poeti Ronsard (shek. XVI) në poemën e tij, Henry Wadsworth Longfellou në shek.XIX, pastaj një autore franceze-anonime, më 1732 shkroi romanin *Skënderbeu apo aventura e princit të Shqipërisë*, Antonio Xonkanda, një romansier italian, shkroi mbi një histori dashurie të Skenderbeut, me vashën e sulltanit e tjerë.

Kurse në letërsinë shqipe si të *tjerë*, si në poezi ashtu edhe në prozë, që nga Rilindja, dominojnë personazhet nga taborri i pushtuesve, deri te botimi i vonshëm i romanit të Gjergj Zhejit, "Muret e Krujës". Pastaj, të tjerë janë fashistët, krejt vonë ata janë komunistë. Është me interes që në një numër të konsiderueshëm të poezive, të Rilindësve, por edhe të poezisë së mëvonshmë, e kryesisht në tipin e poezive përkushtuese, shumë autorë u kushtojnë poezi miqve të popullit shqiptar si dhe albanologëve të huaj. *Të tjerët* në letërsinë shqipe, pra janë armiqtë dhe më pak -e

kryesisht në disa lirika, miqtë, por krahas kësaj, në këtë rast *tjetri* është *tjetra,* që janë të dashurat e krijuesve.

Fjalët çelës: *tjetri, oponenca, konteksti, marrëdhënia, fiksioni.*

Lirika dhe *tjetri* si frymëzim i saj

Tipologjia *e tjetrit* në lirikën shqipe, është mjaft e pasur, lirika patriotike, shoqërore, saterike, përkushtuese dhe ajo e dashurisë. i *hujai-tjetri*, në këtë rast është njeri kërcënues e i padëshirueshëm, por edhe njeri i dashur dhe i dashuruar.

Në këtë tipologji vend të mirë zë lirika e dashurisë, kushtuar të dashurave me origjinë joshqiptare, që nga H. Mosi, P.Vasa, Cajupi, Serembe e deri tek Kadareja e Agolli, krijohen poezi me një ndjenjë admirimi për *tjetrën,* të huajen, në këtë rast, si të dashura.

Gruas së tij me origjinë zvicerane, Evgjenisë, Cajupi ia kushton elegjinë ***Vaje,*** një ndër elegjitë më të bukura të letërsisë shqipe. Këtu, përmes një dialogu imagjinar, pas 10 vjet te vdekjes së saj, ai ndërton emocionin e fuqishëm të mungesës, duke bërë një epërsi emocionale ndaj arsyjes, përmes një qasjeje thuajse afektive ndaj humbjes së saj. Kjo elegji bëhet edhe më intenzive me pikëllimin kulminant si ndjenjë, krahas faktit se shprehet një eksperiencë reale jetësore e autorit. Gjendja psikologjike e heroit lirik shprehet në stadin e një dëshpërimi. Poezia si një përvojë trishtimi dhe reflektimi, shkaku edhe i të birit bonjak, nuk e lë autorit të kapërcejë mbi hidhërimin. Dialogu imagjinar i autorit me Evgjeninë është plot pyetje retorike, që krijojnë një dinamikë emocionale dhe ndërtojnë intenzitetin e saj.

Në c kopshte me lule ke qëndruar vallë?
S të vjen keq për mua? S të vjen mallë për djalë?
O ëngjëll i bukur mos mëno në botë
Ktheu të të shomë të na mbeten lotë[1]

Evgjenia është pafundësisht e dashur për autorin.

Ndërsa, poezitë e dashurisë, të Vaso Pashës dhe e H. Mosit, janë plot dritë lirike dhe tipikisht romantike. Të dashurat janë Anna Sherer e Zonjusha Katerina - gra joshqiptare, por shumë të dashura, gra që shkaktojnë tek ta dhembjen transendentale, mishërime dhe qasje që kryesisht përkon me filozofinë romantike. Thelbi i dashurisë është vasha, që krijon trazimin e bukur poetic, që arsyeton dhembjen tipike romantike. Poezi me gjuhë të thjeshtë, me ndonjë krahasim e metaforë të rrallë, na shpërfaqin

[1] www.shqiperia.com/letersia/**vaje**.php

realitetin e brendshëm romantic të autorëve ku hetohet ndikimi nga letërsia popullore por edhe nga romantikët botëror. Hil Mosi, në një moment, hymnizon deri në skajshmëri dashurinë, si ndjenjë dhe si paradox për kohën, dashurinë e vashës e vë mbi atë të atdheut:

ktu nuk due atdheun me qamun....
do t'vajtoj se ma nuk m'rrihet,
do t vajtoj me lot dashtninë!
E bukur s m duket nata/me at « qetesinë e vet!
T'gjith' pemt më duken t' thata,
Gjithshka më duket shkret[2]

Te romantikët, kryesisht është një dashuri agape, e padjallëzuar dhe jo vetëm emocion i rastësishëm, por përkushtim, duke tejkaluar ndjenën dhe duke zhurmuar si një passion. Hil Mosi, është nga autorët që mbush lirikat e tij edhe me emra të njerëzve të mëdhenj të huajsh, duke krijuar poezi përkushtuese përmes të cilave, ai ngrit artin e poetëve botëror, si *Kanga e nates*, ku autori citon Gëten, H. Hajnin, në poezinë *Larg* (, pastaj Danten, Mickievicin, Katulin, Petefin, Lesingut e tjerë. Këto poezi dëshmojnë edhe korrespondimin e autorit me letërsinë e të tjerëve, si vlerë të dëshmuar, duke dashur edhe ta popullarizojë këtë letërsi. Këta të huaj janë të komunitetit të tij-krijues. Te V. Pasha, dashuria ka parametra universal, pa levizje ambivalente, por insistuese në realizimin e saj. Dashuria paraqitet si një raport, kryesisht një lidhje shpirti, një përshkrim i emocionit, pa pjesën e saj erotike. Poezia *Shej dashnie* (Zonjushës H.) ***Rose*** e ***spine*** **(1873**).

Pashko Vasa, ka edhe të tjerë -*tjerë,* njihen poezitë kushtime Tassos, Petrarkes, poezia *Asaj* -që mendohet se ju kushtua Katerina Bonapartit, gruas së dytë të tij. Ja, disa vargje:

Asaj!….. pse t jepte atë farë hjeshie
qielli, a nuk më thua? pse kuq prej dashurie
dukesh, kur flet me mua?[3]

Vaso Pasha e faktorizon *tjetrin* edhe në poemën e tij të njohur, *Mori Shqypni, e mjera Shqypni* (1880), ku shpreh një idhnim në shqiptarët e vet, duke mos lënë fare shpresë për të mire, sepse

Baheni robt e njerit t'huej,
Qi nuk ka gjuhën dhe gjakun tuej[3]

[2] H. Mosi, Vepra I*, Rilindja*, 1989, fq.125, 152, 137,
[3] V. Pashko, Vepra I, *Rilindja,* Pr. 1989, f. 71

ku ndjehet ipmpulsi i një instinkti mbrojtes, ndërsa, Cajupi dhe Noli, ngjashëm si Vaso Pasha, duke parë integritetin kombetar të dekompozuar, krijojnë poezi satirike për *tjetrin,* që lidhen me aktualitetin, duke karikuar përmes figurës së Sulltanit, në mënyrë shumë poetike e intelektuale, përmes vargjeve estetike e sarkastike, që asocionojnë në terror. Këto poezia me plot mesazhe gjuhësore, ku numeracioni i jep elemente të një deklamimi ideologjik, janë poezi realiste. Cajupi, Noli, Vaso Pasha e Naimi, janë krijuesit më të revoltuar dhe më të zemeruar, në-*tjetrin*, kur ai është shkaktar i fatkeqësisë së kombit. Shëmtueshmëria e formës pushtuese, uria grabitcare, reputacioni negativ e imazhe groteske të dhunës, paraqiten nga pozitat profetiste për lirinë. Te Noli, intonimi bëhet estetikë dominante, kurse te Cajupi elementi komik, por përqeshja këtu është një element social. Kështu, këtu, përmes *tjetrit* reflektohet edhe një politikë.

Një vashëzë t panjohur ikanake-është poezi e **Serembes,** poezi me motiv të dashurisë përkundër që njifet fakti se Zefi kishte Bardhën, arbëreshe të dashur. Por, edhe poezi me motiv social, si: *Një fshatarak tagrambledhsit të …cilitdo vis të Italisë*, fajtori është tjetri:

krejt bota m është bër djerrinë e madhe
s më dhuron qielli një buz'qeshje t'vetme
ndersa un' shpinën prore e mbaj t'përkulur[4]

Apo, poezia kushtuar një intelektuali Italian *Mikut tim të shquar* (prof. Francesk Maradeas, *Një zoti kalabrez*, poezi proteste sociale-fetare, (f.141) *Ideali im*, i kushtohet nje italiani që mendohej se ishte pasardhës i Kastriotit, një poezi prof. Enriko de Marinis, *Vincenc Selvaxhit,* poet kalabrez, *Ushtari i kthyer* e tjerë. Përkundër që Z. Serembe nuk ka shumë poezi, në to hasim shumë personazhe *të tjerë.*

Tjetri te **Mjeda**[5] **-** duket qysh ne *Vajin e bylbylit*, e ai eshte një mizor, pa emër dhe është i *nalti. Tjetri* tek Mjeda *del edhe në* motivin kundër trathtarëve - Mustafë Pasha, një alternativë kritike ndaj robërisë, që ishte intencë e gjithë krijuesve Rilindës. Mjeda *tjetrin* e ka edhe në poezinë *Te vorruemit e Sir John Moore, Vaji i dallendyshes që i kushtohet T. Grossi,* poezia *Mbreti i Tules, kushtuar Gëtes e tj.* Poezia *Gjuha shqype,* kushtuar Gustav Majerit në vazhdën e krijimeve rilindase për krijimin e kultit të gjuhës e tj. Fiksioni lirik realizohet bukur shumë në tipin e poezive përkushtuese, poezi me destinim ku në to, pos që falenderohen albanologë dhe pushtetas (Washingtoni, Presidentit te parë te Amerikes, në poemin *Lirija…* Dom Ndre Mjeda, 1910-1911), edhe himnizohen shumë emra të të *tjerëve.*

[4] Z. Serembe, Vepra II, *Rilindja*, 1989, f. 163, 159, 141
[5] N. Mjedja, Vepra I, *Rilindja*, 1982, f. 66

Të *tjerët* vazhduan të futen në lirikën shqipe edhe pas Rilindjes. Derisa Kadare në poezia *Vdekja e turistit*-ironizon nje ish nacist, në poezinë *Lora* ndodhë një kataklizmë shpirtërore e autorit. Në realitet, proceset e jashtme politike, rrënojnë brendinë - zemrën e autorit, ku fshihet Lora ruse.

Dashuria e vullnetshme e tij, bëhet armike, meqë shteti nga vinte ajo, përnjëherë bëhet armik i shtetit të autorit.

Në sistemin e tij ekzistencial bëhet rrënimi dhe përvoja intelektuale e bën autorin të ashpër në këtë padrejtësi. Kadare është unikal në ironizimin e absurdeve ideologjike- politike, të cilat prejnë fate të dashurish dhe marrëdhënie njerëzish. Përmes kësaj poezie Kadare intervenoi estetikisht në lirikën shqipe të dashurisë, duke i shtuar një faqe të rrallë, protestën për humbjen e saj shkaku i politikave. Kadare i këndoi hyjnisë së humbur dhe përjetimi i trishtimit të së kaluarës përmes kujtimit, bëhet filozofi e ekzistencës-lirisë. Dhembja nis e perfundon me intencën e ndërtimit të absurdit. Kadareja, krijues edhe i periudhës moniste, implikimit të shtetit e ideologjisë në botën e dashurisë, i ngre akuzë poetike, ndaj poezia është një reagim i rreptë për një dashuri të madhe, Lorën - ruse. Poezia ***Lora*** nuk përshfaq vetëm një emocion, ajo është një dramë e rëndë - pasojë e një lufte të ftohtë. Kadare si botë e pasur dhe si intelektual i madh, humbjen e Lorës e reflekton edhe si humbje të lirisë dhe emocioni energjik i tij, është një luftë poetike mahnitëse, luftë e cila i jep autorit një mission tepër human, mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Dashuria te ky autor është një subjekt më tepër psikologjik, i cili reflektohet në jetën e tij reale ndaj, brenda figurave ndjehet dinamika e një padëgjueshmërie, që tingëllon edhe si protestë e heshtur.

Tani shiu godet me shkelma zhamave
Me kujtohet, gazetat hapa në mëngjes
Si nje terbim, si nje shkulm ere,
Shkronjat vallzonin si ne ethe:
Prerje. Prerje. Prerje.

Asfalti i zi më varet nofullave të lodhura.
Kështu pra, Larisa, moskovitja.
Kështu pra, Llora[6]

Dashuri me një vashë të huaj, por përmes një ideologjie kombëtare,përmes një nacionalizmi të lehtë, ka edhe poezia *Turkesha*[7] e Agollit, ku mbisundon një ndjenjë e

[6] Ismail Kadare, *Poezia lirike pelegrin*, 14 prill, 209
[7] D. Agolli, *Lutjet e Kambanës*, *Toena,* Tr. 1998, f. 30

lehtë humori që e krijon vështrimi nga perspektiva historike e raporteve mes shteteve të të dashuruarve. Për të krijuar një atmosferë të kohës dhe të origjinës së vashës, autori përdorë një leksik me plot fjalë turke.

….turkeshë e dashur, kjo që ndodhi
Të kishte ndodhur atëherë,
Kur Krujën digjte Anadolli, c do kishim bërë moj e mjerë
S do mend që kokën Skenderbeu
Ma kishte prerë si karpuz: tani që flakë digjet atdheu
Ti puth turkeshën, more domuz?

Përgjithësisht, përmes etikës krahasuese, vërejmë se në letërsi, në marrëdhënien me *Tjetrin* kemi përbuzje, neveri, por edhe admirim e dashuri.Por, të shpeshtën *Tjetri,* në letërsinë tonë ta kujton lumin Kongo të Konradit në romanin *Zemra e errësirës.* Nuk kemi refuzim të *Tjetrit,* ai trajtohet subjektivisht, me imazhe që janë koncepte të autorëve por karakteri i *tjetrit* të shpeshtën del të jetë i përputhshëm me të vërtetën historike, dhe atë jetësore.

Literatura

A. Z. Cajupi, Vepra, *Rilindja*, 1983 (parathënia)
H. Mosi, Vepra I*, Rilindja*, 1989 (parathënia)
V. Pashko, Vepra I, *Rilindja,* Pr. 1989 (parathënia)
Z. Serembe, fq. II, *Rilindja,* (parathënia)
N. Mjeda*,* Vepra 1, *Rilindja,* 1982 (parathënia)
H. Bergson, *E qeshura*, fq. 84, Tr. 2015,
S. Hamitit, Vepra I, fq. 282, *Rilindja,* 1989 (parathënia)

Dije DEMIRI-FRANGU

OTHERS AND ALBANIAN FICTION

Abstract

Albanian literature is full of *others*; they function through physical and conceptual opposition. Characters as a hierarchy in addition to the structural role create contrast differences, and often the conflict through the other. Our literature has recently begun the conflict with *ours*, and in the cases of fighting the harmful habits of

ideologies (the real socialism) where the other one comes with the purpose of ruining yours and build his own. In this case, fiction through the use of *the other* becomes a tool, even a catalyst for changes and above all, for building of fictional intrigue.

The other or *the stranger* - is the hierarchy that creates the ultra-human in the social context, it creates the caste that builds and maintains certain relationships, certain national and social statuses.

There are many of these *others* in literature, and they are different. But a considerable number of Renaissance poems, mainly in the type of devotional poetry, many authors devote poetry to the friends of the Albanian people. *Others* in Albanian literature mostly are enemies and less - mostly in some lyrical are friends, but in addition, in this case the other is the other, and they are the writer's lover.

Albulena BLAKAJ-GASHI

SHQIPTARËT PËRBALLË MBRETIT TË TYRE GJERMAN

(Romani *Viti i mbrapshtë* i Ismail Kadaresë)

Në romanin tragjikomik *Viti i mbrapshtë*, Ismail Kadare përmbledh trazirat e historisë shqiptare në luftën për pavarësi kombëtare dhe 184 ditët e mbretërimit të Wilhelm zu Wied-it si Princ i Shqipërisë, në një vit të vetëm, të mbrapshtë - 1914. Në këtë roman I. Kadare i ndërthur realitetin dhe imagjinatën dhe, me një humor të zymtë, tregon se si përfundon themelimi i shtetit në një katastrofë. Kam zgjedhur pikërisht këtë roman për të parë se si e shohin shqiptarët *tjetrin*, *të huajin*, edhe atëherë kur ai është mbreti i tyre dhe vjen për të mirë. Në asnjë vepër tjetër të Kadaresë nuk është e lidhur kaq ngushtë tragjikja me groteskun dhe nuk kapërcehet më shpejt nga njëra te tjetra, duke kaluar nga personazhe homerike në luftëtarë donkishoteskë.

Në Shqipërinë e vitit 1914, as edhe dy vjet pas shpalljes së Pavarësisë, si rezultat i interesave divergjente të Fuqive të Mëdha, mbizotëron sërish kaosi e dhuna. Edhe Fuqitë e Mëdha, ashtu si fqinjët, hedhin shikime lakmiqare drejt shtetit të ri. Konferenca e Ambasadorëve në Londër, e gjashtë Fuqive të Mëdha të atëhershme, njohu autonominë e Shqipërisë qysh në dhjetor 1912 dhe në fund të luftës së parë Ballkanike u shpreh për një "*principatë autonome, sovrane dhe bazuar në të drejtën trashëgimisë së të parëlindurit dhe nën garancinë e gjashtë fuqive*"[1]. Vetë shqiptarët kërkonin një demarkacion përgjatë vijave etnike, ndërsa shtetet e Ballkanit dëshironin të merrnin pjesë sa më të mëdha si pre të luftës, pra të linin mundësisht një Shqipëri sa më të vogël. Si kompromis, gjashtë Fuqitë e Mëdha ranë dakord për krijimin e një Shqipërie me kufijtë që ka edhe sot, dmth pavarësisht parimit etnik. Kështu, *"Rreth gjysma e shqiptarëve mbeti të jetonte "jashtë shtetit", para së gjithash në Kosovë dhe në jug të Serbisë (sot Maqedoni), si dhe në Mal të Zi dhe Greqi"*.[2]

"*The borders of the new kingdom did not satisfy the Albanians who saw themselves cut in half and without the greatest part of their bigger cities ... The purely Albanian cities with established markets covering their areas such as Gjakova, Prizren, Dibra and Struga were handed over to Serbia and Montenegro. The inhabitants of Northern and Eastern Albania were cut off from their markets and their civilization ...*"[3][4]

[1] Schmid, Thomas: *Der veratene Prinz*, Berliner Zeitung - 28.06.1997

[2] Po aty.

[3] Duncan Heaton-Armstrong: *The six month kingdom. Albania 1914*, Verlag Tauris, London 2005

Shteti i ri shqiptar, pas pavarësisë, duhej të qëndronte dhjetë vjet nën mbikëqyrjen e një komisioni ndërkombëtar të kontrollit, i cili sigurisht që ishte vendosur nga Fuqitë e Mëdha.

Për fronin shqiptar aplikuan shumë kandidatë. Në mesin e kandidatëve të shumtë "u shfaq një kandidat i ri, Prinz Wilhelm Friedrich zu Wied (Princi Vilhelm Fridrih i Vidit) , i cili ishte 38 vjeç dhe protestant", shkroi Berliner Tageblatt në 05/18/1913. I njëjti njoftim u përhap pothuajse në të gjitha gazetat në Evropë në ditët në vijim. Mbi të gjitha, dy fuqitë e mëdha që luftonin për më shumë ndikim në Shqipëri, pra Austro-Hungaria dhe Italia, në fund ranë dakord që, meqë popullsia në Shqipëri i përkiste tri besimeve fetare, asaj myslimane, katolike dhe ortodokse, një princ i cili nuk i takonte asnjërës nga religjionet në Shqipëri, mund të pranohej si neutral. Kështu Princi i Vidit hyri në listën e ngushtë të kandidatëve dhe, sipas shtypit të atëhershëm austriak e europian, përkeqësoi shanset e kandidatëve të tjerë, sepse ai ishte protestant dhe sepse "*qeveria italiane, franceze dhe ruse duan një princ i cili nuk i përket asnjërës nga tre besimet fetare të Shqipërisë*"[5].

Dhe kështu një princ gjerman, Vilhelm I. i Vidit u emërua si Mbret i Shqipërisë. Vilhelm, u lind si i biri i tretë i Princ Wilhelm zu Wied (Vilhelm i Vidit) dhe gruas së tij Marie von Nassau (Maria e Nasau), Princeshë e Holandës, në një prej familjeve më të vjetra fisnike të Gjermanisë, në oborrin e Widit. Kur u propozua nga tezja e tij Elizabetha, mbretëreshë e Rumanisë, për postin e Princit të Shqipërisë, princi ishte kapiten në ushtrinë prusiane. Mbreti i parë i Shqipërisë, Gjergj Kastrioti -Skënderbeu ka mbetur i pakurorëzuar. Mbreti i parë i kurorëzuar dhe i njohur e pranuar si Mbret i Shqipërisë është Princi gjerman Wilhelm Friedrich zu Wied, i cili deri në vdekje, e edhe sot e kësaj dite është i njohur si Vilhelmi I, Mbret i Shqipërisë, Princi i Vidit (Wilhelm I, Koenig von Albanien, Prinz zu Wied.) Pra, mbreti i parë i shtetit shqiptar ishte një gjerman.

Caktimi i ndonjë të huaji për shtetet e sapoçliruara, nuk ishte praktikë e panjohur në shekullin e 19-të. Kështu ndodhi edhe gjetiu në Ballkan, si në Greqi, Rumani e Bullgari. Përkundër faktit që te romani "Viti i mbrapshtë", shkruar në vitin 1985, sipas Eric Fayes, "historiani rrezik se e humbet toruan", Ismail Kadare u qëndron besnik fakteve historike më shumë sesa në librat e tij të tjerë. Kadare bën një sintezë të ngjarjeve reale dhe imagjinare. Edhe pse disa duken si akte të zmadhuara dhe qesharake, shumë nga to janë shumë të afërta me faktet. Çfarë në të vërtetë ka ndodhur në rrjedhën e disa viteve, vjen e tkurrur në disa muaj dhe përveç

[4] "*Me kufijtë e shtetit të ri nuk ishin të kënaqur shqiptarët të cilët e panë si ndarje të tyre në dysh dhe pa pjesën më të madhe të qyteteve të tyre më të mëdha… Qytetet me popullsi të pastër shqiptare me tregje të konsoliduara që mbulonin rrethinat e tyre si: Gjakova, Prizreni, Dibra e Struga i ishin dhënë Serbisë e Malit të Zi. Banorët vendës të Shqipërisë së veriut e të lindjes u ndanë nga tregjet e tyre dhe nga civilizimi…"* (Përkthimi: A. Blakaj)

[5] Neue Freie Presse, Wien, 22.10. 1913, Abdbl.

protagonistëve të shumtë historikë, takojmë edhe personazhe të shumta të cilat më kot do t'i kërkonim në librat e historisë. Megjithatë, "sa i përket ndërveprimit midis forcave të ndryshme politike dhe sociale dhe atmosferës së periudhës, romani jep një pasqyrë shumë të saktë të Shqipërisë së atëhershme," shkruan Joachim Röhm[6].

Shkrimtarët me këmbëngulje na e sjellin në mend se e kaluara nuk është kapërcyer, historia kthehet si një dhimbje fantazmë dhe troket në kujtesën tonë. Këtë vepër e bën të mrekullueshme, jo vetëm fakti se është një tekst Kafka-esk, por edhe se *në një formë ai parashikon trazirat që do të çojnë drejt një lufte çfarë u pa në Jugosllavi.*[7]

Krijimi i shtetit shqiptar nuk u bë nën një yll me fat apo, në rastin e Kadaresë, nën një kometë me fat, me të cilën edhe e hap romanin e tij. Kjo kometë, në romanin e Kadaresë, që vazhdon rrugën e saj pavarësisht proceseve në roman, simbolizon indiferencën që ka natyra në raport me njerëzit dhe historinë. Kjo bëhet e qartë që në faqet e para të romanit, ku kometa *Delavan* shfaqet si një simbol i fatkeqësisë:

> *"me kalimin e javëve (ngjarjet ende s'kishin filluar), ky synim i përgjithshëm për të parë te kometa një shenjë u shpjegua prej shumëkujt me arsyetimin e thjeshtë se të gjithë popujt kishin për të bërë pyetje për fatin e tyre. Përsa i përkiste zbehjes shumë shpejt të shpresës për t'ia lënë vendin ankthit, u shpjegua me atë që çdo komb e zbërtheu shenjën pas gjendjes së vet, dhe meqenëse te secili kishte të çara, gropa e katastrofa, ishte e kuptueshme që të kometa ata do të shihnin veç të tilla. Shkurt, kometa, ashtu ogurzezë siç u duk, i shkonte lëmshit tokësor."*

dhe:

> *"Ja kështu ishin gjërat në atë vit, të cilin jo vetëm ndjellazinjtë, por edhe ata që gjithkah nuk shihnin veç diell e mjaltë u bindën më në fund për ta quajtur "të mbrapshtë."*[8]

Në këtë roman të Kadaresë gjejmë copëza të kohës së para- dhe të Luftës së Parë Botërore. Heronjtë e romanit, të cilët nuk janë më shumë se një grusht fshatarësh, nisen për t'i dëbuar pushtuesit, por ata mbesin duke u sjellë si pa cak mes fronteve të ndryshueshme. Një rol të rëndësishëm luan këtu ky grup i guerilasve, entuziazmi patriotik i të cilëve, për sa u përket aksioneve militare, shkon krejtësisht huq.

Romani *Viti i mbrapshtë* i Ismail Kadaresë është vepër që paraqet në mënyrë shembullore raportin e shqiptarëve me *tjetrin*. Dhe, *të tjerë* ka shumë. Ngjarja, siç u

---

[6] Röhm, Joachim: *Kurze Nachbemerkung, Historische Einordnung, Glossar und Aussprachregeln*, in: Kadare, Ismail: Das verflixte Jahr, Fischer Tachenbuch Verlag, Frankfurt am Main, 2007, S. 176

[7] Ulrike Sárkány, Norddeutscher Rundfunk, 4. September 2005

[8] Kadare, Ismail: *Viti imbrapshtë*, Onufri, Tiranë, 2003, fq. 10.

përmend më sipër, vendoset në kohën e sundimit të Prinz Wied-it si mbret i Shqipërisë, që zgjati vetëm 184 ditë, në një Shqipëri të vogël ku marshojnë trupa osmane, austriake, greke, frenge, italiane e holandeze. Kadare, përmes hutisë së grupit të fshatarëve të nisur me vendimin për të larguar pushtuesit, na e jep rrëmujën që kishte kapluar Shqipërinë e kohës:

> "*E kuptonte që ushtria serbe të ishte kundër ushtrisë kombëtare shqiptare të Princ Vidit, ose hollandezkës, po nuk ia nxinte mendja se përse serbët, duke qenë armiq me turqit, ishin aleatë me esadistët, që s'donin veç rikthimin e Turqisë në Shqipëri. Ashtu siç nuk e kuptonte dot qëndrimin e francezëve, që duke qenë një ndër Fuqitë e Mëdha, nuk përkrahnin princin e vendosur prej tyre bashkërisht, siç bënin austriakët, por ndihnin armiqtë e tij*."[9]

Princi Vilhelm i Vidit, nga perspektiva e sotme, shihet si dikush që do të kishte ndërruar rrugën e Shqipërisë duke e drejtuar kah Perëndimi.

Për fat të keq, në vend kishte një përplasje mes njerëzve që shihnin kah Perëndimi dhe të atyre që zvarriteshin drejt Lindjes dhe nuk donin të shkëputeshin prej saj. Këta të dytët Kadare i ironizon nëpërmjet thirrjes *Dum Babën*, një thirrje e turkofilëve shqiptarë: Duam Babën, duam babën Sulltan, duam Turqinë!

Ismail Kadare përmes figurës së Princ Ëiedit dhe të huajve të tjerë në atë Shqipëri, trajton temën e *tjetrit* brenda kornizës historike shqiptare, trajton pra, edhe sjelljet e shqiptarëve karshi të huajve dhe fokusohet në përplasjen e identiteteve të ndryshme (individuale, klanore, fetare, kombëtare), duke krijuar një rrëmujë edhe brenda vetë rrëfimit, që tematikisht dominohet nga hija e *tjetrit*.

Të pasigurtë se çfarë të bënin e kundër kujt të pozicionoheshin, vendosin të mos ngrenë dorë kundër ushtrisë kombëtare, por as të mos bashkohen me ta, sepse "*zemra për "hollandezkën" e ftohtë, e ftohtë do t'u mbetej*." Gjithsesi, do ta luftonin gjithkend që ishte kundër Shqipërisë dhe *Esadistët, armiqtë e saj, do t'i luftonin gjer në fund.*

> "*Me atë rast Shestani, që kishte qëndruar gjithë natën pa gjumë, u tha atyre ca gjëra nga ato që kishte lexuar në gazetë. Ai dhe të tjerët pas tij bënë pyetjen: në këtë katrahurë me kë do të bashkoheshindhe kundër kujt do të ishin? Ranë pak a shumë në një mendje se tani për tani e kishin të vështirë ta vendosnin. Zemra do t'ua donte që të bashkoheshin me ushtrinë kombëtare, e mbase kështu do të bënin sikur të mos ishte ajo puna e oficerëve hollandezë... Mbase për këtë arsye kryeministri shqiptar kishte dhënë dorëheqjen. Këtë do ta bënin pak a shumë edhe ata: dorë kundër ushtrisë kombëtare s'do të ngrinin, kurrën e kurrës, por as me të s'do të bëheshin."* [10]

[9] Kadare, Ismail: *Viti imbrapshtë*, Onufri, Tiranë, 2003, f. 33.
[10] Kadare, Ismail: *Viti imbrapshtë*, Onufri, Tiranë, 2003, fq. 38.

Pra, Princ Vidi, bashkë me ushtrinë kombëtare, paraqitet si dikush që është në anën e Shqipërisë, por i huaji është i huaj dhe ai do të mbetej i tillë. Mbreti gjerman, për shkak se është i tjetër kombësie dhe feje, nuk është i mirëseardhur për të gjithë shqiptarët: *Dhe pastaj ai princi i huaj! Ku qe parë që princi i Shqipërisë të ishte një gjerman?*

Disa prej të pakënaqurve kërkojnë nga ai që të bëhet si ata, së paku nga ana fetare. Për të qenë më e lehtë të pranohej si mbret edhe për popullatën myslimane dhe të përkrahej nga ushtria esadiste, Princit Vid i kërkohet të bëhet synet. Pra, ata kërkojnë që *tjetri* të mos jetë *ndryshe*, kërkojnë që tjetri të jetë si ata. Atij i kërkohet si domosdoshmëri synetia për hir të pranimit më të lehtë politik, gjë që e tronditë gruan e tij të re.

Për të shfaqur më mirë raportin e shqiptarëve me tjetrin, të huajin, Kadare në një kapitull të tërë na e paraqet si narrator edhe mbretëreshën Sofie von Schöneburg Waldenburg. Një zonjë e rëndë, ëndërrimtare, e që nuk ia ka haberin, tek e fundit aq sa edhe Fuqitë e Mëdha, dhe ishte krejtësisht e papërgatitur, për atë që do të gjente në mbretërinë e saj të re. Pas letrës me kërkesën që e merr Princi, që sipas mareshallit von Trota *nuk është tragjike,* sepse *Beschneidung*: "*s'është veçse një kumt mirëkuptimi, padyshim një mirëkuptim të çmendurish, por sidoqoftë kumt*"[11], mbretëresha duke ndenjur me orë të tëra në vaskë, mundohet që me parfum e me larje ta heqë neverinë që ndjen për këtë sakrificë që do ta bënte të shoqin më *të afërt politikisht.* Më të afërt për një vend *të rreptë e të pakuptueshëm* ku mbretëresha e ndjente *veten si të flakur nga fati i keq, [12]* në një vend për të cilin fillimisht ishte plot shpresa, meqë "*do të çelet, mendoja, tani që pas ankthit aziatik rigjeti nënën e vet evropiane...*" Por, Shqipëria, shkruan autori, ishte "një lëmsh":

"Rrëmujë e shkuar rrëmujës, o Perëndi! Pa lindur mirë, shteti shqiptar ishte bërë lëmsh,"

apo*:*

"... shteti shqiptar ishte kthyer në njëfarë mishmashi që s'ishte parë kurrë në fytyrë të dheut".

Në "Vitin e mbrapshtë" të atij "kurorëzimi" të çuditshëm dhe të intervalit të mëvonshëm mes mbretërimeve, mbizotëronte gjendje kaotike: kryengritje fshatare, ndërhyrje ushtarake nga fuqitë e huaja, përkrahës fanatik të kryengritjeve popullore dhe vetëgjyqësisë, mercenarë e shpëtimtarë të vetëshpallur të atdheut, përzihen për të formuar një tablo të një beteje të anarkisë dhe të vakumit grotesk të pushtetit.

Në këtë roman Kadare kombinon faktet dhe fiksionin. Fantastikes ai i vë përballë një nivel të analizës historike. Ajo çfarë e bën romanin veçanërisht atraktiv, janë elementet e tragjedisë dhe të groteskut, mitit dhe ironisë, të cilat e bëjnë edhe më prekës homazhin për atdheun. "*Arkaikja e panjohur dhe përzierja e mirënjohur e cinizmit me injorancën në politikën e Fuqive të Mëdha dalin haptazi në shesh, dhe kështu romani nuk është*

[11] Kadare, Ismail: *Viti imbrapshtë*, Onufri, Tiranë, 2003, f. 69.
[12] Po aty, f. 70.

vetëm një imazh artistik i një epoke të çuditshme të tranzicionit në një vend të vogël në periferi të Evropës, por është një interpretim i fuqishëm i Europës së shekullit XX dhe paaftësisë, inkompetencës së saj në Ballkan. Edhe më shumë se nacionalizmi shqiptar, parodizohet perceptimi i të huajve për rajonin."[13]

Jo rrallë në romanet e tij, e veçanërisht në këtë, Ismail Kadare rrëfen gjithçka me ironi. Ironikisht merr në shënjestër jo vetëm luftëtarët e ngathët, të cilët janë vetë viktima të historisë, por edhe Fuqitë e Mëdha që prodhojnë më shumë mite sesa që mund të kontribuojnë në qartësimin e tyre. Kadare, paaftësinë e Fuqive të Mëdha për t'u marrë me Shqipërinë e Ballkanin, e shfaq edhe kur flet për *hulumtuesit e shumtë, gjithëfarë bashkëpunëtorësh të institucioneve të ndryshme, me gjithëfarë gradash e nëngradash shkencore* që u morën më vonë me ngjarjet e atij viti *të paharruar*, duke e shprehur kështu edhe më fort bindjen se Fuqitë e Mëdha, as që ia kishin haberin se çfarë po ndodhte e çfarë duhej të bënin në Shqipëri. Si pasojë e mosnjohjes së historisë, të gjitha 'hulumtimet' janë spekulime, *përsiatje e fluturime poetike nga më të pabesueshmet.*

Ky është një roman në të cilin mbizotëron koha e ëndërrave, lajmërohet dramatikja, rriten shpresat, por mbi të gjitha frika bëhet e zëshme. Gjërat marrin një rrugë të çuditshme, dhe as lufta nuk i ndjek ligjet e veta. Si të mpira enden personazhet nëpër një peizazh ku askush nuk e di se ku janë kufijtë e shtetit. Kështu, *Viti i mbrapshtë* bëhet një roman i një interpretimi metaforik të një realiteti kaotik, që ishte në fakt edhe realitet historik. Si për shkak të historisë, ashtu edhe për arsye të teknikave narrative, romani të jep përshtypjen e një historie fragmentare, bazuar në teknikën e montazhit. Në mënyrë të pashmangshme dominon ajo që Derrida e quan *discours bricoleur*.

Romani *Viti i mbrapshtë* hyn në kategorinë e veprave kadareane që trajtojnë temën e tjetrit, si *Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Muzgu i perëndive të stepës, Dosja H*, *Qorrfermani, Darka e gabuar* etj., por ka një element esencial që e diferencon prej tyre: tendencën për ta bërë tjetrin si veten, tendencë që artikulohet nëpërmjet kërkesës ndaj mbretit për t'u bërë synet.

Kështu, ky roman i stërmbushur me referenca historike e politike, është një komedi dhe tragjedi në të njëjtën kohë: komedi, sepse shqiptarët sillen si rosat në mjegull, duke qenë individualistë pa një ide të qartë mbi bërjen dhe funksionimin e shtetit, dhe tragjedi, sepse përhumbja dhe mosbashkimi i tyre rreth një ideali kombëtar do të ketë pasoja të shumta në fatin e kombit. Kështu, një shtet duhej të lindte, por, për shumë arsye, ecte buzë greminës. Dekada më vonë një poet i kalibrit të Kadaresë arrin që këtë pjesë të historisë botërore ta sjellë si një farsë të konfuzionit kombëtar dhe një blamazhe ndërkombëtare, në të cilën ndërlidhen pra aq mjeshtërisht faktet dhe fiksioni, tragjedia e komedia. Aty dështojnë të gjithë – të çmendurit e largpamësit, të çuditshmit e të mençurit, ëndërrimtarët e veprimtarët- për shkak të të njejtës marrëzi;

[13] Vgl. http://oe1.orf.at/artikel/205347

se duan të bëjnë shtet sipas idesë e dëshirës së vet. Tallja, absurditeti e patriotizmi i dhimbshëm lidhin te Kadare ironinë me humorin e zymtë e thumbues.

Për këtë roman, vetë Kadare, në një intervistë për Deutschlandfunk, bërë me rastin e 70-vjetorit të lindjes, u shpreh:

> *"Kjo është një histori disi groteske. Çlirimi i vendit te ne gjithmonë ishte përlëvduar me shumë eufori dhe patetizëm. Unë doja në romanin tim të krijoj një imazh tjetër, më pak heroik, që është më afër realitetit dhe që është letrarisht më sfidues. Prandaj unë përshkruaj kaosin që mbizotëronte në atë kohë, një situatë pothuajse fantazmagorike, në të cilën as komitët e rinj e as pushtuesit e huaj me gjithë shërbimet e tyre sekrete e raportuesit, nuk e kuptojnë çfarë po ndodh. Si në një kaleidoskop i le të përplasen fraksionet e ndryshme, të ngatërrohen në luftëra të papritura, të vrasin njëri-tjetrin. Thënë shkurt, më interesonte kjo rrëmujë e ngatërruar, tragjikomikja e situatës."*[14]

Si në të gjitha romanet e tij, Ismail Kadare edhe këtu ndjek idenë e Ernest Hemniguejt mbi parimin e ajsbergut: në sipërfaqe rrëfimi është i lehtë e komik, kurse nën sipërfaqe është i thellë dhe tragjik.

Literatura

Kadare, Ismail: *Viti imbrapshtë*, Onufri, Tiranë, 2003

D-Heaton Armstrong: *Princ Vidi- Shqipëria, gjashtë muaj mbretëri*, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë, 2010, S. 179.

Die albanesische Presse für die Kandidatur des Prinzen Wilhelm zu Wied, Neue Freie Presse, Wien, 22.10. 1913, Abdbl.

Duncan Heaton-Armstrong: *The six month kingdom. Albania 1914*, Verlag Tauris, London 2005

Kadare, Ismail:*Das verflixte Jahr,* Fischer Tachenbuch Verlag, Frankfurt am Main, 2007

Prinz und Prinzessin Wilhelm zu Wied, Neue Freie Presse, Wien, 14.09.1913, Morgbl.

Röhm, Joachim: „*Kurze Nachbemerkung, historische Einordnung, Glossar und Ansprachregeln*", in: Kadare, Ismail: Das verflixte Jahr, Fischer Taschenbuch Verlag, Frankfurt am Main, 2007

Schmid, Thomas: *Der veratene Prinz*, Berliner Zeitung - 28.06.1997

Wie ein Preuße Fürst von Albanien wurde, Preußische Allgemiene Zeitung, (25.02.14)

Hüfner, Agnes: *Zum 70. Geburtstag des albanischen Autors Ismail Kadaré*, Deutschlandfunk, (25.01.2006)

[14] Hüfner, Agnes: *Zum 70. Geburtstag des albanischen Autors Ismail Kadaré*, Deutschlandfunk, 25.01.2006

Pressestimmen I, II[15]

Altonaer Nachrichten (6.11.1913 - 01.1914)
Berliner Allgemeine Zeitung (30.10.1913 - 01.1914)
Berliner Illustrirte Zeitung (9.11.1913 - 01.1914)
Berliner Morgenzeitung (5.11.1913 - 01.1914)
Berliner Tageblatt, (18.05. 1913- 01. 1914)
Berner Tageblatt (19. 05.1913 - 01.1914)
Germania, Berlin (4.11.1913- 01.1913)
Illustrierte Zeitung Leipzig (13.11.1913 - 01.1914)
Koelnische Zeitung (4.11.1913 - 01.1914)
La Semaine Litteraire, Geneve (24.05.1913 - 01.1914)
Leipziger Neueste Nachrichten (19.05.1913 - 01.1914)
Magdeburgische Zeitung (19.05.1913 - 01.1914)
National Zeitung, Berlin (03.06.1913 - 01.1914)
Neue Freie Presse, Wien (14.09.1913 - 01.1914)
Neue Zuericher Zeitung (22.11.1913 - 01.1914)
Neues Wiener Tageblatt (4.11.1913 - 01.1914)
Vossische Zeitung, Berlin (06.10.1913 - 01.1914)

Albulena BLAKAJ-GASHI

ALBANIANS VIS-À-VIS THEIR GERMAN KING (ISMAIL KADARE'S NOVEL "*THE DARK YEAR*")

Abstract

Ismail Kadare's novel "The Dark Year" is a work that exemplifies the Albanian relationship with *the other*. The event is set in Albania, when the German Prinz Wilhelm zu Wied was named King of Albania. The new King, being of another nationality and religion, is not welcome to all Albanians, some of whom ask him to

[15] Për këtë punim janë shfrytëzuar edhe një pjesë e lidhur e **Pressestimmen** (Zërave të shtypit), të cilat me gjasë janë mbledhur dhe janë përgatitur nga një zyrtar i oborrit, me urdhër të Princit Otto Viktor II. von Schönburg-Waldenburg, vëllait të madh të Sofisë së Shqipërisë. Kandidatura e Princit Vilhelm i Vidit ishte temë kryesore e gazetave evropiane me shkrime e fotografi, nga pranvera e vitit 1913 deri në verë të vitit 1914. *Pressestimmen* e ruajtura përmbajnë vetëm një pjesë të tyre.

become like them, at least religiously. So they demand from *the other* not to be different, they demand *the other* to be like them.

Ismail Kadare, addressing the subject of *the other* within the Albanian historical framework, has dealt with the behavior of Albanians towards foreigners and has focused on the clash of different identities (individual, clan, religious, national) to create a clutter within the confession, thematically dominated from the shadow of *the other*.

Halil MATOSHI

KONCEPTI I TJETRIT NË LETËRSINË SHQIPE: ÇFARË E KEMI TJETRIN?

Një studim krahasimtar

Abstrakt

Në këtë punim spikatet imazhi i tjetrit në letërsinë shqipe - tjetri qe vjen e rri/miku - (sipas traditës kanunore, sh'pia asht e Zotit dhe mikut) – apo i huaji që vjen si shkelës (armiku.), pra do të hedhet më shumë dritë mbidiskurset letrare për mikun/armikun.

Duke u nisur nga imazhi i tjetrit në letërsinë e përbotshme do të fokusohemi tek romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" të Ismail Kadaresë që manifeston diskursin letrar të tjetrit si armik dhe tek romani i Ben Blushit "Të jetosh në ishull", që spikat një filozofi ishullore apo topikën e tjetrit që banon në "ne".

Pra ky i dyti i shmanget diskursit pët Tjtrin si armik, duke e parë thjesht si njërin nga "ne."

Njeriu lodhet ta kuptojë cilësinë retorike të pyetjes, vërtet cili është ermiku im?

A thua fabrikimi i armikut kujdestar qe rëndom e shohim tek tjetri/tjetra (e kaluemja si ankth e frikë ose e reja si ide, e panjohura) është derivat i frikës dhe paranojës se jemi te rrethuar nga armiqtë, se po na ndjek dikush, apo thjeshtë është monopolizim i gjuhës nga ana e pushtetit, për ta siguruar lojalitetin e qytetarëve ndaj tij (pushtetit pra) ai flet vazhdimisht për një armik fiktiv (kombëtar, shtetëror, ideologjik, fetar, klasor, partiak...) por të konkretizuar sipas cilësorit tjetri/të tjerët.

Studjuesi shqiptar Shaban Sinani në temën e perceptimit të tjetrit thotë se "kultura tradicionale vendëse tregon se koncepti shqiptar për "tjetrin" nuk është armiqësor, siç ndodh rëndom ndër popujt e zonave të nxehta, siç është edhe Ballkani.

"Tjetri" në këtë kulturë nuk është detyrimisht "kundërshtari".

Mirëpo, dikursi letrar për tjetrin, në letërsinë shqipe, që nga Naim Frashëri dhe tek Gjergj Fishta dhe deri tek Ismail Kadare (në prozë) dhe tek disa autorë mediokër të poezisë, merr karakteristikat e diskursit të urrejtjes, përkatëisht diskursit racist.

Fjalët kyçe: Liria, identiteti, tjetri, diskursi letrar, armiku

1. Arketipi i kthimit Odisean

Te romani ***"Mosdija",*** Milan Kundera flet për kthimin e madh arketipor – pra ai shpalos mitin e kthimit në Itakën e tij, të shfaqur si noistalgji emigrantësh që manifestsohet me mosdije dhe humbje.

"Kthimit, në greqisht i thonë nostos. Algos do të thotë "vuajtje". Nostalgjia, pra, është vuajtja që shkaktohet nga dëshira e paplotësuar për t'u kthyer."[1]

Kundera në romanin e tij "Mosdija" sjell jetën e Odiseut modern "qe strehohet" tek emigrantët të cilët komunizmi i ndau nga familjet, të dashurit e tyre, nga gjithçka që ata kishin ndërtuar, për të emigruar në një vend të huaj.

Duke i lidhur personazhet me Odisenë, autori na rikujton se çdonjëri prej nesh është një Odise që frymon në të kaluaren tone duke qenë pengje të dilemes "të kthehesh apo jo në atdhe"?

Emigrantët tërë kohën e kalojnë duke e menduar kthimin e tyre ne vendlindje, e presin gjatë kthimin e madh.

Irena pas kthimit e kupton se vitet e humbura nuk kthehen, mbeten veç në ëndrra që kthehen në mall. Jozefi kupton se vendi i tij ishte "diku tjetër" pra ai ne kujtime.

"Për njëzet vjet ai kishte menduar për kthimin, por kur u kthye e kuptoi i habitur se jeta e tij, vetë thelbi i jetës së tij ishte jashtë Itakës, në ato njëzet vite endacake. Dhe atë thesar që e kishte humbur ta rigjente vetëm duke rrëfyer."[2]

Perzonazhet e romanit Irena dhe Jozefi nuk arrijnë ta kapin fillin e tyre të dashurisë e cila kishte mbaruar ende pa nisur, Jozefi është ai që në kujtesën e tij nuk e ka ruajtur Irenën.

Kundera në romanin "Mosdija" na bënë të kuptojmë se jeta e njeriut nuk duhet të kufizohet mas identitesh të ngurta e vrastare, e cilën gjuhën gjuhë flasim, njerëzit duhen të vlerohen për atë që janë.

Te gjithë ne jemi emigrantë dhe kemi humbur nga një dashuri…

Pra jemi te njëjtë.

Studjuesi shqiptar Shaban Sinani në temën e perceptimit të tjetrit thotë se "kultura tradicionale vendëse tregon se koncepti shqiptar për "tjetrin" nuk është armiqësor[3], siç ndodh rëndom ndër popujt e zonave të nxehta, siç është edhe Ballkani.

"Tjetri" në këtë kulturë nuk është detyrimisht "kundërshtari".

Mirëpo, dikursi letrar për tjetrin, në letërsinë shqipe, që nga Naim Frashëri[4] dhe tek Gjergj Fishta[5] dhe deri tek Ismail Kadare (në prozë) dhe tek disa autorë mediokër

[1] Kundera, Milan: Mosdija; Fq, 7
[2] Kundera, Miolam; Po aty. Fq. 31
[3] Shih Sinani, Shaban:
http://www.albasoul.com/modules.php?op=modload&name=News&file=article&sid=116
[4] Shih: Latifi, Blerim; MM; Nr. 1, 2009; Fq. 140-157

të poezisë[6], merr karakteristikat e diskursit të urrejtjes, përkatëisht diskursit racist, që Robert Miles be quan "racizëm etnocentrik."[7]

Në raportet e letërsisë shqipe me letërisinë botërore, padyshim se në gjykimin e tjetrit, përkatëisht në paragjykimin e tjetrit, merr pjesë autori Ismail Kadare me disa nga romanet e tij, si "Dimri i madh", "Koncert në fund të dimrit" etj, porse me këtë hov do t'i qasemi vetëm "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur" – shkrim ky letrar që e bëri të njohur autorin - porse duke paragjykuar tjtrin si një tabor që ka mësymje armiqësore kundrejt shqiptarëve.

Në anën tjetër, autorë më në zë apo jo, mngrënë edhe teorira konspiracioni duke i rënë telit se Kadare me romanin "Gjenerali…' jo që ra ndesh me vijën e partisë, porse ai e shpiente edhe më tej neverinë e shqipatrëve ndaj Perëndimit duke vënë në mendësinë perëndimore të dëshirueshmen e regjimit, pra në sensin që Perëndimi të shfaqej sa më antishqiptar[8] për ta kthyer këtë mendësi në zemëratë, në nxitje të një nacionalizmi me prirje të majtë që në thelb ishte izolacionaizëm.

Në këtë vazhdë, Ymer Çiraku, si për të mmbështetur tezën se Kadare përket në racizëm etnocentrik, mendon se vështrimi dhe gjykimi i Tjetrit është zakon i lashtë i njeriut dhe doemos edhe i atij shqiptar. Ne antropologgjinë kulturore e posaçërisht në rrafshin e letërsisë, kjo përthyhet në raportet e letërsisë shqipe me proceset letrare botërore, si dukuri kontakti apo kundërshtie refuzimi e blasfemimi sipas rastit.

"Sindromi i ksenofobisë shpiente në mosqarkullimin e vlerave prej së jashtmi, gjë që sillte efekt shterues e atrofizim conceptual në rrafshin letrar. Psh. Eposi i Kreshnikëve është i populluar natyrshëm krahas malësorëve shqiptarë dhe me figura të vendeve të afërta e të largëta, hungarez, frengj, spanjollë, turq, saracenë, afrikanë, grekë, ebrej… që të jep përshtypjen e një bote kozmike apo të një lloj 'Schengeni kulturor', pot ë flasim me terma të sotshëm. Ata mund të kenë arsye të ndryshme për mosmarrëveshje e ndarje mes tyre por asnjëherë të natyrës etnike, fetare apo të rangut shoqëror. Pra në ngjarjet legjendare të këtij eposi nuk ndihet refuzim a priori për Tjetrin, për të huajin, por sipas rastit ndërtohen aleanca e miqësi, dashuri e krushqi, por edhe luftra e konflikte pronësie…"[9]

Sipas studjuesit Anton Berishajt në diskurset e tilla, bazohen 'identitetet predatore', sipas të cilave ideja e popullit është e reduktuar në singularitetin e parimit etnik.

"Kështuqë edhe eksistenca e madje edhe më të vogles pakicë brenda kufijve nacionalë përjetohet si një cenim i padurueshëm i pastërtisë së tërësisë nacionale… Për këtë arsye çdo pakicë, si

[5] Shih: Berishaj, Anton: "Figura e armikut"; Qendra Multimedia, Prishtinë, 2016;
[6] Shih Berishaj, Anton: Po aty;429
[7] Cross, Malcolm: Racsm and the Postmodern City; London 1993; Fq. 11-15 (Cituar sipas Latifi, Blerim; Po aty; Fq.146.)
[8] Shih: Myftaraj, Kastriot: http://www.arkivalajmeve.com/Projektimi-i-Tjetrit.1046953534/
[9] Shih Ymer Ciraku:
http://www.albasoul.com/modules.php?op=modload&name=News&file=article&sid=116

përkujtuese e kësaj mangësie të vogël, port e pakëndshme, nxit instinktet për pastrim"[10] – prej nga Apadauri nxjerr konkluzën e "*frikës nga numrat e vegjël.*"[11]

Ndonëse sipas Amartya Senit,identiteti mund të jetë burim ngrohtësie e pasurie, ai poashtu mund të jetë edhe burim dhun e e terrori. Në këtë aspekt, fuqisë së një identiteti luftëdashës mund t'i kundërvihemi me fuqinë e dientiteteve konkurruese.

"I takon qenieve njerëzore, atëherë, përgjegjësia e zgjedhjeve dhe arsyetimeve. Dhuna, në të kundërt, nxitet nga një ndjenjë pashmangshmërie për një identitet të ashtuquajtur unik, e shpeshherë kundërshtues/belligerent/armiqësor?, të cilit mendohet se i përkasim dhe që kërkon shumë prej nesh (ndonjëherë edhe gjëra qartësisht të pakëndshme.) Ky identitet i imponuar, i ashtuquajtur unik, shpesh është element thelbësor në "artin marcial" të nxitjes të përballjes sektare."[12]

Duke u shprehur kundër solipsizmit, Vincent Descombes e shtron pyetjen, nëse "qenia" = "qenia e njohur" – se prej kujt njihet kjo qenie – prej meje, individ i veçantë dhe i dallueshëm nga të ngajshmit e mi? Prej cilitdo qoftë? Idealizmi ndeshet kështu me vërejtjen e solipsizmit?

"E qortojmë sepse është i detyruar të pranojë tezën absurd sipas të cilës ai që shpreh cogito-n nuk mund të bëjë ndryshe veçse të nxjerrë përfundimin: ekzistenca ime është e sigurt, ekzistenca jote shumë më pak, dhe, më rrënjësisht, "unë jam, pra ti nuk je".[13]

Lufta mes absolutëve konkurrentë tek Descombes është luftë eternale e gjithëkohëshme, për t'u barazitur me absolution – Zotin si unik dhe vetmitar.

"Nëse qenia është e pohueshme, vetëm bnë atë masë që njihet, cila është qenia e tjetrit? (…) Lufat e ndërgjegjeve e ka rrënjën e vet në cogito-n karteziane. Në atë që quhet "filozofia e ndërgjegjes", pra në traditën karteziane, "unë mendoj, pra jam" është njëherësh origjina dhe rregulla e çdo të vërtete. Është e vërteta e parë, e vërteta që është në origjinë të te gjitha të tjerave, dhe së fundmi vetë shembulli i së vërtetës. Ego, e tillë siç jepet në ego cogito, sgo sum është absolute kundrejt të cilit gjithçka tjetër është relative; e vërteta e tij që nuk varet prej asnjë të vërtete tjetër, por i kushtëzon të gjitha të tjerat. (…) Mirëpo nuk mund të ketë disa absolutë njëkohësisht. Një absolute i dytë (tjetri) shënjon domosdoshmërisht një rival të te parit (uni, ego.) Në shumës, absolutët mbetën vetëm pretendentë të absolutist, konkurrentë që hanë kokën njëri-tjetrit në luftën për fron."[14]

Në kontekst të filozofisë së tjetrit të Descambes-it, Berishaj duke bërë fjalë për shënimet e Dobrica Čosić-it, e kundron qasjen e tij nga pozicioni i aktivizimit të mekanizmit diskursiv të identifikimit kontrastiv (Appadurai, 2008, 61) midis shqipatrësh e serbësh.

"Në të vërtet, Čosić-i madje as nuk emërton TJETRIN, sikur është i vetëdijshëm për idenë e Benjaminit se "emir është pika në ët cilën gjuha e papërsosur

[10] Berishaj, Anton; Po aty. Fq. 429.
[11] Apadauri, Arjun: "Fear of small numbers"; Publicplanet books & Duke University Ppress; 2006; Fq.51;
[12] Sen, Amartya: Identiteti dhe dhuna (Iluzioni fatit); ISHM, Tiranë, 2007. Fq 9;
[13] Descombes, Vincent: Vetja dhe tjetri: Fq. 39
[14] Descombes, Vincent: Po aty; Fq. 40-42

njerëzore e prek gjuhën e apstër, hyjnore" (Aichele, 1997, 75) se Tjetri nuk është i denjë për t'u emërtuar, respektivisht për t'iu dhënë e drejat për eksistencë."[15]

"F jala është për strategjitë e konstruktimit të identitetit, të cilat Apadauri i quan "identitete predatore" (gllabëruese, Vër. HM), konstruktimi shoqëror dhe mobilizimi i të cilave kërkon asgjësimin e kategorive tjera të afërta shoqërore. (Apadauri; 2006: 51.)"[16]

Në anën tjetër, për sa i përket figurës së tjetrit, ose diskursit për tjetrin në letërsi, Berishaj duke pasur paarsysh konceptet e Burdjesë mbi fuqinë simbolike (Bourdieu, 1991) si dhe koncepcionet e van Dijkut dhe të Fukosë mbi diskursin racist dhe diskursin e luftës (Foucault, 1998; van Dijk, 2008) vjen në përfudnim se si çdo diskurs tjetër edhe diskursi letrar është i kapërthyer në rrjetin e fushës së fuqisë dhe vednos relacione specifike me sistemin e dominimit politik dhe simbolik.

Ndërsa Elshtajn nuk e ndan fare traditën letrare nga lufta.

"Nuk mund ta përçanësojmë "luftën vetë" si entitet të ndarë nga tradita letrare e fuqishme që i përfshin këngët, epet, mitet, historitë zyrtare, historitë në vetën e parë, si dhe teoritë e artikuluara (…) Lufta dhe diskursi mbi luftën janë të bashkuar në realitetin politik."[17]

Berishaj, sëkëndejmi konkludon (duke cituar Fukonë) se lufta është në praktika të caktuara discursive, gati-gati një kategori universal që e përshkon edhe të kundërten e saj – paqen. "Lufta është motori i institucioneve të rendit: paqja, në ingranazhin e saj më të vogël, udhëhiqet dinakërisht nga lufta. Thënë ndryshe, nën paqen duhet deshifruar luftën: lufta është shifra e vërtetë e paqës. Ne jemi pra në luftë me njëri-tjetrin. Fushëbeteja e përshkon gjithë shoqërinë, pandërprerë dhe gjithë kohën dhe kjo fushëbetejë secilin nesh e vë në njërin apo taborrin tjetër. Nuk ka neutral. Domosdoshmërisht jemi armiq të dikujt. Një strukturë binare e përshkon shoqërinë." (Foucault, 1998, 67.)[18]

Në këtë kontekst, i jap të drejtë Blushit – që gjatë të krijuarit të topikës së tij ideale të Tjetrit që është "ne" i shmanget qëllimshëm një identiteti të ngurtë nacional – dhe jo Kadaresë që insiston në identitetin e forte nacional – që i shërben totalitarizmit shqiptar për veçim nga Tjetri/Armik!?

"Identiteti nacional ka qenë që nga fillimet – dhe ka mbetur i tillë gjatë kohë – nocion agonistik[19] dhe thirrje luftënxitëse".[20]

[15] Cituar sipas Berishaj, Anton. Po aty, Fq. 429.
[16] Cituar sipas Berishaj, Anton: Po aty; (Apadauri; 2006: 51.)
[17] Berishaj, Anton; Po aty. Fq. 421
[18] Cituar sipas Berishaj, Anton: Po aty; Fq. 421. (Foucault, 1998, 67.)
[19] Nocioni agonistik në retorikë karakterizohet nga konflikti apo armiqësia. Është pozicion argumentues/luftarak.
[20] Bauman, Zigmunt: Po aty; Fq 24.

Projektimi i Tjetrit-përbindësh që mësynë zhdukjen "tonë"
Ismail Kadare dhe romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur": Një lexim ndryshe

Romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" i dha famën botërore Ismail Kadaresë për faktin qenësor se ai me stilin dhe gjuhën letrare antiluftë, përafrohej me letërsinë perëndimore.

"Pika shtatëmbëdhjetë, shtojcat B. dhe D. Arkëza druri, komesatë e dyfishtë, 70X40 X 30 cm. Lyet me ngjyrë vaji të bardhë. Numrat me të zezë.".[21]

Kjo është vet lufta, - tha Gjeneralleitnanti,- Këto eshtra janë esenca e saj, ajo ç'ka mbetët në fund, si ato kripërat që precipitojnë në fundin e një ene kur kryhet një reaksion kimik"[22]

Ashiqare që Shqipëria komuniste kishte nevojë për një zë që e mbron fort para të huajve, duke e shpërfaq realitetin ashtu siç shoqëria shqiptare e kohës "e shihte" veten përballë armiqëve – pra ashtu siç e përfytyron vetën - dhe sipas njatij ligjërimi artikulohet bota[23] - e që nuk përkonte kryekëput me shtetin policor – *"shtetin policor in se (në vetvete)"*[24] (Pipa: 1999, 62) porse në diskrecion identifikohej me Enver Hoxhën, kinse si mbrojtjës i sovranitetit të popullit!?

"Romani kishte një shmangie të atillë nga binari mbi të cilin ecte realizmi socialist saqë shkaktoi një shtangie të vërtetë dhe dogmatikët e konformistët ngritën zërin. Shkrimtari u mbrojt, por në fund iu përkul presionit dhe e modifikoi tekstin original. Por, edhe i modifikuar, romani është një punë e kryer me sukses. Aty mungojnë inkrostacionet doktrinale. Shkrimtari gjen shtigjet për të shkruar një libër brenda kornizës ku ndodhej Shqipëria komuniste pa e përmendur partinë."[25] *(Pipa 1999, 10)*

Sëkëndejmi Kadare ka krijuar figurën e tjetrit armik – duke i paraqitur shqiptarët dhe italianët, jo siç janë në të vërtet, porse siç kishte dëshirë pushteti stalinist shqiptar të ishte – pra ashtu siç perëndimoret (sidomos (fqinjtë!?) "duhej" ta shihnin shqiptarin - që refuzimi shqiptar ndaj vlerave perëndimore të ishte edhe më i madh, që hendeku mes "dy botërash" të ishte i pakapërcyeshëm!?

---

[21] Kadare, Ismail: "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"; Botoi Grupi KOHA, Prishtinë, 2005. Fq. 159. Me gjasë Uçi citon botimin e parë – të pandryshuar - të "Gjeneralit...", sepse bie në sy dallimi mes citimit të tij dhe botimit të Grupit Koha (2005.)

[22] Kadare, Ismail; Po aty. Fq. 204.

[23] Cituar sipas Bregasi, Majlinda: Dialogët si strategji për angazhim në romanin e Kadaresë; Kadare, leximi dhe interpretimi (ese dhe studime), Onufri, Tiranë, 2016; Fq. 240;
"Sipas Culler (1983; Culler, J., Structuralist Poetics, Routledge & Kegan Paul Ltd. 1983, romani më shumë se çdo formë tjetër letrare, ndoshta më shumë se çdo lloj tejtër shkrimi, shërben si model sipas të cilit shoqëria e përfytyron veten, si ligjërim në të cilin dhe nga i cili artikulohet bota."

[24] Pipa, Arshi: "Subversion drejt konformizmit – fenomeni Kadare"; Phoenix, Tiranë; 1999. Fq. 62.

[25] Pipa, Arshi: Po aty. Fq. 10.

Ndonëse roman i groteskut[26] (Uçi: 1999, 33) dhe stilit romanësor modern, përmes *stilemave groteske*[27], porse "Gjenerali…" mund të lexohet edhe ndryshe: ai në aspektin historik dhe politik mëton ta ngris ideologjinë e re izolacioniste – tërheqjen e shqiptarit në vete dhe për vete, që s'ia ka besen dhe as shpresen askujt. Duke e përligjë vetmimin si diçka që shqiptarët vetë e zgjodhën!

"- Shqiptarët janë një popull që e lexojnë shumë gazetën, - tha gjenerali.(…) Pas grindjes me Bashkimin Sovjetik ata kanë mbetur në Evropë krejt të vetmuar.

- *Si gjithmonë.*
- *Tani ata janë në bllokadë.*
- *Një vend kaq i vogël e i varfër në bllokadë…Çudi!*
- *Vështirë se do t'i qëndrojnë dot kësaj."*[28]

Dhe kjo, dmth. ai soj njerëzor aq i varfër e që i bë ballë bllokadës, lavdia e tyre del të jetë epike, madhështore me termat e Partisë!?.

Këta dy rreshtat e fundit, në këtë lexim ndryshe - të çliruar nga ideologjia neokomuniste e interpretimit - përafrohet me tezën se Kadare në letërsi e ka përligjur ideologjinë e izolacionizmit të Enver Hoxhës, sipas doctrines së realsocializmit, kur ata aq të varfër që i bëjnë ballë bllokadës së gjigantëve, lavdia e tyre del të jetë epike, madhështore me termat e Partisë!?.

"Në mur ishte shkruar me një cope thëngjill, me shkronja të mëdha e të shtrembra fraza: "Kështu e pësojnë armiqtë."[29]

Dhe pas revoltës së italianëve, Specialisti vendor e përligj këtë parullë me sfond të qartë ideologjik, që autori e quan frazë, duke e relativizuar dhe që është i sigurt se do ta ketë shkruar ndonjë nxënës gjë që pavetëdijshëm dëshmon për in doktrinimin e thellë të shkollës shqiptare me diskursin e Tjetrit si armik:

---

[26] Uçi, Alfred: "Grotesku kadarean", Onufri, Tiranë, 1999. Fq. 33. "Elementi grotesk i stilit të Kadaresë filloi të spikasë qysh në veprën e pare madhore në prozë "Gjenerali…". Grotesku përbën bazën e fabulës e të subjektit të romanit, me një general e me një prift që nisen në ekspeditë për të mbledhur eshtrat e një ushtrie të tërë, të rënë në betejat e mëdha, por të humbura të saj. Qysh në titull ndihet aspekti grotesk që bart kuptime ironike, sarkastike. Kjo frymë e përgjithshme groteske e romanit, i lejon autorit që, me mjeshtëri, ta pasurojë linjën kryesore me segmente të tjerë groteskë, si tema e çeljës së shtëpisë publike, procedura e "përpunimit" (zhvarrimi, verifikimi, paketimi, transportimi) të eshtrave, skeletëve të gjetur, betejat imagjinare të gjeneralit me ushtarët-skeletë, etj. Të tillë motive ose segmente n dihmojnë, jo vetëm për ta ruajtur gjatë gjithë linjës së subjektit frymën griteske, por e pasurojnë përmbajtjen estetike të romanit, duke e bërë ë të larmishëm tekstin e ligjërimin letrar, duke shamngur uniformitetin."

[27] Pipa, Arshi: Po aty; Fq. 39. "vinçat me ca drita sis y të kuq lëviznin nëpër mjegull si përbindësha"; "Ky prift është prej metali"; "Ne jemi varrëmihësit më të mëdhenj të botës"; "Mbretëria e kalçiumit"; Shtëpia publike do të hapet, sepse ka karakter strategjik"; Do të hapej shtëpia publike e jo fronti i dytë"; "Oficeri i një ushtrie të madhe që pranon të ruaj pulat (…)"

[28] Kadare, Ismail: Po aty; Fq. 41.

[29] Kadare, Ismail: Po aty; Fq. 46.

- *"Njëzet vjet më parë ju shkruanit parullat e fashizmit mbi gjokset e shokëve tanë të varur, kurse tani acarohen për këtë frazë të thjeshtë, të shkruar me siguri nga ndonjë nxënës."*[30]

Kjo qasje ilustrohet me fjalët që Kadare i vë në gojën e një gjenerali Italian, i cili po i fliste gjeneralit që ksihte marrë misionin për të ardhur në Shqipëri për zhvarrimin e trupave të ushatrëve italianë, të vrarë gajtë Luftës së Dytë Botërore.

"- S'kam ç'të them tjetër. Desha vetëm t'ju paralajmëroja që të keni kujdes. Të jeni krenar. Të mos e ulni kokën përpara tyre. Ata do t'ju provokojnë, ndoshta do t'ju përqeshin, por ju duhet të dini si t'u përgjigjeni. Ju duhet të jeni syçelët. Ata do të përpiqen të fyejnë eshtrat e ushtarëve tanë. Unë i njoh mirë. Ata shpesh mahiteshin me ne. Na përqeshnin atëherë. Mendoni tani ç'do të bëjnë."[31]

Regjimi stalinist ashiqare që nuk donte thjesht që romani të nxiste urrejtjen e shqiptarëve ndaj italianëve, që shiheshin edhe nga letërsia nën figurën e armikut, por mësyhej të nxietj urrejtja perëndimorëve kundrejt shqiptarëve, që përbuzuja e shqiptarit të rëndomtë të rritej e më këtë edhe shtypja mbi ta të ishte më e lehtë!?.

«- Ju i urreni shqiptarët? - pyeti ai papritur.

Prifti buzëqeshi hidhur.

- Jo. Pse?

Gjenerali i afroi fytyrën te veshi. Prifti bëri një shenjë të lehtë neverie kur ndjeu erën e alkoolit.

- Si pse? - ja bëri me zë të ulët gjenerali sikur të thoshte një të fshehtë - Ne të dy i urrejmë ata, por tani për tani nuk e themi dot se kështu është puna». [32]

Pra, autori Kadare, fshatarëve plot mirësjellje dhe devotshmëri fetare – mëshirë ndaj të vdekurve të huaj – ua rrëfen "një të vërtetë tejtër", atë të kundrimit të palës tjetër si urrejtës:

Madje autori vë në gojën e tjetrit, për ta satanizuar atë edhe pandehma sikur ajo se kinse shqiptarët u vëjnë pushkën në djep të posalindurve, në vend të rushit me rruaza të mësyshit:

"- Shqipatrët janë një popull i ashpër dhe i prapambetur. Atyre që kur janë foshnja, u vënë në djep pushkën, kështuqë pushka bëhet pjesë e pandarë e jetës së tyre." [33]

Mirëpo Kadare, me disa pasazhe edhe i frynë fort nacionalizmit të majtë shqiptarë kur ata nga prizmi i një të huaji i shpall "popull luftëdashës" gjë që kurrë në histori shqiptarët nuk e kanë provuar...

Poashtu, Kadare krijon dialogje letrare që shkojnë në funksion të përmbysjes së postulatit me jete kundër vdekjes, ai nga kënvështrimi i një të huaji mësynë që t'a shpall si karakteristikë qenësore intencën ose shtysën e vdekjes!

[30] Kadare, Ismail: po aty; Fq. 47.
[31] Kadare, Ismail: Po aty; Fq. 39.
[32] Kadare, Ismail: Po aty; Fq. 33.
[33] Kadare, ismail: Po aty; Fq. 32.

«- Ato këngë i këndonin kryesisht shkatërrimit dhe vdekjes, -vazhdoi prifti. - Kjo është karakteristikë e artit të tyre. Këtë e gjen në këngë, në veshje dhe në çdo gjë. Pak a shumë kjo është karakteristikë e popujve ballkanikë, por te shqiptarët është më e theksuar. Bile edhe flamuri i tyre nacional nuk simbolizon gjë tjetër veçse gjakun dhe zinë». [34]

Dhe: *«... shqiptarët prej natyre janë të prirë për luftë, - tha prifti. - Ata e përqafojnë atë me ndërgjegje të plotë. Lufta është bërë pjesë organike e këtij kombi, ajo ia ka helmuar gjakun si një njeriu të alkolizuar»*[35].

Kadare "vëzhgimeve vetanake etnopsikologjike dhe antropologjike" u jep "ngjyrime" perëndimore – rëndom këto 'teori' që në thelb janë stereotype të sllavëve të jugut për shqipatrët dhe Kadare kur "u jep gjallëri" këtyre fjalëve të duket sikur ai po i citon Garašanin-in, Cvijić-in ose Andrić-in, e jo një prift dhe një gjeneral italian. Ai në romanin e tij i shqipton "të dhënat" e tij për shqiptarët, që e nisin një luftë për me hy në një këngë fshati…[36]

"- Ata e kanëpër nder të luftojnë fillikat, - tha prifti. – Madje sa më të vetmuar ta bëjnë luftën, aq më të lavdishëm ndihen…" [37]

4. Filozofia e ishullit: Topika e Tjetrit banon në "ne"

"Të jetosh në ishull", Ben Blushi, Botimet Toena, Tiranë, 2010;

Tek "Ishulli…" i Ben Blushit topika e Polisit shqiptar është Voskopoja – që jepet me mjete idealizuese letrare ashtu siç autori e ëndërron – e siç nuk është, ose siç nuk u bë kurrë… Pra topika e tjetrit (Voskopoja) tek Blushi tashmë banon në "ne":

"…kishte rregull, kishte ligje, kishte shqiptarë, kishte grekë, kishte jevgj, kishte të krishterë, dhe prandaj kishte dhe alphabet."[38]

Në këtë topikë që banon në "ne" Blushi Vs Kadaresë, i shmanget racizmit etnocentrik, duke i ngrehur një monument letrar përafrimit të shqiptarëve edhe me grekët e serbët, edhe me vllehët dhe turqit, madje - duke mos e urryer madje as armikun real – e lëre më mikun, të cilit *"duhet mësuar notin – që të kthehet nga ka ardhur…"* duke iu kundërvënë Kadaresë:

- *"Bunker*ë *kudo, - tha gjenerali.*

- *Atyre u pëlqen të përseritin se Shqipëria është një kështjellë në breg të Adriatikut, - tha prifti.*

[34] Kadare, ismail: Po aty; Fq. 127-128.
[35] Kadare, Ismail: Po aty; Fq. 115
[36] Kadare, Ismail: "Ra ky mort e u pamë"; Fq. 30; "Etjen për lavdi, kapardisjen e kam menduar përherë si një sëmundje të rëndë të shqiptarëve, por kurrsesi gjer në ëtë shkallë mortore" dhe: "…i vetmi qe s'u përkul, i vetmi që rapsodët e katundit do t'i ngrenë këngë me qifteli…"
[37] Kadare, ismail: Fq. 131.
[38] Blushi, Ben, Botimet Toena, Tiranë, 2010; Fq. 248.

Gjenerali kthu kokën nga bregu.

- Më keni thënë se deti u ka sjellë shqiptarëve fatkeqësi dhe prandaj ata nuk e duan.

- Ashtu është, - tha prifti. – Shqiptarët janë si ato qeniet që i tremben ujit. Ata kanë qejf't çepen shkrepave dhe maleve.

Atje e ndiejnë veten të sigurt."[39]

Megjithë kritikat e shumta nga dyja polet, nga taborri proislam dhe ai nacionalist shqiptar, "Ishulli…" i Blushit dhe filozofia e tij ishullore (topika ishullore), tashmë ka krijuar një ideal letrar të një komuniteti diversiv, që ishte multietnik dhe multifetar e multikulturor, sepse me mbërritjen e shtypshkronjës (ata tashëm kishin alphabet pra edhe shkolla[40]) vihen bazat që të krijohet një bashkësi komunitare, mbietnike si bashkësi qytetarësh ose komb politik dhe "komb demokratik"/"Njësi e rritur"[41] siç kanë kombet moderne një shkollë unike kombëtare, një radiotelevizion, gazetë kombëtare etj.

Natyrisht se në "ne" kanë aderuar shumë fise e etni me identitete më të formësuara apo më pak të forta.

Mirëpo as lidhjet martesore mes grupeve të ndryshme etnike nuk mungojnë në "ishullin…" e Blushit. Tek ai martesa e një jevgeje me një arben nuk është ndonjë problem.

"Jani dhe Fatimja u mnartuan pas dy javësh. Kasollja e Bilalit kishte mbaruar dhe Sara me Muhamedin shkuan aty për të kërkuar dorën e nusës…"[42] *dhe: "…Ana Komnena e shikonte Fatimen pa ia ndarë sytë dhe para se të iknin e puthi Janin dhe doli në oborr. Nuk kishte parë kurrë një jevg…"*[43]

Sëkëndejmi në topikën e Tjetrit, s'është e jashtëzakonshme që edhe një fëmijë të rritet duke thither tamblin e një nënë të "huaj":

"Kur nëna jote vdiq, ti kishe nevojë për gji. Unë gjeta një vajzë të re dhe ët shëndetshme nga familjet e vjatra veneciane që kishin mbetur akoma në Kretë pas pushtimit…"[44]

Në romanin e Blushit shpërfaqet ideja e përkatësisë së tjetrit në "ne', kur askujt më nuk i interesojnë rrënjët, por solidarësia qytetare dhe bashkësia e njerëzve të lumtur, ngase *"të menduarit mbi identitetin ka lindur në krizën e përkitjes."*[45]

[39] Kadare, Ismail: Po aty. Fq. 128.

[40] Schnapper, Domenique: Bashkësia e qytetarëve, Dituria, Tiranë, 2008; Fq.149; (Vetëm duke filluar nga Revolucioni francez, mesuesit e shkollave nuk quheshin më 'regjentë', por u bënë 'mësues', sepse tanimë ishin ngarkuar që të themelonin, të krijonin shtetin. (Në frengjisht fjala 'instituteur', që përdoret në kuptimin "mësues", vjen nga folja 'instituer' që shprehimisht do të thotë themeloj, krijoj (shën. i përkth.);

[41] Schnapper, Domenique: Bashkësia e qytetarëve, Dituria, Tiranë, 2008. Fq. 52;

[42] Blushi, Ben: Po aty; Fq. 434.

[43] Blushi, Ben: Po aty; Fq. 435.

[44] Blushi, Ben: Po aty; Fq. 476.

[45] Bauman, Zigmunt: "Identitet"; Palago, Zagreb, 2009. Fq. 23.

Ishullarët e Blushit (ndonëse në qendër të fokusit janë Komnenët e Voskopojës) ata janë bizantinë (pra shtetas), ia qojnë për mrekulli mes vete dhe nuk kërkojnë të dijnë më shumë për rrënjët!

Sepse familjet degëzohen edhe me grekët e serbët, me malazezët por natyrshëm edhe me vllehët, e këta katër popuj nuk kanë të bëjnë me grekët aktualë, as me serbët e Sllobodan Millosheviqit dhe as me rumunët e sotshëm!???

"Serbët të cilët lindën në mbeturinat e kalbëzuara të Perandorisë Avare nuk ishin populli që u mposht në Betejën e Kosovës më 1389, dhe as nuk ishin ata serbë të thirrur për madhështinë nacionale nga Slobodan Milosheviqi. Shqiptarët, viktima të serbëve të Milosheviqit, nuk ishin ilirët e Ballkanit të shekullit të gjashtë..." [46]

Porse, në kontekstin shqiptar, një komb unik shqiptar kurrë nuk është konstituuar si një entitet i pavarur, politikisht i strukturuar, deri më 1913, madje deri në vitin 1925, por ekzistonte vetëm si një "kolektivitet historik".[47]

Mihail Komneni udhëton me një serb mesjetarë nëpër Itali si me vëllamin e tij, madje ata na shfaqen si aleatë për t'u mbrojtë nga invadimi osman dhe rrënjët e tyre janë të përziera saqë më nuk dihet cili është arben, cili serb e cili vlleh! "*Pasi ikëm nga Napoli, unë dhe Brankoviqi kemi fjetur nëpër hanet e Italisë ngarkuar me plaçkat dhe kujtimet e ditëve në Stamboll…"*[48]

Arbnit e supozuar tek Blushi nuk e kanë për dert që në krye të një grupi illegal për organizimin e kryengritjes antiosmane ta vëjnë një serb si Gjergj Brankoviqin. *"Njëri ishte një grup Komnenësh me në krye Gjergj Brankoviqin, të cilët kishin shpresë në një kryengritje antiosmane në Ballkan…"*[49]

Arianiti i parë, "*siç thashë, njëren vajzë, të madhen, ia dha Skënderbeut, Vajzën e dytë, Vosavën e martoi me princin e Malit ët Zi, Ivan Cernojeviqin (…) Tri vajza të tjera i martoi në derën e Dukagjinëve (…) Një vajzë tjetër e martoi me Gojko Balshën (…) Tre të tjera i martoi në Itali, kryesisht në Venedik e Napoli (…), vajzën e tij më të dashur që ai thoshte se i ngjante gjyshës s ëtij, ia dha Stefan Brankoviqit princit të Serbisë dhe stërnipit të Stefan Dushanit të madh..."*[50] Ose: *"Një nga këto netë të gëzueshme u njoha me një tregtar grek, Jorgo Mavromatisin… (…) Ky ishte një rast i mirë për të udhëtuar aq më tepër që unë ksiha lidhur miqësi me grekun dhe gruan e tij çifute, Sheba…"*[51]

Mirëpo tek Blushi, hasim fenomenin që më vonë nëpër histori u bë i natyrshëm ndër shqiptarët – atë të bashkëjetesës së dy feve (kristiane e islame) në një familje, pra "*të jetosh në ishull"* njëkohësisht është *"të jetosh në një shtëpi me tjetrin."*

[46] Geary, Patricj J. Po aty; Fq. 274.
[47] "Thiese, Anne-Marie (2004): Krijimi i identiteteve kombëtare (Europa e shekujve 18 -19); Dukagjinai, Pejë; Fq.100.
[48] Blushi, ben; Po aty. Fq. 86
[49] Blushi, Ben; Po aty. Fq. 226.
[50] Blushi, Ben. Po aty; Fq. 76.
[51] Blushi, Ben: Po aty; Fq. 98.

"Prifti erdhi të nesërmen dhe ai (Ibrahimi. Vër. HM) i tha: Imzot unë u bëra mysliman, por gruaja dhe katër djemtë e mi mbetën të krishterë."[52]

Edhe pse, siç thamë më lart – Blushi i sharë nga të dyja anët – nga proislamikët dhe nga oponentët – në linjat kryesore të rrëfimit shpërfaq idenë e bashkëjetesës paqësore me islamin – si pjesë e një mendjeje dhe një trupi, Autori duke qenë se shkruan romanin e tij në epokën e trazuar të islamit politik, sikur preferon një qasje europiane ndaj islamit – një islam European – që rëndon më pak e kënaq më shumë – duke e pasë parasysh bektashismën - siç shprehet personazhi-narrator Ali Tepelena.

"Megjithatë, ne shqiptarët duhet të dime të zgjedhim. Jo çdo lloj islami i shkon shqiptarëve. Ne nuk jemi as turq dhe as arabë, prandaj duhet të gjëjmë islamin që na rvndon më pak dhe na kënaq më shumë."[53]

Blushi, po përmes këtij personazhi, Aliut në dialogjet e tij me Arianit Komnenin, ngre dilemën nëse Skënderbeu kishte dështuar:

"Dështimi i Skënderbeut ishte dështimi i races sonë, e cila për fat të keq beson se mund të pasurohesh si turk duke jetuar si i krishterë."[54]

Dhe kur i krishtëri Arianit e pohon dështimin e Skënderbeut, Aliu ngre dilemën e dytë të madhe, nëse shqiptarët duhet të nxjerrin një personalitet "të kundërt" me Skënderbeun!?

"Dikush duhet të përpiqet të bëjë të kundërten e Skënderbeut. Përderisa ti mendon se ai dështoi, dikush që bënë të kundërten e tij mund të ketë sukses. Në qoftë se njëri prej nesh bën paqe pa kushte me Islamin në emër të gjithë myslimanëve shqiptarë atëherë mund të arrijmë atë që nuk e kemi pasur kurrë, shtetin tone, tha ai duke mbyllur sytë kur fliste."[55]

Më tej, Arianiti do të pohonte se:

"Shqiptarët e kanë pare Skënderbeun gjithmonë si turk prandaj kurrë nuk e besuan me të vërtetë. Por as turqit nuk e besuan Skënderbeun."[56]

Dhe duke e fajësuar pikërisht kryheroin e arbnevet (të rikthyer nëhistori nga rilindasët dhe të kodifikuar për kryehero edhe nga Shqipëria e pavarme e 1912-ës, por pa e cenuar figurën e tij as komunistët enveristë) për këtë mosbesim, që nga goja e Arianitit del si çortim ndaj tij:

"Për faj të Skënderbeut, sot as turqit dhe as evropianët nuk i besojnë më shqiptarët."[57]

Dhe fjalët e Aliut kur flet për Skënderbeun sa vijnë e ashpërsohen, sigurisht për arsye të spikatjes së konfliktit real që historiografët ia përshkrujnë raportit mes Arianit Komnenit (vjehrrit të Skënderbeut)*:*

[52] Blushi, Ben: Po aty; Fq. 140.
[53] Blushi, Ben: Po aty. Fq. 52.
[54] Blushi, Ben: Po aty; Fq. 65.
[55] Blushi, Ben: Po aty. 67.
[56] Blushi, Ben: Po aty. Fq.68.
[57] Blushi, Ben: Po aty. Fq. 68.

"Skënderbeu djallëzor, për shkak të educates turke që kishte marrë, ia ktheu: Në qoftë se ti më pengon mua të bëhem Mbret i Shqipërisë djalin tim nuk e pengon dot."[58]

Për të ardhur në përfundim se islami është përbrendësuar (pra përshpirtëzuar) tashmë në trupin e shqiptarit dhe është vonë për çfarëdo ndërhyrjeje, prandaj narratori në dialogjet mes Aliut dhe Ariantitit (si yrnekë të prijësve shqiptarë të dyja besimeve) vihet në kërkim të tolerances dhe bashkëjetesës në paqe me islamin.

5. Përfundim

Zakonisht "tjetri" në shtresat më të hershme të kulturës shqiptare është një "i ndryshëm nga vetja".

Nëse është dalluar "tjetri", kjo ka qenë më shumë një nevojë vetë-identifikimi.

Lahutari i këngëve legjendare thotë se kreshniku u foli shokëve "në gjuhë të vet", thjesht për të konstatuar se ishte ndryshe, ishte një "alter", pa kurrfarë konotacioni ndaj atij që nuk ishte "i vet".

Një prej bagazheve më të rëndë të Ballkanit është barazimi i "tjetrit" me kundërshtarin.

Ky sindrom diku-diku ka marrë formën e etnofobisë.

Mosdurimi ndaj "tjetrit", pavarësisht prej burimit, për shkak të ndryshimit etnik, fetar apo kulturor, ka krijuar probleme delikate në të shkuarën dhe sot. Ka qenë një prej dëshmive të frymës së hapur të kulturës shqiptare distanca e saj ndaj angatonizmit dhe frymës së konfliktit. Pra ka prodhuar ksenofobinë, që kultura tradicionale shqiptare nuk e njihte. Atë e riktheu etno-nacionalizmi.

Kurse stereotipet e tjetrit për shqiptarët janë cilësorë racist e hegjemonistë, superioriteti i racës, pra i racës se purifikuar (kombi kulturor) që prodhoi nazi-fashizmin.

Edhe pse konceptet tona lokale mik-armik sot më shumë se kurrë i shkojnë përshtat njëri tjetrit. Të jesh shqiptar etnik dhe patriot duhesh ta kesh një serb armik dhe anasjelltas, të jesh serb i madh, patjetër u dashka ta kesh vrarë, ose sëpaku rrahur një shqiptar etnik!?

Dhe kjo ndodh edhe në institucionmin e quajtur letërsi, ngjashëm si në realitetet e përfytyruara të akëciles shoqëri.

Në fakt, mënyra me të cilën i drejtohemi tjetrit është pa dyshim një moment socio-emocional dhe kulturor. Ajo lidhet me formimin e individit dhe shoqërisë përkatëse e tregon një relacion të caktuar të zhvillimit social-politik dhe kulturor të individit në raport me shoqërinë.

[58] Blushi, Ben: Po aty. Fq. 72.

Ky relacion në historinë e shoqërisë kosovare ka ndryshuar sipas etapave të caktuara historike dhe kulturave të cilat dihet botërisht që këtu janë përzier në mënyrën më mikse të mundshme.

Kjo duhet të jetë një nga shkaqet që individi psiko-social kosovar gjendet konfuz herë pas here.

Gjykoj se në raportet midis njerëzve një përqindje e caktuar dhe domethënëse është raport interesash të ndryshme.

Kjo bën që duke e afruar tjetrin më shumë se çka është dhe meriton, ne padashur ndërtojmë marrëdhënie iracionale të cilat në një moment të caktuar përfundojnë deri në acarim. Siç ndodhi pas bashkim-vëllazërimit me bazë ideologjinë komuniste.

Sot, ne duhet ta trajtojmë tjetrin si bashkëpunëtor biznesi apo edhe konkurrent, bashkëmendimtar politik ose edhe kundërshtar, kulturor, ekonomik etj. i cili, duhet pranuar i tillë çfarë është.

"Nacionalizmi – para së gjithash është paranojë. Paranojë kolektive dhe individuale." (Shih: Kiš, (1995,30.)

Nacionalizmi është kiç[59], thotë Danilo Kiš, dhe si i tillë, mendoj se ai në epokën e televizionit është shndërruar në spektakël masiv, që është i akceptueshëm për turmat.

Turma nga spektakli ekzaltohet dhe lehtë përmes transit hyn edhe në ekzekutimin e një linç publik... Pa e ditur se tjetri – jemi ne, prandaj duhet të refuzojmë që të mos biem viktimë e frikave tona nga numri më i vogël... Si të mënjanohet fobia nga tjetri, nga numri i vogël, sepse raporti shumicë=pakicë shpreh rëndom frikën e zhbërjes nga pakica dhe frikën se kanë për të na bërë siç janë ata, pra pakica.

Raporti shumicë-pakicë edhe nëse është gjeneroz nuk është vlerë por vetëm spektakël... Vlerë është kur nuk ka më rëndësi ky raport...

Megjithatë, sociologu Georg Simmel mendon se i huaji nuk është një shtegtar, që sot vjen e nesër ikën, por ai që sot vjen dhe nesër rri. [60]

Ky shtegtar që vjen e rri, nuk është tutje njeriu i vendosur në hapësira për jetë të zhveshur[61] por refugiumi endacak – qytetari me vizë në mes (Gioggio Agamben), si eurogjerman, eurofrancez, eurokosovar etj.

[59] Kiš, Danilo: "Čas anatomije"(Sabrana dela), 1995. BIGZ, Beograd; Str. 30- 31.

[60] OTTHEIN RAMMSTEDT L'étranger de Georg Simmel (1): http://www.revue-des-sciences-sociales.com/pdf/rss21-rammstedt.pdf

[61] Agamben, Giorgio: HOMO SACER (Sovereign Power and Bare Life); Shih: https://is.muni.cz/el/1423/podzim2015/SOC587/um/AGAMBEN_HomoSacer_1998.pdf

Literatura

KADARE, Ismail (2005): "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"; Botimet KOHA, Prishtinë;
KADARE, Ismail (1999); "Ra ky mort e u pamë", Onufri, Tiranë;
PIPA, Arshi (1999): "Subversion drejt konformizmit – fenomeni Kadare"; Phoenix, Tiranë;
UÇI, Alfred (1999): "Grotesku kadarean"; Onufri, Tiranë'
ESE dhe studime (2016): Kadare, leximi dhe interpretimi; Onufri, Tiramnë;
BLUSHI, Ben (2010): "Të jetosh në ishull", Botimet Toena. Tiranë;
KUNDERA, Milan (2014): Mosdija", Dituria, Tiranë;
COETZE J.M. (2007): *"I ngadalti", botoi Skanderbeg boks, Tiranë;*
SALIH, Tajib (2010): "*"Koha e shpërnguljes në veri*"; Botimet KOHA;
GEARY, Patrick J. (2009): Miti i kombeve; Ombra GVG;
DESCOMBES, Vincent (2000): Vetja dhe tjetri, amc & isp & Dita; Tiranë;
MALOUF, Amin (2006): Identitete vrastare; Onufri Botime, Tiranë;
APPADURAI, Arjun (2006): Fear of small numbers (an essay on the geography of anger); Public Planet books & Duke University Press;.
SEN, Amartya (2007): Identiteti dhe dhuna (Iluzioni i fatit) Instituti shqiptar i medias, Tiranë;
SCHNAPPER, Dominique (2008): Bashkësia e qytetarëve; Dituria, Tiranë;
MM, Revistë mikste (2009), Nr. 1. Prishtinë, Fq. 140 -157 (VEçoritë themelore të nacionbalizmit shqiptar.).
SINANI, Shaban: Shih: http://www.albasoul.com/modules.php?op=modload&name=News&file=article&sid=116
RAMMSTEDT, Otthein: L'étranger de Georg Simmel (1): http://www.revue-des-sciences-sociales.com/pdf/rss21-rammstedt.pdf
THIESSE, Anne-Marie (2004): Krijimi i identiteteve kombëtare (Eutropa e shekujve XVIII – XX), Dukagjini, Pejë;
BROWN, Norman O. (1989): "Život protiv smrti"; Naprijed, Zagreb;
GRUP autorësh (2008): Pro & kundër Blushit, Botimet Toena, Tiranë;
KIŠ, Danilo (1995): "Čas anatomije"(Sabrana dela), BIGA, Beograd;
BAUMAN, Zigmunt (2009): "Identitet", Pelago, Zagreb;

Halil MATOSHI

THE OTHER IN LITERATURE

Abstract

This article emphasizes the image of the other in Albanian literature, more specifically in the novel *The General of the Dead Army* by Kadare and the novel *Living in the Island* by Ben Blushi, while providing examples out of world literature from particular works such as Kundera's *Ignorance*, Salih's *Season of Migration to the North* and Coetze's *Slow Man*. In the novel *Ignorance*, Milan Kundera refers to "the great archetypal return" – i.e. he unfolds the myth of the return depicted here as emigrant nostalgia which manifests with ignorance and loss. Instances will be retrieved from Blushi's *Living in the Island* in order to study the (cultural) rapport of the Albanian with the other and the thematic concern of this close and friendly relation, Constantinople at the time of its thriving. If spectacular examples of fear and phobia from the lesser numbers are exhausting in the domain of politics, the other in world literature and in Albanian literature is not the enemy; he usually is the same as us, or at least a guest. Man strived to find the answer to the rhetorical question: who is my true enemy? It is as if the fabrication of the guardian enemy that can usually be seen in the other (the past an an anxiety and fear or the new as an idea, an unknown) is a derivation of fear and paranoia that we are surrounded by enemies or that we are being followed, or it is merely monopolizing of language by those in power in order to secure the loyalty of their citizens. He constantly talks of a fictive enemy (national, state, ideological, religious, stratous, political...) but made concrete through the attribute 'other'. Apart from some classical works of Albanian literarure and especially some of the works of Ismail Kadare where the other is regarded with contempt (*The Great Winter*), although in *The General of the Dead Army* this author is more careful than in the other novels and essays where the Turks, the Greeks, the Serbs are despised and treated with contempt, forming clichés that through media and ideologically interpreted historiography reach the level of nomos, but in fact are stereotypes that create collective thinking of the other even for a man who has never had any interaction or experience with the other in the Kosovar context, for instance an ethnic Albanian with a Serbian Kosovar and vice versa. In this trail will be conveyed a comparative challenge between four cultures through the study of five novels (two out of Albanian literature and three out of world literature) in order to affirm the hypothesis that in literature we are all alike.

Muhamet HAMITI

LETËRSIA SHQIPE E SHEKULLIT XX NË PËRTHYERJE ME VETEN DHE ME TJETRIN/TJETRËN

Hyrje

Letërsia shqipe e shekullit XX është krijuar në përthyerje me veten dhe me tjetrin/tjetrën. Kjo është kushtëzuar më shumë nga rrethana shoqërore e politike sesa letrare.

Trashëgimia romantike ka jetuar e gjallë në letërsinë paramoderne shqipe. Realizmi kritik apo shoqëror – që në letërsitë evropiane është fenomen i shekullit XIX, dhe nënkupton një realizëm me gamë të gjerë që përfshin njëfarë shkalle të komentit apo të ndërgjegjes shoqërore – te ne është i shekullit XX dhe me zhvillim të paktë, në mes të dy luftërave botërore. Kritika letrare që ka përcjellë këtë letërsi ka qenë e paktë, gjithashtu.

Në shkallë ekstreme politizimi i letërsisë dhe politizimi i studimit të letërsisë kanë ndodhur në gjysmëshekullin e letërsisë soc-realiste në Shqipëri, të soc-realizmit si metodë e praktikë zyrtare për kontrollin e mendjes dhe të zemrës së shqiptarëve, për krijimin e njeriut të ri socialist në Shqipërinë e diktatorit Hoxha. As Kosova nën diktatorin jugosllav Tito nuk i ka shpëtuar krejtësisht kësaj gjame, ndonëse ka dalë prej saj më e pacenuar, kryesisht për faktin se realizmi socialist në ish-Jugosllavi nuk është shenjtëruar si në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e saj satelite. (Jo krejt e pacenuar, megjithatë, për shkak të konsumit të letërsisë soc-realiste si lektyrë shkollore këtu në Kosovë deri vonë. Është servirur me etiketën e letërsisë kombëtare. Herë-herë ndodh edhe sot, për fatin e keq të nxënësve tanë; me fajin e sistemit tonë arsimor, të njerëzve të indoktrinuar nga realizmi socialist shqiptar.)

Një letërsi e naltë (*highbrow literature*, po të përdorim një term anglez), një letërsi autentike është shkruar në Shqipëri, në gjysmën e parë, siç është krijuar një letërsi e tillë në Shqipëri, por edhe në Kosovë, edhe në gjysmën e dytë të shekullit XX, si nevojë e brendshme letrare dhe rezistencë ndaj normës zyrtare. Kjo ka qenë domosdo letërsi elitare. Një letërsi e ultë (*middlebrow literature*, sërish me një term anglez), letërsi e dobët e në shërbim, është shkruar përgjatë gjithë shekullit, dhe ka mbizotëruar prodhimin letrar, sidomos në epokën e realizmit socialist në Shqipëri.

Instalimi i realizmit socialist si doktrinë e praktikë e letërsisë

Kur dhe pse është instaluar realizmi socialist në Bashkimin Sovjetik dhe në Shqipëri? Çka është në të vërtetë *realizmi socialist*? Termi është farkuar nga Maksim Gorki dhe Andrej Zhdanovi, në konsultim me Stalinin. Diktatori Stalin i kishte quajtur shkrimtarët "inxhinierë të shpirtrave njerëzorë", ndërsa në Kongresin e Shkrimtarëve Sovjetikë të vitit 1934, komisari i tij për kulturë, Zhdanov, shpalosi doktrinën e 'realizmit socialist', që kërkonte prej letërsisë të dëftonte realitetin jo si realitet objektiv, por 'realitetin në zhvillimin e tij revolucionar', duke i shtuar kësaj edhe funksionin edukativ në frymën e socializmit. "Këtë metodë në *belles lettres* dhe në kritikën letrare e quajmë metodë të realizmit socialist", shprehej Zhdanovi. Në interpretimin zyrtar sovjetik, realizmi socialist ka qenë një zhvillim historik, në kapërcyell të shekujve XIX dhe XX, që ka shënuar ashpërsimin e kontradiktave brenda shoqërisë kapitaliste, krizën në kulturën borgjeze dhe ngritjen e vetëdijes së proletariatit. Është prandaj, një pasqyrim në art i luftës për fitoren e socializmit.[1] Burimet e metodës janë parë te kritika letrare ruse e shekullit XIX (Belinski, me teorinë e tij për letërsinë në shërbim të shoqërisë, u bë pararendës i hershëm i soc-realizmit, por edhe Çernishevski e ndonjë tjetër), shkrimi i Leninit i vitit 1905 ("Mbi organizimin partiak dhe letërsinë partiake"), si dhe te debatet letraro-teoriko-politike të 15 viteve të para të pushtetit sovjetik. Është kjo koha kur formalizmi, si metodë e studimit letrar, që kishte lindur në dekadën e dytë të shekullit, dhe predikonte autonominë e letërsisë, letërsinë si të tillë, po hidhej poshtë si metodë shterpe!

Metoda themelore e letërsisë sovjetike dhe e kritikës letrare është instaluar me ashpërsi të madhe në Shqipëri nga fundi i viteve 1940. Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë qe bërë, sikurse edhe modeli i saj sovjetik, jo mbrojtëse e shkrimtarëve por polici e tyre. Prodhimi letrar iu nënshtrua kontrollit të kësaj policie, nëpërmjet një departamenti akademik që mundi me vrâ e me kthjellë. Në rastin e Shqipërisë në krye të saj ishte Dhimitër Shuteriqi, kryetari jetëgjatë i Lidhjes së Shkrimtarëve, autori i njërit prej romaneve të parë soc-realistë (*Çlirimtarët*, 1952, 1955), autori kryesor i historive zyrtare të letërsisë shqipe (1959-60 dhe 1983) në Tiranë.

Një histori e lindjes së doktrinës së realizmit socialist

Letërsia dhe studimi për letërsinë në Shqipëri u bënë mbi modelin sovjetik. Kjo bëhet më e dukshme për shumëkushin tash, nga perspektiva e shekullit XXI, ndonëse, që t'ua njohim meritën, e kishin vënë në pah studiuesit letrarë nga Kosova, dhe ndonjë nga diaspora shqiptare, në tri dekadat e mbrama të shekullit të kaluar.

[1] Neil Cornwell, "(Soviet) Socialist Realism (1932-1991)", në "The Literary Encyclopedia", enciklopedi letrare online: www.litencyc.com.

Arshi Pipa, shkrimtari e kritiku shqiptar që veproi në Shqipëri në vitet 1940, para se të burgosej për 10 vjet për agjitacion e propagandë 'armiqësore' nga regjimi i Hoxhës, shkroi në vitin 1991 një histori të shkëlqyeshme të ngritjes së doktrinës së realizmit socialist në Bashkimin Sovjetik dhe në Shqipëri. Kjo histori gjendet në kapitujt e parë të veprës së tij *Letërsia bashkëkohore shqiptare* (*Contemporary Albanian Literature*), që e botoi në SHBA.[2] Vepra përfaqësuese në anglisht për realizmin socialist sovjetik kanë botuar studiuesit anglo-amerikanë S. V. Xhejms (C. Vaughan James, 1925-2009) dhe Katerina Kllark (Katerina Clark),[3] të cilëve u detyrohet autori i këtij shkrimi për kuptimin e tij burimor të doktrinës dhe të praktikës së realizmit socialist, të modelit sovjetik që e vuri në zbatim establishment politiko-letrar i Shqipërisë komuniste për gjysmë shekulli.

Historia politiko-letrare shqiptare e gjysmës së dytë të shekullit XX

Cila është historia politiko-letrare shqiptare e këtij gjysmë-shekulli, siç del nga Arshi Pipa dhe nga të dy historitë kryesore zyrtare të letërsisë shqipe, *Historia e letërsisë shqiptare e realizmit socialist (*1978) me kryeredaktor Koço Bihikun, *dhe Historia e letërsisë shqiptare* (1983) me kryeredaktor Dhimitër Shuteriqin, botuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë?[4]

Arshi Pipa e sheh me të drejtë pararendës të realizmit socialist shqiptar jo Migjenin po Fan Nolin (autor të introduktave për veprat që kishte përkthyer, *Don Kishotin*, *Hamletin*, *Makbethin*, *Othellon*, *Armiku i popullit,* etj.), të cilit i jep merita edhe establishmenti letrar komunist.[5] Esetë (introduktat) e Nolit për veprat janë analiza politike, dhe jo letrare (gjuha, stili nuk diskutohen; meritat letrare përmenden kalimthi, ose hiç). Perspektivizimi shqiptar i një vepre të huaj është më eklatanti te introdukta

[2] Arshi Pipa, *Contemporary Albanian Literature*, East European Monographs, Boulder, distributed by Columbia University Press, New York, 1991.

[3] C. Vaughan James, *Soviet Socialist Realism: Origins and Theory*, Palgrave, Macmillan, London, 1973. Libri përmban në anekse tekstet kryesore, burime të doktrinës së realizmit socialist. Libri tjetër, nga Katerina Clark, *The Soviet Novel: History as Ritual*, University of Chicago Press, 1981, është studim për romanin, zhanrin dominant të praktikës së realizmit socialist.

[4] *Historia e letërsisë shqiptare e realizmit socialist*, kryeredaktor Koço Bihiku, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1978. *Historia e letërsisë shqiptare,* kryeredaktor Dhimitër Shuteriqi, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1983; poashtu, ribotim, *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1989.

[5] "Konceptin materialist mbi burimin dhe rolin e letërsisë në dobi të lirisë, pavarësisë dhe demokracisë për popullin shqiptar, në kundërshtim me konceptin idealist të klerit dhe të estetëve borgjezë, e përvijoi F. S. Noli dhe e zhvilluan më tej përfaqësuesit e brezit të viteve 30, Migjeni, Bulka, Shuteriqi, etj." *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1989, ff. 587-88.

për *Don Kishotin*.[6] Sekretari i dikurshëm i Nolit, Sejfullah Malëshova (për krijimtarinë e të cilin thuhet se Gorki foli me dashamirësi në Kongresin e Parë të Shkrimtarëve Sovjetikë më 1934), ishte fillimisht kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, para se të hiqej më 1946. Falë tij, letërsia shqipe mundi të ligjërohej pa eliminuar shkrimtarët e mëdhenj si Fishta vetëm për një vjet mbas lufte (1945-46). Për 45 vitet e ardhshme, Fishta, Konica, por edhe shkrimtarë të tjerë, jo që nuk u mësuan, por u denigruan, madje edhe prej shkrimtarëve në zë në atë kohë në Shqipëri. Kjo e bëri të vështirë mësimin e tyre edhe në Kosovë dhe gjetiu në ish-Jugosllavi për disa dekada. Arshi Pipa dhe Mitrush Kuteli ishin dy jokomunistët e vetëm në redaksinë e *Botës së re*, organit të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, që mbajti kongresin e parë në tetor të vitit 1945. Ndër 100 pjesëmarrësit e Kongresit shumica ishin jokomunistë. Kuteli e Pipa u burgosën për së shpejti, ndërsa të tjerë, si Dom Ndoc Nikaj e Imzot Prenushi, u ekzekutuan. Shkrimtari më i madh i gjallë në atë kohë, Lasgush Poradeci, u mënjanua në lagjen e përkthyesve letrarë, e cila u bë padashtas streha e vetme letrare për jopraktikuesit e realizmit socialist dhe në njëfarë mënyre çerdhe e refuzimit estetik të tij. Kështu u hap rruga për mbizotërim të Dhimitër Shuteriqit, Fatmir Gjatës, Sterjo Spasses (të reformuar prej nihilistit të viteve tridhjetë) para se të shfaqeshin në fund të viteve pesëdhjetë penat e reja si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, e të tjerë. Kjo treshe e fundit u bë dalëngadalë, në vitet 1960, establishmenti i ri letrar shqiptar. Në këtë kohë flitej për tendenca novatore. Novatorizmi i pandehur duket më shumë si përpjekje për të validuar metodën e realizmit socialist në zhvillim sesa sprovë për kundërshtimin e saj.[7] Ismail Kadare, shkrimtari më i madh i periudhës, ia ka dalë të

[6] Kështu shkruan Noli në "Introduktën" e tij (te Servantes, *Don Kishoti*, shqipëroi Fan. S Noli, Onufri, Tiranë, 2014, f. 6): "Vepra e tij (*Don Kishoti* i Servantesit, MH), pra, ishte doemos revolucionare, se për të diskredituar librat e kalorësisë duhej të diskreditonte tërë Kohën e Mesme me të gjitha përrallat e saj. Për këtë qëllim, Servantesi zgjodhi si heronj të veprës së tij dy nga tipat më reaksionarë dhe medieval, që kishte e që kemi akoma përpara sysh: bejlurçinën, sojliun e fandakosur të katundit, Don Kishotin e Mançës, dhe laron, sejmenin, fshatarin e varfër e të paditur, Sanço Pançën." Dhe më tej, në f. 8: "Në Shqipëri kjo vepër do të kuptohet më mirë se kudo gjetkë. Se atje tipat e bejlurçinës dhe laros i gjejmë në çdo hap. Të gjithë aristokratët tanë, me ca përjashtime të paka, janë të deklasuar pa bazë ekonomike, dhe kanë rënë në klasën e bejlurçinave, që kur u këput Shqipëria prej Turqisë." Shqipërimi i pjesës së parë të *Don Kishotit* nga Noli është më shumë adaptim sesa përkthim. Edhe interpretimet e Nolit për *Jul Cezarin* dhe *Armikun e popullit* janë thellësisht politike/ideologjike, qëllimore për ambientin dhe kohën në Shqipëri.

[7] Te libri i tij *Kah dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës më 1986, Dr. Ibrahim Rugova shkruan për polemikën ndërmjet disa poetëve e kritikëve për novatorizmin e mëtuar në Shqipëri në fund të viteve të pesëdhjeta deri në mes të viteve të gjashtëdhjeta, protagonistë kryesorë të të cilës janë poetët Ismail Kadare, Dritëro Agolli dhe Fatos Arapi, ndërsa kritik Drago Siliqi. Kritiku e teoriku i njohur i letërsisë nga Kosova shesh shenja të novatorizmit, siç sheh edhe Arshi Pipa te libri i tij *Contemporary Albanian Literature* (*Letërsia bashkëkohore shqiptare*) i vitit 1991. Nga perspektiva e sotme, shenjat duken të sforcuara, por të shpjegueshme ndoshta nga malli i studiuesve të njohur Rugova e

krijojë vepra që në rrafsh stilistik e tematik e kanë sfiduar normën e letërsisë së ultë të realizmit socialist dhe janë bërë letërsi e naltë, me moduse letrare realiste e fantastike. Mirëpo, situatën e ndërliqshme të Kadaresë e dëshmon fakti se ka dy variante të romaneve të tij, *Gjeneralit të ushtrisë së vdekur* në vitet gjashtëdhjetë,[8] dhe *Dimrit të madh* në vitet shtatëdhjetë,[9] pa përmendur ndërhyrjet në veprat e tjera, ose pezullimet e përkohshme të tyre. Natyrisht, pa lënë anash edhe poezinë e tij të fillimeve dhe ndonjë vepër në prozë (si *Dasma*), që ishin ekzemplarë të realizmit socialist.[10] Pa përmendur edhe shkrimet e tij në mbrojtje të dogmës soc-realiste.

Lidhjet letrare shqiptare Kosovë-Shqipëri

Lidhjet letrare shqiptare Kosovë-Shqipëri morën hov në fillim të viteve shtatëdhjetë. Ismail Kadare, Petro Marko, Ali Abdihoxha, Jakov Xoxa e ndonjë tjetër u botuan në Prishtinë. Është koha kur një gjeneratë shkrimtarësh, poetësh, prozatorësh e kritikësh letrarë (Anton Pashku, Rexhep Qosja, Ali Aliu, Ali Podrimja, Ibrahim Rugova, Rexhep Ismajli, Mensur Raifi, Sabri Hamiti, Zejnullah Rrahmani) krijuan në Kosovë një letërsi dhe letërsi për letërsinë që rivendosi lidhjet me letërsinë klasike shqipe dhe letërsinë perëndimore. Një kohë kur Anton Pashku me disa shkrimtarë të rinj, më 1971, me shkrimin "Vox clamantis in deserto" kundërshtuan

Pipa për të parë ndryshime potenciale që do të sfidonin një ditë realizmin socialist, të shenjtëruar në Shqipëri.

[8] *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist* (1978) në ff. 289-90 jep këtë dëshmi dhe interpretim; "Në variantin e parë (të romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1964) ideja e qëndresës heroike të popullit shqiptar qëndronte si mënjanë, e shtyrë nga vendi i madh që iu dha gjeneralit të ushtrisë armike. Kuptimi abstrakt i armikut si 'qenie njerëzore' që në rrethana të caktuara bëhet i arsyeshëm, kishte çuar padashur në idenë se armiku mund të ndryshojë thelbin e tij. Kritika e kohës vuri në dukje se kthesa e gjeneralit pas disa muajve të qëndrimit të tij në Shqipëri dhe shndërrimi i tij nga një përfaqësues i një ushtrie imperialiste agresive në një njeri që merr anën e popujve të vegjël, viktima të agresionit imperialist, dhe që nisë të kuptojë luftën e tyre të drejtë për mbrojtjen e lirisë, ishin të pamotivuara si nga ana shoqërore, ashtu edhe nga ana psikologjike. Në variantin e ri, të ripunuar të romanit, që u botua në vitin 1967, autori e konceptoi ndryshe karakterin e gjeneralit dhe vuri në qendër të veprës konfliktin midis tij dhe popullit shqiptar, duke mënjanuar kështu konfliktin gjeneral-prift që në variantin e parë shërbente si konflikt themelor për të shpënë përpara veprimin."

[9] Romani *Dimri i madh* (1977) ishte varianti i ripunuar i romanit *Dimri i vetmisë së madhe* (1973). Edhe për këtë histori të ndërhyrjes në vepër jep variantin e vet *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist* (në ff. 387-388).

[10] Për çudi, te libri i tij *Contemporary Albanian Literature* Arshi Pipa ndonëse e quan roman të dobët, ndoshta as roman, *Dasmën* e Kadaresë e përkufizon si "manifest shqiptar të anti-realizmit socialist" (Pipa, f. 54). Është e vërtetë që *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist* (1978) nuk e përmend *Dasmën*, por kjo nuk e kualifikon si anti-realist-socialiste. Studiuesi Rexhep Qosja e kishte klasifikuar që herët si vepër ilustrative të realizmit socialist shqiptar.

realizmin socialist si metodë e praktikë letrare.[11] Më fuqishëm kjo u kontestua me veprat e botuara letrare gjinish të ndryshme, në kundërshtim me praktikën e doktrinën e realizmit socialist. Një establishment i ri letrar e kulturor në Kosovë afirmoi idenë e një letërsie nacionale të pandashme, që njihte pararendësit dhe krijonte vetë në një *agon* (garë, luftë) me jo-organiken, edhepse nuk e quante kështu, siç ishte krijimtaria e dogmës realist-socialiste. Studimi dhe botimi sistematik i autorëve të traditës, duke përfshirë edhe kritikën letrare (kemi parasysh veprën e Ibrahim Rugovës dhe Sabri Hamitit, *Kritika letrare*, botuar më 1979, një krestomaci e mendimit kritik shqiptar, që përfshinte edhe Konicën, Malokin, e të proskribuar të tjerë) rivendosën gradualisht një baraspeshë të re të vlerave letrare e teoriko-kritike shqiptare.

Ndërsa në Shqipëri damkosej letërsia moderne e moderniste, si dekadente, pesimiste, anti-njerëzore, në Kosovë kjo letërsi nisi edhe të përkthehej (Xhojsi, Prusti, Kafka, Beketi). Ismail Kadare kishte mbajtur një kurs special për letërsinë dekadente në Universitetin e Tiranës në vitin 1970.[12]

Kush është tjetri/cila është tjetra në letërsinë shqipe të shekullit XX? Vepra e Fishtës *Lahuta e Malcís*, epi më i madh shqiptar, u denigrua nga Shuteriqi me shokë me pandehma se ishte antikombëtare, raciste, anti-sllave. Por një shkrimtar jokomunist, Arshi Pipa, gjatë kohës sa vuante në kampet komuniste të Shqipërisë, shkroi një poemë narrative, "Rusha", për dashurinë e një shqiptareje me një serb (Rushës me Melisdravin) në Kosovë në fund të shekullit XIV. Italianë, rusë e kinezë e të tjerë ka në letërsinë e Kadaresë. Jo prej shqiptarëve, si Fishta, po prej të huajve, Kadare është akuzuar ndonjëherë si racist. Tjetri në një pjesë të letërsisë soc-realiste është kundërshtari ideologjik (ballisti, antikomunisti), si te Agolli, por edhe te Azem Shkreli (*Karvani i bardhë*, 1961). Në letërsinë shqipe të Kosovës ke edhe serbë, të mirë e të këqij, te letërsia socialiste e Hivzi Sulejmanit. Tjetri i dashur në letërsinë e Kosovës është edhe Tito, në poezitë e shumë poetëve të njohur e të panjohur. Tjetri i dashur dhe i dhembshur është kosovari në romanin *Lumi i vdekur* të Jakov Xoxës. Tjetra është letërsia e Kosovës, e cila është shpërnjohur në Shqipëri, madje është denigruar me të madhe deri vonë, edhe pas rënies së komunizmit, nga pozita të pashpallura ideologjike

[11] Sigurimi i Shqipërisë dëshmonte në një raport nga viti 1973, mbështetur në bisedat e Andrea Varfit me shkrimtarë në Kosovë, se s'kishte shpresë që Anton Pashku të "hiqte dorë nga rruga e tij". Më tej në këtë raport: "Shoku Andrea ka marrë vesh se njërën nga veprat moderniste të Anton Pashkut [romanin *Oh*, MH]e ka ngritur shumë lart organi fashist i Ernest Koliqit "Shejzat",..."Shih më tej linkun: http://shqiptarja.com/dossier/2711/-bisedoi-n--maj-73-andrea-varfi-me-anton-pashkun-e-rexhep-ismailin--373079.html

[12] Studiuesja dhe shkrimtarja Feride Papleka ka kujtuar së voni, më 2016, këto leksione në një intervistë të botuar, por pa dhënë detaje për kursin dhe pozicionim e Kadaresë ndaj letërsisë moderniste e dekadente, e cila në shkrimet e tij deri më 1990 del kudo e poshtëruar. Intervista e Paplekës, "Kadare pedagog, i mahnitshëm! Si 'shpiku' letërsinë borgjeze", gjendet këtu: http://www.gazetaexpress.com/arte/kadare-pedagog-i-mahnitshem-si-shpiku-letersine-borgjeze-165301/

real-socialiste, të kamufluara si kombëtare; letërsia e Kosovës, me të cilën Arshi Pipa thotë se s'ka dashur të merret mbasi kosovarët përqafuan gjuhën letrare (standarde) që e imponoi regjimi stalinist i Hoxhës në vitin 1972. Pyetja që s'ke si të mos e bësh është: pse u mor ai me letërsinë e Shqipërisë që përqafoi po këtë gjuhë dhe madje në shumicë përqafoi doktrinën e realizmit socialist? Ka paradokse këtu.

Ajo që ishte vetja për letërsinë e naltë, autentike (tradita, vlerat identitare shqiptare, lidhjet me gjirin kulturor perëndimor, letërsia si e tillë, autonome dhe joqëllimore) bëhej shpesh tjetra (konservatorja, e huaja, armiqësorja) për letërsinë e ultë, të realizmit socialist. Prirjet letrare moderne e moderniste që shfaqen në letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit, ndonjëherë me afërsi të madhe kohore me zhvillimet zanafillore në letërsitë e tjera, bëhen tjetra, e luftueshmja, për letërsinë e ultë, mbizotëruese dhe të kanonizuar nga pushteti komunist dhe policia letrare. Kujtojmë akuzat për poezinë hermetike shqipe të Kosovës, mospëlqimet e romanit *Oh* të Anton Pashkut, nga ajo dorë njerëzish që kishin rënë në pellgun realist-socialist të Shqipërisë, në deponinë e miteve shtetërore-ideologjike, që i panë ato të parat si rravgime (*aberration*) të letërsisë kombëtare.

Agoni (gara, lufta) për supremaci estetike në mes të letërsisë së naltë dhe të ultë ka qenë e pandalshme, pa bujë. Kritika e letërsisë ka marrë pjesë në këtë *agon*.

Përkthimet letrare – si kundërshtim dhe afirmim i letërsisë së realizmit socialist

Në gjysmën e dytë të shekullit XX, proklamimi i realizmit socialist si doktrinë e praktikë e letërsisë dhe e studimit të saj ka diktuar llojin e letërsisë botërore që është përkthyer shqip. Janë përkthyer vepra përfaqësuese të realizmit kritik dhe shoqëror që nuk kanë rënë ndesh me doktrinën, por edhe vepra klasike të moçme, si *Iliada* e *Odiseja*, *Eneida*, *Komedia hyjnore*, *Parasja e humbur*, *Fausti*, që s'kanë mundur të jenë në shërbim të saj. Në një mënyrë këto vepra janë bërë në të vërtetë kundërhelm ndaj realizmit socialist shqiptar. Lavdi, si refuzues estetikë të realizmit socialist, u takon Lasgush Poradecit, Pashko Gjeçit, Gjon Shllakut, Skënder Luarasit, Alqi Kristos, e ndonjë përkthyesi tjetër. Në Kosovë, siç u përmend, janë përkthyer, qoftë nga origjinali, qoftë nëpërmjet serbokroatishtes, shkrimtarë klasikë e modernë (Dostojevski, Xhojsi, Fokneri, Kafka, Bullgakovi, Beketi) që soc-realizmi shqiptar i ka poshtëruar me gjuhën më të egër të doktrinës sovjetike. Përkthimet e studimeve teoriko-kritike për letërsinë në Prishtinë, në vitet shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë, kanë qenë një tjetër kundërhelm ndaj "shkencës letrare" ideologjike që prodhonte Tirana.

Muhamet HAMITI

20TH CENTURY ALBANIAN LITERATURE REFRACTED THROUGH ITSELF AND THE OTHER

Abstract

Twentieth-century Albanian literature was produced in a flux of refractions with its own self and the Other. The specificity of our literature lies in the nature and kinds of these refractions which are bound by internal and external laws, but also literary and political exigencies.

The pre-modern (late Romantic) and modern Albanian literature of the first half of the century as well as the Socialist Realist and modern and modernist literature of the second half of the century was accompanied by the literary criticism, the non-fiction literature, which varied in its range of originality as much as fiction did.

The Albanian literature of the twentieth century - which sounds like our century for people as old as the author of this paper - was refracted through the *national* and the *political*. In extremis, the politicization of literature and the politicization of literary scholarship occurred in the half-century of Socialist Realist literature in Albania, of Socialist Realism as a quasi-literary method and vehicle for control of the minds and hearts of Albanians in dictator Enver Hoxha's Albania. Kosovo, under Yugoslav dictator Tito, was not spared entirely of this calamity either, although it emerged less scathed from it due to a different political environment.

A high literature, an authentic literature, was produced in Albania in the first half of the century, as was the case also in both Albania and Kosovo in the second half of the century. A low literature, either poor or in the service to power, was written throughout the century, especially during the era of Socialist Realism in Albania, when literature as such and literary scholarship aped the Soviet variant, an unprecedented plagiarism which had become the policy of the Marxist-Leninist establishment, both of its commissars and its academic cabal. This is more evident for many now in hindsight, from the perspective of the 21st century, although, to their credit, the Albanian scholars from Kosovo and the Diaspora had exposed it in the last three decades of the century.

Who is the Other in and of the 20th century Albanian literature? How does it affect the literature in its own right and the literature of the second degree, literary criticism? What was the Self for authentic, high literature (tradition, values of Albanian identity, bearings with(in) the Western cultural milieu) materialized often as the Other (the conservative, the alien, the hostile) for the low literature of Socialist Realism. Modern and modernist literary tendencies which emerged in the literature of the second half of the century, sometimes in close quarters time-wise with original

developments elsewhere, became the Other, the assailable, for the prevailing low literature canonized by the Communist regime. The ubiquitous range and influence of this literature is evidenced by a mediocre literature which submitted itself unwittingly to it.

The *agon* (struggle) for aesthetic supremacy between high and low literature was incessant. Literary criticism was a participant and arbiter in this *agon*.

Key words: Albanian literature of the 20th century; the Other; high literature, low literature, Socialist Realism, literary criticism

Edmond ÇALI

TJETRI NË LETRAT SHQIPTARE TË REALIZMIT SOCIALIST: LETËRSIA E UDHËTIMIT, POEZIA E ANGAZHUAR DHE KRITIKA E ANGAZHUAR. RASTI I ISMAIL KADARESË DHE GENT ARBANËS *MOTIVE ME DIELL* (1968), *LINJA TË LARGËTA. SHËNIME UDHËTIMI* (1971) DHE SHKRIMET ME PSEUDONIM NË GAZETËN "DRITA" (1973-1987)

A. Në punim shqyrtojmë poezitë "Vietnam", "Bateritë kundër ajrore" dhe "Ullinjtë shqiptarë në Vietnam" nga *Motive me diell*[1] dhe kapitullin "Nën qiellin e Vietnamit" nga libri *Linja të largëta. Shënime udhëtimi*[2]. Nga shkrimet e Kadaresë të botuara me emrin Gent Arbana veçojmë disa prej tyre të botuara në gazetën *Drita*[3].

[1] KADARE 1968, Ismail Kadare, *Motive me diell,* vjersha dhe poema, Tiranë, Shtëpia botonjëse "Naim Frashëri", 1968, ff. 168, ff. 31, 32-33, 90-91.

[2] KADARE 1971, Ismail Kadare, *Linja të largëta. Shënime udhëtime,* Shtëpia botuese 'Naim Frashëri, Tiranë, 1971, ff. 11, ff. 20-63.

[3] ARBANA 1973 a Gent Arbana, "Flirti me SHBA në poezinë e sotme sovjetike", *Drita*, Tiranë 22 korrik 1973; ARBANA 1973b Gent Arbana, "Biznesi në prodhimin letrar", *Drita*, Tiranë 29 korrik 1973, f. 15; ARBANA 1973c Gent Arbana, "Marifetet poetike të Voznjesenskit", *Drita,* Tiranë 19 gusht 1973, f. 14; ARBANA 1973d Gent Arbana, "Komercializmi në botimet letrare", *Drita*, Tiranë 2 dhjetor 1973, ff. 15-16; ARBANA 1974 a Gent Arbana, "Foto-romani", një formë tjetër e degjenerimit të artit, *Drita*, Tiranë 13 janar 1974, f. 15; ARBANA 1974b Gent Arbana, "Farsa Sollzhenicin", *Drita*, Tiranë 31 mars 1974, f. 15; ARBANA 1974c Gent Arbana, "Demagogjia – normë e revizionistëve", *Drita,* Tiranë 13 tetor 1974, f. 15; ARBANA 1976 a Gent Arbana, "Prepotencë e shovinizmit", *Drita*, Tiranë 8 gusht 1976, f. 16; ARBANA 1976b Gent Arbana, "Krushqitë midis borgjezëve dhe revizionistëve", *Drita*, Tiranë, 19 dhjetor 1976, f. 16; ARBANA 1977 a Gent Arbana, "Revizionistët dhe portreti i një antikombëtari", *Drita*, 16 janar 1977, f. 14 dhe f. 15; ARBANA 1977b Gent Arbana, "Fytyra e shovinizmit", *Drita,* Tiranë, 17 prill 1977, f. 16; ARBANA 1977c Gent Arbana, "Pohime te hidhura", *Drita*, Tiranë 9 tetor 1977, f. 16; ARBANA 1977d Gent Arbana, "Nivel i mjerueshëm artistik. Arti në vendet borgjezo-revizioniste", *Drita,* Tiranë 4 dhjetor 1977, f. 16; ARBANA 1982 a Gent Arbana, "Kundrakultura dukuri e sotme botës perëndimore", *Drita,* Tiranë 16 maj 1982, f. 14; ARBANA 1982b Gent Arbana, "Skandalet, pjesë përbërëse e jetës letrare-artistike", *Drita,* Tiranë 6 qershor 1982, f. 15; ARBANA 1982c Gent Arbana, Edhe burgimi kthehet në reklamë", *Drita*, Tiranë 4 korrik 1982, f. 15; ARBANA 1982d Gent Arbana, "Eksperimente të dështuara të letërsisë e artit borgjez. Në kërkim të mistikes", *Drita,* Tiranë 26 dhjetor 1982, ff. 14 dhe 16; ARBANA 1983 a Gent Arbana, ""Të mallkuarit' e letërsisë dhe të arteve", *Drita,* Tiranë 13 shkurt 1983, f. 16; ARBANA 1983b Gent Arbana, "Degradim me përmasa të mëdha", *Drita*, Tiranë 24 korrik 1983, f. 14 dhe f. 15;

Kadare boton me emrin Gent Arbana edhe në gazetën *Zëri i Popullit,* organ i Komitetit Qendror të PPSh-së[4], në revistën *Les lettres albanaises*[5], organ tremujor letrar dhe artistik i botuar nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë në frëngjishte dhe në revistën politike satiro-humoristike *Hosteni*[6].

Shqyrtojmë praninë e tjetrit në një pjesë të veprës së Ismail Kadaresë dhe duam të nënvizojmë dy çështje:

1. nevojën e leximit/studimit/futjes në sistemin letrar të Ismail Kadaresë të të gjithë veprës së tij dhe

2. domosdoshmërinë e një botimi kritik të mbështetur në kritere shkencore të gjithë veprës së Ismail Kadaresë; të pjesës së botuar, të asaj që është ribotuar, të botimeve të dorëshkrimeve të veprave të botuara e të pabotuara.

ARBANA 1983c Gent Arbana, "Rikthime te kulti i vdekjes", *Drita*, Tiranë 6 nëntor 1983, f. 16; ARBANA 1984 a Gent Arbana, "Një duel i gënjeshtërt. Mbi 'konkurencën' midis letërsisë imorale dhe moralizuese në Perëndim", *Drita,* Tiranë 4 mars 1984, ff. 14-15; ARBANA 1984b Gent Arbana, "Lufta e kanaleve televizive", *Drita*, Tiranë 1 prill 1984, f. 15; ARBANA 1984c Gent Arbana, "Dukuri tipike në letërsinë e sotme revizioniste", *Drita*, Tiranë 16 dhjetor 1984, ff. 14-15; ARBANA 1985 a Gent Arbana, "Kthim i palavdishëm", *Drita,* Tiranë 17 shkurt 1985, f. 14 dhe f. 16; ARBANA 1985b Gent Arbana, "Çfarë kujtohet dhe çfarë harrohet prej kritikës borgjeze", *Drita,* Tiranë, 30 qershor 1985, f. 14 dhe f. 15; ARBANA 1985c Gent Arbana, "Personazhe të çuditshëm", *Drita,* Tiranë 20 tetor 1985, f. 16; ARBANA 1986 a Gent Arbana, "Një aksion kriminal në kulturë", *Drita*, Tiranë 6 korrik 1986, f. 16; ARBANA 1986b Gent Arbana, "Ringjallja e Sadit", *Drita,* Tiranë 28 shtator 1986, f. 16; ARBANA 1986c Gent Arbana, "Aksion falsifikatorësh", *Drita,* Tiranë 19 tetor 1986, f. 16; ARBANA 1987 Gent Arbana, "Margaret Jursenar", *Drita*, Tiranë 27 dhjetor 1987, f. 15.

[4] ARBANA 1984d Gent Arbana, Arti dhe politika - "Një zhgënjim i hidhur", *Zëri i popullit*, Tiranë, 10 mars 1984, f. 4; ARBANA 1984e Gent Arbana, Arti dhe politika – "Toleranca e 'intolerantëve'", *Zëri i popullit*, Tiranë 31 mars 1984, f. 4; ARBANA 1984f Gent Arbana, "Profecitë kundër librit", *Zëri i popullit*, Tiranë, 28 prill 1984, f. 4; ARBANA 1984g Gent Arbana, Arti dhe politika, – "Në botën e spekullimeve", *Zëri i popullit,* Tiranë 26 maj 1984, f. 4; ARBANA 1986d Gent Arbana, "Biseda të stilit mesjetar", Pamflet, *Zëri i popullit*, Tiranë 19 janar 1986, f. 3.

[5] ARBANA 1980 a Gent Arbana, "Le réalisme socialiste, grand art de la révolution", *Les lettres albanaises,* 1, 1980, Tirana, ff. 179-184; ARBANA 1980b Gent Arbana, "Naim Frashëri et les promoteurs de la Renaissance Nationale Albanaise", *Les lettres albanaises*, 3, 1980, Tirana, ff. 226-239; ARBANA 1981 Gent Arbana, "Reportage – L'usine qui se rattache au pain", *Les lettres albanaises,* 3, 1981, Tirana, ff. 154-167.

[6] ARBANA 1974d Gent Arbana, "Brezhnjeviada (Poemë)", *Hosteni*, Tiranë, 26 dhjetor 1974, f. 8; ARBANA 1975 a Gent Arbana, "'Epopeja' e pushtimit të Çekosllovakisë", *Hosteni*, nr. 15, Tiranë, 12 gusht 1975, f. 11; ARBANA 1975b Gent Arbana, "Maks Miksi në Bashkimin Sovjetik", *Hosteni*, nr. 16, Tiranë, 26 gusht 1975, f. 20 dhe f. 21; ARBANA 1976c Gent Arbana, "Hanko Selimeja dhe Musabelliu... Në ditët e projektkushtetutës së re", *Hosteni*, nr. 5, Tiranë, 12 mars 1976, f. 10; ARBANA 1976d Gent Arbana, "O, ky dikaster!...."; "Nga na vjen ti, vallë?"; "Prepotenti"; "Jam burokrat"; "Dosjet do t'marr"; "Selimi"; "Mall"; "Idil", *Hosteni*, nr. 9, Tiranë, 12 maj 1976, f. 7; ARBANA 1977e Gent Arbana, "Doktoratat", poemë, *Hosteni*, nr. 3, Tiranë, 12 shkurt 1977, f. 10.

B. Paraqesim tri poezi të vëllimit *Motive me diell* që kanë lidhje me Vietnamin sepse nga kjo temë e pranishme e kohës kemi praninë e Tjetrit në letërsi. Kujtojmë se në gjysmën e dytë të viteve Gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar Ismail Kadare shkon në Kinë dhe në Vietnam me një delegacion[7].

Dy prej poezive, "Vietnam"[8] dhe "Bateritë kundër ajrore"[9] janë shkruar në vitin 1965 kurse tjetra, "Ullinjtë shqiptarë në Vietnam"[10] është shkruar në vitin 1968. Dy të parat i kushtohen Vietnamit nga një shkrimtar shqiptar i realizmit socialist, kurse e treta i kushtohet miqësisë midis Shqipërisë dhe Vietnamit. Poezia e parë, "Vietnam", i kushtohet heroizmit të Vietnamit. Kjo gjë theksohet me përsëritjen e vargjeve 1-2 (Nga ç'epos heroik dole kështu papritur /Me flokët orizorë të djegur me napalm) dhe 12-13 (Nga ç'epos heroik dole kështu papritur / Flokëdjeguri me napalm?). Poezia na kujton ndarjen e Vietnamit, në Vietnam të Veriut dhe në Vietnam të Jugut (vargjet 3-4: Gjysëm i lirë, / Gjysëm i lidhur,) dhe luftën që zhvillohet në Vietnam (vargu 2: Me flokët orizorë të djegur me napalm; vargu 6: Si ushtar, duke u zvarritur mbi globin; vargjet 8-9: Dhe pjatat me oriz mbi tavolina / Befas na u dukën si me bomba; vargu 13: Flokëdjeguri me napalm?). Poezia "Bateritë kundër ajrore" ka rëndësi për përsëritjen në veprën letrare sepse ka një temë të cilën e gjejmë edhe në shkrimin në prozë "Nën qiellin e Vietnamit". Në këto dy poezi Tjetri është Vietnami dhe populli i tij heroik.

C. Libri *Linja të largëta* është një tekst i veçantë në botimet e Ismail Kadaresë dhe ne na intereson për disa arsye në shqyrtimin e strukturës së sistemit letrar të veprës së tij. E para, sepse është një tekst që i përket një gjinie shkrimi jo shumë të kultivuar në veprën e tij. E dyta, sepse është një nga tekstet e pakta në prozë që i përket realizmit socialist. E treta, sepse përmban një dozë liberalizmi në formë (letërsia e udhëtimit) dhe flet për tema jo socialiste dhe për vende jo socialiste ("Një verë në Finlandë" për festivalin ndërkombëtar të rinisë; "Një botë në rënie" për SHBA,

[7] Për këtë shiko Helena Kadare, *Kohë e pamjaftueshme*, Tiranë, Onufri, 2011, ff. 189-192.

[8] "Vietnam" - Nga ç'epos heroik dole kështu papritur / Me flokët orizorë të djegur me napalm / Gjysëm i lirë, / Gjysëm i lidhur,/Si një centaur i ri, Vietnam. //Si ushtar, duke u zvarritur mbi globin, / Hyre papritur në shtëpitë tona, / Dhe pjatat me oriz mbi tavolina / Befas na u dukën si me bomba.// Na priste në jetë një dashuri tjetër: / Dashuria për ty, Vietnam. / Nga ç'epos heroik dole kështu papritur / Flokëdjeguri me napalm? // 1965.

[9] "Bateritë kundër ajrore" - Pranë palmave, bombave, orizoreve, / Mbi tokën e zhuritur vietnameze, / Ngriheni ju, bateri kundër ajrore, / Me tytat e viaskura të zeza. // Viaskat tuaja janë rrudhat e popullit tuaj, / Hendeqet ku rrodhi dhimbja e shpirtit të tij, / Prandaj predhat kur dalin nga grykat tuaja, / Dalin nga e shpirtit thellësi. // Kur qielli gjëmon nga motorët e huaj, / Përkulen palmat, zogjtë tulaten, bari meket, / Vetëm ju ngrini kokat e lëvizshme / Drejt qiellit / Dhe me vdekje i përgjigjeni vdekjes. // Ky është një dialog i rëndë e i madh. / As Eskili të tillë s'pati në tragjeditë / Dhe perdja bije, / Një perde e bardhë tymi / Vigane, horizontet mbulon dhe hapësirat. // Në më rëntë rruga desha t'ju takoj, / Bateri kundër ajrore vietnameze./ Ashtu si dorën e mikut e shtrëngoj. / Të shtrëngoj tytat tuaja të nxehta.// 1965.

[10] Në KADARE 1968, ff. 90-91.

Kongresin botëror të Rinisë të organizuar nga OKB-ja). E katërta, për lidhjet intertekstuale me vepra të tjera të tij, me romanin *Koncert në fund të dimrit*, meqë një pjesë e librit i kushtohet Kinës ("Nëpër Kinën e madhe", ff. 5-19: "Pekini", "Arbania", "Kinezët", "Bota e vjetër", "Degjenerimi", "Hrushovi kinez", "T'i shërbejmë popullit", "Te muri i madh", "Shangaj"). Në këto pjesë të librit Tjetri na jepet sipas kritereve të realizmit socialist. E pesta, sepse kapitulli me titull "Nën qiellin e Vietnamit" na garanton praninë e Tjetrit në këtë tekst dhe na afron me temën e poezive "Vietnam" dhe "Bateritë kundër ajrore". Ja si del tema e baterive kundërajrore në *Linja të largëta*:

1) *Duke u kthyer, takojmë me disa vajza që bëjnë rojen e zakonshme* ***te mitralozat kundërajrorë****. Vajza të tilla kemi takuar kudo. Këto vajza të reja shkollare 16-17-vjeçare, kanë luftuar shumë herë me avionët amerikanë. Para ca kohe një grup avionësh gjuajtën me raketa dhe vranë gjashtë vajza. Ato e dinë ç'do të thotë të luftosh ballë për ballë me avionët, që ikin si të tërbuar, pasi kanë hedhur bombat dhe pasi kanë lënë prapa shokët e tyre. Ato e dinë ç'do të thotë hakmarrje e piratëve të ajrit, megjithatë ja ku rrinë pranë mitralozit, krejt të qeta, të pastra, me flokët të krehur gjithmonë me kujdes, gati për të hyrë në luftë për jetë a vdekje me avionët armiq.*[11]

2) *Duke u larguar nga Nam Bini, shkojmë* ***tek një bateri kundërajrore****, në njërën nga kodrinat që rrethojnë qytetin.* ***Bateria*** *është në alarm. Tytat e gjata lëvizin në errësirë. Në qiell ka avionë, por ata fluturojnë shumë lart. Takohemi me ushtarët. Ju sjellim përshëndetje nga Shqipëria*[12]*.*

D. Trajtimi i temës së luftës në Vietnam e afron Ismail Kadarenë e *Linjave të largëta* me shkrimtaren italiane Oriana Fallaci. Ismail Kadare shkruan nga një pozitë e privilegjuar, nga pozita e shkrimtarit europian të realizmit socialist që ka mundësinë të vizitojë Vietnamin e Veriut gjatë luftës. Oriana Fallaci në fillim shkon në Vietnamin e Jugut. Por pastaj bën edhe një gjë tjetër: pasi e jep Tjetrin duke shkuar si gazetare dhe shkrimtare në Vietnamin e Jugut, e jep Tjetrin sërish duke shkuar edhe në Vietnamin e Veriut (libri *"La rabbia e l'orgoglio",* 2001, 2009, Bur; në vitin 1969 Oriana Fallaci u ftua në Vietnamin e Veriut). Pra ajo e ndan në dysh Tjetrin në analizën e saj. Këtë gjë ajo kishte filluar ta bënte që në librin e parë kur merret me vietkongët dhe me robërit që ka kapur ushtria e Vietnamit të Jugut.

Na intereson në analizën strukturore të tekstit ngjashmëria e temave dhe përsëritja e pranisë të të njëjtave temave në tekstin e Ismail Kadaresë dhe në tekstin e Oriana Fallaci-t. Japim shkurt vetëm disa shembuj dhe pranëvendosim tekstin e të dy autorëve për të treguar praninë e temës së përdorimit të helmetës, gjendjen e fëmijëve në luftën e Vietnamit, temën e rrëzimit të avionëve dhe heliktopterëve amerikanë, temën e figurës së gruas vitnameze në luftë, temën e robërve të luftës.

Pra le të shikojmë fare shkurt përsëritjen e temave në 400 faqet e Fallaci-t[13] dhe në 44 faqet e Kadaresë. Vetëm paragjykimet ideologjike nuk kanë bërë të mundur deri

[11] KADARE 1971, f. 34.
[12] KADARE 1971, f. 42.
[13] FALLACI 2015, Oriana Fallaci, *Niente e così sia,* Rizzoli, Milano, 2015, ff. 429.

më sot që t'i jepet vendi i vet këtij shkrimi në sistemin letrar të veprës së Kadaresë. Në përshkrimin e Tjetrit tek të dy këta autorë kemi gjendjen në bombardim dhe përdorimin e helmetës.

KADARE 1971, f. 23	FALLACI 2015, f. 334
Mëngjez. Ecim nëpër rrugët e Hanoit. Qielli është i pastër. Ajri i freskët. Nëpër rrugët kalojnë mijëra njerëz me biçikleta. Të gjithë kalimtarët mbajnë në kokë ***helmeta prej çeliku ose prej bambuje.*** *Ato të mbrojnë prej copave të predhave të ftohta, në qoftë se bombardimi të zë përjashta. Gjatë trotuareve ka qindra gropa që shërbejnë si strehime personale për kalimtarët kur i zë alarmi në rrugë. Vetëm* ***helmetat*** *në kokat e njerëzve dhe këto gropa ndanë rrugëve të kryeqytetit, të kujtojnë këtë mëngjez luftën.*	*Di lì partono anche i colpi di mortaio che da stamani cadono su questo campo. Il comandante infatti ha preteso che indossassi* ***la giacca antischegge e l'elmetto,*** *per proteggere almeno la testa e le spalle, ma c'è un sole spietato e la testa mi cuoce, la giacca antischegge mi pesa più d'un sacco di piombo.*
KADARE 1971, f. 25	
Qielli është i kthjellët si më parë. Njerëzit gjithashtu të kthjellët. Kthehemi në shtëpi. Pranë krevatëve, mbi komodinë gjejmë nga ***një helmetë. Këto helmeta*** *do t'i mbajmë tani me vete kudo: në shtëpi, në maqinë, pranë tryezës së bukës, mbi kokën e shtratit. Jemi në luftë.*	

Kadare trajton temën e rrëzimit të avionëve dhe të helikopterëve amerikanë[14]: *Ata vrapojnë të parët në drejtim të vendit ku bie parashuta e pilotit pirat të rrëzuar; ata i drejtojnë revolverin pilotit, i heqin parashutën dhe e venë përpara.* E njëjta temë jepet edhe nga Fallaci: *In quel mucchio di carne umana vi sono almeno cento morti e altrettanti feriti. Il sole decompone i cadaveri, i feriti muoiono dissanguati: evacuarli è impossibile. Dieci elicotteri ci hanno provato, otto sono stati abbattuti*[15].

Te Kadare kemi një temë të rëndësishme: kapjen rob të një piloteje amerikane femër. Këtë temë e trajton edhe Oriana Fallaci kur shkon dhe interviston tri gra të burgosura në një kamp të ushtrisë së Vietnamit të Jugut[16].

KADARE 1971, f. 41	FALLACI 2015, f. 341
Para ca kohe vietnamezët rrëzuan një aeroplan,	(Fallaci jep përgjigjen e një vietnamezeje

[14] KADARE 1971, f. 40.
[15] FALLACI 2015, f. 30.
[16] FALLACI 2015, ff. 337-342.

që e pilotonte një grua. Vietnamezët si njerëz gjakftohtë dhe kuriozë, në fillim i peshojnë pilotët. E peshuan sipa zakonit edhe këtë grua dhe gruaja peshonte 96 kg. Kur e pyetën se ç'kishte bërë vaki, që kjo grua kaq e trashë na qenka pilote e, ajo u përgjegj se ishte bërë pilote dhe po merrte pjesë në bombardimin e Vietnamit të Veriut, për të marrë hakun e burrit të saj pilot, që u dogj para ca kohe, bashkë me avionin e tij në qiellin e Vietnamit. Pra, kjo bushtër kriminale, kishte ardhur për hakmarrje. Merret me mend se ç'krime do të ketë bërë ajo gjatë fluturimeve të saj.	të kapur rob që i përgjigjet intervistës së gazetares) *No. Ero una contadina e basta. Ma i vietcong mi chiedevano di portargli la roba e non potevo dirgli di no. Avevo paura. Se gli dici no, diventano cattivi anche loro. E ti puniscono.*

Këtu kemi edhe një temë tjetër të rëndësishme: kujdesin që vajzat vietnameze tregojnë për veten e tyre dhe për paraqitjen e tyre.

KADARE 1971, ff. 34-35. *Na bën përshtypje të jashtëzakonshme pastërtia dhe kujdesi që tregojnë vajzat vietnameze për veten. Në kondita të vështira, në fushat me baltë, në hendekë, pranë mitralozave, pranë gërmadhave, kudo që të ndodhen, vajzat vietnameze, megjithëse të varfëra (disa herë pa këpucë), i kanë bluzat e tyre gjithmonë të bardha dhe të pastra dhe flokët të krehur jashtëzakonisht bukur. Ky fakt i thjeshtë tregon dinjitetin e madh të tyre. Këto vajza të brishta, janë më të forta se lufta. Ato nuk e lëshojnë veten. Kokat e tyre të krehura bukur /dhe me kujdes tregojnë se sa absurde janë shpresat e amerikanëve për të ngjallur panik dhe depresion shpirtëror midis popullit vietnamez. Duke parë vajzat vietnameze, m'u kujtuan librat e atyre shkrimtarëve disfatistë, personazhet e të cilëve në gjendje lufte humbasin tiparet njerëzore, i kap tmerri, histerizmi, degjenerojnë, bëhen si bishat. Me sa duket, prapa gjithë kësaj qëndron frika. Këta shkrimtarë duhet të ulin kokën me turp përpara vajzave të thjeshta vietnameze. Në historinë e lavdishme të popullit vietnamez ato kanë faqet e tyre dhe këto faqe janë nga më të bukurat.*	FALLACI 2015, f. 339 *Come gli uomini, le donne sono raccolte in baracche ciascuna delle quali contiene quaranta cuccette. L'ambiente è pulito, sono pulite anche le donne che indossano pantaloni neri, giacca color rosso vino, e portano sempre quei cappelli a cono.*

Kadare përdor "tjetrin" për të denoncuar regjimin, përdor tjetrin që është identik, i ngjashëm, ose i barabartë me regjimin shqiptar. Një gjë është e sigurt: letërsia

e Kadaresë është pjesë e sistemit letrar shqiptar të kohës kur ai shkroi në Shqipërinë socialiste. Letërsia e shkruar nga Kadareja ishte pjesë e letërsisë së kohës, edhe pse jo gjithmonë ishte letërsi e realizmit socialist. Letërsia e Kadaresë është pjesë e letërsisë shqipe të viteve 1945-1990. Vepra e Kadaresë e viteve 1945-1990 është pjesë e letërsisë shqipe të këtyre viteve dhe jo një kundërletërsi. Mund të bëjë pjesë në pjesën më të mirë të kësaj letërsie, por gjithmonë si pjesë e saj.

Sipas nesh forca e shkrimit të Kadaresë para dhe pas vitit 1990 është sepse ai në pjesën më të madhe të veprës së tij nuk e respekton normën e realizmit socialist. Kështu që kemi një disidencë letrare dhe jo një disidencë të drejtpërdrejtë dhe të mirëfilltë politike.

Për këtë gjë ka shumë rëndësi vendi që zë "tjetri" në letërsisë e Kadaresë.

"Tjetrin" Kadare e përdor për keq, si në rastin e Bashkimit Sovjetik (*Dimri* dhe shkrimet e Gent Arbanës) për të goditur letërsinë e realizmit socialist.

"Tjetrin" Kadare e përdor për keq kur shkruan (si Gent Arbana) keq për Perëndimin, për kulturën perëndimore, sepse këtu kemi rënien në konformizëm e në cektësi letrare.

"Tjetrin" Kadare e përdor për mirë kur shkruan për Vietnamin heroik.

Kadare nuk ka qenë një disident politik. Por ka qenë dhe mbetet një disident ndaj rrymës letrare të realizmit socialist.

Kadare vetëm kur flet e kur shkruan për Tjetrin e kalon këtë cak: kalon nga disidenca letrare në disidencën politike; i sigurt sepse letërsia i siguron mburojën për ta kaluar këtë cak nëpërmjet "tjetrit" (mjaftojnë *Dimri i madh*, *Koncert në fund të dimrit*, *Pallati i ëndrrave* për ta blinduar këtë tezë).

Nuk duhet të paragjykojmë *Linja të largëta* dhe "Nën qiellin e Vitnamit". Ky është një shkrim binjak me *Niente e così sia* të Oriana Fallaci-t. Vetëm paragjykimet ideologjike nuk kanë bërë të mundur deri më sot që t'i jepet vendi i vet këtij shkrimi në sistemin letrar të veprës së Kadaresë. Vërejmë se ngjashmëritë dhe përsëritja e temave dhe e përshkrimeve janë të shumta.

Një shkrimtar shkon në Vietnam nga veriu nga Kina, në Hanoi. Gazetarja dhe shkrimtarja italiane shkon në Vietnam nga jugu, në Saigon, në fillim, dhe vetëm më vonë në Vietnamin e Veriut.

Në shqyrtimin e *Nën qiellin e Vietnamit* del nevoja e rileximit. *Nën qiellin e Vietnamit* është një tekst modern, ku falë pranisë së tjetrit autori ynë afrohet me autorë të tjerë perëndimorë si Oriana Fallaci. Në kufizimin e diktuar nga ideologjia, në konformizmin e shtrënguar të realizmit socialist që të merr frymën trajton një temë qëndrore të asaj periudhe: Vietnamin.

Sot duke e parë nga një pikëvështrim nga jashtë realizmit socialist këtë tekst, tashmë, edhe pse ai vetë është një shprehje normale e kësaj rryme letrare, mund të marrim një pjesë tjetër të mesazhit të tij. Sepse paraqet Tjetrin, Vietnamin, por edhe sepse tani kemi mundësinë që ta shohim edhe ne nga një pikëvështrim i tjetrit, i

lexuesit, i kritikut perëndimor; meqë tani kemi mundësinë të themi se edhe ne (më parë realizmi socialist) vetëm jemi bërë kritika (shkencore), tjetri. Kështu ne, lexuesit, kritikët shqiptarë, bëjmë një hap përpara, e shohim vetë ne, me syrin, me këndvështrimin e Tjetrit këtë tekst të Kadaresë. Dhe kjo gjë, ky kalim mund dhe duhet të bëhet me të gjithë letërsinë e Kadaresë së konformuar brenda realizmit socialist.

E. Ja si prezantohet Gent Arbana:

[J.K.] Si shumë shkrimtarë, të cilët kanë shkruar me pseudonim, nga hulumtimet në shtypin periodik, më rezulton se keni shkruar me emrin Gent Arbana ose dhe G. Arbana, kryesisht në gazetat "Drita" dhe "Hosteni".

[I.K.] Është e vërtetë! Të gjithë e dinin që isha unë. Janë shkrime kryesisht informative, argumente, lajme, gjepura... Shkrime të cilat nuk doja t'i vija me emrin tim, sigurisht. Ka shumë shkrime të tilla, por edhe unë vetë nuk e di sa mund të jenë. Janë shkrime pa ndonjë vlerë, të shkruara gjatë punës sime të detyrueshme si gazetar, kështu që nuk mund të merren si pjesë e krijimtarisë sime. Në gazeta shkruhej edhe çfarë ndodhte nëpër botë, lajme nga kultura botërore, prandaj këto shkrime i kam botuar pa emrin tim, por kam shkruar edhe vjersha satirike. Më vjen keq që i keni dhënë rëndësi këtyre shkrimeve[17].

Le të shohim shkurt vetëm disa prej temave të shkrimeve me emrin Gent Arbana.

Temat e shkrimeve të Gent Arbanës janë të ndryshme, për shembull shtypi i huaj dhe temat që trajton shtypi i huaj[18].

Në ARBANA 1982b merret me skandalet në jetën letrare dhe artistike në Francë, me rastin e Zhan Edern Hallierit [Jean-Edern Hallier, 1936-1997], i cili organizoi rrëmbimin e vetvetes vetëm për bujë e për t'u bërë reklamë veprave të tij.

Në shkrimet e tij Gent Arbana shpesh citon artikuj nga gazeta të huaja.

Në ARBANA 1997b merret me rusistët: *-Ka vite që në Bashkimin Sovjetik ka filluar të përdoret një fjalë e re "rusistët". Kështu quhen shovinistët ruso-mëdhenj në rrethet letrare artistike. Këta grumbullohen kryesisht rreth klubeve "*R*osija" (Rusia) dhe "*R*odina" (atdheu) si edhe rreth revistave "Nash sovremenik" (Bashkëkohësi ynë) dhe "Malladaja gvardia" (Garda e re).*

Temat që trajton Gent Arbana në kuadrin e shqyrtimit të shovinizmit rus prekin tema të rëndësishme të jetës politike të socializmit shqiptar të kohës si qëndrimi ndaj fesë dhe ndaj revolucionit të tetorit. Duke iu referuar gjithmonë botimeve të revistave dhe gazetave të Bashkimit Sovjetik, Gent Arbana jep edhe emrat e autorëve që trajtojnë temën e shqyrtuar prej tij dhe titujt e gazetave dhe revistave. Kjo gjë na lë të kuptojmë se ai ishte i azhornuar për atë që ndodhte në Bashkimin Sovjetik dhe se kishte mundësinë të konsultonte, ndoshta rregullisht, organet kryesore të shtypit dhe sidomos organet letrare dhe kulturore që mbërrinin në Tiranë nga Moska edhe kur Tirana letrare

[17] Në Jorina Kryeziu (Shkreta), *Kadare Bibliografi Vepra I,* Botime Pegi, Tiranë, 2014, f. 389.
[18] Shiko ARBANA 1984e.

zyrtare i kishte mbyllur kontaktet e saj me Lindjen komuniste. Në këtë shkrim Gent Arbana vë në qendër rusistët duke trajtuar shovinizmin në kulturën ruse.

Në ARBANA 1985b shqyrton kritikën borgjeze, artin borgjez dhe vëmendjen e tyre për faktet intime të jetës së shkrimtarëve dhe të qëndrimit të tyre politik.

Në ARBANA 1973d ndalet mbi temën e botimeve të librave me shpenzime të vetë autorit. Kjo temë rimerret duke marrë shkas nga shkrimet e botuara në gazetën franceze *Le Monde* në datën 4 dhe në datën 25 tetor të vitit 1973.

Në ARBANA 1974 a trajton temën e foto-romanit. Niset nga një informacion i botuar në gazetën franceze *Le Monde*. Duke e dënuar foto-romanin si një formë degjenerimi të artit, jep të dhëna për rritjen e numrit të foto-romaneve të botuara në Francë. Trajton shkurt edhe ndërhyrjen e legjislacionit për botimin e foto-romanit në Francë dhe për temat që trajtojnë foto-romanet.

Në ARBANA 1983b trajton temën e romaneve të trandafiltë dhe veprimtarinë e shtëpisë botuese "Harlequin" në Francë.

Në ARBANA 1985 a shkruan për shkrimtarin francez Alen Rob Grije, një nga themeluesit e romanit të ri francez, të antiromanit.

Në ARBANA 1984f trajton problemin e librit në kohën e futjes së informatikës duke kundërshtuar teoritë reaksionare sipas të cilave libri do të dëmtohet nga futja e mjeteve të reja të informatikës. Problemin e librit e sheh në lidhje me rolin e mjeteve të tjera të komunikimit, të kinemasë, televizionit; trajton vendin e librarive dhe anën tregtare të shitjes së librit në tregun e përgjithshëm. Sigurisht e trajton këtë temë në lidhje me zhvillimet në botën borgjeze.

Në ARBANA 1974b shqyrton fenomenin Sollzhenicin duke ndjekur rrugëtimin e botimeve të tij në Bashkimin Sovjetik dhe jashtë vendit. Sipas Gent Arbanës në fillim ai u përdor në kuadrin e destalinizimit të vendit, por pastaj doli edhe jashtë kontrollit të organeve sovjetike dhe kështu u dëbua nga vendi. Këto dy çaste të krijimtarisë së shkrimtarit përfaqësohen nga veprat *Një ditë e Ivan Denisoviçit*, që u pranua nga letërsia zyrtare sovjetike dhe nga *Arqipelagu Gulag,* që konsiderohet libri më kundërrevolucionar dhe më reksionar i letërsisë sovjetike.

Në mbyllje të shkrimit jepet edhe pjesa më negative e vlerësimit të librit "Arqipelagu Gulag" që ka të bëjë me qëndrimin që mbahet në libër ndaj historisë së luftës së dytë botërore dhe ndaj luftës heroike të Bashkimit Sovjetik: *-Por pjesa më diskredituese e "Arqipelagut Gulag" është ajo ku Sollzhenicini merr në mbrojtje të hapët gjeneralin tradhtar të Ushtrisë së Kuqe, Vllasovin dhe partizanët e tij. Gjeneral-lejtnandi Andrej Vllasov jo vetëm që iu dorëzua gjermanëve gjatë luftës së madhe patriotike por, pasi rekrutoi në radhët e robërve sovjetikë armiqtë e pushtetit sovjetik, krijoi me ta një ushtri të armatosur prej gjermanëve dhe me këtë ushtri luftoi krah për krah me hitlerianët kundër Atdheut të vet.*

Në ARBANA 1984d trajton luftën që i bën komunizmit makina e propagandës borgjeze duke shfrytëzuar librin *1984* të Xhorxh Oruellit.

Në ARBANA 1976 a trajton temën e vendit që zë letërsia e republikave të ndryshme të BS, letërsia e popujve jo rusë që nuk kanë si gjuhë të vet gjuhën ruse, në kuadrin e përgjithshëm të letrave të BRSS. Shqyrton një artikull të gazetës "Literaturnaja gazeta" të shkruar nga kryeredaktori i revistës letrare "Miqësia e popujve". Artikulli titullohet "Letërsia plurinacionale dhe unike" dhe merret me botimin e veprave të autorëve jo rusë në gjuhën ruse duke shqyrtuar rëndësinë e përkthimit të veprave në rusishte. Vendi i përkthimit, i përkthyesit, i veprës në letërsinë e vet dhe në letërsinë e BRSS trajtohet duke u nisur nga analiza e bërë nga funksionari rus që ka shkruar për këtë temë.

Disa nga çështjet e trajtuara në këtë shkrim janë çështje me shumë rëndësi për letërsinë e përkthyer nga një gjuhë e vogël në një gjuhë më të madhe e më të rëndësishme.

Në ARBANA 1973 a kemi kritikën ndaj Jeftushenkos. Gent Arbana ngrihet kundër sundimit të botës nga ana e të dy superfuqive. Nuk mungon as referimi për përgjegjësinë dhe për ndërhyrjet e dy superfuqive në Çekosllovaki dhe në Vietnam. Gent Arbana e ndjen veten të autorizuar që t'u kundërvërë superfuqive dhe bashkëpunimit të tyre, që ka arritur në dashuri në vjershat e Jeftushenkos, "gjithë botën përparimtare": *Është vështirë të përfytyrohet hipokrizia e një ankimi kaq pseudoromantik të dy superfuqive agresive të kohës sonë. Ata që kanë djegur e përvëluar tokën e Vietnamit, ata që kanë shtypur me zinxhirat e tankeve tokën Çekosllovake, lëshojnë lotë e psherëtima se po "u bien në qafë", se "nuk i lenë në punë të tyre" ca grindjenxitës e ca përçarës. Për hir të idilit me Amerikën Jeftushenkua është gati të akuzojë gjithë botën përparimtare, gjithë ato forca të shëndosha të njerëzimit që po demaskojnë çdo ditë e më tepër komplotin amerikano-sovjetik për sundimin e botës.*

Në ARBANA 1973b analizon librin *Të padukshmit* të shkrimtarit Vivien Ogilvi që është botuar në shqip.

Në ARBANA 1973c merret me Andrej Andrejeviç Voznjesenskin [Moskë, 12 maj 1933 – Moskë, 1 qershor 2010]. Ja se çfarë shkruan: *-Andrej Voznjesenskij si një nga poetët më të njohur të valës revizioniste, përpiqet që nga libri në libër të shpikë diçka "të re", diçka "të paparë" për të çuditur lexuesit. Në një nga përmbledhjet poetike të kohëve të fundit ai na paska dalë me një teorizim të ri: izotopet.*

Kurse në *Zërin e popullit,* duke shkruar në rubrikën për artin dhe politikën kemi edhe tema politike. E njëjta gjë ndodh me poemat në *Hosteni* ku tema mund të jetë politika e jashtme dhe burokracia në vend. Ismail Kadare boton me emrin Gent Arbana edhe në frëngjishte në revistën *Les lettres albanaises*, kryeredaktor i së cilës është ai vetë.

Na intereson se si na del tjetri në këto shkrime. Politikisht ai paraqitet në mënyrë negative. Por këtu kemi edhe letërsinë e tjetrit, artin e tjetrit. Dhe Tjetri jepet edhe me emër të përveçëm kur shqyrtohen shkrimtarë të veçantë.

Në ARBANA 1977 a paraqet qëndrimin e letërsisë zyrtare të Bashkimit Sovjetik të kohës ndaj shkrimtari të njohur Xhejms Xhojs dhe veprës së tij: *Pas një manovrimi të*

gjatë plot demagogji, gjatë të cilit herë e shanin, herë e përlëgjnin e herë e lavdëronin, revizionistët sovjetikë vendosën më në fund të botojnë një nga krerët e dekadentizmit botëror Xhejms Xhojsin.

Si shpesh në këto shkrime të tijat, analizon shkrime të organeve të shtypit letrar dhe kulturor të Bashkimit Sovjetik. Në këtë shkrim shqyrton përkthimin e "Portereti i një artisti në moshë të re" dhe artikullin që e shoqëron këtë përkthim në "Inostranaja literatura"[19].

Bën shkurt historikun e qëndrimit të letrave zyrtare të Bashkimit Sovjetik kundrejt Prustit dhe Kafkës. Ka pasur një ndarje dhe një dallim në qëndrimin ndaj këtyre dy autorëve dhe Xhojsit. Marsel Prusti dhe Franc Kafka janë botuar më parë pas një qëndrimi kontradiktor, joparimor dhe të gënjeshtërt: *Botimi i Xhojsit në gjuhën ruse, është një hap i mëtejshëm në forcimin e aleancës kulturore borgjezo-revizioniste. Prej shumë vitesh borgjezia e kërkonte këtë, dhe prej shumë vitesh revizionistët përllogaritnin nëse kishte ardhur koha e përshtatshme për të bërë hapin vendimtar. Ata e pregatitën terrenin me kujdes. Botuan në fillim Prustin, pastaj Kafkën, kurse për Xhojsin vazhdonin të bënin naze.*

Na intereson se si jepet lidhja e politikës me artin e tjetrit. Për këtë është emblematik ARBANA 1974c që merret me reagimin në botën e artit dhe të kulturës ndaj rrymës amerikane të pikturës të viteve '60 të quajtur fotorealizëm. Na bën përshtypje sarkazma e përdorur për të prezantuar para lexuesit shqiptar gazetën sovjetike "Sovjetskaja Kultura". Duket që është një artikull i shkruar në mënyrë të sforcuar sepse herë pas here kemi zgjatje e përsëritje[20].

F.1. Do të donim të dinim se ç'mendon sot Gent Arbana për këto tema të trajtuara në këtë mënyrë atëherë. Tani që vetë ai është përfaqësuesi ynë më i denjë brenda kësaj letërsie, brenda Tjetrit.

Po ndoshta është e kotë: Tjetri=Gent Arbana sot nuk ekziston, problemi i Tjetrit për të nuk ekziston. Ndoshta sepse ai vetë është bërë pjesë e Tjetrit.

Mos ndoshta Gent Arbana=Ismail Kadare ka qenë Tjetri që kemi pasur gjithmonë në mes nesh? Përmendim temën e Tjetrit, temën e të huajit brenda letërsisë së Kadaresë; është ajo pjesë e veprës së Kadaresë e shkruar në një mënyrë të tillë që lexuesi i saj mund të ishte shqiptar apo i huaj, Tjetri.

---

[19] Lajmi i botimit në rusisht jepet i saktë: *Revista e tyre kryesore revizioniste, që merret me importin e dekadentizmit borgjez në BRSS, "Inostranaja literatura", në numrat 11 dhe 12 të vitit që shkoi, botoi të përkthyer në rusisht librin e Xhojsit "Portreti i një artisti në moshë të re". Në artikullin shoqërues ajo i lajmëron lexuesit se nuk do të jetë e largët koha kur ata do të mund të lexojnë në rusisht edhe veprën kryesore të Xhojsit "Ulisin", vonesa e botimit të të cilit është shkaktuar, sipas tyre, nga vështirësitë e përkthimit,*ARBANA 1977 a.

[20] Nuk mungon një dozë e mirë propagande që ishte tipike e shtypit të kohës: *-Po e themi që në fillim se fjala është për një gazetë me dy faqe; jo për ndonjë gazetë që del vetëm me dy faqe letër, por për gazetën "Sovjetskaja Kultura", e cila në të tetë faqet e saj, u servir lexuesve sovjetikë një hipokrizi nga më të paturpshmet. Po nuk është vetëm ajo që e bën këtë gjë. Po të shfletosh shtypin letrar – artistik revizionist sovjetik do të vesh re shumë lehtë se një erë e pafund demagogjie fryn tejembanë tij. Nganjëherë demagogjia është e hollë, nganjëherë më e trashë, por sido që të jetë ajo mbetet demagogji,* në ARBANA 1974c.

Një gjë është e sigurt: në atë kohë, por edhe sot, jo Gent Arbana që shkruante për Tjetrin, dmth nga këndvështrimi i Tjetrit, por Ismail Kadare që shkruante për Tjetrin, për botën e tij, ai shkrimtar që i drejtohej Tjetrit, nuk ekziston më: tashmë të gjithë jemi pjesë e Tjetrit, ose minimumi pjesë e një pjese të Tjetrit.

Do të mund të konstatonim se:

1) Kadare e gjen Tjetrin edhe brenda bashkësisë ndërletrare,

2) tek Gent Arbana Kadare futet brenda realizmit socialist falë qëndrimit ndaj Tjetrit,

3) duhet parë duke u mbështetur në kritere shkencore "rasti i Gent Arbanës" dhe i veprave minore,

4) sot në veprën e Kadaresë do të duhet të kishim një rast di "inclusione posteriore"=përfshirjeje të mëpastajme (e marrim hua këtë përcaktim nga "Le comunità interletterarie: una categoria fondamentale del processo interletterario", shiko ĎURIŠIN 1995): p.sh. romani *Dasma*, poezitë e realizmit socialist, Gent Arbana dhe letërsia e udhëtimit.

F.2.Konstatojmë edhe se:

1) vetëm në këtë pjesë të shkrimeve të Ismail Kadaresë, në ato mbi Tjetrin në letërsinë e huaj "revizioniste" (Sollzhenicini, Jeftushenko, fotorealistët), mbi Tjetrin në letërsinë e huaj "borgjeze" (Xhojsi, foto-romani, reklama e skajshme për shitjen e librit, letërsia rozë) vetëm brenda kornizave të rrepta të letërsisë së realizmit socialist, mund të studiojmë duke u mbështetur në kritere shkencore veprën e Ismail Kadaresë në përgjithësi dhe tema të rëndësishme të letërsisë, siç është tema e Tjetrit, në mënyrë të veçantë.

2) studimi i asaj pjese të letërsisë shqipe moderne dhe bashkëkohore që i përket realizmit socialist duke u mbështetur në kritere shkencore është i domosdoshëm për studimin shkencor të gjithë sistemit të letërsisë shqipe. Pra duhet të shqyrtojmë brenda këtij sistemi, në rastin tonë edhe krijimtarinë në vargje të Ismail Kadaresë / Gent Arbanës (*Hosteni*) që futet brenda realizmit socialist. Në këtë pjesë së krijimtarisë së Kadaresë bëjnë pjesë disa nga poemat e tij por edhe vjersha e krijime më të shkurtra ku kemi praninë e Tjetrit në realizmin socialist.

3) është i domosdoshëm për studimin shkencor të letërsisë moderne dhe bashkëkohore shqiptare edhe shqyrtimi i veprave minore të autorëve të mëdhenj që kanë një vend të rëndësishëm në sistemin e tyre letrar, siç është letërsia e udhëtimit e Ismail Kadaresë, ku figura e Tjetrit zë vendin kryesor.

Vepra e Ismail Kadaresë shtrihet në një hark të gjerë kohor. Në një hark të gjerë kohor shtrihet edhe kritika mbi të. Ka rëndësi studimi i mesazhit letrar të veprës së Ismail Kadaresë në kuadrin sistemit letrar shqiptar në tërësi. Një vend të veçantë në këtë sistem letrar zë letërsia e realizmit socialist. Pjesa më e madhe e veprës së Ismail Kadaresë u shkrua në Shqipëri dhe gjatë realizmit socialist. Ajo u botua në Shqipëri gjatë realizmit socialist në gjuhën shqipe, u përkthye në Shqipëri në disa gjuhë të huaja

dhe u botua në Shqipëri dhe jashtë saj në gjuhë të huaj gjatë realizmt socialist. Pjesa dërrmuese e kësaj vepre nuk i zbaton normat e realizmit socialist dhe rrjedhimisht nuk bën pjesë në realizmin socialist. Por edhe ajo pjesë e veprës së Ismail Kadaresë që i përket realizmit socialist ka rëndësinë e saj në sistemin letrar shqiptar dhe në sistemin letrar të vetë Ismail Kadaresë. Pa studiuar këtë pjesë të krijimtarisë së Ismail Kadaresë nuk mund të kemi një studim të plotë shkencor të veprës së tij. Kjo pjesë e krijimtarisë së Ismail Kadaresë, pra ajo që respekton kanonet e realizmit socialist, përbëhet nga disa poema, disa poezi, ndonjë tregim i gjatë a novelë, romani *Dasma*, shkrime të udhëtimit, një pjesë e mirë e shkrimeve publicistike dhe e shkrimeve kritike të Ismail Kadaresë.

Në këtë punim u ndalëm vetëm tek tri poezi të librit *Motive me diell* të Ismail Kadaresë, tek libri *Linja të largëta* dhe tek disa nga shkrimet me pseudonimin Gent Arbana sepse duke analizuar Tjetrin në këtë pjesë të veprës së autorit kemi një panoramë të saktë, të plotë e shkencore të sistemit të tij letrar.

Sipas nesh analiza e veprës së Ismail Kadaresë si një sistem me strukturën e tij në kuadrin e sistemit letrar shqiptar dhe botimi kritik i veprës së tij janë dy tema themelore me të cilat duhet të përballen studimet shqiptare që merren me letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë dhe të fillimit të shekullit të njëzet e një.

Vetë Ismail Kadare nuk e ka mohuar këtë pjesë të krijimtarisë së tij. Por Ismail Kadare nuk e pranon këtë pjesë të krijimtarisë së tij. Nuk do që ajo të bëjë pjesë në sistemin e tij letrar. Gjë që shkencërisht nuk mund ta pranojmë. Përkundrazi sot, pas realizmit socialist, ne kemi më shumë mundësi që edhe këtë pjesë të veprës së tij ta studiojmë në mënyrë shkencore për të analizuar më mirë këtë pjesë të veprës (që i përket realizmit socialist) dhe veprës në tërësi e cila domosdoshmërisht është e lidhur dhe kushtëzohet nga kjo pjesë e saj.

Bibliografia

BELLER 2004, Manfred Beller, "Imagologia", në Michele Cometa, *Dizionario degli studi culturali,* a cura di Roberta Coglitore e Federica Mazara, Maltemi editore, Roma, 2004, ff. 225-230.

CESERANI 1998, Remo Ceserani, *Lo straniero*, Editori Laterza, Roma-Bari, 1998, ff. 78.

DOLFI 2001, Anna Dolfi (a cura di), *Identità alterità doppio nella letteratura moderna.* Atti di seminario, Bulzoni editore, Roma, 2001.

ĎURIŠIN 1995, Dionýz Ďurišin, "Le comunità interletterarie: una categoria fondamentale del processo interletterario", në Armando Gnisci e Franca Sinopoli (a cura di), *Comparare i comparatismi,* Lithos editrice, Roma, 1995, ff. 67-81.

DYSERINCK 1995, Hugo Dyserinck, "Il punto di vista sovranazionale dello studio letterario comparato e la sua applicazione all'imagologia", në Armando Gnisci e

Franca Sinopoli (a cura di), *Comparare i comparatismi,* Lithos editrice, Roma, 1995, ff. 52-66.

GUILLÉN 2001, Claudio Guillén, *L'uno e il molteplice. Introduzione alla letteratura comparata,* Il Mulino, Bologna, 2001, ff. 553 [botimi origjinal Enre lo uno y lo diverso. Ntroducción a la iteratura comparada, Barcelona, Editorial Critica, 1985]

LOTMAN 1993, Jurij M. Lotman, *La cultura e l'esplosione. Prevedibilità e imprevedibilità,* Feltrinelli, Milano, 1993, ff. 224, [titulli origjinal i veprës KUL'TURA I VZRYV, Gnosis, Moskva 1993; në shqipe *Kultura dhe bumi*, Përktheu nga origjinali Agron Tufa, Shtëpia e Librit & Komunikimit aleph, Tiranë, 2004].

LOTMAN 1994, Jurij M. Lotman, *Cercare la strada. Modelli della cultura*, (Introduzione di Maria Corti), Marsilio, Venezia, 1994, ff. 106.

LOTMAN & USPENSKIJ 1975, Jurij M. Lotman – Boris A. Uspenskij, *Semiotica e cultura,* Riccardo Ricciardi editore, Milano – Napoli, 1975, ff. 137.

PROIETTI 2008, Paolo Proietti, *Specchi del letterario: l'imagologia. Percorsi di letteratura comparata,* Sellerio editore, Palermo, 2008, ff. 168.

SINANI 2000, Shaban Sinani, "Koncepti për 'tjetrin' në kulturën tradicionale shqiptare", në "Perla", Nr. 1, 2000, ff. 61-75.

SULA 2005, Lili Sula, ""Tjetri' në formësimin e modernitetit", në "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Materialet e punimeve të Seminarit XXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, gusht 2005", 24/2, Prishtinë, 2005, ff. 217-223.

Edmond ÇALI

THE OTHER IN ALBANIAN PITERATURE OF SOC-REALISM: LITERATURE OF TRAVLEING, ANGAGED POETRY AND ANGAGED CRITICS. THE CASE OF ISMAIL KADARE AND GENT ARBANA

Abstract

The image of "The other" in the Albanian literature of socialist realism: travel literature, engaged poetry and engaged criticism. The case of Ismail Kadare and Gent Arbana. *Motive me diell* (1968), *Linja të largëta. Shënime udhëtimi* (1971) and the pieces with pseudonyms in "Drita" newspaper (1973-1987).

In this paper, we discuss the poems "Vietnam", "Bateritë kundër ajrore" and "Ullinjtë shqiptarë në Vietnam" taken from *Motive me diell* and the chapter "Nën qiellin e Vietnamit" from the book *Linja të largëta. Shënime udhëtimi*. Focused on the writings of I. Kadare published under the name Gent Arbana, we highlight some of them published in the newspaper "Drita". In the isolation of socialist realism I. Kadare is

one of the very few who can give the other's image because he has the freedom to do so. He could travel abroad, meet foreigners, write for them. It was one of the few that could give someone else's image in some genres of writing. He could write about America, Denmark, Paris, Moscow, Vietnam, Russian literature after 1960, Western literature of the time, special authors, publishing concerns, and about the culture of "The other" at the time. This theme in his work is also related to other topics in his work such as repetition in the literary work and the importance of variant in his prose and poetry.

Vehbi MIFTARI

ETNOLETRA SHQIPE
(Miti, gjuha dhe kujtesa në letërsinë shqipe, nga humanistët te pasromantikët)

Njerëzit e një "religjioni" a të një gjuhe besojnë në disa vlera, të cilat jo rrallë i shndërrojnë në premisa për vepra artistike. Dhe, këtu zë fill ndërlidhja mes përkatësisë kombëtare (asaj që më vonë do ta quajmë quajmë *kombëtarizëm prapakthyes*) dhe letërsisë si mjet shprehjeje për mitin, kulturën, religjionin, historinë e përbashkësinë. Sikur propozonte Ernest Gellneri, në versionin e tij socio-kulturor të paradigmës moderniste, letërsia është mjet për krijimin e "homogjenitetit kulturor". Porse, ky lloj homogjeniteti nuk është i mundur pa përkatësinë e miteve e të simboleve,[1] pra pa artefaktet e trashëguara kulturore, krahas atyre që Benedict Andersoni i shihte si *artefakte kulturore moderne*, duke e identifikuar me to edhe vetë formimin e kombeve. Ai (po e cilësojmë: *homogjenitet artefaktor*) përbën "energjinë e vazhdueshme të kombëtarizimit" ose historinë e vlerave të përbashkëta simbolike të etnisë, të cilat Adam Smithi i kategorizonte nën emërtimin "etno-simbolizëm historik",[2] e i cili përbën të "kaluarën e gjallë" të popujve.

Etnoletra shqipe e trajton ndikimin e letërsisë në krijimin e "përkatësisë" gjuhësore, kombëtare, kulturore e historike, si përbashkësi vlerash, besimesh e sjelljesh. Në raport me të, pastaj, e heton ndikimin e përkundërt, rolin që kjo përbashkësi vlerash e besimesh[3] (të artikuluara fillimisht si *vetëdije* kulturore) e luan në zhvillimin e letërsisë, ose, së paku, të një fare të saj. Kësisoj, n*yja përkatësore* (identitare) do t'i përafrojë në një rrafsh studimi *letërsinë* e *kombin*, për të sprovuar se letërsia është mjet për krijimin e *identiteteve* në shoqëri dhe se jeton përhershëm e pashkëputur sojesh, sado që zhvillohet herë duke u pajtuar e herë duke u përplasur me të.

---

[1] Kompleksin e miteve të cilat i shpalosin rrënjët e kulturës së përbashkët, A. Smithi e trajtonte si "kompleks të mit-simboleve". Me të ai e nënkuptonte ndërveprimin e vazhdueshëm mes miteve, simboleve dhe komunikimit për to. Të shihet: A. D. Smth, *Ethno-Symbolism and Nationalism*, ("Routlidge", London, New York, 2009), fq. 24.

[2] Po flasim për elemente "etnike" dhe jo "kombëtare" për të krijuar raportin me trashëgiminë, e cila e njeh etninë si formë primordiale të formimit të kombeve, më vonë.

[3] "Përbashkësia" është parë si nocion i përshtatshëm për të përmbledhur atë që Maks Veberi (Max Weber) e shihte si *ndjenjë të përkatësisë së përbashkët* (zusammengehörigkeitsgefühl). Të shihet: Max Weber: *Studies in sociology*. Cituar sipas përkthimit në gjuhën shqipe: Max Weber, *Studime sociologjike,* përktheu: Enida Rusi ("Plejad", Tiranë, 2004), fq. 129.

I. Etnomitet[4]

Zhvillimi i *etnoletërsive* (në shumës) është i lidhur ngushtë me ekzistencën e *etnomiteve*. Ngaqë jetojnë përgjithnjë në shtratin e lëtërsisë, ato e marrin statusin e "përhershmërive", pra prekin jo vetëm *tekstin* (një tekst), por *tekstet*, letrarësinë. Kësisoj, *trashëgimia mitike* bashkëveporon me *trashëgiminë entike* dhe së bashku e ndërtojnë një platformë për "jetë kombëtare". Ato i lidh së bashku nyja e historisë. Pra, etnomitet janë invariant e variant njëkohshëm, strukturë e cila e përforcon arkistrukturën, duke u rimodeluar.[5] Miti i prejarjdhjes, ta zëmë, qe shndërruar në mit të pëlqyer për të gjithë romantikët. Kjo nënkupton që miti është solidarizim me besimin në një pasqyrë rrëfimtare dhe ja pse ai i kthehet letërsisë si mjet shprehjeje për transcendencat, qofshin ato etnike, kulturore ose idealogjike (jo: ideologjike). Edipi e kërkonte përkatësinë personale dhe, në literaturë, zbulonte se ajo qe e shumëfishtë. Hesiodi e shkroi *Teogoninë* e tij për t'i kërkuar rrënjët e popullit të lashtë grek. Romantikët i kërkuan ato edhe aty ku mund të mos ekzistonin.

Nisur nga titulli i veprës, *Historia e jetës dhe e vepravet të Skënderbeut*, [6] Barleti po shkruante tekst historie. Pra, në kuptimin referencial, teksti i përshkruan të ndodhurat (ngjarjet reale). Por, duke qenë se i mungonin referencat historike, ai i kërkonte dhe i gjente ato në *kujtesën* e njerëzve për to. Veçse, ky *kujtim* nuk përbën *të vërtetën*, por "thurjen", rrëfimin për të, ose, më saktë, rrëfimin e shndërruar në *mit*. Pra, Barleti nuk shkruan vepër të diskursit historik (sikur e thotë vetë), nuk ka referencë me të ndodhurat, por me *kujtesën* për to; nuk i referohet realitetit, por *iluzionit të realitetit.*[7] Barleti i përmbahet parimit të mbindërtimit të realitetit letrar përmbi atë jetësor, por, ngaqë ky realitet është *i kujtuar* dhe jo *i jetuar,* ai e ndërton këtë përvojë përmes jehonës, kujtimit, pra mitit. E, jehona e kujtimit të heronjve dhe betejave është njëra nga shtysat historike për kujtesë të përbashkët. Ajo ka ndikuar në *përbrendësim* e *përbashkim*. Shenjat e para të këtij përbashkimi përmes mitesh i gjejmë në mesjetë. Bashkësitë religjioze, të lidhura përmes gjuhës, qenë bërthamat e para autentike të

[4] Në rrafshin teorik, për rolin e miteve në formimin e kombeve jemi mbështetur në konceptet e Anthony D. Smithit (të shihet: *Myths and Memories of the Nation,* New York Oxford University Press, 1999). Për aspektin antropolgjik të këtij dimensioni janë konsultuar kryesisht teoritë e Claude Lévi – Strauss-it (Të shihet: *Mito e significante*). Për rolin që mitet dhe mitologjia luajnë në krijimin letrar është konsultuar dija teorike e ofruar nga strukturalistët, sidomos nga Rolan Barti (të shihet: Roland Barthes, *Mythologies*, "Editions du Seuil", Paris, 1957). Për praninë e tij në diskurse/forma letrare është konsultuar teksti i Kujtim M. Shalës, *Analepsa* (Fondacioni "Ibrahim Rugova", Prishtinë, 2013), ndërsa për praninë e mitit në etnopoetikat nacionale është konsultuar libri i K. Rrahmanit*, Antropoetikë – Një confession* ("AIKD", Prishtinë, 2008).

[5] Për funksionet e mitit në shoqëri të shihet: A. Smith, *Myths and Memories of the Nation,* e cit., fq. 57-93.

[6] Marin Barleti, *Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum principis,* përkthyer nga nga: Stefan I. Prifti: Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e vepravet të Skënderbeut* ("Rilindja", Prishtinë, 1989), fq. 48.

[7] Për këtë dimension të shihet libri im: *Teoria e objektit* ("AIKD", Prishtinë, 2001), fq. 52-57.

përbashkimkit mitik komunitar. Kjo prirje drejt homogjenizimit të kulturave zhvillohej përmbi dy premisa të fuqishme: *komunikimin* dhe *socializimin*.[8] I pari, komunikimi, zhvillohej përmes një gjuhe të gjithështrirë, gjuhës së shenjave dhe jo të simboleve, latinishtes.

Duke i përkthyer tekstet e vjetra fetare, autorët filobiblikë e plotësonin kriterin e parë të *përbashkimit religjioz*: komunikimin "në gjuhë të vendit", duke e ndërtuar edhe substratin për bashkimin e njerëzve, të cilët jo vetën e flasin të njëjtën gjuhë, por edhe besojnë në të njëjtat vlera të përbashkëta. Në kuptimin e paradigmave, ata, krejtësisht ndryshe nga humanistët, e thurën *mitin religjioz,* përmes pasqyrimit të fjalës së shenjtë në gjuhën e besimtarëve. Letërsia shqipe e mëvonhsme e njohu këtë trashëgimi, duke e zhvilluar një tip letrash i cili i referohej mitit religjioz mesjetar, sidomos në nivel të diskursit. Sot flasim për një letërsi të gjerë me parabazë biblike, e cila paramodelin e gjen pikërisht në këtë tip letërsie.

Buzuku e shkroi *Mesharin n'së dashunit së botësë sanë*,[9] duke e shpallur botërisht synimin e tij: *me zdritunë pak mendetë e atyne qi të ndiglonjinë*. Gjykuar nga pikëvështrimi etno-simbolist, ai i përmbush tri kritere të fuqishme me të cilat ndikon në përbashkimin rreth disa vlerave: e kultivon gjuhën shqipe, e kodifikon "amor patria"-n si shtysë për krijimin artistik, si dhe i fton anëtarët e bashkësisë së tij religjioze që të mblidhen rreth disa vlerave të përbashkëta, të cilat, sado që i referohen kishës, janë përtejkishtare e përtejliturgjike: janë kulturore.

Budi e ndërlidhi krijimin me përshpirtësinë, duke e trajtuar poezinë, artin, si përmasë kulturimi. Poezia e tij e ndërlidh veprimin kryesisht në nivel të përpjekjes për *dishmim* të gjuhës shqipe. Sado jo shumë e lartësuar artistikisht, ajo shënjon përpjekjen e madhe për përdorim të trajtave e të shprehjeve gjuhësore të fuqishme.

Bogdani e jetësoi *mitin teologjik të esencës/ekzistencës* në të parën vepër artistike shqipe. Miti i esencës / ekzistencës (zotit, të një zoti, i cili është njëkohshëm qenie dhe prani) rrjedh nga filozofia mesjetare, e cila e njihte trinitetin (Atin, birin e shpirtin) si formë të qenies së përhershme, qenie e cila ekzistonte në vete:

Zoti asht nja ndë Natyrë e tre ndë vetet, të sillt thonë: Ati, Biri e Shpirti Shenjt.[10]

Variboba kërkonte ta thurte *mitin e shëmbëlltyrës morale*, si vlerë mbi të cilën mund të ruhet ky besim. *Gjella e shën Mërisë Virgjër* e ruan referencën me një poetikë e me një filozofi të krishterë, të cilën e shndërron në referencë të brendshme të tekstit. Për të, *kulti i dashurisë* shndërohet në *kult të familjes*, të dashurisë për njerëzit e afërm.

Romantizmi, dëshmia e ekzistencës dhe platforma e kanonizimit të kombeve, solli lindjen e miteve që lidhen me origjinën, traditën dhe kulturën. Shumica e

[8] A. Smith, *National Identity*, London, Penguin, 1991, fq. 6.
[9] "Për dashuri ndaj atdheut". Të shihet: Gjon Buzuku, *Meshari*, 1555, fq. 387.
[10] Pjetër Bogdani, *Çeta e profetëve* (Padova, 1685). Cituar sipas: Ibrahim Rugova, *Vepra e Bogdanit,* (Instituti Albanologjik i Kosovës, Prishtinë, 1982), fq. 88.

romantikëve, duke përfshirë edhe romantikët shqiptarë, e zhvilluan mitin e origjinës dhe të racës, të cilat së bashku e përbëjnë *mitin e lashtësisë*. Ata krijuan lëvizje kulturore e letrare përmes së cilës synonin "ta zbulonin" origjinën e kombit dhe ta përdornin atë si premisë për letërsinë e artet.

Romantikët i ktheheshin këtij miti, ngase përmes tij donin ta dëshmonin origjinën e kombit. Naim Frashëri, i cili ndikoi më shumë se kushdo në përbrendësimin e shqiptarëve rreth idesë së përbashkësisë, sipas parimit romantik e zhvilloi mitin e ndërlidhjes së populit me tokën. Pellazgët,[11] paraardhësit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve, jetuan në këto troje "bota që kur është zënë".[12] Vepra e tij e shpalos një raport dhe e ngjallë *mallin për përjetësinë* (për zotin si simbol të pavdekësisë), nga i cili derivon një mall tjetër: *malli për vendin*, malin majelartë, Tomorrin, si vend i cili është i lartuar nga zotat. Asdreni përkatësinë e olimpit shqiptar e shihte të ndërlidhur me fuqinë që atij ia jep gjuha, si shprehje e identitetit kombëtar. Gjuha shqipe është gjuha e zanave dhe e zotave, është hyjnore, prandaj buçima e saj është e tejkohshme dhe e tejkufishme.

Fishta e krijonte mitin ideal të etno-vendit (territorit të lidhur me etninë) në një poetikë himnizuese. Ai është vendi i "bijve të shqipes". Kësisoj, *përmasa vendësore* e miti mbi lashtësinë shihet e pashkëputshme nga *përmasa kohësore*: vendi duhet të jetë një lloj përfytyrimi i "parajsës tokësore" sipas përmasës hyjnore; ai duhet të jetë jo vetëm i dashur, por edhe i trashëguar.

Edhe hâna do t'a dije, / Edhè dielli do t'két pá, / Se per qark ksaj rrokullije, / Si Shqypnija 'i vend nuk ká.[13]

Kristoforidhi, me *Gjahun e malësorëve-Hija e Tomorrit* [14] *e teritorializon kujtesën* (nocion i A. Smithit). Vendi lind ndjenjë dashurie, ngase e ruan kujtesën tonë, na i zbulon rrënjët e fshehura dhe na e shpalos raportin me të shkuarën, relacionin me perënditë, prandaj edhe me përjetësinë. Ndjenja që e përfitojmë përmes tij është malli, malli për të shkuarën e për përjetësinë.

Noli e rikrijoi mitin vendësor të ndërlidhur me historinë. Për Nolin, miti i heroit është i lidhur me parimet e tij për jetën: si njeri i kishës ai e kërkonte njerëzoren për secilin anëtar të bashkësisë religjioze. Ai e krijoi mitin e heroit moral, pasqyrimi i të cilit është thellësisht përbashkues: ai shërben si shëmbëlltyrë morale dhe si fuqi për krijim të ndjenjës së *njësisë*, pra të një bashkësie e cila është egalitare, morale e unitare.

[11] Ai i shihte shqiptarët si pasardhës të pellazgëve e pellazgjishten si pararendëse të gjuhës shqipe.
[12] Naim Frashëri, *Shqipëria*, në: Vepra I ("Rilindja", Prishtinë, 1978), fq. 185.
[13] At Gjergj Fishta, *Shqypnija*, në: Fishta: *Lirika* ("Rilindja", Prishtinë, 1997), fq. 37.
[14] Konstandin Kristoforidhi, *Gjahu i malësorëve – Hija e Tomorrit* (tregimi është shkruar më 1884, por është botuar vetëm më 1902, në variantin toskërisht, në *Albania*-n e Faik Konicës. Më vonë ka njohur edhe ribotime të tjera).

Pashko Vasa, në poezinë *Mori Shqypni e mjera Shqypni,* dëshmonte një përplasje mes gjendjeve, strukturës e diskurseve: nga gjendja e krenarisë kalohet në përbuzje të thellë dhe, rishtas, në shpresë për ringritje; struktura e saj është ciklike: ajo i referohet së shkuarës, zbret në të tashmen dhe synon motivimin e së ardhmes; diskursi, ndërkaq, zbret nga *himni* në *lament*, për t'u përmbyllur me *thirrje*, për të dëshmuar poetikisht lidhjen e fuqishme ripërtëritëse mes *rënies* e *ringjalljes* (kujto: reinkarnimin te Danteja).[15]

Sikur dihet, *homeland*-i (hapësira territoriale e anëtarëve të një familjeje, fisi a bashkësie të zgjeruar), si dhe *amor patriae* (dashuria që anëtarët e komunitetit shfaqin për vendin e tyre), janë shtysat për krijim imagjinar nga këngët osianike e këndej. "Përlindja shpirtërore" e ka ushqyer sistematikisht raportin mes letrave e miteve paraletrare. Të dyja kanë ndikuar barasvlershëm në letrat shqipe, sidomos të viteve '30-'40 të shekullit XX, periudhë në të cilin u krijua një *platformë kombëtare kulturore*, u konsolidua jo vetëm *letërsia e temave kombëtare* (me kodifikues Krist Malokin), por, përmes një projekti programatik i cili mblodhi rreth vetes elitat kulturore e kombëtare, u jetësua edhe projekti i *idesë kombëtare* dhe i *ndërgjegjësimit kombëtar*.

II. Etnogjuha

A është letërsia, prandaj, edhe shprehje e shpirtit të kombit, i cili e flet një gjuhë dhe i kultivon disa tradita të përbashkëta, apo gjuha është, thjesht, mjet për t'u shprehur artistikisht?[16] Nëse e pranojmë për të mirëqenë parimin herderian se "në gjeninë e gjuhës ndodhet shpirti i kombit", lidhja mes shenjës së gjuhës e shenjës së kombit bëhet e përhershme.[17] Thelbësor, prandaj, mbetet hamendësimi nëse gjuha është shenjë formuese e përkatësisë, apo mjet shprehës i saj. Për ta hetuar këtë raport që gjuha ka me trashëgiminë letrare në një fill krijimi të kombeve, duhet ta pranojmë qasjen veberiane për *trashëgiminë si paradigmë*. Sipas saj, gjuha mbetet shenja përdalluese (besimi në trashëgimi), krejtësisht e veçantë nga çfarëdo përbashkimi tjetër dhe,

[15] Të shihet: Dante Aligheri, *La Divina Commedia*, shkruar mes viteve 1308-1321, botuar më 1555. Botimi në gjuhën shqipe: Dante Aligieri, *Komedia hyjnore*, përktheu: Pashko Gjeçi ("Rilindja", Prishtinë, 1969).

[16] Sikur do të provojë libri, kombet shihen si derivat i trashëguar etnik, por jo të gjitha kombet kanë etnogjenezë të vetme të përbashkët, prandaj gjuha, përpara se të jetë mjet shprehjeje e një letërsise të zhvilluar në një gjuhë, është shenjë përdalluese, karakteri i së cilës është motivimi i përbashkët i përdoruesve të saj.

[17] Për këtë epokë shkrimesh, "gjuha, poezia dhe populli nuk përbëjnë vetëm veçse një tërsi". Të shihet, A. M. Thiesse, *La création des identities nationals – Europe XVIII-XX siècle*, (Éditions de Seuil, Mars 1999). Cituar sipas përkthimit në gjuhën shqipe: Anne-Marie Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare – Europa e shekujve XVIII-XX*, përkthyer nga: Etleva Shiroka ("Dukagjini", Pejë, 2004), fq. 45. Po kështu, gjuha shihet si faktor "bërthamë" në krijimin dhe ekzistimin e kombeve. Rrjedhimisht, roli i saj përbashkues është i jashtëzakonshëm, krahas shenjave të tjera, sikur janë territori, miti, simbolet e kujtesa e përbashkët.

rrjedhiisht, trashëgimia e cila thirret në kujtesë sa herë që ndjejmë nevojë për shenja identitare.

Për humanistët gjuha nuk qe tipar identitar. Gjuha e tyre qe latinishtja, gjuha e dijes e e kulturës. Por, ngaqë e kishin bartur me vete karakterin e qëndresës, autorë si Segoni, Barleti, Beçikemi, Frangu etj., shkruanin letërsi e cila synonte ta letrarizonte deri në vetëdije kulturore këtë karakter. Kjo është arsyeja pse ata shkruan kryesisht *letërsi heroike*. Letërsia e tyre e kultivon përkatësinë, historike e kulturore.

Për filobiblistët gjuha qe mjeti me të cilin ata e kërkonin krijimin e identitetit social për arbërishtfolësit, para se ta synon përkatësinë letrare. Buzuku, Bogdani, Budi, Bardhi, Variboba etj., për ndryshim nga humanistët, kishin synim që duke e kultivuar *letrën* ta sendërtonin *gjuhën*. Ve]se, duke e përfituar gjuhën, ata e braktisnin subjektin: nga subjekti shqiptar e gjuha latinishte e humanistëve, i ktheheshin gjuhës shqipe, por e përfillin subjektin biblik. Kulti njerëzor i humanistëve vjen e zëvendësohet me kultin e gjuhës e me kultin religjioz, tipare këto të letërsisë filobiblike (prandaj edhe emërtimi filobiblistë).

Gjon Buzuku kultin e gjuhës e shndërroi në synim jetësor: të shkruante vepër 'ëndë gluhët tanë" (në gjuhën tonë), krahas synimit për "të zdriturit" e mendjes së besimtarëve të krishterë.

Lekë Matrënga është shembull klasik i përkushtimit për gjuhën si përkatësi e përbashkët. Ai prirej të shkruante poezi jo nga premisa letrare, por kulturore. Vetë ai thoshte se "Këngën e përshpirtshme", më të njohurën poezi të tij, nuk po e shkruante ngaqë i kishte përcaktuar vetes synime letrare në tekst, por që t'u shërbente bashkëfshatarëve të tij, madje edhe arbëreshëve të Kalabrisë e të Puljes.

Pjetër Budi e ruante kultin e gjuhës, pra synimin për të përkthyer e shkruar në gjuhën shqipe, por *kultin religjioz* e zëvendësonte ngadalë me *kultin letrar*. Prej këtej, mbase, cilësimi i veprës së tij si e para vepër në gjuhën shqipe dhe për vetë Budin si autori i parë original në gjuhën shqipe, kryesisht me poezitë e tij, të botuara në *Doktrina e Kërshtenë (1618)* e gjetiu në katër veprat e njohura të tij.

Për ndryshim, ndoshta, nga autorët e tjerë filobiblikë, Budi e lartësonte gjuhën në nivel të ideologjisë. Ai synonte që përmes saj të ndikonte në krijmin e "përbashkësisë", tashmë jo vetëm si masë sociale, por si platformë për krijimin e një përkatësie të qëndrueshme fetare e etnike.

Bogdani është thellësisht përbashkues, ngaqë i zhvillon disa lloje besimesh mes njerëzve: besimin në krijuesin e botës, besimin në shkathtësitë njohëse të besimtarëve, besimin në dijen e në urtitë, besimin në gjuhën si mjet i cili mund t'i shprehë ndjenjat e përbashkëta të besimtarëve. Kulti i gjuhës aty zhvillohet së brendshmi, si pjesë e krijimit, por nuk është qëllim *më vete*. Duke qenë vepër e shkruar në gjuhën shqipe *Çeta e profetëve* (Cuneus Prophetarum) është vepër e *përkatësisë shqipe*. Parathënia e "Çetës së profetëve", *Të primitë përpatra letërarit*, e ridëshmon përcaktimin budian "për t'i shërbyem dheut", pra për ta lartësuar gjuhën në nivel të literaturës, si mjet për krijim

identiteti e ruajtje të tij. Por, për ndryshim nga Budi, mdaje edhe nga të gjithë filobiblistët, ai nuk e synonte këtë lartësim vetëm duke e bërë të pranishme atë, por duke i zgjeruar e shumëfishuar mundësitë e saj shprehëse. Ta zëmë, derisa pararendësit e tij synonin ta përjetësonin gjuhën idiomatike të krahinave prej nga vinin, Bogdani dëshmonte për vetëdije të lartë në përdorimin e saj (mbase edhe ngaqë idioma e tij nuk përputhej me synimin dhe lexuesit e tij),[18] duke i përbashkuar format shprehëse të gjuhës (ta zëmë idiomën e tij hasjane me mbishkodranishten), por edhe duke i zgjeruar mundësitë shprehëse të saj. Pra, ai e zgjeronte fjalësin e gjuhës shqipe (qoftë duke krijuar fjalë të reja, qoftë duke i përshtatur të vjetrat), por në të njëjtën kohë përqendrohej edhe në zgjerimin e mundësive shprehëse të saj. Por, meqë synim yni këtu nuk është studimi filologjik i veprës së tij, por raporti që vepra e tij letrare krijon me përkatësistë, duke e nënvizuar veçan përdorimin e gjuhës si mjet përbashkimi, po mjaftohemi të venerojmë këtu se ai e arrinte këtë nivel gjuhësisht dhe letrarisht: përmes koineizimit dhe prirjes artistike.

Variboba është bogdanian në kuptimin e shkrimit identitar, por është buzukian në kuptimin e ndërtimit të kultit relizgjioz përbrenda tekstit: bogdanian ngase përballë tekstit e synoi letrarësinë, pra të shkruante tekst thjesht letrar; buzukian ngase ky tekst letrar e ruante doktrinën përbrenda, i referohej asaj. Në letrën që ia drejtonte lexuesit,[19] Variboba i kërkonte atij që ta pranonte veprën e tij, duke e shtruar edhe argumentin:

… *e puru mbrënda ndë këthough kart ësht edhe dotrina e Krishtit.*

Bejtexhinjtë, për ndryshim nga humanistët e sidomos nga filobiblistët, shkruajnë tekste të cilat i përafrohen të shkruemit letrar. Krijimtaria e tyre, prandaj, e shmang përorimin e gjuhës si mjet përbashkësie dhe e kufizon atë në funksion letrarësie, duke e përdorur atë si mjet të të shprehurit letrar. Rrjedhimisht, ata qëndrojnë mes filobiblistëve e pararomantikëve e romantikëve si një daltë letrare, e pandjeshme ndaj funksioneve tjera të tekstit përpos atij letrar.

Për romantikët gjuha qe shenja e parë e krijimit të identitetit nacional. Për ta gjuha qe shtyllë identifikuese e konsolidimit të *kombit* shqiptar. Ajo e krijoi dhe e ruajti substancën kombëtare. Prandaj, konsolidimi gjuhësor nënkupton këtu e tutje konsolidim kombëtar. Kjo është arsyeja pse Kamarda, Kristoforidhi, S. Frashëri etj., duke e ndjerë peshën që ka gjuha në krijimin e palcës kombëtare, iu përkushtuan

[18] Për mesjetën është e zakontë që gjuha e folur nga një bashkësi të mos përputhet me zgjedhjen e gjuhës së shkruar. Të shihet: B. Andersoni, *Imagined Communities: Reflectiones on the Origin and Spread of Nationalism* (Verso Editions and New Left Books, London, 1983). Benedict Anderson, *Komunitete imagjinare,* përkthyer nga: Brenton Kotorri, ("Dy lindje & Dy perëndime", Tiranë, 2013).

[19] Letra *Oj ti që dhiavasën,* si edhe letra tjetër drejtuar Shën Mërisë, *Oj e ndeermja Rexhi*, janë të shkruara në prozë, kurse vepra është e shkruar në vargje.

hartimit të gramatikave të saj. Këto gramatika, pastaj, qenë çelës për zhvillimin e letërsisë romantike. Pra, me romantikët, gjuha dhe letërsia identifikohen si shenja të ekzistencës kombëtare, ndërkohë që i japin vetë atij (kombit) vulën e ekzistimit, duke ndikuar në krijimin e përkatësive.[20]

Në rrafshin gjuhësor, lidhja e fuqishme e letërsisë me "kombin" shprehet në *mjetet fjalësore* (leksikore) që ajo i përdor për ta portretizuar vendin "që e krijoi". Letërsia e romantizmit ka krijuar emërtime të fuqishme, të cilat këtë lidhje e shndërrojnë në lidhje të pashkëputshme mes gjuhës e objektit të saj.

Për romantikët, ta zëmë, vendi quhet me emërtime të ndryshme. Asdreni e quante *atdhe* dhe me të e nënkuptonte *patria*-n. Vjershën *Për atdhenë* e titullonte sipas thirrjes: *pro patria*, e cila del në nëntitull të saj.[21] Në një perspektivë epike, vjersha e synon motivimin e bashkëkombësve për realizimin e synimit: konsolidimit të kombit e të kombëtarisë (*atdhesisë).* Ai i thur lavde gjuhës, ngase sojesh buron dëshmia për ekzistencën e lashtë, kujtimi për qëndresën historike dhe ndjenja për shpirtin e kombit. Poezia e tij kushtuar gjuhës shqipe, *Gjuha shqipe,*[22] me vlera jo të larta artistike, dëshmon lidhjen që gjuha e ka me vlerat përkatësore, por edhe me mundësinë që sojesh të krijohet një motiv përbashkimi, i cili i përafron të gjithë bashkëkombësit drejt një qëllimi: konsolidimin e kombit:

Tek ty qëndron virtuti i gjindjes sonë /Ti t'arthmen me të shkuarën bashkon[23]

De Rada e shihte gjuhën si shenjën themelore të përkatësisë kombëtare. Ajo është tipar dallues mes kombeve të ndryshme, trashëgimia që një popull e bartë me vete:

(...) e vetmja cilësi që e shquan një popull dhe e bën të njihet kudo ku mund ta hedhë fati, është gjuha.[24]

Ndërsa e shkruante *Skanderbekun e pafân* (poemin e madh),[25] de Rada besonte se përmes tij po ndihmonte në ruajtjen e traditave të kombit, po e lartësonte gjuhën dhe, madje, po e "përtërinte kulturën dhe fatin e kombit".

Fishta e trajtonte gjuhën jo vetëm si shenjë përkatësore, por edhe si mjet përkatësor, të rëndësishëm për ta shprehur veçantinë etnike, kulturore e kombëtare.

[20] Të shihet: Rexhep Qosja, *Histori e letërsisë shqipe I, II, III* ("Rilindja", Prishtinë, 1984).
[21] Të shihet:, Për atdhenë, në: *Rreze dielli*, e cit. fq. 138-139.
[22] Të shihet poezia *Gjuha shqipe*, në Asdreni, *Psallme murgu*, botimi i dytë, i plotësuar ("Rilindja", Prishtinë, 1987), fq. 15.
[23] Po aty.
[24] Jeronim De Rada, *Parime të estetikës,* në: *Vepra letrare 3* ("Naim Frashëri", Tiranë, 1987), fq. 267.
[25] Të shihet: Jeronim De Rada, *Skanderbeku i pafan – Histori e shekullit XV*, përgatitur nga Jup Kastrati,, në: *Vepra letrare 6* ("Rilindja", Prishtinë, 1988), fq. 6.

Në poezinë *Gjuha shqype,*[26] krahas funksionit shprehës, ai ia njihte asaj edhe tiparin e shprehjes së "shpirtit të kombit". Në të shpaloset një dimension i fuqishëm i kësaj lidhjeje simbolike mes gjuhës, territorit e bashkësisë kulturore e politike (popullit që flet një gjuhë, ka një territor dhe i përket së njëjtës trashëgimi etnike e kulturore):

Edhè shqyp na thanë se Zoti / Per Shqyptarë Shqypnín e fali.[27]

Lidhja më e fuqishme mes gjuhës, mjeteve të saj shprehëse dhe ideologjisë autoriale te autorët romantikë është krijuar në poezinë lament të Pashko Vasës, *Mori Shqypni e mejra Shqypni*. Duke i thirrur *kujtesës*, autori e ringjallë *kujtimin* për një kohë e një gjendje, kur *patria*, Shqypnija, shkëlqente mes vendeve të tjera. Ai e quan atë "zonj'e randë" e nanë, ndërsa bashkatdhetarët e tij "burra të dheut":

Ti më ke pas ken një zonj'e randë, / Që burrat e dheut të quejshin nanë;

Kodi i gjuhës shpreh ekzistencialitetin karshi esencialitetit, si shenjë *identiteti* dhe esencë e tij. Këtij kodi Ernest Koliqi ia kushtonte poezinë *Gjuhës Shqipe*.[28] Poezia është *himn* për gjuhën. Kulti i saj, i pranishëm në tërë librin, e ndërlidh esencialitetin me autenticitetin, për të shfaqur një dimension identiteti, edhe në shkrim. Koliqi e shihte gjuhën si mjet për zbulim e ridëshmim të "shejave të mshefta" të një kombi.

Naim Frashëri synonte që ta lartësonte gjuhën, duke e përdorur si mjet shprehjeje, por edhe duke ia njohur rolin përbashkues që ajo bart në jetën e kombit. Pra, ai e ngriti mitin "e gjuhës në gjuhë", duke e krijuar lidhjen e pashkëputshme mes jetës së kombit e gjuhës së kombit, si dhe duke ia njohur asaj vetitë përbashkuese (unifikuese). Për të, gjuha qe premisë e fuqishme etno-sociale:

E par' e gjithë mbrothësivet, që i duhenë një kombi, është gjuh' e Mëmëdheut. Gjuha e bashkon kombin, e ndriton, e nxjerr nga errësira.[29]

Himnet kombëtare / "Fryma e përbashkësisë"

Tipar i dytë dallues i raportit që letërsia e romantikëve e krijon me kulturën identitare, janë himnet kombëtare.[30] Ato shfaqen si krijime letrare të përcaktuara nga

[26] Të shihet: Gjergj Fishta, *Gjuha shqype*, në: *Lirika* ("Faik Konica", Prishtinë, 1997), fq. 43.
[27] Po aty, fq. 45.
[28] Të shihet: Ernest Koliqi, *Gjurmat e stinve* (Tiranë, 1933).
[29] Të shihet: Naim Frashëri, *Vepra 1* ("Rilindja", Prishtinë, 1978), fq. 21.
[30] Çështja e himneve kombëtare të vendeve të ndryshme filloi të popullarizohej fillimisht në Angli, aty nga mesi i shek. XVIII. Në fakt, himne ka pasur edhe përpara kësaj kohe, por rëndësia dhe kuptimi i tyre nuk ka qenë në këtë shkallë kaq të rëndësishme së cilës i referohemi ne sot, pasi askush nuk e mendonte se ky lloj formimi i ri muzikor do të përfaqësonte një nga gjetjet gjeniale të të shprehurit të shpirtit të popujve. Muzikologjia daton si të parin himn atë të Holandës, himn i cili i përket vitit 1572 - "Wilhelmus van Nassouwe". Ndërkohë, himni me fjalet më të vjetra në origjinë i përket himnit japonez, rreth shek. IX, tekst i cili rrjedh kryesisht

objekti: kombi, prodhim i së cilës janë edhe vetë himnet. Tema: mobilizimi drejt përbashkimit kombëtar. Imazhi: unisonanca, madje edhe atëherë kur himni mund të mos funksionojë plotësisht si krijim letrar, ose melodik. E rëndësishme është se në të gjendet "fryma e përbashkësisë" dhe të gjithë pjestarët e një populli priren të lidhen në vargjet a notat e tij, pavarësisht se i ç'niveli është teksti ose kompozimi.

Himni është pjesë e *repertorit përdallues simbolik*, prandaj krijon lidhje të fuqishme emocionale, sepse përmes tij (dhe simboleve të tjera përdalluese), ai e ndihmon krijimin e *vijimësisë*, të vashdimësisë së jetës së përbashkët të anëtërëve të bashkësisë. Në simbolikën e tij ndërlidhet gjithë historia e kombit, kultura e trashëguar, ndjenja për të përbashktën, për dallueshmërinë, për atë që "vetëm ne jemi". Pra, himni (sikur edhe flamuri) prek ndjenjën e thellë të ekzistimit të kombit në histori; ai është trashëgimia e përjetësuar në simbol. Himni shqiptar, përmes asaj që Vasil Tole e quante "kushtim të një simboli kombëtar një tjetër simboli kombëtar – flamurit",[31] është ndërlidhja më e fuqishme e mundshme mes shpirtit të kombit dhe "kangës së kombit", shprehjes, ose tingullit të parë të shtetit të shqiptarëve.

Ndërsa i pari, flamuri, ishte shenja e parë e shtetit, i dyti, himni, ishte tingulli kryesor i tij. [32]

Himni i krijuar prej Asdrenit ishte përpjekje e gjatë e tij për ta dëshmuar lidhjen e pashkëputshme mes *shpirtit* e *kângës*, pra mes ndjenjës e shprehjes. Madje, si për rastësi, ai kishte krijuar një tjetër vjershë, të cilën e kishte titulluar pikërisht *Hymn kombëtar*, por i cili nuk shërbeu si "himn" (në kuptimin e ndjesisë dhe jo të formave letrare), as u zyrtarizua ndonjëherë si himn kombëtar, sado që teksti i kangës qe i ngjashëm me atë të himneve kombëtare të kohës. Në të, shenja e tokës (*homeland*-i) ndërlidhet me shenjën e zotit (shenjtërinë), atdhetaria me simbolet etnike, mbi të cilat kultivohet ndjenja e përkatësisë.

Lidhjen mes *shpirtit* e *kângës* e gjejmë të shtresuar në synimin kombdëshmues në poezinë e at Fishtës, *Hymni i flamurit kombtar*.[33] Poezia del si *himn* për simbolin tjetër kombëtar, flamurin, sikur në veprën e Asdrenit. Rrjedhimisht, etnosimbolikës kombëtare Fishta ia përshkruan parashenjën e kombdëshmimit, një synim politik i romantikëve shqiptarë.

---

nga folklori. Po në këtë arsyetim, himni më i gjatë në ekzekutim është "Marcha de la Patria", i Argjentinës, i kompozuar nga Blas Parera në vitin 1813; ndërkaq, himni kombëtar me më shumë vargje është ai i Greqisë. Të shihet: Vasil Tole, *Origjina e himnit kombëtar*, http://www.parajsa.com/forum/t/origjina-e-himnit-te-flamurit (shlfetuar së fundi më 10.10.2014).

[31] "Nuk gjejmë një himn tjetër kombëtar i cili t'i kushtohet po një simboli tjetër kombëtar siç është flamuri dhe që të dy së bashku t'i kushtohen atdheut.

[32] Të shihet: Ismail Kadare, "Rreth himnit të vjetër të shtetit", në *Mosëmarrveshja – Mbi raportet e Shqipërisë me vetveten,* sprovë letrare ("Onufri", Tiranë, 2010)

[33] Gjergj Fishta, *Hymni i flamurit kombtar*, në: *Lirika*, vep. e cit., fq. 56-59.

Karakteri mobilizues i poezisë arrin që nga shenjat simboliste të thurë karakter mobilizues, i cili e njeh parimin e *territorializimit të simboleve. Homeland*-i i Fishtës shtrihet gjithandej nga shtrihet etnia; bashkësitë e tij krahinore, religjioze ose kulturore janë pjesë të komunitetit etnik, i cili i unifikon ato rreth disa paradigmash të fuqishme kulturore e historike. Kapërcimi nga motivimi harmonik parajsor në atë tokësor (të identifikueshëm përmes *amor patriae*), është i pahetueshëm:

Ndihmo, Zot, për Atme e Fe![34]

Hilë Mosi, në poezinë *Flamurit*[35] e krijonte një ndërlidhje të fuqishme mes sakrificës së përbashkët dhe kultivimit të shenjave identitare. Për të flamuri është fusha në të cilën simbolikisht përjetësohet sakrifica: *Sot duam t'skuqnim ty me gjak,* e cila pastaj shndërrohet në mjet motivues për sakrificë të metejme për mbrojtjen dhe kultivimin e përkatësisë.

Fan Noli shkruante po kështu himn për flamurin, madje këtë e vënte titull të poezisë së tij, *Hymni i flamurit*.[36] Pra, ai e ndiqte traditën romantike të thurjes së himnit, ose krijimit të simbolit nacional, në një krijim poetik i cili është "kangë solemne" kushtuar vlerave kombëtare. Porse, ky simbol, i shprehur si kangë e himn, sipas traditës romantike shqiptare rishtas i atribuohet një simboli tjetër kombëtar: flamurit. Në himnin nolian për flamurin, simbolika e tij prek disa shtresa etnosimboliste: së pari, ai përbën fushë në të cilën dëshmohet sakrifica, parim i rëndësishëm për përcaktimin dhe dëshmimin e etnogjenezës së popujve. Ai është *flamur gjak,* pra dëshmi e sakrificës dhe e historisë që i ka paraprirë krijimit të kombit. Si dëshmi ai vetë shndërrohet në kujtesë, të cilën nuk e shlyejnë kohët.

Shembujt e mësipërm dëshmojnë për peshën e simboleve etnike e kombëtare në krijimin e një vetëdijeje përbashkuese rreth disa shenjave / simboleve të cilat e përcaktojnë përkatësinë e përbashkët. Këto shenja u përkasin vetëm anëtarëve të bashkësive të caktuara.

III. Etnokujtesa

Ekziston një lidhje e përhershme ndërmjet letërsisë si mjet për shprehje artistike dhe kujtesës së kombit. Gojëtaria, epika dhe romanet historike e dëshmojnë këtë. Pra, letërsia, përveç tjerash, duhet trajtuar edhe si mjet për pasqyrim artistik të kujtesës së përbashkët, ngase ajo e merr rrëfimin epik legjendar, pastaj historinë dhe kulturën, dhe i shndërron në motive për vepra artistike, duke e ridëshmuar *rrënjën e përbashkët*. Por, po kështu, ajo vetë është substrat mbi të cilën kultivohet një lloj kujtese nga e cila

[34] Po aty.
[35] Të shihet: Hilë Mosi, *Vepra të zgjedhura I,* zgjodhi: Latif Berisha ("Rilindja", Prishtinë, 1972), fq. 21.
[36] Fan. S. Noli, *Hymni i flamurit*, në: *Albumi dyzetvjeçar në Amerikë*, e cit, fq. 37-38.

kultivohen shenjat kolektive. Pra, mes letërsisë si dëshmi kujtesore e shenjave të përbashkëta dhe kujtesës epike, legjendare, historike e deri te ajo politike, ekziston një ndërlidhje e përhershme, e shprehur në raportin e ndërsjellë motivues.

Kujtesa historike

Në jetën e kombeve, ngjarjet historike shndërrohen lehtësisht në proces mbamendjeje e rikujtimi të vazhdueshëm, kolektiv, e cila ruhet si në *kujtesë* e *përbashkët*. Pra, vlerë e përbashkët kujtesore. Kujtesa historike është njëra ndër premisat të cilat komunitetet etnike i përdorin për krijim të një përkatësie të përbashkët. Pra, kombet shndërrohen në "super-familje",[37] të cilat besojnë në solidaritetin mes anëtarëve të tyre. Kjo padyshim ndikon në përforcimin e përkatësisë së përbashkët. Në këtë kuptim, njohja e "kujtesës historike" (prej nga vijmë?) nënkupton njohjen e asaj së çfarë përfaqësojmë ne në të vërtetë (kush jemi?)

Le ta shmangim për sa të jetë e mundur rrezikun që kujtesa historike të përngjasojë me mitet. Në të vërtetë, ajo jo rrallë shfaqet në formë të mitit dhe ne i gjejmë pikëprekjet e vazhdueshme mes tyre në cilindo qëmtim për t'i klasifikuar tiparet e kombeve dhe sidomos bartjen e tyre në gjeneratat e mëvonshme. Miti letrar i Skënderbeut, i krijuar prej Barletit, është mit i cili invariantin e gjen në histori, në figurën e Skënderbeut, por i cili është bartur si variant letrar i një kujtese historike. *Kujtesa e së ndodhurës* dhe *rrëfimi i së kujtuarës,* prandaj, janë karakteristike për të e për një tip të mëvonshëm letërsie e cila rrënjët e saj i fsheh në histori. Le të ndalemi këtu.

Në librin *Historia e Skënderbeut*, Barleti *e rrëfente* të kujtuarën (kujtesën historike) të dëshmitarëve të ngjarjeve të cilat i përshkruan në veprën e tij. Kësisoj, ai shkruan *histori të rrëfyeme* për *ngjarje të kujtueme* dhe jo rrallë ua atribuon atyre madhështinë e të bëmave epike (ai thoshte se po i sillte të shkruara ngjarjet, ashtu siç ia kishin rrëfyer të tjerët). Kjo histori e ngjarjeve, e mbështjellë me petkun e epikës heroike, bartet në një tekst të shkruar, i cili po kaq sa tekst historie, është edhe tekst letërsie, ndërkohë që, sikur kemi provuar të arsyetojmë, heroi i tij nuk është hero vetëm i përmasës historike, por edhe i asaj letrare (jo vetëm për shkak të "rrëfimit"). Kjo ka ndikuar që, për herë të parë në letrat shqipe, të dëshmohet lidhja e ngjarjes me rrëfimin, në një platformë kujtese historike e të rrëfyemi letrar.

Për filobiblistët, kujtesa historike është e lidhur me kodin religjioz, i cili përhershmëritë i shihte të mundshme vetëm në konceptin eternal.

Romantikët, ndërkaq, e trajtonin kujtesën historike si rrjedhojë të *vetëdijes mitkrijuese*. Duke qenë se për ta miti mbi origjinën[38] ishte substrat mbi të cilin krijonin, ata i rikthehen historisë, qoftë asaj të dëshmuar, qoftë asaj mitike, për të dëshmuar se

[37] Të shihet: Donald Horowitz, *Etnic Groups in Conflict* (Barkeley, Los Angeles & London, University of California Press, 1982).

[38] Të shihet pjesa mbi rolin e miteve në krijimin e identiteteve në këtë libër.

kujtesa për të është jo vetëm ridëshmim përmes letrash i "motit të madh" (De Rada), por edhe shkrirje mes dimensionit epik e historik dhe veprës letrare. Sikur u theksua në krye të kësaj pjese, heronjtë letrarë të Fishtës janë po kaq letrar sa edhe historikë. Kufiri mes dy botëve është i tejholluar. Kjo është arsyeja pse epika, nga Homeri e këndej, ia mundëson njerëzimit rilindjen në kujtesë, të vendeve, kohës dhe historisë së të parëve.

Kujtesa historike e De Radës synon ta rindërtojë modelin jetësor të dheut të Arbrit në dhe të huaj, pra ta rikujtojnë e rindërtojnë jetën e arbrishtfolësve, e cila ngaqë nuk është reale, është shenjë personale, e kujtesë e saj. De Rada e shkroi kujtesën për "motin e madh", për të dëshmuar se *historia e kujtueme* është *histori e rishkrueme* dhe se dimensioni epik i saj shndërrohet në motiv të fuqishëm lirik. Në *Këngët e Serafinës Topia (I canti di Serafina Thopia)*[39]ai ngjallte fragmente poezish të jetës arbërore të kohës së Skënderbeut (dhe jo fragmente të një poeme të moçme mbi Skënderbeun). Me *Rapsodi të një poeme shqiptare (Rapsodie d'un poema albanese)* synonte ta krijonte mallin epik e epin gojor nacional të shqiptarëve të shekullit të Skënderbeut, sikur e quante vetë ai.[40] *Rrëfimet e Arbërit* dhe *Skanderbeku i pafân*, ndërkaq, e përplotësojnë përpjekjen e De Radës për t'i dëshmuar të bëmat epike në krijime artistike. Kësisoj, tekstet e tij shndërrohen në tekste ridëshmuese/ evokuese; ato e ridëshmojnë historinë në krijim letrar, por në një perspektivë epike të të rrëfyerit. Prandaj, janë të lidhura fort me shenjën e mitit: mitit mbi *origjinën kohësore* dhe atë *vendësore*. *Kujtesa kohësore* është e pranishme në traditën romantike, qoftë si derivat i mitit, qoftë si synim për rikthim në shenjat identitare.

Gavrill Dara i Riu, sipas modelit homerik, i drejtohej të bijës së Lalës, duke e pyetur për trishtimin që ia sjell të kujtuemit kohësor: "Moti i shkuar" ka referencë historike: kohën e Skënderbeut, "motin e madh", sikur e quante de Rada.[41] Por, referenca që e shpërfaq teksti është *kujtesore*. Ky fakt e ngushton diskursin historik dhe i jep mundësi atij rrëfimtar.

Kujtesa e romantikëve është *e brendshme,* ajo i referohet fuqisë imagjinative për të krijuar vepër letrare e cila pikëprekjen me historinë e ndërton sipas kuptimit që asaj

[39] Jeronim de Rada, *Këngët e Serafinës Topia,* botim kritik i tri varianteve, 1839, 1843 dhe 1898, përgatitur nga Fiorella De Rosa*,* në: *Vepra letrare II* (MKRS, MK, Fondacione Universitario "Francesco Sollano, Prishtinë, 2014).

[40] "Këto 72 kangë popullore përbëjnë një poemë epike kombëtare me vlera të shkëlqyeshme, tepër të rëndësishme, duke qenë se i përkasin shekullit të Skënderbeut" (Përkthyer nga V. Miftari). Të shihet: Giroalmo De Rada, *Epistolario con N. Tommaseo*, Opera Omnia XII/I, Edizione critica a cura di Michelangelo La Luna, Rubbettino, 2006, fq. 16. Cituar sipas: J. de Rada, *Rapsoditë Arbëreshe (Rapsodie Albanesi), në: Vepra letrare V,* e cit.

[41] Osman Gashi, *E shkuara traumatike dhe mjegulla utopike (Poezia e romantizmit shqiptar midis kujtesës dhe vizioneve prospektive),* Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 33/2, Prishtinë, gusht 2015, fq. 50.

ia jep autori, ndërkohë që te Barleti kjo kujtesë historike është *e jashtme*: ai i rrëfen kujtimet e rrëfyeme të të tjerëve.

Ernest Koliqi thoshte se do ta ribënte mitin e etnisë përmes rikrijimit letrar të tij, si shpalim i zhdrivillimeve historike të etnisë, nga antikiteti në romantizëm, me një gjuhë muzikale, duke e shpallur edhe rilindjen e mitit të etnisë. Rindërtimi i mitit për etninë nënkupton kapërcimin nëpër të dhënat historike, por të mbrujtura në traditën orale, madje sipas dimensionit dinamik të saj. Duke qenë se miti është *strukturë statike*, të dhënat që përkojnë me historinë e etnisë janë të dhëna të riorganizuara në këtë traditë, ato shëmbëllejnë sipas kësaj tradite dhe janë pjesë e dinamizmit të shprehur prej saj. *Symfonija e Shqipevet* synon të mbajë të gjallë frymën etnike te brezat e ri. *Kushtrim i Skanderbeut,* në një tablo danteske, përmes dialogut të figurave historike e letrare, të zhvilluar në *ejliz* (parajsë) paraqet kujtesën historike shqiptare, gjithnjë duke pasur parasysh rindërtimin e vetëdijes atdhetare. *Kangjelat e Rilindjes,* ndërkaq, është poemth historik në kuptimin e materies së poezisë, shpërnguljen e arbëreshëve në Itali, por lirik në simbolikën e tekstit dhe në gjuhën e poezisë.

Kujtesa religjioze

Ngaqë kujtesën religjioze e kemi trajtuar gjerësisht në seminarin e vjetmë, këtu vetëm po nënvizojmë disa aspekte kryesore: religjioni, "mbretëria e të shnjtëve", përbën dhuratën që mesjeta ia dhuroi njerëzimit: krijimin e bashkësisë religjioze, si *përbashkësi* e cila i përafron njerëzit mbi disa vlera të përbashkëta. Kësisoj, Bogdani e jetësoi *mitin teologjik të esencës/ekzistencës* në të parën vepër artistike. Miti i esencës / ekzistencës (zotit, një zoti, i cili është njëkohshëm qenie dhe prani) rrjedh nga filozofia mesjetare, e cila e njihte trinitetin (Atin, birin e shpirtin) si formë të qenies së përhershme, qenie e cila ekzistonte në vete. *Çeta e profetëve*, sidomos pjesa e parë e saj, mbi substratin biblik ndërton paradigma kulturore të cilat i shërbejnë homogjenizimit kulturor të *bashkëlexuesve*[42] dhe, rrjedhimisht, krijimit të një *komuniteti* i cili është i përbashkuar së paku në tri elemente të fuqishme: në besim (parimi religjioz), në gjuhë (parimi i gjuhëve "periferike" përtej latinishtes) dhe në ideologji/teologji (përmes doktrinës filozofike të teogonisë). Vetë Bogdani ia parashkruante funksionin veprës së tij, si libër të shkruar "për popull e dobi të fesë".

Gjergj Fishta e krijoi poetikën e ndërlidhjes së *authentica*-s (vlerave përkatësore) me hyjnoren (vlerave qiellore), në formulën e mirënjohur: *atme e fe*. Ai i ndërlidhi vlerat e bashkësisë së të ngjashmëve me dëshirin për të përngjasshmin. Kësisoj, ai ridëshmoi se bashkësia religjioze mund të shërbejë jo vetëm "për t'i lidhur njerëzit për kishe", sikur kërkonte Buzuku, por edhe për t'i homogjenizuar ata rreth disa vlerave që janë të përbashkëta për *bashkëpatrijësit*, sikur i quante Budi.

[42] Termi i B. Andersonit.

Sikur shihet, bashkësitë religjioze qëndrojnë në themel të krijimit të bashkësive të fuqishme kulturore me ndjenjë përbashkimi etnike. Letërsia, artet, ndërkaq, i shërbejnë këtij formësimi, si mjet për përforcimin e ndjenjës së përbashkësisë. Pra, letërsia mund të krijojë përafrim kulturor, sidomos të atyre që priren ta ushqejnë gjuhën e përbashkët jo vetëm si mjet shprehjeje, por edhe si mjet kulture. Kësisoj, ajo i shërben krijimit të një "bashkësie etnike", e cila mund t'i ndryshojë rrënjët mbi të cilat është ndërtuar, por e ruan "funksionin etnik". Edhe nëse një pjesë e besimtarëve të krishterë, të cilëve u atribuoheshin veprat e filobiblistëve, qenë shtrënguar që ta ndryshonin besimin e tyre për shkak të trysnisë politike e ekonomike, efekti i gjuhës dhe i letrave mbeti: tashmë ato ndikuan në krijimin e "përbashkësisë etnike".

Kujtesa zakonore / juridike[43]

Kodi etik-moral ose *kodi zakonor*[44] e përcakton mënyrën e sjelljes së pjesëtarëve të një kulture ose të një etnie, të cilat ne i trajtojmë si *parakulturë* e *parakomb*.[45] Kjo kulturë, e cila merr shkas nga sjellja e përditshme e pjesëtarëve të saj, është kultura përfaqësuese e dokeve, zakoneve, ligjeve (kanuneve) me të cilat rregullohet jeta e tyre. Kësisoj, pahetueshëm mbase ato shndërrohen në *përhershmëri* e në *trashëgimi*, e cila e ringjall jetën e të parëve, duke e shndërruar atë në normë zakonore e cila i obligon të gjithë dhe e cila shndërrohet në premisë të patejkalueshme për sjelljen kulturore e sociale. Prandaj, ajo shërben si *kujtesë e përbashkët* së cilës i referohen të gjithë pjesëtarët e "kombit të synuar".[46] Kjo kulturë, e ndërtuar mbi përvojën e popullit dhe e bartur në

[43] Në traditën letrare, përmbledhja e ligjeve, e dokeve dhe e zakoneve shqiptare të veriut, është njohur edhe me emra të tjerë. Çabej e shihte si përmbledhje të dokeve shqiptare, At Bernardin Palaj, si *kanû dokesh* dhe e quante *Kanû* ose *Kanuni i maleve*. Ai e shihte *Kanunin* si *ligjën* më të vjetër në Europë. Të shihet: Atë Bernardin Palaj, "Kanuni i Maleve", në: *Mitologji, doke dhe zakone shqiptare* ("Shpresa", Prishtinë, 2000), fq. 55. Për at Zef Pllumin *Kanuni* "shprehë urtinë e naltë të trashigueme të popullit tonë". Të shihet: At Zef Pllumi, *Histori kurrë e shkrueme* ("55", Tiranë, 2006), fq. 133. Kadareja, ndërkaq, e trajtonte atë si kod zakonor të shqiptarëve. Madje, ai dëshmonte se Kanuni, bashkë me poezinë epike gojore shqiptare, e sidomos me eposin e kreshnikëve, është pjesë e pandashme e arealit epik europian. Të shihet: I. Kadare, *Identiteti europian i shqiptarëve*, e cit., fq. 22.

[44] At Fishta propozonte që ligjet moderne të bazoheshin në kanunet vendëse.

[45] Ngjashëm me toeritë etno-simboliste, vlerësojmë se etnia është substrati mbi të cilin janë formuar kombet, por jo të gjitha kombet kanë etnogjenezë të përbashkët. Institucionet politike kanë ndikuar po kështu në formimin e kombit dhe në jetësimin e ekzistencës së tij, por bërthama primordiale janë rrënjët entike, sikundër që fuqia e institucioneve politike buron po nga *rrënjët e trashëguara etnike.*

[46] Po e përdorim si term të mundshëm për të shënjuar një strukturë homogjene etnike e cila ka premisa për t'u shndërruar në "komb", ose e cila synohet, por ende nuk është formësuar si e tillë. Pak a shumë, si nocion, i përafrohet nocionit të A. Smithit: "nation-to-be".

formë gojore,[47] nga leksikografët, filologët dhe folkloristët lartësohet në nivel të "trashëgimisë kulturore të popullit",[48] e cila shënjon jo vetëm përbashkësi vlerash, por edhe rend rregullash të cilat duhet t'i përfillë secili pjesëtar. Mbledhja e fjalësit dhe e kulturës gjuhësore të "popullit të synuar", pastaj puna me gjuhën, me vlerat e saj shprehëse e përbashkuese, si dhe mbledhja e folklorit popullor, janë shndërruar në synime të përhershme të romantikëve. Thimi Mitko[49] e Spiro Dine iu rrekën mbledhjes së folklorit; at Gjeçovi punoi një çerek shekulli në mbledhjen e *traditës zakonore shqiptare*, e cila u njoh dhe u botua si *Kanuni i Lekë Dukagjinit* dhe i cili shënjon *kujtesën zakonore shqiptare*. Le të ndalemi këtu.

Tradita zakonore, e ardhur përmes letrave, përbën krijimtari imagjinative e cila shpreh zakonet, doket dhe ligjet e një populli. Duke qenë se u përgjigjet pjesëtarëve të tij dhe i detyron të gjithë ata t'i përmbahen, ai shndërrohet pahetueshëm në një *pikëreference kujtesore,* ose në normë të përsëritshme, por të patjetërsueshme, e cila, duke u bartur brez pas brezi, shndërrohet në *kujtesë*, së cilës i referohen gjeneratat e mëpastajme dhe e cila i ushqen ata për të qëndruar "në kulturë". Kjo traditë, e kultivuar te disa popuj, është e njohur edhe në letrat shqipe.

Kanuni i Lekë Dukagjinit[50] është tekst i shkruar nga Shtjefën Gjeçovi, por *i rrëfyem* prej njerëzish të tjerë. Kjo nënkupton se ai është tekst tekstesh gojore, pra përmbledhje e traditës zakonore, e cila në formë gojore është përcjellë brez pas brezi. *E rrëfyeme*, ajo bartet në shkrim. Pra, nga tradita gjore ajo bartet në tekst të shkruar, i cili e përmbledh traditën gojore dhe bën traditë si tekst i shkruar. Të dyja bashkë, ndërkaq, e përjetësojnë *kujtesën* për normat ligjore e morale të shqiptarëve, duke prekur edhe në ruajtjen e *kujtesës etnike*, ngase ajo përbën traditë të kultivimit të shenjave identitare, të cilat ua bart brezave.

(Kanuni) e njef shprehjen mâ të kthiellten të ligjeve mâ jetike të gjakut t'onë neper rrymen e shekujve per të mprojët njato veti qi e dallojnë prej komesh tjera, si rrem i kotrupit iliro-trak, d.m.th. besen, nderin, fisin, familjen, mikun e burrnín.[51]

Kanuni, në formë të normave të ngurtëzuara, është i rrënjosur në gjuhë, ai e përafron konceptin filozofik me atë gjuhësor, duke ndërtuar një variant komunikimi (sjelljeje, po që po) të shqiptarëve. Këisoj, ai del nga folklori e i nënshtrohet letrarësisë, sikundër që del nga letërsia dhe shndërrohet në paradigmë jete. Sikur që gjuha e tij rezonuese e përfron konceptin me sjelljen, po kështu tërësia e normave të tij e

[47] Gjeçovi e shndërroi përvojën e përmbledhur në përvojë të kodifikuar, ndërsa tekstin gojor në tekst të shkruar (Të shihet: S. Hamiti, *Albanizma*, fq. 62).
[48] A. Smith, *National Identity*, e cit., fq. 12.
[49] Kujtojmë këtu *Bletën shqiptare*, botuar në Aleksandri, Egjipt, më 1878.
[50] At B. Palaj nënvizonte se emërtimi *Kanuni i Lekë Dukagjinit* "asht shtesë fort ma e vonë e emrtimit *kanû"*. At B. Palaj, *Mitologji, doke e zakone*…, vep e cit., fq. 56.
[51] Po aty.

përafron *kartën* me *jetën*, i bashkëdyzon ato në sistem vlerash. Duke e kodifikuar (*kanunëzuar*) këtë përbashkësi vlerash, ai i shërben përbashkimit të etnisë; shndërrohet në pikë të pashmangshme reference për shpirtin e kombit, ose për jetën e përbashkët kulturore, etnologjike, morale e juridike, pra për *jetën kombëtare*.[52] Dëshmi se sistemi i vlerave dhe sistemi politik i shqiptarëve përthyhen në traditën zakonore është shtrirja dhe jetëgjatësia e *kanunit*.

Kujtesa epike

Kjo kujtesë përbën njërin ndër tri dimensionet e fuqishme, së cilave kjo ligjëratë u referohet edhe gjetiu: rolit që filologjia, *folklori* dhe të rizbuluarit e rrënjëve historike kanë në formimin e kombeve. Sikur është nënvizuar aty, *gojëshmëria*[53] (oraliteti) përbën amzën e kultivimit të kujtesës kombëtare, si dhe të ruajtjes së tij. Prandaj, ai paraqet edhe terrenin në të cilin frymëzimi për bëmat e mëdha, qofshin ato historike a mitologjike, shndërrohet në paradigmë për lindjen e një frymëzimi të përbashkët. Duke iu referuar "të bëmave" historike në krijimet artistike, shkrimtarët (ose autorët popullorë) e përjetësojnë një të përbashkët solidare, të cilën e ndajnë dhe nga e cila frymëzohen të gjithë anëtarët e një grupi etnik. Sepse, "kombet janë dukuri historike",[54] dhe jo vetëm produkt i modernizimit, sikur paraprovonte ta shihte Gellneri. Kjo e vërtetë historike e kombeve, e cila jo rrallë është "e vërtetë" e imagjinuar historike, u ka shërbyer etnive në synimet e tyre drejt përbashkimit në strukturën ideologjike të kombeve.

Kângët kreshinke janë krijime gojore: *kangë*, pra krijime poetike të krijuara nga populli. Si e tillë ajo (kanga) jeton në variante. Struktura e saj ndërtohet mbi thurjet popullore: legjendat. E, sikundër kuptohet lehtësisht, legjendat, sikur edhe krijimet e tjera artistike gojore, kanë bërë jetë të fuqishme brenda kombeve, duke nënkuptuar edhe rolin e pazëvendësueshëm që ato kanë luajtur në formimin e tyre. Diskursi i tyre është i lehtë, ai kapërcen nëpër mallin për t'i ngjarë jetës. Por, në të njëjtën kohë ato e bartin jetën epike brenda *tekstit*, duke e shndërruar letërsinë (gojëtarinë) në mjet për *dëshmimin* e të bëmave epike të heronjve legjendarë. Sado letërsi e cila i shmanget mimetikës, ajo është pasqyrim "i të bëmave të mëdha" të këtyre heronjve të cilët, sikur thoshte At Zef Pllumi, "janë mbulue nga nji mjegullnajë e shekujve", duke krijuar motërzime të shumta në gjithë Europën Juglindore dhe duke e vështirësuar përcaktimin e përkatësisë. Vetëm tiparet dhe karakteri i tyre, sikur i thoshte "frati i

[52] Nocion i at Anton Harapit.
[53] Të shihet: *Antologji e kangëve kreshnike shqiptare* (Përgatiti: Anton N. Berisha, Sh.b. "Faik Konica", Prishtinë, 2008), fq. 11.
[54] A. Smth, *Myths and Memories of the Nation*…, e cit., fq. 10.

kangëve"[55] at Palaj Zef Pllumit, mund të krijojë përshtypjen se cilat nga këto kangë i përkasin popullit shqiptar. [56]

Kangët kreshnike, motërzimet e të cilave shtrihen në hapësira të pakufishme dhe në variante të panumërta, e ngjallin kujtesën e përbashkët për *të ndodhshmet* (pra, jo të ndodhurat). Ato, prandaj janë krijime popullore të cilat e ngjallin kujtesën dhe i thurin himn kultit të njeriut. Ky kult i heroit epik është modeli mbi të cilin ripërtërihet kujtesa. E, kujtesa është shtysa për ta rimodeluar pamjen për veten, në një krijim latrar të diskursit fantastik.

Lahuta e Malcís, ndërkaq, është krijim i shkruar, ai nuk i referohet një kohe të kujtuar, por një kohe të jetuar, e cila mund të shndërrohet në kujtesë. Pra, ajo nuk dëshiron të dëshmojë kujtesë epike, por ta monumentojë epikën në një kujtesë të përbashkët, duke shërbyer si paramodel e në parakulturë.

Vetë asaj, poezia epike i shërben si paramodel, por ai i thur këngët sipas mallit të lirikut (sikur dëshmonte Poradeci). Ai është kritik, prandaj edhe moralizues. Nuk e dëshmon shenjën, por e kërkon atë. Prandaj, kângët e tij nuk i këndojnë hirit epik, sikur bënin kângët osianike ose kângët kreshnike. Por, ajo vetë u shndërrua shpejt në mallë epik, të cilit kombësit e tij i rëferoheshin dhe në të cilën e kërkonin hirin epik të kombit. Rrjedhimisht, *Lahuta e Malcís* ka luajtur rol të jashtëzakonshëm në krijimin e përbashkësisë gjuhësore, letrare, kulturore e etnike-kombëtare. Vetë autori i saj, lexues e krijues i shenjave epike, ndikoi në krijimin e identitetit gjuhësor shqiptar, me këmbënguljen e tij (e të Mit'hat Frashërit) për përfshirjen e alfabetit latin si alfabet zyrtar të shqiptarëve, më 1908, kur alfabeti latin kishte aq pak përdorim në këtë hapësirë. Veprimi i tij e i bashkëmendimtarëve të tij, sikur thekson Kadareja, ishte veprim i cili i jepte vulë "mallit tragjik të Shqipërisë për Europën e humbur".[57] Përmes tij, Shqipëria e shpaloste indetitetin e hershëm të saj dhe i rikthehej atij. Alfabeti me të cilin ishin shkruar veprat më të mëdha të historisë e të kulturës mesjetare, duke përfshirë edhe veprat e para të shqiptarëve, të cilët jo vetëm i përdornin shkronjat latine, por edhe gjuhën e tyre (tekstet e tyre ishin kryesisht dygjuhëshe), shndërrohej në mjet për ruajtjen e vazhdimësisë e, përmes saj, edhe të identitetit të hershëm të shqiptarëve.

Kujtesa poetike

Nëse deri këtu është trajtuar kryesisht "pasqyrimi" i përbashkësive në letra, tani do të na duhet ta vështrojmë, në një pikëshikim kujtesor poetik, mënyrën se si përbashkësia, e krijuar si dimension letrar, mund të shërbejë si substrat për veprim

[55] Kështu e quante shkrimtari Ernest Koliqi at Bernardin Palajn.
[56] Të shihet: At Zef Pllumi, "At Bernardin Palaj dhe origjina e ciklit të kreshnikëve legjendarë", në: At Z. Pllumi, *Histori kurrë e shkrueme*, vep. e cit., fq. 207-220.
[57] Të shihet: I. Kadare, *Identiteti*…, vep. e cit., fq. 23-24.

përbashkues. Shembujt mund të jenë të shumtë, sidomos, po të marrim parasysh shpjegimin e Çabejt për "letërsitë politike", sikur i trajtonte ai letërsitë e Europës Juglindore.[58]

Në një vështrim pashmangësues do të hetojmë se pse, ta zëmë, poezia trajtohet si e pashkëputshme nga rrëfimi epik, për të provuar se ekziston një lloj raporti i përhershëm mes temave të letërsisë nga "të bëmat e mëdha", sikur që ajo vetë është jo rrallë frymëzuese pikërisht për të tilla bëma. Pra, kujtesa *poiesis*-te[59] (krijuese, poetike a letrare) është dëshmim i realiteteve, qofshin ato referenciale-kujtesore, qofshin imagjinare.

Koliqi i shpalli dashuni *homeland*-it të vet dhe kësaj *dashunie* ia kushtoi kujtesën e vet poetike. Në *Gjurmat e stinve* dhe *Symfonija e shqipevet* Koliqi synonte që *simbolet nacionale*, të njohura për modernitetin, t'i shndërronte në *simbole letrare*. Ndjenja që e bart poezia e tij është: *kujtimi,* si shenjë e një mungese të vazhdueshme, si dhe *ëndërrimi*, si shenjë e një të ardhmeje dhe e një pritjeje të gjatë e të pafund. Të dyja i bën bashkë shpresa, e cila është e gjithëkohëshme. Tekstet e tij poetike, prandaj, janë *tekste të mallit*, të një kujtese të vazhdueshme për një dashuni të madhe: Shkodrën, dhe për një *përkatësi*. Shkodra, shenja e madhe e identitetit të tij nacional e personal dhe dashuria e tij e përjetshme, është para së gjithash *dashuni e kujtueme*, ajo mund të preket vetëm në të shkuarën, duke u bartur në të tashmen, në formë kujtimi. Drama është e skajshme, ngase synon ruajtjen e *përkatësisë*. Koliqi del kësisoj si *kujtues* i madh i shenjës personale e nacionale, i identitetit të tij, prandaj tekstet e tij janë të lidhura me Shkodrën, me mungesën e madhe.

Kujtesa politike

E ndërlidhur me kujtesën poetike është kujtesa politike. Ajo e dëshmon ndjenjën e zbulimit të vetvetes në një frymë mobilizuese. Prandaj, diskursi i saj është i mbështetur në premisa të fuqishme kulturore, hsitorike e etnologjike. Duke i rimarrë ato, duke ia pranëvënë "frymës", ky diskurs e ridëshmon vetveten (përbashkësinë) në një pamje të re: vetja si tjetri e përkarshi tjetrit. Pra, kujtesa i flet tjetrit që është si vetja, të cilin s'mund ta shohësh përtej vetes. Të folurit është retorik, por edhe programatik. Dëshmia poetike, letra që ipërngjason jetës bëhet synim parësor.

Kujtesa e Nolit është kujtesa retorike për mallin e jetës në letra e për dëshminë e saj përmes tyre. Fryma e poezive të tij, prandaj, është retorikë e fuqishme ndaj

[58] Teoria e Andersonit për komunitetet imagjinare, pra për rolin që rrëfimi e mediet mund ta luajnë në krijimin e vetëdijes kombëtare, bëhet pikëreferencë e pashmangshme. Vepra e tij trajtohet këtu si përçapje për të shpjeguar njërin krah të dysisë: përkatësi - letra, e cila niset nga e dyta (letrat) dhe e synon të parën (përkatësinë). Për Smithin dhe përgjithësisht etno-simb olistët, sikur kemi provuar të argumentojmë, përkatësia ndikonte ne përmbajtjen e letrave.

[59] Term i Aristotelit.

çështjeve që lidhen me veprimin, diskursi i fuqishëm, ndërsa figura e bart emotivitetin e autorit nga jeta në letra. Poezia e tij, kësisoj, shndërrohet në poezi të diskursit patriotik-politik. Karakteri i saj është kryesisht motivues. Ai i përzgjedhte modelet e tij të letrave (madje, edhe kur përkthente) sipas modelit jetësor e sipas karaktereve-modele, nga antika në mdoernitet. Teksteve të përkthyera u paraprinte me nga një tekst të tipit *introduktor*, me të cilët e *orientonte lexuesin e leximin*. Ai synonte që me këto tekste t'ia ofronte lexuesit jo vetëm idetë tekstuale të autorit e të tekstit letrar, por dhe një reflektim të vetin për idetë kontekstuale të shoqërisë shqiptare të kohës. *Kritika introduktore*[60] e tij është kritikë e kërkimeve tematike e të ideve në tekst, madje orientim për kërkimin e tyre në tekst.

Poezia e Nolit, ndërkaq, është përpjekje për dëshmim poetik përmbi një realitet politik. Pra, ai kërkonte që ideja për tekstin të krijohej përmbi idenë politike. E ngaqë, politika nënkuptonte veprimin, ai vetë shndërrohej në bartës të idesë e në ushtrues të saj. Por, meqë kultura i ndërhynte në veprim, shenjat e poezisë së tij (të idesë poetike), ai e trajtonte veprimin të lidhur me shenjën morale. Për këtë synim, ai u referohej shembëlltyrave: asaj morale, historike e politike. Kësisoj, ai shkruante për jetën, për kujtesën politike të atdheut

Mojsiu në mal, poezi autobiografike e Nolit e ndërlidh mitin mbi lashtësinë etnike me mitin mbi lashtësinë kulturore, duke i ndërlidhur ato në shprehje përmes shenjash biblike. Pra, Betlehemi, Lumi i Jordanit e Jerusalemi janë parajsa e trashëguar biblike, e cila njerëzimit i shfaqet si shenjë e lashtësisë së besimit dhe e përkatësisë së përbashkët, por e cila mund të kultivohet vetëm nëse krijohet dëshira për ta jetësuar modelin e tij në jetë.

Ai shkroi për Shqipërinë në kohën kur tashmë ajo jetonte brenda tij, por ai vetë nuk mund të jetonte më brenda saj. Pra, sikur i ngjante Ciceronit, Dantes e Bakonit, ai qe bërë shkrimtar vetëm në mërgim. Para kësaj, ai ishte *predikues moral* e *veprues politik*. Ose të dyja bashkë, që qenë fati i tij dhe fatkeqësia e tij, sikur e dëshmonte në poezinë *Krishti me kamçikun*, të cilën do ta analizojmë më poshtë. Idetë politike, të cilat i kishin mbetur pa u realizuar në Shqipërinë e tij reale, do të shndërrohen në substrat për poezinë në Shqipërinë e tij ideale. Ato shtrihen gjithandej poezisë së tij, si ide për tekstin; predikuesi moral shndërrohet në predikues formal të poezive të tij, duke ia përcaktuar asaj edhe figurën: figurat biblike. Fryma e diskursi do të jenë të vetë Nolit: diskurs luftarak e frymë motivuese. Kësisoj, poezia e Nolit e rimerr modelin biblik dhe përmes figurash biblike synon ta paraqesë kundërshtinë mes gjendjes në të cilën jetonte Shqipëria dhe idealit të bashkëpatrijësve. Shqipëria politike përball shëmbëlltyrës biblike, një realiztet i vrazhdë, i krijuar kryesisht për faj të vetë bashkëpatrijësve, përkarshi një modeli ideal, të cilin na e shpalos Zoti.

[60] I Rugova*, Kahe dhe premisa*…, vep. e cit., fq. 100.

Kujtesa kulturore

Marin Barleti ia fali letërsisë *historinë e rrëfyeme* të Kastriotit. Sipas një perspektive rrëfyese, ai e përbrendësoi historinë në rrëfim letrar, duke e krijuar të parin model të përbrendësimit zhanror. Po sipas këtij modeli, por në një pikëreference jo më me historinë, por me kulturën, at Zef Pllumi e krijoi kujtesën për kombin, kombëtarinë e historinë kulturore e politike të tij, së paku të një gjysmëshekulli. Pikëreferenact janë, prandaj, reale e historike, por dimensioni është tejkohor e tejhistorik: ai shtrihet si përjetim e përjetësohet në rrëfim: për të vërtetat e mëdha kulturore e për sjelljen politike. Ato, prandaj, duken sikur vijnë nga "sfera e epërme"[61] dhe përjetësohen në tokë. Jehona e tyre prandaj, është tejkohore e tejtekstore, ajo përjetohet si *zbritje e fjalës në rrëfim*, në të cilin ne e zbulojmë veten tonë, pavarësisht nëse "të bëmat" janë përjetuar empirikisht ose nëse ajo që na zbulohet rishmi ngjan të jetë e njohur, e pandashme nga qenia, pavarësisht përjetimit. At Pllumi, kësisoj, është *memorialisti i kulturës shqiptare,*[62] i cili ka ikur nga ferri dhe me vete e ka marrë kujtesën historike e kulturore të një kohe e të një vendi. Ai i referohet këtij ferri sikur ferrit të Dantes, të përjetuar e të përjetueshëm.

Kujtesa e at Zef Pllumit, si kohë rrëfimi, është e mëvonshme krahasuar me autorët e me objektin e tekstit tonë, por është e njëkohshme *si e ndodhur e kujtuar* me autorët e mëdhenj letrarë e kulturorë të viteve '30-40 të shekullit XX. At Pllumi dëshmon për kujtesën e fëmijërisë së tij e të pjekurisë së kombit; ai dëshmon të ndodhura të hershme, të rrëfyera në pleqëri. E, sikur thoshte Borhesi, gjërave të cilat u rkhthehemi, i dëshmojmë më mirë. Porse, kujtesa e tij nuk është historike, ajo është kulturore.

Në dy librat e *kujtesës* së tij prej dëshmitari i cili një ditë beftas kishte lënë vetminë e tij dhe kishte zbritur mes njerëzish, "për të dëshmuar ngjashmërinë e botës danteske me vuajtjet që ky burrë i vjetër kishte përjetuar", [63] at Pllumi e shkroi kujtesën e një kohe, e cila përfshinë historinë, kulturën, dijet e artet. Meqë tek ai koha e shkrimit nuk i përmbahet kohës së dëshmimit (vepra e tij është kujtesë e rrëfyeme për ngjarje të mëhershme), si dhe ngaqë at Pllumi nisej nga perspektiva e të rrëfyemit (të treguemit) dhe të dishmimit për të pëthënën, *të pashkruemen*,[64] ne po i referohemi *kohës së kujtueme*, për ta trajtuar objektin e tekstit të tij të njëkohshëm me modernizmin në letrat shqipe, edhe për të ridëshmuar se rrëfimi e shkrimi janë shenjat e dëshmisë letrare e historike.

[61] Të shihet: Parathënia e botimit të dytë, shkruar nga Ismail Kadareja, në: Zef, Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue* ("55", Tiranë, 2006), fq. 5.
[62] Po aty, fq. 5
[63] Po aty.
[64] Të shihen: At Zef Pllumi, *Rrno veç për me tregue* ("55", Tiranë, 2006) dhe *Histori kurrë e shkrueme* ("55", Tiranë, 2006).

Bibliografia

Libra:

Anderson, Benedict: *Imagined Communities: Reflectiones on the Origin and Spread of Nationalism* (Verso Editions and New Left Books, London, 1983); në gjuhën shqipe: *Komunitete imagjinare,* përkthyer nga: Brenton Kotorri, ("Dy lindje & Dy perëndime", Tiranë, 2013);

Antologji e kangëve kreshnike shqiptare (Përgatiti: Anton N. Berisha, Sh.b. "Faik Konica", Prishtinë, 2008);

Aristoteli, *Poetika,* përktheu: Sotir Papahristo ("Buzuku", Prishtinë, 1998);

Asdren, *Ëndrra e Lotë* (Shtypshkrimi Gutenberg, Bukuresht, 1912)

Asdreni, *Psallme murgu* ("Rilindja", Prishtinë, 1990);

Barletius, Marinus, *Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum principis,* pa datë botimi (mendohet se libri është shkruar mes viteve 1508-1510), përkthyer në shqip nga origjinali në latinisht nga: Stefan I. Prifti: Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e vepravet të Skënderbeut* (Rilindja, Prishtinë, 1989);

Barti, Rolan, *Aventura semiologjike* ("Rilindja", Prishtinë, 1987);

Berisha, Gjon, *Arbërorërt ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI-XV* (Instituti i Historisë, Prishtinë, 2015);

Bogdani, Pjetër, *Çeta e profetëve* (Padova, 1685);

Borges, Jorge Luis, *Ligjërata* ("Pika pa sipërfaqe", Tiranë, 2013);

Buzuku, Gjon, *Meshari, 1555.*

Christie, Thomas A., *National Identities: Ideology, Genre and National Identity in Popular Schottish Fiction Since the Seventieth* (Newcastle upon Tyne, UK: Cambridge Scholars Publishing, 2013);

Curtius, Robert Ernst, *Evropska književnost i latinsko srednjovjekovlje* ("Naprijed", Zagreb, 1998);

Çabej, Eqrem, *Shqiptarët midis Lindjes dhë Perëndimit* (Tiranë, 1994);

De Rada, Jeronim, *Parime të estetikës,* në: Vepra letrare 3 ("Naim Frashëri", Tiranë, 1987);

Evangelisti Allori, Paola *Identities in and Across Cultures* (Bern, Peter Lang, AG, 2014);

Fishta, Gjergj, *Lirika* ("Rilindja", Prishtinë, 1997);

Frashëri, Naim, Vepra I ("Rilindja", Prishtinë, 1978);

Gellner, Ernest, *Culture, Identity and Politics* (Cambridge University Press, Great Britain, 1987);

Gerold Dommermuth-Gudrich;

50 Klassiker Mythen ("Gerstenberg" Verlag, Hildesheim, Gjermani, 2000). Përkthimi në shqip: *Mitet – Më të famshmet e lashtësisë* (përktheu: Nasi Lera, "Shekulli", Tiranë, 2006);

Hamiti, Sabri, *Letërsia e vjetër shqipe* – tekst për shkollat e mesme (LIbri shkollor, Prishtinë, 1999);

Hamiti, Sabri, *Vepra letrare VII* ("Faik Konica, Prishtinë, 2002);

Hamiti, Sabri, *Albanizma* (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2009)

Harapi, At Anton, *Njisimi kombtra dhe ideali kombtar* (Kuvendi Françeskan, Gjakovë, 1997);

Hesse, Hermann, *Der Steppenwolf* (Suhrkamp Verlag, Frankfurt am Main), cituar sipas përkthimit në gjuhën shqipe: Herman Hese, *Ujku i stepës*, përkthyer nga Arbër Çeliku ("Asdreni", Shkup, 2010);

Homeri, *Odiseja,* Kënga VIII, V, përkthyer nga Spiro Çomora ("Naim Frashëri", Tiranë, 1979);

Horowitz, Donald, *Etnic Groups in Conflict* (Barkeley, Los Angeles & London, University of California Press, 1982);

Huthcnison, John, *The Dynamics of Cultural Nationalism* (Allen&Unwin, Unwin Human LTD, London, UK, 1987);

Ismajli, Rexhep, *Gjuhë dhe etni* ("Rilindja", Prishtinë, 1991);

Ismajli, Rexhep, *Tekste të vjetra* ("Dukagjini", Pejë, 2000);

Kristoforidhi, Konstandin, *Gjahu i malësorëve – Hija e Tomorrit* ("Albania", Bruksel, 1902);

Kadare, Ismail *Autobiografia e popullit në vargje* ("Onufri", Tiranë, 2002);

Kadare, Ismail, *Identiteti europian i shqiptarëve* ("Onufri", Tiranë, 2006);

Kadare, Ismail, "Tri gjendje të Kastriotit", në: *"Mosmarrëveshja – Mbi raportet e Shqipërisë me vetveten* – sprovë letrare ("Onufri", Tiranë, 2010);

Koliqi, Ernest, *Dy shkollat letrare shkodrane* (Kisha e Shën Ndout, Prishtinë, 1998);

Levi-Strauss, Claude, *Mito e significato* ("Il Saggiatore", Milano, 1980);

Miftari, Vehbi, *Modelet e kritikës – Konica, Maloki, Kuteli* ("Buzuku", 2005);

Miftari, Vehbi, *Kritika dhe moderniteti* ("AIKD", Prishtinë, 2008);

Miftari, Vehbi *Rugova – mendimi, kultura, politika*, botimi i tretë ("Faik Konica", Prishtinë, 2013);

Myhill, John, *Language, Religion and National Identity in Europe and the Middle East: A Historical Study* (Amsterdam, John benjamins Publishing Co., 2006);

Pllumi, At Zef, *Rrno vetëm për me tregue* ("55", Tiranë, 2006);

Pllumi, At Zef, *Histori kurrë e shkrueme* (Shtëpia botuese "55", Tiranë, 2006)

Pultar, Gonul, *Imagined Identities: Identity Formation in tha Age of Globalization* (First Edition: Syracuse: Syracuse University Press, 2014);

Qosja, Rexhep, *Histori e letërsisë shqipe I, II, III* ("Rilindja", Prishtinë,.....);

Qosja, Rexhep, *Asdreni* – monografi, në: Asdreni, vepra e plotë ("Rilindja", Prishtinë, 1987);

Riza, Selman, *Pesë autorë të vjetër* ("Toena", Tiranë, 2002);

Rrahmani, Kujtim, *Letra e ideologji* ("99 aikd", Prishtinë, 2012);
Rugova, Ibrahim, *Vepra e Bogdanit* (Instituti Albanologjik i Kosovës, Prishtinë, 1982);
Smith, Anthony D., *National Identity*, London, Penguin, 1991;
Smith, Anthony D., *Nationalism and Modernism: A critical survey of recent theories of nations and nationalsim*, Routlidge, 1998;
Smith, Anthony D., *Myths and Memories of the Nation* (New York, Oxford University Press, 1999;
Smith, Anthony D., *The Ethnic Origins of the Nations* (Blackwell Publishers LTD, London, New York, 1999);
Smith, Anthony D. *Ethno-Symbolism and Nationalism,* A cultural appreoach, ("Routlidge", London, New York, 2009).
Shala, Kujtim M., *Analepsa* (Fondacioni "Ibrahim Rugova", Prishtinë, 2013);
Thiesse, Anne-Marie, *La création des identities nationales – Europe XVIII-XX siècle* (Éditions de Seuil, Mars 1999). Cituar sipas përkthimit në gjuhën shqipe: Anne-Marie Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare – Europa e shekujve XVIII-XX*, përkthyer nga: Etleva Shiroka ("Dukagjini", Pejë, 2004);
Weber, Max, *Studies in sociology.* Cituar sipas përkthimit në gjuhën shqipe: Max Weber, *Studime sociologjike,* përktheu: Enida Rusi ("Plejad", Tiranë, 2004);

Artikuj:

Çabej, Eqrem, *Për gjenezën e literaturës shqipe* ("Hylli i Dritës", 1938-1939);
Gashi, Osman, *E shkuara traumatike dhe mjegulla utopike (Poezia e romantizmit shqiptar midis kujtesës dhe vizioneve prospektive),* Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 33/2, Prishtinë, gusht 2015;
Hamiti, Muhamet, "Letërsia dhe identiteti", në: Seminari për Gjuhën, Letërsinë e Kulturën Shqiptare, 32/2, 2013;
Hysenaj, Haxhi, "Ernest Koliqi në rrafshin gjuhësor", në: *Filologjia*, revistë e Fakultetit të Filologjisë, nr. 19, Universiteti i Prishtinës, qershor 2013
Maloki, Krist, *A asht poet Lasgush Poradeci?,* "Përpjekja Shqiptare", Tiranë, 1938, nr. 18-24, ndërsa vazhdimin e tij e botoi po në "Përpjekja Shqiptare", nr 25-27,1939

Vehbi MIFTARI

ETHNO-LETTERA

Abstract

Literature has a strong relationship with a collective memory. From the very beginning, she has created a strong connection with the *hidden relicts* (A. M. Thiesse). So far, those *relicts* have played an important role on the function of literature. Modern theories on nations and nationalism, beginning from ethno-symbolists, underline this strong connection between them.

In our lecture, we analyse the relationship of the literature with a so called (national)*distinctive symbolic repertoire* (A.D. Smith) and with the feelings which derive from collective identity (*zusammengehörigkeitsgefühl*, Weber). The sensitivity derived from these symbolic signs, like language, literature, ethnic tradition and ethnic territory has been seen as an evitable repertoire which can stimulate literary writing. We analyse the role of this repertoire and of the collective identity in letters, as we do with the impact of literature in evaluating the sensitivity on collective identity.

For this purpose, we do analyse the role of (ethno) myths, national memories and collective identity in Albanian languageand literature.

Key words: Literature, national memory, national identity, ethno-symbolism, ethno-myths.

Hamit XHAFERI

VLERA MORALE NË VEPRAT E FATOS KONGOLIT

Abstrakt

Kumtesa ka të bëjë me analizën e realitetit letrar artistik dhe vlerën morale në veprat e Fatos Kongolit. Vihen në pah prurjet e reja me vlera dhe veçori, mbi gjuhën, tërësinë ideoartistike dhe mënyrën e shprehjes mbi jetëgjatësinë morale të veprave të këtij autori. Brendia e mënyrës së trajtës ideore dhe ndërtimore, në veprat e Kongolit, ngërthen në vete qenien e gjallë të botës së brendshme të jetës së njeriut të rëndomtë, të mbuluar me nuancat e veçorive të botës shpirtërore. Ngjarjet kohore përmes veprimtarisë së këtij krijuesi me moral dhe vetëdije të lartë njerëzore, janë pasqyruar përmes ndjenjave të njeriut shqiptar si qenie e ndjeshme me vlera të botës së brendshme njerëzore. Kjo dëshmon se mjaftë krijues letrarë nga Shqipëria, Kosova e gjetiu përmes veprave me vlerë estetike, kanë mbijetuar si të tillë. Fatos Kongoli thotë se koha është vlerë morale, ndërsa jeta e krijuesit është përjetuar vetëm si person ose si krijues. Janë të ndjeshme dhe të dallueshme, si rrezet e diellit, vlerat morale dhe artistike në veprat e Kongolit, të cilat dallohen sipas veçantive, tipareve dhe pasqyrimeve kohore. Disa nga romanet e tij janë ballafaquar mirëfilli me gjëllimin dhe realitetin e vlerave të tyre artistike dhe letrare. Proza e tij vërehet se ka një raport moral të pandashëm edhe në kohën e diktaturës. Te krijuesi gjëllon preokupimi i realitetit jetësor të romanit me shkrimtarin si krijues, veçanërisht moralit që e ka shoqëruar. Autori, mbetet stoik, këmbëngulës, i qëndrueshëm, duke dal në skenën letrare për të vepruar, lëvruar e flijuar si moralist me ndjenja dhe synime fisnike. Krahas tipareve të durueshme që i shpreh, përmes rrethanës emocionale të botës së brendshme, ai shfaq vetveten si individ të moralshëm. Shkrimtari mbetet një idealist fisnik, imagjinues dhe moralist. Reputacioni i veprës së tij shndërrohet në një vlerë krijuese dhe morale.

Fjalë kyçe: *koha, diktatura, krijuesi, tërësia ideoartistike, bota shpirtërore, vlera morale*

Kumtesa ka të bëjë me analizën e realitetit letrar artistik dhe vlerën morale në veprat e Fatos Kongolit. Në këto vepra vihen në pah prurjet e reja me vlera dhe veçori të jashtëzakonshme, që kanë të bëjnë me gjuhën, tërësinë ideoartistike dhe mënyrën e shprehjes, që na nxisin dhe motivojnë të gjykojmë më thekshëm mbi jetëgjatësinë morale të këtyre veprave. Brendia e mënyrës ndërtimore në prozën e këtij shkrimtari,

ngërthen në vete qenien e gjallë të botës së brendshme të jetës së njeriut të rëndomtë dhe botës së tij shpirtërore. Sipas Fatos Kongolit, koha është vlerë morale, ndërsa jeta e krijuesit është përjetuar vetëm si person dhe si krijues. Vlerat morale dhe artistike në veprat e tij janë të ndjeshme dhe të dallueshme, mu si rrezet e diellit, sipas veçantive, tipareve dhe pasqyrimeve kohore. Disa nga romanet e tij janë ballafaquar mirëfilli me gjëllimin dhe realitetin e kohës. Kështu që proza e Kongolit vërehet se ka një raport moral të pandashëm edhe në kohën e diktaturës kur thotë: *"Lundroj i rrëmbyer nga vorbullat e tij për t'u zhdukur, pa e ditur ç'më pret: në çastin e kryqëzimit të mijëvjeçarëve do të mbetem në hullinë e të vjetrit apo hullia e re do të më marrë dhe mua. Pa Margën...."* (Kongoli F., 2003: 6).

Te ky krijues gjëllon preokupimi i realitetit jetësor në romanin e tij, duke e vënë në pah reputacionin e shkrimtarit si krijues, veçanërisht moralin që e ka shoqëruar. Kongoli, mbetet stoik, këmbëngulës, i qëndrueshëm, duke dalë në skenën letrare për të vepruar, lëvruar dhe flijuar si moralist me ndjenja dhe synime fisnike. Krahas tipareve të durueshme që i shpreh, përmes rrethanës emocionale të botës së brendshme, ai shfaq vetveten si individ të moralshëm. Për këtë arsye Kongoli mbetet një idealist fisnik, imagjinues e sidomos si moralist i vërtetë. Pikërisht, brendia e veprës së tij e paraqet njeriun si vlerë frymëzuese dhe morale. Te romani "Te porta e shën Pjetrit" vërejmë gjithë atë dhunë që përfaqëson emigrimin, në rastin e dhënë në Greqi, dhe vendosjen e pamundur. Dhunën e dëshirës për të ikur, dhunën e kufirit, dhunën e pritjes, dhunën e nënshtrimit ndaj kushteve të vendit. Bota natyrore e tij është sprovuar në planin moral me dukuritë e jetës njerëzore dhe morale të kohës së monizmit: *Është diçka më e ndërlikuar. Më duket sikur ta kam thënë një herë, së paku jam orvatur të ta shpjegoj, por nuk e marr vesh ç'ka ndodhur, nuk e di përse kam përshtypjen sikur në një shekull apo një mijëvjeçar tjetër, kemi lënë pezull një bisedë.* (Kongoli F., 2005: 69).

Duke lexuar disa nga veprat e tij, na duket se ne gjendemi përsëri në orvatje të një rrugëtimi për të arritur gjer te këndvështrimi moral i njëmendtë. Periudhat e jetuara kohore në monizëm e gjer në bashkëkohësi, kanë pasur një emocion të fuqishëm konceptimi të botës së brendshme për vlerat e letërsisë, përkatësisht moralit të artit letrar. Mënyrat e ngrohta të ndjeshme dhe prekëse të përmbajtjes, vetëm te frymëzimi letrar, ekzistojnë si vlerë morale njerëzore. Kongoli si krijues i artit letrar e përjeton tërësinë e jetës së përbashkët të krijimtarisë si një mënyrë të moralshme, duke vepruar sipas procesit krijues të rregullt, dhe në këtë mënyrë formon një mirëkuptim letrar që kërkon të shijoj butësinë dhe përzemërsinë e jetës. Arti letrar i Kongolit e pasqyron në tërësi pamjen e figurshme me anë të ligjërimit të përshkruar me moral dhe humanizëm mjaft të theksuar. Ligjërimi pulsional sigurisht fiton të drejtën e procedesë letrare duke e parë atë përgjatë gjithë shtrirjes në vepër dhe jo vetëm në një fragment të shkurtër. Personazhet janë të çoroditur. Ata janë ca kërmij që kanë humbur guackën e tyre (është një imazh që nuk ka burim tjetër, përveçse Kongolin). Edhe lugetërit, siç thuhet, janë mediokër, për njerëz mediokër. Shembulli i mëposhtëm e dëshmon këtë

logjikë pulsionale të ligjërimit të personazhit kryesor Platon Gurit: *Dakort, kam shkalluar. Për rrjedhojë mund të konsiderohem i papërgjegjshëm dhe thëniet e mia të mos merren për bazë. E kam fjalën prej teje, ato të drejtohen ty. Nëse ti vazhdon të më dëgjosh, me një shami apo kushedi se çfarë përpara gojës. Në një pikë të galaktikës, koordinatat e së cilës i kam harruar dhe kjo është e shpjegueshme, s'kam as tru, as kokë, nuk më duhet as truri, as koka, s'më shërbejnë, s'më kanë shërbyer kurrë.* (Kongoli F., 2005: 89).

Duke e vështruar realitetin e veprimtarisë së tij letrare, lexojmë krijime të ndryshme letrare dhe artistike, të cilat u përkasin periudhave dhe breznive të ndyshme të krijuesve letrar, në të cilat ndeshim lartësinë e prurjeve të reja, me vlera dhe veçori, mbi gjuhën, tërësinë ideoartistike dhe mënyrën e shprehjes së krijuesve, të cilët na nxisin të gjykojmë më thekshëm mbi jetëgjatësinë morale të veprave të tyre. Brendia e mënyrës dhe trajtës ideore apo ndërtimore, në disa vepra të krijuesve bashkëkohor, ndërlidhen me botën e brendshme të jetës së njeriut të rëndomtë, të ravizuar me nuancat e veçorive të botës shpirtërore. Historia e letërsisë dhe ngjarjet kohore të gjëllimit të saj ndër shekuj, përmes veprimtarisë së rëndësishme dhe të pasur të krijuesve tanë të shquar me moral dhe vetëdije të lartë njerëzore. Kjo dëshmon se mjaftë krijues letrarë nga Shqipëria, Kosova e gjetiu përmes një morie veprash me vlerë estetike, kanë mbijetuar si të këtillë e sidomos me vlerat e tyre artistike dhe letrare. Përmes ndodhive të sprovuara me ndijime brenda ndërgjegjes dhe shpirtit të krijuesit, i cili shquhet me një dhunti dhe parandjenjë natyrore të veçantë, në të cilën është përcaktuar vlera morale e zakonshme njerëzore në shoqërinë shqiptare. Si krijues i denjë letrar veprave të tij orvatet tu japë gjëllim figurave kryesore, duke i vënë në qendër të brendisë shëmbëlltyrat e moralshme. Kongoli thotë se këto janë zbulime vlerash që nuk duhen lënë të enden në kotësi. Pikërisht, brendia e veprës së tij e paraqet njeriun si vlerë frymëzuese dhe morale, ndërsa zhvillimi i ngjarjes duket sikur e dëlirë ndërgjegjen në planin e botës së brendshme. Bota natyrore e tij është sprovuar në planin moral me dukuritë e jetës njerëzore dhe morale në kohën e monizmit: *Ti u orvate të më fusje frikën dhe, me dashje ose jo, po më bëje një fyerje të rëndë. Më të rëndë se epitetet që ti dhe miqtë e tu nuk munguat të m'i përplasni në fytyrë më vonë.* (Kongoli F. 2005: 217).

Duke lexuar disa nga veprat e Kongolit, na duket se gjendemi përsëri në orvatje të një rrugëtimi për të arritur gjer te këndvështrimi moral i njëmendtë. Por gjithsesi ne mbetemi kundrejt artit të tij letrar mjaft kurreshtarë për t'i konceptuar dhe njohur cilësitë dalluese të këtyre veprave. Periudhat e jetuara kohore në monizëm e gjer në bashkëkohësi, kanë pasur një emocion më të fuqishëm apo një konceptim të botës së brendshme pë nga vlera letrare, përkatësisht moralit të artit letrar. Kjo gjendje e brendshme morale s'mund të jetë kurrsesi e ndjeshme, meqë lidhjet e këtij krijuesi me artin letrar kanë ndodhur në kohën e regjimit, që lë të nënkuptohet, se është krijuar fillimisht ndjenja e fuqishme e dashurisë përballë artit letrar.

Përfytyrimi i një misteri, apo përpjekjeje të vetëdijshme hyjnore të kësaj larmie të kompozimit letrar, shëmbëllen me një nënë të re të lehonisë së një foshnje si qenie e

mbinatyrshme e cila vëzhgon rrezet e diellit të shenjtë duke u orvatur të përvetësoj hapësirën e lirë të gjëllimit njerëzor për te dhe për vetë autorin. Kongoli me vërtetësi e përcjell rrëfimin e shprehur me tipare përmbajtësore të botës së brendshme, të shfaqur me anë të një poetike e cila është në harmoni me lartësinë dhe fushën e artit letrar të krijuar me vlera estetike.

Në krijimtarinë letrare të Fatos Kongolit, veçanërisht te romani i fundit "Rënia e pandalshme" merren si çështje të njohura dy sintetizime: kur e vështron mbresën si vlerë morale dhe si lidhje e ndërsjellë, sepse ky roman ka të bëjë me kohën gjatë periudhës së sistemit monist. Në romanin në fjalë lexuesi ndesh krijuesin dhe artistin skalitës të ngjalljes së kurreshtjes së ndërlikuar. Vetëm një krijues si Kongoli mund të jetë në situatë të përqendrohet i tëri me një vistër ngjarjesh që lidhen me rrëmujën e mendjes dhe vetëdijes për të kaluar atypari siç thotë "me perin në rruazë" në zhvillimin e ngjarjes së temës. Të vërtetat që thërrmohen te romani i ri "Gjemia e mbytur", ku si sprovë leximi përqaset me zhvendosjen e karavidhes, në rastin e përshtatshëm për të lëvizur në të gjitha orientimet, me lëvizje të parëndësishme nëpër ujërat e kujtesës dhe të ndjenjës. Romani është i ndërtuar me figura dhe individë, me mjedise dhe aksione, siç është ndërtesa "vila misterioze" e cila detyrimisht e bën kurreshtar lexuesin duke e mbajtur në vështrim qëndrimin e tij. "Gjemia e mbytur" ka qenë një objekt i fshehtë në Tiranë i shfrytëzuar prej misioneve të fshehta, sikurse do të pohoj një ish-mësues i matematikës, mbi ndodhinë e Robert Fushës, ish-lojtarin e basketbollit, që kish lidhje me vajzën e Dullës e cila u shua në kushte të veçanta enigmatike në Spaç, ia lë në dorëzim ish-nxënësit të tij, tani gazetar hetues dhe gjurmues. Gazetari hetues kishte kuptuar për ca kanosje me jetë që patën sjell disa kryetarë të klasave politike veçanërisht disa nëpunës të lartë të dikurshëm. Ish-nëpunësi i lartë, Dhimo Shkurra, ish-vëzhgues në organet e sigurimit i cili kishte arrestuar, syrgjynosur, varur, ekzekutuar, sfilitur, çnjerëzuar, vete në gjurmim të kanosësit të panjohur Glauk Fusha të cilin e mundon "trafikimi i identiteteve" i shfaqur në mënyrën "Ti je unë ndërsa unë jam ti" apo "Unë s' jam ti dhe ti s' je unë". Egoja e Glaukut ka një vete të dyfishuar, Diellin, i cili përdor një sasi ilaçesh të ngurtësuara teksa i kthehet *tjetrit*: "Unë jam i njëjti që ti s'ke dashur kurrë të jesh ose, e kundërta, ti je ai që unë s'kam dashur kurrë të jem". Nga kjo rrëmujë stili dhe vijash që janë në të njëjtin rrafsh, vijojmë të kuptojmë me zotimin mbi zgrip, sepse ndikon atëherë njëfarë rrethane tjetër, sugjestionimi që kemi hasur tek romanet më të njohur të kohës "Burgjet e Kujtesës". Zhgënjimi i nakatosur me trishtim (eksperiencë këndimi që rishfaqet me romanet tjera të Kongolit) kurajon të mirëpresish njëfarë kuptimi të ri. Që nga viti 2014 Kongoli rropatet të imitojë hijen e më të mirës që autori i ka dhuruar prozës së sotme shqiptare. Te "Gjemia e mbytur" secila figurë i ngjason ndonjërës që nuk ekziston, cilado hapësirë i përngjan mjedisit që nuk ekziston, sevdaja shëmbëllen me sevdanë që nuk ekziston. Personazhi kryesor vepron në bazë të tëresisë identike (të cilën e hasim në romanet: I humburi*,* Kufoma, Lëkura e qenit).

Njeriu i cili gjallon në të sotmen e kaluar, me tipare identike psikike, me nivelin e ngjashëm (të pamjaftueshmërisë) të trazimit apo përtëritjes, me vegimet, ngathtësinë, ngatërresën, vetëdijen e zbehur. Rrethanë kjo të cilën Kongoli, në vrprat tjera (i lë mënjanë (!) meqenëse është i nevojshëm redaktori) i cili i pikëzon me të rishfaqjet identike: "*Mua nuk më kujtohet mirë se kur e në ç'rrethana…*" ose "Gjithçka qe një shoqërim idesh…".

Aida Tuci, në shkrimin e saj të publikuar më 8 prill 2011, thotë se në një rrëfim përfundimtar, shpjegohen me anë të këtij libri, në radhë të parë disa nga ngjarjet më të rëndësishme dhe dramatike të jetës së shkrimtarit dhe në radhë të dytë ky libër sikur mbyll përfundimisht një fazë të dytë të krijimtarisë së Fatos Kongolit, (siç e rendit ai vetë), ajo fazë që fillon pas përmbysjes së diktaturës me romanin "I humburi", janë ata që kanë mbetur, askush tjetër, ata që thjesht hoqën dorë të niseshin pas fëmijëve të tyre, ose grave të tyre dhe mbyllet me romanin "Bolero në vilën e pleqve" dhe në fund libri "Iluzione në sirtar", iluzionet atërore kundrejt komunizmit, iluzionet vetiake kundrejt demokracisë që orvatet të vijë, janë lënda e një vepre me kujtime dhe refleksione, që e mbyllin përfundimisht këtë fazë. Në këtë libër, lexuesit do kenë mundësi të shohin se shumë gjëra që ky autor trajton në librat e tij, nuk janë gjë tjetër veçse ndodhi të vërteta të jetës së autorit. Në fund të fundit, "ky është një libër i brengave të mia", kishte thënë Kongoli në një intervistë. "Periudha 20-vjeçare e tranzicionit ka qenë padyshim një periudhë plot iluzione dhe zhgënjime, sepse realiteti që pasoi ishte një realitet i egër nga pikëpamja njerëzore. Këtu është rrëfyer kjo epokë". Periudhë kjo që ka prodhuar konfliktin e madh i cili është ekspozuar në shumë shtresa të shoqërisë, por më i ashpër ishte ndaj botës së artistëve dhe letrarëve, gjatë regjimit komunist. Pra, kemi identifikimin e sundimit të egër të pushtetit, kur sigurimi operonte në hapje dosjesh, listash etj., ku u vunë në vrojtim gati e gjithë inteligjenca.

Kongoli e quan këtë tip personazhi të cilët janë burimi i vuajtjes së paarsyeshme, apo rrjedhojë e cenimit dhe poshtrimit shtetëror dhe mënyrave të tiranisë. Vuajtje që ia vlen të pikëzohet me nderim. Po ashtu në kohën kur bëhet fjalë për vegimet e imagjinatës dashurore të sevdave të ndaluara në Shqipërinë-Had, që ia vlen t'i veshësh me shkëlqim romantik të këndshëm dhe tërheqës, kur pihet konjak me gëlltima *të* bollshme *ose të vogla* sidomos kur vështrohet vargu i tingujve të *"yjeve në qiellin me ngjyrë të kaltër"*. Hadi, te romani "Lëkura e qenit", kujtimi i të cilit endet në trajtën e një ikone politike, të një hijeje nate, të një kërcënimi të gjallë, përfaqëson njëherazi vdekjen dhe pushtetin. Glauku s'kishte mundësi të realizoj zotimin për gjakmarrje të bazuar në vërtetësi, për t'i goditur për vdekje xhelatët me ndëshkimin e duhur për qindra mijë jetë të vjedhura. Përmes këtij ligjërimi autori e zbulon te romani figurën e "Gjemisë…". Kur vjen te skica e së keqes, Kongoli e izolon këtë te zyrtarët e sigurimit përmes shtrëngimit të vrazhdë, detyrimit a shtypjes me forcë gjatë kontrollit, posaçërisht tek çështjet të cilat kanë të bëjnë me udhëzim të Enver Hoxhës mbi tërë

llogarinë e errësirës së skëterrës. Skematizëm që shtyhet nga limitet ku e bukura prej të shëmtuarës, figurat pozitive prej atyre mohuese dhe të këqija vërehen vetëm së jashtmi: prej jetëgjatësisë, lloji i shtëpisë, nga femrat që kanë për krahu, në formën si e vështrojnë epshin erotik. Shëmbëllime të cilat shmangin të zakonshmen apo pengojnë vërtetësinë te trillimi letrar. Apo mbase po shtrojmë më tepër pretendime prej sa është në gjendje të japë letërsia e Kongolit. Hamendësimin të cilin e shton prezantimi përmes shtypit mbi romanin që nxjerret në qarkullim (ku figura e Pranvera Hoxhës qëndron për ilustrim në krah të kopertinës). Krijohet përshtypja se Kongoli e ka shkruar "Gjeminë e mbytur" për më shumë gjepura në Tiranën e viteve '70 apo si përgjigje për debatin e vjetër për hapjen e shkresave dhe dokumenteve të njerëzve vegla të regjimit komunist, ose për çeljen e portave të "shtëpisë me gjethe". Në përfundim të romanit shkruan: "Vila *Gjemia e mbytur*" t'iu vihet në shërbim historianëve apo njerëzve të letrave për të zbuluar misteret sekrete që mbyllen në ta. Një letërsi e tërë dëshmishë të arrestuarish apo të përndjekurish politik, shpallje e të dhënave origjinare dhe historike po krijojnë një shtrat përqasjesh dhe përballjesh, kullimi, interpretimi për debat dhe shqyrtim autentik dhe vlerësues mbi kujtesën. Vendosja e Kongolit sërish apo kaq zbehtë me temën e vë këtë në pozitën e oportunizmit politik. Qëllimi ynë është që të mos e humbim tek autori krijuesin, që prozës tonë të varfër me shumëçka të munguar, ia ka sjellë një klimë psikologjike apo prekëse. *Rrëfimi im më shumë do të jetë një histori, nga ato që njerzit nuk kanë asnjë dëshirë t'i dëgjojnë, u prishin humorin. Më pyete për medalionin dhe mua më duhet të them se ai ka një histori.* (Kongoli F. 2003: 137).

Por shohim që shkrimtari klasik realist i "Burgjeve të Kujtesës" është shndërruar në të panatyrshëm. Prej një decenie letërsia kongoliane na duket sikur njeh paksa rënie krahasuar me nivelin të cilin e kishte me "Lëkurën e qenit" (2004). Flutura Açka, me rastin e prezantimit të romanit "Bolero në vilën e pleqve" të Fatos Kongolit "Një roman i ironisë dhe hidhësisë së trishtuar, është romani i debatit emancipues". – do të shprehej për këtë roman botuesja dhe shkrimtarja e mirënjohur Flutura Açka, 2009. Botën e mbyllur të vilës e trazojnë, kohë pas kohe, doktori i familjes, njeri qejfli, hokatar dhe i paparashikueshëm; djali i pleqve, bos i një firme të fuqishme ndërtimi, me gruan e tij të re e të bukur; vajza e madhe e pleqve, gjyqtare e rreptë; një femër enigmatike, po aq e bukur, veshur gjithmonë me të zeza, etj. Nuk llogarisim këtu "Iluzione në sirtar" (2011 – që i referohet titulli i këtij shkrimi), një libër kujtimesh i nxitur nga nevoja për të kuptuar veten në kuvendim dhe shqyrtim me vetveten, duke i shtyrë të tjerët të kuptojnë se çfarë fuqie kërkon përballja me të kaluarën. Të shkruash për një publik që i përket kohës sonë dhe të mjediseve tona që lexuesi na kupton më mirë, se mund të jetë një çështje. Tjetër çështje është të shkruash për një publik, sikurse mund të shprehej Gramshi, *përputhet me njeriun në përgjithësi*, si qenie universale. Te kjo lloj vetëdije qëndron madhështia e sotme e një vepre s'ka rëndësi ku apo në cilën kohë autori e ka hartuar. Nëse, në fushën e gjerë të jetës dhe veprimtarisë

krijuese letrare, shikojmë apo lexojmë vepra letrare të kohëve, shekujve dhe brezave krijuesish, të niveleve që spikasin, për nga cilësia, mund të vërejmë specifika, stile, individualitete veçori të ndjeshme të cilat mund të na detyrojnë të mendojmë thellë për jetëgjatësinë e tyre morale. Këta kanë ardhur si qenie e jetës shpirtërore, si një përmbajtje të një trajte dhe mënyre të kapshme ideore e strukturore, me shumë pikëpamje të një periudhe historike të racës njerëzore si zanafillë e jetës në tokë, e njeriut të veçantë, të zakonshëm dhe universal, i veshur, me ngjyrimet psikologjike të kohës së tyre, që, për letërsinë apo shkrimtarin kanë sjellë synime, qëllime ose subjekte të domosdoshme për përtëritjen e jetës dhe më pas ngjarje njerëzore. Vlerat morale dhe estetike të veprës letrare, veçanërisht për nga veçoritë dhe refleksionet kohore të shkrimtarëve evropian. Këto vlera kanë qenë të pranishme dhe sërish i ndeshim në mendimin dhe vlerësimin e kohës dhe të subjektivizmit të njerëzve si lexues individual, që tregon qartë se vepra letrare po ashtu edhe krijuesi letrar janë në përballje të mirëfilltë dhe në përputhje të plotë parimore me kohën, realitetin apo seleksionimin e përhershëm të vlerave estetike dhe letrare me ndijimin e së bukurës në art. Koha mbetet kriteri më i pashkëputshëm ose më i paanshëm i seleksionimit në perceptimit të vlerës dhe krijuesit si autor me prirje artistike letrare.

Historia e letërsisë vërteton se shumë e shumë krijues letrarë jo vetëm në Evropë e më gjerë, po ashtu dhe në Shqipëri, Kosovë e gjetiu të cilët mes shumë krijimeve letrare me vlera dhe forma të përkryera në art gjatë kohës së tyre, kanë mbijetuar pak. Për shkrimtarin tonë, koha ka qenë vlerë morale, ashtu siç ka qenë gjëllimi i tij i përjetuar në kolektivitet, si individ ose si krijues. Për këtë arsye shkrimtari ka qenë kriter për vlerësimin e veçorive të qëndrueshme apo të përgjegjshme. Përmes një ngjarjeje rastësore, me shumë talent ose intuitë, vendos në mendjen e tij një vlerë morale tipike njerëzore nga secili individ në shoqërinë që e rrethon, ose në ndjesitë që përjeton krijuesi. Gjatë jetës së vet, krijuesi mund të nxjerr mjaftë krijime të artit letrar, drama dhe novela, vëllime me subjekte nga jeta e përditshme, me vërtetësi dhe pjesë të veçanta, me imtësi apo saktësi të përpiktë të një hulumtuesi të pashoq, saqë proza e tij vërehet sikur ka një lidhje morale të pashkëputshme me kohën, ose sikur pikaset moralisht prej saj, domethënë se për të (krijuesi) akoma është i pranishëm shqetësimi i pranisë së veprës veçanërisht reputacionit të tij si krijues i saj sidomos moralit që përcjell në to. Ndonëse i shkathët dhe i karakterizuar nga një imagjinatë me vetëdije të trazuar e cila mund të shkaktoj gjithfarë konvertimi me kohën, ekzistencën e sidomos me njerëzit. Kongoli sërish, qëndron në përcaktimin e tij si shkrimtar, duke qenë i shkathët, ngulmues, rezistent, i palodhur, i lindur për të punuar e sakrifikuar si moralist dhe idealist. Një autor i këtillë, përveç karakterit të qëndrueshëm që ka dhe e shfaq, përbën tërësinë e brendshme shpirtërore më të ndjeshme njerëzore dhe më emocionale të çështjes, me çka shquhet zotësia e tij si krijues, për të paraqitur vetveten si individ të moralshëm në shoqërinë e qytetëruar bashkëkohore. Kongoli është pa dyshim njëri ndër figurat e pavdekshme të letërsisë sonë, që udhëhiqet në jetë nga

synime fisnike, një vegimtar dhe moralist. Tek Kongoli vepra e tij shndërrohet në vlerë prodhimi dhe kompozimi shpirtëror. Këto të dhëna flasin vetvetiu se ky krijues ka qenë dhe mbetet një individ i posaçëm me dhunti, me mjaft gjallëri për të shkruar vepra letrare, i cili me flijim ka vizatuar artistikisht, portretin e krijuesit të vërtetë, të moralshëm, sepse talenti i tij tashmë është ngritur deri te gjeni letrar.

Një krijues i mirëfilltë i veprës morale njerëzore është në gjendje të krijojë dhe t'u japë jetë figurave të mëdha, në tërësinë e personazheve të tij, duke vendosur në qendër të temës së veprës figura të moralshme, që bëjnë histori. Romani i njerëzve në vuajtje, doemos, nuk sjell ndonjë gjë shumë të veçantë mes librave bashkëkohorë. Ajo që gjejmë të veçantë këtu është kthjelltësia që buron nga personazhet. Krist Tarapin e romanit "Lëkura e qenit", do ta thërrasin gjithmonë Trapi, por ashtu si të ngjashmit e tij, ai do të rrezatojë dritat e mendimit të tij, kthjelltësinë e tij të pakrahasueshme për tema nga më të ndryshmet siç janë emrat, familja, dëshira, seksi, paraja, historia e vendit, alkooli, emigrimi, marrëzia e zbulimit, morrat!..."Jam krejt i pështjelluar, endem qorrazi", thotë Krist Tarapi te "Lëkura e qenit". Shkrimtari i mbushur me eksperiencën njerëzore, jetësore e krijuese i paraqet përmes personazheve ndjenjat dhe moralin në mënyrë të njerëzishme. Jean-Paul Champseix, specialist i letërsisë shqipe do të thotë se "Personazhi i Tarapit në veprën 'Lëkura e qenit' e kualifikon veten si lëkurë qeni". *Më quajnë Krist Tarapi. Emri im u kujtonte njerëzve Krishtin dhe, siç dihet jo shumë larg, te ne Krishti ka qenë një personazh i shpallur armik...* (Kongoli F. 2003: 5-6).

Personazhi femëror në librin e fundit i cili është botuar në Francë, e kualifikon veten si të shëmtuar. I duket se të gjithë e shikojnë si një thes mbeturinash", ka thënë Champseix. Që të arrij këtë dhe për t'u marrë me ta në jetën e tyre, krijuesit i duhet një njohje e thellë kritike, shqyrtuese dhe kureshtare në aspektin profesional, meqë edhe mënyra e të shfaqurit të tyre në rolin e figurës qëndrore i manifeston si objekt dhe temë tejet komplekse. Këto personazhe janë tipik, të veçantë, të cilët me aparencat fizike dhe çastet mbresëlënëse të mënyrës së veprimit artistik bëhen mbizotërues dhe të nevojshëm për kryefjalën e temës së veprës artistike. Këtu personazhi është i paharrueshëm për shkak të vetmisë së tij të madhe, në fshikzën e frikës. Ai e ka të vështirë thjesht t'u drejtohet atyre përreth. Personazhet flasin pa u marrë vesh. "S'munda t'i thosha asgjë", lexojmë, për shembull, te romani "Te porta e shën Pjetrit". Këto janë gjetje vlerash që s'duhen lënë të fluturojnë në kotësi. Pikërisht, përmes kësaj përvoje udhëtimesh njerëzore, tek ata gjen tipare interesante dhe impresionuese, që plotësojnë kuadrin e një fenomeni të çuditshëm që ndodh natyrshëm në jetën njerëzore, kur tërësia tematike afron njeriun si vlerë të botës së brendshme morale. Në këtë rast tema e çliron vetëdijen duke improvizuar ngjarje të papritura në rrafshin moral, por edhe shoqëror të ditës dhe kohës si realitet i përjetuar. Vepra si vetvete dhe shkrimtari si krijues në veçanti janë një kërkim i thelë i fenomeneve tipike njerëzore që paraqesin veçori cilësore dukurish, që bëhen përfaqësim i një koncepti të qëndrueshëm vlerash krijuese. Në vështrimin letrar e konceptual që u bëhet krijimeve

dhe veprave letrare aktualisht në kohën tonë bashkëkohore do të ecin me një qartësi të çuditshme, ndjenjat e epokave të ndryshme, instinktet dhe zakonet e njerëzve të natyrshëm, mekanizmat e jetës si funksion dhe ekzistencë e rrethit shoqëror. Këtë më së miri e vërejme te romani "Jetë në një kuti shkrepësesh", ku një godinë banimi jepet me konkretësinë e një kampi, ku vetëm intimitet nuk ka. Dhe tema arrin të kapërcejë në mënyrë të admirueshme kufijtë e një titulli. *Sot e kam të pamundur t'ju flas për Veronikën, edhe sikur të doni. Nuk jam në formë. Që t'ju flas për Veronikën më duhet të jem me humor më të ngritur. Plot optimizëm. Ndërsa humori im është në pikën më të ulët. fajin për këtë, dua të them që ende nuk ju kam treguar pothuajse asgjë për Veronikën, e keni ju. Kur jam ndier pak a shumë në formë, i gatshëm t'ju flas, keni kundërshtuar.* (Kongoli F. 2007: 141).

Nga romani në roman shpërfaqet një botë e zymtë, pasionante, që i nënshtrohet analizës. Historia e letërsisë dhe kronologjia e jetës së saj ndër shekuj ka ecur nëpërmjet krijimtarisë së madhe të shkrimtarëve me moral e dinjitet të lartë njerëzor, ku bindshëm e fare mirë shihet shpirti i saj si vetë shpirti i njeriut si qenie që ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistoj, thellësia filozofike e madhështisë së letërsisë dhe krijuesit shkrimtar e artist si potencial e si emocionalitet i pakrahasueshëm në të gjitha kohërat. Natyrshëm na lindin shumë pyetje, që kërkojnë përgjigje, se "kush jam, kush je ti e kush janë ata", përpara letërsisë si vlerë shpirtërore dhe fenomenale njerëzore? Le të përpiqemi të gjithë së bashku për të kuptuar se ç'ndodh me letërsinë në realitetin e sotëm. Me gjithë zhvillimin e lartë të gjërave jetësore e njerëzore, ne jemi ende në përpjekje udhëtimi për të mbërritur te një shikim i vërtetë moral i gjërave dhe më qartë, në përgjithësi, ne qëndrojmë përballë letërsisë të pafuqishëm për ta kuptuar e vlerësuar maksimalisht atë. Kohët e tjera, ndoshta të gjitha kohët, të gjitha epokat e hershme deri në ditët e sotme, kanë pasur një ndjenjë më të thellë dhe një kuptim më shpirtëror për vlerat e letërsisë dhe moralit të saj, se sa sot. Kjo ndjenjë morale nuk është kurrsesi e ndjeshme, meqë lidhjet e krijuesit me artin letrar ishin dhe janë mjaft të moçme dhe të gjithhershme, prej vetëdijes sonë të mbarë, që do të thotë, se është ngjallur fillimisht dashuria jonë për artin letrar. Qëllimi ynë për të vështruar gjuhën e artit letrar, vetëdijen e hareshme për larminë e vlerave morale të saj, ngacmimin e brendshëm shpirtëror për të zbuluar domethënien e gjuhës së këtillë të gjithanshme mjaft të moçme sa edhe vetë njeriu. Përfytyrimi i një të fshehtësire, e një vullneti hyjnor pas krejt kësaj larmie të ndjeshme letrare e krijuese, i ngjason një nëne të re të lehonisë së një foshnje engjëllore e cila vështron rrezet e diellit hyjnor dhe orvatet të marr udhën e gjallimit njerëzor edhe për krijuesin dhe letrarin pas të gjitha krijesave letrare, me nuhatjen e tij të mahnitshëm shkon drejt fillimit të gjithësisë e drejt të fshehtave të fillimit, si energji e tërësisë së veprës letrare dhe arteve në gjithëkohësi njerëzore.

Përmes hyjnizimit të krijimtarisë letrare dhe për synimin e një hulumtimi të palodhur për ta ndijuar si ndjenjë shpirtërore të jashtëzakonshme, pikërisht orvatemi që përmes nuhatjes sonë të njerëzishme që ta konkretizojmë si vetëdije më të lartë

komunikimi. Është një bukuri mahnitëse në qoftë se e gjithë bota e kohës sonë e pëlqen dhe adhuron letërsinë dhe artin, duke e ndijuar dhe shijuar me tërë qenien si vetëdije dhe emocion. Lexuesit dhe studiuesit i hyjnizojnë trajtat dhe brendinë e letërsisë së mirëfilltë, meqë krijuesi me vërtetësi paraqet dukuritë e karakteristikave organike shpirtërore të tematikës, të shfaqur përmes një poetike që përkon me vlerën e një vepre të botuar, madje edhe si çast artistik. Në qoftë se i hyjnizojmë pamjet e ngrohta emocionale të përmbajtjes tek shpirtëzimi i artit letrar, ndërkaq raporti ynë i ndërsjellë me të futet në funksion si një zanafillë burimore bashkëkohore të përvijuar dhe për të qenë si vlerë morale njerëzore. Është zgjidhja që transformohet në të tanishmen ose të kaluarën dhe në kohën e duhur, për të hartuar moralshëm ligjërimin e saj letrar. Pra ky është arti letrar. Buron përmes letërsisë dhe me të përfundon çdo gjë, prapëseprapë ajo është në rrugëtim të pambarim. Në rastë se ne hyjnizojmë një njeri, krijues letrar, mjeshtër, mendimtar, ndërkaq ia kemi dalë të kuptojmë për një kohë jetën dhe qenien e tyre si vlerë morale e krijuese, tregon qartë, se përmes vlerës sonë kemi rendur ose jemi interesuar për një moment të ndjeshëm drejt një individi të unifikuar me vlerat e tij, mëtej, piqemi së bashku për tu përshëndetur. Raportet e drejta të krijuesve bashkëkohës me artin letrar ndodhin në një periudhë tjetër e mëtejshme që i mbart nga baza si përmasë morale dhe zemërbutë. Është për shqiptarin dhe botën tonë, për krijuesin dhe mjeshtrin e penës një epokë vetjake, që gjëllon gjatë periudhës së jetuar të përbashkët dhe të moralshme, meqë vepron dhe krijon në trajtë dhe mënyrë të rregullt, derisa arrihet të brumoset një përputhje letrare artistike dhe gjendet një gjallim i frytshëm dhe lakmitar, sepse do ta kuptoj dhe shijoj përzemërsinë e kësaj gjallërie dhe shpirtmirësinë njerëzore në atë hapësirë të gjithanshme dhe pambarim. E në sytë e këtillë të natyrës së ndjeshme i rrëfejmë njëri-tjetrit si letrarë dhe si krijues, qe cili jam unë, qe cili je ti, qe cilët janë ata. Gjithçka që bie në sy a që dallohet paraqet një shfaqje, kësisoj i tërë arti letrarë paraqet një pamje të figurshme, është ligjërim dhe hartim tërësor me nuanca ngjyresash, që paraqesin moral dhe njerëzishmëri.

Literatura

Açka, Flutura (2009), "Bolero në vilën e pleqëve" të Fatos Kongolit, Tiranë.
Bello, Hasan (2009), Letërsia dhe identiteti, Tiranë: Gazeta shqiptare.
Elsie, Robert (2002), "Historia e letërsisë shqiptare", Pejë: Dukagjini.
Grup autorësh (1975), Historia e letërsisë shqipe I-II, Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore.
Kongoli, Fatos (1985), "Ne të tre", Tiranë: Toena.
Kongoli, Fatos (1990), "Karuseli", Tiranë: "Naim Frashëri".
Kongoli, Fatos (1994), "Kufoma", Tiranë: Toena.
Kongoli, Fatos (2003), "Lëkura e qenit", Tiranë: Toena.

Kongoli, Fatos (2004), "Ëndrra e Damokleut", Tiranë: Toena.
Kongoli, Fatos (2004), "Te porta e shën Pjetrit", Tiranë: Toena.
Kongoli, Fatos (2005), "I humburi", Tiranë: Toena.
Kongoli, Fatos (2007), "Jetë në një kuti shkrepësesh", Tiranë: Toena.
Kongoli, Fatos (2008), "Bolero në vilën e pleqve", Tiranë: Toena.
Kongoli, Fatos (2010), "Iluzione në sirtar", Tiranë: Toena.
Kongoli, Fatos (2011), "Si-do-re-la", Tiranë: Toena.
Kongoli, Fatos (2013), "Njeriu me fat", Tiranë: Toena.
Kodra, Klara, Filipi, Rita, Çapaliku, Stefan (1998), "Letërsia shqiptare 2", Tiranë: Toena.
Ramadani, Kujtim (2009), "Letërsia bashkëkohore 13", Botime shkollore, Prishtinë: Albas.
Tuci, Aida (2011). Shkrim i publikuar mbi romanet "I humburi", "Bolero në vilën e pleqve" dhe "Iluzione në sirtar".

Hamit XHAFERI

THE MORAL VALUES IN THE WORKS OF FATOS KONGOLLI

Abstract

The presentation has to do with the analysis of the artistic literary reality and the moral value in the works of Fatos Kongolli. New valuable and characteristic features are highlighted, about the language, ideological integrity and the way of expression on the moral longevity of this author's works. In the works of Kongolli, the interior way of the conceptual and constructive way incorporate the living being of the inner world of a random human's life and nuances of his spiritual world's features. The time events throughout the work of such creator with moral and high consciousness are reflected through the feelings of the Albanian man as a sensitive being with values of the inner human world. This proves that many literary writers from Albania, Kosova and elsewhere have survived as such through works with aesthetic value. Fatos Kongolli says that the time is a moral value, while the creator's life has been experienced only as a person or as a creator. The moral and artistic values in the works of Kongolli are sensitive and quite distinctive, just like the sunlight, to be distinctive by their features and timing. Some of his novels have genuinely faced with the grief and the reality of their artistic and literary values. It is noted that his prose has an inseparable moral relationship even during the time of dictatorship. The creator feels the preoccupation of the reality of the novel with the writer as a creator, especially of the moral that has accompanied him. The author

remains stoic, persistent, sustainable, by going to the literary scene to act and be sacrificed as a moralist with noble sentiments and intentions. Alongside the peculiar features that he expresses, through the emotional circumstance of the inner world, he expresses himself as a moral individual. The author remains a noble, imaginary and moral idealist. The reputation of his work turns into a creative and moral value.

Key words: time, dictatorship, creator, ideological integrity, spiritual world, moral value.

Bajram KOSUMI

"TJETRI" NË TEKSTET LETRARE TË FISHTËS

Abstrakt

Duke qenë se Fishta çmohet si njëra prej majave të letërsisë shqipe, sidomos me epin dhe satirën e tij, shqyrtimi i prezencës dhe statusit social e letrar të "Tjetrit" në veprën e tij është domethënës jo vetëm për tekstin e Fishtës, por edhe për letërsinë shqipe në tërësi. Koncepti i "Tjetrit" në letërsi ka hyrë prej studimeve kulturologjike e sociologjike, prandaj hulumtimi i këtij koncepti në letërsi s'ka se si të mos jetë edhe rezultati i analizës së tekstit në ndërlidhje me studimet kulturore e sociologjike, pra koncepti i "Tjetrit" te Fishta ndërlidhet parësisht me parime kulturore, filozofike, etike, politike e sociologjike. Në analizën e tekstit letrar nga ky prizëm hetohen disa modele të "Tjetrit" në tekstet e Fishtës, por burimi i të gjitha këtyre modeleve kanë dy emërues të përbashkët: një, mendësia e shoqërisë pak a shumë patriarkale dhe e mbyllur, dhe dy, morali i shoqërisë e cila është detyruar të vuajë statusin e të robëruarit për një kohë të gjatë. Në këtë artikull do të përkufizohen këto modele të "Tjetrit" në tekstet letrare të Fishtës duke u argumentuar me shembuj tekstesh të autorit. Në fund do të nxirren përfundime për kulturën e "Tjetrit" në shoqërinë shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX, sipas tekstit letrar të Fishtës. Në artikull është shfrytëzuar përvoja e studimeve kulturore angleze për konceptin e "Tjetrit", sidomos studimet e Eduard Saidit, Bozidar Jezernikut, Cvetan Todorovit, Anthony Giddens, Georg Simmel etj.

Fjalët çelës: *"Tjetri", i huaj, patriarkal, armiqësi, përbuzje, snobizëm.*

Sfondi: qasja teorike

Duke folur për mënyrën e qenësimit të orientalizmit, Eduard Said konstaton me dëshpërim se "orientalizmi në fund të fundit ishte një vizion politik i realitetit, struktura e të cilit theksonte dallimin ndërmjet asaj që ishte e njohur (Europës, Perëndimit, "neve") dhe së huajës (Orientit, Lindjes, "atyre")."[1] Ajo që thekson këtu Said nuk është vetëm dallimi, po fjala **vizion politik i realitetit**. Pra, mënyra se si "njëri" e sheh "Tjetrin" është çështje e vizionit (ndoshta jo vetëm politik!) për

[1] Eduard Said, *Orientalizmi/koncepte perëndimore për Orientin*, Logos-A, 2009, fq. 69.

realitetin. Ky vizion nuk është vetëm i njëanshëm, sepse, si vëren më tej Said, "Orienti ka ndihmuar për të përcaktuar Europën (ose Perëndimin) si imazhin, idenë, personalitetin dhe përvojën kontrastuese të saj."[2] Përkufizimi i Tjetrit është parësisht shenjim **i vetvetes** e vetëm pastaj edhe i Tjetrit, ose, duke shënjuar Tjetrin ne në radhë të parë japim koordinatat e karakterit, mendësisë, traditës, organizimit social, psikologjise individuale dhe të shumë parametrave të tjerë të shoqërisë sonë, pra të "**Neve**". Kjo i bie që Tjetri jemi ne në të vërtetë. Mirëpo, në fund të fundit, këto dallime janë realitet fiktiv, thotë Said, pra nuk ekzistojnë objektivisht, por janë rezultat i mendjes.[3] Sipas kësaj, "ne" dhe Tjetri jemi një realitet fiktiv, i konstruktuar mbi bazën e paragjykimeve "tona" për "të tjerët". Por, ky fakt nuk e zhvleftëson rëndësinë e këtij vizioni politik për realitetin. Këto dallime, thotë Said, janë në funksion jo të njohjes, por të orekseve pushtuese të Perëndimit për të vënë në kontroll Lindjen:

"Orienti kishte së pari nevojë të njihej, pastaj të pushtohej e të vihej nën zotërim, dhe më tej të rikrijohej prej dijetarëve, ushtarëve e gjykatësve..."[4]

Këtu shihet se Said, edhe pse nuk i ka elaboruar një e nga një, krijon tri faza të marrëdhënies me Tjetrin: **njohja, pushtimi** (zotërimi) dhe **rikrijimi** (sipas mendjes së zotëruesve të rinj). Ngjashëm me këtë përshkallëzim, Cvetan Todorov te *Konkuista e Amerikës* krijon tri boshte të marrëdhënies me Tjetrin: 1. Boshti akseologjik (gjykim vlerash te Tjetri), 2. Boshti prakseologjik (afrimi apo largimi me Tjetrin) dhe 3. Boshti epistemologjik (njohja ose mosnjohja e Tjetrit).[5]

Hulumtimi i dallimeve midis "neve" dhe Tjetrit në tekstet letrare të Gjergj Fishtës, na ndihmon në radhë të parë që të kuptojmë veten tonë në një kohë ta caktuar, e vetëm pastaj edhe Tjetrin. Koncepti i "vizionit politik për realitetin" i Saidit është prodhim i një individi apo i një grupi dhe, para së gjithash, ai tregon për vetë individin dhe grupin e jo për Tjetrin. Zakonisht, kur është fjala për vizionin për Tjetrin, roli i individit është fare i parëndësishëm dhe i padukshëm, pra forcohet roli i grupit, i shoqërisë: vizioni për Tjetrin transmetohet përmes individit, por në fakt është vizion kolektiv, është qasje kulturore kolektive. Përfundimisht, shqyrtimi i vizionit për Tjetrin në tekstet letrare të Fishtës dëshmon për vizionin e shqiptarëve për rrethin e tyre "të huaj".

Në këtë artikull janë shfrytëzuar si objekt studime tekstet letrare të Fishtës, duke lënë anash tekstet publicistike dhe të diskurseve të tjera.

[2] Eduard Said, *Orientalizmi*, 2009, fq. 69. 23.
[3] Eduard Said, *Orientalizmi*, 2009, fq. 82.
[4] Eduard Said, *Orientalizmi*, 2009, fq. 123.
[5] Tzvetan Todorov, *Konkuista Amerikës/Çështja e "tjetrit"*, Pika pa sipërfaqe, 2015, fq. 229.

Modelet e situatave me "Tjetrin" në tekstet letrare të Fishtës

Analizën për marrëdhënien me Tjetrin në tekstet letrare të Fishtës e kemi përqendruar te mundësia e përkufizimit të situatave të ndryshme të paraqitjes së marrëdhënieve me Tjetrin. Kjo nënkupton krijimin e një tipologjie të marrëdhënieve me Tjetrin, dhe kjo nuk është e panjohur në literaturën për Tjetrin, e mjafton të kujtojmë tipologjinë e bërë nga Tzvetan Todorov, të cituar më lartë. Në tekstet letrare të Fishtës ka katër modele zotëruese të Tjetrit: modeli i nënçmimit të Tjetrit, modeli i njohjes së vlerave të Tjetrit, modeli i armiqësisë ndaj Tjetrit dhe modeli snobist: imitimi i Tjetrit. Më poshtë do t'i trajtojmë këto modele.

Modeli një

Tashmë është e përshkruar dhe e mirënjohur, nga autorë shqiptarë dhe të huaj, krenaria shqiptare për veten e tij. Kristo Frashëri mendon se një arsye e kësaj krenarie është fakti se osmanët asnjë herë nuk arritën ta pushtonin dhe ta nënshtronin shqiptarin dhe kjo i bënte shqiptarët përbuzës ndaj administratës osmane.[6] Me gjasë, krenaria shqiptare i ka rrënjët më të hershme. Në librin tim *Lirika e Fishtës* kam trajtuar faktin se në shumë këngë të Eposit historik shqiptar narratori thirret në një **vlerë parake**, e cila nuk është e përcaktuar qartë se çka është, por është e tillë për të cilën duhet flijuar edhe jetën.[7] Pavarësisht se në çfarë përmbajtje tematike apo motivore shfaqet kjo vlerë parake, ajo lidhet me të Parët e shqiptarëve dhe me gjakun e gjuhën e përbashkët. Duke qenë se Eposi historik shqiptar ka filluar të krijohet edhe para ardhjes së osmanëve në Ballkan, thirrja në kultin e t'Parëve është shumë më e vjetër se shfaqja e Perandorisë Osmane në Ballkan, pra është shumë e vjetër, e trashëguar që nga epokat e lashta. Si duket, miti ka një gjenealogji të lashtë multikulturore: Herodoti, qëndresën e grekëve të bashkuar kundër persianëve e mbështetë te "mbarë fara greke, e bashkuar prej gjaku dhe gjuhe".[8] Ky mit krenar për lashtësinë, i cili si është dëshmuar në të gjitha epokat e mëvonshme, e ka zotëruar çdo identitet tjetër etnik e fetar, ideologjik e politik, e ka bërë shqiptarin përbuzës ndaj vlerave të huaja. Ky besim në lashtësinë e vet, besim në një si të drejtë natyrore të trashëguar nga Zoti, e ka bërë shqiptarin ndërmarrës të disa veprimeve që e dallojnë nga njeriu i zakonshëm. Kjo psikologji, besoj, e shpjegon urrejtjen për të huajt, që si vëren Koliqi, po edhe shumë studiues të tjerë "shprehet në tanë poezin popullore".[9] Shqiptari ndjehet superior edhe ndaj pushtuesve të vet. Ai i quan me përbuzje: halldupë-turqit, shkie-serbët apo

[6] Kristo Frashëri, *Historia e qytetërimit shqiptar/(nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, fq. 182.
[7] Bajram Kosumi, *Lirika e Fishtës*, Botimet Toena, 2006, fq.118-121.
[8] Robert H. Robins, *Historia e gjuhës*, Dituria, Tiranë, 2007, fq. 30.
[9] Ernest Koliqi, *Kritikë dhe estetikë*, Apollonia, Tiranë, 1999, fq. 75-76.

Europa kurvë (-plakë, -lavire, -rrence e vjeter)-Europën etj. Në poezinë *Shqypnija* Shqipëria mund të jetë e pushtuar, por jo robneshë. Në poezinë *Surgite, mortui* Europa është "mrrutë e ndyt,-/Shkerdhye me evrej t'Parisit e t'Londonit/(së ciles dreqi ia plasi të dy sytë..." sepse ka gjykuar që tokat shqiptare të copëtohen dhe t'u jepen shteteve fqinje. Këtë përbuzje ndaj të huajit nuk mund ta sqarojnë vetëm teoritë sociologjike për shoqërinë patriarkale të mbyllur në vetvete, e cila urren çdo shoqëri tjetër. Shoqëria patriarkale urren vetëm atë shoqëri me të cilën është në kontakt, po në parim jo çdo shoqëri të huaj. Pastaj, vetë-dallimi i shqiptarëve nga të huajt është i natyrës kulturore dhe racore, është përbuzje dhe mospërfillje. Kështu është shprehur në poezinë *Emancipacjoni i Kombit Shqyptar*:

E prap -Zotit shyqyr!- i hue'i mbas sodit
Aj tjetër punë nuk ka me pasë n' Shqypni,
Veç se me ble likura dhish a shkeme;
Me shitë çubukë, bylbyla dheut, ndo'i basme
Per brandavekë, ndo'i kukull fmijsh e tjera:
A se, rrogtar me ne, me ngulun hudra,
Lakna, ndo'i presh neper kopshtije t'ona:
Me bajtë kandilat, kur vorrojmë nd'i t'dekun:
Me fikë ndo'i qiri n'kishë: surles me i ra,
Kur t'i thomë na; por jo ai ma mbas sodit
Me luejtë harushë nder ne; me ngrehë tureçkat
Per dash kumbone e karrapucakue…

Pra, Tjetri këtu vihet jo në një pozitë të barabartë, por i numërohen punët dhe profesionet që mund të ushtrojë në Shqipëri: nga një zot i vendit (pushtues, zotërues, kontrollues), ai tash mund të bëjë punë e profesione që përdoren në kuptimin pezhorativ nga poeti. Pikërisht ky është edhe një argument se pse miti i fesë nuk ishte lajtmotiv i letërsisë së Fishtës (e as i romantizmit shqiptar), edhe në rastet kur është motiv është i bashkërenditur me mitin e gjakut e të gjuhës, pra atdheut, si në formulën "për fe e atdhe". Lajtmotivi i kësaj letërsie është miti i racës, i origjinës së lashtë e i gjuhës së përbashkët, miti i superioritetit dhe i jetës së lirë, dhe ky mit është shtytësi kryesor kundër një race tjetër, pavarësisht nga feja që ka mundur të jetë ose të mos jetë e përbashkët.

Pozita superiore ndaj Tjetrit shfaqet edhe në situata të vështira, kur shqiptarët ende luftojnë për jetë a vdekje, si në këngën *Te Ura e Sutjeskes (LM)*:

Se ti, beli, or Vasil-zeza,
Der me sod me Turk m'je pre;
Por m'ke marr krena Harapësh,
Por m'ke marr krena Zejbekësh,
Vec se sod m'ke hasë m'Shqyptar,

Sa do Vasili, luftëtari malazez, ka qenë i suksesshëm deri në atë ditë në luftëra kundër osmanëve, ai e ka arritur atë sepse ka luftuar me pjestarë të "racave të dobëta" për luftë, por tash që ka hasë një racë tjetër, superiore, ai do ta pësojë.

Në vijim, Tjetri është simbol i së keqes, i degradimit dhe i shkatërrimit:

E mbas sotit Shqyptarët n'gjuhë t'huej do t'flasin:
E gjaksvet t'vet do t'bajn kta t'u ngjatët jeta?
Hajnat lapera zotni do t'i thrrasin,
E t'pa rodit do t'i apin pagë e t'dheta;
Me armë shqyptare, n'za gjithmonë e n'namë,
Sogje Shqyptari shkjaut do t'rrij sod m'kamë.
(Surgite, mortui!)

Modeli dy

Në modelin dy shqiptari dhe Tjetri kanë vlera të përafërta, prandaj edhe nuk ka shkallë mohimi, kundërshtimi a përbuzjeje si në modelin një. Këtu Tjetri është kryesisht luftëtari malazez, të cilin sa do e vlerëson dhe e ngritë lartë, Fishta vazhdon ta quajë shkja, ashtu sikur i quan serbët. Pra, Fishta i njëjtëson malazezët e serbët përmes emërtimit "shkja", edhe pse kjo është në kundërshtim me kuptimet dhe relatat midis shqiptarëve dhe këtyre dy popujve fqinjë, sipas teksteve fishtiane: serbi është armiku numër një, i barabartë me "turkun", pra Perandorinë Osmane, ndaj të cilëve nuk duhet krijuar asnjë mëshirë, deri sa malazezi është armiku me të cilin duhet luftuar me dinjitet. Në këtë model "ne" e njohim Tjetrin, nuk identifikohemi me të, por ia çmojmë ato vlera të cilat për "neve" janë të mira, si janë: trimëria, burrëri dhe qëndrueshmëria. Ai u këndon malazezëve sikur të ishin luftëtarët më të mirë shqiptarë, kur ata i shfaqin këto vlera, apo edhe kur luftojnë kundër osmanëve, si te *Kanga Gjashtë, Dervih Pasha (LM)*:

Heshtu, Zanë, mos qesh me mue:
Se merzitshem kam qellue!
Paj per t'gjallë s'lidhet Nikolla
Se ai po i kisht' do djelm sokola,
Qi per Fe e liri t't'Parit,
Qi per nderë të Gospodarit,
Ndryshe s'bin, jo n'fushë t'mejdanit,
Ndryshe s'rrajn n'asker t'Sulltanit,
Vec si krushku, qi shkon n'darsem:
T'tana plumet presin m'parsem.
Pse edhe ata e kan kanu,
Besë me Turk kurr mos me vu.

Duke lexuar këto vargje, nuk mund ta dallosh Knjaz Nikollën nga ndonjë prej prijësve shqiptarë, dhe nuk mund t'i dallosh luftëtarët e tij nga luftëtarët shqiptarë. Këtu kemi një vlerësim për ato karakteristika të cilat shqiptari i çmon te vetja, të cilat kur i sheh edhe te të tjerët, i vlerëson. Këta luftëtarë malazezë janë të tillë edhe kur luftojnë kundër shqiptarëve. Pra, çmohen vlerat e tyre e jo vetëm fakti se luftojnë kundër osmanëve.

Por kur meritojnë të shahen? Atëherë kur shkelin ato vlera të cilat edhe për kodin e shqiptarit janë të pafalshme, si në rastin kur tradhtojnë, si në Këngën Deka (*Por, s'din Shkjau me mbajtë miqsi!*), apo si në rastin e këngës *Cubat* (LM), kur Vul Cetina thyen kodin kalorësiak të luftës:

Dekun m'tokë e la pushue.
Edhe u turr m'ta i patenzoni
(Shka as atij s'i a epte zakoni),
E i a zdeshi xhamada'n
E i a xuer edhe taga'n,
E i a muer pushken e giatë,
Si nder burra s'asht zanat;

Një rast i tillë është mallkimi që narratori i bën Zeliq Gjukës dhe malazezëve të tjerë të Vraninës, të cilët kishin jetuar më parë në paqe me shqiptarët dhe nën kujdesin e tyre, por kur ushtritë malazeze hyjnë në Vraninë ata tradhtojnë dhe u ndihmojnë atyre në luftën kundër shqiptarëve (LM, *Deka*, 253 dhe 385-391).

Modeli tre

Modeli tre i Tjetrit është më i skajshmi. Ai është Tjetri i pa identifikuar qartë, i huaj, armik, pushtues, zotërues. Ky është modeli i Tjetrit-armik, i cili është krijuar më parë në Eposin historik, si e ka vërejtur Ernest Koliqi.[10] Mund të jenë osmanët, serbët apo çdo tjetër që ka vlera të ndryshme nga ato shqiptare dhe synon t'ia vërë kularin, sikur thotë Fishta, shqiptarëve. E këtij modeli është marrëdhënia e shqiptarëve me Perandorinë Osmane:

N'braz me Turk kurr nuk kan ra
E as kurr pushken s'i a kan da;
Por t'jan gri me të e t'jan vra,
Si me kenë tue u vra me Shkja.
(LM, Cubat, 25-30)

[10] Ernest Koliqi, *Kritikë dhe estetikë*, Apollonia, 1999, fq. 75-76

Si shihet edhe nga vargjet e mësipërme, kulmi i dallimeve dhe i armiqësive është dallimi shqiptar-shkja. Kështu, kur Fishta e vlerëson armiqësinë me osmanët, e krahason me atë ndaj shkjeve (*Si me kenë tue u vra me Shkja*). Ja si shprehet kjo dallueshmëri e skajshme me shkjetë:

Un Shqyptar, ata janë Shkje:
Ne na dan nji gjak e 'i fe:
N'mni t'sho'shoqit kemi le:
Kem' ndermjet nji qiell e 'i dhe!...
(LM, Te Ura e Rzhanicës, 58-61)

Dallimi ndërmjet Neve dhe Tjetrit në këto vargje është sipërore. Natyrisht që krijimi i një dallimi të tillë është i mundur vetëm nëpërmjet hiperbolës, prandaj këto vargje edhe duhet të kuptohen nëpërmjet hiperbolës: dtth. këto vargje nuk vlerësojnë, pra nuk shprehin urrejtje apo armiqësi, por vetëm shprehin dallimin sipëror, aq sa edhe gjaku, feja, lindjet bëhen në këtë kundërshti, qielli e toka janë ndërmjet këtyre dy dallimeve. Këto vargje nuk janë urrejtje natyrore, por një hiperbolë letrare.

Ky Tjetri nuk është kaq i dallueshëm vetëm pse është armik politik ose edhe historik. Fishta njësoj bën edhe me fretërit jezuitë, pra të cilët nuk janë armiq, të cilët shërbejnë dhe mbajnë postet udhëheqëse në Urdhrin e Jezuitëve në Shqipëri. Ai në poezinë *Kur pata kenë ba Papë* i godet ata pa mëshirë, vetëm pse janë të huaj në tokën shqiptare:

Athere kapa nji dajak
M'freten t'huej e t'gjithë vandak
T'i hodha andej detin.

Stefan Çapaliku sheh në këto vargje një qëndrim anti-italian të Fishtës[11], por më tej se kaq, këtu shihet një qëndrim kundër të huajit si sundues i shqiptarëve, qofshin ata miq apo armiq.

Se nuk është fjala për një qëndrim anti-italian apo kundër kujtdo qoftë, por është fjala për një qëndrim kundër të huajit, kushdo qoftë ai, me kusht që ai të jetë dashakeqas i shqiptarëve, e dëshmojnë edhe vargjet e poezisë *Shqipnija*, në të cilat Shqipërinë e ka bërë zoti për inat të huajve:

P'r'ind t'djallit e t'anmikut,
Sot, si shkrue kje m'liber t'qiellit,
- Shkrue me gisht t'nji Perendije
Flamuri kuq e zi l'shon hije:

[11] Stefan Capaliku, *Fishta satirik*, Universiteti i Shkodrës, Shkodër, 1995, fq. 155.

Në këto vargje, sikur edhe në shumë të tjera shfaqet ky vizion përjashtues deri në skajshmëri për Tjetrin: tmerret e luftës mund të maten vetëm me luftën kundër shkjaut dhe më mirë vdekja se robërimi nga shkjau. Armiqësia midis "neve" dhe Tjetrit është gjendje normale, po thuajse natyrore, dhe e kundërta, jo-lufta nuk është gjendje normale. Kështu thotë Fishta në vargjet:

Pse, edhe as hije, tham, nuk ka,
Urtë me ndejun Turk e Shkja.
(LM, Cubat, 363-64)

Ngjashëm me Saidin, një i Huaj i këtij modeli është në radhë të parë I Huaj dhe pastaj edhe njeri.[12] Ky vizion për Tjetrin ka gjasa të jetë, në shumicën e rasteve jo i vërtetë, dhe jo human. Kështu, europianët në shkencën e tyre u kanë mësuar nxënësve për rreth dy shekuj gjëra të pasakta për civilizimin "tanë", si psh. se libri i parë është shtypur në Europë, se makina e parë e shkrimit është shpikur prej Gutenbergut etj., përderisa këto shpikje janë bërë për nja dyqind vjet më herët në Kinë. Këtë vizion europian për inferioritetin e Lindjes e tradhton Samuel P. Huntington në librin *Përplasja e qytetëimeve*, kur thotë: "Ka të ngjarë që gjatë pjesës më të madhe të historisë Kina të ketë pasur ekonominë më të madhe të botës."[13]

Modeli katër

Ky është modeli i snobit ose modeli i shqiptarit të nënshtruar: shqiptari ia nënshtron vlerat, kulturën dhe mendësinë e tij një të huaji, zakonisht më të fortë. Ai mundohet ta imitojë Tjetrin, duke nëpërkëmbur veten dhe vlerat e veta. Ky model shfaqet më shumë në poezinë satirike të Fishtës, si në epin e papërfunduar satirik *Palokë Cuca*. Këtë model të marrëdhënieve shqiptar-Tjetri Fishta e krijon në kohën e krijimit të identitetit të ri shqiptar, në prag të çlirimit nga Perandoria Osmane[14], por është i njëjti model i cili

E 'iqind herë n'ditë tue shitë Atdhenë e fisin,
Zhargas bubrrojshin per nen kambë të t'huejvet
(*Emancipacjoni i Kombit Shqyptar*).

Në stancat 59-66 të *Palokë Cucës* përshkruhet detajisht ky model i shqiptarit, i cili vrapon pas modës, gjuhës dhe kulturës së Tjetrit, duke ua bërë vendin e nderit në

[12] "Një burrë oriental ishte në radhë të parë një oriental dhe vetëm në radhë të dytë një burrë". Eduard Said, *Orientalizmi/koncepte perëndimore për Orientin*, Logos-A, 2009, fq. 279.
[13] Samuel P. Huntington, *Përplasja e qytetërimeve/dhe ribërja e rendit botëror*, Logos-A, 2009, fq. 96.
[14] Zor se mund të besohet që kjo qasje e Fishtës në satirikë krijohet në kohën e "krizës së identitetit", si thotë Stefan Çapaliku duke folur për poezinë Metamorphosis në librin e tij *Fishta satirik* (Universiteti i Shkodrës, 1995, fq. 62-63).

modën, gjuhën dhe kulturën shqiptare. Ndërsa në poemthin satirik *Makeronjana* Fishta ka ironizuar politikat imperialiste italiane ndaj Shqipërisë, të zhvilluara edhe përmes pushtimit kulturor. Për këtë qëllim kanë shërbyer shkolla e gazeta italiane si *La Nazione Albanese*, e drejtuar praj arbërshit Anselmo Lorekio (1843-1924), e në të cilat, si e thotë poeti në paratekstin e poemthit "...tru e zemer u trodhën shqiptarve nder shkolla që gjithcka tjetër të dilshin, përpos se shqiptar-jo..."

Përfundime: Tjetri tradicional i një shoqërie tradicionale

Antony Gidens, duke përfolur George Simmel-in dhe punimin e tij "The Stranger" (1908), thotë se me ardhjen e modernitetit (tre shekujt e fundit) kuptimi i fjalës "i huaj" ndryshon: në kulturat paramoderne "i huaji" është një person i jashtëm, i dyshimtë dhe jo i pranueshëm lehtë në shoqëri; ndërsa në kulturën moderne, ne ndërveprojmë në mjedise urbane me njerëz të tjerë, të huaj, të panjohur etj., mirëpo ky ndërveprim merr formën e kontakteve shoqërore.[15] Ne kalojmë çdo ditë pranë shumë individëve të tjerë në rrugët e qyteteve dhe, në çdo takim, ne e skanojmë njëri tjetrin me sy, duke krijuar për veten dhe për tjetrin besimin se asnjëri nuk kemi qëllime të këqija. Të dy këto variante të kontaktit me Tjetrin, si atë të kulturës paramoderne dhe atë të kulturës moderne, e hasim edhe sot në kulturën shqiptare. Kur kalojmë nëpër viset rurale shqiptare dhe takohemi me Tjetrin e panjohur, pra të huaj, tjetri ose ti e përshëndet me "A je lodhur?" dhe përgjigja është "Jo, jo. Ti a je lodhur?" Kjo përshëndetje është sinjal i krijimit të besimit ndaj të huajit: ka kuptimin se mund të kalojmë lirisht pranë njëri-tjetrit sepse nuk kemi qëllime të këqija. Ndërsa në zonat urbane nuk ekziston një përshëndetje e tillë: njerëzit kalojnë pranë njëri-tjetrit, e skanojnë njëri-tjetrin me sy, por nuk përshëndetën. Ndodhë ajo që Giddens e quan "pavëmendje civile"[16], e cila në të vërtetë nuk është pavëmendje e vërtetë, por vëmendje dhe krijim i besimit.

Ky kufi midis paramodernitetit dhe modernitetit në marrëdhënien ndaj Tjetrit nuk hetohet në tekstin letrar të Fishtës. Prandaj ka katër modele të artikuluara të Tjetrit te ai. Modeli një e ka prototipin e vet te Eposi historik. Në atë Epos është krijuar marrëdhënia me Tjetrin, sipas ligjësive të një shoqërie patriarkale (paramoderne, sipas Giddens-it): kur Tjetri është mik, shtëpia është e tij[17], por kur ai është armik, duhet luftuar deri në fund. Kur malazezët janë në luftë me shqiptarët, janë aq të dallueshëm sa që kanë ndërmjet tyre gjak, fe, tokë e qiell, dhe janë aq të urryer sa që lindin në mëri të njëri tjetrit; por kur ata janë në luftë me osmanët, ata janë me tri zemra, sokola, trima, liridashës dhe shfaqet simpatia ndaj tyre. Modelin dy, të

[15] Anthony Giddens, *Pasojat e modernitetit*, UET Press, Tiranë, 2013, fq. 82.
[16] Anthony Giddens, *Pasojat e modernitetit*, UET Press, Tiranë, 2013, fq. 84.
[17] Në nenin XCVI, paragrafin 20 të Kanunit të Lekë Dukagjinit thuhet: "Po të hini miku në shpi, gjak me të pasë, do t'i thuejsh: ‹Mirë se erdhe!›

cilin mund ta quajmë homerik, është njohja që narratori epik ua bën vlerave të Tjetrit: Tjetri, sa do armik, ka vlera të larta morale, njerëzore e luftarake. Prandaj luftëtarët malazezë luftojnë dhe vdesin heroikisht dhe dëshmojnë cilësi të larta njerëzore e luftarake. Modeli tre, sa do tradicional, shënon një hap përtej konventës: shqiptari është i denjë të jetë i lirë deri në pafundësi, pa asnjë detyrim, përngjasim apo nënshtrim ndaj Tjetrit. Kjo simbolizohet me formulën frazeologjike të Eposit Historik, të përdorur shumë nga Fishta:

Krejt e lirë kjo t'ishte, e askujë
Nji Krajlit a 'i Mbretit t'huej,
Me i ba ma kurr tuniatjeta
Kurr me i la ma pag e t'dheta:
(LM, Cubat, 41-49)

E kundërt me këtë model është modeli katër, po ashtu jokonvencional: koncepti i snobizmit. Ky koncept është edhe i ri në literaturën shqipe të fundshekullit XIX dhe fillimshekullit XX. Me formimin e shtetit shqiptar dhe me krijimin e forcimin e vlerave morale, kulturore, shtetërore e tjera të shoqërisë shqiptare, shfaqet një koncept i inferioritetit ndaj Tjetrit, pra edhe i nënshtrimit apo snobizmit. Kjo theksohet te poezia satirike, sidomos te *Palokë Cuca*, te *Gomari i Babatasit* etj. Këtë koncept të snobizmit e hasim edhe sot në kulturën shqiptare.

Pavarësisht prej tendencës së krijimit të marrëdhënieve të reja në konceptin e Tjetrit, Fishta mbetet tradicional në këtë çështje: "uni" dhe mendësia e tij duhet të jetë superior në marrëdhënie ndaj Tjetrit. Duke përfunduar me katër tipat e Tjetrit në tekstin e Fishtës dhe faktin se ai ka mbetur brenda kulturës paramoderne ndaj Tjetrit, një pyetje shtrohet vetvetiu: pse ai mbeti brenda atij kodi paramodern në fillim të shekullit XX? Mbase, kjo pyetje mund të ketë një përgjigje analoge me përgjigjen se pse Fishta shkroi një ep kombëtar në kohën kur tashmë epi ishte praktikisht një gjini letrare e vdekur. Por, kjo përgjigje kërkon një artikull tjetër.

Literatura e cituar

Çapaliku, Stefan, *Fishta satirik*, Universiteti i Shkodrës, 1995.

Frashëri, Kristo, *Historia e qytetërimit shqiptar/(Nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008.

Giddens, Anthony, *Pasojat e modernitetit/me parathënie për botimin shqip nga Fatos Tarifaj, Ph.D.*, UET Press, Tiranë, 2013.

Huntington, Samuel P., *Përplasja e qytetërimeve/dhe ribërja e rendit botëror*, përktheu Xhevat Lloshi, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2009.

Jezernik, Bozidar, *Europa e egër*, përktheu Dritan Varfi, Plejad, Tiranë, 2010.

Kanuni i Lekë Dukagjinit, Gjonlekaj Publishing Company, New York, 1989.

Koliqi, Ernest, *Kritikë dhe estetikë*, përgatitur nga Stefan Çapaliku, Apollonia, Tiranë, 1999.

Kosumi, Bajram, *Fishta dhe tradita letrare shqiptare*, Brezi '81, Prishtinë, 2012.

Kosumi, Bajram, *Lirika e Fishtës*, Botimet Toena, Tiranë, 2006.

Robins, Robert H., *Historia e gjuhës*, përktheu Genc Lafe, Dituria, Tiranë, 2007.

Said, Eduard, *Orientalizmi/koncepte perëndimore për Orientin*, përktheu Xhevat Lloshi, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2009.

Simmel, Georg, "The Stranger" (1908), në Georg Simmel, *On Individuality and social forms*, edited and with an Introduktion by Donald N. Levine, The University of Chikago Press, 1971.

Todorov, Tzvetan, *Konkuista Amerikës/Çështja e "tjetrit"*, përktheu Primo Shllaku, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015.

Bajram KOSUMI

"THE OTHER" IN FISHTA'S LITERARY TEXTS

Abstract

Considering that Gjergj Fishta (1871-1940) is regarded as one of the most prominent writer in Albanian Literature, especially with his epic and satire, the review of the presence and social and literature status of "The Other" in his work is significant not only for his writing but for the whole Albanian literature. The concept of "The Other" in literature has derived from cultural and sociological studies, therefore the study of this concept in literature is also a result of text analysis, in relation with cultural and sociological studies, thus the concept of "The Other" is primarily related to cultural, philosophical, ethical, political and sociological principles. From the prism of the text analysis, several models of "The Other" in Fishta's texts are identified, however, the source of these models has two common denominators: one, the mentality of a patriarchal and closed society; and two, the moral of a society that has been forced to suffer the status of captivity for a long time.

In this article, the models of "The Other" will be defined and argued by the examples from the Fishta's texts. Based on Fishta's literary text, conclusions will be provided about the culture of "The Other" in Albanian society of the first half of the 20th century. In this article the experience of English Cultural Studies is used for the concept of "The Other", especially the studies of Eduard Said, Bozidar Jezernik, Cvetan Todorov, Anthony Giddens, Georg Simmel, etc.

Key words: "The Other", the foreigner, patriarchal, enmity, contempt, snobbism.

Abdulla REXHEPI

'JEZIDI' SI TJETRI NË POEZINË FETARE TË NAIM FRASHËRIT

Identitetet shoqërore krijohen në ndërveprim me të tjerët dhe identiteti jonë ose i grupit ("ne") formohet nga procesi i mendimit për veten ose për "ne"-në raport me "tjetrin". Është një proces egocentrik ose etnocentrik, ku unë/ne shohim nga perspektiva jonë dhe përcaktojmë kush janë "të tjerët" e kush "ne". Kështu "ne" nuk jemi "ata" dhe anasjelltas. Dikotomitë bazuar në kategori gjinore, racore, të seksualitetit, klasore, fetare e të tjera, si: "Ne" burrat, "tjetri" gratë (Simone de Beauvoir, Seksi i dytë), po kështu, ne normalët, të tjetët të çmendurit Michel Foucault, Histori e marrëzisë/çmendurisë), vendasit/të huajt, oksidentët/orientët ose myslimanët (Said, Orientalizmi) miqtë/armiqtë, të bardhët/zezakët (Stuard Hall), heteroseksualët/homoseksualët (Foucault, Historia e seksualitetit), shqiptarët/turqit-aziatikët (Sulstarova, Arratisje nga Lindja) e dikotomi të tjera. Nëse në poezinë me karakter kombëtar të Naimit, 'turku/aziatiku' përbënte tjetrin e shqiptarit dhe ishte simbol i të keqes dhe prapambeturisë së tij, në poezinë fetare të tij, 'Jezidi' dhe familja e tij janë 'tjetri' i shqiptarit bektashian, i cili ishte dhe shqiptari ideal i Naimit.

Në këtë punim mëtohet të trajtohet koncepti i 'Jezidit' si koncept i tjetrit në poezinë fetare të Naim Frashërit.

Fjalët kyçe: *'Tjetri', Jezidi, bektashizmi, Naim Frashëri*

Traditat fetare paramoderne, gjërat i ndajnë në të përjetshme dhe përkohshme dhe njeriu i këtyre traditave përballë ka një 'tjetër', të madh i cili quhet Zot që është i distancuar nga toka. Për atë dhe sipas Emenuel Levison, njeriu i këtyre traditave gjithnjë synon 'të ikë nga vetvetja dhe t'i bashkohet atij Tjetrit të madh'. Ndërsa tradita filozofike greke, duke qëndruar përballë një çështjeje të këtillë, anon kah veprimi identifikues. Në kuptimin që duke menduar për qenien apo phusisin në vend të hyjnores, njeriu mbetet në brendësinç apo kafazin e tij që e kufizon brenda rrethanave dhe kohës së caktuar. Kështu dhe kjo ontologji mëton që ndërveprimin njeri-botë ta përshkruajë brenda një sistemi të mbyllur në vete që nuk ia mësyn daljes nga vetja e që çdo gjë e përkufizon me veten e tij. Prandaj dhe Levison duke kritikuar filozofinë subjektiviste, na sjell kritika konstruktive edhe mbi epistemoogjinë moderne. Në epistemologji, duke u mbështetur në kogiton dekartiane, mendimtari gjërat apo çështjet tjera i redukton në aktin 'identifkues. Në kohën kur njeriu modern veten e

konsideron vrojtues të gjithësisë dhe mendon se fenomenet dhe objektet e jashtme futen brenda trurit të tij, dhe kështu ai, duke i sistematizuar dhe analizuar ato, mundet ta njohë gjithësinë, mu në këtë rast ai dëshiron që vartësitë njohëse t'i bëjë për vete dhe kështu dhe t'i dominojë ato. Prandaj dhe, duke njohur botën e çështjeve dhe gjërave të ndryshme, i sistematizon ato në një dyzinë subjektive dhe në koordinim të këtyre sistematizimeve –por në bazë të arsyes së vet- krijon rregulla dhe parime. Sipas Levinasit, këtu konceptualizimi, teoritizimi dhe subjektivizimi i 'tjetrit' shndërrohet 'identifikim'[1].

Koncepti i tjetrit në përgjithësi ka të bëjë me përsiatjet dhe mendimet rreth identitetit qoft individual a shoqëror. Për herë të parë, Ernesto Laclau[2] bëri dallimin midis identitetit dhe identifikimit, e që sipas tij, identiteti shpjegon apo na informon për qenësinë substanciale të individit e cila gjithnjë duhet të rizbulohet dhe rinjihet, ndërsa identifikimi tregon për procesin në të cilin i konstruktojmë identitetitin apo identitetet[3]. Prandaj, edhe sot e kësaj dite shohim divergjenca midis substancialistëve dhe konstruktivistëve në çështjen e idenditetit, veçanërisht në trajtesat e tyre rreth dallueshmërisë ose tjetrit. Pyetja kryesore e tyre është se si ta shpjegojmë 'të dallueshmen/diferencën' dhe çfarë lidhje kanë mes vete identiteti dhe diferenca. Ndoshta dhe kjo është njëra nga pyetjet elementare që po i preokupon mendimtarët e sotëm. Për atë dhe, Diana Fuss në librin e saj "Identification papers" analizon ndërveprimin midis identitetit dhe dallueshmërisë/diferencës dhe aty vë një kufi të madh mes identitit dhe identifikimit dhe tregon se si proceset identifikuese përdorin fuqi dinamike dhe të sofistikuara, të cilat bashkë me krijimin e ndjenjës së identitetit, në realitetet e vënë në pikëpyetje identitetin parësor apo origjinal. Sipas saj, identifkimi ose të identifikuarit vepron duke u bazuar vetëm në lidhje apo ndërveprim me të tjerët. Ajo shkruan: identifikimi në një mënyrë është proces devijues sepse gjithnjë 'veten' e formon në relacion me 'tjetrin'[4].

Prandaj dhe, identitetet shoqërore sipas mendimtarëve postmodernë, janë ndërtuar në ndërveprim me të tjerët dhe identiteti jonë ose i grupit ("ne") formohet nga procesi i mendimit për veten ose për "ne"-në raport me "tjetrin". Është një proces egocentrik ose etnocentrik, ku unë/ne shohim nga perspektiva jonë dhe përcaktojmë kush janë "të tjerët" e kush "ne". Kështu "ne" nuk jemi "ata" dhe anasjelltas. Dikotomitë bazuar në kategori gjinore, racore, të seksualitetit, klasore, fetare e të tjera,

[1] Emmanuel Levinas. (1998). Otherwise Than Being or Beyond Essence, Trans by Alphonso Lingis, Duquesne University Press, Pennsylvania. pp. 34-38.

[2] Ernesto Laclau. (1994), "Introduction". In The making of political identities, ed. Ernesto Laclau, 1-8. London, Verso.

[3] Si duket Laclau fjalën identifikim e përdorë në kuptimin e saj në psikologjinë e Frojdit, ku ky i fundit është i mendimit se individi ka nevojë të identifikohet me një grup në kohën dëshiron të eliminojë mungesën e brendshme dhe kështu mundohet të rigjejë një identitet më unik apo që e unifikon më një shoqëri më të madhe.

[4] Diana Fuss. (1995) Identification Papers. New York, Routledge. p.45.

si: "Ne" burrat, "tjetri" gratë (Simone de Beauvoir, Seksi i dytë), po kështu, ne normalët, të tjetët të çmendurit Michel Foucault, Histori e marrëzisë/çmendurisë), vendasit/të huajt, oksidentët/orientët ose myslimanët (Said, Orientalizmi) miqtë/armiqtë, të bardhët/zezakët (Stuard Hall), heteroseksualët/homoseksualët (Foucault, Historia e seksualitetit), shqiptarët/turqit-aziatikët (Sulstarova, Arratisje nga Lindja) e shumë dikotomi të tjera, të cilat tashmë janë shterruar nga studiuesit dhe mendimtarët.

Prandaj, bazuar në rezultatet intelektuale dhe studimore të këtyre dijetarëve, mund të trajtojmë edhe konceptin e tjetrit në veprën e Naim Frashërit, poetit kombëtar shqiptar.

Nëse bazohemi në një studim të Krist Malokit në të cilin personalitetin krijues të Naimit e trajton nga prizmi psikanalitik, shohim se poeti ky i fundit, ka kaluar nëpër dy faza psiqike në jetën e tij, të cilat gjithashtu janë reflektuar edhe në krijimtarinë e tij letrare. Faza e parë është nga lindja deri në vitin 1882 dhe të e dyta pas vajtjes në Stamboll, ku njihet me veprimtarinë e Samiut, Vaso Pashës dhe Jani Vretos. Sipas Malokit, epika e Naimit, më saktësisht Istori e Skënderbeut dhe Qerbelaja qenë krijuar në periudhën parë, në kohën kur poeti akoma ishte nën ndikimin e plotë të letërsisë persiane dhe asaj bektashiane dhe kështu që të dyja këto vepra janë ahistorike. Sipas tij, në fazën e dytë, Naimi është më aktivë në çështjen kombëtare, më realist e më pak idealist e melankolik. Naimi në këto dy vepra më shumë se çdo kund tjetër ndërton tjetrin e tij, e në fakt mëton të identifikojë shqiptarin përballë turkut dhe identitetin bektashian shqiptar përballë atij turko-sunit[5].

Po a thua pse Naimi në fazën e parë të jetës, më tepër i rrekej ndërtimit të konceptit për tjetrin? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, mund të na ndihmojë Hegeli me veprën e tij "Fenomenolgjia e Shpirtit"[6].

Hegeli në fillimet e kësaj vepre thotë se vetdija jonë për ta dëshmuar veten ka nevojë vetëm për një vetdije tjetër të cilën ai e quan "unifikim i vetes në qenien e tjetrit" dhe për herë të parë këtu përballemi me çështjen e 'tjetrit'. Por përballja e dy vetdijeve në fillim është armiqësore dhe secila prej tyre mundohet që duke e njohur tjetrën, ta dëshmojë qenësinë evet. Prandaj dhe këto dy vetdije janë në përleshje të vazhdueshme dhe çdo njëra duke e mohuar tjetrën, përpiqet të vërtetojë qenien e saj.

Në fund të librit, Hegeli flet për 'dijen aboslute' në të cilën, shpirti kur tashmë ka tejkaluar varësitë apo identitetet politike, shoqërore, kulturore, fetare, filozofike dhe artisitike, dhe ka arritur në një nivel absolut, e cila sipas Hegelit quhet 'vetdija absolute'. Kjo dije absolute në fund është një vetdije kolektive ku të gjithë 'unë' kanë zënë vend te 'tjetri' dhe kështu janë krijuar lidhje shpirtërore me njëri tjetrin. Por ky shpirt absolut nuk duhet kuptuar si dicka statike në kuptimin klasik të tij, por gjithnjë

[5] Krist Maloki. (2003). Oriental apo Okcidental, Plejad, Tiranë, fq. 48.

[6] G. W. Friedrich Hegel. (2005) Fenomenologjia e shpirtit. Përktheu: Valentina Kazanxhi. Botimet Ideart, Tiranë.

është në 'bërje' apo 'krijim', pra vazhdimisht është në mohim të vetes së tij. Në fund, Hegeli thekson se ky shpirt aboslut është prodhim i tjetërsisë së vet. Dmth. Gjithnjë veten e vendosë te tjetri dhe mohon dikotominë. Si rezultat, shpirti përfundon në 'ne' ku përfshihet dialektika e 'unë'.

Megjithatë, Hegeli kërkon një rrugë të tretë që do të qëndronte në mes të subjektivizimit dekartian-fishteian-huserlian dhe qëndrimit vetmoues të postmodernistit Levisan. Në këtë kuptim, Hegeli duke shfrytëzuar idenë e zëvendësimit të konceptit 'fuqi' në vend të 'gjësë', dy palët 'unë' dhe 'tjetri' nuk i shehë si elemenet të pavarura esencialisht, por i konsideron si ndërlidhura me njëra tjetrën të cilat koncepte ndërmjetësuese apo intersubjetkive dhe që në fund të fundit edhe 'unë' edhe 'tjetri' janë produkte kulturore.

Pra, Hegeli është i mendimit se shpirti i njeriut në fillimet e jetës së tij ndërtohet apo identifetikohet gjithnjë duke u bazuar te tjetri, të cilin e konsideron të huaj. Ndërtimi i konceptit të tjetrit si i huaj ose armik ndodhë sidomos në moshat apo shkallët intelektuale më të ulët, kur individi doemos dëshiron të ndërtojë një identitet apo dëshiron të identifkohet në realitetin në të cilin jeton.

Pra, duhet të kemi parasysh se Naimi poemat epike të tij i shkroi në pjesën e parë të jetës së tij. Kështu, nëse në poezinë me karakter kombëtar të Naimit, 'turku/aziatiku' përbënte tjetrin e shqiptarit dhe qe simbol i të keqes dhe prapambeturisë, në poezinë fetare të tij, 'Jezidi' dhe familja e tij janë 'tjetri' i shqiptarit bektashian, i cili ndoshta qe dhe shqiptari ideal i Naimit.

Por kush qe Jezidi dhe simbol i ç'gjeje është ai?

Siç dihet, Naimi qe i lindur në një familje bektashiane dhe më shumë se kaq, ai u shkollua nën frymën e filozofisë dhe misticzmit bektashian dhe më pas në krijimtarinë e tij letrare dhe diturore manifesteoi mendimet e tij personale rreth bektashizmit. Sic dihet tashmë nga të gjithë, bektashizmi është një degë apo sekt i shkollës apo interpretimit shi'it i cili u themelua nga Haxhi Bektash Veliu. Edhe pse sot, bektashizmi i shqiptarëve në rrafshin teorik dhe praktik më tepër ka ngjashmëri me alevitët e Turqisë dhe Sirisë sesa me shi'itët, megjithatë historikisht ata janë identifikuar si një krahë apo drejtim shi'it dhe kjo sidomos vërehet edhe nga arketipet dhe idetë e përbashkëta që kanë për të kaluarën opozitare dhe ndoshta armiqësore përballë pushteteve dhe teologjive zyrtare të myslimanëve të cilët identifikohen si synit. Kulmi i ndarjes së shi'itëve nga grupi tjetër, pra synitët, është ngjarja e Qerbelasë, në të cilën u vranë nipi i Profetit Muhamed bashkë me familjen dhe shokët e tij. Kjo vrasje u realizua me urdhër të Kalifit të quajtur Jezit. Qerbelaja qe një tragjedi që pas vetes la gjurmë të pashlyeshme te myslimanët, sidomos tek ata shi'it, të cilët përveç që me rituale të ndryshme, edhe me letërsi e bënë të paharrueshme në mendjet dhe zemrat e ithtarëve të kësaj tradite. Për te, qenë shkruar vepra të shumëta historike, por krijimtraia letrare për këtë ngjarje është e pasur dhe tepër interesante që quhet edhe Maktel. Siç dihet, Naim Frashëri ia ka kushtuar një vepër të plotë kësaj ngjarje,

pra Qerbelanë, në të cilën është i ndikuar plotësisht nga vepra Hadikatus Suada e Fuzliut, poetit azero-turk.

Naimi, në poemën e Qerbelasë, por edhe në poezi tjera me karakter fetar, në njërën anë vendosë të vërtetën, të mirën, mëshirën, e të gjitha epitetet e bukura të cilat gjendeshin te Aliu, familja e tij dhe pasuesit e tij, kurse e joevërteta, e keqja, e shëmtuara, dhuna, dhe veset e keqija qenë të mbledhura te Jezidi, shokët dhe kalifët tjerë emevit. Një dikotomi të tillë mund ta vërejmë fare lehtë gjatë leximit të poezisë së tij.

Gënjeshtra me të vërtetën / po haheshin gjithë jetën / e vërteta kish Alinë / gënjeshtra jezitërinë (Qerbelaja, fq. 246.)

Ajy, që do njerëzinë / beson Muhamet Alinë/ Hatixhen' e Fatimenë / edhe Hasan' e Hysenë / Ajy që bën ligësitë / ka në shpirt jezitëritë / ajy është Jeziti vetë/ Që bën keq në këtë jetë.

Hysejni 'shtë dashuria / që fatbardhëson / buron soje miqësija / që na lartëson

Jeziti 'shtë egërsirë / që sjellë ligësi / dhe s'delë soje punë e mirë/ po dem dhe zi.(Abaz Aliu, Vepra 1, fq. 170)

Poeti në shumë vende nga lexuesi i tij shqiptar kërkon që të largohet nga rruga e Jezidit, rrugë sipas të cilit ndiqej edhe nga ideologjia zyrtare politike e fetare e Perandorisë Osmane dhe kështu t'i bashkohej të vërtetës, pra rrugës së Husejnit të cilën e ndiqnin bektashianët. Duhet theksuar se jezidi si simbol i të keqes apo ligësisë, ka depërtuar thellë edhe në kulturën shqiptare, sa që edhe sot e kësaj dite, gjyshet kur qortojnë nipat e tyre u thonë 'Jezid' apo 'ah jezidi nihere' e shprehje të ngjashme.

Mos u përzje me Syfjanë / mos u bëjë me Mavijenë / Me Jezitn' e me Mervanë / Po bashkohu me Hysenë. (Mirësija, Vep. 2. Fq. 173)

Përfundim

Njeriu i traditave fetare paramoderne veten nuk shihte të ndarë nga Tjetri i madh, dhe kështu nuk e konsideronte të nevojshme të identifikohej përballë të tjerëve, madje sipas Levison, ai gjithnjë mëtonte të unifikohej me Tjetrin e madh (Zotin). Por me daljen në pahë të modernizmit, pas ndarjes së njeriut nga Tjetri i madh, vazhdimisht e ndjente nevojën e krijimit të 'të tjerëve', me qëllim që ta identifikonte dhe t'i jepte kuptim vetes së tij dhe në këtë mënyrë u krijaun identitete fetare, etnike, gjinore, rajonale, etj.. Madje studiues si Fuss bënë dallimin e identitetit dhe identifikimit dhe vë theksin se identifikimi është procesë që e zbehë vet identitetin. Ndërsa sipas Hegelit, shpirti i njeriut në fillimet e tij, pra në moshën e re më tepër ndjen nevojën e krijimit të tjetrit me qëllim të identifikimit të vetvetes.

Prandaj dhe kur kemi për bazë konkludimet e Krist Malokit në lidhje me dy periudhat e jetës së Naim Frashërit, shohim se ai në periudhën e parë shkruan veprat kryesore kombëtare-fetare, nëpërmjet të cilave synon identifikimin e shqiptarëve

karshi turqëve. Meqë bektashizmi qe shkëputur politikisht nga Perandoria Osmane synite, sepse në rrafshin teologjik qe ndarë shumë më parë, edhe shqiptarët të këtij sekti e kishin më lehtë të mendonin për krijimin e kombit-shtetit të pavarur shqiptarë dhe Naimi më mirë se çdo bektashian tjetër shqiptar arriti t'i artikulojë idetë dhe konceptet e tij fetare-kombëtare të cilat ishin në kundështim me pushtetin qëndron osman. Siç duket, Naimi synonte që shqiptarët të mos kishin asnjë lidhje me turqit dhe duke vënë theksin vazhdimisht se e vërteta dhe e mira qëndron në anën e bektashianëve, dëshironte që në kuadër të projektit të tij kombëtar, shqiptarët të kishin një besim shumë të ndryshëm nga ai që kishin turqit.

Literatura

Diana Fuss. (1995) Identification Papers. New York, Routledge.

Emmanuel Levinas. (1998). Otherwise Than Being or Beyond Essence, Trans by Alphonso Lingis, Duquesne University Press, Pennsylvania.

Ernesto Laclau. (1994), "Introduction". In The making of political identities, ed. Ernesto Laclau, London, Verso.

G. W. Friedrich Hegel. (2005) Fenomenologjia e shpirtit. Përktheu: Valentina Kazanxhi. Botimet Ideart, Tiranë.

Krist Maloki. (2003). Oriental apo Okcidental, Plejad, Tiranë.

Naim Frashëri, Vepra 1,2,3,4,5,6, Botimet e Rilindjes, Prishtinë, 1986.

Abdulla REXHEPI

YAZID AS THE 'OTHER' ONE IN THE RELIGIOUS POETRY OF NAIM FRASHERI

Abstract

Social identities are created by interacting with the others so our identity or the identity of the group (us) if formed through the process of thinking about ourselves or about "us" in relation to "the others". It is an egocentric or ethnocentric process, where I 'we see things from our perspective and point out who are "the others" and who are "we". Therefore "we" are not "them" and vice versa. Dichotomies based on sexual, racial, class, religious etc. categories, like "We" the men, "the others" women (Simeone de Beauvoir, "The second sex") and "we" normal people, others, fool people as well (Michel Foucault, The history of stupidity / madness), Natives / Strangers, Occidentals / Orientals or Muslims (Said, The Orientalism), friends / enemies, The white people / The black people (Stuard Hall), heterosexuals /

homosexuals (Foucault, The history of Sexuality), Albanian / Turkish - Asiatic (Sulstarova, The escape from the east) and other discussions as well. If in the national character poetry of Naim, the Turkish/Asiatic made "the other" of the Albanian, and was the symbol of his evil and backwardness, in the religious poetry of him, "Yazid" and his family are "the others" of the Bektashi Albanian, which was the ideal Albanian of Naim as well. In this script we aim to treat the concept of "Yazid" as the concept of "the other" in the religious poetry of Naim Frasheri.

Key words: The Other, Yazid, Bektashi religion, Naim Frasheri

Avdi VISOKA

TJETRI DHE MREKULLIA E HUTISË: KAMY E PASHKU

Abstrakt

Koncepti i Tjetrit në letërsi ka polin e vet filozofik dhe estetik. Në fakt, perceptimi i Tjetrit është i pandashëm edhe nga projektimi i Vetvetes dhe i preokupimeve identitare vetjake, sa edhe nga ndërtimi i raportit me Tjetrin, duke problematizuar kështu artikulimin dhe vetëartikulimin përbrenda iluzionit, fiksionit dhe realitetit.

Tjetri fiton një rezonancë krejt të veçantë në romanet e Kamysë dhe të Pashkut. Koncepti i absurdit si perceptim i Tjetrit, por edhe si artikulim i vetevetes dhe si gjenerues i raporteve reciproke, i bën këta autorë krejt të veçantë në letërsi. Shqyrtimi i përafrimeve dhe diferencave të romanit të këtyre dy autorëve jep mundësinë e vënies së paraleleve ndërmjet letërsisë dhe kulturës shqiptare me kulturat dhe letërsitë e tjera, veçanërisht me atë frënge, duke shërbyer edhe si instrument i matjes së dallimeve dhe përafrimeve kulturore, sociale e letrare ndërmjet "nesh" dhe "atyre".

Fjalët çelës: *tjetri, absurdi, Anton Pashku, Albert Kamy.*

Hyrje

Kur ia kumtuan lajmin për vdekjen tragjike të të birit 47-vjeçar, nëna e Kamysë - gjysmëshurdhmemece dhe fare analfabete - tërë dhimbjen dhe emocionin që e shprehu për humbjen tragjike të të birit e dha përmes një klithmë që i shpërtheu nga fundi i shpirtit: "Oh".Nuk dihet në e dinte këtë fakt Pashku kur po e shkruante romanin e tij, por klithmën "Oh", të ndiertragjikisht thellë, ia vuri titull romanit të tij. Rrallë mund të gjenden simotrat e krijimtarisë letrare të këtyre dy autorëve, jo vetëm në letërsitë respektive, por edhe në atë botërore, që e shprehin më qartë dhe më fuqishëm tragjiken dhe absurditetin e fatit njerëzor.

Pothuaj përjetim si e ëma e Kamysë, pati edhe miku dhe, më vonë, studiuesi e biografi i Kamysë, Zhan Daniel, tek mori kumtin për vdekjen tragjike të Alber Kamysë në aksident komunikacioni derisa po kthehej në Paris me botuesin dhe mikun e tij Mishel Galimar: "Rruga ishte e drejtë, e terur dhe e zbrazët. E zbrazët, e terur, e

drejtë. Ky është fati."[1] Në çantën që Kamy bartte me vete gjetën një doreshkrim, në të cilin ai po punonte ato ditë, ndërsa në xhepin e brendshëm të palltos i gjetën një biletë treni me të cilën ai duhej të kthehej po atë ditë në Paris.

Absurdi pushtoi jetën e Kamysë edhe si vdekje, sikur që kishte pushtuar veprën. Kjo dëshmon sa afër rrinë absurdi, jeta dhe letërsia, temë e cila do të ringrihet edhe sot në veprën e Kamysë nga lexuesi e nga kritika.

Absurdi si vizion për tjetrin

Në të vërtetë, kritika letrare e vendoste dhe ende vazhdon ndonjëherë ta vendosë emrin e Albert Kamysë krahas emrave të mëdhenj të filozofëve ekzistencialistë. Kamy e mohonte me forcë përkatësinë e tij në çfarëdo rryme letrare dhe filozofike. Kur lexojmë Pashkun: "Nuk di, as tash nuk e di ç'më duhej të bahesha njani ndër ata pak aksionarë fatkëqij të projektit të quejtun *Vox clamentis in deserto!*"[2] e gjejmë të njëjtin frymim individualist dhe refuzues ndaj çdo përkatësie kolektive a grupore, ndonëse edhe njëri, edhe tjetri nuk hezituan të prononcoheshin rreth çështjeve që e cënonin fatin e njerëzimit.

Kamy nuk e mësoi absurdin nga sistemet e mëdha doktrinare filozofike, as nga programet elitare akademike e universitare. Pashku as që mësyu asaj rruge. Kamy njohu absurdin që në moshë të re, kur u sëmur nga tuberkulozi, atëbotë i konsideruar si i pashërueshëm. Si i ri, atij iu desh të mësojë të jetojë me vdekjen, të bjerë dhe të zgjohet me të. Dhe, pyetja mbi kuptimin e jetës që çdo ditë i dilte përpara, nuk i takonte rendit filozofik as metafizik sa atij konkret e tokësor. Edhe përjetimet e mëvonshme të tmerreve të Luftës së Dytë Botërore ia imponuan po këto pyetje. Pashku, ndonëse i ri në moshë, i përjetoi po këto telashe dhe u ballafaqua me të njëjtat pyetje të brezit të Kamysë. Konteksti social e politik totalitar në të cilin jetoi Pashku bëri që versionit të parë dhe më të shkurtër të *Oh*-ut, *Eklipsit*, që trajton dramën absurde të individit, t'i japë një dimension të ri të *Oh*-ut roman, dimensionin e dramës absurde kolektive të shtrirë në universin diegjetik të së kaluarës së largët, në historinë e Ilirisë, duke e ngritur në mit, në përvojë e të vërteta universale dhe në të ardhmen e projektuar përmes vizioneve utopike të një shoqërie totalitare *à la* Oruell.

Kamy e kishte shkruar *Të huajin* me një frymë, për dy muaj, si mund të shihet qartë nga letërkëmbimi i tij me të shoqen e cila jetonte në Algjeri. Në atë kohë Kamy punonte si redaktor gazete; tërë ditën ishte i zënë me punë gazetarie ndërsa shkrimit letrar i kthehej pas mesnatës. Romanin e shkroi në një gjendje disi somnabulike. Në të vërtetë, atë e kishte menduar e përgatitur për një kohë të gjatë, rreth katër vjet. Pjesën

[1] Jean Daniel, "Albert Camus, une tragédie du bonheur", CKF Productions, Paris, 1999.

[2] Anton Pashku, *Oh*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f.128.

dërrmuese të materialit redaktues e kishte grumbulluar në *Fletoret* e tij të shënimeve. Copëza të mbledhura majtas e djathtas nëpër kohë e vende të ndryshme nga ndodhi që i kishte përjetuar vetë apo që i kishte parë, dëgjuar a lexuar, qëndronin si fragmente të shkëputura e të palidhura në ditarët e tij. Por, pothuajse të gjitha vërtet kishin ndodhur dhe janë të dokumentueshme. Prisnin vetëm dorën e fundit të Kamysë për t'i lidhur rreth një teme qendrore dhe një zëri narrativ. Tema e absurdit tashmë ishte sfidë me të cilën ai preokupohej përditë, por nuk e kishte aspak idenë për zërin narrativ. Dhe ky proces krijues është rezultat i një pune në atë gjendjen somnabulike dhe i gjenisë së tij krijuese, prandaj edhe puna interpretuese e kritikëve shpesh është tejet e pamundur: të shpjegosh me arsye atë që pikërisht i ik arsyes.

Edhe Pashku kishte pak a shumë të njëjtën metodë krijuese. Ishte koleksionues i palodhur shënimesh. Thuhet se ka lënë shumë shënime, por qasja në to aktualisht nuk është fort e mundur. Prandaj dhe një analizë gjenetike e veprës së Pashkut momentalisht është e parealizueshme, së paku për fazën e saj pararedaksionale dhe redaksionale. Edhe faza editoriale nuk ofron shumë të dhëna, meqë ai ishte fjalëpakë dhe u ikte kontakteve mediatike.

Nga ana tjetër, *I huaji* dhe *Oh* përfaqësojnë dy pole të ndryshme të shkrimit romanesk. *I huaji*është një roman realist, ndonëse Kamy shkruante se "*I huaji* nuk është as realist, as fantastik, më tepër unë shoh aty një mit të inkarnuar, por me rrënjë të thella në thelbin dhe ngrohtësinë e ditëve."[3]Ndërsa *Oh*-u është vazhdimësi e tregimeve të mëhershme të Pashkut, të cilat si zhanër ai i mbititulloi si *Tregime fantastike*. Për finalizimin e *Oh*-ut Pashku përdori teknika narrative të ndryshme nga ato të Kamysë. Në veçanti ndoqi teknikën e përdorur në tregimet e mëhershme me një stil që shkrimin e situon midis reales dhe fantastikes. Stili i bën ata krejt të veçantë në të dy letërsitë respektive. Kamynë për *stilin e hardhë* siç e quante Barti, ndërsa Pashkun për stilin e tijtë fjalës së kondensuari cili, mund të thuhet, sendonjëherëgabimisht është perceptuar e quajtur *hermetik*. Nëse për Bartin *I huaji* paraqiste shkallën zero të shkrimit, *Oh*-u paraqet shkallën e parë të shkrimit: "Shkallën e parë të letërsisë e karakterizon *krijimi* (poiesis). Kjo letërsi nuk ka model paraprak. Shkrimi i saj është njëherësh fakt, esencë e procedurë, që krijon modelin e parë, vetanak. Atë e pushton subjektiviteti e fantazia e pakufizuar, nuk do t'i ngjajë askujt, prandaj e ngrit në vete kultin e autenticitetit e të origjinalitetit. (...) E zotëron shkrimi që çrëndomtëson, shikimi i parë i habitshëm, si i Adamit. Koha, Vendi, Ngjarja e Personazhi janë të krijuara e të figuruara. Kjo letërsi ka një kontratë të pashpallur me vetëveten. Në letërsinë shqipe, shembuj: *Kronikë në gur* e Ismail Kadaresë,*Oh*-ut e Pashkut,*Sheshi i unazës*i Zejnullah Rrahmanit."[4]

[3] Albert Camus, *L'Etranger*, Gallimard, Paris, 2013, f.56.

[4] Sabri Hamiti, *Shkollat letrare shqipe*, Faik Konica, Prishtinë, 2004, f.31.

Vepra e Pashkut, sikurse ajo e Kamysë, për të cilën Alen Rob-Grije thoshte se i parapriu Romanit të Ri, shënon një fillim në letërsinë shqipe; atë që Zhylien Grak e quante *letërsi e thyerjes*[5] në raport me *letërsinë e traditës ose të vazhdimësisë.*

Këto dy vepra paraqesin dy pikënisje edhe për kritikën letrare ato: duke u nisur nga stili asnjanës i *Të huajit* Rolan Barti e zhvilloi konceptin e tij për shkallën zero të shkrimit si fillim i kritikës strukturaliste frënge. Në anën tjetër, interpretimi i veprës së Pashkut, të shkruar me një stil aq të veçantë, në letërsinë shqipe promovoi një kulturë të re komunikimi me fiksionin e cila kërkon mjete të tjera leximi nga ato të deriatëhershmet; rrjedhimisht, në të njëjtën kohë, kjo shënon fillimin e një tipi të ri të kritikës letrare shqiptare.

Një lexim i parë kursiv i njërit dhe i romanit tjetër, në fillim ngjall ndjenjën e hutisë te lexuesi. Pra, *Oh*-u dhe *I huaji* na hutojnë fuqishëm, rrëmbyeshëm, pakthyeshëm. Tjetri i fshehur në lëkurën e Mersosë dhe Atij, te *I huaji* dhe *Oh*-u, fillimisht na shfaqet si njeriu që s'jemi ne; si një subjekt i cili na e farkon dhe zhvillon mrekullinë filozofike-estetike të habisë. Në të vërtetë, ky është efekt i një strategjie të shkrimit të projektuar paraprakisht dhe me shumë kujdes. Të dy romanet sikur janë shkruar në mënyrë që duhen lexuarmë shumë se një herë. *I huaji*lidhetstrukturalisht rreth një boshti simetrik që e ndan romanin në dy pjesë të barabarta, ndërsa *Oh-u*është ndërtuar sipas një modeli me strukturë rrethore dhe një antiheroi: "Prandaj, personazhi i tij nuk vepron, por mendon dhe të gjitha mendimet, nga të cilat buron edhe romani, sillen në rreth, në një rreth që përplotësohet në vazhdimësi e në pambarim."[6] Rrethi, që del edhe si dedikim i librit, mund të lexohet si rreth miqsh, familjar a social, rreth letrar, rreth narratologjik, rreth idesh por në kuptimin e hulumtimit tonë të absurdit në këtë roman na kujtonedhe rrethin katrorsi konceptim absurd.

Pjesa e parë e *Të huajit* i shpalos ngjarjet pa kurrëfarë ngjyrimi emocional, me një stil asnjanës dhe një ton të panuancuar, ndërsa pjesa e dytë e tij i rikthehet të njëjtave ngjarje, por tash nën filtrin e dëshmitarëve që kanë participuar në to dhe atyre u japin kuptim sipas perceptimit të tyre subjektiv me një ton qëështë i huaj për protagonistin. Te *Oh,* rrëfimi fillon përmes një ambientimi diskursiv banal, bën një hark kohor disashekullor para-prapa një boshti okurrent dhe kthehet përsëri në pikënisje. Prandaj dhe rreshtat e parë të njërit dhe të romanit tjetër prodhojnë efekt shokues, habitës, te lexuesi. Indiferenca me të cilën personazhi-narrator kumton lajmin për vdekjen e nënës së tij e huton lexuesin: "Mamaja vdiq sot. Ndoshta edhe dje, nuk e di. Në telegramin që mora nga azili shkruhej: 'Nëna vdiq. Varrimi nesër. Ngushëllime.' Por kjo nuk do të thotë asgjë. Ndoshta ajo vdiq dje."[7]Në mënyrë

[5] Julien Gracq, *Préférences*, José Corti, Paris, 1961.
[6] Nysret Krasniqi, *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, 99 AIKD, Prishtinë, 2016, f.133.
[7] Alber Kamy, *I huaji*, Vëllezërit Tafa, Tiranë, 2006, f.23.

analoge edhe peronazhi-narrator i *Oh*-ut me indiferencën me të cilën e shpalos botën e vet shpirtërore e vë lexuesin në situatë kur nuk di çfarë të presë nga leximi: "Kur u ktheva, me nder me thanë, prej nevojtores, ku për pak nuk më zuni gjumi, e ndoshta dhe do të më zinte, e besa dhe do ta bajsha nji sy gjumë të rrastë sikur të çlirohesha mirë dhe sikur duqi i cigares të mos m'i kishte djegë gishtat, u ndala para pasqyrës ku, tue i pa qyrat e jargët që më kishin ardhë deri te thembrat e kambëve dhe tue i pre me kujdesin ma të madh me gërshanët që vizllojshin, së paku mue më dukej se i prejsha me gërshanët që vizllojshin aqë shumë, sa m'i lëbyrshin sytë, m'u kujtue se kisha harrue ta lëshoj ujin për ta shpërla nevojtoren."[8] Në vazhdim lexuesi kërkon të kuptojë situatën në të cilën është gjendur krejt papritur. Por, çfarë kuptimi mund t'i jepet ndjenjës (së një protagonisti të parëndomtë – antiheroit), e cila në vend të dhimbjes - emocion i pritshëm nga lexuesi - shpreh indiferencë mizore: "Punë e madhe."[9] Këtë indiferencë e gjejmë fund e krye edhe te *Oh-u*: "Për mue asht krejt njisoj."[10], "Për mue ishte krejt njisoj a vizllonte ky apo ai send."[11], "Ajo, tue pushue pakëz në shi, tha se noti e shiu, ndoshta, do ta kenë rrafshue atë piramidë, por kjo, për mendimin e saj, nuk donte me thanë asgja: 'Dhe nëse ka ra, këtë herë, njimijë të tjera janë ngritë përnjiherë!'"[12]Ky është takimi i parë i lexuesit me absurdin. I shtyrë nga intuita e rëndomtë për të depërtuar në thelbin e gjërave, lexuesi i sfiduar nga një shkrim kaq jokonvencional nuk mund të rreshtë së kërkuari kuptimin e asaj me të cilën e ballafaqon ky shkrim. Dhe, sa më shumë që ngulmon të gjejë një kuptim sipas mendjes së tij të shëndoshë, aq më shumë largohet nga ai kuptim. Një klimë e absurdit aq e ngjashme te njëri dhe te romani tjetër fillon ta familjarizojë lexuesin me ndjeshmërinë absurde. Porse, mjetet shprehëse të përdorura në tekstet respektive janë krejt të ndryshme. Te Kamy teksti është i thjeshtë, i qartë, i shkurtër dhe krejt tokësor. Te Pashku ai është simbolik, sentencial dhe abstrakt, fantastik në mënyrën e tij. Shkrimi na e vë përpara absurdin në formë të pastër dhe nuk përpiqet ta analizojë e aq më pak ta sqarojë atë. Sa i ngjashëm absurdi është njëkohësisht edhe i ndryshëm te Kamy dhe Pashku. Absurdi paraqitet në formë të natyrshme ashtu si e hasim në botë dhe në jetë, pa kurrfarë preokupimi interpretues. Thjesht, ai është aty, para lexuesit.

Në vazhdim të të *Të huajit* narracioni zhvillohet në mënyrë lineare: varrimi, kthimi në shtëpi, plazhi, takimi me Marien, kinemaja, historia e Rejmondit, ftesa e këtij të fundit për të kaluar së bashku fundjavën në plazh, sherri me Arabin dhe në fund të pjesës së parë, vrasja e çuditshme e Arabit nën përcëllimin e diellit. Te *Oh-u* narracioni nuk procedohet aspak në të njëjtën mënyrë: qëndrimi para pasqyrës, mandej retrospeksioni në liqenin artificial; tash këtu drama e Atij dhe Asaj përthyhet në kohë

[8] Anton Pashku, *Oh*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f.7.
[9] Alber Kamy, *I huaji*, Vëllezërit Tafa, Tiranë, 2006, f.23.
[10] Anton Pashku, *Oh*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f.11.
[11] Anton Pashku, *Oh*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f.12.
[12] Anton Pashku, *Oh*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f.150.

dhe hapësirë. Këtu ndodh edhe kalimi kualitativ gjenerik nga *Eklipsi* në *Oh,* i cili nuk e prek strukturën fillestare të romanit *Oh*. Në plazhin e liqenit artificial ballafaqohen dy koncepte të ekzistencës njerëzore: ai i absurdit të Atij dhe Tjetri racional i Asaj. Ai i mbyll sytë për të evituar shkëlqimin verbërues të diellit (imagjino sikur Mërso t'i mbyllte sytë në momentin fatal, si do të dukej vazhdimi i *Të huajit*), prej nga edhe buron titulli *Eklipsi*, ndërsa Ajo ndërton piramidën prej rëre. Në këtë hark kohor të eklipsit narracioni dublohet nga prania imagjinare e Plakut nëpërmjet të të cilit inkorporohet rrëfimi, në të tashmen, për nëntëdhjetë e nëntë delet dhe, në të kaluarën, për kryengritjen ilire të vitit 3-6. Instanca tjetër narrative që lidhet drejtpërdrejt me efektin e së parës – me shkëlqimin e pasqyrave me dy faqe, përsëri dublohet nga dy vija narrative: rrëfimi për gjahun, në të tashmen, dhe fjalimi oruellian i mizogamit si projektim utopik, në të ardhmen. Insistimi i Asaj për të dialoguar me sy hapur me Atë e detyron këtë të fundit që t'i hapte sytë dhe ky është fundi i Eklipsit. Por, pothuajse në të njëjtën kohë, fillon shtrëngata e cila e ndërpren qëndrimin e tyre në plazh dhe i detyron të kthehen në dhomë. Këtu rrëfimi rikthehet në fillim.

Pjesa e dytë e *Të huajit* nxjerr në pah absurditetin e procesit gjyqësor. Protagonisti në vend se të gjykohet për vrasjen e Arabit, i cili pothuaj se harrohet krejt gjatë procesit, gjykohet pse nuk ka qarë në varrimin e nënës. Rrjedha triviale e ngjarjeve të pjesës së parë tash merr kuptimin e ri nën optikën e akuzuesve të tij dhe nxjerr në plan të parë figurën e përmbysur të Mërsos, i cili dënohet me ekzekutim në gijotinë. Interpretimi i të bëmave të Mërsos në pjesën e parë të romanit nën pretendimin për zbardhjen e motiveve të vrasjes bën që ato të rikuptimësohen në një seri shpjegimesh që nuk përputhen aspak me kuptimin e tyre të vërtetë. Mërso, i cili jetonte i lumtur në rrjedhën e përditshme të absurditetit jetësor, vetëdijesohet për fatin tragjik të qenies njerëzore. I preokupuar me këtë tragjikë supreme të fatit njerëzor ai e tejkalon vetveten me vetëdijen e revoltës me të cilën Mërso zgjohet një agim duke e pritur i gatshëm ekzekutimin e tij dhe duke dëshiruar që të ketë sa më shumë spektatorë dhe thirrje urrejtjeje në atë spektakël.

Pas kthimit në dhomë të Atij dhe Asaj, në*Oh*, ndërpritet (mos)komunikimi i cili me dialogimin e tyre të mëhershëm në plazh, më shumë të kujton dialogët e personazheve absurdë të Beketit dhe Ioneskos, sesa personazhet e Kamysë. Tashmë skena në nevojtore që e neveriste lexuesin fillon të bëhet e kapshme. Edhe gjestet makinale të Atij, edhe shkëlqimi i gërshërëve, edhe jargët dhe lirimi i gazrave, edhe heshtja e Asaj në dhomë, por edhe bisedat e paqarta të tyre, edhe apatia e Atij, edhe ambicja e Asaj për të ndërtuar piramida prej rëre, edhe halli i Atij për të mbushur thasë me vapë, në plazhin e liqenit, fitojnë një kuptim. Situata në dhomëështë bërë e padurueshme. Jo vetëm për ata të dy, por edhe për peshqët (kujto qenin e plakut Salamano) në akuarium. Duke persiatur për ekzistencën, ngjashëm si Sartri që neveritej nga ekzistenca duke vështruar rrënjën e drurit të gështenjës në romanin *Neveria*, Ajo vetëdijesohet për kotësinë e ekzistencës duke e vështruar mizën. Pas

persiatjeve të gjata e të mundimshme ekzistenciale, në një moment, duke e vështruar një mizë, e cila po lëvizte nëpër dhomë neveritet nga kotësia e ekzistencës njerëzore. E revoltuar nga kjo ndjesi e absurditetit njerëzor dhe e trishtuar nga qëndrimi i Atij që ishte pajtuar, madje edhe jetonte i lumtur, në një jetë absurde, pra që jetonte e nuk mendonte, në një botë në të cilën nuk e mundonin më zurkajat e mendimit, një njeri që jetonte vetëm për të sotmen, i zhveshur nga shpresat për një të nesërme, meqë ia kishin thyer kapërcyell e gavyell, ngjashëm si fundi i *Të huajit,* edhe në fundin e *Oh-ut* Ajo e braktis me klithma e poterë universin absurd të rrjedhës mekanike të jetës në të cilën vegjetonin ata të dy. Zhurma e Asaj duke dalë nga dhoma i trazon fqinjët, gjë që universin absurd të*Oh-ut* e vendos në një kontekst konkret social e historik: "-Ku me dijtë, ore vëlla, ç'do t'i ketë thanë ky në kllapi! –Le të flasi në kllapi, por s'asht e drejtë që të jetoj këtu, si në mulli! Unë dëshiroj të ketë qetësi!"[13]

Pas ikjes së Asaj, Ai, duke e injoruar protestën e fqinjve, e mbyll derën dhe riakomodohet, ndonëse kaps, në botën e tij bashkë me peshkun me pika që krenar notonte në akuarium. Pas ikjes së priftit, Mërso riakomodohet në qetësinë e qelisë, i gatshëm për ta pritur ekzekutimin e tij. Ndërsa diku tutje plaku Salamano, me gjasë, vazhdonte të kërkonte qenin e tij të zgjebosur.

Përfundim

Absurdi në *Oh* del si raport i (mos)komunikimit të Atij dhe Asaj, ku mashkulli është i preokupuar nga metafizika e absurdit, ndërsa femra udhëhiqet nga idetë pragmatike dhe aspiron kërkimin e lumturisë. Absurdi në *Të huajin* del si divorc, si shpërputhje ku në njërën anë është rrjedha e përditshme dhe amorfe e realitetit të përjetuar e në anën tjetër është rindërtimi i sajuar i këtij realiteti nga arsyeja njerëzore dhe ligjërimi. Ajo që pakontestueshëm e kanë të përbashkët këto dy romane është klima e absurdit me të cilën ndërtohen. *I huaji* dhe *Oh* thonë të njëjtën gjë, por në mënyra të ndryshme.

Sartri shkruante për *Të huajin*: "Më patën thënë: 'Është Kafka i shkruar nga Hemingueji.' E pranoj se nuk e kam rigjetur Kafkën. Përceptimet e Kamysë janë krejt tokësore. Kafka është romancier i së pamundshmes: për të universi është i mbushur me shenja që ne nuk i kuptojmë; ka një përmbysje të dekorit. Për Kamynë drama njerëzore, përkundrazi, është mungesa e çdo transcendence."[14] Absurdi i Pashkut qëndron ndërmjet këtyre dyjave, ka tokësoren e Kamysë me konceptin e tij të angazhimit, por e ka edhe fantastiken e Kafkës me universin e tij abstrakt.

[13] Anton Pashku, *Oh*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f.158.

[14] Jean-Paul Sartre, 'Explication de *L'étranger*', in *Situations I*, Gallimard, Paris, 1947, f.136.

Kamy e kishte shkruar *Të huajin* dy vjet para *Mitit të Sizifit,* por insistonte që të dy librat të botoheshin njëkohësisht, sepse njëri e përplotësonte tjetrin. Prandaj, *I huaji* nuk është roman me tezë, sepse shpalos një univers romanesk absurd, ndërsa eseu *Miti i Sizifit* e trajton sensibilitetin absurd. Pra, nuk janë romane me tezë, sepse nuk shtrojnë një doktrinë, por një vizion për një botë pesimiste që është bota jonë.

Te Pashku nuk kemi shkrime eseistike por romanin e Kamysë dhe të Kafkës do të mund t'i lexonim si intertekste të *Oh*-ut. Në analogji me këtë, do të thoshim se Pashku është Kafka dhe Kamy të kondensuara në letërsinë popullore shqiptare, siç preferonte të thoshte për veprën e vet Anton Pashku.[15]Gjuha e Pashkut është një gjuhë e figurshme që tharmin e merr nga kultura orale shqiptare fort e njohur në traditën tonë për komunikimin e figurshëm "me rrotlla": "Megjithë faktin se Anton Pashku është një klasik modern i prozës shqipe, ai ka një qëndrim shumë afirmativ dhe pragmatik ndaj traditës, veçan sa i përket gjuhës. Oraliteti në veprën e Pashkut është pjesë e stilit, ndërsa stili vetë bëhet mënyrë shikimi, diçka qëështë më shumë se teknikë, qëështë vetë vizioni, një vizion origjinal dhe fare personal letrar. (...) Vetë Pashku pranon se si paramodel kishte letërsinë gojore madje edhe e mbante si një gjedhe të përhershme, me të cilën merrej vazhdimisht si krijues, duke çmuar në veçanti strukturat proverbiale."[16]

Kamy dhe Pashku, dy autorë të pakuptuar sa duhet për së gjalli, shpesh edhe të keqkuptuar, të pa vlerësuar sa e meritonin, vazhdojnë të mbesinshumëtë pranishëm në aktualitetin tonë; ndërsa vepra e tyre, sidomos ajo romaneske, po bëhet edhe më e frekuentueshme për lexuesin e sotëm. Absurdi, si njëra nga komponentat thelbësore të veprës së tyre, po e prek sensibilitetin tonë poaq sa edhe të brezit të tij dhe poaq me ngulm po i shtron pyetjet më të ankthshme për njeriun, për kuptimin e ekzistencës dhe të botës.

Literatura

Alber Kamy, *I huaji*, Vëllezërit Tafa, Tiranë, 2006
Albert Camus, *L'Etranger*, Gallimard (botim i veçantë me rastin e njëqindvjetorit të lindjes), Paris, 2013
Albert Camus, *Miti i Sizifit*, Fan Noli, Tiranë, 2016
Anton Pashku, *Oh*, Rilindja, Prishtinë, 1979
Jeta e Re, nr.2, 1968 (Anton Pashku, "Eklipsi")
Jeta e Re, nr.4, 1996 (Numër tematik për Anton Pashkun)
Sabri Hamiti, *Shkollat letrare shqipe*, Faik Konica, Prishtinë, 2004

[15] Rexhep Murtez Shala, *Antidrama – intervistë e improvizuar me Pashkun*, Neokultura, Prishtinë, 2016, f.52.
[16] Kujtim Rrahmani, *Letra e Ideologji*, 99 AIKD, Prishtinë, f.180.

Kujtim Rrahmani, *Letra e Ideologji*, 99 AIKD, Prishtinë
Rexhep Murtez Shala, *Antidrama – intervistë e improvizuar me Pashkun*, Neokultura, Prishtinë, 2016
Nysret Krasniqi, *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, 99 AIKD, Prishtinë, 2016
Avdi Visoka, *Camus – rrëfimi dhe idetë*, Faik Konica, Prishtinë, 2010
Koha, 15 mars 1995, Pashku "Vox Clamantos in Deserto" - Intervistë me Anton Pashkun

Avdi VISOKA

CONCEPT OF *THE OTHER* IN THE NOVELS OF CAMUS AND PASHKU

Abstract

This paper will examine the concept of *the Other* in Literature by introducingmany cultural, philosophical, religious, ethical, and aesthetic issues. In fact, the Other can be considered in the function of cultural, ethical, ethnic, and socialbelonging. The perception of the Other is also inseparable from self-construction and personal identity preoccupations, as well as from the construction of relationships with the other:This is a sui generis articulation and self-articulation within illusion, fiction, and reality.

The Concept of the Otherhas a very particular resonance in the novels of Camus (*The stranger*) and Pashku (*Oh*). The concept of absurd as a perception of the Other, as an articulation of the self and as a generator of mutual relations makes these authors very special in literature. The examination of convergences and differences in the novels of these authors will shed light thorough this paper by interrogating the *lieuxcommuns* between Albanian and French literary space, with a special regard to the relationships of *us* versus *them*.

Key words: Other, strange, absurd, Camus, Pashku.

Kastriot GJIKA

"VDEKJA E TJETRIT" NE SHKRIMET LETRARE TË MITRUSH KUTELIT

1.1. Vdekja si topikë

Prirja më e natyrshme e shekullit të kaluar ka qenë shmangia e vdekjes si topikë, mospërballja direkte me të, projeksioni i saj në mënyrë eufemistike në të tjera hapësira të botës individuale a kolektive. "*Vdekja qëndron e huaj për njeriun, i cili është i aftë të orientohet në çdo botë të huaj, veç saj*"[1]. Njeriu i modernitetit, pré i frenezisë së konsumizmit dhe i zënë me kërkimin e mirëqenies materiale, nuk ka kohë për të menduar për vdekjen. Ai jo vetëm që e mban larg nga mendja e vet idenë e saj, por nuk do as që të flitet për të. E quan të papërshtatshme çdo referencë te "armikja e madhe", prandaj e quan pa shije këdo që guxon t'ia përmendë emrin a ta përfshijë në ligjërimet e veta. E gjithë kultura bashkëkohore karakterizohet nga një sforco e madhe për ta veçuar jetën nga vdekja.

Por rasti i Kutelit është disi specifik dhe krejt në të kundërt të kësaj prirjeje. Vdekja është aq e pranishme në prozat rrëfimtare të Kutelit, saqë duket se ai e ka eksploruar atë me të gjitha teknikat e me mjetet e veta letrare, në të tëra shfaqjet e saj individuale, sociale, etike, religjioze etj. Mund të pohojmë se ai ka një interesim të posaçëm për këtë tematikë dhe është i familjarizuar me të.

Një nga rrëfimet e tij, ku vdekja shfaqet si kryetemë, është "Vjeshta e Xheladin beut". Vdekja në këtë prozë është e analizuar në shfaqjet e saj që kapin një spektër të caktuar, nga individualja te psikologjikja, nga vdekja si ndëshkim, te vdekja si alegori e humbjes dhe e zvetënimit. Personazhi qendror i prozës, Xheladin beu, është i gjithëpushtetshëm, i kamur, i vetëkënaqur me ç'ka e gjithësesi i pangopur.

E megjithatë, ai duket se është i pakënaqur, sepse hija e vdekjes, me format e saj të shfaqjes paraprake, po ia kërcënon ekzistencën. Qejfet e shfrenuara, që nga hajet e pijet e bollshme, te ahengu i çingijeve e deri tek qejfet e "jatakut", nuk mundeshin t'i mbushnin atë zbrazëtirë, atë boshllëk, ato veç mundeshin ta largonin disi idenë që i rrinte pezull mbi kokë.

Praktika e sjellje të tilla duket se na servirin idenë se njeriu, për t'u çliruar nga ankthi i asgjesimit tërësor, nga dorëzimi te "mosqenia", që vdekja ia përkujton, bën çmos

[1] Jünge Eberhard -Life after Death? A Response to Theology's Silence about Eternal Life" in *Word and World* 11 (1991), pp. 5–8.

që ta mbajë larg atë, ta fshijë nga mendja e vet dhe nga mjedisi i vet jetësor jo vetëm mendimin për vdekjen, por edhe përvoja të mundshme të saj, dëshmi të saj të dhimbshme, shenjat e trishta të saj. *"Na e dëshmon shfrenimi me të cilin njeriu i dorëzohet divertissementit, duke lartësuar vlera të paqëndrueshme, si banalja, kitch-i apo duke rendur ankthshëm pas "botëve të reja", "parajsave artificiale", praktikave religjioze ekzotike, përvojave jo të zakonshme*"[2]. Si të tilla i kemi konsideruar edhe praktikat erotike të Xheladin beut, të përshkruara me një farë natyralizmi nga Mitrush Kuteli. Në një moment të rrëfimit, Kuteli e shfaq hapur qëndrimin refuzues e shmangës që ka beu karshi vdekjes: *"Beu s'pyeti më tej si e qysh, si nuk pyeste kurrë për punë vdekjeje"*.[3]

Ndërgjegjësimi i parë i Xheladin beut për gjendjen që e kishte kapluar, vjen befas, si një pohim i jashtëm dramatik, si një pranim i një fakti të pashmangshëm, që mezi i bën ballë: "*ai po mlakej!*". Dhe menjëherë pas këtij pohimi të parë, vjen ai më i tmerrshmi, i dyti, ai që është shkaku i vërtetë i asaj "zbrazëtie të madhe në zemër": "*Po pas pleqërie? - pyeti. Dhe u përgjigj vetë: Pas pleqërie, efnm? Ti e di: varri... I hipën djersë të ftohta, që ia njomën rrethin e festes."*[4] Ky pohim është dramatik për të, sepse ai fiton vetëdijen për çfarë vjen më pas. "*Të ligjtë nuk kishin dyshim që nuk kishin për të rrojtur pas vdekjes, ata nuk do të zgjoheshin dhe do të braktiseshin në një gjendje mosekzistence*".[5]

Me t'u bërë ky pohim i kobshëm, që ishte shtyrë e shmangur e dredhuar deri atëhere, me një intensitet të pazakontë, brenda një paragrafi të vetëm në vijim, vijnë të përsëritura një radhë fjalësh të së njëjtës çerdhe me vdekjen: "kufomë", "varr", "të vdekur", "të pakallur", "vdisnin" etj. Rrëfimtari godet intensivisht në psikën e personazhit me figurën e vdekjes, me shfaqjen e saj të lemerisshme dhe pasojat e saj të pakthyeshme. *"Vdekja, në të vërtetë, shkëput rrjedhën e ekzistencës sonë, duke krijuar një boshllëk të lemerisshëm. Dhe s'ka asnjë shpëtim nga kjo, asnjë gjë që mund ta mposhtë. Ajo na del përpara mjerimit tonë dhe shfaqet, na prek, na bën ta përjetojmë të tërën dhe në absurditetin e saj lemerisës"*.[6]

Një nga imazhet alegorike që parathotë vdekjen e lemerisshme të Xheladin beut, është ajo e "kërmës së gomarit të ngordhur", që me insistim i shfaqet dy herë me radhë, teksa kundërmimi i tij nuk i shqitej: *"Kërmë, krimba, kështu do të bëhem edhe unë nesër?*"[7]. Të tjera shenja tekstuale të vdekjes së paralajmëruar janë galat, korbi i zi, varret, zëri imagjinar që e thërret etj.

[2] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.72
[3] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 1*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 92
[4] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 1*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 75
[5] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq. 27
[6] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq. 55
[7] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 1*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 101

"Vdekja si humbje"

Është rasti të shënojmë se Xheladin beu, para se të vdesë, çmendet. Kuteli, në këtë mënyrë, ka intensifikuar pasojën e asaj kundërshtie skizofrenike e mospranimi të idesë së vdekjes prej këtij personazhi, të të gjitha përpjekjeve të dëshpëruara që ai bën për ta larguar e për ta shmangur vdekjen. Duke tentuar madje të provojë të rinohet përmes theksimit të manive të tij. Çka e çon në limitet e incestit apo në dyshimet vrastare se edhe në mos e ka kryer këtë makabritet, rrezikon ta konsumojë nga dita në ditë. Ky dyshim, si edhe brenga e mungesës së një trashëgimtari të tërë kësaj pasurie e këtij pushteti pa kufi, duket se janë arsyet e çmendjes së tij. Pra nuk është një krizë morali, por një krizë neurotike për shkak të asaj kontradikte mes pushtetit të vet absolut dhe dobësisë e pafuqisë përballë vdekjes, që e çon atë në zgrip të ekzistencës, në absurdin e moskuptimit e pastaj, në mosekzistencën vetë, në vdekjen e vet plot llahtar.

"Vdekja si mallkim"

Vdekja e Xheladin beut, aq e përzënë dhe e shmangur nga ai vetë, si ide dhe si praktikë, si simbol dhe si realitet, është njëherazi aq shumë e dëshiruar nga antagonistët e tij në këtë rrëfim, më konkretisht nga Mara, një prej ish-viktimave të qejfeve të tij të shfrenuara dhe abuzimeve të pushtetit të tij. Ne mund t'iu referohemi atyre për të ilustruar përfytyrimet e llahtarshme të njerëzve për vdekjen, sidomos për vdekjen e "armikut", të kundërshtarit, të atij që konsiderohet si shkaktar i fatkeqësive të veta: "*...të hëngërt mortja!", "thefsh arrëzën e qafës!", "U kalbsh së gjalli, përmbys, siç u kalb yt atë, që e hëngër krimbat!", "Ngorç në ndonjë përrua si qen i zojebosur!", "...t'u shojttë emri, të këndoftë kukuvajka në shtëpi!", "Humbsh e mos u duksh, mos u dëgjofsh!", "Të plastë dhjamët e syrit!", "Të kallçin të gjallë në varr!", "Të djegshin lugat!"*[8]

Të gjitha mallkimet e Marës janë jo thjesht të lidhura me vdekjen, por janë të shqiptuara, në zemërim e sipër, si një dëshirë për një vdekje me llahtari, për një vdekje që ndëshkon e mbi të gjitha, për një vuajtje e llahtari përtej vdekjes vetë. Armikut të vet i dëshiron më të keqen, më të lemerisshmen vdekje, më të thellat humnera të ferrit e të skëterrës që ai, etikisht e moralisht, i meriton.

"Vdekja e zbutur"

"Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit"[9] është nga ato rrëfime ku i gjejmë të mishëruara shumë nga ato tipare të vdekjes që Philippe Ariés-i i përshkruan në studimin e vet "Historia e vdekjes në perëndim"[10]. Rrëfimi nis me vdekjen, me "vdekjen e zbutur",

[8] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 1*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 96-97
[9] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 49
[10] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015

siç e quan Ariési. E këtillë ajo është sepse është vdekja natyrale, e radhës, e pranuar. "*Vdekja dukej si një gjë familjare dhe e afërt, që nuk përçonte as frikë dhe as habi. Prandaj e kam quajtur "vdekje e zbutur". Sot ajo është bërë "e egër"*[11]. Qysh në paragrafin e parë të rrëfimit, vihet re se përdoren një sërë eufemizmash të buta për vdekjen, si për ta përkëdhelur idenë e saj: *"(pleqtë)u rralluan", "ndërroi jetë", "ikën", "e lanë fshatin"* etj[12]. Për ta bërë më të qartë këtë qëndrim "të zbutur" ndaj vdekjes, mjafton të sjellim në vëmendje faktin se duke mos mundur ta përzerë përfundimisht nga jeta e tij e përditshme, njeriu i sotëm kërkon ta ekzorcizojë, duke e quajtur madje me të tjerë emra. Kur është i detyruar, ai flet për të si "fund i jetës", si "përfundim i rrugës tokësore" apo si "dalje nga skena", si "pushim" e "prehje" dhe në lidhje me të vdekurin, flet si për dikë që "nuk është më", që "është shuar", që "mungon" dhe prandaj thirret "i shuari", "i shkreti", "i ndjeri", "i ngrati" etj.

Edhe Ago Jakupi e kupton pleqërinë e vet si fazë tranzitore drejt cakut të fundit të jetës, pragut të vdekjes. Por ndryshe nga Xheladin Beu, Ago Jakupi nuk e "lufton" idenë e vdekjes me bëma të liga e me vepra të kobshme, por me punë e jetë aktive: *"Mbeti jashtë valles vetëm Ago Jakupi, si një lis me rrathë shumë në mes të një korijeje të re; as shembet, as kërruset, as kapitet... Punon si në të ri, e merr të përpjetën si në të ri e gjithë si në të rie bën gjumin ku të ndodhet..."*[13]

Ago Jakupi nuk e pranon idenë e vdekjes, është edhe ai nga ai tip njeriu që e konsideron vdekjen si një gjë që nuk i përket atij, po të tjerëve: "*Ia kishin kohën, ishin pleq, s'kishin punë, unë kam punë, o bir!*"[14]. Por sado larg ta mbajë ai idenë e vdekjes, në një moment ajo vjen e përplaset me të. Është momenti dramatik i vdekjes së të afërmit, i të birit, që e bën Ago Jakupin ta shohë për herë të parë vdekjen në sy, ta ndiejë tërë peshën e rëndësinë e saj: "*Edhe kur i doli i vdekuri nga shtëpia - mbi tabut - agai e ndjeu veten kaq të vogël, kaq të mjerë e të kotë, si nuk e pat ndjerë veten kurrë*".[15] Përballë ndodhen dy imazhe e dy tipe vdekjesh: vdekja e tjetrit dhe vdekja e vetes. E para ka ndodhur e nuk mund të zhbëhet, as të kundërshtohet e as nuk mund t'i kundërvihesh. E dyta ende s'ka ndodhur, por është e pritshme, është natyrale dhe e vetmja gjë që mund të bëhet është të miqësohesh me të, ta zbusësh atë. "*Familjariteti me vdekjen është një formë e pranimit të urdhrit të natyrës, një pranim që mund të jetë njëherazi naiv dhe i nxënë (në përsiatje astrologjike). Njeriu thjesht e pranoi me masën e duhur të seriozitetit.*"[16]

Ago Jakupit iu zbulua kësisoj mundësia për të korrigjuar në jetën e mbetur gabimet e jetës së shkuar. Duhet nënvizuar se ai nuk ishte një besimtar i thekur apo një njeri i përkushtuar pas besimit, aq sa të tjerët e kritikojnë që nuk falet në xhami. I mbetur në kapërcyellin mes jetës dhe vdekjes, agai "*nuk kish frikë nga vdekja, po nga jeta që zgjatej kaq fort*". Kështu, në një klimë e në një gjendje të tillë paqartësie dhe pakënaqësie të thellë,

[11] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.16
[12] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 49
[13] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 49
[14] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 52
[15] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 53
[16] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.25

pashmangshmërisht pasqyra e vdekjes shpërfaqet në mendjen e njeriut dhe rivjen duke hedhur hijen e saj të rëndë mbi mendimet e tij, mbi aspiratat e tij. Këtu është rasti të bëjmë një paralelizëm, sado të shkurtër, mes Ago Jakupit dhe Xheladin Beut. Këtë të fundit e kemi analizuar më sipër si një njeri të terrorizuar nga frika e vdekjes, së pari, për shkak të makutërisë dhe të pushtetit të tij të pakufishëm dhe së dyti, për shkak të ndërprejes së trashëgimisë te ai vetë, pasi nuk ka pasardhës. Edhe Ago Jakupi ka mall e gjë plot, ka vreshat pa anë e fund, ka tokë e pasuri. Por ai nuk e ka frikë vdekjen, ai ka frikë e i druhet pasvdekjes, asaj që vjen në botën tjetër. *"Vdekja u bë rasti kur njeriut i mprihej edhe më shumë aftësia për të arritur ndërgjegjësimin"*. [17]

Në formën e ëndrrave të përsëritura, me një gjuhë të qartë oniriko-simbolike, Ago Jakupi merr mesazhin e përforcuar se bëmat e tij, të mira a të këqija qofshin, i ishin shkrojtur në librin e tij të jetës dhe do t'i peshoheshin në gjyqin e fundit. Ariési e ilustron kështu në studimin e vet këtë koncept të "gjyqit të fundit": *"Çdo njeri do të duhet të gjykohet në bazë të peshimit të librit të tij të jetës. Veprat e mira dhe ato të këqija janë përpikmërisht të ndara dhe të vendosura në anët e kundërta të peshores. Për më tepër, ato vepra janë vulosur në një libër. Ky libër,* ***liber vitae****, duhet të ketë qenë më parë i konceptuar si një libër kozmik, gjykim i tmerrshëm universal. Por nga fundi i mesjetës u kthye në një libër llogarie vetjake. Ky peshim nuk përmbyllet në çastin e vdekjes, por në ditën e fundit të botës, në fund të kohërave. Kështu, idea e Gjyqit të Fundit u lidh me atë të jetëshkrimit vetjak, por ky jetëshkrim përfundon në ditën e fundit, jo në orën e vdekjes. Interpretimi i Gjyqit ishte ai i një beteje kozmike midis forcave të së mirës dhe së keqes, të cilat janë duke luftuar për pronësinë e njeriut që po vdes dhe ky i fundit e kundron këtë betejë si një dëshmitar i paanshëm, ndonëse ai vetë është trofeu"*.[18] Ja ku e kemi edhe arsyen përse Ago Jakupi është i familjarizuar me vdekjen e vet, sepse vdekja i është parathënë, i janë dhënë të tëra shenjat e saj. Në të duket sikur ka gjetur mishërim përpjekja (që në të vërtetë është përmbushur me kohë nga Epikuri dhe nga të tjerë përgjatë shekujve, por e rimarrë në ditët tona), për ta identifikuar vdekjen si një "fakt natyror". Identifikimi i vdekjes si një "ndodhi natyrore" mund të vlejë, siç shkruan Melchiorre, si një "*ide e thjeshtë udhëheqëse... dhe... në këtë rast, vetëm në këtë kuptim, ajo mund të përbëjë një pikë referimi për një shoqëri që gjithmonë e më shumë respekton jetën*". [19]

Duket qartë në këtë perspektivë se problemi i vdekjes nuk mund të përballet duke pasur për objektiv ngushëllimin e njeriut. Ajo duhet marrë në shqyrtim sipas një perspektive më të gjerë, që evokon jetën në tërësinë e saj. Me të drejtë, Garaudy pohon se "*meditimi mbi vdekjen është një reflektim mbi jetën, mbi vërtetësinë e saj të thellë dhe mbi domethënien e saj*".[20]

Nga pikëpamja e tipologjisë së vdekjes që përshkruan Ariés-i në studimin e vet të sipërpërmendur disa herë, vdekja e Ago Jakupit do të jetë një "vdekje e zbutur", pikërisht sepse ai e di që do të vdesë, sepse vdekja i parathuhet përmes ëndrrës. Por jo vetëm për

[17] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.38
[18] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.28
[19] Melchiorre V. - *Metacritica dell'eros* - Milano 1977, fq. 28
[20] Garaudy R. - Parola di uomo - Assisi 1975, fq. 31-32

këtë arsye. Ka një përputhje manualistike mes tiplogjisë ariesiane të "vdekjes së zbutur" dhe asaj kuteliane, së paku në rastin e këtij rrëfimi. E mbështesim këtë pohim në faktin që respektohet jo vetëm i njëjti konceptim për vdekjen, por edhe i njëjti ritual. Duke filluar me vdekjen në shtrat. Ago Jakupi, pasi i ka përmbushur detyrat e tij të kësaj bote, pasi ka ndrequr gabimet e jetës së tij modeste, është "gati" të vdesë. Sipas Ariés-it ky ishte një moment ritual. I përshkuar nga përzishmëria, njëfarë teatraliteti, i sintetizuar në fare pak imazhe të jetës që përcjellin një trishtim të përmbajtur për ata që lihen pas. Kjo ceremoni rituale ishte publike, në të merrnin pjesë njerëzit e dashur, familjarët, madje edhe fëmijët lejoheshin të merrnin pjesë. "Mjeshtri i ceremonialit" të kësaj lloj vdekjeje ishte vetë personi që do të vdiste. Ai jepte porositë e rastit, dirigjonte veprimet e njerëzve, bënte faljen e bekimin e të pranishmëve dhe së fundi, linte amanetet për të afërmit e pasardhësit. Ago Jakupi përmbush pikë për pikë të njëjtin tip ceremoniali. Së pari, ai përgatit shtratin ku do të vdesë: "*As më nxir, moj nuse, ato dërrasat e varrit e m'i vër në diell, të thahen.... Më nxirr, në më do, ato dërrasat*".[21] Një vdekje e këtillë, si ajo e Ago Jakupit, ishte ende një ceremoni publike. Kurse në ditët tona, shoqëria e konsumit dhe e prodhimit kërkon nga i lënguari një "stil vdekjeje" që sociologët e përkufizojnë si "vdekje e ëmbël e njeriut-masë". Është fjala për një "vdekje klandestine", në të cilën lëngimtari del nga skena në heshtje, vjedhurazi, në mënyrë që të mos shkaktojë emocione tepër të forta dhe reagime që mund të shqetësojnë rrjedhën e rregulluar të jetës së përditshme. Njeriu i sotëm, që dikur ka qenë zot i vdekjes së vet, sot nuk është më. Ago Jakupi, përndryshe i thërret vetë njerëzit, kërkon t'i mblidhen njerëzit e tij të afërt, publiku që do të asistojë në vdekjen e tij: *"Të m'i sillni fëmijët t'i shoh dhe një herë, se më ka zënë malli. Dërgoni të vijnë djemtë nga arat e nga mali, se kam disa fjalë t'u them"*.[22]

Amaneti apo porosia e fundit për pasardhësit, testamenti siç njihet sot ligjërisht, ndryshon disi nga tipologjia testamentare që përmend Ariés-i për të tilla raste. Sipas konstatimeve të tij, në gjysmën e dytë të shek. XVIII, një ndryshim shumë i madh ndodhi në testamente. Ai u thjeshtua në aktin ligjor që e kemi sot, një akt ligjor që shpërndan pasuri. Kurse amaneti i Ago Jakupit duket se i takon një periudhe më të hershme, kur kemi diçka të ndërmjetme. Edhe Ago Jakupi e përmend pasurinë, por amaneti i tij për djemtë e ka më shumë të theksuar aspektin etik sesa atë pasuror: *"Nxori pastaj nga beli një qemer e ia hodhi në duar të madhit. Nxori qesen, nxori sahatin me qostek. - Këto nuk më duhen atje ku do vete. T'i kini së bashku e të duheni vëlla me vëlla. Këtë ua lë amanet si gur mulliri"*. [23]

Edhe çasti i mbramë është i mbarsur me teatralitet, me konceptin skenik të fikjes së dritave: *"Edhe pastaj, sa ndizet e shuhet vetëtima, Ago Jakupi mbylli sytë. Edhe u shtua në të shumtët, në të mirët"*.[24] Vemë re se përmëndja e "të mirëve" në fund të rrëfimit në mënyrë të qartë aludon për xhenetin (parajsën), të cilën ai e fitoi përmes veprave të mira, korrigjimit

[21] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq.66
[22] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq.66
[23] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq.66
[24] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 67

të gabimeve, në ndërkohën që iu dha para vdekjes, para gjyqit të fundit. Të mirat që ai bëri, iu shkruan në librin e tij të jetës dhe pikërisht ato bënë që peshorja e jetës të anojë nga e mira.

Kuteli bën që Ago Jakupi ta përjetojë purgatorin e tij që në të gjallë, në pjesën e fundit të jetës së vet, që është edhe pjesa e përshkruar në rrëfim. Për këtë arsye, duket se është e qëllimtë mënyra se si karakterizohet ky personazh nëpërmjet një tipologjie të tipit "as... as" apo "edhe... edhe": "*E qortojnë disa Ago Jakupin, kur rrinë kokë më kokë, se s'ka punuar as të këqija, po as të mira". "Agai nuk heq dorë as nga jeta, as nga puna". "Helbete, kam punuar edhe mirë edhe keq".* [25]

Përfundimisht, ai zgjedh rrugën e Zotit, pikërisht sepse i jepet me kohë kjo mundësi që ta bëjë këtë, që ta bëjë peshoren e jetës së tij të anojë nga e mira, nga e drejta, nga njerëzillëku: *"Pajtohu me njerinë, aga, që të pajtohesh e me Zotin, se Zoti i sheh të gjitha, i shkruan të gjitha".*[26] Në këtë kuptim religjioz, sjellja e Ago Jakupit përpara vdekjes, pas paralajmërimit të saj, është e motivuar edhe si frikë ndaj Zotit, ndaj ndëshkimit të tij. Por siç shënon Ariés-i, *"nën ndikimin e kundërreformës, shkrimtarë shpirtërorë luftuan kundër besimit popullor se nuk ishte e nevojshme të rropateshe të jetoje virtytshëm, meqenëse një vdekje e mbarë i shlyente të gjitha".*[27]

Rrëfimi "I pasuri që ish i varfër fort" tipologjikisht është shumë më afër përrallës. Duke u nisur që nga treguesit formalë (p.sh. nisja formulare *"Na paska qenë një herë një i pasur"*), nga personazhi i tipizuar deri në limit (ai as emër të përveçëm nuk ka) e duke përfunduar te mësimi moral, i një natyre thelbësisht religjioze, që vjen si moral i rrëfimit.

I të njëjtës gjedhe me këtë është edhe rrëfenja tjetër "Natë muaji maj"[28] ose e njohur si "I gjalli dhe i vdekuri". E ndërtuar si një përrallë, ajo realizon, përsa i takon këndvështrimit tonë tematik, njëlloj ekzorcizimi të vdekjes. Ky realizohet nëpërmjet thyerjes së kufirit ndarës mes jetës dhe vdekjes. Bashkekzistenca e të gjallëve me të vdekurit është parë nga studiuesit si një shfaqje e familjaritetit tradicional me vdekjen. "*Mirëdashja kundrejt idesë së vdekjes është ndryshimi i parë madhor që shfaqet në fund të shek. XVIII dhe që u bë një nga karakteristikat e romantizmit*".[29] Bota e përtejme përshkruhet si e bukur, mahnitëse, duke tentuar një estetizim të vdekjes e të botës parajsore përtej saj. "*Për më shumë se 1000 vjet (deri nga shek. XVII) njerëzit ishin po aq të familjarizuar me të vdekurit sa ç'ishin me vdekjen vetjake*" - pohon Ariés-i[30]. Për pjesën tjetër, rrëfenja është njëfarë tregimi religjioz për parajsën, për natyrën e dyfishtë të jetës: *"Dalëngadalë filloi ta dashurojë përsëri këtë jetë kaq të hidhur e kaq tëembël".*[31]

[25] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 51
[26] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 58
[27] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.33
[28] Kuteli Mitrush - Kapllan Aga i Shaban Shpatës, rrëfime - Botim i autorit, Tiranë, 1944, fq 41-52
[29] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.50-51
[30] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.17
[31] Kuteli Mitrush - Kapllan Aga i Shaban Shpatës, rrëfime - Botim i autorit, Tiranë, 1944, fq. 52

Edhe pse e shkruar dhe e botuar vetëm 10 vite pas rrëfenjës "Natë muaji maj" (Pogradec 1928), rrëfenja "Lugetërit e fshatit tonë"[32] (Bukuresht 1938) duket sikur është shkruar shekuj pas saj. Së paku, në aspektin e trajtimit të vdekjes. "Lugetërit" duket sikur i takon një tjetër epoke nga i pari. Ai familjaritet me vdekjen e me të vdekurit ka humbur, varrezat nuk janë më një vend publik, siç kanë qenë për shekuj me radhë, por një vend ku nuk duhet shkelur, pasi aty është pushteti i "qoftëlargut", ku lugetërit ngrihen e kërcejnë valle.

Është rasti të përkujtojmë dy shkrime joletrare të Kutelit, që trajtojnë pikërisht motivin e romantizuar të vdekjes, përmes përshkrimit të varreve e varrezave. Shkrimi i parë titullohet "Vargje mbi gurë varresh" dhe është shkruar në Tiranë në prill 1943 e botuar në "Shënime letrare", 1944.[33] Është një përshkrim paraletrar i shkrimeve në gurët e varreve, epitafeve, a siç i quan Kuteli, "kryeshkrime". Janë mbresa e shënime nga shëtitjet në varrezat e Tiranës e në një rast, të Fierit. Interesimi i Kutelit shkon për ato "kryeshkrime" që kanë karakter poetiko-letrar, duke i parë ato si pasqyrë jete, por edhe vdekje njëherazi. *"Në pasqyrën e vdekjes së vet, speculum mortis, çdo njeri do të zbulojë sekretin e individualitetit të vet"* - thotë Ariés-i.[34] Edhe shkrimi tjetër, "Në Prizren, midis të vdekurve dhe të gjallëve"[35], shkruar në Prizren në maj 1943 e botuar në "Shënime letrare" 1944, kemi sërish një inspektim në varrezat e Prizrenit, kësaj here jo vetëm letrar a paraletrar, por edhe kulturologjik. Edhe një herë kemi një pajtim thuajse të plotë me tezat e Ariés-it për vdekjen, varret e varrezat. Ky i fundit sikur ka pasur parasysh Kutelin kur shkruan: *"Duke nisur nga shek. XVIII, njeriu ishte më pak i shqetësuar për vdekjen e vet sesa për "la mort de toi", vdekjen e tjetrit, humbja dhe kujtimi i të cilit frymëzoi në shek. XIX dhe XX kultin e ri të varreve dhe varrezave dhe trajtimin romantik, retorik të vdekjes"*.[36]

Vdekja në rrëfimin "E madhe është gjëma e mëkatit"[37]

Rrëfimi fillon me "*Rronte në kohërat e para...*" dhe përfundon me "*Pastaj Tat Tanushi u tret ngadalë...*". Sugjerohet kësisoj një koncept ciklik jetë-vdekje, i cili për shkak të mëkateve të Tat Tanushit, tentoi të mos mbyllej, të cenohej e prandaj të mos realizohej. Çka do të thotë prishje e ekulibrit mes forcash të kundërta, por edhe mes atyre forcave që mund të konsiderohen si të të njëjtës kahe: p.sh. dashuria tokësore për Kalien dhe dashuria hyjnore për Zotin. "*Prej shek. XVI në të XVIII, skena të panumërta apo motive në art dhe letërsi e shoqërizojnë vdekjen me dashurinë, Thanatosin me Erosin"*- konstatojnë studiuesit.[38]

[32] Kuteli M. - *Vepra letrare - vol 2*- "Naim Frashëri", Tiranë 1990, fq. 295
[33] Kuteli M. - "Vargje mbi gurrë varresh" - në Shënime letrare- Tiranë 1994 (ribot. 2007)
[34] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.42
[35] Kuteli M. - "Në Prizren midis të vdekurve dhe të gjallëve" - në Shënime letrare- Tiranë 1994 (ribot. 2007)
[36] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.45
[37] Kuteli Mitrush - E madhe është gjëma e mëkatit - Apolonia, Tiranë, 1996
[38] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.47

Në këtë rrëfim gjen të shprehur edhe një herë koncepti i shkrojtjes së mëkateve në librin e jetës, që do të shërbejë si gur peshoreje për të përcaktuar drejtimin që shpirti do të marrë pas vdekjes. Në Parajsë apo në Ferr? Këtë dilemë Tat Tanushi, si shërbëtor i Zotit që është, do të duhej ta kishte shumë të thjeshtë për ta zgjidhur. Por vdekja e Kalies e përmbys dhe e shprish sistemin e tij të besimit e të veprimit. Është rasti tipik i mospranimit të "vdekjes së tjetrit", të njeriut të dashur. "*Do të thotë se ata që mbeteshin, e pranonin vdekjen e njeriut tjetër me vështirësi më të madhe se në të shkuarën. Prej këtej e tutje (edhe ky është ndryshim i rëndësishëm) vdekja që frikëson nuk është më aq dhe aq vdekja vetjake, por është vdekja e tjetrit, la mort de toi, vdekja e tjetrit*"[39]. Ariés-i në studimin e vet nënvizon se në shek. XIX - zija mortore e shpaloste idenë e vdekjes me një nivel të pazakontë: teatralitetin. Shekulli i XIX ishte i sunduar nga shfaqja e zisë, të cilën psikologët e sotëm e quajnë zija histerike. E cila ndonjëherë mbërrinte lajthitjen. Ariés-i na përkujton një tregim të Mark Tueinit, "Historia e një kaliforniani", shkruar në 1893-in, në të cilin një burrë që edhe pas nëntëmbëdhjetë vjetësh që i kish vdekur e shoqja, nuk e kish pranuar këtë fakt, por i festonte përvjetorët e saj të lindjes, duke pritur kthimin e saj të pamundur në shoqërinë e miqve të vet dashamirës që e ndihmonin ta ushqente këtë iluzion. Tata bën të njëjtën gjë, duke iu kundërvënë idesë së vdekjes së të dashurës së tij, gruas së tij, Kalies. Fillimisht duke u vetofruar për të vdekur e për t'u kallur edhe ai në varrin e saj. Pastaj duke i mbajtur mëri Zotit për faktin që ia mori gazin e tij të jetës. Mëkati i tij thellohet kur ai mendon t'i zbulojë varrin që ta shohë e të çmallet me të. Kulmin e arrin kur nis të gdhendë ikona (kora) me imazhin e saj e t'i adhurojë njësoj si shëmbëlltyrat e shenjtorëve të kishës. Të gjitha këto, në fakt, nuk janë veçse shfaqje e përshkallëzim i të njëjtit mëkat, që është ai i mospranimit të vdekjes si përmbushje e një vullneti të epërm, hyjnor. Mendojmë se pikërisht këtu duhet kërkuar edhe çelësi i kuptimit të ndëshkimit të këtij mëkati pikërisht me "mosvdekje". "*Et morimur - të gjithë do të vdesim. Kjo përbën qëndrimin e parë ndaj vdekjes*" - shkruan Ariés-i[40].

Por le të merremi me vdekjen e Kalies. Kemi në rastin e saj një shfaqje të asaj dukurie që mund ta quajmë "estetizimi i vdekjes": "*Ajo kish në atë kohë edhe bukurinë e të vdekurit, edhe të të gjallit*"[41]. Për këtë dukuri, në studimin e vet, Ariés-i shprehet se "*Vdekja nuk ishte më e dëshirueshme, por ishte e adhurueshme në bukurinë e vet*"[42]. Parathënia e vdekjes së Kalies realizohet përmes një teknike të thjeshtë, por edhe të përdorur herë të tjera në raste të ngjashme nga Kuteli (shih më sipër): përmes ëndrrës. Në të vërtetë, kjo ëndërr është thelbi dhe përfaqësimi alegorik i asaj që vjen, asaj që pritet të ndodhë. Alegoria është fund e krye e karakterit religjioz, me të gjitha shenjat e transfigurimit mistik fetar. "*Krishti i veshur me të shenjtat e meshës dhe me kurorë drite rreth kryes*", "*Kupa e kishës... plot dritë që ngrihej gjer sa u bë qjell*" (simbol i hapësirës parajsore) "*në tendat e të drejtëve do të prehet*"; e pas kësaj edhe

[39] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.54-55
[40] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.45
[41] Kuteli Mitrush - E madhe është gjëma e mëkatit - Apolonia, Tiranë, 1996, fq. 15
[42] Ariès Philippe - Historia e vdekjes në Perëndim - Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq.48

rënia, shembja e tij: "*Tat Tanushi i Bubutimës ish engjëlli i zi i hedhur nga qielli në hadh*". Ky i fundit na vjen i përshkruar "*plot ferra e gurë*", me "*errësirë katrani*".[43]

Vdekja reale e Kalies vjen, megjithëse e paralajmëruar, në një trajtë verbale shumë të drejtpërdrejtë, me një fjali të kursyer e disi të thatë, dramatike, por të zhveshur nga emocionet: "*Në parverë, vdiq.*"

Vdekja e Kalies, për të gjitha arsyet e sipërpërmendura, ngjan të jetë një "vdekje e zbutur": ajo ish e sëmurë për një kohë të gjatë, ajo kish pasur mundësinë e kohën e mjaftueshme për të lënë porosi e amanete ("*Ti, Tan, të më bësh varrë, të më vëndosësh brenda*"[44]). Kjo porosi e Kalies duket si një përpjekje e saj për ta pajtuar paraprakisht Tatën me vdekjen e saj, por "*ay harroj se varri është dera me anën e së cilës hyjmë në jetën e përtejshme...*"[45]. Varret shërbenin si shenja të pranisë së të dashurve pas vdekjes së tyre, një prani që nuk ishte domosdoshmërisht rrjedhojë e konceptit të pavdekshmërisë, që është qendror për religjionet e shpëtimit si krishterimi. Ajo ishte rrjedhojë e mungesës së dëshirës së të gjallëve të pranonin që të dashurit i kishin lënë. Kalia vetë ishte e pajtuar me vdekjen edhe në dukje, në pamje: "*Fytyra e saj kish ëmbëlsinë e vdekjes*"[46]. Por Tat Tanushi nuk u pajtua me vdekjen e saj. "Vdekja e tjetrit", e njeriut të dashur në këtë rast, i duket si një kundërvënie, si një adversion, teksa, për hir të dashurisë, ai ofron vdekjen e vet në këmbim: "*Ay i mbante mëri zotit për vdekjen e së shoqes*"[47]. Kalimi konceptual nga "vdekja ime" në "vdekjen e tjetrit", ishte një kalim shumë i rëndësishëm, që prodhoi disa pasoja të rëndësishme: në mbretërinë e imagjinatës, vdekja iu bashkangjit erotikes. Në religjion shënjoi përbuzje ndaj botës dhe një imazh të zbrazëtisë. Në familje - edhe kur ata besonin në jetën tjetër dhe në një pasjetë më realiste, një kalim (*transpositionem*) të jetës tokësore në përjetësi (amëshim) - vdekja u bë ndasia e papranueshme, vdekja e tjetrit, vdekja "jote", vdekja e njeriut të dashur.

[43] Kuteli Mitrush - E madhe është gjëma e mëkatit - Apolonia, Tiranë, 1996, fq. 22-23
[44] Kuteli Mitrush - E madhe është gjëma e mëkatit - Apolonia, Tiranë, 1996, fq. 26
[45] Kuteli Mitrush - E madhe është gjëma e mëkatit - Apolonia, Tiranë, 1996, fq. 27
[46] Kuteli Mitrush - E madhe është gjëma e mëkatit - Apolonia, Tiranë, 1996, fq. 26
[47] Kuteli Mitrush - E madhe është gjëma e mëkatit - Apolonia, Tiranë, 1996, fq. 27

Kastriot GJIKA

"THE DEATH OF THE OTHER" IN THE WRITINGS OF MITRUSH KUTELI

Abstract

Death is not only one of the most universal topics, in addition to love, travel, life, beauty, etc., but is also seen as one of the most difficult to deal with, both ethically and psychologically and religiously. The most natural tendency of the last century has been to avoid death as topic, to non-rebound directly, to project it euphemistically into other areas of the individual or collective world.

But Kuteli's case is somewhat specific and quite contrary to this trend. Death is so present in Kuteli's narrative prose, that he seems to have explored it with all his techniques and literary means in all of its individual, social, ethical, religious manifestations. We can affirm that he has a special interest in this subject and he's familiar with it.

"The Death of the Other", however, as a concept explored in his writings, but also in other paraliteratur and nonfictional writings, gives us a complete insight into his ethical, religious, philosophical and literary concepts of death and of life itself.

"The death of the other," is seen in confrontation and in a comparative way with "my death", in the M. Kuteli's "rrëfenja"-s, but also in other its writings.

Valbona GASHI-BERISHA

VETVETJA SI NJË TJETËR - TRANSIDENTITETI NË DRAMËN *"NITA"* TË JOSIP RELËS

Çështja e identitetit është në qendër të të gjitha vështrimeve letrare ku shprehen marrëdhëniet komplekse ndërmjet Vetes dhe Tjetrit. Nevoja për ta njohur Veten në raport me Tjetrin, ta pohojë identitetin e vet, i takon çdo individi, çdo komuniteti dhe çdo kulture. Identiteti mund të shihet si rezultat i përkohshëm i një procesi kulturor, i cili është në transformim të vazhdueshëm.

Në këtë punim do të paraqesim një nga çështjet më delikate sa i përket identitetit femëror-transidentitetin. Për këtë do të bazohemi në teorinë e Paul Ricoeur-it *"Soi-même comme un autre - Vetvetja si një tjetër"*, dhe në dramën "*Nita"* të Josip Relës. Heroina, Nita është personazhi femër e cila e paraqet më së miri çështjen e transidentitetit dhe definimin e Vetvetes. Si çdo vajzë tjetër, edhe ajo ka një identitet, një baba dhe të dashurin Zefin. Mirëpo, gjithçka ndryshon prej momentit kur banorët e fshatit Brisk të Shkodrës nga frika e sulmeve turke, shpërngulen në Arbnesh të Zarës, në Kroaci. Para se të largohej, Nita i premton Zefit se do ta priste tërë jetën. Dhe se, për t'i larguar djemtë që dëshironin të martoheshin me të, ajo kërkon pëlqimin e Këshillit të Pleqve që të shpallet mashkull. Transidentiteti i saj miratohet me një ceremoni kishtare, me ç'rast pagëzohet me emrin Tani. Por, si e ndjeu Nita veten në lëkurën e një tjetri?

Për t'iu përgjigjur kësaj problematike komplekse së pari do të paraqesim dëshirën e Nitës për të qenë Tjetri, së dyti përjetimet, sfidat brenda Vetvetes në fazën e transit dhe, së fundi, ankthin që përjeton për t'u kthyer në Veten e vet.

Në punimin Çështja e identitetit: Vetvetja *dhe* Tjetri, *definicioni i dhënë tregon qartë se njeriu evoluon dhe ndryshon:*

«Identiteti i një personi është çdo gjë që formon egon "uni", dhe si person vazhdon, evoluon dhe pëson ndryshime gjatë gjithë kohës. Për shkak të të gjitha këtyre ndryshimeve të mundshme që mund të ndodhin në jetën e një personi, identiteti shpesh definohet si më delikati, më i brishti dhe se qenia njerëzore përpiqet ta ruajë të paprekur»[1].

[1] Valbona Gashi-Berisha, *Çështja e identitetit: Vetvetja dhe Tjetri*, Seminari i XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, f. 488.

Identiteti personal

Se me çfarë një person konsiderohet unik dhe i ndryshëm nga të tjerët, formohet prej tipareve të personalitetit që i atribuohen atij nga rrethi ku jeton dhe nga pasardhësit e familjes së tij. Këto tipare bëhen vetë produkte kulturore të shoqërisë në të cilën personi lind dhe jeton. Komponentja personale e identitetit, si një proces psikosocial, ka të bëjë me një tërësi të emocioneve, përvojave dhe dëshirave që i bart në vete. Kjo është arsyeja pse imazhi i vetes është, në fund të fundit, vetëm paraqitja dhe ilustrimi koshient i kësaj strukture.

Sipas Paul Ricoeur-it[2], janë tri forma të identitetit personal:

- *identiteti-idem* - i referohet konceptit psiko-sociologjik të *karakterit*.
- *identiteti-ipse* - është definuar në aspektin e etikës si *ruajtja e vetvetes* që ka të bëjë me *premtimin* që i jep tjetrit.
- *Identiteti narrativ* - i vetmi që mund të "përfshijë ndryshimin, është labil, brenda kohezionit të një jete".

Transidentitei mund të përkufizohet si një gjendje jo e zakonshme e vetëdijes (metacognition) që manifestohet me qëndrimin dhe sjelljen duke u bazuar në vullnetin dhe veprimin jo të zakonshëm (métamotivation), për të cilat referenca kryesore është vetvetja.



[2] (Ricœur, 1985, p 443) RICŒUR, P. (1985). *Temps et récit*. Tome III. *Le temps raconté*. Paris: éditions du Seuil.

Transidentiteti është term mjaft kompleks, i cili ka të bëjë jo vetëm me pamjen e jashtme, por edhe me perceptimin e identitetit të brendshëm të personit që ka veshje, sjellje dhe paraqitet si person i gjinisë së kundërt. Transidentiteti nënkupton transformimin gjinor: ndryshimin e veshjes[3], emrin e ri, prerjen e flokëve, ndryshimin e sjelljes etj.

Mund të flasim për mashkull dhe femër në kuptimin biologjik, që i përkasin gjinisë mashkullore dhe femërore dhe, mashkull dhe femër në kuptimin psikologjik. Mund ta përcaktojmë një femër e cila e percepton veten si mashkull nga aspekti psikologjik dhe rastet kur një femër transformohet në mashkull nga aspekti biologjik me anën e intervenimit mjekësor. Raste të tilla kanë të bëjnë më tepër me transeksualitet sesa me transidentitet dhe intervenimet mjekësore nuk kanë ekzistuar në kohën kur është shkruar drama "*Nita"*. Duhet të cekim se, edhe kur ka raste të operimit dhe të ndryshimit të gjinisë, nuk mund të bëhet ndryshimi i të gjitha kromozomeve dhe organeve të tjera të brendshme. Transformimet e hormoneve me anë kirurgjikale, të cilat bëhen në ditët e sotme, mund të ndryshojnë pamjen dhe po ashtu ndryshimin e gjinisë, por këto raste prej një qenieje njerëzore të shëndoshë kalojnë në një qenie që duhet trajtuar gjatë gjithë kohës. Këto raste disa i quajnë persona transgjini, transgenres, transsexes, mirëpo termi transidentitet përshtatet më mirë duke folur për identitet trans.

Transidentiteti paraqitet në shumë vepra letrare dhe luan një rol të rëndësishëm në kulturën e secilit popull[4]. Ky fenomen është i pranishëm edhe tek populli shqiptar ku gjejmë shembuj qysh nga këngët kreshnike. Heroizmin e vajzës, e cila, për të shpëtuar nderin e familjes, vishet me rroba mashkulli (të babait apo edhe të të vëllait) dhe del në dyluftim. Shembull tipik e kemi Shote Galicën, e cila vishet me rroba burri dhe lufton armikun me trimërinë e një burri. Ajo që duhet të ceket është se te këto raste transformimi gjinor ndodh për një periudhë të shkurtër kohore dhe femra prapë i kthehet gjinisë biologjike.

Sipas traditës për shkaqe të ndyshme: mungesës së trashëgimtarit mashkull, ruajtjes së nderit, apo edhe arsyeve të tjera, disa femra ndryshojnë jo vetëm veshjen, por edhe sjelljen. Këto femra bëjnë jetë burrash dhe nuk martohen kurrë, ndryshe quhen edhe "virgjëresha të përbetuara".

---

[3] Pothuajse të gjitha shoqëritë njerëzore gjatë historisë bëjnë dallimin në mes mashkullit dhe femrës për nga veshja: mënyra e të veshurit, ngjyra të caktuara, stilin e po ashtu edhe kodin e veshjes që janë e përshtatshme për secilën gjini. Ka raste të shumta kur kodi i veshjes nuk i përshtatet gjinisë të cilës i përket, por këto raste kanë qëllime të caktuara. Për shembull, veshjet në teatër kur një mashkull luan rolin e një femre ose një femër rolin e një mashkulli.

[4] Raste të tilla kemi tek pothuajse të gjithë popujt. Në Francë kemi shembullin e Jeanne d'Arc, e cila vishej si mashkull për të luftuar gjatë luftës 100-vjeçare në mes të Francës dhe të Anglisë. Historia e Mulanit, vajzës kineze, e cila si vajza e vetme e familjes nuk dëshiron që babai i saj i sëmurë të niset për luftë. Ajo vendos që të vishet me rrobat e babait dhe fshehtas niset të luftojë kundër armikut.

Sa u përket virgjëreshave të përbetuara, transformimet e tyre kanë të bëjnë vetëm me pamjen e jashtme, ndërsa identiteti i tyre biologjik nuk pëson ndryshime. Në këto raste nuk mund të flitet për martesë e që kjo nënkupton edhe privim të plotë të jetës seksuale.

Te drama "*Nita"* gjejmë një reflektim të shpirtit të një vajze e cila preferon ta ndryshojë identitetin e saj gjinor për ta ruajtur besën që ia kishte dhënë dashnorit të vet. Transformimi i Nitës do të formësojë një tjetër identitet. Një transidentitet që Nita e shpreh me këto fjalë: «mashkull për katundin, për njerëzinë, për djemtë e vajzat dhe për punë… »[5]. Me një fjalë, transidentiteti i saj është i ngjashëm me transidentitetin e përkohshëm, siç e cekëm më herët dhe identik me transidentitetin e virgjëreshave të përbetuara.

Që në fillim të aktit të parë lexuesi ndeshet me grabitjen e Nitës nga ushtarët e Aqim beut dhe shpëtimin e saj nga Zefi, i dashuri i saj, me disa të rinj të fshatit. Gjatë gjithë këtij akti, Nita paraqitet si një vajzë e rëndomtë, mirëpo grabitja dhe më vonë ikja nga fshati do të ndikojnë shumë në personalitetin e saj për transidentitet.

Transformimi i Nitës prej identitetit-ipse në transidentitet është një strukturë e përbërë prej tri pjesësh që bashkëveprojnë: transidentiteti i egos, transidentiteti personal dhe transidentiteti i grupit.

Nëse i kthehemi teorisë së Paul Ricoeur-it, identiteti-ipse te Nita shfaqet me rastin e largimit të saj nga fshati duke i premtuar Zefit se do ta presë: "Lehtë do ta kem të të pres, Zef, lehtë... Me ty po mbetet edhe shpirti im, Zef!"[6] - shprehet Nita.

Si mund të jetë e lehtë pritja për Nitën? Mos vallë është nënvetëdija e saj që flet dhe që thellë në vetvete e di se askush tjetër përpos Zefit nuk do të mund të zërë vend në zemrën e saj. Atëherë, edhe nëse Nita ndryshon, transformohet, merr një identitet të ri, premtimi i dhënë nuk ndryshon. Edhe nëse Nita largohet, edhe nëse pamja e saj fizike ndryshon, prapëseprapë shpirti i saj mbetet me Zefin.

Prej momentit kur Nita posedon identietin e saj, identitetin-ipse deri te marrja e vendimit për transidentitet, lexuesi nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me mendimet e saj. Lidhja e personalitetit të saj me egon (unin) na lejon të supozojmë se vullneti për ta njohur vetveten dhe aftësia për ta tejkaluar veten e saj në raport me të tjerët i kanë mundësuar që të marrë përgjegjësi dhe të marrë vendimin për transidentitet. Me këtë transformim Nita ndihet e sigurt për ta pritur të dashurin e saj, transidentiteti ia mundëson këtë: "Të pres, Zef, të pres edhe tre, edhe tridhjetetë e tre vjet!"[7].

Tre vjet kanë kaluar dhe Nita nuk ka asnjë lajm nga Zefi, asnjë shenjë jete që ajo të mund të mendojë për një fije shprese. Kjo periudhë është e errët për lexuesin. Se si Nita vendosi ta ndryshojë identitetin e saj gjinor mund të dimë vetëm nga identiteti i

[5] Akti III, skena I, f. 55.
[6] Josip Rela, "*Nita"*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës, 2001, Prishtinë, akti I, skena XV, f. 26
[7] "Nita", akti III, skena I, f. 55

saj narrativ. Pritja e të dashurit për Nitën ka qenë sa e gjatë edhe e ëmbël: «Të gjatë kanë qenë për mua këta tre vjet, por, duke pritur, më janë dukur të ëmbël…»[8]. Kjo na bënë të kuptojmë se lumturia e saj e vetme është pritja dhe lutjet: «A i dëgjon ti, Zef, lutjet dhe thirrjet e mia të përditshme? Mua më duket sikur i dëgjoj të tuat!...»[9].

Nita do të ishte e lumtur për sa kohë priste dhe lutej, por qetësia e saj shpirtërore nuk zgjati shumë. Bukuria e saj nuk i linte indiferentë djemtë e tjerë që ishin dashuruar pas saj. Ajo ndihej keq jo vetëm ndaj djemve, por edhe ndaj vajzave: "Për qetësi të djemve... mos mendojnë djemtë për mua... Për qetësi të vajzave... se vajzat kanë të drejtë të zemërohen me mua, nga që s'e zgjedh njërin dhe të tjerët të mbeten të lirë"[10].

Edhe pasi Nita u shpall mashkull, një prej djemve, i dashuruar gjithnjë pas saj, nuk mund ta harronte. Nita e kuptonte mjaft mirë gjendjen e tij shpirtërore në të cilën gjendej edhe ajo vetë: "Më vjen çudi se ç'po prêt Mimqi… Ose është dashuruar me ndonjërën, ose po mendon akoma për mua… I shkreti ai... E mjera unë...»[11].

Perceptimi dhe vullneti për ta njohur vetveten gjatë këtyre tre vjetëve sa e ka pritur Zefin, ka qenë për Nitën një nxitje drejt vendimit të marrë. Duket qartë se Nita është koshiente ndaj fatit që ia ka caktuar vetvetes dhe pyetjeve të shumta të shoqeve u përgjigjet me shumë vendosmëri dhe pa asnjë mëdyshje: «Tjetër gjë është të bëhesh mashkull e tjetër gjë të shpallesh… »[12].

Procesi i transidentitetit është më se i qartë për Nitën. Transidentiteti gjinor kirurgjikal – domethënë transformimi i gjinisë me anë të operacionit nënkupton *të bëhesh mashkull* dhe transidentiteti gjinor psikologjik – domethënë transformimi i gjinisë në pamje nënkupton të *shpallesh mashkull*.

Mund të themi se edhe ankthi ishte i pranishëm te Nita, edhepse ajo e dinte mjaft mirë dallimin e identitetit të saj me anën e transformimit. Në një mënyrë ajo ishte e ngrysur në vetvete dhe kjo është ndoshta arsyesja që lexuesi nuk ka informacione mbi mendimet e saj lidhur me vendimin që kishte ndërmarrë. Përgjigjjen mund ta gjejmë te këto fjalë: «Vajzave duhet t'u ruhem e meshkujve duhet t'u qëndroj larg. Dhe unë do të jem mashkull!»[13].

Nëse përdorim terminologjinë e Frojdit[14], egoja[15] e Nitës është në kontradiktë të brendshme dhe vendimi që të shpallet mashkull vjen si pasojë e rrethanave në të

[8] Po aty
[9] Po aty
[10] Akti II, skena X, f. 48
[11] Akti III, skena IV, f. 59
[12] Akti II, skena III, f. 34
[13] Po aty, f. 35
[14] Teoria e personalitetit sipas Zigmund Frojd-it (1856-1939) përbëhet prej tri koncepteve kryesore: Id-i, ego (uni) dhe super-ego (super-uni). Idi është instikti i pranishëm që në lindje dhe përfaqëson prirjen instiktive dhe biologjike. Egoja vepron mbi parimin e realitetit dhe

cilat ajo gjendet. Nita e ka kuptuar realitetin dhe tani super-egoja[16] e saj reagon duke marrë vendimin për transidentitet. Këtë mund ta ilustrojmë me anën e trekëndëshit duke marrë parasysh ekzistencën e Nitës – Idi, që analizon dhe arsyeton egon me identitetin e saj femëror dhe reagimin e super-egos për vendimin që kishte ndërmarrë për transidentitet.



Pra, mund të themi se çdo gjë është kontradiktore në vetvete. Si çdo gjë tjetër, edhe identiteti, pra, është kontradiktë në vete e që poeti francez Arthur Rimbaud e ilustron mjaft mirë me thënien: *"Je est un autre-Unë është një tjetër"*[17]. Ndryshe, mund të themi se ekzistenca e një Tjetri në secilin prej nesh qëndron në ndërgjegjen e thellë dhe paraqitet me rregullat e shoqërisë në të cilën jetojmë. Ky dimension është i pranishëm edhe te drama "*Nita*". Nuk mungojnë as fjalë plot sarkazëm që i drejtohen

arsyes, ndërsa super-egoja është pjesë e personalitetit e cila zhvillohet më vonë nën ndikim e familjes dhe rrethit shoqëror.

[15] Koncepti i egos është rregullatori kryesor i personalitetit normal, i cili ndërvepron me dy konceptet e tjera: idin dhe super-egon, duke harmonizuar instinktin biologjik, realitetin me rregullat e caktuara të shoqërisë dhe veprimin e super-egos.

[16] Super-ego është pjesë e personalitetit e cila zhvillohet më vonë nën ndikimin e mjedisit social me të cilin jeton individi. Në vetvete, super-egoja ka dy komponentë: ndërgjegjen dhe egon ideale. Ndërgjegjja përbëhet prej proceseve mendore (ndijimet, perceptimet, kujtimet, emocionet dhe mendimet) që ndodhin në mendjen tonë. Ego ideale - është sistemi që na nxit drejt përsosmërisë morale të personalitetit.

[17] Arthur Rimbaud në letrën e tij drejtuar Paul Demeny 15 maj 1871

babait të Nitës: «Prenk, ti je me fat të bardhë! Një fëmijë ke, por e ke edhe djalë edhe vajzë»[18].

Sipas zakonit, ceremonia e transidentitetit të Nitës u bë në kishë, ku ishin të pranisëhm Guvernatori, Gjon Kristofoli, Prifti, pleqtë dhe të gjithë bashkëfshatarët e Briskut. Gjatë ceremonisë, e vetmja gjë që Nita kërkoi ishte emri i saj i ri: «Me dëshirën tuaj, kërkoj që emrin të ma ktheni nga Nita në Tani»[19]. Ceremonia vazhdoi me dhurata, djemtë i dhuruan rroba meshkujsh, ndërsa prifti një kobure: «Tani i Prenk Vukës: Duke nderuar këtë festë, jam i gëzuar se po mundem të të uroj emrin tënd të ri të mashkullit. Jam shumë i gëzuar që mund të të fal këtë kobure të re. Mbaje me nder si mashkull e si trim, në kujtim të ditës së sotme»[20].

Në këtë mënyrë, proklamimi i transidentitetit të Nitës u bë sipas ligjeve dhe zakoneve të fshatit Brisk. Këto zakone janë identike me zakonet e përshkruara në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Sipas Kanunit, virgjinat (femnat që vishen si burrë) kanë "të drejtën e mbajtjes dhe përdorimit të armës, të drejtën e mbajtjes së "sahatit me qystek", siç e mbanin burrat, të drejtën e mbajtjes së plisit, të veshjeve të burrave, të drejtën e pronës, të drejtën e gjakmarrjes, të drejtën e pjesëmarrjes në luftë si mashkull". Femra e cila deklarohej si mashkull për arsye të ndryshme kishte këto të drejta që u cekën më lart, por një gjë ishte e ndaluar: e drejta e fjalës. Në librin 12, kreu 24, § 1228, pika VIII, Kanuni thotë: Virgjinat (femnat qi veshen si burrë): s'veçohen prej grâsh tjera, posë qi janë të lira me ndejë nder burra, porse pa tagër zânit e kuvendit[21].

Tanimë identiteti i Nitës ka ndryshuar, ajo njihet si mashkull nga të gjithë dhe për ta bindur edhe veten e vet ai/ajo shprehet: «O, i mjeri unë...". Pse Nita e quan veten të mjerë? Mos vallë me këtë fjalë ajo tregon mospajtimin e vet për këtë akt, apo tani është ndërgjegjja e saj e thellë që gjykon. Pakënaqësinë e saj e shpreh edhe kur i vesh rrobat e meshkujve "i kam veshur këto rroba që ma rrjepin lëkurën"[22].

Këto fjalë na bëjnë të kuptojmë se vendimi për transidentitet është marrë për të ikur më shumë nga vetvetja sesa nga të tjerët. Siç duket, në ditët e para Nita ka pasur vështirësi me veshjen dhe sjelljen, mirëpo pamja e re disi iu përshtat personalitetit të saj: «Të them të vërtetën, ditët e para s'e pata lehtë. Por tashti jam mësuar. Tashti me këto rroba, më duket më lehtë e më bukur sesa me ato të femrës»[23].

Ndryshimi i saj fizik nuk është edhe ndryshim karakteri apo force. Se Nita nuk kishte ndryshuar, veçse nga pamja e jashtme, e kuptojmë gjatë organizimit të garës për

[18] «Nita », f. 52
[19] F. 49
[20] F. 51.
[21] Gjeçovi, 1986, f. 152
[22] Akti III, skena I, f. 55
[23] F. 62

vrapim. Ajo i referohet identitetit të saj të mëhershëm, duke e treguar fuqinë e saj me këto fjalë: «Unë kam vrapuar mirë edhe me rroba femrash…»f. 62.

Fitorja e Nitës në garat e vrapimit dhe shpëtimi i një fëmiuje nga uji i detit ishin vetëm sfida që ajo i tejkaloi për ta vulosur më mirë transidentitetin e saj. Sjelljet e saj ishin në harmoni me zakonet e familjes dhe të rrethit ku jetonte. Mirëpo, ky realitet ndryshoi me ardhjen e Zefit. Lumturia e fitores së garës së vrapimit u ndesh me ardhjen e të dashurit. Zemra e Nitës gati sa s'pushoi së rrahuri nga gëzimi. Shumë shpejt Zefi e kuptoi se Nita i kishte veshur rrobat e meshkujve për ta "ruajtur pastërtinë e zemrës së vet"[24].

Dëshira e Nitës tani ishte të kthehej në veten e vet, në identitetin e saj të parë, të ishte femër ashtu siç ishte dhe të martohej me Zefin. Egoja e saj rezononte si kurrë më parë: «S'dita më mirë të fshihesha, të mbrohesha dhe të ruaja dashurinë e zemrës sime… Nuk e kam gjetur udhën më të mirë…»[25].

Sigurisht se rrugën që e zgjodhi Nita, transidentitetin, ishte një vendim i vullnetit të saj për t'u fshehur pas këtij identiteti të ri, për t'u mbrojtur dhe për të ikur nga vetvetja, për ta ruajtur të paprekur dashurinë e saj. Problemi qëndron tek zakonet: «Kur vajza s'do të martohet… mund të shpallet mashkull, por (zakonet) nuk thonë, se kjo vajzë mund të kthehet prapë në femër»[26].

Jo vetëm zakonet, por edhe Prifti edhe pleqtë ishin kundër veprimit të Nitës. Personat e njëjtë që e kishin shpallur mashkull, tani e shpallnin Nitën fajtore: «Fajtore se ka gënjyer pushtetin tonë të ri, fajtore se ka mashtruar zakonin tonë të vjetër, fajtore se ka nxirë veten e katundin… Kështu që tani duhet ta mbysim, ta vrasim, ta lidhim pas bishtit të qeve»[27].

Mbrojtja e vetme e Nitës që ndryshoi mendimin e gjykimit, qe Luka, udhëheqësi i grupit, i cili jo pse nuk donte t'i respektonte zakonet e vjetra, por dëshira e tij ishte që bashkëfshatarët t'i ndryshojnë mendimet e tyre, sepse zakonet «nuk mund të mbahen aq fort dhe rreptë si në tokën e vjetër…»[28].

Ndryshimi i mendimit dhe i vendimit të gjykatësve ndaj veprimit të Nitës ishte marrë tepër vonë. Super-egoja e Nitës ishte fyer rëndë nga Prifti dhe pleqtë, duke e gjykuar si «gënjeshtare», «tradhtare», «fajtore» dhe me epitete të tjera. Këtë gjë ndërgjegjja e saj nuk e përballoi dot. Vendimi i saj i fundit, për t'u fshehur, për ta mbrojtur vetveten nga të tjerët, ishte vetëvrasja. Një vetëvrasje, që në një mënyrë e shpëton atë edhe nga zakonet e vjetra edhe nga transidentiteti e sidomos nga vetvetja.

[24] F. 85
[25] F. 82
[26] F. 88
[27] F. 91
[28] F. 90

Bibliografia

FREUD, S. (1923). *Essais de psychanalyse*. Traduction de l'Allemand par le Dr. S. Jankélévitch en 1920, revue par l'auteur. Réimpression: Paris: Éditions Payot, 1968.

GASHI-BERISHA, V. (2013). *Çështja e identitetit: Vetvetja dhe Tjetri*, Seminari i XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë

GJEÇOVI, SH. (1985). *Kanuni i Lekë Duakgjinit.* Rilindja. Prishtinë.

RELA, J. (2001). "*Nita"*. Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës, Prishtinë.

RICŒUR, P. (1990). *Soi-même comme un autre*. Paris: éditions du Seuil.

RICŒUR, P. (1975). *La Métaphore vive*, Paris, Éditions du Seuil.

RICŒUR, P. (1983). *Temps et récit I, l'intrigue et le récit historique*, Éditions du Seuil, Paris.

RICŒUR, P. (1984). *Temps et récit II, la configuration dans le récit de fiction*, Editions du Seuil, Paris.

RICŒUR, P. (1985). *Temps et récit III, le temps raconté*, Editions du Seuil, Paris.

SHEMA, I. (2016). *Josip V. Rela- Jeta dhe krijimtaria letrare*, Drita, Prishtinë.

Valbona GASHI-BERISHA

SELF AS ANOTHER - TRANSIDENTITY IN DRAMA "NITA" OF JOSIP RELA

Abstract

The issue of identity is at the centre of all literary observations which express the complex relationship between self and the other. The need to recognize ourselves in relation to the others, to assert its identity, belongs to every individual, every community and every culture. Identity can be seen as a result of a temporary cultural process, which is in constant transformation.

In this research we will present one of the most delicate issues regarding female-trans- identity. For this we will rely on the theory of Paul Ricour's "Soi-même comme un autre - self as another", in the drama "Nita" of Josip Rela. Heroine, Nita is the female character who represents the best issue of trans- identity and self-definition. Like any other girl, she also has an identity, a father and the lover Zef.

However, everything changes from the moment when the residents of the village Brisk of Shkodra, from the fear of Turkish attacks move to villages Arbnesh of Zadar, in Croatia. Before leaving, Nita promises to Zef that she would wait for him for the rest of her life. And to avoid the young men who wanted to marry her, she

asks the consent of the Elderly Council to be declared as a male. Her Trans -identity endorsed by a church ceremony and she was baptized by the name Tani. But how did Nita felt into other skin?

To answer this complex issue we will first point to Nita's desire to be another, secondly experiences, the challenges within herself at the transit phase and, finally, the anxiety she experiences to return to herself.

Key words: identity, self, other, trans-identity, complexity.

Besim REXHAJ

ALTER-EGOJA NË FUNKSION TË TJETRIT DHE SI BURIM I KONFLIKTIT INTRAPSIKIK

Observacione teorike

Koncepti i tjetrit, si një koncept i shumëkuptimshëm, nga fusha e kulturës, e psikologjisë dhe e sociologjisë, kultivohet edhe në letërsi si një koncept, i cili, në të vërtetë, e ka shoqëruar, nëse jo edhe në superstrukturën e saj, në praktikën e saj krijuese po se po, letërsinë që nga fillet e saj, si një koncept inherent, edhe para formave të tjera të dije e të njohjes. Qoftë kur koncepti i tjetrit identifikohet në letërsi **si koncept i cili e identifikon tjetrin si një qenie të ndryshme nga qeniet e tjera të grupit a të bashkësisë**, le të thuhet me metaforë, nga unë dhe nga ne, qoftë kur identifikohet si koncept që shënjon hendekun social ose gjinor dhe, madje, shërbehet edhe me stigmën sociokulturore, ai gjithnjë përbënë atë që është specifike dhe imanente për letërsinë. Përse e them këtë? Sepse përmes artikulimit të konceptit të tjetrit si të ndryshëm, në gjini, në rang shoqëror, në status psikologjik, në pozitë sociale margjinale etj, letërsia, në shtrirje historike dhe, doemos, edhe aktuale, identifikon realitete, të cilat format e tjera të njohjes nuk mund t'i identifikojnë e artikulojnë. Le të kujtojmë këtu kryepersonazhet e autorëve të mëdhenj, Medenë e Euripidit, Heda Gablerin ose Norën e Ibzenit, si personazhe të ndryshëm, të kundërt, rebel dhe të rebeluar, të diskriminuar, nonkoformist, që i përgjigjen konceptit të tjetrit si koncept modern ose të individit nonkonformist dhe të rebeluar e të liberalizuar, personazhe të cilët, krahas tipareve të tjera, pikërisht duke qenë të ndryshëm, përbëjnë modele të personazheve të rëndësishme, autentike, origjinale dhe aktuale. Me fjalë të tjera, duke e identifikuar dhe artikuluar atë që është e ndryshme, tjetrin ndryshe nga unë dhe nga ne, në shkallë dhe në kontekste të caktuara të ndryshimësisë, letërsia e këtij modeli e **artikulon atë që është atipike në kontekstet tipike**, atë që është e pazakonshme dhe e çrregullt në kontekstet e zakonshme dhe të rregullta sociopolitike dhe kulturo-psikologjike. Duke e pasur në imanencën e saj artikulimin e dionisiakes, **të asaj që qëndron mbi ose nën normën**, cilado qoftë ajo normë, **kultivimi i konceptit të tjetrit në letërsi si i ndryshëm** e hap mundësinë e njohjes, të pushtimit të zonave të panjohura të qenies njerëzore, të mbretërisë së ndërdijes, me çka, atë realitetin latent të njeriut, të cilin e shtyp, e margjinalizon shoqëria me mekanizmat e saj represiv, e shndërron në realitet manifestativ. Me këtë, në të vërtetë, ky tip i letërsisë, bëhet

instrument i aktit të njohjes dhe të vet-njohjes, të njohjes së një bote tjetër, të ndryshme. Por, edhe njëherë, për shkak të domethënies dhe kontekstit specifik të konceptimit e të zbatimit të konceptit të Tjetrit, që shpesh prodhon paqartësi e pasiguri, le të kujtojmë këtu përkufizimin, më mirë observacionet e studiuese së njohur Katherine Weiss, e cila në librin e saj monografik për Becketin, duke analizuar dhe interpretuar dramat e këtij krijuesi, thotë:"Njeriu mund të filloj të mendoj për tjetrin si diçka që qëndron përtej Vetjes (Selfit), por ky përkufizim rudimentar nuk shpie shumë përtej kësaj: një portet i plotë i Tjetrit në diskursin modern dhe post-modern është shumë më kompleks. Edhe pse termi është i rrënjosur në ndërveprimet e vërteta me një person tjetër ose me një grup tjetër, forma e tij konceptuale (e kapitalizuar) gjithmonë përfshin ide më të gjera që zotërojnë të gjitha ndërveprimet, reale ose hipotetike, me të gjithë personat, të njohur ose të panjohur. Disa formulime psikologjike të Tjetrit e kuptojnë atë para së gjithash si një konstrukt imagjinar, të bazuar në botën e jashtme, por, pastaj, të internalizuar brenda Vetjes, duke e formësuar aty identitetin dhe sjelljen (pra, "Super-egon" e Sigmund Freudit, "objektet internale" të Melanie Kleinit dhe 'imazhet' e Jacques Lacanit)"[1].

Alter-ego si tjetri te drama "Teuta" e Y. Shkrelit

Konceptin e këtillë të tjetrit, në një formë krejt të veçantë, do ta takojmë tek drama "Teuta" të Ymer Shkrelit (1978), **ku dimensionet konfliktuale dhe të panjohura të qenies së personazhit ballafaqohen me vetveten si me tjetrin, ku tjetri i internalizuar si normë etike e sociale ose alter-egoja ushtron ndikim të pakthyeshëm psikologjik në botën e tij të polarizuar së brendshmi dhe së jashtmi**. Në të vërtetë, tek "Teuta" takojmë një formë të veçantë të projektimit të tjetrit si entitet dhe, tjetrin, si faktor të diskriminimit, të ndëshkimit, të gjykimit të jashtëm, e gjejmë të internalizuar, të trupëzuar në formën e alter-egosë apo të super-egosë, të këtij dimensioni i cili gjykon, ndëshkon dhe shpërfaq zona të panjohura të ndërgjegjes.

Një nga konstantat psikologjike, të cilat e përçajnë dhe që e prishin drejtpeshimin psikologjik të Mbretëreshës Teutë, dhe që vjen nga zona e Tjetrit, nga zona e Alter-egosë, është ajo përçarja midis femrës e mbretëreshës, kur një zë nga ajo zonë asaj i thotë: "Femra na qenka gabim i natyrës!...Jo!...Më shumë është mëkat!... E unë? Qenkam unë femër o mbretëreshë?... Si t'i ndajë? Në cilin front të hidhem, në cilin më shumë? Ku dhe çka? Sikur të ishte e mundur ta nxjerri kokën nga lufta e ta kthejë në shtrat!(...) Po cila jam unë, cila? Këtë s'ma thotë askush."[2] Krahas faktit se konstatimi ose zëri i këtillë artikulon difuzionin e identitetit të Mbretëreshës Teutë, për

[1] Katherine Weiss, The Plays of Samuel Beckett, Methuen Drama, Great Britain, London, 2013, f. 166.

[2] Ymer Shkreli, Trilogji ilire, Rilindja, Prishtinë, 1977., f. 94.

hir të qartësisë, do konstatuar se Mbretëresha Teutë, në kohën kur dëgjon zërat që i shfaqen nga zona e tillë, ndodhet në situatë kufitare ekzistenciale, ndodhet para humbjes së mbretërisë, në një situatë e cila sikur i kërkon bilancin e bëmave të jetës së saj paradoksale. Pra, Teuta, edhe si femër, edhe si mbretëreshë, e ka të luhatur bazën e saj, sepse, si njeri i fronit, ndodhet para rrezikut të shthurjes së mbretërisë së saj, dhe, si femër, si e veja e mbretit Agron, si dashnore e Dhimitrit, vetëm pjesërisht realizohet si e tillë, si femër, sepse edhe këtë dimension të qenies së saj e ka të rrezikuar. Qoftë me statusin e mbretëreshës, qoftë me statusin e femrës, e mbërthyer nga përjetimi i ankthit të skajshëm ekzistencial, e mbërthyer nga konfliktet e jashtme e të brendshme, ajo, para pasqyrës, kur është hapur para zonave të fshehura të personalitetit të saj dhe nuk mund të ikën më nga vetja, artikulon këto fjalë, kur i pëshpëritë vetes me tronditje: "Jam unë kjo që shoh, ose është dikush tjetër në mua?...ç'është? ç'po ngjet?...Diçka po ndodh?...Midis meje e meje, çka ka që nuk kuptojë, që nuk përthekon koka ime?...ç'është kjo vjeshtë në fytyrën time, kur bën dimër i ftohtë në natyrë?..."[3]

E ndodhur në një situatë kufitare ekzistenciale, me mekanizmat mbrojtës psikologjik pothuaj të paqenë, pra, pothuajse e çarmatosur psikologjikisht, asaj i troket në ndërgjegjen e saj rikujtimi i konstatimit të dhembshëm mbi një pjesë të së kaluarës së saj. Mund të them se rrallë mund të takohen personazhe në letërsinë shqiptare që artikulojnë ashtu me dhembje e në lakuriqësi paradokset e të qenmes e të pozitës së saj si mbretëreshë e si femër, ashtu siç i takojmë këto artikulime në këtë dramë, që ndodhet në kufi me tragjiken: "Fatkeqësisht, gjumi as që është qelës për t'ikur nga vetja. S'ke ku shkon. Rruga është e vrazhdë, mbretëresha ime, e vrazhdë dhe e shkurtër... E tillë është jeta. Meritë e saj është që ëndrrat zgjasin pak. Shkurt... Ti je femër, e mbretëria e femrës, nis e sos, është veç shtrat...Shtrat, shtrojë, shtrirje, o-pësim!..."[4] Sipas teorisë psikanalitike të ëndrrave, realiteti i ëndrrës shpreh realitetin e psikikës së atij që ëndërron, zakonisht pjesët e fshehura, ato pjesët të cilat ne, me mekanizmat e vetëdijes sonë, i shtypim dhe i hedhim në pjesën e pavetëdijshme të psikikës, pjesë të cilat, në gjumë, kur dobësohet autocenzura e vetëdijes, shpërthejnë dhe, me gjuhën, kryesisht, simbolike, na transmetojnë shenjat, sinjalet, mesazhet, siç do të thoshte themeluesi i shkollës dytë të psikanalizës, C. G. Jungu. Së këndejmi, gjumi, si mekanizëm mbrojtës, si mbrojtje nga vetja dhe nga realiteti i jashtëm, si dhe konstatimi rreth mbretërisë së femrës, e cila fillon dhe përfundon me shtratin, shprehin, sa anksiozitetin aktual si rrjedhojë e gjendjes aktuale kufitare, aq edhe vijat e karakterit dhe të temperamentit të Teutës, shprehin, jo vetëm atë që nuk është rastësi e personalitetit të saj, por, mbi të gjitha, ato që mund të quhen dominanta, dominonte të personalitetit të saj.

[3] Po aty., f. 128.
[4] Po aty., f. 102.

Karakteri krejt i ndryshëm, sui generis, temperamenti kontradiktor dhe, në përgjithësi, personaliteti paradoksal i mbretëreshës Teutë si qenie e ndryshme, e pangjashme me Grupin apo me statusin e saj rojalist është shprehur në ëndrrën e saj me dreqin, i cili i shfaqet në gjumë, me dreqin, i cili i i drejtohet mbretëreshës me këto fjalë: "Në jetën tënde kam pasur më shumë punë unë, se ti vetë..."[5] Dreqi në këtë ëndërr është projektuar në funksionin simbolik dhe jo në funksionin e njohur mitologjik dhe këtu shënjon të keqen, irracionalen dhe, së këndejmi, vetëm kështu mund të kuptohen fjalët e tij: me fjalë të tjera, më shumë se mbretëresha me të keqen e saj, me dimensionet, me shtytjet e saj irracionale, e keqja, irracionalja, është marrë me te, e ka zotëruar mbretëreshën, ka vënë pushtet mbi të. Shenjat, të cilat i shfaqen mbretëreshës Teutë përmes dhe në formën e djallit janë ato shenjat të cilat sinjalizojnë rrënimin e drejtpeshimit psiko-afektiv dhe ikja e saj nga vetnjohja, ikja nga realiteti brendapsikik në funksion të shmangies së obsesionit të fajit e të mëkatimit, në situatën kufitare ekzistenciale pothuajse nuk funksionon më. Përse? Sepse, paralel me dinamikat intrapsikike, edhe dinamikat e zhvillimeve të jashtme jetësore, situata para shthurjes së mbretërisë, shënojnë çrregullimin apo ashpërsimin e skajshëm të situatës së saj jetësore dhe, së këndejmi, ajo është e rrezikuar edhe së jashti e edhe së brendshmi, Me anë të simbolikës së Dreqit të Zi, që shqipton dimensionet destruktive të Teutës, faktikisht përmes shenjave të ndërdijes së saj, mbretëreshës i shfaqen në ëndërr mëkatet, fajet, të cilat i ka "harruar": ambicia, shtytja për pushtet, e cila, madje, e gllabëron deri në nivelin sa luan me ndjenjën e shenjtë të dashurisë, të cilën e flijon që të zë fronin e mbretëreshës; dëbimi i rivales së saj, Triteutës me të birin, Pinin; sprova për t'u çliruar nga Dhimitri. Ja se si i flet Dreqi i zi, i cili në ëndërr e takon Teutën me pjesët e vet-harruara: "Po, përse mos të them? Për shembull: kur ishte i gjallë Agroni, më shumë ia shikove kurorën se sa kokën... S'flas për dashurinë. Nuk ishte çast për zemër, ai ... Më vonë, pas vdekjes së Agronit, e ndoqe Pinin nga Pallati, Pinin me të ëmën, Triteutën... Tani e shikon si dhia thikën...Dhe, më e reja: Dhimitrin, që aq shumë e deshe, e mundon, e lodh mendjen si të lirohesh prej tij…është pak kjo?..."[6]

Në fund të kësaj pjese të observacioneve për "Teutën" e Y. Shkrelit, do rikujtuar se pjesët e cituara të personazhit të Teutës, që përbëjnë fushën qendrore semantike dhe ideofilozofike të kësaj drame, që të gjitha, janë pjesë të shqiptuara nga vet ajo, jo nga personazhi tjetër apo nga personazhet e tjera në komunikimet midis personazheve si forma e zakonshme e komunikimit, por, si formë dramatike, si monolog, si monolog me vetveten, ku tjetri, tjetri i internalizuar si alter-ego, si kodeks i normave etiko-morale, flet e artikulohet, si përmbajtje, si vetja.

[5] Po aty., f. 127.
[6] Po aty., f. 128

"Sinkopa" e Pashkut – pozita dhe forma sui generis e artikulimit të tjetrit

Një formë krejt specifike të artikulimit të tjetrit si të ndryshëm e takojmë tek Anton Pashku, në përgjithësi tek proza e tij, po, në veçanti në dramaturgjinë e tij e, mbi të gjitha, tek drama e parë e botuar moderne në letërsinë shqiptare, "Sinkopa" (1969), e cila shquhet me karakterin e veçantë të modelimit të personazhit. Në këtë dramë, jo vetëm kryepersonazhi, Xhexheu, po edhe personazhet e tjera janë projektuar si entitete me funksione dyjësore artistike, filluar nga Lumnia (si personazh konkret) e Lumtunia (si gjakim metafizik), nëpër Shpresën (si femër konkrete) e deri te Shpresa filozofike (si synim, gjendje dhe gjakim psikologjik) e, mbi të gjitha, kryepersonazhi, Xhexheu, si njeriu i rebeluar, i ekskomunikuar, i margjinalizuar dhe i izoluar nga bashkësia, nga shoqëria, dhe Gjegjeu, kipci i Xhexheut, Gjegjeu, i cili është projektuar si njeriu i përshtatur, i uniformuar, i standardizuar në përputhje me modelin kontraproduktiv social të filozofisë së shoqërisë e të kohës. Përse e them këtë? **Nëse tjetri në letërsi konceptohet si i ndryshmi, i ndryshmi nga qeniet e tjera të grupit a të bashkësisë, nëse në mes të tij dhe të tjerëve ka një hendek social, nëse është i etiketuar me stigmën sociale e morale, me një fjalë, nëse statusi i tij si qenie shoqërore, etiko-morale dhe psikologjike dallon deri në pikën sa krijohet përjashtimi, refuzimi, mosdurimi, atëherë sigurisht se Xhexheu i "Sinkopës" së Pashkut përbënë përfaqësuesin tipik të tjetrit si i ndryshëm, i rebeluar, i ekskomunikuar, jo-konformist.** Dhe, për qartësi dhe saktësi të mëtejme, e para, le ta them edhe këtë: derisa tjetri si i ndryshëm mund të jetë i tillë për shkak të orientimit gjinor ose politik, që mund të kufizoj me perversionin ose me dhunën dhe mund të jetë jo vetëm i përjashtuar por edhe përjashtues dhe, po ashtu, derisa tjetri mund të jetë i ndryshëm për shkak të racës e të prejardhjes sociale dhe kjo në bashkësinë e tij të reflektohet si dallim dhe tjetërsi tragjike, si diskriminim fatal racor ose social (Othelloja, Zonja me Kamelie, kurtizanet etj), do kujtuar se tjetri i "Sinkopës" së Pashkut është ndryshe dhe tjetër me filozofinë dhe me utopinë e tij sociale, me modelin e jetesës së tij në të tashmen dhe me vizionin e jetës për të ardhmen, filozofi, utopi, modele dhe vizione këto që Xhexheun si individ e shndërrojë në një personalitet tragjik. E dyta, Pashku e projekton kryepersonazhin e tij në dy rrafshe të receptimit: si një të tërë, si një entitet unik, brenda të cilit veprojnë dy personalitete, dhe si një tërësi të plotë të pavarur, autonome në qenësinë e tij, si personalitet i cili i kundërvihet tjetrit si tjetri dhe jo si një pjesë e tjetrit. Kjo, në të dyja rastet i detyrohet modelimit krejt specifik të strukturës së personazhit dhe, në këtë kontekst, e shprehur në frymën e haptësisë (openness) së Umberto Ecos, i detyrohet poetikës së hapur, që ndërtohet mbi shenjat e ambiguitetit dhe të polisemisë artistike. Edhe njëherë: cili është Gjegjeu? Është krijuar ai në funksion të artikulimit ekskluziv të një modeli hedonistik, mekanik, të zhveshur nga vlerat sublime të jetës, të tjetërsuar, të varfëruar dhe të uniformuar në ndjeshmërinë e tij vulgare si qenie autonome, e cila në

kuptimin e prosedeut dhe teknologjisë dramatike shfaqet në skenë vetëm në pjesën e dytë të dramës, në Fillimin e mbarimit të **Sinkopës,** apo (edhe) në funksion të theksimit të individualitetit paradoksal e tragjik të Xhexheut? Në të dyja rastet Gjegjeu, mbase si pjesë e Xhexheut edhe më shumë, artikulon tragjikën e paradokseve të individit nën sistemin totalitar, të individit i cili, si strategji e mbijetesës, detyrohet të ndërtojë personalitetin e dyfishtë, njëherë dhe, së dyti, të jetojë (Gjegjeu) ekskluzivisht sipas një modeli joproduktiv, konformist, hedonistik dhe të tjetërsuar nga vlerat e njëmendta sociokulturore dhe kulturo-psikologjike. Duke u marrë me strukturimin e veçantë të kryepersonazhit të "Sinkopës" apo të këtyre "dy personazheve" të kësaj drame, në një studim timin kam konstatuar se "mund të thuhet se Gjegjeu është pjesa e përshtatur, e adaptuar e Xhexheut karshi sociumit, është egoja sociale, derisa Xhexheu është egoja e papërshtatur, ajo egoja psikologjike. Me një gjuhë tjetër, mund të thuhet se Gjegjeu është jashtësia e Xhexheut, ajo pjesa e standardizuar, e cila i shtrohet ligjeve dhe determinanteve sociokulturore të sistemit totalitar, kurse Xhexheu ajo pjesa e pabindur, e rebeluar, e cila e mohon sistemin totalitar dhe mekanizmat e tij morbid."[7] Duke qenë se Xhexheu është projektuar si qenia e cila e gjakon individualizimin, si qenia e cila e refuzon sistemin totalitar dhe nuk është i gatshëm të bëhet pjesë e dhëmbëzorit të diktaturës autoritare, si qenie e cila më parë pranon të jetojë në kthetrat e vetmisë sociale dhe të ekskomunikimit nga bashkësia a sociumi se sa të konformizohet dhe të heq dorë nga ego-ideali dhe vizioni i tij për të tashmen dhe për të ardhmen, ai i plotëson shumicën dërmuese të tipareve, me të cilat karakterizohet dhe përkufizohet tjetri si qenie e ndryshme sociale, psikologjike, emocionale, si qenie e papërshtatur, e margjinalizuar dhe e përjashtuar nga grupi ose sociumi. Në anën tjetër dhe në të njëjtën kohë, Xhexheu, duke qenë i shtrënguar që të integrojë entitetin e Gjegjeut brenda makro-entitetit të tij si strategji e mbijetesës, shprehë paradokset e dikotomisë brenda individit dhe të dikotomisë midis individit dhe shoqërisë dhe, në të dyja rastet, artikulon frustrimin, frustrimin kronik të qenies njerëzore si qenie kreative, si qenie e cila nuk është e gatshme të jetojë sipas sistemit të përmbysur të vlerave, sipas sistemit të kiçifikuar të vlerave, gjerësisht të përqafuara dhe të afirmuara nga turmat, nga turmat e manipuluara nga mekanizmat e dhunës shpirtërore dhe kulturore totalitare.

Qoftë edhe fare kalimthi, këtu do theksuar karakterin specifik të dramës tjetër të A. Pashkut, të dramës "Gof", e cila, po ashtu, shquhet për karakterin krejt origjinal të strukturimit të personazhit në frymën e personazhit, pjesët e të cilit veprojnë herë si ego, herë si e herë si alter-ego. Në këtë kuptim, Lulua, Lulani dhe Lulashi, që e çojnë më tutje prosedeun e modelimit të personazhit sipas modaliteteve, të cilat tashmë i kemi analizuar, për shkak të situatës së skajshme ekzistenciale si dhe për shkak të

[7] Prof. Dr. Besim REXHAJ, Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, 1948 – 2008, Vëllimi II, Faik Konica, Prishtinë, 2009, f. 24.

botës sui generis, lexohen si entitet i dyfisht: së pari, secili prej tyre, si një entitet i vetëm, si tri personazhe, që shprehin tragjikën e pamundësisë së bashkërendimit të kategorive apo shtresave të ndryshme të njerëzve në situatë kufitare ekzistenciale të luftës dhe, së dyti, si një tërësi e vetme, si një personazh, brenda të cilit kundërvihen pjesë të ndryshme të këtij personaliteti, i cili artikulohet me tone kronike konfliktuale. Tek është fjala për pamundësinë e bashkërendimit të kategorive apo shtresave të ndryshme, do kujtuar observacionet e studiuesit, Dr. Nebi Islamit, i cili thotë:" Vetëdijësimi i këtillë përputhet me situatën paradigmatike të pamundësisë së një brezi tjetër për t'i shpërthyer situatat hermetike të kushtëzuara nga faktorë të shumtë të brendshëm e të jashtëm.[8]" Ndërsa kur është fjala për personazhin si një tërësi e vetme, si një personazh, brenda të cilit kundërvihen pjesë të ndryshme të këtij personaliteti, në frymën e asaj që e thamë në fillim të observacioneve tona lidhur me Tjetrin sipas logjikës së Katherine Weiss ("Disa formulime psikologjike të Tjetrit e kuptojnë atë para së gjithash si një konstrukt imagjinar, të bazuar në botën e jashtme por pastaj të internalizuar brenda Vetjes, duke e formësuar aty identitetin dhe sjelljen") do sjellë në vëmendje observacionet e Dr.Sabri Hamiti, të artikuluara fillimisht në librin e tij të njohur "Teksti i dramatizuar" (Prishtinë, 1978) dhe, më vonë, në parathënien e librit "Tragjedi moderne", ku thotë se "Lulua, Lulani e Lulashi, herëherë, janë vetje të një baze, tri shkallë të një personaliteti të shprishur, tri alternativa të një vetëdije të shkapërderdhur."[9]

Në fund të observacioneve për karakterin specifik të dramaturgjisë së Pashkut, do rikujtuar observacionet e studiuesit të njohur të dramës shqiptare, të Josip Papagjonit, i cili çështjen e karakterit të ndryshëm dhe të dyfishtë apo të trefishtë të kryepersonazhit të dramës "Gof" e shtron prej një perspektive krejt të veçantë: njëherë, duke mos e parë si problem çështjen e strukturimit të personazhit a të personazheve, sepse të tre personazhet (Lulua, Lulani, Lulashi) konceptohen si personazhe me vete dhe, së dyti, duke e vështruar në kontekstin krejt specifik të një bote të veçantë, e cila nuk e përjashton komunikimin me këto personazh edhe në një rrafsh tjetër, i cili flet për karakterin krejt të ndryshëm të personazhit në kuptimin e Tjetrit:"E ngarkuar me simbole, parabola dhe alegori të shumëfishta, drama sjell një realitet psikik të përthyer e të zymtë, gjendje në formë kllapie tek personazhet, frikë, pasiguri, tragjikën dhe fatalitet, të cilat gërshetohen me synimin për të përballuar situatat e vështira e të jashtëzakonshme, që ose jepen si rrethana dhe të dhëna të trashëguara e të përfunduara, ose si asociacione të një realiteti historik të njohur (që datohet në prill të vitit 1939, kohë kur Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste)".[10]

[8] Dr. Nebi Islami, Historia dhe poetika e dramës shqiptare (1886 – 1996), Universiteti i Prishtinë, Fakulteti i Arteve, Art Qendra, Prishtinë, 2003, (Vëllimi II) f. 11.
[9] Anton Pashku, Tragjedi moderne, Rilindja, Prishtinë, 1982., f. 9.
[10] Josip Papagjoni, Historia e Teatrit Shqiptar, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2011, f 237.

Në fund

Në fund të këtyre observacioneve nuk mund të mos them se letërsia, letërsia e mirëfilltë, e vendos në epiqendrën e saj personazhin e tipit të tjetrit, le të them kështu, atë personazhin si të ndryshëm, të papërshtatur, të pazakonshëm, të panënshtruar, rebelin, heroin e rebeluar, të margjinalizuar e, madje, edhe anti-heroin, njeriun i cili sfidon sistemet e (pseudo)vlerave. Që kjo të qartësohet përfundimisht, vetëm le të përpiqemi të mendojmë, vetëm hipotetikisht dhe shkurt, për një letërsi në të cilën (krye)personazhet e saj do të ishin të përshtatur, të zakonshëm, të bindur, uniform, të rregullt etj. Pavarësisht se historikisht edhe kategoritë e këtilla të personazheve e popullojnë letërsinë, pavarësisht se edhe tipat e tillë janë pjesë përbërëse e botës së letërsisë, mund të thuhet pa mëdyshje se letërsia e mirë, madje as mesatarja e vlerave letrare, nuk ndërtohet mbi një model të tillë të ndjeshmërisë së personazheve, madje, jo vetëm letërsia dramatike, si letërsi e konflikteve, (që në thelbin e saj e ka konfliktin dhe personazhin konfliktuoz), po edhe format e tjera të shprehjes letrare. Që ta demonstroj dhe argumentoj karakterin specifik të personazhit të tjetrit si i ndryshëm, jashtë dhe në kundërshtim me grupin, klasën dhe vlerat e tyre grupore e klasore, le të përkujtojmë këtu varfërimin e skajshëm të personazhit të letërsisë së realizmit socialist si letërsi e turmave, atë praktikën që turma të vendoset në epiqendër, që ajo turmë të shndërrohet në hero dhe që, po ashtu, edhe heroi prijës i kësaj turme të njëjtësohet, të shkrihet me turmën, duke e humbur identitetin vetjak dhe duke e përqafuar identitetin grupor, klasor, kolektiv. Le të kujtoj po ashtu se personazhi i kësaj letërsie, si individ i cili duhet t'i përkasë klasës punëtore dhe të identifikohet me idealet e saj politike dhe ideologjike, është ai personazhi, në thelb, i kolektivizuar, i pa individualizuar, ai personazhi i cili, në luftën e tij klasore, nuk stepet, nuk luhatet, nuk përçahet, nuk pushtohet nga mëdyshjet, sepse e ka çelësin dhe formulën klasore, që ia rregullojnë, ia sigurojnë dhe kultivojnë drejtpeshimin e dhe lumturinë e deklaruar kolektive. Pa dashur që të thellohem më tej në këtë drejtim, vetëm le të them se, së këndejmi, letërsia e tjetrit e konceptuar në parametrat më lart të shqiptuar, pashmangshëm është letërsi e konfliktit dhe e konfliktualitetit, letërsi e individit që, në kuptimin jungian të fjalës, e gjakon individuimin, qoftë duke qenë i ballafaquar, duke u rebeluar, qoftë duke u (vet)margjinalizuar, por gjithnjë duke gjakuar për të ruajtur ndryshimësinë e tij, origjinalitetin dhe integritetin e tij, potencialin e tij specifik si qenie individuale, e papërsëritshme njerëzore.

Bibliografi:

Anton Pashku, Sinkopa, Jeta e Re, Prishtinë, 1969.
Anton Pashku, Gof, Rilindja, Prishtinë, 1976.

Anton Pashku, Tragjedi moderne, Rilindja, Prishtinë, 1986, me parathënien e Sabri Hamitit

Besim REXHAJ, Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, 1948 – 2008, Vëllimi II, Faik Konica, Prishtinë, 2009.

Josip Papagjoni, Historia e Teatrit Shqiptar, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2011.

Katherine Weiss, The Plays of Samuel Beckett, Methuen Drama, Great Britain, London, 2013.

Dr. Nebi Islami, Historia dhe poetika e dramës shqiptare (1986 -1996), Universitetio i Prishtinës, Art Qendra, Prishtinë, 2003.

Sabri Hamiti, Teksti i dramatizuar, Rilindja, Prishtinë, 1978.

Ymer Shkreli, Rilindja, Prishtinë, 1977.

Besim REXHAJ

ALTER EGO AS A FUNCTION OF THE OTHER AND AS A SOURCE OF INTRAPSYCHIC CONFLICT

Abstract

The concept of the other, as a many-sided concept, from the field of culture, psychology and sociology, is also cultivated in literature as a concept which, in fact, as an inherent concept, has accompanied literature since its beginning, even before other forms of knowledge and recognition. Both when the concept of the other is identified in literature as a concept that identifies the other as a being different from beings of the group or community, different from them, or even when it identifies social and gender differences and implies socio-cultural stigma, it always constitutes what it is specific and immanent for literature. Why do I say that? Because by articulating the concept of the other as different, as gender, social rank, psychological status, at marginal social position etc., literary, in its historical and current dimension, identifies realities, which other forms of recognition can not identify and articulates the way the literature does. In other words, by identifying and articulating what is different, the other different from me and us, to the degree and in certain contexts of difference, literature articulates what is atypical in typical contexts, what is unusual and disorderly in ordinary and regular sociopolitical and cultural-psychological contexts. Having in its immanence the articulation of Dionysus, of what stands above or below the norm, whatever that norm, the cultivation of the concept of the other in literature opens up the possibility of knowledge, the conquest of unknown areas of human being, of the kingdom of unconsciousness, by which, mysterious and latent human reality is

transformed into manifestative reality. With this, in fact, this type of literature becomes an instrument of the act of recognition and self-recognition. Such a concept of the other, in a very special form, will be found in the drama "Teuta" (1977) of Ymer Shkrel, and "The Death of a Queen" (1978) by Rexhep Qosja, where the conflicting and unknown dimensions of being of these characters face themselves like the Other, like some else, where the Other internalized as an ethical and social norm or alter ego exercises irreversible psychological impact in their polarized worlds inside and out of them.

Lili SULA

LETËRSIA E MIGRACIONIT SI FORMË *KREOLIZIMI*: RASTI GËZIM HAJDARI

Letërsia e migracionit nuk është një fenomen i kohëve të fundit; vende europiane me të kaluar të rëndësishme koloniale shënojnë shkrimtarët e brezit të dytë a të tretë. Te ne letërsia bashkëkohore e migracionit është dukuri e re, e cila mori trajtë me hapjen e Shqipërisë, me valët migratore të viteve '90. Krijimtaria artistike e shkrimtarëve tanë që jetojnë dhe shkruajnë në shtete të tjera është pak e njohur, e thuajse aspak e studiuar (ndërkohë është e vlerësuar dhe e studiuar nga kritika e huaj) dhe përbën një fakt të padiskutueshëm letrar e kulturor po aq sa dhe një fushë të rëndësishme studimi.

Termit *Letërsi bashkëkohore e migracionit*, me përdorim fluid e të ndërdyztë, do t'i shkojmë sipas përkufizimit të një prej studiuesve më në zë të saj, prof. Armando Gniscit, që në këtë klasifikim përfshin "tekste letrare të shkruara në italisht nga autorë i/migrantë në Itali […..] që përcjellin karakteristika të pushtimit kolonial, varfërisë, shfrytëzimit ekonomik, asimilimit kulturor etj."[1] Rrethet studimore karakterizohen nga ngurtësia e kanonit letrar e kulturor perëndimor eurocentrist, për t'i jashtëshkruar nga Vetja këto fenomene, nga njëra anë, si letërsi përtej kufijve, periferike e provinciale, e për rrjedhojë minore, e jo e denja për t'u studiuar, e nga ana tjetër, një kahje e fortë e shkrimtarëve migrantë dhe e studiuesve, synojnë ripërkufizimin e nocionit të letërsisë në fushën e studimeve letrare dhe qendërzimin e letërsisë së migracionit brenda letërsisë e kulturës nacionale dhe europiane, duke ngritur për diskutim çështjen e krijimit të imazhit kolektiv dhe mitit të identitetit kolektiv. Kjo parakupton shndërrimin e konceptit të letërsisë nga një sistem i mbyllur e monoetnik drejt një sistemi të hapur ndaj krijimtarisë deri më sot të margjinalizuar, të shkrimtarëve bilingë a plurilingë që në tekstet letrare transmetojnë shtresa e ndikime të ndjeshme nga tradita burimore dhe ajo e vendit (letërsisë) pritës. Është fjala për krijimin e një poetike të së ndryshmes, të ndërkulturores vs. poetikës nacional-centriste, të një modeli dhe veprimtarie të qëndrueshme brenda letërsisë dhe kulturës sonë nacionale, përvojë kreative që perceptohet si e Huaj, si e Tjetrit.

Në fazën e parë kjo letërsi dominohet nga autobiografizmi: rrëfehen faza të ndryshme të udhëtimit drejt destinacionit të dëshiruar. Shpejt shkrimtarët migrantë në raport të vijueshëm, refuzues ndaj kulturës e ligjërimit burimor, kalojnë në forma poetike

[1] A. Gnisci: *La letteratura italiana della migrazione*, Lilith, Roma, 1998, f. 31. Përkufizimi i Gnisci-t përcakton deri diku hartën gjeografike të letërsisë së migracionit, Afrikën postkoloniale e me poshtë nënvizon edhe vende me të kaluar të ashpër historike si Shqipëria.

shumë më të përpunuara; ata përdorin gjithnjë e më natyrshëm gjuhën e vendit pritës, gjuhën "e huaj". Tema e "ikjes" zhvendoset më shumë në rrafsh ligjërimor si shpëtim, liri e pasuri artistike. Për F. Sinopolin,[2] dimensioni më i qenësishëm i poetikës së letërsisë së migracionit qëndron te lëvizja e brendshme, te migrimi i brendshëm, vertikal dhe i shtresuar, që ndërton e sjell vlera të rëndësishme në përvijimin dhe hetimin e *ubi consistam* të një poetike transitore, të një poetike që krijon subjekt/tekstin dhe receptues të papërcaktuar.

Gëzim Hajdari është poet biling e përfaqëson një nga autorët më të spikatur të letërsisë së migracionit. U largua nga Shqipëria më 1991, pas një periudhe të vështirë jete nën regjimin komunist. Në Tiranë ka botuar përmbledhjen *Antologjia e Shiut*, 1990, po pas vendosjes në Itali, ku kreu studimet në "Letra moderne", në Universitetin "La Sapienza" të Romës, publikoi mbi 20 vepra në dy gjuhë, shqip e italisht, si: *Ombra di cane/Hije qeni*, 1993; *Sassi contravento/Gurë kundër erës*, 1995; *Corpo presente/Trup i pranishëm*, 1999; *Erbamara/Barihidhër*, 2001; *Stigmate/ Vragë*, 2002; *Spine nere/Gjemba të zinj,* 2004; *Maldiluna/Dhimbjehëne,* 2005; *Poema dell' esillio/Poema e mërgimit* 2005; *Puligòrga/Peligorga*, 2007; *Delta del tuo fiume/Grykë e lumit tënd,* 2015 etj.

I patrajtuar dhe i pastudiuar e thuajse i palexuar në Shqipëri, vepra e G. Hajdarit ka tërhequr jo pak vëmendjen e kritikëve të huaj, ku veçojmë tre libra me përmbledhje studimore e monografi, disa teza doktoratash e shumë tema diplomash universitare. Krijimtaria e tij poetike qarkullon në disa gjuhë të huaja (italisht, anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht etj.) dhe është vlerësuar me çmime letrare, ndër të cilët: Eugenio Montale, 1997; Fratellanza nel mondo, 1999; Scritture di frontiere - Umberto Saba, 2000; Popoli in cammino, 2005; Multietnicita, 2006 etj. Është një ndër autorët shqiptarë me aktivitet të spikatur në qarqet letrare italiane e ndërkombëtare e një nga poetët tanë më të pranishëm në konferenca e ligjërata universitare në Europë, Amerikë, Afrikë etj.

Po shqyrtojmë dy vëllime poetike, që besojmë se përfaqësojnë dy faza të veçanta të krijimtarisë së tij: *Corpo presente/Trup i pranishëm* (1999), mbart shenja të kalimit nga

[2] Franca Sinopoli: *Poetiche della migrazione nella letteratura italiana contemporanea: il discorso autobiografico.* - Në: *Poesia dell'esilio*, *Saggi su Gëzim Hajdari* /a cura di Andrea Gazzoni - Itali, 2010, f. 95. Studiuesja mbështet e thekson idenë e hapjes së kanonit të letërsisë perëndimore që për analogji do të shtronte në diskutim çështjen e hapjes së kanonit të letërsisë shqipe bashkëkohore në kurrikula shkollore e universitare, për ta parë këtë krijimtari si një model ndërnacional të letërsisë shqiptare në një rrjet marrëdhëniesh integrues në rrafsh horizontal e vertikal.

Presione të dhunshme me efekte paralizuese, bllokuese e tiranizuese -i cilëson M.Fuko- ligjërimet teorike unitare, gjithëpërfshirëse dhe globale (f.75); që i mbajnë "dijet të nënshtruara" dhe i lenë në heshtje, të paautorizuara nga hierarkia e njohjes shkencore (f.78). Kryengritja e "dijeve të nënshtruara," copëtimi e karikaturimi i unitetit teorik të ligjërimeve globale për të përmbysur efektet pushtetore centralizuese, efekte që lidhen me institucionin dhe funksionimin e ligjërimit të organizuar shkencor në shoqëri (f.80) do të sjellë në "rizgjimin e dijeve". Për më shumë: Michael Foucault: *Pushteti dhe dija* – katër sprova- Tiranë, 2000.

poetika autobiografike tek ajo kreolizuese dhe *Grykë e lumit tënd/Delta del tuo fiume* (2015), që karakterizohet nga poetika ndërkulturore e ndërletrare.

Kalimi nga njëri vëllim tek tjetri, me diferencë kohore 15-vjeçare, ilustron mënyrën e formësimit të poetikës kreolizuese te ky shkrimtar, si e vetmja formë që ai ka zgjedhur në mënyrë të ndërgjegjshme për të arritur në një tekst objekt i multikulutralizmit dhe plurilinguizmit.

Bilinguizmi i vëllimeve të para do të transformohet dalëngadalë në plurilinguizëm, që del në vëllimin e fundit *Grykë e lumit tënd*, jashtë kufijve të ekzilit italian në formën e një gjuhe të përzier, *kreole* deri në kufijtë e asaj që quhet "Lingua franca" (gjuhë universale) që lind si nevojë për të komunikuar gjuhën universale.

Trup i pranishëm është kërkimi i vazhdueshëm i një identiteti me peshë të re specifike që bart e transmeton peshën prej guri të përvojës shqiptare.

Leksema *gur* shoqëron shpesh imazhet e figurave të këtij vëllimi, për t'u bërë monedha e kalimit nga sistemi kulturor gjuhësor i origjinës në sistemin e mbërritjes.

Jemi në fazën fillestare të kreolizimit, në një idiomë që bart kontaktin aq të nevojshëm për komunikimin, por që bart, gjithashtu, dhe shkallën më të ulët të shkrirjes. Imazhi ndërtohet si pasojë e një përplasjeje të shurdhët tingujsh: *Sono campana di mare/ di silenzi e di voci/ chiuso nel Tempo// E nessun Dio sente suoni/ di acqua e di guoco/ della mia carne//* Jam këmbanë deti/ me heshtje dhe zëra/ mbyllur në Kohë// E asnjë Zot ndien tingujt/ prej uji e Zjarri/ të mishit tim/*

Ligjërimi ndalet në një pozicion të ndërmjetëm të zërit poetik, thuajse "afon", të shurdhët: "le nostre lingue mute", në pritje të artikulimit që nuk mbërrin të realizohet në mënyrë të plotë: "in attesa di una voce", të një zëri që nuk mbërrin në qiellin e gozhduar të universit poetik: "Ora non riusciamo a parlare/ sotto questi cieli fissi", të zërit të fshehur mes gurësh: "denunciando la mia voce/nascosta tra le pietre"; të një gjuhe që artikulon fjalë pa kuptim në netët e huaja:

dhe trupi im do të mbes/ i vetëm/ me emrin tënd prej mishi/ dhe errësire/ në duart e ftohta/ e me fjalë absurd në buzë.**

Çdo fjalë e çdo imazh i sistemit të mbërritjes nuk asimilohet dot pa u bartur në përvojën individuale që peshon rëndë dhe kushtëzon imazhin.

Prandaj dhe reflektimi i Hajdarit mbi gjuhën e poezinë ndalet në shterpësinë e lëndës që mbush përvojën e krijimit në dhé të huaj: *Nuk mundemi të flasim/nën këta qiej të fiksuar/gjuha jonë rivishet/ nga një tjetër gjuhë që çel/korbe/ …/dhe zjarret nga vijmë/ nuk na dorëzojnë te zjarret e rinj/ për të cilët kemi ende nevojë/*" (f. 28).

* Gëzim Hajdari: *Corpo presente*,- Tiranë, "Dritëro", 1999, f.16. Citimet poetike, në vijim, nga i njëjti botim.

** Anche il mio corpo resterà solo/ con il tuo nome di carne e di buio,/ nelle mani fredde,/ e con parole assurde sulla labbra.", të kërkimit të fjalëve të fshehura "parole nascoste" që përkthehen e shumta në britma "Nulla troveremo al di là dei corpi/ e delle grida. (f. 65)

Varfërimi dhe zhveshja shpirtërore thellohet në mënyrë proprorcionale me pasurimin përkatës leksikor të tekstit shqip me bartje zëvendësuese nga italishtja, si: dimora për banesë: heshtja që përsëritet në *dimorën* time/il silenzio che si ripete nella mia dimora (f. 124), apo raste të rralla e të sforcuara përdorimesh kalkesh të shpejta të gjuhës së përditshme, si: dhe unë *extrakomunitari* anonim/ed io extra-comunitario anonimo (f. 96); është plagosje që *rinovohet*/é ferita che si rinova (f. 16); që duket se zbehin ligjërimin poetik po, në të vërtetë, shënjojnë dinamikën e raporteve gjuhësore, që tregojnë fazën kalimtare[***].

Pesha semantike e tekstit të këtij vëllimi vjen prej përvetësimit në shqip apo ndërgjegjësimit për situatën e ekzilit.

Denudimi, zhveshja shpirtërore e poetit, ndërton imazhe që vijnë si forma elementare të ndjesive të reduktuara në shprehje të nevojës primare të subjektit poetik për të kumtuar trupin e tij të zhveshur.

Marcello Carlino[3] analizon ligjërimin poetik të Hajdarit të strukturuar në dy çelësa kryesorë: *Guri/Pietra* e *Hija/Ombra*, në fushën semantike të të cilëve do të shtonim një seri fjalë-çelësash që strukturojnë lirikat si një poemë a cikël poetic, i cili artikulon *Ezilin* autorial – si shkruan poeti – jetën pezull, si: Mungesë/Assenza; Kujtim/Ricordo; Pritje/Attesa; Dhomë e Zbrazët/Stanza Sgombra; Heshtje/Silenzio, Ndërdyzje, Vegullim, Ëndërr, Agoni, Ankth, Iluzion, Ç'ekuilibrimin, Dëlir, Muzg Gjysmëhije Pluhur e Zbehtësi etj.

Shenjat biografike të *ikjes, ezilit* dalin kryesisht si efekte emocionale pas udhëtimit të migrantit në Perëndim, si nota e ngjyra të projektuara e të ligjëruara emocionalisht. Hajdari përdor rregullisht italianizmin *Ezil-i/Esilio,* si emër dhe *iki/fuggo,* si folje dhe si emër. Del vetëm dy herë trajta italiane *emigroj/emigro* dhe një herë trajta shqipe *mërguar*. Shqipja diferencon kuptimisht vendosjen në vend të huaj për të jetuar e punuar, për arsye ekonomike **e***migrimin* dhe për motive politike *imigrimin*. Zgjedhja e qëllimtë *Ezil/Esilio* që në italisht shënon[4] largimin nga atdheu si masë ndëshkimi, trajtë thuajse homografe e homofone me gjegjësen e vet në shqip, synon denotimin e dhunës (politike) gjatë aktit të ikjes a largimit, gjë që për lexuesin italian e ndoshta dhe për poetin nuk do të transmetohej përmes këmbimit fonemor ***e/i***. Nga ana tjetër, zgjedhja leksikore e semantike *Ezil/Esilio*, që mbështetet më shumë në realitetin historiko-kulturor e letrar të Tjetrit se sa në botën amësore të poetit, mbart tension tematik individual që në tekst transmetohet si tension konstant ligjërimi artistik e përshkallëzohet në ndjesinë e ankthit, agonisë, skutës, pasigurisë, hijes, dhimbjes e sfilitjes dhe që receptohet e përjetohet vetëm si e tillë. Të vërejmë se nuk del kund emri *kurbet* (barbarizëm turke) edhe pse në traditën tonë historike e në atë letrare popullore përdoret

[***] Si dhe: gjithçka *procedon* në heshtje/tutto procedo nel silenzio (140); të procedosh drejt zërit/procedure verso la voce (142); që del nga lumenj *pezulluar*/e dalla agonia dei fuochi (130)

[3] Marcello Carlino: *Prefazione*,- Në: Gëzim Hajdari: *Corpo presente*,- Tiranë, "Dritëro", 1999, f.8

[4] Sipas: http://www.zanichelli.it/dizionari

rregullisht (si: shkoi në kurbet ose këngë *kurbeti*) edhe pse ndikimet prej këtyre të fundit janë të hapura.

Të gjitha (150) poezitë e vëllimit *Corpo presente*, destinuar për lexuesin tonë e atë huaj, italofon, nuk mbajnë titull, po në fund të librit, gjejmë përmbajtjen e lëndës, vetëm në italisht e vërejmë se vargu i parë i çdo krijimi shërben si titull i poezisë. Kemi të bëjmë me një ndërdyzje të poetit për të mos e shprehur titullin ose për ta shprehur atë; për ta shprehur apo për ta fshehur të inkorporuar me tekstin poetik në variantin shqip e italisht. Kjo ka çuar në një variant të përzier e të rrallë: paraqitja e titujve në fund të librit vetëm në gjuhë të huaj shënon shmangie nga praktika krijuese e gjuhës burimore dhe *intecio auctoris* të pastër për gjuhën Tjetër të vendit të mbërritjes. Të jetë rrëfim i rrugëtimit poetik e fizik? Një ftesë a /epilog/Hapje leximi për receptuesin e Huaj krejt të ndryshëm nga poeti, që s'e ka provuar e njohur migrimin dhe tekstin poetik do ta perceptonte më shumë se të huaj, të çuditshëm, prandaj do ta lexonte *recto versus*, nga përmbajtja? Dhe, në fakt, ky *corpus poetico,* që përbëhet nga fragmente lirike, ku mbarimi i njërës funksionon si fillim i pasardhëses a nuk përvijojnë dhe a nuk perceptohet si një poemë migrimi me 150 projektime fragmentesh emocionale e stacione rrugëtimi fizik e filozofik që lidhen mes tyre, në strukturë zinxhirore ose ciklike, nga boshti tematik e stilistik? Besoj se po; ja ç'thonë ato: Këndoj trupin tim prezent; Gjuha e këtij vendi; Jemi këtu midis gurëve; Nuk mundemi të flasim; Ëndrra të shkreta; Ndiej se qiej të çuditshëm, britma, hije; Më jep hijen tënde; Nën lëkurën tënde digjen yje; Do të mbes unë; Gjithnjë e më vetëm; Ç'pres në dhomën e zbrazur dhe përse; Në skutën time erë dheu; Gurë brenda gurit; O e vogla njollëz e zezë; Na ndan shtrirja e lehtë; E tmerrshme është forma e heshtjes; Përkulem në zbrazëtirë; Krahët e dëshpërimit tim; Unë shpall verbërinë tënde; O ti që endesh midis të gjallëve e të vdekurve e të tjerë e të tjera. Ndërsa flet për krijimtarinë e tij, në këtë pikë Hajdari thotë: "Çdo përmbledhje imja është një poemë që rimerret në librin pasardhës dhe librat e mi nuk janë tjetër veçse një poemë epikë që vijon"[5].

Motivi i vetmisë dhe i mungesës që përjeton imigranti në dhé të huaj, tëhuajtësimi që shprehet si shkëputje e ndarje përfundimtare me të kaluarën, vendin e kohën dhe gëzim e frikë për Tjetrin dalin në vargjet që jo rastësisht përsëriten në dy poezi të ndryshme: *Në luginë……./ gjersa arrijnë/ në territore të zhveshur/ pa fëmijëri* (f.62). Dhe: *Gjithnjë e më vetëm/ në territore shterp/ pa fëmijëri* (f.68).

Udhëtimi mes dy botësh e dy imazhesh (shqiptare e italiane) është para së gjithash kalim mes dy ligjërimesh, amtare dhe italiane, si ndërkallje bjerrje/humbje, po aq sa fitimesh/rifitimesh.

Poezia e migracionit jeton përmes botëve gjuhësore-artistike-kulturore-historiko-nacionale, në një proces të vazhdueshëm që refuzon të kaluarën për të njohur e përthithur të huajën, po në këtë fazë të parë niveli i raporteve me kulturën e letërsinë e vendlindjes është më i fuqishëm se ai i kulturës pritëse. Ja si artikulohet poetikisht: Duan të më japin

[5] Andrea Gazzoni: *Cantare nel sisma dell' esilo*. - Në: *Poesia dell`esilio,* … f. 16

më zor një atdhe (f. 90). Jam e vërteta/ e një udhëtimi dhe e një linje hijeje/ ruajtur mbi tokën e gjallë e të mbyllur/ që don të më fsheh diçka/ Jetoj pezull/ pa i përkitur asnjë vendqëndrimi/ në udhëkryq të një ekuilibri (f. 86). Mëdyshës në zgjedhjen gjuhësore që identifikohet me *gurin*, subjekti lirik ngulmon në amën ligjërimore në artikulim metaligjërimor, përmes refuzimit të prerë të gjuhës së Huaj; *Gjuha e këtij vendi/ S'i shërben më askujt/ Udhëheq drurë e zogj/ në rrënim/ Në këtë anë të botës/ jetojmë me fjalë guri/e lavdi/* (f. 0).

Prof. M. Carlino gjen "jehona të stilemave të Ungaretit, që është poeti më i dashur, ndoshta, i traditës perëndimore për poetin"[6]. Fulvio Pezzarossa[7] shton dhe gjurmë poetike nga një autor tjetër i rëndësishëm i letërsisë italiane të shekullit XX, U. Saba Ndërkohë vargje, si: *krahët e dëshpërimit tim/ përplasen në muret e një bote të tmerrshme/heshtja që përsëritet në dimorën time/ më vret …,* flasin për ndikime bodleriane. Po dhe çelësa simbolikë e akustika e vargut, e ajo këngë pikëllimi zogjsh, në një jetë pezull, pasigurie, frike, ankthi, iluzioni, mjegullimi, çekuilibrimi, dëliri, muzgu, hijen e gjysmëhijen, zëra, jehona, agoninë, janë gjurmë të poetikës simboliste.

Silvia de Pava, burimet e shenjave hungaretiane i gjen te tradita letrare shqiptare dhe ajo italiane dhe e vlerëson si "lehtësi" në praktikën krijuese të poetit. Modeli hungaretian krijon mundësi të përmbledhë e të shprehë tërësi ndjenjash në pak fjalë, në vargje të shkurtra ku spikasin poetikisht fjalë të veçanta. "Me këtë model - shkruan De Pava - nuk duam të aludojmë për një "model të thjeshtë" sesa për mundësinë që ofron modeli për t'i dhënë shprehësi ndjesive në një gjuhë që nuk zotërohet ende plotësisht, përmes nënkuptimeve të fjalëve të veçanta, të cilat të izoluara e në formë lakuriqe bëhen më të fuqishme poetikisht."[8]

Shenjat e poetikës së Hungaretit e kanë burimin nga vitet e formimit poetik, me ndërmjetësinë e autorëve tanë: Mjeda, Koliqi e Camaj, si dhe nga leximet personale të rinisë shqiptare gjatë diktaturës, lexime të fshehta që përthithen, përjetohen e leënë gjurmë të brendshme pikërisht edhe pse janë të tilla.

Të pritshme do të ishin shenjat kronotopike tekstuale, te *Trup i pranishëm* por ato dalin rrallë e shumë rrallë, sa duket kemi krijimtari poetike atemporale. Të vetmen poezi në të cilën poeti jep informacione të sakta për kohën e vendin (periteksti *Cervara di Roma, 5 luglio 1997*) është poezia sa e trishtë është Roma/ pa ty e dashura ime …….. por hijet tona të fshikura/e të largëta në harrim/ mërguara e të huaja do të mbeten / mbi këtë Gur të Cervarës (f. 110), ku huajtësimi i imigrantit artikulohet në rrafsh fizik e emocional. Rrafshimi i shenjave shkëput subjektin me të kaluarën që përjetohet përmes kujtimit e ëndrrës. Në trajtë implicite, të papërcaktuar shprehet koha, viti e vendi në vargjet: Është e *gjashta pranverë*/ në këtë qytet të trishtë/ kam humbur Fjalën/ dhe qarjen/edhe pse banoj në Corso/ ballë kalimtarëve të lumtur/ *(Gëzim / hije qeni do të*

[6] M. Carlino, po aty, f.8
[7] F. Pezzarossa:- Në: *Poesia dell`esilio* …f.8
[8] Silvia Vajna de Pava: *La peligorga canta in italiano: la poesia di Gëzim Hajdari e i suoi apporti interculturali,*- vep. cit. f.190

mbetesh/ kudo që të shkosh)/ I vetëm mes mureve/jetoj vetminë time/dhe çmendurinë time/Ti *dhomë e zbrazur*/ më je bërë tempull/dhe unë një Zot që lundron/në zjarr. Trajta homonome e emrit të përveçëm dhe emrit të përgjithshëm ***g(G)ëzim*** edhe pse krijon iluzionin e ndryshimit të tonit ligjërimor, artikulohet e perceptohet si thirrje e Tjetrit/Vetes në komunikim dialogus hipotetik (mes kllapash) si mallkim e vetëmallkim në bazë modeli popullor e biblik. E qartëson këtë varianti italisht: Gëzim/gioia/ Ombra di cane rimarrai/ovunque tu vada!)

Marrëdhënia me vendin, që në tri krijime del dhe në përbërjen titullore (Roma, Albania, Tirana), transmetohet si vatër malli për fshatin e lindjes dhe të dashurën që mungon: (një erë e akullt fryn/ në kodrat e **Darsisë**/ ku enden dy sy si dy rrokje/ dalëngadalë do të kuptosh/ në netët ballkanike/ ditët në të cilat jemi dashur/ e harruar (f. 144); që rrezaton e këndohet në raport bipolar alá lasgushian për **Tiranën,** qyteti-krye i atdheut: Tirana, nënë dhe kuçedër, /je dashuria ime/dhe tirania ime; për të thelluar pikëllimin në ndeshje të brendshëm jete e vdekjeje në poetizimin e atdheut: **Shqipëria** Shqipëri**/**ç'pikëllim fati ynë/ …/vdesim çdo ditë te njëri-tjetri (f. 80). Zgjerohet gjeografia poetike kur poetizohet Ballkani (nënkuptueshëm **Kosova**) në vargjet: nesër, në agim, ndoshta do të bombardojnë/ mbi Ballkan/ nesër të tjerë të vdekur, qartësi dhe yje (f. 120) dhe individualizohet e zgjerohet përkatësia gjeografike si subjekt lirik: jam poeti më i trishtë i Ballkanit. Tejkalohet vendi e atdheu gjeografik në atdhe poetik e metafizik ballkanik, si fazë tranzitore drejt përkatësisë europiane e asaj globale që ligjërohet në vëllimin *Grykë e lumit tënd.*

Ligjërimi poetik antonimik (tmerruar nga *gëzimi dhe frika* (f. 128) kërkoj të ribashkoj e të ndaj (f. 126) lidhur fillin tënd që mban jetën dhe vdekjen/plakushja ime/je lumturia ime dhe tragjedia ime (f. 104) në fund të fundit kështu do të jet përreth meje/ dritë dhe hije (f. 134) shkoj e vij në shkretëtirën time (f. 148), dëshmojnë topos universal të poetikës së Hajdarit, lëvruar mjeshtërisht prej kryelirikut shqiptar L. Poradeci.* Loja me botën e përtejme, kalimi nga toka e të gjallëve në amshim e dëshira për të bashkëligjëraur me ta, si: O ti që endesh midis të gjallëve e të vdekurve (f. 136) më duket se nuk kam më asgjë për t'u thënë/ të gjallëve e jo të gjallëve (f. 134); Megjithatë do të kthehen për të ndarë/të gjallët nga të vdekurit/ (f. 38) përkime të tjera poetike, si: ngarkuar me kohë e dëlir/…/udhëhequr në buzë të honit /e harrimit (f. 150); iki pa frymë/ në *territore të huaj*, nëpër tempuj që në italisht tingëllon: fuggo senza sosta/*nelle terre straniere,* nie temple (f. 33), dëshmojnë për takime të forta me traditën e letërsisë sonë të kultivuar, nga Skiroi, Kuteli, Poradeci, Kadare etj.

Rast sinjifikativ të ligjërimit kalimtar te *Trup i pranishëm* përbën leksema *peligorga*, zog i vogël i vetmuar me pupla jeshile që jeton në lumenjtë dhe përrenjtë tanë, njësi

* Nëse topika universale i përbashkon poetët (edhe pse nuk kemi të dhëna që Lasgush Poradeci të ketë qenë ndër të preferuarit e Hajdarit) edhe pse nuk bëjmë fjalë për ndikime të ndërgjegjshme poetike, fare mirë mund të flasim për ndikime të vetëvetishme lasgushiane, posaçërisht të një poli të përbashkët ndjesish (frika, shkëputja, dhimbja), ngjyrash e tingujsh.

artistike që kalon nga shqipja në italisht pa asnjë modifikim: Mund të rikthehesh *peligorga*/ të matësh distancën tonë/distan**z**a jonë joshur nga shtjella mashtruese/Puoi ritornare *piligòrga*/ a misurare la nostra distanza/.ʔ.ʔ.ʔ.ʔ./attratta da vortici ingannevoli. Vërejmë këtu që nga teksti shqip në atë italisht janë rrudhur njësitë sintaksore; në variantin e huaj mungon togfjalëshi *distan**z**a jonë* (kemi të drejtë të hamendësojmë për një pakujdesi njerëzore, për mundësinë e gabimit gjatë shtypshkrimit ose gjatë procesit të botimit), po kështu si paraqiten vargjet, në gjuhën burimore theksojnë distancën, largësinë (lakimi në rasë emërore e kallëzore të emrit dhe përemër pronor distancën tonë-distan**z**a jonë), ndërsa në ligjërimin tjetër fuqizon vlerën semantike të burimit të distancës (shtjella mashtruese).

Edhe masa e vargut, struktura metrike e larmishme janë një tjetër dëshmi e krijimit poetik si kërkim identitar. Vargjet e lira 4-, 5-, 6-, 7-, 8-, 9-, 10-, 12-, 14-rrokëshe etj., si dhe struktura metrike kaq të larmishme sa nuk mund të klasifikohen, i përgjigjen konceptit të strukturës poetike fragmentare. Përpjekja për krijimin e koordinatave të reja identitare nuk arrijnë ta asimilojnë atë që aftësia krijuese ka trashëguar me gjuhën: spikat këtu afërsia me metrikën e këngëve popullore shqipe (7-, 8-, 10-rrokëshi) ku vargu harmonizohet përmes melodizmit e ritmit të brendshëm.

Pas 15 vitesh kërkime të ndërgjegjshme të një poetike të migrimit, vjen vepra e fundit e Hajdarit ***Delta del tuo fiume/Grykë e lumit tënd***.

Në dukje një udhëtim artistik ekzotik, ky test paraqet udhëtimin poetik të krijimit të një atdheu tjetër, jashtë kufijve kohorë e hapësinorë të poezisë tradicionale, i vetmi vend ku trupi i verbit të tij migrant mund të paqtohet. Autobiografizmi i fazës së parë, zbulimi i vetes dhe i Tjetrit plotësohet e shtresohet me rrokjen e një game komplekse raportesh dhe me vetëdijen krijuese e ideologjike, që artikulohet në ligjërim të dyfishtë e të shumëfishtë të fuqishëm, që kapërcen Veten e bëhet pjesë e Tjetrit, e të gjithëve.

Të udhëtosh për të qëndruar te të Tjerët, si Tjetri mes të Tjerëve, si udhëtar i lirë i botës, atdheu i të cilit është vendi ku mund të jetohet me dinjitet, përfaqëson formë kreole të ezilit. Poeti "pa atdhe" e "pa shtetësi" kalon urën e dëshpërimit, vetminë e ankthin për t'iu dhënë aventurës, duke marrë statusin e *metisit* kulturor; poeti braktis rolin e ndërmjetësit që luan te *Trup i pranishëm,* ai zgjedh të mos zgjedhë duke u shkrirë me Afrikën në *dhomën e zbrazët* të së cilës vallëzojnë shpirtrat e savanës që i çshenjtërojnë Verbin. Këtu nuk shtrohet më thjesht çështja e ndikimit dhe marrëdhënieve, por ajo e krijimit të një poetike kreole ndërkomunitare, që përballet me atë europiane, një katarsis dekolonizues që, për analogji, në rrafsh ideor do të nyjëtonte një Europë të "kolonizuar" nga popujt e Afrikës, një "revansh të bukur"[9] ligjërimor artistik që lidh e strukturon stacionet e shtegtimit të poemës për Afrikën.

[9] Tzvetan Todorov: *Konkuista e Amerikës*, *çështja e "tjetrit"*. - Tiranë, Pika pa sipërfaqe, 2015, f. 298

Ndryshe nga pesha e *Gurit* identitar në kërcitje të vazhdueshme gjatë përplasjes me Tjetrin, në Afrikë e përtej kufijve të saj përthithja thellohet në fitimin e identitetit të ri e në vetidentifikim, si shprehet subjekti lirik: humba emrin tim lindor/.../Nga dashuria për ty jam bërë Afrikë. Në reaksion konstant me Europën, *rospi e vjetër me huqe*, *Lamtumirë Europë e gjakut të derdhur në emër të kufijve vrastarë*/, shtegtimi hajdarian vijon si përvojë zbulimi e migrimi e më fort si ndërgjegje "pushtimi" ligjërimesh poetike: *Do t'i vë zjarrin gjuhëve të vjetra gjithë ndryshk/do të xhvas nga shpina identitare nënshtetësi dhe atdhera-njerkë.* Tek Afrika zgjerohet gjithnjë e më shumë pasuria kulturore e poetike dhe zëri i vetmuar lirik socializohet e solidarizohet në vetëdije artistike, që zbulon e bashkon botët përmes përvojave ekzistenciale nga më të ndryshmet e një ligjërim kompleks të përpunuar, duke i hapur horizontin e pritjes lexuesit global. Zgjerohet gjeografia e udhëtimit, me topose afrikane me të kaluar koloniale, si: me Kongon, Saharanë, Baharin, Sudanin, Kenian, Marokun, Malin, Etiopinë etj., për t'u ndalur *Në kufi me Kinën, ballë rojve të kuq/nën hijen e Murit të Madh,* në ligjërim polifonik e ideologjik, të revoltuar, që denoncon padrejtësitë në botë.

Thellohet rrafshi vertikal, nga paganizmi në kohët moderne, në shtegtim sinkretik kulturor e ligjërimor, nga një atdhe tek tjetri, në kërkim të gjuhës zanafillore që krijohet nga shkrirja e "Gjuhëve në gjuhë universiale-primordiale, - siç shkruan Giorgio Linguaglossa, - e vetmja që mund të mirëpresë këngën e shtegtimit"[10]. Poeti preferon jo thjesht të ndërfusë gjuhë të "re" po t'i kombinojë e ndërkallë ato si perspektivë të përbashkët artistike e sociologjike. Ja procesi i kreolizimit: *Si baticë e Zanzibarit përparonte e zeza jote zezake,/përmbyste vargjet e mia të huaj,/në dunat e dëshirës tënde, si vera e Shirazit.* Pasurohet ligjërimi duke miksuar idioma e forma gjuhësore të vendeve të ndryshme, nga antikiteti e politeizmi (Uliksi, Medea, Circia, Penelopa, Jutbina, Bjeshkët e Nemuna, Zana, Orë e Xhind) me mitin, legjendën e baladën (Përtej Urës së Qabesë) me poetë e filozofë të Lindjes (Saadi e Hafiz, Krishan Çandar, Rajnesh Osho, Li Bo, Du Fo) në rrëfimin e riteve fetare e njerëzore sa të krijohet përshtypja se po lexon shkrime për Afrikën: *Përshkojmë territore shterpë me gjysma hëne/ për ta braktisur Jemenin herët në agim/ para thirrjes të muezinit për falje.*[*] konfigurohet e ndërtohet kështu identiteti letrar e kulturor përmes një ballafaqimi të vijueshëm me cilësitë e fituara të popullit tjetër me gjithë ndikimet e pësuara në kohë, që trupëzohen si kushte ekzistenciale jete e poetizohen: *Nga balta jote ripërtërihet fisi njerëzor.*

I shkrirë me Afrikën e verbin e saj, poeti gjen te femra objektin fizik e artistik të parrokur e të pakënduar më parë. Zbulues e "pushtues" këndelljesh hiresh femërore, që gjenden shpesh në vëllimin poetik, subjekti kulmon në poemat *Grykë e lumit tënd* e *Rojë e*

[10] G. Linguaglossa: *Prefazione*,- Në: Gëzim Hajdari: *Delta del tuo fiume,*-Roma, 2015, f.7

[*] Ose: *Në zemër të natës, tribuja përgatitet mes këngëve dhe valleve, nesër do të përurohet festa e virgjëreshave* Ose: *Kam kërcyer me barinjtë mazai në kraterin e Ngorongorës/ vullkan dhe Olimpi i perëndive zezake;* dhe më poshtë: *Jam hedhur përpjetë sipas ritit të tribusë së lashtë…*

verës sime, që përfaqësojnë raportin seksual femër-mashkull në një shkrirje sensuale dhe erotike kreative: *Jam duna jote/ikja jote/ kur ti vdes tek unë, unë ringjallem tek ty.*

Nëse migrimi i ligjërimit shqip te ligjërimi në gjuhën italiane, në një raport ngërthyes me *Gurin* (verbin), i ngjashëm me shtegtimin nga periferia në qendër, përfaqëson fazën tranzitore të kreolizimit (*Trup i pranishëm*), shkartisja e ligjërimeve me tregues të gjuhës enciklopedike ndërton poetikën kreole, e kjo i jep liri Hajdarit të rimarrë procesin e krijimit poetik, në thelbin e vet më të qenësishëm, si një marrëdhënie origjinare të njeriut (fshatarit) me tokën. *Fshatar i poezisë* strukturohet në një ligjërim imperativ e programor që "rrëfen" e modelon manifestin jetësor, artistik e ideologjik të autorit si një perspektivë poetike vetjake e sociale qartësisht të angazhuar. Poezia i bindet misionit, sepse për poetin, kreolizimi nuk mund të jetë vetëm ligjërim poetik panafrikan po mirëfilltësisht përkatësi e ideuar ekzistence:

të jesh fshatar i poezisë do të thotë të bisedosh me Evropën
si ballkanas,
[…] të jesh fshatar i poezisë do të thotë të krijosh çdo ditë një atdhe
të ri në lëkurën tënde me majën e thikës e të vdesësh
në një tjetër vend
[..] të jesh fshatar i poezisë do të thotë të jetosh tek të tjerët
të jesh fshatar i poezisë do të thotë shpëtim
të jesh fshatar i poezisë do të thotë të jesh një i huaj në kalim.

A. Gnisci e sheh letërsinë e migracionit si një fenomen raportesh mes botëve të botës, ku shkrimtarët migrantë nuk i përkasin një, dy ose më shumë kombeve, i përkasin një *rrjeti raportesh* të formuar nga valët e migrimit transbotëror, pra një forme të re kulture, *interkulturore*, asaj të *kreolizimit planetar.*[11] Fenomenet lokale e globale të takimit të kulturave përmes migrimit, shkrimtari i Karaibeve E. Glisant, i vlerëson vetëm në gjuhën kombëtare me të cilën poeti vendos të ndërtojë "shtëpinë e tij të dyfishtë" në sensin e një jetë të re në shtëpi, pas *shizmës* së migrimit, jetë e re në të cilën historia dhe arti transmetohen sot dhe në të ardhmen përmes një gjuhe të re, *metise,* si e quan ai.

Sheshet popullore "bankarelat", "pazaret" bëhen hapësira e përsosur e evokimit të gjuhëve të përziera, të gjuhëve metise që bartin kulturën origjinare dhe atë të kolonizatorit: "midis zhurmave dhe zërave në frëngjishte e në bambàra të peshkatarëve të lumit Nixher".

Pikërisht aty, poeti fekondon krijimin e tij të një "Burri/(Njeriu) ezilant" me tharmin e forcës konstruktive të ezilit vetë, në kushtet e idealit të përbashkët politiko-kulturor për Europën.

Zëdhënës i dukurisë së migrimit, Hajdari mbwrrin tw artikulojw funksionin e angazhuar të tekstit të tij poetik: është e rëndësishme që "kombi" europian të dijë të jetë një "botë reale" ku të bashkëjetojnë të gjithë. Kemi të bëjmë me një tipologji të veçantë

[11] A. Gnisci: *Creolizzare l'Europa. Litteratura e migrazione*,- Roma, 2003, f. 9

në raport me Tjetrin, të kundërt me atë të fazës kalimtare: nëse do të mund ta quanim me "asimilim" të pakushtëzuar të përqafimit të vlerave të Tjetrit, barazimi i Tjetrit me Veten që shkon në vetidentifikimi,[12] duke i imponuar imazhin e vetes. Një variant i ri i dashurisë për Tjetrin, që është i ngjashëm me Veten, një dashuri rrezatuese ku secili ka vlerat e veta e diversiteti gjen *unicucus*-in e vet të përbashkët.

Literaturë

Armando Gnisci: *Creolizzare l'Europa.*- Roma, Meltemi, 2003
Armand Gnisci: *La letteratura italiana della migrazione*.- Roma, Lilith, 1998
Michel Foucault: *Pushteti dhe dija* **-**katër sprova**,-** Tiranë, ISP & Dita, 2000
Edward Said: *Orientalizmi: Imagjinimi evropian i Orientit*. Dy lindje dhe Dy Perëndime, Tiranë, 2009
Poesia dell'esilio - saggi su Gëzim Hajdari (a cura di Andrea Gazzoni),**-** Itali, 2010
Scritture migrant (rivista di scambi intercultural),- Itali, 2007/1
Tzvetan Todorov: *Konkuista e Amerikës: çështja e "Tjetrit",*- Tiranë, Pika pa sipërfaqe, 2015

Lili SULA

LITERATURE OF IMMIGRATION AS A CREOLISM FORM, G. HAJDARI CASE

Abstract

The immigration of Albanians in the '90 was followed by various literary works (G. Hajdari, O. Vorpsi, R. Kubati, A. Hanxhari etj.). Immigration literature is a continuation of linguistic, historic and national worlds; in the first stage this literature is dominated by autobiographic works: different phases of "The Other's" travel are narrated. Often, the immigrant writers on a twofold ratio: refusing the source discourse culture, and susceptible and assimilative towards "The Other", pass into more elaborate poetic forms; they are increasingly and naturally using the "foreign" language. The theme of "leaving" is displaced from the motif-personal discourse into poetic discourse. From one volume to the other, G. Hajdari builds up, alongside with the reader, a continuous exchange of structures and formations, from the social and personal level to that of linguistic and poetic one. (*Corpopresente*, *Erbamara, Delta del tuofiume*); the "Foreign" becomes his "Own"; a discourse poetic space is created and

[12] Todorov: po aty, f. 229

obtained as an artistic escape and freedom, as a new culture form, the *intercultural one*, that of *creolism*.

Viola ISUFAJ

TAKIMI ME MUZIKËN NË POEZINË E ZORBËS

Imazhet kulturore të *tjetrit* janë një fenomen shumëpërmasor në poezinë e Zef Zorbës. Ato zbulojnë shumë anë të mënyrës së të menduarit dhe të psikologjisë së këtij poeti - e mund të shihen në akse të:

1. marrëdhënieve intertekstore (thirrja e poetëve të huaj në tekstet e tij)[1]
2. përkthimeve (ende të pabotuara) ku marrëdhënia me tjetrin, ndërlidhet me *Imagjologjinë*. Problematika e ndërmjetësimit letrar, e thekson përkthimin si një ndërmjetësim ndërmjet letërsive të shkruara në gjuhë të ndryshme.
3. qëndrimit të tij universal, përbotësues, kundrejt letërsisë dhe kundrejt marrëdhënieve shpirtërore mes njerëzve të kombësive të ndryshme - i cili del përmes personazheve që veprojnë si "agjentë të kozmopolitizmit" (si tek *Raki e lirika*).
4. marrëdhënieve ndërlëndore, të një fenomeni letrar me një fenomen joletrar: pra, inkorporimi i sferave tjera të shprehjes njerëzore (si piktura e muzika) ku do të përqëndrohemi posaçërisht.

Në pasthënien e vëllimit të tij poetik *Buzë të ngrira në gaz*, autori ndalet edhe tek relacionet e veprës së tij me muzikën:

Për një unjisim muzikal është kërkuar jo vetëm ritmi i qenësishëm në fjalët e në vargje, po edhe tentativa e riprodhimit të formave muzikore: fugat, fugatot, sonata me tempot, kadencat etj.

Tituj të poezive së Zorbës në vëllimin *Buzë të ngrira në gaz* shpalosen pikërisht në këtë mënyrë. Pjesët e *Fugave të fundit* -cikli i katërt- do të emërtohen sipas tempit: *Allegro*, *Andante Mosso*, *Lento*, *Largo* dhe *Alegro Furioso*.

Sakaq, edhe cikli i pestë që është poema *Mbresat e rrugëve*, konceptohet me këto pjesë: *Introduksion*, *Tema e fagotit*, *Tema e Ksilofon -kumbonëve*, *Tema e Instrumentave me perkusion*, *Tema e Violës*, *Parte concertante*, *Kadenca e Ksilofon –kumbonëve*, *Kadenca e fagotit*, *Kadenca e Violës*, *Kadenca e Instrumentave me perkusion*, *Ripressa*, *Stretta Finale*.

Madje edhe tek cikli i fundit *Në zgrip*, ndiejmë takimin me muzikën; sidomos ai është i dukshëm në poezinë *Një gozhdë*, me ritëm *rock*, bazuar mbi aliteracionet vështrimore *thik*, *thellë*, *thatë*, - siç shpjegon autori, - e, së fundmi, pjesa *Natën kur bie shi*, - e konceptuar alla Ravel.

[1] E kam trajtuar tek "Katër pamje të identitetit", *Materialet e punimeve të Seminarit XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 19-30.08.2013

Tituj të tillë janë domethënës por natyra e domethënies së tyre lipset të tregohet.

Qyshse Lesingu na paralajmëroi për rreziqet e analogjive të paarsyeshme midis arteve, kritikët kanë qenë të prirur të mendojnë se tërë këto analogji janë të dyshimta.

Është plotësisht e vërtetë se pjesa dërrmuese e analogjive sipërfaqësore janë të çoroditura apo spekulative. Shumica e këtyre qasjeve konsiston në një përkthim të termave nga një art në një tjetër. Dhe të përshkruash një art me terma të artit tjetër është një trill retorik pa ndonjë rëndësi të veçantë. [2]

Mirëpo në këtë studim nuk do jetë fjala për një përkthim të tllë, as për muzikalitetin a harmoninë në vetvete, e cila mund të studiohet në çdo krijim artistik. Bëhet fjalë për një poezi tek e cila M*uzika* është cilësi fundamentale. Bëhet fjalë për një rast ku mund të analizohet një ndikim thellësor nga arti i muzikës. Analogjitë këtu nuk janë të sipërfaqshme, po substanciale. Qysh në krye të herës mund të hetohen qartë *ide muzikore*-që janë aty për të formatuar një art-i cili aspiron kushtet e muzikës.

Së dyti, ndërlikueshmëria lidhet me tipin e muzikës së Zorbës që është jo imitim i drejtpërdrejtë por përshkrim poetik e simbolik i fenomenit. Zorba nuk ka për qëllim të përshkruajë një skenë apo një ngjarje të veçantë vërtet, por me anë të rrethanave të jashtme të komunikojë emocionet që i janë provokuar pikërisht nga këto rrethana. Kjo është, thënë ndryshe, paraqitja e fenomeneve të reflektuara në mendjen e poetit.

Në vëllimin poetik *Buzë të ngrira në gaz* dallon një sistem muzikor i ndërtuar nga:

Ide muzikore; Struktura muzikore; Teknika në lojë instrumentesh;Tinguj instrumentale

- Sa u takon strukturave muzikore: Tek Zorba vihet re një prirje për të lidhur pjesët e ndryshme të veprës, me anë të një materiali të përbashkët muzikor, pra me anë të një teme muzikore që paraqitet në të gjitha kohët duke dhënë përshtypjen e unitetit mes tyre. Psh *Allegro*, *Adante Mosso*, *Lento*, *Largo* dhe *Alegro Furioso* lidhen midis tyre me anë të konceptit të *fugës*, (në ciklin poetik me titullin përbashkues *Fugat e Fundit).*

Këtë cikël, Zorba, e nis me një me nëntitullin *Kthehen kujtime*. Si një prelud, pjesa hyrëse i përngjet një loje që përgatit pjesën që do të ekzekutohet dhe rikthimet ngjajnë me përsëritjet e sekuencave muzikore.

- Sa u takon teknikave në lojë instrumentesh dhe tingujve instrumentalë te Zorba, mund të tregohet se si tek psh *Tema e Ksilofon-Kumbonëve*, tonaliteti, sekuencat e zanoreve, frekuencat e përcaktuara të kombinimeve të bashkëtingëlloreve, çlirojnë tinguj si të dalë prej drurit. Janë sidomos asonancat në këtë poezi ato që lëshojnë tingëllima të tërhequra e të shtrira, *u*-të dhe *o*-të e zgjatura, që duket sikur vijnë nga larg, përhapen me jehonë.

[2] Fraye, *Collected Works of Northrop Frye*,Toronto Press, f. 237

Ndërsa tek *Tema e fagotit*, mbizotërojnë *g*-të (*këngë*, *gërhet*, *gërgasin* etj), frazat janë tipikisht të shkurtra; zërat e ulët si notat e ulëta, në rrafshin asociativ ndjellin imazhin e tingujve të fagotit.

Dhe prapëseprapë nuk mund ta thuhet se ky është imitimi apo ekuivalenti në poezi i temës së fagotit. Besoj se do të gaboheshim.

Zorba, me mprehtësi zgjon ritme të brendshme dhe i funksionalizon ato. Ai tejçon në poezi temperamentin dhe përshtypjen; ai rindërton pjesët e tij prej mbresave e jo prej koncepteve rigoroze -dhe muzika humbet formën e saj klasike.

Pa folur për ritmin a eufoninë, le të flasim për idetë e tij muzikore, funksionalizimin e brendshëm tek *Allegro*, *Allegro Furioso* dhe *Lento*.

Cikli apo "libri" *Fugat e fundit* hapet me *Allegro*.

Allegro, -që, si formë muzikore është krijuar që të performohet shpejt, në mënyrë të shkathët, në poezi vjen levend, i ndezur, energjik për nga substanca e fjalëve të zgjedhura dhe imazhi akustik i tyre (*ernat, përtërimjen, çatrafillojnë*). Përfytyrimi i lëvizjes së rrymave të ajrit në drejtime të ndryshme të forta, të holla a të tërbuara, është diç nxitëse, aktive, ai shenjon pështjellim dhe çrregullim të bukur. Përdorimi i fjalëve *çatrafilloj* dhe *përtërimje* paralajmërojnë gjallërimin, lulëzimin, rishfaqjen ashtu siç ka qenë njëherë.

Përtërimjen ernat gjithnjë
çatrafillojnë

Por, kuptojmë, gjithmonë e më shumë, se si modernist genuin, Zorba, ruan kështu diçka nga koncepti "allegro", tempin e shpejtë e të gjallë - dhe kjo imanencë kalon nëpër një shqiptim të lartë poetik, duke u veshur kësaj rruge me elemente të tjera në varësi të konditave të veçanta, gjendjeve shqiptërore, përjetimeve.

Porse asnjëherë *Allegro* e Zorbës nuk është vërtet thelbi i formës muzikore-emrin e së cilës mban-, por dëshirimi, ravgimi, pritja e mrekullisë.

Në muzikë, jo vetëm pjesët e gëzueshme jepen me *allegro*, ose kanë temp *allegro*, por ka pjesë të trishtueshme po me këtë temp (si *Allegro con brio* e Bethovenit). Kështu, ndodh që pjesa e dytë e kësaj poezie të Zorbës nis e na paralajmëron trishtimin. Në strofë shfaqen duke pluskuar fjalë qe zymtojnë si *mavi, moçal, re, kufizuese*; aq më tepër, valencat që krijojnë këto fjalë me njëra tjetrën në frazë, fuqizojnë edhe më shumë potencialet e tyre zymtuese në lidhjet sintagmatike *ngjyrën mavi të moçalit*; *re kufizuese*-kurse folja *zbres*-njofton uljen, lëvizjen më poshtë, tatëpjetën, të themi, kadencën.

Mbi ngjyrën mavi të moçalit
Re kufizuese zbresin.

Ndiejmë një ironi papritmas; nga ironia e autoironia, gati rrëshqitet pastaj në sarkazmën e sinjalizuar qysh më parë nga kadenca.

Dhe zhaurimë e pafund
Larvave të sapolindura
Vetëm një gjallëri të drojtur u lejon

Duket sikur zbërthehet fjala e parapërmendur *kufizim* në një situatë konkrete paradoksale. Është çuditërisht zhurma e madhe apo rrapama që s'ka fillim e as mbarim, ajo që kufizon, *që gjallëri të ndrojtur u lejon*, larvave. Është e pakonceptueshme të kufizohet lëvizja e shpejtë e me gjallëri e larvave, kur dihet se është pikërisht lëvrima e pandërprerë ajo që i cilëson kur trumbat e tyre dridhen lehtë e shpejt; dhe pellgu i vogël vlon, gëlon prej lëvizjes së tyre.

Vargjet vijojnë:

Hare
Për (po qe se shfaqet) një mrekulli
Vezullimi.

Ajo çka thotë Zorba në pasthënien e tij: *Një lloj pranimi "i mjerimit" afër formulës së Shën Françeskut, si rrugë për ushqimin e "shpresës*"-besojmë se është filozofia e kësaj poezie. Dëshirimi për mrekullinë e vezullimit është aty. Allegroja është përfytyrimi, dëshirimi, ushqimi i shpresës, ëndërritja, dhe jo gjendja e tanishme.

Koncepti *allegro* na shfaqet në një temp më të stuhishëm që në fund njeh një bjerrje të beftë në poezinë tjetër *Allegro furioso*.

Allegro furioso

....e shpesh ka pa liqenin të shpupurishur:
kundër reve të mbarsura
me shkreptima të dhunshme,
me kordha shkumësh të pareshtura,
me gjithë sa kishte frymë,
sulmonte, e gërmushej;

por shi vazhdoi me ra……

Allegro furioso, me efekte zanore shumë ekspresive, me përshkallëzim shumë të fuqishëm në emra, folje e mbiemra- kundërvë dy ide kryesore a grupazhe imazhesh- në përputhje a në ngjashmëri me dy ide muzikore; ku ideja e parë është aktive,

energjike, me rrahje të theksuara, me klimaks të fortë në fund dhe mishëron forcën që ecën gjithnjë përpara dhe që duket se nuk sprapset kurrë dhe pjesa e dytë, ose ideja e dytë, paraqitet me tipare më të buta dhe nota lirike - përbërë nga një varg i vetëm, duke dhënë pjesës një karakter të theksuar dramatik.

Vetëm një poet i tillë, i interesuar kaq fort në fushë të muzikës mund të kombinonte ritmin pengues e të rrëmbyer (të erërave) në këtë përleshje forcash me motivin e trishtuar e të shtruar, kontrapunktual: *por shi vazhdoi me ra…*

Poezia tjetër, *Lento*, përkundrazi, është përshtatur për gjendje të rënda tëhuajësuese, angsioze, plot vegimeve të shpirtit të njeriut.

Virtualitetet e Zorbës shpërfaqen sidomos në përpjekjet për t'u dhënë vijimësi lëvizjeve të ngadalta-të cilat janë më të vështira dhe shqetësuese se lëvizjet e shpejta.

Pjesa *Lento* duke qenë një formë ndjesore që evokon ndjeshmërinë e një gjendjeje të amullt e të trishtë plot me tension emocional, kërkon kohëzgjatje më të madhe të tingullimit; nyjëtimi artistik ka lidhje me një mendim, disi të zvargur, me emocione të përmbajtura dhe mbytëse. Është një modelim i ndryshëm i tingujve në varësi të asaj çka ato shenjojnë. E, në këtë model tingullor përsëritja e zanoreve apo e bashkëtingëlloreve me cilësi të veçanta, konfiguracionet e papërsëritshme të lëvizjeve të ngadalta apo të gjendjeve të pezullta janë vendimtare.

Njësitë leksikore që pluskojnë aty si *amulli, mjegull, qull, lëbyrje-* evokojnë moslëvizjen, ngecjen në vend. Bërthamat semantike dhe imazhet akustike pengojnë "rrëshqitjen" e shpejtë të verbit, e ngadalësojë, e bllokojnë atë. Këto gjendje dalin nga kapaciteti shënjues i fjalëve, veçanërisht nga cilësitë e veçanta të bashkëtingëllores *ll.*

Bllokimin, pezullimin e krijojnë dhe heqjet e gjymtyrëve a të fjalëve në fjali, padyshim edhe heqjet e referencave të ndryshme (kohore, hapësinorë a sociale).

Poezia në fjalë është një sistem elipsimi i ndërlikuar. Tipi i ritmit të frymëmarrjes është i ngadaltë. Subjekti lirik bëhet gati për asfiksi.

Rrugë e përmbytur në mjegull, ngushtime
Rrathësh, kjo amulli e hirtë ku shuhen
Hingëllime kuajsh të stërvinuar harrese.
(Oh, kot se i përsëris me mend poetët!
Kurdoherë e më fort ushtojnë fjalët
Që, herët atë mëngjes, të cunguara
Si lamsh iu lidhen gruas..në … fyt kur tha:
"O burrë, nuk ke çka bën, nuk ke…na vdiq…

E vështrova –atëherë - majat e pemëve:
avullonin në qullin e çative
me vorbuj vese.
Stinës i paskëshin mbaruar ditët

S'kam më nevojë me pa. Tash përmbi mjegull
e di se plyma shpendësh të uritur
sulen drejt bregut moçalor të liqenit….
Por i kthen veri mbrapa;sikur dhe mua
Shortin ma dredh e që s'më shqitet më dot:

Ngushtimet e rrathëve shenjojnë angështinë, ndaljen e kohës në vend, amputim shpirti: një vdekje, me gjasë i një prej fëmijëve të tij.

Është rasti ku mund të thuhet me bindje se duke ndier melodinë, arrijmë të ndiejmë në mënyrë më të plotë tekstin e poezisë.

Në poezitë e tij, ne nuk do të shohim ndonjëherë përshkrime të qashtra; e ashtuquajtura qartësi e strukturës dhe e temës i është nënshtruar efekteve harmonike, të cilat në mënyrë karakteristike përdorin thuajse tërë gamën e larmisë së toneve sidomos në përdorimin e orkestrës moderne.

Si ndodh tek pjesa për koncert *Parte concertante* -cilësuar "muzikalisht absurd".

Ashtu si muzika, poezia e tij nuk është një sekuencë harmonish, por një sekuencë plot disakorde që përfundojnë në harmoni.Thënia e Brownings: *Pse mësyjnë disakordacnat, përveçse për hir të harmonisë?*-duket se i shkon për shtat shqetësimit të vazhdueshëm, dhe kërkimit të një qendre të përfytyruar tonale te *Parte concertante*.

Parte concertante, e Zorbës, i ngjan si një muzike që është jashtëzakonisht e vështirë për të luajtur, një muzike që paraqet për instrumentistët sfida të avancuara teknike dhe artistike.

Si poet modern që është, Zorba i zhduk konturet kryesore të temës, të cilat rezultojnë të jenë një iluzion, ose një hije, një lojë impresionesh. Me këtë konceptim lidhet fakti se poezitë e tij me tema muzikore nuk e kanë një fabul- ("një poemë simfonike pa një subjekt, ku i gjithë interesi do të jetë në ritmin"-a nuk ishin ky projekti artistik i *Orkestrale*-s së Ravel-it, *Bolero*?), Papërputhjet, do të guxonim t'i quanim *Harmonike*, të orkestrës së Zorbës janë në frymën e asaj çka Raveli tha: se violina dhe piano janë "në thelb instrumente të papajtueshme", dhe sonata e tij tregon papajtueshmërinë e tyre. Pjesët e Ravelit kanë të bëjnë me vështirësitë e balancimit të pianos me perkusion me tingujt e qëndrueshëm të violinës dhe violonçelit.

Në artin e Zorbës tek *Parte concertante* ndihemi parehatshëm derisa vendoset toni i fundit i cili nuk mund të mos na ndërmendë vërejtjen e Miltonit për muzikën kontrapunktuale të *Allegros*: *të shpleksësh gjithë zinxhirët që lidhin/shpirtin e fshehur të harmonisë*".

Në pjesën tjetër *Natën kur bie shi*, Zorba eksperimenton me formën muzikore; përsëritja arrin të jetë po aq e rëndësishme sa zhvillimi. Ky inspirim dhe konceptim artistik i përngjet në mënyrë të veçantë eksperimentimit të Ravelit. Ravelit i pëlqente të eksperimentonte me formën muzikore, si në veprën e tij më të njohur, *Bolero*, në të cilën përsëritja zë vendin e zhvillimit.

Disi ngjashëm dhe me sonata të hershme ku zakonisht përsëritja zakonisht bëhej duke paraqitur me saktësi muzikën e ekspozicionit (paraqitjes) edhe Zorba tek *Natën kur bie shi*, paraqet materialin "muzikor" një pjesë introduktive, hyrje, që vendoset para zhvillimit të saj dhe një pjesë mbyllëse, që i shtohet fundit. Introduksioni tregon se ekspozicioni akoma nuk ka filluar. Introduksioni do të kthehet, megjithatë, disa herë në formën e përseritjes dhe do të bëhet njësh me ekspozicionin. Përsëritja (e temës muzikore) është rikthim në idenë e parë dhe njëkohësisht, zhvillim i saj.

Kështu, *Natën, kur bie shi me rrëshekë* - që autori e paraqet në fillim të poezisë, nis ta përsërisë e ta zhvillojë atë në mënyrë dramatike, por ai këtë përsëritje e bën gjithnjë e më lirshëm, gjithnjë e më natyrshëm; ndihet se ekziston një skema por skema nuk e kontrollon vërtet poezinë e tij dhe ai, ndonëse i qëndron një rregulli shumë të brendshëm, nuk ka kujdesin pedant t'i rrijë krejt besnik atij. Kjo poezi është dramatike po sidomos psikologjike dhe ajo nuk mund të kufizohet e të adaptohet me kallëpe të dhëna. Poezia do të vijojë me përsëritje të pjeshme të dyvargëshit për t'ia rikujtuar atë marrësve dhe gjatë zhvillimit të njëjtin dyvargësh do ta bëjë të tingëllojë me tonalitete të tjera të papërdorura deri në atë çast.

Muzika krijon përshtypjen e stuhisë në jo pak fragmente tek *Natën kur bie shi*, me të gjitha efektet e njohura, si dhe të qetësisë që vjen pasi ajo shuhet.

Tek, *Natën kur bie shi* e kemi një eksperiment që merr trajtën e një lloj xhazi të sinkopuar - dhe sinkopimi është një shenjë e pagabueshme e poezisë muzikore.

Përdorimi i rëndë i poliritmeve dhe sinkopës, lëkundjet dhe shtrirjet e notave si dhe të ashtuquajturat notat blu, janë asosacione e përafrojnë *Natën kur bie shi* edhe me disa aspekte të zhazit. Notat blu janë më të ulëta nga ç'mund të priten. (Ulja në terma muzikorë do të ishte gjysmë ose çerektoni në instrumentat muzikorë (me tastierë). Një lloj rrëshqitje e ngadaltë dhe e ëmbël, kryesisht përposhtë e disa tingujve. Tingujt e poezisë së Zorbës *Natën kur bie shi*, të butë e të lëmuar si dhe mjaft të ëmbël do të korrespondonin në imagjinatën tonë me tingujt e pianos dhe të saksofonit. Natyra e këtyre tingujve dhe ritmeve, dukshëm të patrazuar, të qetë e më të lëmuar se të tjerët si dhe mënyra si ndërfuten në linja melodike të gjata dhe lineare, na bashkëshoqëron në mendje amplifikimin e tingujve të një saksofoni në muzikën xhaz derisa vjen mbyllja: një lloj shkrirje dhe shuarje e ëmbël e të gjithë tingujve-me sa duket kapitja e gjumit që është ndjellë.

Natën,
Kur bie shi me rrëshekë
e n'errësirë
radioja transmeton
-ritmuar me shkrepëtira-
mazurkat e Shopenit

…
mendime yjesh përçape,
botën e ndritur me flakë,
që akujt e kobit, shtijakë
t'mos e shporojnë.
Rëndomët një gazmend e vokë,
në sfera përmbi sfera
e flakëron të lehtë,
në ëndrrën që nis të bëhët jetë.....
natën,
kur bie shi me rrëshekë.
…
Natën
kur bie shi me rrëshekë
në "allegrot" e pafund
që këso netësh
burojnë e kullojnë
shkëndijshëm
-ngjyrime që përfîtohen
përtej gamës optike-
kur mjaltë e gjumit përkëdhelë,
kur duar të buta të kapitjes-
qafën me afsh të rrokin,
…….
Natën….
kur bie shi me rrëshekë…
kur bie shi…kur bie…kur…

…

Nëse përpiqemi t'u japim përgjigje pyetjeve që i shtron Letërsia e Krahasuar për çdo marrëdhënie binare se: në çfarë shkalle ky shkrimtar ka qenë i prirë ndaj këtij ndikimi të jashtëm nga një sferë tjetër e njohjes njerëzore- (këtu: muzika), si krijoi kontakte me të dhe çka arriti, çka sublimoi nga gjithë këto përjetime, do të dilnim në këto përfundime:

- Afria me muzikën dhe me arte të tjera është gjenetike; Zorba rrjedh nga një familje artistësh, emrat e të cilave janë kryeshenjë në kulturën shqiptare. Ishte nip i Kolë Idromenos, I cili pati influencë të madhe në njohuritë dhe afinitetin e Zorbës për artet pamore. Me muzikën e pati në lidhje genuine dhe përtej lidhjes genuine me muzikën, si mik i ngushtë me Preng Jakovën, mësoi prej tij koncepte e teknika muzore për t'i kulluar ato në artin e tij.

Duket sikur ky artist, Zorba, ka studiuar imtësisht aftësinë e çdo instrumenti orkestral për të përcaktuar potencialin e secilit, për t'u dhënë pastaj ngjyrave individualitet dhe timbrave (të posaçëm) një përdorim maksimal.

Duket se ai është, poeti që më së miri e di peshën e një note tromboni, harmoninë e një violonçeli, kombinimet e intrumenteve me perkusjon apo tam-tam-et dhe kumbimet në marrëdhëniet e një grupi orkestral. Por dukuritë muzikore që mbarten nëpërmjet kontakteve nga njëri art te tjetri, gjatë këtij procesi, pësojnë ndryshime.

Përmbi të gjitha njohuritë, Zorba, më shumë i vetëdijshëm se i pavetëdijshëm, derdh derdh në poezinë e tij, veç formimit të veçantë, dhe shijen e tij dhe ndjeshmërinë dhe sensualitetin, e këtu verbi i tij melodioz është si në përputhje të plotë me muzikën e brendshme që ekziston në zemër të universit. Ai ka kapur me intuitë lidhjet e fshehta që ekzistojnë në relacione të thella midis sendeve. Pra, çka është më e rëndësishme: ai ka ndier një rend të tërë të nënkuptuar muzikor që ekziston dhe komunikon prej brendësisë së thelbeve të fenomeneve të kësaj bote dhe të të gjitha botëve.

E në këtë shkrirje ku vështirë se mund të veçohet melosi nga lexis-i, mund të thuhet me plot bindje se ideja muzikore ka lindur megjithatë, njëkohësisht me poezinë e tij. Për këtë, poezia e Zorbës u pa thjesht jo si një sistem tingujsh i studiuar, por si shkrirje parimesh që ndërton një sistem që kërkon dialog ndërmjet sferave të krijimtarisë njerëzore.

Se me gjithë dijet e tij muzikore dhe pasionin për këtë art, më shumë se nga teknikat e muzikës dhe analogjitë, ka mësuar nga vetë teknikat e artit të tij.

Ndonëse nuk përdori struktura dhe tema klasike dhe ndonëse Zorba është një poet thellësisht modern, pastëria e pabesueshme në përdorimin e teknikave për të realizuar virtuozitetet e tij poetike, e bën atë një klasik modern.

Viola ISUFAJ

MUSICAL RELATIONS IN THE POETRY OF ZEF ZORBA

Abstract

The other's cultural images are a phenomenon in the poetry of Zef Zorba. They reveal many aspects of the thinking and psychology of this poet - and can be seen in:

- intertextual relations (foreign poets and poetry in his texts)

- translations ("the other" here is related to *Imagery*. The problem of literary mediation emphasizes translation as a mediation between literature written in different languages.)

- his universal point of view, and the spiritual relationships between people of different nationalities - which comes through his characters acting as "agents of cosmopolitanism" (as in the poem "Raki and lyrics"). Now the "alien", "the other" comes as we see him and how he sees us.

- the relationships of a literary phenomenon with an non-literary phenomenon: that is, the incorporation of other spheres of human expression (such as paintings and music).

Zorba's "Buzë të ngrira në gaz" includes poems with musical concepts in their titles such as: *Allegro, Adante Mosso, Lento, Largo and Alegro Furioso, Introductions, Xylophone Symphony, Percussion Instruments Theme, Viola Theme, Concert Part, Cadence of the Xylophones, The Cadence of the Fagot, The Cadence of Viola, The Cadence of Percussion Instruments, Ripressa, Stretta Finale*.

Even at the last cycle *Në zgrip*, we feel the meeting with the music; especially in the poetry "Një gozhdë" with rock rhythm, - as the author explains, - based on alliterations: *deep, dry*, etc and, finally, in the piece "Natën kur bie shi" - conceived *alla Ravel.*

In this paper we are particularly interested in analyzing how the so-called:"clarity of structure and subject" has been undergone to harmonic effects, how Zorba's music in poetry is non-imitative but poetic and symbolic description of the phenomenon.

And in this relationship with "the other" (which in this case is music) let us try to get closer to the intentions and feelings of the author. Let us redo his course inward.

Maybe we'll discover Zorba once again.

Key words: musical relations, "the other", harmonic effects, symbolic description of the phenomenon.

Albanë MEHMETAJ

"TJETRI" NË MODERNITETIN LETRAR
(Pashku, Kadare dhe Rrahmani)

1.

Kumtesa e titulluar "Tjetri në modernitetin letrar (Pashku, Kadare, Rrahmani)" e shqyrton problemin e pranisë së tjetrit në letërsinë moderne shqipe të gjysmës së dytë të shekullit njëzet dhe synon që të japë kornizat e vështrimit të këtij problemi tek autorët e përdorur si model dhe te kjo epokë letrare.

Autorë të zgjedhur për këtë rast janë Anton Pashku, Ismail Kadare dhe Zejnullah Rrahmanin, me veprat: "Kulla", "Kështjella" dhe "Romani për Kosovën".

Veprat e zgjedhura dëshmojnë për vlerën e autorëve dhe mënyrat e paraqitjes së "kategorisë së tjetrit" në letërsinë moderne. Këta autorë janë përfaqësues të modeleve poetike dhe të stileve të zgjedhura të letërsisë moderne shqipe, ndërsa edhe problemi i tjetrit në letërsi, te këta autorë, përfaqëson disa nga variacionet më kryesore të paraqitjes së tij.

Kjo kumtesë është vetëm inicuese, meqë "problemi i tjetrit" në letërsi nuk është vetëm letrar, por ka të bëjë edhe me kontekstin kulturor, social, identitar etj. Metoda themelore e kërkimit është ajo krahasuese, me të cilën edhe vërtetohet origjina krahasuese e "problemit të tjetrit" në letërsi.

Koncepti i tjetrit, si në terma historikë, si në terma psikologjikë dhe letrarë, merr karakter të veçantë, shpesh dramatik dhe përcillet me pikëpamje kundërthënëse, prandaj qëllimi ynë është të ndjekim këtë vijë të manifestimit të tij. Problemi i tillë, pa dyshim, do sqaruar me argumente teorike.

Ernest Gellner, kur merret me problemin e "mbërritjes së tjetrit" dhe i qaset kësaj çështjeje duke analizuar dhe duke kërkuar fuqinë e madhë njohëse të njeriut modern në raport me njeriun primitiv, mendon se "njerëzit janë mjaft të ngjashëm, kurse ato që bën secili syresh janë të shumëllojta". Dhe, në këtë rrugë të gjykimit të problemit, ai konstaton: "Sido të jetë, këtë shpjegim parapëlqejnë antropologët: ngaqë profesionalisht kanë gërdi ta nëpërmkëmbin njeriun primitiv dhe, nga ana tjetër, kanë trashëguar kureshtjen për të gjetur 'funksione' në çfarëdolloj gjëje që ai bën, besimet magjike i lidhin shumë më tepër me rendin shoqëror sesa me natyrën. Kështu duket se i bëjnë të ndjeshëm. Por që t'i quash të tilla ide, transhendente"do të thotë, në shumicën e herëve ose gjithëherë, që t'i rrasësh njeriut të hershëm me zor idenë e një dallimi të prerë e të qartë midis kësaj bote dhe Tjetrës.Kjo projekton një ndarje të

mprehtë që në të vërtetë mungon në strumbullarin lokal të ideve ose që, nëse vërtet ekziston, ndjek një vijë krejt tjetër. Në hinduizëm e në budizëm, kjo botë përfshin një mizëri shpirtash; botët tokësore dhe frymësore janë së toku të ndara nga ajo që është mirëfilli Tjetra".

Duke e konceptuar në këtë mënyrë dhe duke bërë të njohur konceptin e tjetrit, si dhe duke krijuar një ide mbi domethënien e kësaj kategorie, bëhet e mundur që ai të vështrohet në kuptimin modern letrar, për ta parë vlerësinë dhe efektet letrare të tij. Duhet sqaruar se "tema e tjetrit" është e pranishme që në shkrimet e para të letërsisë shqipe, duke qenë gjithmonë preokupim i saj, por me sensibilitete të ndryshme nëpër epokat e saj letrare. Kështu, "tema e tjetrit" në letërsinë shqipe është bërë një temë letrare dhe ne do ta vështrojmë se si është trajtuar në kuptim modern, se si del si temë, stil, kompozicion, formë narrative, do të thotë në teknikën letrare.

Problemi këtu dëshmohet dhe konkretizohet me Pashkun, Kadarenë dhe Rrahmanin, pra duke parë se si koncepti i tjetrit del tjetërfare, kur shqyrtohet te autorët modernë, kur kemi ikje nga ideologjia në estetikë dhe ku qëllim parësor është estetika.

Realizimin e "temës së tjetrit" në letërsinë shqipe Pashku, Kadare dhe Rrahmani e bëjnë duke e pasur preokupim parësor identitetit shqiptar dhe duke qenë të udhëhequr nga motive nacionale e atdhedashëse. Në këtë kontekst, *koncepti letrar i tjetrit* te këta autorë ka kuptimin e pushtuesit, ka kuptimin e imponuesit të idesë, prandaj mbi këtë vështrim mbeten të huaj përgjithmonë. Tjetri në veprën e tyre formësohet nëpërmjet botës fiksionale, personazheve letrare, historisë së theksuar si kohë dhe si dëshmi e mundshme, si dhe nëpërmjet figuracionit letrar. Por, përceptimi *i tjetrit* këtu dallohet në planin tematik: te Pashku tjetri del ngjashëm me Kadarenë, nëpërmjet ngjarjeve historike (por te njëri e keqja, vetëm sa lëshon rrënjë, ndërsa te tjetri e mira mund të keqen), kurse te Rrahmani si temë personale (vzhdimësi e pushtuesit). Por që të tre si autorë modernë që janë, e kanë të ngjashëm universalitetin e temës, pra që çështjet shqiptare të trajtohen si çështje njerëzore dhe kanë njohuri të mira histografike e etnografike.

2.

"Historia jonë është një histori llogoret e sot më i madhi luftëtar në mbrojtje të kulturës, identitetit dhe integrmit europian të shqiptarëve është Ismal Kadareja e unë gjindem krah për krah tij në atë llogore", mendon Zef Pllumi, autori, i cili tash ka marrë edhe epitetin e fenomenit kulturor, tek i cili jeta dhe rrëfimi letrar janë shëndrruar në dokument të rëndësishëm në kulturën shqiptare.

Në këtë vështrim, do ta shohim se si Kadareja, i identifikuar si autor-luftëtar në mbrojtje të identitetit europian të shqiptarëve, e mbron atë në letërsi dhe se si e koncepton praninë e tjetrit në kulturën shqiptare. Para se të ndalemi te vepra që kemi zgjedhur për shqyrtim, duhet theksuar se në planin e poetikës së romaneve, do të

thotë për nga problematika dhe tematika e zgjedhur, Kadareja tashmë identifikohet si autor që do të ruajë rrënjët e traditës kulture evropiane të shqiptarëve.

"Kështjella" është vepra themelore me tematikë historike e Ismail Kadaresë,që në shtresimet dhe vijat narrative, duket haptazi motivimi i letërsisë për të theksuar idetë nacionale, e mbi të gjitha të qëndresës shqiptare e të rezistencës nëpërmjet mitit të kështjellës. Kështjella, pra si figurë e fuqishme letrare e Kadaresë, ka kuptim mbrojtës dhe ruajtës të njerëzve dhe të kulturës tipike shqiptare, prandaj në këtë kuptim del e pamposhtur.

Tema e luftës shtrihet në tërë romanin, por ajo që është e rëndësishme dhe i përgjigjet natyrës së kësaj kumtese është mënyra se si jepet tjetri e, po ashtu, si rrëfehet rezistenca shqiptare nga tjetri.

Në planin imagjinativ, romani rrëfen ndodhinë historike të një kështjelle të Shqipërisë të shekullit XV, përmes dy strategjive: stategjisë së Ugurlu Tursun Pashait, kryekomandant i trupave turke, dhe strategjinë e Gjergj Kastriotit, udhëheqës i shqiptarëve. Prandaj, kjo problematikë duhet të vështrohet me anë të krahasimit: të njerëzve që sulmojnë dhe njerëzve që mbrohen.

Duke qenë "Kështjella" vazhdimësi e librave që kanë temë çështjen e identitetit shqiptar si identitet evropian pa dyshim që figura e kështjellës ka një mbrojtës dhe një strateg kryesor, Gjergj Kastriotin, që në vështrimin e Kadaresë del si mbrojtës i Evropës së krishtërimit, i cili do t'a krishtëoj Shqipërine, të bëjë ashtu si Krishti që ajo të ringjallet.

Një ditë, në mos gaboj, të kam folur për Skendërbeun-vazhdoi tjetri. - Flasin shumë për të: e quajnë gjeneralin më të madh të kohës, luan, rimohues, tradhtar të Islamit, atlet i Krishtit e kështu me radhë.

- Ai rreh t'i veshë Shqipërsië petkun e pashkatërrueshmërisë, vazhdoi.-T'i japë, so të thuash, një tejtrajtë, ta bëjë të ringjallshme, me fjalë të tjera, ta përgatisë për një botë tjetër. Në shëmbëlltyren e hyjnisë së tyre, ai rrah ta krishtëoj Shqipërinë, pra, ta bëjë që, ashtu si Krishti, ajo të ringjallet. Tri ditë pas vdekjes, tre shekuj, tre mijëvjecarë, kjo s'ka rëndësi. Rëndësi ka vegimi i tij.

Intenca autoriale nëpërmjet Skënderbeut do t'a ndërtoj personazhin e tij si hero që do shpëtimin e atdheut, ruajtjen e identitetit, dijnitetit, qenësisë personale e etnike, të cilat janë të vëna në krizë nga të *tjerët.* Kadare do të potencojë rrënjët e historisë së shqiptarëve në krishtërizëm, sikur të gjithë evropianët.

Fenë dhe kulturën shqiptare, përballë tjetrës, Kadareja e ilustron edhe me mënyrën e të luftuarit: të parët i karakterizon me luftën e drejtë për të mbrojtur vendin, duke menduar dhe vepruar njëzëri, e duke qëndruar kështu të fortë falë këtij bashkimi dhe veprimi, ndërsa palën e dytë e karakterizon me shenjat e një traditë okupuese, që vepron për interesa dhe përfitime e, mbi të gjitha, është luftë e padrejtë.

"Kështjella", si vepër e kërkimit të idenitetit dhe e rrrëfimit të luftës atdhedashëse, del më fuqishëm nga këndvështrimi i tjetrit: "Në kronikën time do të

shkruaj, se ata, domethënë shqiptarët, nuk durojnë të kenë njeri mbi kokë, sa që, ashtu si tigrat kthetrafortë, grinden edhe me retë që kalojnë rastësisht sipër kokës së tyre."

Për të vënë në pah filozofinë e qëndresës dhe të bashkimit të shqiptarëve, si dhe ndrojtjen dhe mosbesimin që kanë turqit përballë tyre, Kadare zgjedh një teknikë të veçantë të të rrëfyerit, duke u parë dhe duke u ndjerë gjithçka nëpërmjet palës turke. Ky tip mbarështrimi i Kadaresë del mjaft funksional në kuptim të tjetrit në letërinë shqipe, pasi që nëpërmjet tjetrit jepet mendimi për shqiptarët, për qëndresën e tyre e po në këtë vështrim del kategoria e së keqes, që idenitfikohet me tjetrin.

3.

"Romani për Kosovën" e bën Zejnullah Rrahmanin ndër autorët më të fuqishëm që ndërlidh në rrëfim letrar funksionit e tjetrit në lëtërsinë shqipe. Me një fjalë, letërisa te ky autor del si një shkrim i kulluar i historisë së Kosovës dhe i njeriut kosovar të shekullit XX. Prirja letrare e Rrahmanit për të kërkuar identitetin nacional tashmë është një fakt letrat, por se si reprezentohet tjetri, i huaji në plan estetik duket më së miri nëpërmjet këtij romani. Do të thotë, është tema nacionale ajo që e identifikon Rrahmanin dhe që te ky roman del përmes disa linjave të rrëfimit dhe identifikohet me veprimin e misionarit Ahmet Zeqiri, i cili konkretizohet nga sensibiliteti i autorit duke vënë në relacion botën shqiptare me botën tjetër, të huaj e armiqësore.

Ahmet Zeqiri, shqiptari intelektual e atdhetar, përfundon si një hero tragjik e me mision të lënë përgjysmë brenda botës së pushtuesve. Ideja e tij të hap shkolla shqipe, duke bashkëpunuar me një pushtues (italianët), për të mposhtur një pushtues tjetër (serbë), mbetet e kontestuar. Ahmet Zeqiri, edhe pse përpara kësaj ideje sillet si i humbur, duke mos e njohur tjetrin deri në fund, shpreson në projektin intelektual, duke lënë çdo gjë pas e duke humbur edhe familjen.

Kështu, Ahmet Zeqiri, si personazh me shenja autobiografike, di të fokusojë deri në fund trishtimin dhe dhimbjen e njerëzve të shtypur si në të kaluarën historike, po ashtu dhe në aktualitet. Në të vërtetë, "Romani për Kosovën" kap fate të ndryshme personazhesh, të cilët, edhe pse nuk i bënë bashkë profili, janë të njëjtë për nga qëllimi, janë persona të cilët janë djegur për atdheun. Për të shprehur kështu më fuqishëm temën e historisë, të identitetit dhe të atdhedashurisë, Rrahmani romanin e ndërton duke e realizuar nëpërmjet dy linjave të rrëfimit: njëra ka në qendër Ahmet Zeqirin, ndërsa linja tjetër ka në qendër Zbulesën, që del si rrëfim i figurshëm. Përveç rrëfimtarit të të dy linjave, për të konkretizuar ardhjen e tjetrit si fatkeqësi, Rrahmani ndërliks planet narrative, duke bërë që edhe personzhet të marrin rolin e narratorit për të rrëfyer jetët personale. Kështu, rrëfimet ngrihen në kthesa të ndryshme, sepse personazhet janë të ndryshëm, dy palësh: shqiptarët dhe të tjerët. Rrëfimet shpeshherë marrin edhe titullin e situatave dhe të ndodhive historike dhe në këtë mënyrë dalin më të qarta idetë autoriale.

Kjo metodë krijuese e Rrahamnit ka vënë në pah konceptin dhe ardhjen e tjetrit. Ardhja e tjetrit, planet dhe strategjitë shkatruese të tij konkretizohen edhe nëpërmjet rrëfimit *Mallkimi*, në të cilin protagonisti Ahmet Zeqiri shtron pyetjet më vendimtare në këtë kontekst: përse duhet luftuar pushtuesi, duke vrarë shqiptarë. Autori e ka idenë se me të tjerët nuk mund të krijohet asnjë raport e në asnjë mënyrë raport kulturor. Edhe pse ushtria italiane dhe ushtria gjermane e çlirojnë Kosovën nga pushtuesi serb, edhe vetë bëhen pushtuese.

Historia e tjetrit në romanin e Rrahmanit del në çdo faqe e kjo hapet që në faqet e para të romanit, kur në mënyrë parodizuese e grotekste autori shenjon se si flamuri, si shenjë identifikuese e shqiptarëve, pas festës se *28 Nëntorit*, mbetet në duart e "magjupëve": "Flamujt, të lagur, gati të kalbur prej shirave, tani po hiqeshin. Një grumbull mëditësish, jevgë, e bënin punën e tyre ashtu siç dinin, me sharje të pamëshirshme në gjuhën magjupishte, me një shkujdesje të përgjithshme, pa asnjë respekt ndaj atyre copërvae të mëndafshta."

Përceptimi i tjetrit te "Romani për Kosovën" shtrihet në tabllo të gjera të situatave historike, duke i vështruar në çdo aspekt: kur Ahmet Zeqiri i përshkruan popujt slllavë si okupues, me synim të përfitimit të pasurisë e të uzurpimit të tokave. Pothuaj në tërë romanin ndihet frika ndaj të huajit, prandaj Rrahmani zhduk ndasitë fetare të shqiptarëve, duke ua bërë të përbashket frikën dhe pasigurinë ndaj tjetrit. Efekti më i madh i frikës në "Romani për Kosovën" manifestohet atëhere kur jeta dhe historia rrëfehet duke pasur objekt rrugët, vendet, qytetet reale të Kosovës e, po ashtu, edhe peronazhet me emra tipikë kosovarë. Për të krijuar lidhjen sa më të afërt me vendin, njerëzit dhe gjuhën, Rrahmani ka përdorur më pak figura në roman e më shumë stil të drejtpërdrejtë, natyrisht në vijë imagjinare, e kështu me më shumë efekt estetik.

Heroi i "Romanit për Kosovën", Ahmet Zeqiri, përfundon tragjikisht, duke dashur të ruajë e të mbajë kulturën shqiptare. Ai humbet si pasojë e veprimeve të tjetrit.

4.

Tregimi "Kulla" i Anton Pashkut është një ndër veprat më ilustrative të letërsisë sonë, që rrëfen mitin e ekzistencës shqiptare. "Kulla", si titull që shenjon vetë kuptimin, e redukton poetikën e tregimit në figurë dhe tregimi del si simbol dhe alegori, duke reduktuar edhe strukturën narrative në figurë, pa rrëfim klasik e pa strukturë klasike.

Tjetri në këtë tregim nënkuptohet që do të jetë faktor kryesor, pasi që rrëfimi te "Kulla" rrjedh si rrëfim i etnisë shqiptare, nëpërmjet simbolit të kullës shqiptare, e vetë fjala kullë ndër shqiptarët parimisht jep mbijetesën në rrugët e vështira të historisë së saj. Prandaj, Pashku, duke bashkuar kulturën e vjetër popullore shqiptare, me mitin e kullës, si simbol të qëndresës shqiptare, e shenjon kullën si element të jetës, që në

periudha të ndryshme jetërore, në periudha luftërash e vuajtjesh, ka qenë përherë e lidhur me njeriun e saj. Kështu, kulla, në këtë vështrim, duket se ka bërë të sajin njeriun shqiptar, duke e mbështjellë dhe ruajtur shpirtin e tij.

Pra, në kulm të tregimit, kemi kullën shqiptare, e cila përveç kuptimit simbolik, me të cilin përthekon botën shqiptare, del edhe si shenja kryesore e tregimit "Kulla". Kështu, ajo duke u identifikuar me ekzistencën shqiptare, duke ua ditur hallet e problemet njerëzve shqiptarë e duke ua njohur armikun, qe ne tash në këtë tekst po e konceptojmë si tjetrin, kulla del si personazhi kulmor që jeton dhe frymon me njerëzit e saj.

Më tej nëpërmjet figurës së **kullës** del kërkimi letrar i identitetit nga Pashku, duke bërë që edhe tema e tregimit të jetë e lidhur pashmangshëm me etnicitetin dhe historinë e popullit shqiptar. Sa i përket Kullës si simbol, ajo tashmë në kulturën e shqiptarëve është shëndrruar si monument letrar që sinjifikon një lloj strehimi, mbrojtjeje të popullit nga e keqja, nga armiku. Këtë më së miri e thekson studiuesi K. Rrahmani: "Në etosin shqiptar, kulla edhe së jashtmi është ndërtuar, përpos tjerash me qëllime të mbrojtjes, të ruajtjes nga sulmet që sillnin zhdukjen. I është vënë derë e fortë, dritare të vogla-frëngji dhe është punuar me material guri, me qemer e me dru." Kështu, Rrahmani mendon se vetë predestinimi mbrojtës i kullës, në eposet dhe në rrëfimet e në traditën gojore, ka krijuar mitin e kullës, si mit të Rrënjës, të këmbënguljes dhe të vitalitetit.

Tregimi i Pashkut problemin e fatit të popullit e shtron nëpërmjet personazhit të Plakës, që shenjon të kaluarën dhe vazhdimësinë historike përmes dëshmisë artistike. Këtu Pashku vendos një raport midis plakës dhe kullës që përfaqësojnë fate individuale dhe historike. Rrëfimi për jetën e Plakës, e cila përfaqëson jetën kolektive, ndikon në fatin dhe në rrjedhat e kullës ose edhe anasjelltas.

Te tregimi "Kulla" personazhi Plaka del si figurë imagjinare që e ka prodhuar figura e kullës (K.Shala) për të rrëfyer të ndodhurat individuale, me qëllim të kërkimit të universales. "Plaka i përket brezit që ka shkuar në varr, kurse botëkuptimi si dhe përvoja e këtij brezi jetojnë dhe dëshifrohen vetëm vetëdijen dhe ndërdijen e brezit të mbetur, që tash në një ngushtësi të ekzistencës dhe në ligështim të shpirtut, mund të rikonstruktojnë të kaluarën popullore e kulturore si mënyrë për të shpëtuar shprishjen" (S. Hamiti).

Ideja themelore në vështrimin e tjetrit në këtë tregim formësohet përmes personazhit të Kasapit, i cili po ashtu del si figurë "e pushtuesit, e së huajës, përfundimisht shenjë e ideologjisë që rrezikon idenë/frymën nacionale (K.Shala). Në këtë vështrim, sikurse tema e qëndresës dhe mbijetesës që është realizuar përmes figurës së kullës, edhe tema e ozurpatorit, tema e armikut, tema e tjetrit është realizuar përmes personazhit të kasapit.

Filozofia negative e Kasapit**,** mënyra e ardhjes së tij dhe e sjelljes së tij vërehen më së miri në dialogët që ka me Plakën. Thënë më mire, Pashku nga dialogu i tillë vë

në pah kulturën e tjetrit përballës kulturës së popullit të tij: derisa plaka shfaq shenja të një kulture të veten, për të ruajtur çdo gjë që është e vetja, pa cenuar të drejtat e askujt, tjetri shfaq të gjitha shenjat e një kulture mizore e shkatërruese. Për ta ilustruar më mirë të keqen e tjetrit në këtë tregim, duhet të shohim se si narratori rrëfen ngjarjen, pra se si vendos që *kasapi ka shpuar me thikë qafen e Bardhokë*s. Do të thotë, në këtë prizëm, mund të shohim se deri ku shkon fuqia e zezë e Kasapit në tregimin "Kulla". Dhe, që ai ka synim parësor dhe që është figurë e idesë së shuarjes së një kombi me traditë, mund ta shohim më së miri nëpërmjet këtij ilustrimi:

"A i ke parë ato gërmadha?", i pat thënë kasapi. "Edhe ato, thonë, kanë qenë kulla. Po tash? Tash janë vetëm gërmadha".

"Por, ti nuk di ç'janë ato gërmadha", i pat thënë plaka. "Ti nuk di se në ato gërmadha gjendet një këmborë".

Rrëfimi i dhënë nga narratori, i cili figurën e plakës e konstrukton si ide autoriale, ka vënë në qendër plakën si figurën më përfaqësuese të dëshmisë së tjetrit (kasapit). Plaka është figura që me naivitetin e saj, mirësinë, dashurinë për vendin e pasardhësit e saj konkretizon më së miri të huajin në letërsinë shqipe. Plaka nxjerr fytyrën e vërtetë të Kasapit, misionin mizor e shkatërrues të etnicitetit shqiptar.

Ky tregim, ashtu siç fillon me pamje të dhimbjes dhe të trishtimit për vdekjen e plakës dhe varrimin e saj, po ashtu me pamjen e rëndomtësisë së jetës dhe vazhdimësisë së saj, po në këtë kuptim edhe mbaron. Do të thotë, jeta dhe vdekja jetojnë njëkohësisht në tregimin e Pashkut, duke qenë gjithherë shenjë e tjetrit. Vazhdimësisnë e ekzistencës e të jetës, të lidhur me kullën e kulturën e vendit, fizikisht e shpirtërisht, në tregimin "Kulla" e reprezenton figura e Djalit. Nëpërmjet figurës së djalit, efektet e historisë fiksionale krijojnë iluzionin e një jete të vërtetë letrare që lidhet me figurën e kullës.

Albanë MEHMETAJ

THE "OTHER" IN LITERARY MODERNITY
(Pashku, Kadare, Rrahmani)

Abstract

The paper titled "The ‚Other' in Literary Modernity (Pashku, Kadare, Rrahmani)" examines the problem of the „other" presence in modern Albanian literature (of the second half of the twentieth century) and aims to give the frameworks of this problem to the authors used as a model and in this literary era.

This paper is only an initial, since the problem of the „other" in literature is not only literary, it is also relates to the cultural and the social identity context. So, the

basic method of research, is the comparative one, which also verifies the comparative origin of the "other“ in literature.

The concept of the „other“, in historical terms, both in psychological and literary terms, takes on a particular character, often dramatic, and conveyed with contradictory views, so our goal is to follow this line of manifestation. Such a problem will undoubtedly be clarified with theoretical arguments.

The authors chosen for this case are: Anton Pashku, Ismail Kadare and Zejnullah Rrahmanin, with the works "Tower", "Castles" and "Romani for Kosovo". Selected works are testify to the value of the authors and the ways of presenting the ctagiry of the "other " in modern literature.

These authors are representatives of poetic patterns and selected styles of modern Albanian literature, while the problem of the „other“ in literature, in the works of these authors, represents some of the most important variations of his appearance in the Albanin modern literature.

Realizing the theme of the „other“ in Albanian literature Pashku, Kadare and Rrahmani make it having primary concern for the Albanian identity and being guided by national motives and patriotism. In this context, the literary concept of the other of these authors, has the meaning of the conqueror, meaning the impersonator of the idea, and therefore, on this look remain foreign forever.

The „other one“ in their work is shaped by the fictional world, literary characters, history as time-stamped and as probable evidence, and through literary figuration.

But the perception of the other here is distinguished in the thematic plan: in the other side, it is similar to the literary works of Kadare, through historical events (but to one evil only root causes, while the other good can be bad), while to Rrahmani as a personal theme (continuation of the invader).

All three of them, as modern authors, are similar to the universality of the subject, so that Albanian issues are treated as human issues and have a wery good histographic and ethnographic knowledge.

Anton BERISHAJ

VETJA SI TJETRI / TJETRI SI VETJA
- Semio-etika e letërsisë shqipe -

Unë jam ti,
Nëse Unë jam
Paul Celan

Kur njeriu është vetëm nuk dihet kush është: mund të jetë ky këtej, mund të jetë ai andej, mund të jetë edhe një tjetër që nuk e di ku ka qenë, ku është dhe ku mund të jetë. Por që nga koha që me të bashkohet një i dytë, ai e kupton kush është dhe kush është ajo tjetra dhe ku kërkojnë të venë... Kështu, nga paqenësia dalin qeniet reale, që pastaj të shuhen përsëri në një paqenësi po aq të kuptueshme sa ajo prej nga ato kishin dalë!... T'ju them të drejtën, ma ha mendja se edhe për botët nuk mund të kishim një qenësi tjetër reale...

Kasëm Trebeshina: *Odin Mondvaldsen*

Abstrakt

Kategoria e *Tjetrit* është thelbësore dhe kusht i domosdoshëm për çdo proces/sistem komunikimi dhe semioze. *Tjetri/Tjetërsia* është e paevitueshme, madje kategori strukturale për vetë jetën, sepse *shenjat, trupat dhe zërat janë të pajisura me potencialin që t'i përgjigjen njëri-tetrit dialogjikisht.* (Petrilli, 2014). Logjika e tjetërsisë, kështu, është e lidhur ngusht me semiozën humane, polilogjizmin dhe shumëzëshmërinë, që janë tipike për letërsinë dhe semiozën e pafundme të saj.

Vetë letërsia, në këtë kontekst, mund të konsiderohet si *Tjetri/Tjetërsia.* Tjetri nuk zë vend vetëm në hapësirat e brendshme të unit si *alter ego*, pra si e gjithë *ajo që unë nuk jam* (Levinas, 1979), por edhe relacionet midis lexuesit dhe autorit në procesin e komunikimit letrar janë si një relacion midis *vetjes* dhe *tjetrit*, respektivisht ku secili është edhe vetja edhe tjetri (Hart, 2015). Tjetri/Tjetërsia janë kusht i domosdoshëm i modelimit të kuptimeve/domethënieve në tekstet letrare; në të vërtetë, letërsia me modelimin e *botërave të mundshme fiktive* është një 'hapësirë' e privilegjuar e tij/saj.

Poetika e Tjetërsisë në letërsinë shqipe shfaqet në trajta dhe dimensione të shumta dhe merr trajta imagjinare të panumërta.

Disa nga më domethënëset dhe me më shumë ndikim në sistemin letrar shqiptar janë: 1. *Tjetri transcendental/metafizik/religjioz* (Buzuku, Budi, Bogdani...), 2. *Tjetri politik/kulturor* (romantizmi), 3. *Tjetri ideologjik/klasor* (Xoxa), 4. *Tjetri si Vetja/Vetja si Tjetri* (Petro Marko) dhe *Vetja si Tjetërsi Radikale* (Trebeshina), 5. *Tjetri si markim i gjinisë/seksit: trupi femëror si Tjetri* (Dones) *dhe trupi mashkullor si Tjetri dhe si objekt i dëshirës* (Myftiu).

Kategoria e *tjetrit* dhe e *tjetërsisë* trajtohet në kornizat e një *leximi liminal/etik*, i cili ka për qëllim përvijimin e një *semio-etike* të letërsisë shqipe.

Fjalë çelës: *tjetri, tjetërsia, leximi etik, semioetika, poetika e tjetërsisë*

1. TJETRI/TJETËRSIA – SEMIOSFERA/SEMIOETIKA

1.1. Konceptet si *tjetri/tjetërsia* janë bërë koncepte bazë të 'spekulimit' filozofik/teorik në fusha të ndryshme të disiplinave humane. *Tjetri,* si kategori, zë një vend të privilegjuar posaçërisht tek afiliacionet teorike në kuadër të fenomenologjisë, hermeneutikës dhe teorisë etike (Levinas 1998, 1999; Ricoeur 1994), psikanalizës (Laplanche 1999), në studimet në fushën e relacioneve të religjionit me letërsinë (Gunn 1979, Arnold 1993, Fernando 2009), si dhe në kuadër të studimeve gjinore (Butler 1990, 1993, 2005) dhe semiotikës (Lotman 2004, Petrilli 2014).

Shqyrtimet e Levinasit të kategorisë së *tjetrit/tjetërsisë* janë komplekse dhe, ndonjëherë, në shikim të parë kontradiktore, por kjo rrjedh rëndom nga modalitetet e kontekstualizimit të saj në relacion me konceptet ontologjike të *imanencës dhe transcendencës*, por edhe me problematizimin e dimensionit etik që nocioni i *tjetërsisë* e imponon si i tillë. Për Levinasin, siç pohon Butler (2005, 53), *adresimi i tjetrit është ajo që më konstituon mua. Primatin e Tjetrit,* madje me konsekuenca etike gati fataliste e gjejmë edhe te psikanaliza e Laplanche-it, për të cilin "*tjetri që më flet nuk është në një shkëmbim 'reciprok' ose komunikim të balancuar. Situata, që nga fillimi, është asimetrike dhe 'Unë' e gjen veten të çarmatosur dhe pasiv në relacion me mesazhin që vjen nga tjetri."* (Butler 76). Për pasojë, *trauma* do të bëhet pjesë konstitutive e subjektit/egos. Por, ajo që mund të nxirret si një përfundim, sado i thjeshtëzuar, i koncepcioneve të të dy këyre autorëve, është ideja e ç'përqendërzimit të subjektit si rezultat i dialogjikës dhe definimit diskursiv nga/me dhe të Tjetrit.

1.2. Koncepcione të ngjashme të Tjetrit/Tjetërsisë, por me shtrirje përtej relacionit të reduktuar individuacionist "Unë-Tjetri" dhe logjikës binare, i gjejmë në fushën e debateve bashkëkohore semiotike. *Logjikën e tjetërsisë* Lotmani e sheh mu te modalitetet e funksionimit të hapësirës që e bën të mundshme dhe e krijon/tansformon pandërprerë kulturën, te *semiosfera*. Modalitetet e funksionimit të semiosferës ai i lidh me *përkthimin*, si një mekanizëm bazë të semiozisit.

"Struktua e semiosferës është asimetrike. Kjo shprehet te sistemi i rrjedhave të orientuara të përkthimeve të brendshme që e përshkojnë të gjithë masën e semiosferës. Përkthimi është mekanizmi themelor i vetëdijes. Shprehja e një qenieje me mjetet e një gjuhe tjetër – është bazë për zbulimin e natyrës së asaj qenieje. E meqenëse në të shumtën e rasteve gjuhët e ndryshme të semiosferës janë semiotikisht asimetrike midis tyre, e tërë semiosfera mund të shikohet si një gjenerator informacionesh" (Lotman 189). Nisur nga konstatimet e cituara, mund të konkludojmë se relacionet e ndryshme Unë-Tjetri/Ne-Të tjerët bëjnë pjesë pikërisht në këtë mekanizëm bazë kulturor. Për më tepër, një fuksionim të tillë kompleks semiosferës ia mundësojnë *mekanizmi i dialogut* (si "mekanizëm elementar i përkthimit") dhe *koncepti i kufirit.*

"Hapësira e brendshme e semiosferës është në mënyrë paradoksale njëkohësisht jo e njëtrajtshme, asimetrike dhe unike, e njëllojshme. E përbërë nga struktura në konflikt, ajo e posedon edhe individualitetin e saj. Vetëpërshkrimi i asaj hapësire presupozon një përemër në vetën e parë. Një nga mekanizmat themelorë të individualitetit semiotik është kufiri. E këtë kufi mund ta përcaktojmë si një vijë në të cilën përfundon forma e vetës së parë. Atë hapësirë e definojmë si "tonën", "timen", "të kulturuar", "të sigurt", "të organizuar në mënyrë harmonike" etj. Asaj i kundërvihet "hapësira e tyre", "e huaja", "armiqësorja", "e rrezikshmja", "kaotikja" (Lotman 194/5). Por, kategoria e kufirit shtrihet edhe përbrenda vetë hapësirës semiotike, duke e bërë edhe atë një hapësirë me ndryeshueshmëri dhe në një lëvizje e transformim të vazhdueshëm. "Përfytyrimi për kufirin që e ndan hapësirën e brendshme të semiosferës nga ajo e jashtmja ofron një ndarje elementare, të vrazhdë. Në fakt, e gjithë hapësira e semiosferës është e përshkuar me kufij nivelesh të ndryshme, kufij gjuhësh të ndryshme dhe madje tekstesh, ku hapësira e brendshme e secilës nga ato subsemiosfera e ka një "unë" të vet semiotik, i cili realizohet si relacion i një gjuhe, grupi tekstesh, teksti të veçantë (duke patur parasysh se gjuhët dhe tekstet janë vendosur sipas një hierarkie në nivele të ndryshme) ndaj një hapësire metastrukturore që i përshkruan ato. Përshkimi i semiosferës nga kufij të veçantë krijon një sistem me shumë nivele" (Lotman 205).

1.3. Edhe pse Lotmani konsideron se *hapësira në anën e jashtme të kufirit të semiosferës është një vend i dialogut të pandërprerë*, mund të themi, në gjurmë të Peirce-it, se edhe hapësira e brendshme e *shenjës,* e cila e merr një status të tillë vetëm pasi të jetë ballafaquar me interpretantët e njëpasnjëshëm, – shumësinë e tjetrit (në relacion me shenjat tjera) që është pjesë strukturale e saj - të cilët e mundësojnë semiozën e pakufishme dhe bazohen në një dialog të pandërprerë, respektivisht në *logjikën e tjetërsisë (alteritetit)*. Kjo dialogjikë e brendshme, sipas Bahtinit, merr format e *polifonisë /shumëzëshmërisë***,** të një "plurilingualizmi dialogjik", *i cili është struktural jo vetëm për relacionin midis diskursesh të ndryshme, por po ashtu edhe për diskursin e një zëri të vetëm* (Petrilli, 2014: 173). Madje, për Bahtinin, komunikimi me tjetrin është kusht i të qenit:

"Unë jam i vetëdijshëm për vetveten dhe bëhem vetvetja vetëm sa kohë e zbuloj vetveten për tjetrin, nëpërmjet tjetrit dhe me ndihmën e tjetrit... Dhe gjithçka e brendshme graviton jo drejt vetes, por është e kthyer nga jashtë dhe e dialogëzuar, çdo përvojë e brendshme përfundon në kufi, duke takuar tjetrin dhe në këtë takim të mbushur me tension qëndron e gjithë esenca e saj... Të qenmit e njëmendtë e njeriut (si ai i jashtëm ashtu edhe i brendshëm) është një *përbashkësi më e thellë. Të jesh* do të thotë *të komunikosh* (Bakhtin, 1984: 287). Madje, ai në po këtë tekst e precizon më tej pohimin e fundit: *Të jesh do të thotë të komunikosh dialogjikisht. Kur dialogu mbaron, gjithçka mbaron... Të gjitha të tjerat janë mjet; dialogu është qëllimi* (Bakhtin, 252)

1.4. Nisur nga këto premisa teorike (në themel të të cilave qëndrojnë idetë e, midis të tjerëve, Peirce-it, Levinasit dhe Bahtinit), Petrilli disiplinën e semiotikës - që e emërton *semioetikë* - e zhvillon mbi *logjikën e tjetërsisë*, mbi relacionet me tjetrin. Meqenëse kuptimi nuk mund të lokalizohet në vetë shenjën, e konceptuar si një singularitet i mbyllur dhe i izoluar, por në relacionin midis shenjash, është e qartë se mekanizmi i dialogut, i cili *per definitionem* është një mekanizëm relacional Unë-Tjetri (madje edhe Unë-Unë'/'"Tjetri"/) është fundamental edhe në kontekstin e funksionit semiotik të Alteritetit/Tjetërsisë. Por, dialogu dhe dialogjizmi, ashtu si edhe vetë semioza, janë të pamundshëm pa një proces *interpretimi* dhe *translacioni/përkthimi* semiotik. Përkthimi në kuptimin e tij më të gjerë – si përkthim intralingual, interlingual, interkuluror, inrasemiotik dhe intersemiotik, gjithnjë e 'themelon një relacion *tjetërsie* (ose *alteriteti*) me tekstin burimor' (Petrilli, 226). Në këtë kontekst, natyrisht, trajtohet edhe paradigma e intertekstualitetit/transtekstualitetit. Vetë semioza, sipas semiotikës globale, është një proces interpretimi/translacioni, respektivisht një *proces semiotranslacional.* Në këtë proces paradoksalisht prodhohet një *"tjetër i njëjtë",* i cili është identik dhe i ndryshëm, i ngjashëm dhe i pangjashëm. (Idem., 234) Gjithashtu, përkthimi i kuptuar si më lart, sipas Petrillit e fuqizon relacionin e tjetërsisë absolute me kreativitetin, në njërën anë, por edhe me *agape*-n, dashurinë, si *forcë lëvizëse në procedurën logjike të karakterizuar me termat e abduksionit, ikonicitetit dhe kreativitetit.* "Agape e kuptuar si orientim drejt tjetrit absolut është e aftë ta shndërrojë të urryerën në të dashur". (Petrilli, 71) Prandaj, në planin e përgjithshëm etik (jo të normativitetit moral), semioetika shfaqet edhe si një ndërmarrje intelektuale që angazhohet për *humanizmin e tjetërsisë*, siç do të thoshte Sebeok – si një *semiotikë e jetës.*

2. POETIKA E TJETËRSISË DHE HAPËSIRA LIMINALE

2.1. Trajtat e *Tjetrit* dhe të *Tjetërsisë* në letërsi janë të pakufishme dhe ato zënë vend si në vetë natyrën formale dhe strukturale të vetë teksteve letrare dhe (dia)logjikën e funksonimit të tyre (si p.sh. strukturat narrative, 'modeli aktansial', etj.) ashtu edhe në universin semantik dhe relacionet referenciale të tekstit letrar (me dimensionin 'tematik, 'objektin', 'botën'), por edhe në modalitetet e komunikimit

letrar. "Në letërsi relacioni midis lexuesit dhe autorit është i ngjashëm me atë midis vetjes dhe tjetrit. Te grupi a shoqëria e arsimuar, lexuesit janë shkrimtarë dhe shkrimtarët lexues. Secili është tjetri i vetvetes, ose, në terma të tjerë, çdo person është edhe vetja edhe tjetri" (Hart 2015, 27). Sipas Hartit, ky relacion paradoksal e krijon *dramën e kuptimit*, e cila është e lidhur me *traumën* dhe përvojën traumtike, ashtu edhe me dimensionin etik. Madje, edhe vetë leximi, relacioni midis lexuesit dhe tekstit, hapësira e leximit, përfaqëson një tjetërsi në relacion me të dyja këto kategori (Fernando 2009, 145).

2.2. Për t'i parë trajtat e shfaqjes dhe të modelimit të tjetrit dhe tjetërsisë në letërsinë shqipe, domosdo përciptazi dhe më shumë në një mënyrë të reduktuar, pra edhe vetëm si indicje, do të fokusohemi te nocioni i *liminalitetit* dhe kategoria e *trupit*, si një rast special i tij. Nocioni i liminalitetit në dijet humane zuri fill në antropologji. Van Gennep (1909) e futi në përdorim në kontekstin e studimit të riteve/ritualeve të 'kalimit' – *rites de passage*, të clat ai i ndante në tri nënkategori: *rite të ndarjes, rite të transicionit* dhe *rite të inkorporimit*, duke e vendosur *liminalitetin* te kategoria e dytë, si një *periudhë liminale* (Thomassen 2014, 3). Unë këtë kategori të ekzistencës specifike, të të qenmit-në-mes, në prag (në kufi, siç do të thoshte Lotmani), do ta (për)kufizoj më tepër në dimensonin e saj hapësinor se temporal, si një *locus simbolicum,* si një *hiper-realitet* ku *marrin formë procesi i strukturimit dhe formësimit kuptimor* (pra edhe i shndërrimit/transformimit), në njërën anë, por edhe ku formësohet një *liri potenciale e pakufizuar nga çdo formë strukture*, që po ashtu *indukton kreativitetin dhe inovacionin* dhe ku *zhduket hierarkia dhe normat e pandrysueshme* (Thomassen, 1). Pikërisht, në këtë hapësirë zë fill dhe intensifikohet relacioni me tjetrin dhe tjetërsinë dhe procesi i transformimeve të Vetjes në Tjetrin dhe të Tjetrit në Vetjen. Përvoja e Tjetrit dhe me Tjetrin *kondensohet në hapësirat/'çastet' liminale*. Në të vërtetë, konsekuencat paradoksale centrifugale dhe centripetale në relacionet i *idem-identitetit* dhe *ipseitetit* (Ricoeur, 1994, 116 et passim) me Tjetrin/Tjetërsinë më së shumti theksohen pikërisht në spacialitetin dhe temporalitetin, respektivisht kronotopinë liminale. Kjo bën që drama e domethënieve/kuptimeve të bëhet më intensive dhe komplekse.

2.3. *Letërsia e vjetër shqipe* (shek. XVI-XVII) relacionet me tjetrin dhe *tjetërsinë transcendentale* (Zotin, hyjnoren) i realizon në hapësira liminale specifike – në 'hapësirën e shenjtë' (kishë/katedrale si *simbole të kozmosit*) dhe në *hapësirën e ritualit*, ku përmes praktikës liturgjike dhe tekstuale (në kuptimin semiotik) radikalisht Tjetri bëhet Unë/Vetja dhe Vetja bëhet radikalisht Tjetri – ku hyjnorja dhe njerëzorja bëhen kategori semantike transgresive dhe dialogu midis tyre është i përhershëm (Berishaj 2010). Megjithatë, inkarnimi si shndërrim i Tjetrit në Vetja realizohet vetëm përkohësisht, ndërsa kjo presupozon që një transformim i tillë i plotë – i Vetjes te Tjetri (i humanes te hyjnorja) do të ndodhë vetëm në gjithëkohësinë eternale dhe jo në temporalitetin njerëzor, profan; jo në spacialitetin korporal/tokësor, por në atë 'qiellor'/'parajsor'. Megjithatë Zoti/hyjnorja (edhe përmes paradigmës së Krishtit-

Zot/Njeri) nuk mbetet vetëm Qenie në vetvete (Gunn 1979, 27), pra jo vetëm në hapësirat e pafundësisë simbolike të Tjetërsisë radikale. Kjo shihet qartë edhe nga fakti se edhe brenda paradigmës teologjike – hyjnorja, përmes frymëzimit/'inspirimit' dhe praktikës tekstuale, inskriptimit të 'fjalës hyjnore' te njerëzorja, e projekton dimensionin hyjnor te dimensioni human (kjo vlen për tekstet e Buzukut, Budit, Bogdanit, etj.). Më anë tjetër, me relacionet intertekstuale me tjetrin dhe procesin e përkthimit/translacionit semiotik të tjetrit, të 'gjuhës tjetër' (latinishtes, italishtes) *letërsia e vjetër shqipe* e bën Tjetrin pjesë të Vetes, nëpërmjet Tjetrit e konstituon Vetveten, e themelon kështu kulturën tekstuale dhe qendrën e semiosferës shqiptare pikërisht në relacion me Tjetrin.

2.4. Edhe pse i modeluar në kontekstin e *traumës* dhe përvojës traumatike me Tjetrin, Petro Marko në dy romanet e tij e formëson një *humanizëm të tjetërsisë*, ku model mbizotërues është relacioni Vetja si Tetri dhe Tjetri si Vetja. Te *Qyteti i fundit* (Marko 2000) hapësirën liminale e përfaqëson një 'qytet prej kartoni dhe çarçafi'(si replikë ironike intertekstuale ndaj 'qytetit të përjetshëm') në portin e shkatërruar të Durrësit, një hapësirë limbike dhe simbolike, një 'purgator' politik e moral, një vend kalimtar/liminal drejt 'tokës së premtuar' – *atdheut*, ku armiqësia (edhe ideologjike) ndaj tjetrit/armikut shndërrohet në *agape/dashuri* dhe *kujdes për tjetrin* (të simbolizuar me relacionin e akterëve Lekë Gurra dhe Ana-Maria Monti). E njëjta strategji narrative ndiqet edhe te romani *Nata e Ustikës* (Marko 2010), ku *ishulli* e përfaqëson hapësirën liminale. Hapësira limbike e vendosur në ishullin Ustika (ku janë vendosur të internuarit gjatë Luftës së Dytë Botërore), merr tipare skëterre, ku akterët janë vendosur në një pozitë hajdegeriane *të të qenmit drejt vdekjes*, e vdekjes së projektuar te *trupi*: "...Fytyra e mortjes së arrirë. Fytyrë e qetë. Pa zhurmën e gjakut. Pa ngjyrat e gjakut. Fytyrë pa gjak. Pa mish. Pa kërkesa, pa ambicie. Pa pasione. Pa ëndrra. Pa ligësi. Pa jetë" (Marko 2010, 142). Përkundër kësaj, te Marko relacioni ekstrem traumatik midis Vetes dhe Tjetrit realizohet në *mbretërinë e shenjave të jetës* dhe kërkesës performative: *Më thuaj, jeto!* Për të *tjetërsia e njeriut tjetër* nuk është vetëm tjetërsi logjike, por ajo *shenjohet burimisht me termat e dijes (një dijeje politike, por thelbësiht dijeje) në të cilën Unë e njeh vetveten si një fraksion i së Tërës që e drejton solidaritetin njerëzor, si një organizëm unitetin e të cilit e garanton solidariteti i anëtarëve* (Levinas 1998, 185).

2.5. Te *Odin Mondvaldsen* (Trebeshina 1992) liminaliteti modelohet në disa nivele: si liminalitet hapësinor – 'çmendina' si *locus simbolicum* i pogramit narrativ dhe kronotop – të cilin e modelon dhe në të cilin modelohet narratori intradiegjetik, protagonisti i romanit; në nivelin e dytë, në hapësirën skizoide, e cila e definon si konfiguracionin narrativ, ashtu edhe botën psikike të protagonistit. Në kuadër të këtyre dy modaliteteve liminale modelohet relacioni Vetja si Tjetërsi radikale, *një situatë aporetike kur një person është edhe vetja edhe tjetri në të njëjtën kohë* (Fernando 88), si një identitet skizoid, i cili në vetvete përfaqëson një *liminalitet të pafund* (Thomassen 4). Te *Mekami* (Trebeshina 1994), ndërkaq, liminaliteti shfaqet në një trajtë specifike – si

ëndërr, vizion onirik, i narratorit "primar". Ky pozicion liminal (i derivuar poashtu nga përvoja thellësisht traumatike – rrënimi i objekteve sakrale në periudhën e 'revolucionit kulturor' në Shqipërinë komuniste) i shërben subjektit semiotik për të siguruar një alibi ideologjike, sepse 'Vetja' e definuar në trajtë *denominacioni primitiv* /"shqiptarët"/ projektohet nga pozicioni i radikalisht Tjetrit /"Turku im"/, në kontrapunkt me modelet mbizotëruese të Tjetrit politik/ideologjik në kulturën dhe semiosferën shqiptare (ku "Turku" shfaqet si Tjetri radikal ideologjik, politik e kulturor).

2.6. Ndër relacionet më interesante të modelimit të *logjikës e tjetërsisë* në letërsinë shqipe lidhet me kategorinë e *trupit*. Nëse për Merleau-Pontyn pa trupin e njeriut nuk mund të ketë fare jo vetëm hapësirë, po as koncept të hapësirës (Merleau-Ponty 1962), për Lotmanin *semiotizimi i trupit* është thelbësor për proceset e semiozës dhe semiosferën përgjithësisht, posaçërisht me semiotizimin e karakterit asimetrik nga burojnë edhe kategoritë *majtas/djathtas,* kudërshtitë *lart/poshtë, mashkullore/femërore, i/e gjallë/i/e vdekur*, etj., të cilat marrin vlera simbolike të veçanta në kultura të ndryshme dhe në vetë semiosferën (Lotman, 197). Ato bëhen kusht i domosdoshm edhe i modelimit artistik/letrar. Sipërfaqja e trupit (ku, siç do të thoshte Pallasmaa (2005, 45), *bota është e pasqyruar në trup dhe trupi është i projektuar në botë*), *kufiri diskret trupor*, ku janë vendosur kapacitetet shqisore, shpesh konsiderohet si kufiri midis *botës së brendshme* dhe *botës së jashtme* /madje, sipas Butler (1993, IX), trupat *jo vetëm që tentojnë të shenjojnë botën përtej vetvetes, por kjo lëvizje përtej kufijve të vet, lëvizja e vet kufijve, duket të jetë vërtet qendrore për atë cfarë trupat "janë"*/, ndërsa vetë trupi si një *hapësirë liminale* ku zënë fill inskriptimet diskursive, ideologjike e kulturore.

Kështu p.sh. në letërsinë e *realizmit socialist*, rëndom roli aktancial i antagonistit/kundërshtarit gjithnjë modelohet nëpërmjet projektimit negativ ideologjik/etik/estetik të *trupit*: "Ai trup i shukur mbi minder si ndonë qese misër, me këmbët e ngërthyera si mos më keq (e kishte zor fieraku *i pasur* të hante *fshatarçe*), me barkun kaluarth sipër mbi shalët e shkurtëra, nga të cilat dukeshin vetëm pulpat dhe shputat e këmbëve, ai trup, i parë sidomos për së larti, siç po e shikonte vajza, ishte me të vërtetë qesharak. Shto pastaj duart që fërkoheshin në të thatë, ndërsa ujët shkonte kot. (Xoxa 1987, 72)

2.7. Funksioni semiotik i *trupit* në *ecriture feminine* zë një vend të veçantë. Në të vërtetë, funksioni i tij parësor është në krijimin e *subjektit semiotik*, trup i cili nuk do të jetë vetëm një objekt midis objektesh të tjera në hapësirë. Konceptimi i trupit si themel i modelimit semiotik ka si pasojë krijimin e *vetes* dhe *tjetrit* si *subjekte semiotike, e jo thjesht objekte* (Lotman 206), siç ndodh rëndom në letërsinë e *realizmit socialist.*

Një shembull tepër domethënës të subjektivizimit semiotik femëror e përfaqëson teksti i E. Dones (romani "Hana" – "Vergine giurata", 2012). Përpos rolit të lartë modelues të hapësirës liminale – *aeroplani* – që lidhet me kategorinë e *fillimit të rrëfimit*, respektivisht të *kornizës* së botës së mundshme fiktive dhe hapësirës syzheore,

në të cilën nis procesi i transformimit të subjektit semiotik (të 'personazhit kryesor' Markut/Hanës), edhe kompozicioni i romanit, konfiguracioni narrativ, është në funksion të konstituimit të saj si subjekt semiotik, respektivisht zhvendosjes/ transformimit në kuadër të hapësirës kulturore/semiotike nga pozicioni i "objektit" (si "virgjëreshë e përbetuar", me trupin femëror të 'burgosur' brenda Tjetrit, trupit mashkullor. Nocioni "burrneshë" që përdoret me vlerë sinonimie e ngërthen në vete, edhe si formë gjuhësore, karakterin liminal thellësisht paradoksal) në subjekt semiotik e diskursiv, pra në një *Vetje autentike*. I gjithë teksti i romanit është në funksion të procesit të subjektivizimit të figurës kryesore – subjektit aktancial, i cili është në kërkim të 'objektit', rikthimit të seksualitetit femëror dhe sovranitetit të trupit – në kundërvënie ndaj institucioneve të detyrimit social (*Kanunit* dhe pushtetit të tij performativ), respektivisht *regjimit të së vërtetës që vendos çka do të njihet dhe çka jo si formë e pranueshme e të qenmit* (Butler 2005, 22). Procesi i këtij transformimi mund të përshkruhet edhe si në vijim: Hana si Marku si Hana/gruaja si burrë si grua/Vetja si Tjetri si Vetja; por edhe si transformim simbolik në kontekstin e *rites de passage*: 'trupi i vdekur', i shndërruar në "*burrë"* – 'trup i rilindur', i shndërruar në *"grua"*. Por, edhe këtë e arrin vetëm në takim me Tjetrin, në ekzil (hapësirë po ashtu liminale), në tjetërsinë kulturore, por edhe brenda një semiosfere tjetër (romani është shkruar në italisht). Ajo bëhet pjesë e semiosferës së 'vet' vetëm nëpërmjet procesit të *përkthimit/translacionit semiotik*.

Mirëpo, brenda *normativitetit heteroseksual* (Butler 1990) funksionon edhe diskursi letrar i Bessa Myftiut (Mytiu 2016). Tek ajo "trupi i burrit/mashkullit" konstituohet si *objekt dëshire,* si Tjetri që bëhet pjesë e vetes nëpërmjet *transferencës/tejbartjes erotike*. Në të vërtetë, Myftiu relacionin e shumëfishtë me tjetërsinë dhe subjektivizimin semiotik femëror, përveç me intensitetin simbolik të modelimit të relacionit erotik (madje edhe incestuoz) me tjetrin dhe veten, e realizon edhe në planin e relacioneve intertekstuale (narratorët intradiegjetikë – Anila, Diana dhe Monda - të saj takohen në një hapësirë liminale – Aeroportin Fiumiçino – duke e rikrijuar një situatë analoge narrative me *"Dekameronin"* /doemos *femëror*/ dhe me funksionin performativ të narracionit te "Një mijë e një net") dhe të ekzilit radikal kulturor e semiotik, ku Tjetri kulturor, semiosfera e "huaj" bëhet kusht i realizimit të Vetes. (Jo rastësisht Myftiu do të deklaronte: "Nuk do ta shkruaja kurrë në shqip të shkuarën time" (Myftiu 2012). Madje, ajo në semiosferën e Vet *i rikrijon tërësisht* tekstet e saj (Po aty), duke ia nënshtruar një interpretimi/translacioni radikal semiotik.

Trupat në ekzil, ekzili kulturor e gjuhësor – që, në të vërtetë, përfaqëson zgjerim të hapësirës së kulturës/semiosferës (Lotman 225) – në rastin e Dones dhe të Myftiut është kusht i domosdoshëm i subjektivizimit semiotik e diskursiv femëror.

2.8. Kategoria e liminalitetit, e trajtuar si më lart dhe posaçërisht në dimensionin e saj trupor/korporal, shpie doemos edhe te kategoria bazë e poetikës së tjetërsisë – *procesi i leximit*, respektivisht te relacioni midis lexuesit dhe tekstit. Leximi

në këtë perspektivë mund të shihet edhe si një hapësirë liminale e Tjetrit, pikërisht në hapësirën midis lexuesit dhe tekstit. Madje edhe vetë leximi mund të konsiderohe *si një akt dhe proces transubstanciacioni, ku trupi i lexuesit hyn në - hyn brenda vetë tekstit.* (Fernando 134). Ashtu si edhe vetë teksti brenda *trupit të lexuesit*. Edhe në këtë dimension, logjika e tjetërsisë e mundëson rikrijimin e vazhdueshëm të Vetes në raport me Tjetrin, qoftë edhe, siç do të thoshte Coleridge-i, në "aktin eternal të kreacionit në një UNË JAM të pambarim" (Gunn 62). Por, mbi të gjitha, *Tjetri/Tjetërsia* e bën të mundshëm tejkalimin e binarizmit, e mundëson shfaqjen e të resë; e në letërsi - kjo është një *conditio sine qua non* i ekzistencës së saj.

Literatura

Arnold, David Scott (1993) *Liminal Readings – Forms of Otherness in Melville, Joyce and Murdoch*. London: Macmillan.

Bahktin, Mikhail M. (1984) *Problems of Dostoevsky's Poetics*. (Tr. by C. Emerson). Minneapolis, Minnesota: University of Minnesota Press.

Berishaj, Anton (2010) *Letërsia per-formative*. Prishtinë: Buzuku.

Butler, Judith (1990) *Gender Trouble*. New York, London: Routledge.

Butler, Judith (1993) *Bodies that Matter*. New York, London: Routledge.

Butler, Judith (2005) *Giving Account of Oneself*. New York: Fordham University Press.

Dones, Elvira (2012) *Hana*. Tiranë: Botimet Dudaj.

Fernando, Jeremy (2009) *Reading Blindly – Literature, Otherness anf the Possibility of an Ethical Reading*. Amherst, New York: Cambria Press.

Garcia, Patricia (2015) *Space and the Postmodern Fantastic in Contemporary Literature – The Architectural Void*. New York, London: Routledge.

Gunn, Giles (1979) *The Interpretation of Otherness*. New York: Oxford University Press.

Hurt, Jonathan (2015) *The Poetics of Otherness – War, Trauma and Literature*. New York: Palgrave/Macmillan.

Laplanche, Jean (1999) *Essays on Otherness*, London, New York: Routledge.

Levinas, Emanuel (1997) *Vrijeme i drugo*. Podgorica: Oktoix.

Levinas, Emmanuel (1998) *Entre nous – Thinking-of-the-Other*. New York: Columbia University Press.

Levinas, Emmnuel (1999) *Alterity and Transcendence* (Trans. by Michael B. Smith). London: The Athlone Press.

Lotman, Jurij (2004) *Semiosfera*. Novi Sad: Svetovi.

Marko, Petro (2000) *Qyteti i fundit*. Tiranë: Shtëpia Botuese OMSCA.

Marko, Petro (2010) *Nata e Ustikës*. Tiranë: Dita books.

Merleau-Ponty, Maurice (1962) *Phenomenology of Perception* (trans. by Colin Smith). New York and London: Humanitis Press&Routledge&Kegan Paul.

Myftiu, Besa (2012) *Besa Myftiu: Nuk do ta shkruaja kurrë në shqip të shkuarën time* (intervistë me Oliverta Lila). Tiranë: Gazeta Shqip, 23 dhjetor.

Myftiu, Bessa (2016) *Dashuri në kohën e komunizmit*. Tiranë: Botimet Dudaj.

Pallasmaa, J. (2005) *The Eyes of the Skin: Architecture and the Senses*. London: Academy Editions.

Petrilli, Susan (2014) *Sign Studies and Semioethics – Communication, Translation and Values*. Boston/Berlin: De Gruyter Mouton.

Punday, Daniel (2003) *Narrative Bodies: Toward a Corporeal Narratology*. New York: Palgrave Macmillan.

Ricoeur, Paul (1994) *Oneself as Another* (Ttrans. by Kathleen Blamey). Chicago and London: The Universit of Chicago Press.

Thomassen, Bjørn (2014) *Liminality and the Modern – Living Through the In-Between*. Farnham/Burlington: Ashgate.

Trebeshina, Kasëm (1992) *Legjenda e asj që iku*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve.

Trebeshina, Kasëm (1994) *Mekami*. Prishtinë: Buzuku.

Xoxa, Jakov (1987) *Lumi i vdekur*. Prishtinë: Rilindja.

Anton BERISHAJ

THE SELF AS THE OTHER/ THE OTHER AS THE SELF
- Semio-ethics of Albanian literature -

Abstract

The category of The Other is fundamental and it is a necessary condition for any communicative and semiotic process/system. The other/Otherness is inevitable, it is even a structural category for life itself due to the fact that signs, bodies, and voices are equipped with the potential to respond to each-other dialogically (Petrilli, 2014). Thus, the logic of otherness is closely related to human semiosis, to polylogysm and polyphonism, which are typical for literature and its infinite semiosis. In this context, literature itself can be considered as The Other/Otherness. The Other is not only part of the inner spaces of the self as an alter ego i.e. as all that which I am not (Levinas, 1979), but the relationship between the reader and the author in the process of the literary communication is also a relation between the self and the other, where each is both the self and the other (Hart, 2015). The Other/Otherness are obligatory conditions of the modelling of the meaning/significance in literary texts; in fact, literature with its modelling of possible fictive worlds is a priviledged 'space'. The poetics of Otherness in Albanian literature is present in various forms and

dimensions. This study focuses on some of those which are most meaningful: 1. The transcendental/metaphysical/religious Other (Bogdani), 2. The political/cultural Other (Romanticism), 3. The ideological/stratous Other (Xoxa), 4. The Other as The Self/ The Self as The Other (Petro Marko) and The Self as a Radical Otherness (Trebeshina), 5. The Other as marking of gender/sex: the female body as The Other (Dones) and the male body as The Other and as the object of desire (Myftiu). The category of the other and otherness will be dealt with within the frames of a luminal/ethical reading which will aim at the delineation of a semio-ethics of Albanian literature.

Key words: the other, otherness, ethical reading, semioethics, the poetics of otherness.

Eljon DOÇE

"TË TJERËT E MIGJENIT"
(Drejt një poetike të margjinales)

> *"Mund të zbulosh të tjerët te vetja, të marrësh vesh se nuk je një substancë homogjene dhe rrënjësisht e huaj ndaj gjithçkaje që nuk është vetja: uni është një tjetër. Por edhe të tjerët janë unë-r subjekte si unë, që vetëm këndvështrimi im, për të cilin të gjithë janë atje dhe vetëm unë jam këtu, i ndan dhe i dallon vërtet prej meje."*[1]

Kur T. Todorovi flet për zbulimin dhe pastaj pushtimin e Amerikës, më shumë sesa si një fakt apo një e dhënë historike, ai këtë çast të historisë e trajton në një plan të thellë kulturologjik dhe antropologjik dhe brenda këtij plani duket se për tëështë jo thjesht zbulimi fizik i Indisë së supozuar fillimisht e cila më pas do të quhej Amerikë, porse zbulimi i tjetrit nga sytë e unit, në atë që Todorovi e quan si "takimi mëi habitshëm i historisë sonë".[2]

Na shërbejnë metaforat e*udhëtimit*,*zbulimit*dhe *takimit*kur i qasemi letërsisë për shkak se duket se në çdo akt receptimi estetik ka vazhdimishtbrenda një udhëtim drejt botëve të trilluara, pastaj një takim me të renë e të panjohurën (ose ritakim apo rinjohje me të njohurën), takim i cili në letërsi, në jo pak raste rezulton edhe në një zbulim (ose rizbulim) të diçkaje e cila ka qenë përherë aty dhe që ndoshta ka kaluar pa vëmendje, por që kur bëhet objekt i ligjërimit krijon ndiesinëepifanisë, shfaqjes apo zbulimit.

Duke e rilexuar veprën e Migjenit nën optikën e zbulimit të tjetrit, shohim se"tjetri", si personazhnë krijimtarinë e këtij autori është i pranishëm në mënyrëgati përjashtuese çka do të thotë se sidomos në nivel personazhi thuajse në të gjitha rastet personazhi është gjithnjë një "tjetër" dhe ky personazh ndërtohet duke mos pasur modele paaradhëse në traditën e letërsisë shqipe, pra është e pamundur të gjenden në të gjurmë personazhesh me të hershëm (të intertektualizuar), ose edhe kur këto gjurmë (gjegjësisht intertekste) janë, ato përherë vijnë si përpjekje për t'i parodizuar ose çmitizuar[3], praështë sistematike qëllimshmëria autoriale për t'i tëhuajësuar këta personazhe nga modeli prej të cilit zënë fill.

---

[1] Todorov, Tzvetan. *Konkuista e Amerikës (çështja e "tjetrit")*, përktheu P. Shllaku, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015.

[2] Todorov, T., po aty.

[3] Për këtë rast mund të kujtojmë këtu figurën e malësorit te "Legjenda e misrit" e cila është çmitizuar dhe kthyer në një figurë parodike dhe madje e gjithë skica është një parodi për aq sa

Arshi Pipa, ndër të parët lexues të Migjenit dhe mbase edhe ndër më tëvëmendshmit në kohë, e ka vënë re qysh herët dhe e ka nënvizuar faktin se personazhet e Migjenit janë tjetërsoj dhe se te ata ka diçka të ndryshme në raport me personazhet e tjerë që tradita krijuese shqipe kishte ofruar deri në kontekstin lerat të viteve '30.

Këtë fakt, në mënyrë sistematike e ka nënvizuar edhe kritika e realizmit socialist, por ndryshe nga qasja e Pipës, kjo lloj kritike është mjaftuar duke i parë personazhet që autori i marrë në shqyrtim ka krijuar, vetëm në planin e një analize ngushtësisht të drejtuar kah përplasja e shtresave apo, më saktë, klasave shoqërore.

Lidhur me personazhet e Migjenit Pipa shprehet:

"Ndër skutat e qelbta të rrugavet, mes poteravet të tymosuna të mejhanavet, mbi shtratet e zhyeme të prostitutavet,ndër burgje, ndër kësolla edhe ma t'errta se burgjet, lohet nji tragjedi (apo nji komedi?) e përherëshme. Njerëzit qi e losin (njerëz a maska?): lavira, rrugaça, dobiça, hajna, pijanecë, të burgosun, të sëmundë, të çmendun, sillen në nji valle fantasmagorike turpi e uje të pa-fund. […] Ky asht skenari qi zbulon syni i Migjenit. Tjerët kan kalue pa e shënue. Vagabonda, të burgosun, lavira! Bota sjell kryet mënjanë për mos me i pa kto qenje të mjera të neverituna…Migjeni i ban protagonist të poemavet të tij. Nji simpati e fortë e afron kah kta të dënuem, kah kto viktima të shoqnis."[4]

Duket se vetëdija krijuese e Migjenit merr dhe bën pjesë të botës së saj artistike një kategori të tërënjerëzoredhe tepër të pazakontë për letërsinë e kësaj periudhe në letërsinë shqipe, kategori e cila mund të emërtohet thjesht si "ata, të tjerët".

Në veprën e tij "Pushteti dhe dija" Mishel Foucault shprehet: *Shumë nga ne e kanë këtë ëndërr fisnike: t'u japësh më në fund fjalën atyre që deri më sot nuk e kanë marrë dot kurrë, atyre që u detyruan të heshtin nga historia, nga dhuna e historisë, nga tërë sistemet e sundimit dhe të shfrytëzimit."*[5]

Nga i burgosuri te"Kanga e të burgosurit", te i papuni në prozën e shkurtër "Moll' e ndalueme", pastaj te lypësi në "Një refren i qytetit tem", te Luli në "Luli i vocër", foshnja në "Bukuria qe vret", Zeneli në prozën me të njëjtin emër, Kola në "Bukën e përditshme falna sot", Trumcaku te "Vetvrasja e trumcakut", malësori në "Legjenda e misrit", përsëri malësori në "Recital' i malësorit", malësorja në "A do gjymyr zotni?" dhe ndoshta rasti më emblematik, Lukja në "Historia e njenës nga ato" dhe të tjerë shembuj si këta, personazhet janë në të gjitha rastet të deheroizuar (edhe atje ku pritet të jenë heronj) dhe madje në mjaft raste ata kanë trajta të antiheroit.

Duke i bërë pjesë e madje qendër të krijimtarisë dhe duke u dhënë zë këtyre personazheve, Migjeni bën, në letërsinë shqipe, pak a shumëdiçka të ngjashme me atë

shkruhet me ton\stil epik ndërkohë që ngjarja në vetvete nuk përmban asgjë e cila të mund të asociohet me legjendën.

[4] Pipa, Arshi. *Për Migjenin -tri ese*, Princi, Tiranë, 2006, f. 6.

[5] Foucault, Michel. "Pushteti dhe dija", ISP & DITA 2000.

që patë bërë Sh. Bodleri në poezinë e tij i cili duke kishte si muzë frymëzimi, ndër të tjera, edhe femrën, por një femër ndryshe, tjetër, atë që ishte shmangur si figurë e denjë për frymëzim poetik, prostitutën.

Të tjerët e Migjenit, janë personazhe të përditshmërisë, ata janë të rëndomtë, përgjithësisht nuk kanë ndonjë cilësi të dallueshme morale apo intelektuale, ose edhe kur e kanë, rrethanat në të cilat ndodhen nuk ua mundësojnë që ata të shkëlqejnë; ata mund të jenë madje me vese dhe shpesh (në mos gjithmonë) nuk ia dalin dot t'i shpëtojnë rrethanave në të cilat janë mbërthyer. Gjithsesi, *të tjerët* e Migjenit janë pikërisht aty për të dëshmuar ekzistencën e tyre dhe të drejtën që "tjetri", "i ndryshmi", "i huaji", "i mënjanuari", "alieni" etj. ka për të qenë pjesë e historisë dhe për t'u dëgjuar.

Migjeni, përmes personazheve tëkrijuar, të tjerëve, dëshmon se në vetëdijen e tij krijuese ka një qasje për të zhvendosur dhe ndërkëmbyer statusin e asaj çka përbën qendrën dhe të asaj çka përbën periferinë.Këmbëngulja e tij për ta ndërtuar thuajse të gjithëkorpusin e personazheve të tij me këta "të tjerë", çon vetëm në përfundimin se ai e ka pasur këtë një intencë autoriale të mirëpërcaktuar për ta drejtuar objektivin e vet krijueskah margjina, bota dhe jetët e vogla, të përbëra nga njerëz të vegjël, nga histori të vogla dhe pse jo edhe të rëndomta e deri fare banale, por për të zbuluar atje njëunivers të tërë,i cili gjallon dhe qëështë po aq njerëzor dhe i rëndësishëm sa ato që zakonisht (dhe gabimisht, gjithashtu) quhen "botë të mëdha".

Nëse vijojmë të flasim për konceptin e tjetrit, me interes gjejmë edhe toposin artistik në të cilin vendosen\marrin jetë ngjarjet dhe gjallojnë personazhet dhe ky interes vjen për faktin sepse "qyteti i veriut", te i cili identifikojmë Shkodrën (edhe pse nominalisht nuk përmendet asnjëherë në skicat apo poezitë e Migjenit) është një Shkodër krejt e ndryshme dhe madje e përmbysur në raport me një tjetër autor bashkëkohës te i cili gjejmë të njëjtin topos artistik dhe këtu është fjala për Shkodrën e Koliqit.Ndërkohë që te ky i fundit toposi letrar është në kufijtë e një Shkodre të mitizuar, gati utopike, në rastin e Migjenit, kjo Shkodër është pasqyra e përmbysur e së parës.Te të dy autorët kemi epifanizimin[6] e toposit dhe objektve, por epifania e njërit është epangjashme me atë të tjetrit.

Në këtë pikë, pashmangshëm mund të lindë pyetja se pse kjo zgjedhje e Migjenit në ndërtimin e personazheve dhe cilat mund të kenë qenë shtysat e brendshme, ndoshta edhe të pandërgjegjshme, të autorit për të shkuar drejt kësaj estetike?

Interpretimet mund të jenë të shumta dhe ndër vite studuesit, të nisur prej premisave të ndryshme teorike kanë dhënë përgjigjet e tyre çështje të ndryshme lidhur

[6] Për më gjerë për konceptin e epifanisë te Koliqishih Dhurata Shehri në "Koliqi mes malit dhe detit",Onufri, Tiranë 2006.

me krijimtarinë e Migjenit, interpretime të cilat nisin nga atomarksiste e deri nëpsikoanalitike.

Duke iu rikthyer edhe një herë M. Foucault-it, në trajtesën e hollësishme strukturaliste që ai i bën pikërisht kategorive të margjinalizuara brenda një shoqërie në "Pushteti dhe dija", mendojmë se ka një përgjigjje që ndoshta e kënaq pyetjen tonë dhe që duket se në rastin e Migjenit është një shpjegim i mundshëm se pse ai zgjedh për t'i bërë pjesë të ligjërimit të tij pikërisht *të tjerët*:

"Po vërtet, do të më pëlqente të shkruaja historinë e të mundurve."[7]

Bibliografi

Tzvetan Todorov, *Konkuista e Amerikës (çështja e "tjetrit")*, përktheu P. Shllaku, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015.

Michel Foucault, "Pushteti dhe dija", ISP & DITA 2000.

Arshi Pipa, *Për Migjenin -tri ese*, Princi, Tiranë, 2006.

Migjeni, Vepra, *Vargjet e lira dhe Novelat e Qytetit të Veriut*, mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi, Cetis Tirana,Shtypur në Gorenjski Tisk, Slloveni, 2002.

Dhurata Shehri, *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri, Tiranë 2006.

Eljon DOÇE

"THE OTHERS OF MIGJENI"
(Towards a marginal poetics)

Abstract

The purpose of this paper is to consider the concept of "the other" in the work of Migjeni.

Within the course of the many thematic, formal and, in general, aesthetic innovations that Migjeni brought to the Albanian literature of the 1930s, one can note the presence and even the exclusionary presence of the characters that may be called "the others".

Since the term "the other" consists only of the half of the dichotomy *"I-he/she (the other)* and *we-they (the others)"*, as well as the synonymous subordinate meanings of the "other" as, "the foreigner" "the different", "the outsider", "the alien", and also "the harmful", "the dangerous" etc., to Migjeni the apparent presence of this "other" encourages you to look at this dimension.

[7] Foucault, Michel. "Pushteti dhe dija", ISP & DITA 2000, f. 15.

Especially when we look at the historical context when his works were created, where such characters in Albanian literature did not seem to have been present.

With "the others" in Migjeni's work, we will not understand only the idea of creating different personalities/characters in the field of Albanian literature of this period, but in the "others" we will see his conscious selection to build his work by making present the poetics for the "other", a marginalised one, an attempt that can simultaneously bring the periphery to the center, or move the center to the periphery, ie to "others" where the Albanian literature had not yet gone, and where Migjeni went by gathering all of that which M. Foucault calls "the plebeian" in a way to give them a voice to speak for themselves.

Anila MULLAHI

"TJETRI" NË KRIJIMTARINË E AGOLLIT

Në periudhën para viteve '90, në kontekstin e një tradite të fortë të letërsisë së realizmit socialist, në qendër të veprave letrare vendoseshin heronjtë pozitivë, ata që krijoheshin sipas një modeli standard. Ata zhvilloheshin në vijë lineare dhe shpesh jo në përputhje me logjikën e brendshme. Tendenca për të krijuar "*tipa shoqërorë*" shkaktoi shuarjen e të veçantës dhe humbjen e kuriozitetit. Personazhet e këtyre veprave, janë dhënë pa dilema, pa kthesa të mëdha, pa thyerje shpirtërore, pa asnjë luhatje për jetën, për botën, për ekzistencën njerëzore. Pranë personazhit pozitiv janë ata që ose e adhurojnë ose duan të bëhen si ai, ndërsa në anën tjetër, në të kundërtën janë antagonistët, armiqtë.

Në veprat e Agollit, përveç këtyre dy grupeve ka nga ata personazhe që shihen si "të çuditshëm" ose "të parregullt" "jo korrekt". Ata nuk janë personazh negativë sepse nuk janë "armiq-pushtues" të jashtëm, nuk janë as "armiq të brendshëm të klasës", sepse nuk shpallin ide politike, por nuk janë as personazhe pozitiv, sepse nuk i ngjajnë aspak standardit. Ky lloj personazhi mund të konsiderohet si "tjetri", dhe në të vërtetë ai strehon thellë brenda tij të pavetëdijshmen e autorit.

Tjetri është një individ i cili perceptohet nga grupi, si dikush që nuk i përket, si i ndryshëm në një mënyrë thelbësore. Grupi e sheh veten si normë dhe gjykon ata të cilët nuk i plotësojnë elementët e saj. Tjetri mund të jetë në shumë forma, në rastin e Agolli shfaqet si ai që nuk është i indoktrinuar, por as nuk e kundërshton atë. Atij nuk i intereson politika, por nuk i intereson as ti kundërvihet asaj. Mos përfshirja, mos idealogjizimi i tij e bëjnë atë të ndryshëm. Ata shpërfaqin një tipar thelbësor që i dallon nga të tjerët, flasin hapur, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk kanë para syve të tyre velin e mashtrimit dhe e shohin realitetin ashtu siç është, pa idealizime.

Krijimtaria e Agollit është e mbushur me personazhe atipike, me karaktere të veçanta, me individualitete jashtë standardit, gjë që përbënte një largim të hapur nga parimet e metodës skematike zyrtare.

Tek "Kalorësi Lakuriq" Dane Gajtani është ndryshe nga të gjithë personazhet e tjerë të romanit. Ai është për ta i paturp, i pamatur, i pasjellshëm, i rrezikshëm.

Kapitulli i parë i këtij romani u botua në fillim të viteve '80 tek Hosteni në fund të vitit 1990, një variant i shkurtuar me titullin "I nëmuri" u dorëzua në gazetën Drita, dhe filloj të botohej në muajt e parë të 91.

Ngjarjet zhvillohen në periudhën kur ekonomia e shtetit komunist ishte në vështirësi të madhe, gjë e cila nuk pranohej. Veçanërisht studiuesit dhe shkencëtarët ishin ata të cilët kishin krijuar në letrat e tyre një imazh krejt ndryshe nga ai i vërteti. Në sytë e njerëzve më të nderuar të asaj shoqërie Akademikut Xheladin Apollonia, studiuesve Zyrap Kandari dhe Sotir Kucka, ai Dane Gajtani është "Tjetri". Ai perceptohet prej tyre si një individ që nuk bën pjesë në grupin e tyre. Ai ka të njëjtën origjinë si akademiku, dikur kanë qenë shokë klase, ai nuk shpreh asnjë pikëpamje ideologjike që mund ta kundërvërë politikisht me ata. Ai është i ndërtuar mendësish ndryshe prej tyre dhe gjykohet negativisht.

Grupi e sheh veten si 'standard' dhe gjykon ata që nuk i plotësojnë normat e tij të shprehurit dhe të sjellurit. Ai thotë atë që është e vërtetë, ndonëse e di se nga kjo do të ketë pasoja. Ai e thotë të vërtetën "troç" dhe kjo gjë perceptohet si mungesë e karakteristikës thelbësore të poseduar nga grupi, që është konformizmi. Ata thonë se "Ekonomia është një sukses i vërtetë".

Ndërsa ai thotë - "Ekonomia ndodhet në vështirësi të madhe, tufëzimi i bagëtive i gabuar". Ai është tjetër dhe shihet pothuajse gjithmonë si një qenie më e vogël apo më e ulët se ata. Ai është edhe i çuditshëm sepse është i guximshëm, ndaj ata edhe e kanë frikë atë. Ai është i rrezikshëm sepse është i ndryshëm. Prania e tij si "tjetër" i bën ata të bëhen më të bashkuar njëri me tjetrin. Ata përbëjnë një grup, të cilët nuk e duan njëri tjetrin dhe mezi presin që dikujt ti rrëshqasë këmba që ata ta shtyjnë, por përball atij, "tjetrit" ata janë bashkë sepse i bashkon pushteti. Ata janë nëse do të përdorim një shprehje të Fukos "të fabrikuar në mënyrë të kujdesshme".

Tjetri nuk dallohet aq shumë për pamjen nga të tjerët, sesa prej karakterit, por në "Kalorësi lakuriq" ai ka dhe ndonjë karakteristikë fizike dalluese, si qimet e hundës.

Ata kanë pushtetin mbi tjetrin, por për ta ruajtur atë i nevojitet ta mbajnë në kontroll atë ndaj e vëzhgojnë gjithë kohën çfarë bën. Fuko e lidhte pushtetin me njohuritë dhe informacionin.

"Tjetri" i Agollit shfaqet edhe si dikush i cili shfaq pasion të madh për jetën. Një mënyrë për ta shijuar atë me të gjitha kënaqësitë që të afron ajo, nëpërmjet humorit, të ngrënit e të pirit, femrave, të kërcyerit, të kënduarit siç është Cute Babulja në romanin "Arka e djallit". Një njeri i tillë me dashuri të madhe për kënaqësitë që të afron jeta nuk është në përputhje me heroin pozitiv i cili e "farkëton karakterin e tij mes vështirësive të mëdha". "Arkën e djallit", Agolli filloj ta shkruante në fillim të viteve '80, por e botoi në '97. Dy kapituj të tij janë botuar në revistën Hosteni qysh në fillim të viteve '80. Kjo kohështrirje e shkrimit të veprës e lejoj shkrimtarin të jetonte në dy kohë ku dimensionet e lirisë dhe perceptimet letrare kishin ndryshuar plotësisht.

Cute Babulja ka një filozofi të tij për jetën, për atë që ndodh, për mënyrën sesi e jeton jetën. Ai është ndryshe nga të tjerët. Është një njeri i ditur, i lexuar i lë me gojë hapur me mendimet e tij jo vetëm njerëzit e mbyllur brenda kufijve të Shqipërisë komuniste, por edhe studiuesit nga tërë bota që janë mbledhur në Kongresin Botëror

për letërsinë dhe kulturën popullore në Konian. Mendimet e tij të thëna nga gjithkush tjetër janë të papranueshme nga shoqëria dhe koha kur jeton. Por është mënyra sesi ai i thotë ato, i qeshur, i dashur, gati naiv, që e bëjnë atë të falshëm. Ai i thotë gjithmonë me humor, të fshehura pas shprehjeve popullore, nën avujt e alkoolit. Ai është ndryshe, ai as nuk e merr mundimin të flasë me petkun e nëpunësit, nuk i pëlqen të flasë me shprehjet standarde të kohës, flet si të ishte një këngëtar popullor, herë si një i çmendur, herë si një i dehur që nuk duhet t'ia vësh veshin. Ai këndon, ai kërcen jo vetëm në vendi e tij por edhe jashtë. Ai është tjetri që i habit të tërë ata që janë rreth e qark tij. Ai është tjetri jo vetëm për ata që flasin gjuhën e tij, jo vetëm ata që e duan por edhe ata që nuk e duan. Ai ndërhyn mes valltarëve dhe kërcen vallen e Semasë, ndonëse ka shekuj që nuk ka ndërhyrë askush në të, madje ai se ka kërcyer atë kurrë më parë.

Ai është i ndryshëm, ndaj është edhe i rrezikshëm. Ai rrezikon veten me ato që thotë, por dhe miqtë e tij që i rrinë pranë dhe e dëgjojnë, dhe nuk janë aq të guximshëm sa ai. Me pasionin, me energjinë, vrullin, ai tërheq vëmendjen. Atë e vëzhgojnë vazhdimisht, për të mbledhin informacion, shkruajnë letra, bëjnë raporte. Ata që janë ndryshe vëzhgohen vazhdimisht nga ata që kanë pushtetin ose që duan ta ruajnë atë. Sapo ata identifikohen si të tillë menjëherë fillon mbledhja e informacionit për ta. Fuko në 1977 do të shkruante: "Pushteti vjen nga informacioni, njohuritë që akumulohet nga vëzhgimet e veprimeve, në një mënyrë rrethore" "duke u kombinuar dhe i përgjithësuar, ata arrijnë një nivel në të cilin informacioni dhe rritja e fuqisë rregullisht përforcojnë njëra tjetrën"[1]. Të gjithë duan që të zhduket dorëshkrimi i shkrimtarit të dënuar Bamkë Dynjaja sepse ai brenda tij ka shumë informacion që mund tu japë disave pushtet dhe disa mund ti fundosë.

Cute Babulja ashtu si Dane Gajtani kanë një të përbashkët, vazhdimisht këndojnë nën zë ose me zë. Ata janë shpirtra të lirë dhe kënga buron nga shpirti dhe është shenjë e lirisë dhe dashurisë për jetën.

Një tjetër është edhe Sherif Abeceja, shkrimtari që nuk ndalet para asgjëje për të zbuluar dorëshkrimin e zhdukur. Ai nuk i fiksohet asaj që do të ndodhë, por do domosdoshmërish të jetë ai i pari që do ta zbuloj atë. Diku arrogant, diku i sjellshëm, i kulturuar që nuk e merr mundimin të përzihet me të tjerët duket se ai e ka zgjedhur vetë të jetë një tjetër, si vazhdim i famës së shkrimtarit të famshëm që vjen nga Tirana. Ai është një tjetër që nuk përpiqet të fshehë ndryshimin madje e thekson atë.

Rita te "Kalorësi lakuriq" dhe Anthulla tek "Arka e djallit" janë dy personazhe femra të një forme krejt të ndryshme nga personazhet femra të letërsisë paraprijëse të Agollit. Për personazhet e tjera femra të veprave të Agollit flitet si " për ndihmëse në shërbim të burrave, nënat e fëmijëve si dhe kujdestaret e shtëpive"[2]. Krejt ndryshe

[11] Michel Foucault, Discipline and Punish: the Birth of the Prison, Vintage Books, 1977

[2] A. Saraçi, D. Agolli personalitet i shquar i letërsisë dhe kulturës shqiptare, Konferenca kushtuar shkrimtarit dhe akademikut Dritëro Agolli, Prono-print, Korçë, 2012, f. 94.

janë Anthulla dhe Rita. Sensualiteti është një nga tiparet dalluese të tyre dhe i shfaqur shumë lirshëm në gjithë praninë e tyre. Ata shfaqin një liri të çuditshme dhe rrallë të gjetura në figura të tjera femrave të letërsisë së kohës. Rita është e bukur por kokëkrisur, bën gjithmonë atë që i do mëndja, e bën këtë aq shpesh sa e ka bërë tipar karakteristik të saj e ndonjëherë ë shfaq atë edhe thjeshtë për inat të vëllait të saj që është kaq i standardizuar e që do të thotë i mërzitshëm për të. Jo rastësisht do të shfaqë shumë interes ndaj Dane Gajtanin, i cili i duket krejt ndryshe.

Anthulla një shartim i sensualitetit të figurave femërore të poezive erotike të letërsisë popullore dhe gruas të zgjuar dhe të pavarur që vendos çdo gjë vetë për jetën e saj. Ajo është mjeke, e bukur, shëron trupin e sëmurë dhe zemrat e sëmura. Ajo dashurohet me Sherif Abecenë, por sapo humb interesin për të nuk e merr mundimin ti shkoj pas.

Në grupin e personazheve që mund ti etiketojmë edhe si tjetri, mund të përfshijmë dhe ata të cilët ndonjë studiues shqiptar i quan ata nga të cilët "s'mund të presësh vetëm ndriçim virtyti, por edhe dobësinë njerëzore"[3] të tillë mund të konsiderojmë Mato Grudën në romanin "Njeriu me top" ose Komandantin Rrapo tek "Komisari Memo". Në këto raste, "tjetri" në fund i nënshtrohet normës së grupit, ndonëse duhet të theksuar se edhe ekzistenca e tyre si të ndryshëm, i bën veprat e Agollit të dallojnë nga të tjerat.

Në krijimtarinë e Agollit "tjetri" shfaqet në forma të ndryshme herë si dikush që ka një mendësi tjetër si Mato Grudo që vendos të ndryshojë, herë si Cutja tek Arka e djallit që ndonëse e di që ai thotë të vërtetën, më dyshet nga frika e pasojave të saj, por e vërteta është brenda tij, e shpërfaqet në të gjithë format e marrëzisë. Krejt ndryshe shfaqet Dane Gajtani te "Kalorësi lakuriq" ai nuk do të ndryshojë, pavarësisht se sjellja e tij i krijon një status inferior ndaj të tjerëve shoku i tij i dikurshëm aspak më i zgjuar se ai është akademik. Ai fillon të ndiqet të dhe vëzhgohet, por ai nuk shfaq frikë.

Sherif Abeceja është tjetri që me dëshirë mëvetësohet nga të tjerët edhe është i bindur se është më i zgjuar, më i kulturuar dhe nuk gabon për këtë. Ai nuk njëtrajtësohet me të tjerët, por as përpiqet të përballet me ta, as t'u thotë ndonjë të vërtetë.

Personazhet atipik të Agollit, që njëtrajtësohet ose që refuzojnë të njëtrajtësohen, krijojnë shumësinë e identiteteve njerëzore të një shoqërie të caktuar në një fazë zhvillimi të dallueshëm.

[3] Shaban Sinani, "Njerëzit e krisur të Dritëro Agollit, Naimi, Tiranë 2012, f. 148.

Anila MULLAHI

"THE OTHER" IN AGOLLI'S WORK

Abstract

In the period before the 1990s, in the context of a strong tradition of socialist realism literature, the positive heroes were placed in the center of the literary world; those that were created according to a standard model. They were developed in a linear way and often were incompatible with the internal logic. The tendency to create "social characters" caused the extinction of the particular and loss of curiosity. The characters of these works appear without any dilemmas, without great twists, without spiritual breaks, without vacillation for the life, the world or the human existence. Near the positive character are the others, who worship them or they want to resemble to the heroes; while on the other side, opposite them are the antagonists, the enemies.

In Agolli's works, besides these two groups, are those characters that are seen as "weird", "irregulars" or "incorrect". They are not negative characters because they are not "enemies" but they are not even positive characters because do not resemble the standard example at all. This kind is considered as "the other", and actually this is what it is deep inside the unconscious of the author.

"The other" is an individual who is perceived by the group as someone who does not belong, as different in an essential way. The group sees themselves as the norm and judges those who do not meet the norm elements. "The other" can have many forms, in the case of Agolli appears as one who is not indoctrinated. He is not interested about politics, but either he is interested in objecting it. His non-inclusion and non-ideology make him different. They reveal an essential feature that differs from others; speak openly and directly and do not have the veil of deceit in front of their eyes and they see the reality as it is, without idealizing it.

In some cases at Agolli's characters, "the other" is ultimately subjected to the group's norm, but also their existence as being different, makes Agolli's works distinct from the others. One form of "the other" can be considered Commander Rrapo in the novel "Commissar Memo" or Mato Gruda in "The Man with the Cannon".

There are other cases where Agolli's "the other" it may be someone who shows great passion for life. A way to enjoy life with all the pleasures that it brings, through humor, eating, drinking, dancing, women, as it is Cute Babulja in the novel "The Ark of the Devil". Such a man with great love for life and the pleasures that life brings is not in line with the positive hero "whose character is shaped among the great difficulties". Agolli's literature work is filled with atypical characters, with special

features, with individuals in conflict with the society norms, which consists in alienation from the principles of the official frame method.

Belfjore QOSE

"KONCEPTI I TJETRIT SI PËRJASHTIM DHE SI VETËPËRJASHTIM TEK "ODIN MONDVALSEN" I K. TREBESHINËS"

"Odin Mondvalsen" është një nga romanet e pakta të letërsisë sonë që fillon me një diskutim ekzistencialist: "*ku tregohet kush jam unë dhe kush nuk jam unë*"[1].Përgjigja që marrim që në fillim të veprës nuk na qartëson aspak në raport me identitetin e personazhit, por i vetmi tregues me të cilin mund të dallojmë tiparet e tij, identitetin e tij, raportin e tij me të tjerët, pra atë çka ai është dhe nuk është, është pikërisht emri i tij. Menjëherë ai është i identifikueshëm si *tjetri, i ndryshmi, i përjashtuari.* Punimi do ndalet në dy mënyra kryesore përmes të cilave e shohim të realizuar këtë veçim të personazhit, si përjashtim nga shoqëria dhe si vetëpërjashtim nga vetë subjekti.

Të qenit ndryshe është tipari i parë i këtij personazhi, me anë të të cilit ne kuptojmë midis narracionit fragmentar dhe ligjërimit kinse irracional, se çfarë nuk është personazhi rrëfimtar në këtë vepër. Dhe kjo nuk ka të bëjë me një kuptim filozofik të të qenit tjetri, ku çdokush prej nesh është një tjetër në raport me një grup të caktuar, ku për terminologjinë e Derrida-së të gjithë jemi *tjetri*[2]. Ai qartësisht nuk është pjesë e shoqërisë, sepse menjëherë kuptojmë se gjendet në spital psikiatrik. Në fund të romanit personazhin do e shohim të dalë nga çmendina në botën normale, duke na u dhënë mundësia e krahasimit midis dy vendeve dhe organizimeve krejt të ndryshme, si dhe për të parë marrëdhëniet e personazhit me këto dy realitete.

Ne të gjithë kemi nevojë të identifikojmë subjekte si *tjetri* në mënyrë që të përkufizojmë vetveten, kjo është një pasojë e natyrshme e të menduarit të botës mbështetur në dualitete. Natyrisht, kjo na çon në karakterizimin e tjetrit si më inferior dhe negativ në raport me tiparet dualizuese, cilatdo qofshin kriteret, fetare, gjinore, klasore etj. Deri këtu duket se ngjasojmë me çdo kulturë, e cila krijon identitet përmes identifikimit të të huajit, por edhe njeh grupe dhe individë si *të tjerë*, duke duke i përjashtuar nga brenda saj. Tzvetan Todorov në "Konkuista e Amerikës", çështja e *tjetrit*, dallon dy grupe kryesore të huajsh.

"Mund t'i konceptoj këta të tjerë si abstraksion, si një instancë e konfigurimit psikik të çdo individi, si *tjetrin*, tjetrin në lidhjet që ai ka me mua, ose si një grup social

[1] Trebeshina, Kasëm, *Legjenda e asaj që iku*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1992, f. 81.

[2] Derrida, Jacques, *The Other Heading, Reflection on Today's Europe,* Indiana University Press, 1992 (First Edition 1991), pg. 45.

konkret të cilit ne nuk i përkasim. Ky grup, nga ana e tij, mund të jetë i brendshëm për shoqërinë: gratë për burrat, të pasurit për tëvarfrit, të marrët për normalët; ose mund të jetë i jashtëm, pra një shoqëri tjetër, e cila do të jetë, sipas rastit e afërt ose e largët."[3]

Na duhet të shohim më afër në romanin e Trebeshinës, për të kuptuar ku qëndron veçantia e *tjetrit* në kronotoposin konkret, duke dalluar një botë absurde, ku spitali psikiatrik dhe bota e njerëzve të shëndoshë mendërisht ndërkëmbejnë vendet. Në letërsinë botërore njohim mjaft raste ku shkrimtari përdor çmendinën si vendngjarjen e veprës dhe joshet nga dikotomia gjuhësore që mund të përdoret pas fjalëve të një personazhi të çmendur. Hamleti është modeli më përfaqësues i përdorimit të çmendurisë si *maskë* për të thënë të vërteta që ndryshe nuk thuhen dot, për të përballuar krizën etike dhe morale si dhe traumën personale. Derivati logjik i këtyre modeleve të përdorimit të çmendinës dhe të të çmendurit në letërsi, na çojnë menjëherë në pyetjet nëse Odin Mondvalseni është vërtetë i çmendur dhe nëse çmendina është vërtetë e tillë, pra një *heterotopi*, apo është një ndërtim i rremë, si një pasqyrë e rreme qëndihmon tënxjerrim në pah të vërtetën?

Odin Mondvalseni si personazh është një rast i veçantë në letërsinë tonë, për vetë mënyrën me të cilën ai ndërtohet dhe se si paraqitet identiteti i tij. Nuk kemi të bëjmë me një rrëfim klasik, në të cilin personazhi menjëherë paraqitet me të gjitha tiparet e tij, madje duke na treguar edhe të shkuarën e tij, fëmijërinë etj. Përkundrazi, analogjia e rrëfimit letrar e ngjarje të supozuara jetësore thyhet që në fillim të rrëfimit. Ne kemi pritshmërite tona në raport me një roman i cili titullohet me emrin e personazhit që ka në qendër, duke pritur një identitet relativisht të qartë dhe një narracion që mbështetet në parimin e kronologjisë së ngjarjeve. "Premtimi" se në këtë roman do tregohet se kush është dhe kush nuk është personazhi, ka një kuptim krejt të ndryshëm nga ai që presim dhe kjo befasi i jep një përmasë edhe më të thellë të ontologjisë së personazhit. Personazhi me identitet të koklavitur dhe me vetëdije të traumatizuar, shmang përngjasimet me modelet e narracionit klasik, të tipizimit duke marrë përmasa më universale dhe përgjithësuese. Figura e tij mund të vendoset në dy përmasa interpretimi, së pari Odini është individi i mbyllur në çmendinë, i huaji, tjetri universal, i përjashtuari i cili pohon një identitet që menjëherë e kuptojmë se është i trilluar. Nga ana tjetër, duke parë shenjat e qarta që i japin një referencë kohore ngjarjeve të paraqitura në roman, ai është një i dënuar politik gjatë periudhës së diktaturës, i cili i sëmurë mendërisht, me vetëdije ose jo krijon një identitet tjetër për veten. Duke krijuar emrin e tij dhe mbi të gjitha duke ndryshuar kombësinë, personazhi rrëfimtar shpreh vullnetin e plotë të qenies së tij për të mos i përkitur mëasaj shoqërie që e ka dhunuar dhe më pas përjashtuar.

[3] Todorov, Tzvetan, Konkuista e Amerikës, cështja e *tjetrit*, Primo Shllaku, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015 (bot I 1982), f. 11.

Edhe në pikëpamje të procedimit letrar, që ndikon natyrisht edhe në konceptin e këndvështrimit, "Odin Mondvalseni" është një roman me shenja të qarta të modernitetit, në këtë model paraqitet edhe personazhi rrëfimtar. Ai nuk portretizohet vetëm nga rrëfimet e tij për veten, por siç analizon instancat narrative në vepër Dh. Shehri, ai paraqitet nëpërmjet shumësisë së këndvështrimeve:

"Në veprën Odin Mondvalsen, pavarësisht se është tregimtari ai që tregon përvojën e vet, ai vetë (në kuptimin klasik të përcaktimit të një personazhi, qoftë edhe ai kryesori) mbetet qëllimisht i paqartë ose, për ta shprehur më saktë, përcaktohet në disa variante. Kështu kemi:

1. Fjalët e tregimtarit për karakterizimin e vetvetes;

2. Fjalët që tregimtari thotë se "i kanë thënë personazhet për të", ku dallojmë:

a. Karakterizimit sipas fjalëve të Faraonit të Madh dhe Putifarit;

b. Karakterizimi sipas fjalëve të të tjerëve."4

Jemi të qartë se emri dhe kombësia e tij janë të trilluara, por gjatë romanit hamendësojmë nëse marrëzia e Odinit është maska e tij dhe njëherësh shpëtimi i tij, pra duke u fshehur pas marrëzisë ai mund t'i shpëtojë golgotës së dënimeve dhe nga ana tjetër nëse ai është vërtetë i sëmurë mendor. Këtë dyshim e ngre pohimi që vajza, e dashura e tij i thotë Odint ndërsa e këshillon se nga kush duhet të ketë kujdes e nga kush jo *"Kujdes me atë njeri!... Kurse me atë mjekun plak... Ai është i mirë. Atij mos i thuaj që të quajnë Odin Mondvalsen!... Nuk është i keq ai... Dhe do të na ndihmojë."*[5] Mendimi se personazhi ka zgjedhur të fshihet pas marrëzisëështë i gjendshëm shpesh në letërsinë e krijuar nën sisteme diktatoriale dhe censurë të ashpër. Ndërsa e provokojnë të flasë për kulakët, ai kujton porosinë e të dashurës, ai pohon se është danez dhe se nuk i lejohet të ndërhyjë në punët e një shteti tjetër.[6]Mjafton të kujtojmë personazhin e Mjeshtrit në një nga romanet më të mëdha të letërsisë moderne ruse, "Mjeshtri dhe Margarita", në të cilin po ashtu personazhi e gjen mënyrën e tij të mohimit të botës duke u izoluar në çmendinë. Nga ana tjetër Odini duket se vërtetë e beson identitetin dhe prejardhjen që ka krijuar për veten. Pëveç "Kapitullit të parë, të dytë dhe të tretë" ku ai paraqet si e mendon veten dhe duke qenë se të dhënat për veten e tij përzihen me pohime jologjike dhe për rrjedhojë dyshojmë në fjalët e tij, ka dy momente të tjera përgjatë rrëfimit, në të cilat ndihet edhe më shumë se Odini vërtetë beson në identitetin e pohuar. Një prej tyre është momenti ku vajza e këshillon që të dalë nga çmendina duhet të thotë se është shqiptar dhe jo danez, ndërsa Odini ripohon se është danez. *"Fol pak dhe qartë... Kryesorja është të mos i zësh me gojë ato punët e Danimarkës. U thuaj*

[4] Shehri, Dhurata, *Trebeshiniana, Trajtat e rrëfimit në romanin Odin Mondvalsen të K. Trebeshinës,* Faik Konica, Prishtinë, 2001, f. 77.

[5] Trebeshina, Kasëm, *Legjenda e asaj që iku*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1992, f. 105.

[6] Po aty, f. 105.

atyre që je shqiptar. E kupton? Kjo ka rëndësi të madhe. – Mirë, i thashë, megjithëse nuk më vinte hiç mirë që të mohoja kombësinë time daneze."[7]

Momenti tjetër dhe më i rëndësishmi për të përfocuar këtë mendim është fundi i romanit, në të cilin personazhi pohon *"Oh!... Sa larg që ishte Danimarka!..."*[8] Në këtë moment është e qartë se nuk vlen logjika se personazhi ka diçka për të fshehur, këtu Danimarka del si vend i dëshiruar, i ëndërruar. Ajo është utopia me një rend tjetër shoqëror pse jo dhe vlerash. Jo më kot edhe emri i Odinit na vjen nga mitologjia nordike, e mbrujtur nga heronj dhe vlera të larta morale, e largët kulturalisht, moralisht, por edhe gjeografikisht prej vendit ku ai jeton, por nuk ndjen se i përket. Danimarka e tij është një vend i krijuar në mendjen e tij, një vend joreal, por i vërtetë për qenien e Odinit, i cili kishte arritur pikërisht në çmendinë qetësinë e tij relative, duke mohuar botën në të cilën jeton. Aty kur ai tenton t'i kthehet realitetit, gjithçka shkatërrohet pa kthim! Larg prej ndikimit të zëvendësimit të toposit dhe përjashtimit të individit, qëndron zemërimi i zmadhuar, i theksuar ndaj hipotezës së çmendurisë së personazhit. Sepse në fund të fundit, çmenduria matet gjithnjë në raport me normalitetin e një shoqërie.

Si duhet kuptuar Odin Mondvalseni midis kësaj dikotomie? Në kapitullin "Çështje të marrëzisë" në "Historia e marrëzisë në periudhën klasike, Fuko dallon tipare të ndryshme të të sëmurit mendor, kryesisht të prekur nga melankolia, ku në thelb ai zëvendëson gjësende që nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, për shembull lënda i zë vendin trupit të tij dhe shkon deri në pikën ku mund të shohë ndryshime tek vetja. Ndryshe nga deliri, skizofrenia, apo idetë fikse, fobitë etj., melankolia është një gjendje ku *"Nga njëra anë mund të veçojmë simptomat dhe shfaqjet e saj në një lloj të veçantë trishtimi, vetmie, ngadalësie dhe palëvizshmërie. Nga ana tjetër mund të sugjerohet një bazë e cila nuk mund të jetë më një psikologji e humorit, por e patologjisë për një ide, frikë dhe tmerr. Entiteti ngjethës nuk përkufizohet nga shenja të jashtme dhe as nga shkaqe të supozuara, por diku ndërmjet dhe përtej tyre."*[9]Po kështu, Fuko shton se *"Shpirti i tyre është i mbushur me shqetësime, por të shoqëruara me pafuqi, pa asnjë lloj dhune: një lloj goditje e pafuqishme që nuk drejtohet kundrejt diçkaje dhe as krijion rrugë, por krijon një gjendje mendore në të cilën pafundësisht krijon pore të reja, ku shpirti nuk ikën larg nga rrugët që ndjek, shumë shpejt shqetësimet kthehen në brenga, fuqia bie dhe lëvizja ndalon."*[10] Pikërisht Odini është një i marrë që nuk vepron dot, apatik, ka humbur aftësinë për të reaguar, por nga ana tjetër kemi shenja të një aftësie mendore herë herë edhe më të lartë sesa të njerëzve të zakonshëm, që humbasin mjaft nga vetëdija për qenien duke u kufizuar në jetën praktike dhe në perceptimin shqisor. Ndërsa flet për shamanizmin dhe aftësinëmbinjerëzore tëkëtyre njerëzve të shenjtë, por edhe të

[7] Po aty, f. 134.
[8] Po aty, f. 154.
[9] Foucault, Michel, *A History of Insanity in the Age of Reason*, Translated by Richard Howard, Vintage Books, New York (2nd edition) pg. 120.
[10] Po aty, f. 121.

përjashtuar nga shoqëria, Mirçja Eliade vë në pah pikërisht nevojën e tyre për të kaluar një proces tranformimi, një lloj vdekjeje të jetës së mëparshme për të krijuar një entitet të ti. *"Nganjëherë shamani i ardhshëm rrezikon të jetë i pranuar gabimisht si i "çmendur", çka ngjet shpesh ndër malajanët – por në realitet "çmenduria" e tij, përmbush funksion mistik: hap para tij anë të caktuara të realitetit, të cilat janë të pambërrijshme për vdekatarët e rëndomtë, dhe vetëm pasi ky "i çmendur" të ketë provuar gjithçka, hyn në këtë dimension të fshehtë, ai bëhet shaman."*[11]

Odini nuk merr përsipër ndonjë mision të shenjtë, por shpjegimi për këtë gjendje ku bashkekzistojnë marrëzia dhe herë pas here shenja të një vëzhgimi më të thellë për botën, lidhet me analizat e mësipërme. Ndërmjet kësaj dikotomie të*marrëzisë* së personazhit duhet të ndalemi për të reflektuar mbi metrin e një shoqërie që e përjashton atë.

Odin Mondvalseni nuk është cilësuar si *tjetri* për arsye të marrëzisë së tij, sepse ajo çfarë mjekët e marrin për të tillë, në fakt është një gjuhë më e ndërlikuar, më e thellë dhe për pasojë përtej "normalitetit" të krijuar në utopinë e supozuar, por që nuk është e tillë për asnjë çast. Vajza e këshillon Odin Mondvalsenin që të flasë sa më thjesht me mjekët, në mënyrë që ata të firmosin për daljen e tij nga spitali. Thjeshtësia e mendimit bëhet atribut i dëshirueshëm për njerëzit "normalë", për njeriun e ri – rievokojmë dëshirën e kahershme të diktatorëve për të zëvendësuar njeriun me një qenie më të thjeshtë, më të vogël, më të sundueshme. Fragmenti që vijon pasi Odini duhet të flasë "thjesht dhe normalisht" në mënyrë tepër domethënëse lidhet pikërisht me këtë ide:

"Bota dikur në kohë të shkuar ka qenë më e madhe jo vetëm se ishin shumë të pakët, megjithëse fjalët i kishim më të shumta... [...] Bota është zvogëluar fare dhe është mbushur me madhërinë e atyre që kërkojnë ta varrosin madhërinë dhe nga dëshira për lavdi e atyre që ngërdheshjet e majmunëve i marrin për fillimet e qytetërimit të njerëzimit."[12]

Të jesh dikush që mendon në fund të fundit na qenka tjetri. Jean Baudrillard në "Simulakra dhe Simulacioni", pohon se kalimi drejt fazës së re, ku imazhet thjeshtëzohen dhe për pasojë tjetërsohen dhe në fakt kthehen në një utopi të mirëfilltë, sepse ato nuk përfaqësojnë asgjë veç vetes, ka ndodhur nëpërmjet këtyre hapave.

"Imazhi është një reflektim i një realiteti të thellë.
Imazhi denatyralizon dhe maskon një realitet të thellë.
Imazhi maskon mungesën e një realiteti të thellë.
Imazhi nuk ka asnjë marrëdhënie me asnjë lloj realiteti.
Imazhi është një përngjasim i kulluar i vetvetes."[13]

---

[11] Eliade, Mirçja, *Mitet, vegimet dhe misteret, kapitulli: Realitete arkaike,* përktheu Agron Tufa.
[12] Po aty, f. 144.
[13] Baudrillard, Jean, *Simulacra and Simulation,* Translated by Sheila Faria Glaser, University of Michigan Press, Michigan, 1995, pg. 6.

Baudillard vendos në raporte kundërshtuese përngjasimin (simulacrum – të kopjosh pa një origjinë) me përfaqësimin, të cilat në shqip mund të duken e njëjta fjalë, për shkak të mundesës së terminologjisë, por që shpjegimi do i bëjë më të qarta. Përfaqësimi rrjedh nga parimi i barazisë midis shenjës dhe reales edhe nëse ky barazim është utopik, kjo është një aksiomë themelore. Përngjasimi nga ana tjetër, rrjedh nga utopia e parimit të ekuivalencës, nga mohimi radikal i shenjës si vlerë, kuptim. Çdoherë që përfaqësimi përthith përngjasimin si një përfaqësim të pavërtetë, përngjasimi përfaqëson vetë përfaqësimin. Në shkallën e parë, përfaqësimi funksionon si një përfaqësim i gjërave të shenjta, ndërsa në fazat e fundit manipulimi me realen, është kthyer ne vetë imazhin.

Ky përfaqësim pa imazh, të cilin Baudrillard e quan si 'përngjasim', emërton më së miri tërë ndryshimin kulturor, si epokë e leximeve të përmbledhjeve mbi librat dhe jo vetë librat dhe me tej, leximin e përmbledhjeve të përmbledhjeve, deri në thjeshtimin minimal të dijes, e cila kthehet në një imazh të vetes. Dhe një thjeshtëzim i tillë ndonjëherë nuk është vetëm mungesë inteligjence, por edhe spekullim me të vërtetën.

Thjeshtëzimi, zvogëlimi dhe më së fundmi skllavërimi mendor është i qartë qëkurse që të hysh në botën e normalëve duhet të jesh me patjetër i thjeshtë, të mos kërkosh të vërtetën, lëre më nëse përsijat mbi metafizikën dhe qenien. Në *Historinë e marrëzisë,* Fuko vëzhgon natyrën e mendimit mbi të marrin, i cili herë herë është ai që mund të përkapë të vërteta më të larta sesa njerëzit e zakonshëm, por përfundon duke qenë po ashtu *tjetri:*

"Paradoksalisht ky çlirim vjen nga një zgjerim i kuptimit, nga një vetëshumim i sensit, që end në mes të gjërave lidhje të shumta, kaq të gërshetuara dhe të pasura, sa mund të deshifrohen vetëm me ezoterizmin e dijes; nga ana tjetër, gjërat mbingarkohen me atribute, më shenja, me aluzione, në të cilat humbet fizionomia e tyre e veçantë, kuptimi nuk mund të kapet me një perceptim të menjëhershëm."[14]

Fraza më domethënëse për të shënuar marrëzinë dhe njëherësh aftësinë e tij për të depërtuar më thellë në qenien njerëzore, e cila në fakt krijon që në fillim dyshimin nëse kemi të bëjmë me një të çmendur të zakonshëm, është "Duket Harizit të Dajlanit i kishte humbur gomari dhe ne u nisëm në Mars që ta gjenim. Pesë vetë për një gomar... Dhe ne ishim që të pestë*komisarë*."[15] Aludimi është i qartë dhe njëherësh bëhet i qartë edhe kronotoposi letrar.

Pasi jemi ndalur në fizionominë e identitetit të personazhit dhe ndërlikimet që sjell në vepër, na duhet të ndalemi në atë që përfaqëson në një kuptim më përgjithësues, *çmendina* në këtë roman. Çfarëështë spitali psikiatrik? Një utopi, antiutopi

[14] Fuko Mishel, *Historia e marrëzisë në periudhën klasike*, Leka Toto, Toena dhe Sh.L.K, 2003, f. 20.

[15] Trebeshina, Kasëm, Legjenda e asaj që iku, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1992, f. 82.

ose distopi, apo një heterotopi? Utopi, shoqëri ideale jo se jo, por gjithashtu nuk mund të themi edhe se është antiutopi, pra një botë e ndërtuar në mënyrë të tillë ku gjithçka është negative. Çmendina është një*heterotopi*, një realitet ndryshe, që bota "normale" të ndihet utopike, duke përjashtuar nga brenda individët të konsideruar si jonormalë.

Mishel Fuko në kapitullin "Hapësirat e ndryshme" tek "Estetika, Metoda dhe Epistemologjia" krijon dhe përdor për herë të parë konceptin e *heterotopisë,* të vendeve të ndryshme. Këto vende janë të ndryshme nga utopitë, sepse ato nuk janë joekzistente dhe nga ana tjetër nuk ka asnjë shoqëri që nuk krijon vende të tilla, zona të ndërmjetme, të cilat në shoqëritë primitive i rezervohen njerëzve të shenjtë, shamanëve, të privilegjuarve dhe në kohët e sotme kemi ndërtuar spitalet psikiatrike, burgjet, teatrot, kinematë apo edhe vendet ku shkohet për muaj mjalti[16] etj. Në vendet e civilizuara spitali psikiatrik ka për qëllim të rehabilitojë individin, jo thjesht ta veçojë atë. Tek "Odin Mondvalseni" në fjalët e turbullta të personazhit, lexojmë për policë dhe hetues pothuaj po aq sa për mjekë:

"Sa zbrita në Mars më diktuan, më arrestuan, më pyetën, më shanë dhe pastaj erdhën njerëz me bluza të bardha. Këta e kanë punën me inxheksione dhe, kur heqin dorë nga ato, vijnë të tjerët. Më 37 gusht më arrestuan ngaqë kisha zbritur në Mars. Më rrethuan një numër i madh njerëzish me uniforma dhe më arrestuan në vend. Kur erdhën autoritetet e shtetit, më mbyllën në një dhomë dhe filluan hetimet."[17]

Edhe pse koha dhe vendi na tregojnë se personazhi vuan nga sëmundje mendore, pasi ato që ai thotë janë irracionale, *veçimi* i tij është i qartë "Në pasdrekë më çuan në vilën e caktuar. Ishte një vilë e bukur dhe aty më trajtonin sikur të isha ndonjë princ gjaku mbretëror. Më sollën edhe revista e gazeta dhe kështu kaluan më shumë se dy javë."[18]

Ç'punë kanë hetuesit dhe policët me një të sëmurë? Kjo bëhet e qartë më vonë dhe jo nga personazhi rrëfimtar, i cili me vetëdije të gjymtuar, nuk kujton dhe as i jep rëndësi shkakut të veçimit të tij. Gjatë dialogut të dy mjekëve, më i riu thotë "Aty puna me të vërtetë ndryshonte. Por a nuk është bërë shtrimi i këtij njeriu në spital pas një arresti për kryerjen e një*krimi politik*?!..."[19] Ky është një ndër referentët që na bën tëkuptojmë më shumë për organizimin shoqëror, për të cilin krimet politike ndëshkohen dhe për natyrën e veçantë së çmendinës, heterotopisë trebeshiniane.

Fuko veçon së paku pesë parime të ndërtimit të heterotopive, nga të cilat për ne përbën interes të veçantë parimi i dytë i heterotopisë[20], siç shihet gjatë zhvillimit

[16] Foucault, Michel, *Aesthetics, Methods and Epistemology,* The New Press, New York, 1994, pg. 178-179.

[17] Trebeshina, Kasëm, Legjenda e asaj që iku, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1992, f. 83.

[18] Po aty, f. 86.

[19] Po aty, f. 125.

[20] Foucault, Michel, *Aesthetics, Methods and Epistemology*, The New Press, New York, 1994, pg.180.

historik, ka të bëjë me faktin se çdo shoqëri krijon heterotopitë ekzistuese (pra jo ato që kanë përfunduar së ekzistuari) me organizimet e tyre specifike brenda shoqërisë. Heterotopia ka një sistem operimi preciz, madje edhe e njëjta heterotopi mund të veprojë në një mënyrë ose një tjetër në bazë të sinkronisë së kulturës në të cilën gjendet. Veçantia e spitalit psikiatrik në rastin e "Odin Mondvalsenit" lidhet pikërisht me këtë pikëprerje të historisë së vendit dhe kulturës së tij. Individët në këtë institucion shpesh nuk duken aspak jo të shëndetshëm mendërisht. Shoku i dhomës së personazhit rrëfimtar e këshillon shpesh të mos flasë, të ketë kujdes kur të flasë. Ideja e survejimit është e kudogjendshme, aq sa edhe nëse personazhet veprojnë në mënyrë refleksive, irracionale, gjithnjë në nënvetëdijen e tyre ekziston frika se janë të survejuar.

Pikëprerja e rrethanave historike dhe kulturore që kanë prodhuar një heterotopi të tillë siç është çmendina, janë krejt të ndryshme nga ç'presim në një shoqëri normale. Mënyra si e kuptojmë këtëështë nëpërmjet një operacioni të kundërt, duke kuptuar shkaqet nga pasojat. Pasoja kryesore që e gjejmë tek të gjithë individët e veçuar është frika për të folur, kjo na bën të kuptojmë menjëherë se nuk kemi të bëjmë vërtetë me të çmendur, pasi sidoqoftë ato nuk do kuptonin nga vjen rreziku, çfarë nuk duhet bërë etj. Përfytyrimi që krijojmë mbi lirinëështë krejt i kundërt, çmendina i shpëton personazhet sepse duke qenë të çmendur ata nuk gjykohen si të tjerët. Edhe pse heterotopia ka organizimin e vet të brendshëm, i cili është një pasqyrim i organizimit shoqëror, por me rregulla të ndryshme, aty duket sëështë më mirë sësa jashtë saj. Për të kuptuar këtë do na duhej të bënim krahasimin midis ngjarjeve në çmendinë dhe atyre jashtë saj, brenda saj personazhi gjen në mënyrën e tij paqe duke mohuar botën, identitetin e tij dhe duke mos pasur më qëllime, dashurohet dhe është i lumtur në mënyrën e tij (edhe pse brenda gjendjes së përgjithshme të ankthit),ndërsa jashtë saj, pra në botën "normale" atij i vrasin tragjikisht të dashurën. Përtej ngjarjeve, personazhi brenda çmendinës ka shpresat dhe ëndrrat e tij, do të dalë dhe mendon se do jetë i lumtur paskësaj, jashtë saj ai humb shpresën, humb besimin tek njeriu dhe tek dashuria njerëzore.

"Zot i madh! Kush mund të duronte t'i vdiste dy herë njeriu i dashur?!... Kush mund ta duronte ta shihte përsëri atë në pellgun e gjakut të saj?!... A mund ta shikonte përsëri të mbuluar me një çarçaf të bardhë?!..."[21]

Traumatizimi i personazhit shfaqet në çdo instancë të veprës, në narracionin fragmentar dhe renditjen e çorganizuar të kapitujve, në gjuhën e përdorur prej tij, e deri në frikën për të ndërtuar diçka të re. Ai arrin kulmin e tij në këtë fragment, ku shkatërrimi që i bëhet individit ka arritur pikën shkatërrimtare, duke e bërë të humbasë përfundimisht aftësinë për të dashuruar një qenie tjetër, nga frika e humbjes së saj.

[21] Trebeshina, Kasëm, *Legjenda e asaj që iku*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1992, f. 153-154.

Heterotopia është përmbysur. A është vërtetë bota jashtë çmendinës "normale", apo ajo është një instancë tjetër e një heterotopie tëhuajësuese, në themel të ideologjisë të së cilës qëndron me krenari ideja e krijimit të një njeriu të ri. Ide që na vjen që nga mitologjia antike, ku Zeusi kërkon të zëvendësojë njeriun me një njeri të ri, më të bindur, më të vogël dhe më të komandueshëm. Absurdi i shoqërisë merr një përmasë të re, kur kuptojmë se çmenduria nuk është e izoluar, ajo ka hedhur rrënjë në vetë shoqërinë, e cila po ashtu është në vetvete një izolim dhe veçim nga bota.

Edhe më parë kjo është paralajmëruar nga rrëfimtari, i cili si qenie e traumatizuar mbart ende frikën e mungesës së rrugëdaljes "Nuk mund ta merrja dot me mend ç'po bëhej andej jashtë dhe po mundohesha t'i merrja të gjitha sa kishin ndodhur si një gjë të jashtëzakonshme për një vend tjetër, por për praktikën dhe në praktikën e njohur të vendit ku ndodhesha, ato të gjitha ishin mëse të zakonshme. Ku mund të ishin ato një gjë e jashtëzakonshme? Zot i madh!... Në të gjithë vendin po ndodhin gjëra të tilla dhe të tmerrshme!... Prandaj mendimi i shkretë nuk dinte ku të qëndronte, nuk dintë të ndante të zakonshmen nga e jashtëzakonshmja..."[22]

Na duhet të rikthehemi në fillimin e romanit, por edhe në fillimin e punimit tonë. Gjithçka fillon me Odin Mondvalsenin, i cili ka mohuar identitetin e tij, ka krijuar për veten një emër të ri dhe një kombësi të re. Por, na u desh të analizonim në mënyrë të përmbysur, duke parë pasojat për të arritur tek shkaqet, në mënyrë që të kuptojmë se çfarë e ka çuar personazhin deri në këtë pikë. Odini nuk është thjesht i përjashtuar, ai nuk ka më asnjë ngjashmëri me këtë shoqëri qëështë krijuar, e cila jo vetëm është e huaj për të, por edhe e tremb me përçudnimin që i ka shkaktuar thelbit njerëzor. Mbetet vetëm *kryevepra* e saj, vrasja tragjike e një vajze të re, një motiv i përsëritur në prozën e Trebeshinës, për të dhënë sa më ngjeshur dhe fuqishëm tragjizmin.

Shoqëria ndalon atë qëështë e huaj, por në mënyrë të veçantë në rrethanat e shoqërisë shqiptare, edhe atë që ka frikë. Tjetri, më shumë sesa i jashtëm është brenda nesh, jemi ne në të shkuarën tonë, dhe në një kuptim më universal jemi ne në raport me rrezikun e tëhuajësimit që na qëndron mbi krye çdo ditë. Frika ndaj tjetrit nuk është gjë tjetër veçse frika ndaj çka nuk duam të jemi apo të bëhemi. Kështu marrin kuptim edhe "pasojat shpirtërore" të një shoqërie që pas rënies së diktaturës e sheh deri edhe më sot shpëtimin tek largimi prej vendit, identitetit dhe vetes.

Bibliografia

Trebeshina, Kasëm, *Legjenda e asaj që iku*, Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1992.

Përmbledhje artikujsh, *Trebeshiniana*, Studime, artikuj, ese, Tiranë, 1998.

[22] Po aty, f. 124.

Mullahi, Anila, *Veçori të poetikës në prozën romanore të Kasëm Trebeshinës*, Dudaj, Tiranë, 2013.
Dhurata Shehri, *"Lexuesit empirikë të Odin Mondvalsen",* seminari XVIII, Tiranë, 1996.
Aurel Plasari "*Odin Mondvalsen dhe fundi i utopive",* Drita, 14 mars, 1993.
Kuçuku, Bashkim, Leksionet e lëndës: Histori romani, në kursin MND, UT, 2010.
Genette, Gerard, *Narrative Discourse (An Essay in Method),* Translated by: Jane E. Lewin, Cornell University Press, Ithaca, New York, 1972.
Zhenette, Zherar, *Figurat*, Sabri Hamiti, Binak Kelmendi, Rilindja, Prishtinë.
Fuko, Mishel, *Historia e marrëzisë në periudhën klasike*, Leka Toto, Toena dhe Sh.B.L.K., Tiranë, 2003.
Eliade, Mirçja, *Miti i kthimit të përjetshëm*(fragment), Mehr Licht, nr. 23, Ideart, Tiranë, 2004.
Eliade, Mircja. *Mitet, vegimet dhe misteret*, kapitulli "Realitete arkaike", Agron Tufa.
Mircea, Eliade, *The myth of the eternal return,* Princeton University Press, 1974.
Mircea, Eliade, *The Sacred and the Profane, The Nature of Religion*, Willard R. Trask,A Harvest Book, New York.
Genette, Gerard, *Diskursi i ri i rrëfimit,* MIrela Shella, Dy Lindje & Dy Perëndime, Tiranë, 2014.
Ricoeur, Paur, *Time and Narrative (Vol I),* Translated by K. Mclaughin, D. Pellauer, The University of Chicago Press, 1984.
Derrida, Jacques, *The Other Heading, Reflection on Today's Europe,* Indiana University Press, 1992 (First Edition 1991).
Todorov, Tzvetan, Konkuista e Amerikës, cështja e *tjetrit*, Primo Shllaku, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015 (bot I 1982).
Foucault, Michel, *Aesthetics, Methods and Epistemology,* The New Press, New York, 1994.
Baudrillard, Jean, *Simulacra and Simulation,* Translated by Sheila Faria Glaser, University of Michigan Press, Michigan, 1995.

Belfjore QOSE

"*THE OTHER* AS EXCLUSION AND SELF-EXCLUSION IN THE NOVEL *ODIN MONDVALSEN* BY K. TREBESHINA"

Abstract

The concept of the *otherness* in Albanian literature displays a unique and original dimension during the period of the dictatorship, at a time in which *the other* could be easily described by the confrontation with the political ideology. In this study we aim

to analyze how *the other* is described through the character of Odin Mondvalsen, in the novel with the same title by K. Trebeshina.

We will focus on the theoretical perspectives on the *otherness* and the different definitions of it as a literary term, by distinguishing it from the sociological function of the word, by setting the relations between *the other* and *exclusion*. In the novel *Odin Mondvalsen* the concept of *the other* is created by two ways, as exclusion from the society by isolating the individual in an asylum and also as a self-exclusiveness by the character, who makes this clear by changing his name/identity. The structure of our paper will be organized by the study that these two ways of dealing with the *other*.

This paper will include interpretations on the reversed reality of the Trebeshina's characters, where the identification with *the other* becomes the only way to survive the human values. Polyvalence of the image of the madman (the other, the stranger) in this system becomes a key to interpret being the other as the only way to be free. The madhouse functions as heterotopia in Michel Fuko's terms, functioning as a mirror (a false, a utopian mirror) of the real world. To analyze the causes of the creation of the other, in the case of "*Odin Mondvalsen"*, we will be using the reverse narration in terms of Genette, in order to understand the causes by the consequences.

The Methodology used in this study will combine analytic criticism, theories of interpretation and comparative methodology, based mostly on theoretical bases of Bauman, Derrida, Foucault, Eliade, Genette Barthes etc.

Key words: the other, exclusion, heterotopia, belonging, absurdity

Edlira MACAJ-TONUZI

VIRGJËRESHA SHQIPTARE, "TJETRI EKZOTIK" NË RRËFIMIN E ALICE MUNRO-SË

Abstrakt

Koncepti i "tjetrit" trajtuar fillimisht në filozofi si lidhje me veten, (Hegel), si bazë për ndërsubjektivitetin (Husserl), si shfaqje e pashmangshme (J.P. Sartre) si trajtim mitik, historik, sociologjik, ku "tjetri" është femra (S. De Beauvoir), si pjesë e kundërt e vetes (Lacan) si tjetri pas tjetrit (Derrida) etj., por edhe në letërsi, psikologji, sociologji e kulturologji e ka shënuar zhvillimin e tij në disa drejtime. "Tjetri" është parë si i ndryshmi, i papranueshmi, diferencuesi, i panjohuri, etj. kushtëzuar nga këndvështrimi i studimit duke gjeneruar kështu edhe kuptimin që i vishet në çdo rast. Ky punim do të shqyrtojë sesi "tjetri", njohur që në krye të herës si pjesë e veçantë sociale shqiptare (Virgjëresha e përbetuar) bëhet motiv frymëzimi, huazimi kulturologjik dhe transformimi në rrëfimin e Alice Munro-së1 duke fituar rifunksionalizim për arsye letrare. Huazimi i këtij "tjetri" që vjen nga larg, shfaqet si "tjetri" ekzotik. Marrë nga një realitet i largët për lexuesin e saj me funksionin e ekzotikes, ky "tjetër" do të diskutohet në vijim nga optika filozofike, moralitike, sociologjike, kulturologjike referuar teorive përkatëse (Derrida, Todorov, Baumann, Jenkins etj.)

Objekt konkret studimi bëhet: Njohja me Virgjëreshat e përbetuara si fenomen social shqiptar. Përcaktimi i saj si "tjetri" dhe integrimi në tekstin e Munrosë në përballje me kulturën tjetër. Virgjëresha shqiptare si "Tjetri ekzotik" i Munro-së.

Përthyerja kulturore e kësaj "tjetër" shfaqjeje sociale, ndërtuar nga kodi i saj unik, e kuptuar në psikologjinë e arealit ku ajo funksionon, vjen përmes fantazisë dhe strukturave narrative nga një autore pa kontakte reale me kulturën nga huazon. Rimarrja në kontekstin e ekzotikes, joshjes nga e panjohura, thërritëse për ta kuptuar, bëhet një variant lidhjeje kohësh dhe njerëzish. Ajo i shërben qenies moderne për njohjen e tjetrit e vjen si një qasje e lirë ku fantazia letrare shkëput lidhjen nga gjeneza dhe e gjithë skema kuptohet përmes pasurimit të kuptimeve që merr tjetri si: tjetri i vetëm, në marrëdhënie me të tjerë përmes diferencave apo ngjasimeve.

Fjalët çelës: *Virgjëresha shqiptare, "tjetri", ekzotika, sociologjia, Alice Munro*

[1] *Dikur shkrova një tregim rreth Shqipërisë, i cili më ka pëlqyer shumë.* Cit. Alice Munro në: *Queen's Quarterly,* 22.06.2005

1. "Tjetri", *Virgjëresha shqiptare*[2] si "Tjetri"

Kulturalisht, "tjetri" perceptohet si ai që është jashtë një grupi etnik apo religjioz kur këta të fundit besojnë se kush është ndryshe nga ata është "tjetri"[3]. Tjetri në këtë rast është femra në shndërrimin e saj simbolik, në virgjëreshën e përbetuar. Femra dhe feminiteti në përgjithësi e kanë vulosur ekzistencën e tyre deri në këtë fazë sot përmes ndryshimeve të ngadalta sociale. Teoritë flasin rreth femrës sipas qëllimit nga nisen për ta studiuar, por më së shumti e kanë identifikuar atë si të varur ndaj gjinisë tjetër edhe pse kjo nuk mirëpritet gjithkund si tezë. Qasja interdisiplinore e Simone de Beauvoir-it lidhur me gratë, i cilëson ato në thelb si klasa tjetër, duke theksuar se një person nuk lind femër po bëhet e tillë se individi formohet sipas ligjësive sociale e në veçanti ato të seksit, se gratë nuk lindin të tilla, po bëhen, se asnjë fat biologjik, psikik, ekonomik nuk e përcakton trajtën që ajo merr në gjirin e shoqërisë etj.[4] Në këndvështrimin e saj gruaja është "Tjetri". Teori të tjera si ajo feministe, e kanë parë "tjetrin" tek femra; ajo bëhet subjekt edhe tek kritika "gender"etj, e kësisoj secila prej tyre ka platformën e vet studimore. Edhe në letërsi femra dhe çështjet e lidhura me të ka përthyerjet e veta. Alice Munro-së i kanë interesuar gjithnjë problemet me thyerjen e tabuve, apo kompleksitetin seksual të femrave[5] ndaj edhe në një nga rrëfimet e saj ajo zgjedh një subjekt të veçantë që e lidh drejtpërdejt me Shqipërinë siç është *Vigjëresha e përbetuar*. "Tjetri" i Munro-së shoqërohet edhe me disa elementë tipikë si: të dhëna faktike, informacione të karakterit kulturologjik e social për vendin dhe njerëzit e Shqipërisë veriore të viteve '20-të të shekullit të kaluar duke e mbrujtur rrëfimin e saj mes faktimit dhe trillit.

Dritësimin mbi fenomenin e Virgjëreshave të betuara, traditë nisur që nga shekulli i pesëmbëdhjetë në Shqipëri, e vulosur në arealin e vet, por e panjohur, e ndryshme dhe e pakuptueshme për një pjesë tjetër të qytetërimit fillimisht e bënë misionarët, udhëtarët, biografët dhe antropologët të cilët u njohën me veriun e Shqipërisë në fundshekullin e XIX-të dhe fillimin e shek. të XX-të.[6] Disa prej tyre u njohën drejtpërdrejt me fenomenin si Edith Duham. Ajo takohej me to në përditshmërinë e jetës së veriut[7]; të tjerë kanë folur rreth tyre. Ato ende janë objekt studimi edhe pse sot në të gjithë vendin numërohen pak prej tyre[8]. Të gjithë burimet rreth tyre luajnë rol zbulues. Disiplinat shkencore (antropologjia, historia, sociologjia,

[2] *Virgjëresha shqiptare* është botuar në përmbledhjen e tregimeve të përzgjedhura (*Open Secrets*), në vitin 1994, por ribotuar edhe në vitet 1996, 2004, 2006

[3] Samuel P.Huntington. *The Clash of civilizations*. Foreign Affairs, 72(3), f. 22

[4] Simone De Beauvoir. *Seksi i dytë*. Tiranë, Çabej; Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2002

[5] Alice Munro. *Virgjëresha shqiptare*. Tiranë, Ideart, 2005

[6] Robert Elsie, *Historical Dictionary of Albania* (2nd ed.). Lanham: Scarecrow Press, 2010, f. 435

[7] Edith Durham. *High Albania*, London, Edward Arnold, Publishers to the India office, 1909, f. 80

[8] *At home with Albania's last sworn virgins*. The Sydney Morning Herald, qershor, 2008

psikologjia etj., dokumentarët[9] apo artet: si letërsia, fotografia, kinematografia[10]etj. thelb kanë studimin e këtyre femrave që zgjedhin për të jetuar jetën si një burrë të privuara nga lidhjet intime.

Studimi i antropologes Antonia Young mbi virgjëreshat e betuara që ka qasje dokumentuese dhe analizuese, e shpjegon kalimin e tyre nga një gjini në tjetrën motivuar nga varfëria, izolimi politik, gjakmarrjet, largimit ndaj një martese të padëshiruar, etj. Nëse interesohet në prirjet seksuale të tyre, Young nuk mund të hartojë asnjë tezë përtej motiveve të mësipërme për shkaqe që sipas saj është vështirë të flitet për këtë temë me to, është një përkthyes në mes e mbase ato nuk janë të lira, bie reputacioni, etj, apo në fund të fundit ato nuk e kanë fare të pranishme në brendinë e tyre interesimin mbi këtë aspekt.[11] Edhe ndonjë analizë e rastit që e sheh fenomenin sipas teorisë "gender" (steriotipit konvencional social) apo ndonjë tjetër që e studion fenomenin përmes kontradiktave[12] si psh.: gruaja nga njëra anë është e frustruar nga punët dhe pozicioni karshi burrave e nga ana tjetër nga respekti që fitojnë po të kthehen në burra; apo nga njëra anë e konceptuar me syrin e një tolerimi ndaj sjelljes seksuale, e nga tjetra me regjimin që propagandon zgjedhjet hetero, në rastin e burrneshave të Shqipërisë duket si ngatërresë dhe jo si qartësim. Përgjithësisht studimet e antropologëve dhe sociologëve e qartësojnë çështjen e virgjëreshave të Shqipërisë si zgjedhje prej tyre bërë me vullnet të lirë, si një akt social i motivuar nga një sërë arsyesh që lidhen me traditën, ekonominë, socialitetin. Studiuesi Berishaj[13] e sheh fenomenin si përcaktim jetësor të shtyrë nga rrethana sociale, si një vetëflijim për detyrime familjare dhe sociale. Ai është një shndërrim simbolik. Pra ekzistojnë një sërë motivesh për marrjen e vendimit të pakthyeshëm. Në një analizë estetike të veprës së Munrosë rreth kësaj çështjeje D. Filipcak mendon se ky kthim nuk lidhet me ndjekjen e një dëshire me orientim seksual. Ai është një akt racional i vullnetit që forcon ndarjen e gjinisë që ndodh kur femra shmang një martesë të padëshiruar, kur mirëqënia e familjes është në dorë të saj e ajo kthehet në një përjashtim që kontollohet nga ligji patriarkal.[14] Shpëtimi nga një martesë e padëshiruar është edhe motivi i kthimit në virgjëreshën e përbetuar të kanadezes së Munrosë në arealin shqiptar. Këtu

[9] Dokumentar filmik nga National Geographic National Geographic. Aksesuar nga http://video.nationalgeographic.com/v...

[10] Shkrimtaret: Elvira Dones (romani:*Hana)*, Alice Munro (*Virgjëresha shqiptare*); fotografi Jill Peters (në projektin: *Virgjëreshat shqiptare*); regjisorja italiane Laura Bispuri (filmi: *Sworn Virgin* me të cilin garoi në festivalin e 65-të ndërkombëtar të filmit, zhvilluar në Berlin, 2015, bazuar në romanin e shkrimtares Elvira Dones

[11] Antonia Young. *Gratë që u bënë burr*a. Tiranë, Skanderbeg Books, 2015

[12] Ian Whitaker. *A Sack for Carrying Things: The Traditional Role of Women in Northern Albanian Society*, *Anthropological Quarterly,* Vol. 54, No. 3 (Jul., 1981), f. 146-156

[13] Anton Berishaj. *Virgjërat e përbetuara – jeta ndërmjet detyrimit dhe vetëflijimit,* Prishtinë, ASHAK*, 2016*

[14] Dorota Filipczak. *Gender and Space in "The Albanian Virgin*", në: *Alice Munro. Understanding, adapting and teaching*, red. Mirosława Buchholtz, Springer International Publishing, 2016, f. 20

ia vlen të ndalemi në një konsideratë objektive të tipit: *Në një botë ku ishte si një mallkim të ishe femër, ku femra veç mundime kish nga lindja deri në vdekje, ku në një libër me emrin Kanun, që për malësorët ish më i shenjtë se librat e shenjtë.... bëheshin pohime të tilla, si "gruaja a'në detyrë me i ndjejë nën sundim burrit",.... ose "me rrah burri gruen, nuk bie në faj kah kanuja...etj, etj, në një botë të tillë pra dëshira për të qenë burrë ka ekzistuar në rropullitë e çdo gruaje. E çudi nuk është që ka pasur burrnesha. Çudi është që nuk ka pasur shumë më tepër.*[15]

2. *Virgjëresha e përbetuar* si "tjetri" ekzotik tek Munro-ja

Shqipëria e veriut e viteve '20-të diferenconte shumë nga vendet e tjera europiane të kohës për njëmijë e një arsye. Ky diferencim reflekton edhe një tëhuajësim perceptues sigurisht për lexuesin e sotëm të cilit i drejtohet vepra. Viset e veriut atëherë shiheshin nga zbuluesit, udhëtarët, studiuesit etj. me syrin e një zbulimi ekzotik e me këtë cilësim kuptojmë në parim shfaqjen e *diçkaje nga vise të largëta, i pazakonshëm për vendet europiane, e kjo pazakonshmëri lidhet me natyrën, zakonet, kulturën.*[16] Ekzotika në rrëfimin e Munro-së merr formë mes imagjinares dhe faktit falë një gjuhe të ngjeshur që mbulon një dinamikë rrëfimi në të tri përcaktimet e mësipërme të ekzotikes, ndaj shtrirja funksionale e këtij tipari nuk izolohet vetëm edhe pse kryesisht tek virgjëresha e përbetuar. Me të vijnë edhe zakonet e vendit, gjurmë identifikuese të lokalitetit, natyra tipike etj. Në një kuptim të caktuar kjo ekzotike lidhet me "tjetrin" të përcaktuar si i panjohuri përtej të njohurit. Udhëtimet me karakter zbulimi kultivuan shijen për të renë, piktoresken[17] dhe ekzotizmi që lind nga fantazia, tipi i rrëfimit kthehen në objekt estetik të çështjes të tjetrit.

Ndërfutja e fenomenit të *Virgjëreshës Shqiptare*, shkëputur nga një shoqëri patriarkale si ajo e Shqipërisë së veriut të viteve '20-të, në një rrëfim të letërsisë moderne, lë të kuptohet që në fillesë një disavantazh i pozicionit social të femrave me të cilën lidhet "Tjetri'. "Tjetri", ashtu sikurse e cilëson edhe Jenkins në qasjen e tij sociologjike është një përcaktim individual ose kolektiv e ky proces përcaktimi kërkon një audiencë. Meqenëse ai e sheh përcaktimin në lidhje me çështjen e etnisë ai e ndan atë në dy përkufizime: procese të përcaktimit të brendshëm dhe të jashtëm. Proceset e brendshme përcaktuese ndodhin atëherë kur individët ose grupet përcaktojnë veten, i japin kuptim vetes, pra vetëidentifikohen. Në këtë kontekst një *virgjëreshë e përbetuar* është vetëpërcaktim (përcaktim i brendshëm) me ligj etnie e rregull kanuni, është përcaktim me liri zgjedhjeje dhe me vullnet të plotë. Nga ana tjetër proceset përcaktuese të jashtme ndodhin ku tjetri përcaktohet nga të jashtmit. Diferenca mes

[15] Mustafa Nano. *Për burrneshat tona ka kohë që shkruhet*, botuar në Shqip, aksesuar nga: http://lajmifundit.al/2014/07/nga-mustafa-nano-per-burrneshat-tona-ka-kohe-qe-shkruhet/

[16] *Fjalor i shqipes së sotme*, Bot. i dytë. Tiranë, ASHSH, 2008, f. 297

[17] Tefik Çaushi. *Fjalor i estetikës*. Tiranë, Ombra GVG, 2005, f. 108

tyre shpjegohet nga diferencimi i ngjashëm mes grupit (të brendshmit) dhe kategorisë (së jashtmit) Grupi pra përcaktimi i brendshëm i di vlerat dhe rregullat e tij ndërsa kategoria është më radikale dhe shpeshherë e njësuar me termin shkencor kur shkencëtarët analizojnë marrëdhëniet sociale. [18] Sipas tij në grupe ne flasim për përjashtime dhe integrime. Në këtë rast, "Tjetri" është përjashtimi. *Virgjëresha e betuar* edhe vetë në shoqërinë e saj është përjashtim, por ky është një përjashtim i mirëpranuar nga grupi, pasi për grupin e saj social ajo nuk është aspak e çuditshme, ndërsa për botëkuptimin e Lotarës ndaj saj ndryshon përcaktimi. *Virgjëresha* për Lotarën është përjashtimi-"tjetri", krejtësisht i panjohur si fenomen, por shumë i rrallë e i veçantë për t'u mos u vënë re e për të mos e studiuar. "Tjetri" futet nga Munro si burim i panjohur social e kulturor, si përcaktim i jashtëm, ku vetë përcaktimi mbetet akt social, akt identifikimi, e ku ka rëndësi në është përcaktim individual apo kolektiv[19]. Edhe *Virgjëresha shqiptare* si "tjetri" i përcaktuar nga jashtë, i panjohur dhe unik zhvillohet në planin e rrëfimit me dy linja paralele, të cilat lidhen nga disa konstante kuptimore universale. Dy linjat janë:

1. Sharlota, kanadezja (martuar me Gjurdhin shqiptar) e cila rrëfen mes trillit të plakjes dhe nostalgjisë historinë e Lotarës (Sharlota-Lotara, Gjurdhi-prifti) së rrëmbyer në Shqipërinë e veriut dhe
2. Klara, autor rrëfyesja që braktis burrin e të dashurin dhe shijon lirinë në botën e librave.

Konstantet janë: gruaja dashuria, martesa, liria. Munrosë sa i intereson Klara në bashkëkohësi si femër që përballet me kriza sociale e familjare, aq edhe merret me Lotarën fatin dhe aventurën e saj si *Virgjëreshë e betuar*, pasi me këtë performancë ajo hidhet tek "tjetri". Kjo përvojë i shërben për ta njohur dhe kuptuar, jo aq për t'i ndarë sa për t'u thelluar në çështje delikate lidhur me femrën. Linjat e rrëfimit segmentojnë njëra tjetrën. Rrëfimi i Klarës ndërpritet nga ai i Sharlotës për Lotarën. Brenda rrëfimit humbet edhe zëri i Sharlotës e tabloja zbret pa ndërhyrës drejt në perfomancën e personazheve si Lotara, prifti, etj., derisa mbyllet me ikjen misterioze të Sharlotës e Gjurdhit si dikur Lotara e prifti.

Ka ndodhur në Shqipëri në pjesën veriore që quhet Malësia e madhe, më 1920 kur jeta ishte shumë primitive,[20] e nis rrëfimin Sharlota në spital. Cilësimi ka ndodhur, i referohet faktit që e lidh me referencën historike duke i veshur dhe trillimin aq sa kufiri mes tyre bëhet i zbehtë pasi lexuesi që kapërcen nga njëri rrëfim tek tjetri paralel nuk di çfarë është historike apo trillim. Në këtë strukturë të alternuar rrëfimi ku njëra histori është në bashkohësi e tjetra në të shkuarën ndërfutja e "tjetrit", bëhet element intrigues dhe

[18] Richard Jenkins. *Rethinking ethnicity*. London, Tousands oaks, New Delhi, Sage Publications, 1997, f. 53, 54

[19] Richard Jenkins. *Rethinking ethnicity*. London, Tousands oaks, New Delhi, Sage Publications, 1997, f. 97

[20] Alice Munro, *Virgjëresha shqiptare*. Tiranë, Ideart, 2015, f. 30

surprizues, i cili kërkon në integrimin tekstor me patjetër një përshkrim dhe informacion shpjegues. Në këtë kuptim sipas sociologut Z. Baumann *të flasësh për tjetrin është e rastit, ndaj edhe duke e përcaktuar si të tillë ai nuk mbetet më tjetri pasi bëhet objekt përshkrimi, pra fillon të njihet*[21] Sipas Baumann-it tjetri është nocion qendror sesi krijon shoqëria kategoritë identifikuese të ngritura mbi bazë **dikotomie** p.sh: gruaja është "tjetri" për burrin, i ardhuri është "tjetri" për vendasin, armiku "tjetri" për mikun, të tjerët janë të tjerë për ne e kështu me radhë. Me ndërveprimin e tyre kristalizohen edhe pjesët përthyese të njërit tek tjetri.

3. Përthyerja e "tjetrit" tek "tjetri" (elementët ekzotikë)

Virgjëresha është një realitet ekzotik për botëkuptimin e Lotarës. Lotara është një kanadeze që në rrethana të pakuptueshme i bie të jetojë pak kohë në brendësi të një organizimi shoqëror të panjohur. Njerëzit që u përkasin kulturave të ndryshme me patjetër që kanë qasje të ndryshme ndaj kulturës tjetër. "Tjetri" për të, siç shprehet Todorov, *është tjetri në raport me mua ose është një grup social konkret të cilit ne nuk i përkasim, grupi mund të jetë brenda shoqërisë p.sh.: gratë për burrat.... ose të huajt që nuk ua kuptojmë as gjuhën as zakonet që nuk kanë lidhje kulturore.*[22] Lotara, kanadezja e emancipuar papritur e gjen veten të plagosur në rrugët e ashpra e majat e larta të Shqipërisë veriore ku përballet me disa situata brenda të cilave ajo zhvillohet si personazh.

Situata e parë e pabesueshme: Lotara "e huaja" e sheh veten të rrëmbyer e mendon se shkak është grabitja. Mendimi i parë i saj për "të panjohurin", ndërsa për vendasit është turp i madh të vrasësh një grua. Ata ia vranë shoqëruesin për shkak të gjakmarrjes[23] Gjakmarrja sipas kanunit dhe pak shpjegime të Munro-së mbi të (gjakmarjen) në kontekstin e kullës, nderit, dhe këmbënguljes për ta çuar atë deri në fund[24] ndihmojnë për të hyrë në kulturën e "tjetrit". Këtu vjen situata e dytë e pabesueshme për Lotarën. Një i huaj nuk e bën njohjen ndaj "tjetrit" sa hap e mbyll sytë, vetëm në rast se do që të ketë keqkuptime, ndaj Lotara ka dy rrugë ose përshtatjen në grupin e ri social, futjen në mendësinë e vendasve ose refuzimin me rezultat të pasigurt. Lotarës i duhet të vendosë një marrëdhënie, një njohje me vendasit. Todorov në qasjen e tij ndaj tjetrit shprehet: *Raporti me tjetrin nuk ndërtohet vetëm brenda një dimensioni por përmes një njohjeje, që i lejon tjetrit autonominë. Mund të zbulojmë të tjerët tek vetja jonë.*[25] Lotara shpejt shqiptarizohet e më pas rikthehet në identitetin e

[21] Zygmunt Baummann. *Postmodernity and its discontents*. London, Polity Press, 1998
[22] Tzvetan Todorov. *La conquista dell'America, il problema dell'"altro*". Torino, Gulio Einaudi, 2014, f. 5
[23] Alice Munro. *Virgjëresha shqiptare*. Tiranë, Ideart, 2005, f. 24
[24] Po aty, f. 25
[25] Tzvetan Todorov. *La conquista dell'America, il problema dell "'altro*". Torino, Gulio Einaudi, 2014, f. 225

saj të mëparshëm. Pikërisht franceskani i kudogjendur ndihmon këtë pjesë në rrëfimin e Munro-së. Ai ka një njohje të rregullave kanunore dhe mendësisë së traditës patriarkale e roli i tij është zbutës në përplasjen e dy kulturave. Edhe pse të ngritura vetëm në nivel informacioni dhe pa ndërhyrje autoriale rrëfimi i Munrosë nënvizon disa çështje "të tjetrit" që vijnë nga përcaktimi i jashtëm, (Jenkins) lidhur me vendin dhe njerëzit si: natyra, ritet, patriarkalizmi dhe pozicioni i femrës në shoqëri. Përballja e dy kulturave vihet në diskutim edhe në çështjet e seksualitetit i cili për vendasit konsiderohej diskutim tabu, e që gratë edhe në bisedat e tyre e artikulonin në fshehtësi. Situata ndryshon shpejt, pasi Munroja thotë shumë në pak tekst dhe nevoja për t'u përshtatur e kthen Lotarën ta hetojë "tjetrin"- në vlerat dhe paradokset e tij dhe të shohë një pjesë të veçantë brenda tjetrit, *Virgjëreshën e përbetuar,* si një model shpëtimi. Kjo grishje për ta kuptuar e më vonë edhe për ta provuar kërkon që Lotara të përjashtojë nga vetja vajzën kanadeze dhe të futet brenda "tjetrit", pra brenda jetës së një "Virgjëreshe të përbetuar" duke realizuar ndryshimin. "Tjetri" për malësorët-*Lotarë kanadezja* fshihet, ndërsa "Tjetri"për Lotarën-*Virgjëresha e përbetuar* futet në lojë. Sipas Jenkins përcaktimi që njëri përjashtohet e tjetri që futet, krijon lidhje të fuqishme mes tyre. Transformimi i Lotarës në Virgjëreshë të betuar kalon shpejt se Munro ka dinamikë veprimi në rrëfimin e saj edhe pse nuk harron të theksojë detajet informative rreth ritit, si p.sh:. rregullin e betimit që mund të bëhet në çfarëdo moshe të vajzës, në prani të 12 burrave dëshmitarë; kjo e lidh atë me saktësinë. Pikërisht duke qenë se ngjarjet marrin kthesë shumë shpejt dhe teksti është i ngjeshur e gjithë historia e një rrëmbimi në një vend të panjohur e ndërfutja në një jetë të pabesueshme për mentalitetin e një qytetareje kanadeze, bëhet shtrat për krijimin e një atmosfere ekzotike krijuar falë disa elementëve që shoqërojnë aventurën.

Lotara me futjen e saj tek "Tjetri", kupton edhe ritet, natyrën, patriarkalizmin, etj. *Virgjëresha* kthehet në "subjekt për zbulim" tek Munro-ja. Baumann thotë se çdo shoqëri prodhon "tjetrin", të ndryshmin, të huajin dhe tjetrin duke theksuar dhe ndryshimin referencial mes tyre. "I huaji" (the stranger) dhe "tjetri". Sipas tij i huaji shihet si surprizuesi, i panjohuri, ndërsa "tjetri" ka konotacionin e atij që punon në shërbimet tona jetike etj[26]. Në zhvendosjen logjike kemi këtë përngjasim: për malësorët Lotara është i huaji, elementi surprizues ndërsa për Lotarën në fillim ata janë "tjetri", ndërsa *Virgjëresha e përbetuar* është habia e madhe, e huaja, me potencial zbulimi për të**.**

Kontaktin e parë perceptues mbi "tjetrin", në akt tjetërsimin e një gruaje në burrë me gjithcka mban mënyra e jetesës së tij, Lotara e vë re tek burrnesha e ftuar në një darkë të rastit. *Duar të vogla, krahë pa qime, lëkurë si zhabë, pa mustaqe, zë i hollë.*[27] Perceptimi i dytë me vrojtim më të përqendruar pikas se ky "tjetër" pinte duhan, ulej

[26] Zygmunt Baummann. *Postmodernity and its discontents*. London, Polity Press, 1998, f. 28
[27] Alice Munro. *Virgjëresha shqiptare*. Tiranë, Ideart, 2005, f. 34

në sofër, mbante pushkë. Ky përshkrim i saktë është i mjaftueshëm për Munronë. Mirëpo dinamika e veprimit kërkon një kompromis të rastit dhe bashkëpunimi me franceskanin vjen shpejt dhe kthimi i saj në një virgjëreshë të betuar bëhet një zgjidhje pragmatike "sa hap e mbyll sytë". Kështu bëhet kalimi në pragun e tjetrit. Pas vrojtimit nga ana e jashtme dhe të mësuarit rreth virgjëreshave, kuptimit të domethënies së aktit simbolik të kalimit nga grua në burrë fillon edhe sfida reale, përshtatja në stilin e të jetuarit. Aventura e jetës së Lotarës në këto vise të largëta vijon me "arratisjen për shpëtim nga martesa e sajuar" ndihmuar nga franceskani. Lotara kësisoj shpëtohet dy herë. Malësorët i rikthyen jetën pas plagosjes, prifti lirinë. Arratisja e saj me të është vetë një aventurë brenda historisë. Dalja nga jeta e "tjetrit" dhe rihyrja në ritmin e saj të parë bëhet një tregues i aventurës, ku virgjëresha është si një mjet kureshtues, tregues i një pjese, aventurës shpirtërore dhe reale e cila prek realitetin e një bote të panjohur. Rikthimi i saj në identitet, përmes largimit nga Shkodra dhe arritja e saj në Trieste, ku ai e priste ne mol[28] (*Ajo thërriste papushim. Kur anija hyri në portin e Triestes, ai po priste në mol)* sigurisht duhet të rimerret në konsideratë për t'i dhënë kuptim historisë së Sharlotës dhe Gjurdhit, si një histori enigmatike, si vijim i ikjes së dikurshme të Lotarës e fanceskanit. Munro këtë e lë në imagjinatën e lexuesit, duke dhënë si tregues vetëm detaje si emrin Gjurdhi, veshjen e tij të pazakonshme, kryqi, librat, karroca etj.[29] Kjo histori aventure e romance i vesh *Virgjëreshës së përbetuar* funksionin ekzotik, duke e larguar nga kuptimi i saj parësor. Ideja që një femër mund të jetojë si një burrë me të drejtë kontrolli të jetës së saj duket primitive në sytë e modernitetit. Por në një kontekst tjetër, mbase, të një kulture të hershme, para feminizmit, kjo zgjedhje mund të shihet si progres.[30] Shtrirje në funksion të ekzotizmit janë çështje të lidhura me gruan, zakonet, natyrën.

Gruaja. Ka një galeri të vogël portretizimesh të femrës tek kjo "tjetër" kohë dhe areal gjeografik. E largët dhe e huaj duket ajo për optikën sot. Pa ndërhyrje emocionale po me një gjuhë të prerë informative Munro i portretizon gratë e këtij vendi nisur nga veprimet e tyre. Ato janë gratë e forta, të egra.... *gratë në këtë vend lindnin ku t'u qëllonte, nëpër fushat e misrit ose ndanë shtigjeve kur çapiteshin të ngarkuara.*[31] Mjafton kaq të kuptohet mënyra e jetesës programuar për punën tekstile, ushqimin, pastrimin, bujqësinë, si dhe rrugët e mbijetesës së saj përmes punës dhe konkurencës mes tyre[32]. Por janë edhe gratë si Tima, *punëtore e mrekullueshme që mund t'i ngjitej me vrap shpatit të*

[28] Po aty, f. 103

[29] Alice Munro. *Virgjëresha shqiptare*. Tiranë, Ideart, 2005.*Gjurdhi kishte veshur mbi pantallonat një rrobdëshambër mëndafshi në ngjyrë të kuqe të errët, ndërsa në kokë mbante kapuçin*, f. 87; f. 48

[30] Joshua Zumbrun. *The Sacrifices of Albania's 'Sworn Virgins*', W*ashington Post Staff Writer***,** 11 Gusht, 2007, aksesuar nga:
http://www.washingtonpost.com/wp-dyn/content/article/2007/08/10/AR2007081002158.html

[31] Alice Munro, *Virgjëresha shqiptare.*Tiranë, Ideart, 2005, f. 22

[32] Po aty, f. 31

pjerrët që të çonte në kullë me një barrë drush të lidhura në shpinë e që ishte dhjetë herë më e madhe se ajo[33]. Ajo ishte edhe një mjeke popullore. Po ashtu portretizohen edhe vajzat shqiptare kureshtare ndaj Lotarës, ndaj "tjetrit"; kureshtare ndaj gjuhës së tjetrit.[34] Ky portretizim bëhet i njëanshëm pasi niset nga përcaktimi i jashtëm, sipas Jenkins, jep vetëm një pjesë të "tjetrit", atë që shihet pjesërisht. Munro-së kaq i duhet për ta bërë femrën të ndryshme dhe ekzotike për lexuesin e saj.

Lokalja dhe piktoreskja. Treguesi për viset e panjohura si referencë e jashtme ndërfutet në mes të rrëfimit, gjatë bisedës së Gjurdhit më Klarën për librat. *Një udhëtim përmes Majave të zeza. Shqipëria e Sipërme. Tokat e fshehta të Evropës jugore.*[35] Gjurmë të lokalitetit shfaqen tek përzgjedhjet e riteve popullore. Ndalesa në këto rite është një zbulim i natyrës së jetesës së "tjetrit". Të tilla janë prerja e flokëve në hënë të plotë, gruaja shtigë, supersticionet, orët, etj. Këto detaje lidhin fijet e kësaj tërësie ekzotike me elementët fantastikë që i mbart çdo qytetërim në format e para të fantazisë trilluese, ndërsa piktoreskja është një element që shfaqet tek lokacione të veçanta, vende të caktuara të cilat Munro i ka qëmtuar me kujdes nga burimi i saj informues. Detaje si guri, histori krismash, natyra e egër, pishat e larta, malet, yjet, Liqeni i Shkodrës, kallamat, kasollja, kulla, shtrati prej fieri, rakia, janë elementë ndërtues të përshkimit dhe tregues të këtij lokaliteti të huaj.

4. Përballja

Historia e Lotarës segmenton rrëfimin e Klarës, jo aq për të thelluar diferencat mes "tjetrit" virgjëreshës së betuar dhe gruas moderne por për të shkrirë kufirin ndarës mes njëra tjetrës. Një femër vendos lirinë e saj me burgosjen në kurthin e vetmisë së virgjërisë dhe me detyrimin për t'u bërë "tjetri" e nga ana tjetër një grua që është e lirë të zgjedhë në jetën e saj, edhe pse zgjedhjet i paguan me vetminë. Vetmitë e tyre janë sa të ndryshme aq të afërta. Klara është gruaja e divorcuar. Të dy femrat në dy kohë të ndryshme si edhe hyrja në jetën e njëra- tjetrës, bëjnë ndarjen e vetmisë. Kjo i kthen në një farë mënyre të fitojnë vetë lirinë. Klara gjen paqen e brendshme në këtë liri fituar pas divorcit duke u zhytur në botën e librave. Lotara shpëton nga një martesë e padëshiruar falë një zgjedhjeje të guximshme "futjes në jetën e "tjetrit" që në kulturën e saj as që nuk ekzistonte. *Virgjëresha e përbetuar,* si "tjetri" ekzotik lidhet me dy pozicionime femërore. Nga njëra ana Lotara në jetën e "tjetrit', virgjëreshës, në të cilën i duhet një burrërim, duke filluar që nga lëvizjet me kalë, e nga ana tjetër

[33] Alice Munro, *Virgjëresha shqiptare*. Tiranë, Ideart, 2005, f. 32

[34] Alice Munro, *Virgjëresha shqiptare.*Tiranë, Ideart, 2005, f 33 *Nganjëherë cucat i thoshin: "fol në gjuhën tënde!" dhe ajo fliste anglisht për t'i zbavitur. Nga këta tinguj të çuditshëm ato shtrembëronin fytyrën dhe rudhnin buzët. Ajo përpiqej t'u mësonte fjalët hand, nose e fjalë të tjera. Atyre u dukej si shaka. I përsërisnin fjalët me njëra tjetrën e ia plasnin gazit*.

[35] Alice Munro, *Virgjëresha shqiptare*. Tiranë, Ideart, 2005, f. 44

sensualiteti i Klarës dhe çështja e adulterit. Kësisoj tjetri nuk është edhe aq tjetri e duket sikur tjetri është tek tjetri në mënyrë të pandërprerë, edhe pse kërkojmë ta bëjmë ndarjen, që në fakt janë vetëm përcaktime sociale. Kjo pjesë të kujton edhe qasjen Derridiane kur thotë: *Ne jemi të gjithë së bashku të huaj*. Në këtë kuptim ne veç i krijojmë të tjerët[36]. Çdo tjetër është çdo tjetër, tjetri është krejt tjetri. Tjetri është tjetri për këdo që në subkoshiencë, rrjedhimisht çdo tjetër është tjetri. Pra çdokujt i duhet të përcaktojë të tjerët, që të identifikojë veten.[37] Ndaj tjetri që nga subkoshienca është tjetri për këdo dhe kategoritë për ta vlerësuar janë imagjinare. Tjetri është takimi me të panjohshmen e parritshme për logjikën në një moment të caktuar, siç shfaqet *Virgjëresha e përbetuar* jashtë kontekstit tradicional dhe social të saj. Munro nuk i viktimizon femrat shqiptare dhe po ashtu nuk ndalon në gjykimin e sistemit patriarkal të vendit. Me qendërsimin në rrëfim të femrës, gruas në kohë të ndryshme ajo në fakt interesohet të ngrejë lart forcën femërore, forcën e tyre për të jetuar. Edhe pse i sheh ato në disfavor me meshkujt në role sociale, ajo përzgjedh të bëjë subjekt Virgjëreshën, e njohur për rrugën dinjitoze dhe sfiduese që një femër zgjedh për të fituar lirinë, respektin, dhe për të demostruar stoicitetin e saj. Në egërsinë patriarkale ajo është më e forta dhe kjo zgjedhje në sytë e Munrosë ishte krejtësisht e panjohur, burim për një trillim ekzotik. "*Nuk kisha dëgjuar ndonjëherë për ndonjë shoqëri tjetër në botë, ku ndryshimet gjinore e vinin femrën në një pozitë të tillë*".

5. Përfundime

Qasja estetike dhe sociologjike ndaj ekzotizmit të *Virgjëreshës së përbetuar* në një rrëfim modern shkon në disa përfundime nisur më së pari nga koncepti i "tjetrit" si pjesë e panjohur jashtë grupit ose vetes, si i huaji, i pazakonshmi etj., kushtëzuar nga objekti i fushës studimore. Teoritë shërbejnë si një përballje me "Tjetrin" edhe në çështje që lidhen specifikisht me femrën dhe zgjedhjet e saj. Në skemat narrative të Munrosë "tjetri"- pëcaktuar që në krye të herës *Virgjëresha e përbetuar*, vjen si një burim kulturologjik i largët e i panjohur për lexuesin bashkëkohës, në përputhje me estetikën e ekzotikes. Zbuluar më së pari si formë jetese, nga udhëtarët (E.Durham) e misionarët, ende sot ajo është burim habie, kureshtjeje apo frymëzimi artistik në letërsi e kinematografi. (E. Dones, L.Bispuri) Si një realitet social ende mbijetues në Shqipëri, kalimi nga një gjini në tjetrën shihet nga antropologët e sociologët si kalim nga varfëria, izolimi politik, gjakmarrjet, largimit ndaj një martese të padëshiruar, (A.Young), si përcaktim jetësor të shtyrë nga rrethana sociale, si një vetëflijim për detyrime familjare dhe sociale, shndërrim simbolik (A. Berishaj) etj. Kjo mënyrë jetese

[36] Jacques Derrida, *Archive fever/ A Freudian impression*. Chicago, The University of Chicago Press, 1996, f. 96

[37] Jacques Derrida, *Archive fever/ A Freudian impression*. Chicago, The University of Chicago Press, 1996, f. 77

edhe për Munronë ishte e padëgjuar deri në rastësinë e zbulimit të një libri për Shqipërinë.

Vigjëresha si "Tjetri" në përballje me kulturën tjetër si përcaktim i jashtëm (Jenkins) bëhet "Tjetri" për Lotarën. Si përcaktim i brendshëm ajo është e mirëpranuar, respektuar nga grupi i saj social. Kalimi i Lotarës në përvojën jetësore të Virgjëreshës shërben për të njohur (Baumann) dhe kuptuar kulturën tjetër. Përthyerja e njërës kulturë tek tjetra shërben për njohjen e së panjohurës. Njohja e "tjetrit" bëhet përmes zbulimit të tyre tek vetja jonë (Todorov). E kthyer në "subjekt për zbulim" tek Munro-ja, Virgjëresha si "tjetri" shërben për të kuptuar botën e "tjetrit" shoqëruar edhe me elementë plotësues si: femra, zakonet, lokalja dhe piktoreskja etj., me anë të të cilave kuptohet edhe një nga motivet e zgjedhjes së kësaj forme jete, ajo e fitimit të një lirie. Kjo liri edhe pse fitohet me një sakrificë të fortë, në një kontekst të caktuar mund të quhet progres.(Zumbrun). Rrëfimet e dy linjave: Sharlota-Gjurdhi si vijim i fantazisë së historisë Lotara-franceskani dhe Klara me sfidat e saj personale lidhen nga disa konstante kuptimore universale si: gruaja dashuria, martesa, liria, ku çështjet e "Tjetrit" shkrihen tek "Tjetri" e "Tjetri i largët as nuk gjykohet as nuk lartësohet, por merret siç është e zhvendoset për arsye letrare drejt një receptuesi modern.

Referenca

Alice Munro. Understanding, adapting and teaching (2016). New York, Dodrecht, London, Springer International Publishing.

At home with Albania's last swon virgins (27 qershor, 2008). The Sydney Morning Herald, aksesuar nga: http://www.com.au/news/world/woman-have-to-swap-genders-to-suvive/2008/06/26/1214472673664.html

Baummann, Zygmunt (1998). *Postmodernity and its discontents*. London, Polity Press

Beauvoir, Simone De (2002). *Seksi i dytë*. Tiranë, Çabej; Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit

Berishaj, Anton (2016). *Virgjërat e përbetuara – jeta ndërmjet detyrimit dhe vetëflijimit,* Prishtinë, ASHAK.

Çaushi, Tefik.(2005) *Fjalor i estetikës*. Tiranë, Ombra GVG.

Derrida, Jacques (1996). *Archive fever/ A Freudian impression*. Chikago, The University of Chicago Press.

Durham, Edith (1909) *High Albania*, London, Edward Arnold, Publishers to the India office

Elsie, Robert (2010) *Historical Dictionary of Albania* (2nd ed.). Lanham: Scarecrow Press Dokumentar filmik nga National Geographic National Geographic aksesuar nga: Videos: http://video.nationalgeographic.com/v...

Fjalor i shqipes së sotme (2008). Bot. i dytë. Tiranë, ASHSH.

Huntington, Samuel P. (1993). *The Clash of civilizations*, in: *Foreign Affairs*, 72(3),

Jenkins, Richard (1997). *Rethinking ethnicity*. London, Tousands Oaks, New Delhi, Sage Publications.

Munro, Alice. (2005). *Virgjëresha shqiptare*. Tiranë, Ideart.

Nano, Mustafa. *Për burrneshat tona ka kohë që shkruhet*, botuar në Shqip, aksesuar nga: http://lajmifundit.al/2014/07/nga-mustafa-nano-per-burrneshat-tona-ka-kohe-qe-shkruhet/

Peçi, Admirina. (tetor, 2013) *Alice Munro, Nobelistja që shkroi për Virgjëreshat shqiptare*, Shqiptarja.com, dt. 11. Tetor, 2013 aksesuar nga: http://shqiptarja.com/kulture/2730/alice-munro-nobelistja-qe-shkroi-per-virgjereshat-shqiptare-181725.html#sthash.j0natbF8.dpuf

Todorov, Tzvetan (1994). *La conquista dell'America, il problema dell'"altro"*. Torino, Gulio Einaudi.

Whitaker, Ian (korrik, 1981). *A Sack for Carrying Things: The Traditional Role of Women in Northern Albanian Society. Anthropological Quarterly,* Vol. 54, Nr. 3

Young, Antonia (2015) *Gratë që u bënë burra*. Tiranë, Skanderbeg Books.

Zumbrun, Joshua (gusht, 2007) *The Sacrifices of Albania's 'Sworn Virgin*s', W*ashington Post Staff Writer*, 11 Gusht, 2007. Aksesuar nga: http://www.washingtonpost.com/wp-dyn/content/article/2007/08/10/AR2007081002158.html

Edlira MACAJ-TONUZI

THE ALBANIAN VIRGIN, "THE EXOTIC OTHER" IN ALICE MUNRO'S STORY

Abstract

The concept of "the other" initially studied in philosophy as a self-reliance (Hegel), as an inter-subjectivity foundation (Husserl), as an inevitable manifestation (J. P. Sartre), as a mythical, historical, sociological approach, where "the other" is the female (S. De Beauvoir); as an opposite part of the self (Lacan), as the other after the other (Derrida) etc., but also studied in the literature, psychology, sociology and culture, has marked its development in several directions. "The other" is considered as the different, the unacceptable, the differentiator, the stranger, etc. depended from the study's point of view, thus generating the meaning that it takes in every case.

This paper will examine how the "other", known since at the beginning as an Albanian typical social part (The sworn virgin), becomes a motif of inspiration, cultural lending and transformation in the Alice Munro's story, gaining so new functions literary motivated. This "other" borrowed from far away, appears as the exotic "other". Taken from a distant reality for her (Munro's) readers, especially

vitalized with its exotically function, this "other" will be discussed in our point of view from a philosophical, moral, sociological and cultural perspective referred to the relevant theories (Derrida, Todorov, Baumann, Jenkins, etc.)

The concrete subject of study is: an introduction to the typical sworn virgin as an Albanian social phenomenon. Defining it as "the other" and displaying its integration in the Munro's text while facing the other culture. The Albanian sworn virgin as the Munro's "Exotic Other".

The cultural refraction of this social "other" made by its unique code and recognized in its psychology of the place where it works, comes throughout the fantasy and narrative structures from an author without real contact with the culture from she borrowed the model. Reactivation in the exotically context, of the seduction from the unknown, vocative, etc., becomes a version of connection of time and mankind. It serves to the modern human being to accept and respect the other and it comes to us as a free choice where the literary fantasy disengages the connection from the genesis, and the whole scheme is understood by enriching the meanings that 'the other' takes as: the only one-other in relationships with others through differences or similarities.

Key words: Albanian virgin, sworn virgin, "the other", exotic, sociology, Alice Munro.

Ermir XHINDI

(RI)NDËRTIMI I TJETRIT SI PROCES E OBJEKT I INTERPRETIMIT NË KUFIJTË E STRUKTURËS

Ç'është ***Tjetri***? Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe[1], midis 6 zërave përshkrues për njësinë *'Tjetër'*, *'Tjetri'* përkufizohet në zërin 6, si: - *përdorim emëror sipas kuptimeve të përemrit të pakufishëm* -.

Me një koment shkurt, kryesisht të lidhur me zërat *-4-*[2] dhe *-5-*[3], si më të përshtatshëm për qëllimin tonë, ***'Tjetri'*** *është entitet jashtë nesh, ekzistencë e dukshme, me të cilën ndërlidhemi, përkufizohemi ndërsjelltazi e që mund të zbulohet fenomenologjikisht si diferencë*[4] *gjatë marrëdhënies me të.*

Tjetri në letërsi? Ky është njëlloj kurthi teorik nga pikëpamja e përkufizimit. Të vetmet objekte relativisht të sigurt për *Mua* janë *Unë*[5] dhe *Teksti.* A është e mundur të tërhiqemi nga joshja për ta marrë *Tjetrin* si konstrukt të dhënë e për t'u përfshirë në një aventurë interpretimi ku *karroca del përpara kalit*? *Tjetri bëhet/kryhet/prodhohet/ndodh, gjatë një marrëdhënieje.* Më tej, mund të përshkruhet e të interpretohet. Por, sidoqoftë, *Tjetrin* nuk e prodhon interpretimi, bindja se ai ekziston, madje se ekziston në një konstrukt që *mund të përshkruhet parimisht*, sa ç'e sjell në jetë një marrëdhënie, që ne mendojmë se është kushti i pashmangshëm për t'u marrë me të. Etikë elementare. Mund të pranojmë të mendojmë ne mënyra të ndryshme, por pikësepari duhet të mendojmë.

Shkurt, për sa na takon, po i qëndrojmë komentit të mësipërm për ***Tjetrin si pasojë e marrëdhënies me tekstin***, e përkatësisht si *sistem diferencash* e i prodhuar *si objekt* prej *përvetësimit përkatës nga lexuesi gjatë leximit*, *funksion i strukturës* së kryer gjatë *leximit si ndërveprim me një kod të caktuar strukturor*. Me fjalë të tjera, *kryerja e një strukture gjatë leximit përbën edhe një realizim të Tjetrit*. Çështja qëndron në caktimin e natyrës së kodit strukturor sipas të cilit kryhet (pasi *udhëhiqet, kushtëzohet, kontrollohet*…) struktura që e prodhon atë funksion.

---

[1] Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, Akademia e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Tiranë 1980, f. 2002

[2] Po aty: '*I ndryshëm nga qenia a nga sendi që përmendim, jo i tillë si ky që kemi, i ndryshëm nga ky'*..

[3] Po aty: *'Që është në anën e kundërt ose të përkundërt a përballë, i anës matanë, i përkundërt, i kundërt'.*

[4] Sistem diferencash. Do të flasim për sistem diferencash, pasi sidoqoftë do të veprojmë mbi objekte e veprimtari të *'përkufizuara'*. Diferenca shprehet vetëm si sistem diferencash.

[5] Ky është abstragim mbi bashkësinë.

Na duhet, gjithashtu, të caktojmë kategorinë: *NE* dhe të pajtohemi mbi një skeme ndërveprimi. Në njëfarë mënyre çështja e dytë dhe e tretë mund të bashkohen në një, në një platformë teorike të parashtruar edhe më parë nga ne, mbi një model hibrid Eko-Fish[6], si marrëdhënie e ndërtimit të tekstit e mbi tezën se çka prodhon si kuptim lexuesi i mundshëm nën shtrëngimet e një teksti, e prodhon edhe lexuesi empirik i atij teksti. Atëherë, ne mbërritëm në përfundimin që vlera e kuptimit të kryer nga lexuesi i mundshëm, prodhim i tekstit, si kategori teorike, shfaqet në një interval pothuaj të njëjtë me atë të lexuesit empirik[7].

Lidhur me çështjen e parë, ne mendojmë se në teori, kodet strukturore e për pasojë, strukturat, gjallojnë në një interval relativisht kompleks, çka duhet të sjellë (teorikisht) edhe një interval po kaq të pasur funksionesh.

Por, për letërsinë shqipe ky rast, mendojmë, është dukshëm relativ; nga pikëpamja e funksionit që përmbush ***struktura e përfunduar***, ky interval aty është monoton. Kodet e organizimit strukturor ruajnë njëlloj *izotopie*, veçori e një sistemi të "hapur" ndaj faktorëve të tjerë institucionalë e të "mbyllur" ndaj përvojës së bashkësive që nuk e kanë mbërritur gjendjen institucionale. Njëlloj kundërvënieje mes spontaneitetit të përvojës (lirisë) dhe domosdoshmerisë për rregull poetik, ku e dyta e nënshtron të parën. Kodet e sundojnë përvojën, madje mbërrihet deri në asgjësim të përvojës, veti e standartizimit të skajshëm të kodeve.

Qoftë romantizmi shqiptar, qoftë realizmi socialist, përjashto një periudhë të shkurtër gjatë viteve '30, për arsye historike, institucionale e politike, kanë pësuar

[6] Shih: '*Modeli i Ekos formulonte në terma te poetikës ç'ka ndodh mes tekstit dhe lexuesit në kohë. Eko e sheh kuptimin të ndryrë në marrëdhëniet interpretative tekst-lexues, ku statusi i të parit duke mbetur objektiv është i hapur ndaj bashkëveprimit të lexuesit, i cili provon një seri zgjedhjesh interpretative, të cilat ndonëse të kufizuara tekstualisht, mbeten të pakufizuara saktësisht brenda një modeli semantik në formën e një enciklopedie, që përmbush kushtet për ekzegjezën e një pragmatike tekstuale. Ai e zhvendos kuptimin nga kornizat tekstuale për të ofruar një model në lëvizje, ku kuptimi nuk zbulohet, por materializohet në bashkeveprimin e lexuesit me tekstin. Lexuesi merr pjesë në formën e shfrytëzimit të një enciklopedie, përmes së cilës mund të ndërtohet një nga pamjet e mundshme të tekstit. Fish argumenton gjithashtu se padyshim, fjalët kanë kuptim apo se lexuesi nuk është i lirë nga shtrëngesat tekstuale. Lloji i përvojës që teksti lejon rregullohet nga kompetenca letrare e linguistike e lexuesit individual. Lexuesi reagon në një mënyrë e jo në një tjetër ndaj fjalëve sepse ai vepron i mbështetur në të njejtat rregulla që autori përdor për t'i gjeneruar ato – në këtë pikë Fish ripërsërit thelbin e aktivitetit bashkëveprues të lexuesit sipas Ekos. Për të dy kuptimi nuk është më veçori e tekstit letrar, por produkt i aktivitetit të lexuesit, të shtrënguar e të kufizuar nga teksti. Pyetja që kërkon përgjigje nuk është çfarë kuptimi ka teksti, por si e krijojnë lexuesit kuptimin, në kohë? Nga kjo pikëpamje kuptimi kohor i Ekos shfaqet si funksion i kompetencës së lexuesit nën shtrëngimin e tekstit për të marrë vendime interpretative për realizimin e strukturës tekstore, ndërsa te Fish kuptimi paraqitet si rend impulsesh fillestare të lexuesit mbi përvojvn e tij ndaj shtrëngimeve tekstore dhe që për Fish, mund të interpretohen, por nuk shfaqen me këtë gjendje (pra si të interpretuara). Kuptimi sipas Ekos është funksion strukturor i tekstit, ndërsa për Fish është funksion, nëse mund të quhet, parastrukturor, impuls i menjëhershëm, kuptim i rendit të parë. Modelet kanë përputhshmëri, pavarësisht nga debati mbi tekstcentrizmin*', Ermir Xhindi, *Inicüimi i religjionit në letërsi*, Materialet e punimeve të Seminarit XXXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 34/2, Prishtinë 2015, cit. në f. 136.

[7] Po aty, f. 147 (cit.bold)

veprimin e disa konstanteve jashtëletrare, standarde, në pikëpamjen e kodeve strukturore për tekstet e përkatësisht njësuese për funksionin e strukturave në lexim, **(a)** *nxitja për vetëdijësim e përcaktim kombëtar* apo **(b)** *nxitja për vetëdijësim e përcaktim shoqëror, kombëtar e ndërkombëtar marksist-leninist*. Ka një *Poetikë* të ngathët të Tjetrit në letërsinë shqipe.

Një parashtrim i tillë sjell implikime vërtet interesante: *sistemi i diferencave* është në natyrën e tij i ndryshueshëm e realizohet si *objekt* përmes një procesi (përvetësimi) asimilimi të diferencave nga lexuesi, gjatë leximit të tekstit, objekt, i cili natyrisht nuk pritet të jetë përfundimtar. *Asimilimi* në vetvete është kusht për vijimin e leximit e shprehet si tërësi e vendimeve që merr lexuesi i mundshëm, tërësi 'zbulimesh', 'aktesh njohëse', të drejtuara/kontrolluara nga teksti (kodi strukturor) për ndërtimin e strukturës së tekstit.

Në njërën anë për shkak të natyrës së saj - thelbi i funksionit të çdo strukture *si ngjarje* e ndodhur në kohë është të prodhojë *gjithnjë* një version të ndryshëm të *Tjetrit* - në anën tjetër, janë të rralla rastet kur funksioni i strukturës prodhon ndryshime të rëndësishme, në rrafshin e të qenit të dallueshme gjatë këtij procesi. Megjithatë, gjatë romantizmit shqiptar e realizmit socialist ky funksion ndodh me intensitet posaçërisht të ulët.

Vlen të theksohet se rastet e ndryshimeve të dukshme, jashtë këtij intensiteti të ulët të prodhimit të *Tjetrit,* janë pasojë e kodeve te reja të organizimit të saj. P.sh., [***Klasat e përmbysura***] përvojë standarde për tekstet/bashkësitë e leximit gjatë periudhës '45-'90, në tekstet e Kadaresë përfaqësojnë në mënyrë interesante *Tjetrin*, si objekt të realizuar në një mënyrë kryekëput të ndryshme nga pjesa më e madhe e letërsisë shqiptare të kohës.

Siç u përmend, periudha të rëndësishme të letërsisë shqipe zotërohen në rrafshin strukturor nga konstante që caktojnë e kushtëzojnë një sistem diferencash mes bashkësive të lexuesve dhe teksteve përkatëse, duke e ngadalësuar e varfëruar procesin e duke ndihmuar kështu ndërtimin e pak arketipave zotërues mbi ***Tjetrin***. Struktura të ngjashme prodhojnë funksione të ngjashme kur përdorin lëndë/përvoja[8] të ngjashme, dhe, megjithë pikëpyetjet që lindin për marrëdheniet e tyre me bashkësitë e atëhereshme të leximit, mendojmë se qoftë letërsia e romantizmit shqiptar, qoftë ajo e realizmit socialist, përshkruhen lehtë nga kjo pikëpamje.

Rindërtimi i Tjetrit

Ne mendojmë se *Tjetri* në letërsinë shqipe në fillim të viteve '90 kryhet sipas një modusi të ri ndërveprimi, ndaj edhe e propozojmë si ***Rindërtim të Tjetrit***. Kode të reja sjellin moduse të reja ndërveprimi, një Poetikë të re të *Tjetrit.*

[8] Në modelin tonë *lënda në tekst* është e barazvefshme me *përvojën e lexuesit të mundshëm të tekstit*

U jemi drejtuar dy fakteve letrare që shfaqen jashtë veprimit të konstanteve të sipërpërmendura, për shkaqe historike e letrare, romaneve *"Lekura e qenit"*[9] të Fatos Kongolit dhe *"Te jetosh në ishull"*[10] të Ben Blushit. Tekstet janë përafërsisht të një periudhe, jane të njohur për publikun, u është bërë marketing dhe jane shitur mjaft. Blushi, të paktën, e pohon se një pjese të mirë të të ardhurave e siguron nga shitja e librave të tij[11]. Ndërsa Kongoli, përjashto Ismail Kadarenë, nga autorët shqiptarë që shkruajnë sot, është i vetmi me një skedë kaq të pasur botimesh, ribotimesh, përkthimesh, vlerësimesh të marra në Shqipëri dhe jashtë saj, kaq i paraqitur si objekt i vëmendjes së opinionit publik dhe i kureshtjes së masmedias, i profesionistëve dhe profanëve[12].

Po e përdor këtë premisë empirike, që nuk besoj se do të më dyshohet, për të paraqitur, përmes tyre dy farë të përhapura të *Tjetrit* në letërsinë e sotme shqiptare. Teorikisht, konteksti ndryshon mjaft për strukturat, madje edhe për **përvojen, nga çfarë kanë qenë tipologjitë zotëruese deri në fund të viteve '80**: siç u tha, tekstet janë të lire nga shtrëngimet e *konstantes* që i lidhnin detyrimisht me bashkësitë e leximit, qoftë gjatë romantizmit, qoftë gjatë realizmit socialist. Kodet e organizimit strukturor nuk mund të përshkruhen 'së jashtmi' – letërsia '*mbyllet'* ndaj faktorëve institucionalë, çka sjell '*lirinë'* e përvojes, larmi strukturash e funksionesh.

Çështja e implikimeve të farëve mes vetes, mund të ketë interes si çështje në vetvete dhe nuk do të jetë objekti ynë. Është i mundshëm edhe një krahasim mbi tipologjinë e proceseve, njëlloj marrëdhënieje mes tyre.

Metodologjikisht na është dukur e pavend të kqyrim rrjetin referencial të teksteve si kod referencial përkatës, pasi, tek e fundit, ky kod realizohet në strukturë, pra në mënyrën se si pajtohet përvoja e lexuesit në përvojën e leximit të tekstit. Në njëfarë mënyre, ky vështrim nuk mund të mos jetë *formalist* në thelbin e tij.

Lëkura e qenit **- Përshkrim i sistemit të diferencave**

Te Lëkura e Qenit, ***struktura ligjërimore*** *nuk i nënshtrohet ndonjë qëllimshmërie apo funksionalizimi mes njësive ligjërimore: ndryshe nga tekstet e tjerë të Kongolit ku ligjërimi zakonisht fiton karakter shpjegues mbi një subjekt me përmbajtje kohore, te Lëkura e Qenit ligjërimi përbën njëlloj palimpsesti paraqitës, shënues, mbi një botë mbi ekzistencën. Struktura ligjërimore përftohet*

[9] Fatos Kongoli, *Lëkura e qenit, Toena, Tiranë, 2003 (ribot. Toena, 2004; 2005)*

[10] Ben Blushi, *Të jetosh në ishull, Toena, Tiranë, 2008*.

[11] http://www.open.data.al/sq/lajme/lajm/id/1832/titull/Deputetet-te-ardhura-te-deklaruara-sipas-burimit-te-krijimit-Viti-2015-Renditje

[12] Mund të përdoret një skedë e jona mbi botimet e Kongolit e për Kongolit prej fillimviteve '90 e të paktën deri në fund të dekadës së parë të viteve '2000, Ermir Xhindi, *Lector faber, Europrint, Vlorë, f. 18-34*.

prej alternimit në fakt, projektimit nga një njësi ligjërimore e një të tashmeje të aspektualizuar mbi një njësi ligjërimore të ndërtuar mbi një të shkuar relative në raport me të.

Me çfarë është barazavlershme në lexim kjo strukturë? Veprimet e lexuesit paraqiten më të thjeshta për shkak të një idenditeti të vetëm ligjërimor. Strukturimi ligjërimor synon realizimin e njësive që sugjeron teksti – lexuesi duhet të ruajë unitetin ligjërimor prej nga kryhet projektimi duke zhvilluar një shqisë të diferencës në kohë: në fillim lexuesi ndan kohen e prologut (Kap. I) si kohë e tashme në raport me të cilën shfaqen dy nivele të së shkuarës, të cilat hyjnë në marrëdhënie projektimi mes tyre. Në disa raste, struktura ligjërimore ndihmohet prej izotopisë ligjërimore, pra, veç identifikimit të qartë të nje përmase relative kohore, është ligjërimi që vetëstrukturohet. Mekanizmi kryesor aktualizues i lexuesit është strukturimi i kohës ligjërimore: ai përgatitet të zhvendoset periodikisht nga një nivel i dhënë i së shkuarës në një nivel tjetër relativ me te: lexuesi strukturon njësi ligjërimore të përfshira prej projektimeve kohore, të cilat i bashkon në një njësi të vetme, në nivelin nga kryhet projektimi.

Çfarë ndodh gjatë zhvendosjeve kohore? Ç'përbën koha e projektuar për lexuesin?

Në tërësi ajo jepet si shenjë e gjendjeve, kryesisht shpirtërore psikike, në formën e disa nyjeve të përvojës, nyje që identifikojnë sinjale orientuese, struktura të përvojës: në këtë rast koha shfaqet si mekanizëm identifikimi i objekteve, ajo zhvishet nga konkretësia, bëhet përmase shenjuese objektive. Lexuesi e identifikon kohën si shenjë e gjendjeve të përfunduara të ruajtura ose jo, si shenja e sendeve të humbura: nga kjo pikëpamje e shkuara në tektet e Kongolit fiton herë funksion pajtues e kjo lidhet me përvojat e protagonistit, të moshuar, në gjendjet e tij në të tashmen: një e shkuar tjetër është ajo e sendeve të humbura, të humbura në vetvete, çka përbën edhe raportin dramatik të së tashmes me të shkuarën që vëren lexuesi: në një mënyrë tjetër e shkuara konfigurohet si realitet i gjendjeve të protagonistit dhe si realitet objektiv e subjektiv i së shkuarës që vijon të ekzistoje: në pjesën më të madhe të rasteve Kongoli nuk e zgjedh këtë aspekt shenjues të së shkuarës-lexuesi e aktualizon gjendjen e protagonistit si përfundimtare, në raport me kujtimet e sendeve të humbura.

***Struktura narrative**. Veprimet interpretuese të lexuesit gjatë aktualizimit të strukturës narrative i përgjigjen kodit kohor të përdorur gjatë aktualizimit të struktuës ligjërimore: përgjithësisht njësitë ligjërimore të së shkuarës projektuese orientohen në lexim mbi topiket e sëmundjes së Margës, vdekjes së Margës, drejtimit që merr familja pas vdekjes së saj, në mënyrë të veçantë, Kristi. Njësitë ligjërimore të orientuara mbi topikët e mësipërm formojnë izotopi narrative në lexim - shihet se izotopitë narrative vijojnë të kenë përmbajtje kohore. Njësitë ligjërimore të kryera si një e shkuar e aspektualizuar, e formuar mbi projektimet topike të përvojave të inicimit seksual, të adulterit, të përvojave seksuale të jetës studentore, punës në fshat, të njohjes me Delian, Sytë e Gjelbër etj, etj, formojnë njësi izotopike narrative. Teksti ofron dy izotopi narrative të aktualizuara, përkatësisht, mbi dy forma relative të së shkuarës – lexuesi i aktualizon si njësi izotopike me orientim të ndryshëm strukturor, intensitet të ndryshëm dhe në raporte të qarta pavarësie prej njëri tjetrit në lexim. Izotopia e parë narrative paraqitet si tërësi sekuencash izotopike mbi topikët e orientuar nga tregues referenciale unikë për procese që ndodhin me karaktere te ndryshme-vdekja e Margës.Izotopia e dytë narrative, për subjekte të ndryshëm të rrëfimit ofron tregues referenciale të ndryshëm: persekucioni (Dolora, Lori), rrebelimi (Sonila, Delia), dashurinë (Sytë e Gjelbër). Lexuesit i duhet të strukturojë*

me vështirësi përmbajtjen e ndryshme referenciale të karaktereve, mbi topikët e domethënies së tyre sensuale për Krist Tarapin. Siç shihet, edhe inventari referencial paraqitet më shumë i fokusuar në izotopinë e dytë narrative. Në ndryshim nga struktura narrative në romanet e tjerë të ciklit, izotopitë narrative në tekst nuk hyjnë në raporte funksionale me njëra tjetrën, në kuptimin klasik të fjalës per funksionet izotopike në cikël. Izotopia e parë narrative nuk e funksionalizon të dytën – në lexim, asnjë nga topikët orientues të izotopisë së dytë nuk shërben për të shpjeguar ndonjë nga topikët orientues të izotopisë së parë narrative (vdekjes së Margës, rrugës që merr familja).

***Ndërtimi i strukturës narrative**. Më sipër u përmend se topikët narrativë të izotopisë së dytë, në fakt izotopia në tërësi, vështirë se mund te korrespondojë me izotopinë e parë narrative në mënyrë të qartë. Në njëfarë mënyre kjo nënkupton një izotopi të dytë narrative jo domethënëse, që medoemos duhet strukturuar nga lexuesi, edhe kur topikët narrativë të izotopisë së dytë nuk ndërtojnë sekuenca domethënëse me ndikim në të tashmen e protagonistit, apo që shpjegojnë ritmin e jetës së tij: topikët narrativë të kësaj izotopie, ndonëse jo plotësisht, arrijnë të shpjegojnë habitatin ekzistencial të protagonistit, pra t'i japin formë, rethanës ku vendoset protagonisti. Nga pikëpamja e ndërtimit të strukturës narrative, teksti e fton lexuesin të kuptojë protagonistin në njëlloj perspektive e jo në gjendjen e tij konkrete, e cila zakonisht në romanet e Kongolit është edhe gjendje përfundimtare e protagonistit, e për pasojë dhe e fabulës.*

Aktiviteti parashikues i lexuesit për ndërtimin e fabulës përdor si botë referenciale për aktualizimin e gjendjeve perspektive të protagonistit, te dyja izotopitë narrative: gjatë izotopisë së parë lexuesit i bëhet e mundshme të krahasohen botën e tekstit me botën e referencës dhe të kryejë parashikimet e mundshme: karakteri i strukturuar i kësaj izotopie bën të mundur këtë. Prej botës referenciale mund të parashikohet bota e tekstit të kësaj izotopie, gjë e pamundur në izotopitë sundues e narrative në romanet e tjerë të ciklit. Aktiviteti parashikues i lexuesit mbi protagonistin mbështetet edhe në krahasimet e botës së tekstit me botën referenciale gjatë izotopisë së dytë narrative - ky tip i aktiviteteve parashikuese merr formë veçanërisht në fund të tekstit, kur lexuesi mund të parashtrojë paradoksalisht gjendjet fillestare të protagonisitit. Aktiviteti parashikues i lexuesit mbi izotopinë e dytë narrative lidhet me gjendjet e marrëdhënieve të protagonistit me karakteret e tjerë: në këtë mënyrë mund të shpjegohet për së largu reagimi i Tomit apo formimi dramatik shpirtëror i Lorit gjatë izotopisë së parë narrative.

Përditësimi i fabulës përmes aktivitetit parashikues të lexuesit që ndërton njësi izotopike komplementare, në këtë roman paraqitet si më zotërues se në romanet e tjerë të ciklit "Burgjet e kujtesës". Nëse te ata aktiviteti ndërtues i fabulës merrte kuptim relativisht vonë në lexim, pra në pikën ku bota e tekstit mund të vendosë lidhje domethënese me botën e referencës në funksion të shpjegimit të gjendjeve të protagonistit, në romanin Lëkura e Qenit, ky aktivitet paraqitet më i ekuilibruar. Gjatë izotopisë së parë narrative bota e tekstit hyn në botën e referencës çka e lejon shpjegimin e gjendjeve të protagonistit deri në pikën ku gjendja e tij shihet në perspektivë, pra ku hyjnë në lojë pohimet e lexuesit prej marrëdhënies mes botës së tekstit në izotopine e dytë narrative dhe botës referenciale përkatëse.

***Struktura aktanciale e ideologjike**. Për kompetencën sistemike, pra për kompetencën e lexuesit të Kongolit në vijim gjate ciklit 'Burgjet e kujteses', struktura aktanciale e ideologjike e*

romanit nuk sjell elemente të rinj. Funksioni i kësaj kompetence sistemike është rishpërndarja e disa mikrostrukturave aktanciale relativisht të njohura edhe më parë në tekstet e Kongolit. Natyra aktanciale e Krist Tarapit përbën një rimarrje në lexim të protagonistit p.sh. te Kufomës apo te Dragoi i Fildishtë, por konotacionet aksiologjike të aktantëve përkatës janë krejt të ndryshme: p.sh në rastin e Genc Skampës humbja e Sui Linit e përmbys botën e tij, ajo vijon të jetë peng edhe pas tridhjetë vjetësh. Prirje themelore aktanciale me të cilën strukturohet në lexim protagonistit është zbërthimi i motiveve, krijimi i përvojave mbi botën permes femrave me të cilat Krist Tarapi ka pasur marrëdhënie. Nëse edhe më parë leximi orientohej nga topikët e obsesivitetit erotik të protagonistëve, në romanin Lëkura e Qenit çdo fazë e jetës së tij në shkuarën apo në tashmen ka në qendër një femër, një femër me të cilën ai zakonisht shkon në shtrat. Veç kësaj, kjo prirje aktanciale obseduese çuditërisht nuk sjell pasoja për protagonistin: asnjë zhvillim në jetën e tij të mbushur me femra nuk kushtëzohet prej pranisë së tyre. Lexuesi i mësuar me praktikën aktanciale të protagonistëve të ndëshkuar përmes topikut te ndalimit të marrëdhënieve me një femër, e ka të pamundur në roman të rindërtojë aktivitetin e vet interpretues mbi këtë topik. Edhe kur është e mundur plotësisht që kjo të ndodhë, protagonisti i shmanget, duke e shpëtuar leximin nga interpretimi i ndonje topiku me përmbajtje melodramatike (rinjohja e gruas së profesorit, e Dolorës). Pas Ëndrra e Damokleut si ekzorcizëm i kompleksit te Edipit, Lëkura e Qenit përbën ekzorcizmin e dytë të rëndësishëm në krijimtarinë e Kongolit–ndërprerjen, ndalimin e një femre. Gjatë leximit ky funksion aktancial i protagonistit (sensualizmi) mbetet konstant dhe pa ndonjë pol aktancial kundërvënës. Teksti e vendos ekuilinrin në fund, ashtu si Ëndrra e Damokleut: asgjë, asnjë femër nuk i ndalohet protagonistit. Në këtë mënyrë ai mbërrin një identitet, i cili është mungesa e madhe e protagonistëve në romanet e tjerë. (mund të flitet, madje, për një lloj vijimësie të identitetit–e vetmja krizë identiteti e mundshme e protagonistit është mungesa e femrave, ai është i lidhur dëshpërimisht me to). Në këtë plan, ky topik aktancial është i perputhshem me atë që në lexim përbën fabulën e gjendjeve perceptive. Në këtë kuptim Lëkura e Qenit vijon të jetë një tekst i dekadencës – për aq sa është teksti i karakterit, – por i një dekadence rozë, me disa hije optimizmi. Funksioni rishpëndarës i kompetencës sistemike shërben në lexim për të caktuar e krahasuar:

1) riaktivizimin aktancial mbi topikun e gruas si objekt i dhunimit sistematik (Liza/gruaja e vilës/Dolora/Lori/Sonja; mbi topikun e adulterit Dolora/Sara; mbi topikun e marrëdhënies indiferente me bashkëshorten (Juli/Sytë e Gjelbër); mbi topikun e femrës si konfidente erotike e shpirtërore njëkohësisht (Faika/ Suzi); mbi topikun e persistencës së dhunës (Dolora/Sonja);

2) homologjinë e plotë aktanciale mbi topikun e përndjekjes: Krist Tarapi/Hadi, Festim G./Valmir A-B-D, Thesar Lumi/Sytë e Bardhë etj.

Nga ky këndvështrim Lëkura e Qenit përbën një strukturë aktanciale me të cilën lexuesi është familjarizuar. Mungesa e aksit kundërvënës aktancial përbën risinë më të rëndësishme të kësaj strukture. Në këtë kuptim funksioni strukturor i kompetencës sistemike në leximi, e vendos protagonistin në rrjetin aktancial klasik, ku mungon poli i kundërt aktancial, duke strukturuar kështu një njësi me përmbajtje simbolike: protagonistin që realizon identitetin e vet, megjithatë të pjesshem. Ç'ideologjizimi i raporteve aktanciale si mundësi për të ndërtuar kundërvenien aktanciale, e

shtron në një plan të ri çështjen e identitetit, ***si perspektivë, megjithatë një perspektivë e errët.***[13]

Objekti i përftuar

Objekti i perftuar si sistem i diferencave paraqet detyrimin e lexuesit për të vendosur marrvdhënie mes disa rrafsheve të kohës, të tashmes dhe dy gjendjeve të aspektualizuara të së shkuarës, në marrëdhënie projektimi mes tyre e midis të cilave ai zhvendoset periodikisht. Lexuesi duhet të përmbushë kushtin për të krijuar izotopi ligjërimore mes së shkuarës së afërt me projektimin e saj izotopik, në një të shkuar relative me të, të cilat shfaqen si gjerdan nyjesh ligjërimore të mbyllura, të përfunduara, gati si një *palimpsest strukturor*. Në rrafshin narrativ ai duhet të kryejë e të miratojë praninë e dy njësive izotopike në marrëdhënie jo funksionale mes tyre, (e para e kryer mbi topikë të lidhur me krizën morale të protagonistit, ndërsa e dyta mbi topikë të historisë së tij morale e psiko-seksuale) e mbi këtë të asimilojë natyrën persepektive të një strukture të hapur.

Tjetri: *dëshmohet si konstrukt mbi një repertor kaotik të historisë së një habitati ekzistencial midis diktaturës e pas saj, pa kontinuitet, pa qëndrueshmëri, pa shkakësi, veç nxitjeve intuitive e seksuale, njëlloj reduktimi rronitës moral, shpirtëror, psikologjik, deri në biologjizëm, në mungesë të çdo sistemi ndërlidhës vlerash, të çdo lloji, dhe si zhvleftësim i çdo trashëgimie*.

Të jetosh ne ishull – Përshkrim i sistemit të diferencave

Në pikepamjen e (makro)strukturimit ligjërimor ky tekst i përket manierës klasike, një lloji të konservatorizmit klasik në rrëfim që është rimarrë shpesh, tash së fundi, në traditën europiane e botërore: izotopi ligjërimore të rendit sintagmatik në pikën e ndarjes/bashkimit mes tyre (të kapitujve), kryhen mes vetes si izotopi me fond paradigmatik për lexuesin. Lexuesit i duhet të shfrytëzojë, madje të shterojë kompetencën e vet, në funksion shpesh, të rindërtimit të saj: kapitulli i parë, i *konvertimit*, p.sh., është shembull për *rrëmujën* shumëplanëshe të kompetencës. Ky ndërlikim bëhet shkak edhe për *intensitetin e ulët izotopik* që e shoqëron ndërtimin e strukturës. Rindërtimi i kompetencës kërkon të arsyetojë vetveten.

Bash për këtë, pikat sintagmatike të bashkimit nuk janë tjetër veçse ndërmjetëse mbi njësi të reja izotopike në funksion të njësive paraardhëse, të rritjes së intensitetit izotopik të strukturës e të rindërtimit të kompetencës, mjet që teksti e ofron si *trambajtës* të qartë për strukturën. Lexuesit, pra, i duhet të kryejë strukturë mbi tërësi izotopike që e kushtëzojnë njëra-tjetrën, në dukje linearisht, por mbi pasigurinë e

[13] Teksti ne korsiv është riprodhim prej punës sonë: Ermir Xhindi, *Lector faber, Europrint 2009, f.* 219 - 225

natyrën e paqartë të nyjave sintagmatike. A janë ato, pikat e vërteta të *bashkimit* strukturor të tekstit, kështu, kaq pak domethënëse në krahasim me njësitë që lidhin?

Në lexim kjo është e barazvlershme me njëlloj *blatimi strukturor, njëlloj lëshimi* që teksti i bën lexuesit, i cili duhet të rindërtojë kompetencën për të kryer tekstin. Pothuaj e gjithë *enciklopedia* e lexuesit tani vihet në provë përballë referencave të reja, nxitet *lëndë e re izotopike, izotopi të reja.*

Në rrafshin narrativ, struktura karakterizohet prej evoluimit të një gjendjeje shenjuese për fillimin e tekstit: *intensiteti i ulët izotopik* i njësive ligjërimore fillestare, medoemos duhet të rritet - pavendosmëria e lexuesit duhet të shmanget, përndryshe struktura nuk *mund të kryhet.* Bashkimet e thjeshta sintagmatike në kufij të izotopive ligjërimore *grafike,* ndërsa në njërën anë e joshin lexuesin të vijojë të kryejë strukturën, mbartin edhe rrezikun e renies edhe më të dukshme të intensitetit të ulët izotopik ligjërimor për një pjesë të mirë të romanit.

Teksti e zgjidh këtë thjesht: në njërën anë, duke shtuar masën e njësive ligjërimore, ndërsa në anën tjetër, duke e shtuar masën e treguesve të rinj referencialë (njëlloj *aritmetike narrative në funksion të një matematike referenciale*). Ndërsa në njërën anë, shtohet masa izotopike, në anën tjetër i jepen sinjale koherence kompetencës së lexuesit, për të siguruar tërthorazi rritjen e intensitetit izotopik, pra ngjizjen e strukturës.

Teksti e *pavarëson dalëngadalë lexuesin,* aq sa t'ia besojë atij plotësisht jo vetëm arkitekturën e vet, por edhe qëndrueshmërinë e strukturës. *Fabula* si izotopi narrative është plotësisht çështje e lexuesit, e *besimit të tekstit* mbi kompetencën e tij të rindërtuar. Sidoqoftë, romani i Blushit ndeshet me një vështirësi jo të vogël: treguesit e rinj referencialë janë aq dukshëm *revolucionarë* saqë veprimet parashikuese të lexuesit mbi botë të mundshme të referencës bëhen me të vërtetë të vështira. Për më tepër, jo rrallë ka një asimetri të dukshme mes *treguesve referencialë ritualë dhe atyre alternativë* në pikëpamje të koherencës, çka e lëkund botën e referencës mes përvojës së lexuesit si e tërë dhe një përmase kulturore e fiksionale të saj. Pikërisht gjatë kësaj faze, pra gjatë ndërtimit të *botëve të mundshme*, kompetenca e rindërtuar hyn në krizë: ajo i është nënshtruar një *shtypjeje* kaq të fortë prej domosdoshmërisë për të ndërtuar izotopi *të reja/fabul të re*, saqë e humb aftësinë e saj për të përshirë botën e tekstit në një botë të referencës (*teksti i jep lexuesit pavarësinë të cilën ai nuk mund ta përdorë).*

Veprimet mbi *strukturën aktanciale e ideologjike* janë pasojë, në një masë të madhe, të konfliktit të brendshëm që karakterizon ndërtimin e fabulës si izotopi narrative themelore e tekstit[14]: ndërsa treguesit ritualë zbresin deri në rrafshin *parodik*[15] të kompetencës, treguesit alternativë shkojnë në një rrafsh të rindërtuar thellësisht të përvojës, në një rrafsh gati fiksional. Është kryer një proces i çuditshëm: intensiteti i

[14] Asimetrisë mes treguesve referencialë rituale me ata alternativë

[15] Sali Benishi.

ulët izotopik e rrezikonte të ardhmen e strukturës; rritja e tij (e intensitetit) e siguron atë (të ardhmen e strukturës), por e *cënon* qëndrueshmërinë e saj. Në këtë rrafsh teksti *pavarësohet prej* lexuesit, i cili është i lirë *të mos bëjë asgjë*.

Objekti i përftuar

Objekti i përftuar si sistem diferencash, në këtë rast, përmban sërish zhvendosjet periodike të lexuesit mes së tashmes dhe së shkuares - kjo e dyta, në funksion të orientimit izotopik të strukturës nga lexuesi, por kësaj rradhe në kufijtë e njësive të mëdha, të përfshira linearisht të njëra-tjetra, qoftë si izotopi ligjërimore, qoftë narrative. Sistemi i diferencave shfaqet më pak në arkitekturën izotopike e më shumë në vëllimin e në natyrën e treguesve referenciale që e bëjnë të mundshme strukturën - e shprehur qartë, strukturë e thjeshtë, por e ndërtuar me shumë material, (mbase më shumë se ç'duhet), për më tepër, të panjohur. Kryerja e strukturës, është e barazvlershme me rindërtimin e kompetencës së lexuesit, hendek mjaft i lartë diferencash.

Tjetri: një konstrukt i panjohur historik, i pasigurt, rindërtim i identitetit, mbi një rend mohimesh të sistemit të derisotëm të vlerave, bindjeve, njohjeve, rindërtim i sistemit të vlerave.

Ermir XHINDI

(RE)CONSTRUCTION OF THE *OTHER* AS A PROCESS AND INTERPRETATION OBJECT AT THE STRUCTURE'S LIMITS

Abstract

The definition of The Other in the Albanian literature is consequence of self-identification national, social, cultural and spiritual endeavor which begins with the romanticism during Albanian National Renaissance. In its early stages, this process was accomplished 'out' of texts for as long as structurally Albanian literature lived its naïve stage, without its subsequent complexity which relocated the respective phenomena inside the limits of literary text as dialectic relationship between the definition of 'I'/'WE' and 'The Others', in all its structural totality. Nevertheless until of the '80th of the XX century despite important changes in Albanian literature, one of rare inviolable categories remained the definition of 'The Other' expressed under unified cultural and ideological 'out of literature' platform which was disintegrated at the beginning of the '90th of XX century.

We aim to represent an investigation on this case especially after '90th e so on when this process continues on the absence this 'out of literature' platform. We used texts written by Fatos Kongoli and Ben Blushi as the most distinct representative in our judgment of the most important tendencies of this phenomena from the viewpoint of structural construction and relevant meanings made by a cultural instrument 'The possible reader' based on theoretically hybrid version 'Eco-Fish'. In this sense 'The Other' is manifested at the limits of literary structure simultaneously as a process and an object done by interpretation.

Atdhe HYKOLLI

FIGURAT E SË KEQES NË LETËRSINË TONË

Figurat e së keqes në letërsinë tonë, posaçërisht në letërsinë popullore (gojore) dhe nëatë të kultivuar, janë shfaqur pëherë, kund më rrallë e kund më shpesh, duke nxjerrë në pah veset dhe tiparet e këqija të njerëzve smirëzinj, mizorë, katraligë etj., që veprojnë në dëm të njerëzve shpirtmirë, të pafajshëm e naivë.

Meqë këto shëmbëlltyra të sëkeqes shfaqen në letërsinë tonë (për të rritur dhe për fëmijë), gjithnjë e më shumë e më shpesh i nxjerrin në shesh këto figura, që mbeten në kujtesë, si diç të lemerishme, rrëqethëse, traumatizuese e të ngjashme, që shkaktojnë revoltë, tmerr, frikë e çka jo tjetër.

Shfaqja e së keqes, si nocion i tëpadëshirueshmes, i të neveritshmës, i të papëlqyeshmes etj., që është pjellë e dukurive që shkaktojnë: frikë, revoltë, mërzi, ankth, neveri, rrezik te njerëzit e pafajshëm, të sinqertë, e të pambrojturbëhet gjithnjë në dëm të tyre.Figurat e së keqes paraqesindisa veti e tipare të përbashkëta, të cilat lënë gjurmë në vetëdijen e njerëzve. Prandaj shfaqja e tyre kurdoherë mbetet e padëshiruar, e urryeshme, pasi të keqen askush nuk e dëshiron dhe gjithnjë e kundërshton. Edhe në letërsinë tonë të gjithë krijuesit e kanë pikturuar të keqen me gjithë shëmtimin e saj.

Në letërsinë tonë, si në atë popullore dhe atë të kultivuar, që nga antikiteti e deri në ditët e sotme, hasen një sërë figurash që përfaqësojnë karakteret e ulëta, të neveritshme, lemeritëse, trishtuese dhe të papëlqyera, tëcilat si bartëse të veprimeve të këqija shkaktojnë pasiguri, refuzim, nënçmim dhe revoltë. Kështu, figura e sëkeqes zë fill që nga gojëdhënat, legjendat a përrallat, duke u shfaqur edhe në letërsinë e shkruar në të gjitha gjinitë letrare, ku më shumë e ku më pak.

Në këtë kumtesë, pa u thelluar më shumë për secilën figurë veç e veç, do të përqendrohemi vetëm në disa sish, për t`i zënë në gojë ato më të shpeshtat, të cilat tashmë janë të njohurapër shumëkënd.Shumënga këto figura e kanëzanafillënnë mitologjinëshqiptare[1], përndriçimine së cilës kanë kontribuar shumëstudiues eminentë shqiptarë dhe të huaj. Kështu, këto figura, subjekte të mitologjisë sonë dhe të disa popujve tjerë, ku vend të rëndësishëm zënë: kuçedra (kulçedra, kulshedra), dragoi (drangoi, drangoni), zanat, gjarpri (gjarpni i shpisë), djalli (dreqi, shejtani), lugati, shtriga[2] etj., janë figurat më të njohura dhe më të pranishme edhe në mitologjinë tonë

[1] Mark Tirta, Mitologjia ndër shqiptarë, ASHSH dhe IKP-DE, Tiranë, 2004, fq. 121.
[2] Mark Krasniqi, Aspekte mitologjike-besime e bestytni, "Rilindja", Prishtinë, 1997, fq. 299.

bashkëkohore edhe në besime e besëtytni, jo vetëm tek ne, por edhe tek popujt e tjerë, në Ballkan e më gjerë. Këto figura mitologjike, varësisht nga popujt, kanë trajtim të ndryshëm, për shumë sosh. Pra, që nga gojëdhënat, në legjendat a përrallat e shumta, të përcjella brez pas brezi e të bartura edhe në letërsinë e kultivuar (në të gjitha gjinitë letrare) ndeshen këto figura të së keqes, për t`i karakterizuar a tipizuar vetitë e këqija, që shfaqin dukuri a vese të ulëta a dashakeqe.

Në mitologjinë shqiptare kuçedra (kulshedra, kulçedra)[3]është qenie me pamje rrëqethëse e të neveritshme. Fytyra dhe i gjithë trupi i saj janë të mbuluara me qime të gjata. Ajo përfytyrohej si një grua e thinjur, trupmadhe, por më shpesh si një gjarpër shumë i madh me 7-12 krerë, që nxjerr flakë nga goja. Kulçedra[4] rritej në shpellat e maleve, ajo i shterte puset e burimet e ujit të pijshëm dhe nuk i lironte derisa asaj t`i bënin fli njerëz, të cilët ajo i gëlltiste të gjallë. Me kuptimin figurativ kuçedër i thonë edhe gruas zemërligë, tëvrazhdë e grindavece. Kjo figurë e së keqes në mitologjinë tonë e hasim në tregime e përralla popullore, por edhe në gjini të tjera të letërsisë së shkruar. Figurën e kuçedrës e hasim edhe në sa e sa shkrime letrare të sa e sa shkrimtarëve tanë bashkëkohorë. Pra, kuçedra paraqet figurën e së keqes, antipodin e së cilës e hasim te dragoi, që i kundërvihet asaj për të sjellë mbarësi, e qetësi. Sinonim i kuçedrës është lubia, që figurativisht shpërfaq njeriun e pangopur që nuk di të ngopet me asgjë dhe kurrë, që nënkupton njeriun që ha shumë, që nuk nginjet fare. Kjo figurë e së keqes në letërsinë tonë, qoftë në atë popullore apo të kultivuar, është përhapur në të gjitha trojet tona, si dhe në të gjitha gjinitë letrare, ku më shumë e ku më pak. Me fjalën kuçedër, në kuptimin figurativ kuptohet se është fjala për gjithçka të keqe, të tmerrshme, lemeritëse, të rrezikshme, qëështë imponuese, pushtuese, që cenon lirinë e veprimit tëtëtjerëve. Me këtë fjalë, po ashtu, vetvetiu kuptohet se personifikohen të gjithë pushtuesit e kohëve të ndryshme, si: Perandoria Bizantine, Perandoria Osmane, Mbretëria Serbe[5] etj., që element të përbashkët kanë pushtimin e popujve, që i mbajtën nën thundrat e tyre shekuj me radhë.

Ndërkaq, djalli është qenie e mbinatyrshme, e përfytyruar zakonisht si njëgjysmënjeri me brirë, me thundra e me bisht; mishërimi i së keqes dhe i ngasjes për punë të liga, shpirti i keq, dreqi, shejtani etj. Kështu, gjatë historisë sënjerëzimit, në mitologjinë e të gjithë popujve, kanë ekzistuar dy fuqi kryesore kundërshtare. Njëra nga këto është e mirë, kurse tjetra e keqe. Kështu, e mira gjithmonëështë në anën e njerëzve të mirë, për punë të mbara, kurse fuqitë e këqija apo negative bëjnë të kundërtën. Pra, burimi i të këqijave vjen nga djalli, satanai, dreqi, demoni - figura këto që shpërfaqen edhe në letërsinë tonë - simbole këto të së keqes, varësisht nga rrethanat e krijuara në kohë e hapësirë. Pra, djalli paraqitet me karakteristikat e tij si:

[3] Mark Tirta, vep.e cit. fq. 123.
[4] Sterjo Spasse, Elementet e paratë teorisë së letërsisë, ETMM, Prishtinë, 1971, fq. 159.
[5] Veis Sejko, Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate, Tiranë, 2002, fq. 120.

gjysmënjeri, gjysmëkafshë, shpend, përbindësh etj. Kështu, njëra nga vetitë kryesore të djallit është aftësia e tij që të transformohet në krijesa të ndryshme, që për syrin e njeriut bëhet i padukshëm, por vetëm për veprime të këqija, prandaj sa herë që zihet në gojë nënkuptohet se kemi të bëjmë vetëm më veti të këqija. Në letërsinë tonëeksitojnë sa e sa sinonime për djallin si: dreq, shejtan, nalet, djall, ai i përronit,ai i shpellave,ai i grrellave,ai i malit, ai i territ, ai i mallkuemi, ai i ferrit,ora e ligë, ai qoftëlargu, ai i pusit, ai që digjet, ai i mbrapshti[6] etj. Pra, djalli është sinonim i së keqes, gjë që në letërsinë tonëshpreh të gjitha të këqijat e mundshme. Këto fjalë (sinonime) që kanë të bëjnë me djallin i hasim në të gjitha trojet shqiptare dhe në të gjitha gjinitë letrare.

Si figurë e së keqes në letërsinë tonë haset edhe shtriga - figurë e krijimeve popullore, e përfytyruar si plakë e keqe dhe e shëmtuar, që ha njerëz dhe bën magji të liga. Kjo figurë mitologjike ka lidhje me djallin. Figura e shtrigës haset në letërsinë tonë popullore dhe atë të kultivuar, ku simbolizon njerëzit me veti të këqija duke dëmtuar lirinë e njerëzve të mirë, të pafajshëm. Këtë figurë e hasim sidomos në përrallat a legjendat e shumta nga letërsia popullore, që kultivohet brez pas brezi. Ndërkaq, tashmë në kuptimin e sotëm "gjuetia e shtrigave" ka konotacion politik, që shpreh përndjekjen politike. Në mitologjinë shqiptare figura e shtrigës paraqet, po ashtu, një plakë që me magjitë e saj vepron për të keq, sidomos ndaj fëmijëve, grua e cila i ha fëmijët, sipas besëtytnive të shfaqura në popull. Shtriga është demon negativ, ajo është mashë e djallit, nga i cili rrjedhin të gjitha të këqijat në botë.

Lugati është një nga figurat mitologjike[7] që shfaqet edhe në letërsinë tonë, sidomos në letërsinë popullore, ku ai paraqitet si një ardhës nga një botë tjetër misterioze. Kjo figurë e besimeve popullore, e përfytyruar si njeri, i cili në gjallje të tij është shumë i keq dhe pas vdekjes ngrihet natën nga varri e tremb njerëzit. Kjo figurë haset, pos në letërsinë popullore, edhe në atë të kultivuar.

Figurën e lugatit e ndeshim sidomos në përralla, në letërsinë fantastike, ku besëtytnitë krijojnë pasqyrën e narracionit, posaçërisht nga frika e territ të natës. Kjo figurë mitologjike, që paraqet veti e tipare të së keqes, ndeshet në shumë troje shqiptare, kurse në letërsinë artistike të kultivuar e hasim si sinonim i vetive të këqija të njerëzve, ku vihet në pah karakteri i njeriut shpirtkeq, smirëzi e dashakeq, i cili vepron në dëm të njeriut të mirë.

Figura e bajlozit[8] në letërsinë tonë ka konotacion negativ, meqë paraqet pushtuesin që del nga legjendat dhe vjen nga deti, për të mbjellë zi. Kështu, kjo figurë mitologjike shpreh gjithë ato të këqija që ndjellin kob e zi. Në letërësinë tonë bajlozi tipizon dhe karakterizon gjithçka është e zezë, tmerruese, ogurzezë, lemeritëse etj., që bën kërdi për të marrë pushtetin, duke shfarosur e përmbysur gjithçka të pushtuar.

[6] S. Spasse, vep.e cit. 159.
[7] Zihni Sako, studime për folklorin, ASH dhe IKSH, Tiranë, 1984, fq. 304-307.
[8] Grup autorësh, Studime dhe kritikë letrare, Tiranë, 1983, fq. 153-178.

Në përmbyllje të kësaj që u zu në gojë më parë, mund të pohohet me të drejtë se edhe letërsia jonë (gojore dhe e kultivuar) sikurse simotrat e saj të popujve tëndryshëm (fqinjë apo më të largët), ka elemente të përbashkëta dhe të veçanta të figurave të shumta mitologjike[9], të veshura aty-këtu edhe me petkun e modernes, duke pasqyruar veti, tipa e karaktere të figurave të së keqes, duke vënë në pah këto tipare në dëm të së mirës. Këto figura, që nga e kaluara e deri në ditët e sotme, në letërsinë tonë hasen në të gjitha gjinitë letrare nga sa e sa shkrimtarë, të cilët me gjuhën dhe stilin e tyre dinë t`i përdorin në procesin e krijimtarisë së tyre, për të arritur efektin e fjalës së shkruar. Këto figura (sinonim i së keqes) shfaqen në të gjitha gjinitë letrare, nga vjersha e deri te romani a drama, ku figurae së keqes vihet aty ku e ka vendin.

Kujtoj se do të ishte e pamundshme dhe e paarsyeshme (për shkaqe tëhapësirës kohore të kufizuar) për t`i ilustruar me shembuj konkretë të gjitha këto figura (sinonim i së keqes) në letërsinë tonë, pasi shembujt janë të shumtë dhe se lypet hapësirë më e gjerë dhe kohë më e gjatë për t`u mbarështruar ashtu veç e veç.

Prandaj, për një mbarështrim më të plotë dhe më të përimtuar jo vetëm që duhet analizë më e thellë dhe më e zgjeruar, por lypset një studim më gjithëpërfshirës, ku do të duhej të paraqiteshin dy paralele të këtyre figurave, ku në njërën anë do të duhej të radhisnim figurat e së mirës dhe në anën tjetër figurat e së keqes në letërsinë tonë, ku do të jepeshin të dhëna më të plota, me qëllim që të pasqyrohet kjo begati e vlerave shpirtërore, krahasuar me letërsitë simotra në Ballkan e më gjerë.

Figura e së keqes, sikurse në letërsitë simotra, në letërsinë tonëështë shfaqur pothuajse në të gjitha gjinitë letrare, ku më pak e ku më shumë, duke i paraqitur ato karakteristika të dukurive të ndryshme, në vende dhe në situata të shumta. Kështu, bie fjala: kuçedra, djalli, kukudhi, lubia, shtriga, lugati, shejtani, bajlozi etj., jo rrallëherë i ndeshim pothuajse në të gjitha gjinitë letrare, me të cilat figura para nesh shpërfaqen në të gjitha karakteristikat e tyre, ku revolta, tmerri, frika, rreziku, nënçmimi, trauma paraqiten tek njerëzit për t`u mbajtur në mendjet dhe zemrat e tyre, duke shkaktuar dukuri a fenomene të padëshiruara. Këto figura të së keqes i venerojmë si në: legjenda, përralla e gojëdhëna po ashtu edhe në të gjitha gjinitë letrare në letërsinë e shkruar. Këto figura të së keqes nuk janë vetëm ato nga antikiteti, por edhe të ditëve tona, ku e keqja si figurë mitologjike vishet me petkun e modernes, duke ndërruar personazhet por assesi vetitë ose karakteristikat e fenomeneve a dukurive nëpër shekuj.

Derisa ne tërheqim dy paralele të këtyre dy farë figurave kundërshtuese: e mira kundrejt së keqes, përqendrimi ynëështë te kjo e dyta, duke vënë në pah ato tipare dhe karakteristika të cilat mbjellinfrikë, tmerr, zi, trishtim, revoltë, para nesh sikur shpërfaqen figurat e së keqes si: kuçedra, djalli, shtriga, bajlozi[10], lugati,lubia, ora e zezë, qoftëlargu, shejtani, laneti, etj.

[9] Mark Tirta, vep.e cit. fq. 121.
[10] Mark Krasniqi, vep.e cit. fq. 299.

Këto figura të së keqes i hasim kudo në trojet dhe gjinitë letrare të kulturës sonë shpirtërore, sa në letërsinë popullore, ashtu edhe në atë të shkruar, ku krijuesit tanë i kanë shfrytëzuar me masë dhe me vend për t`i shpërfaqur vetitë dhe karakteristikat tipike të fenomeneve dhe dukurve të këqija. Këto figura që nga mitologjia e deri më sot, në letërsinë tonë janë futur me qëllim që të vihet në pah e keqja që duhet luftuar.

Mbase do të ishte fare e pamundur që në këtë vështrim përmbledhës dhe fare të shkurtër që t`i zbërthenim më gjerësisht e thellësisht përmbajtjet e këtyre figurave, meqë do të na duhej jo vetëm koha e hapësira, por një qasje tjetër. Kështu, po t`i qaseshim kësaj problematike në mënyrë sa më të plotë, do të duhej pasur parasysh edhe disa këndvështrime të tjera shumëdimensionale, ku çështja do të shqyrtohej më gjerësisht e më thellësisht. Prandaj, në këtë rast, me këtë paraqitje të shkurtër e përmbledhëse, në formë të një letërnjoftimi, paraqitëm vetëm disa nga figurat më karakteristike të fenomeneve e dukurive të këqija, duke i bartur ato veti me këto figura të njohura, nga vendi në vend, nga koha në kohë, nga brezi në brezpërmes shembujve të ndryshëm.

Literatura

Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912), pjesa e tretë, Tiranë, 1972;
Letërsia popullore shqiptare, 1970;
Todi Dham, Fjalori i mitologjisë, Prishtinë, 1988;
Shtjefën Gjeçovi, Vepra II, Prishtinë, 1985;
Aleksandër Stipçeviq, Simbolet e kultit te Ilirët, Prishtinë, 1983;
Mark Tirtja, Probleme të besimeve në kulturën popullore, Tiranë, 1977;
Bernard Palaj, Ora e shtëpisë, Tiranë, 1934;
Mark Krasniqi, Gjurmë e gjurmime, Prishtinë, 1979;
Edith Durham, Brenga e Ballkanit, Prishtinë, 1990;
Mark Krasniqi, Aspekte mitologjike - besime dhe bestytni, Prishtinë, 1997;
Veis Seiko, Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptaro - arbëreshe dhe serbo-kroate Tiranë, 2002.
Mark Tirtja, Mitologjia ndër shqiptarë, Tiranë, 2004;
Mark Krasniqi, Aspekte mitologjike, Prishtinë, 1997;
Zihni Sako, Studime për folklorin, Tiranë, 1994;
Sterjo Spasse, Elementet e teorisë së letërsisë, Prishtinë, 1971.

Atdhe HYKOLLI

THE FIGURE OF THE VILLAIN IN ALBANIAN LITERATURE

Abstract

Taking into consideration of the current data, for the concept of the other one -villain- in Albanian folk or written literature, we have many examples of their presence in literature from the antiquity till nowadays. Historically the concept of villain in Albanian history is present from the early ages, in the traditional and oral history, up to contemporary Albanian literature where is more or less present.

So while with some of our neighboring nations those figure appear as heroes from the antiquity, in our culture they have a negative connotation, and are considered as concept of the other one-the villain in Albanian literature. So the mythical figure like: Black Knight, Cyclopes, Hades, Dragon, Mummy, Cerberus,Bogeyman, etc. are considered as terrifying figure that cause bad luck, hatred, jealousy, dismay, and great traumas, so they are considered as the foreign element of the other one -the villain.

Key words: The other one, the villain, heroes, mythical figures, etc.

Myrvete DRESHAJ-BALIU

TJETRI NË ROMANIN HISTORIK SHQIPTAR

Rezyme

Ky studim synon identifikimin dhe përmasën reflektuese *të tjetrit* në raport me *veten* në romanin historik shqiptar. I shkruar në një periudhë të gjatë kohore (në krahasim me llojet e tjera), romani historik shqiptar vetëm në dekadat e fundit ka sjellë pamje të tjera të ridimensionimit *të tjetrit* në tekstin romanor. Pavarësisht periudhës së shkrimit, modelit apo stilit, koncepti për tjetrin në romanin historik shqiptar, përgjithësisht ruan përmasat nacionale apo frymën gjeokulturore të traditës së tij.

Fjalët çelës: *romani, tjetri, vetja, miti, demonizimi, heroi, identiteti, gjuha.*

Hyrja

Është bërë objekt kërkimi koncepti për tjetrin në romanin historik shqiptar për shumë arsye, e megjithatë po i theksoj disa nga ato: shtrirjen e këtij diskutimi në një hapësirë njëshekullore të shkrimit të romanit shqiptar; ndërndikimin dhe ndërlidhjen me gjini dhe lloje të tjera letrare, si kusht për diskutimin e çështjes; përmasën e shtrirjes dhe të reflektimit të tij në botën moderne globale; si dhe mundësinë që jep romani për shfaqjen totale të reflektimin mbi *tjetrin*, strukturën semantike, totalitetin historiko-shoqëror të kohës, hapësirën dhe përbërësit universalë të botës.

Ajo që më ka intriguar që në nismë të kësaj teme është fjala *tjetri,* i munguar në fjalorët historiko-letrarë, si term a si nocion, dhe madje i munguar në tekstet historiko-letrare, e megjithatë i ndërthurur brenda tyre. Në të vërtetë *tjetri*, një përdorim emror*,* sipas kuptimeve të përemrit të pakufishëm, nuk është as simbol as metaforë prej të cilit do të kishim rrjedhoja stilistike, e megjithatë në tekstet e viteve të fundit merr disa dimensione referenciale dhe madje paradigmatike mbi të cilën teoritizohet jo pak dhe jo pa predispozitën paradigmatike të epokës së globalizmit. Si i tillë *tjetri* pretendon të ngrihet në nocion a referencë fal pranisë së tij në kontekste të tjera letrare në rrjedhat historike të letërsisë dhe të kritikës së saj, brenda përbërësve letrarë e estetikë të disa gjinive dhe të llojeve letrare, por në të shumtën e rasteve në kontekstin tematik, për të mos thënë i veshur me përbërës të tjerë historikë, etnografikë, folklorikë e përtej tyre ideologjikë; përbërës këta, të cilët e përjashtojnë pamjen e brendshme të tjetrit, edhe

kur e theksojnë me ngulm ngjyrën dhe racën, e kjo d.m.th. anën identitare të tjetrit pa ngjyresën racore dhe ideologjike të tyre.

Në kontekstin historik, më parë se sa në rrafshin letrar koncepti për *tjetrin* shfaqet më i plotë në rrafshin antropologjik, po të përjashtojmë epokën e re të globalizmit kur përmasa mitike kushtimisht 'realizohet' si shfaqje planetare fal mundësive jo vetëm imagjinare, sikur ndodh në disa gjini dhe lloje letrare, por edhe teknologjike, e ku tjetri nuk është kusht të jetë domosdoshmërisht *kundërshtari*.

Tipologji dhe transformime *të tjetrit*

Nisur nga rrafshi historiko-kronologjik i zhvillimit të romanit shqiptar dhe të shkrimtarëve të shekullit XX, në periudhën e parë (gjysma e parë e shekullit XX) autorë të shumtë të romanit historik kanë trajtuar gjerësisht dhe thellësisht marrëdhëniet kolektive të popullit shqiptar me popujt fqinj a më të largët, duke i parë ato kryesisht edhe si marrëdhënie kolektive, për të cilat mund të thuhet se: më parë se për *tjetrin* mund të flitet për *ardhësin*; ndërsa në periudhën tjetër, të gjysmës së dytë të shekullit XX, ndonëse në përmasa më të vogla, shfaqen vepra të autorëve përfaqësues, të cilët reflektojnë për *tjetrin* në përmasa kur individuale e kur planetare.

Në radhë të parë shfaqen autorë romanesh të dy periudhave, si: Ndoc Nikaj, Zef Harapi, Anton Frashëri, Hasan Petrela, Haki Stërmilli, Sylejman Krasniqi, Sabri Godo, Skënder Drini, Sefedin Fetiu, Gjergj Zheji, Jonuz Dini etj., të cilët në romanet e tyre me temë historike: "Shkodra e rrethueme" (1913), "Pushka e tradhtarit"(1914), "Peng a rob" (1930-1933), "I fundmi i Kastriotëve" (1944), "Kalorësi i Skënderbeut" (1968), "Mic Sokoli"(1978), "Shqipja e kreshtave tona" I, II (1967, 1971), "Skënderbeu" (1976), "Në humbëtirat e kohës" (1980), "Muret e Krujës" (1968), "Shpatë dhe dashuri" (1982) etj., kanë reflektuar për të *tjetrët* si individualitete a si raporte të bardëve të luftës mes heronjve (si përfaqësues të popullit shqiptar) dhe pushtuesve (si të dërguar nga Perandoria Bizantine apo Perandoria Osmane), një koncept ky i reflektimit mbi *tjetrin*, bartur nga tradita e letërsisë popullore shqiptare.

Për ushtarët turq Skënder Drini në romanin "Shqipja e kreshtave tona", sjell këto trajta të veçori tipike e mitike, të njohura edhe në traditën popullore për kundërshtarët sllavë, grekë apo latinë: nuk kanë besë (Drini, 1971: 20); janë një mizëri (Drini, 1971: 31), nuk flasin por mërmërisin (Drini, 1971: 32), ikin si të çakërdisur (Drini, 1971: 78), bërtasin si të lebetitur (Drini, 1971: 209) etj. Po kështu mund të thuhet për tipologjinë e dy figurave historike të kohës, që janë njëkohësisht edhe dy personazhet kryesore të këtij romani: Skënderbeun dhe Sulltanin, që përmes detajeve domethënëse teoricienti i romanit Pierre Chartier do të theksonte veprimin e efektit të reales që kur ushqehet nga aparenca, i jep detajit vlerën e tij të përgjithshme të "kuptimit të reales", megjithëse ky kuptim motivohet nga shkrimtari dhe vendoset në seritë shkakësore të shprehura qartë ose ose të nënkuptuara. (Chartier, 2015: 119)

Skënderbeu**:** një djalosh i pashëm me një hundë të kthyer si sqep i shqipes, zot i Arbërisë, me një ballë të lartë e me sy çuditërisht të gjallë. Kishte një trup të lidhur mirë prej burri të pjekur, krahët gjithë muskuj dukeshin sikur do të shpërthenin jashtë rrobave (Drini, 1971: 16), më i zoti, më trimi e më i zgjuari nga të gjithë (Drini, 1971: 20), i lidhur për vdekje me tokën (Drini, 1971: 63), sokol (Drini, 1971: 66) etj.

Sulltan Murati**:** Zoti i Turqisë (Drini, 1971: 33), shkëlqente nga shëndeti (Drini, 1971: 33), kishte vështrim tinëzar (Drini, 1971: 33), sytë e vegjël si shigjeta (Drini, 1971: 134), e kish frikë të birin (Drini, 1971: 139), ishte egërsirë (Drini, 1971: 154), turk i paftyrë (Drini, 1971: 189), dhelpër (Drini, 1971: 189) etj.

Në radhë të dytë shfaqen shkrimtarë dhe vepra romanore, të cilat i tejkalojnë në një përmasë disa aspekte të reflektimit tradicional mbi tjetrin, duke e parë atë jo vetëm si kundërshtar, si ardhës, po edhe si pjesë të sjelljes dhe të veprimeve të përbashkëta, të përpjekjeve për mbijetesë dhe madje të të menduarit vetjak për një ideal të përbashkët. Të kësaj natyre janë veprat e disa shkrimtarëve, si ato të: Sterio Spasses, Mitrush Kutelit, Dritëro Agollit, Thoma Kacorit, Petro Markos, Skënder Drinit, Sabri Godos, Mira Meksit, etj., dhe romaneve të tyre, si: "Zgjimi" (1974), "Në një cep të Ilirisë së Poshtme" (1983), "Njeriu me top" (1975), "Për mëmëdhenë" I, II (1961, 1962), "Hasta la vista" (1959), "Ultimatum" (1972), "Vraje tradhtinë" (1980), "Skënderbeu" (1976), Ali Pashë Tepelena"(1970), "Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë" (2014) etj., të cilët marrëdhëniet *vetje/tjetri* dhe *komb/fqinj*, i shohin në kontekstin kryesisht ballkanik, dhe përgjithësisht me përmbajtje foklorike dhe me nëntekst e porosi ideologjike. Hapësira gjeografike e ngjarjeve romanore është kryesisht shqiptare, por edhe ballkanike, ndërsa qytetet kryesisht shqiptare dhe vetëm personazhet përfaqësojnë edhe identitete të tjera: bullgare, serbe, greke, malazeze, në disa romane dhe spanjolle, italiane, franceze, në disa të tjerë.

Në rastin e parë personazhet kanë një qëllim të përbashkët, kryesisht luftën kundër Perandorisë Osmane, ndërsa në rastin e dytë subjekti bartet në hapësirën europiane, te lufta kundër një ideologjie të re në Europën Perëndimore. Në këtë mënyrë këto vepra, me modelin e pakundërshtueshëm epik, do të thoshte Chartier, në trajtën shkrimore, me prosedimet dhe teknikat e shkrimit, megjithatë e kanë tejkaluar gjedhën romantike, ku totaliteti i shkrimit mbështetej kryesisht në poetikën dysore: sociale dhe historike, si dhe atë të realizimit socialist, brenda të cilave sprovohet proza totale e jetës.

Në radhë të tretë shfaqen shkrimtarët e periudhës së fundit, të cilët me qasjen e tyre ndaj *tjetrit/tjetrës* tejkalojnë përmasat kombëtare e rajonale dhe kështu reflektojnë mbi universin, duke e parë 'nacionin', sikur shprehej Profesor Çabej, dhe botën në mënyrë komplementare. Fjala është për shkrimtarë dhe vepra romanore të tyre, sikur janë: Petro Marko, Ismail Kadare, Vath Koreshi, Mehmet Kraja, Jusuf Buxhovi etj., të cilët tejkalojnë përmasën etnike dhe ballkanike të rrëfimit dhe e zgjerojnë rrafshin tematik, religjioz e etno-psikologjik. Romanet e Kadaresë "Kamarja e turpit"(1978),

"Dimri i vetmisë së madhe" (1972), "Koncert në fund të dimrit" (1988), "Muzgu i perëndive të stepës" (1978) etj., romani i Petro Markos "Nata e Ustikës" (1989); romani i Vath Koreshit, "Ulku dhe Uilli" (1996); romanet e Mehmet Krajës "Moti i madh" (1981), "Udhëzime për kapërcimin e detit" (1984), etj., triptiku i Jusuf Buxhovit "Prapë vdekja" I-III (1991-1995) dhe "Vdekja e kolonelit" (2004), romanet e Mira Meksit, "E kuqja e demave" (2009) dhe "Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë" (2014) etj., ndryshojnë rrjedhën e përmasës gjeografike të romanit historik shqiptar në gjerësinë mesdhetare, euroaziatike të Perandorisë Osmane, të Kinës dhe të Mongolisë, të Bashkimit Sovjetik dhe madje të Afrikës. Përtej *tjetrit* si individ dhe kolektivitet simbolik, hapësirës si qytetërim apo edhe qytetit si referencë shtetërore dhe etnike, në veprat e tyre këta autorë, brenda poetikës origjinale dhe destruksionit të fabulës kanë shquar edhe veçori të caktuara të personazheve apo institucioneve përfaqësuese të tyre nacionale dhe shtetërore, sikur janë: gjuha dhe qytetërimi (Kadare); identiteti dhe qytetërimi (Mehmet Kraja), qytetërimi dhe religjioni (Jusuf Buxhovi) etj. Në këtë mënyrë, përmes konceptimit *të tjetrit* këto vepra hapin mundësinë e ridimensionit të hapësirës dhe tipologjisë së personazhit, duke zgjeruar kështu edhe temën e romanit historik shqiptar.

Trajtat *e tjetrit*

Në rastin e parë, te romani "Kamarja e turpit", Kadare gjuhën e shkrimit për tjetrin e shikon nga konteksti narrativ i personalitetit të tjetërsuar të Ali Pashë Tepelenës: "...pastaj e mori librin në duar, i pa një copë herë me vëmendje ato shkronja të vogla, ato *thnegla tinzare,* që mendohej se do të mbartnin emrin e tij mbi shpinat e tyre të mjera drejt shekujve që do të vinin, dhe e flaku librin tutje (Kadare, 2008: 330); kurse në rastin tjetër te romani "Dimri i vetmisë së madhe", gjuhët e të tjerëve shihen si një përbërës qytetërimesh të papranuara: "Te salla e doganës vërtiteshin në një mishmash gjuhësh gjithfarë nëpunësish, kërkues të naftës, gjeologë, sllavistë, riparues ikonash, ushtarakë, bizantinistë, diplomatë". (Kadare, 1988: 569-570). Por, si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, në të vërtetë, si kur e vë mendimin në gojën e kundërshtarit ashtu edhe kur flet nga pozita e narratorit, ndaj gjuhës/përkatësisht gjuhëve flet përjashtueshëm, si në kontekstin e *të tjetërsuarit* ashtu dhe *të tjetrit:* "thnegla tinëzare/gjuhë mishmash". Po kështu mund të thuhet dhe për individët, qytetet dhe shtetet, përkatësisht perandoritë. Venedikasi i romanit të Mehmet Krajës "Moti i madh" "dukej si një korb (54); me atë rrobën e zezë mbi trup dhe me pamje prej djalli në fytyrë (63); kish hapur gjithkah varret, madje kish zbritur edhe nën tokë dhe nxirrte eshtra, i bënte grumbull në breg të detit, i ngarkonte mbi një anije të madhe dhe i shpiente dikah (120). Për autorin e romanit "Vraje tradhtinë" shkrimtarin Skënder Drini, arkeologu anglez Artur Evans edhe në romanin e tij është po ai që e gjejmë në botimet e historiografisë shqiptare: "gazetar i fletushkës

"Mançester Gardian" (487), "armik i shqiptarëve dhe sllavofil"(487), dhe madje mban nofkën "Arturoviç" (487); ndërsa për lirikun e poezisë dhe prozës shqiptare Dritëro Agollin ushtari italian i mbetur në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, Augustino, në romanin "Njeriu me top" është "djalë i pashëm" (61), "i urtë dhe i sjellshëm" (61), "me flokë gështenjë dhe fare të drejtë" (61) "me bishtrinjtë e vetullave të hollë si të vajzave (61), "i sjellshëm" (63) "njeri i ndershëm" (64) etj. Për Besnikun e romanit të Kadaresë "Dimri i vetmisë së madhe", në prag të takimit Nikita Hrushqov-Enver Hoxha: "Moska shtrihej e pafund nën një qiell të shterpët, pa spikama e pa horizont" (191), ndërsa për Kolonelin e romanit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", sapo shkel në aeroportin shqiptar "mbi tokën e huaj binte shi përzier me dëborë" (21). Për narratorin e romanit "Qyteti i fundit", Petro Marko, "Abisinia është një vend me plotë margaritarë"(16); ndërsa, për narratorin e romanin "Kamarja e turpit", Perandoria Osmane me kufijtë e saj, respektivisht hapësira e saj gjeografike identifikohet me një pasthirrmë të shqipes: Kra-kra ("As skaj, as qendër, Kra-kra. Pastaj qendër dhe fund" (370) etj.

Ashtu si edhe në studimet antropologjike edhe në sintezat e mëdha romanore "bota shqiptare, sikur shprehet studiuesi Shaban Sinani, qoftë në vështrimet klasike (atlantiste, Makinder), qoftë në ato moderne (neoatlantiste-Hantington); qoftë në pikëpamjen perëndimore ("doktrina Monro"), qoftë në atë lindore (L. Gulilev, A. Dugin), rezulton në pikëtakimin "zonat e kontaktit". Në këtë rast, nga ana perëndimore "zonat e kontaktit" tangohen nga romanet e Kadaresë dhe Krajës "Ura me tri harqeve" (1978), "Moti i madh" dhe "Udhëzime për kapërcimin e detit", në anën lindore nga romani i Jonuz Dinit "Shpatë dhe dashuri" (1982) dhe përtej tij, shtrihet brenda gjithë qytetërimit Lindor, romani i Kadaresë "Kamarja e turpit", si dhe ai i Jusuf Buxhovit "Prapë vdekja". Në kufi të zonës së kontaktit Lindje - Perëndim ridimensionohet romani i Mira Meksit "Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë", ndërsa koncepti i prirjes për të sunduar botën nga romanet e Kadaresë "Dimri i vetmisë së madhe" dhe "Koncert në fund të dimrit".

Duke e përmbyllur

I parë në kontekstin historik-kronologjik të shkrimit dhe në përmbajtjen historike të temave, në romanin shqiptar koncepti për *tjetrin* përgjithësisht është ndërtuar në tri pamje: në hapësirën kombëtare (duke shquar kontekstin nacional të refuzimit): në "zonën e kontaktit" Lindje/Perëndim duke shquar dhe ruajtur kontekstin historik e antropologjik të reflektimit; në përmasën totale (universale të pushtimit); si dhe në tri kontekste: nga pozita e narratorit/autorit (Kadare, Krasniqi, Kraja, Fetiu), nga konteksti politik i reflektimit mbi historinë e një periudhe të caktuar (Spasse, Kadare, Marko, Drini etj.) dhe në kontekst të zhanrit (Agolli, Kallamata etj.).

Brenda këtij kërkimi, koncepti për tjetrin është ndërtuar edhe në kontekstin vertikal historik/qytetërues, ngritur në së paku tri paradigma: gjuhën, religjionin dhe qytetërimin. Mbi këto parakushte dhe paradigma janë shkruar veprat më të mira romanore me temë historike të letërsisë shqipe gjatë gjithë shekullit XX dhe brenda tyre janë kontekstualizuar e ridimensionuar edhe raportet me *tjetrin*.

Romane të shqyrtuara

Buxhovi, J. (1991-1995). *Prapë vdekja*, I-III. Prishtinë.
Buxhovi, J. (2004). *Vdekja e kolonelit*. Prishtinë.
Dini, J. (1982). *Shpatë dhe dashuri*. Tiranë.
Drini, S. (1967,1971). *Shqipja e kreshtave tona*, I, II, 1967, 1971. Prishtinë.
Drini, S. (1980). *Vraje tradhtinë*. Tiranë.
Frashëri, A. (1944) *I fundmi i Kastriotëve*. Tiranë.
Godo, S. (1976). *Skënderbeu*. Tiranë.
Godo, S. (1970). *Ali Pashë Tepelena*. Tiranë.
Harapi, Z. (1914). *Pushka e tradhtarit*. Tiranë.
Harapi, Z. (1930-1933). *Peng a rob*. Tiranë.
Petrela, H. *Të munduarit*. Tiranë.
Kadare, I. (2008). *Kamarja e turpit*. Tiranë
Kadare, I. (1972). *Dimri i vetmisë së madhe*. Tiranë.
Kadare, I. (1978). *Muzgu i perëndive të stepës*. Tiranë.
Kadare, I. (1988). *Koncert në fund të dimrit*. Tiranë.
Kallamata, M. (1977). *Sos për mua a për ti*. Tiranë.
Krasniqi, S. (1977). *Mic Sokoli*. Tiranë.
Nikaj, N. (1913). *Shkodra e rrethuese*. Tiranë.
Sefedin F. (1980). *Në humbëtirat e kohës*. Prishtinë.
Stërmilli, H. (1968). *Kalorsi i Skënderbeut*. Tiranë.
Marko, P. (1989). *Nata e Ustikës*. Tiranë.
Koreshi, V. (1996). *Ulku dhe Uilli*. Tiranë.
Zheji, Gj. (1968). *Muret e Krujës*. Tiranë.
Kraja, M. (1981). *Moti i madh*. Prishtinë.
Kraja, M. (1984). *Udhëzime për kapërcimin e detit*. Prishtinë.
Meksi, M. (2009). *E kuqja e demave*. Tiranë.
Meksi, M. (2014). *Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë*. Tiranë.

Literatura

Dado, F. (1999). *Teoria e veprës letrare-Poetika*. Tiranë.
Dreshaj-Baliu, M. (2004). *Konteksti i shkrimit* (studime dhe ese). Prishtinë.

Genette, G. (2014). *Diskursi i ri i rrëfimit*. Tiranë.
Hamiti, S. (1983). *Arti i leximit*. Prishtinë.
Kaller, Xh. (2001). *Teori letrare*. Prishtinë.
Krasniqi, B. (1988). *Kode të ligjërimit letrar*. Prishtinë.
Krasniqi, B. (1985). *Poetika e romanit historik shqiptar*. Prishtinë.
Mekuli, H. (2000). *Romani shqiptar*. Prishtinë.
Chartier, P. (2015). *Hyrje në teoritë e mëdha të romanit*. Tiranë.
Hutcheon, L. (2013). *Poetika e postmodernizmit*. Prishtinë.
Zhenet, Zh. (1985). *Figura*. Prishtinë.
Barthes, R. (2008). *Aventura semiologjike*. Pejë.
Poliakov, L. (2013). *Miti arian,* Tiranë.
Dykro-Todorov (1984). *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit*. Prishtinë.
Geary, P. (2009). *Miti i kombeve*. Tiranë.
Velek-Voren, (1982). *Teoria e letërsisë*. Prishtinë.

Myrvete DRESHAJ-BALIU

THE OTHER **IN THE ALBANIAN HISTORICAL NOVEL**

Abstract

Seen in the historical and chronological context of writing and the historical content of themes, the concept on *the other* in the Albanian novel is generally constructed according to three main types: in the national arena (where the national context of rejection is displayed): in the East/West "contact area", which displays and preserves the anthropological and historical context of reflection; in the total dimension (universal of invasion); as well as in three contexts: from the position of the narrator / author (Kadare, Krasniqi, Kraja, Fetiu), from the political context of reflection on the history of a particular period: (Spasse, Kadare, Marko, Drini etc.) and in the context of a genre (Agolli, Kallamata etc.). In this research, the concept on the other is also built in the vertical historical/civilization context, constructed according to at least 3 paradigms: language, religion, and civilization. It is on these preconditions and paradigms that the best novels of historical themes in Albanian literature were built during the entire XX century, and within them, the reports with *the other* have been contextualized and reshaped.

Key words: novel, other, self, myth, demonization, hero, identity, language.

Blerina ROGOVA-GAXHA

DËNIMI ME JETË: AGA DHE TATA

Mitrush Kuteli është njëri nga autorët e *temës së vdekjes* në letrat shqipe. Provokuar nga leximi i saj, ky shkrim shtrohet mbi intencën autoriale të dialogut mes dy botëve, në veprën e autorit që jep disa pamje të *vdekjes* në letërsinë e modernitetit shqiptar.

Novelat e Mitrush Kutelit *Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit* dhe *E madhe është gjëma e mëkatit- Tat Tanushi i Bubutimës,* shkruajnë personazhet e Agës dhe Tatës, heronjve krijuar në lojën e jashtëzakonshme mes jetës dhe vdekjes. Rrëfimi për priftin dhe të dashurën e tij dhe rrëfimi për plakun që kërkonte udhën e zotit, na kallëzojnë për mëkatin e çmimin e mëkateve, për 'sevapet' e borxhet e karaktereve që Zoti s'ua mirrte shpirtin.

Autori portreton personazhet në udhëtimin e tyre drejt vdekjes, në historitë që japin aventurë, udhë e udhëkryqe të ndryshme. Në këtë udhë, Aga dhe Tata, kanë disa emërues të përbashkët, që zënë fill në mëkatet e vetëprodhuara, deri te udhëtimi final-vdekja. Tekstet komunikojnë me shenja të ngjashme o të afërta, me motive, diskurse, efekte dhe ide që lëvizin nga njëri te tjetri.

Relacioni

Të parën Kuteli e shkroi novelën *Qysh e gjeti Ago Jakupi udhën e Zotit*[1], dhe me vonë, më 1947, novelën E *madhe është gjëma e mëkatit, Tat Tanushi i Bubutimës*[2]. Ndërmjet dy teksteve shfaqet relacioni i njohur si *intratekstualitet* – relacion *intertekstual* brenda veprës së një autori.[3]

Aga dhe Tata kanë disa lidhshmëri, por në kombinatorikën e relacioneve, kanë për themelore temën e vdekjes. Mosvdekja bëhet akt kryesor i të dy rrëfimeve. Ajo rri në lidhjen shkak-pasojë duke ndjekur vijën që përshkojnë personazhet; nyje që lidh mëkatet në historitë e Agës e Tatës, nga ndëshkimi që iu jep krijuesi deri te çlirimi nga mallkimi.

[1] Shih *Mitrush Kuteli, Vepra letrare 2*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990, fq, 49-67.
[2] Shkruar më 1947, botuar në vitin 1993
[3] Kujtim M.Shala, *Kujtesa e tekstit – Mitrush Kuteli*, Buzuku, Prishtinë, 2003, fq. 71

Gjejmë të pranishëm këtu një *kod tematik në variante*[4], shtrirë në diskursin e figurshëm e në kategoritë morale e kulturore që dalin e përthyhen mes kodit biblik, kodit oral dhe kodit filozofik, nëse për këtë i përmbahemi nocionit klasik të kodeve se ato janë *perspektiva të citimeve, mirazhe të strukturave, të cilave ua njohim vetëm nisjet e rikthimet dhe njësitë që kanë dalë nga to*[5]. Kësisoj, dialogu me Biblën, si një referencë kulturore e tekstore, shënon nivelin tjetër *intratekstual* mes novelave. Po dialogu me Biblën vjen përkrah dialogut me Oralitetin, rrëfimin oral-mitologjik; të dy kodet japin e marrin ndërmjet vete, duke i dhënë Kutelit një manovrim të shkëlqyer narracioni. Në rrëfimin për Agën e Tatën, etika e tekstit ruan sa frymën e teksteve religjioze, aq dhe ato që na vijnë nga Oraliteti, duke e vënë mbi to gjithnjë filozofinë autoriale të Kutelit, si letërsi që e kërkon universalen.

Relacioni *intertekstual* i teksteve del i fortë me Shkrimin e shenjtë, me Oralitetin dhe kodin filozofik, pëlhurat e të cilëve janë endur bukur edhe ndërmjet pëlhurave intratekstore.

Ago Jakupi, na jep kryepersonazhin e mbetur në jetë, plakun e harruar nga vdekja. Tata dënohet me jetë, me mosvdekje. Kryepersonazhi është mëkatari që s'mund të vdesë: *Unë kam shekuj që jam këtu në tokë. Dua të vdesë, e nuk vdes dot*, pohon Tata gjatë konfesionit. As Ago Jakupi s'mund të vdesë, dhe është "mbetja" në jetë që reprezenton frikën e madhe të tij: *Nuk kish frikë Agaj nga vdekja, po nga jeta që sgjatej kaq fort.* Agoja reprezenton frikën e jetës së gjatë, siç e reprezenton ngujimin për shekuj në botën e të gjallëve Tat Tanushi. Studiuesi Kujtim M. Shala shkruan se: "Këto tekste njohin për esencë relacionin vertikal Tokë-Qiell, pra Njeri - Zot. (Secili prej tyre njeh edhe relacionin horizontal Njeri-Njeri: Ago Jakupi – Katundarët, Tat Tanushi – Kalija. Në të dyja rastet, relacioni horizontal e kushtëzon relacionin vertikal.) Kjo, së pari, është lidhje nëpërmjet Objektit, njërit prej kritereve *arkitekstuale.* Personazhet e secilit prej tyre njihen me Zotin."[6] Por rruga deri te Zoti, është e gjatë për Agën e Tatën.

Një pronar tokash dhe një prift, një materialist e një spiritualist, një koprac dhe një i dashuruar tmerrësisht, dy mëkatar, dy të dënuar, dy të sprovuar dhe dy paqtues në fund. Dy tekste të lidhura me një moral dhe personazhet me të.

Dëshira për të vdekur

"Karakteret që e dëshirojë vdekjen dhe karakteret që e kundërshtojnë a shpërfillin hapur vdekjen, e meritojnë vëmendjen tonë".[7] Heronjtë e rrëfimeve apologjetike ndaj hirit e zotit, vdekjen e kërkojnë dhe e dëshirojnë fort për t'u çliruar e

[4] Po aty, fq. 73
[5] Roland Barthes, *S/Z*, Hill and Wang, New York, 1974, fq. 20
[6] Kujtim M. Shala, *Shekulli i Letërsisë Shqipe*, Buzuku, Prishtinë 2006, fq. 76-77
[7] Shih: *Death in Literature*, Introduction, Edited by Outi Hakola, Sara Krivisto, Cambridge School Publishing, Camridge, 2014

shpëtuar nga jeta, udhë e cila i nënshtron ndaj sprovave të mëdha psikologjike. Dëshira e vdekjes vjen e bëhet esenciale në këto proza. Vdekja, prezente gjithkund e askund, shndërrohet në sfidën e rëndë, duke i detyruar personazhet të mësohen të jetojnë me jetën e gjatë. Mes dualitetit të mishit, trupit si 'burg', dhe shpirtit, si frymë metafizike, Kuteli shtron idenë e tij për shpirtin njerëzor, ndaj në lojën e tij letrare i jep peshë të mirës karshi të ligës, të padukshmes karshi të dukshmes, dashurisë universale karshi imanencës tokësore, duke i ndëshkuar personazhet me jetë, si shkas i ndotjes spirituale- si ndëshkimi më i madh për frymën njerëzore.

Nëse letërsia e Kutelit *i lufton veset, lakminë, maninë*[8] - Lakmia e Tatës për femrën, lakmia e Agait për të mirat materiale,- ose mania e Tatës për Kalijen dhe kopracia e Agait, janë veset që e kërkojnë ndëshkimin. Studiuesi Nysret Krasniqi shkruan se në rrafshin konotativ mund ta theksojmë fenomenin e *ndëshkimit të trupit* apo të burgut të shpirtit, që e gjejmë te Platoni, por që bëhet temë esenciale e veprës letrare të Mitrush Kutelit. "Të kujtojmë këtu se Ago Jakupi nuk mund ta lërë këtë botë përderisa të mos gjejë rrugën adekuate që shpirti të dalë nga "tharku" platonian për ta marrë udhën e së vërtetës."[9] Udhë e cila bëhet shumëfish më e vështirë për heroin e novelës *E madhe është gjëma e mëkatit*... Tat Tanushin.

Nga kjo perspektivë, narrativa kuteliane projekton personazhet, të cilët në lojë me jetën dhe vdekjen, duhet të njohin esencat dhe kuptimet eternale; heronjtë që duke e zbuluar veten, njohin të tjerët, për të tjerët, dhe në këtë aventurë, në fund, realizohet *katharsis-i* i protagonistëve, pastrim që i çon deri te zbulimi i udhës drejt Zotit - udhën e kalimit në botën përtej.

Ago Jakupi – udha e Zotit

Ago Jakupi, protagonisti i cili shenjohet në titullin e novelës, i lidhur fort me jetën, mëson se s'mund të dalë në bregun tjetër, vdekjen, pa i larë fillimisht hesapet me jetën. Ideja e Kutelit për *shpirtin e drejtë*[10] njeriun në pajtim me shpirtin e qetë, njeriun në pajtim me dashurinë universale[11], e vë Ago Jakupin, mëkatarin e dominuar nga apetitet, në sfidë me shpirtin, duke ia shtruar kërkesën e pastërtisë së tij.

Autori ka motivuar letrarisht efektin e vdekjes, duke e motivuar vetë temën e vdekjes. Protagonisti i pasur lakmitar vihet në sprovë. Autori i mbytë të birin duke e përballur plakun me fenomenin e vdekjes si sprovë e dhembjes dhe e vetëdijes për kalueshmërinë e njeriut në këtë botë, duke e shënuar kësisoj kthesën në planin e rrëfimit dhe në vetëdijen e protagonistit. Autori na kujton se qeniet vdesin për t'u parë kuptimet dhe gjurmët e tyre. Nga vdekja e garantuar për qenien njerëzore te vdekja që

[8] Shih: Nysret Krasniqi, *Udha kratilike*, AIKD, Prishtinë, 2008, fq. 55
[9] Po aty.
[10] Vep. e cituar, fq. 160
[11] Po aty.

për again nuk vjen, dëshira për të vdekur kthehet në dëshirim të fortë të personazhit, por njohja me të nuk do të vijë, jo pa i larë hesapet me botën, me jetën dhe njerëzinë, jo pa i dhënë Zoti *hallallin* e tij.

Një rrëfim për protagonistin që kish rrojtur në harmoni me veten, po kjo nuk është e mjaftueshme për etikën që e kërkon teksti i Kutelit. Në filozofinë krijuese të Kutelit ka një premisë nga e cila ai niset: mëkati ndëshkohet! Ndaj, besimi në fuqinë e ndëshkimit del si kërkesë autoriale. Në rrafshin e rrëfimit kutelian zgjedhja e modelimi i një personazhi të tillë ka intencën dhe motivueshmërinë e vet.

Ëndrra, zëri, subkoshienca - Ëndrra në këtë novelë shërben si pjesë e rëndësishme strukturale dhe kuptimore e rrëfimit. Ëndrra (ëndrrat) e agait shënon pikën e kthesës apo pikën e vetëdijësimit. Nga ata që e njohin psikanalizën e sidomos interpretimin e ëndrrave nga Freud-i, figura e shfaqur dhe dialogu në ëndërr, mund të interpretohet si dialog me veten i heroit, dialog me subkoshiencën. Në fiksionin e dyfishtë të ëndrrës, protagonisti përfton urdhërin për të ndërruar drejtim në jetë. Zëri retorik, që vjen nga bota e përtejme, nga irealja, apo si zë që vjen nga subkoshienca është zëri që e sjellë në vete heroin. Ankthi e frika nga porosia e ëndrrës, e nxisin protagonistin që në pleqërinë e thellë, të niset ta gjejë udhën e drejtë, e përkthyer në udhë të Zotit.

Megjithëse motivimet e ëndërrimit mund të jenë nga më të ndryshmet, e ndërkohë që historia e interpretimit të tyre është e lashtë sa vetë historia njerëzore, ëndërrimi i protagonistit projekton "kthjelljen", si fillim pendimi e konfesioni para vetes e para Zotit.

Gjedheja narrative e këtij lloji konsiston në heroin që në jetë s'kish bërë as të mira, as të këqija, të kthehet në arketipin e bëmirësit: *Ago Jakupi është një arketip biblik e mitik por që haset edhe në rrëfimet gojore*[12]. Kësisoj, i dalë nga substanca e oralitetit e në frymën e tregimeve popullore, protagonisti merr *sinjalin* se si të bëjë e të bëhet i mirë, si të gjejë udhën e 'sevapeve', që të mund t'i dalë shpirti. Njohja me Zotin e kërkon paraparakisht njohjen me njeriun. Ago Jakupit i duhet të gjejë fillimisht rrugën për te bota rreth tij, rrugën te njerëzit, për të realizuar raportin human me njeriun, që të mund të marrë 'izën' e Hyjit. *Me gjithë referencat ndaj një diskursi biblik, ky tregim në vete përmban edhe referenca orale nga rrëfimet për të pasurit dhe të varfërit, përkatësisht për të pasurit që, në një çast të caktuar, vijnë në udhë të zotit.*[13] Pas efektit të ëndrrës, mesazhit të saj, ai i kthehet hirit të mirësisë ndaj tjetrit, njeh moralin e jetës, njeh veten dhe të tjerët, duke e fituar kështu në fund edhe *hallallin* e Zotit. Kthimi retrospektiv në jetë, si shansi i fundit për t'u shkëputur nga ajo, i jep plakut mundësinë "ta zhbëjë" dënimin me mosvdekje e të shpërblehet me prehjen finale – Vdekjen.

[12] Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe Oraliteti – E.Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku*, Prishtinë, 2002, fq. 190

[13] Po aty, fq. 191

Tat Tanushi, i vdekuri i gjallë

Novela e dashurisë dhe e vdekjes, *E madhe është gjëma e mëkatit*, *Tat Tanushi i Bubutimës*, është krejtësisht e veçantë, si motivim, rrëfim, shtrim e shkrim letrar. Një tekst i jashtëzakonshëm për dashurinë dhe vdekjen, dashurinë për zotin e njeriun, një tekst i përplasjes së fort mes besimit e dyshimit, mishit e shpirtit, gruas e hyjit.

Rrëfimi për priftin dhe të dashurën e tij, Tat Tanushin e Kalijen, na kallëzon për forcën e jashtëzakonshme të dashurisë, për mëkatin e çmimin e mëkateve, për fuqinë e vdekjes dhe pafuqinë e njeriut, në një lojë brilante të heroit që në udhën e tij përballet me vdekjen dhe mosvdekjen. Autori portreton udhën e protagonistit, duke e shtruar filozofinë e tij kulturore e letrare në diskursin biblik; duke i sfiduar e vënë në pikëpyetje zgjedhjet ndërmjet udhës së lumturisë eternale e të lumturisë tokësore të Tatës. Kësisoj, historia e Tat Tanushit e Kalijes duke e shfrytëzuar rrëfimit kristian shtron temën e vdekjes e të dashurisë, thurur në një komunikim të jashtëzakonshëm mes dy botësh.

Tata mbetet në jetë, i dënuar *me jetue* përherë. Toka për të është kthyer në ferr. Gjithçka ndërron fytyrë, humb, zhduket, njerëz, vende, popuj, ai mbetet po Ai. Të gjallët vdesin, të dënuarit me jetë mbesin. Tata, i vdekuri i gjallë, është bërë një me jetën, një me natën, me ditën, një me gjithë kohën e saj, në këtë njëjtësim banon dhe vuajtja e tij.

Mëkatimi dhe pendimi - Dy veprimet kryesore të Tatës, Mëkatimi dhe Pendimi, e ndajnë dhe tërësinë tekstore në dy pjesë kryesore. Tërësia e parë na rrëfen mëkatet e Tatës që vijnë njëri pas tjetrit. Brenda personazhit kemi përballjen në mes të dashurisë së përkohshme dhe asaj të përhershme, dashurinë mes gruas e Zotit, mes tokës e qiellit, trupit e shpirtit. Tata, prifti mëkatar, zgjedh gruan përballë Zotit dhe këtu nis rrënimi e përshkallëzimi i mëkatave që ecën nga njëri te tjetri- mëkate që nisin nga ëndrra, mendja, trupi deri te mëkati final "çasti i shembjes". Heroi Tat rron me shekuj, për të provuar vuajtjen e kaluar nëpër rrathët e spastrimit të shpirtit.

Historia e vuajtjes së Tatës thuret në tërësinë e dytë, në jetën e shtrirë pambarim. Duke na çuar në një botë ndryshe nga e njohura, aty ku funksionojnë të tjera ligje, në një botë të mbinatyrshme ku shtrihet tisi i fantastikes. Midis të shkuarës dhe të ardhmes, personazhi mbetet peng, dhe vetëm në këtë hapësirë rrëfimi, i vdekuri i gjallë, mund të shlyejë mëkatet. Po, edhe me shekujt e kaluar vdekja nuk vjen, jo pa u purifikuar heroi e jo pa e falur Zoti, derisa të vijë koha për *katharsisin* e tij.

Strategjia e rrëfimit e ka kërkuar vazhdimisht purifikimin e shpirtit të protagonistit, shkëputjen e tij nga fizikja e lidhjen me metafizikën, dhe vetëm në fund, Tata i mbyllur e me veten lë pas botën e së ligës për të hyr në botën e mirësisë universale. Autori nxit vetëdijen për t'u parë kuptimet, motivimet dhe udhët e qenies.

Në epilogun e tekstit, në pjesën e tretë të tij, prifti mëkatar, i penduar tashmë, pas shekuj vuajtjesh, agjërimi e asketimi, kthehet në vendin ku kish mëkatuar e ish

dënuar, i "pajtuar" me Zotin, lutet për falje. Në dialogët eternalë, mes Tatës e Zotit, Zoti e falë Tatën dhe Tata e falë atë. Ai i shfaqet për ta liruar nga jeta. Vdekja e dëshiruar fort më në fund i vjen heroit, çliruese e kohës në këtë botë, për të ikur drejt eternales. Dhe *Tat Tanushi u tret ngadal në syt e të gjithëve dyke mbetur vetëm një dorë hi në pragun e derës së shenjtë*".

Vdekja *e vonuar* e Tatës vjen si shpëtim, vdekja shënon kalimin në pavdekësi, në kohën e pakohë. Njësia e tretë tekstore e mbyll tekstin, duke e mbyllur edhe rrëfimin për Tatën.

Pajtimi / Vdekja

Vetë modelimi i mesazhit të novelave, e kërkon që personazhet të vijnë *në udhë të Zotit.* Mbi karakteret e njërit dhe tjetrit, autori ka shkrirë motive e shenja ta ngjashme. Në pendimin e brendshëm deri te pajtimi me Zotin (Tat Tanushi) dhe pajtimin me njeriun për ta gjetur Zotin (Ago Jakupi), intenca autoriale e favorizon fuqinë e shpirtit njerëzor përballë lëndës dhe dëshirave kalimtare, e favorizon të bukurën ideale përballë mashtrimit të së bukurës fizike; shpirti nuk mund ta gjejë eternalen pa qenë i pastër, meqë vetëm një shpirti *puro* mund t'i jepet drejtësia universale. Ndaj dy mëkatarët në fillim teksti, kthehen në dy paqtues në mbarim. *Si për njërin, ashtu për tjetrin, jeta mbyllet me një pajtim.* [14]

Studiuesi Nysret Krasniqi shkruan se: Kjo edhe është etika e letërsisë së Kutelit. Tema që del si etikë e moral, është e dashurisë universale, pa trup e shqisë, që kërkohet në *telos* e jo në *logos*. Kjo dashuri e njeh motivimin – *kratilizmin* e jo konvencën – *doktrinën.*[15] Kjo shkrepje e ngadaltë e mirësisë, dashurisë së lart deri tek amshimi i saj në dashurinë e vërtetë që është Zoti si Universalitet, është pjesë esenciale e letërsisë së Kutelit në përgjithësi, por shenjat e para më të forta i gjejmë te novela *Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit*, dhe te novela *E madhe është gjëma e mëkatit...*[16]

Filozofët Barthes dhe Foucault na thonë se në modernitet vepra merr fuqinë që ta vrasë personazhin[17], ndaj dhe në këtë frymë Kuteli, projekton e bëhet vrasës i personazheve të veta, ai *i mbyt ata për hir të etikës njerëzore.*[18] Vrasja mund të lexohet si krejtësisht intencionale në raport me botëkuptimin autorial për fenomenin e jetës dhe vdekjes, si dy konceptet më të ndërliqshme për qenien e për mendimin filozofik.

Në zemrën e pikëpyetjeve universale njerëzore, vdekja te Kuteli, vjen si shpëtim; mbyllja e jetës së personazheve jep idenë e çlirimit nga jeta dhe ikjen e

[14] Kujtim M.Shala, *Shekulli Letërsisë Shqipe*, Buzuku, Prishtinë, 2006, fq. 77
[15] Nysret Krasniqi, vep. e cituar, fq. 230
[16] Po aty, fq. 190
[17] Shih esetë: Roland Barthes: *Death of the Author* (1968) dhe Michel Foucault: *What is an Author*? (1969)
[18] Nysret Krasniqi*, Harta letrare*, Cuneus, Prishtinë, 2014, fq. 280

shpirtit mistereve universale. Shpirti triumfon përmbi trupin, e përhershmja përmbi të përkohshmen, kultura përmbi natyrën, duke nxitur vetëdijen për esencat dhe kuptimet eternale.

Bibliografia

Aurel Plasari, *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*, Apolonia, Tiranë, 1995
Death in Literature, Edited by Outi Hakola, Sara Krivisto, Cambridge School Publishing, Camridge, 2014
Kujtim M. Shala, *Shekulli i Letërsisë Shqipe*, Buzuku, Prishtinë, 2006
Kujtim M. Shala, *Kujtesa e tekstit- Mitrush Kuteli*, Buzuku, Prishtinë, 2003
Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe Oraliteti – E.Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku*, AIKD, Prishtinë, 2002
Mitrush Kuteli, Vepra letrare 2, Naim Frashëri, Tiranë, 1990
Mitrush Kuteli, *Ago Jakupi dhe rrëfime të tjera,* Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, përzgjedhur nga Ali Jasiqi, Prishtinë, 1968
Mitrush Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit, Tat Tanushi i Bubutimës,* Botimi III, Grand Prind, Tiranë, 2006
Michel Foucault: *What is an Author*? 1969
Nysret Krasniqi, *Udha kratilike*, AIKD, 2008, Prishtinë
Nysret Krasniqi, *Harta letrare*, Cuneus, Prishtinë, 2014
Plato, *Cratylus*, përkthyer në gjuhën angleze nga Benjamin Jowet, ueb, biblioteka klasike
Roland Barthes, *S/Z*, Hill and Wang, New York, 1974
Roland Barthes: *Death of the Author* 1968
Sigmund Freud: *Psikanaliza e artit dhe e letërsisë*, Dituria, Tiranë, 2000
Sigmund Freud, The Interpretation of Dreams, ueb. (http://psychclassics.yorku.ca/Freud/Dreams)

Blerina ROGOVA-GAXHA

PUNISHMENT WITH IMMORTALITY: AGA AND TATA

Abstract

Mitrush Kuteli novels: "Si e gjeti Ago Jakupirrugën e Zotit" (How Ago Jakupi found God's way) and "E madheështëgjëma e mëkatit - Tat Tanushi i Bubutimës" (The curse of the sin - Tat Tanushi ofBubutima), tells us about the characters of Ago Jakupi and Tat Tanushi, protagonists created on the extraordinary play between life

and death. The story about the priest and his woman and the story of the old man who seeks for the God's way, tells us about the sin and the price of it, the goods and the evils of the two characters, to whom God didn't take the souls.

The two protagonists are punished by their creator with no death as a consequence of ignoring the doctrinal principles of life set up on Christian ethics, and the moral categories arising from the great cultural code of Bible. Heroes of the stories pray for the God's grace, they wish to die and seek death in order to be liberated from life, but they will undergo a great psychological tests, until the purification of the soul and its passage into the world beyond.

The paper puts in front and compares two protagonists from the best novels of the author MitrushKuteli, trying to understand the dialogue between the two worlds, between life and death, with the aim to give a more understanding on the work of the author who wrote the theme of death in Modern Albanian Literature.

Flamur MALOKU

IDEOLOGJIA E TJETRIT NË LETËRSINË SHQIPE

1. Tjetri, situata tekstologjike

Koncepti i tjetrit në letërsinë shqipe, diskursi për tjetrin në letërsinë shqipe, ose për papraninë e pranishme, një përqasje rastësore e sugjerimit të Umberto Eco-s, është një nga piketat moderne dhe postmoderne si optikë verifikimi, ku tashmë duhet të niset studimi i letërsisë shqipe, për të hetuar hapësirat e nëntekstit. Termi *Tjetri* si ideologji dhe prani, para së gjithash është kërkimi i diçkaje që deri më tani e kemi marrë si të mirëqenë, të rrokshëm në situatën tekstologjike, megjithatë pa hetuar më tutje se ku është realisht dhe mbi të gjitha, pa qartësuar situatën e pranisë së tij, si një nga aspektet më të ndërlikuara të ligjërimit letrar, ndonëse ka qenë i pranishëm gjithherët. Tjetri si ideologji në letërsinë shqipe, gjithnjë në shenjim të kamerës verifikuese, jo të një simboli a metafore që vetëm sa do ta ndërlikonte vorbullën e shikimit të letërsisë me anë të letërsisë, gjithnjë brenda letërsisë, ndërkaq është bota tjetër që gjendet brenda dhe jashtë një teksti letrar, pra edhe të një letërsie. Tjetri gjerë më tani është një koncept më tepër i përfoluar se sa i sqaruar në shenjëzimin e vetë, ku madje as vetë teoritë letrare, nuk është se të japin dorë për të mbërritur diku, në një përfundim adekuat. Megjithatë, për të patur një ide, sado përciptazi, për atë që përfaqëson koncepti i *Tjetrit* në letërsi, po përmendim këtu një pohim të Ernesto Sabatos, ku në mes të tjerash nënvizon: Tjetri. *Ndoshta, ashtu siç thoshte Kirkegardi, ngaqë arrijmë universalitetin duke gërmuar unin tonë, falë kësaj dialektike ekzistenciale nisi të dilte në pah ekzistenca e Tjetrit, sa më shumë që njeriu dukej se zhytej në humnerat e veta. Cilado qoftë arsyeja, epoka jonë ka qenë ajo e zbulimit të Tjetrit, (2015: 101, në librin Shkrimtari dhe fantazmat e tij)*. Këto mendime hedhin dritë në përpjekjen për të depërtuar në misterin që bart termi dhe hapësira e tjetrit, si një situatë bashkëshoqëruese e letërsisë, pra edhe e letërsisë shqipe. Pra, deri më tani, megjithatë vetëm sa është përcaktuar termi mbi tjetrin, mbi gjasat se ku është, si prani që duhet evidentuar, duke lënë kështu jo pak dritëhije në aspektet e hetimit të pranisë së tij, si një prani e pashmangshme. Tjetri është brenda tekstit, pra edhe të gjithë letërsisë si univers letrar, që me të rrallë rastis që të përputhet edhe me praninë e vlerës letrare. *Tjetri*, përveçse kaq sa përmendëm, është edhe jashtë hapësirës së tekstit, është konteksti i ndërlidhjes së fatit të autorit, të librit dhe të gjithë letërsisë, tashmë si hulumtim i gjasave dhe rrethanave që e mundësuan një tekst, që e pranuan ose mohuan, që e zbuluan në kohë ose me vonesë si model vlere, e cila

shoqëron fatin e veprës letrare. Tjetri si ideologji, një nocion që kërkon të shpreh një semantikë, një domethënie të dyfishtë, të pranisë dhe të zgjerimit të komunikimit me letërsinë, në këtë mjegullësi trajtimesh, mungese të një ideje teorike që e kthejllon vetë termin dhe hapësirën që posedon, dhe shumë më tepër të llafollogjemës mbi të, pa mbërritur ende të përcaktueshmëria e plotë, e cila endet si një hapësirë: *A – Fiktive*, sepse ligjërimi letrar me të gjithë ngjyrat e veta artistike, gati është hetuar në të gjitha optikat, kritike, studimore, eseistike, gjuhësore dhe semiotike, përmes metatekstesh të secilës lami të verifikimit letrar, duke krijuar kështu një vështirësi të studimeve. *B – Reale*, sepse dikursi i letërsisë së krahasuar, përmes konceptit të *Tjetrit* në letërsi do të rimerrte fushëpamjen e vetë, tashmë edhe në letërsinë shqipe, ku më tepër është folur teorikisht, me anë të hipotezave që tashmë do të duhet të argumentohen, se çfarë është, pa hetuar praninë e tjetrit, që ndërkohë zgjeron hapësirat e komunikimit me letërsinë, kryesisht me pjesën e mbetur në hije, për shkak të lënies në harresë të tjetrit, ose të marrjes në konsideratë, si prani vetëm të idesë fillestare mbi të.

2. Tjetri në letërsinë shqipe

Pas një përpjekje për të kuptuar *Tjetrin* si koncept, tani vjen në radhë edhe puna më e vështirë, hetimi dhe zbulimi i tjetrit në disa nga veprat e letërsisë bashkëkohore shqipe. Për të shmangur keqkuptimet dhe mbi të gjitha për të hyrë në marrëdhënie me arealet e letërsisë shqipe, të rrafesheve bashkëkohore, do të ndelemi në hulumtimin e *Tjetrit* në tri vepra të tre autorëve të spikatur të letërsisë shqipe, *Kadare, Pashku dhe Trebeshina*, duke u marrë me *Tjetrin*, si prani dhe shpalim, si shenjëzim etik dhe estetik.

a) Tjetri në prozën e Trebeshinës

Koncepti i tjetrit në prozën "Odin Mondvalsen", të Kasëm Trebeshinës, që dikush e emërton roman, e të tjerë novelë, mundet që të zbërthehet kryesisht nëpërmjet personazhit kryesor. Si shenjë të parë të këtij tjetërsimi/tëhuajësimi, pra si tjetri që na e zbulon praninë e tjetrit në këtë tekst, mund të veçojmë origjinën e tij: "Po, zotni, jam danez, ngaqë gjyshi im ka qenë italian dhe u martua me një franceze, ndërsa nëna e Odinit u martua me një danez". Në lidhje me këtë prozë, modern në shpalim dhe strukturë, tjetri është i hapur, madje shqiptohet rast pas rasti, nëpër episode e veprës, në marrëdhënie me mjedisin dhe personazhet e rastësishëm, si për të dëshmuar se tjetri, ose ana tjetër e medaljes së materies letrare, në këtë tekst dhe në një letërsi, është prani totale dhe që shqiptohet me një adresim të përcaktuar, me shumë gjasa të mishëruar në hapësirën e tekstit. Tjetri shpërfaqet këtu jo vetëm në pikëpamje të identitetit personal, por edhe sa i përket kombësisë, duke qenë se, personazhi, atdhe dhe parajsë të tij quan Danimarkën, që tregon për ikjen nga vetja, me gjasë për kalimin te përsëdytësi i vetë, që ose nuk ka atdhe, ose e ndërron sa herë të dojë atë. Absurdi,

paradoksi, alogjika, janë tri elemente të tjera themelore të estetikës së kësaj vepre, që përpos se shenjëzon surrealizmin, ashtu si edhe në disa proza të tjera të autorit, nëpërmjet të cilave autori paraqet jo shformimin e personazhit të vet, a tjetërsimin e tij, por shformimin e gjithë shoqërisë përqark, të individit dhe komunitetit, madje diçka më tepër të mendësisë së saj, të kolektivitetit të shformësuar, që nuk ka pikën e mëshirës për qenien njerëzore. Në këtë pikëpamje, duke qenë se personazhi ka një logjikë të pastër brenda alogjikës së vet, kjo rrethanë e pazakontë, por jo pak vepruese në jetën e përditshmërisë së sistemit monist, e përveçon dukshëm, e bën të huaj kundrejt individëve që e rrethojnë, kundrejt mjedisit në të cilin gjendet, duke dëshmuar kështu shenjat e qarta të tjetrit si univers kundërvënës ndaj atij mejdisi, që ndërkaq ka marrë përsipër që shkatërrimin ta emërtoj zhvillim dhe përparim. Ai, në hapësirën e këtij teksti, shmanget me qëllim, distancohet nga mjedisi, dallohet nga figurat e tjera, ndihet i huaj në ide, qëllime dhe në filozofinë e të konceptuarit të realitetit, por edhe më në veçanti, të mënyrës së të menduarit, që i kundërvihet hapur dhe me ashpërsi absurdit politik, shoqëror, të sistemit monist, që ka marrë përsipër ta fsheh fytyrën e vërtetë, ndërkohë që personazhi kryesor, ose tjetri real, si botë dhe prani, përmes groteskut, vetëdemaskues, shkatërron moralin fallco të një kohe dhe shoqërie të indoktrinuar në shtjellat ideologjike të komunizmit.

b) Tjetri në prozën e Kadaresë

Te romani "Pallati i ëndrrave", një prozë unike e Isamail Kadaresë, që shpesh herë ka zgjuar interesin e studimeve letrare, për natyrën e vetë, të ndërlikuar në adresimin, e një realiteti të kohës së diktaturës, apo të një tingëllime të atmosferës së sundimit osman, koncepti i tjetrit na vjen nëpërmjet një mori personazhesh-nëpunës, që duket se bëhen pjesë e ngrehinës së ëndrrave, me gjasë e vendit ku mblidhen dhe analizohen ëndrrat, e një kontrolli të imtësuar të tyre, tashmë të ngritur në sistem, ku mblidheshin, sistemoheshin e përpunoheshin ëndrrat, varësisht porosive dhe urdhërave të dhënë nga shefat që kishin në dorë gjithçka dhe që po përpiqeshin të shtinin në dorë edhe ardhëmrinë, bashkë me të edhe ëndrrat dhe shpirtin e njeriut. Të ishe pjesë e kësaj strukture, të rëndë dhe mistike, fatsjellëse dhe ndjellëse e fatkobit, shndërrohet në dilemë dhe ankth, pasi duhej të hiqje dorë nga ëndrrat, iluzionet, e vërteta, pra, të depersonalizoheshe deri në ind, të ikje nga vetvetja, të ishe thjesht dhe vetëm një numër i ëndrrës së mbledhur dhe analizuar deri në imtësi. Pikërisht këtu, në këtë shpërfytrim individual dhe shoqëror, moral dhe mendor, qëndron edhe koncepti kyç i tjetrit, i të *Huajit* që i kundërvihet *Vetes*. Me veprimet dhe mosveprimet e tyre, me dëshirën e madhe për të bërë karrierë brenda pallatit të ëndrrave, e cila rezulton të jetë vetëmse një utopi e pastër, personazhet e këtij romani shmangen nga realiteti, shmangen nga bindjet dhe idetë personale, ikin nga vetja, pa e kuptuar dhe me vetëdije, krijojnë një marrëdhënie të re me strukturat shtetërore, të secilës formë të

sistemeve, të shtetit që vret individualen, pra larminë e ekzistencës së qenies, i përshtaten një realiteti të ri, bindjeve të të tjerëve dhe ideve që nuk janë më të tyret, por që një ditë pikërisht ato ide edhe mundet që t'i veçojnë nga të tjerët, e pastaj t'i fshijnë nga kjo botë. Kjo i bën të mos jenë vetvetja, të veprojnë e mendojnë sipas një mendësie që nuk është e tyre. *Tjetri* në këtë vepër na vjen edhe metaforikisht, duke qenë se ngjarjet vendosen në periudhën e Perandorisë Osmane. Në një lexim të parë, të sipërfaqshëm, tjetri apo i huaji mund të identifikohet edhe si pushtues, që ka ardhur për të ndërruar fytyrën e vendit.

c) Tjetri në prozën e Pashkut

Romani "OH" i Anton Pashkut, është një tekst tjetër që të jep dorë për të hetuar *Tjetrin*, madje që vjen në një formë më të padukshme se në dy shembujt e parë. Është e vetmja prozë e gjatë e shkrimtarit, që madje nuk përkon me prozën fantastike, që e ka konceptuar vetë shkrimtari. Hapësira e këtij romani, në narrativë dhe shpalimin estetik, është pjesë e lëvrimit modern të prozës, pra edhe e pranisë së tjetrit në aureolën e veprës. Për të hyrë më në brendësi të ligjëratës mbi shenjat e tjetrit në këtë vepër, le të shikojmë hapësirën e kësaj proze, ku ndeshim dy personazhe, që më tepër po jetojnë mbarimin e jetës bashkëshortore. Materia e romanit afron nëj situatë absurdi, ku ata janë larguar kaq shumë nga njëri-tjetri, sa duken si dy të huaj, që as kanë nevojë të shihen, e jo më të llafiten me shoshojnë. Pra, dy personazhet e prozës që formësojnë tjetrin, tjetrin e dyfishtë, simbolin e tëhujazimit, si dhe të një tjetërsimi skajor, zë vend në këtë tekst të pazakontë si formë dhe shpalim artistik. Në këtë situate, ata që dikur nuk pushonin, një dikur që është fshirë, më shumë ngjën më me praninë e papranishme, sepse vërtet janë bashkë, në një bregdeti për pushime, por ama vetëm fizikisht, se shpirtërisht janë diku tjetër, shumë larg nga aty, pra jeta e tyre ka marrë një rrjedhë tjetër, nuk janë më për njëri-tjetrin, dikush tjetër janë në marrëdhenien e tyre. Kjo rrethanë e bjerrjes së dheniemarrjes, normale si modernitet, në jetën bashkëshortore, por edhe personale, përpos se tregues i një dashurie të lodhur, të fshirë tashmë, ndërkaq më tepër shenjëzon përmasën ekzistenciale të njeriut bashkëkohor, të ndarë dhe grimcuar në copa, që as vetë nuk e di se ku kanë rënë, mbase të njeriut modern, që gati i ka ndërprerë lidhjet pranë, jo vetëm lidhjen bashkëshortore, por çdo lloj marrëdhënie ndërpersonale, duke shpërfaqur dukshëm botën e njeriut pasiv, indiferent, që nuk ka asnjë interes për botën përqark, që nuk do të dijë për të. Në figurën e personazhit kryesor, përveç tjetërsimit të lidhjes, të martesës së ndryshkur, si një nëntekst më shumë, ka edhe një tjetërsim tjetër, më të largët në kohë, që zbret deri në lashtësi, një kërkim te vetja e tjetërsuar të gjurmëve të identitetit të tjetrit, si një përmasë shoqëruese e lëvrimit të letërsisë. Velur nga jeta individuale dhe familjare, më tepër e të jetuar bosh, për hir të botës dhe opinionit të tyre, nga zvetnimi i një jete shoqërore, të mbytur në idhujtari dhe zhurmërima

patriotizmi fallso, ikën në kohën ilire, e prej aty bashkëbisedon me vetveten, me përsëdytësin e transformuar si indentitet, si dëshmi ekzistence, më tepër si një ikje prej kohës së bashkëkohësisë.

Kah Përkufizimi

Tjetri, si nocion dhe mëshirim në hapësirën e teksteve, ku dhe u ndalëm, është vetëm një sprovë për të sjellë në vemendje praninë e tjetrit, e sidomos për ta përfshirë në optiokën e studimeve letrare, si një shmangie nga një prani që nuk e vumë re. Më tej, ndaj letërsisë, secilit tekst është shtuar edhe një dritare, *Tjetri*, nga ku mundet të vështrohet dhe interpretohet shenja letrare.

Literatura

Sabato, Ernesto: *Shkrimtari dhe fantazmat e tij*, Sh. B. pika pa presje, Tiranë 2015.
Trebeshina, Kasëm: *Odin Mondvalsen*, Buzuku, Prishtinë, 2016.
Kadare, Isamail: *Pallati i ëndrrave*, Onufri, Tiranë, 1990.
Pashku, Anton: *OH*, Rilindja, Prishtinë, 1971.

Flamur MALOKU

THE IDEOLOGY OF THE OTHER IN ALBANIAN LITERATURE

Abstract

The concept of the other in Albanian literature, the discourse on the other in Albanian literature or on the present unpresence, a random association of Umberto Eco's suggestion, is one of the modern and postmodern landmarks as an optical verification from which the study of Albanian literature must begin its course. First of all, the term 'other' as ideology is the search for something which until now has been taken for granted, it has been presupposed in textologic situations without a further investigation of where it really is, and most importantly, without clarifying the condition of its presence as one of the most complex aspects. The other as an ideology in Albanian literature, in signifying a verification camera and not a symbol or a metaphor, would only complicate the vortex of looking at literature through literature, while there is another world that can be found in and out a literary text, i.e. of a literature. The other is within the text, and in the universe of the literary reality, which at times is in accordance with the presence of the literary value. The other is also on the outside; it is the context of the interrelation between the fate of the author,

the book and all of literature, as an inquiry into the probabilities that made possible a text, that accepted or denied it, that discovered it as a model of value in the right time or in delay.

Orjela STAFASANI

TRIUMFI NDAJ TJETRIT

Pas disa eksperimentesh ironike, Ridvan Dibra shkruan dy romane parodike, të cilët mund të lexohen në raport varshmërie ndaj njëri-tjetrit, siç edhe janë analizuar nga studiuesit (Vinca, Olluri, Prendi), por mund të lexohen edhe si romane të ndara, siç sugjeron autori (Dibra, 2002: 5). Statusi i dyfishtë, për t'u lexuar herë si pjesë, herë si tërësi, është një karakteristikë e veprave postmoderne, e pranishme dhe e shpeshtë si në prozën e Shqipërisë, ashtu edhe në atë të Kosovës.

Sidoqoftë, romane më vete, apo diptik romanesh, veprat *Triumfi i Gjergj Elez Alisë* dhe *Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë* janë proza me platformë të tejdukshme postmoderniste. Prandaj, leximi i tyre jo vetëm që nuk mund ta shpërfillë njërën pjesë, apo njërin vëllim, por kërkon patjetër edhe leximin e tekstit bazë, hipotekstit, i cili ka prodhur dy variante sipas modelit të poetikës që ka për bazë principin e rivizitimit ironik. Falë këtyre dy romaneve dhe prozës tjetër që i përmbahet së njëjtës poetikë, Ridvan Dibra tashmë njihet si një autor përfaqësues në prozën postmoderne shqipe.

Parodia, alegoria dhe satira

Triumfi i Gjergj Elez Alisë dhe *Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë* janë dy romane që, përveç ironisë, kanë shenjë të dallueshme edhe parodinë. Derisa ironia i përket tekstit, parodia ruan relacionin me hipotekstin, prej ku është marrë heroi epik për t'u demitizuar dhe për t'u afruar me kohën tonë. Meqenëse parodia nënkupton përmbysjen e një figure të madhe, në dy romanet e Dibrës kemi përmbysjen e njërës prej figurave më të sublimuara të folklorit shqiptar i cili del në mejdan, apo shkon në han, për ta mundur Balozin, të ardhurin, tiranin, tjetrin. Beteja bëhet mes vendasit dhe tjetrit, kurse triumfi i përket të parit, si në legjendë, ashtu edhe në roman.

Gjergj Elez Alia në roman nuk është hero epik, madje nëpërmjet rrëfimit autodiegjetik, ne më shumë e njohim botën e brendshme të heroit sesa atë të jashtmen. Një hero lirik që shkrihet me autorin ironik brenda diskursit parodik është një tallje e pastër me temën burimore dhe me të gjitha tiparet himnizuese të epikës. Përmbysja shkon duke u forcuar gradualisht: heroi nuk ka nëntë plagë, por vetëm dy, mbetet i fundit në garat me gurë, vjell rakinë dhe humb garën, ka një lidhje (vetëm) fizike me Norën, frekuenton prostitutën Irenë, është njeri i kontemplacionit, i pëlqen të vrojtojë e të shkruajë, nuk jepet pas aksionit, nuk e pëlqen as luftën, as duelin,

prandaj në vend të betejës epike, që përshkruhet në këngë, ai zgjedh betejën retorike, duke e mundur kundërshtarin me fjalë. Heroi, duke u munduar të përmbahet nga plagët e veta, zbulon plagët e kundërshtarit, plagët e tjetrit, i cili, pasi dëgjon argumentet e Gjergj Elez Alisë, largohet si humbës.

> Si mund të shpëtoj prej plagëve të mia?, pyeti papritur Balozi.
> Të ndryshosh. Domethënë të mësohesh me plagët e tua. Ose të largohesh nga kjo botë.
>
> (Dibra, 1999: 174)

Gjergji zbulon plagët e Balozit, sepse plagët e tjetrit, sipas autorit, mund të zbulohen vetëm nga njeriu që edhe vetë ka plagë. E plaga e zbuluar këtu është: *Vetëm një njeri me plagë do që ta ketë gjithë botën të vetën* (1999: 172). Ky konstatim nxit përfundim logjik: tjetri si unë.

Në mënyrë parodizuese në roman është trajtuar edhe motra e heroit. Ndryshe nga përkushtimi dhe kujdesi pa asnjë ankesë, për çfarë këndohet në këngë, në roman ajo di edhe të ankohet pse ka harxhuar rininë duke u përkujdesur për një "invalid" si i vëllai. Po ashtu ajo ka një lidhje, që pastaj ndërpritet, me shokun e vëllait, si dhe është e gatshme të shkojë në shtrat me Balozin.

Në romanin e dytë mbi të njëjtin hero vazhdojnë përmbysjet, ruhet parodia, por bëhet më e dukshme alegoria dhe shfaqet satira. Pas një viti, Balozi kthehet në Egobokë, por tashmë si Baloz i bardhë, si njeri i mirë, i gatshëm për t'i ndihmuar egobokasit, të cilët i besojnë "ndryshimit" të tij. Pra, tjetri kthehet, por me sjellje tjetër, me petk tjetër, me qëndrim tjetër. Për çdo takim e aheng që bën, ai i dërgon ftesë Gjergj Elez Alisë, i cili tashmë nuk denjon as t'i pergjigjet, duke treguar kështu që arma më e mirë për të triumfuar mbi tjetrin është shpërfillja. Beteja retorike në han, në romanin e parë dhe shpërfillja olimpike, në romanin e dytë, janë dy triumfet e vërteta të Gjergj Elez Alisë në variantet autoriale postmoderne të cilat bazohen në legjendën ku Gjergji triumfon me topuz.

Dhe pas këtyre triumfeve, Gjergji nuk preferon të marrë rolin e liderit, rolin e shpëtimtarit. Në vend të këtij roli, ai zgjedh internetin, apo siç e quan autori, gojeveshnetin. Po ashtu, ai nuk e pëlqen këngën diferencuese që fillon me "trim mbi trima ai Gjergj Elez Alia", por dëshiron të njihet ashtu siç është: "Njeri si të gjithë njerëzit ai Gjergj Elez Alia".

Triumfi i Gjergj Elez Alisë mund të lexohet kryesisht si një hipertekst parodizues i këngës folklorike shqiptare, kurse *Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë* mund të lexohet njëherësh si parodi, alegori dhe satirë. Në të ka aludime të shumta në figurën dhe kohën e Enver Hoxhës (kënga për Balozin është e ngjashme me këngën për Enverin, burgjet e mbushura me rapsodë ngjajnë me burgjet e mbushura me shkrimtarë dhe intelektualë që s'u pajtuan me dikatorin), po ashtu ka aludime edhe në kohën e

politikanëve shqiptarë të periudhës postkomuniste, aq sa leximi mund të prodhojë asociacione mes Balozit dhe diktatorit shqiptar, po aq sa paralelizma mes Balozit dhe politikanëve të paskomunizmit.

Ndërsa, diskursin satirik varianti i dytë i Dibrës e shfaq në relacion me aktualitetin shqiptar. Përqeshja e aktualitetit si komponente bazike e satirës, demitizon figurat e legjendës dhe "mitizon" në mënyrë përqeshëse figurat e politikës postkomuniste shqiptare. Një lloj satire është edhe preokupimi aq i madh me *gojeveshnetin*, nga i cili heroi, që në këtë dipitik nuk është dhe as që pretendon të jetë hero, merr lajmet për ato që ndodhin jashtë kullës së tij.

Gjithashtu, vokabulari i heroit në këtë roman është shumë i modernizuar, i pasuruar edhe me fjalë nga bota e show-bizit. Edhe detaji për një homoseksual që dashurohet në Gjergj Elez Alinë është futur në funksion të satirës.

Përdorimi i parodisë, alegorisë dhe satirës, të trija të dominuara nga diskursi ironik autorial, flasin për një guxim eksperimental me mitet dhe për një vetëdije postmoderniste.

Dorëshkrimi i hapur

Në variantet e Ridvan Dibrës, heroi nuk u beson rapsodëve që i ekzagjerojnë bëmat e njerëzve, prandaj vendos ta shkruajë vetë historinë e tij. Ai është shkrimtar, narrator, personazh. Si shkrimtar i aluduar funksioni i tij shtrihet vetëm te dorëshkrimi, si narrator është brenda rrëfimit, si personazh është në qendër.

Të folurit e narratorit mbi shkrimin e historisë brenda historisë ku ai është personazh, është gjithashtu një tjetër tipar postmodern, që e bën veprën të duket e hapur, *e shkrueshme* (Barthes). Të dy romanet që në faqe të parë tregojnë funksionet e Gjergj Elez Alisë (shkruan, rrëfen dhe ndien, mendon e vepron).

> Kam shkruar vetëm kaq pak rreshta dhe ndihem i lodhur, si të kisha mbushur faqe të tëra. Ndoshta ngaqë kam plot nëntë vjet pa hedhur një fjalë në letër, ndoshta ngaqë nuk i kam fort të qarta arsyet se, përse pikërisht sot, në këtë ditë të zymtë vjeshte, kur veten e ndiej si ai guri i kuq në kthesën e tretë të Përroit të Thatë, ulem në tryezën e shkrimit.
>
> (1999: 5)

> Jam mbyllur prapë në Kullën time dhe prapë jam ulur në tryezën e shkrimit. Domethënë i gatshëm për t'ia rinisur punës. (...) para disa vitesh kisha menduar se bashkë me Balozin më qe gremisur edhe dëshira e vullneti për ta hedhur jetën time në letër...
>
> (2002: 7)

Romani *Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë* mbyllet me një dilemë, që e lë të hapur mundësinë për vazhdimin e serisë mbi Gjergj Elez Alinë:

> Balozi kishte ikur. I mundur, më duket. Ky ishte triumfi im i dytë. Ose më saktë bejlegu im i dytë me Balozin. Nuk e di a do të ketë edhe një të tretë. Nëse po, do të më duhet të zgjedh të tjera armë. Ato që kam përdorur deri më tash, domethënë *urrejtja* dhe *shpërfillja*, do të jenë ndryshkur deri atëherë. Kurse tashti nuk e di se cila mund të jetë ajo armë e re. Ndoshta dashuria. Ndoshta diçka tjetër: një armë e re, që nuk është zbuluar akoma.
> Ku i dihet?
>
> (2002: 225)

Derisa autori lë të hapur mundësinë e realizimit të një triptiku, apo trilogjie, mund të thuhet se në dy romanet mbi të njëjtin hero Ridvan Dibra është dëshmuar si shkrimtar autentik që risemantizon në mënyrë kreative temat legjendare.

Bibliografia

Agim Vinca, *Triumfi i postmodernes*, albanovaonline.com më 28.9.2007
Adil Olluri, *Romani postmodern shqiptar*, AIKD'99, Prishtinë, 2011
Arben Prendi, *Letërsi shqipe bashkëkohore*, Fiorentia, Shkodër, 2015
Linda Hutcheon, *A Poetics of Postmodernism*, Routledge, New York-London, 1988
Ridvan Dibra*, Triumfi i Gjergj Elez Alisë,* Onufri, Tiranë, 1999
Ridvan Dibra, *Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë,* Buzuku, Prishtinë, 2002
Roland Barthes, *Variazioni sulla scrittura-Il piacere del testo*, Einaudi, Torino, 1999

Orjela STAFASANI

THE TRIUMPH OVER THE OTHER

Abstract

In the diptych of Ridvan Dibra, the *Triumph of Gjergj Elez Alia* and the *Second triumph of Gjergj Elez Alia*, as in the postmodern literature the author make a ironical revisitation of the past. In both novels, the legendary heroism is parodied through the postmodern battle of two well-known folklore figures. In the first novel, Gjergj Elez Alia defeat Bajloz, not with force, but with words, while in the second novel, Gjergj Elez Alia "wins" the battle with Bajloz, without challenging him. In this way, Bajloz is

not only the other, but it is also the power, wich the postmodern Albanian can "challenge" by collaborating with him, or ignoring him.

Ridvan Dibra's diptych is an original treatment of a legendary subject, which has been re-contextualised, re-semanticized and parodied according to the postmodern poetic.

Key words: the other, irony, parody, allegory, manuscript, legend, histori

Serafina LAJÇI

KONCEPTI I TJETRIT NË ROMANIN "VITET E URITHIT" TË KIM MEHMETIT

Romani "Vitet e urithit" i Kim Mehmetiti shkruar si metafiksion historiografik që*reflekton dallimin ndërmjet vetëprezantimit formal dhe kontekstit vetjak historik* (Hutcheon 2013: 152), si kohë të rrëfimit ka kryesisht periudhën komuniste në Maqedoni, konkretisht atë tënjë fshati të izoluar të Shkupit. Romani ndjek modelin postmodernist, i cili argëtohet (luan) me të kaluarën, duke i shpërfaqur lexuesit, atë që Linda Hutcheon e koncepton, si kënaqësi të dyfishtë, bazën reale dhe fiktivitetin. Personazhet e këtij romani, sinjerëz të ngecur brendanjë fshati të izoluar i cili nuk i ruan, madje,as raportet me fshatrat përreth, reflektojnë pikërisht frikën e përballjes me *tjetrin* (të huajin) dhe në të njëjtën kohë, përpjekjen për ruajtjen e identitetit.

Eks-centrikja dhe frika nga tjetri

Romani "Vitet e urithit' e fuqizon eks-centriken, jashtë-centriken, duke e minimizuar kështu centriken, qendrën. Si i tillë, ky roman, subjektin e vet e ndërton duke u bazuar nga lënda lokale *e cila përpiqet ta lidhë konceptin e qendrës me të përjetshmën dhe universalen*(2013:88). Personazhet e romanit, si personazhe lokale, qoftëmendërisht e fizikisht,duke u karakterizuar e veçuar nga mentaliteti, veshja e qëndrimi, thellësisht lokal, janë të papërqueshëm në raport me qendrën, e që në këtë roman shenjon Shkupin. Duke qenë jashtë qendrës dhe duke u mpleksur nën ndikimin e lokales, personazhet e këtij romani, pritshmërinëe jetës, dashurisë e vdekjes, e lidhin ngushtë me njëri-tjetrin.Këtu,edhe zë e zhvillohet frika, dyshimi e ngurrimi i tyre, në raport me të tjerët, pra të huajin, qoftëme ata që vijnë dhe bëhen pjesë e fshatit të tyre, siçështë rasti me magjistaren Fatka, qoftë me ata që janë vetëm kalimtarë, siçështë rasti i oficerit gjerman. Në të dyja situatat, është i rëndësishëm fakti që Tzvetan Todorov e quan *zbulimi i tjetrit,*qësipas tij, tregon më së miri se *cilat janë efektet e mosnjohjes*, pra *se çfarë rreziku mund të ndodhë nëse nuk arrihet të zbulohet tjetri* (Postbllok 2015). Meqë,*identitetet sociale janë relative; grupet në mënyrë tipike e definojnë vetveten në raport me tjetrin. Kështu, duke e definuar vetveten, grupi i definon dhe të tjerët* (Okolie 2003: 2). Në këtë rast, personazhet e këtij romani,qëndrimin për të huajin, për atë që vjen dhe zbarkon në hapësiren e tyre,e kanë të definuar,veçmas nga disa komponentë kryesorë: nga qëndrimi i paraardhësve të tyre ndaj tjetrit e qëështë qëndrim fundamental për ta; nga

gjykimi që ata vetë kanë për tjetrin, veçmas nëse ky gjykim është i lidhur ngushtë me trajtesën historike; nga ndikimi i kodit kanunor, si përcaktues i jetës morale dhe shpirtërore të tyre,si dhe nga bestytnitë, si veçanti shprehëse.

Qasja me *tjetrin* (të huajin)

Prania e tjetrit në të njejtën hapësirë, veçanërisht nëse ajo është e shoqëruar me kërkesat për një pjesë të pushtetit dhe për njohjen e kulturës tjetër, fesë ose gjuhës, përceptohet si një kërcënim për integritetin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë së grupit dhe mënyrën e tyre të jetesës (Kelman 2001:1-2).Pikërisht këtu, zë fill edhe domosdoshmëria e ruajtjes së identitetit, traditës e kulturës, si një reflektim i menjëhershëm ndaj tjetrit. Tek personazhet e këtij romani,e që janë njerëz realë të së shkuarës, lojën me të cilën, autori e vendos shpesh brenda një konteksti ironik, komponenta e parë, që reflekton lidhjen e tyre me paraardhësit,është zbuluese errënjëve të vjetra, në shoqërimin me të huajt,të cilat janëdëshmitare besnike të një lidhjeje, që nuk mundta rrezikojë mirëqenien e tyre.Kjo, nënkupton, se nëse paraardhësit e tyre e kanë pasur të zhvilluar miqësinë me të huajin, siçështë rasti me bullgarët, edhe ata, sikurse të parët, do të jenë vazhdues të denjë të kësaj miqësie:...*kryeplakut i ishte kujtuar pse dy bullgarët kishin menduar se në fshatin tonë do të gjenin strehim dhe se ne nuk do t'i linim në rrugë. Thjesht, ata kishin dëgjuar për burrërinë e parardhësve tanë që dikur thuajse ishin themelues të fshatit të tyre, dhe kjo lidhje nga e kaluara, ishte ajo që kishte lëshuar degë deri në të sotmen* (Mehmeti 2011: 202). Pra, lidhjet reciproke të cilat nuk rrezikojnë identitetin e tyre, shënjojnë komponentën e parë të qasjes sëkëtyre personazheve me tjetrin.Një pasqyrim i kësaj, është edhe raporti me oficerin gjerman e të cilin vendasit e konsiderojnë si shpëtimtar, kur kuptojnë se është stërnipi i të afërmit të tyre, Sefos.

Meqë romani, lëndën e vet e merr nga fshati, duke e reflektuar kështu ruralen, elementi kanunorështë një tjetër përbërës i rëndësishëm, në ndërtimin e marrëdhënieve me të huajin. Derivati i Kanunit, shtrihet në një pjesë të konsiderueshme tëkëtij romani, duke u shpërfaqur më së miri tek figura e kryeplakut. Është pikërisht kryeplaku, që megjithë frikën dhe ngurrimin e bashkëfshatarëve, e mirëpret si mikun e vet, oficerin gjerman, duke e respektuar kështu kodin kanunor,për nderimin e tjetrit në konak, qoftë ai edhe armik i përbetuar.Sado që përballja me tjetrin mund të jetë e padëshiruar, sadoqë ardhja e një të huaji mund të shkaktojë kaos e frikë, megjithatë, personazhet e këtij romani, janë ruajtëse të vlerave e traditave të tyre, edhe atëherë kur përballen me të huajin. Sinonim i kësaj, është edhe përpjekja e fshatarëve për të mos i zhvarrosurnga fshati, eshtrat e ushtarit të panjohur,të cilët varrin e tij *e mirëmbajnë më kujdesshëm se atë të kullave të veta* (2011: 101).

Si komponentë e fundit, por jo më pak e rëndësishme, në ndikimin e raporteve të këtyre personazheve me tjetrin, janë edhe bestytnitë, që në formë ironike, e përshkojnë një pjesë të romanit. Fakti se çdo gjë qëështë e huaj, nuk mund të jetë e

mirë dhe si e tillë mund të ketë pasojat e veta, e dëshmon më së miri shembullime bagëtinëe kthyer nga Dalmacia, (kur Sefoja kishte ngatërruar rrugën për në Edrene, me atë të Dalmacisë), nga i cili kthim,për shkak të kullotes në vise të huaja,*kishin lindur qengja pikaloshë, disi të deformuar*. Si rezulat i kësaj, *qengjat e atij viti i kishin therur ende pa u ndarë nga gjiri dhe i kishin gruposur në fund të fshatit* (2011: 58).

Si përfundim, skema eks-centrike e romanit, brenda së cilës janë te vendosura personazhet është përcaktuese e qartë e qëndrimeve, gjykimeve e raporteve të tyre karshi tjetrit, atij që vjen nga larg e që ka tjetër kulturë e pikëpamje.

Femra, si *tjetër*

Sipas Bauman-it, *ardhja e një të huaji ka ndikimin e një tërmeti* (1997: 30), sepse ai duke ardhur nga një qendër tjetër që nuk ndan të njëjtat përshtypje lokale, me anëtarët e qendrës ku vijon, bëhet esencialisht njeriu që kanos integritetin e shoqërisë përkatëse.

Në romanin "Vitet e urithit", krahas komponentëve tjerë që reflektojnë lidhjet me tjetrin, njërol krejtësisht unik, luan personazhi Fatka, magjistarja e ardhur nga Turqia e cila, tërheq vëmendjen e personazheve dhe të lexuesit. Si e tillë, ajo është jashtëstrukturave dhe përcaktimeve të shoqërisë, duke u shndërruar kështu nga një përsonazh centrik, që vjen nga Stambolli, në një personazh eks-centrik, që jeton e vdes në fshat. Pikërisht, kjo pozitë e saj eks-centrikei jep asaj dhëmbshurinë për njerëzit në nevojë. Ky është edhe shkaku, pse ajo, megjithë dyshimin e përbuzjen e rrethit, vazhdon të kontribuojë në mënyrën e vet për të mirën kolektive të fshatit. Nëse nisemi nga postulatat feministe, Fatkën, mund ta perceptojmë sidyfish të huaj, si një e ardhur, në një fshat të izoluar, dhe si një*tjetër*, përballërelacionit me mashkullin. Pra, shikuar nga ky aspekt, Fatka përveç ndarjes etnike që e specifikon atë si të huaj, ajo është tjetra edhe në aspektin gjinor, kriter ky që e bën edhe më të dallueshëm, atë, si personazh.

Qëndrimin e saj në një mjedis krejtësisht të ri e të huaj, autori e shpalos nga pozicioni i trekëndëshit: Si femër, si një e ardhur e panjohurdhe si magjistare. Që të trija këto nuanca e portretizojnë karakterin e saj kontradiktor. Si femër, Fatka, është një mishërim i bukurisë me të mistershmën, si një e huaj e ardhur, ajo është një kërcënim për rrethin dhe si magjistare, ajo është një shtrigë e mundshme në sytë e të tjerëve.Edhe raporti i saj me personazhet e romanit është poashtu specifik dhe kompleks. Veçmas, vlen të theksohet raporti i saj me kryeplakun, i cili tejkalon balancin e miqësisë, duke u zhytur në detin e thellë të njëraporti intim. Raportin e tyre, narratori e trajton në formën e mozaikut, duke ia lënë narraterit, lexuesit, vendosjen e copëzave dhe zbulimin e nënkuptuar të autorit. Përveç, raportit me kryeplakun, raportet e Fatkës me personazhet e tjera të romanit, në të shumtën e rasteve, janë të vëna nën impaktin e dyshimeve, herë-herëtë përbuzjeve me epitete, si e *shthurur* dhe *shtrigë*. Në këtë kontekst, mund ta vendosim edhe raportin e saj me hoxhën e fshatit, i

cili përkundër pasionit për magjistarën e bukur, shfryn mllefin e vet shpirtëror, si pasojë e refuzimit që ajo i bën. Kështu, *duke ballafaquar magjistaren me kryeplakun dhe hoxhën, autori ka ballafaquar estetikën me etikën* (Apolloni 2016).

Edhepse Fatka, si personazh, nuk përbën linjën kryesore për të cilën thuret rrëfimi, megjithatë, ajo është pjesë përbërëse e historisë sërrëfimit dhe si e tillë, ajo është degëzim i rrënjëve nga të cilat do të lindin të vërtetat e pathëna. *Me vdekjen e saj kishte marrë fund një pjesë e së kaluarës së fshatit tonë. Por me këtë nuk kishin marrë fund edhe bëmat që ndërlidheshin me Fatkën. Sepse aty ku merrnin fund trondtitjet e papritura dhe ndizej drita e largët e shpresës se do të fillonte një jetë e qetë; lidhej nyja e rrjedhës së ngjarjeve të ngatërruara e të papritura, të cilat të çonin të dyshosh në atë që kishte ndodhur, e të mos i besosh ardhmërisë* (2011:82). Kështu, Fatka, ndonëse personazh, që siç e potencon autori, *vjen në këtë rrëfim si hije anësore* (2011:126), është megjithatë gërshetuese e dy periudhave kohore:e së shkuarës, në të cilën ajo është prezente dhe e së ardhmes, në tëcilën veprimet e së shkuarësnuk mund ta anashkalojnë prezencën e saj. Ajo, si tjetër, pra e huaj, krijohet e vjen nga qendra për t'u shqendërzuar dhe për të mbetur përherë e tillë.

Si roman, që subjektin e vet e rimodelon nga lokalja, periferikja, duke iu shmangur qendrës, centrikës, konceptin për tjetrin/tjetrën, autorie konstrukton me elemente të tilla eks-centrike, si lojë e një modeli postmodernist të cilit i takonedhe vet romani.

Literatura

Apolloni, Ag (2016) *Poetika dhe Profile*, nëGazeta Express, 07 prill.

Bauman, Zygmunt (1997) *Postmodernity and its Discontents*, USA: Polity Press.

Hutcheon, Linda (2013) *Poetika e Postmodernizmit*, Prishtinë: SHB "OM".

Kelman, Herbert C (2001) *National Identity and the Role of the "Other" in Existential Conflicts: The Israeli-Palestinian Case1,*Oxford and New York*:* Oxford University Press.

Mehmeti, Kim (2011) *Vitet e urithit*, Shkup: Logos-A.

Okolie, Andrew C. (2003) *Identity and Power in Africa and the Caribbean*: Lawrence Erlbaum Associates.

Todorov, Tzvetan (2015) Tjetri në sytë e europianëve: nga 'Konkuista e Amerikës', në Post Bllok, 06 gusht.

Serafina LAJÇI

THE CONCEPT OF THE OTHER IN KIM MEHMETI'S NOVEL "VITET E URITHIT"

Abstract

Kim Mehmeti's novel "Vitet e Urithit" at the same time reveals a familiar and yet unimaginable worldview concept. Main subject of the novel reveals life in a village of Skopje, seen from an original point of view. The characters of this novel, being stuck in a totalitarian system, do not know that, outside their world, outside the shell in which they are 'developed', physically and mentally, life flows intensely. Constellation on the edge of the state reflects precisely the fear of confronting the other (the unknown) and at the same time the necessity of preserving culture and tradition. Particularly distinguished is the character of Fatka, which, being stranger in the village, attracts the attention of the other characters, but also of the reader. It is exactly, the *other*, she that turns into a center around which all the events occur. She has fled from the Turkish center and has come to an Albanian village, where she remains until she dies, because the village is the one who does not leave strangers.

Jolanda LILA

KONCEPTI I ZOTIT NË POEZINË E ALI PODRIMJES

Abstrakt

Epiqendër e kësaj kumtese shkencore është shpërfaqja e konceptit të Zotit në poezinë e Ali Podrimjes. Prania e këtij koncepti nuk lidhet me frymën mistike të besimit, as me traditën artshkruese të poezive religjioze, por përthyhet në botën e tij poetike, duke u karakterizuar nga specifika të veçanta.

Podrimja nuk e madhëron Zotin, por krijon Zotin e vet dhe i jep atij trajta të ndryshme, që në të shumtën e rasteve e përdhosin shenjtërinë e qenies së mbinatyrshme (*Kur dashurohem në fuqinë e rrufesë/ në majë të Olimpit zotin pshurr,* "Kur dashurohem me fuqinë e rrufesë*"*).

Poeti nuk i referohet Zotit në konceptin spiritual të monoteizmit, gjë që dëshmohet edhe nga përdorimi i një numri të vogël simbolesh religjioze (*bibla, djalli, ferri, varka e Noes, satanai, Nazareti, Krishti* etj.), por i drejtohet Zotit me tipare antropomorfike të besimit politeist. Këtë e dëshmojnë edhe raportet e subjektit lirik me Zotin, që shfaqen në disa trajta:

- Subjekti lirik nuk e sheh Zotin si burim shprese, por si burim fataliteti (*pas shumë vjetësh/ në zot hetuan gjarprin* - poezia "Përralla"; *Një tokë e djegur/Nga Zoti braktisur dhe Robi i vet* - poezia "Ishulli Albania");
- Ai nuk e sheh Zotin si pikëmbështetjeje e burim prehjeje, por është përherë në luftë me të. (*Kohët keq të mësuan/Kur i munda zotërat).*
- Ai e sheh Zotin si barasvlerës të djallit *(Lavdi djallit/lavdi Zotit* – poezia "Pas rënies pas ngadhënjimit).
- Ai e sheh Zotin si të madhëruar vetëm në kuptim ironik (*Zoti është i madh/ Dhe i rëndë dënimi i tij* - "Robi i Zotit")

Gjuha e poezisë dhe gjuha e religjionit janë vënë pranë njëra-tjetrës prej shumë studiuesve, për shkak të karakterit simbolik të ndërtimit të tekstit dhe vlen të përmendim në këtë kuadër, studiuesin Umberto Eko, i cili thekson se pa ontologji dhe metafizikë të së shenjtës, të religjiozes nuk ka simbolizëm dhe nuk ka pafundësi të interpretimit. Duke qene se një nga përbërësit kryesor të shprehjes poetike të Ali Podrimjes është simboli, ai rifunksionalizon elemente të legjendave e të miteve, të cilat bartin në vetvete frymën religjioze dhe karakterin e së mbinatyrshmes. Kjo kumtesë

do të dritësojë jo vetëm raportin e subjektit lirik me Zotin, por edhe funksionin që bartin këto raporte në kontekstet poetike.

Fjalët çelës: *Zoti, religjioni, simboli, kaosi, çmitizimi*

Koncepti i Zotit në poezinë e Ali Podrimjes

Prania e Zotit dhe trajta e mistikes

Në poezinë e Ali Podrimjes vihet re një denduri përdorimore e fjalës "Zot". Vetëm në përmbledhjen poetike "Litari i ankthit" (poezi të zgjedhura nga studiuesi Bashkim Kuçuku, Toena, Tiranë, 2002, rezulton që në 256 poezi (që konsiderohen edhe si poezitë më përfaqësuese të poetit), fjala "Zot" të jetë përmendur 54 herë dhe fjala "perëndi" 12 herë.[1] Pavarësisht perceptimit fillestar që mund të të ofrojnë të dhëna të tilla, prania e këtij koncepti nuk lidhet me traditën artshkruese të poezive religjioze dhe as me botëkuptimin mistik të besimit, por përthyhet në botën e tij poetike, duke u karakterizuar nga specifika të veçanta. Në çdo përdorim të fjalës "Zot" kodifikohen kuptime e mesazhe të larmishme, varësisht nga sfondi kontekstual. Ky mbishtresim kuptimor buron nga shprehja poetike moderne që karakterizon poezinë e Ali Podrimjes, ku në bazë të strukturës së saj figurative dhe semantike qëndron simboli, ironia dhe elipsa që përftojnë asosacione të larmishme kuptimore. Këto specifika artshkruese të imponojnë edhe qasjen metodologjike për të dritësuar konceptin "Zot" brenda strukturës shumëkomplekse tekstuale dhe konteksteve të mundshme që derivojnë prej saj.

Gjuha e poezisë dhe gjuha e religjionit janë vënë pranë njëra-tjetrës prej shumë studiuesve, për shkak të karakterit simbolik të ndërtimit të tekstit. Vlen të përmendim në këtë kuadër, studiuesin Umberto Eko, i cili thekson se pa ontologji dhe metafizikë të së shenjtës, të religjiozes nuk ka simbolizëm dhe nuk ka pafundësi të interpretimit. Simboli në vetvete është bashkim metafizik i asaj që shihet me atë që nuk shihet. Pikërisht simboli është një nga përbërësit kryesor të shprehjes poetike të Ali Podrimjes, që rifunksionalizon elemente të legjendave e të miteve, të cilat bartin në

[1] **Denduria e përdorimit, ose koncepti i dominantes është një nga tiparet më të rëndësishme që e identifikon stilin e autorit. Sipas Roman Jakobsonit, dominantja është elementin qendror i veprës artistike: ajo i orienton, i përcakton dhe i shndërron të gjithë përbërësit e tjerë të strukturës poetike. Është dominantja ajo që i jep veprës veçanësinë dhe njëherësh, garanton tërësinë e strukturës, duke lidhur formën me përmbajtjen në një unitet të pandashëm. Megjithatë, në mendimin teorik bashkëkohor ekzistojnë pikëpamje të ndryshme, ku shpesh thuhet se në poezinë moderne nuk funksionon logjika e statistikave të fjalë-çelësave si shpeshti përdorimi, pasi kjo poezi flet më shumë me atë që nuk thuhet, sesa me atë që thuhet. Përtej kësaj kundërvënieje këndvështrimesh, denduria përdorimore e fjalë-çelësave, si dhe format e paraqitjes së tyre në tekstin poetic podrimjan janë një e dhënë që nuk mund të anashkalohet.*

vetvete frymën religjioze dhe karakterin e së mbinatyrshmes. Pra, është gjuha konotative ajo që realizon përmbajtjen tejracionale, të cilën arsyeja nuk arrin ta krijojë dhe ta përkapë deri në fund, prandaj prania e madhe e fjalës "Zot" por edhe e elementeve mistike në përgjithësi tek Podrimja nuk duhet parë si koncept i misticizmit, por si trajtë dhe figurë poetike. T'i drejtohesh Zotit, nuk do të thotë se je mistik, por kjo lidhet me përditshmërinë e njeriut universal, me gjendjen psikologjike pa rrugëdalje dhe me alkiminë e përjetësimit të gjërave e dukurive të shtrenjta për ne.

Vetë botëkuptimi mistik nënkupton ndjekjen me vetëdije të një realiteti final hyjnor, të një të vërtete absolute shpirtërore, ose të vetë Zotit, në konceptimin më shumëfaqësh të tij. Kjo mendohet të arrihet nëpërmjet përvojës direkte, intuitës, instinktit, ose edhe zhbirimit përbrenda vetes në meditim. Asnjëra prej këtyre përvojave nuk shfaqet në poezinë e Podrimjes, sepse ai nuk krijon kurrfarë mënyre dualiste apo distance mes vetes dhe Zotit, por krijon Zotin e vet dhe i jep atij trajta të ndryshme.

Poeti bëhet një lloj ndërmjetësi mes qiellit dhe tokës, por pa qenë kurrë nën pushtetin e një zoti të vetëm, këtë e dëshmon edhe aspekti grafik (i cili është domethënës për rolin që bart në ndërtimin dhe të kuptuarit e kësaj poezie), ku në pjesën dërrmuese të rasteve fjala "Zot" shkruhet me shkronjë të vogël. Ndërsa në aspektin gramatikor, ndeshim shpesh trajtën e shumësit "Zotëra", që sërish bie në kundërshti me botëkuptimin fetar të "idesë absolute", ose të Zotit, si një dhe i vetëm, krijues i gjithçkaje në univers. Hejdeger thotë se poetët nuk janë nën pushtetin e një zoti të vetëm sepse: "... përpjekja e tyre e fundme nuk ka të bëjë vetëm me njohjen e zotave, por me zbulimin e asaj hapësire të përtejme që gjendet mbi ta."[2] Ndërsa Guardini i konsideron poetët "profetë" pasi të gjithë përçojnë vizionin poetik për botën[3]. Kështu, edhe në poezinë e Podrimjes koncepti i "Zotit" dhe elementet e tjera mistike dalin si përftesa letrare.

Përftesat poetike të Zotit

Poeti nuk i referohet Zotit në konceptin spiritual të monoteizmit, gjë që dëshmohet edhe nga përdorimi i një numri të vogël simbolesh religjioze (*bibla, djalli, ferri, varka e Noes, satanai, Nazareti, Krishti* etj.), por i drejtohet Zotit me tipare antropomorfike të besimit politeist.

Bazamenti mbi të cilin ngrihet ky koncept lidhet me frymën pagane nga njëra anë dhe me një lloj racionaliteti intelektual nga ana tjetër, gjë që dëshmohet nga tonet ironike të cilat nënkuptojnë paradokset, mungesat dhe denatyrimin njerëzor.

[2] Anxhaku, Adriana, "Homo metaphysicum dhe poezia", Tiranë, 2009, f. 85.

[3] Langenhorst, Georg, "Why theologians are interested in Literature: Theological-Literature Hermeneutics in the Works of Guardini, Balthasar, Tillich and Kuschel", *Poetry and the Religious Imagination (The power of the word)*, Edited by Francesca Bugliani Knox and David Londsdale, Heythrop College, University of London, UK, 2015, f. 31-32.

Duke iu referuar konteksteve poetike, mund të themi se koncepti i Zotit shenjohet përmes tri përftesa kryesore:

Përftesa e parë, realizohet nëpërmjet rifunksionalizimit të fjalës "Zot", ku rimerret me një kuptim të ri, në përqasje me aktualitetin. Fjala "Zot" është shenjuese jo vetëm e zotit në kuptimin hyjnor, por edhe e zotit-njeri. Kryesisht njeriu - zot është pushtuesi, i cili rrëmben lirinë, duke u bërë zotërues i jetës.

Përmasa e së mbinatyrshmes, ekstremiteti i egërsisë dhe dhunës janë tiparet më të zakonshme, me të cilat shenjohet pushtuesi. Pavarësisht niveleve që shpërqafet, si: njeri, zot apo përbindësh me fuqi të mbinatyrshme, pasojat që shkakton pushtuesi janë katastrofike dhe kjo dëshmohet në raportin që vendos me kampin mbrojtës, i cili pavarësisht qëndresës, gjithnjë gjymtohet.

Një nga poezitë që e shpërfaq qartazi konceptin tipik podrimjan të njeriut-zot është poezia "Evropa përmes grilave". Që në titull del roli i Evropës si një "Zot kokëfortë" që mbikëqyr ngjarjet politiko - shoqërore të Shqipërisë. Vështrimi përmes grilave nënkupton kundrimin në pozicion të distancuar nga ndodhitë, por edhe vështrimin fshehtas e të copëzuar. Pikërisht ky pozicion i jep mundësi që të veprojë:

forma kentaurësh po që se marrin grilat
gjak i ri duhet Evropës miku im
dhe një Zot kokëfortë
("Evropa përmes grilash", *Litari i ankthit*, f. 249)

Për nga natyra e veprimeve të saj, Evropa i përngjan përbindëshit kentaur. Ajo që fshihet pas këtyre veprimeve shkakton ankthin për qenien e rrezikuar. Grila është metonimi e sigurisë, e cila nuk është funksionale, sepse dhuna është kaq e egër, saqë nuk mund të përballohet nga asnjë masë sigurie.

Si kundërpërgjigje ndaj dhunës, kasaphanës, vrasjeve e përgjakjeve të pushtuesit-zot, qëndrojnë heronjtë kulturorë, të cilët mund të jenë hyjni (Prometeu), njerëz (Sizifi), por mund të paraqiten edhe në mënyrë të pashpirtëzuar (Torzo). Ata bëjnë veprime në dobi të jetës njerëzore, prandaj përpjekjet e tyre ndëshkohen. Bëmat e tyre heroike nuk vlerësohen, por marrin si shpërblim prova të rënda që përherë qëndrojnë në kufirin mes jetës e vdekjes. Sakrificat e heronjve kulturorë janë të ngjashme me sakrificat e njerëzve që u cënohet liria. Në motërzimet podrimjane të këtyre simboleve gjithnjë zbulojmë përmasa kuptimore të reja, që lidhen me gjendjen sociale, politike dhe psikologjike të shqiptarëve. Në thelbin e resemantizimit të heronjve kulturorë është modusi i mbijetesës në rrethana të skajshme mes jetës e vdekjes.

Përftesa e dytë, shpaloset nëpërmjet perifrazimit të funksioneve të përbërësve mistikë. Një nga këto lloj përftesash ndeshet edhe në poezinë "Kur dashurohem në fuqinë e rrufesë", në të cilën Zoti shpërfaqet përmes simbolit mitologjik të Zeusit:

Kur dashurohem në fuqinë e rrufesë
në majë të Olimpit zotin pshurr
veshin e gurit shurdhon një këmbanë e vdekshme
sytë gjarpëri m'i kërkon edhe në ëndërr

kur dashurohem në fuqinë e rrufesë
jeta gjithfarë formash merr
mbi emrin tim shi bie e bie
dhe zogjtë harrojnë të kthehen në kohën tonë

("Kur dashurohem në fuqinë e rrufesë, *Litari i ankthit,* fq.93)

Sintagma "fuqia e rrufesë" është bartëse kuptimore e mitit të kryeperëndisë Zeusit, i cili posedonte fuqinë e "administrimit" të rrufesë dhe bubullimave.

Në variantin e aktualizuar, Zeusi nuk qëndron në piedestalin e Olimpit, duke menaxhuar botën hyjnore dhe njerëzore, por vjen me një përmasë specifike. Ky invariant i simbolit të Zeusit rindërtohet mbi rrethana politiko-shoqërore që nuk shfaqen drejtpërdrejt, por ndryhen nëpër çdo grimcë të tekstit. Përkapja e fenomeneve dhe jo përvijimi e formësimi preciz i tyre, e bën shprehjen poetike të Podrimjes tejet eliptike. Karakteri mungesor shfaqet në rrethanat e papërcaktuara dhe në shenjat e pikësimit të munguara, gjë që shkakton çoroditjen nga linja e njëtrajtshme kuptimore.

Dashuria për fuqinë e rrufesë receptohet në një kënd vështrimi të përmbysur, sepse është shprehur në mënyrë ironike. Në të vërtetë, nëse do të bëjmë një dekostruksion të tekstit, fusha semantike e sememave të copëzuara nuk të çon te asnjë dashuri, por tek urrejtja, dhuna, përleshja, prirja asimiluese, denduria e sulmeve të herëpashershme, mbikëqyrja, fati i pashpresë dhe ligësia. Mjafton të përmendim disa nga përbërësit e kësaj poezie dhe depërton menjëherë në atmosferën poetike: *këmbana e vdekshme, sytë e gjarpërit, shiu* etj. Ky sistem metaforik dhe simbolik rindërton mitin e ri të Zeusit, i cili del në trajtën e përgjithësuar të pushtuesit dhe përfaqëson shkatërrimin. Metafora *sytë e gjarpërit* shënjon mbikëqyrjen, pabesinë dhe vdekjen e sigurt prej pabesisë, sepse mjeti i tij identifikues është helmi vdekjeprurës. Në analogji me figurën e gjarpërit është edhe *flaka e rrufesë,* e cila shkrepëtin pabesisht dhe përdhunisht, e vdekja prej saj është e sigurt. Kjo përqasje e tipareve funksionale midis trajtave simbolike të *gjarpërit* e *rrufesë* shkrihet brenda të njëjtës figurë, pikërisht Zeusit si kryeperëndi.

Rishfaqje të simbolit mitologjik me perifrazim, ku fjala zëvendësohet me sintagma kemi edhe për toponimin ku strehoheshin perënditë, pra Olimpin, që gjendet me sintagmën "vendi ku perënditë e rrejshëm grinden":

E perënditë e rrejshëm grinden
Kush do të ketë
Hapësirë më të madhe për varr

("Fëmija vdes në Bodrum", *Litari i ankthit*, f. 326)

Konstatimi se hyjnitë zemërohen, hakmerren e dashurohen si njerëzit nuk përbën ndonjë risi, sepse kjo është parë që tek poemat homerike *Iliada* e *Odiseja*. Mirëpo, tek poezia "Fëmija vdes në Bodrum", ku është shkëputur vargu i mësipërm, hyjnitë karakterizohen nga grindja, zilia dhe garimi për uzurpim hapësirash, sepse ato do të jenë varri i tyre, vendi i prehjes edhe në botën tjetër.

Konotacioni i kësaj poezie shpërfaq një tjetër realitet, një tjetër kohë dhe një tjetër rrethanë, sepse nuk bëhet fjalë për grindjen tekanjoze mes perëndive të Olimpit, por për një grindje më specifike mes perëndive në trajtë pushtuesi, të cilët nuk kishin fuqi sakrale, por kishin fuqi artificiale të stisur përmes karakterit të tyre agresor. Fuqia e perëndive-pushtuese rritej me zgjerimin e hartës së uzurpimit të hapësirave që nuk u përkisnin. Sa më shumë hapësira përvetësonin, aq më shumë fuqizoheshin. Me këtë logjikë është përcaktuar edhe fati i Shqipërisë, e cila u nda në pesë pjesë dhe prej saj përfituan perënditë-pushtuese. Uria e perëndive-pushtuese merr trajta faraonike, sepse grindja për hapësirën shtrihet edhe në botën e përtejme, pikërisht në varr. Përdorimi i detajit poetik të varrit e përligj faktin se nuk kemi një grindje të njëmendtë mes hyjnive të Olimpit, përderisa ato janë të përjetshme, por kemi një grindje në rrafshin njerëzor. Zënka për hapësirën në varr është përcjellës i diferencimit të fuqisë dhe pushtetit edhe në botën e përtejme, njëlloj si botëkuptimi faraonik, të cilët kërkonin të mbretëronin në të gjitha kohërat. Pas vdekjes së faraonit, trupi i tij balsamosej për t'u ruajtur nga dekompozimi dhe bashkë me të duhet të largoheshin nga kjo botë edhe shërbëtorët, kafshët e tij të dashura dhe pjesa dërrmuese e të mirave materiale. Në varret e faraonëve ka pasur raste që janë gjetur edhe anije gjigante, të dhëna këto mjaft dëshmuese për hapësirën e varrit të tyre.

Përftesa e tretë, vjen nëpërmjet krijimit të atmosferës mistike, ku transplantohen në bashkëkohësi elemente pagane. Pavarësisht se kemi të bëjmë me vargje poetike, herë pas here shfaqen reminishenca të dukurive mistike e mitologjike. Një element që përcjell atmosferën mistike është edhe simboli *maca e zezë*, i cili vjen si një ritualemë që shoqëron të gjitha hapat e jetës së njeriut, ajo dikton fatin me ngjyra fataliste e të kobshme duke dhënë parashenjat e fatkeqësisë. Këto parashenja që shenjohen nëpërmjet rrethanave të vartësisë dhe të kushtëzimit të jetës prej *dikujt* te "Maca e zezë" janë në formë alegorike. Parandjenja, parashikimi dhe predestinimi i fatit përbënin themelin e poetikës së tragjedisë greke. Këtë filozofi të artit letrar e kanë rimarrë shpesh shkrimtarë e poetë bashkëkohorë, herë si përmbysje, herë si risemantizim, por përherë si një pikënisje që të tërheq, me synim të qartë apo në trajtë të pavetëdijshme. Kjo fuqi e krijuesit për të parandjerë, e figurës për të përçuar dhe e marrësit për të njohur përmes leximit të kodit ishte një dukuri e njohur në antikitet.

Kuptimi i parë i sintagmës "maca e zezë", *si një kafshë shtëpiake me ngjyrë të zezë,* përbën një izotopi të thjeshtë, sepse te kjo strukturë semantike nuk mund të shtresëzohen apo mbivendosen njësi të tjera të teksit. Për këtë arsye, sintagma "maca e zezë" aksiologjizohet, duke u veshur me vlera, përmes një kategorie specifike që

Greimasi e quan kategoria timike. *Maca e zezë* është një lloj stereotipi kulturor, që ka karakter përgjithësues. Sipas mendësisë popullore, kur të del përpara në rrugë një mace e zezë, atëherë kjo është një shenjë e keqe. Macja e zezë paralajmëron dhe parathotë keqvajtjen e punëve. Në kulturën mesdhetare macja e zezë shpreh errësirën, vdekjen dhe të keqen.

Në poezinë e Ali Podrimjes, macja e zezë jo vetëm i ka dalë në rrugë subjektit lirik, por edhe e ndjek pas në udhëtimin e tij të jetës, duke i paracaktuar keq gjithcka. Ajo e ndjek subjektin lirik tërë jetën, që nga lindja. E ndjek këmba-këmbës, duke i diktuar edhe orën e fatit, pra ka në dorë edhe fijet e fatit të subjektit lirik. Macja e zezë sjell me vete rrezikun dhe pasigurinë, është fuqi e errët, që lajmëron kobin e fatkeqësinë. Ky kontekst ndërtohet përmes konotatorëve homogjenë që të çojnë në dy rrafshe izotopike: 1. Rrafshi i tentativës dhe rrafshi i dështimit. Këto rrafshe përftohen përmes kriterit bazë të leximit të izotopive, që është zgjedhja e elementeve që marrin pjesë në tekst, duke analizuar tiparet kontradiktore të tyre, ose marrëdhëniet kundërvënëse që krijojnë mes tyre izotopitë:

- Udhëtimi/ maca e zezë
- Kënga/ s'do këndosh
- Drita/ i verbër
- Ëndrra/ zhgjëndërr
- Dashuron/ urren

Kundërvënia e këtyre izotopive nuk vendos në raport antagonist thjesht dy sekuenca sintaksore, por sheston të nxjerrë në pah dy ndjesi dhe dy mendësi të ndryshme. Raportet antonimike të semave të tekstit ngrihen mbi opozicionin mes **tentativës** së subjektit lirik për të vazhduar udhëtimin dhe **dështimit** të përpjekjeve të tij, për shkak të parandjenjës që e ka kapluar nga parashenjat fatkeqe sinjalizuese, nëpërmjet maces së zezë. Pasojat e përndjekjes nga macja e zezë përftohen nëpërmjet kundërvënieve të dy boshteve kryesore: boshtit të tentativës dhe boshtit të dështimit, që paraqiten përmes situatave:

Boshti i tentativës (Parandjenja)	**Boshti i dështimit**
shpirti më thotë	në gjysmë rruge ke për të mbetur
kënga më thotë	kurrë s'do t'më këndosh me zë
drita më thotë	i verbëri i verbër ka mbetur
ëndrra më thotë	më kërko në zhgjëndërr

Këto dy boshte ecin paralelisht me njëri-tjetrin dhe nuk takohen në asnjë pikë, sepse sa më shumë shestojnë të pranëvihen, aq më shumë rritet raporti i antagonizmit ndërmjet tyre. Të gjitha tentativat e subjektit lirik, që shprehin vitalitetin dhe vijimësinë

e jetës (shpirti, kënga, drita dhe ëndrra), rezultojnë të dështuara, për shkak se përcjellin zymtësinë, mosveprimin, errësirën dhe botën e hiçit (në gjysmë rruge, kurrë s'do t'më këndosh me zë, i verbër ka mbetur dhe zhgjëndrra). Kundërvëniet e këtyre dy boshteve nxjerrin në pah gjendjen fizike, psikologjike e shpirtërore të qënies njerëzore që përndiqet dhe shantazhohet në çdo hap.

Në të trija llojet e përftesave, koncepti mistik vjen me një nënshtresë të re kuptimore, e cila në çdo përdorim letrar mbart një larmi interpretimesh. Analiza e disa prej poezive të autorit na dëshmoi se prania e konceptit të Zotit nuk vjen aq si një përpjekje për të prekur a ndjerë prezencën e tij sesa si një trajtë që shpërfaq raportet ekzistenciale të individit me mikro dhe makromjedisin.

Literatura mbështetëse

Anxhaku, Adriana, "Homo metaphysicum dhe poezia", Tiranë, 2009.

Campbell, Joseph. *The Power of Myth*, Anchor Ediction, Toronto, Canada, 1991.

Could, Eric. *Mythical Intentions in Modern Literature*, Princeton University Press, USA, 1981.

Hugo, Friedrih. *The structure of modern poetry (From the Mid-Nineteenth to the Mid-Twentieth Century),* Northwestern University Press, Evanston, USA (Translation is based on the revised German edition of 1967), 1974.

Jakobson, Roman. *Selected Writings: Poetry of gramar and gramar of poetry*, Mouton Publishers, Printed in Netherlands, 1981. (ed. Stephen Rudy. MOUTON PUBLISHERS The Hague, Paris, Mouton, in six volumes 1971–1985).

Langenhorst, Georg, "Why theologians are interested in Literature: Theological-Literature Hermeneutics in the Works of Guardini, Balthasar, Tillich and Kuschel", *Poetry and the Religious Imagination (The power of the word)*, Edited by Francesca Bugliani Knox and David Londsdale, Heythrop College, University of London, UK, 2015.

Podrimja, Ali. *Litari i ankthit,* TOENA, Tiranë, 2002. (Me përzgjedhjen dhe parathënien e Prof. dr. Bashkim Kuçuku).

Topsett, Daniel, "Poetry and religion", *Wallance Stivens and Pre-socratic Philosophy*, Rouledge Taylor& Francis, London, 2002.

Jolanda LILA

CONCEPTOF THE "OTHER" IN ALIPODRIMJA'S POETRY

Abstract

Given that poetry of Ali Podrimja was created in Kosovo, mainly under Serbian nationalist censorship, in the center of it, is the risk of the collapse of identity from "the other". The poetry of Ali Podrimja marks the existential crisis of personal and national identity,as well as the insecurity, terror and anxiety of living under the tragic circumstances created becauseof the invaders.

The Parable of the other, the invader on our case, revels in several forms,which are sometimes marked directly through stylistic figures (mostly metaphors and symbols) and sometimes implied by the consequences that it has left.

Even if, logically, has no consequence without a cause, "the other" even is implicited,is the primary (or essential) and determines the consequence.

There is a whole set of semantic fields that have a common functional denominator:the risk of dissolving the cultural, political and national essences,from the constant pressure of aggressive and chauvinistic politics, on one hand,as well as the disclosure of a range of our internal weaknesses, on a political and cultural level, on the other hand.

The lyrical subject is always in relationship with the "other", but this relationship is not in equilibrium between each and the other, but is entirely conditionedby historical circumstances.

Conditionality goes to the degree of acquisition of the identity of the lyricalsubject and assuming it as their ownand naming them as their own.So parts of yourself become parts of the otherand in this way, arises the need for self-regeneration.

Thus, Podrimja builds the map of ethnic Albanian poetically,by unifying the most extreme Albanian lands,through the use of toponyms and hydronyms with the value of historical symbols: *Arta, Preveza, Shkodra, Janina, Iliria, Atlantida, Vaterllo, Drini, Buna, Joni, Ohri, Varda*rietc.

The parable of ethnic - homeland is obtainedeven through symbols who are building from the basis of historical figures, such as*Sulltani, MbretiDioklecian, Skënderbeu, Ali Pasha, FotoXhavella, MarkoBoçari, Bubulina, Teuta, Genti etc.* This parable is outline furtherthrough historical dates transformed into symbols for ethnicity, like the years:*1978, 1913, 1981, 1982, 1924, 1945, 1992,*which means important juncture in the history of the Albanian nation.

These components, which are not just geographic or historical signs,but are genuine symbols with archetypal function,create a clear background for the interpretation of the concept of "the other", as object and subject.

Key words: poetry, identity, conflict, parable of the other

Jorida SOTIRI

GJENERIMI I JETËS NJERËZORE NË KUSHTËZIM TË LISIBILITETIT QYTETËS

Abstrakt

Autorët modernistë e paraqitin shoqërinë me problemet e mprehta të saj nëpërmjet personazhit tip, mbartës i mendësive dhe i prirjeve më konfliktuese të saj, zakonisht në kundërvënie me mjedisin tradicional. Eksterierët dhe interierët e Parisit, Londrës, Nju-Jorkut, të përshkruar mjeshtërisht me të dhëna të shumëllojshme, janë në funksion të personazhit për zbulimin e tipareve të theksuara të tij.

Heronjtë e shëmbëlltyrës njerëzore në letërsi krijojnë shëmbëlltyrën e vet edhe kur fati përcaktohet nga gjithëfuqishmëria e mjedisit. Në këtë drejtim letrar, kahu i mendësisë së personazhit është drejtuar nga qyteti, duke vënë në dukje "*një qytet modern të madh që ka funksionin dhe vlerën e personazhit*" , të atij qyteti ku "*mjedisi i personazhit, në veçanti shtëpia e tij, mund të shihet si shprehje metonimike, ose metaforike e karakterit të tij. Shtëpia është vazhdim i njeriut.*"

Në këtë logjikë mund të shikohet edhe qyteti, shumësia e gjithë shtëpive, bëhet vazhdimësi, shprehje metonimike dhe metaforike e këtyre personazheve. Ky lloj interieri, duke përshkruar personazhin metonimikisht, nënkupton gjendjen e brendshme psiko-shpirtërore. Pikërisht nga ky rrafsh ku njësohet përshkrimi i këtyre autorëve me rrëfimin, edhe qytetin, nga mjedisi i interierit, krijohet personazhi.

Personazhet që na paraqiten në vepër nuk janë shëmbëlltyra kanunore, por shëmbëlltyra e qytetit. "*Antropomorfizues i qytetit të veriut është vlerësues, sepse bëhet i afërt e i njashëm, komunikues e ndihmues i heroit rrëfimtar.*" Qyteti-simbol i jetës njerëzore merr tipare njerëzore, ndërsa shëmbëlltyra njerëzore shndërrohet në simbol. Valeri, me emrin "qytetërim" karakterizon një gjendje domethënëse: *"Banori i qendrave të mëdha qytetare po kthehet përsëri në gjendjen e egërsisë, të themi të vetëveçimit. Ndijimi i të qenit i varur prej të tjerëve , ndaj të cilëve lypset të jesh kudoherë syçelur, topitet dalëngadalë në rrjedhën e qetë të mekanizmit shoqëror, çdo përsosje e këtij mekanizmi nxjerr jashtë përdorimit mënyra sjellje, emocione të caktuara... komforti të veçon.*"

Modernizmi kërkon personazhe me *përgjegjësi qytetare dhe shoqërore*, ku në gjykimin e Mishel Fukosë njeriu shihet *"si ndërgjegje epistemologjike e vetvetes"*. Nën këtë ndikim ndodhet personazhi i cili ka sunduar mendimin perëndimor qysh nga fillimet e tij. *"Melankolia moderne"* shfaq tensionin e papërballueshëm të kërkesave të shoqërisë në

drejtime të ndryshme. Personazhet me termat e një utopie "përtej jetës" janë përherë në kërkim të një qytetërimi modern, të një lëvizje qytetëse.

Fjalët-çelës: *Personazh, lisibilitet, urbis, lëvizje, qytetërim, modernizëm.*

"*Po tregoj ngjarje të vërteta, duke ditur se po i flas një brezi shumë mendjemadh , e që për citat ka fjalët e Pilatit: Cila është e vërteta?"*

Jeronim De Rada

Autorët modernistë e paraqitin shoqërinë me problemet e mprehta të saj nëpërmjet personazhit tip, mbartës i mendësive dhe i prirjeve më konfliktuese të saj, zakonisht në kundërvënie me mjedisin tradicional. Eksterierët dhe interierët e Parisit, Londrës, Nju- Jorkut, të përshkruar mjeshtërisht me të dhëna të shumëllojshme, janë në funksion të personazhit për zbulimin e tipareve të theksuara të tij.

Heronjtë e shëmbëlltyrës njerëzore në letërsi krijojnë shëmbëlltyrën e vet edhe kur fati përcaktohet nga gjithëfuqishmëria e mjedisit. Në këtë drejtim letrar, kahu i mendësisë së personazhit është drejtuar nga qyteti, duke vënë në dukje "*një qytet modern të madh që ka funksionin dhe vlerën e personazhit*"[1], të atij qyteti ku "*mjedisi i personazhit, në veçanti shtëpia e tij, mund të shihet si shprehje metonimike, ose metaforike e karakterit të tij. Shtëpia është vazhdim i njeriut.*"[2]

Në këtë logjikë mund të shikohet edhe qyteti, shumësia e gjithë shtëpive, bëhet vazhdimësi, shprehje metonimike dhe metaforike e këtyre personazheve. Ky lloj interieri, duke përshkruar personazhin metonimikisht, nënkupton gjendjen e brendshme psiko-shpirtërore. Pikërisht nga ky rrafsh ku njësohet përshkrimi i këtyre autorëve me rrëfimin, edhe qytetin, nga mjedisi i interierit, krijohet personazhi.

Personazhet që na paraqiten në vepër nuk janë shëmbëlltyra kanunore, por shëmbëlltyra e qytetit. "*Antropomorfizues i qytetit të veriut është vlerësues, sepse bëhet i afërt e i ngjashëm, komunikues e ndihmues i heroit rrëfimtar"*[3] Qyteti-simbol i jetës njerëzore merr tipare njerëzore, ndërsa shëmbëlltyra njerëzore shndërrohet në simbol. Valeri, me emrin "qytetërim" karakterizon një gjendje domethënëse: *"Banori i qendrave të mëdha qytetare po kthehet përsëri në gjendjen e egërsisë, të themi të vetëveçimit. Ndjimi i të qenit i varur prej të tjerëve , ndaj të cilëve lypset të jesh kudoherë syçelur, topitet dalëngadalë në rrjedhën e qetë të*

[1] KUÇUKU, Bashkim, "Qyteti-personazh, përftesë e modernitetit bashkëkohor", në *Letërsia dhe qyteti*, akte të konferencës shkencore, Fakulteti Histori-Filologji , Tiranë, 2009, faqe 83.
[2] WELLEK Rene & WARREN, Austin, *Teoria e letërsisë*, përkth. Abdurrahim Myftiu, Onufri, Tiranë, 2007, faqe 207.
[3] KUÇUKU, Bashkim: "Qyteti-personazh, përftesë e modernitetit bashkëkohor", në akte të konferencës shkencore *Letërsia dhe qyteti*, Fakulteti Histori-Filologji , Tiranë, 2009, faqe 87.

mekanizmit shoqëror, çdo përsosje e këtij mekanizmi nxjerr jashtë përdorimit mënyra sjellje, emocione të caktuara... komforti të veçon."[4]

Modernizmi kërkon personazhe me *"përgjegjësi qytetare dhe shoqërore"*, ku në gjykimin e Mishel Fukosë njeriu shihet *"si ndërgjegje epistemologjike e vetvetes."*[5] Nën këtë ndikim ndodhet personazhi i cili ka sunduar mendimin perëndimor qysh nga fillimet e tij. *"Melankolia moderne*[6]*"* shfaq tensionin e papërballueshëm të kërkesave të shoqërisë në drejtime të ndryshme. Personazhet me termat e një utopie "përtej jetës" janë përherë në kërkim të një qytetërimi modern, të një lëvizje qytetëse.

Shëmbëlltyra të tilla në letërsinë shqipe janë personazhet e Koliqit, shkrimtar i formuar në Perëndim, me filtrin intelektual, nëpërmjet të cilit ai e kalonte realitetin njerëzor shqiptar, ishte filtri i një njeriu që kishte koncepte euro-perëndimore të qytetërimit dhe të zhvillimit. Dante, Petrarka, Ariosto etj., janë emra që kishin hyrë thellë në formimin e tij. Simbolizmi europian, sidomos ai danuncian, kishte formuar shijet e tij artistike. Modernizmi i prozës së Mopasanit, Floberit, Prustit etj., i dhanë format dhe strukturat ku Koliqi derdhi një përmbajtje shqiptare.

Personazhi i Koliqit, ashtu si i Prustit, është i shqetësuar për të tashmen e tij, gati-gati preket nga ndjenja e kotësisë. Koliqi e jep personazhin si një vëzhgues indiferent të së tashmes, me admirim për një të kaluar që vetëm humb. Personazhi i Koliqit sheh shpëtimin e ndërgjegjes së vet, vetëm në kujtimet e largëta. Të njëjtën gjë bën edhe Prusti në veprën "Në kërkim të kohës së humbur".

Koliqi mundohej ta bënte të lexueshëm realitetin shqiptar për sytë europianë; ai njihte kodin perëndimor të vlerësimit dhe e quante si njësinë më të përshtatshme, me të cilët matet një qytetërim i vërtetë.

Koliqi e vështron botën në mënyrë krejt të lirë dhe në një zhvillim burimor e të natyrshëm, si në rrafshin ekzistencial, ashtu edhe në atë filozofik. Nëpërmjet rrëfimit artistik ballafaqohen realitete konkrete, psikologjike dhe mitike, probleme, ndjesi, mëdyshje, shqetësime. Ballafaqohet individualja me kolektiven, e kaluara me të tashmen, e vjetra me të renë. Këto realitete, para së gjithash, ai lidh me botën shkodrane. Ai veçon çështje të rëndësishme, që rrezatojnë kuptimësi të shumta; që simbolizojnë botën shqiptare në përmasa shumë të gjera e të thella. Koliqi, me prozën e vet, krijoi një realitet artistik të pavarur, i cili ekziston e funksionon nëpërmjet strukturës tekstore, gjuhës artistike dhe mesazhit artistik.

Pas tij, në letërsinë shqipe, në kërkim të lisibilitetit qytetës vjen Migjeni, që me personazhin e tij, godet atë që ngjante më e paprekshmen. Mendësia kanunore kishte shpallur koncepte të tilla si burrnia, nderi, besa, si rruaza të gjerdanit arkaik. Duke i përjetuar ato jashtë çdo konteksti shoqëror, duke i idealizuar e thurur himne në luftën

[4] BENJAMIN, Walter, "Mbi disa motive te Bodler", *në Iluminacione*, përkth. Afrim Koçi, Korbi, Tiranë, 1977, faqe 205.
[5] Po aty, faqe 200.
[6] Melankolia e personazhit është një ndër tiparet kryesore të letërsisë modern.

ndaj përparimit dhe emancipimit të njeriut shqiptar. Malësori shqiptar shkatërronte jetën e tij dhe të tjetrit për një thyerje rregullash kanunore, duke mbetur si i mpirë *"si i shituar nga zana"* përpara hijes së nëpunësit civil. Personazhi i tij zhytet në mjerimin e përditshëm material e shpirtëror. Te novela "Studenti në shtëpi" Migjeni tregohet realist deri në detaj. Ai i hedh dorashkat qytetit dhe gjithë shoqërisë, sfidon moralin zotërues, sfidon të ashtuquajturat virtyte të shqiptarit, ngre notat e së vërtetës, çjerr maskën që mban qyteti në fytyrë. Kjo çjerrje mban uturimën e një orteku. Agia është një vajzë shumë e bukur. E martuan që me kërkesën e parë. Kështu ishte zakoni në përgjithësi. Ajo vetë nuk e dëshironte këtë martesë, por as që bëhej fjalë të ngrinte krye kundër saj. Do të shkonte në vend vullnet i të atit. I pari që e nuhati qysh në fillim se Agia nuk e donte burrin, madje që ajo ishte dyzuar në jetën bashkëkohore, qe Nushi, vëllai i saj. Ai i dha të kuptonte të atit që motra nuk e donte personin me të cilin e kishin fejuar, por u mjaftua me kaq. Qe i paaftë për kryengritje. Botëkuptimi i ri që pat fituar në Europë mund t`i thyente kokën, në qoftë se do të përplasej me pseudomoralin e shoqërisë. Atëherë edhe ai u fut vullnetarisht, madje me dëshirë, në ballon me maska që luante gjithë qyteti. Unë nuk pajtohem me moralin që ma imponon shoqëria. Unë e marr atë sa për sy e faqe, kurse prapa e kundërshtoj kur të dua. Kështu si unë e kundërshtojnë me qindra veta. Prandaj, shoqëri e dashur, po deshe të mos lozin në kurrizin tënd, ndërro format. Hiqi brekushet!

Titulli i kësaj novele është bartëse e një traktati etiko-moral, me gjuhën e artit. Në të ndihet përpjekja për ta bërë këtë. Por gjithsesi është një "*kambanë që bie, që lajmëron se ka ardhur koha që dikush duhet të largohet nga bota shqiptare*".[7] Në prozën "Legjenda e Misrit" "*Malësori legjendar bëhet njeri i vogël përpara rrezikut të ekzistencës*[8]". Lëvizja qytetëse në vendin që ushqehej me legjenda të Perëndive tani kthen në legjendë fjalën "misër", si elementin primar të lindjes, jetës, vdekjes. Te personazhi i Lukes është ndërtuar "*presioni jetësor në personazhin letrar*[9]". Ajo përshkruan trajektoren e lëvizjes nga Malësia drejt qytetit, ku kupton shumë shpejt edhe filozofinë e jetës së tij. Por "*lakuriqësia banale*" e këtij qyteti i thyen ëndrrën këtij personazhi të kushtëzuar nga e shkuara e errët. Shpresa nuk e pret as në të ardhmen qytetëse.

Më tej, këtë trajektore drejt qytetit e gjejmë të shfaqur në romanin "Pse?!", ku personazhi na rrëfen jetën e tij. Ky rrëfim i takon tipit retrospektiv-autobiografik. Si formë, ditarit të improvizuar. Rrëfimi, megjithatë është i menduar mirë. Në këtë mënyrë, Spasse ka konsideratë për lexuesin, prandaj vë në funksion formulime hyrëse, të cilat paralajmërojnë një situatë tjetër. Ai sjell copa kujtimesh, rrëfimesh, bisedash që marrin dimensionet e një mozaiku të teksteve të diskursit, të cilat funksionojnë në vepër krejt natyrshëm. Rrëfimi dhe ligjërimi kthehen në dëshirë te autori. "*Ai na krijon*

[7] ÇAUSHI, Teki, "Pudra e një morali", *në Klubi i Personazheve* , Tiranë, 2000, faqe 40.
[8] HAMITI, Sabri, *Letërsia moderne shqipe*, Maluka, Tiranë, 2009, faqe 395.
[9] Po aty, faqe 407.

një sistem ngjarjesh që i përmbahen rendit të rrëfimit, sipas skemës: të informohesh, të pohosh, pastaj të rrëfesh."[10]

Gjon Zaveri është njeri jo i zakonshëm. Ai është simbol i të riut intelektual. Ai vihet përballë një ambienti të zakonshëm tipik shqiptar. Prindërit ndikojnë mbi intelektin e këtij të riu duke e fejuar me vajzën e katundit, të cilën nuk e do. Për të plotësuar këtë normë familjare ai martohet me të, duke u përpjekur të krijojë rregullat kanunore të jetës. Në jetën shpirtërore të tij, ngrihet çrregullimi, formohet shkallë-shkallë tragjedia që çon në vetëvrasje. Zaveri e mohon një shoqëri të tërë, duke kërkuar format e saj të reja, të pajtueshme me dëshirat e me lirinë e njeriut. Në letrën e fundit para se të vetëvritej, Zaveri e radikalizon kritikën e vet; kritikon dhe rrënon edhe filozofët, duke e shpallur edhe jetën e vet të gabuar, ashtu si edhe hapin e fundit. Po në këtë pikë ai sikur njeh vlerat e jetës, duke e parë në sy fytyrën e vdekjes. Mendimi i tij se filozofët me ide të tyre vrasin shumë njerëz, kurse individi mundet me gjestin e vet të bëjë vetëm një të keqe, është akuza dhe vetakuza më e rëndë. Mirëpo Zaveri në fund imagjinon një jetë tjetër, që do të mund ta jetonte, një jetë individuale e njerëzore, krejt të ndryshme nga ajo që ka jetuar një herë. "*Ky himnizim i jetës tjetër merr format e fantazisë së të humburit: Po lëvizja mendore?- pyet trishtueshëm Zaveri. Asgjë për këto s`po bëhet... A thua ka kuptim jeta e këtij qyteti? Pyetja e pafajshme e Gjon Zaverit është një nga pyetjet më të rëndësishme në konceptimin e thelbit të qytetit. Gjenerimi i lëvizjes mendore dhe i jetës kulturore do të duhej të kushtëzonte lisibilitetin e qytetit si të tillë. Kuptimësia e tij zbehet në mënyrë të tyre, shenjat qytetëse nuk kuptimësohen në kuptim të konceptit antologjik të qytetit, të jetuarit në të i afrohet gjallimit, thelbi i qytetarit zbehet e shkon kah mediokriteti. Gjon Zaverit nuk i mbetet atëherë veçse të largohet prej skeletit të një qyteti, a po thënë ndryshe të një klisheje qytetëse*."[11]

Qyteti është "ankthi ekzistencial" që i rrezikon seriozisht personazhet, duke i kthyer në vetmitarë, apatikë, pasivë, indiferentë, cinikë, të pushtuar nga kotësia e ekzistencës.

Nën dhunën e këtij ankthi ekzistencial, personazhet herë janë të mjerë, herë fatkëqij, herë shpresëhumbur, herë vetëvrasës, herë të dështuar në jetë, herë të palumtur, herë të dyzuar, me disa identitete, të lëkundur, të pakuptueshëm.

Duke theksuar edhe më tepër idenë e autorit në krijimin e personazhit letrar: "Personazhi në veprën e këtyre autorëve vendoset në vektorin qytet-fshat. Por ata nuk mund të dalin dot nga vetvetja, të shkruajnë për ato që nuk ua sygjeron përvoja e tyre, që nuk janë në natyrën e përjetimeve të tyre."[12] Por përvoja i drejton e sugjeron këto personazhe pa shpresë për të ardhmen, duke kërkuar prehje në të kaluarën e tyre. Por

[10] GASHI, Agron Y., *Autopoetika (Modelet narrative autobiografike),* Faik Konica, Prishtinë, 2009, faqe 69.
[11] ASLLANI, Persida, "Ndërtimi letrar i Qytetit në letërsinë moderne", në akte të konferencës *Letërsia & qyteti*, Fakulteti Historisë e Filologjisë, Tiranë, 2009, fq. 103.
[12] PRENDI, Arben, *Tekste në kontekste*, Naimi, Tiranë, 2011, faqe 144.

bota ku përplasen është përfundimisht e padrejtë dhe shikimi nga QYTETI NUK I SHPËTON DOT MË.

Bibliografia

ÇAUSHI, Teki, "Pudra e një morali", në *Klubi i Personazheve*, Tiranë, 2000.
HAMITI, Sabri, *Letërsia moderne shqipe*, Maluka, Tiranë, 2009.
GASHI, Agron Y., *Autopoetika (Modelet narrative autobiografike),* Faik Konica, Prishtinë, 2009.
KUÇUKU, Bashkim, "Qyteti-personazh, përftesë e modernitetit bashkëkohor", në akte të konferencës shkencore *Letërsia e qyteti*, Fakulteti Histori-Filologji, Tiranë, 2009.
BENJAMIN, Walter, "Mbi disa motive te Bodler", *në Iluminacione*, përkth. Afrim Koçi, Korbi, Tiranë, 1977.
ASLLANI Persida, "Ndërtimi letrar i Qytetit në letërsinë moderne", në akte të konferencës *Letërsia & qyteti*, Fakulteti Historisë e Filologjisë, Tiranë, 2009.
PRENDI, Arben, *Tekste në kontekste*, Naimi, Tiranë, 2011.

Jorida SOTIRI

HUMAN LIFE GENERATION UNDERSTANDING LITERATURE OF CITIZENS

Abstract

Modernist authors present the society with its sharp problems through the tip character, the bearer of minds and the most conflicting tendencies, usually in opposition to the traditional environment. The different characters of Paris, London, New York, neatly depicted with diverse information, are in the function of the character to reveal its highlighted features. Heroes of the human image in literature create their own image even when destiny is determined by the omnipotence of the environment. In this respect, the literary character of the character's mind is directed by the city, pointing to *"a modern city that has the function and value of the character" of that city where "the character environment, in particular his home, can is seen as a metonymic or metaphorical expression of his character. House is a continuation of man"*. In this logic can be seen the city, the proximity of all houses, continuity, metonymic and metaphorical expressions of these characters. This type of inner describing of the character metonymically means the inner psycho-spiritual state. Exactly, from this plane where the description of these authors with the confession, and the city, from the interior of

the interior, is created the character. The characters that appear in the work are not the canonical but the different part of the city. *"The anthropomorphicator of the northern city is appreciative because it becomes close, similar, communicative and helper of the confessing hero"*. The city-symbol of human life assumes human traits, while the human image is transformed into a symbol. Valery's name "civilization" characterizes a significant state of relations "*The resident of large civic centers"* - he writes - is returning to the wild state, say self-extradition. The sense of being dependent on others, to whom it is necessary to be ever-urgent, is slowly ignited in the smooth flow of social mechanism; any perfection of this mechanism puts an end to the behavior of certain emotions, the confusion of separation. Modernity requires characters with *"civic and social responsibility"* where in the judgment of Michel Fuko we see man *"as his epistemological conscience" Under this influence is the character who has ruled Western opinion ever since its inception. "Modern Melancholy"* displays the unbearable tension of the demands of society in different directions. Characters with the terms of a *"beyond life" utopia* are always in search of a modern civilization, a civic movement.

Key words: Character, Liability, Urbis, Movement, Civilization, Modernism, etc.

Meliza KRASNIQI

SERAFINA TOPIA - BOTA E SAJ TJETËR

Koncepti i "tjetrit" është mjaft kompleks dhe është e vështirë të identifikohet saktë domethënia e tij. Sipas Michel Foucault, koncepti i tjetrit është i lidhur ngushtë me fuqinë dhe diturinë. Tjetri është individi i cili perceptohet si i ndryshëm nga grupi që nuk i përket. Çdo i huaj bëhet tjetër. Për më tepër tjetri merr forma të shumta, si: identitet, racë, gjini, religjion, klasë shoqërore, ideologji politike, origjinë etj.

Simone de Beauvoir fut nocionin "e tjetrit" me analizën filozofike te *Seksi i dytë* (1949), si ndërtim që kundërshton dhe në këtë mënyrë ndërton "vetën"; mandej koncepti i "tjetrit", "tjetërsimit", dhe "të qenit ndryshe" është përhapur në fushën e mendimit dhe të shqyrtimit në shumë shkenca e edhe në shkencën e letërsisë. Megjithatë dihet se ky koncept nuk ishte ide krejtësisht e re, por ishte i ndikuar prej dialektikës së Hegelit.

Në letërsi tjetri është figurë e zakonshme. Këtë koncept mund ta njohim në gjithë letërsinë shqipe, në forma të ndryshme, sepse ajo është e krijuar mbi bazën e këtij koncept.

Studiuesit të cilët merren me strukturalizmin, post-strukturalizmin, feminizmin, marksizmin, dhe metodologji të tjera të cilat varen nga "kundërshtitë binare" shpesh shqyrtojnë vepra ku personazhet janë krijuar duke u thirrur në ndonjë retorikë të "tjetrit." Për të kuptuar konceptin e tjetrit te *Serafina Topia* e Jeronim de Radës është përdorur kjo qasje formale (e opozicionit binarë) e cila ndihmon të kuptojmë si janë formuar dhe si janë krijuar kuptimet në tekst.

Personazhi i *Serafina Topisë* mund të dallohet që në titull se është diferencuar nga personazhet e papërshtatshme që janë të përfaqësuar si "të tjerë" nga norma e dhënë nga De Rada për lexuesit e nënkuptuar të veprës. Ne do ta kuptojmë botën e saj "tjetër" nëpërmjet kundërshtive.

De Rada e shkroi "Serafina Topinë" që prej vitit 1838, këngët e saj i botoi në katër variante, në poemat "Skënderbeu i pafat", "Katër histori", "Këngët e Serafina Topisë" dhe "Një Pasqyrë e shtegtimit njerëzor."

Poema është e ndarë në katër libra, çdo libër përbëhet nga një numër i ndryshëm rrëfimesh, çdonjëra prej të cilave përmban disa këngë, serenata a rima të vëna në gojën e Serafinës, Bozdarit dhe Dukagjinit. Përkatësisht Libri i Parë përmban Kent'k e Serafinës dhe gjashtë rrëfime, Libri i Dytë përmban shtatë rrëfime, Libri

u tretë përmban pesë rrëfime, Libri i katërt përmban Këngën e Serafinës, pesë rrëfime dhe testamentin e Serafinës.

Që prej botimit të poemës, Serafina Topia ka qenë objekt i analizave të ndryshme letrare e kritikave. Tema e dashurisë këtu si e tillë si temë e marrëdhënies së pushtetit dhe ndarjes së roleve tradicionale gjinore janë në qendër të kësaj vepre dhe duke paraqitur dhe analizuar këto tema do të argumentohet se protagonistja jonë, Serafina, është tjetër. Ajo qartëson atë se çfarë është parë tradicionalisht karakteristikë e sjelljes së femrave dhe sfidon rolin gjinor të vendosur gjatë duke humbur kontrollin mbi fatin e saj dhe jetën e saj.

Serafina Topia është dukeshë e Artës dhe e Himarës, ajo bie në dashuri me Bozdarin nga dera e Stresëve. Mirëpo kjo ishte një dashuri e pafat, jo vetëm se Serafina ishte fejuar me Nikollë Dukagjinin, princin e Zadrimës, por edhe për shkak të një hasmërie të vjetër mes dy familjes Topia dhe Stresi. Dashuria mes dy të rinjve mbetet e fshehtë.

Tema pra është romantike dhe gërshetohet dashuria ndaj të zgjedhurit/zgjedhurës me dashurinë ndaj atdheut, Serafina Topia sakrifikon dashurinë ndaj Bozdarit, nipit të Skënderbeut dhe martohet me Nikollë Dukagjinin duke e respektuar fjalën e prindërve se kjo martesë do të ndihmonte në bashkimin e forcave kombëtare kundër armikut.

Analiza është e ndarë në seksione që përfaqësojnë kundërshti të ndryshme binare, janë përdorë katër grupe binare për të nxjerrë në pah Serafina Topinë tjetër.

Dyshja fillestare binare e trajtuar është:

Tjetërsia gjinore grua/burrë

Identifikimi i këtij tjetërsimi lidhet me anë të narratorit apo drejtpërsëdrejti. Ajo është "abject" sipas fjalëve të Julia Kristev-ës, e vënë midis kufirit të gjuhës dhe jetës sociale.

Theksohen tiparet dhe karakteristika që tradicionalisht janë lidhur me binomin burrë/grua përkatësisht duke analizuar se si Serafina Topia është larg pritjeve tradicionale të vendosur për gratë, posaçërisht për gratë e asaj kohe; sepse sipas iluzionit të De Radës kjo poemë ishte fragment i këngës arbëreshe i një poeme tjetër të moçme mbi Skënderbeun rrjedhimisht ishte shkruar në vitet 1442-1468.

Kundërshtitë binare këtu janë përcaktuar zakonisht si struktura semantike të kuptimeve të kundërta brenda të cilëve një fjalë nga pala përforcon konceptin tonë për tjetrin. Do të përpiqemi të shpjegojmë udhëtimin jetësor të Serafinës drejt vetë kontrollit dhe pavarësisë.

Ky parim i kontrastit ndërmjet dy termeve reciprokisht përjashtues është një koncept i rëndësishëm i lëvizjes intelektuale të referuar si strukturalizëm, e cila pabarazitë e tilla i percepton si thelbësore për gjithë gjuhën dhe mendimin.

Serafina Topia është një nga figurat femër më të dashura dhe më të plota të galerisë deradiane. Tek ajo, më shumë se te çdo figurë tjetër, De Rada, ka mishëruar

shumë ndjenja e mendime të veta. Për të theksuar dhe për të përcaktuar traditën grua/burrë është aplikuar një këndvështrim struktural në vepër duke sjellë temat kryesore. Karakteri qendror i paraqitur në emër të Serafina Topisë, duhet të vihet në diskutim për arsye të raportit të saj ndaj kohës, ajo është heroinë që përfaqëson patriotizmin, humanizmin, ajo është romantike. Por personazhi i saj është figurë moderne, duke e përshkruar atë si vajzë e grua të emancipuar, me pikëpamje iluministe e demokratike, që nuk na jep shkak të besojmë se mund të formohej në ato kushte shoqërore që jep vepra.

Gjithënjë lexon, bija ime,
Si një murg, mbyllur, andaj...
(Kënga e Tretë, Libri i Parë)

Serafina jepet si një intelektuale që lexon shumë, leximin ia kishte mësuar i ati, ndanë kësaj ajo paraqitet edhe si poete. *Kënga e Serafinës* i atribuohet asaj.

Andaj si te Serafina dhe te personazhet e shumtë të tjerë De Rada fsheh anësitë e veta dhe në poemë dëgjojmë shumë zëra, që bashkohen në kor, e aty ndahet Serafina Topia tjetër për të thënë e për të shprehur diçka që zbulon anën e saj tjetër e ndryshe për jetën, për shpirtin njerëzor dhe qëndrimin ndaj atij realiteti.

Serafina dhe dashuria e saj ndaj Bozdarit, e bën atë figurën e parë të madhe tragjike në letërsinë shqipe. Ajo ngrihet para kohe kundër një bote zakonesh, interesash e mentalitetesh, që shtypnin zemrat e grave e të vajzave dhe i bënin ato rob të kohës. Ajo është personazh tjetër, botë tjetër dhe e kupton se është e lindur që të mos jetë e zonja ndaj fatit dhe vetvetes dhe prandaj personaliteti i saj është i "lirë" ndaj të fshehtave dhe bukurive të botës. Ndonëse e fejuar ajo hedh poshtë shumë zakone e paragjykime: martesën pa dashuri, kufizimin e lidhjes ndërmjet djalit e vajzës, armiqësitë familjare etj.

N'është faj, unë jam dashur
me një trim që më nderonte:
tashti, që prej tij të zgjidhem,
duan me tjetër të lidhem:
t'i shkel besën kujt më deshi...
(Kënga e parë, Libri i dytë)

Në funksion të këtij qëndrimi opozicional të përgjithshëm është edhe karakteri tragjik dhe i dhimbshëm i ngjarjeve të poemës, sidomos i figurave kryesore të saj, Serafinës dhe Bozdarit.

Këtu tani Serafina e Bozdari pavarësisht kundërshtisë fillestare burrë/grua, kemi opozicionin e dytë që bashkon dhe shkrinë në një figurat e të dyve.

Si zgjedhje e opozicionit binare, dhe përcaktimin e parë burrë/grua dhe karakteristikave të personazhit, janë të përfshirë në një proces arbitrar, dhe gjithmonë ka një rrezik se subjektet nuk do të mbulohen në mënyrë të kënaqshme. Megjithatë, janë zgjedhur disa çifte binare të cilat përbëjnë subjektet e përmendura shpesh në tekst.

Çështja kryesore është se, nëse ka, përvoja nuk mund të fshihet. Çfarë mbart identitet, dhe çfarë përfaqëson veçantinë midis personazheve? - është çështje e hapur në universin deridian, e fshehur dhe e pazgjidhshme nën sipërfaqen e teksteve të tij, më shumë sesa gjendje e trazuar për identitet sesa kundër saj. Por kjo gjithashtu është, dhe ndoshta për të njëjtën arsye, një kontradiktë estetikisht produktive, si në tekstin e "Serafina Topisë."

Këtë që e shohim është një estetikë deridiane duke krijuar terren të njëjtë si te veprat tjera: fragmentariteti shndërrohet në strategji estetike.

Opozicioni binar i personazhit të Serafinës përcaktohet lidhur me katër lloje të tjetërsisë. Secila prej tyre ka rëndësi të ndryshme, por tërësore, dhe përcaktojnë radhitje të tillë:

1) tjetërsia kulturore
2) tjetërsia sociale
3) tjetërsia gjinore
4) tjetërsia diskursive

Serafina tenton të çlirohet tërësisht nga të gjitha por kjo është arsyeja pse kapet, sikur edhe personazhet tjera, nga një ngjashmëri në të cilën ajo nuk njeh asnjë veçanti, e cila në thelb do të thotë vetmi dhe jo ngjashmëri.

"Vallë vetëm si të vdes,
do të jem zonjë e vetvetes?"
(Kënga e tretë, Libri i parë)

Ajo, megjithatë, është e vetmja që duhet të pranoj situatën pa zbuluar vetën, pa zbuluar dashurinë dhe për të pranuar një situatë të panjohur dhe të pandryshueshme të jetës së saj nga gjithë të tjerët. Kjo i jep narratorit rolin e heshtur, ashtu si tjetërsim i veçantë dhe përvoja e procesit të shkrimit kthehet në diçka më estetike.

Tjetërsia kulturore e Serafina Topisë, përbëhet nga çdo gjë jashtë konvencës që lidhet me të. Për përmirësimin e shëndetit të saj mjekët i këshillojnë klimën e Himarës. Mandej në bisedë me të atin tregohen tiparet dhe përvoja e saj kulturore si njeri i "ndritur" e i ditur, ajo flet me shqetësim për realitetin, për fatin e njerëzimit, për zhdukjen e popujve, përderisa personazhet tjerë reagojnë ndryshe në përvojat e tyre kulturore. (Kënga e dytë, Libri i parë)

Tjetërsia kulturore përbën një fushë jashtë gjuhës dhe jashtë rutinave sociale, por që shënohet brenda gjuhës si heshtje apo si paqartësi dhe brenda rutinës së zakonshme sociale, nuk vjen si çarje, si rishqyrtim normash që gjer atëherë dukeshin të jenë të qëndrueshme dhe pafundësisht të përsëritshme. Pra për të dhënë shqetësimin e vetë shpirtëror Serafina vetë rrëfehet në mënyrë poetike ose e bën këtë përpara Patriarkut të Venedikut. Dyluftimin e brendshëm midis dashurisë e detyrës që i ngarkohet të martohet me një tjetër ia thotë atij, dhe ky është një presion i heshtur emocional që nuk lejohet të jetoj jashtë.

Prandaj arrijmë të dimë lidhur me efektet tjera kulturore kryesisht përmes strategjive tekstuale të narratorit; dhe në fund Serafina fejohet me tjetrin, pa protestë, sipas narratorit (Kënga e tretë, Libri i dytë)

Tjetërsia diskursive është narratori. Narratori nuk është vetëm narrator i jetës së Serafinës, por i të gjithë personazheve tjerë. Narratori nuk del të jetë një zë neutral dhe transparent në strategjinë e narrative, pasi ai mbron pozicione dramatike dhe shfaq një pjesë të vet; përpjekja për një narrator të besueshëm është shmangur, kjo bëhet sidomos me futjen e poemës "Parallyja e Radavanit":

Ish një prift, bir prej mirësh,
në janinë, q'humbet gruan
aq të shtrenjtë, krejt të re
...
Parallyja: - radavan, çkërkon prej
meje?-
Radavani: - Këkoj besën që të jesh
zonjë në shtëpinë time!...
Parallyja: -
Kush të sotmen s'ka në dorë
Nuk jep besën as për të ardhmen!...
...
Tashti që s'kam time-bijë,
s'ka pse të më gdhihet dita,
se njeri mua s'më zgjohet.

Narratori është instancë tekstuale strategjia e të cilit përcaktohet nga mënyra se si ndryshon kultura, politika dhe gjina në vepër. Narratori merr rolin e tjetrit, kur në të tre rastet zhduket tjetërsia. Narratori është zëvendësues i përhershëm për tjetrin.

Ndërtimi i pozitës së narratorit në këtë mënyrë tregon strategjinë narrative të dyfishtë. Së pari, si ndërtimi i pjesshëm i identiteti mes narratorit dhe Serafinës, Bozdarit dhe Nik Dukagjinit. Së dyti, një pavarësi të shënuara në mënyrë të qartë të narratorit përballë gjithë personazheve tjerë. Kjo distancë shprehet në çdo rast të

përdorimit të përemrit në vetën e parë (unë, ose ne) kur i adresohet lexuesit drejtpërdrejtë (p.sh. "Ishim vasha bujaresha...", "Ditët po ikin, e ti m'u mbylle...."), dhe nga futjet autoriale që përmbajnë kthim prapa apo shpjegime që narratori i sheh të nevojshme të lidhen me lexuesit (p. sh kënga e Bozdarit me shokë Serafinës, Kënga katërt, etj.).

Narratori ka aftësi të shoh dhe të thotë çdo gjë që zgjedh. Por nuk e bën këtë.

Kështu, thirrja diskursive të rrëfej përshkon tërë veprën e Serafina Topisë. Personazhet mund të jenë të vetëm, por kurrë nuk janë të izoluar nga të tjerët që u jep atyre identitet dhe i detyron të vendosen në raport me tjetrin për ta treguar natyrën e tjetrit dhe të veten në të njëjtën kohë. Serafina mund të bëjë këtë në universin fiktiv të De Radës lidhur me babain e saj apo me Bozdarin, por narratori, që manifeston tjetërsinë në nivelin diskursiv na detyron ne, si lexues, të lidhemi me rrëfimin si instancë komplekse të tjetërsimit.

Kështu, vepra *Serafina Topia*, edhe pse e vendosur në margjinat e veprës së Jeronim de Radës tregon se si identiteti dhe tjetërsia ndërlidhen në personazhin e Serafinës.

Meliza KRASNIQI

SERAFINATOPIA - HER OTHER WORLD

Abstract

The concept of "the other" is quite complex and it is difficult to accurately identify its meaning. According to Michel Foucault, the concept of the other is closely related to power and knowledge. The other is the individual who is perceived as different from the group that does not belong. Every foreigner becomes the other. Moreover, the other takes many forms, such as: identity, race, gender, religion, social class, political ideology, origin, etc.

Simone de Beauvoir introduces the notion of "the other" with her philosophical analysis in "The Second Sex" (1949) as a construction that opposes and thus builds "itself"; then the concept of "other", "alienation," and "being different" has spread to the field of thought and exploration in many sciences and also in literature science. Yet it is known that this concept was not entirely new, but it was influenced by Hegel's dialectics

In literature "the other" is a common figure. This concept can be recognized in all Albanian literature in various forms because it is created on the basis of this concept.

Researchers who deal with structuralism, post-structuralism, feminism, Marxism, and other methodologies that depend on "binary opposition" often examine works where the characters are created being called by any "other" rhetoric. To understand the concept of “the other” in SerafinaTopiaofJeronim de Rada, it was used this formal approach (binary opposition), which helps to understand how meaningsin the text are formed and created.

Key words: the other, Simone de Beauvoir, binaryopposition, SerafinaTopia

Lumnije KADRIU

INTERAKSIONI NË HAPËSIRAT PUBLIKE VIRTUALE (CYBERSPACE) SI MBËSHTETJE E REALIZIMIT TË HAPËSIRAVE SHOQËRORE TRANSNACIONALE

Sipas Thomas Faist, 'hapësirat shoqërore transnacionale i referohen lidhjeve të qëndrueshme të personave, rrjeteve dhe organizatave përtej kufijve të shumëfishtë të shteteve nacionale që shtrihen nga format e institucionalizuara të ulta deri në ato më të larta...'

Interneti është bërë pjesë e jetës së përditshme për shumicën e njerëzve anë e mbanë botës e prandaj ndikimi i internetit dhe hapësirës publike virtuale është bërë temë e interesit për shumë studiues nga fusha të ndryshme. [1] *Disa prej këtyre fushave fokusohen në studimet e këtij fenomeni dhe impaktin e këtij fenomeni prej së larti, që do të thotë të pushtetit ideologjik dhe ekonomik, por disa nga to fokusohen në impaktin social e kulturor të tyre duke e vëzhguar prej së poshti, pra, nga shtresat e gjëra sociale.*

Në këtë kumtesë, me një qasje etnologjike, shikuar prej së poshti, do të analizohet se ç'rëndësi kanë cyberhapësira dhe mediat për mërgimtarët në ruajtjen e lidhjeve të tyre me vendlindjen duke bërë kështu atë një hapësirë të rëndësishme transnacionale ku kultivohen lidhjet kulturore e familjare. Cilat janë mënyrat që reflektojnë jetën e përditshme në këto hapësira? Në ç'mënyrë konfirmohen lidhjet e shumëfishta kulturore e sociale? Analiza do të jetë e bazuar në të dhënat e siguruara nga bisedat me një numër të mërgimtarëve, si dhe vëzhgimit me pjesëmarrje në disa hapësira publike virtuale si youtube dhe facebook.

Koha postmoderne e karakterizuar me konceptin e globalizimit në aspektin ekonomik, politik dhe sociokulturor, në mënyrë të theksuar është e përshkuar edhe me zhvillimin e teknologjisë informative dhe të komunikimit të realizuar nëpërmjet cyberhapësirës, apo siç njihet thjeshtë dhe në mënyrë më popullore, internetit.

Sipas Fuchs, 'Cyberhapësira është një rrjet global socio-teknologjik që bazohet në strukturat teknologjike të përbëra nga rrjetet kompjuterike të rrjetëzuara të cilat

[1] Ndër punimet më me ndikim lidhur me internetin dhe globalizimin shih: Appadurai, *Globalisation at large;* Urry, *Consuming Places*; Christian Fuchs, 'Transnational Space and the "Network Society"', në *21st Century Society* vol.2, No.1, (2007) pp. 49-78, http://fuchs.uti.at/wp-content/uploads/transnationalspace_networksociety.pdf [qasur 25 prill 2015], Ky punim paraqet një punim mjaft gjithëpërfshirës mbi cyberhapësirën të lidhur me përdorimet teknike, teorike e praktike të internetit në aspektin ekonomik, politik e social që përbëjnë një fenomenet e globalizimit të ditëve të sotme.

punojnë me ndihmën e protokolit TCP/IP[2] që e grumbullon/ruan dijen e objektifikuar njerëzore. […] Interneti përbëhet edhe nga infrastruktura teknologjike edhe akterët njerëzorë që komunikojnë.'[3] Ai përshkruan raportin e kapitalizmit global me përhapjen e korporatave kapitaliste prej korporatave nacionale në ato transnacionale, të cilat kanë pasë ndikim edhe ekonomik edhe socio-kulturor. Ai pra e sheh internetin si 'hapësirë ekonomike të rrjetit kapitalist global ' (ff. 63) dhe për më tepër dallon krijimin e një 'hapësire politike të rrjetit të kapitalizmit global' (f. 65), ku numëron organizatat e fuqishme transnacionale siq janë NATO, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtarë dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë, etj. Në anën tjetër ai fokusohet në atë që e quan 'hapësirë kulturore të rrjetit të kapitalizmit global' (f.66) të cilën e përshkruan si hapësirë ku ndeshen kultura të ndryshme dhe ku dominimi i vlerave kulturore perëndimore mund të çojë drejt homogjenizimit kulturor. Të gjitha këto mund të konsiderohen si aspekte të cyberhapësirës prej së larti. Sidoqoftë, kur merren parasyshë agjensët njerëzorë dhe mundësia për demokratizimin çdo herë e më të madh të cyberhapësirës, ai e bën me dije edhe praninë e kundër-rrymave, më së shumti në hapësirat sociale, të cilat mundësojnë shprehje të ndryshme kulturore, identitare dhe të interesimeve. Në këtë mënyrë, në njërën anë sfidohet 'homogjenizimi i botëkuptimeve dhe stileve të jetës nga kultura konzumuese kapitaliste' e në anën tjetër, në nivelin personal, bëhet si pasurimi i personaliteteve me identitete të ndryshme, me krijimin e shoqërive të ndryshme, madje edhe me mundësinë për rënie në dashuri ashtu edhe pasurimi kulturor me 'pluralizimin dhe hapjen e botëkuptimeve duke ofruar forma të ndryshme të publikimeve online, gazetarisë online, cybershkencës, artit digjital dhe e-shëndetësisë.'[4]

Nëse e krahasojmë këtë që u tha më sipër me definimin e Thomas Faist të hapësirave shoqërore transnacionale sipas të cilit ato 'i referohen lidhjeve të qëndrueshme të personave, rrjeteve dhe organizatave përtej kufijve të shumëfishtë të shteteve nacionale që shtrihen nga format e institucionalizuara të ulta deri në ato më të larta...'[5] atëherë na bëhet e qartë se cyberhapësira paraqet një terren të begatshëm si fushë shoqërore transnacionale në të cilën ekzistojnë mënyra të shumta për të analizuar cyberhapësirën dhe hetuar se si përdoret 'nga poshtë', apo thënë ndryshe nga njerëzit e zakonshëm, e që natyrisht një qasje e tillë paraqet pjesën qendrore të interesimeve në etnologji dhe shkencat e tjera shoqërore.

[2] Shkurtesa TCP/IP është shkurtesë për Transmition Control Protocol/ Internet Protocol, që nënkupton Protokolin e Kontrollit të Transmetimit/ Protokolin e Internetit, për më shumë shih http://searchnetworking.techtarget.com/definition/TCP-IP [qasur 4 korrik 2016] shenim i autores

[3] Fuchs, 'Transnational Space and the "Network Society"', ff. 35.

[4] Fuchs, 'Transnational Space and the "Network Society"', ff. 71.

[5] Thomas Faist, 'The Transnational Turn in Migration Research: Perspectives for the Study of Politics and Polity'. në Maja Povrzanovic Frykman, ed., Transnational Spaces:Disciplinary Perspectives (Malmö University IMER, 2004), ff. 17.

Në të vërtetë për njerëzit mobil (të cilësdo kategori), cyberhapësira është ndihmuesi/lehtësuesi më i rëndësishëm i mbajtjes së lidhjeve me ata që ose ngelin mbrapa ose lëvizin gjetkë në një apo disa vende të ndryshme, sepse cyberhapësira gjithashtu përfshinë të gjitha format e informatave dhe komunikimeve me çmime të ulëta. Aty mund të krijohen lidhje si telefonike siq është Skype, pastaj qasen kanalet e ndryshme televizive nga lokalitete më të largëta, dhe mbi të gjitha janë të pranishme rrjetet sociale pa pagesë si Facebook dhe Twitter të cilat mundësojnë krijimin e rrjeteve/komuniteteve tjera të panumërta për secilin individ. Për më tepër teknologjia e ngarkimit të fotografive dhe video-inqizimeve është bërë aq e lehtë saqë është bërë një hapësirë ku i gjithë globi mund të lidhet menjëherë me një pamje apo ngjarje të caktuar. Disa familje përdorin You Tube si hapësirë për të ngarkuar inqizimet e ngjarjeve të ndryshme jetësore, si martesat/dasmat, ceremonite mortore/varrimit, dhe ngjarje tjera të rëndësishme. Duke qenë ky mbase një website shumë më i hapur se sa psh., vetë Facebook-u, ku rrjetëzimi mund të kontrollohet individualisht, këtu mundësohet një kontakt, shprehje e komunikim shumë më i gjerë, i pakufizuar, e kështu edhe mundësitë për studimin e tyre.

Pra, siç shihet, shumë dimenzione të transnacionalitetit praktikohen përmes dhe me anë të cyberhapësirës dhe në këtë kumtesë do mundohem të paraqes disa ilustrime, ku cyberhapësira na vjen edhe si vendtakim edhe si vendreflektim.

Gjatë hulumtimit tim të diasporës nuk e kam diskutuar shumë qështjen e telekomunikimit, internetit apo cyberhapësirës, por kjo temë u ngrit disa herë spontanisht dhe si diçka e vetëkuptueshme. Derisa ata e tregonin psh. historinë e marrëdhënies me partnerin e tyre aktual, shumë nga bashkëbiseduesit shpjegonin se si, në fillim, ata e kishin mbajtur lidhjen e tyre dhe ndërtuar marrëdhënien me anë të bisedave të gjata në telefon. Sipas analizës mund të konkludohet se telefoni ndonjëherë përdorej ose meqë asnjëra palë nuk posedonte kompjuter apo internet, posaqërisht para vitit 1999, ose meqë personi në Kosovë nuk posedonte kompjuter apo internet. Por, gjatë punës kërkimore në vitin 2013 kam vërejtë në disa raste se familjet në shumë fshtara tashmë posedonin kompjuterë (Uglare, Llapushnik, Kqiç etj.). Në fakt në Kosovën e ditëve të sotme kompjuterët dhe lidhjet e internetit janë shumë të pranishme. Disa vjet më parë ishte shumë interesante dhe të binin në sy internet-kafetë edhe nëpër fshatra, por si duket gradualisht, çdo herë e më shumë, familjet e veçanta janë në gjendje të sigurojnë kompjuterët e tyre, e prandaj edhe numri i internet- kafeve ka rënë dukshëm. Kjo posaqërisht është e vërtetë për familjet transnacionale të cilat mund t'i sigurojnë këto pajisje nga mërgimtarët, apo të paktën të financohen nga ta për t'i siguruar ato. Kur vizitova fshatin Kçiq për herë të parë, një grua e familjes u vonua me arsyetimin se ishte duke biseduar në internet me njërin nga kusherinjtë e saj në mërgim. Ky ndryshim mjaft i theksuar për brenda vetëm një dekade flet për një zhvillim të shpejtë të situatës socio-ekonomike në botë e në

Kosovë ndër të tjera si rezultat i zhvillimit të shpejtë të teknologjisë dhe uljes së çmimit të paisjeve dhe shërbimeve.

Por si reflekton cyberhapësira në marëdhëniet shoqërore e kulturore transnacionale?

Në një rast, një i njohur që më mundësoi kontaktin me vëllain e tij migrant më tregoi se si vëllai i tij një vit për shkaqe financiare kishte vendosur të mos vinte në shtëpi për Vitin e Ri. Mirëpo, kur një natë vajzat e tij po bisedonin me gjyshërit e tyre dhe gjatë bisedës të dyja palët po shprehnin zhgënjim të madh për dështimin e vizitës, biseda ishte bërë aq emocionale, dhe kishte shkaktuar aq presion në të, sa të vendosë menjëherë, aty për aty, që përkundër vështirësive ekzistuese, të marrë vendimin që sërish të bëhen bashkë për natën e Vitit të Ri. Kështu, duke qenë në gjendje që t'i ofrojë njerëzit emocionalisht, interneti kontribuon edhe në marrjen e vendimeve për t'i ofruar më shumë edhe fizikisht.

Një qështje tjetër që u theksua gjatë bisedave të kërkimit në terren në lidhje me vendlindjen dhe lidhjet familjare ishte pohimi, të shumtën i thënë me shumë krenari, se fëmijët e mërgimtarëve e flasin gjuhën shqipe shumë mirë, dhe se arsyeja për këtë është që në shtëpitë e tyre flasin vetëm shqip. Në këtë mënyrë interneti forcon dhe përmirëson lidhjet jo vetëm familjare e shoqërore por edhe kulturore e identitare. Ata nëpërmjet njohjes së gjuhës konfirmonin edhe mënyrën e të qenurit edhe të përkatësisë. [6] Sidoqoftë, e futa këtë të dhënë këtu sepse në disa raste ata pohuan dhe madje theksuan se përdorimi i internetit dhe chat-dhomave derisa kontaktojnë anëtarët e familjes në vendlindje dhe mundësia që jo vetëm të flasin por edhe të shkruhen me ta ka bërë që fëmijët të përmirësojnë shkatësitë e tyre gjuhësore të shqipes.

Në ruajtjen e identitetit kombëtar e kulturor rëndësi mjaft e madhe i është dhënë edhe mundësisë që të shiqojnë kanale televizive nga vendlindja. Kështu shumë mërgimtarë rreth e përqark botës shpenzojnë para shtesë për të siguruar satelitë. Një

[6] Këto nocione janë të lidhura me një qasje të studimeve transnacionale të quajtur fushë shoqërore transnacionale të konceptuar nga autoret Nina Glick Schiller and Peggy Levitt. Kjo qasje sipas tyre do të mundësojë një kuptimin më të mirë empirik të praktikave të kryera nga migrantët. Ato e definojnë fushën shoërore si ' një set të rrjeteve të shumëfishta e të ndërlidhura të raporteve shoqërore nëpërmjet të të cilave idetë, praktikat dhe burimet shkëmbehen, organizohen dhe transformohen në mënyrë jo të barabartë. (Schiller & Levitt 2004:9) Brenda kësaj qasjeje ato definojnë 'mënyrat e të qenurit në fushën shoqërore…duke iu referuar raporteve dhe praktikave aktuale shoqërore në të cilat individët angazhohen më parë se sa identiteteve me të cilat shoqërohen veprimet e tyre. Fushat shoqërore përfshijnë institucionet, organizatat dhe përvojat, brenda niveleve të ndryshme të tyre, që gjenerojnë kategori të identiteteve të cilat u atribuohen apo të cilat i zgjedhin individët apo grupet…Përkundrazi, mënyrat e përkatësisë iu referohen praktikave që sinjalizojnë apo e vëjnë në pah identitetin I cili demontron një lidhje të vetëdijshme me një grup të caktuar. Këto veprime nuk janë simbolike por konkrete, veprime të dukshme që e shenojnë përkatësinë si psh mbajtja e një kryqi të krishterë apo ylli hebraik, një flamuri valvitës, apo edhe zgjedhja e një kuzhine të caktuar. (Schiller & Levitt 2004:11)

mërgimtar në Suedi, i cili ishte kthyer për disa vite në Kosovë dhe tash shkonte të jetonte sërish në Suedi, gjatë bisedës më tregoi gjëra të ndryshme që kishte bërë gati të marrë nga Kosova (flamuj- edhe të Shqipërisë edhe të Kosovës, plisa, fotografi dhe mini-skulptura të pesonaliteteve të shquara kombëtare, erëza të ndryshme për ushqime), e ndër të tjera gjithashtu përmendi se ai tashmë e kishte dërguar antenën satelitore në mënyrë që të mbajë fëmijët e tij të lidhur me kanalet televizive të vendlindjes dhe në këtë mënyrë të parandalojë asimilimin e tyre. Ai nuk donte të rrezikonte, siq kishin bërë disa bashkvendas të tij, të lejojë fëmijët të shikojnë vetëm kanalet Suedeze. Kjo qështje ishte adresuar edhe nga autori Arjun Appadurai në kuadër të rrjedhave kulturore globale me konceptin e tij të prodhimit të lokales.

Informatat më të shumta dhe më cilësore në lidhje me cyberhapësirën mund të them se i kam fituar duke u bërë vetë përdoruese e rrjetit social Facebook. Për një kohë shumë të shkurtë u bëra intenzivisht transnacioanle duke pranuar e dërguar kërkesa shoqërimi nëpër pothuaj gjithë botën. Papritmas, për çdo ditë isha e vetëdijshme se çka po ndodhte me miqt e mij reth e përqark botës, e kështu, më duhet të pranoj, mu deshën disa ditë, nëse jo javë, që të ri-organizoj mendimet e mia, perceptimet dhe sjelljen që mund të shpreheshin aq lehtësisht në kontekste të përziera. Për shembull, derisa pija kafen rutinore të mëngjesit me kolegët, do t'i referohesha papritmas diçkaje që kisha parë apo diskutuar në Facebook dhe meqë disa nga kolegët akoma nuk kishin profil FB-u komunikimi ynë u bë pak sa i çuditshëm dhe medoemos nevoiteshin shpjegime shtesë. Jeta ime e përditshme përmbante veprimet, mendimet, ngjarjet e përditshme të njerëzve të njohur e panjohur nga e gjithë bota. Ndihesha disi sikur në një zonë të mugët. Kjo gjendje shumë shpejt u bë realiteti im i ri, dhe sidoqoftë u mësova ta menaxhoj, kontrolloj dhe bëj pjesë të zakonshme të jetës sime. Kjo u bë edhe më e lehtë kur anëtarët e familjes sime si dhe shoqëria e ngushtë gjithashtu u bënë pjesë e qarkut shoqëror të FB. Prandaj konsideroj se ajo që po ndodh aty është pasqyrim i përditshmërisë sonë, preokupimeve, kompenzimeve, promovimeve, reklamimeve tona të niveleve dhe dimenzioneve të ndryshme.

Me kalimin e kohës disa nga të intervistuarit e kontaktuar u bënë miq të mij të facebookut. Në anën tjetër, shumë kusherinj dhe të njohur të mij që nuk janë fare pjesë e mostrës sime kërkimore u bënë burime të rëndësishme të informatave dhe shembujve për studimin tim.

Shembujt janë të shumtë por këtu do të paraqes vetëm disa që ndërlidhen me pushimet, familjen dhe shokët, si manifesim i transnacionalitetit në kohë dhe hapësirë të caktuar dhe shpërfaqjen e saj virtuale.

Ajo që më impresionoi ishte fakti se FB përdorej si medium për të lajmëruar risitë e fundit personale a familjare tek familjarët dhe shokët e shpërndarë nëpër botë. Në këtë mënyrë, përveç informimit instant ishte bërë i mundshëm edhe reagimi i menjëhershëm.

Kështu, një numër i madh i njerëzve ngarkojnë fotografi të foshnjeve të sapolindura dhe e bëjnë të ditur emrin e fëmijës, derisa të tjerët postojnë foto të dasmës që ishte bërë një natë më parë, duke i mundësuar të gjithëve që tu urojnë për ngjarjen në fjalë.

Shumëkush madje lajmëron edhe vdekjen e anëtarit të familjes, duke njohtuar ditën dhe kohën e varrimit, me ç'rast u mundësohet njerëzve të marrin pjesë në ceremoni apo të paktën të shprehin ngushëllimet e tyre. Më la përshtypje një rast se si FB, për një familje theksueshëm transnacionale, kishte bërë të mundur për anëtarët e saj që mungonin në ceremoni jo vetëm vizualizimin e ceremonisë por edhe sjelljen e tyre më afër momentit të varrimit të personit të dashur me anë të postimit të një fotografie të varrit pikërisht në ditën e varrimit. Komentet që shoqëronin këtë postim ishin shumë emocionuese, të dhembshme, dhe ky akt i afronte dhe bashkonte ata duke u ndjerë pothuaj të pranishëm.

Brenda Facebook-ut mund të gjinden webfaqe të ndryshme që individët mund t'i pëlqejnë apo ku ata mund të abonohen dhe në këtë mënyrë rregullisht të marrin të rejat nga ajo faqe. Inkuadrimi në to i bën anëtarë të komuniteteve përkatëse dhe pjesëmarrës në interesime përkatëse, siq u cek më sipër. Një e tillë është edhe faqja *Kosovo Diaspora Society/Culture Website*, e cila është përshkruar në gjuhën angleze kështu: 'Kosovo Diaspora is an online platform that highlights and celebrates achievements of individuals, businesses and organizations related to Kosovo/ Kosovo Diaspora është një platformë online e cila thekson dhe feston të arrituart e individëve, bizneseve dhe organizatave që kanë lidhje me Kosovën.'[7] Pra, kjo përfaqëson një hapësirë tipike transnacionale e cila lidhë njerëzit, ngjarjet, mendimet, idetë, sukseset, investimet, risitë, lajmet, reklamat etj., të Kosovës me vendet e tjera. Të gjitha këto gjithashtu e bëjën cyberhapësirën një medium për shprehje të shkallëzuar prej kontekteve e niveleve individuale deri te ato nacionale e supranacionale, edhe në aspektin social edhe atë kulturor.

Përveç tjerash, nëpërmjet FB mund të lidheni edhe me shumë të ashtuquajtura portale ku mund të gjinden shumë reklama në lidhje me mërgimtarët apo interesimet e tyre. Për shembull, portali Express reklamon NIMI TV[8] - <www.nimitv.- com> si 'një platformë TV e cila për vetëm 13.9 € mund të ofrojë gjithsecilin më afër vendlindjes nëpërmjet 1000 kanaleve televizive. 20 prej tyre janë kanalet kryesore nacionale derisa më shumë se 100 kanale tjera janë nga *"rajonet tona"* [theksimi im], e pastaj vazhdon një listë e numrave të telefonit në 14 shtete të ndryshme si: Austria, Norvegjia, Franca, Gjermania, Australia, etj., si dhe web-linqet ku mund të blihet oferta apo merret informata.

[7] Kosovo Diaspora: <https://www.facebook.com/KosovoDiaspora?fref=ts> [qasur 26 Maj 2015].
[8] Nimi TV <www.nimitv.- com> [qasur 12 maj 2015]

Shumë postime nga mërgimtarët, siq kam vërejtur, janë të lidhura në mënyrë eksplicite me pushimet e kaluara në vendlindje. Për shmebull, një video e ngarkuar në FB nga thotë: 'Shaban K. nje melodi me kavall gjat pushimit veror na ke knaq ago. [9] Pra si duket personi nga diaspora kishte inqizuar të afërmin e tij që jeton në Kosovë, mbase gjyshin, derisa luante në instrumentin tradicional dhe theksonte se kjo kishte ndodhur gjatë pushimeve të verës.

Me një rast, në janar rë vitit 2014, vërejta një vido postim nga një mik i mikut në fb që jeton në Londër i cili ishte titulluar 'KS Family and Friends –Viti i Ri 2014 me [list e emrave]…'. Për fat të keq kur desha ta shiqoj edhe njëherë këtë postim më nuk e gjeta. Sidoqoftë, titulli i këtij postimi më ngjau mjaft kuptimplotë meqë ishte i lidhur me pushimet, diasporën dhe Kosovën.

Siç theksova më sipër, shembuj janë të panumërt, por këtu do të paraqes vetëm edhe një nga një kusheri i imi. Një ditë (24 mars 2015) ai kishte postuar disa foto me titullin në gjuhën angleze 'Nostalgic and thankful. Mum and Dad, sisters and more good folk without FB - ëith [list of persons]//Nostalgjik dhe falënderues. Nëna dhe Babai, motrat e më shumë njerëz të mirë pa FB -me [lista e personave]', duke kujtuar kështu një vizitë në vendlindje dhe të afërmit që kishte takuar, tash duke i parë dhe i kujtuar përmes fotove dhe FB. E mëpastaj në maj 2015 vërejta sërish 'N.N. ka shtuar 14 foto të reja - feeling nostalgic with [lista e personave] - 366 ditë më parë në Keqekollë...'

Të gjitha këto janë ilustrime praktike të asaj se si cyberhapësira e mundëson kompresionin kohë – hapësirë, duke lidhur njerëz në mënyrë instante, sinkronike apo asinkronike[10] si dhe duke përmirësuar lidhjet e tyre globalisht. Forcon lidhjet ndërnjerëzore e kulturore brenda familjarëve, shoqërisë e komunitetit duke sjellë në shprehje theksimin e identiteve.

Por megjithatë në lidhje me cyberhapësirën, në fund, mund të shtrohen edhe pyetje tjera. A e bën ajo jetën vetëm më të lehtë apo në disa raste e bën atë më të parehatshme? A e mundëson ajo kontrollin shoqëror përtej kufinjve? A bën ajo që njerëzit të jenë më të përgjegjshëm për komunikimin e tyre me familjarë pikërisht për shkak të aksesit? Simbas të gjitha gjasave po, por njerëzit mësohen të menaxhojnë këtë çështje përderisa ajo po bëhet një pajisje e përditshmërisë, e zakonshme/mondane. Arsyetimet dhe kërkim faljet lehtësojnë këto tensione nëse nevoja për komunikim nuk është e përshtatshme për të dy palët në të njejtën kohë, njejtë sikurse edhe në cilëndo situatë tjetër të rëndomtë shoqërore në kohën e tashme reale. Ndoshta?!

[9] Shaban K. duke performuar në kavall, <https://www.facebook.com/nagip. kryeziu/videos/10202- 770646500125/>, [qasur 27 maj 2015].

[10] Shih më shumë në: Fuchs, 'Transnational Space and the "Network Society"' ff.55.

Lumnije KADRIU

INTERACTION IN CYBERSPACE AS A FACILITATOR IN CREATION OF TRANSNATIONAL SOCIAL FIELDS

Abstract

According to Faist, transnational social fields 'refer to sustained ties of persons, networks and organizations across the borders across multiple nation-states, ranging from low to highly institutionalized forms...'.

Internet has become a part of everyday life for most of people all around the world and therefore its impact has become a topic of interest for scholars of different fields. Some of the fields are focused in the study of this phenomenon and its impact from above, i.e. its ideological and economic power, while some are focused in its social and cultural impact observing from below, thus as practiced by wider social strata.

In this paper from ethnological perspective, from below, will be analyzed the importance the cyberspace and media have among diasporans in preserving relations and ties with homeland, making it this way a relevant transnational space in which familial and cultural ties are cultivated. How is reflected their everyday life in these spaces? In what ways are confirmed their multiple cultural and social ties? The analysis will be based on the data collected from a number of conversations with Kosovo Albanian migrants, as well as through participant observation in some public virtual spaces such as YouTube and Facebook.

Leontina GEGA-MUSA

KULTURA TRADICIONALE NË HAPËSIRËN VIRTUALE

Abstrakt

Në erën e informacionit të shpejtë në të cilën jemi, hapësira virtuale krijoi mundësi të një forme të re dominuese të komunikimit ndërmjet përdoruesve të internetit. Komunikimi na shfaqet në forma të reja, siç janë faqet e ndryshme si: Google e Youtube, rrjetet e ndryshme sociale, si dhe portalet e ndryshme informative. Kjo formë e re e komunikimit, po bëhet bartëse edhe e kulturës tradicionale në përgjithësi, po edhe e asaj shpirtërore në veçanti, e cila paraprakisht rekonstruktohet duke e ndryshuar praktikën tradicionale të performimit, duke iu përshtatur një audience e cila ka dëshirë t'i përcjell ato. Kjo dukuri në literaturën mbi mediet është emëruar si *autenticitet i inskenuar* 'straged authenticity' që do të thotë se në mas media synohet të transmetohet vetëm ajo që do të mund të pëlqehet nga shikuesit, ose që nga inskenuesit (në këtë rast koreografët, regjisorët...) konsiderohet se është autentike. Do të thotë se në internet na shfaqen si vlerat e vjetra, ose ato të krijuara mbi to, si dhe krijimet tërësisht të reja, shpesh të tjetërsuara, duke ofruar dhe krijuar mundësi të qasjes, analizimit dhe studimit të këtyre vlerave, sidomos për fushat sociale e humane.

Kumtesa ka për qëllim që të shqyrtojë raportin të cilin e dikton hapësira virtuale në transmetimin e një forme të re të kulturës tradicionale, si dhe sa e rrezikon kjo hapësirë virtuale autenticitetin dhe specifikën përmbajtjesore të formave të kulturës tradicionale.

Fjalët kyçe: *hapësira virtuale, komunikimi, kultura tradicionale, kultura shpirtërore, autenticiteti*

Në erën e informacionit të shpejtë në të cilën jemi, hapësira virtuale krijoi mundësi të një forme të re dominuese të komunikimit ndërmjet përdoruesve të internetit. Komunikimi na shfaqet në forma të reja, siç janë faqet e ndryshme si: Google e Youtube, rrjetet e ndryshme sociale, si dhe portalet e ndryshme informative. Kjo formë e re e komunikimit, po bëhet bartëse edhe e kulturës tradicionale në përgjithësi, po edhe e asaj shpirtërore në veçanti, pjesë e së cilës është edhe krijimtaria folklorike, e cila paraprakisht rekonstruktohet duke e ndryshuar praktikën tradicionale të performimit, duke iu përshtatur kështu një audience e cila ka dëshirë t'i përcjell ato.

Nga ana tjetër, kjo teknologji e re, e cila i zhvilloi mjetet e komunikimit deri në kufijtë e pakapshëm, po mundëson edhe qasje më të madhe në këmbim dijesh dhe përvojash mbi format e reja të kulturës tradicionale në përgjithësi.

Hapësira virtuale, krahas informacionit të shpejtë dhe të shumtë që ofron, krijon një formë të re konsumimi të krijimeve tradicionale, si edhe atyre të reja të folklorit bashkëkohor. Marr në përgjithësi karakteristikë e kësaj kulture të popullarizuar, është se marrësi e në këtë rast shfrytëzuesi i internetit e bën zgjedhjen e temës sipas interesimit. Interneti është një medie interaktive dhe dallon nga media televizive ku temat janë të kufizuara, sepse në internet ofrohet jo vetëm mundësia e zgjedhjes së temës, por edhe e dhënies ose postimit të temave personale me qëllim komunikimi me të tjerë të interesuar për atë temë. Kështu në web faqen Youtube ku bëhet shpërndarja e videove muzikore, mund të kërkohen zhanre të ndryshme këngësh folklorike nga më të ndryshmet, prej atyre epike me lahutë, e deri te këngët lirike me sharki e çifteli. Një formë e këtillë komunikimi, krijoi mundësinë e pakufishme të hulumtimit në internet, ku mund të gjinden variante të performancave të vjetra të cilat dikur ishin të njohura nga një audiencë e caktuar, ndërkaq sot duke e humbur anonimitetin bëhen të njohura për një audiencë të gjerë. Krahas këngëve si njësi folklorike, aty mund të kërkohen edhe forma të tjera të krijimtarisë gojore, si: përralla, anekdota, fjalë të urta etj. Kjo ndodh edhe me rrjetin social facebook në të cilën shpërndahen njësi të ndryshme folklorike sipas preferencave dhe shijes së "autorit" tani më të ditur e jo më anonim si në rastin e komunikimit gojor.

Gjithsesi se bashkëkohësia edhe në shoqërinë tonë karakterizohet nga zhvillimi arsimor e kulturor, nga migrimet, nga zbehja e kontakteve ndërmjet gjeneratave, si dhe nga zhvillimi i hovshëm i teknologjisë së komunikimit, siç janë mediet televizive e elektronike dhe interneti; dhe si pasojë e këtij zhvillimi na shfaqet relativizimi i kulturës tradicionale dhe njohurive të marra nëpërmjet masmedias. Këta faktor ndikuan që kultura shpirtërore dhe krijimtaria folklorike gradualisht të dalë nga hapësirat e veta tradicionale të qarkullimit. Pra, krahas këtij transformimi shoqëror që kemi në bashkëkohësi, na shfaqet një folklor i transformuar i cili po e humbet përkrahjen e shtresave që e bartin, ku procesi interaktiv ndërmjet interpretuesit dhe marrësit është bërë më i ndërlikuar. Derisa dikur folklori komunikoi në formën gojore me bartësit e folklorit, sot kjo formë më pothuajse nuk ekziston. Prandaj, ky transformim i karakteristikave esenciale të konceptit mbi folklorin, siç janë: interpretimi, cenzura preventive, shpërndarja ose përcjellja gojore, diktuan që në studimet bashkëkohore të zgjerohet koncepti mbi folklorin.

Studimet e shkencave sociale ku gradualisht po përfshihet edhe folkloristika bashkëkohore, kanë krijuar një nocion të ri të njohur si "netlore" që nënkupton ato forma të reja të folklorit, të cilat përhapen në mënyrë elektronike nëpërmjet faqeve të ndryshme në internet ose me e-mail. Ky nocion përfshin thashethemet, shakatë, të ashtuquajturat legjenda urbane, letrat zinxhir, e kështu me radhë. Por, këto studime

bashkëkohore, të cilat po mundohen të tejkalojnë hendekun ndërmjet njohurive dhe nocioneve formale në folkloristikë dhe nocioneve të reja, thellohen edhe më tutje në kryqëzimin e nocioneve "netlore" dhe "newlore". Kështu profesori i komunikimit Russell Frank në studimin e tij "Newslore, Contemporary Folklore on the Internet" (Newslor, Folklori bashkëkohorë në internet) me nocionin newslore përmbledh format si: shakatë, legjendat urbane, fotografitë e ndryshueshme digjitale, lajmet e simuluara, njoftimet për shtyp, memorandumet brenda zyrave, këngët parodi, poemat, njoftimet politike dhe komerciale, pllakatet dhe reklamat, deri edhe filmat e vizatuar dhe filmat e shkurtër të aksionit. Autori i këtij studimi gjen mbështetje në konkluzionet e Alan Dundes, se nëse folklori i vjetër rural reflekton vlera dhe botëkuptime rurale Amerikane, atëherë është po aq e mundshme që folklori i zakonshëm urban do të reflektojë tema të rëndësishme për jetën bashkëkohore urbane Amerikane. Prandaj, sipas Dundes, duke u larguar jetëgjatësia dhe oralja si parametra të traditës, folklori mbetet një shprehje artistike e cila shpreh vlerat e një grupi, pa marr parasysh si ato qarkullojnë dhe sa gjatë qarkullojnë.[1]

Por, sa ndikon në autenticitetin dhe specifikën përmbajtjesore të formave të kulturës shpirtërore ky raport, të cilin e dikton hapësira virtuale në transmetimin e kësaj forme të re të kulturës tradicionale në përgjithësi? Kur them formave të kulturës shpirtërore e kam fjalën me theks në ato krijime folklorike tradicionale të cilat qarkullojnë dhe shpërndahen në këtë hapësirë virtuale.

Pra, kemi të bëjmë me një raport të ri të folklorit me audiencën, e cila bëhet nëpërmjet të internetit, si dhe medieve audiovizuele. Prandaj, ky raport i ekspozimit të së kaluarës në një horizont uniform komunikimi, sipas studiuesit H. Bausinger, bëri që folkloristët t'i kthehen studimeve në proceset afatshkurtra dhe grupeve më të vogla.[2]

Nga ana tjetër, ky raport i ri i folklorit me audiencën, padyshim se vë në pyetje një karakteristikë esenciale të folklorit, siç është komunikimi gojor. Sipas studiuesi H. Strobach ky lloj komunikimi e ka humb kuptimin në raport me komunikimin mediatik. Mënyra e transmetimit gojor me anë të kujtesës, si karakteristikë e folklorit kalon në një karakteristikë sekondare, prandaj folkloristika sot duhet që kërkimet e saj t'i zgjerojë në veprimtaritë amatore të shoqërive kulturo-artistike dhe në shprehitë dhe zakonet e reja të jetës bashkëkohore.[3]

Padyshim se folklori si pasqyrues i realitetit nuk mund të lerë jashtë trajtimit të tij artistik edhe periudhën bashkëkohore, dhe pikërisht një proces i këtillë ndikoi që në folklorin e sotëm të praktikohen një sërë krijimesh tradicionale zhanresh të ndryshme, një pjesë e tyre të pasurohen me elemente të reja, si dhe të ketë krijime të reja në

[1] Frenk, Russell (2011) *Newslore, Cotemporary Folklore on the Internet*, University Press of Mississippi, f. 8.
[2] Bausinger, Hermann (1982) *Usmeno,* Narodna Umjetnost, knjiga 19, Zagreb, f.13
[3] Strobach, Hermann (1982) *Direktna usmena komunikacija kao bitno obiljezje Folklora? (Uz povjesno obrazlozenje problema),* Narodna Umjetnost, knjiga 19, Zagreb, f.19.

zhanre të caktuara. Kjo situatë folklorike, siç cek edhe studiuesi A. Xhagolli "mbart me vete edhe problemin e ruajtjes ose jo të autenticitetit folklorik, pasi, krahas veprimit të spontanitetit dhe të rregullsive folklorike, ndjehet edhe ndërhyrja e "specialistëve", të aftë për të bërë gjithçka, por jo lënien e lirë dhe zhvillimin normal të folklorit në rrugën e vet të zakonshme".[4]

Por, një dukuri e këtillë është e njohur që në periudha të më hershme të zhvillimit dhe promovimit të kulturës shpirtërore në botë. Për një dukuri të këtillë shkruan studiuesi P. Burke në studimin e tij për epokën e Evropës para-industriale, kur siç i quan ai 'artist popullor' si këngëtar, tregimtarë etj., duke shfaqur një 'kulturë popullore' fitonin bukën dhe konsideroheshin 'komuniteti zëdhënës'. Ata duke konkurruar për të tejkaluar kolegët e tyre shpesh përdornin improvizime duke ndryshuar kështu traditën. Nga ana tjetër, disa për të ruajtur traditën përdornin fjali që nuk i kuptonin, ndërsa të tjerët interpretonin preferencat e tyre. Kështu qoftë ajo këngë apo histori, ata 'artist popullor' rikrijonin në çdo performancë, duke lënë vend kështu për shumë risi.[5]

Prandaj, si pasojë e shfaqjes së këtyre dukurive, në folkloristikë është bërë emërtimi dallues duke përdorur termin *folklor* për krijimtarinë e mirëfilltë folklorike dhe *folklorizëm* për ato krijime që realisht janë të lidhura ngushtë me folklorin, por që praktikën e tij të ekzistimit e bëjnë jashtë zhvillimit natyral të folklorit.

Nëpërmjet të shembujve të shumtë të postimeve individuale në internet, si dhe të shfaqjeve skenike të shoqërive kulturo artistike të ndryshme, ku edhe bëhet përshtatja dhe ekspozimi i këtyre shfaqjeve në mas medie, mund të vërehen edhe një sërë elementesh larguese nga autenticiteti dhe ruajtja e formave të kulturës tradicionale dhe folklorit. E në rastet edhe më të skajshme, kur këto shfaqje xhirohen nga ana e medieve për transmetime dhe plotësime hapësirash televizive, vije edhe te një manipulim i audiencës. Kjo dukuri në literaturën mbi mediet është emëruar si 'straged authenticity' *autenticitet i inskenuar* që do të thotë se në mas media transmetohet vetëm ajo që do të mund të pëlqehet nga shikuesit.[6] Kjo nuk do të thotë se krejt faji për këtë dukuri i takon mas medieve, sepse marrësi ose shikuesi në këtë rast duhet të veprojë si censurë preventive dhe të vendos se a duhet të pëlqehet ose ruhet dhe në çfarë forme një këngë e caktuar folklorike. Por kjo do të mund të arrihet vetëm me ngritjen e nivelit të njohurive mbi kulturën shpirtërore. Nisur nga këto ndryshime, një formë e këtillë e riprodhimit të vlerave të kulturës shpirtërore, po që se janë të përgatitura nga

[4] Xhagolli, Agron (2013) *Folklori shqiptar në bashkëkohësi*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit, Tiranë, f. 70.

[5] Burke, Peter (1991) *Junaci, nitkovi i lude: Narodna kultura predindustrijske Evrope*. Školska knjiga, Zagreb.

[6] Jelinčić, Daniela Angelina; Žuvela Bušnja, Ana, *Uloga medija u predstavljanju, mijenjanju i kreiranju tradicije,* (The Role of the Media in Presenting, Changing and Creating the Tradition), marrë në gusht 2016, http://bib.irb.hr/prikazi-rad?rad=380813

profesionist të fushës përkatëse, gjithsesi se do të kontribuonin në prezantimin sa më të denjë të vlerave kulturore tradicionale para një auditori shumë më të gjerë, po pse jo edhe të shfrytëzoheshin si një potencial i favorshëm për marketing kulturorë edhe në hapësirën virtuale.

Prandaj, në fund do të shtoja se kultura tradicionale shpirtërore e përhapur në hapësirën virtuale sot nuk paraqet tërësinë e asaj kulture tradicionale të dikurshme, por paraqet një kulturë tradicionale aktuale, ku për shkak të faktorëve të ndryshëm gjithnjë diçka humbet apo transformohet, duke pranuar forma e dukuri të reja të cilat shfaqen në periudha të caktuara, por që në të ardhme do të mund të bëhen edhe vetë pjesë e "traditës kulturore".

Bibliografia

Bausinger, Hermann (1982) *Usmeno,* Narodna Umjetnost, knjiga 19, Zagreb

Burke, Peter (1991) *Junaci, nitkovi i lude: Narodna kultura predindustrijske Evrope*. Školska knjiga, Zagreb

Frenk, Russell (2011) *Newslore, Cotemporary Folklore on the Internet*, University Press of Mississippi

Jelinčić, Daniela Angelina; Žuvela Bušnja, Ana, *Uloga medija u predstavljanju, mijenjanju i kreiranju tradicije, (*The Role of the Media in Presenting, Changing and Creating the Tradition), marrë në gusht 2016, http://bib.irb.hr/prikazi-rad?rad=380813

Strobach, Hermann (1982) *Direktna usmena komunikacija kao bitno obiljezje Folklora? (Uz povjesno obrazlozenje problema),* Narodna Umjetnost, knjiga 19, Zagreb

Xhagolli, Agron (2013) *Folklori shqiptar në bashkëkohësi*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit, Tiranë

Leontina GEGA-MUSA

TRADITIONAL CULTURE IN CYBERSPACE

Abstract

In the era of fast information that we are in, cyberspace has created the possibility for a new dominant form of communication between internet users. Communication appears in new forms, as are various sites like Google and Youtube, than various social networks, and various information portals. This new form of communication is also becoming the bearer of traditional culture in general, including spiritual in particular, which is beforehand being reconstructed by changing the traditional practice of performing, by being adapted to an auditor wishing to see them

off. This phenomenon in media literature has been labelled as 'staged authenticity', meaning that in media it is intended to be broadcast only what viewers might like, or what is considered to be authentic by stage managers (in this case, choreographers, directors...). Therefore in the internet are shown old values, or those that are build on them, as well as completely new creations, often alienated, offering and creating opportunities to access, analyze and study them, especially from perspective of social and humane fields.

The aim of this paper is to review the report that cyberspace dictates in transmitting a new form of traditional culture and to what extend it jeopardizes the authenticity and content specificity of traditional forms of culture.

Key words: cyberspace, communication, traditional culture, spiritual culture, authenticity.

Ibrahim BERISHA

E DREJTA E AUTORIT DHE INTERNETI: PRONA INTELEKTUALE, RASTI KOSOVA

Abstrakt

Shkrimi fokusohet në temën e pronës intelektuale dhe të drejtën e autorit në epokën e internetit. Shërbimet e internetit janë bërë lehtë të qasshme mbas vitit 2000 edhe në Kosovë dhe kjo ka shtuar problemet e menaxhimit të pronës intelektuale dhe të drejtës së autorit, përfshirë raportin ndërmjet veprës, tregut dhe publikut. Zhvillimi teknologjik digjital transformoi teknikat e editimit, të transmetimit dhe të komunikimit, veçmas duke sfiduar standardet klasike të mbrojtjes së të drejtës së autorit. Gjerësisht u ofruan mundësi të kopjimit, plagjiatit, mashtrimit, falsifikimit etj. të kulturës materiale dhe jomateriale: libra apo pjesë të tyre, vepra audiovizuale, arkitekturë etj. Në këtë punim do të trajtohet edhe norma rregulluese dhe vetërregulluese si dhe efekti i zbatimit të tyre, në mbrojtjen e të drejtës së edituesve dhe të autorit, në rastin e Kosovës. Po kështu adresohen edhe sfidat që shprehen për reformë të thellë të sistemit të së drejtës së autorit, me qëllim të përshtatjes me zhvillimet dinamike të teknologjisë infoormative.

Fjalët kyçe: *Kulturë, internet, komunikim, e drejta e autorit, Kosova, ligje.*

Shtrirja e teknologjisë informative dinamizoi decentralizimin e artit dhe kulturës edhe në Kosovë. Krijime zhanresh e gjuhësh të ndryshme u bënë lehtë dhe shpejt të qasshme. Konsumi i përmbajtjeve të artit, madje edhe nga ambiente më periferike lokale, ndërlidhi idenitetitet kulturore me sisteme diferente, u dha hapësirë për të hyrë në tregun përbashkët të pa kufizueshëm të dhëniemarrjeve. Në këtë kontekst, teknologjia informative ndikoi edhe në ndryshimin e kuptimit për kulturën "tonë" dhe kulturën e "tyre", të cilat të konzervuara kishin më shumë prirje përjashtuese se sa tërheqëse. Krahas shtrirjes së teknologjive informative dhe konvergjimit kulturor, u ngrit edhe tema e së drejtës së autorit dhe e mbrojtjes së pronës intelektuale. Edhe në Kosovë ka tendencë, krahas shtrirjes së teknologjisë informative, për të qenë në trendin normativ dhe etik, për të mos lejuar keqpërdorimin e të drejtës së autorit, përkatësisht të shfrytëzimit të pronës intelektuale, të veprës apo pjesëve të saj, pa pasur më parë pëlqimin e autorit apo botuesit.

1.1. Teknologjia informative dhe leximi

Shfrytëzimit i internetit në Kosovë nis nga viti 1990 përmes rrjetëzimit që shtrihet nga kompanitë private[1] duke qenë në fillim një numër simbolik përdoruesisht, kryesisht në qytetet kryesore. Interneti krahas një mundësie teknologjike kishte rëndësinë edhe të thyerjes së kufizimeve në komunikime publike, mbasi mediet elektronike, radiot dhe televzionet, në gjuhën shqipe, që nga korriku 1990 ishin ndaluar nga qeveria e Serbisë. Pas vitit 2000 kishte shtrirje dinamike dhe shtim të numrit të përdoruesve të teknologjive informative duke ndjekur dinamikën botërore në këtë fushë. Për të kuptuar këtë dinamikë të përdorimit do referuar krahasimit të statistikave të shtrirjes së tij dhe shtimit të numrit të konsumatorëve në botë. Në vitin 2010 kishte dy miliardë, ndërsa në muajin korrik 2016 në botë kishte 3,436,269,137 përdorues të internetit.[2] Tani mbi 50 për qind e popullsisë në botë ka qasje në internet. Edhe në Kosovë ka ngritje në shkallë të lartë të qasjes, madje kjo qasje është dukshëm më e lartë se sa mesatarja në botë. Internetin në Kosovë e përdorin 76.6% e popullsisë, përqindje kjo e përafërt me vendet e zhvilluara.[3]

Raport i Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit publikuar më 2013 njofton se shtrirja e internetit në vendet e zhvilluara është 77%.[4] Kështu, bazuar në këto statistika, Kosova bën pjesë në vendet me përdorim të lartë dhe të gjerë të internetit dhe është fare pranë mesatares me vendet e zhvilluara si SHBA, Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe Kanadaja, vende këto ku mbi 80 për qind e popullsisë kanë lidhje me internet. Shqipëria ende është më e vonuar se sa Kosova, pasi 62 për qind e popullsisë ka qasje dhe e shfrytëzon internetin.[5] Qasja e një përqindjeje kaq të lartë të popullsisë në Kosovë ka shtuar format, teknikat dhe kohën e shfrtyëzimit të përmbajtjeve intelektuale. Platformat dixhitale kishin efektin e tyre, ato ndikuan të përfitojnë jo vetëm lexuesit, por edhe krijuesit, artistët, shkencëtarët, studiuesit në tërësi, duke pasur mundësinë të konsumojnë nga rezultatet dhe kreativiteti autorial në gjithë globin. Teknologjia informative në shoqërinë e Kosovës, natyrisht sikur edhe në gjithë botën, ndikoi të paraqiten dukuri të reja sociale dhe kulturore. Nuk bëhet fjalë më vetëm për lexuesin elit, aristokrato-eknomik. Përdoruesit e librave dixhitalë janë kategori të ndryshme intelektuale, sociale dhe profesionale, moshe e gjinore. Hulumtimet në këtë fushë tregojnë trendin e rritjes së numrit të lexuesve që lexojnë E-librin, po edhe të blerësve të këtij libri. Rreth 20 për qind e gjithë librave të shitur në

[1] Për Ne-KUJTESA. http://adresari.net/place=kujtesa-net. (21.05. 2015)
[2] Internet users in the ëorld.ëëë.internetlivestats.com/internet-users/ (14.07.2016)
[3] Kosova në hap me standardet globale për depërtimin dhe përdorimin e internetit: www.stikk-s.org/index.php (20.7.2016)
[4] Kosova në hap me standardet globale për depërtimin dhe përdorimin e internetit. ëëë.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/ICTFactsFigures2013.pdf
[5] Internet users in the world.www.internetlivestats.com/internet-users/ (14.07.2016)

SHBA i përkasin E-librit,[6] ndërkohë që në Britani të Madhe kjo përqinjedje arrin në 10 për qind.[7] Ndërkohë edhe leximi i librit elektronik është duke ndryshuar që lë të kuptohet se po rritet edhe numri i lexuesve në ekran. Një e katërta e francezëve kanë lexuar më shumë vepra në ekran se sa në letër.[8]

1.2. E-libri shqip jashtë internetit

Publikimi dhe oferta e librit në gjuhën shqipe në Kosovë, ka ngecje jo vetëm në formë eletronike, po edhe në formë të printuar. Këtë e tregon numri i vogël i publikimeve konvencionale. Bazuar në raportet e Zyrës së ISBN në Bibliotekën Kombëtare dhe pastaj edhe nga dorëzimi i ekzemplarit të detyrueshëm të botuesve në këtë Bibliotekë, në Kosovë në vitin 2011 janë botuar 296 tituj libri, në 2012- 475 tituj, më 2014- 567 tituj, më 2015- 1127 tituj dhe në gjashtëmujorin e parë 2016, 367 tituj.[9] Numri i botimeve tregon për ngecjen që vazhdon të përcjell financimin e projekeve të librit kovencional, dhe në këtë kontekst edhe të krijimit të bibliotekave dhe librarive digjitale, si formë më e lehtë dhe më e lirë e transmetimit të botimit nga edituesi tek lexuesi. Mungesa e bibliotekave dhe librarive digjitale favorizon shtimin e kopjimeve konvencionale, të cilat janë të përhapura në të gjitha qytetet e Kosovës. Nuk ka shitje të librit elektronik pos nga sisteme globale. Madje ende diskutohet për mungesë dhe hezitim të kulturës së botuesve dhe të autorëve për të plasuar veprat e tyre në libraritë dhe bibliotekat digjitale. Do theksuar që kundërvënia për të plasuar në rrjete interenti librin bëhet edhe nga dhe disa nga autorët më të famshëm të letërsisë dhe të shkencës. Shkrimtari franko-çek Milan Kundera refuzon të lejojë dixhitalizimin e librave të tij. Ai madje kontratave me botues u shton klauzolën ku thuhet se romanet e tij mund të publikohen vetëm në formë tradicionale të librit, me qëllim që të lexohet vetëm në letër dhe jo në një ekran.[10]

[6] Nocioni E-Book, (nga anglishtja "libër elektronik") është përkufizim identik me termin - Terminus, një përkufizim ky për librin e shtypur në letër, dhënë nga UNESCO: Libri është botim jo-periodik me të paktën 49 faqe, duke përjashtuar faqet e kopertinës, botuar në një vend dhe duke ia paraqitur ato publikut.(7) (7 UNESCO (1965): Recommendation concerning the International Standardization of Statistics Relating to Book Production and Periodicals vom 19.11.1964. In: Records of the General Conference. Thirteenth Session. Resolutions. Paris: United Nations Educational, Scientific an Cultural Organization, S. 144.)

[7] Mary Murrell. The datafied book and the entanglements of digitization. ANTHROPOLOGY TODAY VOL 30 NO 5. OCTOBER 2014.

[8] Ibid.

[9] Raport Zyra e ISBN. Biblioteka Kombëtare e Kosovës. Prishtinë.(20.06.2016).

[10] Le numérique ne passera pas par Kundera. Par LEXPRESS. http://ëëë.lexpress.fr/culture/livrer, publié le 19/07/2012

1.3. Mbrojtja e të drejtës së autorit

Shtrirja dhe përdromi i internetit në Kosovë, sikur edhe në gjithë botën, shumëfishuan mundësitë për keqpërdorimin e të drejtës së autorit. Marrëdhënia e pronës intelektuale dhe e internetit nisi të jetë temë e hulumtuar nga fundi i viteve 1990, ndikuar nga përfshirja e teknologjive informative, të cilat marrin rol të madh në krijimin dhe shpërndarjen e prodhimeve intelektuale. Është normë e përgjithshme se një vepër origjinale ka një autor apo grup autorësh, të cilët janë pronarë të autorizuar, dhe autorësia atyre duhet t'u njihet në formë të ligjshme. Vepra autoriale është e drejtë e njohur, e pranuar dhe patjetërsueshme (ang: *intellectual property*) që mbrohet përmes ligjit. Prona intelektuale (IP) u referohet kreacioneve të mendjes, si shpikje; krijime letrare dhe artistike; dizejn dhe simbole, emra dhe imazhe që krijohen, plasohen dhe shiten në treg.[11] Natyrisht se mbrojtja përfshin disa kategori, duke pasur parasysh specifikat zhanrore të prodhimtarisë origjinale intelektuale. *Trademark* (marka) mbulon fushën e dizejnit: emri, shenja, llogo, imazhi i kompanisë përmes së cilat ajo identifikohet para konsumatorit. Lufta për të krijuar *trademark*-s të veçanta ka bërë që sot kompanitë që synojnë të hyjnë në treg të shpenzojnë miliona në krijimin e *trademark*-eve. Tiparet dalluese të një kompanie synohet të jenë sa më inovative, origjinale dhe të nguliten në mend nga konsumatori. Për këtë arsye e drejta e trademark, kësisoj rregullon mbrojtjen e simboleve, llogove, sllloganeve kur ato i njihen kompanisë si e tillë.[12]

Copyright, në anën tjetër përkufizon e mbron punën e autorit dhe ka të bëj edhe më të drejtën për përdorim dhe shpërndarje. Kjo lloj mbrojtjeje përfshin forma krijuese sikur librat, pikturat, filmat, fotografitë, veprat muzikore, vallëzimet, dizajnet etj. Për të treguar se sa shumë është i shtrirë keqpërdromi *trademark* dhe *copyright* në Kosovë, tregon një hulumtim i shkurtër bërë në dizejnin dhe shenjat e lokaleve në Prishtinë. Ndikuar edhe nga imazhet në internet bëhet dizejni i stereotipizuar prishtinas që duket në rrugë dhe lokale: MANGO, TERRANOVA, ADIDAS, NIKE, REEBOK, PUMA, AND1, VANS, LITLLEBIG, PEKO, BITSIANI, SPRIENGFIELD, GOLDEN POINT, GEOX, IL CAMMINO, VOGUE, VERSACE, DIESEL, GUCCI, POLICE, VERSACE, CHANNEL, RAYBAN, SWATCH, CHANNEL, TOMMY HILFIGER, MORELATO, SËAROVSKI, UNITED COLOURS OF BENNETON, PHARD, MISS SIXTY, LISCA. Natyrisht se prodhimet në lokalet e Prishtinës nuk kanë të bëjnë me kompanitë e mëdha, por janë pjesë e mashtrimit, ngjashëm me atë në grabitjen e pronës intelekutuale në arte dhe shkencë.

[11] What is Intellectual Property? WIPO**,** ttp://www.wipo.int/portal/en/index.html (12.06.2016)
[12] Ibid.

2.1. Liria e kopjimit

E drejta e autorit dhe mbrojtja e pronës inteletuale në teknologjitë digjital, në Kosovë, nis mbas vitit 2000. Është koha kur Kosova qeveriset nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, UNMIK, dhe shtrirja e internetit detyron Institucionet e Përkohshme, të bëjnë hapat e parë në krijimin e normës rregulluese dhe vetrregulluese për të frenuar shfrytëzimin e paligjshëm të përmbajteve intelektuale në formë të piratërisë, mashtrimit, kopjimit, plagjiatit.[13] Format e shkeljes ishin shumë më të llojllojshme se sa kornizimi ligjor për të mbrojtur dhe aq më pak, mund të bëhet fjalë për ndonjë mundësi ndëshkimi për ndërhyrësit dhe shfrytëzuesit e paligjshëm të pronës intelektuale në teknologjitë informative. Do pasur parasysh, se përvoja e marrjes së rezultateve nga veprat origjinale nuk ishte e re. Ajo kishte ekzistuar edhe në shoqërinë komuniste, por nuk kishte pasur ndëshkime edhe në rastet kur qe zbuluar se ishte marrë punë dhe e arritur intelektuale, shkencore apo artistike, të një autori apo grup autorësh nga një autor tjetër pa u shënuar burimi apo edhe pa u marrë pëlqimi i autorit apo trashëgimtarëve të të drejtës autoriale.

E drejta e autorit ishte përcaktuar edhe në rregulloret për medien e shkruara dhe atë elektronike nxjerrë nga UNMIK. Këto rruegullore nuk qenë të fokusuara fare në komponentën e autorësisë dhe në vitet 1999-2004 shkelja e kësaj drejte mori përmasa të gjëra. Për të frenuar procesin e shkeljes dhe për të mbrojtur të drejtën e autorit, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr.2004/45 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta në vitin 2006. Ligji përcaktuoi që të konstituohet Zyra për të Drejtat e Pronës Intelektuale në kuadër të Ministrisë për Rini, Kulturë dhe Sport të Kosovës dhe puna e kësaj Zyreje ishte "të autorizojë dhe licencojë subjektet kompetente për të mbrojtur të drejtat e autorit". Zyra kishte edhe detyrën për të promovuar ndërmarrjen e aktiviteteve për dhënien e informatave të duhura autorëve, bartësve të të drejtave dhe opinionit të gjerë lidhur me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta; përcjelljen e legjislacionit ndërkombëtar dhe dhënien e rekomandimeve përkitazi me fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.[14] Vonesa e punës së Zyrës për tre vjet nga miratimi Ligjit, dhe pastaj edhe mospuna e saj bëri që të mos frenohej kopjimi dhe plagjiati konvencional, dhe kuptohet, aq më pak, të mundësohet mbrojtja e pronës intelektuale në platforma dhe linçe të teknologjive informative, veçmas në internet. Prishtina, qendra ku janë të koncentruara institucionet universitare dhe qeveritare, është e mbushur me lokale të fotokopjimit, në të cilat kopjohen ilegalisht libra pa pasur fare lejen e autori apo botuesit. Zyra për të

[13] Përfaqësuesi Speciali i OKB, nxjerr dy rregullore, dhe aty ndalohet marrja e paautorizuar e punës intelektuale të tjetrit: Rregullorja nr. 2000/37, UNMIK, Prishtinë/ Rregullorja nr. 2000/36, UNMIK, Prishtinë.

[14] Doc. Informacioni mbi Piraterinë. Ministra e Kulturës, Rinisë dhe Sportit www.mkrs-ks.org. (24.07.2016)

Drejtat Intelektuale nuk ka ndikuar fare në luftimin e piraterisë digjitale. Edhe në faqen e Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Kosovës, pranohen problemet e kahershe se "uebsajtet ofrojnë linçe apo lidhje të uebsajteve të ndryshme, ku vendosen materiale, të cilat shkelin të drejtën e autorit, për shembull në muzikë apo filma, sa do që janë të identifikuara një numër i tyre."[15] Natyrisht që duhet ndërhyrje për bllokimin e këtyre uebsajteve për territorin e Kosovës, në bazë të detyrimeve ligjore lokale por edhe obligimi që pason për respektimin e dokumentave ndërkombëtarë që të bllokohen serveret që bëjnë ndërhyjre dhe shkelin të drejtën e autorit.

2.2. Ligjet për të drejtën e autorit

Kosova ka miratuar një mori ligjesh, të cilat mbulojnë fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta. Këto ligje janë të harmonizuara me parimet themelore ndërkombëtare që burojnë nga konventa, rregullore, direktiva si edhe marrëveshjeve të ndryshme dhe ato rregullojnë të drejtën e pronës intelektuale.[16] Për të paraqitur një pasqyrë më të plotë për punën e bërë në krijimin e normës rregulluese në këtë fushë, do përmendur ligjet kryesore, të cilat janë në fuqi (2016): Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta Nr. 04/L-065; Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale Nr. 03/L-170; Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimeve kibernetike, Ligji Nr. 03/L-166; Ligji për investimet e huaja - Nr. 02/L-33; Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik - Nr. 02/L-67; Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, 20 Prill 2012.

Ligji që më për së afërmi trajton të drejtën dhe mbrojtjen e punës intelektuale, është ai për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta që u miratua në vitin 2011, me të cilin përcaktohet struktura dhe përmbajtjet e pronës inteleletuale, të cilat janë të mbrojtura, ndërsa shfrytëzimi i paautorizuar i tyre tërheq ndëshkime ligjore. Ai mbron veprat letrare, artistike, shkencore, publicistike dhe veprat tjera duke nënkuptuar krijimet origjinale intelektuale, pavarësisht formave të shprehjes si vepra të shkruara, përfshirë edhe programet në kompjuter.[17] Kur është fjala për programet e kompjuterit në Kosovë kemi të bëjmë me dukurinë masive të piraterisë, e cila përfshin riprodhimin dhe shpërndarjen e kopjeve të mbrojtura me të drejtën e autorit, apo komunikimin dhe vënien në dispozicion të materialit të mbrojtur në internet, pa autorizim parprak,[18]

[15] Ibid.

[16] Ligjet për mbrojtjen e të drejtës së autorit në Kosovë kanë respektuar dokumentat ndërkombëtarë për këtë çështje nisur nga Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike të vitit 1886 e deri te Direktiva 2009/24/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 23 prill 2009 që ka të bëjë me mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike.

[17] Neni 1. Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta të Përafërta / Gazeta Zyrtare e Republiks së Kosovës / Nr. 27 / 30 Nëntor 2011. Prishtinë.

[18] Ibid.

dmth. kur autorizimi i tillë është i nevojshëm në bazë të ligjit.[19] Ndërsa si forma më të kamufluara të shkejes së të drejtës së autorit vazhdojnë të jenë citimet, të cilat merren të pjesshme dhe nuk theksohet burimi, dmth. se prej nga është marrë në internet. Mundësia e identifikimit të kopjimit të citimeve është e vështirë. Ligji për të Drejtat e Përafërta e ka përkufizuar këtë veprim si shfrytëzimi "për veprën vetanake i pjesëve të shkëputura nga një vepër e huaj e publikuar, ose vepra e plotë e huaj e publikuar....".[20]

Ndëshkimet e parapra për persona fizik dhe juridik në Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta nuk kanë zbrapsur kopjimin dhe keqpërdorimin e veprave intelektuale. Në nenin 190,[21] parashihet ndëshkimi për persona fizik prej 500 derë në 2.000 euro, ndërsa për persona juridik 2.000 deri në 10.000 euro. Ndërsa neni 191, për kryerje të veprimit të shmangies së masave teknologjike dhe për kryerje të veprimit të heqjes apo ndryshimit të informacionet elektronik të realizimit të të drejtave, personi juridik do të dënohet prej 5.000 deri në 25.000 euro dhe personi fizik prej 1.000 deri në 5.000 euro. Edhe Kodi Penal i Kosovës trajton mbrojtjen e të drejtës së autorit. Neni 296 vë në theks se cenimi i të drejtës së autorit përfshinë veprimet e më poshtme: Kushdo që nën emrin e tij apo të dikujt tjetër, shfaq apo në ndonjë mënyrë tjetër i kumton publikut punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjen e tjetrit, në tërësi apo pjesërisht, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.[22]

Përfundim

Kosova është në një pikë të ulët të mbrojtes së të drejtës së autorit dhe të pronës intelektuale. Aq më pak kjo mbrojtje bëhet në teknologjitë informative. Veprat e letërsisë, shkencës, artit, publicistikës, filmit, muzikës-audio dhe videot, video lojërat etj. në internet, por edhe në medie dhe publikime konvencionale, jo vetëm konsumohen pa pasur këtë të drejtë më përpara, por bëhet edhe zhvendosja e plotë e autorësisë. Për shkak të përdorimit të *google translate*, është vështirë të dihet ndonjëherë se kemi të bëjmë me marrje prone intelektuale të paautorizuar dhe vetëm vënia e programeve kontrolluese për zbulimin e plagjiateve mund të ndihmojë në frenimin e kopjimeve dhe mashtrimeve në fushën e të drejtës së autorit.

Vetëm ndëshkimet nuk arrijnë të mënjanojnë dukurinë e përhapur të shkeljes së të drejtës së autorit në Kosovë. E drejta e autorit dhe e mbrojtes së pronës intelektuale, nuk arrrin të mbulohet vetëm me ligje, por ka më shumë hapësirë për kulturë etike dhe publike, për të ndihmuar konsumuesit e internetit të arsimohen, të

[19] Doc. Informacioni mbi Piraterinë. Ministra e Kulturës, Rinisë dhe Sportit www.mkrs-ks.org. (24.07.2016)
[20] Neni 50. Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta të Përafërta / Gazeta Zyrtare e Republiks së Kosovës / Nr. 27 / 30 Nëntor 2011. Prishtinë.
[21] Ibid.
[22] Neni 296. Kodi Penal i Kosovës. NR. 04/L-082/2012. Kuvendi i Kosovës. Prishtinë.

mos bëhen aktorë të kopjimit, piraterisë, falsifikimit dhe mashtrimit. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, ka një strategji për edukimin e nxënësve, studentëve dhe mësuesve për çështjet e të drejtave të autorit dhe përshtatjen e kurrikulave mësimore në të gjitha nivelet e arsimimit, me temat për të drejtat e autorit. Është e kuptueshme, se për të krijuar kulturën e respektimit të të drejtës së autorit dhe të pronës intelektuale nuk është e lehtë, aq më pak, pa edukim për komunikim intelektual përmes tekonolgjive informative.

Literatura

Bertrand Colude-Jean.1997. Deontologjia e medieve. Tiranë.
Baylon, Christian & Mignot, Xavie. 2004. Komunikimi, LogosA, Shkup.
Berisha, Ibrahim.2007. Media, agjensët e komunikimeve. AAB. Prishtinë
Berisha, Ibrahim. 2009. Konvergjenca mediale. PEN. Prishtinë.
Boef, M. Le.1991. Imagination, Inspiration, Innovation. MVG.
Day, Luis Alvin. 1999. Ethics in Media Communications and Controversis, e—book, fefth edition./ www. amazon.com.
Jakubowicz, Karol. 2001. Media in Transition. London. Routledge.
Karlsrajter, Ana. 2003. Mediat në shoqëritë shumë gjuhësore.OSBE. Vjenë.
MCluhan Marshall. 2004. Instrumentat e komunikimit. Tiranë.
Yoffie, David B. 1997. Competing in the age of digjitale convergence. Boston.
Doc. Ligji Nr. 04/L-065 Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Prishtinë.
Kushtetua e Republikës së Kosovës (me amendamentet I-XXIII). Nëntor 2013. Prishtinë.
Ligjit i Komisionit të Pavarur të Medies Nr. 04/L-44. Prishtinë.
Ligji për Qasje në Dokumente Publike LIGJI Nr. 03/L-215. Prishtinë.
Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë Ligji Nr. 04/L-137. Prishtinë.
Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik, Nr. 03/L-166. Prishtinë.
Ligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve.2015. Prishtinë.
Ligji për Mbrojtjen e Informator Nr. 04/L-043. Prishtinë.
Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, Nr. 04/L-046.
Rregulloren nr. 2000/3. UNMIK. Prishtinë.
Rregulloren nr. 2000/36. UNMIK. Prishtinë.
Raporte: www.stikk-ks.org.
Raport:/www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/ICTFactsFigures 2013.pdf.
Biblioteka Kombëtare e Kosovës. www.biblioteka-ks.org/.

Ibrahim BERISHA

THE INTERNET AND AUTHOR'S RIGHTS INTELLECTUAL OWNERSHIP, CASE KOSOVO

Abstract

This article focuses on the topic of intellectual property and author's rights in the epoch of the internet. Internet services have become easily accessible after 2000 in Kosovo as well, and this had led to problems of managing intellectual property and the copyrights of the author including the relationship between the work (as property), the market and the public. Technological advancement transformed editing, transmitting and communication techniques, thus challenging the classic standards of protecting the rights of the author. Opportunities at copying, plagiarizing, fraudulence, falsification, etc. of both material and immaterial culture were widely spread: books or sections of books, audiovisual sources, architecture, etc. Works or sections of works can easily be found in electronic pages, in online communication, regardless of the approval of the editor or the author. This paper will treat both the regulatory and self-regulatory norm and the effect of their application in protecting the rights of the editor and the rights of the author in Kosovo. Challenges on a fundamental reform of the existing system will also be addressed with the purpose of adaption with the dynamic developments of digital technology.

Key words: Culture, internet, communication, author's rights, Kosovo, regulatory norm.

Rezarta GJERGJI

MEDIA SHKOLLORE DHE EDUKIMI QYTETAR I NXËNËSVE

Abstrakt

Media shkollore në ditët e sotme përbën një pjesë të rëndësishme të strukturës së shkollës. Tashmë, në shekullin XXI, atë mund ta shohim absolutisht si pjesë të rëndësishme për rritjen e rezultateve shkollore dhe në rritjen e edukimit qytetar të nxënësve. Kur flasim për median shkollore, kemi parasysh, si fillim, bibliotekën e shkollës, si burim kryesor informacioni. Më pas, këndvështrimin për median do ta shtrijmë te gazeta dhe revista e shkollës.

Mediat shkollore luajnë një rol shumë të rëndësishëm për t'u mundësuar nxënësve informacione të temave të ndryshme dhe për t'u mësuar atyre sesi ta përvetësojnë dhe ta përdorin atë informacion.

Ky punim do të shohë pikërisht rëndësinë e mediave shkollore në lidhje me dy ndryshore: ajo e pavarur e medias shkollore (ku përfshihen biblioteka, këndi i klasës, gazeta dhe revista e shkollës) dhe ajo e varur (ku përfshihet edukimi qytetar). Për matjen e këtyre ndryshoreve do përdoren pyetësorë me nxënësit dhe intervista gjysmë të strukturuara me mësuesit.

Punimi është i fokusuar te hipoteza: Përfshirja e nxënësve në median shkollore ndikon në edukimin qytetar të tyre. Gjithashtu, punimi fokusohet në pyetjet vijuese kërkimore: Sa ndikon media në edukimin e fjalës së lirë? Sa ndikon media në edukimin e shumëllojshmërisë kulturore? Sa ndikon media në edukimin e mendimit ndryshe? Sa ndikon media në edukimin e të drejtave të fëmijëve? Sa ndikon media në edukimin e humanizmit?

Rezultatet e studimit na çojnë në vërtetimin e hipotezës se ka një ndikim të medias shkollore në edukimin qytetar të nxënësve. Sa më të informuar të jenë nxënësit dhe sa më të zgjeruar ta kenë horizontin ata, aq më pozitive janë sjelljet e tyre dhe niveli i edukatës së tyre qytetare rezulton edhe më i lartë.

Fjalë kyçe: *media shkollore, edukim qytetar, biblioteka e shkollës, gazeta e shkollës, revista e shkollës.*

1. Hyrje

Shkolla është institucioni ku fëmija merr formimin bazë, mëson dhe u jep më tepër formë karakterit dhe prirjeve të tij drejt së ardhmes. Në shkollë, fëmija rritet, nxë dhe njeh më mirë veten dhe fushat mësimore ku ai jep maksimumin. Për këtë arsye, nuk është shumë më i rëndësishëm vetëm integrimi, sesa përfshirja aktive e nxënësit, të çfarëdolloj kategorie qoftë ai, në të gjitha programet dhe aktivitetet e shkollës.

Punimi flet për median shkollore dhe ndikimin e saj në edukimin qytetar të nxënësve. Në përgjithësi, është një term i ri që i referohet një shumëllojshmërie të madhe të akseseve që mund të kenë nxënësit për shkollën e tyre, duke përfshirë: libraritë shkollore ose bibliotekat, revistat ose gazetat, *websitet* shkollore etj. Në fakt, media shkollore fillon nga biblioteka e shkollës, e cila është vendi ku të gjithë do të marrin burime informacioni. Studime të shumta e lidhin ndikimin e mediave shkollore jo vetëm me edukimin qytetar të nxënësve, por edhe me arritjet e tyre shkollore (Lance, Keith Curry, 1994).

Historikisht, si burim primar i mediave shkollore shihet biblioteka e shkollës dhe, më pas, gazetat apo revistat e shkollës. Mediat shkollore luajnë një rol shumë të rëndësishëm për t'u mundësuar nxënësve informacione të temave të ndryshme dhe për t'i mësuar ata sesi ta përvetësojnë dhe ta përdorin çdo informacion. Në ditët e sotme, median shkollore nuk mund ta përkufizojmë vetëm në të pasurit e një biblioteke shkollore apo reviste shkollore. Pajisja me sisteme kompjuterike u krijon shkollave mundësi dhe hapësira më të mëdha për informimin e nxënësve. Nevoja për të pasur mjedise "high-tech" apo të një teknologjie të lartë, siguron përvoja të reja të procesit të të nxënit.

2. Metodologjia

Ky kërkim bazohet te deduksioni, që nënkupton se, për zhvillimin e këtij punimi, është kaluar nga e përgjithshmja në të veçantën. Deduksioni përfaqëson një metodë studimi e arsyetimi që niset nga teza e këtij punimi e cila, siç është evidentuar që në krye, është të vërtetojë se media shkollore ndikon në edukimin qytetar të nxënësve. Ndaj, për këtë punim, është nisur nga e përgjithshmja se media shkollore ndikon në edukimin qytetar për ta kufizuar këtë gjë në shkollën 9-vjeçare "Kushtrimi i Lirisë" në qytetin e Durrësit. Deduksioni nënkupton nxjerrjen e një përfundimi nga një mendim i përgjithshëm. Metodat deduktive na ndihmuan të grumbullojmë dhe të përpunojmë një material të pasur faktik, prej të cilit arritëm të nxjerrim përfundime të veçanta.

Gjithashtu, gjatë hartimit të punimit tonë iu referuam dhe metodës metafizike, metodë që lidhet në mënyrë të shumanshme me natyrën njerëzore, meqenëse matja zhvillohet midis medias shkollore dhe edukimit qytetar. Në fakt, metafizika

konsiderohet komplekse, por, në këtë punim, ne e shohim atë në kontekstin e lidhjeve dhe të bashkëveprimit midis nxënësve dhe mësuesve (kulturës, etikës dhe edukimit qytetar të nxënësve).

Për realizimin e punimit zhvilluam 120 pyetësorë dhe 7 intervista gjysmë të strukturuara. Pyetësorët janë sasiorë me zgjedhje të shumëfishta, me pikëzim nga 1 deri në 4 dhe me 3 alternativa: Po, Jo, Nuk e di. Pyetësori përmban në total 24 pyetje, të cilat fokusohen te çështjet kryesore të temës, të cilat janë dy: Media shkollore e pavarur dhe ndikimi i saj në edukimin qytetar të nxënësve. Edukimi qytetar ndikohet drejtpërsëdrejti nga media shkollore, varet prej saj, ndaj vlerësohet si ndryshore e varur. Ndërkohë që, kur flasim për median shkollore, në punim kemi përfshirë bibliotekën e shkollës, faqen e saj në internet e aksesuar nga nxënësit, revistat dhe gazetat e shkollës, gjithashtu, edhe këndin e shkollës. Siç do ta trajtojmë në vijim, shkolla "Kushtrimi i Lirisë" ka edhe gazetën e saj, e cila aksesohet nga nxënësit dhe trajton çështje që lidhen drejtpërdrejt me interesat e nxënësve.

Intervista gjysmë e strukturuar, që është instrumenti i dytë matës, fokusohet te marrja e opinioneve, perceptimeve dhe interesave të mësuesve dhe të drejtuesve të shkollës. Fokus-grupi i të intervistuarve përbëhet prej 5 mësuesish (tre mësues të gjuhës shqipe, një mësues të gjuhës angleze dhe një mësues gjeografie), ndërsa një intervistë u zhvillua me psikologun e shkollës dhe një tjetër me drejtuesin e shkollës. Intervistat gjysmë të strukturuara përbëhen nga 9 pyetje të hapura, në mënyrë që informacionet e marra të jenë sa më subjektive (individuale) dhe, më pas, të krahasoheshin me ato të nxënësve te kapitulli i rezultateve.

Pra, për hartimin e studimit u përfshinë 120 nxënës të shkollës "Kushtrimi i Lirisë" në qytetin e Durrësit, 5 mësues, psikologu dhe drejtuesi i shkollës. Nxënësit u zgjodhën në mënyrë krejt rastësore, mbështetur në listën emërore në regjistrat e klasave VI-IX (secila klasë ka nga tri paralele, dhe në secilën klasë u ftuan në pyetësor 10 nxënës). Nxënësit përfaqësojnë nivele të ndryshme formimi shkollor dhe kulturor.

Gjithashtu, u zbatua edhe etika e privatësisë, ruajtja e fshehtësisë së të dhënave personale. Asnjë nxënësi nuk i është kërkuar të shënojë emrin në pyetësor. Pyetësorët u realizuan gjatë muajit maj, në praninë tonë, për t'i ndihmuar ata për ndonjë paqartësi që mund të hasnin gjatë plotësimit.

Pas plotësimit të pyetësorëve nga nxënësit, u bë përmbledhja e tyre, u hodhën rezultatet në tabela në Excel dhe rezultatet u përpunuan më pas me Spss, i cili është një program që përdoret për analizat statistike në shkencat shoqërore.

3. Vlerat e medias shkollore

Kur flasim për media shkollore dhe për edukim qytetar të nxënësve, nuk mund të lëmë pa përmendur vlerën që ka media shkollore te nxënësit.

- Nxënësit që përdorin median shkollore:

- ✓ kanë më shumë gjasa të arrijnë rezultate të larta;
- ✓ janë frekuentues të rregullt të bibliotekës së shkollës, janë më aktivë dhe marrin pjesë masivisht në veprimtaritë që zhvillohen gjatë orëve të mësimit;
- ✓ parashtrojnë argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media;
- ✓ njohin dhe përdorin programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemeve dhe për kryerjen e detyrave në lëndët/fushat mësimore;
- ✓ bashkëveprojnë në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët.

- Nxënësit që janë frekuentues të vazhdueshëm të bibliotekave të shkollave, janë vazhdimisht në kërkim të dijeve për të zgjeruar njohuritë e tyre dhe zhvillojnë kompetenca që i përdorin në shkrime që botojnë në gazeta apo revistën e shkollës, madje dhe në media lokale e kombëtare.
- Mirorganizimi i medias shkollore:
  - ✓ promovon shumëllojshmërinë e kulturave dhe bën që të gjithë nxënësit, pavarësisht përkatësisë, të ndihen të barabartë në komunitetin shkollor;
  - ✓ u ofron nxënësve informacione dhe një realitet të caktuar;
  - ✓ i nxit nxënësit të "negociojnë" me median për më shumë informim, argëtim etj.;
  - ✓ zhvillon te nxënësit kompetenca, ndërthur dije, qëndrime dhe vlera që u nevojiten atyre për zhvillimin vetjak, qytetarinë aktive dhe përfshirjen shoqërore, për zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave;
  - ✓ është për nxënësit burim informacioni për tema të ndryshme duke u mësuar atyre sesi ta zotërojnë dhe ta përdorin atë informacion.

4. Literatura

Kur flasim për median shkollore, referenca e parë shkon te biblioteka e shkollës, biblioteka e parë, me të cilën njihen shumë fëmijë dhe adoleshentë në mjediset shkollore, dhe e cila shërben si bazë për promovimin e lirisë intelektuale. Aspektet e lirisë intelektuale shihen në një këndvështrim të gjerë nga përgjegjësit e bibliotekës së shkollës, për faktin se ata janë përgjegjës për krijimin e një aksesi fizik dhe intelektual, procedura dhe shërbime që kanë të bëjnë me bibliotekën e shkollës.

Duke qenë se pikëpamjet rreth shkollës janë në zhvillim e sipër, e njëjta gjë ndodh edhe me bibliotekën e shkollës. Nocioni i teksteve shkollore, si i vetmi burim

informacioni i përdorur në mësimdhënie në shumë mjedise mësimdhënieje, është zëvendësuar me metodologjinë e mësimdhënies të bazuara në burime të ndryshme. Në këtë formë mësimdhënieje, mësuesi njeh mënyrat individuale të përvetësimit nga ana e nxënësve dhe, gjithashtu, njeh variacionin e interesave, aftësive, rezultateve dhe *background*-in e çdo nxënësi në një metodologji përvetësimi të shumanshme.

Biblioteka e shkollës duhet të sigurojë akses ndaj burimeve të shumta duke përfshirë materiale në bibliotekat e shkollave, në bibliotekat shtetërore dhe *network*-eve. Biblioteka e shkollës funksionon si një mundësi për mësuesit që të kenë kontakt me të dhe t'u sigurojnë nxënësve akses ndaj librave të ndryshëm për projekte shkollore, në mënyrë që, me këto projekte shkollore, të krijohet mundësia e ndërveprimit midis nxënësve. Biblioteka e shkollës konsiderohet si pikë kyçe e medias shkollore, sepse mësuesit e bibliotekës, mësuesit e shkollës, mësuesit e medias dhe administratorët e shkollës punojnë së bashku për të siguruar mundësi shoqërore, kulturore dhe edukative për rritjen e performancës së nxënësve.

Gjithashtu, aktivitete që përfshihen në planin mediatik të medias shkollore, mund të zhvillohen në mjediset e bibliotekës, ose në laboratorët e shkollës duke shfrytëzuar burime të marra nga biblioteka e shkollës. Programi i UNESCO-s parashtron disa synime të bibliotekës së shkollës, të cilat janë:

- Biblioteka e shkollës është pjesë integrale e procesit edukativ.
- Pikat vijuese janë të domosdoshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies, të nxënit, literaturës dhe edukimit kulturor dhe qytetar të nxënësve:
  - ✓ Mbështetja dhe rritja e synimeve edukative sipas kurrikulës së shkollës.
  - ✓ Zhvillimi i të lexuarit dhe të mësuarit te nxënësit dhe përdorimi i bibliotekës gjatë gjithë jetës së tyre.
  - ✓ Ofrimi i mundësive për përvojë duke përdorur informacionin për dije, kuptim, imagjinatë dhe argëtim.
  - ✓ Mbështetja e të gjithë nxënësve për mësimin dhe praktikimin e aftësive duke përdorur informacione të marra nga media shkollore dhe jo vetëm;
  - ✓ Sigurimi i aksesit te burimet globale, kombëtare, rajonale dhe lokale dhe mundësitë për t'i ekspozuar nxënësit me ide, përvoja dhe opinione.
  - ✓ Organizimi i aktiviteteve që inkurajojnë ndërgjegjësimin social dhe kulturor.
  - ✓ Të punuarit me nxënësit, administratorët dhe mësuesit për të arritur misionin e shkollës, duke mbështetur konceptin se liria intelektuale dhe aksesi ndaj informacionit janë thelbësore dhe përgjegjëse për edukimin qytetar të nxënësve.

- Biblioteka e shkollës i përmbush këto funksione duke zhvilluar politika dhe shërbime, duke përzgjedhur dhe duke siguruar akses intelektual ndaj burimeve të duhura të informacionit, duke siguruar shërbime të duhura dhe duke punësuar staf të trajnuar (UNESCO, 2014).

Vitet e fundit, edukimi qytetar, një element i rëndësishëm që demokracia të lulëzojë, është lënë në përgjegjësi të shkollave publike, universiteteve dhe kolegjeve. Por çfarë është edukata qytetare? Është zhvillimi i çdo personi në jetën civile; personi në bordet e shkollave, bordet e komunitetit. Njerëzit mund ta mendojnë edukimin qytetar si kohë të shpërdoruar, me fëmijë apo të rinjtë mbyllur në një klasë. Por ky është një koncept i gabuar, normalisht, sepse arsimi nuk ka të bëjë vetëm me studimin dhe reflektimin, por me ndërmarrje të veprimeve, me vënien në jetë të atyre që mësojmë, me marrjen e masave. Ashtu siç e drejta civile nuk është diçka që ne e mësojmë, por është diçka që e jetojmë. Gjithmonë do jetë një përgjigje dhe për rëndësinë e madhe të edukimit.

Me edukimin vjen dhe konkurrenca e pamëshirshme, e cila ka nxjerrë në pah ekselencën, ata që kanë arritur në optimizimin e kërkimeve dhe kanë sjellë përfitime me vlera globale. Ne të gjithë përfitojmë nga rezultatet produktive të dijes, nga studimet, nga shpikjet shkencore etj. Por duket sikur edukimi qytetar e ka humbur balancën gjatë këtij procesi të edukimit të ekselencës. Kështu, edhe pse duke bërë përpjekje për më mirë, ne përsëri nuk do mund të përmbushim detyrimin tonë: ta bëjmë botën një vend më të mirë (Harry Lewis & Ellen Condliffe Lagemann, 2012).

Edukimi social është shumë i rëndësishëm te fëmijët, sidomos atyre në shkollat fillore dhe të mesme. Duhet pasur kujdes për këtë, sepse shumë të rinjve mund t'u jepet informacion i gabuar në lidhje me edukimin social. Temat e edukimit social mund të jenë nga më të ndryshmet duke filluar nga droga, alkooli, cigaret apo sëmundje të ndryshme seksualisht të transmetueshme, si AIDS, apo sëmundje të tjera, e megjithatë, një informacion i tillë nuk është asnjëherë i mjaftueshëm (Conbacy, 2010).

Duke qenë se fëmijët u përkasin klasave dhe vendeve të ndryshme, ata mund të keqinterpretojnë fakte të ndryshme që në jetën e përditshme i lexojnë. Megjithatë, nuk është efikase të thuhet se çdo individ që i njeh faktet e vërteta, do t'i zbatojë ato, pasi këtu futet në linjë presioni nga bashkëmoshatarët, të cilët jo domosdoshmërisht kanë informacionin e duhur rreth këtyre temave sociale. Për të shmangur një gjë të tillë janë ndërtuar programe të ndryshme nëpër shkolla, të cilat, me ndihmën e mësuesve ndihmojnë nxënësit të krijojnë një besueshmëri më të madhe në vete dhe të ulin presionin që u vjen nga bashkëmoshatarët e tyre. Klasat janë vendi kryesor ku duhet të zhvillohen grupime të tilla ku të rinjve u jepet mundësia të zhvillojnë mendime pozitive lidhur me veten.

5. Rezultatet

5.1. Rezultatet nga pyetësorët

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	po	95	79.2	79.2	79.2
	jo	5	4.2	4.2	83.3
	nuk e di	20	16.7	16.7	100.0
	Total	120	100.0	100.0	



Tabela dhe grafiku 1. *Gazeta e shkollës ndikon në edukimin e nxënësve*

Te pyetësori i shkallëzuar (Po/Jo/Nuk e di), nxënësit u pyetën nëse gazeta e shkollës ndikonte në edukimin e tyre. Kjo pyetje mat faktin nëse gazeta e shkollës ka ndikim te nxënësit. Kjo pyetje lidh ndryshoren e pavarur "Media shkollore" me ndryshoren e varur "Edukimi qytetar i nxënësve". Sipas 79,2% të nxënësve, gazeta e shkollës ndikon në edukimin e tyre, 4,2% e nxënësve e mohojnë këtë fakt, ndërsa 16,7% nuk e dinë këtë gjë. Duke u bazuar te matjet, *mean*-i arrin vlerën 1,38 dhe SD.757, gjë që nënkupton faktin se nga N=120, shumica (95 nxënës apo 79,2%) pohojnë faktin se media shkollore ka ndikim në edukimin e tyre qytetar.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	po	93	77.5	77.5	77.5
	jo	18	15.0	15.0	92.5
	nukedi	9	7.5	7.5	100.0
	Total	120	100.0	100.0	



Tabela dhe grafiku 2. *Gazeta e shkollës është zëri i nxënësve, pasi ajo shpreh shqetësimet e tyre.*

Gjithashtu, nxënësit janë pyetur nëse do të dëshironin që gazeta e shkollës të ishte zëri i tyre dhe shumica prej 77,5% kanë thënë se janë dakord me këtë gjë, ndërsa 15% nuk janë dakord, 7,5% thanë se nuk e dinin. SD=.603 dhe Mean=1.30 nga N=120, dhe arrijmë në përfundimin se gazeta e shkollës duhet të jetë një reflektim i zërit të fëmijëve dhe i shqetësimeve që ata mund të hasin në shkollë.

5.2. Rezultatet nga intervistat gjysmë të strukturuara



Pjesa e dytë e studimit përbëhet nga 7 intervista gjysmë të strukturuara drejtuar: drejtuesit të shkollës, psikologut, mësuesit të gjeografisë, mësuesit të gjuhës angleze dhe tre mësues të gjuhës shqipe. Mësuesit dhe drejtuesi u pyetën se cilat vlera dhe kompetenca edukohen nëpërmjet medias dhe nëse ata mendojnë se media shkollore ndikon në edukimin ndërkulturor në shkollë. Nga mësuesit pohohet se nga media

shkollore edukohen vlerat e humanizmit, bashkëpunimit midis nxënësve, harmonizimit të marrëdhënieve midis nxënësve, vlerat morale, edukimi ndërkulturor.

Psikologu pohon se përmes medias së shkruar integrohen kompetencat kyçe dhe të fushave të ndryshme që përfshihen te gazeta apo revista e shkollës, apo edhe rrjetet sociale të shkollës. Drejtuesi pohon se media shkollore ka një ndikim shumë të rëndësishëm në formimin e nxënësve, përmes saj nxënësit zhvillojnë kulturën e tyre, njihen me shumëllojshmërinë kulturore, me respektin e kulturave të ndryshme etj. Gjithashtu, nxënësit sjellin në median shkollore zakonet e traditat e vendlindjes, krijimtarinë popullore, folklorin dhe etnografinë.

Përsa i përket ndryshores së humanizmit, mësuesit, drejtuesi dhe psikologu u pyetën nëse gazeta apo revista e shkollës i informon nxënësit mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Drejtuesi i shkollës e pohon këtë fakt duke thënë se roli i gazetës, si një lloj i medias shkollore në këtë drejtim, është shumë i çmuar. Nxënësit kanë mundësi të informohen për të drejtat dhe liritë e tyre, të drejtat për të qenë të barabartë dhe për t'u integruar në komunitet. Psikologu pohon se nxënësit janë të informuar për këtë gjë, por duhet edhe të zbatohet në praktikë. Pyetja e fundit e intervistës gjysmë të strukturuar u fokusua sërish te ndryshorja e humanizmit, duke pyetur nëse të pasurit e një gazete apo reviste shkollore ndikonte në rritjen e humanizmit nga ana e nxënësve. Psikologu e pohon këtë fakt duke thënë se kjo gjë e ka fillin që te fillimi i bashkëpunimit nga ana e nxënësve për sigurimin dhe përpunimin e përgatitjen për botim të materialeve për gazetën dhe revistën e shkollës. Pasqyrimi i përvojave pozitive dhe i një pune të përbashkët nxit humanizmin dhe rrit vetëvlerësimin për të ndërmarrë nisma edhe më të suksesshme për të ardhmen.

Gjithashtu, ky fakt pohohet edhe nga mësuesit dhe nga drejtuesi i shkollës, i cili pohon se nëpërmjet gazetës shpalosen vlera humanizmi, por nxënësit edhe edukohen me këto vlera. Gazeta dhe media shkollore, në përgjithësi, kur përdoren objektivisht, në thelb të çdo publikimi kanë humanizmin vetjak e kolektiv.

6. Përfundime dhe rekomandime

Kur flasim për median shkollore, përfshijmë: rrjetin e internetit, i cili mund të jetë i aksesueshëm në disa shkolla dhe fakultete të ndryshme, biblioteka e shkollës, gazeta, revista e shkollës dhe këndi i klasës. Në fakt, kur flasim për shkollën "Kushtrimi i Lirisë", kemi të bëjmë me një institucion arsimor që i ka të gjitha këto "pajisje". Por, kur flasim për *website*, mund t'i referohemi vetëm faqes në rrjetin social që shkolla ka në profilin e saj në *Facebook*. Sipas pyetësorit, studimi arrin në përfundimin se 118 nxënës (apo 98.3%) kanë vlerësuar praninë e gazetës së shkollës.

Gjithashtu, të gjithë mësuesit e anketuar, psikologu dhe drejtuesi i shkollës e pranojnë se shkolla ka gazetën e saj edhe në rrjetin social të *Facebook*-ut. Drejtuesi i shkollës pohon se në shkollë botohet gazeta "Kushtrimi i së ardhmes" dhe "Zëri ynë".

Gjithashtu, shkolla është e pajisur edhe me një qendër zëri që funksionon kryesisht gjatë pushimit dhe kur zhvillohen aktivitete jashtëshkollore. Theksojmë se shkolla është e pajisur me një infrastrukturë thuajse të plotë mediatike, me organe shtypi dhe audioje.

Nxënësit u pyetën nëse gazeta botohet vetëm nga nxënësit apo edhe me ndihmën e mësuesve. Në fakt, përgjigjet këtu kanë qenë më të ndryshme nga pyetja e parë nga N=120. Frekuenca e atyre që kanë thënë "Po" ishte 64, apo 53.3 %, duke mbetur sërish shumica, frekuenca e 37 nxënësve nxjerr se ata kanë thënë "Jo", apo 30.8%, ndërsa "Nuk e di" janë përgjigjur 19 nxënës, apo 15.8%. Këtej nxjerrim përfundimin se gazeta botohet nga nxënësit me ndihmën e mësuesve koordinatorë, gjë që nënkupton se vetë nxënësit kontribuojnë me artikuj për gazetën e shkollës. Gjithashtu, edhe mësuesit e anketuar dhe psikologu pohojnë se çdo vit botohet gazeta e shkollës, ku janë përgjegjës mësues të caktuar dhe zgjidhen disa punime të nxënësve për t'u botuar.



87.5% e të anketuarve pohojnë se secili nxënës ka të drejtë të botojë shkrimet e tij në gazetën e shkollës. Vetëm 4.2%, apo 5 prej tyre, kanë thënë "Jo" dhe 8.3% nuk kanë pasur njohuri rreth kësaj, duke zgjedhur alternativën "Nuk e di". Nisur nga këto të dhëna, pohojmë se secili nxënës ka të drejtë botimi dhe pjesëmarrjeje në revistën dhe gazetën e shkollës. Bazuar në rezultatet e pyetësorëve, rezulton se nxënësit e lexojnë me dëshirë gazetën e shkollës, shumica prej 82,5% janë shprehur me "Po" apo, e thënë ndryshe, 99 nxënës nga N = 120. 13,3% kanë thënë "Jo", ndërsa 5% nuk e dinin. Lehtësisht duket se gazeta e shkollës lexohet masivisht nga shumica e nxënësve dhe do të rekomandohej që edhe pjesa e mbetur të nxitej për të lexuar gazetën dhe revistat e përvitshme shkollore. Gazeta dhe revista e shkollës përmbajnë

materiale interesante për nxënësit, në mënyrë që këta të fundit të kenë interes për t'i lexuar.

Për ta ritheksuar, shkolla "Kushtrimi i Lirisë" ka gazetën e saj të shkollës ku botohen materialet nga nxënësit nën kujdesin e mësuesve përkatës. 73.3% e nxënësve pohojnë faktin se materialet janë interesante, ndërsa 17,5% e nxënësve nuk e pohojnë këtë gjë. 9.2% nuk kanë informacion rreth kësaj gjëje.

Gazeta e shkollës trajton një tematikë të pasur, ku, temat më të trajtuara janë: *Aktualitet, Temat e ditës, Kulturë, Art, Rreth e rrotull, Sport, Krijimtari, Kuriozitete*. Nga psikologu i shkollës pohohen trajtimet e po të njëjtave tema. Gjithashtu, pohohet se në faqet e gazetës dhe në revistën e shkollës përfshihen intervista të ndryshme, fotografi të festave apo të projekteve të organizuara nga nxënësit dhe mësuesit, pjesë nga historiku i shkollës, materiale letrare etj. Veçojmë faktin se media e shkollës sonë është e depolitizuar, nuk propagandon asnjë lloj ideologjie, as nuk orientohet nga besimet fetare. Media e shkollës sonë është e hapur për të gjithë fëmijët e moshës së detyrimit shkollor, pa diskriminuar askënd nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

Mësuesit e anketuar pohojnë se nga media shkollore edukohen vlerat e humanizmit, bashkëpunimit midis nxënësve, harmonizimit të marrëdhënieve midis nxënësve, vlerat morale, edukimi ndërkulturor etj., përmes botimit dhe publikimit të materialeve shumë interesante dhe nxitëse për t'u lexuar. Në gazetë integrohen kompetencat kyçe dhe ato të fushave të ndryshme duke i trajtuar ato të lidhura ngushtë me arsimimin e çdo individi dhe me synimin për të formuar qytetarë të së ardhmes.

Media shkollore ka një ndikim shumë të rëndësishëm në formimin e nxënësve. Nxënësit, përmes medias zhvillojnë kulturën e tyre, njihen me kultura të ndryshme, edukohen të respektojnë shumëllojshmërinë dhe mendimin ndryshe etj. Gjithashtu, nxënësit, duke u njohur përmes medias shkollore me zakonet e traditat e vendlindjes, me krijimtarinë popullore, me folklorin dhe etnografinë, zgjerojnë njohjen për vendlindjen dhe më gjerë, nxiten të bëhen pjesë e aktiviteteve ku promovohen këto vlera lokale e kombëtare, si dhe rritin interesin për t'i ruajtur, për t'i pasuruar e për t'i çuar më tej ritet, zakonet, traditat, gjithçka të mirë që ka atdheu dhe kombi. Sipas 79,2% të nxënësve, gazeta e shkollës ndikon në edukimin e nxënësve. Vetëm 4,2% e nxënësve e mohon këtë fakt, ndërsa 16,7% nuk janë shprehur në mënyrë pohuese apo mohuese.

Studimi na shpie në përfundimin se nxënësit do të dëshironin që gazeta e shkollës të kishte më shumë informacion shkencor, kjo bazuar te shumica e tyre 81,7% që kanë thënë "Po", 13,3% kanë thënë se nuk e kanë këtë interes, ndërsa vetëm 5% kanë thënë se nuk e dinë këtë gjë. Stafi i gazetës, i përkushtuar për ta bërë sa më të

pasur e sa më interesant organin mediatik të shkruar, duhet të freskojë e të përditësojë të gjitha rubrikat, pse jo, duke e zgjeruar tematikën edhe me materiale të fushave që përputhen më mirë me zhvillimin moshor të lexuesve të saj dhe me qëllimin e misionin që ka shkolla si institucion arsimor.

Fëmijët do të kishin më shumë dëshirë që gazeta e shkollës të botonte më shumë shkrime për të drejtat e tyre, për humanizmin dhe për edukimin qytetar. Shumica prej 76.7% ishte dakord me këtë pohim, ndërsa 16,7% nuk pajtohej dhe një pjesë shumë e vogël prej 6,7% nuk e dinte. Ndërsa drejtuesi i shkollës e pohon këtë fakt duke thënë se roli i gazetës në këtë drejtim është shumë i çmuar.

Nxënësit kanë mundësi të informohen për të drejtat dhe liritë e tyre, të drejtat për të qenë të barabartë dhe për t'u integruar në komunitet. Psikologu pohon se nxënësit janë të informuar për këtë gjë, por duhet që gazeta e shkollës të merret më shumë edhe me zbatimin praktik konkret në jetën e përditshme brenda e jashtë shkollës.

Është interesant përfundimi që del nga studimi se nxënësit nuk dëshirojnë që të përfshihen në gazetën dhe revistën e shkollës shumë materiale artistike, pasi shkrimet aktuale janë të mjaftueshme dhe se ata nuk e ndiejnë të nevojshme që në faqet e shtypit të shkollës t'u ofrohen më shumë seç duhet materiale letraro-artistike.

Gjithashtu, studimi arriti në përfundimin se gazeta e shkollës duhet të reflektojë më shumë problemet socialo-kulturore të nxënësve.

Rrjetet sociale kanë ndikim në edukimin e nxënësve. Në fakt, siç është përmendur edhe më sipër, shkolla disponon në rrjetin *Facebook* një adresë ku postohen të gjitha veprimtaritë e saj, njoftime etj. Kjo faqe është e aksesueshme nga të gjithë nxënësit dhe prindërit e tyre për t'u informuar për të rejat më të fundit të shkollës. Shumica e nxënësve (66.7%) thotë se rrjetet sociale kanë ndikim tek ata, ndërsa 27.5% shprehen se nuk kanë ndikim, 5.8% nuk e dinin. Nxënësit janë dakord (77.5%) se shkolla duhet të jetë e pajisur me Wi-Fi duke u aksesuar atyre mundësinë e hyrjes në internet në çdo moment, ndërsa pakica prej 16.7% nuk janë dakord me këtë gjë, 5.8% kanë zgjedhur alternativën "Nuk e di". Ndaj do të rekomandonim pajisjen e shkollës me rrjet Wi-Fi, por që të ishte në dispozicion vetëm gjatë periudhave të pushimit ose te biblioteka e shkollës, duke u mundësuar nxënësve të punonin edhe nga biblioteka për projektet e tyre apo për të zgjeruar njohuritë e tyre.

Shumica e nxënësve (95%) shprehen se i përdorin rrjetet sociale, ndërsa vetëm 1.7% nuk i përdorin ato, dhe 3.3% nuk e dinin që ka rrjete sociale. Mësuesit, psikologu dhe drejtuesi i shkollës pohojnë se ka një *website online* i cili pasurohet vazhdimisht dhe ajo është faqja *online* e shkollës. Faqja *online* ndodhet vetëm në rrjetin social *Facebook*, por një adresë *online* e aksesueshme nga të gjithë mësuesit e shkollës dhe nxënësit nuk ekziston. Të pasurit e një *websiti* të aksesueshëm nga nxënësit do të ishte më efektive për procesin edukativ, por edhe faqja e aksesueshme e rrjetit social *Facebook*, për momentin, ka mundësuar informimin e nxënësve për aktivitete të ndryshme të

shkollës. Gjithashtu, ajo ka luajtur një rol për promovimin e të gjitha arritjeve të nxënësve.

Nga sa parashtruam, mund të themi se asgjë nuk mund të funksionojë në mënyrë të përsosur dhe në kohezion me zhvillimet e sotme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Shkolla "Kushtimi i Lirisë" disponon vërtet median bazë shkollore, ku hyjnë biblioteka, gazeta, revista, qendra e zërit dhe këndi i klasës. Gjithsesi, fakti është se shkollës i mungon biblioteka elektronike, ku secili nxënës mund ta aksesonte edhe nga shtëpia duke pasur kështu mundësinë e kontaktit me pafundësi librash, revistash, gazetash etj.

Pavarësisht debateve, nuk mund të themi me plot bindjen se rrjetet sociale janë të dëmshme për fëmijët. Në fakt, shumica prej 59.2% pohon faktin se rrjetet janë të dëmshme për nxënësit, 29.2% e mohojnë këtë gjë, ndërsa 11.7% nuk e dinin. Do të rekomandonim që nxënësit t'i përdorin rrjetet sociale për qëllime pozitive.

Së fundi, vlerësojmë se rëndësia e medias shkollore nuk qëndron vetëm në faktin se ajo është një burim më shumë për nxënësit, që u siguron atyre informacione nga fusha të ndryshme dhe për nevoja të zhvillimit të lëndëve / fushave mësimore e të veprimtarive të shumta jashtë klase e shkolle. Rëndësia e medias shkollore qëndron dhe në faktin se nxënësit, në një mënyrë a në një tjetër, gjejnë veten e tyre në këtë media si individë dhe si grupe, pasi çdokujt i mundësohet botimi e publikimi i shkrimeve të tij. Rëndësia e medias shkollore qëndron, sidomos, në rolin që luan ajo për edukimin qytetar të nxënësve. Media shkollore zhvillon te nxënësit kompetenca, ndërthur dije, qëndrime dhe vlera që u nevojiten atyre për zhvillimin vetjak, qytetarinë aktive dhe përfshirjen shoqërore, për zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave.

Bibliografi

Conbacy, M. (2010). *Tecnology and newspaper.* New York: British Llibrary.

David Faith. Kontribues: Seth Andrew, Bruce Kole, etc. (2011).

Erikson, r. (2007). *fde.* chicago: american library association.

Harry Lewis & Ellen Condliffe Lagemann. (2012). *what is collage for ? The public purpose of higher education.* New York: Teachers collage press.

Lance, K. C. (1994). The impact of school media centers on academic achievement. Colorado: Library Research Service.

Lo, D. L. (2010). *Social education in ASIA.* Library of congres.

Markuson, R. E. (2007). *Designing a school library media center for the future* (second ed.). Chicago: American library association.

Mary Benedict, D. (1976). High schoool students and newspapaer. *Jurnalism Quarterly.*

Mary Gurney, B. H. (2009). *Personal and social education.* United Kingdom: Delta place.

Picard, C. (January, 2004). *The American Library Association.* Louisiana State Department of Education.
Rao, V. (2004). *special education.* New Dehli: A.p.h.publishing corporation.
Tamlinson, L. B. (2001). *Special education.* New York: British library.
UNESCO. (2014). State Americas Libraries Report.
W, C. K. (1994). *School library media in the 21st century.* USA: Greenwood.

Rezarta GJERGJI

SCHOOL AS MEDIA AND CITIZEN EDUCATION OF STUDENTS

Abstract

Nowadays, school media plays an important role in the school'sstructure. In the XXIstcentury, it can be seen as an important factor in increasing academic achievement and students' civil education. In mentioning school media, the first thing considered is the school library, as a primary source of information, then including the school magazine and newspaper.

School media plays an important role in providing students information from different topics and to teach them how to acquire and use thatin formation.

This study will focuson the importance of school media measures by two variables: the independent variable of school media (including the school library, classroom posts, the school's newspaper and magazine) and the dependent variable (civil education). Questionnaires and semi-structured interviewes were used for measuring the two variables.

The study is focused on the following hypotheses: the students inclusion on school media influences on their civil education. The study is also focused on the following research questions: How does school media influence on the freedom of speech? How does school media influence on cultural diversity? How does school media influence in teaching new thoughts and ides? How does school media influence on teaching the children's rights? How does school media influence on humanism?

The results of the study prove the hypothesis that there exists an influence of school media on students' civil education. The more informed the students, the more broaden their thoughts, the more positive is their behaviour and their level of education.

Key words: school media, civil education, school library, school newspaper, school magazine.

Shpresë MULLIQI

MEDIET E REJA DHE NDIKIMI I TYRE NË SHTIMIN E NUMRIT TË KONSUMATORËVE NË INDUSTRINË E KULTURËS

Abstrakt

Duke u nisur nga përshtypja se e-Kultura, e definuar si aplikim i teknologjive të reja të informimit në industrinë e kulturës, ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në menaxhimin e institucioneve kulturore, si: teatri, kinemaja, bibliotekat etj., si dhe në ngritjen e numrit të vizitorëve të këtyre institucioneve, përmeskëtij punimi do të prezantohen të dhënat e nxjerra nga analiza e sjelljes së konsumatorëve, e kondicionuar nga ndikimi i teknologjisë së komunikimit dhe rrjeteve shoqërore gjatë marrjes së vendimeve "vis-à-vis" ofertave të institucioneve kulturore.

Gjithashtu, ky punimka për qëllim të argumentojë se, pavarësisht nga kundërshtitë e hetueshme që mund të hasen, subjektiviteti i informatës së plasuar nga ana e institucioneve kulturore si dhe subjektiviteti i informatave të shpërndara nga individë të ndryshëm në rrjete shoqërore (e njohur si e-WoM /Word of mouth apo fjala e gojës), si zëvendësuese të medieve të vjetra si dhe të fjalës së gojës (WoM) sot janë prej faktorëve më qenësorë të informimit dhe të përcaktimit të publikut në lidhje me një ngjarje të caktuar kulturore.

Për të arritur deri te të dhënat relevante dhe për ta shqyrtuar dhe analitikisht përshkruar ndikimin e teknologjisë së re dhe rrjeteve shoqërore në procesin e vendimmarrjes, në hulumtimin tonë përdoren burime primare dhe dytësore, duke përfshirë këtu edhe sondazhe dhe intervista gjysmë të strukturuara me vizitorë dhe udhëheqës të institucioneve kulturore.

Në fund të këtij punimi do të jepen edhe disa rekomandime të cilat ndërlidhen me përdorimin e teknologjisë së re të komunikimit dhe rrjeteve shoqërore në industrinë kulturore për ta rritur numrin e konsumatorëve, si dhe rekomandime mbi mundësitë që ofrojnë mediet e reja në zhvillimin e kësaj industrie.

Fjalët kyçe: *e-Kulturë, e-WoM, teknologji e komunikimit, medie të reja, rrjete shoqërore, konsumatorë, institucione kulturore*

Hyrje

Kultura, ambasador i secilit vend, sipas SirEduardBurnetTejlorit[1], *është ajo tërësi komplekse që përfshinë dijen, besimin, artin, etikën, zakonet, dhe cilëndo aftësi dhe shprehi të fituar nga njeriu si pjesëtar i shoqërisë* andaj edhe *shpërndahet, mësohet dhe bartet në gjenerata[2],* gjë që nënkupton përfshirjen e konsumatorëve edhe si bartës/transmetues. Shih për këtë, zhvillimi i *audiencës është i një rëndësie të madhe[3]për vendosjen e artit dhe kulturës në qendër të shoqërive tona për ta shtuar përfitimin shoqëror, kulturor dhe ekonomik.*[4]

Me shpikjen e teknologjisë së re dhe me paraqitjen e medieve të reja, konsumatorët janë shumë më të angazhuar për gjetjen e mënyrave të efektshme dhe besueshme të komunikimit dhe për gjetjen e informatave. Prandaj përdorimi i medieve të reja për mbledhjen e këtyre informatave dhe plasimin e tyre për konsumim përdoret edhe në kërkim të informatave që kanë të bëjnë me ngjarjet kulturore. Informatat vijnë drejtpërdrejt nga konsumatorët dhe nuk ofrohen nga institucionet kulturore të cilat po përpiqen ta ngrehin numrin e konsumatorëve, duke konsideruar se këto informata janë më të afërta për konsumatorët dhe më të pranueshme. Integrimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit (TIK) në mjedise kulturore, *një element i rëndësishëm në mundësimin dhe lehtësimin e procesit të krijimit, ndarjes dhe ruajtjes së kujtesës tonë kulturore*[5], ka një ndikim të madh në ndërveprim ndërmjet individëve dhe institucioneve të kulturës dhe shihet edhe si një prej shtytësve kryesorë të modernizimit të ekonomive në mbarë botën.[6] Sikur thotë edhe Gurnsey[7], *njerëzit gjithnjë e më shumë po mbështeten në opinionet e postuara në sisteme të tilla për të marrë një vendim.*[8]

Të ballafaquara me ndryshimet si rezultat i teknologjisë së re, sidomos ato që ndërlidhen me mënyrat e reja të komunikimit, si dhe duke synuar rritjen e numrit të konsumatorëve, edhe institucionet e kulturës në Kosovë i kanë ndërmarrë disa hapa konkretë në përputhshmëri me këto zhvillime. Numri i konsumatorëve është rritur falë

[1] Sir Edward Burnett Tylor (02.10.1832 - 02.01. 1917) antropolog anglez, themelues i antropologjisë së kulturës.

[2] Spencer-Oatey, Helen, (2012), *What is culture?* A compilation of quotations. Global PAD Core Concepts. Available at Global PAD Open House: http://www2.warwick.ac.uk/fac/soc/al/globalpad/openhouse/interculturalskills/global_pad_-_what_is_culture.pdf

[3] *European Audiences: 2020 and beyond* është mbajtur nga 16-17 tetor 2012; Konkluzionet e konferencës: http://ec.europa.eu/culture/library/reports/conference-audience_en.pdf

[4] Ibidem!

[5] *European Audiences: 2020 and beyond*; Konkluzionet e konferencës të mbajtur nga 16-17 tetor 2012: http://ec.europa.eu/culture/library/reports/conference-audience_en.pdf

[6] IT Barometër, 2015, Kosovë (STIKK)

[7] Guernsley, L., (2000), *Suddenly, Everybody's an Expert*, "The New York Times": http://www.nytimes.com/2000/02/03/technology/suddenly-everybody-s-an-expert.html

[8] Dellarocas, C., (2003), *Digitalization of word of mouth: Promise and challenges of online feedback mechanisms*; Management Science, Vol. 49, No. 10, fq. 1407-1424

kësaj, ndonëse sjellja e konsumatorëve të teatrit në Kosovë, përveç disa artikujve në medie[9], nuk është hulumtuar asnjëherë. Të dhënat empirike të nxjerra nga Konventa Evropiane e Teatrit[10] që kanë të bëjnë me situatën dhe audiencën e teatrove, tregojnë se këto të dhëna edhe në Evropë janë shumë heterogjene. Sipas tyre, në një numër të vendeve (këtu përfshihet edhe Kosova), *nuk ka të dhëna të mjaftueshme, ndërsa ato të cilat janë në dispozicion janë të pastrukturuara, respektivisht dallojnë nga vendi në vend.*[11]

Evoluimi i kulturës së komunikimit dhe aplikimi i teknologjisë së re në institucionet e kulturës

Para se ta shpalosim procesin hulumtues për të ardhur deri tek të dhënat mbi ndikimin e teknologjisë së re në rritjen e numrit të konsumatorëve, prezantimi i një pjese të historisë jo të kamotshme të komunikimit është i domosdoshëm ngaqë ka të bëjë me kanalet e komunikimit të përdorur nga shqiptarët e Kosovës gjatë një decenie për t'i mbuluar nevojat e tyre për informim. Në Kosovën e viteve të '90-ta popullata shqiptare, e cila, sipas statistikave të kohës, përbënte 81.6% të popullatës[12], jetoj në *terr* informativ, ngaqë i vetmi televizion kombëtar, Radio Televizioni i Prishtinës (RTP)[13], i mbulonte nevojat informative vetëm të një pjese të popullatës së Kosovës.[14] Gjatë kësaj periudhe edhe mediet e shkruara në gjuhën shqipe janë mbyllur disa herë pasi e morën rolin e të vetmit burim informimi.[15] Si rezultat, informatat kryesisht janë shpërndarë përmesfjalës së gojës (Word-of-Mouth, WoM), si në komunikimin ballë për ballë, po ashtu edhe përmes bisedave telefonike, ndonëse ndikimi i këtyre informatave është varur nga aftësitë bindëse

[9] "Kosova Press", 24/07/2014: A do t'i kthehet shpirti 'teatrit fatkeq' të Prishtinës? Avdiu: Teatri nuk ka ofruar ndonjë shfaqje që do ta nxiste qytetarin të vijë në teatër… Një teatër pa investime në marketing...ai premton rritje të shikuesve, nga 200 sa kanë qenë, të arrihet në rreth 2 mijë të tillë: http://www.kosovapress.com/sq/lajme/a-do-ti-kthehet-shpirti-teatrit-fatkeq-te-prishtines-22081/

[10] Faqja zyrtare e European Theatre Convention: http://www.etc-cte.org/index.php

[11] Po aty

[12] Enti i Statistikave të Kosovës. Për më shumë informata shih uebfaqen zyrtare të Entit: http://ask.rks-gov.net/

[13] RTP, radio televizioni i parë i Kosovës është themeluar në vitin 1945. Puna e tij është ndërprerë dhunshëm nga Qeveria e Serbisë në vitin 1990. Nga libri i Ibrahim Berishës, *Komunikimi medial në shoqërinë postkonfliktuale*; e nxjerrë nga *Thesis Kosova*, nr. 1, 2008

[14] RTP gjatë kësaj periudhe mbulonte nevojat informative të popullatës serbe e cila përbënte vetëm 9.9 % të popullatës së Kosovës dhe nacionaliteteve të tjera, duke përfshirë këtu edhe jugosllavët apo "të papërcaktuarit", të cilët përbënin 8.5% të popullatës. Informatat janë nxjerrë nga *Report on the size and ethnic composition of the population of Kosovo*, e shkruar në vitin 2002 nga Helge Brunborg.

[15] Biggins, M. and J. Crayne, (2000), *Publishing in Yugoslavia's Successor States*, The Haworth Information Press, An Imprint of The Haworth Press, Inc. New York, USA; Volume 1, Numbers 2/3; fq. 162-163

të personit i cili e bartte informatën.[16] Fjala e gojës, në rastin e Kosovës kishte ndikim të madh në njohuritë e fituara dhe ndjenjat e njerëzve, edhepse varej nga aftësia bindëse e folësit i cili duhej të kishte një set të vlerave[17]që kontrollohen nga vet folësi.[18]

Në vitin 1999 Kosova është pasuruar me një numër të madh të medieve, ndërkohë që filloi edhe depërtimi i internetit[19]. Kompanitë e TIK-ut, gati inekzistente para 16 vjetëve, filluan të ofrojnë një mori shërbimesh për klientët e tyre[20], duke"zëvendësuar" komunikimin nga fjala e gojës, në atë të ndërmjetësuar nga kompjuteri (ComputermediatedCommunication-CmC), një proces ky gjatë të cilit njerëzit *takohen* dhe i zhvillojnë *marrëdhëniet e tyre* duke u mbështetur në porositë e shtypura.[21]Shtrirja dhe depërtimi i internetit[22] e ka revolucionarizuar komunikimin (ndërpersonal), duke ofruar mënyra të reja për shpërndarjen sa më efikase të informatave, ndërsa mediet e reja e kanë *mundësuar komunikimin e drejtpërdrejtë dhe ndërveprues me konsumatorët me shpenzime të ulëta*[23], *promovimin dhe reklamimin e ofertave të reja*[24] gjë që, sikur thotë Dellarocas, kishte *implikime të rëndësishme edhe në gjetjen dhe mbajtjen e klientëve, zhvillimin e produkteve dhe sigurimin e cilësisë.*[25] Një numër i institucioneve kulturore në Kosovë i kanë mirëpritur këto ndryshime dhe kanë hapur faqe të internetit dhe adresa në rrjete shoqërore[26], ndonëse oferta dhe rifreskimi i tyre lënë akoma shumë për të dëshiruar.

---

[16] Krauss, R. M., (1987), *The role of the listener: Addres see in fluences on message formulation*. Journal of Language and Social Psychology, 6, fq. 81-97.

[17] Për trekëndëshin retorik etos, patos dhe logos mund të gjeni më shumë në librin e Aristotelit, *Retorika,* ndërsa një përmbledhje të shkurtër mbi këtë trekëndësh mund ta gjeni në uebfaqen e Ford's Theatre: http://www.fords.org/sites/default/files/rhetorical-triangle.pdf

[18] Steinberg, Sheila, (1999); *Persuasive Communication Skills: Public Speaking*, Cape town: Juta Co and Pvt Ltd.

[19] Sipas një raporti të STIKK të publikuar më 2013, depërtimi i internetit në vend është i krahasueshëm me normat botërore. Sipas përdoruesve, depërtimi është 76.6%, ndërsa sipas ekonomive familjare, është 84.8%. http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,1944#.VkLy2tRwaE0. Shikuar në qershor 2016

[20] Barometri i TI-s në Kosovë për 2015, publikuar nga STIKK: http://stikk.org/fileadmin/user_upload/it_barometer_kosovo-2015_ang_1_.pdf. Shikuar në shtator 2016.

[21] Walther, J. B., (1996), *Computer-mediated communication: Impersonal, interpersonal, and hyperpersonal interaction. Communication Research*, 23, fq.3-43.

[22] Me zhvillimin e teknologjisë së re të bazuar në nevojat e konsumatorëve, interneti është bërë i arritshëm për çdo person. Si rezultat i kësaj sot kemi një shumëllojshmëri të aplikacioneve dhe shërbimeve të bazuara në internet.

[23] Cockrum, J., (2011), *Free Marketing: 101 Lowand No-Cost Ways to Grow Your Business, Online and Off*; Published by John Wiley&Sons, Inc., Hoboken, New Jersey, fq. 97

[24] Basu, A. and S. Muylle, (2003), *Online support for commerce processes by ueb retailers*, Decision Support Systems 34(4), 379-95

[25]Dellarocas, C., (2003), fq. 1407-1424

[26]Faqet e internetit: Teatri Kombëtar: http://www.teatrikombetar.eu/?m=t&id=4, Baleti i Kosovës: http://www.baletikosoves.com/, Qendra Kinematografike e Kosovës: www.qkk-rks.com; Llogaritë e institucioneve në rrjete sociale dhe në "Youtube": https://www.facebook.com/Teatri-Kombëtar-i-Kosovës-525429354192045/ etj.

Përgatitja dhe subjekti kërkimor

Fokus i hulumtimit tonë është Teatri Kombëtar i Kosovës si dhe individët të cilët marrin vendim mbi përdorimin e burimeve të besueshme për informim për ta kursyer *kohën dhe të hollat në këmbim të shërbimeve.*[27] Është marrë parasysh i gjithë kompleksiteti i kësaj fushe në mënyrë që të kuptohet sjellja e konsumatorëve "vis-a-vis" teatrit për shkak të veçantive dhe karakteristikave unike të shfaqjeve teatrore.

Në mungesë të tëdhënave krahasimtare që kanë të bëjnë me Teatrin Kombëtar të Kosovës dhe audiencën e tij, është dashur të mbështetemi kryesisht në të dhënat e ofruara nga institucioni, deri te të cilat kemi ardhur përmes intervistave.[28] Për qëllime të hulumtimit ne e kemi analizuar ofertën e teatrit, si: cilat zhanre u ofertohen shikuesve, sa shfaqje i përgatisin dhe sa i shfaqin gjatë një viti, nëse ato i shfaqin duke e ndryshuar repertorin në baza ditore apo i shfaqin në blloqe javore.[29] Pas diskutimit të repertorit hapi tjetër ishte gjetja e numrit të përgjithshëm të vizitorëve. Me këtë rast është bërë edhe krahasimi mes vizitorëve që janë nga qyteti i Prishtinës[30] dhe atyre që janë nga qytetet e tjera.[31] Falë këtyre informatave konsumatorët i kemi ndarë në tre tipa.

Konsumatorët e rregullt, të cilët e vizitojnë teatrin në premierë, para se të ketë ndonjë reagim apo dhe informatë. Këta konsumatorë i përkasin një lloji të institucionalizuar të vizitorëve të cilët informohen nga teatri mbi produktet dhe përmes mjeteve të vjetra të marketingut si reklamat televizive dhe afishet para teatrit.

Konsumatorët e kohëpaskohshëm të cilët janë të ngjashëm me konsumatorët e rregullt, mirëpo këta janë më fleksibilë në vizitat dhe vendimet e tyre, por që për dallim prej të parëve, duan që të kenë informata mbi procesin e punës. Ky tip i konsumatorëve ka varësi të konsiderueshme në informatat të cilat ofrohen nga teatri, njëkohësisht merr informata shtesë nga personeli.

Dhe *konsumatorët të cilët informohen përmes rrjeteve sociale,* përmes të ashtuquajturit komunikim i ndërmjetësuar nga kompjuteri. Ky tip konsumatorësh vepron i pavarur nga informatat e teatrit, ndërsa planet mbi konsumimin e një produkti teatror i bënë duke u bazuar në informatat të cilat i merr përmes rrjeteve shoqërore. Mirëpo gjatë këtij hulumtimi është dashur ta kemi parasysh faktin se rezultatet mund të ndërrojnë

[27] Schiffman, L. G. and Kanuk, L. L., *Consumer behaviour*. Global Edition. London. Pearson Higher Education, 2010

[28] Informatat e prezantuara shpërfaqin tendencat që kanë të bëjnë me audiencën e Teatrit Kombëtar dhe do të shërbejnë si pikënisje për hulumtimet e ardhshme, duke shërbyer si pikë referimi

[29] Sipas drejtorit artistik të Teatrit Kombëtar të Kosovës, në repertorin e tyre i kanë tetë (8) produksione në vit dhe 234 shfaqje

[30] Teatri Kombëtar i Kosovës është i vendosur në qendër të Prishtinës

[31] Sipas drejtorit menaxhues të Teatrit, numri i përgjithshëm i vizitorëve është 17447, prej të cilëve 93% janë banues në Prishtinë, ndërsa 7% janë nga jashtë Prishtina

brenda disa muajve ngaqë secili person kalon përmes një procesi të ndryshimeve jetësore, me ç'rast një konsumator mund të lëvizë nga një tip i konsumatorit në tipin tjetër.

Mostra

Për një hulumtim të mirëfilltë fillimisht duhet të sigurohet instrumenti bazë e që në këtë rast janë personat të cilët do të intervistohen.Prandaj edhe janë përzgjedhur pesëdhjetë (50) persona, përfaqësues të gjeneratave dhe gjinive të ndryshme (23 burra dhe 27 gra) dhe të tre tipave të vizitorëve. Përfaqësuesit e mostrës ishin vizitorë të rregullt të teatrit, shfrytëzues aktiv të teknologjisë së informimit dhe të komunikimit, dhe përdorues të internetit si burim kryesor i informatave kur ata planifikojnë ta vizitojnë teatrin dhe institucionet tjera kulturore.

Personat e intervistuar janë të këtyre grup moshave: nga 19 deri në 30 vjet (29 persona ose 58%), nga 31 deri në 41 (9 persona ose 18%), nga 42 deri 51 (3 persona ose 6%), nga 52 deri 61 (6 persona ose 12 %) dhe nga 62 deri 72 (3 persona ose 6%). Kjo mostër është konsideruar si përfaqësuese e vizitorëve të teatrit për t'i nxjerrë të dhënat e besueshme por gjithashtu edhe për faktin se ata kanë njohuri për mjetet tradicionale të marketingut (afishet, broshurat, etj.) si dhe me mediet e reja, internetin dhe rrjetet shoqërore.





Rezultatet e hulumtimit mbi rolin e medieve të reja dhe zhvillimin e konsumatorëve të teatrit

Nga hulumtimi del se mënyra klasike e marrjes së informatave mbi shfaqjet është gati e papërfillshme, ngaqë tani shumica e informatave mblidhen përmes medieve të reja, rrjeteve sociale, puna e të cilave është mundësuar nga teknologjia e re. Për më tepër, edhe mënyra tradicionale e menaxhimit të institucioneve kulturore i

takon së kaluarës ngaqë kalimi në e-Biznes[32], *proces ky i blerjes, shitjes, transferimit dhe këmbimit të produkteve, shërbimeve dhe/ose informatave nëpërmjet rrjeteve kompjuterike, përfshi këtu edhe internetin*[33], ka bërë që konsumatorët të kenë rol aktiv sepse *mund të krijojnë përmbajtje dhe të ofrojnë shërbime.*[34]

Uebfaqet dhe adresat e hapura në rrjetet shoqërore nga institucionet kulturore ua kanë mundësuar konsumatorëve të vendosin marrëdhënie me përdoruesit e tjerë (peer to peer) dhe të *takohen* me komunitetin "on-line" për t'i këmbyer informatat që ndërlidhen me aktivitetet, përvojat dhe opinionet, e cila do të duhej të ketë ndikim në sjelljen e konsumatorëve. Nga hulumtimi del se konsumatorët nuk i përdorin vetëm informatat të cilat përgatiten nga departamentet e marketingut, por edhe informatat e paanshme deri tek të cilat vijnë përmes internetit para se të vendosin nëse do ta vizitojnë teatrin. Janë këto informata të cilat shpërndahen në rrjetet shoqërore, përmes të cilave përvojat në teatër dhe fotografitë, opinionet e shkruara dhe videot e ngarkuara, kontribuojnë në procesin vendimmarrës të konsumatorit. Andaj, sipas menaxhmentit të teatrit,uebfaqet dhe adresat e tyre në rrjetet shoqërore mëtojnë ta përcjellin trendin që ndërlidhet me pritshmëritë e konsumatorëve të rinj.

Rëndësia e e-Fjalës së Gojës në sjelljen e audiencës së teatrit

Rezultatet e pyetësorit dhe intervistave, por edhe literatura në dispozicion sugjerojnë se e-FeG dhe komunikimi i ndërmjetësuar nga kompjuteri kanë më shumë ndikim te konsumatorët sesa llojet e tjera të komunikimit[35] nisur nga fakti se shfaqjet nuk mund të shihen para premierës, gjë që i bënë njerëzit më shumë të mbështetën në opinionet dhe përvojat e njerëzve të tjerë sesa në informata të tjera (zyrtare). Sipas rezultateve, konsumatorët kanë nevojë për informata të *dorës së parë* të cilat vijnë nga burime të besueshme dhe ata besojnë se informata të tilla janë ato që vijnë nga publiku sepse nuk janë të prira për ta shtuar buxhetin e teatrit. Komunikimi përmes e-FeGnga shumë autorë konsiderohet si *një nga format më të fuqishme të marketingut në treg.*[36]

[32] Biznesi elektronik (e-business) mund të përkufizohet si përdorimi i internetit për të rrjetëzuar dhe fuqizuar procesin e biznesit, tregtisë elektronike, komunikimit organizativ dhe bashkëpunimit në një kompani si dhe me klientët e saj, furnizuesit dhe aktorët e tjerë

[33] Turban, E., Mclean, E. and Wetherbe, J., 2004. *Information technology for management: transforming organizations in the digital economy*. 4th ed. Chichester: Wiley

[34] Straubhaar, J., La Rose, R., and Davenport, L., Media Now: Understanding Media, Culture, and Technology, Ninth Edition, Cengage Learning, Boston, USA, 2014. Accessed through https://books.google.com/books?

[35] Paul M. Herr, Frank R. Kardes, and John Kim, Effectsof Word-of=MouthandProduct-Attribute Informationon Persuasion: An Accessibility - Diagnosticity Perspective, Journal of Consumer Research, 17 (4), 1991

[36] Silverman, G., (2001), *The Powerof Word of Mouth*. Direct Marketing, 64(5), fq. 47

Dallimet e identifikuara

Duke u fokusuar në tri gjenerata veç e veç në procesin e analizës së të dhënave mund të identifikohen disa dallime. Përdoruesit e internetit dhe rrjeteve shoqërore, personat e moshave mes 19 dhe 30 vjeç dhe 31 deri 41 vjeç, janë konsumues të rregullt dhe kërkuesit më aktivë të informatave nga të gjitha gjeneratat, me përvojë për të kërkuar dhe gjetur informatat "on-line". Sipas të intervistuarve, ata i gjejnë informatat në disa mënyra; disa informata janë të vendosura nga aktorët të cilët janë të interesuar për t'iu treguar publikut se ata janë të përfshirë në një projekt teatror, disa informata janë të publikuara nga regjisori apo edhe shkrimtari i pjesës, mirëpo pjesa më e madhe e informatave janë të vendosura nga shikuesit. Ia vlen të përmendet se disa nga të intervistuarit ngritën si dilemë nëse informatat e publikuara nga ata që janë të përfshirë në prodhimin e një shfaqje janë të besueshme? Edhepse ata i përdorin si referencë për kërkim të mëtejmë,sa iu përket të intervistuarve të moshës nga 42 deri 51 vjeç, ata nuk i përdorin rrjetet shoqërore aq shpesh sa edhe gjenerata më e re. Përkundër kësaj, kur vendosin për të shkuar në teatër, edhe ata janë të ndikuar nga *e-Fjala e Gojës*. Me këtë rast ata iu drejtohen rrjeteve shoqërore të cilat janë më të *lehta për t'u orientuar* si "Facebook".

Kanalet më të përdorura, sipas të intervistuarve, janë: "Youtube"6%;"Twitter"-i 2%;"Facebook"-u, respektivisht llogaria e Teatrit Kombëtar të Kosovës në "Facebook", 15%; dhe *e-Fjala e Gojës* (partnerët/ miqtë/bashkëpunëtorët/të afërmit përmes medieve të reja) 60%.

Informatat e publikuara në rrjetet shoqërore i përdorin si referencë, mirëpo stendat e afishimit dhe afishet janë burimi i parë i informatës për 16% të të intervistuarvetë moshave prej 52 deri 61 vjeç dhe ata mes 62 dhe 72 vjeç.



Gjatë krahasimit të gjeneratave të intervistuara mund të gjenden disa dallime. Edhepse çështja e subjektivitetit në raport me përmbajtjen e ofruar në këto platforma është vendosur si faktor përcaktues për përdorimin e rrjeteve shoqërore, rezultatet kryesore sugjerojnë se konsumatorët të cilët i përdorin rrjetet shoqërore gjatë marrjes së vendimeve për ta përcjellë një ngjarje kulturore iu besojnë këtyre informatave më së shumti ngaqë ato janë të paanshme, pra jo të prira nga klientelizmi, të besueshme edhepse bazohen në bindje subjektive të përdoruesve të rrjeteve shoqërore.

Disa të intervistuar të cilët i pëlqejnë mediet e vjetra për marketing thonë se disa informata janë të rreme dhe të shtrembëruara, andaj edhe duhet të shqyrtohet besueshmëria e tyre.

Përfundim

Platformat e rrjeteve shoqërore janë media të reja edhepse jo media të së ardhmes ngaqë teknologjia e informimit dhe e komunikimit po evoluon dita-ditës, por gjithsesi e zënë një vend të rëndësishëm si media të sotme. Ato u ofrojnë konsumatorëve mundësi të shprehen, që ta shpërndajnë një përmbajtje të caktuar, ide dhe përvoja të cilat mund të përdoren apo të cilave mund t'u referohen edhe konsumatorët e tjerë gjatë fazës së vendimmarrjes, një fakt ky shumë i vlerësuar nga konsumatorët të cilët janë në kërkim të informatave të besueshme. Zhvillimi i internetit, i teknologjisë së re të informimit dhe të komunikimit si dhe rrjeteve shoqërore e kanë ndryshuar mënyrën e komunikimit në mënyrë rrënjësore[37], ndonëse institucionet e kulturës, në rastin tonë Teatri Kombëtar i Kosovës, vazhdojnë të ndajnë shuma të caktuara për marketing *tradicional*. Paralelisht, shumica e institucioneve kulturore ka themeluar kanalet fillestare të komunikimit "on-line" dhe është duke ofruar adresa në rrjetet shoqërore, ku secili institucion ka një llogari në "Facebook".

Platformat e rrjeteve shoqërore përdoren gjatë procesit të vendimmarrjes nga të gjitha gjeneratat. Mirëpo, përdorimi i tyre ndryshon nga etapa e procesit të vendimmarrjes si dhe mes gjeneratave. Në etapën para vendosjes për të shkuar në teatër rrjetet shoqërore paraqesin burimin kryesor të informatave. Konsumatorët gjatë kërkimit të informatave janë të prirë t'i lexojnë përvojat e konsumatorëve të tjerë sepse konsiderohen të paanshme, të besueshme dhe si mjete të cilat ofrojnë mundësinë e ndërveprimit. Një numër i madh i platformave, si: forumet, blogjet dhe rrjetet shoqërore përdoren për shpërndarjen e informatave, prandaj përdorimi gjithëpërfshirës i këtyre platformave do të ishte me interes për institucionet kulturore për ta shtuar praninë e vet dhe përmes kësaj për ta rritur numrin e konsumatorëve.

[37] Audience Development research: http://www.etc-cte.org/base.php?code=908

Përkundër përdorimit të rrjeteve shoqërore dhe platformave të tjera, pyetjet që ndërlidhen me subjektivitetin dhe besueshmërinë e tyre mund të paraqiten. Disa vështrime dhe opinione merren si të pavërteta, andaj konsumatorët sikur janë të shtrënguar të bëjnë vlerësimin e vërtetësisë së këtyre informative përmes komunikimit të ndërmjetësuar nga kompjuteri, përmes së ashtuquajturës *e-Fjalës së Gojës* për ta gjetur të vërtetën prapa këtyre postimeve. Ky proces mund të marrë kohë, gjë që mund t'i bëjë konsumatorët të kërkojnë burime më të besueshme dhe që marrin më pak kohë.

Sa i përket etapës së pas shikimit/konsumimit të shfaqjes/aktivitetit teatror, rrjetet shoqërore dhe platformat e tjera ndërvepruese nuk përdoren si burim i informatës, por si platforma për shpërndarjen e përmbajtjeve dhe informatave me miq dhe komunitetin "on-line" të artdashësve duke iu ofruar përvojat vetjake, fotografi dhe video për t'iu ndihmuar klientëve potencialë për t'u përgatitur për përvojat e reja, përvojat personale.

Ky studim është hulumtimi i parë i zhvilluar për ta kuptuar bashkëveprimin mes rrjeteve shoqërore dhe sjelljes së konsumatorëve andaj duhet të përdoret nga hulumtuesit e tjerë, por edhe nga institucionet e kulturës për zhvillimin e audiencës ngaqë, sikur edhe ka thënë z.Richard Hadley, drejtor i Rrjetit Evropian të Audiencës, *zhvillimi i audiencës nuk ka të bëjë vetëm me njerëzit që vijnë te arti. Ka të bëjë edhe me ata njerëz që nuk vijnë te arti,* e që institucionet kulturore duan t'i ofrojnë. Ndikimi i internetit dhe rrjeteve shoqërore, i cili është konfirmuar edhe gjatë intervistave me konsumatorë, sugjeron se institucionet e kulturës duhet të fokusohen në zhvillimin e një strategjie të re të komunikimit për t'i tërhequr konsumatorët duke ua ofruar informatat për të cilat ata kanë nevojë dhe në kërkim të tëcilave janë.

Bibliografia

Alfredo M. Ronchi, (2009), *eCulture, Cultural Content in the Digital Age*, Springer-Verlag Berlin Heidelberg

Bailey, A.A., (2007), *Public Information and Consumer Scepticism Effects on Celebrity Endorsements: Studies among Young Customers*. Journal of Marketing Communications, 13 (2), Routledge

Basu, A. and S. Muylle, (2003), *Online support for commerce processes by web retailers*, Decision Support Systems 34(4)

Biggins, M. and J. Crayne, (2000), *Publishing in Yugoslavia's Successor States*, The HaworthInformationPress, An Imprintof The HaworthPress, Inc. NewYork, USA; Volume 1, Numbers 2/3

Blackwell, L.D., Miniard, P.W. and Engel, J.F., (2006), *Costumer behaviour*. 10th ed. Mason: Thomson Business and Economics

Brunborg, H., (2002), *Report on the size and ethnic composition of the population of Kosovo*

Cockrum, J., (2011), *Free Marketing: 101 Low and No-Cost Ways to Grow Your Business, Online and Off*; Published by John Wiley & Sons, Inc., Hoboken, New Jersey

Czaja, R. and Blair, J., (2014), *Designing Surveys: A guide to decisions and procedures*. Thousand Oaks, CA: Pine Forge Press

J. L.Borgerson, J.E.Schroeder, (2005), *Identity in Marketing Communications: An Ethics of Visual Representation. Marketing Communication: New Approaches, Technologies and Styles*, Oxford University Press

J. Lipnack, J. Stamp, *Virtual Teams: Reaching Across Space, Time and Organizations with Technology,* John Wiley & Sons, New York, 1997

Krauss, R. M., (1987), *The role of the listener: Addressee influences on message formulation*. Journal of Language and Social Psychology, 6

M. Trusov & E.R. Bucklin & H.C. Pawels, (2010), *Effects of word of mouth versus Traditional Marketing*, Findings from Internet Social Networking Site

Paul M. Herr, Frank R. Kardes, and John Kim, (1991), *Effects of Word-of-Mouth and Product-Attribute Information on Persuasion: An Accessibility-Diagnosticity Perspective*, Journal of Consumer Research, 17 (4)

R.E. Rice, J. D'Ambra, E. More, (1998),*Cross - cultural comparison of organizational media evaluation and choice*, Journal of Communication 48(3)

Schiffman, L. G. and Kanuk, L. L., (2010), *Consumer behaviour*. Global Edition. London. Pearson Higher Education

Steinberg, S., (1996), *Persuasive Communication Skills: Public Speaking*, Cape town: Juta Co and Pvt Ltd. 1999

Turban, E., Mclean, E. And Wetherbe, J., (2004), *Information technology for management: transforming organizations in the digital economy*. 4th ed. Chichester: Wiley

Walther, J. B., & Carr, C. T., (2010), *Internet interaction and intergroup dynamics: Problems and solutions in computer-mediated communication*. In H. Giles, S. Reid, & J. Harwood (Eds.), The dynamics of intergroup communication. New York: Peter Lang

Materiale nga ueb faqet

Audience Development research: http://www.etc-cte.org/base.php?code=908

Barometri i TI-s në Kosovë për 2015; publikuarnga STIKK; http://stikk.org/fileadmin/user_upload/it_barometer_kosovo-2015_ang_1_.pdf. Shikuar në shtator 2016

Dellarocas, C. (2003), *Digitalization of word of mouth: Promise and challenges of online feedback mechanisms*; Management Science, Vol. 49, No. 10, fq. 1407-1424

Ford's Theatre: http://www.fords.org/sites/default/files/rhetorical-triangle.pdf

Guernsley, L., (2000), *Suddenly, Everybody's an Expert*, TheNewYorkTimes! http://www.nytimes.com/2000/02/03/technology/suddenly-everybody-s-an-expert.html

Ibrahim Berisha, *Komunikimi medial në shoqërinë postkonfliktuale*; e nxjerrë nga "Thesis Kosova": https://aab-edu.net/downloads/01_2008_07_ibrah_jnaDQ.pdf

Kosova Press, http://www.kosovapress.com/sq/lajme/a-do-ti-kthehet-shpirti-teatrit-fatkeq-te-prishtines-22081/

Raporti i publikuar në vitin 2013 mbi depërtimin dhe përdorimin e internetit në Kosovë, të publikuar nga Shoqata e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (STIKK); http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,1944#.VkLy2tRwaE0

Silverman, G., (2001), *The Power of Word of Mouth. Direct Marketing*, 64(5), 47: https://www.ualberta.ca/business/PaulMessinger/Research/~/media/business/FacultyAndStaff/MBEL/PaulMessinger/Documents/Research/Issue2/GoyetteEtAl.pdf

Spencer-Oatey, H., (2012), What is culture? A compilation of quotations. Global PAD Core Concepts. E qasshme në Global PAD Open House; http://www2.warwick.ac.uk/fac/soc/al/globalpad/openhouse/interculturalskills/global_pad_-_what_is_culture.pdf

Straubhaar, J., La Rose, R., and Davenport, L., (2014), *Media Now: Understanding Media, Culture, and Technology,* Ninth Edition, Cengage Learning, Boston, USA, E qasur nëpërmjet https://books.google.com/books?

Shpresë MULLIQI

NEW MEDIA AND THEIR IMPACT ON INCREASING THE NUMBER OF CONSUMERS IN THE CULTURE INDUSTRY

Abstract

Given the perceived perception that e-Culture, defined as the application of new information technologies in the industry of culture, has significantly influenced the management of cultural institutions such as theaters, cinemas, libraries, etc. as well as in increasing the number of visitors of these institutions, through this paper will be presented the data derived from consumer behavioral analysis, conditioned by the impact of the communication technology and social networks in decision making vis-à-vis the offers of cultural institutions.

This paper also argues that despite the apparent controversies that may be encountered, however, the subjectivity of information provided by the cultural institutions as well as the subjectivity of information disseminated by various individuals on social networks (known as e-WoM / Word of mouth), as the substitute of the old media as well as the word of mouth (WoM) today are among the most

important factors of information influencing public decision regarding a particular cultural event.

At the end of this paper, recommendations are made regarding the use of new communication technology and social networks in the cultural industry to increase the number of consumers, as well as recommendations on the opportunities offered by new media in the development of this industry.

Key words: e-Culture, e-WoM, communication technology, new media, social networks, consumers, cultural institutions

Haqif MULLIQI

TEKNOLOGJIA E RE E KOMUNIKIMIT DHE NDËRVEPRIMI I FAKTORËVE STRUKTURORË, INSTITUCIONALË DHE SOCIO-EKONOMIKË NË ETIKËN GAZETARESKE NË KOSOVË

Abstrakt

Shumë pak periudha në historinë e njerëzimit kanë qenë po kaq revolucionare për shkencën e komunikimit dhe dijes sa kjo e sotmja. Ndërkohë që interneti ka shpërthyer përmesbarrierave komunikuese si një forcë e madhe transformuese, e cila ka krijuar një mjedis të ri që shënon kalimin nga një shoqëri industriale tek një shoqëri digjitale dhe të bazuar në dije, teknologjia e re mediale e ka transformuar rrënjësisht edhe gazetarinë në mbarë botën dhe, në këtë kuadër, as Kosova nuk bën përjashtim. Modeli i komunikimit vertikal dhe njëdrejtimësh i komunikimit - ne flasim, ju dëgjoni, është duke u zëvendësuar nga një model horizontal dhe shumëdrejtimësh, në të cilin njerëzit janë prodhues po aq sa janë konsumatorë të përmbajtjes, dhe po aq transmetues sa edhe marrës. Sidoqoftë, hulumtimet mbi ndikimin e kësaj teknologjie në etikën gazetareske janë shqetësueshëm të pakta. Për më tepër, numri më i madh i studimeve në këtë fushë fokusohet në përdorimin e teknologjisë së re në gazetari si një ofruese e informatave për publikun, si bazë e besueshme, gjithëpërfshirëse dhe e paanshme e lajmeve dhe ngjarjeve (Pavlik, 2000), ndërkohë që implikimet etike sikur janë lënë në harresë. Ndaj, qëllimi i studimit tonë qëndron tek intenca e shqyrtimit të sfidave etike me të cilat ballafaqohen praktikuesit e gazetarisë së Kosovës në punën e tyre, ndërsa deri te të dhënat është arritur përmesnjë pyetësori dhe intervistave gjysmë të strukturuara të cilat kanë mundësuar gjenerimin e të dhënave për sfidat etike dhe dilemat me të cilat ballafaqohen gazetarët në Kosovë.

Fjalët kyçe: *Teknologjia e re e komunikimit, interneti, etika gazetareske, sfidat etike, shpërdorimi i profesionit.*

HYRJE

"Në kohët e errëta njerëzit kanë nevojë për dritë.
Gazetaria e mirë mund ta sigurojë atë"
Aidan White

Në epokën e internetit, kur lajmet lokale me vetëm një klikim të vetëm bëhen globale dhe kur qindra lexues kthehen në miliona ngaqë janë të lidhur në kompjuterët e tyre ose nëpërmjet telefonave të tyre të mençur, pra në mënyra të cilat ishin, të thuash, të paimagjinueshme vetëm disa vite më parë, revolucioni i teknologjisë së komunikimit po e transformon, në thelb dhe në mënyrë të pakthyeshme, natyrën e gazetarisë dhe etikën e gazetarisë. Ndërsa interneti nxit forma të reja të gazetarisë që janë interaktive dhe të menjëhershme, mjetet për ta publikuar tashmë janë edhe në duart e çdo qytetari. Shih për këtë, vlerësimet mbi teknologjinë e re të komunikimit ndryshojnë. Disa e shohin atë si burim dhe mishërim të standardeve më të larta të jetesës, të tjerë ia atribuojnë këtë edhe edukimit dhe komunikimit më të mirë, ndërsa janë edhe ata të cilët e vlerësojnë shpejtësinë me të cilën arrihet deri tek informata si dhe faktin se tashmë nuk gjendenvetëm në rolin e konsumatorit, por janë edhe kontribuues aktivë si pjesëtarë të një komuniteti virtual, të njohur edhe si *qytetarë të rrjetit.*[1] S'do mend se janë edhe të atillët që pretendojnë se *teknologjia e re e komunikimit u ka sjellë jo vetëm të mira dhe se problemet e shkaktuara nga ajo tashmë nuk mund të zgjidhen as përmes teknologjisë më të avancuar* (Barbour, 1989 - 1991). Kjo është evidente në gazetari ngaqë lajmi, që një herë dhe një kohë ishte monopolizuar nga gazetarët, nga mënyra në të cilën është konceptuar, mbledhur, prodhuar dhe shpërndarë, po ndryshon falë ndryshimeve të cilat po shpërfaqen me prezantimin e teknologjive të reja të komunikimit. Për më tepër, gazetarët profesionistë kanë filluar t'i kuptojnë mundësitë të cilat ua ofron teknologjia e re e komunikimit dhe se kjo po e ndryshon fushën e tyre, ndonëse as ata dhe as studiuesitnuk e kuptojnë plotësisht se *çfarë ndryshimesh do të ndodhin me këtë zhvillim të hovshëm të teknologjisë* (Hauben, 1995), e kundruar në ndërveprimin me faktorët strukturorë, institucionalë dhe socio-ekonomikë të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në punën e gazetarit.

Hulumtimet e mëhershme mbi ndikimin e teknologjive të reja të komunikimit në gazetari kanë pasur tendencë që të fokusohen më shumë në atë se si teknologjia ka ndryshuar mënyrën e mbledhjes dhe seleksionimit të informatave dhe në mënyrën e prodhimit dhe shpërndarjes së tyre, ngaqë teknologjitë e reja të komunikimit, si telefonat mobilë dhe interneti (për mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave), ua mundësojnë gazetarëve mbledhjen e informatave nga çdo kënd i globit, si dhe

[1] Në diskursin shkencor e hasim si *Netizen,* që i referohet një pjesëmarrësi aktiv në komunitetin on-line të internetit, e që si nocion, sipas të dhënave të numërta, për herë të parë është përdorur nga Michael Hauben.

dërgimin e mesazheve me tekst, fotografi dhe video në redaksitë e tyre me lehtësi relative. Njëkohësisht kjo teknologji (kompjuteri, tabletat, telefonat mobilë/ smartfonat) ua mundëson gazetarëve, dhe jo vetëm atyre, qasjen e pakufizuar në informacione, në një bibliotekë virtuale *që, në fakt, është truri kolektiv i mijëra njerëzve, të çdo subjekti që në një formë apo tjetrën kontribuon në mbamendjen kolektive* (van Dijk, (2007).

Ndërkohë, edhe pse Emery & Emery (1996) e kanë bërë një dallim të qartë në mes të teknologjisë së prodhimit dhe transmetimit që ndërlidhet me grumbullimin dhe shpërndarjen e lajmeve, ata i konsiderojnë të *dy llojet e teknologjive si parakushte themelore për modernizimin e gazetarisë si një profesion*. E njëjta frymë optimiste e ka nxitur edhe van Dusseldorpin[et al. (1999)] të deklarojë se *revolucioni informativ ka potencial për ta fuqizuar profesionalizmin në shërbim të proceseve zhvillimore* përmes përparësive që iu atribuohet teknologjive të reja. Ky është edhe këndvështrimi optimist përsa i përket teknologjisë së re të komunikimit, e cila konsiderohet si një burim i *mundësive të reja për gazetarët*. Mirëpo këtunuk duhet anashkaluar as fakti se në diskursin shkencor ekziston edhe këndvështrimi pesimist i cili bën përgjegjëse pikërisht teknologjitë e reja për *krijimin e një kaste të re të gazetarëve me kreativitet dhe profesionalizëm të cunguar për shkak të kopjimit të materialeve nga mediet dhe burimet e tjera* (Garrison, 2004). Apo, siç thotë Ardian Vehbiu, *nuk ka nevojë për analiza shkencore, për t'u bindur se pjesa më e madhe e materialeve on-line përcillen nga një medium në tjetrin, si vagonët e mallrave kur ndërrojnë lokomotivat dhe shinat.*[2]

Ky binom sikur ka tendencë t'i maskojë ndryshimet e krijuara në rutinën gazetareske, në vlerën e lajmeve dhe praktikat etike që ndërlidhen edhe me mjediset shoqërore, politike dhe ekonomike në të cilën këto teknologji të reja të medies janë vendosur dhe përshtatur. Kështu, fitohet përshtypja se studiuesit më parë kanë qenë më pak kureshtarë ta dinë se si gazetarët i perceptojnë ndryshimet në praktikat etike të gazetarisë në kontekstin e teknologjive të reja të medies, dhe se si këto ndërrime janë ndërthurur me mjedisin socio-politik dhe ekonomik në të cilin veprojnë gazetarët.

Nuk duhet anashkaluar, gjithashtu, as fakti se teknologjia në vetvete nuk është shkaku i performancës profesionale ose joprofesionale të gazetarëve. Mund të jetë ndihmës, por jo edhe definues i performancës etike ose joetike, apo edhe i marrëdhënieve në vendin e punës. Sepse, është vetë individi ai i cili bart përgjegjësinë për veprimet e veta etike dhe profesionale, ndërkohë që vendimet e menaxhmentit, marrëdhëniet brenda mediumit, si dhe politikat editoriale janë burime themelore të praktikave të punës. Kështu ndikimi i teknologjisë mund të kuptohet vetëm në një bashkëveprim kompleks brenda një sistemi të përbërë nga të gjitha këto elemente, sepse *etika e gazetarisë, normat e gazetarisë së përgjegjshme, mund të gjurmohen që në fillim të gazetarisë moderne* (Bertrand, 2007). Prandaj, në këtë hulumtim është bërë studimi i

[2] Një dukuri e tillë ka marrë hovë edhe në mediat e Kosovës ndonëse si e tillë tashmë konsiderohet si problemi numër një edhe në gazetarinë botërore, gjë të cilën e konfirmon edhe Nick Davies, autori i librit më kontrovers *Flat Earth News* (2008).

sfidave etike dhe dilemave me të cilat përballen gazetarët e Kosovës gjatë përdorimit të internetit, të rrjeteve sociale dhe telefonisë mobilegjatë punëssë tyre të përditshme.

Në veçanti, në këtë studim është shqyrtuar se si këto teknologji të reja kanë ndikuar në praktikat e përditshme gazetareske dhe praktikat etike mes gazetarëve që përdorin internetin, rrjetet sociale dhe telefonat mobilë në punën e tyre. Për më tepër, bën përpjekje për t'i zgjeruar mundësitë për ta teorizuar etikën e gazetarisë, duke u fokusuar në atë se si gazetarët i perceptojnë sfidat e paraqitura nga teknologjia e re e komunikimit dhe se si këto sfida dhe dilema ndikojnë në kushtet në të cilat praktikohet gazetaria. Mirëpo, etika në këtë hulumtim nuk është shtjelluar përmes analizës së gjuhës së përdorur nga gazetarët, objektivitetit të tyre dhe natyrës së arsyetimit etik. Qasja e përzgjedhur pretendojmë se kontribuon në të kuptuarit tonë se si praktikat etike janë ndërthurur me kushtet teknologjike, socio-politike dhe ekonomike në të cilat praktikohet gazetaria. Një qasje e tillë na ka ndihmuar t'i kuptojmë më mirë kushtet në të cilat etika gazetareske është duke u ristrukturuar nga kjo valë e risive teknologjike. Prandaj, ne jemi fokusuar tek ajo që njihet si *etikë e aplikuar*[3] (Christopher, 2013) ngaqë, para së gjithash, ka të bëjë me çështjet dhe problemet specifike që ndërlidhen me fushën në fjalë, duke parë etikën e aplikuar, *në mënyrë që t'i justifikojë veprimet e duhur për një vendim të caktuar në medium*.

Nga të dhënat në dispozicion del se në studimet e mëhershme është analizuar ndikimi i medieve të reja nga këndvështrime të ndryshme duke përdorur metoda të ndryshme. Megjithatë, kërkimet që ndërlidhen me mediet e Kosovës dhe ndikimin e teknologjive të reja të komunikimit në praktikën gazetareske janë të pakta, të fragmentuara dhe praktikisht nuk ka studime të njohura mbi mediet e reja dhe etikën e gazetarisë në Kosovë. Ndonëse ekzistojnë disa studime në rajon, megjithatë duhet cekur se nuk përqendrohen në atë se si *në epokën e trans-medialitetit shohim migrimin e përmbajtjes dhe pronës intelektuale në të gjithë format e i mediave* (Martin Lister et all, 2010), gjë që ka ndikuar edhe në etikën e gazetarisë.

Edhe përmeskëtij studimi është synuar gjenerimi i të dhënave fillestare si dhe fillimi i një diskursi akademik mbi këtë temë, para së gjithash, duke hulumtuar perceptimet e gazetarëve të Kosovës që ndërlidhen me sfidat etike të shfaqura me paraqitjen e internetit, rrjeteve sociale dhe telefonave mobilë. Kështu ne këtu kemi trajtuar dy çështje kryesore, përkatësisht: 1) Cilat janë sfidat etike dhe dilemat që gazetarët i hasin gjatë përdorimit të internetit, të rrjeteve sociale dhe telefonave mobilë? Dhe, 2) Cilat janë implikimet e këtyre teknologjive në praktikimin e gazetarisë?

[3] Deri më tani ne jemi fokusuar kryesisht në etikën normative, e cila studion se çfarë karakteristika ka e mira / e keqja, një vepër e drejtë / e gabuar apo një tipar i virtytshëm ose i lig, dhe meta etikën, e cila studion pyetje filozofike rreth kuptimit të fjalëve etike, ose natyrën e fakteve etike. Ndërsa etika e aplikuar është një kategori e veçantë e filozofisë etike e cila ka të bëjë me pyetje të vështira morale dhe çështjet e diskutueshme morale me të cilat njerëzit në fakt përballen në jetën e tyre.

Zhvendosja e kufijve të etikës si pasojë e revolucionit teknologjik e shikuar nga aspekti deontologjik

Edhe pse termi teknologji të reja të komunikimit është një term përgjithësues, ngaqë i referohet *një shumëllojshmërie të gjerë të teknologjive të komunikimit si Internet, telefoni mobile, kompjuter, multimedia, rrjetet shoqërore dhe mediet e tjera shoqërore* (Friedman & Friedman 2008), në hulumtimin tonëtermi teknologji të reja është përdorur për t'iu referuar internetit, rrjeteve sociale dhe telefonave mobilë.

Për të arritur deri te të dhënat e synuara fillimisht kemi definuar termin "etikë". Në udhëzuesin e BBC-së, ta themi, *etika* definohet si *një sistem i parimeve morale që ndikojnë në mënyrën se si njerëzit marrin vendime dhe e jetojnë jetën e tyre, që janë të mira për individët dhe shoqërinë, e përshkruar edhe si filozofi morale*. Që është e përafërt edhe me atë se çfarë Claude-Jean Bertrand (2007) konsideron etike ngaqë, sipas tij, ai është një *grup i parimeve morale, formë e sjelljes korrekte, si dhe ndërveprim i drejtë dhe njerëzor*. Ndërsa në *Kodin e mediave të shkruara të Kosovës*, thuhet se *parimet etike iu shërbejnë gazetarëve dhe redaktorëve të mbrojnë integritetin profesional të gazetarisë*. Në këtë kontekst, në *Kodin e sjelljes për shërbimet mediale audio-vizuale*, etika definohet si rregull i *sjelljes dhe punës së shërbimeve mediale audio-vizuale*.

Pra, etika ka të bëjë me gjykimin praktik të gazetarit (dhe redaktorit) si dhe zbatimin dhe aplikimin e parimeve në vendimmarrje. Prandaj, mund të thuhet se etika e gazetarisë, e shikuar përmes ndërveprimit me faktorët strukturorë, institucionalë dhe socio-ekonomikë,përfshinë një varg të vendimeve praktike të gazetarit gjatë procesit të mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes së lajmeve. Ndaj ne jemi ndalur ta analizojmë etikën nga aspekti deontologjik[4], të shqetësuar me atë që gazetarët bëjnë, e jo me pasojat e veprimeve të tyre, aq më tepër kur besojmë se gazetarët tashmë e kanë të njohur se duke e praktikuar gazetarinë etike, si mjet për krijimin e legjitimitetit, fitojnë edhe besimin e publikut. Hardt dhe Brenner (1993) argumentojnë se *gazetaria i pasqyron dhe i mishëron proceset historike në të cilat është zhvilluar dhe kushtet bashkëkohore sociale në të cilat është krijuar*.

E praktikuar në mënyrën profesionale, duke respektuar të drejtën e individit për të qenë i informuar, si dhe gjithnjë duke iu përshtatur zhvillimeve dhe kushteve moderne, e gjithë *historia e gazetarisë është ndërtuar përmes ndikimit të faktorëve të ndryshëm siindustrializimi, infrastruktura dhe demokracia në masë* (Carey, 2007) të cilat, duke ndërvepruar me faktorët strukturorë, institucionalë dhe socio-ekonomikë, i godasin praktikuesit e gazetarisë në çdo kohë. Kjo do të thotë se mënyra se si gazetarët e perceptojnë etikën është e ndikuar nga rrethanat shoqërore në të cilat ata veprojnë.

[4] Teoria e deontologjisë thotë se ne jemi moralisht të detyruar për të vepruar në përputhje me një grup të caktuar të parimeve dhe rregullave pavarësisht nga rezultati.

Andaj edhe integrimi i sociologjisë së gazetarisë dhe etikës na e mundëson zgjerimin e bazës konceptuale të etikës së gazetarisë.

Në qoftë se ne e pranojmë se vlerat etike janë një si produkt i historisë shoqërore, atëherë lidhja midis etikës së gazetarisë dhe teknologjive të reja të komunikimit bëhet më e qartë. Norton Batkin (1990) vë në dukje se si kërkimi për të vërtetën objektive është inkurajuar nga shpikja e fotografisë, një medium ky i cili e tregon *saktë të vërtetën e dukshme*. Sociologjia e etikës së gazetarisë, pra na mundëson ta kuptojmë se si etika e gazetarisë është gërshetuar pazgjidhshmërisht me proceset socio-historike. Përderisa produkti i punës gazetareske si dhe forcat strukturore, organizative si dhe të jashtme që e bëjnë gazetarinë u janë nënshtruar hulumtimeve akademike (shih Lesage, Frederik dhe Hackett, Robert A., 2013) studimet të cilat merren me etikën e gazetarisë në një paradigmë sociologjike nuk ekzistojnë fare. Prandaj, kjo është arsyeja pse ky studim gjen vend meritor për shqyrtimin e sociologjisë së etikës së gazetarisë. Një qasje na ndihmon edheqë ta bëjmë një vlerësim më të mirë të forcave të vendosura brenda dhe jashtë kontekstit organizativ të cilat i kufizojnë gazetarët nga praktikimi i gazetarisë etike. Ndërkohë që ka pasur një vëmendje të konsiderueshme në zhvillimine praktikave gazetareske në kontekstin e një mjedisi të ndryshueshëm nga aspekti teknologjik, shumë pak hulumtime janë drejtuar ndaj praktikave etike.

Mendojmë se integrimi i sociologjisë së gazetarisë dhe etikës së gazetarisë ndihmon në hartimin e shtigjeve të reja teorike mbi aspekte të rëndësishme të vendimeve gazetareske, duke përfshirë këtu edhe vendimet etike, deri në një masë të tillë që ne mund të fillojmë të flasim për një sociologji të etikës së gazetarisë, e cila mund të na ndihmojë t'i kuptojmë mirë edhe specifikat e marrjes së vendimeve etike në organizatat e medieve.

Nga ana tjetër, një sociologji e etikës së gazetarisë mund të na ndihmojë t'i kuptojmë më mirë edhe kushtet në të cilat është duke u zhvilluar etika e gazetarisë si dhe shkaqet e shumta të cilat e formësojnë një evolucion të tillë, në vend se të mbështetemi në një faktor të thjeshtëzuar apo, siç thuhet, një shkakor. Një sociologji e etikës së gazetarisë është urgjente dhe e domosdoshme jo vetëm për ta pasuruar fushën e teorisë, por edhe për shkak se kufijtë e etikës janë duke u zhvendosur si pasojë e revolucionit teknologjik.

Shqyrtimi i praktikave gazetareske të krijuara përmes një rrjeti të gjerë të burimeve dhe mundësive teknologjike

Studimet e fundit që kanë të bëjnë me bashkëveprim në mes të medieve të reja dhe praktika e gazetarisë janë të bazuara kryesisht në teorinë e determinizmit teknologjik, teori kjo e cila teknologjinë e sheh si *një forcë lëvizëse të ndryshimeve shoqërore sepse ndikon në atë se si një individ mendon, si ndien, si vepron, dhe si funksionon në një shoqëri*

(Mcluhan, 1962). Kjo qasje të gjitha ndryshimet në praktikat gazetareske ua atribuon risive teknologjike. Kështu, teknologjia lavdërohet për ofrimin e mundësive të pakufizuara për profesionin e gazetarisë, njëkohësisht fajësohet për shtrirjen e madhe, e që konsiderohet si ndryshim negativ sepse ndikon në cilësinë e produkteve të medieve. Ndërkohë që vlerësimi i ndikimit të teknologjisë së re në praktikën e gazetarisë si - *pozitiv* ose *negativ* është problematik sepse maskon bashkëveprimin kompleks të forcave që i formojnë praktikat gazetareske.

Sikundër edhe thotë edhe Evans (1979, i cituar në Robins & Uebster, 1989) *interneti e ka transformuar profesionin e gazetarit, para së gjithash, përmes rritjes së kulturës demokratike, pastaj edhe përmes krijimit të një rrjeti të gjerë të burimeve dhe mundësive teknologjike* që ofron si dhe përmes mundësimit të llojit të ri të gazetarisë - gazetarinë *on-line*, e cila ua mundëson qytetarëve të bashkëveprojnë mes vete dhe me të zgjedhurit e tyre. Disa studiues argumentojnë se praktika e gazetarisë bëhet brenda një mjedisi të caktuar institucional dhe një strukture organizative, ku merren vendimet dhe ku mbizotërojnë proceset e prodhimit. *Të gjithë këta faktorë duhet të merren parasysh në qoftë se duam ta kuptojmë plotësisht ndikimin e teknologjisë në praktikën e gazetarisë* (Boczkowski,1999). Ndërsa, studimet që kanë hulumtuar ndikimin e teknologjive të reja të medies në praktikën e gazetarisë janë të bazuara në përvojat e medieve në vendet e Perëndimit andaj, si rezultat i kësaj, edhe ndikimi i teknologjive të reja të medies në mediet tradicionale, veçanërisht në Kosovë, mbetet i papërfillshëm. Ky artikull përpiqet të gjenerojë të dhëna fillestare për ndikimin e internetit, rrjeteve sociale dhe telefonave mobilë në etikën e gazetarisë, duke u fokusuar në përvojat e gazetarëve të Kosovës.

Gjatë punës problem kyç është konsideruar mungesa e literaturës që ka të bëjnë me mediet e reja dhe gazetarinë *on-line* në Kosovë. Një studim i publikuar nga Shpresë Mulliqi (2015: 388) është ndoshta një nga përpjekjet e para që mbulon aplikimin e teknologjisë së re në media si dhe ndikimin e tyre në disa nga redaksitë e përzgjedhura në Kosovë. Gjatë punës në këtë studim, kemi vërejtur një shfrytëzim të gjerë të teknologjisë së re dhe internetit, e që ka rezultuar me një numër të konsiderueshëm të gazetarëve që e kanë pranuar se ata kishin aplikuar disa praktika jo-etike, të tilla si vjelja e materialit nga interneti pa e dhënë burimin e informatës, përfolja e materialit të kolegëve pa i cituar etj. Të pyetur nëse ata personalisht kishin bërë plagjiaturë, gazetarët e Kosovës që morën pjesë në studim e hedhën poshtë këtë.

Studimi ynënuk gërmoi në mënyrë të veçantë në çështjen që ka të bëjë me sfidat etike dhe dilemat sepse ishte më shumë i orientuar kah përhapja dhe përdorimi i teknologjive digjitale dhe praktikave në redaksi të lajmeve në një mjedis që dita-ditës po ndryshon.

Sipas të intervistuarve, situata në redaksitë e medieve të Kosovës ka ndryshuar rrënjësisht që nga rikthimi i tyre në vitin 1999, pas përfundimit të luftës, ngaqë me përhapjen e internetit dhe me përdorimin e telefonisë mobile në mënyrë dramatike janë përmirësuar kushtet e punës në mediet e Kosovës, si në redaksi, po ashtu edhe në

nivel kombëtar. Përderisa në fillimet e veta telefonia mobile dhe interneti ishin simbole të statusit, në vitin 2016 është e vështirë të gjesh një gazetar në redaksi që nuk i përdor këto teknologji për të mbledhur lajme. Andaj edhe ekziston një bazë e fortë për ta studiuar këtë fenomen sepse ndihmon për t'i kuptuar implikimet që ka interneti, rrjetet sociale dhe telefonia mobile në praktikat etike mes praktikuesve e gazetarisë në nivel vendi.

Të dhënat demografike

Të anketuarit dhe intervistuarit kishin një përvojë mesatare pune prej gjashtë vjetësh. Gjashtëdhjetë e tetë përqind (68%) e të anketuarve ishin femra (20 femra), ndërsa tridhjetë e dy përqind (32%) ishin meshkuj (10 meshkuj). Tetëdhjetë e shtatë përqind (87%) prej tyre janë të punësuar në medien elektronike (26 gazetarë), ndërsa trembëdhjetë përqind (13%) ishin të punësuar në mediet e shkruara (4). Dhjetë përqind (10%) e të anketuarve iu përkisnin pakicave kombëtare: turq, serb dhe boshnjak, ndërsa 90% ishin shqiptarë (27). Afërsisht çdo i intervistuar kishte një diplomë, ku gjysma e tyre kishin diploma nga Universiteti i Prishtinës, nga Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë. Mosha më e re (20 - 25) përbënte 60% të intervistuarve ose 18 gazetarë, ndërsa më të mëdhenjtë në moshë (25 - 40 plus) përbënin 40% e të anketuarve ose 12 gazetarë.

Teknologjitë e reja të komunikimit dhe dilemat me të cilat ballafaqohen gazetarët e Kosovës

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte për t'i shqyrtuar sfidat etike dhe dilemat me të cilat ballafaqohen gazetarët e Kosovës si rezultat i teknologjive të reja të komunikimit, të tilla si: internet, rrjete sociale dhe telefona mobilë. Në pyetjen tonë, nëse ata mendonin se interneti, rrjetet sociale dhe telefonia mobile kanë kontribuar në thellimin e problemeve etike, të definuara sipas kodeve etike të aplikueshme në Kosovë, 24 gazetarë ose 80 % e gazetarëve të anketuar kanë pohuar ndikimin e tyre në etikën profesionale, 3 gazetarë ose 10 % mendojnë se ka ndikuar pak, 2 gazetarë ose 7 % e të anketuarve mendojnë se nuk ka ndikuar aspak, ndërsa 1 gazetar ose 3 % e të anketuarve ka deklaruar se nuk ka dijeni nëse interneti, rrjetet sociale dhe telefonia mobile kanë ndikuar në etikën profesionale të gazetarëve.

Në pyetjen tonë me shumë opsione, se çfarë konsiderojnë joetike në punën e gazetarëve, e që vjen si rrjedhojë e përdorimit të internetit, rrjeteve sociale dhe telefonisë mobile, 29 gazetarë ose 96.7% e të anketuarve kanë identifikuar **plagjiaturën** si problem kyç, 22 gazetarë ose 73.3% kanë përzgjedhur përhapjen e **gjuhës së urrejtjes**, ndërsa 17 gazetarë ose 56.7% konsiderojnë se shkelje etike janë **shkelja e privatësisë** dhe **shpërndarjaestatuseve nga rrjetet sociale**

përmesmedieve *on-line*. Në pyetjen tonë, nëse e konsiderojnë shkelje etike përdorimin e **telefonave mobilë për të mbledhur informata**, 27 gazetarë ose 90% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht. Në pyetjen nëse **përdorimi i e-mailit për t'i intervistuar bashkëbiseduesit** është shkelje, 29 gazetarë ose 96.7 % e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht. Ndërsa në pyetjen nëse shpërndarja e informatave të pa konfirmuara nga,**së paku, dy burime,** është shkelje etike, 16 gazetarë ose 53.3% e të anketuarve janë përgjigjur negativisht, ndonëse 14 gazetarë ose 46.7% e tyre konsiderojnë se shfrytëzimi i shpeshtë i **burimeve anonime është shkelje** e kodit gazetaresk.

Gjetjet nga intervistat gjithashtu konfirmojnë rezultatet e studimit të nxjerra përmes anketave, e që kanë të bëjnë me praktikat më të përhapura joetike. Plagjiatura, përdorimi i rrjeteve sociale si burime dhe shfrytëzimi i burimeve anonime janë përmendur si problemet kryesore etike. Gjithashtu, mbështetja e gazetarëve në internet, rrjete sociale dhe telefoni mobile për kontaktimin e bashkëbiseduesve, mbledhjen e informatave dhe të dhënave relevante janë potencuar si probleme. Për më tepër, varësia e gazetarëve në mediet e reja, sidomos në përpilimin e lajmeve, është konsideruar vrastare e etikës profesionale dhe ndihmës shkatërruese e krijimtarisë dhe kulturës së gazetarisë që nga të intervistuarit u quajt gazetari e *mirëfilltë dhe tradicionale*. Disa gazetarë të intervistuar u shprehën të shqetësuar për faktin se gazetarët nga hulumtuesit në terren po kthehen në hulumtues nga karriget, për shkak të teknologjive të reja të komunikimit të cilat po ua mundësojnë atyre mbledhjen informatave nga tavolinat e tyre duke e humbur kështu kontaktin me ata të cilëve iu dedikohet produkti final i gazetarit - pra me lexuesin, shikuesin dhe dëgjuesin. Për më tepër, shumë nga të intervistuarit shfaqën shqetësimin se, duke i pakësuar kontaktet personale me burimet e informatave, po rrezikohet dita-ditës që raportimi i tyre do të jetë joreal. Këtë shqetësim e kishin jo vetëm gazetarët që nuk ishin edhe shumë pro medieve të reja, por edhe ata të cilët ishin tepër pozitiv përsa iu përket të mirave të cilat vijnë nga teknologjia e re e komunikimit.

Mirëpo gjatë intervistave bashkëbiseduesit potencuan se dukuritë e lartpërmendura si plagjiatura, shkelja e privatësisë, përdorimi i burimeve anonime, gjuha e urrejtjes apo dhe mbledhja e informatave nga tavolina vërtet mundësohen nga interneti, rrjetet sociale dhe telefonia mobile, mirëpo burim më së shpeshti i kësaj performance etike janë faktorëte tjerë, si: ata strukturorë, institucionalë dhe socio-ekonomikë. Po ashtu, sipas të intervistuarve, numri i madh i medieve dhe numri i vogël i të punësuarve brenda një mediumi shpesh është faktori vendimtar në shkeljet e etikës profesionale. Sipas po të njëjtëve, jo rrallë ndodh që gazetarët këmbejnë informata në pamundësi që fizikisht të jenë në të njëjtën kohë në disa vende për t'i përcjellë ngjarjet si rezultat i numrit të ulët të punëtorëve në terren, mungesës së pajisjeve për mbulimin e ngjarjeve etj.

Sa i përket ndarjes sipas medieve, nëntëdhjetë e nëntë përqind (99%) e gazetarëve të medieve të shkruara konsiderojnë se plagjiatura është e keqja më e madhe e profesionit krahasuar me pesëdhjetë e gjashtë përqind (56%) të gazetarëve të medieve on-line të cilët arsyetojnë se shpërndarja e informatave,"përafërsisht" të njëjta, është si rezultat i përgatitjes së njëjtë profesionale dhe mënyrës përafërsisht të njëjtë të të shkruarit të informatës (?!) dhe se e keqja më e madhe e gazetarisë qëndron në përdorimin e burimeve anonime, të cilën e pohojnë shtatëdhjetë e tre përqind (73%) e gazetarëve të medieve on-line.

Plagjiaturën nuk e konsiderojnë si shkeljen më të madhe as gazetarët e medieve të pakicave kombëtare në Kosovë, të cilën e pohojnë njëqindpërqind e të anketuarve. Gjatë intervistës këtë e arsyetojnë me faktin se shumica e tyre jetojnë dhe punojnë në kushte shumë të vështira ekonomike dhe sociale, ndërsa disa prej tyre thonë edhe se këtë e bëjnë ngaqë nuk e njohin gjuhën e komunitetit shumicë. Në pyetjen se pse nuk e vendosin burimin nga ku e kanë marrë informatën, të gjithë janë përgjigjur se atëherë ato informata nuk do të ishin të besueshme për lexuesit, shikuesit dhe dëgjuesit e tyre.

Përfundim

Studimi është kombinim i një hulumtimi përshkrues dhe intervistave gjysmë të strukturuara për të hulumtuar dhe gjeneruar të dhëna mbi përhapjen e teknologjisë së re të komunikimit dhe etikën e gazetarisë si dhe mbi dilemat me të cilat përballen gazetarët kosovarë e që ndikon edhe në cilësinë e lajmeve dhe informacionit. Anketa është përdorur kryesisht për të mbledhur të dhëna mbi perceptimet e gazetarëve kosovarë që ndërlidhen me dilemat etike dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë përdorimit të internetit, rrjeteve sociale dhe telefonave mobilë në punën e tyre për mbledhjen e informatave. Sondazhi është përdorur ngaqë studiuesit argumentojnë se përdorimi i tij është më efikas sesa metodat e tjera kur hulumton problemet në mjedise reale si dhe kur mëtohet mbledhja e sasive të mëdha të të dhënave (Bertrand dhe Hughes, 2004).

Pjesë e studimit kanë qenë përfaqësues të medieve të ndryshme, gazetarë të cilët, në kohën e krijimit të studimit, punonin në mediet e shkruara dhe në ato elektronike (radio, televizion dhe portale). Mostra e qëllimshme është përdorur për t'i përzgjedhur të anketuarit për shkak të pamundësisë që të intervistohen subjektet që janë me rëndësi për studimin. Me këtë rast (30) gazetarëve u janë shpërndarë pyetësorë, duke bërë përpjekje për të siguruar se mostra është përfaqësuese e gjinisë, etnisë, llojit të medies dhe pronësisë. Ndonëse mostra e qëllimshme shpesh është kritikuar sepse konsiderohet e njëanshme, numri relativisht i vogël i gazetarëve në vend dhe natyra e shpërndarë e redaksive në të gjithë vendin ka bërë që *procedura e mostrës së qëllimshme për gjenerimin e të dhënave të konsiderohet si më e përshtatshme për këtë studim* (Bertrand dhe Hughes, 2004). Për t'i vërtetuar të dhënat e nxjerra nga anketa

dhe për t'i sjellë nuancat që nuk mund të nxirren përmesnjë pyetësori, janë zhvilluar edhe intervista gjysmë të strukturuara të cilat janë realizuar me 15 gazetarë të ndryshëm. Intervistat u zhvilluan në Prishtinë, Pejë, Ferizaj dhe Mitrovicë, në mes të 5 dhe 8 prillit 2016. Shënimet nga intervistat gjysmë të strukturuara janë transkriptuar, koduar në tema dhe analizuar duke përdorur interpretimin hermeneutik.

Bibliografia

Barbour, I. G. (1989-1991), *Ethics in an age of technology*, The Gifford Lectures, Vol. 2. San Francisco: HarperSanFrancisco, 1993

Batkin, N. (1990), *Photography and Philosophy*; Garland Publishing; New York

Berger, Arthur A. (2013), *Media and Communication Research Methods: An Introduction to Qualitative and Quantitative Approaches*. Thousand Oaks, CA: Sage

Bertrand, Claude J. (2007), *Deontologjia e mediave,* Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë

Bertrand, I. and P. Hughes (2004), *Media Research Methods,* London, Palgrave MacMillan

Carey, J. (2007), *A Short History of Journalism for Journalists: A Proposal and Essay*; Harvard Journal for Press and Politics, 12(1)

Coleman EG, Hill B. 2004, The social production of ethics in Debian and free software communities. *In Free and Open Source Software Development*, ed. S Koch, pp. 273-95. Hershey, PA: Idea Group

Emery, M. & Emery, E. (1996), *The Press and America: An Interpretative History of the Mass Media*, 8th ed., Needham Heights: Allyn and Bacon

Friend, C., & Singer, J.B. (2007), *Online journalism ethics: Traditions and transitions,* New York: M.E. Sharpe

Garrison, B. (Autumn 2000), *Journalists' Perceptions of Online Information-Gathering Problems*, Journalism & Mass Communication Quarterly, 77(3): 500-514

Garrison, B. (Spring 2004), *Newspaper journalists use e-mail to gather news,* Newspaper Research Journal*,* 25:58-69

Hutchby, I. (2001), *Conversation and Technology: From the Telephone to the Internet,* Cambridge: Polity

Johnson, M. J., Wilcox, P. A. (2007), *The world of connected things*. *The Journal of Government Financial Management,* 56(4), Winter, 48-53

Martin Lister, Jon Dovey, Seth Giddings, Iain Grant, and Kieran Kelly (2010),*New Media: A Critical Introduction,* London: Routledge Publication, pp. 446

Mcluhan, M. (1962), *The Gutenberg Galaxy: The Making of Typographic Man,* London: Routledge & Kegan Paul

Nair, Meera (2009), Copyright and ethics: An Innisian exploration. Global Media Journal -- Canadian Edition, 2(1), 23-39

Osgood, C. E., Suci G.C., and Tannenbaum, P.H. (1957),*The Measurement of Meaning*. Urbana, IL: University of Illinois Press

Pavlik, J. (2001), *Journalism and New Media,* New York, Columbia University Press

Robins, Kevin & Frank Webster (1989),*The Technical Fix: Education, Computers and Industry,*London: Macmillan

Van Dijk, J. (2007), *Mediated Memories in a Digital Age,* Stanford, CA: Stanford University Press. Interdisciplinary Science Reviews. 36:1. p90-96

Van Dusseldorp, Monique, Scullion, Roisin, Bierhoff, Jan (1999), *The Future of Printed Press*, Maastricht, European Journalism Centre Publication.

Bibliografia elektronike

"Profiles in Plagiarism: Journalism" FamousPlagiarists.com. No Date. 15 April 2007. http://www.famousplagiarists.com/books.htm

Boczkowski, P. J. (1999). *Mutual shaping of users and technologies in a national virtual community*. *Journal of Communication*, *49*(2), 86-108

https://www.scholars.northwestern.edu/en/publications/mutual-shaping-of-users-and-technologies-in-a-national-virtual-co

Christopher, Andrew (2013),*Ethical Theories In Journalism,* http://ethics.journalism.wisc.edu/resources/ethics-in-a-nutshell/, shkurt 2016

David E. Boeyink (1990),*Anonymous Sources in News Stories: Justifying Exceptions and Limiting Abuses.Journal of Mass Media Ethics* 5 (4):233-246 http://www.tandfonline.com/loi/hmme20#.V6ROd9Jf2wg

Friedman, L.W. and Friedman, H.H (2008), High impact areas of the new media technologies: A review, *Management Online Review*

Friedman, L.W., & Friedman, H.H., (2008) The New Media Technologies: An Overview and Research Framework. Social Science Research Network. http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=1116771, janar 2016

Hauben, Michael. *The Effect of the Net on the Professional News Media: The Usenet News Collective--The Man-Computer News Symbiosis*, Teachers College, Columbia University, http://www.columbia.edu/~hauben/CS/net-and-newsmedia.txt

Hauben, Michael; Hauben, Ronda.*"Preface: What is a Netizen". Netizens: On the History and Impact of Usenet and the Internet (PDF).* pp. 2–3. Shkurt 2016. http://www.morexpertise.com/download.php?id=97, janar 2016

Lesage, Frederik, and Hackett, Robert A. (2013). *Between Objectivity and Openness: The Mediality of Data for Journalism.* Media and Communication, 1. http://www.librelloph.com/mediaandcommunication/article/view/MaC-1.1.39

Mulliqi, Sh. (2015). *Konvergjenca e medieve: një studim mbi të arriturat në Kosovë.*CRC-Journal Volume 2, No. 3-4, 387-397.

http://crc-journal.com/wp-content/uploads/2016/03/Revista-CRC-Journal-3-4.pdf

Pawlik, J. (2000); *The Impact of Technology on Journalism*, Journalism Studies, 1:2, 229 – 237; http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/14616700050028226, shkurt 2016

Thurstone, L. L. (1928). *Attitudes can be measured.* American Journal of Sociology,33, Nr. 4. The University of Chicago; http://www.journals.uchicago.edu/doi/pdfplus/10.1086/214483

Vehbiu, A. (data mungon). *Etika e mediave në epokën e digjitalizimit*; Botuar nga Instituti i Medias, Tiranë. http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/A.Vehbiu%20shqip%20follow-up.pdf

Dokumente

BBC Ethics guide; Ethics*: a general introduction*
http://www.bbc.co.uk/ethics/introduction/intro_1.shtml

Kodi i medieve të shkruara të Kosovës, Këshilli i Medieve të Shkruara; http://www.presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Press-Code-for-Kosovo_alb.pdf

Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale; http://www.kpm-ks.org/?pamja=dokumentet&gjuha=1&kerko=kodi

Haqif MULLIQI

NEW COMMUNICATION TECHNOLOGY AND INTERACTION OF STRUCTURAL, INSTITUTIONAL AND SOCIO-ECONOMIC FACTORS IN JOURNALISTIC ETHICS IN KOSOVO

Abstract

Very few periods in the history of mankind have been almost as revolutionary to the science of communication and knowledge as this is. While the Internet has broken up the communication barriers as a major transformation force, which has created a new environment that marks the transition from an industrial society to a knowledge-based digital society, new media technology has radically and globally transformed journalism and, in this context, Kosovo is no exception. The vertical and one-way communication model - we talk, you listen, is being replaced by a horizontal

and multi-directional model in which people are producers as much as content consumers as well as broadcasters as much as recipients. Researches on the impact of this technology on journalistic ethics are worryingly scarce. Our study, however, examines the ethical challenges faced by Kosovo journalism practitioners in their work. The results show an impact of new technologies in journalism and they suggest that they can be helpful as much as an obstacle to ethical journalism. Herewith it has been also argued that the application of ethical journalism is hindered by the interaction of complex system of structural, institutional and socio-economic factors, both internal and external, part of the environment in which journalism is practiced.

Key words: New Technology, Internet, Journalistic Ethics, Ethical Challenges, Abuse of the profession.

Albert MECINI

PËRTEJ PEDAGOGJISË PUBLIKE TË KOMUNIKIMIT MASIV

Abstrakt

Komunikimet uniforme, pedagogjia publike dhe emancipuese, mendimi unitar, cenueshmëria ideologjike e subjektit, janë vetëm disa nga karakteristikat e frymës së universit politik dhe shoqëror të modernitetit. Burimet konvencionale të komunikimit masiv: gazeta, radio dhe më vonë televizioni janë transmetuesit idealë të kësaj logjike. Nën dirigjimin e pushteteve politike, fuqia dhe efikasiteti i këtyre mediumeve u shndërrua në forcë kontaminuese të ambientit shoqëror, pikërisht se u shfrytëzua pika e dobët e tyre; pamundësia teknike, hapësinore e interferimit dhe kundërshtimit të lirë nga ana e subjektit. Lajmi dhe mesazhet që përçohen përmes mediumeve konvencionale i nënshtrohen një redakture profesionale ekspertësh, ngase synimi primar përveç shitjes si produkte të masave, është arritja e efekteve politike dhe kulturore brenda një komuniteti shoqëror apo edhe më gjerë.

Pjesa e dytë e kësaj trajtese synon të vë në pah rënien e pedagogjisë emancipuese, të uniformitetit mediatik, si dhe shfaqjen e terrenit të lirisë individuale të subjektit komunikues. E tëra ndodh në fillim shekullin njëzetenjë, pikërisht si rezultat i transformimeve të teknologjisë informative në rrafshin e komunikimeve masive.

Në shoqëritë virtuale rëndësia e informimit dhe komunikimit përmes medieve klasike po zhvendoset në platforma sociale ku teknikisht është e mundur menaxhimi i hapësirës dhe privatësisë, si dhe organizimi i tyre sipas vullnetit individual, por jo edhe pacenueshmëria e plotë e subjektit sepse ai është i kontrolluar më shumë se kurrë. Megjithatë ne na intereson liria e tij, në të shprehur, në veprim, në përzgjedhje të informatës si dhe fusha në të cilën e realizon atë.

Mediet konvencionale janë zgjatimi i fundit i frymës emancipuese të diskursit iluminist të modernitetit, dhe vizionit pedagogjik për emancipimin e njeriut. Në epokën e komunikimit digjital - *cyberculture-s*[1], teza e McLuhanit se "Media është mesazhi"[2], po metamorfozohet, dhe tipizohet në kuadrin e nocionit të informatës.

[1] Mckee, David. "Cyberculture". *Encyclopedia Of Postmodernism*. Victor Taylor & Charles Winchiust. 1st ed. London & New York: Routledge, 2001. 75-76. Print.

[2] Mc Luhan, M. (1994).*Understanding Media - The extensions of Man* (p. 9). London: The MIT Press Cambridge, Massachusetts.

Ekziston një dallim fondamental në mes të mesazhit dhe informatës. Përderisa informata mund të përmbajë lajm rreth njëngjarje ditore, aktiviteti sportiv etj, si e tillë mbetet spontane sepse është ngjarje rastësore. Ajo nuk detyron, shtyn, dhe nuk ka synime pedagogjike për emancipim vleror, ideo-estetik apo ushtrim kontrolli social mbi masat dhe individët. Mesazhi është e kundërta, sugjestionon, reprezenton frymën e pushtetit, karakteristikë e shoqërive të kontrollit dhe disiplinimit.

Burimet informimit medial konvencional (Gazeta, radio televizioni) janë reprezentim i skemave pushtetore, gjuhës politike, stratifikimit socio-kulturor, pa dallim ideologjie apo sistemi politik, si të tilla mbesin pjesë e pandashme e pushtetit politik.

Analiza në vijim tenton të nxjerrë në pah dy dallime kruciale të informimit medial konvencional. Siç thekson Giovani Sartori: Mendësia politike totalitare e menaxhimit social të masave në regjimet diktatoriale përçohet përmes mediave, struktura e të cilave është njëngjyrëshe , një qendrore dhe flet me një zë, me atë të regjimit[3]. Kjo është logjika emancipimit, spektrit paradigmatik totalitar e cila përcillet përmes ligjërimeve mediatike, dhe pretencave shkencore. P.sh. për rast analize po e marr periudhën e monizmit nëShqipëri, ku në median e shkruar gjenden titullime të tilla si: "Edukimi ideo-politik, bosht i punës përpërsosjen e mëtejshmetë figurës morale tërinisë."[4]; "Sjellja e kulturuar kërkesë e natyrshme dhe e domosdoshme në jetën e rinisë sonë"[5]; dhe "Si duhet dëgjuar Muzika"[6]. E njëjta logjikë pedagogjike, karakteristikë e sistemeve diktatoriale, haset edhe në shkrimet e gazetës Rilindja në Kosovë, para viteve 1990. P.sh."Luftohen dukuritë negative"[7]. Pra, gjithçka qëështë jashtë spektrit të edukimit ideologjik të sistemit, partisë shihet si e degjeneruar, mbi të fillon të ushtrohet tortura e disiplinimit dhe ndëshkimit. Ndërsa, "ushtrimi i disiplinës nënkupton ekzistencën e një dispoziviteti ku loja e shikimit të ketë forcë detyruese, të një aparati ku teknikat që mundësojnë shikimin të jetë njëkohësisht bartëse efektesh pushteti dhe ku, në kthim, mjetet e trysje t'i bëjnë qartësisht të dukshëm objektet mbi të cilat ushtrohet pushteti."[8]; objektifikimi i këtij procesi në rastin konkret është rinia. Në modelin totalitar mediatik kemi të bëjmë me media që nuk dalin nga kodi i nënshtrimit dhe shërbimit të përhershëm ndaj pushtetit politik dhe jo pushtetit publik.[9] Organizimi totalitar nuk njeh fushën e publikes, aty nuk ka grupe indivishësh që operojnë në bazë të autonomitetit dhe interesave personale, gjithçka është e unifikuar, brenda gjuhës totalizuese të ligjërimeve politike dhe ideologjisë.

[3] Sartori, G. (1998). *Ç'është demokracia* (f. 53). Tiranë: Dituria.
[4] Zëri i rinisë, (19.02.1975), f. 2.
[5] Po aty, (4.01.1975), f. 2.
[6] Zëri i rinisë, (10.01.1970), f. 4.
[7] Rilindja, (19.06.1984), f. 12.
[8] Foucault, M. (2010). *Disiplinë dhe ndëshkim - lindja e burgut* (f. 176). Tiranë: Odeon.
[9] Berisha, I. (2009). *Media-agjensët e komunikimeve* (f. 66). Prishtinë: Universiteti AAB.

Roli i medieve konvencionale në shoqëritë demokratike dallon drastikisht nga ato të sistemeve dhe organizimeve totalitare. Këtu ekziston hapësira e lirë mediatike, ka konkurrencë në tregun mediatik, dhe fushëveprimi për subjektet individuale. Megjithatë nocioni i pedagogjisë publike është prezent edhe në këtë rast. Në analizën e tij 'Mbi televizionin', Pierre Bourdieu vë në pah elemente të stratifikimit socio-kulturor, që përjashtojnë grupe të tëra sociale, dhe për të cilat ekziston mundësia tëmbesin në harresë dhe të margjinalizuara. Ndër tjerash ai thekson: "Këtu do mund të sillja në vëmendje moralizimin e televizionit, anën e tij *telethon,* që do të duhej tëvështrohet brenda kësaj logjike. 'Me ndjenjat e mia mund të prodhojmë vetëm letërsi të keqe' thotë A. Gide, por me ndjenjat dashamirëse 'prodhohet një audimat'. Ka shumë për të reflektuar mbi moralizimin e njerëzve të televizionit: shpesh cinikë ata mbajnë gjallë një konformizëm moral tërësisht perfekt"[10]. Shpesh ata promovojnë: "atë që duhet të mendosh' dhe i quajnë si 'probleme të shoqërisë' agresionet në periferi apo dhunën nëpër shkolla."[11]Sërish synohet disiplinimi, përmirësimi moral i ndërgjegjes individuale,veç në parametra dhe kushte tjera, ndryshe nga ato të shoqërive në sistemet diktatoriale.

Një perspektivë tjetër analitike mbi shoqëritë e informacionit dhe teknologjisë e ofron Jean Baudrillard, në të cilën rolqendrorë në krijimin e artificialiteteve vizuale që sipas Baudrillardit, fshehin të vërtetat reale, kanë edhe mediat. Ai prezanton nocionet *simulacra* dhe *simulation*[12].Sipas Baudrillardit simulacra paraqet sferën e së vërtetës që fshihet nga materialitetet objektive të jashtme të tjetërsuara nga dimensioni tekniko-teknologjik, ndërsa simulacioni është e kundërta, është ajo që fsheh të vërtetën përmes shenjave dhe simboleve. Media në këtë rast luan rol të pazëvendësueshëm në transmetimin e këtyre të vërtetave fiktive deri te publiku.

Në pjesën e fundit të këtij punimi tentohet të elaborohet transformimi i vetëdijes së subjekteve komunikuese nga një stad modernist që tentonte gjetjen e esencave universale përmes pedagogjisë emancipuese, në një stad postmodernist të komunikimeve. Për shumicën e studiuesve dhe teoricienëve tëshkencave sociale, transformimi i madh në këtë drejtim ndodh në vitet 90 të shek. e kaluar. Siç thekson sociologu Zygmunt Buman: Ne banuesit e habitatit postmodern, jetojmë në një territor që nuk pranon koncepcione statike, nuk ofron strategji apo vizione me tendencë korrektuese[13]. Këtu është fillimi i fundit i pedagogjisë së komunikimit masiv, ngase që atëherë bota e informimit është sekularizuar nga tendencat totalizuese, abstraksionet ideore, dhe komunikimet uniforme.

[10] Bourdieu, P. (2015). *Mbi televizionin* (f. 61-62). Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
[11] Po aty, (f. 61-62).
[12] Baudrillard, J. (1995). *Simulacraandsimulation* (p. 3). The body in theory - histori of cultural materialism. University of Michigan Press. 1995. PDF
[13] Bauman, Z. (1992). *Intimations of postmodernity* (p. 185). London & New York: Routledge.

Shekulli i ri solli risinë e jashtëzakonshme tekniko-teknologjike, komunikimet digjitale që revolucionarizuan botën e masmediave dhe informimit. Në intervistën e tij të fundit para disa dekadave duke folur për fundin e filozofisë apo metafizikës, në pyetjen se çka vjen pas filozofisë Heideger jep një përgjigje të shkurtër "kibernetika"[14].

Nga emaili tek platformat sociale të komunikimeve është një kohë mjaft e shkurtër, ndërsa themelimi i kompanisë Facebook në vitin 2004[15], ndryshoi përgjithnjë mënyrën e komunikimit. Më në fund subjektet individuale hynë në interaksion të lirë komunikimi, pa barriera ideologjike, racore, socio-kulturore etj.

U krijua një kulturë e kolektivitetit apo socialitetit,[16] jashtë kornizave ideore disiplinuese që për qëllim kishin emancipimin e njeriut e që transmetoheshin përmes mjeteve të komunikimit masiv.

Sigurisht, duhet theksuar fakti se kontrolli mbi individin, mënyrën se si sillet dhe mendon, nuk ka qenëasnjëherë në këtë shkallë, megjithatë në tregun e lirë të ideve dëshirave dhe preferencave, kompanitë janë të detyruara t'i përshtaten audiencës apo publikut. Ne shohim se si facebooku inkorporon risi të reja çdo gjatë muaj, me tëvetmin qëllim që të shtojë rritjen financiare, gjë që logjika e njëjtë nuk ka funksionuar të stadet e kaluara të teknologjive informuese, sepse ato ishin pjesë e sistemit dhe kontrollit politik. Ndryshe epoka e postmoderne nuk e duron statiken, dinamizmi social dhe risia veçojnë kompleksitetin e marrëdhënieve shoqërore.

Michel Faucault tek libri i tij, *Pushteti dhe dija*prezanton koncepcionin e gjenealogjisësë dijes, si përpjeke e hulumtuese për të dekonstruktuar fatin e të vërtetave të nënshtruara që nuk arritën të dalin në pah dhe u ndrydhen nga ana e pushteteve politike. Janë ato dije azilore, dije naive në rangun e hierarkisë. Ato nuk u komunikuan, u detyruan me heshtje sëbashku me subjektet individuale[17]. Për këtë arsye sot gjendja postmoderne e komunikimeve masive ofron një terren tjetër të lirisë, prandaj edhe flasim për një individualizëm në rritje, dhe në të njëjtën kohë, një masivizim të marrëdhënieve ndërkomunikuese, ku në vend të homogjenitetit mbretëron heterogjeniteti dhe marrëdhënia e lirë komunikuese.

Literatura

Baudrillard, J. (1995). *Simulacraandsimulation* (p.3). The body in theory - histori of culturalmaterialism. University of Michigan Press. 1995. PDF

Bauman, Z. (1992). *Intimations of postmodernity* (p.185). London & NewYork: Routledge.

Berisha, I. (2009). *Media-agjensët e komunikimeve* (f.66). Prishtinë: Universiteti AAB.

[14] Salihu, A. (1997). *Diskursi filozofik i postmodernës* (f. 14). Pejë: Dukagjini.

[15] Mezrich, B. (2011). *Die Gründung von Facebook - The social network* (s.8 7). München: Riva.

[16] Van Dijck, J. (2013). *The cultureofconnectivity - a critical histori of social media* (p. 175). London: Oxford university press.

[17] Foucault, M. (2000). *Pushteti dhe dija - katër sprova* (f. 77). Tiranë: ISP & Dita.

Bourdieu, P. (2015). *Mbi televizionin* (f.61-62). Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
Foucault, M. (2000). *Pushteti dhe dija - katër sprova* (f.77). Tiranë: ISP & Dita.
Foucault, M. (2010). *Disiplinë dhe ndëshkim - lindja e burgut* (f.176). Tiranë: Odeon.
McLuhan, M. (1994). *Understanding Media - The extensionsof Man* (p.9). London: The MIT Press Cambridge, Massachusetts.
Mckee, David. "Cyberculture". *Encyclopedia of Postmodernism*. Victor Taylor & Charles Winchiust. 1st ed. London & New York: Routledge, 2001. 75-76. Print.
Mezrich, B. (2011). *Die Gründung von Facebook - The social network* (s.87). München: Riva.
Rilindja, (19.06.1984), Prishtinë.
Salihu, A. (1997). *Diskursi filozofik i postmodernës* (f.14). Pejë: Dukagjini.
Sartori, G. (1998). *Ç'është demokracia* (f.53). Tiranë: Dituria.
Van Dijck, J. (2013). *The kulture o fconnectivity - a critical histori of social media* (p.175). London: Oxford university press.
Zëri i rinisë, (10.01.1970), Tiranë.
Zëri i rinisë, (19.02.1975), Tiranë.

Albert MECINI

BEYOND PUBLIC PEDAGOGY OF MASS COMMUNICATION

Abstract

Public emancipatory pedagogy, unitary thought and ideological vulnerability of the subject, are some of the main characteristics of the political and social universe of modernity. Conventional media, namely newspapers, radio and later television, are the ideal narrators of this logic. Under the orchestration of politics, the power efficiency of these media became a contaminating force of the social environment, mainly because of their weak points, such as their technicality and lack of space of interference by the subject.

The second part of this paper aims to highlight the decline of emancipatory pedagogy and the emergence of the field of individual freedom of the communicative subject. It all happens at the beginning of the twenty-first century, precisely as a result of technology transformations in the field of mass communication. In virtual societies, the importance of information and communication through the conventional media is shifting to social platforms where it is possible to manage space and privacy as well as organize them according to individual will, however, not to the full vulnerability of the subject. Nevertheless, at this point here we are concerned with the freedom of action, selection of information, and the field in which the subject realizes its freedom.

Mimoza SHQEFNI

ROLI I INTERNETIT DHE I MEDIEVE ELEKTRONIKE NË BARTJEN E FOLKLORIT

Abstrakt

Folklori si trashëgimi popullore që na identifikon si popull, po has në vështirësi në bartjen e tij nga brezi në brez. Kjo po bëhet evidente edhe pse kemi një evolucion të teknologjisë. Teknologjia ofron mundësi pafund për ruajtjen e vlerave kombëtare, vetëm në rastin kur studiuesi i folklorit kërkon dhe insiston të paraqesë origjinalitetin.

Në këtë punim do të përpiqemi të sjellim një vështrim të disa rasteve të evenimenteve folklorike të cilat përfshihen në internet, videoklipe apo në forma të tjera audiovizive dhe që rreken të sjellin elemente tradicionale përkundrejt atyre moderne.

Interneti dhe media si mjete për bartjen e folklorit ofrojnë mundësi të mira. Këto janë evidentuar në transmetimin e një sërë festivalesh folklorike, të cilat shpalosin vlerat tradicionale, por në momentin që ato nuk kontrollohen mund të jenë rrezik për trashëgiminë kulturore dhe me efekte pasvepruese. Pse themi se duhet të kontrollohen? Emigrimi dhe migrimi i popullsisë ka bërë që të kemi shtegtime folklorike. Kjo vlen edhe për pasurimin e folklorit, por në të njejtën kohë shton edhe rrezikun e humbjes së origjinalitetit krahinor, duke u përzier me atë pjesë moderne që nuk mund të jetë më folklor.

Interneti mund të jetë një mjet bartës shumë i vlefshëm, por duhet të dihet kufiri i përdorimit të tij. Në një shoqëri në zhvillim, ku niveli i aftësive personale përthithëse nuk është në lartësinë e duhur, roli i internetit merr ngarkesë të madhe, por paraqet edhe një rrezik përsa i përket karakterit komercial dhe ndikon në ekzistencën edhe të programeve që përbëjnë kërcënim për evidentimin e vlerave autentike folklorike.

Fjalë kyçe: *internet, medie, origjinalitet, traditë, folklor, trashëgimi kulturore*

Hyrje

Folklori si trashëgimi shpirtërore gojore që na identifikon si popull, veçmas gjatë kësaj periudhe, po has vështirësi në bartjen e tij nga brezi në brez, me format dhe shprehësinë unike. Kjo po bëhet evidente edhe pse tanimë kemi në evolucion të

teknologjisë. Teknologjia e shumtë dhe e larmishme, ofron mundësi pafund për ruajtjen e vlerave kombëtare vetëm në rastin kur antropologu (studiuesi i folklorit) këmbëngul që të paraqesë origjinalitetin. Kjo rrethanë ekzistenciale e kujtesës shpirtërore, përmes bartjes dhe ruajtjes së dëshmisë autentike, patjetër ka të bëjë drejtpërdrejt me përgatitjen shkencore të tij, por edhe njohjen e mirë të terreneve ku është aplikuar më tepër teknologjia. Kësisoj, mundësitë e sotme teknike ofrojnë sisteme të reja pune, pamëdyshje shumë më lehtësuese për të ruajtur materialet dhe krijimtaritë folklorike. Që visaret folklorike të jetojnë sa më gjatë, duhet me patjetër të krijohen sa më shumë arkiva folklorikë e po kaq kushte të përshtatshme për ta bartur këtë pasuri në pajisjet teknologjike. Sprovat e kryera për të arkivuar lëndën folklorike, janë bërë që herët, gjithnjë për t'u sistemuar sipas kritereve të caktuara nga IAKSA (Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit) në Shqipëri apo edhe në IAP (Insituti Albanalogjik i Prishtinës). Po ashtu, në këto institucione të rëndësishme gjenden edhe studime folklorike apo monografi, për forma të ndryshme të artit gojor, të cilat sjellin në fokus dhe me një shkëlqim të pazakontë, tradita nga zona të caktuara.

Sa i përket rolit të internetit dhe mjeteve të tjera të medias në bartjen e folklorit, themi se ai mund të jetë një mjet edukues dhe argëtues shumë i zellshëm, sidomos për brezin e ri, që të mund të njohë vlerat kombëtare, këngët, ritet, traditat, të cilat edhe pse sot më tepër nuk aplikohen, nuk mbeten në harresë, por megjithatë duhet ditur edhe kufiri i përdorimit të tij. Jo rrallë, në vitet e kaluara bëhej një punë e mirë në bartjen dhe ruatjen e vlerave folklorike në transmetimin e një sërë festivalesh folklorike (kujtojmë këtu festivalin e Gjirokastrës, që risillte në kujtesë vlerat gjithëkohore dhe gjithëhapësinore të folklorit shqiptar), por sërish nuk mund të quhet e mjaftueshme. Festivali i parë folklorik kombëtar në Gjirokastër, u organizua më 1968 (8-16 tetor), duke u pasuar në çdo pesë vjet, një limit ky i menduar deri më 1988, kur u shkëput për t'u rikthyer më 1995.

Krijimtaria folklorike pasqyron me gjuhën e artit plot vibracion, madhështi dhe saktësi jetën e popullit dhe përpjekjet e tij gjatë shekujve.

Përcjellja e folklorit tek publiku në rrjedhë të kohës

Qëllimi i këtij punimi është vështrimi i rolit të internetit dhe medies në bartjen e folklorit, por e gjykoj të rëndësishme të hedhim një vështrim të shkurtër mbi historinë e bartjes së folklorit në shekuj.

Dimë që tiparet e folklorit janë disa, ndër të cilat është karakteri anonim. Individi, krijon në një mjedis të caktuar, ndërkohë që kolektivi, përzgjedh prej individit krijimet më të veçanta të tij duke ruajtur ato që janë më të bukura por edhe ato që i pëlqejnë më shumë. Kështu individi i parë krijues humbet. Kjo karakteristikë është rrjedhojë e transmetimit brez pas brezi dhe përpunimit sipas shijeve, duke bërë edhe improvizime, tipar tjetër ky i folklorit.

Sa i përket iniciativave për mbledhjen e folklorit kemi parasysh se nga rrethana tashmë të ditura, fatkeqësisht gjuha e shkruar shqipe është dokumentuar shumë vonë, por duke u bazuar në to mund të themi se fillimet e mbledhjes së folklorit i gjejmë që me botimin e fjalorit të Frang Bardhit më 1635, i cili mblodhi disa fjalë të urta shqiptare. Kjo prirje u kanalizua shumë në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare, nga ku u bë i mundur hedhja e vështrimit mbi gurrën popullore të pashterrshme. Në këtë periudhë folklori ishte lënda bazë mbi të cilat rilindasit krijuan kryeveprat e tyre. Por do të jetë fundi i shekullit XIX, pikërisht viti 1878, që do të finalizohet me botimin e materialit burimor folklorik "Bleta shqiptare" të Thimi Mitkos, që do të pasohej vetëm disa vjet më vonë me botimin "Valët e detit" të Spiro Dines.

Në fillimin e shekullit XX, Vinçens Prenushi do të botonte "Kangë popullore gegnishte", ku në parathënien e këtij vëllimi përveç rëndësisë së mbledhjes së materialit folklorik, do të theksonte ndër të tjera se "qëllimi kryesor i këtij botimi asht përparimi dhe qytetnimi i kombit". Sipas tij, ruajtja dhe transmetimi i këtyre vlerave janë "nji flakë prej t'cillës do t'marri drit' e ner komi". (Prenushi, Vinçens: 1999. 23) i cili do të ndiqej nga shumë të tjerë që do të jepnin kontributin e tyre për mbledhjen dhe sistemimin e trashëgimisë kombëtare.

Mbledhja e folklorit shqiptar nuk ka qenë vetëm atribut i shqiptarëve. Për të janë interesuar edhe albanologë të huaj, Majer, Hahni, Petersen etj, të cilët në veprat e tyre, përveçse kanë përfshirë material folklorik, kanë shkruar edhe për rëndësinë e bartjes së folklorit duke e ruajtur si një thesar.

Edhe sot bëhën përpjekje që të ruhen thesaret folklorike në mënyra të ndryshme nga individë të caktuar që përpiqen ta mbajnë gjallë këtë thesar me mundësi të kufizuara. Mund të përmendim këtu artizanët, të cilët mundohen të rikrijojnë veshje apo objekte mbi bazën e origjinaleve. Po kështu edhe vargje folklorike, të cilat këndohen dhe ekzekutohen me muzikë tipike folklorike.

Disa probleme me të cilat po përballet folklori sot në median vizive

Sot është e vërtetë se nëpërmjet internetit dhe rrjeteve të tjera sociale jemi shumë më të informuar se sa në të shkuarën, porse jemi më të varfër në përcjelljen dhe bartjen e vlerave folklorike. Ndoshta këtë informacion që na vjen nga interneti mund ta fajësojmë për trajtimin e përciptë të materialit folklorik, duke mos u preokupuar shumë për ruajtjen e vlerave, sesa për të rritur shikueshmërinë.

Shohim sot një tendencë të këngëtarëve të rinj nëpër videoklipe: përpiqen të sjellin veshje kombëtare, që me kuptimin e plotë të fjalës i kanë vulgarizuar. Nën një jelek me motive popullore shfaqet një dekolte shumë e hapur, apo poshtë një përpareje popullore na del një minifund. Në rastin më të mirë kur është veshur një veshje e plotë, këpucët stonojnë totalisht me veshjen. Nuk kanë asgjë të përbashkët një kostum popullor dhe një palë këpucë me skarpina. Jemi të vetëdijshëm që me

kalimin e kohërave edhe veshjet edhe folklori evoluon, por kjo gjë po e diskriminon totalisht folklorin dhe të gjithë jemi përgjegjës për këtë.

Po kështu ndodh herë pas here edhe me vargjet folklorike. Bie fjala, një rrymë muzikore e quajtur turbofolk, ka në modë miksimin e vargjeve folklorike me vargje të krijuara, që për hir të së vërtetës janë për t'u mëshiruar, pasi përveç rimës nuk i bashkon asgjë tjetër me vargjet folklorike.

Kush e ka fajin për këtë problem? Është e vërtetë se edhe nëpër botë ndodhin fenomene të tilla, por ata kanë rregulluar me kohë arkivat folklorike, kanë krijuar mundësinë e ndërthurjes së saj me muzikën moderne, por pasurinë origjinale e kanë të paprekur.

Folklori është krijuar nga njeriu, krijohet në vazhdimësi dhe krijohet kudo. Studiuesi Alen Dundes thotë: "Midis të tjerëve, edhe ne". (Dundes, Alan: 1980.12). E thënë ndryshe çdo ditë folklori krijohet nga ne në veprime, praktika, vargje etj, që përdoren në përditshmëri. Por a është folklor ky në rastin e këtyre këngëve apo videoklipeve që u përmendën më lart? Edhe pse kjo mund t'i lihet së ardhmes, me lehtësi kuptohet se ato nuk janë jetëgjata, më e shumta mund të jenë hit i një vere. Kësisoj ato nuk plotësojnë asnjë kusht për të qenë folklor. Është e vërtetë se jemi edhe ne krijues të folklorit, por në këtë mënyrë ne jemi edhe shkatërrues të tij. Vetë folklori ka treguar në rrjedhë të shekujve rëndësinë e tij. Ka përjetësuar në këngë ngjarje, histori, individë, të cilët kanë ardhur deri sot, por njëkohësisht ka lënë mënjanë edhe vargje të cilat siç duket nuk kanë pasur të njejtën rëndësi.

Roli i internetit dhe medies për bartjen e folklorit

"Folklori është i pranishëm në shumë forma të komunikimit informal, qoftë ky verbal (i folur dhe i shkruar), zakonor (sjelljet, ritualet) ose material (objektet fizike), për njerëzit dhe për mënyrën sesi ata mësohen, që na ndihmon të njohim veten dhe ta kuptojmë botën që na rrethon." (Sims dhe Stephens: 2005. 32). Ky pohim vjen në kohën e duhur për të qartësuar nivelin dhe format e përfaqësimit të dijes, krijimtarisë gojore të popullit. Folklori shqiptar me të gjithë treguesit e vet, krahas origjinalitetit dhe specifikave të tij, ka komunikuar dendur dhe pa ndërprerje me folklorin e popujve të tjerë, me funksione marrëse e dhënëse, që përkon me tipologjinë e funksionimit të tij.

Sa i përket rolit të internetit dhe të mjeteve të tjera të medies në bartjen e folklorit, themi se ai mund të jetë një mjet edukues dhe argëtues shumë i zellshëm, sidomos për brezin e ri, që të mund të njohë vlerat kombëtare, këngët, ritet, traditat, të cilat edhe pse sot më tepër nuk aplikohen, nuk mbeten në harresë, por megjithatë duhet ditur edhe kufiri i përdorimit të tij. Jo rrallë, në vitet e kaluara bëhej një punë e mirë në bartjen dhe ruatjen e vlerave folklorike në transmetimin e një sërë festivalesh folklorike (kujtojmë këtu festivalin e Gjirokastrës, që risillte në kujtesë vlerat gjithëkohore dhe gjithëhapësinore të folklorit shqiptar), por sërish nuk mund të quhet

e mjaftueshme. Festivali i parë folklorik kombëtar në Gjirokastër, u organizua më 1968 (8-16 tetor), duke u pasuar në çdo pesë vjet, një limit ky i menduar deri më 1988, kur u shkëput për t'u rikthyer më 1995.

Mirëpo, edhe këto lloj nismash, madhore në pamjen e vet, kanë minuset e veta. "*E duam apo s'e duam, materiali folklorik që paraqitet në festivale, ashtu si edhe në televizion, nuk mund të mos fitojë disa elemente spektakolare. Dalja në podium, përdorimi i mikrofonit, ndërhyrja e aparateve të filmimit, masa e publikut pasiv që e sodit spektaklin, etj, janë dukuri të pazakonta për jetën tradicionale të folklorit dhe nuk mund të mos ndikojë mbi zhvillimin e spektaklit folklorik*" (Uçi, Alfred: 1980. 12). Tërheqja e vëmendjes mbi tendencën për të shndërruar edhe folklorin, të gjitha format e tij, është më së e drejtë, sepse kjo rrethanë ndikon për të humbur autenticitetin e shpirtit të popullit. Festivalet folklorike nuk janë gjë tjetër, veçse riprodhim i folklorit, por shpërfaqja e këtyre vlerave me anë të mjeteve të teknikës, ndikon për të patur një transformim të pashmangshëm. Pra në këto raste, më shumë kemi të bëjmë me folklorizëm. Folklori ndryshe nga folklorizmi është më spontan, më burimor dhe mbi të gjitha vjen dhe ekzekutohet natyrshëm, nuk ka nevojë për parapërgatitje, improvizim, kompozim, skenarizim etj.

Pas viteve '90, përgjithësisht pati pak ose aspak nisma serioze nga televizionet për përhapjen e folklorit. Kjo situatë, aspak normale, vazhdon fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite (përjashto ndonjë përpjekje të izoluar televizive). Çfarë mundëson televizioni në të mirë të ruajtes dhe bartjes së folklorit? Falë teknologjisë së fundit ai mund të përhapë gjerësisht dhe në mënyrë shumë komode dhe të transmetojnë çdo lloj folklori, këngë, prozë, traditë, rite, etj, kudo nëpër shqiptarë. Por problem i mprehtë për vlerat shpirtërore në këtë periudhë transformimesh, është se duke u vënë në plan të parë komercializmi, vlera e folklorit kalon në plan të dytë, gjë që është shkatërruese për të. Është vënë re një prirje e disa televizioneve publike apo private, për të bërë emisione të përgjithshme mbi traditën, ruajtjen e folklorit, madje duke i ilustruar ato edhe me realizime skenike (improvizimi i dasmave tradicionale nga zona të ndryshme të Shqipërisë). Për hir të së vërtetës ideja ishte shumë e bukur, përçimi i vlerave folklorike mbarëkombëtare, por ajo që e zbehte kënaqësinë e këtyre vlerave ishte se organizatorët e këtyre emisioneve, duke mos qenë specialistë të fushës, por as njohës të folklorit, vetëm për të rritur shikueshmërinë, u larguan shumë nga evidentimi i vlerave folklorike, duke i dhënë përparësi kuadrit skenik, gjë që kushtëzon në maksimum folklorin, duke iu nënshtruar kështu në një masë të madhe cungimit, modifikimit dhe rrjedhimisht edhe transformimit të tekstit.

Kësisoj që nga veshjet, të cilat për çudi kishin ndërhyrje jashtë tradicionales, tek tekstet e këngëve në të cilat ndërhyhej duke hequr vargje e prandaj muzika largohej nga origjinali, vija melodike e këngës pësonte një transformim të rrokshëm, qoftë nga orkestrimi, qoftë nga veglat muzikore bashkëkohore, pra humbnin shumë nga origjinali. Për shembull një këngë që mund të jetë shoqëruar me dajre, në emisione e gjejmë të shoqëruar me bateri, apo curla tashmë është zëvendësuar me klarinetë, lodra

me bateri etj. Të gjitha këto elementë të ndryshuar vërtet sillnin një spektakël, ku kishte folklorizëm por jo folklor. Pra, është shumë e rëndësishme të bëhet dallimi midis folklorit burimor dhe folklorit të riprodhuar, që më tepër dëshmon folklorizimin, dhe në fakt aty mbizotëronte i dyti.

Emisionet televizive mbi pasurinë folklorike, si dhe mbi prirjet e bartjes së tyre në median vizive, duhet të organizohen në mënyrë të tillë që shikuesi të marrë bashkëndërthurjen e natyrave të ndryshme të përcjelljes së folklorit siç janë veshjet, koha dhe hapësirat e praktikimit të formave të ndryshme të folklorit. Në këtë pikë kërkohet kujdesi dhe vëmendja maksimale e studiuesve të folklorit pasi kemi të bëjmë me krijimtarinë artistike shpirtërore të komuniteteve praktikuese. Folklori duhet të respektohet dhe të përçohet tek brezi i ri, si një lloj i veçantë arti me ligjësitë dhe specifikat e veta, mbi të gjitha pa u përzier në lloje të tjera të arteve. Ai duhet parë dhe përcjellë si një art sinkretik që ka një fillesë krijuese individuale dhe shndërrohet në folklor nëse hyn në qarkullimin folklorik të një bashkësie të caktuar. Por, që të arrihet aty, është e nevojshme respektimi i parimeve krijuese folklorike në përgjithësi. Këtu unë shoh një anë dhe ngjyresë negative të televizionit për bartjen e folklorit.

Në një shoqëri në ndryshim si kjo e jona pas viteve '90, duke marrë përpara për një modernizim të shpejtë, duke kërkuar të shikohet vetëm përpara, fatkeqësisht jo rrallë folklorin e shohin si një prapambetje, me gjasë si një gjurmë e harruar dhe pa vlera. Prandaj, shikuar në përgjithësi, shqiptarët "tashmë të moderuar", folklorin le që nuk e çmojnë dhe as e vlerësojnë, por edhe parapëlqejnë të mos dëgjojnë për të, e konsiderojnë si diçka anakronike, që i lë prapa dhe nuk i lejon të bashkohen me botën moderne. Në një shoqëri si e jona, ku të jemi të sinqertë niveli i aftësive personale përthithëse nuk është në lartësinë e duhur, roli i internetit dhe i mjeteve të tjera të masmedies merr një ngarkesë të madhe. Karakteri komercial i televizioneve shqiptare, aq i rrokshëm në këto kohë, ndikon në ekzistencën e programeve që i përshtaten një kategorie të caktuar shikuesish.

Interneti dhe media si përthithësit më të mëdhenj të vëmendjes së publikut

Interneti ofron hapësira të mjaftueshme në të mirë të bartjes së folklorit, përkundrejt hapësirës televizive, e cila është e kufizuar dhe e strukturuar rreptësisht, çka i kushtëzon tepër edhe hollësirat që janë të nevojshme për folklorin, psh: për ritet e ndryshme. Kështu që edhe kjo në fakt është e kuptueshme, por si mund të procedohet në mënyrë që edhe shikuesi/bartësi të orientohet saktë dhe të marrë qoftë informacionin, qoftë sadisfaksionin në emisionet folklorike. Ndonëse në pamje të parë duket diçka e moderuar, mendoj se fare mirë përçimi i vlerave folklorike mund të shkojë tek shikuesi në formën e serive, pra pjesëve fragmentare. Kjo mund të duket e pakuptimtë, por sot është e qartë për të gjithë ne se serialet, telenovelat, emisionet me pjesë, janë të shumëndjekura dhe të preferuara për shikuesin edhe pse në të vërtetë

nuk kanë asnjë vlerë krahasuar me vlerat e identitetit kombëtar, janë më tepër komerciale sesa edukuese. Megjithatë edhe kjo ka riskun e vet, për faktin se organizatori dhe regjisori duhet të jenë të kujdesshëm që të mos shkaktojnë monotoni, por të mbajnë të përqendruar vëmendjen e shikuesit.

Në të vërtetë televizioni vazhdon të jetë akoma një thithës i vëmendjes së publikut, kështu që po të ishte dëshira dhe vullneti i organizatorëve në televizion për të marrë inciativa të përmasave kombëtare për ruajtjen e thesareve folklorike, atëherë edhe bartja dhe njohja e folklorit do të merrte përmasa të reja në mosha të ndryshme.

Sasia e kohës që njerëzit harxhojnë duke parë televizor është e konsiderueshme. Psh, nëse një njeri do të harxhonte nga koha e tij ditore mesatarisht tre orë përpara televizionit, në moshën 75 vjeçare do të kishte harxhuar nëntë vjet të jetës së tij. Imagjinoni sikur një pjesë e kësaj kohe të shpenzohej për të parë emisione, programe me bazë folklorike, apo duke dëgjuar muzikën folklorike. Përveç njohjes së vlerave, shikimi i këtyre programeve do të shkaktonte relaks dhe emocione pozitive.

Stefano Zecchi në veprën e tij *Njeriu është çka ai sheh*, theksonte se: "*Televizioni dhe në përgjithësi mjetet informatike që propozojnë të mësuarin nëpërmjet pamjeve mund të kenë një efekt shkatërrues mbi shkollën dhe modelin tradicional të mësimdhënies*"(Zecchi, Stefano: 2005. 83). A mund të themi të njejtën gjë edhe për folklorin, i cili mund të bazohet tek pamjet, por edhe duke vënë në veprim shqisa të tjera; të dëgjuarit. Në fakt ekziston një trashëgimi kulturore mbi të cilën bazohet identiteti, vetë ekzistenca jonë, e cila duhet të kultivohet duke bërë përpjekjen maksimale për t'i ruajtur vlerat origjinale dhe shmangien nga asimilimi.

Përfundime

Natyrisht se për folklorin shpeshherë në ditët e sotme aludohet se është një kthim pas, një regres, në kohën kur bota synon majat e shkencës, megjithatë është e nevojshme të pohohet në këtë sistem vlerash dhe antivlerash, se përparimi i një populli shihet nga vlerësimi që ka ai për të kaluarën e tij dhe ruajtjen e vlerave identitare, duke u përpjekur që t'i vendosë ato në panteonin kombëtar, mbi të cilin është krijuar identiteti.

Folklori u ka qëndruar shekujve ndonëse është transmetuar e ruajtur në kujtesën popullore brez pas brezi, kësisoj sot secilit prej nesh i lind detyra që ta vazhdojë këtë traditë.

Duke mësuar folklorin ne mësojmë se si ka ecur dhe është zhvilluar populli si i ka përjetuar fatet e veta historike çfarë ka vlerësuar etj. Ndoshta arsyeja pse interneti dhe media nuk i kushtojnë shumë rëndësi folklorit është se statusi publik i folklorit është pak dyshues për shoqërinë (megjithëse është mendim paragjykues), sepse u duket sikur folklori është diçka e prapambetur dhe që nuk ia vlen të studiohet apo të transmetohet dhe mund të duket si një kulturë tradicionale e dalë mode, si diçka që

duke qenë atdhetare nuk të jep asnjë mundësi ecjeje përpara, për të kapur modernen me shpejtësi rrufe.

Askush nuk ka të drejtën t'u kërkojë televizioneve, qofshin ata publikë ose privatë, që të kenë në përmbajtjen e programacionit të tyre, një numër të caktuar programesh kulturore, por ama si ndjekës dhe si konsumues të këtyre programeve, na lind e drejta që të kërkojmë më shumë kulturë brenda këtyre emisioneve, që edhe kur merren iniciativa të tilla shpesh janë të fryra nga përmbajtja, por shumë larg origjinalitetit folklorik.

Në kohën kur bota mbarë ka marrë përsipër që ta ruajë trashëgiminë kulturore dhe madje shpenzon financa dhe energji për këtë, fatkeqësisht tek ne ndodh ndryshe. Me gjithë dëshirën e mirë të studiuesve të folklorit, ekspeditat në terren sa vijnë e po rrallohen më shumë, që ka si pasojë humbjen përfundimtare të jo pak vlerave të memories shpirtërore të popullit. Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e mungesës së një politike të qartë dhe nxitëse e në rastin më të mirë, kur ka një të tillë, fondet e akorduara janë të pamjaftueshme dhe shpesh herë qesharake. Por problemi në marrëdhënie me visaret gojore të popullit shkon edhe më tej. Folklori si program në arsimin parauniversitar është në minimumin e mundshëm të përfshirjes, në arsimin e lartë publik është reduktuar në një masë shumë të frikshme, ku në shumë syresh është hequr fare psh: (UAMD), është shkrirë në Etnofolklor (UT), për të mos thënë pastaj që në institucionet jopublike as që bëhet fjalë.

Dëgjojmë dhe shikojmë në medie dhe internet (dhe kjo është shumë e rëndësisshme, pasi tregon rolin që ka interneti në bartjen e vlerave folklorike), se këtu apo aty deri në Amerikën e largët, shqiptarët përpiqen të paraqesin folkorin në evenimente të ndryshme që organizohen, në dasmat e tyre, në festa e përvjetore tregohen si njerëz të apasionuar, të cilët e respektojnë dhe e paraqesin folklorin autentik shqiptar. Kjo pra është njëra nga mënyrat për t'i bashkuar njerëzit dhe për të shprehur identitetin e tyre. Mund të themi, madje pa pikën e drojës se ato janë më origjinale sepse shqiptarët atje nuk interesohen shumë për anën skenike, komercializmin apo të tjera, ata kërkojnë të ruajnë vlerat e tyre që të mos asimilohen në një vend ku trysnia e kulturës së huaj është mbytëse. Prof. Dr. Agron Fico, albanolog i njohur, në mes të tjerash, thotë se folklori shqiptar tregon se është shpirti artistik i kombit tonë, ngjizur në rrjedhën e shekujve si pashaporta e tij etnike. Ai karakterizohet nga këto tri veçori: lashtësi, unitet dhe diversitet.

Nga ana tjetër, vijmë në një situatë të bashkekzistencës së folklorit me letërsinë, ku "folkori është mitra e letërsisë" thoshte Propp. Si nevojë jetike, duke e perifrazuar këtë pohim, do të thoja gjithashtu se folklori është mitra e kulturës sonë mbarëkombëtare. Na lind detyra si studiues, si vlerësues të folklorit, si shqiptarë, që të ruajmë sa më shumë të jetë e mundur folklorin, pasi vazhdon të jetë aktiv dhe i gjallë, sidomos në zonat rurale, por jo për shumë kohë nëse vazhdohet me cungimin e tij dhe ky cungim do të vinte nga përzierja e folklorit me folklorizanten (siç do ta emërtonte

prof. dr. Agron Xhagolli), duke nxitur kështu daljen e folklorit nga jeta shqiptare. Ruajtja mund të ravijëzohet në shumë forma, ku më kryesorja është akordimi i fondeve për ekspedita në mbledhjen e materialeve burimore në terren, me vjeljen nga goja e bartësve origjinalë të folklorit. Po kaq vlerë merr edhe bartja e vlerave të folklorit në masmedia, ku media vizive ka peshën dhe ndikimin me të madh. Një hap i hedhur sot pa kujdes mund te jetë me pasoja negative nesër dhe me efekte pasvepruese për kulturën shqiptare.

Bibliografi

Barbier, Frederik. Lavenir Berto, Catherina: *Historia e medias, nga Dideroi tek interneti*. Botim i Institutit shqiptar të medias.

Dundes,Alan: (1980). *Interpreting folklore*. New York.

Dushi, Arbnora: (2011). *Folklori përtej kufijve*. Prishtinë.

Prenushi, Vinçens: (1999). *Kangë popullore gegnishte*. Tiranë.

Sims, C. Martha & Stephens, Martine: (2005). *Living folklore*. Logan, Utah State University Press.

Uçi, Alfred: (1980). *Festivali folklorik kombëtar dhe disa probleme aktuale të shkencave etnologjiko-folkloristike*. në *"Probleme të zhvillimit të folklorit bashkëkohor"* Insituti i Kulturës Popullore, Tiranë.

Xhagolli, Agron: (2007). *Etnologjia, dhe folklori shqiptar*. Vlorë

Zecchi, Stefano: (2005). *Njeriu është çka ai sheh*. Botimet Max, Tiranë.

Mimoza SHQEFNI

THE ROLE OF THE INTERNET AND ELECTRONIC MEDIA IN THE TRANSFER OF FOLKLORE

Abstract

Folklore as a popular heritage that identifies us as a nation is facing difficulties in its transfer from generation to generation. This is becoming evident even though we have a technological evolution. Technology offers endless possibilities for the preservation of national values, only when the folklore scholar wants and insists to submit originality.

In this paper we will try to bring into focus the cases of folklore usages which are included in the media, clips or other forms of audiovisual which attempt to bring modern elements alongside traditional ones.

Television as a tool for transfer of folklore offers good opportunities. These are recorded in the transmission of a series of folk festivals, which disclose traditional values, but at the moment they are not being controlled, they can be a threat to cultural heritage and with prospectively effects.

Why do we say that it should be checked? Emigration and population migration have made pilgrimages of folklore. This is also worth to enrichment of folklore, but at the same time increases the risk of losing the regional authenticity, being mixed with modern pieces that cannot be folklore.

In fact there is a cultural heritage upon which it is based the identity, our own existence, which must be cultivated by making maximum effort to preserve the original values and avoid assimilation.

Television can be a very valuable tool, but we have to know the limits of its use. In a society that is not very developed, in a society where the absorption skill level is not up to the mark, the role of television takes a huge load, but it also presents a risk in terms of commercial character and it affects the existence of programs that pose a threat to identification of folklore authentic values.

Key words: internet, media, originality, tradition, folklore, cultural heritage

Alfred HALILAJ

KUJTESA SOCIALE NË ZONAT PARAURBANE

Fjalët kyçe kujtesë sociale, farefisni dhe zonë paraurbane përbëjnë aparatin konceptual përmes të cilit do të rrekemi të kuptojmë nëse kujtesa sociale e njerëzve që kanë ndryshuar vendbanimin ruhet. Nën këtë linjë do fokusemi në rastin tonë studimor, zonën e Kamzës.

Në këtë rast po bëjmë "Anthropology at home", e cila na jep mundësinë të jemi studiues të shoqërisë ku jetojmë, me risqet që mbart brenda vetes, por edhe me avantazhet e saj. Autori i këtij studimi është edhe vetë subjek i ndryshimeve të tilla. Nga ana tjetër studimi 'everyday life', sic edhe quhet studimi i jetës së përditshme,duke qenë vetë pjesëmarrës në zhvillimin e jetës së përditshme të banorëve, është një ndihmë e jashtëzakonshme për të sjellë realitetin sa afër të vërtetës. Deontologjia shkencore është një kusht i panegociueshëm prej autorit, sepse rreziku i subjektivizmit në analizën shkencore mund të jetë një minus shumë i madh në këtë punë studimore.

Puna do jetë e fokusuar nga metoda e vëzhgimit të drejtpërdrejtë, përmes kontakteve në terren, fotografisë, me intervista dhe anketime te ndryshme.

Lidhjet fisnore, dhe kujtesa sociale janë themeli mbi të cilin ngrihen marrëdhëniet e reja, nën një konjekturë të re, që mbart kompleksitetin më dinamik që mund te kalojnë marrëdhëniet njerëzore. Realiteti i ri ka qenë sfida e vazhdueshme në këto 26 vite liri që Shqiptarët kanë provuar. Gjatë kësaj kohe është dashur të përshtaten, të ndryshojnë, por dhe linja e ruajtjes së kujtesës për vendlindjen, ruajtja e lidhjeve fisnore, ka qenë prezent. Vendosja e banesave në bazë të marrëdhënieve të farefisnisë,shkaqet e së cilës janë më të komplikuara, veprimtaritë kryesore te jetës si dasma, vdekje, lindje etj, rithërrasin këto marrëdhënie prej banorëve.

Pyejtja qëndrore që ngrihet është: A ruhet kujtesa sociale ndër këta banorë, dhe cilat janë mënyrat e shfaqjes së saj?

Ka dy linja teorike që shpjegojnë këtë dinamikë. E para argumenton se kujtesa sociale dhe lidhjet fisnore harrohen, ne funksion të krijimit të një realitetit të ri, dhe përshtatjes me kushtet e reja. Së dyti, argumentohet se kujtesa sociale dhe lidhjet fisnore përvijohen, ndoshta me modifikime te caktuara, por në thelb rëndësia e kujtesës është mjaft e madhe për ruajtjen e identitetit të banorëve.

Teoria e kujtesës sociale i atribuohet sociologut Francez,Maurice Halbwachs (1877-1945). Teza kryesore e tij është se kujtesa nuk është thejsht individuale, por kolektive në sensin që njerëzit individualisht kujtojnë gjëra në bazë të strukturave kulturore. Ai vërejti se në shoqëri njerëzit zakonisht fitojnë kujtimet e tyre. Është gjithashtu *shoqëria*

në të cilën ata rikujtojnë, njohin dhe lokalizojnë kujtimet e tyre. Kujtesa personale e të gjithëve nuk është në të vërtetë private, kujtesa e sejcilit është e formuar nga normat shoqërore.Ndër të tjera ai shprehet se: "*As identiteti individual as ai kolektiv nuk paraqiten si etnitete 'statike', ose si 'gjëra' që mund të analizohen vecmas njëri tjetrit. Ata janë dinamike dhe fluide, vazhdimisht në ndërtim e sipër, sic edhe parashikimet e mia mbi veten marrin si feedback reagimet prej të tjerëve. Kujtesa 'personale' dhe 'kolektive janë vazhdimisht duke u negociuar si 'objekte' dhe 'subjekte' të ndërveprimit shoqëror, dhe të dyja reciprokisht themelojnë 'thelbin social'*" [1].

Roli i kujtesës mbetet themelor pasi pa kujtesën grupet nuk mund të ndajnë veten nga grupet e tjera, familja, miqtë, funksionarët, institucionet, grupet etnike, ose grupe të tjera kolektive, nuk do të dinë nëse duhet apo si të negociohet, të luftojnë ose të bashkëpunojnë me njëri tjetrin. Që nga cështjet më të vogla tek ato më të komplikuarat, ne të gjithë mbështetemi tek kujtesa për tiu dhënë kuptim jetëve tona: për të treguar se kush jemi, cfarë kemi nevojë të bëjmë, si ta bëjmë atë, nga vijmë dhe si të jetojmë më njerëzit e tjerë. Por kujtesa, individuale apo kolektive, ndërtohet dhe rindërtohet nga dialektika midis kujtesës dhe harresës, formohet nga kornizat semantike dhe interpretative dhe i nënshtrohet jehonës së shtrembërimeve. Kompleksitete të tilla e bëjnë kujtesën kaq interesante dhe kaq bindëse[2].

Studiuesi Gjerman Jan Assmann, ka theksuar se kujtesa sociale për një ngjarje vjen, deri atëherë kur nuk ka një të gjallë për ta treguar historinë, ose për të cilën ka dëgjuar prej të tjerëve apo e ka përjetuar vetë atë. Ai bën një përpjekje për të vendosur një urë në kapërcimin e hendekut midis *'kujtesës sociale'* dhe *'kujtesës kulturore'*, duke argumentuar se në këtë fazë kujtesa *'komunikuese'* do ta transformojë veten në kujtesë 'kulturore'.

Rregullat që vijnë prej kujtesës sociale, jo domosdoshmërisht mund të aplikohen ashtu sic do të duhej të ishin sepse kemi të bëjmë me rregulla që transmetohen *'gojë më gojë'*, të pashkruara, të cilat kanë pësuar ndryshime edhe brenda vetes gjatë kohës, por edhe janë përshtatur, negociuar, vijuar prej vetë përdoruesve të tyre. Edhe në rastin tonë është e qartë se ruajtja e kujtesës sociale nuk ka shqetësim kryesor zbatimin e rregullave në vetvete, por ruajtjen e *identitetit* të banorëve që mbetet edhe objektivi parësor. Lejohen plot hapësira likuide të cilat po të analizohen me hollësi janë edhe në kundërshtim me rregullat e tentuara të zbatohen, por me sa duket edhe banorëve i mjafton ky implikim fillestar dhe janë të kënaqur pasi qëllimi është realizuar. Në gjykimin tonë ata janë selektiv, pasi në cështjet e pronësisë dhe trashëgimisë mbeten të lidhur pas rregullave të së shkuarës, por nuk duan që këto rregulla të shtrihen në gjithë veprimtarinë e tyre jetësore.

[1] Halbwachs, Maurice, *The collective memory*, New York, Harper & Row Colophon Books, 1980, p 182.

[2] *Social Memory and History, Anthropological Perspectives,* Edited by Jacob J. Climo and Maria G. Cattell, p 1-2.

Ky lloj ambiguitetit sic duket edhe banorëve iu përkon. Për shembull një prej informatorëve tanë në terren shprehet se: *'Na dum me hy edhe pak në Kanu edhe pak në Sheriat'. Pas kësaj shprehjeje tregon se kur thirrej Hoxha në katun tonë për me nda burrin me gruen, thoshte se na do t'i zbatojmë të dyja.* Por arsyeja ishte se sipas Sheriatit gruas i takonte të merrte shumë pasuri, pothuajse më shumë se gjysmën, dhe banorët nuk mund ta pranonin një ndarje të tillë, kështu që thuhej shprehja *'me hy në Kanu'*. Për tiu përshtatur traditës lokale për këtë cështje. Duket se Kanuni iu hap portën, i fton me hy e me dalë prej situate, dhe me rujtë të paprekur dimensionin patriarkal të jetës.

I pari që ka tërhequr banorët kërkon të luajë rolin e 'babait' dhe ruajtësit në kujtesë, të prejardhjes së përbashkët, dhe me këtë ka realizuar parimin *ius sangiuniss,* për të krijuar përfytyrimin e një babai të përbashkët dhe kjo përkatësi krijon bashkësinë e vëllezërve dhe motrave me lidhje gjaku[3]. Kështu zbatimi i rregullave i lidh ata me të shkuarën dhe automatikisht i pajis me një identitet të caktuar, dhe në kushtet e reja urbane në të cilat ata do të jetojnë, ky identitet merr një valencë të vecantë përballë individualitetit, inpersonalitetit, interesave, jetës qytetase që ky realitet i ri urban ofron. Kujtesa i pajis gjithashtu me përfytyrim të përbashkët ndaj të ardhmes, një guidë me rregulla të përcaktuara për të ndërtuar të ardhmen.

Roli i shtetit pothuaj ka qenë inekzistent në shumë aspekte në zonën e Kamzës, por edhe në zonat e tjera paraurbane të krijuara rishtas. Kjo nuk do të thotë se shteti nuk ka pasur ndikimin e tij në fusha të ndryshme. Për shembull janë realizuar investime publike me paratë e buxhetit të shtetit, edhe pse pa projekte afatgjata, janë ngritur shkolla, kopshte dhe qendra shëndetësore, por, ajo që edhe ne na intereson në cështjen që po trajtojmë, ka të bëjë me faktin se shteti nuk ka ndikuar drejtpërsëdrejti në shuarjen e kujtesës sociale të banorëve apo në krijimin e një kujtese sociale tjetër. Tjetër gjë ka pas ndikim në këtë pikë. Koncepti i *'qytetarit'* si një status që rrafshon kujtesën dhe tenton të krijojë një individ të ri në një habitat social të ri, është ndoshta më ndikuesi.

Dua të shënoj këtu se *'të ardhurit'* nuk vijnë nga e njejta zonë, edhe pse pjesa më e madhe e tyre vijnë nga zonat verilindore dhe veriore të vendit. Ka banorë që vijnë nga Gramshi, Fieri, Korca, Përmeti, Kruja apo dhe nga fshtrat e Tiranës. Vijnë nga fshati por dhe nga qyteti, i përkasin kategorive të ndryshme sociale dhe kanë nivele të ndryshme intelektuale. Arsyeja se pse e bëj këtë saktësim ka të bëjë me idenë e krijuar gabueshëm se kur bëhet fjalë për ruajtjen e raporteve të farefisnisë apo kujtesës sociale, menjëherë bëhet lidhja me zonat e veriut të Shqipërise dhe me ato zona ku mendohet se edhe sot ka ndikim Kanuni i Lekë Dukagjinit, ndërkohë që përjashojnë zonat jugore të vendit. Si rrjedhim dilet shpesh në përfundimin se banorët e ardhur rishtas që ruajnë raportet e farefisnisë i përkasin më shumë zonave verilindore e

[3] Bardhoshi, Nebi, *'Kujtesa sociale në skajet e kufirit politik'*, Shoqata 'Gjon Buzuku', Ulqin 2013, p. 339.

veriore të vendit. Kjo është një e pavërtetë. Mund të diskutohet forca e këtyre raporteve, apo modalitetet e shfaqjes së tyre, por nga faktet në terren është lehtësisht e kuptueshme se këto raporte kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në jetën e banorëve të vendosur këtu, pa dallim prej zonës nga vijnë. Këtë e dëshmojnë, sic kemi argumentuar dhe më herët, formimi i lagjeve me familje prej të njejtit fis, fshat, qytet apo zonë, që reflektohet në emërtimin që banorët vetë bëjnë si: lagja e Gramshalinjve, lagja e Korcarëve, lagja e Kuksianëve, lagja e Tropojanëve, lagja e Dibranëve etj. Kjo nuk do të thotë se kudo vendosja është e tillë por këto janë fakte që dëshmojnë se lidhjet e farefisnisë kanë pasur një peshë të vecantë në procesin e lëvizjes së vendbanimit dhe ndërtimit të një jete të re bazuar mbi një kozmologji të përbashkët.

Në terren kuptohet se jeta e përbashkët themelohet mbi parakushtin e lidhjeve sociale, dhe më thellësisht akoma, lidhjeve të farefisnisë apo lidhjeve të gjakut. Kritikohen jo pak familjet e mëdha patriarkale, fiset që kanë zgjedhur të vijnë së bashku në vendbanimin e ri, apo dhe vendosja sipas lagjeve që përmendëm. Por në fakt këto lëvizje janë realizuar edhe si një reagim ndaj realitetit të ashpër ekonomik, politike dhe social të këtyre viteve. Familja patriarkale ka bashkuar energjitë për të përballuar sfidën ekonomike, dhe vendosja e re në këtë mënyrë, bashkë me njerëzit me lidhje gjaku iu siguron ambjent social ku mund të realizojnë veten dhe mbrojtje nga të tjerët, pasi nuk ishin më në vendin e tyre të origjinës. Banorët shpesh kanë tërhequr njëri tjetrin për ta zgjeruar sa më shumë rrjetin e njerëzve të njohur. Pasi kanë thirrur së pari njerëzit me lidhje gjaku, kanë kaluar në nivelin e fshatit, krahinës, apo zonës që ky rrjet të zgjerohet sa më shumë.

Reflektohet sot në lidhjet që krijohen mes banorëve. Tentohet që martesat të bëhen me cifte që vijnë nga e njejta zonë. Lidhjet më të forta midis komshinjve janë midis familjeve që vijnë nga zona të njejta. Përjashtim bëjnë rastet e fatkeqësive që aktivizojnë pothuaj të gjithë banorët në shenjë solidariteti. Ky zgjerim i lidhjeve ndodh për të pasur raporte sa më të sigurta, për të mos rrezikuar të lidhen me njerëz të zonave të tjera pasi nuk iu njohin traditat, rregullat apo mënyrën e jetesës. Preferojnë të mos kenë të papritura në të ardhmen.

Në zonat paraurbane, pothuaj në të gjitha rastet babai, apo i pari i familjes që ka marrë iniciativën për të lëvizur vendbanimin, ka pasur në përfytyrimin e tij paraprak mënyrën se si do të vendosen djemtë, apo vëllazëria, apo të afërmit, brenda tokës së blerë. Në rastin kur babai ka tre djem, gjithmonë llogaritet mënyra se si do të vendosen brenda asaj prone të blerë dhe gjithnjë llogaritet që ajo do të ndahet në tre pjesë. Ka raste të ndryshme, si psh. kur nuk ka tokë të mjaftueshme atëherë shtëpia do të bëhet tre kate ku sejcili prej djemve do të ketë nga një kat duke përshtatur në shumë raste arkitekturën e shtëpisë me qëllim që hyrjet të jenë sa më të ndara nga njëra tjetra, apo në rastin kur ka tokë sejcili do ketë hapësirën ku do të ndërtojë shtëpinë në të ardhmen. Këtu vjen në kujtesë sistemi i ndarjes së pronës *për vëlla*, sipas të cilit vëllezërit marrin pronë në mënyrë të barabartë, ndërsa motrat dhe bijat e tjera të

familjes nuk kanë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, sidomos për tokën dhe shtëpinë[4]. E njejta logjikë është ndjekur edhe kur dy vëllëzër të ndarë nga njëri tjetri, por që kanë vendosur të vijnë bashkë në vendin e ri të banimit, ndajnë në mënyrë të barabartë parcelën e tokës që kanë blerë, duke respektuar një prej parimeve shumë të rëndësishmë në të drejtën zakonore Shqiptare, por jo vetëm, *parimin e barazisë*.

Një pikë tjetër e rëndësishme është kapërcimi që bëhet në lidhje më ruajtjen e linjës së babait në vendosjen e re të banorëve. Rastet kur vëllai thërret motrën që të shkojnë bashkë drejt Tiranës me familje, për të jetuar së bashku, dëshmojnë për një thyerje të fortë.

As që mund të mendohej që parimi i ekzogamisë të thyhej, dhe dhëndrri ishte patjetër banor jashtë fshatit. Rastet kur dhëndrri mund të shkonte në fshatin e gruas janë pak a shumë të qarta dhe lidhen me një situatë specifike, sic mund të jetë rasti kur familja e gruas nuk ka djalë, por edhe ky rast trajtohet me kujdes sipas negociatave paraprake midis palëve pasi cështjet e trashëgimisë dhe linjës atësore identitare apo cështjet e pronës mbeten themelore. Në rastin tonë nuk kemi të bëjmë as me cështjet e pronësisë dhe as me ndryshimin e identitetit patriarkal të linjës atërore, por kemi të bëjmë me një situatë krejtësisht të re. Një thirrje që ka projeksion jetesën e përbashkët midis tyre, duke vendosur para nesh një situatë që rrallë mund ta gjeje nëpër Shqipëri.

Ka pasur fshatra të cilët praktikonin martesat brenda fshatit(si psh rasti i fshtit Radomirë në zonën e Kalasë së Dodës, në Dibër), por gjithnjë duke repsektuar parimin e lidhjeve të gjakut. Më së shumti në Shqipëri(sidomos në Shqipërinë verilindore, në Kosovë e Rrafshin e Dukagjinit) është ndeshur dukuria e fshatit ekzogam, ku familje me prejardhje të ndryshme fisnore i nënshtroheshin ideologjisë fisnore të gjakut të përbashkët që kishte përfshirë organizimin e fshatit dhe që kishte bërë të mundur kthimin e frshatit në një njësi gati-fisnore, por që edhe në vetëdijen e banorëve ajo nuk ishte e tillë.Banorët silleshin sikur të ishin një fis sa u takon marrëdhënieve fisnore, dhe për vijimin e kësaj lidhjeje sociale luante rol të mbajturit mend[5]. Dukuria e ekzogamisë, në vendet ku ndaloheshin martesat jo vetëm brenda fshatit, por dhe brenda deri në një krahinë, me arsye të lidhjeve fiktive e jot ë vërteta në gjak, pra ngaqë ishin *të një vëllazërie*, ose thjesht si *"vllaznim trojesh"* (afri me vendbanime) lidhej me shkaqe morale, të besimit, por kishte dhe ssnksione juridike mjaft të rënda me dënime të tilla si djegia e shtëpisë e dëbimi nga krahina, apo deri në grimje(pushkatim) të atyre që prishnin rregullat e ekzogamisë. Ky mekanizëm tre funksionësh i dukurive të traditës, juridik, moral dhe religjioz, bënte që këto norma vetëqeverisjeje, të zbatoheshin me forcë e korrektësi, por bëhen dhe shkak të ruheshin këto dukuri arkaike në këto bashkësi fshatare[6].

[4] Po aty, p. 341.

[5] Bardhoshi, Nebi, 'Kujtesa sociale në skajet e kufirit politik', Shoqata 'Gjon Buzuku', Ulqin 2013, p. 342.

[6] Tirta, Mark, 'Etnologjia e Shqiptarëve', GEER, Tiranë, 2003, p. 36-37.

Kjo thyerje për të cilën u shprehëm më lart, është prezent në zonat paraurbane, dhe ka raste konkrete ku tregohet dinamika e raporteve. Për shembull në zonën e Bathores një prej informatorëve tonë shprehet: 'Ma ka sjellë baba në kufi motrën, se po të ishte për mua nuk do ta kisha lejuar kurrë'. Informatori ynë është rreth 35 vjec, i ardhur nga Dibra, por babai tij nuk jeton më, dhe me këtë qëndrim ai shpreh revoltën e tij se pse kunati është komshiu tashmë. Me sa kuptojmë ai nuk ka raporte të mira me të, por nuk shprehet asnjëherë keq për nipërit dhe mbesat e tij. Është një fakt që dëshmon shumë për konstruktin e kujtesës sociale, për të mbajtur nipin afër, pasi dihet që *'daja shtin për nipin'*, por refuzon dhëndrrin që sipas të drejtës kanunore nuk duhet të jetë afër shtëpisë së vjehrrit. Ne mendojmë se kjo,ka të bëjë ndër të tjera, edhe me faktin se një ekspozim i tillë publik shkakton në opinionin përreth në lloj paragjykimi, sepse është jo e moralshme në rregullat e ekzogamisë që dhëndrri të jetojë afër njerëzve të gruas. Arsyet se pse babai i djalit mori vendim të marrë me vete dhe vajzën me dhëndrrin janë nën një kontekst tjetër që lidhet me kushtet e kohës, problemet ekonomike që kishte vazja në familjen e saj, apo dhe tendenca për të qenë bashkë. Ska diskutim që është një fushë e re raportesh para tyre.

Sa mbajnë mend banorët e rinj të zonave paraurbane?

Është një tjetër pyejtje që ngrihet natyshëm për të kuptuar nëse ka një vazhdimësi të raporteve të farefisnisë. Pas anketimeve të realizuara, rezulton se moshat mbi 60 vjec mbajnë mend deri në 10 breza, sigurisht që jo në të gjitha rastet, por ka një tendencë prej tyre të ruajnë dhe afirmojnë origjinën, të ruajnë kultin e gjakut të të parëve. Kujtojmë se ky është brezi që më së shumti ka marrë iniciativën e lëvizjes së vendbanimit dhe ndoshta, ndër të tjera, është edhe arsyeja se pse i kushtojnë më shumë rëndësi mbajtjes mend të pemës familjare, fshatit, qytetit apo zonës nga vijnë. Ata e kanë shqetësim origjinën, për të mos humbur rrënjët e të parëve dhe trashëgiminë. Kriza postmoderne e kujtesës, që studiuesi Pierre Nora e trajton si një ndarje midis vazhdimësisë apo kthimit pas, është prezente edhe tek banorët e zonave paraurbane. Ata janë të shqetësuar sepse të rinjtë *'po harrojnë'* nga vijnë,kush janë, dhe rrjemimisht nuk do të dinë se ku të shkojnë.

Çështjen e harresës, dhe humbjes së të shkuarës, apo shqetësimin e antropologëve se me vdekjen e një plaku vdes një arkivë, e ka trajtuar studiuesi Nebi bardhoshi, në kuadër të debatit më të madh në Antropologji për *krijimin e traditës*,por edhe në kuadër të ridimencionimit të traditës etnografike shqiptare. Edhe shqetësimi i banorëve për shkëputjen ndaj të shkuarës që të rinjtë po bëjnë është i tillë. Mos po ndodh që ata harrojnë dhe nga ana tjetër nuk do të ketë kush t'i mësojë.

Rezultatet e një anketimi të bërë në shkollën "Ibrahim Rugova" në Kamëz, në rreth 120 gjimnazistë të përfshirë në anketim, tregon se të rinjtë e moshës 16-19 vjec nuk mbajnë mend më shumë se tre breza, dhe nuk kanë shumë interes të dinë më tepër për këtë cështje. Arsyet lidhen si me moshën e re në të cilën ata janë, pasi përgjithsisht shqetësimet e tyre lidhen me të ardhmen, por edhe me faktorë tjerë si

kushtet sociale ku jetojnë, pse jo dhe trended e sotme të jetës rinore të fokusuar tek rrjetet sociale, një jetë me kushte shumë herë më të mira etj.

Një mënyrë tjetër e shfaqjes së ruajtjes së kujtesës është e folura në dialekt. Vihet re se nuk është shqetësim ndryshimi i dialektit në drejtim të gjuhës standarte letrare. Në rrugët e Kamzës dëgjon të flitet i gjithë koloriti i dialekteve të gjuhës shqipe. Në shkolla fillore dhe 9-vjecare, gjatë kohës së pushimit kemi vërejtur se fëmijët flasin në dialekt. Në shkollat e mesme disa gjimnazitë me të cilët kemi kontaktuar e shikojnë të folurën në dialekt si një mënyrë për të treguar vendin se nga vjen. Një prej tyre shprehet: 'Unë du me kallzu se jam prej Kuksi, e vetëm qeshtu mirret vesh'. Në ambjente familjare gjithashtu e folura në dialekt është e zakonshme. Ndjehet që dialektet ndikojnë në kujtesën psiko-kulturore të banorëve. Për këtë cështje do të mjaftohemi me dy shënime, për ta lënë të hapur për punime të mëtejshme: *Së pari* është një shenjë e rezistencës që banorët bëjnë për të ruajtur identitetin dhe prejardhjen e zonës nga vijnë, *së dyti* ata ndihen rehat brenda dialektit, duke e përdorur si aparatin shprehës më adekuat për të shprehur gjithcka ata mendojnë, veprojnë, ndjejnë, kujtojnë, planifikojnë etj.

Gjuha është një arenë e rëndësishme për të ballafaquar popujt, grupet, klasat pavarësisht peshës respektive të sejcilit. Ajo është një simbol i rëndësishëm i identiteteve personale dhe politike, dhe një mjet për të përcaktuar ose për të ripërcaktuar identitetin përmes gjuhës së folur. Gjuha ç'kodon kujtimet e jetës së përditshme si dhe është mediumi i zakonshëm për t'i shprehur këto kujtime, ndoshta duke e renditur me ushqimin (Sutton 2001) dhe praktikat trupore (Connerton 1989) si një evokim emocional, personi që është në qendër i jep vend triumfues kujtesës[7].

Një tjetër fakt që dëshmon për ruajtjen e kujtesës sociale është tendenca që kanë banorët e ardhur rishtas në Kamëz për të pasur sasi të mëdha toke. Këtë e gjejmë në terren, por mund të shpjegohet edhe me analizën që studiuesi Olsi Lelaj ka bërë në librin 'Nën shenjën e modernitetit' kur shpjegon proceset proletarizuese që sistemi komunist kishte ndërmarrë. Idea për të pasur një tokë edhe për një ekonomi shtëpiake, mund të shikohet edhe si një reflektim i mungesës së të drjetës për të pasur toke, për një kohë të gjatë nga sistemi komunist, ku proceset ploretarizuese, që në fund të viteve '60 kishin përfshirë edhe kooperativat dhe fshatrat e zonave malore të Shqipërisë, duke bërë që jeta në fshat dhe jeta e fshatarit të jetë në të gjitha aspektet, qoftë edhe në aspektin fizik, nën kontrollin e plotë të shtetit. Këto procese ploretarizuese u përpoqën te zhdukin realitetin dhe konceptin e pronës private në shoqërinë shqiptare, duke përdorur *ligjin* si kategorinë përmes të cilës shoqëria moderne shfaqet, për ta ndryshuar çdo herë statusin e individit me pronën në favor të shtetit, përmes koncepteve dhe proceseve të tilla si: pronësia mbi tokën dhe mjetet e

[7] *Social Memory and History, Anthropological Perspectives,* Edited by Jacob J. Climo and Maria G. Cattell, p. 19.

prodhimit, oborri kooperativist, norma, tufëzimi, brigada etj[8]. Lidhja me tokën është dhe shenja dalluese e banorit rural, që e konsideron atë jo vetëm për ta përdorur thjesht për banim, por edhe në funksion të organizimit të një ekonomie familjare si mbjellja e një kopshti me perime, mundësinë për të mbajtur një kafshë si lopa apo dhia rrace që prodhojnë qumësht, për të mbjellë pemë që prodhojnë si rrush, mollë, pjeshkë dhe hurma si pjesë e traditës së Kamzës etj.

Pa dyshim që kjo mënyrë është fondamentale për transmetimin e mënyrës së jetesës dhe bindjes për këta banorë se kjo është kozmologjia e tyre jetësore, kjo është një pedagogji shumë efikase për ruajtjen e modelit të jetesës. Dhe nga kontaktet në terren rezulton se shumë banorë në Kamëz vazhdojnë akoma të mbajnë këtë model, që nuk është adekuat me modelin rural të jetesës që ata kanë bërë në të shkuarën, por elementët ruhen. Nëse nuk është më lopa apo dhia në shtëpi, kasollja në të cilën ato kanë qëndruar është në skajin e shtëpisë, mbajtja e një kafshe shtëpiake ka zëvendësuar këto të fundit, gjelbërimi i kopshtit dhe mbjellja e pemëve vazhdojnë të ruhen. Duhet të bëjmë shënimin së nuk është e njejta qasje që ndodh përgjithësisht në zonat urbane ku kopshtet jepen me qera dhe janë më shumë oborre publike, por kopshtet e zonave paraurbane për të cilat flasim, janë në funksion vetëm të shtëpive të banimit dhe nuk kanë për qëllim fundor gjelbërimin.

Ushqimi që konsumojnë dhe kuzhina që ata përdorin është gjithashtu pjesë e ruajtjes së kujtesës sociale, ku trupi pranon me kënaqësi ato ushqime që tradita e zonës nga vijnë konsumon. Ndaj dhe kopshti ka të mbjella edhe ato perime, që ata kanë traditë, dhe që toka dhe klima i lejon të rriten, pasi në zonën e Kamzës jo cdo lloj bime mund të zhvillohet normalisht pa spërkatjet me helmet përkatëse. Për shembull në një prej panaireve të ushqimeve tradicionale të organizuar në Kamëz, shpreheshin qartë llojet e ushqimeve dhe zonat nga vinin.

Mund të përmbledhim disa pika:

- Kujtesa sociale iu shërben banorëve të zonave paraurbane për të ruajtur identitetin social.
- Shteti ka luajtur rol minimal në zonat paraurbane, në kuptimin e orientimit apo të vendosjes së banorëve, apo dhe në shuarjen apo krijimin e një kujtese të re sociale.
- Farefisnia dhe lidhjet e gjakut, pavarësisht dinamikave të reja mbi të cilat zhvillohen(për shembull thuerja e raporteve të komshinjve-miq, që vendosen së bashku dhe ndryshojnë një rregull të ekzogamisë), mbeten shumë të rëndësishme për kozmologjinë e jetës së banorëve.

[8] Lelaj, Olsi, 'Nën shenjën e modernitetit', Pika pa Sipërfaqe, 2015, p. 119-122.

- Mbajtja mend e brezave dhe pemës familjare mbetet shqetësim për të vjetrit, por element të tillë si dialekti, lidhja me tokën, ushqimin, dhe mënyra e jetesës, janë faktorë që ndikohen thellë prej kujtesës sociale.

Referencat

- **Libra**

Halbwachs, Maurice, *The collective memory*, New York, Harper & Row Colophon Books, 1980.

Social Memory and History, Anthropological Perspectives, Edited by Jacob J. Climo and Maria G. Cattell.

Tirta, Mark, *'Etnologjia e Shqiptarëve'*, GEER,Tiranë, 2003.

Lelaj, Olsi, *'Nën shenjën e modernitetit'*, Pika pa Sipërfaqe, 2015.

- **Artikuj**

Bardhoshi, Nebi, *'Kujtesa sociale në skajet e kufirit politik'*, Shoqata 'Gjon Buzuku', Ulqin 2013, p. 339.

Alfred HALILAJ

SOCIAL MEMORY IN THE PRE-URBAN AREAS IN ALBANIA

Abstract

This paper explores whether the social memory of people who have changed their residence is preserved. Under this line we will focus on one of the most typical pre-urban areas in Albania, the Kamza area. In this case we are doing "Anthropology at Home", which gives us the opportunity to be researchers of the society we live in.

Tribal ties, and social memory, are the foundation upon which new relationships arise, under a new conjecture that carries the most dynamic complexity that human relationships can cross. The new reality has been a constant challenge in the 26 years of freedom that Albanians have tried. During this time they had to adapt, to change, but the memory retention line for the birthplace, the preservation of tribal ties, was present. Placement of dwellings based on kinship relationships (the causes of which are more complicated), to say that in all major life activities such as weddings, deaths, births, etc. these relationships are reversed.

The central thrust that is raised is: Is the social memory of these inhabitants preserved, and what are the ways of its emergence?

There are two theoretical lines that explain this dynamics. The former argues that social memory and tribal links are forgotten, in function of creating new reality, and adapting to new conditions. Second, it is argued that social memory and tribal connections are outlined, perhaps with certain modifications, but in essence the memory is very important for preserving the identity of the inhabitants.

The work will be focused on the direct observation method, through field contacts, with different interviews and surveys.

Key words: social memory, kinship, the pre-urban area, urban life, tradition, culture.

Arben FETOSHI

KARAKTERISTIKAT E MESAZHIT ZGJEDHOR NË KOSOVË (Zgjedhjet Parlamentare 2014)

1. HYRJE

Ne s'mund të mos komunikojmë. Çdo gjë që bëjmë ose nuk bëjmë është akt komunikimi, pohojnë Watzlavick, Beavin dhe Jackson (1967), ndërsa në këtë kontekst, *Mesazhi* përbën *conditio sine qua non* për komunikimin. Historia është përplot ngjarje që i faturohen komunikimit të dështuar, por dështimi përgjithësisht i referohet përpjekjeve jokompetente dhe indolente.[1]

Tema e punimit "Karakteristikat e Mesazhit Zgjedhor në Kosovë" hulumton përmbajtjen, impaktin, kanalet e transmetimit dhe veçoritë e mesazheve politike në Zgjedhjet Parlamentare 2014. Faktori vendimtar që e bën komunikimin 'politik', nuk është burimi i mesazhit, por përmbajtja dhe qëllimi i tij[2]. Prandaj, duke analizuar përmbajtjen e mesazheve të partive politike, format dhe kanalet e transmetimit, si dhe duke e krahasuar rastin e Kosovës me fushatat zgjedhore në vendet perëndimore, do të mbështesim hipotezën themelore të këtij punimi se *mesazhi zgjedhor në Kosovë, me gjithë tendencën imituese në formë, reflekton mungesë të theksuar të konkurrencës dhe ballafaqimit politik*. A është sfera publike e manipuluar në Kosovë, sa janë të kontrolluara mediet nga politika dhe pse nuk janë ballafaquar asnjëherë në medie liderët kryesor politik, janë pyetjet ndihmëse përmes të cilave arrijmë në disa konkluzione të qëndrueshme sa i përket raportit të politikanëve me votuesit e tyre.

Depërtimi serioz i medieve të reja dhe efektet e komunikimit të mesazheve përmes Facebook, Twitter apo Instagram në raport me ato të medieve masive si televizionet dhe radiot, janë po ashtu çështje të kësaj analize që mundësojnë një shpjegim sa më të saktë të karakteristikave të mesazhit zgjedhor në Kosovë.

[1] Eadie, F. William, *21st Century Communication*, A Reference Handbook, Volume 1 & 2, SAGE Publications, Inc., 2009, f. 241

[2] Denton, R., E.,/Woodward, G., C., *Political Communication in America*, New York, Praeger, 1990, f.11

1.1. Metodologjia

Gjatë realizimit të këtij punimi janë përdorur metoda të alternuara, duke përfshirë Krahasimin dhe Analizën Cilësore e Sasiore të të dhënave. Për pjesën teorike janë shfrytëzuar bibliografi të autorëve të njohur lidhur me Mesazhin dhe Komunikimin Politik, ndërsa për pjesën empirike janë monitoruar llogaritë e politikanëve kryesor në Facebook, janë analizuar të dhënat nga monitorimet e organizatave vendore e ndërkombëtare të fushatës, si dhe janë realizuar enkas për punimin intervista me gazetarë dhe studiues të fushave të ndryshme.

2. MESAZHI – SFONDI TEORIK

Mesazhi është njëri nga elementet e komunikimit që mund të përkufizohet si 'një përmbajtje e caktuar (informatë, deklaratë, etj.) e cila në formë verbale, të shkruar, elektronike apo pamore dërgohet te pranuesi'. Në komunikimin ndërnjerëzor, mesazhi mund të jetë verbal dhe joverbal. Lloji i parë nënkupton shkëmbimin e informacionit duke përdorur fjalët dhe që mund të realizohet në komunikimin ndër-personal, grupor apo publik, kurse lloji i dytë nënkupton komunikimin përmes veprimeve, sjelljeve ose *gjuhës trupore*[3].

Modeli i parë i komunikimit është ai i Shannon dhe Weaver (1949), i dizajnuar për të pasqyruar funksionimin e radios dhe telefonit. Ky model bazohet në pesë elemente të komunikimit: dërguesi (prodhuesi i mesazhit), transmetuesi (kodimi i mesazhit në shenja), kanali (rruga nëpër të cilën transmetohen shenjat), marrësi (dekoduesi i mesazhit nga shenjat) dhe pranuesi (destinacioni ku arrin mesazhi).[4]

Edhe te modelet e tjera si *komunikimi i ndërmjetësuar*, *interaktiv* apo *transaksional*, mesazhi përbën elementin më të rëndësishëm të procesit të komunikimit. Por, derisa modeli transmetues është më i fokusuar te mënyra e transmetimit dhe nëse ka arritur ose jo te pranuesi, modeli ndërveprues është më pak i fokusuar te mesazhi, i cili në rastin tonë është mesazh elektoral.

2.1. Konstruktimi i mesazhit

Konstruktimi i mesazhit është procesi në të cilin individët kompozojnë mesazhe për arritjen e ndërveprimit të tyre. Gjatë komunikimit ndër-personal ky proces mund të zgjasë fare pak, që nënkupton pauzën e bashkëbiseduesve për t'u

[3] Gjuha trupore është trajtë e komunikimit joverbal që nënkupton shprehjen e mendimeve, qëllimeve dhe ndjenjave nëpërmjet mimikës, gjesteve, lëvizjeve të trupit, etj. Fusha studimore që merret me interpretimin e gjuhës trupore quhet **kinezika.**

[4] Davis Foulger, *Models of the communications process*,
http://infocuib.laborales.unam.mx/~mt12s01j/archivos/data/2/40.pdf

përgjigjur në deklaratat e njëri-tjetrit, ndërsa në komunikimin indirekt siç është për shembull një deklaratë politike, konstruktimi i mesazhit mund të marrë më shumë kohë.

Në fillim, studiuesit janë marrë vetëm me katalogimin e llojeve të mesazhit, mirëpo me kalimin e kohës, fokusi i tyre është zhvendosur kryesisht në proceset njohëse dhe konstruktuese të tij. Ndonëse ka shumë teori për këtë çështje dhe secila ka veçoritë e saj, ato ndajnë disa parime të përbashkëta si:

a) *mesazhet* konstruktohen për qëllime **interaktiviteti**;
b) *mesazhet* shpesh dizajnohen për arritjen e qëllimeve **të shumëfishta**;
c) gjatë konstruktimit të *mesazhit* **parashikohen** qëllimet, nevojat dhe reagimet e pranuesit;
d) kur presin kundërshtim, individët i **përshtasin** *mesazhet* për t'i tejkaluar problemet (përshtatja e bisedës me pikëpamjet, qëllimet dhe kërkesat e bashkëbiseduesit);
e) *mesazhet* efikase në arritjen e qëllimeve të interaktivitetit mbahen në mend dhe **përsëriten** (kur mesazhet e tilla përsëriten brenda një komuniteti folësish, ato kthehen në konvencione të të shprehurit).[5]

Konstruktimi i mesazheve politike gjatë një fushate zgjedhore përfshin kandidatë, këshilltarë dhe ekspertë të marrëdhënieve publike. Duke analizuar ndikimin e *imazhit* të kandidatit në formimin e sjelljes gjatë votimit, McNair thotë se të njëjtën rëndësi në këtë aspekt ka edhe *reklama politike* e një partie.[6]

2.2. Përmbajtja e mesazhit

Përmbajtja e mesazhit mund të jetë *verbale* dhe *joverbale*. Lloji i parë nënkupton bisedën, shenjat gjuhësore, tekstin, komunikimin në rrjetet sociale, etj., kurse i dyti sjelljen, lëvizjet trupore, gjestet, shikimin, prekjen, etj. Të dy llojet zakonisht janë në funksion të qëllimit të mesazhit, pasi në të kundërtën komunikimi do të ishte joefektiv. "Në qoftë se përmbajtja joverbale nuk lidhet me mesazhin verbal, atëherë do të shfaqet dykuptimësia dhe do të rritet pasiguria", vlerësojnë Burtis dhe Turman.[7] Politikanët i kushtojnë rëndësi të madhe definimit të mesazheve, sidomos në komunikimin e ndërmjetësuar. Lidhur me këtë, Peter Obstler merr shembull sloganin e Presidentit Regan në fushatën presidenciale të vitit 1980: "A jeni më mirë sot se ç'ishit para katër vjetësh? "Thjeshtësia e këtij mesazhi mundësoi që fushata e Reganit

[5] Eadie, F. William, *21st Century Communication*, f. 101-104
[6] Po aty, f.48
[7] Burtis, O. John &Tuman, D. Paul, *Leadership Communication as Citizenship*. Sage, 2010

të kontrollonte çdo debat zgjedhor, pavarësisht nga natyra ose kompleksiteti i situatës në të cilën ai ishte përdorur", vlerëson Obstler në studimin "Të punuarit me media".[8]

2.3. Kanalet e komunikimit

Kanalet e komunikimit janë *personale* dhe *jopersonale*. Komunikimi verbal dhe joverbal në një tubim elektoral apo në takime të drejtpërdrejta me qytetarë gjatë fushatës realizohet përmes kanaleve personale. Ndërkaq, kanalet jopersonale janë ato që bartin mesazhin pa kontakt të drejtpërdrejtë të dërguesit dhe pranuesit. Mediet janë përfaqësues tipik të këtyre kanaleve, të cilat ndahen në dy kategori të mëdha: mediet **e shkruara** dhe ato **transmetuese**. Mediet kanë rolin kryesor në zbatimin e demokracisë, vlerëson Habermas, duke shtuar se është esenciale që qytetarët të kenë informacion në mënyrë që të mund të bëjnë zgjedhjen e duhur politike. "Pjesëmarrja publike e qytetarëve e krijon **hapësirën publike** e cila funksionon më efektshëm në shoqëritë ku media është e pavarur nga shteti dhe nga forcat ekonomike të shoqërisë. Një shembull i tillë është ai i BBC-së", pohon ai[9].

2.4. Karakteristikat e mesazhit

Format verbale dhe joverbale të komunikimit janë pjesë esenciale e ndërveprimit njerëzor. Ndonëse që të dyja mund të përdoren ndaras, ato zakonisht paraqiten së bashku. Paul Ekman dhe Wallace Friesen janë ndër të parët që kanë ekzaminuar ndërveprimin e kodeve verbale dhe joverbale. Sipas tyre, marrëdhëniet mes komunikimit verbal dhe joverbal janë: përsëritja, zëvendësimi, komplimentimi, kundërthënia dhe theksimi. Por, ku dallojnë komunikimi verbal dhe ai joverbal? Sipas shumicës së studiuesve, dallimi është i thjeshtë: fjalët përbëjnë komunikimin verbal, gjithçka tjetër përveç fjalëve është komunikim joverbal (Burgoon & Saine 1978; Eisenberg & Smith 1971; Knapp 1978; Mehrabian 1972).[10]

Karakteristikë tjetër e mesazhit është *retorika*. Si art i ligjërimit, retorika ka tërhequr vëmendjen e studiuesve që nga antikiteti, ndërsa si disiplinë shkencore është zhvilluar në funksion të nevojave të veçanta, sidomos të politikës. Dramaticiteti, strategjia, argumentimi dhe mbështetja shoqërore janë po ashtu karakteristika, të cilat në komunikimin politik mund të zbërthehen nëpërmjet efekteve dhe suksesit të akterëve politik. Situatat që karakterizohen nga mesazhe me elemente dramatike janë të 'zakonshme' në jetën tonë të përditshme, ndërsa në komunikimin politik ato i

[8] Peter Obstler, "Working With the Media." *Fighting Toxics: A Manual for Protecting Your Family, Community, and Workplace*, ed. by Gary Cohen and John O'Connor. Island Press, 1990
[9] Jurgen Habermas, *The structural transformation of the Public Sphere*, First MIT Press, 1991, f. 236
[10] Eadie, F. William, *21st Century Communication*, f. 241

marrim zakonisht nëpërmjet retorikës së ashpër të një politikani në parlament, diskutimeve në një konferencë, reagimeve qeveritare, etj.

3. ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2014

Pas votimit për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës, Presidentja Jahjaga shpalli zgjedhjet e parakohshme të cilat u mbajtën më 8 qershor 2014. Në garë morën pjesë 30 subjekte politike (koalicione, parti, nisma qytetare dhe një kandidat i pavarur) prej të cilave 9 shqiptare dhe 21 nga komunitetet pakicë.

3.1. Standardi

Zgjedhjet e vitit 2014 janë vlerësuar kryesisht të qeta, të lira dhe demokratike. Shkeljet që kanë konstatuar monitoruesit nuk e kanë dëmtuar *standardin* për zgjedhje të lira e demokratike, ndonëse për përmirësimin e mëtejshëm të tij kërkohet edhe shumë punë.[11]

Demokracia në Veprim (DnV) është rrjeti i organizatave joqeveritare vendore që e ka monitoruar fushatën. Krahas vlerësimit pozitiv për këto zgjedhje, në *Raportin e Vëzhgimit* ajo ka konstatuar shkelje të tilla si votim familjar, përdorim të automjeteve zyrtare për qëllime të fushatës, etj.[12] Me vlerësim pozitiv kanë dalë edhe monitoruesit ndërkombëtar. Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve[13] deklaroi se ato ishin transparente dhe të organizuara mirë. "Në pjesën më të madhe të Kosovës, fushata u zhvillua në atmosferë të qetë, subjektet politike ushtruan lirinë e tubimit e të shprehjes dhe liria e medieve në përgjithësi është respektuar", thuhet në raportin e këtij misioni.[14]

3.2. Pjesëmarrja në votim

Zgjedhjet janë karakterizuar me pjesëmarrje mjaft të ulët të qytetarëve në votim dhe me numër të madh të fletëvotimeve të pavlefshme. Në komentet e para, abstenimi i zgjedhjeve u shpjegua me gjendjen e mjeruar ekonomike e sociale, si dhe me

[11] DnV, *Raport i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2014*, http://www.demokracianeveprim.org/publikime/RVZgjedhjeve2014.pdf

[12] Po aty, f. 13

[13] Misioni i Bashkimit Europian (EUEOM) ka ardhur në Kosovë më 20 maj 2014, kishte gjithsej 96 vëzhgues nga 26 shtete anëtare të BE-së dhe Norvegjia e Zvicra, për të vlerësuar procesin zgjedhor në Kosovë.

[14] EUEOM, *Raporti Përfundimtar - Kosovë 2014*, http://ëëë.eods.eu/library/eu-eom-kosovo-2014-final-report_sq.pdf

korrupsionin që sundon gjithçka në Kosovë", raportonte *Deutsche Wele* në përmbyllje të procesit të votimit.[15]

"Ulja e përqindjes së daljes në votime është më e madhja që nga viti 2007. Në këto zgjedhje dolën rreth 77.474 votues më pak se në zgjedhjet lokale të organizuara vetëm shtatë muaj më herët. Numri i votuesve në këto zgjedhje ishte më i ulët edhe se në zgjedhjet e viti 2010 ku kishte rreth 10 përqind më pak votues me të drejtë vote", thuhet në Raportin e Vëzhgimit të DnV-së.[16]

4. KARAKTERISTIKAT E MESAZHIT ZGJEDHOR

Mesazhet e subjekteve garuese në Zgjedhjet Parlamentare 2014 reflektuan zotime për kurs të ri politik dhe ishin kryesisht me përmbajtje ekonomike. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e cila ishte në pushtet, u paraqit me mesazhin "Misioni i Ri", rivalja e saj kryesore Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) iu drejtua qytetarëve me mesazhin "Vetëm Ne Mundemi", Lëvizja Vetëvendosje (LV) artikuloi thirrjen për votuesit nëpërmjet mesazhit "Tash me Lëvizjen", Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) lansoi mesazhin për "Drejtimin e Ri" të qeverisjes së vendit, Aleanca Kosova e Re (AKR) që ishte partnere e koalicionit qeverisës, iu drejtua votuesve me mesazhin "Na kryjmë Punë", ndërsa subjekti më i ri Nisma për Kosovën, që ishte produkt i përplasjeve në kreun e PDK-së, doli fushatë me dedikimin 'për Kosovën'.

Diskursi politik u kufizua përgjithësisht brenda konceptit që reflektonin këto mesazhe, duke e bërë karakteristikë diskursive *promocionin* si shpalosje vlerash dhe jo *reklamën negative* e cila dominon shpesh në vendet perëndimore.

4.1. Manipulimi

Fushata u karakterizua më tepër nga retorika mbi trashëgiminë sesa ballafaqimi i fakteve lidhur me ofertat politike. Të gjitha subjektet opozitare u bashkuan joformalisht në agjendën kundër PDK-së në pushtet, por nuk arritën ta rrëzonin atë. Dështimin e tyre, nëse i referohemi Habermasit, mund ta shpjegojmë me ndikimin e sferës publike të prodhuar në mënyrë **manipulative**. "Në sferën publike të manipuluar, gjendja me brohoritjet bën që të mbizotërojë *atmosfera e opinionit* në vend të *opinionit publik*. Posaçërisht manipulative janë ofertat e kalkuluara në mënyrë socio-

[15] Deutsche Wele, *Kosovë: Pjesëmarrje e ulët në zgjedhjet parlamentare*, http://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-pjes%C3%ABmarrje-e-ul%C3%ABt-n%C3%AB-zgjedhjet-parlamentare/a-17692601

[16] DnV, *Raport i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2014*, f. 32, http://www.demokracianeveprim.org/publikime/RVZgjedhjeve2014.pdf

psikologjike që u bëjnë thirrje prirjeve të pandërgjegjshme dhe që nuk janë të lidhura me obligimin e përmbajtjes"[17].

Në rastin tonë kjo vërtetohet nga premtimet për vende të reja pune (150 deri në 220 mijë) gjatë mandatit të ardhshëm. Duke argumentuar manipulimin e qytetarëve me premtimet për hapjen e 150 deri në 250 mijë vendeve të reja të punës, profesori i Ekonomisë, Naim Gashi, thotë se me këtë rritje të ulët ekonomike vetëm sa do të shtohet papunësia. "Vetëm për ta frenuar rritjen e papunësisë na nevojitet trefishim i rritjes ekonomike, nga 3 përqind sa është tani në 9 përqind. Nëse ekonomia e Kosovës do të rritej 9 përqind, maksimumi i vendeve të punës për katër vjet do të ishte 80 mijë".[18] Këtë karakteristikë e pohon edhe gazetari Milaim Shefkiu, sipas të cilit, premtimet për vende të reja pune dhe për rritjen e pagave kanë qenë demagogjia më e madhe e këtyre zgjedhjeve. "Kjo u vërtetua vetëm disa muaj më pas kur drejt Evropës Perëndimore ikën më shumë se 120 mijë kosovarë"[19]

4.2. Instrumentalizimi

Fushata 2014 u karakterizua edhe me instrumentalizimin e punonjësve të administratës, arsimit, etj. për qëllime elektorale. "Në Mitrovicë e Gjakovë, janë evidentuar dy raste ku për shkak të fushatës është ndërprerë puna e spitaleve. Në Mitrovicë për shkak të aktiviteteve elektorale të kryetarit të PDK-së, Hashim Thaçi, udhëheqësit e spitalit kanë urdhëruar pezullimin e punës në këtë institucion shëndetësor. Ndërsa në Gjakovë, gjatë vizitës që Thaçi i ka bërë spitalit, është ndërprerë puna e këtij institucioni", evidenton raporti i DnV-së.[20]

Karakterin instrumental të fushatës e vërtetojnë edhe rastet e tentimit për votim të dyfishtë (vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar për 82 raste), ato të keqpërdorimit të fëmijëve në tubime ose për aktivitete elektorale, apo rastet e votimit familjar si dukuri ende prezente në Kosovë.

4.3. Amerikanizimi

Risia e fushatës zgjedhore në Britaninë e Madhe me debatet televizive të liderëve politik që filloi për herë të parë në Zgjedhjet e Përgjithshme 2010, u vlerësua nga media britanike si 'amerikanizim' i fushatës. Tiparet dalluese të 'amerikanizimit' janë: mbështetja e fushatave në sondazhe, mediatizimi i tyre, personalizimi i garës dhe

[17] Jurgen Habermas, vep.cit., f.217

[18] Intervistë e realizuar enkas për punimin me Naim Gashin, profesor i Ekonomisë në ISPE dhe drejtues i OJQ "Kosova in EU".

[19] Intervistë e realizuar enkas për punimin me Milaim Shefkiun, gazetar dhe redaktor i politikës në të përditshmen "Zëri".

[20] DnV, *Raport i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2014*, f 13

marketingu negativ. Ky model me shpejtësi e ka prekur edhe Kosovën, me gjithë asimetrinë e dukshme sa i përket zhvillimit socio-ekonomik dhe nivelit të demokracisë. Sidomos zgjedhjet e fundit (2014) janë karakterizuar me *personalizim* të mesazhit zgjedhor, si pasojë e përdorimit të madh të rrjeteve sociale në komunikimin politik. Liderët e subjekteve garuese kanë postuar (në Facebook apo Tëeeter) çdo ditë, madje edhe nga disa herë në ditë, mesazhe elektorale që vërtetojnë personalizimin e tyre.[21] Mirëpo, debati televiziv si një ndër karakteristikat e modelit amerikan vazhdon të mungojë në Kosovë.

4.4. Mediatizimi

Në zgjedhjet e vitit 2010, roli i medieve ka vazhduar të konsistojë në dominimin e mediave masive, por me një depërtim të rëndësishëm edhe të mediave online, ndërsa në zgjedhjet lokale të vitit 2013 e sidomos në ato parlamentare 2014, ky dominim është zbehur në favor të mediave online. Megjithatë, televizionet kanë vazhduar të kenë rëndësinë më të madhe në kuptim të qëllimeve të kalkuluara elektorale.

Transmetimet e tubimeve dhe fjalimeve të liderëve partiakë në televizion, *Raporti i Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve* i cilëson si element të ri të kësaj fushate, që shpërfaq karakteristikën **personalizuese** të mesazhit zgjedhor. Pjesa më e madhe e kohës së transmetimit me pagesë (kombinim i spoteve reklamuese politike dhe mbulimit të sponzorizuar) në katër kanalet e vëzhguara televizive në gjuhën shqipe është blerë nga PDK (32%), pasuar nga LDK (20%), AAK, Vetëvendosje dhe AKR (13-15% secila) dhe Nisma (6%).[22]

4.4.1. Raportimi favorizues

Duke analizuar rëndësinë e medies për politikën, Francis Balle e cilëson komunikimin si "...veprim mbi rrjedhën e ngjarjeve për të ndikuar në jetën e qytetarëve; dhe përpjekje për ta bindur çdo qytetar me qëllim që të përligjen vendimet e marra dhe të arrihet efikasiteti më i lartë i mundshëm"[23]. Pra, mediet masive janë mekanizmi më efikas i realizimit të komunikimit politik dhe qëllimeve të këtij komunikimi të theksuara nga Balle. "Politikanët dhe partitë, qeveria dhe opozita, komunikojnë çdo ditë me njëra-tjetrën në mënyrë publike; ato i përdorin dhe i

[21] Pohimi mbështetet në faqet personale të Facebook të Hashim Thaçit, Isa Mustafës dhe Ramush Haradinajt, shikuar në gusht 2015

[22] EUEOM, *Raporti Përfundimtar – Kosovë 2014*, f. 18, http://www.eods.eu/library/eu-eom-kosovo-2014-final-report_sq.pdf

[23] Francis Balle: *Mediat dhe Shoqëritë*, Botimi 15, Botimet Papirus, Tiranë, 2011, f. 765

instrumentalizojnë mediet e gazetarët si 'amplifikatorë' dhe 'altoparlantë', për të vënë në zbatim programet e tyre, interesat dhe synimet e tyre pushtetore"[24].

Kjo qasje dhe këto synime vijnë në shprehje veçanërisht gjatë proceseve zgjedhore. Në zgjedhjet 2014, mediet e Kosovës kanë ofruar hapësirë të barabartë për të gjithë garuesit, duke aplikuar *barazi proporcionale*[25], por jo edhe trajtim neutral. Përmbajtjet e gazetave si *Kosova Sot*, kryeredaktorja e së cilës hyri në listën garuese të PDK-së, *Bota Press*, kryeredaktori i së cilës hyri në listën garuese të LDK-së, *Bota Sot* e cila gjithmonë ka anuar në mbështetje të LDK-së, apo *Koha Ditore* e cila është 'pozicionuar' nëpërmjet *marketingut negativ*, vërtetojnë pohimin mbi anshmërinë e tyre politike.[26] "*Koha Ditore* ka shfaqur njëanshmëri kundër PDK-së, ndërsa *Kosova Sot* ishte e njëanshme kundër LDK-së. *Tribuna* i ka dhënë AKR-së pothuajse të njëjtën hapësirë sa të dytës dhe të tretës, PDK-së dhe LDK-së së bashku, duke bërë fushatën e AKR-së shumë të dukshme", thuhet mes tjerash në gjetjet e vëzhguesve të BE-së.[27]

4.4.3. Mesazhi vizual

Marketingu politik për Zgjedhjet 2014 është realizuar në formë të kombinuar të spoteve reklamuese dhe transmetimeve të sponsoruara të tubimeve elektorale. Reklamat për mesazhet zgjedhore të partive ishin joproporcionale në pikëpamje të hapësirës, duke reflektuar fuqinë financiare të tyre.

Nga tipologjia e McNair për reklamën politike, në zgjedhjet e fundit në Kosovë kemi identifikuar reklamën *negative* (spotet kritike që fokusojnë pikat e dobëta të kundërshtarit), reklamën *koncept* (spotet që fokusojnë ofertën programore dhe premtimet), dhe spotet *cinema-verite* (reklamat që i përshkruajnë kandidatët në mjedise informale si në familje, duke bashkëbiseduar me njerëz në rrugë, etj.). Në fakt, reklama *negative* ka qenë më pak e shprehur sepse diskursi 'kundër –PDK' ishte bërë rutinor dhe mesazhet në këtë funksion rezultuan të paefektshme. Nëse i referohemi ideve të McNair, kjo ka ndodhur për dy arsye: e para, sepse 'cilësia e një mesazhi, aftësia dhe sofistikimi i ndërtimit të tij nuk kanë fare vlerë nëse audienca nuk është asimiluese' dhe e dyta, sepse 'efektet e reklamës politike kushtëzohen më fort nga sjelljet politike ekzistuese të audiencës', që do të thotë se përkrahësit e një kandidati do të dëgjojnë

[24] Mohl, Stephan, *Gazetaria,* K&B, Tiranë, 2010, f. 26

[25] EUEOM, *Raporti Përfundimtar – Kosovë 2014*, f. 18, http://www.eods.eu/library/eu-eom-kosovo-2014-final-report_sq.pdf

[26] Disa media si KTV-ja, Koha Ditore, Bota Sot, etj. Kanë raportuar hapur kundër PDK-së. Shih serinë e artikujve të botuar në Koha Ditore gjatë fushatës (Maj 2014) kundër figurave më të rëndësishme të saj, duke iu referuar një raporti të pakonfirmuar zyrtarisht të NATO-s.

[27] EUEOM, *Raporti Përfundimtar – Kosovë 2014*, f. 19, http://www.eods.eu/library/eu-eom-kosovo-2014-final-report_sq.pdf

vetëm atë që duan të dëgjojnë, pa marrë parasysh çka thotë kandidati i tyre i preferuar.[28]







Tipin e reklamës *koncept* e hasim te mesazhet e të gjitha subjekteve garuese. Në raportin "Monitorimi i Mediave - Fushata Zgjedhore 2014" të DnV, pasqyrohen të dhëna të hollësishme për hapësirën e reklamave dhe transmetimeve të sponsoruara të partive politike në televizionet me shtrirje nacionale. Në Televizionin publik (RTK1), koalicioni i udhëhequr nga PDK-ja ka pasur hapësirë dukshëm më të madhe sesa partitë e tjera me 57 përqind, në KTV prin Lëvizja Vetëvendosje me 27 përqind, ndërsa PDK-ja ka vetëm 6 përqind, ndërsa në RTV21 prin Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me 49 përqind [29].

[28] McNair, Brian, *Hyrje në Komunikimin Politik*, f. 44 dhe 48
[29] DnV, *Monitorimi i Mediave – Fushata zgjedhore 2014*, http://www.demokracianeveprim.org/publikime/MM-ALB-2014.pdf

5. PËRFUNDIM

Mesazhi zgjedhor si shprehja më intensive e komunikimit politik në Kosovë reflekton transformimin shoqëror dhe shkallën e zhvillimit të medieve si *instrumente të demokracisë* dhe si *ndërmjetëse* në raportin mes politikës e publikut. Nga analiza e përmbajtjes, formave të paraqitjes dhe mënyrave të transmetimit, në zgjedhjet parlamentare 2014 mesazhi zgjedhor rezulton të ketë qenë i *njëtrajtshëm*, i *personalizuar*, *manipulativ* dhe me tendenca *amerikanizimi* për nga forma dhe kanalet e komunikimit.

Zgjedhjet e fundit janë karakterizuar gjithashtu me *personalizim* të mesazhit zgjedhor që rezulton nga përqendrimi ekskluziv te liderët e partive dhe shfrytëzimi jashtëzakonisht i madh i rrjeteve sociale në komunikimin politik. Duke analizuar dhe krahasuar të dhënat e raporteve zyrtare të organizatave që i kanë monitoruar këto zgjedhje (*Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve* dhe *Demokracia në Veprim*), kemi konkluduar po ashtu se roli i medieve në transmetimin e mesazheve ka qenë më **polarizues** sesa në zgjedhjet e mëparshme dhe kjo vlen sidomos për mediet e shkruara. Derisa hapësira që mediat u kanë dhënë partive është vlerësuar përgjithësisht e barabartë, politika editoriale e tyre ka reflektuar anim partiak. Kjo vërehet edhe në hapësirën reklamuese të partive politike, sidomos në transmetimet e sponsoruara.

Nga tipologjia e reklamës politike, në Zgjedhjet 2014 kemi identifikuar reklamën *negative* (spotet kritike që fokusojnë pikat e dobëta të kundërshtarit), reklamën *koncept* (spotet që fokusojnë ofertën programore) dhe spotet *cinema-verite* (reklamat që i përshkruajnë kandidatët në mjedise informale).

Bibliografia

William F. Eadie, 21st Century Communication, A Reference Handbook, Volume 1 & 2, SAGE Publications, Inc., 2009, f. 241

Jurgen Habermas, *The structural transformation of the Public Sphere*, First MIT Press, Paper back edition, 1991,

R. E. Denton, G. C. Woodward: *Political Communication in America*, New York, Praeger, 1990, f.11

Brian McNair, *Hyrje në Komunikimin Politik*, UET-Press, Tiranë, 2009

Brian McNair: *Journalism and democracy, an evaluation of the political public sphere*, Taylor & Francis e-Library, 2002

Jay G.Blumler, Michael Gurevitch: *The Crisis of Public Communication*, Taylor & Francis e-Library, 2001

Francis Balle: *Mediat dhe Shoqëritë*, Botimi 15, Botimet Papirus, Tiranë, 2011

Stephan Mohl: *Gazetaria,* K&B, Tiranë, 2010

Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve: *Raporti Përfundimtar – Kosovë 2014*,

http://www.eods.eu/library/eu-eom-kosovo-2014-final-report_sq.pdf
Demokracia në Veprim: *Raport i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2014*, f. 32, http://www.demokracianeveprim.org/publikime/RVZgjedhjeve2014.pdf
Demokracia në Veprim: *Monitorimi i Mediave-Fushata Zgjedhore 2014*, http://www.demokracianeveprim.org/al/?subaction=shoëfull&id=1407447219&archive=&start_from=&ucat=1&
KPM: *Raporti i Monitorimit të Shërbyesve Medial Audio-Vizuel Gjatë Fushatës për Zgjedhjet Parlamentare 2014*, http://ëëë.kpm-ks.org/?mod=njoftimet&id=779
KIPRED: *Kosovo Electoral System Review*, http://www.kipred.org/advCms/documents/28022_Kosovo_Electoral_System_Review.pdf
John O. Burtis & Paul D. Turman, *Leadership Communication as Citizenship*. Sage, 2010
Peter Obstler, "Working With the Media." *Fighting Toxics: A Manual for Protecting Your Family, Community, and Workplace*, ed. by Gary Cohen and John O'Connor. Island Press, 1990
Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (2008/03-L-072), www.kuvendikosoves.org
Davis Foulger, *Models of the communications process*, http://infocuib.laborales.unam.mx/~mt12s01j/archivos/data/2/40.pdf

Arben FETOSHI

CHARACTERISTICS OF THE ELECTORAL MESSAGE IN KOSOVO (Parliamentary Elections 2014)

Abstract

The paper "Characteristics of the Electoral Message in Kosovo- Parliamentary Elections 2014" analyzes the content, transmission forms and the effects of political messages in election campaigns, comparing them with the discourse and forms that characterize electoral communication in Europe and the United States. To argue the main hypothesis that "the electoral message in Kosovo, despite tendency of imitation in form, reflects a serious lack of competition and political confrontation", the role of media (mass media and online media) in electoral communication is elaborated.

The methodology used in this research includes analysis and comparison. For the theoretical part of the paper, a bibliography of most well-known authors regarding the message and Political Communication was used, while for the empirical part were used interviews with scholars and journalists as well as reports of organizations that have monitored 2014 Parliamentary Elections.

The Electoral Message as the most intense expression of political communication in Kosovo as well, reflects the social transformation and the degree of media development as an *instrument of democracy* and as a *mediator* in relations between politics and the public. From the analysis of content and broadcasting forms, the electoral message in Kosovo results to be a *uniform*, *personalized*, *manipulative* and with tendency for *Americanization*. The main discursive feature of this message is *promotion* as a disclosure of values and not *negative advertising* which often dominates in Western countries.

Florent RRAHMANI

SHOQËRIA KOSOVARE: INTERNETI, SHUMËSIA DHE CILËSIA E INFORMATËS

Roli jashtëzakonisht i rëndësishëm i komunikimit në ndërtimin e raporteve mes njerëzve e shoqërive është pohuar shumë herë. Siç do të thoshte Mounier, "personi është marrëdhënie; takimi me tjetrin në njëfarë mënyre është përbërës i qenies,"[1] prandaj dhe i tërë komunikimi shndërrohet në qendër të *universit personal*, si një lloj "*uni i lëvizshëm* që plazmohet dhe përcaktohet në marrëdhënie me tjetrin"[2].

Por, komunikimi me tjetrin/të tjerët, sikur edhe mënyrat e komunikimit, kanë evoluar në vazhdimësi. Ky evoluim i marrëdhënies me tjetrin sot ka marrë tjetër kuptim, si në formë edhe në përmbajtje, nga rrafshi intra deri te ai inter-personal duke i shtuar individit një *rol të ri*. E tërë kjo ka ndodhur falë zhvillimeve teknike-teknologjike. Megjithatë, përtej këtij roli, është shtrembëruar vetë qëllimi i individit, në rend të parë në raport me vetveten, me botën dhe me zhvillimet rreth saj.

Këtë të kuptuar ndryshe, të vetë individit dhe të shoqërisë, e solli interneti, si një *botë e re* mendimi, gjykimi e veprimi, ku vetëm përmes një klikimi mund të gjesh gjithë atë që kërkon, kudo qoftë. "Interneti krijoi botën aq të theksuar dhe të njohur, me emrin, provokues, *virtuale* – botë përtej reales, konkretes, të mundshmes"[3] e cila sot po paraqet sfida të mëdha.

Pavarësisht se sa mund të interpretohet si një kërcënim dhe devijim i një kulture sociale e publicistike, fakti se mund të publikohet nga kushdo, flet më së miri për një liri 'të tepruar' të manipulimit me hapësirën e shprehjes, proces i cili mund ta cënojë privatësinë individuale. Madje është thënë se "interneti po zbulon privatësinë e elitave, po njëherësh edhe të fshehtat e njerëzve të zakonshëm"[4] sado që, paradoksalisht, ai "është mjeti më i fuqishëm që posedojmë për ruajtjen e lirisë së shprehjes dhe të drejtave të njeriut, (siç) kishte thënë VivienReding, Komisionar për Shoqëri Informative dhe media i Komisionit Evropian në qershor 2005"[5].

Nëse interneti ia del të nxjerrë lehtë në shesh privatësi, kjo dëshmon se vetë njeriu u kontribuon anomalive të tilla, përmes informatës së tepërt/të panevojshme

[1] Mounier, Emanuel (2000) *Personalizmi*, Tiranë: Dita, f.13
[2] Mounier, Emanuel (2000) *Personalizmi*, Tiranë: Dita, f.13
[3] Berisha, Ibrahim, (2014) Mediakultura, PEN/AAB, Prishtinë, f. 31
[4] Po aty, f. 37
[5] Po aty, f. 37

apo përmes keqinformimit. Individi po përballet me një rol krejtësisht të ri në shoqëri. Ndryshimet teknologjike po shihen edhe si një *e keqe e domosdoshme*, apo siç e quan Shumpeter "shkatërrim krijues"[6], duke i dhënë kështu një rol të ri individit si dhe duke e fuqizuar në anën tjetër ndikimin teknologjik. Ky rol, për aq sa ka krijuar mundësi, hapësirë, liri gjykimi, mendimi e shprehjeje, po aq ka robëruar jetën e tij. Me apo pa vetëdije, mishërimi i individit me mediat elektronike u bë në vazhdën e interesimeve për zhvillimet përtej lagjes, qytetit, kryeqytetit, përtej shtetit e deri tek vendet dhe kulturat e ndryshme. Pa dyshim, ky *rol i ri*, kapërceu pasojat individuale, i preku edhe ato shoqërore, sepse, fundja, "pasojat vetjake e sociale të çdo mediumi, pra çdo zgjatimi të qenies sonë, janë rrjedhojë e raporteve të reja që sjell në jetën tonë çdo zgjatim i vetvetes, apo çdo teknologji e re"[7].

Pra, vetë zhvillimi teknik-teknologjik, pa i menduar efektet anësore, bëri që të nxiten ndërhyrje përtej kufijve të individuales, duke e shndërruar privaten në publike dhe duke u bërë kështu një kërcënim serioz për individin, shoqërinë, kulturën dhe të ardhmen. Në këtë kontekst, Joseph Dominick e sheh internetin si një shkaktar të një sërë problemesh[8] në rrafshin e privatësisë, ndërsa Andrew Keen thotë se "interneti është media e re, e cila, luan rol në shkatërrimin e kulturës *së mirëfilltë*"[9], pavarësisht që të gjithë pajtohen për të mirat që interneti ka sjellë në njërën anë.

I ndodhur përballë mediokritetit teknologjik dhe realitetit të ndryshueshëm e të papërballueshëm jo vetëm në rrafshin kulturor e mediatik, por edhe në atë filozofik e politik, Umberto Eco, përshkruan shumë mirë përballjen me epokën teknologjike dhe internetin, kur thotë: "mediat sociale u kanë dhënë të drejtën e fjalës budallenjve"[10]. Sot, aq sa ka informata, ka edhe dezinformata, sa ka liri dhe hapësirë të shprehjes intelektuali, akademiku, profesori, po të njëjtën e ka edhe një analfabet.

Zhvillimet teknologjike pa dyshim se kanë kontribuuar shumë në pasurimin e shoqërive të ndryshme me informacione të shumta, porse aq sa kanë kërcënuar perspektivën dhe jetën e tyre sa u përket standardeve dhe kulturës ekzistuese të publikimeve. E ndodhur në një interkomunikim të vazhdueshëm me kulturat dhe vendet evropiane, shoqëria kosovare është prekur gjithashtu nga efekti i internetit dhe zhvillimit të hovshëm teknik-teknologjik. Ky zhvillim ka lehtësuar tej mase jetën e njerëzve dhe ka thyer mite por kufijtë ndërmjet shoqërive janë zhytur në pakuptimësinë e kuptimësisë së dikurshme, pa asnjë rol në rrafshin e bashkëpunimit teknologjik, kulturor, e posaçërisht në atë medial. Tashmë "konvergjenca dhe zhvillimi

[6] Doyle, Gillian, (2015) "Ekonomia e medias",Papirus, Tiranë f. 39

[7] Mcluhan, Marshall "Instrumentat e komunikimit - Media sinjëzgjatim i njeriut", IDK, Tiranë f. 12

[8] Dominick, Joseph R (2010) "Dinamika e komunikimit masiv – Media në periudhën digjitale",UET/Press, Tiranë f. 445

[9] Berisha, Ibrahim, (2014) Mediakultura, PEN/AAB, Prishtinë, f. 13

[10] http://www.lapsi.al/stil/2016/01/03/umberto-eco-interneti-u-ka-dh%C3%ABn%C3%AB-t%C3%AB-drejt%C3%ABn-e-fjal%C3%ABs-budallenjve#.V1f8n_l96Uk

i internetit kanë rrëzuar kufijtë e vjetër dhe kanë ridimensionuar tregjet mediatike dhe mënyrat e konsumit"[11] edhe në Kosovë.

Gjithë ky zhvillim ka krijuar pikëtakime mendimesh, gjykimesh e veprimesh të shoqërive e kulturave të ndryshme, duke bërë të panjohurën të njohur dhe duke i shndërruar të njohurat në dije globale, për konsum të përgjithshëm. Por, përveç përparësive, kjo ka edhe mangësitë e veta. Shoqëria e cila është në tranzicion teknologjik, është edhe në tranzicion socio-politik.

Zhvillimi i hovshëm teknologjik i kësaj shoqërie me epokën e internetit si një nga shfaqjet e fundit, përveç që ka lehtësuar jashtëzakonisht jetën, ka ndikuar edhe negativisht, duke shkaktuar huti, paqartësi e pasiguri në aspektin teknologjik, ekonomik, politik, kulturor, sociologjik e psikologjik. Interneti ka mundësuar praninë e mediave dhe shtrirjen e ndikimit të saj kudo, si në vendet urbane ashtu edhe në ato rurale, duke u bërë burimi themelor i informacionit. Për më tepër, pothuaj gjithë mediat e tjera, si gazetat, portalet por edhe televizionet, shfrytëzojnë internetin si rrjet komunikimi. Vetë gazetaria konsiderohet si një hartografi në vete për shoqëritë, ajo shtrembërohet me apo edhe pa dashje dhe "krijon një hartë falë së cilës qytetarët mund të lundrojnë në shoqëri"[12]. Duke fituar një rol kaq të rëndësishëm për të gjitha zhvillimet në kuadër të shoqërisë, gazetaria ka fuqinë e një pushteti të padiskutueshëm. Prandaj, shumë fenomene kulturore kanë mbetur nën hijen e zhvillimit të mediave në internet, si një nga agjensët kryesore në fushën e informimit.

Shtrirja e ndikimit të internetit duket se tashmë është e pashmangshme. Secila sferë e jetës është e prekur nga efekti i internetit. Në një mënyrë ai ka thyer mitin e ndasive në klasa, mosha, gjini apo përkatësi fetare. I mirë apo i keq, me ndikim pozitiv por edhe negativ, të gjithë pa dallim, të pasur e të varfër, profesorë dhe nxënës, bujq dhe intelektualë, kanë qasje dhe janë të ndikuar nga ai tashmë. Efektet e tij pozitive, por edhe negative në masë të madhe duket se janë shtrirë tek mediat elektronike, por me theks të veçantë tek ato të shkruara, për faktin se mediat të cilat nuk arrijnë t'u përshtaten këtyre ndryshimeve teknologjike apo që fillojnë të përshtaten me një ritëm të ngadaltë, eliminohen nga tregu. Nga ana tjetër, "paguesit e përditshëm të informacionit në 'letër' pësojnë sulmin e faqeve në internet, të siteve të informacionit falas dhe të blogjeve"[13]. Për më tepër, në rastin e Kosovës kemi pasur media të cilat janë detyruar që të mbyllin gazetat në formën e shtypur dhe të dalin në treg konform kërkesave momentale, si gazetat *Express* e *Infopress*.

Sot, pothuajse të gjitha gazetat ditore në Kosovë, kanë edhe portalet e tyre elektronike, përmes të cilave përçojnë lajmin deri tek lexuesi i tyre. Hapja e portaleve nganjëherë lidhet me mbylljen gazetës së shtypur "më tepër si rezultat i përparimeve

[11] Doyle, Gillian, (2015) "Ekonomia e medias", Papirus, Tiranë, f 30
[12] Kovach Bill, Rosenstiel Tom, (2009), "Elementet e gazetarisë", ISHM, Tiranë, f 238
[13] Maigret, Eric, (2010)"Sociologjia e komunikimit dhe e mediave", Papirus, Tiranë *f. 314*

teknologjike dhe i modeleve të ndryshme të konsumit dhe publicitetit"[14]. E tëra kjo ndodh edhe si rrjedhojë e një konkurrence të pakompromis që zhvillohet në botën e medias, në garën e përçimit të lajmit *i pari*.

Siç thoshte Bourdieu, "bota e gazetarëve është një botë e përçarë ku ka konflikte, konkurrencë, armiqësi"[15], dhe kjo vërehet sot qartë në luftën për sasinë dhe shpejtësinë e përçimit të informacionit, për çka interneti ka një ndikim të veçantë, si për marrjen ashtu edhe për dhënien e informatës. Se efekti i internetit ka prekur në masë të madhe dhe tashmë të pashmangshme mediat në shoqërinë kosovare, e pranojnë edhe vetë njerëzit e mediave të cilët çdo ditë janë në përballje me internetin, shumësinë dhe mosbesueshmërinë e informacioneve. Lidhur me këtë temë, kam anketuar njerëz të medieve në Kosovë të cilët kanë opinione të ndryshme.

A.B., redaktore në RTV 21, pohon se interneti "padyshim që ka pasur ndikim shumë pozitiv sepse është lehtësuar tej mase qasja në informacione". Ndërsa L. Sh., korrespodent për "Zërin e Amerikës" nga Kosova, saktëson: "Në punën time si gazetar, interneti ka ndikuar në dy çështje. Ka rritur shpejtësinë e marrjes së informacionit duke shtuar kujdesin ndaj burimeve ndërkaq, sa i përket anës teknike të realizimit dhe dërgimit të materialit, ka lehtësuar shumë punën."

Por, interneti nuk ka ndikuar më pak te televizionet; ndikimi i tij është shtrirë sidomos tek portalet e lajmeve. "Meqë jemi portal, atëherë puna jonë është e pamundur të funksionojë pa internet. Në kohën që po flasim, interneti është mjeti më adekuat për plasimin e informacionit të lexuesi, por jo vetëm kaq, sepse interneti është bërë pjesë e pandashme edhe e të bërit biznes, promovimit të të drejtave të njeriut, mirëqenies sociale etj", thotë B. B, kryeredaktor në portalin e lajmeve Indeksonline.

Por efekti i internetit tek mediat është i dyanshëm, për faktin se ka krijuar hapësirë jashtëzakonisht të madhe të shprehjes, duke krijuar hapësirë të tepruar për kategori të caktuara, që kanë për qëllim keqpërdorimin e mundësisë dhe lirisë së shprehjes. Kundërefektet e tilla vërehen bukur qartë në shoqërinë e Kosovës, e cila e ndodhur përballë një tranzicioni të stërzgjatur shoqëror dhe jo thjesht vetëm medial e kulturor, ndodhet përballë një shumësie të informacioneve dhe një cilësie të dyshimtë të tyre.

"Sot në të gjitha portalet i shihni informacionet e njëjta, shumica prej tyre lirisht mund të thuhet se janë të paverifikuara. Nuk ka kreativitet për të ripërpunuar një informacion i cili "vidhet" nga një portal tjetër ku fare nuk citohet burimi dhe rrjedhimisht askush nuk mban përgjegjësi publike e për atë juridik as që flitet. Interneti po e stimulon sensacionin më shumë se sa informacionin", pohon A. B, nga RTV 21. Se një gjendje e tillë tashmë është bërë rutinë në shoqërinë kosovare, e pranon edhe kryeredaktorja e gazetës "Zëri", A. Xh.: "Fatkeqësisht po bëhet normalitet plasimi i

[14] Patterson, 2007; Slattery, 2009

[15] Bourdieu, Pierre, (2015), "Mbi televizionin", Tiranë, f 28

informacioneve të shpejta të paverifikuara dhe në të njëjtën kohë prej shumë burime jokredibile. Nëse ndalemi vetëm tek portalet, lehtësirat për të pasur një të tillë, të pambikëqyrura, dhe të pandëshkuara për shpifjet që bëjnë, kanë krijuar ambient të favorshëm të të bërit biznes." Nga ana tjetër, një dukuri e tillë, tashmë e pashmangshme, arsyetohet në emër të asaj që konkurrenca po krijon terren të tillë të plasimit të shumë informacioneve, të shpejta dhe të paverifikueshme, që çojnë në uljen e besueshmërisë në atë që i ofrohet publikut. Edhe vetë konkurrenca se kush po e publikon lajmin i pari, sipas L. SH., "ka ndikuar në uljen e besueshmërinë".

Në gjithë këtë shumësi informatash, në gjithë këtë pavërtetësi në emër të shumësisë dhe shpejtësisë, sot roli i gazetarit është ndryshe nga ai që ishte dikur; gazetari kryen më tepër se një funksion, ai shkruan lajmin, bën fotografi nga vendi i ngjarjes dhe raporton edhe përmes videos, në mënyrë që të luhet një rol i ri jo vetëm i zhvillimit të medias, por edhe në rrafshin ekonomik të saj. Në gjithë këtë ndryshim jo vetëm teknologjik, por të vetë rolit të individit në shoqëri, sot vërehet qartë se raportimi i lajmeve në epokën digjitale ka sjellë ndryshime të rëndësishme siç janë "rritja e numrit të burimeve të reja, blogjet, gazetaria e qytetarëve, lajmet hiperlokale, gazetari i shumanshëm dhe mjetet e raportimit të lajmeve,"[16] etj. Në ndërkohë, teknika dhe instrumentet kanë marrë kuptim në vend të parimeve të dikurshme gazetareske, kur nuk ka qenë e lehtë të krijosh një lajm me mungesë burimesh themelore, apo me të pavërteta. Gjithçka lidhet me fuqinë e shpejtësisë dhe aspak mbi parimin e verifikueshmërisë. Mbi këtë bazë, merr kuptim jo vërtetësia, jo cilësia, jo parimet themelore të gazetarisë, por teknika dhe teknologjia që mundësojnë shpejtësinë e përçimit të lajmit. Pra, përderisa vetë korrektësia dhe ekuilibrimi i informatës marrin një kuptim të ri "në vend të parimeve fisnike, në realitet janë teknika e instrumentet që shërbejnë si udhërrëfyes për gazetarët në redaksi dhe për verifikimin e shkrimeve të tyre."[17]

Në këtë rrugëtim ndodhet edhe shoqëria kosovare, lajmi i shpejtë dhe i paverifikueshëm tashmë ka filluar të pranohet si i zakonshëm, madje si diçka tepër normal, fundja si një luftë e shpejtësisë dhe jo luftë argumentesh. Prandaj, edhe pse përballë kësaj shumësie informacionesh, si për zhvillimet brenda ashtu edhe për ato jashtë vendit, shoqëria kosovare çdo ditë e më tepër po përballet me një lloj informacioni që duhet të merret gjithnjë me rezervë. Sot, në Kosovë secili individ luan rolin e gazetarit. Prandaj, në gjithë këtë shumësi zërash, edhe vetë gazetaria është futur në tunelin e një propagande të qëllimshme përballë lexuesit, që nganjëherë dëshiron të zhbëjë fuqinë e argumenteve, me tendencën e vetme për të krijuar opinionin e caktuar. Gazetari B. K, në një intervistë për "Zërin e Amerikës", duke folur për shumësinë e informacioneve, pohon se është e rëndësishme të dallohen informatat e verifikuara dhe ato që qëllimisht mund të jenë me gabime, apo edhe me pretendime të caktuara.

[16] Dominick, Joseph R (2010) "Dinamika e komunikimit masiv – Media në periudhën digjitale", UET/Press, Tiranë, f. 454

[17] Kovach Bill, Rosenstiel Tom, (2009),"Elementët e gazetarisë", ISHM, Tiranë, f 109

"Nëse ka 500 zëra të ndryshëm që të tregojnë se çfarë po ndodh, në këta zëra do të ketë korporata që flasin për qëllime fitimi, zëra politikë që bëjnë propagandë, do të ketë mashtrues por do të ketë edhe disa burime të pakta që ofrojnë informacione të verifikuara. Gjëja e rëndësishme tani është që në këtë mori informacionesh të dimë të dallojmë ato që janë të verifikuara,"[18] thotë ai.

Të ndodhura përballë këtij mediokriteti mediatik e kulturor, përballë atyre që përhapin dhe propagandojnë informata të paverifikuara si dhe përballë shumësisë së informatës, roli që sot duhet ta kenë gazetat dhe mediat në përgjithësi është dukshëm më i madh për shkak të besueshmërisë që duhet të krijojnë në raport me lexuesin apo shikuesin e vet. Mediat si TV, Radio e gazetat, dikur kishin për synim që të mbanin sa më të informuar opinionin për zhvillimet e ndryshme, meqë ato ishin burimet e vetme të informatës ndërkaq sot është me rëndësi që të informohet drejt nga mediat, ngase publiku është tepër i informuar dhe shpeshherë i informuar keq. U. Eco thoshte se roli i gazetave është shumë më i rëndësishëm ngase "duhet të filtrojë me ekipe specialistësh informacionet që vijnë nga interneti sepse askush nga ne nuk është i aftë të kuptojë sot nëse një informacion është i besueshëm apo jo"[19].

Sot, opinioni është i informuar, madje tejet i mbiinformuar dhe i dezinformuar. Në këtë rast, roli i gazetarëve dhe mediave është vetëm të verifikojë informacionin dhe t'i sjellë atij atë që është e vërtetë. B. K. pohon se në këtë shumësi informatash, roli i gazetarëve është t'ua sqarojnë njerëzve cila është e vërteta, cili është mashtrimi, propaganda apo fantazia. "Me teknologjitë e reja, kemi mijëra linja komunikimi tek të cilat ka qasje çdo njeri, mjafton të ketë një kompjuter. Sot, në këtë sasi gjigante informacioni, njerëzve u duhet të kërkojnë për të gjetur se cilat gjëra janë të verifikuara, cilat janë mashtrime, cilat janë propagandë e cilat fantazi"[20]. Pra, vërehet qartë se sot nuk atakohemi nga mungesa e informacioneve sa nga shumësia e informacioneve dhe nga mungesa e cilësisë së tyre sepse "besueshmëria e përgjigjeve që vijnë nga një grup lajmesh është e diskutueshme"[21]. Për më tepër, "në thelb, rregulli i verifikimit është ai që dallon gazetarinë nga zbavitja, nga propaganda, nga fiksioni apo nga arti"[22] dhe kjo duhet sendërtuar në parim të etikës së informimit edhe në Kosovë.

Konkurrenca ndërmjet mediave, ka shtyrë ato drejt një politike redaktoriale të publikimit të shpejtë dhe të verifikimit sipërfaqësor apo në disa raste edhe të mosverifikimit, duke shkaktuar shpeshherë huti, paqartësi dhe një lloj pasigurie

[18] http://www.zeriamerikes.com/a/bill-kovac-gazetari-legjendar-me-origjine-shqiptare-rrefen-jeten-135436328/519761.html

[19] http://www.lapsi.al/stil/2016/01/03/umberto-eco-interneti-u-ka-dh%C3%ABn%C3%AB-t%C3%AB-drejt%C3%ABn-e-fjal%C3%ABs-budallenjve#.V1f8n_l96Uk

[20] http://www.zeriamerikes.com/a/bill-kovac-gazetari-legjendar-me-origjine-shqiptare-rrefen-jeten-135436328/519761.html

[21] Dominick, Joseph R (2010) "Dinamika e komunikimit masiv – Media në periudhën digjitale", UET/Press, Tiranë, f. 444

[22] Kovach Bill, Rosenstiel Tom, (2009),"Elementët e gazetarisë", ISHM, Tiranë, f 100.

publike në raport me atë se çfarë po ndodh në realitet ose cila informatë është e vërtetë. Në këtë formë, media po fiton një rol të ri brendapërbrenda shoqërisë kosovare, njësoj sikur që individi fitoi këtë rol falë zhvillimit teknologjik..

Të ndodhur përballë një situate, ku rol kyç ka shpejtësia dhe sasia e informatës, dhe fare pak cilësia, njerëzit e mediave në shoqërinë kosovare e pranojnë hapur se realiteti medial i konstruktuar në këtë mënyrë shkakton paqartësi dhe hapësirë të madhe për plasim të pavërtetash. "Me faktin qe secili po vrapon pas sensacionit e jo pas informacionit, rreziku për huti, paqartësi, plasim të të pavërtetave është shumë evident", thotë A. B. nga RTV 21. Një situatë pothuaj e pamenaxhueshme po krijohet përmes portaleve informative të cilat aktualisht janë në numër të madh në Kosovë ku aktualisht janë të regjistruar mbi 200 portale dhe vetëm një numër i vogël i tyre kanë pronar, kryeredaktor apo redaksi të konsoliduar, të tjerët janë më shumë fiktivë. Dhe mundësia e plasimit të lajmeve në rrjetet sociale ku ka mijëra ndjekës, bën që këto portale fiktive të ngjallin huti në opinion, duke dëmtuar edhe portalet serioze dhe të konsoliduara. Prandaj "mediat në përgjithësi dhe portalet në veçanti duhet të bëjnë më shumë që lexuesit t'i ofrohet e vërteta dhe asgjë tjetër, sepse koha e klikimeve po perëndon," shtoi B. B. kryeredaktor në Indeksonline.

Dyshimet në qëndrueshmërinë dhe seriozitetin e punës së portaleve të dyshimta shtohen kur kemi parasysh faktin se ato ndonjëherë mund të jenë edhe pa adresë të saktë dhe pa staf redaktorial. Dyshimi se ato portale mund të jenë konstruktuar për qëllime të caktuara rritet. "Është e vërtetë që në Kosovë janë me qindra portale të lajmeve, e që shumica e tyre nuk kanë as adresë e as zyre të punës. Një numër kaq i madh i portaleve në një hapësirë të vogël si Kosova vë dyshime për seriozitetin në kryerjen e misionit të gazetarisë, shpesh edhe për dyshime në vërtetësinë e lajmeve (meqë ka edhe raste që ato trillohen e nuk kanë të bëjnë asgjë me të vërtetën)", deklaroi Agron Shala, nga portali *Telegrafi.com*.

E tërë kjo luftë për të qenë i pari me lajm, është përkthyer në një konkurrencë të shpejtësisë, të kuantitetit e jo kualitetit, duke ndërtuar informacione të dyshimta dhe të pabesueshme. Fakti që ekziston një konkurrencë e tillë dhe një nguti për të përçuar lajmin, absolutisht shtyn drejt një cilësie të dobët të informatës dhe plasimit të një lajmi të pavërtetuar apo tendencioz.

Sot përveçse nuk ka analizë të thuktë të ngjarjes dhe "të menduar mendues"[23], në disa raste, konkurrenca mes gazetarëve, mediave dhe veçanërisht ajo mes portaleve, ka bërë që të mos ketë as verifikueshmëri të informatës. Si rrjedhojë, duket e plotkuptimshme ajo që thotë Bourdieu, kur pohon se nënshtrimi përballë ngutisë, "shtyn televioznin të privilegjojë një numër të caktuar *fast-thinkers* të cilët prodhojnë *fastfood* kulturor, ushqim kulturor të para-përtypur, të para-menduar."[24] Dhe këtë nuk e

[23] Bourdieu, Pierre, (2015), "Mbi televizionin", Tiranë, f. 37
[24] Po aty, f. 37

bëjnë vetëm televizionet (duke prodhuar e privilegjuar këta mendimtarë të shpejtë dhe të gjithëdijshëm), por edhe portalet e shumta të cilat, në një mënyrë, luajnë vetë rolin e *fast-thinkers*-ëve dhe të *fast-informer*-ëve.

Kur me një situatë të tillë sfidohen shoqëri që në një mënyrë ose në një tjetër kanë qenë të përgatitura deri në një masë për zhvillimet kaq të hovshme teknologjike, sfida mund të jetë më e lehtë, por si mund ta përballojë demokracia e brishtë kosovare këtë dramë të informatës? Redaktimi apo filtrimi i mëhershëm e informatës i kishte përmbushur sadopak kriteret elementare të informimit publik, duke pasur për bazë më shumë se dy burime. Epoka e internetit tashmë e ka pamundësuar këtë duke mos i lënë rast informatës të kalojë as nëpër një filtër elementar burimi e redaktimi. Vetë atakimi me këtë shumësi informatash sot ka për rrjedhojë një standard të ulët verifikimi e publikimi, kulture të shprehjes e komunikimit.

Shoqëria kosovare, si kurrë më parë, ka qasje në informacione të ndryshme në vend e në botë. Por nga ana tjetër, meqë sistemi i përpunimit të informatës në internet nuk i referohet ndonjë kulture a standardi publik të verifikueshëm, hiperproduksioni i informatës krijon probleme kulturore e sociale që lidhen me cilësinë e informatës, përkatësisht me autoritetin që verifikon informatën.

Literatura

BillKovach, TomRosenstiel, (2009), "Elementët e gazetarisë", ISHM, Tiranë

EmanuelMounier, Personalizmi, Dita 2000, Tiranë"

PierreBourdieu, "Mbi televizionin", 2015, Tiranë

JohnDewey, "Publiku dhe problemet e tij", ISP&DITA 2000, Tiranë

MarshallMcluhan, "Instrumentat e komunikimit- Media si një zgjatim i njeriut", IDK, Tiranë

EricMaigret, "Sociologjia e komunikimit dhe e mediave", 2010, Papirus, Tiranë

GillianDoyle, "Ekonomia e medias", 2015, Papirus, Tiranë

Joseph R. Dominick, "Dinamika e komunikimit masiv – Media në periudhën digjitale", 2010, UET/Press, Tiranë

Francis Balle, "Mediat & Shoqëritë", 2011, Papirus, Tiranë

Stephen E. Lucas, "Arti i të folurit publik", 2010, UET/Press, Tiranë

Ibrahim Berisha, (2014), Mediakultura, PEN/AAB, Prishtinë

http://www.zeriamerikes.com/a/bill-kovac-gazetari-legjendar-me-origjine-shqiptare-rrefen-jeten-135436328/519761.html(marrë më 12dhjetor 2011)

http://www.lapsi.al/stil/2016/01/03/umberto-eco-interneti-u-ka-dh%C3%ABn%C3%AB-t%C3%AB-drejt%C3%ABn-e-fjal%C3%ABs-budallenjve#.V1f8n_l96Uk, (marrë më 3 janar 2016)

Florent RRAHMANI

THE KOSOVAR SOCIETY: THE INTERNET, THE AMOUNT AND QUALITY OF INFORMATION

Abstract

The rapid technological development in the Internet era, besides having greatly facilitated life, in many societies, it has caused confusion, uncertainty and insecurity in the technological, economic, political, cultural, sociological and psychological aspect.

In such a rapid period of an indispensable development and in step with other societies, the internet has enabled the presence of other media everywhere, both in urban and rural areas, and has facilitated the extent of its impact, becoming the basic source of information. Moreover, almost all other media, such as newspapers, portals, and television stations, use the internet as a communication network. Therefore, many cultural phenomena have remained under the shadow of online media development, as one of the leading information agencies.

The Kosovar society, as never before, is informed and has access to various information domestically and in the world. But on the other hand, the information processing system on the Internet does not refer to any verifiable public culture or standard and thus, over-information (information hyper-production) creates cultural and social problems of information quality, namely of the public authority that verifies the information. Not only Kosovo but other countries are also facing this danger...

How to create a trusted public authority that provides information? This is the dilemma that deals with the amount of information today and with its quality, even in Kosovo, without forgetting also the other (social, propagandistic, economic) motives on which today's internet culture is set up as a kind of *industry*.

Gentiana (ANNA) FRANGU

REALIZIMI I ROLIT KREATIV TË MUZIKËS, PËRMES FORMAVE TË PEDAGOGJISË NË KRIJIMIN E PREFERENCAVE ESTETIKE-MUZIKORE

Muzika brenda vetes përfshin edhe pedagogjinë abstraguese –abstragon për ta harruar realitetin, këtu del edhe roli human e kurues i muzikës, këtu shfaqet me plotninë e tyre roli i preferencave muzikore. Pedagogjia ndihmon që zhvillimet në arte-muzikë, ashtu si në shkencë, të bëhen pronë e dobishme e njeriut.

Pedagogjia në muzikë realizohet thuajse në mënyrë të plotë, duke qenë pedagogjia humaniste dhe njëkohësisht dialektike, ajo përmes formave dhe zhanreve muzikore, krahas funksioneve të tjera, luan edhe këto dy role në mënyrë shumë funksionale, ndaj ajo duhet aplikuar, pos shkollës edhe në rrafshe të ndryshme të aktiviteteve, në mënyrë që emancipimi muzikor të jetë më masovik dhe preferencat muzikore të shënojnë edhe stad të kulturës së shoqërisë në përgjithsi.

Pedagogjia-edukimi, është shkencë që fillon me empirizmin, konkretësinë, pragmatizmin, përvojën, eksperimentin, qëndrimin kritik dhe më pas me progresivitetin. Parasegjithash unë do ta quaja qëllimin e këtij edukimi-humanizimin e njeriut përmes "zbutjes" së destruktivitetit të njeriut, do ta quaja emancipim, civilizim, konstruktim apo edhe plotësim të botës së njeriut, takim me pjesën e fshehtë të tij, sepse muzika është si pasionet që flejnë dhe si të fjetura bëhen të rrezikshme dhe vetëm kur manifestohen, janë të bukura, kreative dhe të rëndësishme për universin e njeriut, botën e tij. Por duhet diktur se pikërisht brenda pasioneve flejnë edhe preferencat mbi sportet, shkencat, por edhe mbi artet si letërsia, arti figurative e posaçërisht vet muzika.

Si i tillë, arti muzikor krijon emocione – emocione që ndikojnë në edukimin estetik, të individit dhe grupeve, formë e cila mund të aplikohet gjatë ores së edukatës muzikore. Kjo orë krijon atmosferë artistike e të shpeshtën festive, ofron kënaqësi për shpirtin artistik, i ndihmon të shtjellohet ndjenjës muzikore te fëmijët, zgjon kurreshtje dhe interesim për botën muzikore, ndërton një komunikim absolut me shpirtëroren, por edhe me kohët, me krijimin dhe sasinë e llojet e zhanreve. Qëllimi është edhe informimi direct me zhvillimin e kulturës muzikore nëpër shekuj, me ndikimet e saj nga kulturat e ndryshme, me njohjen e instrumenteve –tipeve të tyre.

Faza e pare e komunikimit të fëmijëve me muzikën është përjetimi, i cili nuk kërkon përgaditje të veçantë, sepse njeriu lind me shqisën e përjetimit, me ndjesinë

ndaj zërave ashtu si lind me ndjesinë ndaj temperaturës, dhe më pas fillon njohja e që është një process i gjatë dhe që varet prej shumë faktorëve, varet edhe nga edukimi që ne e japim, d.m.th me njohjen fillon mishërimi më i madh i tyre me këtë art, duke u shkallëzuar kjo njohje deri në krijimin e preferences së caktuar për një zhanër, për një këngëtar apo për një këngë.

I.2. Aplikimi i llojeve të pedagogjisë në muzikë për krijimin e preferences për muzikën artistike

Llojet e pedagjisë s janë të pakta, gjatë historisë së shkollës duke u paraqitur nevoja të ndryshme, janë krijuar edhe tipe të shumta të pedagogjisë. Janë dëshmuar pedagogjia eksperimentale, speciale, didaktike, historike, e të rriturve, ndërkulturore, pedagogjia e krahasuar dhe ajo fëminore. Këu vetëm duhet pasur kujdes se cila pedagogji përkon me cilin mësim, me cilin zhanër, që mësimdhënia të jetë më e realizueshme në kuptimin e arritshmërisë së suksesit në fusha të caktuara, e në këtë rast në fushën e muzikës.

Bruner[1] është autor që i dha rëndësi të veçantë proceseve njohëse dhe rolit të edukimit –pedagogjisë, ndaj pedagogjia është pjesë e çdo transmetimi të dijes dhe si thotë ai –përmes motivimit. Duke u nisur se periudha fëmijënore jashtë shkollës, nuk ju ofron fëmijëve shije të muzikës së kultivuar, pos në raste të veçanta, duhet pasur parasysh se edukata muzikore si lëndë, lehtë korrespondon me letërsinë, artin figurative dhe për shkak të sistemit të notave edhe me matematikën. Është mundësia e parë që nxënësit të bëjnë numërimin përmes vlerave të notave muzikore, që e bëhen permes operacioneve matematikore, si janë pjestimi dhe mbledhja. Duke u nisur nga ky korrelacion i muzikës me këto lëndë, duhet bërë edhe harmonizimi i preferencave të nxënësve rreth këtyre lëndeve dhe vet edukates muzikore.

Në këtë mënyrë nxënësi e ka më lehtë të hy në botën artistike të muzikës dhe në rast se nuk bëhet një muzikant, bëhet një receptues me preferencë fine dhe të arrirë për këtë art të lashtë.

Shpjegimi i vlerës si dhe i vet përmbajtjes së edukatës muzikore, bëhet përmes fjalëve, tekstet muzikore po ashtu janë tekst ndaj, vlera e gjuhës në elaborimin e kompleksitetit të lëndës edukatë muzikore, është e madhe. Këtu del edhe raporti i muzikës me fjalën-letërsinë. Natyrisht me artin figurativ, sidomos në aspektin tematologjik si e lidh me letërsinë, e lidhë edhe vet terminologjia artistike, ndaj duhet provuar në kompletimin e njohurive dhe shkathtësive muzikore të afrohen edhe njohuritë nga këto lëndë që do të ndihmonin në aftësinë e lidhjes së elementeve të përbashkëta, do të ndihmonim në krijimin e logjikës në sistemimin e elementeve të njëjta dhe të ndryshmeve. Qëllimi i njohjes së nxënësit me këtë korrelacion, është edhe

[1] http://sq.swww.net/word_show.htm

për lehtësimin e arritjes së njohurive muzikore-profesionale në mënyrë sa më komplete dhe më të lehtë.

Është interesant se kur flitet për pedagogjinë në muzikë dhe kudo tjetër, flitet edhe për utopinë dhe iluminizmin, gjë që lidhet më shumë me Rilindjen e madhe evropiane kur nisi edhe favorizimi i arteve dhe kthimi nga to, si një mundësi reale e humanizimit dhe edukimit të njeriut përmes tyre. Kjo ide pedagogjike forcon idenë tonë se krijimi i preferencave që përkojnë me artin e mirëfilltë, është një sukses i çdo shkolle dhe çdo mësimdhënësi.

Këto janë qëllimet dhe synimet e një shoqërie të emancipuar me një sistem shkolle, ku nxënësit duhet të bëhen pjesë aktive e arritjeve muzikore, duke mbjellë tek ta ndjenjën për muzikën, për të bukurën, që ata të kenë interesime më të theksuara për këtë art.

Capitini[2] duke folur për rolin e pedagogjisë, ai flet për edukatorin –pedagogun, dhe atë e sheh si profet, ndërsa nxënësin - fëmijën, si prirje që natyrisht nënkuptohet se këtë prirje mësimdhënësi duhet kultivuar.

II. 4. Pedagogjia e muzikës-edukim, arsim, formim i preferencës

Pedagogjia qëndron midis njeriut, shoqërisë, dijes dhe kulturës. Këtu shihet edhe lidhja mes pedagogjisë dhe psikologjisë ose thënë ndryshe dallimet mes arsyjes dhe dëshirës, të cilat na dalin edhe në muzikë. Për t'u arritur ky qëllim, duhet filluar aty ku gjithçka fillon, te folklori kombëtar duke u shtrirë edhe në folklorin botëror. Më pastaj për të realizuar profesionalizmin e tyre duhet ndjekur shkollat profesionale muzikore me drejtime të ndryshme. Natyrisht një realizim më i plotë do të mund të bëhej që nga formimi i koreve nëpër të gjitha shkollat, gjë që do të mundësonte masovizimin e kulturës muzikore, pastaj në shkolla duhet pasur instrumente ritmike e melodike ku do të luanin nxënësit vepra të ndryshme të autorëve të ndryshëm, duke shpërfaqur edhe preferencat e tyre. Ata do të njiheshin me historinë e kulturës muzikore, krahas socializimit dhe kultivimit të ndjenjës pozitive për edukatën muzikore. Kjo punë në kore dhe orkestra, do të zhvillonte edhe ndjenjën e kolektivitetit, kultivimin e punës në grupe, familjarizimin me muzikën, traditën e jetës muzikore e tjerë dhe do të hetonin çka është e bukur në muzikë e çka është shund e tallava dhe duke bërë këtë diferencim ata diferencojnë shijen dhe preferencën e tyre.

Njëkohësisht, në këtë formë do të realizohej edhe qëllimi i njohjes me kompozitorët, zhvillimin e stileve e rrymave të ndryshme muzikore, e parasegjithash me traditën kombëtare muzikore.

Ekzekutimi në instrumente, është një shnas i hetimit të preferencës dhe njëkohësisht fahut të tyre për muzikën, ekzekutimi do të realizonte kultivimin e

[2] blogspot.com/2014/01/kerkesa-pedagogjike-e-psikologjike-ndaj.html

shkathësive interpretuesetë nxënësve dhe gjithë kjo do të ndikonte në krijimin e shijes, gati deri në një vartësi të bukur me edukimin e vazhdueshëm me artin muzikor. Kështu edhe nxënësit do të mbroheshin nga antivlerat, nga kiçet e shundi, që krijojnë një hendikap për shoqërinë

Pos formimit të koreve dhe orkestrave, edukimi muzikor arrihet edhe perms dëgjimit të muzikës në klasë, përmes shpërndarjes së CD-ve me muzikë artistike, përmes popullarizimit të saj në emisione të ndryshme arti e rubrika të ndryshme nga edukata muzikore në revista, krahas përhapjes së librave, broshurave e doracakëve të ndryshëm për vepra dhe kompozitorë me vlera të dëshmuara, krejt kjo që të kemi një rini të emancipuar artistikisht dhe që të mos krijohen preferenca për vlerat e ulta muzikore.

Ekziston edhe pedagogjia e ashtuquajtur religjioze, gjë që haset edhe në muzikën e hershme, kur ajo u bë pjesë e kultures së krishterë, kulturës kishtare dhe pedagogjia laike, e përfaqësuar perms Marxit, e që u shtri në të gjitha veprimtaritë shoqërore dhe në arte, sidomos në vendet e bllokut socialist.Disa nga funksionet e muzikës, e që janë shumë të rëndësishme, janë ai njohës, edukativ, estetik e artistik, por edhe ai hedonistik-i kënaqësisë, që lidhet me hedonizmin e antikitetit. Këtë në fjalorin pedagogjik e gjejmë edhe si funksion argëtues, zbavitës që natyrisht arti i muzikës i përmban në vete.Pedagogjia e muzikës, nuk lidhet shumë me njohjen shkencore, sa me njohjen e të vërtetës subjektive. Ajo ka ndikim të madh te marrësi përmes elementeve tematike –motivet, elementet mitike, tragjike, komike e tj. U morëm me këtë element sepse shumë fëmijë, duke pasur një edukate religjioze familjare, kanë preference të një muzike tematikisht religjioze, ashtu si shumë të rinj pas luftes, kanë krijuar preference të muzikës me motive patritike. Kjo dëshmon për faktorin familje dhe faktorin kohë –në krijimin e preferences muzikore. Edukata muzikore duhet dhënë dhe ofruar në vazhdimësi, që nga mosha më e re sepse ndikon edhe në zhvillimin e intelegjencës, krahas zhvillimit të fantazisë dhe imagjinatës, kjo realizon qëllimin e ndërtimit artistik të individit, me vlera të njëmenda e të mirëfillta muzikore, që preferencë e tyre për art të jetë një shije e lartë, fine, një shije e hollë, e cila do të të reflektonte kulturë dhe dije muzikore.

Literatura

Vasil S. Tole, *Muzika dhe Letërsia, Onufri*, Tiranë, 1997
C. E. Wragg, *Classroom teaching skiles*, London, 1998

Gentiana (ANNA) FRANGU

REALIZING THE CREATIVE ROLE OF MUSIC, THROUGH PEDAGOGY FORMS IN CREATING AESTHETIC-MUSICAL PREFERENCES

Abstract

Music within itself includes the abstraction pedagogy- to forget the reality. Here, it also emerges the human and curative role of music; here we find the role of musical preferences with its fullness. Pedagogy helps the developments in art-music, as in science, to become a useful human asset. In music, pedagogy is almost entirely practiced. Being humanistic and at the same time dialectical pedagogy, through musical forms and genres, besides other functions, it plays these two roles in a very functional way, so in addition to the school it should also be applied in a variety of activities so that musical emancipation is more massive and musical preferences mark the stage of the culture of society in general.

Key words: music, preference, pedagogy, genre, emancipipation

Ylberza HALILI

FOLKLORI I SHKRUAR: NGA GRAFITET TE MEMET

Abstrakt

Sot, fjala "folklor" emëron një dimension të madh dhe thellësisht të rëndësishëm të kulturës. Ai si i tillë manifestohet në forma të ndryshme komunikimi, jo gjithmonë vetëm gojore por edhe përmes shkrimit. Ideja se folklori pasqyron vetëm të kaluarën, sot i takon të kaluarës. Folklori krijohet në vazhdimësi dhe si i tillë e pasqyron jetën tonë në vazhdimësi, nga e kaluara në të tashmen. Duke qenë reflektim i botës shpirtërore të njerëzve ai është aty ku janë njerëzit, në punë, në fshat, në rrugë, në qytet, në internet. Folklori urban, i rrugës, na shfaqet përmes grafiteve – shkrimeve mbi mure që shprehin një refleksion të një individi a grupi që përfaqëson. Një nga tiparet më të pranuara gjerësisht të çdo folklori urban është reflektim i tij për ato që konsiderohen të jenë probleme sociale apo individuale. Dundes dhe Pagter merren me "folklorin urban të perandorisë së shkrimit" të bërë nga karikaturat, folklorin e fotokopjes (xerox-lore), letrat zinxhirë, grafitet, latrinaliat (mbishkrimet në banjot publike) etj. të cilat, si tërësi shprehin forma të reagimit të njerëzve ndaj disa dukurive të jetës urbane.

Teknologjia dixhitale sot ka zgjeruar më tej fushën shprehëse të folklorit duke hapur një vend shtesë për shprehje kulturore. Shumë njerëz, të të gjitha moshave, gjinive dhe racave, bashkëveprojnë në internet rregullisht, duke lexuar, duke iu përgjigjur, dhe duke krijuar një shumëllojshmëri të teksteve dixhitale, të shoqëruar edhe me fotografi. Me kuptim humoristik, tallës apo sarkastik, fotografitë ose videot e shoqëruara me tekst të shkurtër e me domethënie (që mund t'i ofrohen barcoletës ose anekdotës), në folklorin bashkëkohor njihen me termin meme.

Çështjet që shtron ky punim ndër tjera, do të jenë: Çka përfaqëson folklori i shkruar? Si karakterizohen format e folklorit të shkruar: grafitet dhe memet? Sa janë të pranishme këto forma në mjedisin urban shqiptar? Sa janë të përhapura memet dhe grafitet në gjuhën shqipe në faqet e ndryshme të internetit si Facebook, Instagram,etj.? A janë pranuar dhe asimiluar memet edhe për aktualitetin tonë? etj.

Punimi do të shoqërohet me shembuj nga interneti dhe terreni, të cilat e dëshmojnë dukurinë e folklorit të shkruar në kulturën shqiptare.

Folklori shkruar apo i shtypur

Edhe pse termi "folklor" mendohet se i referohet kryesisht traditës gojore, ka një numër të formave tradicionale të cilat kanë qarkulluar gjithmonë në formë të shkruar ose të shtypur. Këto përfshijnë autografët në libra, letrat zinxhirë, mbishkrimet mbi gur, grafitet, dhe baladat e kënduara apo të printuara. Për më tepër, qarkullimi i shtypur i formave të tilla si këngë popullore, përralla, shaka, tregime të gjata, fjalë të urta, gjëegjëza, gjatë shekujve, ka ndihmuar për t'i mbajtur gjallë materialet e tilla, duke kaluar poshtë e lartë në mes fjalës së shtypur dhe asaj të gojës.

Gazeta veçanërisht kolumnet, kanë qenë prej kohësh një medium i rëndësishëm për transmetimin dhe diskutimin e legjendave urbane. Në vitet e fundit, faxi dhe emaili janë bërë kanalet kryesore për transmetimin jo - oral të thashethemeve dhe legjendave urbane; të tilla si "faxlore" (folklori i faksit) dhe "netlore" (folklori i internetit) shpesh duke marrë dhe dhënë nga tradita gojore.

Studimi i folklorit është profesionalizuar dhe forcuar nga Alan Dundes (1934-2005). Dundes ishte mësimdhënës i folklorit në Universitetin e Kalifornisë, Berkeley dhe ka shkruar shumë libra mbi këtë temë, duke përfshirë *The Study of Folklore* (1965), që krijoi përkufizimet e njohura të folklorit dhe praktikat teorike dhe metodologjike të folkloristëve. Sipas Dundes "Termi 'folk - popoullore' mund t'i referohet çdo grupi të njerëzve që ndajnë të paktën një faktor të përbashkët.

Ndërsa shumë folkloristë gjatë shekullit të 20-të ankoheshin me futjen e teknologjisë moderne, si një dënim me vdekje për folklorin, në anën tjetër Dundes kishte kundershtuar duke thënë: "teknologjia nuk është zhdukja e folklorit; por është duke u bërë një faktor i rëndësishëm në transmetimin e folklorit dhe është duke siguruar një burim të mrekullueshëm të frymëzimit për brezin e folklorit të ri.[1] "Rritja e kompjuterit simbolizon ndikimin e teknologjisë mbi botën moderne. Argumenti im është se ka folklor në dhe rreth kompjuterit " thekson ky studiues[2]. Dundes, konsiderohet si babai i folklorit modern, në fakt ka parashikuar kalimin e folklorit në hapësirën kibernetike dhe ka bërë të njohur formulimin e folklorit rreth dhe brenda domenit dixhital.

Folkloristët e interesuar për folklorin digjital kanë studiuar fenomene si memet, letrat –zinxhirë, dhe faqet përkujtimore në internet për individë të vdekur, i njohur ndryshe si varreza dixhitale.

[1] Alan Dundes, *Interpreting Folklore*, Bloomington: Indiana University Press, 1980, fq.17
[2] Po aty, fq. 17.

Grafitet

Folklori që lind në përgjigje të jetës së qytetit, shpesh në forma të vjetra, por me përmbajtje të re, është folklori urban i cili përfshin traditat dhe shprehjet kreative që pasqyrojnë kushtet e përgjithshme të jetës urbane apo historinë dhe traditat e një qyteti të veçantë. Një nga artet e rrugës që është i lidhur me grupe të veçanta popullore dhe paraqet format shprehëse të komunikimit urban, është *grafiti*.

Grafiti është term i përgjithshëm që i referohet mbishkrimeve kaligrafike ose imazheve të vizatuara, të gdhendura në mure, në ndërtesa private ose publike[3]. Fjala *grafit* vjen nga italishtija "graffiare", që do të thotë "të gërvishtësh", dhe "graffito" emër, që do të thotë "gërvishtje". Kjo formë alternative e artit ka lindur si shkas i pakënaqësive kulturore dhe politike. Është një fushë e re e artit që bëhet në tërë botën dhe ka qasje direkte te publiku që e sheh. Grafiti mund të mendohet si forma e parë e të shprehurit, dhe në këtë mënyrë është aq e vjetër sa pamjet vizuale dhe vetë gjuha.

Grafitet si formë e shprehjes folklorike

A mund të konsiderohen grafitet pjesë e folklorit? Cilat veçori i afrojnë dhe i largojnë grafitet nga folklori? Folkloristët përgjithësisht i lidhin pesë cilësi me folklorin e vërtetë: 1.përmbajtja e tij është gojore (zakonisht verbale), ose ka të bëjë me zakonet ose materialet; 2. Është tradicional në formë dhe transmetim; 3. Ekziston në versione të ndryshme; 4. Zakonisht është anonim, dhe 5. Ka tendencë të bëhet formulativ. Secili nga këta terma është përdorur në kuptim mjaft të gjerë, dhe tri cilësitë e para janë kryesoret që duhet të konsiderohen për të arritur në një përkufizim.[4]

Sa i takon pyetjes se a mund të përfshihen grafitet në kompetencat e folklorit, le t'i analizojmë në vazhdim tiparet e tyre: E para, në diskutimin se a janë grafitet gojore apo jo, studiuesi Jan Harold Brunvand thekson se shumica e folklorit "dëgjohet" duke arritur veshin nga zërat apo nga instrumentet muzikore, mirëpo folklori i shkruar, (i tillë si grafiti apo rimat e autografit) është folklor verbal pa qenë gojor (oral). Ky studiues në studimin e tij për folklorin amerikan, e vë grafitin në kuadër të lirikës popullore dhe rimave, së bashku me rimat e lojërave, lirikat e punës, rimat e autografit, etj. "Grafitet apo shkrimet mbi muret publike janë shpesh tradicionale, ndonjëherë të rimuara, por më shpesh marrin formën e komenteve të prozës së mprehtë"[5], shkruan ky studiues.

[3] Sălcudean Ileana Nicoleta, *Art and Vandalism: Cross Breeding of Street Art (re)interpretation of street art from a sociological, aesthetical and interactivity perspective.* European Studies Facultyn Babeş-Bolyai University, Cluj-Napoca, Romania, Gjendet në http://newmedia.yeditepe.edu.tr/pdfs/isimd_10/nicoleta-salcudean.pdf. Shikuar së fundi më 05.02.2015.

[4] Jan Harold Brunvand, *The Study of American folklore*, W.W. NORTON&COMPANY, New York & London, 1986, fq. 8.

[5] Po aty, fq. 125

Më tutje, folkloristë të ndryshëm theksojnë se grafitet janë tradicionale dhe transmetimi i tyre është i zakonshëm, dhe jo në mënyrë zyrtare. Gjithashtu, për grafitet mund të themi se përsëriten dhe ekzistojnë në versione të ndryshme (p.sh.: në mure të ndryshme të ndërtesave në Prishtinë mund të hasësh në disa versione të grafitit "Plisat", apo "Blest", etj.) Përgjithësisht, grafitet shkruhen nga persona anonimë, edhe kjo karakteristikë që e lidh me folklorin, si dhe e përmban të folurën formulaike.

Memet

Edhe pse mund të thuhet se komunikimi në Internet në internetkafe ose dhoma të chat-it, nuk rezulton në prodhimin e të shprehurit, për të qenë të sigurt, shumë rrjete përmes komunikimit të grupeve rezultojnë në rrëfime dhe bindje, duke e përfaqësuar internetin kështu si një hapësirë kulturore. Një shembull i kësaj janë memet, fotografitë apo videot digjitale të përhapura shpejt nga shoku te shoku në internet. [6]Shumë meme janë në fakt folklorike për shkak se shpesh marrin formën e frazave që mbahen në mend, thashethemeve, skemave dhe materialeve të legjendave.[7]

Biologu evolucionist Richard Dawkins e ka shpikur termin "meme" në vitin 1976 për t'iu referuar njësive të rishfaqura përmes të cilave aspekte të veçanta të kulturës njerëzore janë të transmetueshme. Ai sugjeroi si shembuj të memeve "melodité, idetë, frazat që mbahen në mend, mënyra për të bërë enët, etj.". Ky studiues ka bërë një analogji me evolucionin gjenetik: "Ashtu si gjenet që e përhapin veten në pishinën e gjeneve duke kërcyer nga trupi në trup nëpërmjet vezëve, ashtu edhe memet përhapen duke kërcyer nga truri në tru me anë të një procesi i cili, në kuptim të gjerë, mund të quhet imitim."[8]

Identifikimi i memeve si "replikatorë të rinj" nga Dawkins, u bë i njohur, dhe nga viti 1998, kur ai shkroi parathënien për Susan Blackmore rreth eksplorimit të fushës së re të memetikës, Daëkins bëri një kërkim në kompjuter për emrin e kësaj shkence të re dhe u shfaqën më shumë se 5000 njësi që e kishin përmendur atë në World Wide Web. Fjalori anglisht i Oksfordit përmbante këtë përkufizim për "memet": "Një element i kulturës që konsiderohet të bartet përmes mjeteve jo gjenetike, p.sh.: imitimit". Dawkins kishte theksuar në librin e tij "Unweaving the Rainbow" (1998) se "gjenet ndërtojnë hardware-in, memet software-in ".[9]

[6] Simonh J. Bronner, *Explaining Traditions: Folk Behavior in Modern Culture*, The University Press of Kentucky, Kentucky, 2011, fq. 447

[7] Mark Jeffreys, *"The Meme Metaphor",* Perspectives in Biology and Medicine Journal*,* John Hopkins University Press*,nr.* 43, Baltimore, Maryland, 2000, fq. 227.

[8] Jan Harold Brunvand, Encyclopeedia of Urban Legends, Expanded Edition, e qasshme në https://books.google.com, shikuar së fundmi më 28.09.2016.

[9] Po aty.

Monica Foote në punimin e saj *Userpicks: Folk Cyber Art in 21 century,* shkruan: "Format e folklorit në dispozicion për shqyrtim dhe metodat e transmetimit me të cilat janë përhapur, në vitet e fundit, në masë të madhe janë zgjeruar për shkak të rritjes së aftësisë që zhvillimet në teknologji u kanë dhënë njerëzve që të komunikojnë në distanca të mëdha në periudha të shkurtra kohore.[10]" Me tutje Foot thekson se ata që frekuentojnë dhomat e chat-it, dhe përdorin programe të bisedës së çastit kanë zhvilluar të folurën popullore të tyre: "Mjedisi i internetit na jep mundësinë për t'u angazhuar në etnografi virtuale, për të zbuluar objekte të reja dhe për të eksploruar sistemin e ideve që ka çuar në krijimin e tyre. Interneti nuk duhet të hidhet poshtë nga studiuesit si thjesht një depo për shaka dhe legjenda urbane apo një makinë e re për llojet e materialit që kanë kaluar si kopje për tridhjetë vitet e fundit" shton kjo studiuese[11].

Ndërsa studiueset Anne Heimo & Kaarina Koski në punimin e tyre "Internet Memes as Statements and Entertainment", sqarojnë se termi meme i referohet përmbajtjes virale, sic janë format e ndryshme video klipet, shakatë, gjestet, shprehjet e fytyrës dhe frazat verbale, të cilat kanë fituar një shpërndarje të gjerë dhe popullaritet. Sipas tyre, Memet janë fenomen i kulturës bashkëkohore të cilat nuk duhet të studiohen vetëm në kuadër të memetikës, sepse ato kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve në fusha të ndryshme, të tilla si media, studimet e komunikimit dhe gjuhësi. Interneti ka bërë të dukshëm procesin e përhapjes, variacionit dhe riqarkullimit, jo vetëm duke përshpejtuar qarkullimin e fenomeneve kulturore, por edhe duke ofruar metadata për qarkullimin dhe popullaritetin.[12]

Si koncept i të folurit, meme shkon nga ideja abstrakte e çdo fenomeni deri te shprehjet shumë konkrete. Një meme tipike përbëhet nga një imazh (ose video) dhe një tekst që shpreh një mesazh me kujdes dhe me humor. Një formë e memes është ajo që tregon imazhin dhe tekstin në një kornizë të zezë, duke portretizuar fenomenin në një dritë kritike. Memet shpërndahen si të tilla, ose janë të përshtatura për t'i shërbyer një qëllimi të ri duke rishkruar tekstin ose ndryshimin e imazhit.

[10] Monica Foote, Userpicks: Cyber Folk Art in the Early 21st Century Folklore Forum 37.1 (2007), e qasshme në https://scholarworks.iu.edu/dspace/bitstream/handle/2022/3251/FF%2037-1%20Foote%20.pdf;sequence=1, shikuar së fundmi më 28.09.2016.

[11] Po aty.

[12] Anne Heimo & Kaarina Koski, *Internet Memes as Statements and Entertainment*, Folklore Fellows' Network, No.44, July 2014, fq. 3.

Sa janë të përhapura memet dhe grafitet? A janë të pranishme ato në faqe të ndryshme të internetit?

Arti i rrugës në Kosovë ka arritur më vonë, diku nga fundi i viteve të 90-ta. Punimet e para të artistëve të rrugës, janë krijuar pas luftës, në Prishtinë nga Urban Gorillas.

Problemet sociale apo politike janë në pjesën më të madhe mesazhet që trasmeton ky art urban. Grafitet janë kryesisht të shkruara në mure publike, ndërtesa, universitete, shkolla, etj. Nga fillimi i viteve 1980 është i njohur gjithashtu slogani popullor dhe politik "Kosova Republikë". Ndërsa, grafitet që kanë qenë subjekt i polemikave vite me radhë, janë ato të Vetëvendosjes. Këto grafite i karakterizon mesazhi politik që ato përcjellin. Në pjesë të ndryshme të Prishtinës janë të pranishme edhe grafitet e tjera artistike si: "Biest", "Bashkë për Brazil", "Prishtinali", "Mitrovica", "Plisat", "Teshat e bojn njerin", "Bankat tona kancer i shoqërisë', etj.

Grafitet në Kosovë mund t'i klasifikojmë në: grafite popullore me dimensione politike (Kosova Republikë!, Bac u kry!, Mitrovica, etj.), grafitet e të rinjëve me dimension kulturor dhe urban (Bonu cool mos bjer shpull, Tesha e bojn njerin, All men must die, etj.), grafite reaguese (Bankat tona kancer i shoqërisë, Dal e shikoj/asgjë s'veroj…, Munësh mu dokë cool edh epa cigare, etj.)grafite të komunitetit LGBT (Come out, Lequ zemër, Homophobia, etj.) dhe grafitet e Vetëvendosjes (Blej shqip, Jo negociata/vetëvendosje, etj.).

Nga mesi i vitit 1990, interneti ka ndikuar në lehtësimin e përhapjes së grafiteve. U ka ofruar komuniteteve qasje më të shpejtë në fotografi, ngjarje, dhe kontakte.

Ndërsa memet në gjuhën shqipe, janë mjaft të përhapura në faqe të ndryshme. Pashë familjen, shqip-zone, shqip_funny janë disa nga faqet në Facebook dhe Instagram ku shfaqen vazhdimisht meme që trajtojnë tema të aktualitetit tonë. Këto ikona përmbajnë çdo lloj çështje, të frymëzuara nga politika, marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes, mes shokëve të klasës, etj.


shqiptari_star
Tuj Mendu qysh Mi Hjek
1-shat
@Shqiptari_star


PER
BAJRAM



Përfundim

Në fund mund të theksojmë edhe një herë se folklori nuk manifestohet vetëm në forma gojore të komunikimit, por edhe përmes shkrimit. Grafiti është një shembull i mirë i folklorit sepse është zakonisht anonim dhe shpjegues i mendimit të një individi apo grupi. Për ta dëshmuar lidhjen e grafiteve me folklorin disa studiues kanë mbledhur fraza nga muret në përgjithësi për të zbuluar përhapjen e humorit popullor dhe të folurës popullore në formën e fjalëve tradicionale, dhe të lojrave të fjalëve.

Gjithashtu interneti përveç transmetimit dhe ruajtjes së kulturës, është duke luajtur rol të rëndsishëm edhe në krijimin e saj aktiv. Memetika na jep një model të dobishëm për të na ndihmuar të shohim se si folklori transmetohet dhe se si ai zhvillohet. Ajo gjithashtu informon mënyrën se si shumë njerëz në komunitetet e internetit e shprehin me fjalë folklorin e tyre. Interneti përmban një pjesë të madhe të folklorit që është i përshtatshëm për mjedisin e memeve.

Literatura e shfrytëzuar dhe e konsultuar

Alan Dundes, Interpreting Folklore, Bloomington: Indiana University Press, 1980.

Jan Harold Brunvand, *The Study of American folklore*, W.W. NORTON&COMPANY, New York & London, 1986.

Limor Shifman, *Memes in Digital Culture*, The Mit Press Essential Knowledge Series, Cambridge, 2014.

Mark Jeffreys, *The Meme Metaphor*, Perspectives in Biology and Medicine Journal, John Hopkins University Press,nr. 43, Baltimore, Maryland, 2000.

Richard Dawkins, *The Selfish Gene*, Oxford University Press, New York, 30th Anniversary Edition, 2006.

Trevor J. Blank, *Folklore and the Internet, Vernacular Expression in a Digital World*, Utah State University Press, Logan, Utah, 2009.

Anne Heimo & Kaarina Koski, *Internet Memes as Statements and Entertainment*, Folklore Fellows' Network, No.44, 2014.

Jan Harold Brunvand, *Encyclopeedia of Urban Legends*, Expanded Edition, e qasshme në https://books.google.com, shikuar së fundmi më 28.09.2016.

Monica Foote, *Userpicks: Cyber Folk Art in the Early 21st Century,* Folklore Forum 37.1 (2007), e qasshme në https://scholarworks.iu.edu/dspace/bitstream/handle/2022/3251/FF%2037-1%20Foote%20.pdf;sequence=1, shikuar së fundmi më 28.09.2016.

Sălcudean Ileana Nicoleta, *Art and Vandalism: Cross Breeding of Street Art (re)interpretation of street art from a sociological, aesthetical and interactivity perspective,*. European Studies Faculty, Romania, Gjendet në http://newmedia.yeditepe.edu.tr/pdfs/isimd_10/nicoleta-salcudean.pdf, Shikuar së fundmi më 05.02.2015.

Ylberza HALILI

WRITTEN FOLKLORE: FROM GRAFFITI TO MEMES

Abstract

Today, the word "folklore" appoints a big dimension and profoundly important culture. As such, it is manifested in various forms of communication, not always only verbal but also through writing. The idea that folklore reflects only the past, today belongs to the past. Folklore is created continuously, and as such reflects our lives constantly, from past to present. Being a reflection of the spiritual world of the people, it is present where people are: at work, in the countryside, in the street, in the

city, online. Urban folklore of the street appears through graffiti - writings on the walls that express a reflection of an individual or group of youth. One of the most widely accepted features of any urban folklore is its reflection of what are considered to be social and individual problems. Digital technology today has further expanded the expressive folklore, opening an additional place for cultural expression. Many people, of all ages, genders and races, regularly interact online, reading, responding, and creating a variety of digital texts, accompanied by photographs. With humorous, mocking or sarcastic meaning, pictures or videos associated with short text, in contemporary folklore are known under the term meme.

This paper will discuss these issues: What does written folklore represent? What are the characteristics of the forms of written folklore: graffiti and memes? How are these forms presented in the Albanian urban environment? How much are common memes and graffiti in Albanian various websites such as Facebook, Instagram, etc.? Have memes been accepted and assimilated to our actuality?, etc.

The paper will be accompanied by examples from the internet and the terrain, which prove the phenomenon of written folklore in Albanian culture.

Key words: Written folklore, dynamics of folklore, urban folklore, graffiti, memes

PËRMBAJTJA

GJUHËSI / LINGUISTICS 3

Bardh RUGOVA
GABIMET GJUHËSORE.....5

Rrahman PAÇARIZI
NETLEKTI 17

Linditë SEJDIU-RUGOVA & Giuseppina TURANO
ANALIZË E ROLEVE SEMANTIKE DHE STRUKTURAT THEMELORE
TË FJALIVE NË GJUHËN E VIBER-IT..... 23

Emilia CONFORTI
GLI ITALIANISMI NELL'ARBËRESH DI ALCUNE COMUNITÀ
ALBANOFONE DELLA CALABRIA 37

Giovanni BELLUSCIO, Universiteti i Kalabrisë
VARIETETE/VARIANTE FONETIKE "TENDENCIALE" NË
PËRDORIMIN E KONTROLLUAR TË SHQIPES STANDARDE
NË NJË EMISION TELEVIZIV TË SOTËM..... 51

Aljula JUBANI - Maklena ÇABEJ
IZOKRONIA, KLASIFIKIMI I SHQIPES MBËSHTETUR NË VEÇORITË
TË ORGANIZIMIT KOHOR NË SHQIPE..... 77

Ledi SHAMKU-SHKRELI
JETA DHE POZICIONI I PASKAJORES NË GJUHËN SHQIPE. SHTEGTIM
MES FAKTEVE GJUHËSORE DHE DOMENEVE KULTURORE 87

Maximiljana BARANČIĆ
SPEECH OF ARBANASI FROM ZADAR AND THEIR MASTERING
IN THE CROATIAN LANGUAGE..... 95

Maria PEEVA
E FOLMJA E MANDRICËS NË FJALORIN E PARË BISEDIMOR ME FJALORTH ME AUTOR MARIJA GEORGIEVA-PEEVA 107

Vjosa HAMITI
GJUHA SHQIPE E DEPUTETËVE NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 111

Teuta ABRASHI
BASHKËVEPRIMI I DOMENIT EMËROR DHE FOLJOR 123

Haki HYSENAJ
VARIETETI NË ZHDUKJE, RASTI I SË FOLMES SË RUGOVËS 131

Adelina ÇERPJA
ÇINTEGRIMI I ASNJANËSIT DHE MBETJE TË TIJ NË TË FOLME TË SHQIPES 145

Majlinda BREGASI
NDAJFOLJET E QËNDRIMIT NË GJUHËN E FOLUR 157

Julie KOLGJINI
(RI)VALORIZIMI I FORMAVE TË STIGMATIZUARA KONKURUESE: MUNDËSIA E EMANCIPIMIT TË SHQIPES BASHKËKOHORE 167

Anila ÇEPANI
ANALIZË GJUHËSORE E SHQIPES SË PËRDORUR NË RRJETET SOCIALE, RASTI I FACEBOOK-ut 185

Anila KANANAJ
REALIZIMI I KRYEFJALËS NË VARIETETE TË SHQIPES: TË DHËNA GJUHËSORE NATYRALE NGA FOLËS AMTARË 205

Merita PLANGARICA - Tomorr PLANGARICA
VARIACIONI GJUHËSOR SI OBJEKT SHQYRTIMI NË SHKENCAT E LIGJËRIMIT 221

Idriz METANI
E FOLMJA E SKRAPARIT NË DRITËN E TË DHËNAVE TË ATLASIT DIALEKTOLOGJIK TË GJUHËS SHQIPE (ADGJSH) 237

Berton SULEJMANI
GJUHA E DOKUMENTACIONEVE TË SHKOLLAVE TË SHKUPIT 243

Merima KRIJEZI
PROBLEMET KRYESORE DHE LLOJET E GABIMEVE NË MËSIMDHËNIEN E SHQIPES SI GJUHË E HUAJ 253

Tanja TRAJKOVIĆ
FRAZEOLOGJIZMA ME KOMPONENTËT E ZOTIT DHE DJALLIT NË GJUHËN E SOTME SHQIPE DHE SERBE 265

Evalda PACI
ÇËSHTJE TË RECEPTIMIT TË TEKSTEVE TË VJETRA SHQIPE NË PROGRAMET UNIVERSITARE SHQIPTARE 277

Agron GASHI
ALTERGRAFIA DHE AUTOBIOGRAFIA 287

Xhavit BEQIRI
GJUHA STANDARDE DHE DIALEKTET – RASTI I SHQIPES 295

Rijetë SIMITÇIU
MARRËDHËNIET BRENDA FAMILJES SHQIPTARE TE FJALËT E URTA SHQIPE 301

Rifat KRASNIQI
GJUHA DHE DISKURSI AKADEMIK 311

Anton PANÇEV
KONCEPTET E KOLONISË SHQIPTARE NË BULLGARI RRETH STANDARDIT DHE ALFABETIT TË SHQIPES NË FILLIM TË SHEK. XX 325

Ardita BERISHA - Kadire BINAJ
DO TË PUNOJ DHE *DO PUNUAR* – MODALITETI DHE REFERENCAT KOHORE 335

Helena GRILLO - Kledi SHEGANI
PRIRJE ZHVILLIMORE TË GJUHËS PËRMES VARIETETEVE 345

Migena BALLA
LIGJËRIMI NË ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE 351

Anila HIMA
"KONVERSACIONALIZIMI" I LIGJËRIMIT FEMËROR NË POLITIKËN SHQIPTARE 357

Mensur VOKRRI
SISTEMI RASOR I SHQIPES NË KËNDVËSHTRIMIN HISTORIK 365

Bahri KOSKOVIKU
KONCEPTI PËR PARAFJALËT NË GJUHËSINË MODERNE 385

Mustafa IBRAHIMI
VARIETETET GJUHËSORE NË MJEDISET E NDRYSHME SOCIOLINGUISTIKE TË SHQIPES 395

Elvis BRAMO
SHQIPJA E VANGJEL MEKSIT NË SHEKULLIN E XIX 407

Elsa SKËNDERI-RAKIPLLARI
KËNGË DASHURIE NË DY KOHË 415

Dedë QOKAJ
SHQYRTIME ONOMASTIKE NGA TREVA E NIKAJ – MËRTURIT 435

Teuta DHIMA
BASHKËJETESA E VARIETETEVE TË SHQIPES GJATË LËVIZJEVE MIGRUESE TË POPULLSISË BRENDA VENDIT
RASTI I TË FOLMES SË MUHURRIT TË DIBRËS DHE TË FOLMES SË QYTETIT TË DURRËSIT DHE RRETHINAVE TË TIJ 449

Vaide KQIKU-HOXHA
LEKSIKU I SHQIPES LETRARE TË SHEKUJVE XV-XVII 463

Nertila KELLICI-GOGA
NDIHMESA E GJUHËTARIT POLAK JAN HANUSZ NË HISTORINË E ALBANOLOGJISË 475

Lendita KRYEZIU
NDËRRIMI I KODEVE GJUHËSORE NË SHQIP NË RRJETET SOCIALE 487

LETËRSI / LITERATURE 501

Sabri HAMITI
MËSIMI I LETËRSISË 503

Kujtim M. SHALA
DON KISHOTI: AUTENTIKË E UNIVERSALITET 511

Muhamet HAMITI
SHEKSPIRI NË 400-VJETORIN E VDEKJES 519

Nysret KRASNIQI
LETËRSIA DHE HEGJEMONIA 531

Lindita TAHIRI
KONCEPTI DIALOGJIK NDAJ *TJETRIT* NË VEPRËN E KADARESË 543

Ag APOLLONI
TJETRI SIPAS TË TJERËVE TE *GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR* 551

Dije DEMIRI-FRANGU
TË TJERËT DHE FIKSIONI SHQIPTAR 559

Albulena BLAKAJ-GASHI
SHQIPTARËT PËRBALLË MBRETIT TË TYRE GJERMAN 567

Halil MATOSHI
KONCEPTI I TJETRIT NË LETËRSINË SHQIPE:
ÇFARË E KEMI TJETRIN? 577

Muhamet HAMITI
LETËRSIA SHQIPE E SHEKULLIT XX NË PËRTHYERJE ME VETEN
DHE ME TJETRIN/TJETRËN 593

Edmond ÇALI
TJETRI NË LETRAT SHQIPTARE TË REALIZMIT SOCIALIST:
LETËRSIA E UDHËTIMIT, POEZIA E ANGAZHUAR DHE KRITIKA
E ANGAZHUAR. RASTI I ISMAIL KADARESË DHE GENT ARBANËS
MOTIVE ME DIELL (1968), *LINJA TË LARGËTA. SHËNIME*
UDHËTIMI (1971) DHE SHKRIMET ME PSEUDONIM NË
GAZETËN "DRITA" (1973-1987) 603

Vehbi MIFTARI
ETNOLETRA SHQIPE 619

Hamit XHAFERI
VLERA MORALE NË VEPRAT E FATOS KONGOLIT 645

Bajram KOSUMI
"TJETRI" NË TEKSTET LETRARE TË FISHTËS 657

Abdulla REXHEPI
'JEZIDI' SI TJETRI NË POEZINË FETARE TË NAIM FRASHËRIT 669

Avdi VISOKA
TJETRI DHE MREKULLIA E HUTISË: KAMY E PASHKU 677

Kastriot GJIKA
"VDEKJA E TJETRIT" NE SHKRIMET LETRARE
TË MITRUSH KUTELIT 687

Valbona GASHI-BERISHA
VETVETJA SI NJË TJETËR - TRANSIDENTITETI NË DRAMËN *"NITA"*
TË JOSIP RELËS 699

Besim REXHAJ
ALTER-EGOJA NË FUNKSION TË TJETRIT DHE SI BURIM
I KONFLIKTIT INTRAPSIKIK 709

Lili SULA
LETËRSIA E MIGRACIONIT SI FORMË *KREOLIZIMI*:
RASTI GËZIM HAJDARI 719

Viola ISUFAJ
TAKIMI ME MUZIKËN NË POEZINË E ZORBËS 731

Albanë MEHMETAJ
"TJETRI" NË MODERNITETIN LETRAR 741

Anton BERISHAJ
VETJA SI TJETRI / TJETRI SI VETJA 749

Eljon DOÇE
"TË TJERËT E MIGJENIT" 761

Anila MULLAHI
"TJETRI" NË KRIJIMTARINË E AGOLLIT 767

Belfjore QOSE
"KONCEPTI I TJETRIT SI PËRJASHTIM DHE SI VETËPËRJASHTIM
TEK "ODIN MONDVALSEN" I K. TREBESHINËS" 773

Edlira MACAJ-TONUZI
VIRGJËRESHA SHQIPTARE, "TJETRI EKZOTIK" NË RRËFIMIN
E ALICE MUNRO-SË 785

Ermir XHINDI
(RI)NDËRTIMI I TJETRIT SI PROCES E OBJEKT I INTERPRETIMIT
NË KUFIJTË E STRUKTURËS 799

Atdhe HYKOLLI
FIGURAT E SË KEQES NË LETËRSINË TONË 811

Myrvete DRESHAJ-BALIU
TJETRI NË ROMANIN HISTORIK SHQIPTAR 817

Blerina ROGOVA-GAXHA
DËNIMI ME JETË: AGA DHE TATA 825

Flamur MALOKU
IDEOLOGJIA E TJETRIT NË LETËRSINË SHQIPE 833

Orjela STAFASANI
TRIUMFI NDAJ TJETRIT 839

Serafina LAJÇI
KONCEPTI I TJETRIT NË ROMANIN "VITET E URITHIT"
TË KIM MEHMETIT 845

Jolanda LILA
KONCEPTI I ZOTIT NË POEZINË E ALI PODRIMJES 851

Jorida SOTIRI
GJENERIMI I JETËS NJERËZORE NË KUSHTËZIM TË
LISIBILITETIT QYTETËS 861

Meliza KRASNIQI
SERAFINA TOPIA - BOTA E SAJ TJETËR 869

Lumnije KADRIU
INTERAKSIONI NË HAPËSIRAT PUBLIKE VIRTUALE (CYBERSPACE)
SI MBËSHTETJE E REALIZIMIT TË HAPËSIRAVE SHOQËRORE
TRANSNACIONALE 877

Leontina GEGA-MUSA
KULTURA TRADICIONALE NË HAPËSIRËN VIRTUALE 885

Ibrahim BERISHA
E DREJTA E AUTORIT DHE INTERNETI: PRONA INTELEKTUALE,
RASTI KOSOVA 891

Rezarta GJERGJI
MEDIA SHKOLLORE DHE EDUKIMI QYTETAR I NXËNËSVE 901

Shpresë MULLIQI
MEDIET E REJA DHE NDIKIMI I TYRE NË SHTIMIN E NUMRIT
TË KONSUMATORËVE NË INDUSTRINË E KULTURËS 915

Haqif MULLIQI
TEKNOLOGJIA E RE E KOMUNIKIMIT DHE NDËRVEPRIMI
I FAKTORËVE STRUKTURORË, INSTITUCIONALË DHE
SOCIO-EKONOMIKË NË ETIKËN GAZETARESKE NË KOSOVË 929

Albert MECINI
PËRTEJ PEDAGOGJISË PUBLIKE TË KOMUNIKIMIT MASIV 943

Mimoza SHQEFNI
ROLI I INTERNETIT DHE I MEDIEVE ELEKTRONIKE
NË BARTJEN E FOLKLORIT 949

Alfred HALILAJ
KUJTESA SOCIALE NË ZONAT PARAURBANE 959

Arben FETOSHI
KARAKTERISTIKAT E MESAZHIT ZGJEDHOR NË KOSOVË 969

Florent RRAHMANI
SHOQËRIA KOSOVARE: INTERNETI, SHUMËSIA DHE CILËSIA
E INFORMATËS..... 983

Gentiana (ANNA) FRANGU
REALIZIMI I ROLIT KREATIV TË MUZIKËS, PËRMES FORMAVE
TË PEDAGOGJISË NË KRIJIMIN E PREFERENCAVE
ESTETIKE-MUZIKORE..... 993

Ylberza HALILI
FOLKLORI I SHKRUAR: NGA GRAFITET TE MEMET..... 999